VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS SË LARTË 2016 – 2021

GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDIME
TË PËRZGJEDHURA
TË GJYKATËS SË LARTË

2016 – 2021

GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

© Të drejtat e autorit në lidhje me përmbajtjen e këtij botimi, duke përfshirë tekstin dhe fotot e përdorura, i takojnë Gjykatës së Lartë.
Tiranë, 2022

Kopertina: Kleida Maluka

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022". Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës
EUROPEAN UNION
COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE
Zbatohet nga Këshilli i Evropës

PËRMBAJTJA

Në vend të hyrjes 11

Vendime të Kolegjit Administrativ 15

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.11211-02151-00-2013, datë 24.03.2016
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-746, datë 22.02.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.11243-01170-2013, datë 21.03.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-479, datë 28.03.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-398, datë 04.04.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-872, datë 18.04.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-02174-00-2014, datë 19.04.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-02536-00-2015, datë 11.07.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-1816, datë 19.07.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2017-1541, datë 26.09.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-2037, datë 24.10.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-01436-00-2014, datë 31.10.2017
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-44, datë 16.01.2018
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-33, datë 23.01.2018
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-62, datë 06.02.2018
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-216, datë 13.02.2018
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2018-540, datë 03.04.2018
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-606, datë 24.04.2018
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31001-2896-2018, datë 27.12.2018
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-1683-2016, datë 10.04.2019
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-315, datë 30.04.2019
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-232-2020, datë 04.05.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-12, datë 11.05.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-13, datë 11.05.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-8, datë 27.05.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-75, datë 27.05.2020

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-122, datë 27.05.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31001-304-2020, datë 08.06.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-377-2020, datë 15.06.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-78, datë 18.06.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-180, datë 22.06.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-394-2020, datë 26.06.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-265, datë 01.07.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-172, datë 06.07.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-184, datë 06.07.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.11243-02916-00-2014, datë 27.07.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-608-2020, datë 14.09.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-412, datë 21.09.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-453, datë 21.09.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-505, datë 12.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-507, datë 12.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-511, datë 12.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00–2020-563, datë 12.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00–2020–572, datë 12.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-793-2020, datë 12.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-2224-2019, datë 12.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-00440-2015, datë 26.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31001-00164-2015, datë 27.10.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-673, datë 02.11.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-778, datë 02.11.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00–2020–836, datë 16.11.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-903, datë 16.11.2020
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021- 142, datë 01.02.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-01557-2015, datë 22.02.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-991-2016, datë 22.02.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-2135-2015, datë 16.03.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021- 418, datë 25.03.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-01179-2015, datë 06.04.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-208-2021, datë 07.05.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2021- 1032, datë 17.05.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021-1040, datë 14.06.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021-1111, datë 12.07.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ, nr. 00-2021- 1238, datë 12.07.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ nr. 00- 2021- 1215, datë 15.07.2021
Vendim i Kolegjit Administrativ nr. 00-2021- 1317, datë 22.7.2021

Vendime të Kolegjit Civil 513

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2020-211, datë 02.07.2020
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 179/1, datë 30.09.2020
Vendim i Kolegjit Civil nr. 00-2020-606, datë 18.11.2020
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2020-696, datë 25.11.2020
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2020-728, datë 26.11.2020
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-204, datë 06.01.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-61, datë 20.01.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-181, datë 10.02.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-139, datë 03.03.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-597, datë 04.03.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1007, datë 21.06.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1179, datë 23.06.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1279, datë 23.06.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1082 (38), datë 05.07.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1084, datë 05.07.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1085, datë 05.07.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1194, datë 05.07.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1299, datë 21.07.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1253, datë 28.07.2021
Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1311, datë 28.7.2021
Vendim i Kolegjit Civil datë 18.10.2021
Vendim i Kolegjit Civil, datë 18.10.2021

Vendime të Kolegjit Penal 721

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-145, datë 15.05.2020
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-144, datë 29.05.2020
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-175, datë 12.06.2020
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-300, datë 09.10.2020
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-336, datë 06.11.2020
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-473, datë 22.12.2020
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-6, datë 15.01.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 1, datë 01.06.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-483, datë 06.07.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-492, datë 06.07.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-514, datë 12.07.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-643, datë 15.07.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 23, datës 27.07.2021

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-639, datë 07.09.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021, datë 14.09.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-53, datë 07.10.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-670, datë 26.10.2021
Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021, datë 02.11.2021

Vendime të Përzgjedhura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut 855

Neni 4
Ponsetti dhe Chesnel k. Francës – nr. 36855/97, 41731/98, datë 14/09/1999

Neni 5
Eggs k. Zvicrës – nr. 10313/83, datë 12/07/1984

Neni 6
Zimmermann dhe Steiner k. Zvicrës - nr. 8737/79, datë 13/07/1983
Poiss k. Austrisë – nr. 9816/82, datë 24/03/1987
Weber k. Zvicrës – nr. 11034/84, datë 22/05/1990
Smith Kline dhe French Laboratories Ltd k. Holandës – nr. 12633/87, datë 04/10/1990
Vocaturo k. Italisë - nr. 11891/85, datë 24/04/1991
Cappello k. Italisë – nr. 12783/87, datë 27/02/1992
X k. Francës - nr. 18020/91, datë 31/10/1992
Bendenoun k. Francës – nr. 12547/86, datë 24/02/1994
Bulut k. Austrisë - nr. 17358/90, datë 22/02/1996
Foucher k. Francës – nr. 22209/93, datë 18/03/1997
Malige k. Francës - nr. 27812/95, datë 23/09/1998
Morris k. Mbretërisë së Bashkuar – nr. 38784/97, datë 26/02/2002
Crisan k. Rumanisë - nr. 42930/98, datë 27/05/2003
Bobek k. Polonisë - nr. 68761/01, datë 17/08/2007
Beian k. Rumanisë - nr. 30658/05, datë 6/12/2007
Oleksander Volkov k. Ukrainës - nr. 21722/11, datë 9/1/2013
Avotiņš k. Letonisë – nr. 17502/07, datë 25/02/2014
Duralivski k. Bullgarisë – nr. 45519/06, datë 04/03/2014
Brusco k. Francës - nr. 1466/07, datë 2010/10/14
Regner k. Republikës Çeke – nr. 35289/11, datë 19/09/2017
Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë - nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, datë 6/1/2018
Gulamhussein dhe Tariq k. Mbretërisë së Bashkuar – nr. 46538/11 dhe 3960/12, datë 03/04/2018
Ali Riza dhe të Tjerë k. Turqisë - nr. 30226/10, 17880/11, 17887/11, 17891/11 dhe 5506/16, datë 28/1/2020

Neni 8
Lupsa k. Rumanisë - nr.10337/04, datë 08/06/2006
Uener k. Holandës – nr. 46410/99, datë 19/10/2006
Liu k. Rusisë - nr. 42086/05, datë 06.12.2007
C.G. dhe të Tjerë k. Bullgarisë – nr. 1365/07, datë 24/4/2008
Darren Omoregie dhe të tjerë k. Norvegjisë – nr. 265/07, datë 31/07/2008
Onur k. Mbretërisë së Bashkuar - nr. 27319/07, datë 17/02/2009
Neulinger & Shuruk k. Zvicrës – nr. 41615/07, datë 06/07/2010
Kaushal & të Tjerë k. Bullgarisë – nr. 1537/08, datë 02/09/2010

Neni 10
Meltex Shpk dhe Mesrop Movsesyan k. Armenisë - nr. 32283/04, datë 17/06/2008
Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) k. Zvicrës (nr. 2) [DhM] - nr. 32772/02, datë 30/6/2009

Neni 11
Cudak k. Lituanisë - nr. 15869/02, datë 23/03/2010
Navalnyy k. Rusisë - nr. 29580/12, 36847/12, 11252/13, 12317/13 dhe 43746/14, datë 15/11/2018

Neni 14
Van Raalte k. Holandës – nr. 20062/92, datë 21/02/1997

Neni 41
Engel & të Tjerë k. Holandës – nr. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72, datë 23/11/1976

Neni 46
Karanović k. Bosnjës dhe Hercegovinës - nr. 39462/03, datë 20/11/2007
Scozzari dhe Giunta k. Italisë - nr. 39221/98 dhe 41963/98, datë 13/7/2013

NË VEND TË HYRJES

I nderuar lexues,

është përherë kënaqësi të prezantosh një botim të ri, sidomos kur është i veçantë dhe paraqet interes. Botimi merr më tepër vlerë kur vjen pas një periudhe apatie të gjyqësorit në përgjithësi dhe Gjykatës së Lartë në veçanti, për shkak të riorganizimit të sistemit gjyqësor, sipas reformës në sistemin e drejtësisë të vitit 2016. Ky botim është një nga treguesit se Gjykata e Lartë ka kaluar tashmë në fazën e normalitetit të funksionimit, gjë që vërehet çdo ditë nga vendimmarrja e saj e shtuar.

Shqetësim i vazhdueshëm i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë mbetet jo vetëm sigurimi i uniformitetit të praktikës gjyqësore, por dhe përçimi në kohë dhe me cilësi i vendimmarrjes, e cila, me gjithë interesin që bart tek profesionistët e së drejtës, nuk duket se arrin në kohë ose ashtu siç duhet tek përdoruesit. Për këtë qëllim, krahas publikimit të vendimmarrjes, menjëherë pas zhvillimit të seancave gjyqësore, në faqen zyrtare të Gjykatës, u është kushtuar vëmendje edhe formave të tjera të publikimit të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, si p.sh., botimeve me përmbledhjet e vendimeve të përzgjedhura, siç është edhe ky botim që promovohet sot, përgatitjes së buletinit informativ periodik, që ka filluar të përgatitet dhe të shpërndahet tek praktikantët e së drejtës në rrugë elektronike, organizimit të tryezave nëpër rrethe gjyqësore, etj.,. Besojmë se një vendimmarrje e gjykatave më të larta, sado e dobishme qoftë, nuk arrin të pasqyrohet tek praktika e gjykatave më të ulëta, nëse nuk njihet prej gjyqtarëve dhe avokatëve. Prandaj merr vëmendje të posaçme përhapja në kohë dhe cilësisht e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, sipas metodave më të mira bashkëkohore.

Ky botim u përgatit duke mbajtur parasysh kriterin e rëndësisë që kanë për praktikën gjyqësore qëndrimet dhe orientimet e Gjykatës së Lartë, nëpërmjet interpretimit që ajo i bën ligjit, si instanca më e lartë gjyqësore, e cila ka si mision kushtetues njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Në funksion të njësimit dhe qëndrueshmërisë së praktikës gjyqësore nga të gjithë praktikantët, veçanërisht nga gjyqtarët e të gjitha niveleve, çdo vendim i nxjerrë nga Gjykata e Lartë duhet kuptuar si një lloj vendimi njësues. Për këtë arsye, në këtë botim nuk janë përfshirë vetëm vendime njësuese "klasike" me trupë gjyqësore të përbërë nga 5 gjyqtarë, por edhe vendime të trupës gjyqësore të zakonshme, me 3 gjyqtarë. Grupimi i tyre është bërë sipas tri kolegjeve, administrativ, civil dhe penal dhe përfshin periudhën kohore 2016-2021. Vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të nxjerra para vitit 2018, të cilat janë botuar më parë në një përmbledhje të veçantë, nuk janë të përfshirë.

Vendimet e përzgjedhura lidhen kryesisht me çështje të tilla që paraqesin interes për praktikën gjyqësore. Konkretisht, nga vendimmarrja e kolegjit administrativ mund të shkëpusim çështje që kanë të bëjnë me koncepte si: përcaktimi i kompetencës dhe juridiksionit ndërmjet gjykatës administrative e civile, apo të gjykatës penale dhe asaj kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kriteret e përcaktimit të organit të së drejtës publike kundrejt atij të së drejtës private, ndarja e kompetencës administrative nga ajo gjyqësore kur lidhet me vlerësime objektive dhe thelbësore të aktit administrativ (rasti i gradave në shërbimin policor), kufijtë e shqyrtimit gjyqësor në rastin e nxjerrjes së një akti administrativ që cenon të drejtat themelore të njeriut dhe ndaj tij nuk lejohet ankim (mosdëbimi i shtetasit të huaj bazuar mbi informacionin e klasifikuar sekret shtetëror, mbrojtjen e veçantë që gëzojnë fëmijët në procedurat administrative dhe gjyqësore të kësaj natyre, aksesi gjyqësor në të dhënat e klasifikuara "sekret shtetëror" dhe roli i gjykatave, si edhe të drejtat procedurale të palëve ndërgjyqëse, në gjykimet sensitive të kësaj natyre), kriteret e vlerësimit nga gjyqtari i zakonshëm i pajtueshmërisë së të drejtës së brendshme me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme (zbatimi i vendimit të GJEDNJ-së nga shteti shqiptar, kur imponon marrjen e masave të përgjithshme dhe vlerësimi nga gjykatat e zakonshme i pajtueshmërisë së ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara); shtrirja e juridiksionit gjyqësor kombëtar ndaj Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në rastet kur paditësi kundërshton vendimin e Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e listës së kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit; e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor e lidhur me natyrën juridike dhe raportin ndërmjet sanksioneve të parashikuara në nenin 184 të Kodit Rrugor; faktin nëse mund të kufizohet e drejta e ankimit në gjykatën më të lartë për aktin administrativ, pezullimin e lejes së drejtimit, etj.

Nga vendimmarrja e kolegjit civil mund të përmendim trajtimin e konceptit të gjyqvarësisë dhe gjësë së gjykuar; kuptimi i padive që nuk mund të ngrihen; faza procedurale se kur duhet të verifikohen nga gjykatat pengesa

të tilla që nuk lejojnë shqyrtimin meritor të çështjes; mundësia e vendosjes së masës së sigurimit, sipas neneve 202 e vijues të KPC-s në lidhje me një padi që nuk mund të ngrihet; koneksiteti midis dy çështjeve në kuptim të nenit 297/a të KPC-s, si ndikon procesi penal mbi falsitetin e dokumentin në gjykimin civil, a kushtëzohet i dyti nga i pari etj.; kompetenca lëndore e gjykatave për shqyrtimin e padive me objekt pavërtetësinë e dokumenteve në lidhje me të drejtën e pensionit; regjistrimi i padive reale në regjistrat publikë si masë sigurimi padie, sipas nenit 197 të KC-s.

Kolegji penal ka shqyrtuar, midis të tjerave, çështje lidhur me të drejtën e ankimit në seancën paraprake duke qenë se shkeljet procedurale që mund të konstatohen në seancë paraprake mund të rregullohen gjatë gjykimit të themelit; detyrimin e shtetit shqiptar për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, konkretisht ndalimin e trajtimit çnjerëzor dhe degradues, sipas nenit 3 të Konventës; gjykimin e kërkesës penale me objekt revokimin e vendimit të pushimit të procedimit penal; përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë që shqyrton një kërkesë të tillë; ligjin procedural të zbatueshëm për çështjet penale që kishin nisur para hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe kompetencën lëndore të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e kërkesës për revokim vendimi pushimi, në kushtet kur vendimi i pushimit është dhënë prej kësaj gjykate para ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të miratuara me ligjet nr. 2016/76 dhe nr. 2017/35; njësimin e praktikës gjyqësore për kompetencën e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP-s, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese (akuzë private), të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të KPP-s.

Ky botim u bë i mundur falë asistencës së Këshillit të Evropës, i cili prej vitesh është i angazhuar në ofrimin e ndihmës institucioneve shqiptare, me qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore, të parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo përmbledhje vendimesh është pjesë e projektit *Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey*, një nga komponentët e të cilit është edhe drejtësia efektive. Gjykata e Lartë, ashtu si Këshilli i Evropës, beson se vetëm nëpërmjet një qasjeje që garanton aksesin në gjykata dhe njëkohësisht efektivitetin e tyre mund të bëhet e mundur dhënia në kohë dhe me cilësi e drejtësisë së shumëpritur nga qytetarët shqiptarë.

Botime të tjera të kësaj natyre do të jenë vazhdimisht në fokusin e Gjykatës së Lartë dhe partnerëve të saj të besueshëm.

Sokol Sadushi

VENDIME TË KOLEGJIT ADMINISTRATIV

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.11211-02151-00-2013, datë 24.03.2016

Respektimi dhe ndjekja e të gjitha kërkesave që parashikojnë aktet nënligjore nuk është thjesht me karakter formal, por substancial, pasi mosndjekja e kritereve të përcaktuara nga aktet nënligjore, bën që procedura e ndjekur dhe aktet e lëshuara nga subjektet të jenë të pavlefshme.

Aktet nënligjore që rregullojnë rastet përjashtimore nga procedura e zakonshme, si për shkak të emergjencës dhe vlerës së vogël, parashikojnë rregulla të posaçme, me qëllim që kjo procedurë të mos përdoret rëndom nga ana e autoriteteve kontraktore, por vetëm në ato raste për të cilat ka qenë qëllimi i parashikimit të saj.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se, pala paditëse "I.F." SHPK, është shoqëri tregtare e cila ushtron veprimtarinë e saj në fushën e tregtimit të artikujve farmaceutikë.

2. Pala paditëse ka pretenduar se, në datën 03.07.2008 ka bërë furnizimin e Spitalit Rajonal Durrës, me prodhime farmaceutike e konkretisht me 200 copë "Antema", mbi bazën e urdhitr të prokurimit nr.647, datë 01.07.2008 të nxjerrë nga titullari i autoritetit kontraktor.

3. Pala paditëse ka pretenduar se, pavarësisht faktit që ka dorëzuar mallin në sasinë e sipërcituar, nuk është likuiduar vlera e tij nga ana e palës së paditur, e cila rezulton të jetë në masën prej 400.000 lekë.

4. Në kushtet kur pala e paditur nuk ka bërë likuidimin e vlerës së mallit që ka dorëzuar pala paditëse, kjo e fundit në datën 27.04.2010 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me padinë me objekt të sipërcituar, duke pretenduar detyrimin e anës së paditur që t'i likuidojë shumën prej 400.000 lekësh, që përbën vlerën e mallit të dorëzuar sipas urdhër prokurimit nr.647, datë 01.07.2008 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës (titullari i autoritetit kontraktor).

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.2854, datë 03.11.2010, ka vendosur: Pranimin e kërkesë-padisë së palës paditëse

Shoqëria "I.F." shpk; Detyrimin e palës së paditur Spitali Rajonal Durrës, të paguajë në favor të palës paditëse shoqëria "I.F." shpk shumën prej 400.000 (katërqind mijë) lekë që përfaqëson çmimin e shitjes së një sasie ilaçesh. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur. [...].

6. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.10-2013-275 (163), datë 04.03.2013, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.2854, datë 03.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. [...].

7. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs pala e paditur Spitali Rajonal Durrës, që kërkon ndryshimin e vendimit nr.10-2013-275 (163), datë 04.03.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr.2854, datë 03.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke parashtruar ato shkaqe që pasqyrohen në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

8. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs edhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës, që kërkon ndryshimin e vendimit nr.10-2013-275 (163), datë 04.03.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr.2854, datë 03.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim me trup tjetër gjykues, duke parashtruar të njëjtat shkaqe si edhe pala e paditur, Spitali Rajonal Durrës.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, rekursi i paraqitur nga pala e paditur Spitali Rajonal Durrës dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", që i bëjnë të cenueshme vendimet e gjykatave më të ulëta.

10. Në shqyrtim të akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, të cilat i janë nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor në gjykatat më të ulëta, objektit dhe shkakut ligjor të padisë, pretendimeve të parashtruara në këto akte, si dhe në analizë të vendimeve të gjykatave më të ulëta, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ashtu edhe Gjykata e Apelit Durrës, kanë interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin material të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi dhe për këtë arsye çmon se, këto vendime duhet të ndryshohen, duke u rrëzuar kërkesë padia e paditësit.

11. Rezulton se, kërkimi i palës paditëse në këtë gjykim, është: *"Detyrimin e të paditurit të paguajë shumën prej 400.000 (katërqind mijë) lekë që përfaqëson vlerën e shitjes të një sasie ilaçesh*", të cilin pala paditëse e ka bazuar në nenet 31 dhe 153, të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s dhe nenet

419, 420, 422, 455, 463, 659, 705, 714 e 730, të Kodit Civil (KC)-s.

12. Pala paditëse në këtë gjykim ka pretenduar se, nëpërmjet urdhër prokurimit nr.647, datë 01.07.2008 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës i titulluar "Për prokurim me vlera të vogla", është vendosur që: *"... për nevoja të Spitalit Rajonal Durrës të përdoret procedura e prokurimit me vlera të vogla për sa më poshtë: Antema (materiale mjekimi) sasia 200 copë*". Bazuar mbi këtë urdhër, pala paditëse ka pretenduar se, ka bërë menjëherë furnizimin e anës së paditur me medikamentin e quajtur "Antema", në një sasi prej 200 copësh, duke kryer edhe faturimin e rregullt të këtij malli, i cili është përcaktuar në vlerën prej 400.000 lekë. Por edhe pse ana e paditur ka përfituar këtë sasi medikamenti, fakt i cili provohet nga nënshkrimi i faturës së furnizimit nga Shefja e Farmacisë së Spitalit Rajonal Durrës, ky i fundit nuk e ka kryer likuidimin e faturës, pavarësisht të gjitha përpjekjeve që pala paditëse ka kryer për të zgjidhur këtë çështje jashtëgjyqësisht. Në kushtet kur pala paditëse nuk ka arritur të zgjidhë çështjen me mirëkuptim, në datën 27.04.2010 i është drejtuar gjykatës me padinë objekt shqyrtimi bazuar në dispozitat e KC-s, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur për të bërë pagimin e shumës prej 400.000 lekësh.

13. Ndërsa ana e paditur në këtë gjykim si dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës, kanë prapësuar se, pala paditëse nuk rezulton të ketë nënshkruar një kontratë me anën e paditur dhe as të ketë depozituar ndonjë shkresë, me të cilën të kërkojë pranë të padituri likuidimin e shumës prej 400.000 (katërqind mijë) lekësh. Bazuar në nenin 420 të KC-s, si dhe nenin 463 të po këtij Kodi, në kushtet kur ana e paditur nuk ka lidhur një kontratë me palën paditëse, ajo nuk mund të detyrohet t'i paguajë asaj shumën e pretenduar. Procedura që duhet të ndiqet në rastin konkret, rregullohet nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, kreu VI, pika 2; VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", e ndryshuar, si dhe udhëzimi nr.2, datë 18.02.2008 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla". Urdhri i prokurimit që është nxjerrë në këtë rast nuk i drejtohet firmës por komisionit të blerjeve të vogla të krijuar në fillim të çdo viti, sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar. Në rastin në fjalë, lidhur me medikamentin "Antema", nuk është respektuar procedura që parashikon ligji. Sipas kësaj procedure, komisioni i ngritur me urdhër të titullarit për blerjet e vogla, duhet të gjejë minimalisht 3 oferta në treg dhe të mbajë procesverbalet përkatëse (formulari 3 dhe formulari 4). Janë pikërisht dy anëtarë të këtij komisioni të cilët kryejnë blerjen e mallit. Komisioni, në këtë rast, nuk ka mundur dot të plotësojë procedurën e parashikuar nga ligji, pasi sikundër shprehet edhe vetë pala paditëse në këtë gjykim, ky mall zotërohet vetëm nga kjo firmë. Në këto kushte, komisioni

nuk ka dhënë urdhrin e veprimit për të realizuar këtë blerje, çka vërtetohet dhe me mungesën e firmave të anëtarëve të komisionit për blerjet e vogla, në faturën e shitësit. Personi i cili ka firmosur faturën është një person i cili ka qenë i punësuar pranë anës së paditur në detyrën e Shefes së Farmacisë, por që nuk ka qenë personi i ngarkuar me ligj apo i autorizuar për të nënshkruar faturën e dorëzuar nga pala paditëse. Në këto kushte, veprimi i kryer nga ish-punonjësi i anës së paditur në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, nuk mund të justifikojë pretendimin e palës paditëse për të detyruar anën e paditur që t'i paguajë një faturë për të cilën nuk është respektuar procedura e parashikuar nga ligji.

14. Por pavarësisht pretendimeve të anës së paditur dhe parashikimeve ligjore që rregullojnë këtë mosmarrëveshje, rezulton që të dyja gjykatat më të ulëta kanë pranuar kërkimet e palës paditëse, me arsyetimin se: *"... Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të administrimit të shkresës nr.817/1, datë 28.06.2010, faturën e furnizimit datë 03.07.2008 dhe furnizimit me 200 copë të ilaçit "ANTEMA" të palës së paditur, u vërtetua marrja në dorëzim e mallit nga pala e paditur, nëpërmjet nënshkrimit të ekonomistes dhe shefes së Farmacisë V.B. Për sa më sipër, me të drejtë gjykata ka pranuar padinë e shoqërisë "I.F." SHPK, duke detyruar palën e paditur Spitali Rajonal Durrës të paguajë shumën prej 400.000 lekë, çmimin e ilaçeve të shitura. Pretendimet e ngritura në ankim nuk merren parasysh në këtë gjykim, pasi ato kanë të bëjnë me problemet që ka vetë Spitali në organizimin e punës dhe të caktimit të punonjësve për kryerjen e veprimeve me të tretët, pa mohuar furnizimin me mallin e mësipërm nga shoqëria "I. F." SHPK Tiranë..."*.

15. Këtë arsyetim të gjykatave më të ulëta, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e gjen të pambështetur në prova dhe në ligj. Ky Kolegj, vlerëson se të dyja gjykatat, në marrjen e vendimeve të mësipërme, në kundërshtim me nenin 16 të KPC-s, nuk e kanë kuptuar dhe nuk e kanë përcaktuar drejt natyrën e vërtetë të mosmarrëveshjes, shkakun ligjor të kërkimeve të paditësit, ligjin që duhet të zbatohej dhe për rrjedhojë, nuk e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin.

16. Fillimisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të evidentojë faktin se, pavarësisht mënyrës sesi paditësi ka formuluar kërkimet në objektin e padisë, i cili ka kërkuar kthimin e vlerës se ilaçeve që ka furnizuar anën e paditur, në të vërtetë shkaku ligjor i kërkimit të paditësit, që del qartë nga gjithë hetimi gjyqësor, është detyrimi i palës së paditur për të përmbushur detyrimin kontraktor që rrjedh nga një procedurë prokurimi publik, referimi ligjor për zgjidhjen e të cilës, nuk duhet të bëhet vetëm tek dispozitat e KC-s, por duhet të bëhet edhe tek dispozitat e ligjit të posaçëm

që rregullon këtë mosmarrëveshje, sikundër është ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

17. Ky konkluzion i gjykatës vjen në përputhje edhe me qëndrimin e mbajtur në Vendimin Unifikues nr.3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku shprehimisht citohet se: "*Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë, del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast, gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar*". Kjo pasi, mosidentifikimi i saktë i mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi si dhe i dispozitave ligjore të zbatueshme në lidhje me të, ka ndikuar që vendimmarrja e gjykatave më të ulëta të jetë e gabuar dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme.

18. Referuar kërkimit të palës paditëse si dhe shkakut ligjor ku ajo e mbështet këtë pretendim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se çështja objekt shqyrtimi përbën një mosmarrëveshje administrative në fushën e prokurimit publik për zgjidhjen e të cilës, referimi ligjor siç u tha edhe më lart në këtë vendim, do të bëhet tek dispozitat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr.2, datë 18.02.2008 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", që rregullojnë këtë lloj veprimtarie.

19. Në nenin 29 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të titulluar "Procedurat standarde të prokurimit", parashikohet se: *"1. Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesve të kontratave publike, zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj. Llojet e procedurave të prokurimit publik janë: a) procedurë e hapur; b) procedurë e kufizuar; c) procedurë me negocim, me ose pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës; ç) kërkesë për propozime; d) konkurs projektimi. 2. Procedura e hapur mund të përdoret për të gjitha kontratat. Procedura e kufizuar mund të përdoret atëherë kur është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet fazës së përzgjedhjes, ku trajtohet kualifikimi i kandidatëve dhe fazës së përcaktimit të kontratës fituese, ku shqyrtohet oferta. Dallimi ndërmjet procedurës së hapur dhe procedurës së kufizuar bëhet sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit. 3. Autoriteti kontraktor përdor procedurën e hapur, procedurën e kufizuar dhe konkursin e*

projektimit për kontratat mbi kufirin e ulët monetar. Procedura me negocim përdoret vetëm në rrethana të veçanta, siç përcaktohet në nenet 32 e 33. të këtij ligji dhe në rregullat e prokurimit publik. 4. Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën me negocim, me ose pa shpallje paraprake dhe kërkesën për propozime për kontratat me vlerë më të ulët se kufiri i ulët monetar. 5. Për prokurimet me vlerë të vogël, nën kufirin e ulët monetar, të mallrave, shërbimeve apo punëve, autoritetet kontraktore mund të përdorin procedura të thjeshtuara, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik".

20. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, ku në kapitullin II të tij, të titulluar "Rregullat e përgjithshme të prokurimit", në pikën b të tij, parashikohet se: "*Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 400 (katërqind) mijë lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlera të vogla, siç përshkruhet në kreun VI, të këtyre rregullave*", ndërsa po në kreun VI të titulluar "Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, blerje me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit", në pikën 2 të tij, është zbërthyer në mënyrë të detajuar se cila është procedura për "Blerjet me vlerë të vogël", në të cilën pasqyrohet se: "*a) Në rastin e blerjes me vlerë më të ulët se 400.000 lekë në vit, në fillim të vitit kalendarik, titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar, ose autorizon njësinë e prokurimit, për të zbatuar këtë procedurë. Autoriteti kontraktor planifikon në fillim të vitit natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë mënyrë. Kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës, për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit. Si rrjedhim, për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe që, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure. b) Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar, lëshon një urdhër, ku përcaktohen natyra dhe sasia e tyre. c) Anëtarët e komisionit duhet të vihen në kontakt me operatorët ekonomikë, duke marrë prej tyre të paktën tre tregues për çmimet e mallrave e të shërbimeve. Bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, komisioni përcakton fituesin. Anëtarët e komisionit i drejtohen operatorit ekonomik, që ka ofruar çmimin më të mirë dhe bëjnë blerjen e mallrave ose të shërbimeve. Gjatë gjithë procedurës duhet të mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces. Në fund hartohet edhe një raport përfundimtar, me faturat e blerjeve përkatëse, si shtojcë e këtij raporti, i cili, në çdo rast, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët. ç) Kjo procedurë, përveç rasteve të mësipërme, mund të përfshijë të gjitha shërbimet me vlerë të ulët dhe të paparashikueshme, si për shembull: riparime të tilla, si ndryshimi i bravës, riparimi i pajisjeve të ndryshme, i fotokopjeve, kompjuterëve, dhe riparimi i defekteve të vogla të automjeteve gjatë udhëtimit, si dhe shërbime të tjera të së njëjtës natyrë. Në të tilla raste emergjence dhe ku prania e komisionit është e pamundur, shërbimet mund të kryhen edhe nga persona, që nuk janë anëtarë të komisionit. Këto lloj shërbimesh mund të paguhen edhe me lekë në dorë, por pa kaluar vlerën 10 mijë lekë në total. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta e sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur. d) APP-ja autorizohet të nxjerrë udhëzimet dhe dokumentet përkatëse, që përdoren për këtë procedurë nga çdo autoritet kontraktor*".

21. Për plotësimin dhe zbatimin e këtyre akteve nënligjore, të cilat janë në funksion të njëra-tjetrës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se është nxjerrë edhe akti udhëzimi nr.2, datë 18.02.2008 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", ku në pikën 3 të tij parashikohet se: "*Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve dhe nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave normale të prokurimit, duke prokuruar në këtë formë dhe brenda kësaj vlere, të ndarë nga njëri-tjetri, mallra apo shërbime që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre apo për shkak të funksionit kryesor*", ndërsa në pikën 6 të po këtij udhëzimi është përcaktuar se: "*Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, mund të përdorët për blerjen e mallrave, apo kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me vlerë jo më të madhe se 400.000 (katërqind mijë) lekë. Në të tilla raste emergjence dhe ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimi do kryhet në vend pa u respektuar procedura e mësipërme, në prani të personave (përfaqësues të institucionit) që ndodhen në vend dhe që mbajnë një procesverbal midis tyre për ngjarjen e ndodhur. Mënyra e pagesës kur përdoret prokurimi me vlerë të vogël në rastet e emergjencës do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave, shërbimeve apo punëve duhet të jenë të rregullta, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe duhet të nënshkruhen nga të gjithë personat (përfaqësues të institucionit) e pranishëm në vendin e kryerjes së prokurimit. Procesverbali i mbajtur midis personave të pranishëm*

së bashku me faturën përkatëse të nënshkruar prej tyre, i dorëzohen Komisionit të prokurimit me vlera të vogla, të cilët mbajnë procesverbalin, sipas formularit 5 bashkëlidhur, nënshkruajnë faturën dhe të gjithë dokumentacionin dhe ia dërgojnë Zyrës së Financës për likuidim".

22. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në analizë të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të përmendura më lart në këtë vendim, vlerëson se ligjvënësi ka parashikuar kushte dhe kritere të veçanta për kryerjen e procedurës së prokurimit për blerje të vogla. Referuar përmbajtjes së dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore të cituara si më sipër, legjislatori ka përcaktuar saktësisht se cilat janë rastet në të cilat një autoritet kontraktues, duhet të përdorë procedurën e prokurimit të "Blerjes me vlerë të vogël" sikundër pretendohet në rastin objekt shqyrtimi. Në rastin e zbatimit të kësaj procedure, si Këshilli i Ministrave ashtu edhe Agjencia e Prokurimit Publik (APP) kanë zbërthyer procedurën që duhet të ndiqet në një rast të tillë, duke përcaktuar që çdo autoritet kontraktor se në cilat raste duhet të përdorë procedurën e prokurimit për blerje të vogla, si dhe çdo veprim që duhet të kryejë në një procedim të tillë.

23. Në referim të përmbajtjes së këtyre dispozitave ligjore, vlerësohet qartësisht se procedura me blerje të vogël, nuk kërkon domosdoshmërisht vetëm faktin që vlera që do të vihet në dispozicion të jetë deri në 400.000 lekë, por ajo kërkon edhe karakterin emergjent të përdorimit të saj. Pra, në rast se për një mall apo grup shërbimesh duhet të përdoret procedura e prokurimit publik sipas llojeve të parashikuara nga neni 29, pika 1, e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar (të cituar si më sipër në këtë vendim), autoriteti kontraktor nuk mund të përdorë procedurën me "Blerje të vogël", që është parashikuar nga legjislatori si një procedurë e veçantë dhe e thjeshtuar, referuar qëllimit për të cilin ajo është përcaktuar që të përdoret.

24. Nisur nga natyra emergjente e mallrave që i nënshtrohen kësaj procedure prokurimi, ligjvënësi ka ngarkuar Këshillin e Ministrave si dhe autoritetin shtetëror (sikundër është Agjencia e Prokurimit Publik), që të bëjnë zbërthimin e rasteve se kur duhet të aplikohet kjo procedurë, si dhe veprimet konkrete që duhet të ndiqen gjatë aplikimit të saj. Në germën "ç", pika 2, të kapitullit VI, të VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, është parashikuar se: "*...Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta e sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur*". Në interpretimin që i bëhet kësaj dispozite, rezulton se në rastin e zbatimit të procedurës së prokurimit me blerje të vogla, nuk është parashikuar detyrimisht lidhja e

një kontrate formale furnizimi midis autoritetit kontraktor dhe operatorit që do të furnizojë mallin. Në rastin e kryerjes së procedurës me blerje të vogël, Këshilli i Ministrave ka parashikuar qartësisht se fatura e lëshuar nga operatori privat në momentin e dorëzimit të mallit, ka fuqinë e kontratës për palët kontraktuese pasi të jetë nënshkruar nga anëtarët e komisionit (për autoritetin kontraktor në cilësinë e palës së furnizuar dhe operatorit privat në cilësinë e palës furnizuese).

25. Në vijim të sa më sipër, në kushtet kur fatura e lëshuar nga pala paditëse në këtë gjykim ka vlerën e kontratës së lidhur mes palëve, për zgjidhjen e drejtë të çështjes objekt shqyrtimi, Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i shtrohen për trajtim dy çështje: *i)* a përbën fatura e lëshuar nga pala paditëse një kontratë administrative dhe njëkohësisht një veprim juridik të vlefshëm në kuptim të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij? *ii)* a ka detyrim pala e paditur të shlyejë detyrimin palës paditëse të përcaktuar në vlerën prej 400.000 lekë?

26. *Në lidhje me çështjen e parë* të shtruar për zgjidhje, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, referuar dhe dispozitave ligjore të cituara më lart, vlerëson se fatura e lëshuar nga pala paditëse në kuptim të germës "ç", pika 2, të Kapitullit VI, të VKM-s nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, për të cilën është kërkuar edhe pagimi i shumës prej 400.000 lekësh në këtë gjykim, përbën një kontratë (pasi ligji i ka dhënë vlerën e kontratës). Koncepti mbi kontratat administrative jepet qartësisht në nenin 151 të KPA-s, i titulluar "Kuptimi i kontratave administrative", në të cilin parashikohet se: "1. *Kontrata administrative është një marrëveshje nëpërmjet së cilës krijohet, modifikohet apo shuhet një marrëdhënie juridike e së drejtës publike. 2. Kontratat e mëposhtme konsiderohen administrative: a) sipërmarrjet e punëve publike; b) prokurimi i punëve publike; c) prokurimi i shërbimeve publike; ç) licencimi i lojërave të fatit; d) kontratat e furnizimit të vazhdueshëm; dh) kontraktimi i shërbimeve të subjekteve private në rastet e fatkeqësive natyrore.".*

27. Në analizë të sa më sipër, ky Kolegj, çmon të theksojë se, akti administrativ është mënyra më e qartë e ushtrimit të pushtetit dhe funksioneve nga organet e administratës publike, por nuk është i vetmi. Administrata publike shpreh vullnet pushteti edhe nëpërmjet një veprimi tjetër administrativ, që është kontrata administrative. Kontratat, në të cilat mund të paraqitet si palë administrata, mund të jenë private ose publike. Kontratat private qëndrojnë në të njëjtën bazë si dhe kontratat ndërmjet dy personave privatë. Ato rregullohen nga KC dhe gjykatat

e zakonshme. Ndërsa kontratat publike ose administrative janë çështje të së drejtës administrative dhe çdo gjë që ka lidhje me to shtrihet brenda juridiksionit të gjykatave administrative.

28. KPA nuk parashikon ndonjë kërkesë të përgjithshme detyruese, apo rekomanduese rreth formës që duhet të ketë një kontratë administrative. E vetmja kërkesë është që në rastet e mosparashikimit me ligj të ndonjë forme tjetër kontrate, atëherë është e kuptueshme se forma duhet të jetë me shkrim. Kërkesa e ligjshmërisë në kontratat administrative detyron organin që të mos mundë të zmadhojë fuqitë e veta dhe të bëjë gjëra të cilat nuk është i autorizuar që t'i bëjë. Prandaj, si të gjitha aktet e tjera të administratës, një kontratë administrative sigurisht që duhet të ketë dhe mbështetjen e saj në ligj. Shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi midis palëve në kontratën administrative përbën, ashtu si në kontratat e së drejtës private, një nga kushtet kryesore për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës. Në rastin objekt shqyrtimi, për sa kohë dispozitat ligjore që rregullojnë mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, parashikojnë se fatura e lëshuar në rastin e procedurave të prokurimit me "blerje të vogël" ka vlefshmërinë e kontratës, atëherë është detyrim ligjor që në këtë gjykim të vlerësohet nëse kjo kontratë administrative, përbën ose jo një veprim juridik të vlefshëm.

29. Për vetë natyrën që ka kontrata administrative (pavarësisht se është një veprim juridik), ajo nuk mund të barazohet plotësisht me veprimin juridik që realizohet midis subjekteve private dhe ka disa veçori që e dallojnë nga kjo e fundit. Për vlefshmërinë e një kontrate administrative nuk mjafton vetëm plotësimi i kushteve thelbësore të veprimit juridik (vullneti i palëve, shkaku i ligjshëm ku mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e kërkuar nga ligji), por duhet të përmbushen edhe një sërë detyrimesh që përcaktohen në ligjin specifik, veçanërisht për palën e kontratës administrative që është organ i administratës publike. Palët në një kontratë të tillë, përveç plotësimit të detyrimeve ligjore për veprimin juridik, duhet të zbatojnë edhe parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari, si dhe të përmbushin kërkesat ligjore dhe kushtet e përcaktuara nga këto akte. Një kontratë administrative shpall, modifikon ose revokon një marrëdhënie juridike në sferën e së drejtës publike. Një kontratë administrative duhet të ketë mbështetjen e saj në ligj dhe nuk duhet të jetë e papajtueshme me ndonjë parashikim ligjor. Në këtë kontekst, ligj nuk do të thotë vetëm ligji bazë por në përgjithësi nënkupton legjislacionin administrativ, ligjet e zakonshme, po aq sa edhe parimet e përgjithshme të së drejtës.

30. Referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton e provuar se nga ana e palës së paditur në këtë gjykim, i cili ka qenë me

cilësinë e autoritetit kontraktor, nuk është ndjekur dhe nuk është kryer procedura ligjore që parashikon VKM-ja nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, si dhe udhëzimi nr.2, datë 18.02.2008 i Agjencisë së Prokurimit Publik, në mënyrë që të konkludohet se edhe kontrata administrative (fatura) e cila përbën aktin final të kësaj procedure, të përbëjë ose jo një veprim juridik të vlefshëm.

31. Në dosje, rezulton të jetë administruar urdhri i brendshëm me nr.34, datë 08.01.2008 "Për krijimin e komisionit të prokurimit për blerjet e vogla" të Spitalit Rajonal Durrës, Urdhër Prokurimi me nr.647, datë 01.07.2008 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës për "Blerje me vlerë të vogël" për medikamentin "Antema", si dhe fatura e lëshuar nga ana e palës paditëse për mallin e dorëzuar. Ka rezultuar e provuar se, nga ana e Drejtorisë Rajonale e Spitalit Durrës nuk është planifikuar blerja e këtij malli që në fillim të vitit, sikundër e parashikon germa "a", pika 2, e kapitullit VI, të VKM-s nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, ku pasqyrohet se: "*...Autoriteti kontraktor planifikon në fillim të vitit natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë mënyrë*". Nga ana e autoritetit kontraktor nuk rezulton të jenë kryer veprimet procedurale që ka parashikuar ligji në këtë lloj procedure prokurimi, komisioni për blerjet e vogla të ketë mbajtur procesverbalin përkatës, nëpërmjet të cilit të ketë pasqyruar procedurën për vendosjen në kontakt me operatorët ekonomikë, duke marrë prej tyre të paktën tre tregues për çmimet e mallit që është prokuruar, si dhe të ketë përpiluar raportin përkatës ku edhe të jetë përcaktuar operatori që ka ofruar çmimin më të mirë, të cilit pretendohet se i janë drejtuar për të marrë mallin.

32. Konkluzioni i sa më sipër, rezulton i provuar jo vetëm nga pohimet dhe prapësimet që pala e paditur ka dhënë gjatë procesit gjyqësor pranë dy gjykatave më të ulëta, por edhe nga fakti se në dosje nuk është administruar asnjë dokument shkresor që të provojë kryerjen dhe respektimin e procedurave që parashikon ligji, ku të paktën të ishte administruar oferta që pala paditëse ka ofruar për këtë autoritet kontraktor, në lidhje me çmimin e saj të ofertës për medikamentin "Antema". Gjithashtu, nuk rezulton e provuar dhe e mbështetur me prova shkresore se, malli i prokuruar me procedurën e prokurimit "Blerje me vlerë të vogël" është marrë në dorëzim dhe është nënshkruar nga ana e anëtarëve të komisionit. Fatura e paraqitur nga pala paditëse, që në kuptim të germës "ç", pika 2, të kapitullit VI, të VKM-s nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, ka vlerën e kontratës, nuk rezulton të jetë nënshkruar nga anëtarët e komisionit për blerjet e vogla apo nga personat e autorizuar për të qenë prezent në dorëzimin e mallit, sikundër

e kërkon ligji. Pra, që kjo faturë të merrte vlerën e kontratës duhet të ishte nënshkruar nga anëtarët e komisionit për blerjet e vogla.

33. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, konstaton se, në dosje është administruar vetëm fatura e lëshuar nga pala paditëse, që rezulton të jetë firmosur nga ekonomistja dhe Shefja e Farmacisë së anës së paditur, për të cilat nuk rezulton të jetë lëshuar një urdhër autorizimi për marrjen në dorëzim të medikamentit "Antema". Po ashtu, nuk rezulton që kjo faturë t'u jetë përcjellë anëtarëve të komisionit të blerjeve të vogla së bashku me procesverbalin përkatës, sikundër parashikohet në pikën 6, të udhëzimit nr.2, datë 18.02.2008 të Agjencisë së Prokurimit Publik, ku thuhet se: "*...Procesverbali i mbajtur midis personave të pranishëm së bashku me faturën përkatëse të nënshkruar prej tyre, i dorëzohen Komisionit të prokurimit me vlera të vogla, të cilët mbajnë procesverbalin, sipas formularit 5 bashkëlidhur, nënshkruajnë faturën dhe të gjithë dokumentacionin dhe ia dërgojnë Zyrës së Financës për likuidim*". Për këtë arsye, ky Kolegj vlerëson se në rastin objekt shqyrtimi nuk është respektuar forma dhe procedura që parashikon ligji në rastin e zbatimit të procedurës së prokurimit publik të "blerjes me vlerë të vogël" dhe si e tillë, edhe fatura që kërkohet të likuidohet nga ana e palës paditëse, të cilën ligji e barazon me kontratën e lidhur mes palëve, rezulton të jetë një kontratë administrative absolutisht e pavlefshme. Pra, marrëdhënia e krijuar midis palëve ndërgjyqëse në këtë gjykim, është një marrëdhënie juridike e pavlefshme, pasi vjen në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit. Për këtë arsye, prej saj nuk mund të derivojnë të drejta dhe detyrime të ligjshme për palët, që të kërkojnë gjyqësisht përmbushjen e tyre.

34. Ky Kolegj, çmon të theksojë se, në kuptimin e së drejtës administrative, kontrata administrative absolutisht e pavlefshme është ajo kontratë, e cila për shkak të shkeljes thelbësore të ligjeve mbi bazën e të cilës është lidhur, nuk ka fuqinë e një akti administrativ të vlefshëm dhe objektivisht nuk konsiderohet që të ketë ekzistuar në asnjë çast. Një kontratë administrative absolutisht e pavlefshme është e tillë që nga momenti i lidhjes së saj dhe si e tillë, nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike për të cilat ajo është lidhur. Një kontratë administrative absolutisht e pavlefshme nuk është formë e ligjshme e shprehjes së vullnetit; ajo është një nulitet i plotë, i cili konsiderohet se nuk ka hyrë në fuqi asnjëherë. Për shkak të shkeljes së rëndë thelbësore të ligjit, pavlefshmëria absolute e një kontrate administrative nuk mund të rregullohet në të ardhmen, pasi ky veprim juridik konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si e tillë, ajo nuk mund të ketë fuqi detyruese ndaj palëve midis të cilave është lidhur.

35. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se kushtet dhe

kriteret e përcaktuara në VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, kanë karakter urdhërues dhe jo fakultativ. Pra, respektimi i këtyre dispozitave ligjore është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga ana e autoritetit kontraktor, në mënyrë që procedura e prokurimit publik të zbatuar prej tij në rastin e blerjeve të vogla, të jetë e vlefshme. Mosplotësimi i këtyre kritereve të përcaktuara nga aktet nënligjore, bën që procedura e ndjekur për kryerjen e këtyre blerjeve të jetë e pavlefshme e si e tillë, edhe marrëdhënia e lidhur mes palëve si dhe aktet që formalizojnë këtë marrëdhënie (sikundër është fatura e lëshuar nga pala paditëse) të konsiderohet si një veprim juridik i pavlefshëm. Kjo për faktin se, respektimi dhe ndjekja e të gjitha kërkesave që parashikojnë aktet nënligjore në kryerjen e kësaj procedure nuk është thjesht me karakter formal, por substancial. Ky Kolegj, çmon të theksojë se, Këshilli i Ministrave e ka parashikuar procedurën e prokurimit publik si një rast përjashtimor për shkak të emergjencës dhe vlerës së vogël që pretendohet të prokurohet, duke parashikuar rregulla të posaçme, me qëllim që kjo procedurë të mos përdoret rëndom nga ana e autoriteteve kontraktore, por të përdoret vetëm në ato raste për të cilat ka qenë qëllimi i parashikimit të saj.

36. Në vijim të sa më sipër, në kushtet kur marrëdhënia midis palëve ndërgjyqëse në këtë gjykim, është një marrëdhënie e cila është krijuar në mosrespektim të dispozitave ligjore, palët nuk mund të kenë të drejta dhe detyrime ndërmjet tyre. Kjo për faktin se, fatura e paraqitur nga pala paditëse në këtë gjykim përbën një kontratë administrative absolutisht të pavlefshme në kuptim të neneve 116/c dhe 117, të KPA-s, pasi është lidhur në kundërshtim me formën dhe procedurat e parashikuara nga VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe udhëzimi nr.2, datë 18.02.2008 i Agjencisë së Prokurimit Publik. Për këtë arsye, kjo faturë, të cilën ligji e ka ekuivalentuar me kontratën, përbën një veprim juridik të pavlefshëm dhe si e tillë nuk mund të krijojë të drejta dhe detyrime të ligjshme midis palëve kontraktuese.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-746, datë 22.02.2017

Ankimi administrativ që nuk ka marrë përgjigje brenda afatit të përcaktuar nga ligji i zbatueshëm, i jep të drejtë kërkuesit të kundërshtojë aktin objekt shqyrtimi në rrugë gjyqësore.

Gjykata është e detyruar të marrë vendim mbi themelin e padive të vlefshme që sipas ligjit plotësojnë kushtet themelore të të pasurit të një interesi të ligjshëm (për të ngritur padi) dhe legjitimitetit për të vepruar.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se paditësi A.M. është banor i fshatit Fushë Bardhë dhe është pajisur me lejen nr. 27, datë 25.11.2016 nga Agjencia e Shërbimit Bujqësor Veterinar dhe Mjedisor pranë Bashkisë Gjirokastër "*Për prerje/mbledhje dru zjarri*".

2. Pala paditëse ka pretenduar se, bazuar në lejen e sipërcituar ka bërë prerjen e druve për zjarr dhe ka kryer transportin e tyre, në magazinën që e përdor për depozitimin e tyre.

3. Nga ana e inspektorëve të palës së paditur është pretenduar se subjekti paditës është kontrolluar në datën 12.12.2016, gjë për të cilën është mbajtur edhe procesverbali me nr. serie 0004251 me të njëjtën datë, nga i cili ka rezultuar se: *"...Transport i lëndës drusore në sasinë 7 mst, i llojit Lis Lënda drusore e pashoqëruar me lejen përkatëse të transportit, destinuar në Gjirokastër. Dokumenti i paraqitur nga shtetasi "Për leje, prerje/mbledhje dru zjarri" me nr. 27 lëshuar nga Bashkia Gjirokastër nuk i përkon personit dhe sasisë dhe nuk e justifikon shkeljen e kryer..."*.

4. Bazuar në procesverbalin e mësipërm, me vendimin nr.6, datë 12.12.2016 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër "Për dënim administrativ", është vendosur të dënohet subjekti A.M. në këtë mënyrë: *"...1. Të dënojë me gjobë në vlerën 100.000 lekë (njëqindmijë lekë)...., 4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtme 7 mst dru zjarri lis..."*. Ky vendim i është komunikuar subjektit A.M. në datën 14.12.206 nëpërmjet shkresës me nr.888 prot., datë 13.12.2016 të kryeinspektorit të

Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër.

5. Në kushtet kur paditësi nuk ka qenë dakord me dënimin administrativ të cituar si më sipër, e ka kundërshtuar atë në rrugë administrative pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Tiranë, për të cilin ka pretenduar se nuk ka marrë ende përgjigje.

6. Në kushtet kur pala paditëse nuk ka marrë zgjidhje në rrugë administrative, në datën 30.12.2016 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me padinë me objekt të sipërcituar, duke pretenduar se aktet e nxjerra nga ana e paditur kanë dalë në kundërshtim me ligjin dhe jo në prezencë të tij. Për këtë arsye, ka kërkuar shfuqizimin e tyre si të nxjerra në kundërshtim me ligjin.

7. Pala e paditur Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër, me prapësimet e saj të datës 20.01.2007, ka kërkuar para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, fakt të cilin e ka pohuar edhe në seancën gjyqësore të datës 01.02.2017.

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me vendimin nr.78 (31004-00001-85-2017), datë 01.02.2017, ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes administrative [...].

9. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim të veçantë pala e paditur Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër, e cila kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, si dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke paraqitur ato shkaqe që pasqyrohen në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, është marrë në përputhje me dispozitat e ligjit procedural dhe atij material e për rrjedhojë, ai duhet lënë në fuqi.

11. Fillimisht, ky Kolegj e vlerëson të arsyeshme që të evidentojë faktin se, sipas të drejtës sonë procedurale çështja e juridiksionit është një nga çështjet më të rëndësishme procedurale, mosrespektimi dhe moszgjidhja e drejtë e së cilës, sjell automatikisht prishjen e vendimit. Kjo është dhe arsyeja se përse në nenin 9 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", parashikohet shprehimisht se: "*1. Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim*

për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent. 2. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë...".

12. Në analizë të dispozitës së mësipërme, konstatohet se çdo lloj gjykate dhe në çdo shkallë gjykimi, ka të drejtë të marrë në shqyrtim, të analizojë dhe të vendosë në lidhje me juridiksionin e çështjes objekt gjykimi. Kjo e drejtë e gjykatës për të vepruar *edhe kryesisht,* është e lidhur drejtpërsëdrejti me zbatimin dhe respektimin e parimit të një procesi të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)-së.

13. Nisur nga rëndësia e madhe që ka përcaktimi i drejtë i juridiksionit, në nenin 9 të ligjit nr. 49/2012 është përcaktuar qartë raporti dhe marrëdhënia midis dy juridiksioneve, atij administrativ dhe atij gjyqësor "*Gjykatat nuk mund të shqyrtojnë një çështje që ligji e ka lënë në juridiksionin administrativ*".

14. Në analizë të dispozitave të mësipërme, juridiksioni administrativ pengon gjykatën në shqyrtimin e themelit të çështjes. Në bazë të nenit 129 të Kodit të Procedurave Administrative-s, të titulluar "Shterimi i mjeteve ligjore administrative", është parashikuar shprehimisht se: *"Shterimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, përveç rasteve kur: a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar; b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar drejtpërdrejt në gjykatë; c) organi më i lartë në shqyrtimin e ankimit administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personalë të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedurën administrative.".*

15. Rezulton që paditësi në këtë gjykim ka kërkuar: *"Shfuqizimin tërësisht të gjobës me nr.6 prot., datë 12.12.2016 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër"*, duke e bazuar këtë kërkim tek nenet 153 dhe 154, të KPC-s, si dhe tek nenet neni 40/a e 45/b, të ligjit nr.49/2012 .

16. Në analizë të objektit dhe shkakut ligjor të padisë, rezulton se pala paditëse nëpërmjet këtij gjykimi, kërkon të anulojë aktin administrativ, vendimin për dhënien e gjobës nr.6 prot., datë 12.12.2016 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër, referuar dispozitave të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor". Referuar pretendimeve që ka ngritur pala paditëse në padi, por edhe gjatë zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë, si dhe fakteve dhe rrethanave të cilat janë pranuar nga gjykata deri në këtë fazë të gjykimit, rezulton e provuar se jemi para një kundërvajtjeje administrative të kryer në fushën e shërbimit pyjor. Për

këtë arsye, mosmarrëveshja objekt shqyrtimi është e natyrës administrative dhe rregullohet sipas parashikimeve të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe mund të kundërshtohet në gjykatë, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë ligj dhe atyre të përcaktuara në nenet 7/ç, 17/a dhe 18, të ligjit nr.49/2012 .

17. Në vlerësim të sa më sipër, ky Kolegj arrin në konkluzionin se çështja objekt gjykimi është në juridiksionin gjyqësor dhe ajo duhet të gjykohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër. Kjo për arsyen se, duke analizuar dispozitat e ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, nuk rezulton në asnjë dispozitë detyrimi për paditësin që, përpara se t'ia nënshtrojë gjykimin e kësaj çështjeje juridiksionit gjyqësor, të ndjekë një rrugë të detyrueshme administrative në organet më të larta administrative.

18. Në nenin 40 të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të titulluar "Vendimi për kundërvajtjet administrative dhe ankimi", parashikon se: "*1. Inspektori i Policisë Pyjore merr vendimin për marrjen e masave urgjente, caktimin e dënimit kryesor dhe dënimeve plotësuese, në përputhje me ligjin për inspektimin. 2. Në zbatim të këtij ligji dënime plotësuese janë: a) masa e sekuestros, sipas nenit 39 të këtij ligji; b) mbyllja e përhershme e veprimtarive dhe çmontimi i instalimeve, sipas nenit 40/3 të këtij ligji. 3. Ndaj vendimit të dhënë në zbatim të këtij neni mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin*", ndërsa në nenin 44 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën Shqipërisë", të titulluar "Ankimi i veçantë", është parashikuar se: [...]. *4. Vendimi për zgjidhjen e ankimit të veçantë merret dhe njoftohet brenda 6 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit. 5. Kundër vendimit për zgjidhjen e ankimit apo në rast se organi kompetent, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, nuk ka shqyrtuar ankimin në afatin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit*".

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në analizën që i bën ligjit specifik që rregullon mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, e konkretisht nenit 40, pika 3, të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, konstaton se e drejta e subjektit për të bërë ankim administrativ ndaj vendimeve me gjobë për kryerjen e kundërvajtjeve administrative të nxjerra nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, nuk është përcaktuar nga legjislatori si një detyrim. Përdorimi i fjalës "mund" tregon qartë se sa më sipër, është një e drejtë e subjektit për të bërë një ankim administrativ sipas ligjit "Për inspektimin" dhe jo një detyrim i tij. Në këtë kuptim, ligjvënësi e ka lënë në diskrecionin e të interesuarit për ta kundërshtuar ose jo në rrugë administrative vendimin me gjobë.

20. E drejta jonë publike dhe konkretisht Kodi i Procedurave Administrative (KPA), njeh ushtrimin e ankimit administrativ nëpërmjet apelimit administrativ të detyrueshëm dhe kërkesës joformale. Qëllimi dhe dallimi ndërmjet këtyre mjeteve të ankimit ndikon në përcaktimin e juridiksionit që i shqyrton ato, në procedurat, rrugën dhe radhën e detyrueshme të investimit të juridiksionit administrativ e atij gjyqësor.

21. Ushtrimi i ankimit administrativ nëpërmjet kërkesës joformale, nuk përbën një rrugë administrative të detyrueshme të subjektit për t'u ankuar, por një të drejtë të tij për ta paraqitur atë kërkesë, duke pasur parasysh se organi administrativ të cilit i kërkohet të shqyrtojë këtë lloj ankimi, mund ta zgjidhe atë. Në rastet e kërkesës joformale, duke mbetur një opsion, një mundësi që ligji i njeh individit për t'i paraqitur organit administrativ pretendimin e tij, gjykata nuk ka pengesë të investohet direkt për ta marrë atë në shqyrtim.

22. Në kuadër të sa më sipër, paditësi me qëllim mbrojtjen e interesave të tij të ligjshme, mund t'i ishte drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Tiranë për kundërshtimin e vendimit të dënimit me gjobë, sikundër edhe ka pretenduar se e ka kryer, por edhe në rast se ai nuk do t'i drejtohej fare këtij institucioni, paditësi nuk mund të pengohet që t'i drejtohet direkt gjykatës. Kjo, pasi kërkesa që mund t'i drejtohej Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Tiranë ka karakter joformal, për sa kohë ligji nuk e ka parashikuar si një ankim të detyrueshëm.

23. Ndërsa apelimi i detyrueshëm administrativ, i njohur dhe i përcaktuar shprehimisht në ligj si një mjet juridik i plotë për të kërkuar shfuqizimin apo ndryshimin e aktit administrativ, përbën një mjet ankimi me natyrë shteruese dhe njëkohësisht të detyrueshme për t'u ezauruar, me qëllim që më pas t'i drejtohesh gjykatës. Apelimi administrativ kërkon respektimin e disa kushteve formale, pa të cilat nuk mund të pretendohet të kryhet një proces i rregullt administrativ. Kushte formale janë ato të parashikuara nga KPA, si dhe nga ligjet e veçanta. Ndërkohë që, e drejta dhe detyrimi i subjektit për të paraqitur apelim administrativ, si dhe e drejta dhe detyrimi i organit konkret administrativ për ta marrë atë në shqyrtim, si formë ankimi administrativ me efekt shterues, duhet të jenë parashikuar konkretisht dhe shprehimisht në ligjet e posaçme, që rregullojnë fushat e veçanta të veprimtarisë administrative.

24. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr.1, datë 26.11.2010, kanë arritur në konkluzionin unifikues se: "*Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ... Ligji i posaçëm mund të parashikojë edhe modalitete konkrete mbi afatet, kushtet e procedurat që duhen respektuar për të bërë të pranueshëm për shqyrtim në themel ankimin administrativ, për procedurat e shqyrtimit dhe natyrën e vendimmarrjes nga organi administrative, etj.,. Nëse rregulla të tilla eventuale nuk janë parashikuar, gjejnë zbatim afatet, kushtet e procedurat e parashikuara nga KPA*".

25. Në analizë të sa më sipër, e duke u bazuar në sa arsyetojnë Kolegjet e Bashkuara, në Vendimin Unifikues nr.1, datë 26.11.2010, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, për sa kohë në ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, nuk është parashikuar në mënyrë të detyrueshme ndjekja e një procedure administrative të tillë, e detyrueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, (kur flasim për rrugë administrative të detyrueshme kemi parasysh parashikimin në ligj të të gjithë elementëve të domosdoshëm, si paraqitja e kërkesës organit më të lartë që e shqyrton atë, afati brenda së cilës shqyrtohet ankimi, vendimet që merren nga organi me i lartë, e drejta e ankimit etj.,), paditësi ka të drejtë që të rivendosë të drejtat e tij të shkelura, duke iu drejtuar direkt juridiksionit gjyqësor.

26. Gjithashtu, ky Kolegj vlerëson të theksojë edhe faktin që vetë ligji nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", që i është referuar ligji specifik që rregullon mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi për t'u zbatuar në rast se pala e interesuar do të ushtrojë të drejtën e ankimit administrativ ndaj vendimit të gjobës të dhënë nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër, parashikon në nenin 44, pikat 4 dhe 5, të tij, që në rast se organi kompetent nuk kthen përgjigje në lidhje me ankimin brenda afatit 6-ditor nga momenti i depozitimit të ankimit, pala e interesuar mund t'i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës për kundërshtimin e vendimit administrativ të gjobës. Nga aktet e administruara në dosje, si dhe faktet e pranuara nga palët ndërgjyqëse në gjykim, ka rezultuar e provuar se pala paditëse ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj dënimit administrativ objekt i këtij gjykimi, e cila është administruar pranë Komisionit të Ankimeve në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Tiranë, në datën 20.12.2016 me nr.8395 prot.. Ndërsa padinë objekt shqyrtimi, pala paditëse e ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër në datën 30.12.2016, pra, pas 10 ditëve që kërkesa ankimore ishte administruar në organin më të lartë administrativ.

27. Në analizë të këtyre fakteve dhe rrethanave, pretendimi i ngritur nga pala e paditur se çështja objekt shqyrtimi është jashtë juridiksionit gjyqësor, nuk qëndron. Kjo, jo vetëm për sa u analizua edhe më lart në këtë vendim (pra që ligji specifik që rregullon mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi nuk e parashikon të drejtën e ushtrimit të ankimit administrativ si një detyrim), por edhe për faktin se pala paditëse e ka depozituar padinë pas 10 ditëve, nga momenti që Komisioni i Ankimeve pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Tiranë ka administruar kërkesën e tij ankimore. Ky i fundit, sipas nenit 44, pika 4, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", kishte detyrim të shprehej rreth ankimit brenda 6 ditëve nga dita që ka regjistruar ankimin, pra nga data 20.12.2016. Në këto kushte, Komisioni i Ankimeve kishte detyrimin që të shprehej me vendim dhe t'ia komunikonte atë paditësit deri në datën 27.12.2016, e cila ka qenë ditë e martë dhe ditë zyrtare pune. Për sa më sipër, referuar faktit që organi më i lartë administrativ nuk është shprehur me vendim brenda afatit ligjor që parashikon ligji, por edhe deri në datën 30.12.2016, kohë në të cilën paditësi ka depozituar padinë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështja objekt shqyrtimi është brenda juridiksionit gjyqësor dhe me të drejtë Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër ka vendosur rrëzimin e kërkesës së anës së paditur për ta nxjerrë atë jashtë juridiksionit gjyqësor.

28. Në kushtet kur pala paditëse, edhe pse nuk e ka pasur detyrim ligjor ushtrimin e ankimit administrativ, e ka ushtruar atë dhe nuk ka marrë përgjigje brenda afatit të përcaktuar nga ligji i zbatueshëm, bazuar në nenin 44, pika 5, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në të cilën parashikohet se: *"Kundër vendimit për zgjidhjen e ankimit apo në rast se organi kompetent, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, nuk ka shqyrtuar ankimin në afatin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit",* ka të drejtë të kundërshtojë aktin objekt shqyrtimi në rrugë gjyqësore, sipas parashikimeve të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", gjë që gjen mbështetje të plotë.

29. Në analizë të sa më sipër, për sa kohë ligji nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, që rregullon mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, e ka parashikuar të drejtën e ankimit ndaj vendimeve me gjobë të dhënë në kuadër të këtij ligji si një të drejtë dhe jo si një detyrim, është e drejta e paditësit që brenda afateve të përgjithshme që parashikon e drejta për të kundërshtuar aktet administrative si dhe nenit 18 të ligjit

nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", t'i drejtohet gjykatës me padi si mjet i vetëm procedural, nëpërmjet të cilës, të mund të rivendosë në vend të drejtat e tij të pretenduara si të shkelura nga pala e paditur.

30. Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Pala kundërshtare ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi (neni 31 i KPC-s). Që padia të jetë e vlefshme, duhet të plotësojë dy kushte themelore: (a) interesi i ligjshëm për të ngritur padi; dhe (b) legjitimiteti për të vepruar. Në rast se ekzistojnë këto dy kushte, mund të konsiderohet që padia ekziston, në kuptimin që gjykata është e detyruar të marrë vendim mbi themelin e saj, pra për ta pranuar ose rrëzuar atë. Interesi për të ngritur padi, parashikohet qartë në nenin 32 të KPC-s, dhe është një element i së drejtës së padisë, që konsiston në interesin për të marrë nga gjykata, vendimin e kërkuar.

31. Në çështjen objekt gjykimi, paditësi ka disponuar të drejtën e tij për të ngritur padinë me kërkimet e paraqitura më lart, në mënyrën që ai e ka çmuar më të drejtë për mbrojtjen dhe rivendosjen e interesave të tij të pretenduara si të shkelura. Gjykata ka për detyrë të zgjidhë mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët (neni 16 i KPC-s).

32. Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, ky Kolegj, çmon se, mosmarrëveshja objekt shqyrtimi është brenda juridiksionit gjyqësor dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.11243-01170-2013, datë 21.03.2017

Shkresat e hartuara në mungesë apo tejkalim të kompetencës nga një person zyrtar apo noter i cili ka kryer një veprim që nuk është i ndaluar nga ligji, kanë fuqi provuese të një shkrese të thjeshtë, nëse janë nënshkruar nga palët.

Në kushtet e pamundësisë objektive për t'u nënshkruar nga palët, këto shkresa nuk janë prova ligjore, por janë të përdorshme nga gjykata në cilësinë ligjore të provës së zakonshme, të vlerësuara nga gjykata në raport me përmbajtjen e të dhënave të përfituara nga provat e tjera të marra gjatë gjykimit, sipas bindjes së brendshme të gjykatës.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me datë 24.07.2009.

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se pala paditëse është ish bashkëshortja e djalit të palës së paditur. Martesa e tyre është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë. Me vendimin nr.6362, datë 27.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore ndërmjet tyre. Në pasurinë e pjesëtuar është vetëm pasuria e luajtshme. Martesa e tyre është lidhur në vitin 1988 dhe vendimi për zgjidhjen e martesës ka marrë formë të prerë në vitin 2007.

3. Sipas vetëdeklarimit të bërë nga znj. B.H. me datë 23.11.2006, rezulton se ajo ka deklaruar se ka ndërtuar pa leje në Shkozë, Tiranë, një dyqan njëkatësh, të ndërtuar në vitin 1995 dhe një banesë trekatëshe nga toka dhe një kat nëntokë, e ndërtuar në vitin 1998. Pas interesimit të palës paditëse pranë organit të legalizimit lidhur me pasuritë e individualizuara më lart, ajo është bërë me dije se ato pasuri ishin vetëdeklaruar nga e ëma e ish-bashkëshortit të tij dhe për rrjedhojë, ajo kishte kërkuar t'i legalizonte.

4. Rezulton se paditësja është e regjistruar si person fizik tregtar që prej vitit 2003 dhe se objekti i veprimtarisë ekonomike të saj është tregtimi i materialeve të ndërtimit. Gjithashtu rezulton se pala paditëse dhe ish-bashkëshorti i saj kanë lidhur dy kontrata kredie bankare, për marrjen e shumave 12.000 $ dhe 1.800.000 lekë. Në kontrata nuk specifikohet se

përse do përdoreshin shumat.

5. Në fashikullin e gjykimit ndodhen edhe deklaratat noteriale të disa prej punëtorëve që kanë ndërtuar shtëpinë dhe e shoferit të automjetit që ka transportuar materialet e ndërtimit. Gjykata e shkallës së parë i ka administruar si prova shkresore ato, por në marrjen e vendimit ka konkluduar se këto prova nuk mund të përdoren, pasi janë marrë në kundërshtim me ligjin, duke sjellë në vëmendje se këto prova potencialisht mundet të ishin dëshmi dhe se dëshmia merret nën betim dhe vetëm sipas kësaj mënyrë ligjore dëshmia mund të jetë e përdorshme si provë. Gjykata e Apelit Tiranë nuk mban asnjë qëndrim lidhur me këtë çështje, por mjaftohet me konsideratën që vendimi i shkallës së parë është i bazuar në ligj dhe në prova.

6. Për të zgjidhur përkatësinë e të drejtave mbi sendet e përfshira në procedurën e legalizimit dhe për të përcaktuar raportet e tyre, pala paditëse i është drejtuar sakaq me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Me vendimin nr.7915, datë 13.10.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: "*Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Detyrimin e të padituri Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Tiranë të përfshijë paditësen F.H. në legalizimin e një dyqani me sipërfaqe ndërtimore 65 m² dhe sipërfaqe të përgjithshme 200 m² ndodhur në Shkozë, Tiranë, përballë ish-uzinës "Traktori". Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj.*".

8. Gjykata ka arsyetuar se të dy pasuritë e vetëdeklaruara dhe të përfshira në procesin e legalizimit nuk janë pasuri që i nënshtrohen regjimit pasuror martesor, megjithëse janë pasuri të vëna gjatë kohës së martesës së tyre. Për rrjedhojë, gjykata ka konkluduar se raportet e pronësisë nuk mund të rregullohen nga prezumimi ligjor i barazisë ideale të pjesëve, por nga provueshmëria e kontributit të dhënë që palët arrijnë të provojnë gjatë gjykimit. Gjykata ka konkluduar se dyqani përfaqëson një pasuri që i ka shërbyer drejtpërdrejt ushtrimit të aktivitetit ekonomik që kryente pala paditëse dhe se për rrjedhojë është provuar gjatë gjykimit se dyqani i vetëdeklaruar me qëllim legalizimi është ndërtuar edhe nga pala paditëse. Sakaq gjykata ka arritur në konkluzionin se, ajo duhet të përfshihet si titullare e së drejtës në procesin e legalizimit. Ndërkohë lidhur me shtëpinë e banimit të vetëdeklaruar me qëllim legalizimin, gjykata ka arritur në konkluzionin se nuk provohet që pala paditëse të ketë kontribuuar në ndërtimin e saj dhe për rrjedhojë, ajo nuk mund të përfshihet në procesin e legalizimit të kësaj prone. Gjykata ka vlerësuar se formularët e vetëdeklarimit janë shkresa të thjeshta por kanë fuqi juridike të provës së plotë dhe se mund të goditen vetëm për falsitet. Sakaq, kjo pjesë e padisë është rrëzuar.

9. Gjyqtari relator dhe kryesues i trupës gjyqësore në shkallë të parë ka qenë kundër vendimit, duke arsyetuar edhe qëndrimin e saj. Sipas gjyqtares së mbetur në pakicë, ndërtesa objekt banimi është ndërtuar me kontributin e paditëses, të padiurës dhe ish-bashkëshortit të paditëses. Në këtë qëndrim arsyetohet se pala paditëse ka jetuar dhe banuar në objektin trekatësh ndër vite dhe ka kontribuuar për ndërtimin e saj. Gjyqtari i mbetur në pakicë ka vlerësuar se padia duhet të pranohej e gjitha.

10. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim pala paditëse. Ankimi është paraqitur më datë 27.10.2011 dhe se nuk përmban asnjë nga shkaqet e ankimit apo arsyetimin se pse pala ankimon vendimin, duke parashtruar se, duke qenë se vendimi nuk është zbardhur, paraqitet shkurtimi i ankimit për të zënë afatin. Më datë 22.02.2012 pala paditëse ka dorëzuar ankimin e plotë. Në ankim ajo ka pretenduar se ka banuar në banesë që nga momenti i ndërtimit të saj dhe se kontributi i saj provohet edhe nga prezumimi ligjor i pasurisë në bashkëpronësi sipas regjimit martesor. Në ankim pretendohet se ndërtimi i shtëpisë ka nisur që nga muaji shtator i vitit 2002 dhe se ka rritur fëmijët 16 dhe 18 vjeç në këtë banesë. Pala pretendon në ankim se vetëm e paditura nuk kishte mundësi objektive të kishte ndërtuar edhe dyqanin edhe shtëpinë katër kate, pasi ajo ka qenë pensioniste dhe në moshën 75 vjeç. Në ankim pretendohet se, fakti që kontratat e kredisë përmendin se shumat e lekëve janë dhënë si kapital i qarkullueshëm, nuk përjashton apriori mundësinë e investimit të tyre në ndërtimin e pasurive të paluajtshme. Ankimi si konkluzion paraqet kërkimin për ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin tërësisht të padisë.

11. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim edhe pala e paditur znj. B.H., më datë 21.10.2011. Në ankim pala e paditur ka parashtruar se padia është ngritur jashtë afatit 30 ditor, sikurse parashikonte neni 328 i KPC-s. Pala pretendon se është e provuar se pala paditëse nuk është vetëdeklaruese për dy objektet dhe se si e tillë paditësja nuk mund të jetë objekt i ligjit të legalizimit. Pala në ankim pretendon se paditësi nuk arriti të provojë dot kontributin e pretenduar në objektet në proces legalizimi. Ankimi, si konkluzion, paraqet kërkimin për ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin tërësisht të padisë.

12. Me vendimin nr.2830, datë 03.12.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr.7915, datë 13.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*".

13. Në vendim gjykata e apelit ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është zbatim i drejtë i ligjit dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Gjykata e apelit ka konkluduar se pala paditëse nuk ka arritur të provojë kontributin e dhënë në ndërtimin e objektit të banimit, ndërkohë që ka arritur të provojë kontributin e dhënë për ndërtimin e dyqanit.

14. Në vendimin e gjykatës së apelit relatori dhe njëkohësisht edhe kryesuesi i trupit gjykues ka dalë në pakicë, duke argumentuar qëndrimin e tij. Gjyqtari në pakicë argumenton se pala paditëse, e paditura dhe ish-bashkëshorti i palës paditëse bashkë me fëmijët e tyre kanë jetuar në një ekonomi të përbashkët dhe në një shtëpi dhe për rrjedhojë kaq do të mjaftonte për të prezumuar barazinë në pjesë të secilit prej tre kontributorëve në të dy pronat e kërkuara për legalizim. Gjyqtari në pakicë ka vlerësuar si të përdorshme edhe provat e marra me deklarata noteriale të punëtorëve që kanë ndërtuar shtëpinë dhe të shoferit të automjetit që ka transportuar materialet e ndërtimit. Gjyqtari i mbetur në pakicë ka sjellë në vëmendje se i bashkohet plotësisht qëndrimit të gjyqtares në pakicë në vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

15. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë pala paditëse znj. F.D., më datë 12.12.2012. Nuk rezulton të ketë rekurs të palës së paditur dhe nuk rezulton të ketë as kundër-rekurs. [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se rekursi ka ngritur disa shkaqe ligjore që cenojnë vendimet e gjykatave të faktit, për arsye se gjykatat kanë kryer shkelje procedurale në mënyrën se si kanë marrë provat në gjykim dhe se si kanë zbatuar ligjin procedural lidhur me përdorshmërinë e provave të paraqitura nga pala paditëse. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vendimi nr.2830, datë 03.12.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë si pasojë e mosgarantimit të së drejtës për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor dhe duke mos garantuar shqyrtim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, duke konkluduar sakaq se për këto arsye vendimi duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

17. Kolegji vlerëson se pjesa tjetër e shkaqeve të ngritura në rekurs, konkretisht ato shkaqe që kanë lidhje me vlerësimin ndryshe të provave nga gjykatat e faktit, nuk mund të kualifikohen si shkaqe të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr.49/2012. Për rrjedhojë, këto shkaqe nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, pasi nuk hyjnë në juridiksionin e posaçëm rishikues të saj, sipas nenit 141 të Kushtetutës.

18. Kolegji vlerëson se për pjesën e të dy vendimeve të gjykatave të faktit në të cilat është pranuar pjesërisht padia, lidhur me objektin e vetëdeklaruar për legalizim e dyqanit, ato kanë marrë formë të prerë dhe njëkohësisht kjo

pjesë është gjë e gjykuar. Kolegji konstaton se nuk ka kontestime nga pala paditëse dhe pala e paditur dhe për rrjedhojë, nuk ka as rekurs mbi këtë pjesë të vendimeve. Sakaq Kolegji konkludon se mosrekursimi brenda afatit 30 ditor nga dita kur ka nisur të ecë afati i ankimit, passjell prekluzivitetin e ankimeve potenciale ndaj kësaj pjese të vendimit. Për rrjedhojë, kjo pjesë e gjykimit dhe e vendimit nuk mund t'i nënshtrohet më shqyrtimit gjyqësor dhe juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë. Kolegji vlerëson se ka si objekt gjykimi vetëm pjesën e gjykimit dhe vendimit të gjykatës së apelit që ka lënë në fuqi gjykimin dhe disponimin e gjykatës së shkallës së parë, për pjesën që padia është rrëzuar, domethënë kërkimet e palës paditëse për t'u përfshirë si bashkëtitullare në procesin e legalizimit mbi objektin tjetër. Thënë ndryshe, objekt gjykimi në Gjykatën e Lartë është vetëm disponimi gjyqësor mbi përkatësinë e së drejtës për të legalizuar objektin katërkatësh shtëpi banimi.

19. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë garantuar të drejtën e palës paditëse për t'u mbrojtur dhe për rrjedhojë ka cenuar të drejtën e saj për proces të rregullt ligjor. Kolegji sjell në vëmendje se gjykata e shkallës së parë ka pranuar të marrë në shqyrtim deklaratat noteriale të paraqitura nga pala paditëse për të provuar përkatësinë dhe bashkëtitullaritetin në pronën trekatëshe objekt banimi, por në vendimin përfundimtar gjykata ka dalë në konkluzionin se këto prova janë të papërdorshme, pasi janë shkelur rregullat e pyetjes së dëshmitarëve dhe se janë marrë në kundërshtim me ligjin. Kolegji vlerëson se kjo mënyrë e gabuar e të proceduarit nga gjykata lidhur me marrjen e provave ka cenuar të drejtën e palës paditëse për t'u mbrojtur me të gjitha mjetet ligjore që ligji garanton.

20. Kolegji duhet të sjellë në vëmendje të gjykatave se është në detyrimin ligjor të tyre, që në bazë dhe për zbatim të nenit 183 të KPC-s, rast pas rasti, provë pas prove, gjykatat e shkallës së parë, apo gjykatat e shkallës së dytë kur çështja është mbajtur për gjykim në fakt, me vendim të ndërmjetëm gjatë gjykimit dhe deri sa nuk është deklaruar shqyrtimi gjyqësor i mbyllur, të disponojnë edhe kryesisht mbi kërkesat e palëve lidhur me marrjen e provave, që janë parashtruar që në seancën përgatitore apo në seancën gjyqësore, sipas parashikimeve të neneve 158/a dhe 180, të KPC-s, apo neneve 25 dhe 34, të ligjit nr.49/2012 për gjykimin administrativ. Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje parashikimin e paragrafit të dytë të nenit 183 të KPC-s, i cili parashikon se: "*Gjykata, me vendim, lejon marrjen e provave dhe kur është rasti, edhe mënyrën e marrjes së tyre. Refuzimi i marrjes së provës së kërkuar duhet të arsyetohet nga gjykata, pa e paragjykuar çështjen.*". Kjo do të thotë se rast pas rasti dhe provë pas prove, apo qoftë edhe në rastet kur gjykatat për lejimin e provave vendosin në bllok, gjykatat

kanë detyrimin ligjor të bëjnë me dije palët për provat që pranojnë t'i marrin në shqyrtim dhe provat që nuk pranojnë t'i marrin në shqyrtim. Kjo mënyrë procedimi lidhur me provat mban palët të informuara dhe të ndërgjegjshme mbi cilësinë e materialit provues të përdorshëm në veçanti dhe në përgjithësi mbi cilësinë e aktivitetit të mbrojtjes së tyre. Vetëm në këtë mënyrë procesi gjyqësor plotëson standardet e procesit të ndershëm dhe të rregullt ligjor dhe njëkohësisht palëve u respektohet e drejta e mbrojtjes.

21. Në rastin konkret gjykata i ka administruar në gjykim provat shkresore të paraqitura nga pala paditëse, konkretisht deklaratat noteriale, por ka deklaruar papranueshmërinë e tyre vetëm në momentin kur ka arsyetuar vendimin përfundimtar. Në këto kushte pala paditëse vetëm në momentin e njohjes me vendimin përfundimtar ka marrë dijeni për shkakun e papërdorshmërisë së provave të paraqitura nga ai. Kolegji vlerëson se kjo mënyrë e të proceduarit nuk respekton nenin 183 të KPC-s dhe bashkë me të edhe nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), lidhur me parimin e realizimit të një mbrojtje efektive. Kolegji vlerëson se nëse gjykata, menjëherë apo pas paraqitjes së provave shkresore nga pala paditëse, do të duhet të kishte disponuar me vendim të ndërmjetëm, sipas nenit 183 të KPC-s, për moslejimin e marrjes së atyre provave, duke bërë të ditur edhe arsyetimin se mund të ishin të përdorshme përmbajtjet e atyre shkresave vetëm nëse kanalizoheshin proceduralisht si prova me dëshmitarë. Vetëm në këtë mënyrë pala paditëse do të kishte pasur mundësi që të provonte faktet e pretenduara në gjykatë me mjetet ligjore të tjera dhe të ndikonte në mënyrë të ligjshme në vendimmarrjen përfundimtare të gjykatës.

22. Mënyra se si ka proceduar gjykata me lejimin e marrjes së provave, të konsideruara prej saj të papërdorshme në fundin e gjykimit, ka krijuar pritshmëri gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor tek pala paditëse se, në marrjen e vendimit përfundimtar dhe në vlerësimin si të provuar apo jo të faktit të pretenduar mbi bashkëpërkatësinë e shtëpisë trekatëshe për efekte legalizimi, provat do të përdoren, pasi ato nuk janë refuzuar si të papërdorshme. Duke vendosur me vendimin përfundimtar gjykata, për një çështje e cila duhet të kishte vendosur me vendim të ndërmjetëm dhe derisa të mos kishte deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, ka mohuar të drejtën e palës për t'i garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 14 të KPC-s, dhe njëkohësisht edhe të drejtën e saj për t'u mbrojtur, duke e vënë atë në disavantazh në krahasim me palën e paditur dhe duke cenuar standardet e detyrueshme për t'u zbatuar që rrjedhin nga parimi i kontradiktoritetit. Kolegji sjell në vëmendje se në jurisprudencën kushtetuese mbi parimin e gjykimit kontradiktor Gjykata

Kushtetuese ka vlerësuar se duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre dhe se, nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor.[1] Bazuar në këto parime, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë.[2]

23. Kolegji vlerëson se, nuk qëndron ligjërisht argumentimi i papërdorshmërisë së provave akte noteriale që përmbajnë deklaratat e subjekteve që potencialisht mundet të ishin thërritur në gjykim me cilësinë e dëshmitarit. Kolegji vlerëson se papërdorshmëria e provës, sikurse në gjykimin penal edhe në gjykimin civil dhe atë administrativ, fillimisht është çështje që gjen rregullim në ligj dhe se më tej vlerësohet provë pas prove nga gjykata, që vendos refuzimin e lejimit apo marrjes së provës me vendim të ndërmjetëm sipas nenit 183 të KPC-s, me kërkesë të palëve apo kryesisht. Në rastin konkret gjykatat e faktit janë gjendur para kërkesës së palës paditëse për të lejuar marrjen si provë shkresore të disa deklarimeve të personave që kanë dijeni për faktet juridike që kërkohen të provohen prej paditësit në gjykim, të dhëna para noterit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se këto prova shkresore nuk mund të përdoren, pasi janë dëshmi të marra në kundërshtim me rregullat ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile që regjojnë marrjen e provës me dëshmitar. Kolegji sjell në vëmendje se deklaratat noteriale të personave, të administruara si provë, paraqesin të dhëna mbi faktin se në ndërtimin e banesës tre katërshe ka kontribuar pala paditëse, duke u pasqyruar në to deklarimet e personave që kanë ndërtuar banesën në konflikt gjyqësor dhe deklarimet e shoferit të automjetit që ka transportuar materialet e ndërtimit.

24. Kolegji vlerëson se deklaratat noteriale në rastin konkret duhet të ishin vlerësuar si prova shkresore nga gjykatat e faktit, në kuptimin që jep për shkresën private në kuptimin e gjerë neni 246 i KPC. Kolegji sjell në

[1] Shiko, Vendimi nr.34, datë 29.05.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

[2] Shiko, Vendimi nr.21, datë 16.04.2015; Vendimi nr.34, datë 29.05.2015; Vendimi nr.37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

vëmendje se neni 1, paragrafi i dytë, i ligjit nr.49/2012 thërret në mënyrë komplementare në zbatim parashikimet ligjore të KPC-s. Për rrjedhojë, në vlerësimin e këtyre provave të kërkuara për t'u marrë në shqyrtim nga gjykatat e faktit duhet të ishin pasur parasysh normat ligjore që rregullojnë provën me shkresë në ligjin procedural civil.

25. Kolegji sjell në vëmendje se, vërtet deklaratat noteriale të personave në çështjen objekt gjykimi potencialisht do të përbënin dëshmi për gjykimin dhe se për rrjedhojë do të duhet të ishin marrë sipas rregullave që KPC parashikon për formësimin e provës me dëshmitar. Megjithatë, Kolegji vlerëson se është i pabazuar në ligj konkluzioni i gjykatave të faktit se marrja e deklarimeve të këtyre personave, nëpërmjet shkresës së veshur në formën e aktit noterial, përbën shkelje të rregullave ligjore për marrjen e provës dhe për pasojë prova është e papërdorshme. Kolegji sjell në vëmendje se në rastin konkret deklarimet e personave që mund të ishin potencialisht dëshmitarë pasqyrohen në shkresa, të cilat janë veshur në formën e aktit noterial. Si të tilla, nuk ka asnjë ndalim ligjor për përdorimin e tyre në gjykim me cilësinë e provës. Sigurisht ato nuk janë dëshmi dhe për rrjedhojë nuk futen në gjykim me cilësinë procedurale të provës me dëshmitar. Megjithatë nuk mund të vihet në dyshim që ato janë prova të llojit shkresë e thjeshtë, për sa kohë, sipas përcaktimit të nenit 11 të KPC-s, ato shkresa përmbajnë të dhëna që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve mbi ekzistencën e fakteve të caktuara.

26. Kolegji vlerëson se, këto deklarata janë pasqyruar në dokumente shkresore dhe janë marrë nga një subjekt që ligji e shquan si zyrtar apo person të cilit ligji i ka njohur detyra dhe funksione publike, sikurse është noteri. Por, noteri nuk mund të jetë gjykatë dhe se marrja e dëshmisë bëhet ekskluzivisht nga gjykata dhe jo prej tij. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se noteri në këtë mënyrë ka ushtruar një detyrë jashtë kompetencës së tij ligjore por që ligji nuk e ndalon si veprim.

27. Në këtë pikë të arsyetimit Kolegji sjell në vëmendje të gjykatave të faktit nenin 258 të KPC-s, dispozitë e cila e përkufizon ndër të tjera shkresën e thjeshtë në kuptimin e gjerë[3] se: *"Shkresa që është përpiluar nga një person zyrtar që nuk ka qenë kompetent ose që nuk është sipas formës së caktuar, ka fuqinë provuese të një shkrese të thjeshtë, në rast se është nënshkruar nga palët."*. Në këtë dispozitë legjislatori, krahas kategorisë më të madhe të shkresave private që janë shkresat që rrjedhin nga palët apo shkresat private në kuptimin e ngushtë, njeh me cilësinë procedurale të

[3] Ajo shkresë e thjeshtë që, megjithëse nuk paraqitet prej palës kundërshtare, ka vlerë provuese në gjykim.

shkresave private shkresat të cilat janë hartuar nga një person zyrtar jashtë kompetencës së dhënë nga ligji. Ndërkohë që kushti tjetër që ligji vendos në këtë dispozitë është që, megjithëse shkresa të mos ketë respektuar kufijtë e kompetencës së personit zyrtar që e ka përpiluar, të jetë nënshkruar nga palët.

28. Kolegji vlerëson se kjo normë nuk rregullon statusin e të gjithë atyre shkresave që janë nxjerrë nga persona zyrtarë jashtë kompetencës, por nuk janë nënshkruar nga palët, ose nuk janë nënshkruar nga askush përveç personit zyrtar, ose janë nënshkruar nga persona të tretë, të lidhur apo të palidhur me palët, sikurse është rasti objekt gjykimi. Në respektim të së drejtës për t'u mbrojtur dhe në zbatim të nenit 1, paragrafi i dytë, të KPC-s, Kolegji vlerëson se nenit 258 të KPC-s duhet t'i bëhet një interpretim pajtues dhe njëkohësisht edhe i zgjeruar, në mënyrë që kushtëzimi ligjor që bën dispozita të mos bëjë të papërdorshme në gjykim prova që nuk ka asnjë arsye juridike të mos përdoren.

29. Kolegji vlerëson se, pavarësisht se dispozita vë si kusht nënshkrimin e palëve, në shkresën që shndërrohet nga provë ligjore në provë të zakonshme, për shkak se nuk është respektuar kompetenca e personit zyrtar, neni 258 i KPC-s nuk mund të zbatohet edhe në rastet kur palët nuk kanë mundësi objektivisht të nënshkruajnë shkresën potencialisht zyrtare, pasi ajo vetëm në këtë mënyrë mundet të bëhet. Një interpretim i tillë do të cenonte të drejtën e mbrojtjes së palëve në një proces gjyqësor, në kushtet kur atyre, për përdorshmërinë e një shkrese, u kërkohet nënshkrimi dhe në të njëjtën kohë një gjë të tillë vetë ligji apo vetë rrethanat e hartimit të shkresës e pamundësojnë objektivisht. Kështu, interpretimi pajtues dhe i zgjeruar i nenit 258 të KPC-s, nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, është se, nënshkrimi i palëve në këto lloje shkresash do të kërkohet vetëm kur ato kanë mundësi ta nënshkruajnë atë, pra kur nënshkrimi i palëve është pjesë integrale e formës së shkresës, e jo në rastet e tjera, kur nënshkrimi i palëve është objektivisht i pamundshëm.

30. Kolegji në arritjen e këtij konkluzioni mban parasysh dispozitën ligjore të përgjithshme për fuqinë provuese dhe përdorshmërinë e shkresave në kuptimin e gjerë, konkretisht nenin 246 të KPC-s. Kjo dispozitë parashikon se: "*Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementët e nevojshëm për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen.*". Kjo do të thotë se çdo dokument ka fuqi provuese, pavarësisht përmbajtjes së tij, mjafton që të ketë formë, të mos jetë i copëtuar, i grisur, i gërvishtur, i shuar apo i kompromentuar qëllimisht derisa të jetë denatyruar për të dëmtuar provën.

Sigurisht, mbi këto kërkesa ligjore të fuqisë provuese të provës në vetvete, si kusht për lejimin e marrjes së saj do të mbetet edhe relevanca me objektin e gjykimit apo me objektin e të provuarit.

31. Kolegji, në rastin konkret, vlerëson se mosnënshkrimi i deklaratave noteriale, potencialisht dëshmi, nga palët ndërgjyqëse nuk ka ardhur si pasojë e mungesës së vullnetit të tyre për të konfirmuar vërtetësinë e përmbajtjes së shkresës, pasi nga ana strukturore dhe përmbajtësore kjo lloj shkrese, mundet të bëhet vetëm nën praninë dhe pjesëmarrjen e noterit, si person zyrtar, dhe deklaruesit, si autor i deklaratës dhe përmbajtjes së shkresës. Kështu, Kolegji konkludon se, në kushtet e pamundësisë objektive për t'u nënshkruar nga palët, shkresat nuk mund të bëhen të papërdorshme dhe nuk mund të arrihet në konkluzionin se këto prova nuk parashikohen nga ligji, për shkak se nuk mund t'u kundrejtohet dot ligjërisht ky detyrim palëve, në rrethanat ku shkresa u formësua dhe në mënyrën se si ajo formësohet. Kolegji konkludon se këto shkresa të paraqitura nga pala paditëse si prova janë të përdorshme dhe kanë vlerën ligjore të provës së zakonshme, që do të thotë se do të duhet të ishin vlerësuar nga gjykata në raport me provat e tjera, nën optikën dhe ndërgjegjen juridiko-profesionale të lirë të gjykatës.

32. Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje edhe për efekt të zhvillimit të jurisprudencës se, Kodit i Procedurës Civile numërton mjetet e provës që mund të përdoren gjatë gjykimit për të hedhur dritë mbi faktet juridike nga të cilat varet zbatimi i ligjit material apo procedural dhe për të zbuluar të vërtetën gjyqësore. Këtu sillen në vëmendje si të dhëna me fuqi provuese nga ligji si shpjegimet e palëve, dëshmia, ekspertimi, provat shkresore me nënndarjet e tyre, këqyrja dhe eksperimenti. Kolegji vlerëson se, parimi i tipicitetit dhe i tipizimit në ligj e rregullimit në mënyrë të shprehur të mjeteve të provës, është shprehje e parimit të ligjshmërisë dhe shprehje e vullnetit të ligjvënësit për ta kanalizuar në binarë proceduralë, të sigurt dhe racionalë procesin e vërtetimit të fakteve juridike në gjykimin civil, administrativ dhe penal. Megjithatë, Kolegji vlerëson se, parimi i tipicitetit të provës, më shumë se i llojeve të ndryshme provës, i referohet mënyrës së formimit të këtyre burimeve dhe mënyrës së futjes së tyre në proces, duke siguruar një funksion eminent garancie në formimin e bindjes së brendshme të gjyqtarit.[4] Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se, ligjvënësi nuk parashikon mjete të përcaktuara dhe listë shteruese të provave, por një procedurë dhe formë të mirëpërcaktuar të futjes së tyre në proces, që është çështje ekskluzivisht ligjore.

[4] Salvo Leuzzi, "I mezzi di prova nel processo civile. Formazione, acquisizione, integrazione", Giuffrè Editore, Milano, 2013, fq. 64.

33. Në këtë linjë arsyetimi, çështja që shtrohet për zgjidhje në vlerësimin e Kolegjit është nëse mund të përdoren mjete prove atipike njohjeje (si p.sh. ekspertimet jashtëgjyqësore, deklaratat e shkruara të të tretëve jo pjesëmarrës në proces[5], provat e grumbulluara në procese të tjera gjyqësore etj.,.), që mund të ndikojnë në formimin e bindjes së brendshme të gjyqtarit. KPC hesht në lidhje me provat atipike, ndryshe nga rregullimi që bën KPP, që në nenin 151/3 të tij parashikon se: *"Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë atë në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës, pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj*".

34. Në vlerësimin e Kolegjit, pavarësisht se KPC hesht dhe ometon në këtë pjesë, prova atipike duhet të pranohet si e përdorshme në procesin civil, njëlloj sikur pranohet se mundet të përdoret edhe në procesin penal. Kolegji sjell në vëmendje paragrafin e dytë të nenit 1 të KPC-s, që detyron gjykatën të vendosë edhe për çështje, për të cilat ka ligj dhe duke i dhënë gjykatës pushtetin e formësimit të normës dhe plotësimit të boshllëkut ligjor, sipas parimeve kushtetuese të interpretimit dhe të zhvillimit të jurisprudencës.

42. Kolegji vlerëson se çdo lloj prove, që nuk është përjashtuar në mënyrë të shprehur nga ligji si e papërdorshme, pranohet nga gjykata në gjykimin civil, administrativ dhe penal, kur ka lidhje me objektin e të provuarit. Nga ana tjetër Kolegji vlerëson se, përgjithësisht provat atipike, më shumë se prova të paparashikuara apo të parregulluara nga ligji, janë prova që mbartin elementë të përzierë dhe të ndërmjetëm të provave tipike. Kështu, tipiciteti i mjetit provues ka të bëjë jo vetëm me formën por edhe me përmbajtjen (elementë këta që përcaktojnë statusin ligjor të provës), ndërkohë që provat atipike mund të kenë formën e një prove të caktuar, ndërsa në përmbajtje kanë elementë të një prove tjetër dhe pikërisht në këtë natyrë të përzier qëndron atipiciteti i tyre[6]. Kështu për shembull akti i ekspertimit privat ka formën e shkresës private, por në përmbajtje ekuivalentohet me provën me ekspert, sikurse edhe deklaratat e shkruara të të tretëve jo pjesëmarrës në proces, kanë formën e shkresave private[7], por në përmbajtje kanë elementë të dëshmisë, për sa kohë mund të jenë deklarime të personave të painteresuar në përfundimin e çështjes mbi faktet për të cilat ata kanë dijeni. Kolegji arrin në konkluzionin se provat atipike mundet të përdoren

[5] Të cilat kanë natyrën e *quasi*-dëshmisë.

[6] Francesco Carnelutti, " *Lezioni di diritto processuale civile, III, 2",* Padova 1923, fq. 342-344.

[7] Shiko qëndrimin e mbajtur në Vendimin nr.14122, dt. 27.07.2004; në Vendimin nr.5974, datë 04.11.1988 të Seksionit Civil të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë.

në gjykimin civil dhe administrativ dhe se për provat atipike do të zbatohen rregullat ligjore të zbatueshme për provat tipike korresponduese, qoftë edhe nëpërmjet interpretimit të këtyre normave me analogji.

43. Ndaj, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se deklaratat noteriale të personave që kanë pranuar se janë punëtorë apo shoferë dhe kanë punuar për të ndërtuar shtëpinë objekt konflikti gjyqësor, duhet të ishin pranuar nga gjykata si prova dhe duhet të ishin përdorur në marrjen e vendimit të saj, duke iu nënshtruar përcaktimit të fuqisë provuese në raport me përmbajtjen e të dhënave të përfituara nga provat e tjera të marra gjatë gjykimit, sipas bindjes së brendshme të gjykatës (shiko, paragrafi i dytë i nenit 309 të KPC-s). Kolegji sjell në vëmendje të gjykatave të faktit se këto prova nuk janë prova ligjore, por prova me fuqi të zakonshme provuese, që do të thotë se gjykata e përcakton fuqinë dhe aftësinë provuese të tyre sipas vlerësimit të lirë në optikën vlerësuese të bindjes së arritur në raport me provat e tjera që janë pranuar.

44. Kolegji vlerëson se pjesa e vendimit përfundimtar të gjykatave të faktit për të mospërdorur këto prova shkresore, ka cenuar të drejtën për t'u mbrojtur të palës paditëse dhe për rrjedhojë, këto vendime edhe për këtë arsye janë të cenueshme. Kolegji vlerëson se vetëm pas marrjes në vlerësim dhe përdorim edhe të këtyre provave, gjykata e faktit do të jetë në gjendje të japë një vendim të bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor. Në arritjen e këtij konkluzioni Kolegji mban parasysh se thelbi i konfliktit është çështja nëse pala paditëse provon apo jo që ka kontribuuar në ndërtimin e paligjshëm të objektit katër kate, shtëpi banimi, të deklaruar për legalizim. Kështu gjykata duhet të lejojë palët që të përdorin të gjitha mjetet ligjore që ligji vë në dispozicion të tyre për të provuar pretendimet e artikuluara gjyqësisht. Vetëm pas lejimit të zhvillimit të procesit sipas parimit të garantimit të së drejtës së palëve për të kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, gjykata e faktit do të jetë në gjendje të zgjidhë mosmarrëveshjen sipas së drejtës pozitive në fuqi.

45. Gjykata vlerëson se në kushtet kur shqyrtimit gjyqësor nuk i janë nënshtruar edhe këto prova, nuk mund të zgjidhë çështjen në themel, por çështja duhet të kthehet për rigjykim në shkallë të dytë. Gjykata e apelit në rigjykim duhet të mbajë parasysh zhvillimin e gjykimit në përputhje me nenin 14 të KPC-s dhe 17, pika 2, të ligjit nr.49/2012. Vetëm pas vlerësimit sipas rregullave të fuqisë provuese të provave të zakonshme, gjykata e apelit do të jetë në gjendje të marrë një vendim meritor dhe përfundimtar lidhur me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-479, datë 28.03.2017

Ngritja në gradë në policinë e shtetit nuk është një e drejtë automatike pasi kandidatët duhet plotësojnë dy kushte, në mënyrë kumulative, vjetërsinë në gradën e mëparshme dhe ekzistencën e vendeve të lira për konkurrim në gradën pasuese.

I. Rrethanat e Çështjes

1. Paditësja V.V. rezulton të ketë mbaruar në vitin 1998 Akademinë e Rendit Publik dhe në datën 22.09.1999 ka filluar punë në Komisariatin e Policisë Berat.

2. Në datën 30.09.2002 paditësja ka shkëputur marrëdhëniet financiare si agjente e Policisë Kriminale pranë kësaj strukture policore, në bazë të urdhrit të datës 28.09.2002, për përjashtimin e saj nga Policia e Shtetit.

3. Paditësja rezulton të ketë kundërshtuar gjyqësisht ligjshmërinë e këtij urdhri. Padia e saj për anulimin e këtij akti administrativ është pranuar me vendimin nr.168, datë 04.03.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

4. Paditësja ka kërkuar pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat vijimin e karrierës së saj në strukturën policore dhe kjo e fundit ka përcjellë dokumentacionin pranë palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

5. Me vendimin nr.1069, datë 21.05.2009, Komisioni i Verifikimit ka vlerësuar se paditësja përmbush kriteret ligjore, duke i rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm ripranimin e saj në strukturën e policisë dhe caktimin e saj me detyrë "Trupë Shërbimi", në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat, duke i dhënë gradën policore "Inspektor".

6. Duke vlerësuar se i takon grada policore "Kryeinspektor", paditësja, në datën 05.12.2011, është ankuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Me shkresën "kthim përgjigje" nr.745/2 prot., datë 23.12.2011, pala e paditur ka refuzuar ndryshimin e vendimit të komisionit të verifikimit, me arsyetimin se grada që ka përfituar paditësja në momentin e ripranimit "*është në përputhje me nenin 58 të ligjit "Për Policinë e Shtetit" dhe se grada më e lartë fitohet nëpërmjet procesit të konkurrimit*". Paditësja rezulton të ketë marrë dijeni për këtë shkresë në datën 03.01.2012.

7. Për shkak të refuzimit të ndryshimit të gradës paditëses, kjo e fundit, në datën 01.02.2012, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me padinë, me palë, objekt e bazë ligjore të cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.507, datë 02.04.2012, ka vendosur: *Shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për gjykimin e çështjes civile nr.546, datë regjistrimi 01.02.2012. Dërgimin e akteve në gjykatën kompetente, Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, Seksioni Administrativ.* Kundër këtij vendimi, ka bërë ankim të veçantë, në Gjykatën e Lartë, paditësja V.V..

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2012-1715 (283), datë 29.05.2012, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr.507, datë 02.04.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.*

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3538, datë 05.04.2013, ka vendosur:*Pranimin e padisë së paditëses V.V. si të bazuar në prova dhe në ligj; Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit t'i japë paditëses V.V., punonjëse e policisë së Shtetit, gradën policore "Kryeinspektor", refuzuar nga pala e paditur në kundërshtim me ligjin nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe VKM nr.803, datë 21.11.2007 "Për caktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", me anë të shkresës nr.745/2 prot., datë 23.12.2011. [...]*

11. Kundër vendimit nr.3538, datë 05.04.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 24.04.2003, ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë.

12. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1973, datë 08.05.2014, ka vendosur: *Të shpallë moskompetencën e gjykimit të çështjes civile nr.2019 akti, datë 30.09.2013 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë;*

13. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.2988, datë 11.07.2014, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr.3538, datë 05.04.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.* Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka parashtruar të njëjtat arsye si gjykata e shkallës së parë.

14. Kundër vendimit nr.2988, datë 11.07.2014, të Gjykatës së Administrative të Apelit, ka bërë rekurs pala e paditur, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr.3538, datë 05.04.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Kjo palë ka parashtruar në rekursin e saj shkaqet e përmendura në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të cilat i bëjnë të cenueshme të dyja vendimet e gjykatave më të ulëta.

16. Vendimi nr.2988, datë 11.07.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit si dhe vendimi nr. 3538, datë 05.04.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit material dhe si të tilla, duhet të ndryshohen, duke u vendosur rrëzimi i padisë.

17. Të dyja gjykatat, në marrjen e vendimeve të tyre, kanë arsyetuar se paditësja nuk konsiderohet si punonjës policie i liruar nga radhët e policisë, por si e përjashtuar në mënyrë të kundërligjshme, urdhër i cili është anuluar më tej me vendimin nr.168, datë 04.03.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Gjithashtu, këto gjykata kanë arritur në përfundimin se paditëses i takon grada "Kryeinspektor", pasi ajo ka arsim të lartë dhe në të njëjtën kohë ka plotësuar afatin e qëndrimit në gradën "Inspektor", me qëllim promovimin në gradën pasuese.

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se së pari, në çështjen në shqyrtim, nuk bëhet fjalë për trajtimin me gradë të punonjësit të policisë, pas ripranimit të tij në radhët e Policisë së Shtetit. Në gjykim ka rezultuar e provuar se paditësja nuk është liruar nga Policia e Shtetit, në mënyrë që trajtimi i saj të bëhej në përputhje me nenin 58 të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", "Ripranimi në polici". Nga gjykimi, në të dy gjykatat e faktit ka rezultuar se paditësja është përjashtuar nga Policia e Shtetit, në bazë të urdhrit të datës 28.09.2002. Ky urdhër, më tej, siç u theksua, është anuluar nga vendimi nr.168, datë 04.03.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

19. Me anulimin e një akti administrativ individit i kthehen të gjitha të drejtat e mohuara apo të cenuara nga akti i paligjshëm, duke u rikthyer situata në gjendjen që ka qenë përpara nxjerrjes së aktit. Pra, me anulimin e këtij urdhri, paditësja është konsideruar se nuk i ka shkëputur asnjëherë marrëdhëniet e punës me Policinë e Shtetit. Kjo shprehet edhe në nenin 41/5, shkronja "c", pika "iv", e ligjit nr.9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", që parashikon se: *Në vjetërsinë për efekt gradimi llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të – pezullimit apo përjashtimit për shkaqe disiplinore, si rezultat i një urdhri ose vendimi të paligjshëm dhe/ose të padrejtë*. Pra, paditësja, në asnjë rast nuk mund të trajtohet si një person i ripranuar në polici, sipas nenit 58 të ligjit nr.9749, datë

04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit".

20. Së dyti, të dyja gjykatat kanë gabuar kur kanë arritur në përfundimin se paditëses i takon grada "Kryeinspektor", për shkak se ajo ka arsim të lartë dhe ka plotësuar kushtin e vjetërsisë.

21. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, jo vetëm në funksion të zgjidhjes së çështjes në gjykim, por edhe të orientimit të praktikës gjyqësore, si një rol që ia njeh neni 58, shkronja "a", e ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çmon të theksojë se ngritja në gradë sipas ligjit nr.9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", bëhet pasi të plotësohen dy kushte, në mënyrë kumulative, vjetërsia në gradën e mëparshme dhe ekzistenca e vendeve të lira për konkurrim në gradën pasuese.

22. Ligji nr.9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", shpërndarjen e gradave e lidh me funksionin që kryen punonjësi i policisë. Si rrjedhojë, ngritja në gradë bëhet përmes një procesi konkurrues, pasi punonjësi përkatës të ketë shërbyer për minimumin e kohës së parashikuar në nenin 41/5 të ligjit të sipërcituar. Kjo shprehet mjaft qartë në nenin 42 të këtij ligji, i cili, ndër të tjera, parashikon se: *Ngritjet në gradë bëhen vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë. Në urdhrin për ngritje në gradë, autoriteti përgjegjës përcakton gjithashtu funksionin përkatës të punonjësit të Policisë. Punonjësit e Policisë mund të ngrihen në gradë vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses kursin e trajnimit përkatës për atë gradë. Punonjësit e Policisë zgjidhen për të ndjekur kursin e trajnimit, duke u bazuar në listën emërore të së drejtës për gradë, të hartuar pas procesit konkurrues. Pas përfundimit me sukses të trajnimit, përzgjedhja për ngritje në gradë bëhet sipas listës emërore të së drejtës për gradë, të përcaktuar në pikën 1 shkronja "c" të këtij neni. Kuotat e pranimit në trajnim për secilën gradë përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, por nuk kalojnë: 5 për qind mbi vendet e lira të përllogaritura për ngritjen në gradën e "Kryeinspektorit"; 10 për qind mbi vendet e lira të përllogaritura për gradat e nivelit të parë drejtues; 15 për qind mbi vendet e lira të përllogaritura për gradat e nivelit të mesëm drejtues*.

23. Pra, siç shihet, ngritja nga një gradë me e ulët në një gradë më të lartë, është e lidhur, *së pari*, me ekzistencën e vendeve të lira në atë gradë, *së dyti*, me plotësimin e kushtit të vjetërsisë së qëndrimit në gradën e mëparshme, i cili përbën një kriter kualifikues për t'u futur në konkurs nga ana e punonjësit kandidues dhe, *së treti*, pas përfundimit me sukses të trajnimit për gradën më të lartë.

24. Sistemi i gradave në ligjin nr.9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", është i lidhur me funksionin dhe nuk është një sistem që u jep automatikisht të drejtën për të përfituar gradën superiore të gjithë atyre që plotësojnë kriteret e vjetërsisë. Përcaktimi i numrit të mbajtësve të një grade të caktuar, pra i numrit të funksioneve korresponduese, bëhet në përputhje me politikat e rendit dhe sigurisë, si pjesë e politikave ekzekutive të shtetit.

25. Në këtë kuadër, pushteti gjyqësor nuk ka juridiksion për të verifikuar përshtatshmërinë apo dobishmërinë e politikave në këtë fushë, pasi kjo i përket sferës së pushtetit ekzekutiv. Mbështetur në parimin e ndarjes së pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, zgjidhjet që i takojnë kompetencës ekskluzive të një pushteti, nuk mund të përbëjnë lëndë të shqyrtimit nga pushtetet e tjera.

26. Në këtë kontekst, fusha e përcaktimit të gradave dhe funksioneve që i korrespondojnë atyre, është një fushë që i përket diskrecionit të pushtetit ekzekutiv dhe për mbarëvajtjen në tërësi të politikave në fushën e rendit dhe të sigurisë, ashtu si edhe në fusha të tjera, ai përgjigjet përpara pushtetit legjislativ që e ka votëbesuar.

27. Në këto çështje, roli i gjykatës kufizohet vetëm në ato raste kur nga ana e organeve kompetente janë shkelur kriteret e vendosura me ligj në raport me një kandidat, si pasojë e së cilës atij i është cenuar e drejta për të avancuar në karrierë. Pra, gjykata mund të investohet vetëm nëse një kandidat, padrejtësisht, është përjashtuar nga konkurrimi i shpallur, nuk është renditur në vendin e merituar ose nuk i është dhënë grada pasi ka përfunduar me sukses trajnimin për vendet e shpallura. Nga ana tjetër, gjykata nuk mund të detyrojë organet ligjzbatuese për të shpallur një konkurrim, për të shtuar numrin e vendeve ose funksioneve korresponduese për një gradë apo për të dhënë grada më tepër se ç'janë vendet e punës për ato grada.

28. Referuar rrethanave të çështjes, siç kanë rezultuar të provuara në gjykim, në momentin e kthimit të paditëses në detyrë, asaj i është dhënë funksioni "Trupë Shërbimi", në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat, duke i korresponduar grada policore "Inspektor". Kjo është plotësisht në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.803, datë 21.11.2007 "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", sipas të cilit gradës "Inspektor" i përket, ndër të tjera, funksioni "Trupë shërbimi".

29. Në të njëjtën kohë, konstatohet se edhe me ekuivalentimin e gradës së mëparshme të paditëses me gradën e re, asaj i takon sërish grada "Inspektor", pasi një gradë e tillë përfshin edhe gradën "Agjent", sipas sistemit të vjetër të gradave, gradë të cilën paditësja ka pasur në momentin e përjashtimit të saj nga radhët e Policisë së Shtetit.

30. Vlen të theksohet se edhe fakti që paditësja është me arsim të lartë policor nuk sjell automatikisht përfitimin prej saj të një grade më të lartë. Një fakt i tillë merret në konsideratë nga ligji nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", që e ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën e shkollimit policor, i cili, në nenin 41/5, shkronja "b" e tij parashikon se: Punonjësit e Policisë që kanë përfunduar një shkollë të lartë të njohur nga shteti dhe që kanë plotësuar së paku dy të tretat e minimumit të kohës që kërkohet për qëndrimin në gradë, mund të konkurrojnë në procesin e përzgjedhjes për ngritjen në gradë nga "Inspektor" në "Kryeinspektor" dhe nga "Kryeinspektor" në "Nënkomisar". Pra, pasja e një diplome të njohur sjell shkurtimin e kohës së qëndrimit në një gradë, për efekt të konkurrimit në gradën vijuese më të lartë.

31. Së fundi, pretendimi i ngritur në rekurs se padia është parashkruar, rezulton të jetë i pabazuar, pasi nga aktet e administruara në gjykim dhe siç ka rezultuar e provuar nga gjykimi në gjykatat e faktit, paditësja ka marrë dijeni për refuzimin e përfitimit të gradës "Kryeinspektor" në datën 03.01.2012 dhe e ka paraqitur padinë në datën 01.02.2012, pra brenda afatit prej 30 ditësh, të parashikuar në ligjin e posaçëm.

Në lidhje me sa u tha më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se rëndësia e orientimit të praktikës gjyqësore në këtë drejtim vjen edhe nga fakti që në Vendimin Unifikues nr.1, datë 29.02.2016, nuk u arrit të njësohej praktika në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për unifikim, se cilat do të ishin kriteret ligjore që duhet të merren parasysh për caktimin e gradës së re, në rastin e ekuivalentimit të gradave policore të dhëna sipas ligjeve të mëparshme, për shkak të rrëzimit të padisë, si rrjedhojë e kalimit të afatit të parashkrimit të saj.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-398, datë 04.04.2017

Kërkimet që rrjedhin nga një marrëdhënie jashtëkontraktore, parashkruhen brenda afatit të tre vjetëve për paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe ato për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë, afat i padisë i cili fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës më datë 22.05.2006. Në dhomë këshillimi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë realizoi kalimin procedural të palës së paditur, duke parë zhvillimet e ligjit nga koha kur është ngritur padia e deri më sot.

2. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se paditësi H.S. figuron pronar i dy sipërfaqeve trualli, respektivisht [...].

3. Pronësia mbi këto sipërfaqe është fituar në zbatim të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën" dhe në kuadrin e procesit të privatizimit të serrave i kanë kaluar palës paditëse në pronësi edhe serrat. Kështu pala paditëse ka blerë nga Ndërmarrja Bujqësore Spitallë, Durrës, objektin "Serra diellore me xham nr.7", që ndodhet në Shkozet, me anë të kontratës së shitblerjes nr.1839/1487, datë 25.09.1996, me një sipërfaqe 30399 m2. Rezulton se kontrata është regjistruar në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

4. Nëpërmjet kontratës së pjesëtimit vullnetar nr.3077/929, datë 10.06.1997, 17 bashkëpronarët e sipërfaqes së tokës bujqësore kanë pjesëtuar sendin. Pala paditëse ka përfituar sipërfaqen 750 m2 dhe 968.7 m2. Kontrata e pjesëtimit vullnetar rezulton të jetë e regjistruar.

5. Për shkak të ndërtimit të superstradës Durrës-Sukth, pjesë e superstradës Tiranë-Durrës, me Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.747, datë 26.11.1998 dhe nr. 524, datë 21.08.1998, për efekt interesi publik, paditësit i janë shpronësuar 1.254 m2 objekte serra dhe 1.254 m2 tokë truall poshtë serrave. Për këto sipërfaqe dhe objekte të shpronësuara paditësit i është dhënë shpërblimi përkatës, për të cilin nuk ka pasur asnjë lloj kontestimi. Shpronësimi rezulton të jetë bërë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 747, datë 26.11.1998 dhe se shpronësimi është bërë në favor të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Shpronësimi parashikohej të përfundonte deri me datë 30.06.1999.

6. Paditësi, me pretendimin se, nga sipërfaqja prej 6.447 m2, në përfundim të punimeve nga superstrada i është zënë një sipërfaqe më e madhe se ajo e përcaktuar në aktin e shpronësimit, duke u zhveshur efektivisht nga pronësia edhe nga 394 m2 tokë, e duke iu dëmtuar edhe 394 m2 serra (objekte), ndërsa sipërfaqja prej 968 m2, që referon në pasurinë nr.1/157 zona kadastrale nr.8515, është zënë në fakt tërësisht nga Zvinkola e superstradës Durrës-Sukth, duke u zhveshur nga pronësia edhe nga kjo sipërfaqe, me padi ka kërkuar detyrimin e palës së paditur t'i paguajë vlerën e këtyre sendeve (sipërfaqeve truall dhe serrave), si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mospërdorimi i serave dhe truallit.

7. Në seancën gjyqësore të datës 27.06.2006 (*shiko, procesverbali, faqe 9, i fashikullit të gjykimit në shkallë të parë*) dhe në seancën e datës 12.09.2006 (*shiko, procesverbali në faqen 135 të fashikullit të gjykimit në shkallë të parë*), gjatë parashtrimit të prapësimeve, Avokatura e Shtetit ka pretenduar se padia nuk duhet të pranohet, pasi është parashkruar sipas nenit 115, shkronja "dh", të Kodit Civil (KC)-s, për shkak se ka kaluar afati 3-vjeçar i parashkrimit. Prapësimi i parashkrimit shues është ngritur dhe sqaruar edhe në konkluzionet përfundimtare mbi padinë objekt gjykimi nga Avokatura e Shtetit.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.385, datë 09.02.2007 ka vendosur: "*Pranimin e kërkesë padisë. Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Punëve Publike dhe e Transporteve, të shpërblejë paditësin H.S. në shumën prej 5.911.136 lekë. Shpenzimet gjyqësore në masën 150.050 lekë në ngarkim të palës së paditur.*".

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ka administruar dhe praktikën dokumentare të shpronësimit dhe ka urdhëruar kryerjen e akt ekspertimit nga ku ka konkluduar për pranimin e padisë dhe vlerën konkrete të detyrimit. Në pranimin e padisë, gjykata, pasi ka pranuar të vërtetuar faktin se nga ndërtimi i superstradës Durrës-Sukth pa ndonjë akt të organeve kompetente shtetërore, paditësit i janë zënë prej saj për të dyja pasuritë 1362 m2 tokë dhe 394 m2 objekte sera, arsyeton se paditësi duhet të shpërblehet për pjesën e pronës që atij i është zënë duke u zhveshur nga pronësia prej tyre në vlerën e përcaktuar nga akt ekspertimi.

10. Lidhur me prapësimin e parashkrimit shues të padisë së dëmshpërblimit financiar për shpronësimin *de facto*, dëmshpërblimit të zhvleftësimit të pronës dhe fitimit të munguar ndër vite, gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se ky prapësim është i pabazuar në ligj dhe se si i tillë duhet

të rrëzohet. Gjykata ka arsyetuar se afati i parashkrimit për shpërblimin e dëmit jokontraktor, sipas nenit 115, shkronja "dh", të KC-s, nuk mundet të zbatohet për kërkimet e dëmshpërblimit që rrjedhin nga padia e kërkimit të sendit, sipas nenit 296 të KC-s. Sipas gjykatës së shkallës së parë kërkimet e dëmshpërblimit dhe fitimit të munguar të pronarit që i është hequr posedimi në mënyrë të paligjshme dhe që rrjedhin nga padia e rivendikimit, i nënshtrohen afatit të përgjithshëm të përcaktuar me karakter mbetës në KC. Pra kur nuk ka afate të posaçme parashkrimi, kjo do të thotë se këto padi parashkruhen brenda afatit 10 vjeçar, sipas nenit 114 të KC-s.

11. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim Avokatura e Shtetit. Në ankim është parashtruar se gjykata nuk ka respektuar ligjin kur konkludon se padia objekt gjykimi parashkruhet brenda afatit 10-vjeçar, pasi në rastin objekt gjykimi jemi para një marrëdhënieje juridike jashtëkontraktore dhe se padia ka si objekt dëmshpërblimin jashtëkontraktor. Gjykata, vijohet në ankim, duhet të kishte konstatuar se padia është parashkruar dhe se ka kaluar afati 3-vjeçar, duke konkluduar se ajo duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj. Në ankim është kërkuar ndryshimi i vendimit të shkallës së parë dhe rrëzimi i padisë.

12. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim Ministria e Punëve Publike dhe Telekomunikacionit. Ndër të tjera në ankim, edhe pse gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk ishte pretenduar, pala e paditur pretendon se gjykata ka gabuar kur ka konkluduar se padia objekt gjykimi nuk është parashkruar sipas nenit 115, shkronja "dh", të KC-s, pasi kërkimet e paditësit kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor. Në përfundimin e ankimit është kërkuar ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimi i padisë si i pabazuar në ligj dhe në prova.

13. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.10-2008-29, datë 21.02.2008 ka vendosur: "*Prishjen e vendimit civil nr.385, datë 09.02.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.*". Kështu gjykata e apelit, pa shqyrtuar çështjen në themel, ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka dërguar çështjen për rigjykim, me argumentin se në gjykim duhet të ishte thirrur, të paktën si person i tretë, dhe Këshilli i Ministrave, pasi ky është organi shtetëror që urdhëron shpronësimet.

14. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.440, datë 11.10.2011 ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr.10-2008-29, datë 21.02.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.*".

15. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjykata e apelit kishte

detyrimin e gjykimit të çështjes në themel të saj dhe se mospjesëmarrja si ndërgjyqës e Këshillit të Ministrave nuk mundet të jetë shkak për mosformim të rregullt të ndërgjyqësisë, në kushtet kur ky subjekt nuk ka lidhje me pretendimet e palës paditëse në padi. Kolegji Civil ka konkluduar se në padi nuk ka asnjë kërkim që t'i kundrejtohet Këshillit të Ministrave dhe se gjykata e apelit duhet t'i japë zgjidhje meritore çështjes, duke u shprehur në themel për bazueshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

16. Sakaq çështja është rikthyer për vazhdimin e gjykimit në Gjykatën e Apelit Durrës.

17. Me vendimin nr.220/10-2013-380, datë 19.03.2013 Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit civil nr.385, datë 09.02.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës*".

18. Gjykata e Apelit Durrës ka argumentuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në ligj dhe në prova. Gjykata ka konkluduar se pala paditëse është pronar i pjesës së pronës që është shpronësuar *de facto* nga të padituri. Gjykata ka konkluduar se në çështjen objekt gjykimi nuk provohet se kur ka marrë dijeni pala paditëse për disponimin administrativ të Këshillit të Ministrave dhe se në këto kushte nuk mund të konkludohet apriori mbi respektimin apo jo të afatit ligjor të pretenduar. Gjykata ka vlerësuar të bazuar në prova edhe masën e dëmshpërblimit nga shpronësimi. Në këtë vendim nuk ka asnjë arsyetim se përse gjykata e shkallës së parë ka konkluduar drejtë mbi çështjen nëse padia objekt gjykimi është parashkruar ose jo, duke mos u dhënë përgjigje përfundimtare kërkimeve të palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit në ankim për parashkrimin e padisë.

19. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, me datë 23.05.2013, është ushtruar rekurs nga Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Durrës, duke kërkuar ndryshuar vendimet e gjykatave të faktit dhe duke vendosur rrëzimin e padisë. [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

20. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se gjykimi në të dy shkallët nuk ka shkaqe nuliteti, sikur pretendohet në rekursin objekt gjykimi. Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i gjykatës së apelit është pjesërisht i bazuar në ligj, si për sa i përket arsyetimit ashtu dhe për mënyrën se si kanë disponuar mbi padinë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vendimet duhet të lihen në fuqi për pjesën e zbatimit të drejtë të ligjit dhe të ndryshohen për pjesën tjetër, sikurse arsyetohet në vijim.

21. Kolegji vlerëson se shkaqet e paraqitura në rekursin e Avokaturës së Shtetit, që kanë të bëjnë me mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë, për shkak

se nuk është thërritur si palë në gjykim Këshilli i Ministrave, kanë marrë zgjidhje nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 440, datë 11.10.2011. Kolegji Civil ka vlerësuar se ky shkak nuk është i bazuar në ligj dhe për rrjedhojë konstatohet se rekursuesi ka ngritur si shkak rekursi një pretendim që tashmë i është dhënë përgjigje gjyqësore me vendim gjë të gjykuar.

22. Kolegji vlerëson se pretendimet e ngritura në rekurs mbi qenien si pronar të palës paditëse, vendndodhjen e pronës, vërtetësinë e saj me atë të pasqyruar në certifikatën e pronësisë dhe masën e dëmshpërblimit, janë shkaqe që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga gjykatat e faktit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se si të tilla këto pretendime nuk mundet të jenë shkaqe të ligjshme për rekurs dhe se në të njëjtën kohë nuk mund të aktivizojnë juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë.

23. Kolegji vlerëson se shkaqet e ngritura në rekurs mbi mosrespektimin e afatit të padisë për të kundërshtuar aktin administrativ të shpronësimit apo për të kërkuar gjyqësisht masën e drejtë të kompensimit janë të pabazuara në ligj dhe si të tilla duhet të rrëzohen. Afati 60 ditor, i parashikuar nga ligji i shpronësimit për ngritjen e padisë, nuk ka lidhje me pretendimet në padinë objekt gjykimi, pasi kërkimet e padisë në gjykim pretendojnë dëmshpërblimin nga shpronësimi *de facto*, dëmshpërblimin nga rënia e vlerës së pronës dhe fitimin e munguar përkatës. Këto tre kërkime, që mund të ishin potencialisht edhe padi të veçanta, janë padi për kërkimin e dëmit që rrjedh nga marrëdhënie jashtëkontraktore dhe si të tilla afati i paraqitjes së padisë nuk mund të pretendohet se rregullohet në ligjin për shpronësimin por rregullohet në KC.

24. Çështja që duhet të marrë vëmendjen e Kolegjit vlerësohet të jetë zgjidhja e pretendimit dhe prapësimit të palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit mbi parashkrimin shues të padisë objekt gjykimi për të gjitha kërkimet e saj. Kështu rezulton se që në seancën përgatitore, e më tej në seancën gjyqësore, në konkluzionet përfundimtare, në apel dhe në rekurs, Avokatura e Shtetit ka pretenduar se padia objekt gjykimi është një padi shpërblimi dëmi të pësuar nga një fakt i paligjshëm, që rrjedh nga marrëdhënia jashtëkontraktore, dhe si e tillë afati i parashkrimit të padisë është 3 vjet, sipas parashikimit të nenit 115, shkronja "dh", të KC-s.

25. Kolegji sjell në vëmendje se rasti objekt gjykimi paraqet një padi me tri kërkime, ku pala paditëse fillimisht kërkon kompensimin e vlerës ekuivalente të pasurisë së shpronësuar *de facto* nga pala e paditur gjatë ndërtimit të rrugës, shpërblimin e dëmit për zhvlerësimin e pronës dhe fitimin e munguar. Kolegji konstaton se në zërat e dëmshpërblimit, që i janë nënshtruar debatit gjyqësor dhe për të cilat gjykatat e faktit kanë disponuar në përfundim të gjykimit, janë shpërblimi i vlerës ekuivalente të pronës së

shpronësuar *de facto* dhe kamatat ligjore të këtij detyrimi principal. Ndaj kësaj mënyre disponimi gjyqësor nuk rezulton të ketë pasur apel, apo nuk rezulton të ketë rekurs, nga pala paditëse. Për rrjedhojë, Kolegji do të përqendrohet ekskluzivisht në ligjshmërinë e këtij disponimi sipas shkaqeve të rekursit të paraqitura nga pala paditëse. Për efekte të zgjidhjes në themel të çështjes dhe për efekte të zhvillimit të jurisprudencës mbi këto çështje që shtrohen për zgjidhje, Kolegji vlerëson se të dy disponimet e gjykatave të faktit duhet të analizohen, në kuadër të prapësimit të parashkrimit shues të padisë, më vete.

26. Disponimi i parë ka të bëjë me kërkimin e padisë për të dëmshpërblyer paditësin lidhur me pjesën e pronës së shpronësuar *de facto* nga pala e paditur, gjatë ndërtimit të veprës publike. Kolegji vlerëson se ky kërkim i palës paditëse vjen si pasojë e pamundësisë së ngritjes së padisë së rivendikimit (*shiko, neni 296 i KC-s*). Kështu pala paditëse, ndodhur para faktit të shpronësimit *ultra vires* nga ana e palës së paditur në ndërtimin e rrugës, pasi sipërfaqja e shpronësuar ka dalë jashtë asaj të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave përkatës, dhe njëkohësisht ndodhur para faktit të ndërtimit të rrugës si vepër publike dhe pamundësisë së pronës për t'u kërkuar dhe kthyer, ka paraqitur padinë e shpërblimit të vlerës ekuivalente nga cenimi i së drejtës për gëzimin e qetë të pasurisë.

27. Kolegji sjell në vëmendje nenin 297 të KC-s, dispozitë që parashikon se: "*Poseduesit me mirëbesim i takojnë frutet natyrore të veçuara dhe frutet civile të vjela që janë bërë të kërkueshme deri në ditën që ka marrë dijeni se është posedues i paligjshëm, ose që i është njoftuar padia e pronarit për kërkimin e sendit. Ai nuk detyrohet të shpërblejë pronarin për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit për çdo shkak tjetër, por pas kësaj dite ai përgjigjet për frutat e vjela ose që duhet të kish vjelë, duke vepruar me përkujdesje deri në kohën e kthimit të sendit, për shpërblimin për përdorimin e sendit, si dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit për faj të tij.*". Në rastin konkret, fakti që pala e paditur ka realizuar veprën publike tej sipërfaqes së shpronësuar formalisht, do të thotë se sipërfaqja e marrë e pronës së paditësit sipas shpronësimit *de facto* nuk mundet të kthehet, sikurse parashikon neni 297 i KC-s për pamundësinë e kthimit të sendit.

28. Pala e paditur, sipas kritereve të dispozitës së sjellë në vëmendje më lart, kualifikohet si poseduese në keqbesim e pronës së paditësit, në momentin e marrjes së pronës, dhe për rrjedhojë detyrohet të përgjigjet civilisht me vlerën ekuivalente të saj kundrejt palës paditëse. Kolegji vlerëson se prezumohet se pala e paditur, e cila ka realizuar procedurën formale të shpronësimit, studimin e veprës publike dhe projektin e saj, ka pasur dijeni

lidhur me pronarin e pronës ku po ndërtohej vepra publike dhe për planin e gjurmës që zinte projekti i miratuar. Kjo do të thotë se pala e paditur ka qenë poseduese me keqbesim e pronës së shpronësuar *de facto* të palës paditëse dhe se kjo plotëson kushtin ligjor të aktivizimit të përgjegjësisë pasurore për të dëmshpërblyer palën paditëse për çdo dëm të pësuar.

29. Kolegji vlerëson gjithashtu se shpronësimi i pronës private *de facto* nga ana e shtetit, për hir të ndërtimit të një vepre publike, përbën një shkak të ligjshëm të pamundësisë së kthimit fizik të pronës, në kuptim të nenit 297 të KC-s. Shpronësimi *de facto* i pronës private është i njohur tashmë si një nga mënyrat e fitimit të pronësisë së shtetit, si në jurisprudencën evropiane dhe në atë shqiptare. Shpronësimi *de facto* përbën një nga format e ndërhyrjes së shtetit për interesa publikë në pronën private.[8]

30. Kolegji sjell në vëmendje se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)-ja, për qëllimet e zbatimit të nenit 1, Protokolli nr.1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)-së ka pranuar se shteti, edhe në rastet e shpronësimeve *de facto* është i detyruar të dëmshpërblejë pronarin e shpronësuar me vlerën ekuivalente të vlerës së pronës[9]. Gjithashtu pranohet se shpronësimi *de facto* ndryshon nga shpronësimi formal apo *de jure* në pjesën që nuk respektohen formalitetet e parashikuara nga ligji. Por në çdo rast edhe shpronësimi *de facto* juridikisht passjell fitimin e pronësisë nga shteti kundrejt pronës private, sikurse nga shpronësimi formal. Shpronësimi *de facto* është njohur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si një nga mënyrat e fitimit të pronësisë së shtetit kundrejt pronës private.[10]

31. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në rastin objekt gjykimi pala e paditur, për llogari të ndërtimit të veprës publike, ka shpronësuar *de facto* palën paditëse nga sipërfaqja e tokës në pronësi të saj, të individualizuar sipas aktit të ekspertimit. Në të njëjtën kohë pala e paditur nuk ka kompensuar palën paditëse me vlerën ekuivalente të pronës së shpronësuar *de facto*. Ndodhur para këtyre rrethanave pala paditëse nuk ka pasur mundësi të ngrejë padinë e rivendikimit, për të kërkuar sakaq lirimin dhe dorëzimin e sendit, posedimin e të cilit dhe pronësinë shteti e ka marrë jo sipas ligjit, pasi prona për shkak të zhvillimit urban është e pamundur juridikisht të kthehet. Për rrjedhojë, pala paditëse të vetmin mjet juridik që ka pasur në dispozicion për të ushtruar ka qenë kërkimi pasuror i vlerës ekuivalente të pronës së shpronësuar *de facto*.

[8] Shiko, çështjen "*Sporrong dhe* Lönnroth v. S*weden*", Aplikimi nr. 7151/75; 7152/75, Vendim i GJEDNJ-së, Strasbourg, datë 23 shtator 1982.

[9] Shiko, çështjen "*Papamichalopoulos dhe të tjerë v. Greqisë*", Vendim i GJEDNJ-së, datë 31.10.1995, Aplikimi nr.14556/89.

[10] Vendimi nr.35, datë 10.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

32. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se, kërkimi i kompensimit të vlerës së pronës së shpronësuar *de facto* dhe kërkimi pasuror i fitimit të munguar mbi këtë vlerë, janë padi për të cilat ligji civil nuk parashikon afate parashkrimi të posaçme dhe nga ana tjetër nuk parashikon as paparashkrueshmërinë e këtyre padive, që parashikohet në nenet 297 dhe 298, të KC-s. Nga ana tjetër pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit kanë pretenduar se të dy këto padi janë kërkime të shpërblimit të dëmit që rrjedhin nga marrëdhënie jashtëkontraktore dhe për rrjedhojë, do t'i nënshtrohen parashkrimit 3-vjeçar të padisë, sikurse parashikohet nga neni 115, shkronja "dh", e KC-s.

33. Kolegji vlerëson se asnjëra nga këto mënyra të interpretimit të ligjit nuk është e bazuar në ligj. Padia e kërkimit pasuror të kompensimit të vlerës ekuivalente të sendit të shpronësuar *de facto* lind si pasojë e pamundësimit të ngritjes së padisë së rivendikimit, për shkak se sendi është humbur, shkatërruar apo nuk mundet të kthehet për shkaqe të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 297 të KC-s. Kolegji vlerëson se në këto raste padia e kompensimit me vlerën ekuivalente të sendit nuk është gjë tjetër veçse mjeti alternativ i mbrojtjes së të drejtës kushtetuese dhe themelore të pronësisë, në kushtet e pamundësisë së ngritjes së padisë së rivendikimit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se, edhe për shkak të rregullimit ligjor të njëjtë në dispozitat e KC-s që normojnë mbrojtjen e pronësisë me padinë e rivendikimit, regjimi juridik i padisë së rivendikimit do të ndjekë edhe regjimin juridik të padisë që rrjedh nga pamundësia e ushtrimit të saj, konkretisht padisë së kompensimit të vlerës ekuivalente të pronës, e cila për shkaqe të parashikuara nga neni 297 i KC-s nuk mund të kthehet fizikisht.

34. Kolegji sjell në vëmendje unifikimin e praktikës gjyqësore të bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendimin nr.5, datë 31.05.2011, ku është konkluduar ndër të tjera se: [...] *Padia e kërkimit të sendit, parashikuar nga neni 296 i KC-s, nga natyra e saj është një padi e pa parashkrueshme.*".

35. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se, duke pasur parasysh natyrën juridike dhe mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronësisë, nuk mundet të pranohet si i bazuar në ligj interpretimi dhe pretendimi se kompensimi i vlerës ekuivalente të sendit, i pamundur për t'u kthyer me padinë e rivendikimit, parashkruhet brenda tre vjetëve, si padi dëmshpërblimi që rrjedh nga marrëdhëniet kontraktore. Po ashtu, njëlloj i papranueshëm është edhe interpretimi dhe konkluzioni që bëjnë gjykatat e faktit, se padia e kompensimit të vlerës ekuivalente e sendit, i pamundur për t'u kthyer me padinë e rivendikimit, në mungesën e parashikimit të posaçëm ligjor mbi afatin e parashkrimit dhe në mungesën e parashikimit ligjor

mbi paparashkrueshmërinë e kësaj të drejte, parashkruhet sipas afatit të përgjithshëm dhe 10-vjeçar, të parashikuar nga neni 114 i KC-s.

36. Kolegji vlerëson se secili prej këtyre interpretimeve do të vinte një barrë joproporcionale mbi të drejtat e pronësisë së pronarëve privatë, pasi atyre fillimisht iu është marrë prona në mënyrë formalisht të paligjshme. Më tej, për shkak të ndërtimit të një vepre publike, iu është pamundësuar ushtrimi i mjetit kryesor real të mbrojtjes së pronësisë, konkretisht padisë së rivendikimit, dhe më tej ligji do t'i vendoste afat ngritjes së padisë së vetme të mundshme për të mbrojtur të drejtat e cenuara. Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit do të vinte në kundërshtim me kriteret kushtetuese, test universal i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës. Njëlloj sikur padia e rivendikimit, në kushtet e pamundësisë së ushtrimit të saj, sipas nenit 297 të KC-s, edhe padia e kompensimit të vlerës ekuivalente e sendit të pakthyeshëm është e paparashkrueshme. Për rrjedhojë, pjesa e vendimeve të gjykatave të faktit që kanë pranuar këtë pjesë të padisë, do të lihet në fuqi, por me arsyetimin si më lart.

37. Kolegji tashmë mbetet të vlerësojë nëse padia e fitimit të munguar apo ajo nëpërmjet së cilës kërkohen kamatëvonesat parashkruhet apo jo. Kolegji vlerëson se, nëse padia e kompensimit financiar të vlerës ekuivalente të sendit të pamundur për t'u kthyer, në kuptim të nenit 297 të KC-s, është zgjatimi dhe transformimi juridik i padisë së rivendikimit për shkak të pamundësisë së ngritjes, padia e fitimit të munguar apo e kamatave ligjore, edhe kur ato rrjedhin nga detyrimi i mësipërm, nuk kanë lidhje me padinë e rivendikimin. Kolegji vlerëson se këto kërkime kanë karakter të prejardhur dhe dytësor dhe u nënshtrohen rregullimeve të parashikuara në KC. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se këto kërkime nuk mund të ndjekin regjimin juridik të padisë së rivendikimit dhe nuk mund të konkludohet se nuk u nënshtrohen afateve të parashkrimit shues të padisë.

38. Si fitimi i munguar, ashtu edhe kamata ligjore janë forma të posaçme të dëmit pasuror dhe për rrjedhojë, edhe mënyra të posaçme të dëmshpërblimit pasuror që rrjedh nga marrëdhëniet jashtëkontraktore. Për rrjedhojë, Kolegji arrin në përfundimin se, duke qenë se këto padi rrjedhin nga marrëdhëniet jashtëkontraktore të dëmshpërblimit pasuror, gjykatat e faktit duhet të kishin vlerësuar se afati i parashkrimit për të gjitha kërkimet pasurore të tilla parashkruhen brenda tre vjetëve nga momenti i lindjes së të drejtës së padisë, sipas nenit 115, shkronja "dh" dhe 120, të KC-s.

39. Kolegji vlerëson se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë dhe vendimi i gjykatës së apelit për këtë pjesë janë zbatim i gabuar i neneve 114 dhe 115, të KC-s. Kolegji vlerëson se zbatimi i afatit të përgjithshëm të parashkrimit

shues të padisë bëhet me karakter mbetës dhe shterues njëkohësisht, që do të thotë se në çdo rast kur ligji hesht për afatin e paraqitjes së një padie në gjykatë, atëherë do të veprojë neni 114 i KC-s dhe konkretisht afati i përgjithshëm i padisë. Neni 114 i KC-s parashikon se: "*Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë.*".

40. Në rastin konkret pala paditëse në objektin e padisë kërkon fitimin e munguar, sipas vlerës së normës së interesit bankar të detyrimit principal, nga viti 1999 e deri në momentin kur ka përllogaritur eksperti. Në vlerësimin e kolegjit ky kërkim rrjedh nga një marrëdhënie jashtëkontraktore, që do të thotë se parashkrimi shues i tyre do të rregullohet sipas nenit 115, shkronja "dh", që përcakton se: "Parashkruhen brenda afateve prej: dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë.". Kolegji sjell në vëmendje se lindja e së drejtës së padisë së dëmshpërblimit nga marrëdhëniet jashtëkontraktore rregullohet në nenin 120 të KC-s, ku kjo dispozitë parashikon se: "Për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar.".

41. Në rastin konkret shpronësimi i palës paditëse është bërë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.747, datë 26.11.1998 dhe shpronësimi është bërë në favor të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Kolegji sjell në vëmendje se shpronësimi parashikohej të përfundonte deri më datë 30.06.1999 dhe se vërtetimi i këtij fakti nuk është kontestuar nga asnjëra prej palëve në të gjithë gjykimin. Kolegji gjithashtu sjell në vëmendje se pala paditëse përgjatë gjykimit ka pranuar se është dëmshpërblyer financiarisht për shpronësimin formal në vitin 1999. Ndërkohë padia është paraqitur në gjykatën e shkallës së parë me datë 22.05.2006. Kolegji konstaton se minimalisht padia për fitimin e munguar ka nisur të ecë pas lindjes së të drejtës së padisë për kompensimin e vlerës ekuivalente të sendit të pamundur për t'u kthyer, sipas nenit 297 të KC-s. Konkretisht, në momentin e përfundimit të punimeve të ndërtimit të veprës publike dhe shpronësimit *de facto*. Nga gjithçka u arsyetua më lart, Kolegji vlerëson se ky kërkim i padisë dhe disponimet e të dy gjykatave të faktit mbi të janë pjesërisht të bazuara në ligj. Kolegji vlerëson se kërkimi i fitimit të munguar nga principali i detyrimit, e për rrjedhojë edhe disponimet e të dy gjykatave të faktit mbi të, duhet të lihen në fuqi vetëm për tre vitet e fundit nga momenti i ngritjes së padisë. Padia për pjesën tjetër të këtij kërkimi duhet të rrëzohet si e parashkruar.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-872, datë 18.04.2017

Në përputhje me parimin kushtetues të pavarësisë së gjyqtarit, veprimtaria gjyqësore si dhe bazueshmëria në ligj dhe në prova e vendimeve gjyqësore nuk mund të përbëjë lëndë shqyrtimi për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që mund të vlerësojë vetëm aspekte formale të punës së një gjyqtari që lidhen me procedimin disiplinor dhe që nuk mund të jenë objekt vlerësimi nga një organ tjetër.

I. Rrethanat e çështjes

1.Nga hetimi gjyqësor i çështjes, i zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit, rezulton se paditësja L.H. aktualisht kryen detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

3. Ministri i Drejtësisë, me shkresën nr.42 prot., datë 08.01.2013, i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për procedimin disiplinor ndaj paditëses. Kjo kërkesë është bazuar në shkeljet e konstatuara nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, në inspektimin e kryer në zbatim të urdhrit nr.379, datë 13.08.2012, "*Për ushtrim inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatën e Apelit Shkodër*", në datat 14.08.2012 dhe 15.08.2012, ku objekt ka qenë verifikimi i procedurave gjyqësore të zbatuara gjatë gjykimit të tri çështjeve penale në ngarkim të të dënuarit S.K..

4. Nga konkluzionet e arritura gjatë procedimit administrativ rezulton se, sipas raportit të inspektimit në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit S.K., gjyqtarja, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka anashkaluar kriteret e përgjithshme (*neni 229/1/2 i Kodit të Procedurës Penale (KPP)-s*), ashtu dhe kriteret e veçanta (*neni 230/1 i KPP-s*), pa bërë analizë konkrete të rrethanave të faktit mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale. Nga pala e paditur veprimet e gjyqtares janë konsideruar se, kanë sjellë pasoja të pariparueshme për administrimin e drejtësisë, sepse ka dhënë vendim haptazi të padrejtë dhe në kundërshtim me frymën e ndjekjes së parimit të ligjshmërisë së caktimit të masave të sigurimit, parashikuar nga nenet 228, paragrafi 3, dhe 230 i KPP-s.

5. Gjithashtu, në kërkesë, ministri i Drejtësisë i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, bashkimin e saj, me kërkesën për procedim disiplinor

dërguar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr.239/11, datë 30.10.2012, me anë të së cilës përsëri Ministri i Drejtësisë ka kërkuar procedimin disiplinor të paditëses, pasi ajo ka rezultuar me shkelje të ligjit gjatë inspektimit të ushtruar në zbatim të urdhrit nr.239, datë 05.06.2012 "*Për ushtrimin e kontrollit në Prokuroritë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Fier, Vlorë e Shkodër, si dhe në Gjykatat e Apelit Vlorë e Shkodër*". Në referim të konkluzioneve të arritura nga ky kontroll del se gjyqtarja znj. L.H., rezulton të ketë mangësi në lidhje me dorëzimin në afat të 2 vendimeve penale (masë sigurimi), përkatësisht vendimi nr.137, datë 30.05.2011, dhe vendimi nr.89, datë 06.04.2011, të Gjykatës së Apelit Shkodër. [...]

6. Këto shkelje, referuar nenit 32, pika 3, të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", janë konsideruar nga Ministri i Drejtësisë, si shkelje të rënda të disiplinës nga gjyqtarja znj. L.H.. Për rrjedhojë, në përfundim të këtij inspektimi, me aktin nr.239/11, datë 30.10.2012, Ministri i Drejtësisë i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, procedimin disiplinor të gjyqtares së Gjykatës së Apelit Shkodër, znj. L.H., si dhe caktimin e masës "*Ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër*" ndaj saj, e parashikuar nga neni 33/1, shkronja "c", të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Para votimit, Ministri i Drejtësisë ka kërkuar ndryshimin e masës, duke kërkuar dhënien e masës disiplinore "*Vërejtje me paralajmërim*".

7. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur bashkimin e dy procedimeve disiplinore të veçanta ndaj gjyqtares në një të vetëm. Me shkresën nr.1843, datë 23.05.2014, gjyqtarja znj. L.H., është njoftuar se kërkesa e ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj saj, do të shqyrtohej në mbledhjen që do zhvillohej më datë 28.05.2014. Në këtë datë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar kërkesën për dhënie mase disiplinore ndaj gjyqtares.

8. Me vendimin br.62, datë 28.05.2014, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: *"Pranimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore ndaj gjyqtares të Gjykatës së Apelit Shkodër L.H.. Dhënien e masës disiplinore "Vërejtje" ndaj gjyqtares së Gjykatës së Apelit Shkodër znj. L.H..*". [...].

13. Kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në datën 03.07.2014, ka paraqitur padi znj. L.H. në Gjykatën Administrative të Apelit. Paditësja ka pretenduar se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk ka mbajtur parasysh se përgjatë dy viteve pala paditëse ka gjykuar 20 çështje në ditë në gjykatën e saj dhe se ka gjykuar në 2 – 3 gjykata njëherësh, për shkak të komandimeve. Paditësja ka pretenduar se vonesa në dorëzimin e dy vendimeve nuk ka ardhur si pasojë e neglizhencës apo veprimeve të

qëllimshme, por vetëm për pamundësi objektive. Gjithashtu, pretendimi se në një vendim gjyqësor është marrë një masë sigurimi në kundërshtim me kërkesat procedurale, sipas paditëses është i rremë.

14. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr.21, datë 24.11.2014, ka vendosur: "*Rrëzimin e padisë.*". [...].

21. Kundër vendimit nr.21 datë 24.11.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs pala paditëse L.H., e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, duke parashtruar shkaqet e prezantuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

22. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në vlerësim të rrethanave të faktit, siç kanë rezultuar të provuara në gjykimin e zhvilluar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila në këtë rast ushtron juridiksion fillestar, çmon se kjo gjykatë u ka dhënë një përgjigje ezauruese të gjitha pretendimeve të paditëses, duke bërë një analizë të saktë të fakteve dhe interpretim korrekt të ligjit material.

23. Rezulton se ndaj paditëses është marrë masa disiplinore "vërejtje", për shkak të dorëzimit me vonesë, tej afateve procedurale të dy dosjeve gjyqësore si dhe për shkak të mosvlerësimit të drejtë prej saj të kritereve të përgjithshme dhe të veçanta në caktimin e masave të sigurimit. Në këto rrethana, paditësja e ka kundërshtuar vendimin e palës së paditur, si në lidhje me bazueshmërinë në ligj dhe në fakte të masës disiplinore të dhënë ashtu edhe për sa i përket procedurës së zhvilluar nga organi që ushtron ndjekjen disiplinore, ministri i Drejtësisë si dhe organi që zhvillon procedimin disiplinor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

24. Gjykata e Administrative e Apelit, pasi ka shqyrtuar pretendimet dhe prapësimet e palëve ka vendosur të rrëzojë padinë, duke konstatuar se masa disiplinore e dhënë i përgjigjet shkeljes së kryer dhe në të njëjtën kohë nuk ka konstatuar shkelje të procesit të rregullt ligjor gjatë procedimit disiplinor të zhvilluar ndaj paditëses në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

25. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se pretendimet e parashtruara nga paditësja në rekursin e saj nuk gjejnë asnjë mbështetje në aktet e fashikullit gjyqësor. Gjykata Administrative e Apelit rezulton që t'u ketë dhënë më parë përgjigje këtyre pretendimeve.

26. Konkretisht, paditësja pretendon se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor, duke cenuar parimin e kontradiktoritetit si dhe të drejtën e mbrojtjes, ka cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, e ka zhvilluar procedimin administrativ tej afateve ligjore si dhe ka ndryshuar

shkakun dhe objektin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë.

27. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se e drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një garanci e cila duhet të gjejë zbatim jo vetëm në procedurat gjyqësore por në çdo procedurë, në të cilën potencialisht mund të cenohen të drejtat dhe liritë themelore të personave. Neni 42/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se: *Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*.

28. Në lidhje me shtrirjen e garancive të procesit të rregullt ligjor edhe në procedura të ndryshme nga ato gjyqësore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është shprehur se: *Gjykata Kushtetuese konstaton se në çdo rast Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendos standardet e domosdoshme dhe garancitë që çdo shtet kontraktues duhet të sigurojë për të realizuar një proces të rregullt ligjor dhe jo rrethin e personave që duhet të përfitojnë prej saj. Ajo çmon se procesi i rregullt ligjor zbatohet për të gjitha konfliktet që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi qoftë ai edhe funksionar publik. Pra, Gjykata Kushtetuese e shikon pozicionin e funksionarit publik në këndvështrimin e garancive që i siguron Kushtetuta, jurisprudenca e saj e deritanishme dhe fryma e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Kushtetuese ka parasysh edhe dallimin që ekziston ndërmjet nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 42/1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal apo civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ, siç është rasti në shqyrtim (shih vendimin nr. 76, datë 25.04.2002, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë)*.

29. Në vlerësim të respektimit të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor Gjykata e Lartë ka juridiksion të plotë, pra ajo nuk bën vetëm një vlerësim të bazueshmërisë në ligj të këtyre pretendimeve por e shqyrton çështjen *de plano*, duke hetuar mbi materialet e fashikullit, të administruara nga gjykatat e faktit.

30. Në çështjen në shqyrtim konstatohet se asnjë prej pretendimeve të paditëses nuk gjen mbështetje në dokumentet e marra si prova në gjykim. Nga ana tjetër, këtyre pretendimeve u është dhënë përgjigje ezauruese nga Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj nr.21, datë 24.11.2014, dhe për këtë shkak Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të mos ndalet, duke përsëritur të njëjtat argumente të dhëna nga gjykata e apelit, por, si një gjykatë rishikimi, mjaftohet me konstatimin e bazueshmërisë së vendimit të ankimuar

dhe mjaftueshmërisë së argumenteve të dhëna nga gjykata më e ulët.

31. Paditësja pretendon se arsyetimi i vendimit nr.21, datë 24.11.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit nuk është bazuar në rrethanat e faktit, por është edhe jologjik. Edhe ky pretendim i paditëses rezulton të jetë haptazi i pabazuar.

32. Arsyetimi i vendimit përbën një nga elementët e procesit të rregullt gjyqësor, pasi përmes tij palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces mund të njihen me argumentet mbi të cilat gjykata e ka mbështetur vendimmarrjen e saj dhe kanë mundësinë më tej për të parashtruar kundërshtimet e tyre në gjykatat e një niveli më të lartë. Nga ana tjetër, arsyetimi i vendimit është një mjet me të cilin publiku i gjerë njihet me mënyrën e administrimit të drejtësisë nga gjykatat, duke ushtruar kontrollin e tij mbi respektimin e parimit të shtetit të së drejtës.

33. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (shih, vendimet nr.8, datë 16.03.2011; nr.23, datë 04.11.2008; nr.11, datë 02.04.2008 dhe nr.7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

34. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (shih, vendimet nr.20, datë 13.04.2012 dhe nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

35. Nga ana tjetër, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke iu referuar procesit të drejtë garantuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se: *Shtetet gëzojnë liri të konsiderueshme në përzgjedhjen e mjeteve të përshtatshme, të cilat do të garantonin që sistemi i tyre juridik të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës. Megjithatë, gjykatat kombëtare duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi i tyre (shih, çështjen Haxhianastasiu kundër Greqisë, kërkesa. 12945, datë. 16.12.1992 si dhe çështjen Balani kundër Spanjës, kërkesa. 18064/91, datë 09.12.1994).*

36. Rezulton se vendimi nr. 21, datë 24.11.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit, i përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar. Kjo gjykatë pasi ka parashtruar rrethanat e faktit ka analizuar provat dhe dispozitat ligjore të zbatueshme, duke qenë në përputhje me elementët e përcaktuar në nenin 310 të KPC-s. Gjithashtu, përfundimet e arritura prej saj në këtë vendim, mbështeten mjaftueshëm nga argumentet e dhëna në pjesën arsyetuese, të cilat janë në kohezion me njëra tjetrën, duke dhënë një panoramë të qartë të çështjes dhe zgjidhjes së ofruar nga gjykata.

37. Për sa i përket themelit të pretendimeve të paditëses, masës disiplinore "vërejtje" dhënë ndaj saj nga ana e palës së paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 62, date 28.05.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se kjo masë është në përputhje me rëndësinë e shkeljes së kryer nga paditësja dhe për këtë arsye, me të drejtë Gjykata Administrative e Apelit vendosi rrëzimin e padisë, me vendimin e saj nr.21, datë 24.11.2014.

38. Nga inspektimi i kryer nga ana e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, në zbatim të urdhrit nr.239, datë 05.06.2012 "*Për ushtrimin e kontrollit në Prokuroritë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Fier, Vlorë e Shkodër, si dhe në Gjykatat e Apelit Vlorë e Shkodër*", ka rezultuar se paditësja ka dorëzuar me vonesë dy dosje penale (masë sigurimi), përkatësisht në afatet 7 muaj e 17 ditë dhe 9 muaj e 11 ditë. Si rezultat, është konsideruar se paditësja ka kryer akte dhe sjellje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, në përputhje me nenin 32, paragrafi IV, shkronja "ç", ttë ligjit nr.9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Për këtë shkak, ndaj paditëses është dhënë masa disiplinore "vërejtje".

39. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka mbajtur në konsideratë drejt faktin që i atribuohet paditëses dhe ka dhënë një masë disiplinore në përpjesëtim me shkeljen e kryer.

40. Në këtë kuadër, neni 32, paragrafi IV, shkronja "ç", të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e

Shqipërisë", parashikon se: *1. Shkeljet e disiplinës së gjyqtarit ndahen në: a) shumë të rënda; b) të rënda; c) të lehta. ... 4. Janë shkelje të lehta aktet dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë: ... ç) akte dhe sjellje të tjera që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.*

41. Në lidhje me shkeljet e kryera nga gjyqtari në kryerjen e detyrës, neni 33 i këtij ligji sanksionon masat disiplinore që jepen, në përputhje me natyrën e rëndësisë së shkeljes së kryer. Kjo dispozitë përcakton se: *1. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 2. Masat disiplinore janë: a) vërejtje; b) vërejtje me paralajmërim; c) ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët; ç) dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij; d) shkarkim nga detyra. ... 5. Për shkeljet e lehta, të parashikuara në nenin 32, pika 4, të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të këtij neni.*

42. Ky Kolegj, duke i marrë të provuara shkeljet disiplinore të kryera nga paditësja, ashtu sikurse janë konstatuar nga Gjykata Administrative e Apelit, siç u përshkruan më sipër, vlerëson se masa disiplinore e dhënë ndaj saj ka qenë proporcionale me rëndësinë e shkeljes së kryer.

43. Koha prej 7 muaj e 17 ditë dhe 9 muaj e 11 ditë, e kaluar nga momenti i dhënies së vendimeve e deri në dorëzimin e këtyre vendimeve të arsyetuara në sekretari, është pakrahasimisht e gjatë në raport me afatin ligjor prej 5 ditësh të përcaktuar në nenin 113 të KPP-s. Në këtë kontekst, një afat i tillë nuk mund të justifikohet as me faktin se paditësja ka pasur ngarkesë të madhe në punë. Një argument i tillë do të merrej në konsideratë nëse paditësja do të kishte disa vendime të dorëzuara në sekretari jashtë afateve ligjore dhe gjithsesi jo në këto ekstremitete.

44. Në këtë drejtim, gjykata çmon t'u referohet edhe përfundimeve të arritura nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin e tyre nr.5, datë 12.12.2013, me objekt kundërshtimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore "shkarkim nga detyra" ndaj gjyqtarit. Në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur si vijon:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se respektimi i dispozitave procedurale të cilat lidhen me dorëzimin e vendimeve brenda një afati te arsyeshëm, në mënyrë që të mos cenohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është e lidhur drejtpërsëdrejti me respektimin e parimit të zhvillimit dhe përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Referuar parimeve të së drejtës vendase dhe ndërkombëtare, me afat të arsyeshëm ligjor do të kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në dhënien/shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut kërkon garantimin e procesit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore për përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin, etj.,. Afati i arsyeshëm që merret në konsideratë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi merr formë të prerë.

Pas shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljes së vendimit, gjykata duhet të marrë një kohë të arsyeshme për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimit në sekretari, e cila ka për detyrë të njoftojë palët e interesuara për të marrë dijeni si dhe për të marrë kopjen e vendimit. Eficienca në drejtësi është një kriter i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe për rivendosjen e të drejtave të palëve të pretenduara të shkelura.

Afati brenda të cilit duhet të dorëzohen vendimet e arsyetuara është përcaktuar dhe në dispozitat procedurale si neni 308 i KPC-s, nenet 113, 179, e 386 të KPP-s. Por pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre; dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve nga ana e KLD-s.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund të pengojnë ata në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë: ngarkesa e madhe në punë, kompleksiteti i çështjeve në ngarkim, sjellja e palëve gjatë procesit, pamundësia objektive e gjykatave për zhvillimin e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuara shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë atë të ushtrojë detyrën e tij, etj.,.

Por dhe duke marrë në konsideratë shkaqet e mësipërme objektive (në rast se ato ekzistojnë), Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimet gjyqësore duhet të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm.

Në çdo rast duhet të gjenden zgjidhje ligjore brenda institucionit në mënyrë që dorëzimi i tyre të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo ato të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të padorëzuara, sepse vonesa të tilla ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces pasi u cenohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor degradon në një proces jo efektiv.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në konkluzionin e mësipërm duke marrë në konsideratë jo vetëm normat procedurale të së drejtës sonë të brendshme, (penale dhe civile), praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, por dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së si dhe legjislacionet e vendeve perëndimore, të cilat kanë trajtuar këtë problem.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vazhdim të analizës së mësipërme, vlerësojnë të theksojnë dhe njëherë se jo në çdo rast mosrespektimi i afateve procedurale të përmendura më lart e çon gjyqtarin përpara procedimit disiplinor. Jo në çdo rast shkeljet që konstatohen në veprimtarinë e gjyqtarit dhe në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e tij për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohen si shkelje që kanë çuar në humbjen e besimit dhe kredibilitetit ndaj gjyqtarit apo akte që kanë diskretituar rëndë figurën dhe sjelljen e tij. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tilla që kalojnë "kufirin e të arsyeshmes", dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, duke çuar në cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

45. *Nga jurisprudenca e GJEDNJ-së konstatohet se kjo gjykatë në shumë çështje e ka konsideruar vonesën në arsyetimin e vendimeve gjyqësore si cenim të procesit të rregullt ligjor (shih, vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut PGV kundër Italisë, vendimi i GJEDNJ-së, i datës 07.11.2000; Çështja X kundër Francës, 1998; Vocaturo kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K.Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097).*

46. Në referim të vendimeve të kësaj gjykate, por edhe praktikës së saj në përgjithësi "case law", gjykatat kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm "të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm". Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj "vonesave të tepruara procedurale", që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Drejtësia e vonuar është e

njëjtë me drejtësinë e mohuar (Magna Carta). Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Siç edhe është parashtruar më sipër në këtë vendim, në çështjet gjyqësore periudha e arsyeshme që merret në konsideratë për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi i arsyetuar merr formë të prerë.

47. Procesi gjyqësor në vetvete mund të ndahet në dy segmente kohore: (1) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimet procedurale që duhet të ndërmarrin palët në proces; dhe (2) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e gjyqtarit, duke zbritur nga e gjithë kohëzgjatja reale e procesit gjyqësor afatin kohor "që i atribuohet gjyqtarit" dhe aparatit gjyqësor për mbylljen përfundimtare të procesit. Jo e gjithë periudha kohore që i atribuohet gjyqtarit brenda një procesi gjyqësor (si pjesë e punës së tij), në kuptimin e përmendur më sipër, mund të konsiderohet automatikisht si tej afatit të arsyeshëm. Në fakt, çdo proces gjyqësor, edhe ai proces që kryhet dhe përfundon "shpejt" ka kohëzgjatjen e tij normale që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë si me kryerjen e disa fazave procedurale, ashtu dhe me gjykimet e çështjeve në disa nivele gjykatash (sipas rastit). Në mënyrë që afatet kohore të konsiderohen të paarsyeshme nuk mjafton vetëm të merret për bazë e gjithë kohëzgjatja reale e procesit, por duhen verifikuar rast pas rasti veprimet konkrete që janë ndërmarrë në kuadër të këtij procesi dhe nëse këto veprime justifikojnë apo jo vonesën dhe neglizhencën e gjyqtarit (shih, vendimin nr.1921, datë 03.02.2004, të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë).

48. *Në çdo rast kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkaluar për sa kohë vonesa cenon të drejtën e palëve për të pasur një proces që zhvillohet brenda afateve të arsyeshme sipas nenit 6, prg. 1 të KDENJ-s"; Për sa i takon pretendimit për numrin e çështjeve dhe përmasave të vonesës në këto çështje, kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkaluar në momentin që sjellja e gjyqtarit (pra faji i tij) ka të bëjë me paaftësinë e tij organizatore për të kryer në mënyrën e kërkuar, detyrën e gjyqtarit" (shih, vendimin nr.1768, datë 25.01.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë).*

49. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se nga ana Këshillit të Lartë të Drejtësisë në rastin në shqyrtim është dhënë masa më e lehtë disiplinore e parashikuar në nenin neni 32 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", çka është e përshtatshme në raport me shkeljen e kryer.

50. Siç u theksua më lart, arsyetimi i vendimit është jo vetëm mjeti që u lejon palëve të njihen me argumentet e dhëna nga gjykata në zgjidhjen e çështjes, me qëllim ushtrimin e të drejtës së mbrojtjes në shkallët më të larta por edhe një mënyrë e kontrollit të miradministrimit të drejtësisë nga publiku i gjerë, me qëllim forcimin e besimit të tij në organet e dhënies së drejtësisë. Mungesa e arsyeve mbi të cilat bazohet vendimi për një afat të gjatë cenon thelbin e të drejtës së ankimit, të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës.

51. Tej argumenteve të dhëna më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në çështjen në shqyrtim, ka tejkaluar kompetencat e tij kur ka shqyrtuar meritat e zgjidhjes së një prej gjykimeve penale që ka pasur për shqyrtim paditësja, me objekt caktim mase sigurimi. Një fakt i tillë është vënë në dukje edhe nga Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj nr.21, datë 24.11.2014.

52. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i tërheq vëmendjen Këshillit të Lartë të Drejtësisë se, nuk është në misionin e këtij organi kushtetues të vlerësojë bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimeve gjyqësore, qofshin këto të formës së prerë ose jo. Si një organ që procedon disiplinarisht gjyqtarët, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të vlerësojë vetëm aspekte formale të punës së një gjyqtari (si p.sh. respektimi i solemnitetit në gjykim, i etikës gjatë dhe pas kohës së punës, frekuentimi i rregullt i punës, moszvarritja e pajustifikuar e gjykimit të çështjeve, mosndikimi tek kolegët në kryerjen e detyrës, mospërfshirja në veprimtari që cenojnë paanësinë e gjyqtarit, gjatë dhe jashtë seancës gjyqësore, mospërfshirja në veprimtari që cenojnë integritetin e funksionit dhe besimin e publikut tek organet e drejtësisë, mospengimi i kolegëve, administratës ose inspektorëve në kryerjen e detyrës, etj.,), të cilat nuk mund të jenë objekt i një vlerësimi të ndryshëm, nga një organ tjetër.

53. Çdo veprimtari gjyqësore, duke përfshirë edhe vendimmarrjen, e cila është objekt i kontrollit nga një gjykatë më e lartë nuk mund të përbëjë lëndë shqyrtimi për Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Një qëndrim i kundërt do të përbënte shkelje të parimit kushtetues të pavarësisë së gjyqtarit.

54. Në nenin 145/1 të Kushtetutës parashikohet se: "*Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*". Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007). Gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për funksionin e dhënies së drejtësisë. Asnjë institucion tjetër shtetëror apo zyrtar publik, përveç gjykatave

të pavarura, nuk mund ta ushtrojë këtë funksion. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e organeve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve (shih vendimet nr.11, datë 02.04.2008; nr.11, datë 06.04.2010; nr.5, datë 16.02.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

55. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësia e gjyqësorit kuptohet si pavarësi substanciale, që do të thotë "liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit"; pavarësi strukturale që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij; pavarësi organizative që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave; pavarësi financiare që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit etj.; si dhe pavarësi personale, që kërkon emërim në bazë të kritereve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor (shih, vendimet nr.11, datë 06.04.2010; nr.5, datë 16.02.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

56. Në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor duhet të jetë edhe statusi ligjor i gjyqtarëve. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, masat disiplinore pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre (shih, vendimet nr.11, datë 02.04.2008; nr.26, datë 24.07.2009; nr.5, datë 16.02.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

57. Gjykata rithekson se parimi i pavarësisë së gjyqtarëve është i përfshirë në një sërë dokumentesh ndërkombëtare të cilat identifikojnë parimet bazë të pavarësisë së gjyqësorit, si p.sh. se gjyqtari duhet të ketë autoritetin për të vendosur për çështjet i lirë nga çdo ndërhyrje; ndarja e pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit të përfshihen në rendin kushtetues; gjykatat dhe gjyqtarët duhet të kenë pavarësi administrative dhe të përfshihen në procesin buxhetor; mbrojtja e gjyqtarëve nga shfuqizimi arbitrar ose rishikimi i vendimeve të tyre duhet të jetë i garantuar; pavarësia ndërinstitucionale, që është e drejta e gjyqtarëve për të marrë vendime pa ndërhyrje të papërshtatshme nga gjykatat më të larta etj., (shih, vendimin nr.11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

58. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 135 të saj ka parashikuar ushtrimin e pushtetit gjyqësor në tri shkallë, ku procedura dhe vendimet e shkallëve më të ulëta janë objekt i shqyrtimit nga një gjykatë më e lartë. Kjo ka dy funksione. *Së pari*, përbën një filtër, në mënyrë që marzhi i gabimit gjyqësor të jetë sa më i vogël, duke qenë se pushteti gjyqësor është porta e fundit në garantimin e shtetit të së drejtës dhe, *së dyti*, përbën një

mburojë për pavarësinë funksionale (pavarësinë substanciale) të gjyqtarëve, duke qenë se gabimet e tyre janë të korrigjueshme brenda sistemit dhe si rrjedhojë logjike ato nuk mund të ndëshkohen për akte të cilat ende nuk përbëjnë produkt përfundimtar të pushtetit të cilit i përkasin.

59. Gjithashtu, nëse bëhen gabime nga gjyqtarët apo nga gjykatat në zbatimin e ligjit, kjo mund të korrigjohet nëpërmjet mjeteve ligjore që disponohen nga pjesëmarrësit në proces, jo përmes ndërhyrjes nga gjyqtarët e niveleve më të larta ose nga persona apo organe të tjerë. Gjyqtarët janë të garantuar nga imuniteti funksional. Mjeti për ndreqjen e gabimeve gjyqësore duhet të mbështetet në një sistem të përshtatshëm apelimesh (shih, mendimi i ndërmjetëm i Komisionit të Venecias nr.600/2010, mbi projektligjin "Për Këshillin e Lartë të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Turqisë", Strasburg, 20 dhjetor 2010).

60. Ndryshimi apo prishja e një vendimi të një gjykate nga një gjykatë më e lartë, në vetvete, nuk mund të përbëjë bazë të mjaftueshme për ndjekjen disiplinore të gjyqtarëve, nëse nuk shoqërohet me akte dhe sjellje të tjera, të cilat venë në diskutim dinjitetin e detyrës. Cenimi i vendimmarrjes është objekt i një vlerësimi të ndryshëm nga procedimi disiplinor. Ajo merret në konsideratë në vlerësimin profesional të gjyqtarit dhe për këtë shkak nuk mund të përfshihet dy herë në sitën e analizës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

61. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë por edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në disa vendime të tyre, të cilat lidhen me procedimin disiplinor të gjyqtarëve, kanë theksuar rëndësinë që ka pavarësia substanciale (pavarësia funksionale) e gjyqtarëve si dhe kanë delimituar kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

62. Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së gjyqtarëve është mospërgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në Kushtetutë dhe në ligje. Megjithatë, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria u jep gjyqtarëve është e tillë që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur gjyqtarët përgjegjës, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim. Për shkelje të funksioneve të tyre gjyqtarët mund të mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe penale. Bazuar në nenin 147 të Kushtetutës, gjyqtarët shkarkohen nga detyra nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Sjellja e një gjyqtari lidhur me veprimtarinë e tij, për detyrat e tij funksionale, si dhe për veprimtarinë e tij jashtë detyrës, nuk duhet të krijojë dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.

Gjykata çmon se në vendimmarrje, gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të aftë të veprojnë pa ndikim të papërshtatshëm, presione, kërcënime ose ndërhyrje, të drejtpërdrejta ose jo, nga kushdo dhe për çfarëdo arsye.

Gjyqtarët duhet të kenë liri të plotë për t'i vendosur rastet me paanësi, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin e tyre për faktet dhe në zbatim të normave të së drejtës.

Gjykata është shprehur se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë (shih, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nr.11, datë 27.05.2004 dhe nr.11, datë 02.04.2008).

63. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr.7/2006, shprehen se: *"Në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë si shkelje që konsistojnë në veprime që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe që sipas tij në vetvete përbëjnë akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, përmenden 10 vendime gjyqësore me shkelje të ligjit material apo procedural të nxjerra nga periudha e kontrolluar 2001 - 2004. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka të drejtë t'i interpretojë vendimet gjyqësore në mënyrë negative, për të ngarkuar me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin që ka qenë në përbërje të trupit gjykues. Këto vendime, qoftë dhe të formës së prerë, mund të jenë shkak për shkarkim nga detyra vetëm nëse shoqërohen me akte e sjellje që diskreditojnë figurën e gjyqtarit"*.

64. Nga analiza e jurisprudencës së mësipërme arrihet në përfundimin se vendimmarrja e gjyqtarit është subjekt i kontrollit vetëm nga gjykatat e shkallëve më të larta të sistemit gjyqësor, ashtu sikurse nga Gjykata Kushtetuese, për cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, pasi të jenë shteruar mjetet e tjera të ankimit. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si organi i ngarkuar nga Kushtetuta për të mbrojtur pavarësinë institucionale të pushtetit gjyqësor ashtu edhe të gjyqtarëve individualisht nuk mund të bëhet organi që e kërcënon këtë pavarësi përmes procedurave administrative – disiplinore të kryera në kundërshtim me ligjin themelor.

65. Vendimmarrja e gjyqtarit, kur kjo cenohet nga një gjykatë më e lartë, për shkaqe materiale apo procedurale, mund të përbëjë shkak për nisjen e procedimit disiplinor ndaj tij vetëm nëse është e shoqëruar me akte e sjellje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Në të kundërt, çdo vendimmarrje gjyqësore e cenuar do të përbëjë vetëm një rekord negativ në shqyrtimin tërësor të punës së gjyqtarit, duke u vendosur në balancë me të gjitha të dhënat e tjera që grumbullohen gjatë vlerësimit profesional të tij.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-02174-00-2014, datë 19.04.2017

Gjykata zgjidh çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë që përfshin të drejtat apo interesat që pretendohen në të dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi.

Për sa kohë një akt administrativ nuk është kundërshtuar, ndryshuar apo shfuqizuar në rrugë administrative apo gjyqësore, ai përbën një akt me fuqi të plotë provuese, i cili prodhon pasojat juridike për të cilat ai është nxjerrë, përfshirë interesin e ligjshëm për të kërkuar gjyqësisht përmbushjen e të drejtave që ky i akt ka njohur.

I. Rrethanat e çështjes

1.Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se paditësi R.A., është banor i lagjes nr.5, Kukës dhe është poseduesi i një apartamenti banimi me nr.17/29+2+1, i ndodhur në zonën kadastrale nr.2315.

2. Ndërtesa në të cilën jeton aktualisht paditësi, ka filluar së ndërtuari për strehim nga ish-Ndërmarrja Komunale Banesa Kukës para viteve 1990 e për shkak të ngjarjeve të atij viti janë ndërprerë punimet. Paditësi, duke mos pasur zgjidhje tjetër për strehim është futur vullnetarisht në këtë apartament, duke i kryer vetë punimet e nevojshme dhe duke e bërë këtë apartament të përshtatshëm për banim.

3. Me vendimin nr.2/6, datë 02.06.1992, paditësit i është dhënë e drejta që të lidhë një kontratë provizore tremujore, e cila është e shoqëruar me aktin e dorëzimit të banesës.

4. Në bazë të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "*Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha*" si dhe VKM nr.49, datë 29.01.1993 "*Për përcaktimin e kritereve për të pastrehët*" me vendim të Këshillit Bashkiak, paditësi ka fituar statusin e të pastrehëve. Në datën 29.12.2006 Enti Kombëtar i Banesave, Dega Kukës në cilësinë e shitësit, ka lidhur me paditësin, kontratën me kusht me nr.3575 rep. dhe nr.553/1 kol. me objekt: "*shitjen e një apartamenti banimi në bashkëpronësi të pandarë Tip - me sipërfaqe ndërtimi – m2, e cila përbëhet nga dy dhoma e një kuzhinë me sipërfaqe shfrytëzimi, si dhe nga 70,2 m2 sipërfaqe në pjesën e përbashkët të shkallëve dhe pjesëve të tjera të përbashkët të pronës*".

5. Paditësi i është drejtuar Bashkisë Kukës me kërkesë, për të përfituar falas apartamentin objekt shqyrtimi. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) Kukës, Këshilli Bashkiak Kukës me vendimin nr.27, datë 13.06.2012, ka vendosur: "*Të miratojë të drejtën e përfitimit të kontributit falas qytetarit R.A. nga lidhja e kontratës me Entin Kombëtar të Banesave. Kontributi i njohur falas është në shumën 717.000 lekë sipas tabelës së llogaritjeve bashkëlidhur këtij vendimi...*".

6. Bazuar sa më sipër, pala paditëse ka kërkuar ekzekutimin e vendimit të mësipërm, por pala e paditur nuk ka pranuar që të bëjë ekzekutimin e tij, duke përdorur arsyetimin se, ky vendim është marrë jashtë afateve ligjore që përmban ligji, e konkretisht neni 6 i ligjit nr.9416, datë 20.05.2005 "*Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fondet shtetërore*".

7. Në këto kushte, paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës me padinë me objekt të sipërcituar, duke pretenduar detyrimin e palës së paditur që të ekzekutojë vendimin nr.27, datë 13.06.2012 të Këshillit Bashkiak Kukës.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr.19, datë 28.01.2013 ka vendosur: Pranimin e padisë së paditësit R.A.. - Detyrimin e palës së paditur Entit Kombëtar të Banesave, Dega Rajonale Kukës për të zbatuar vendimin [...].

9. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.251, datë 16.01.2014 ka vendosur: - Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për kompetencë gjykimi, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. [...].

10. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr.309, datë 24.02.2014 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.19, datë 28.01.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës. Pushimin e gjykimit të çështjes administrative me palë: *Paditës: R.A.; Të Paditur: Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Kukës; Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës; Person i tretë: Bashkia Kukës; Objekti: "Detyrimin e palës së paditur për të zbatuar vendimin nr.27, datë 13.06.2012 të Këshillit Bashkiak Kukës",* për shkak se padia nuk mund të ngrihej. [...]

11. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala paditëse R.A., i cili kërkon ndryshimin e vendimit nr.309, datë 24.02.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.19, datë 28.01.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duke parashtruar ato shkaqe që pasqyrohen në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, çmon se rekursi i paraqitur nga pala paditëse R.A., përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin nr.309, datë 24.02.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

13. Paditësi ka kërkuar në këtë gjykim: *"Detyrimin e palës së paditur për të zbatuar vendimin nr.27, datë 13.06.2012 të Këshillit Bashkiak Kukës",* duke u bazuar në nenet 31, 32, 154, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ligjit nr.9416, datë 20.05.2005 "*Për procedurat e privatizimit të ndërtesave të ndërtuara apo të blera me fondet shtetërore*". Në analizë të kërkimit që ka paraqitur paditësi në padi si dhe shkakut ligjor të tij, ky Kolegj çmon se, çështja objekt shqyrtimi përbën një mosmarrëveshje administrative gjykimi i të cilës do të bëhet si duke respektuar dispozitat ligjore të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", ashtu dhe aktet ligjore dhe nënligjore të përmendura më lart në këtë vendim.

14. Nga aktet e administruara në dosje, ka rezultuar e provuar se, paditësi është banor i lagjes nr.5, Kukës dhe është poseduesi i një apartamenti banimi me nr.17/29+2+1, i ndodhur në zonën kadastrale 2315. Paditësi e ka fituar posedimin mbi banesën, nëpërmjet vendimit nr.2/6, datë 02.06.1992 të Komiteti Ekzekutiv i Qytetit të Kukësit, duke iu dhënë fillimisht e drejta që të lidhë një kontratë provizore tremujore, e shoqëruar kjo me aktin e dorëzimit të banesës. Më vonë, paditësi me vendim të Këshillit Bashkiak Kukës ka fituar statusin si i pastrehë. Për këtë arsye, në datën 29.12.2006 Enti Kombëtar i Banesave, Dega Kukës, në cilësinë e shitësit ka lidhur me paditësin kontratën me kusht me nr.3575 rep. dhe nr.553/1 kol., me të cilën paditësit i është njohur e drejta e blerjes së apartamentit, kundrejt vlerës së përcaktuar në masën prej 725.662 Lekë, pagesë e cila do të bëhet me këste mujore të barabarta me masën e 2.450 lekë në muaj. Sipas përllogaritjeve të bëra në këtë kontratë, një pjesë e vlerës së apartamentit që kishte të bënte me shpenzimet operacionale në masën prej 28.333 Lekë, paditësi e kishte parapaguar, ndërsa pjesën tjetër do ta përfitonte sipas parashikimeve të ligjit nr.9416/2005, pasi kishte statusin e pastrehë (me kredi të butë ose falas referojuni kontratës me kushte tek kapitulli "Vlefta e apartamentit dhe çmimi i shitjes", faqja 6 e dosjes gjyqësore të shkallës së parë). Në këtë kontratë ishte parashikuar

që me shlyerjen e vlerës së plotë të apartamentit, ky i fundit do të kalonte në pronësi të paditësit R.A..

15. Paditësi ka pretenduar se, në cilësinë e subjektit të pastrehë, i është drejtuar Bashkisë Kukës me kërkesë për të përfituar nga kontributi falas i anës së paditur, apartamentin objekt shqyrtimi. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga EKB Kukës, Këshilli Bashkiak Kukës me vendimin nr.27, datë 13.06.2012, ka vendosur miratimin e njohjes së kontributit falas për paditësin në shumën 717.000 lekë, e cila përbënte edhe të gjithë shumën që paditësit i kishte mbetur për të shlyer për apartamentin objekt shqyrtimi. Por, edhe pse Këshilli Bashkiak Kukës i ka njohur paditësit kontributin falas në vlerën prej 717.000 lekë për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, këtë të drejtë pala paditëse nuk e ka realizuar duke u detyruar që ta bëjë çështjen konflikt gjyqësor.

16. Pala e paditur në këtë gjykim, Enti Kombëtar i Banesave, Dega Kukës ka prapësuar se vendimi nr.27, datë 13.06.2012 nuk mund të ekzekutohet, pasi është marrë jashtë afateve ligjore që përmban ligji, e konkretisht nenit 6, pika 1, të ligjit nr.9416, datë 20.05.2005 "*Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fondet shtetërore*", në të cilën parashikohet se: "*1. Për familjet, që kanë lidhur kontrata me EKB-në, por që nuk u është njohur e drejta e përfitimit, sipas neneve 4 e 5 të këtij ligji, këshilli i komunës ose i bashkisë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë të drejtën e përfitimit falas, pas verifikimit të dokumentacionit, që vërteton se çdo anëtar i familjes: a) nuk ka përfituar nga ligji për tokën; b) nuk ushtron veprimtari ekonomike dhe nuk është subjekt i taksës mbi vlerën e shtuar apo nuk zotëron kapital (para në qarkullim, tokë, mall, ndërtime etj.,.), me vlerë më të madhe se dyfishi i vlerës së banesës, ku është strehuar nga Enti Kombëtar i Banesave; c) nuk ka në pronësi banesë, sipërfaqja e banimit të së cilës i korrespondon normës së strehimit prej 9 - 11 m2 për frymë*".

17. Bazuar në pretendimet dhe prapësimet e ngritura nga palët ndërgjyqëse në këtë gjykim, si dhe aktet shkresore të administruara në dosje, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur pranimin e padisë me arsyetimin se: *i)* Këshilli Bashkiak Kukës ka vendosur miratimin e njohjes së kontributit falas për paditësin R.A. me vendimin nr.27, datë 13.06.2012; *ii)*. Ky vendim është konfirmuar për ligjshmërinë e tij nga ana e Prefektit të Qarkut Kukës, brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligj; *iii)* paditësi ka plotësuar kushtet ligjore, pasi ai me një vendim të Këshillit Bashkiak nr.47, datë 16.05.1994 është miratuar në listën e të pastrehëve, grupi a/2, nr.232, faqe 10; *iv)* paditësi ka lidhur kontratën me kusht me EKB në datë 29.12.2006, si rezultat i

faktit që ka pasur statusin i pastrehë. Ndërsa Gjykata Administrative e Apelit ka prishur vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe ka pushuar gjykimin e çështjes me arsyetimin se*: i*) gjykata e shkallës së parë ka disponuar në vendimin përfundimtar mbi një padi që nuk mund të ngrihet; *ii)* padia e ngritur nga pala paditëse nuk përfshihet në asnjë prej llojeve të padive të parashikuara në nenin 17, pika 1, të ligjit nr.49/2012; *iii)* Paditësi ka kërkuar vënien në ekzekutim të një akti administrativ, siç është vendimi i Këshillit Bashkiak, por kjo nuk mund të kërkohet me padi; *iv)* Vetëm kërkimi i zgjidhjes së pasojave që ai synon të realizojë dhe që i mohohen nga pala e paditur (detyrimi i palës së paditur për të kryer një veprim administrativ që është refuzuar), nuk legjitimon gjykatën në shqyrtimin e pretendimeve të paditësit.

18. Këtë arsyetim të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e gjen të pabazuar në ligj dhe në prova. Në çështjen objekt shqyrtimi, ka rezultuar e provuar se paditësi ka një interes të ligjshëm për të paraqitur kërkesë padinë në shqyrtim, pasi kërkon rivendosjen e të drejtave të tij, të pretenduara të shkelura nga mosveprimi i institucioneve shtetërore, palë të paditura në këtë gjykim.

19. Rezulton që në momentin e lindjes së konfliktit mes palëve, si bazë ligjore për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, përveç ligjit specifik ishin dhe dispozitat e KPC-s (nenet 324-333) konkretisht kreu II, i titulluar "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative". Kolegji Administrativ i Gjykatës së Larte nisur nga arsyetimi i përdorur nga gjykatat më të ulëta dhe në mënyrë të veçantë nga interpretimi që bën Gjykata e Administrative e Apelit, vlerëson të analizojë në këtë vendim, fillimisht se cili është ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi. Pavarësisht se në momentin e shqyrtimit të çështjes objekt gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit kishte hyrë në fuqi Kodi i ri i Procedurave Administrative, në analizë të të cilit rezultojnë dispozita si me karakter material, ashtu edhe me natyrë procedurale, duke qenë se konflikti mes palëve ndërgjygjese ka lindur në datën 13.06.2012 (momenti i daljes se aktit) dhe kërkesë padia e palës paditëse është paraqitur në datën 12.11.2012, padia në kuptimin material do të shqyrtohet me dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në momentin e lindjes së konfliktit dhe konkretisht me dispozitat e KPC-s, nenet 324, 326 të tij. Janë pikërisht këto dispozita të cilat duhet t'u referohej Gjykata Administrative e Apelit në zgjidhjen e kësaj çështjeje, pasi është i njohur në jurisprudencë parimi që për zgjidhjen e një konflikti do të zbatohen ato dispozita të ligjit material që kanë qenë në fuqi në momentin e daljes së aktit dhe lindjes së konfliktit.

20. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se paditësi

legjitimohet për të ngritur padinë objekt shqyrtimi. Legjitimimi i palëve në një proces administrativ do të përcaktohet nga natyra e aktit, fakti se kujt i kundrejtohet ai, cilët janë subjektet që cenohen nga pasojat e aktit etj.,. Në kushtet kur konflikti objekt shqyrtimi ka lindur përpara se të hynte në fuqi ligji nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", atëherë referimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi do të bëhet sipas dispozitave të zbatueshme për këtë rast në KPC.

21. Në nenet 324 deri në 326, të KPC-s, përcaktoheshin qartë se, cilat ishin llojet e padive që subjektet e interesuara mund të ngrinin pranë seksioneve administrative të gjykatave të shkallës së parë. Sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e mësipërme, rezulton që, kërkimet të cilat mund të ngriheshin dhe paditë që mund të merreshin në shqyrtim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor ishin: *(i)* padia me të cilën kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i aktit administrativ dhe *(ii)* padia me të cilën kundërshtohet refuzimi i miratimit të një akti administrativ, ose kur lihet pa u shqyrtuar brenda një afati të caktuar, kundërshtimi i shtetasit në organin kompetent administrativ.

22. Referuar të drejtës subjektive procedurale, çdo individ ka të drejtën t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, ose një interes të ligjshëm, të cilin, ai pretendon se i është shkelur apo i është cenuar, e drejtë kjo dhe garanci, e cila sanksionohet nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë e dhënë, e cila është një e drejtë themelore, e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme, i jepet vetëm atij që pretendon se, i janë shkelur këto të drejta dhe interesa të ligjshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore mund t'i drejtohet gjykatës").* Në referim të sa më sipër, del qartë që, çdo subjekt mund t'i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm, vetëm kur ekziston interesi i ligjshëm. Vetëm në këto kushte, subjekti i interesuar mund të kërkojë nga gjykata, që kjo e fundit, të realizojë një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të vendosë në lidhje me pretendimet e tij.

23. Në nenin 2 të ligjit nr.9416, datë 20.05.2005 "*Për procedurat e privatizimit të ndërtesave të ndërtuara apo të blera me fondet shtetërore*", është parashikuar se: "Çdo familje e pastrehë përfiton falas të drejtën për të shpenzuar një shumë parash sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ky përfitim do të quhet shumë përfitimi. Shuma e përfitimit falas të çdo familjeje të pastrehë do të përcaktohet nga numri i pjesëtarëve të familjes dhe mosha e tyre, si dhe kategoria e familjeve të pastreha, e

përcaktuar nga akte nënligjore, sipas tabelës nr.1 që i bashkëngjitet këtij ligji. Për familjet e pastreha që banojnë në ish-prona private dhe që kanë pasur kontrata qiramarrjeje, shuma e përfituar nga tabela nr.1 do të shumëzohet me koeficientin 1.3", ndërsa në VKM nr. 49, datë 29.01.1993 "*Për përcaktimin e kritereve për të pastrehët*", në nenin 1 dhe 2 të tij është përcaktuar se: "1. *Të quhen të pastrehë: a) Qytetarët që nuk kanë kontratë me ndërmarrjen komunale të banesave, si: - Të qarkulluarit e të transferuarit, të cilët e kanë zgjidhur kontratën e qirasë; - Qytetarët që përbëjnë familje të veçanta brenda trungut dhe që sipas gjendjes ekzistuese të strehimit nuk janë qiramarrës e nuk disponojnë një dhomë, kur kanë një fëmijë nën 10 vjeç, ose kur kanë një dhomë me një fëmijë mbi 10 vjeç (për këtë kategori dhomë do të quhet edhe kuzhina); b) Qytetarët që janë me banim të përkohshëm në ndërtesa, të cilat nuk hyjnë në fondin e banesave, si konvikte, shkolla, hotele, qendra administrative etj.; c) Qytetarët që banojnë nëpër bodrume, banesa që nuk përmbushin kushtet higjienike-shëndetësore, pa banjë, instalime hidro-sanitare etj.; ç) Qytetarët që banojnë në banesa shtetërore ish-pronë private, si dhe ata qytetarë që banojnë si qiramarrës në banesa private; d) Qytetarët që, si pasojë e vendimeve gjyqësore, rezultojnë me strehim të përkohshëm. 2. Ngarkohen komisionet e privatizimit pranë këshillave të rretheve, bashkive e komunave të përcaktojnë këtë kategori qytetarësh dhe listën përkatëse të firmosur nga kryetari i rrethit ose bashkisë dhe ta depozitojnë pranë degës së Entit Kombëtar të Banesave të rrethit përkatës*".

24. Në analizë të dispozitave ligjore të sipërcituara, ka rezultuar e provuar se paditësi është cilësuar si i pastrehë nga organi kompetent i përcaktuar në ligj dhe përfundimisht, pasi janë ndjekur shumë procedura ligjore administrative, duke qenë se ai plotësonte kriteret ligjore për të përfituar kontribut falas nga shteti, nga ana e Këshillit Bashkiak me vendimin nr. 27, datë 13.06.2012 është vendosur t'i njihet kontributi falas në masën prej 717.000 lekë. Kjo shumë përbënte edhe vlerën e plotë të pashlyer të apartamentit objekt shqyrtimi, të cilin, pala paditëse e posedonte që nga viti 1992 dhe për të cilin kishte lidhur edhe kontratën e shit-blerjes me kusht nr. 3575 rep. dhe nr. 553/1 kol., datë 29.12.2006. Kushti i parashikuar në këtë kontratë, në mënyrë që paditësi të bëhej pronar i apartamentit objekt shqyrtimi, ishte shlyerja e plotë e çmimit të apartamentit të përcaktuar në këtë kontratë në masën prej 725.662 Lekë, nga e cila ka rezultuar e provuar se paditësi ka parapaguar vlerën prej 28.333 Lekë. Për sa i përket pjesës tjetër të çmimit të shitjes së apartamentit, rezulton se ajo i është njohur paditësit nga Këshilli Bashkiak nga kontributi falas dhe për këtë arsye, kushti për kalimin në pronësi të apartamentit rezulton të jetë përmbushur

dhe mbetet vetëm formalizimi i veprimeve ligjore për kalimin e pronësisë së apartamentit objekt shqyrtimi në favor të paditësit, nëpërmjet lidhjes së kontratës së shitblerjes mes paditësit dhe Entit Kombëtar të Banesave, Dega Kukës.

25. Në kushtet kur Enti Kombëtar i Banesave Dega Kukës, që është organi shtetëror për të bërë zbatimin e vendimeve të dhëna nga Këshilli i Bashkisë Kukës, në lidhje me problemet e strehimit, ka refuzuar që të bëjë zbatimin e vendimit nr. 27, datë 13.06.2012, duke mos i lidhur paditësit kontratën e shitblerjes për apartamentin, këtij të fundit nuk i ka mbetur asnjë lloj mundësie tjetër për të rivendosur në vend të drejtat e tij të pretenduara të shkelura, përveçse duke iu drejtuar gjykatës. E drejta e fituar nuk duhet të mbetet në letër, por ajo duhet të jetë reale, ligjore dhe konkrete. Qëllimi i aktit administrativ është që të sjellë pasojat e kërkuara nga ligji. Sa më sipër del qartë nga analiza e nenit 105 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA)-s, në të cilin thuhet se: *"akti administrativ nuk është gjë tjetër, veçse çdo vendim, urdhër apo veprim që merret nga autoritetet administrative për rregullimin e një marrëdhënieje konkrete të posaçme ose rasteve të përgjithshme në sferën e të drejtës publike"*. Akti administrativ rregullon në mënyrë të hollësishme veprimtarinë e subjekteve të së drejtës në marrëdhëniet që ato krijojnë ne mes tyre. Akti administrativ flet me gjuhën e pasojave ligjore konkrete që ai sjell, duke përcaktuar qartë të drejta dhe detyrime për subjektet të cilëve ky akt u drejtohet. Meqenëse akti administrativ lidhet me fakte të caktuara kundrejt subjekteve të caktuar, atëherë ky akt ka efekte të drejtpërdrejta tek këto subjekte dhe për rrjedhojë, ata legjitimohen në ngritjen e padisë për përmbushjen e tij.

26. Neni 44 i KPA-s pranon se pjesëmarrës në një procedim administrativ mund të jetë çdokush që ka një interes të ligjshëm për çështjen në shqyrtim. Po sipas këtij kodi, pjesëmarrës në një procedim administrativ është personi ose subjekti që është mbajtës i të drejtave dhe interesave të ligjshme, me kërkesë të të cilit fillon procesi ose kundër të cilit zhvillohet procesi. Koncepti "*interes i ligjshëm*" bën që rrethi i subjekteve të jetë shumë i gjerë. Neni 45 i KPA-s përcakton pak a shumë rrethin e subjekteve që mund të marrin pjesë në një procedim administrativ, duke e shtrirë atë sa më shumë. Në këtë dispozitë parashikohet se: *"Mbajtësit e të drejtave dhe interesave të ligjshme, të cilat preken nga vendimet që merren gjatë procedimit administrativ, kanë të drejtë të fillojnë procedimin administrativ, si dhe të marrin pjese në të..."*.

27. Kur flasim për "*interes të ligjshëm*" të palëve në një proces të tillë, duhet të kemi parasysh plotësimin e tri kushteve: *(i)* aftësia për të qenë

palë në një proces, d.m.th., aftësia për të qenë mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve. Kjo lidhet jo vetëm me zotësinë për të vepruar, por dhe me zotësinë juridike të subjekteve, në mënyrë të veçantë të personave fizikë dhe juridike, si dhe me personalitetin e tyre juridik; (*ii*) të kenë aftësi për kryerjen e veprimeve të caktuara, aftësi procedurale, pra që subjekti të ketë zotësi për të vepruar në respektim edhe të nenit 44/2 të KPA-s; (*iii*) të vërtetojë lidhjen e domosdoshme midis interesit të saj dhe çështjes konkrete. Pra të vërtetohet në gjykim cenimi i interesit të ligjshëm nga mospërmbushja e aktit administrativ.

28. Është e qartë nga e drejta jonë administrative se kur flasim për proces administrativ, nënkuptojmë jo vetëm procedurën e ankimit të ndjekur në organin administrativ por edhe gjithë procesin gjyqësor që vjen dhe zhvillohet pas procedurës administrative. Sa më sipër, këto janë të pandara dhe përbëjnë një të tërë. Pra ashtu siç individi ka të drejtë dhe legjitimohet të ngrejë padi kur cenohet nga një akt administrativ, ashtu ai ka të drejtë të ngrejë padi edhe nga mosveprimi i organit administrativ, kur ky i fundit, në kundërshtim me ligjin nuk përmbush detyrimet ligjore dhe kur nga kjo mospërmbushje, subjekti cenohet në të drejtat dhe interesat e tij.

29. Neni 326 i KPC-s parashikon qartë se cilat janë paditë që nuk mund të ngrihen, të cilat janë: "*Nuk mund të ngrihen padi në gjykatë për: a) aktet administrative të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës publike të nivelit qendror ose vendor që kanë karakter normativ, përveç kur ato cenojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe interesa të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë; b) aktet administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë; c) aktet administrative të cilat sipas Kushtetutës janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese*". Në analizë të kësaj dispozite, del qartë se çdo lloj padie tjetër e ngritur nga subjektet e përcaktuar në ligj për rivendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura apo të cenuara, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me një organ administrativ të krijuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit të këtij organi, duhet të merret në shqyrtim nga ana e gjykatës administrative dhe kjo e fundit, duhet të vendosë në lidhje me zgjidhjen e saj.

30. Enti Kombëtar i Banesave, Dega Rajonale Kukës duke mosvepruar për evidentimin e plotësimit të kushtit të kontratës së lidhur mes tij dhe palës paditëse, vlerë e cila është miratuar nga fondi shtetëror dhe përbën vlerën e plotë të shitjes së apartamentit, si dhe duke mos vepruar për kalimin e tij në pronësi të paditësit sipas parashikimeve të nenit 6, pika

2 të ligjit nr.9416, datë 20.05.2005 "*Për procedurat e privatizimit të ndërtesave të ndërtuara apo të blera me fondet shtetërore*", e ka cenuar paditësin në të drejtën e tij të njohur dhe të garantuar nga ligji për të përfituar apartamentin objekt shqyrtimi, si subjekt që gëzon statusin e të pastrehut. Të njëjtin qëndrim si më sipër, mbajnë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.686, datë 11.05.2000 ku shprehen se: *"Gjykatës i lind e drejta të detyrojë me vendim cilindo organ jo vetëm të ushtojë detyrën, por ta ushtrojë atë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet duke garantuar të drejtën e individit për një gjykim të drejtë dhe në një afat të arsyeshëm".*

31. Sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të theksojë faktin se, pavarësisht mënyrës se si paditësi ka formuluar kërkimin e tij në padi, qëllimi kryesor i tij në ngritjen e kësaj padie, është që të realizojë gjyqësisht fitimin e të drejtës së pronësisë mbi apartamentin objekt shqyrtimi, sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm nr. 9416, datë 20.05.2005, "Për procedurat e privatizimit të ndërtesave të ndërtuara apo të blera me fondet shtetërore", pasi pretendon se i ka plotësuar të gjitha kriteret që parashikon ky ligj. Ky konkluzion, vjen në përputhje të plotë edhe me qëndrimin unifikues që kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin nr. 3/2012, në të cilin është parashikuar se: "*Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë, del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast, gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar".*

32. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se, sipas akteve të administruara në dosje, por edhe nga hetimi gjyqësor i kryer nga gjykatat më të ulëta, nuk rezulton që vendimi nr. 27, datë 13.06.2012 i Këshilli Bashkiak Kukës të jetë ndryshuar, shfuqizuar apo konstatuar si i pavlefshëm (absolutisht apo relativisht i pavlefshëm), në mënyrë që të vihet në diskutim fakti nëse ky vendim vazhdon të prodhojë pasojat e tij juridike apo jo. Për më tepër që ky vendim është aprovuar dhe kundërfirmosur nga prefekti, duke vlerësuar në këtë mënyrë edhe ligjshmërinë e këtij akti. Gjithashtu, argumenti që jep pala e paditur se vendimi nr.27, datë 13.06.2012 i Këshillit Bashkiak Kukës nuk është i ekzekutueshëm, pasi ka dalë jashtë afatit ligjor gjashtë-mujor nuk është një pretendim që mund të

goditet në formën e prapësimit. Për sa kohë akti administrativ, vendimi nr. 27, datë 13.06.2012 i Këshillit Bashkiak Kukës nuk është kundërshtuar, ndryshuar apo shfuqizuar në rrugë administrative apo gjyqësore, ai përbën një akt me fuqi të plotë provuese, i cili prodhon pasojat juridike për të cilin ai është nxjerrë dhe për këtë arsye, paditësi ka interes të ligjshëm që të kërkojë gjyqësisht përmbushjen e të drejtave që ky i akt i ka njohur.

33. Në këto kushte, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, çmon se, Gjykata Administrative e Apelit jo vetëm që nuk e ka kuptuar drejt objektin e vërtetë dhe qëllimin e kësaj padie, por ka vepruar në kundërshtim me sa parashikojnë nenet 324 dhe 326, të KPC-s, dispozita ligjore në fuqi në momentin e lindjes së mosmarrëveshjes. Kjo gjykatë, jo vetëm që e ka cilësuar padinë e paditësit si një padi që nuk mund të ngrihej (duke e lidhur thjesht me formulimet e ligjit), por në asnjë argument të saj nuk tregon se si mundet paditësi të realizojë të drejtën e tij kur një organ administrativ nuk respekton vendimin e një organi tjetër administrativ më të lartë në hierarki, kur ky i fundit ka vepruar dhe ka marrë vendim brenda kompetencave që i njeh ligji. Termi i parashikuar në nenin 324 të KPC-s "*padia me të cilën kundërshtohet refuzimi i miratimit të një akti administrativ…*", shumë qartë mund të interpretohet me padinë me të cilin kundërshtohet moskryerja e veprimeve nga ana e organit administrativ (siç ka ndodhur në rastin konkret që Enti Kombëtar i Banesave, Dega Rajonale Kukës, organi i ngarkuar me ligj nuk pranon të lidhë kontratën e shitblerjes me paditësin).

34. Në rastin konkret, vullneti i këtij organi për të vepruar dhe për të lidhur kontratën e shitblerjes, nuk është lënë në dëshirën e tij por ai është detyrues, pasi ky vullnet del nga ligji nr.9416, datë 20.05.2005 "*Për procedurat e privatizimit të ndërtesave të ndërtuara apo të blera me fondet shtetërore*", nenet 2, 6 dhe 10, të tij, ku përcaktohet qartë procedura që ndiqet për evidentimin e subjekteve që konsiderohen të pastrehë; cilat janë mënyrat për përfitimin e banesave falas; cilët janë mënyra dhe organi që miraton listat përkatëse; organi që merr vendim për njohjen e kontributit falas, si dhe detyrimi i Entit Kombëtar të Banesave për të bërë kalimin e banesave në favor të subjekteve të pastrehë. Konkretisht, në nenin 6 të ligjit të sipërcituar, të titulluar "Organi përgjegjës për miratimin e së drejtës së përfitimit falas", është parashikuar qartësisht se: "*1. Për familjet, që kanë lidhur kontrata me EKB-në, por që nuk u është njohur e drejta e përfitimit, sipas neneve 4 e 5 të këtij ligji, këshilli i komunës ose i bashkisë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë të drejtën e përfitimit falas, pas verifikimit të dokumentacionit, që vërteton se çdo anëtar i familjes: a) nuk ka përfituar nga ligji për tokën; b) nuk ushtron veprimtari ekonomike dhe nuk është subjekt i taksës mbi vlerën e shtuar apo nuk zotëron kapital (para në qarkullim, tokë, mall, ndërtime etj.,.), me vlerë më të madhe se dyfishi i vlerës së banesës, ku është strehuar nga Enti Kombëtar i Banesave; c) nuk ka në pronësi banesë, sipërfaqja e banimit të së cilës i korrespondon normës së strehimit prej 9-11 m2 për frymë. 2. Enti Kombëtar i Banesave, për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kur shuma e paguar nga familja plus përfitimi falas rezulton e barabartë ose më e madhe se detyrimi i familjes ndaj tij, mbyll kontratën dhe bën kalimin e pronësisë së apartamentit në favor të familjes*".

35. Në vijim të analizës ligjore të kryer si më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të theksojë faktin se, aktualisht ligjvënësi edhe në ndryshimet që ka bërë në Kodin e ri të Procedurave Administrative, por edhe në parashikimet e ligjit nr.49/20112 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar e ka qartësuar dhe më shumë të drejtën e subjekteve që kërkojnë një të drejtë të tillë. Kështu, në nenin 17, pika 1, germa "e", të ligjit nr.49/20112 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", është parashikuar se: "*1. Padia ngrihet: …e) për detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo interesave të paditësit…*". Ndërsa kuptimin mbi nocionin e "veprimit administrativ" dhe "veprimit tjetër administrativ", ky ligj e ka përcaktuar qartësisht në nenin 2, pikat 7 dhe 8 të tij, në të cilin parashikohet se: "*7. Veprim administrativ është akti administrativ, kontrata administrative dhe veprimi tjetër administrativ. 8. Veprimi tjetër administrativ është formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik, në kryerjen e funksionit publik dhe që nuk plotëson kushtet për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative dhe që krijon pasoja juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshëm*".

36. Në analizë të dispozitave ligjore të mësipërme, si dhe fakteve dhe rrethanave të trajtuara në gjykim, rezulton qartësisht e provuar se në çështjen objekt shqyrtimi kemi të bëjmë me mosveprimin e organit administrativ në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin specifik nr. 9416, datë 20.05.2005 "*Për procedurat e privatizimit të ndërtesave të ndërtuara apo të blera me fondet shtetërore*". Refuzimi i Entit Kombëtar të Banesave për të mbyllur kontratën e shitjes me kusht dhe për të bërë kalimin e apartamentit në favor të palës paditëse, përbën refuzim të kryerjes së një veprimi tjetër administrativ të parashikuar nga

ligji dhe për këtë arsye, padia objekt shqyrtimi është padi që mund të ngrihet dhe si e tillë duhet të ishte shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

37. Në kushtet kur në çështjen objekt gjykimi, mungon një shkallë gjykimi për shqyrtimin në themel të saj, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk mund të kryejë gjykimin në themel të kësaj çështjeje por vlerëson të prishë vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit e cila është marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale të zbatueshme dhe ta kthejë çështjen sërish për rigjykim pranë kësaj gjykate, me një tjetër trup gjykues. Në këto raste, është detyrë e gjykatës që pasi të shqyrtojë padinë dhe të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm, të vlerësojë nëse pretendimet e paditësit rezultojnë të bazuara në ligj e prova ose jo.

38. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në rigjykim, duhet t'u bëjë të qartë palëve që është detyrë e secilës prej tyre që në përputhje me ligjin, të provojnë faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet në lidhje me të drejtat që kërkojnë. Palët ashtu siç kanë të drejta kanë dhe detyrime që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara.

39. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, çmon se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, duhet të lejojë të dyja palët që të paraqesin prova shkresore me anën e të cilave ato të provojnë pretendimet e tyre, bazuar në nenet 12 dhe 19, të KPC-s dhe t'i lejojë ato që t'ia nënshtrojnë hetimit e debatit gjyqësor. Ky Kolegj, çmon gjithashtu se kryerja e veprimeve të përmendura më sipër, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të lindin gjatë rigjykimit, do të lejojnë gjykatën të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive, lidhur me zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-02536-00-2015, datë 11.07.2017

Largimi nga shërbimi civil është masë disiplinore që nuk merret nga eprori i drejtpërdrejtë por nga Komisioni Disiplinor i ngritur pranë institucionit përkatës sipas parashikimeve të ligjit për nëpunësin civil.

Masat disiplinore marrë nga një organ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, si dhe në kundërshtim me procedurën që parashikon ligji, përbëjnë akte tërësisht të pavlefshme.

I. Rrethanat e çështjes

1.Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se paditësja V.Sh., ka qenë pjesë e administratës së Departamentit të Administratës Publike (DAP), konfirmuar si nëpunëse civile, nga drejtori i këtij institucioni me vendimin nr.1797/1 prot., datë 29.04.2005.

2. Me vendimin nr.1591/12 prot., datë 06.11.2013 të Drejtorit të DAP, paditëses i është miratuar kalimi në pozicionin e specialistes për politikat e rekrutimit dhe konfirmimit, në Sektorin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Njësinë e Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit, në DAP.

3. Me Vendimin nr.66/4 prot., datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit në Departamentin e Administratës Publike, pra të eprorit të drejtpërdrejtë, paditësja rezulton të jetë ndëshkuar me masën disiplinore të largimit nga Shërbimi Civil, me motivacionin "*për moszbatimin e dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, bazuar në nenin 1, shkronja "e", të VKM nr.306, datë 13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil"*. Kjo masë disiplinore është miratuar nga drejtori i DAP me shkresën nr.66/5 prot., datë 07.02.2014.

4. Duke mos qenë dakord me largimin e saj nga shërbimi civil, pala paditëse në datën 19.02.2014 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padinë me objekt të sipërcituar, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit [...].

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1918, datë 28.04.2014 ka vendosur: Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë;

Shfuqizimin e veprimit administrativ të pasqyruar në vendimin nr.66/4, datë 16.01.2014 të Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit, pranë Departamentit të Administratës Publike. Detyrimin e palës së paditur, Departamenti i Administratës Publike të kthejë paditësen V.Sh. në vendin e mëparshëm të punës. [....].

6. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr.1911, datë 21.09.2015 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.1918, datë 28.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; Pranimin e kërkesëpadisë; Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.66/4, datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit në Departamentin e Administratës Publike dhe të vendimit nr.66/5, datë 07.02.2014 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike; Detyrimin e palës së paditur të rikthejë paditësen V.Sh. në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend ekuivalent me vendin e mëparshëm të punës; [...].

7. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs pala e paditur Departamenti i Administratës Publike, e cila kërkon ndryshimin e vendimit nr. 1911, datë 21.09.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të vendimit nr.1918, datë 28.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar ato shkaqe që pasqyrohen në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, rekursi i paraqitur nga pala e paditur [...], si dhe rekursi i paraqitur nga pala e paditur Departamenti i Administratës Publike, nuk përmbajnë shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", që të mund ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Ky Kolegj, çmon se vendimi nr.1911, datë 21.09.2015 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që ka ndryshuar vendimin nr.1918, datë 28.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe ka pranuar padinë, është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe atij material, e për rrjedhojë, ai duhet të lihet në fuqi.

9. Ky Kolegj, ashtu sikurse edhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, duke iu referuar akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe që janë marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta, pretendimeve të palëve në proces, dhe në mënyrë të veçantë akteve administrative, vendimit nr.66/4 prot., datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve

Njerëzore dhe Inovacionit në Departamentin e Administratës Publike, si dhe shkresës nr. 66/5 prot., datë 07.02.2014 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, arrin në konkluzionin se vendimi i marrë ndaj paditësit për largimin e saj nga shërbimi civil, është marrë në kundërshtim me ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë marrëdhënie pune, si dhe "*largimin nga shërbimin civil*".

10. Referuar shkakut ligjor të kërkimeve të palës paditëse në proces, arrihet në konkluzionin se jemi para një mosmarrëveshjeje që ka lindur si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës midis paditëses dhe anës së paditur, mosmarrëveshje kjo që rregullohet nga ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil". Nëpërmjet këtij gjykimi, pala paditëse kërkon të rivendosë në vend të drejtat e saj të pretenduara të shkelura nga pala e paditur Departamenti i Administratës Publike, të cilat ajo i gëzonte si punonjëse e administratës shtetërore me statusin e nëpunësit civil.

11. Ky Kolegj, çmon fillimisht të theksojë se, administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil. Qëndrueshmëria në detyrë është një prej elementëve thelbësorë të legjislacionit që rregullon statusin e nëpunësve civilë si dhe të subjekteve që gëzojnë këtë status, për arsye se ka lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin dhe respektimin e parimit të një administrate të përgjegjshme, e cila gjatë kryerjes së detyrave të saj zbaton me profesionalizëm, integritet dhe korrektësi, kuadrin ligjor në mbrojtje të interesave publikë dhe atyre privatë. Për të garantuar një administratë të përgjegjshme publike, është e rëndësishme që të krijohen garancitë e nevojshme me qëllim palëvizshmërinë nga detyra të nëpunësve publikë të specializuar në fushën përkatëse, përveç rasteve të shkeljeve të parashikuara shprehimisht në ligj.

12. Nisur nga rëndësia e madhe që paraqet respektimi dhe mbrojtja e interesave të nëpunësve civilë që punojnë në administratën publike, si dhe nisur nga fakti që ata të mos bëhen pre e abuzimit nëpërmjet largimit të tyre të padrejtë, u miratua ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", që kishte si qëllim përcaktimin e rregullave të njëjta për kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, për mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë, për vlerësimin e ecurisë në punë, me synim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe efecient.

13. Në nenin 41 të ligjit nr.152, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", të titulluar "E drejta e informimit dhe e ankimit", është pasqyruar

qartësisht se: "*1. Nëpunësi civil ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedimi administrativ dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij të shërbimit civil. 2. Nëpunësi civil ka të drejtë të kontrollojë dosjen e tij të personelit dhe të kërkojë ndryshimin e të dhënave të saj. 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil*". Në analizë të dispozitës së mësipërme, rezulton se është kompetencë e gjykatës zgjidhja e çdo ankese ndaj vendimeve që mund të marrin titullarët e institucioneve ose personat e ngarkuar me ligj në lidhje me nëpunësin civil si dhe çdo pretendimi që rrjedh nga të drejtat e statusit që ata gëzojnë. Për këtë arsye, pala paditëse në kushtet kur pretendon se i është cenuar një e drejtë e ligjshme nga pala e paditur, kjo e fundit institucion shtetëror, e ka bërë çështjen objekt shqyrtimi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

14. Rezulton nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore se pala paditëse ka filluar punë pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) dhe është konfirmuar si nëpunëse civile nga drejtori i këtij institucioni, me vendimin nr.1797/1 prot., datë 29.04.2005. Ndërsa me vendimin nr.1591/12 prot., datë 06.11.2013 të Drejtorit të DAP, paditëses i është miratuar kalimi në pozicionin e specialistes për politikat e rekrutimit dhe konfirmimit, në Sektorin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Njësinë e Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit, në DAP. Me Vendimin nr.66/4 prot., datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit në Departamentin e Administratës Publike, paditëses i është dhënë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, me motivacionin "*për moszbatimin e dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, bazuar në nenin 1, shkronja "e", të VKM nr.306, datë 13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil"*. Kjo masë disiplinore është miratuar nga drejtori i DAP me shkresën nr.66/5 prot., datë 07.02.2014.

15. Pala paditëse në këtë gjykim, ka pretenduar se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga ana e paditur, është bërë në kundërshtim të plotë me ligjin material që rregullon këtë lloj marrëdhënieje si dhe me provat e administruara në dosjen gjyqësore. Pala e paditur ka dhënë ndaj paditëses masën disiplinore më ekstreme, sikundër është largimi nga shërbimi civil, në kundërshtim të plotë me procedurën që parashikon ligji që ka qenë në fuqi në momentin e dhënies së saj. Kjo masë disiplinore nuk është dhënë nga organi kompetent që parashikon ligji, duke e bërë në këtë mënyrë aktin

administrativ të largimit nga detyra si një akt absolutisht të pavlefshëm. Pala e paditur ka zbatuar procedurën e dhënies së masës disiplinore dhe rregullat procedurale të parashikuara nga ligji nr.8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", pavarësisht faktit se ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" që ka shfuqizuar ligjin e mëparshëm kishte hyrë në fuqi në datën 01.10.2013. Gjithashtu, masa disiplinore "largim nga shërbimi civil" është masë disiplinore shumë e rëndë dhe sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, kjo masë disiplinore tashmë me ligjin e ri nuk mund të jepej më nga eprori i drejtpërdrejtë, sikundër ka ndodhur në rastin konkret, por duhej të jepej nga Komisioni Disiplinor i përbërë prej 5 anëtarësh. Për këtë arsye, akti administrativ, Vendimi nr.66/4 prot., datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit, në Departamentin e Administratës Publike është një akt absolutisht i pavlefshëm, pasi është nxjerrë nga një organ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore dhe jo në përputhje me procedurën që parashikon ligji.

16. Gjithashtu, pala paditëse ka pretenduar që edhe sikur ky akt të mos ishte absolutisht i pavlefshëm, për sa i përket anës procedurale dhe kompetencës së organit, ai është një akt që vjen në kundërshtim me ligjin material. Pretendimet e ngritura nga pala e paditur se nga ana e saj nuk janë përmbushur detyrat e saj funksionale nuk rezultuan të provuara. Në lidhje me skualifikimin e kandidates B.A., e cila kishte aplikuar për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Standardeve, Cilësisë dhe Jetësimit të Prioriteteve, ky skualifikim nga ana ime është bërë në përputhje të plotë me ligjin, pasi kjo kandidate nuk plotësonte kriterin trevjeçar të eksperiencës në punë në administratën publike, në institucionet kombëtare apo ndërkombëtare. Në lidhje me shkeljen e detyrës për rastin e kandidimit të shtetases B.J., sipas akteve të administruara në dosje dhe të evidentuara edhe gjatë procedimit disiplinor administrativ, për këtë kandidate nuk ka pasur asnjë vlerësim nga ana ime për kualifikim apo skualifikim, pasi konkurrimi ku ka marrë pjesë kjo shtetase është shtyrë për shkak të mospjesëmarrjes së numrit të mjaftueshëm për kryerjen e konkurrimit. Në lidhje me dy rastet e tjera të pretenduara nga ana e paditur, që janë kryer në shkelje të plotë të detyrave funksionale të palës paditëse, konkretisht për aplikimin e shtetaseve I.C. dhe A.M., praktikat e këtyre kandidateve nuk janë ndjekur nga pala paditëse, pasi shkresa për testimin e tyre nuk mban nënshkrimin e paditëses dhe për më tepër në datat 06-08.01.2014 kur është zhvilluar ky konkurs, paditësja ka qenë me raport mjekësor të administruar në dosjen gjyqësore. Pra të gjitha pretendimet e ngritura nga pala e paditur se paditësja nuk ka respektuar ligjin dhe ka kryer shkelje të detyrave të saj funksionale nuk rezultuan të provuara në këtë gjykim. Për këtë arsye, paditësja ka pretenduar se akti i

largimit të saj nga shërbimi civil është nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë duhet të anulohet ose të konstatohet si i pavlefshëm nga gjykata.

17. Pala e paditur Departamenti i Administratës publike ka prapësuar në gjykim se, nga ana e saj gjatë procedimit disiplinor është respektuar tërësisht dhe korrektësisht ligji i zbatueshëm, që në rastin konkret ka qenë ligji nr.8549/1999 "Për statusin e nëpunësit civil". Procedura disiplinore ndaj paditëses ka filluar përpara se ligji nr.152/2013 të kishte hyrë në fuqi dhe i referohet ligjit të zbatueshëm në momentin që janë kryer shkeljet administrative të pretenduara, të cilat janë kryer në kohën që ka qenë në fuqi ligji nr.8549/1999 "Për statusin e nëpunësit civil". Masa disiplinore ndaj paditëses është dhënë nga eprori i drejtpërdrejtë si organi kompetent administrativ dhe brenda komptencave që i ka njohur ligji nr.8549/1999 "Për statusin e nëpunësit civil", mbi bazën e të cilit rregullohet mosmarrëveshja objekt i këtij gjykimi.

18. Pala e paditur ka pretenduar gjithashtu se, vetë pala paditëse i ka pranuar shkeljet e kryera prej saj, të cilat janë pasqyruar qartësisht në procesverbalin e mbajtur gjatë procedurës administrative, i cili, në kuptim të neneve 81 dhe 98 të KPA-s dhe neneve 253, 258 dhe 259, të KPC-s, përbëjnë provë të plotë dhe të pakundërshtueshme. Vendimi i eprorit të drejtpërdrejtë për lirimin nga shërbimi civil të paditëses ka ardhur pasi u konstatuan dhe u verifikuan shkeljet e vazhdueshme qe paditësja kishte kryer gjatë kohës që ushtronte detyrën. Shkak për nisjen e procedimit disiplinor kanë qenë shkeljet e vazhdueshme të konstatuara përgjatë zhvillimit të procedurave të paraseleksionimit të kandidatëve që paraqiten për konkurrim në administratën publike. Drejtoria pranë së cilës punonte znj. V.Sh., për arsye të mospërmbushjes në mënyrë të vazhdueshme të detyrës nga ana e saj, është bërë objekt i disa ankimeve të ndryshme nga konkurrentët, të cilëve iu është mohuar e drejta e konkurrimit. Në të gjitha rastet, pala paditëse ka skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht sipas rastit, kandidatët në kundërshtim me kriteret specifike të shpallura për konkurrimin për pozicionet e lira të shpallura nga DAP. Në këtë mënyrë, paditësja me veprimet e saj ka cenuar rëndë imazhin e DAP dhe besimin që qytetarët kanë kundrejt institucionit. Veprimet e paditëses përbëjnë mospërmbushje të detyrës funksionale me pasoja në ligjshmërinë, në paanësinë dhe besueshmërinë e veprimtarisë administrative në drejtim të mosrespektimit të kërkesave urdhëruese ligjore që garantojnë zhvillimin e procedurës së konkurrimit në përputhje me ligjin.

19. Bazuar në pretendimet dhe prapësimet e pasqyruara si më sipër, si dhe akteve shkresore të administruara në dosje, ka rezultuar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka pranuar pjesërisht padinë

e paditësit, ndërsa Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, e ka ndryshuar këtë vendim dhe ka vendosur pranimin e plotë të padisë duke arsyetuar se: *i)* Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të aplikueshme në këtë rast dispozitat e ligjit nr.8549/1999 dhe bazuar në këto dispozita ka konkluduar në pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë; *ii)* në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, gjykata administrative e apelit vlerëson se mosmarrëveshja objekt shqyrtimi rregullohet sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i cili ka hyrë në fuqi me datë 01.10.2013, qëndrim i cili është mbajtur edhe në praktikën e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; *iii)* aktet objekt gjykimi datojnë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 dhe e gjithë procedura e largimit të paditësit nga shërbimi civil, ka nisur dhe ka përfunduar pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, çka e bën të detyrueshme zbatimin e dispozitave të këtij të fundit; *vi)* largimi i paditëses nga detyra nuk rezulton të ketë qenë e drejtë e organit që e ka kryer atë; *v)* konstatimi i mosrespektimit të kompetencës dhe procedurës së largimit të paditëses nga detyra, përbën shkak ligjor të mjaftueshëm për të konstatuar nga ana e gjykatës pavlefshmërinë absolute të akteve objekt shqyrtimi, duke mos qenë i nevojshëm për me tej analizimi i ekzistencës ose jo i shkaqeve të tjera që kanë diktuar për marrjen e vendimit të largimit nga pala e paditur.

20. Konkluzionet e mësipërme të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë vlerësohen nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, si të bazuara në prova dhe në ligj. Siç u përshkrua në mënyrë më të detajuar më lart në këtë vendim, ka rezultuar e provuar se pala paditëse ka qenë punonjëse pranë Departamentit të Administratës Publike, ku edhe ka gëzuar statusin e nëpunësit civil. Me vendimin nr.1591/12 prot., datë 06.11.2013 të Drejtorit të DAP, paditëses i është miratuar kalimi në pozicionin e specialistes për politikat e rekrutimit dhe konfirmimit, në Sektorin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Njësinë e Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit në DAP. Me vendimin nr.66/4 prot., datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit në Departamentin e Administratës Publike, paditëses i është dhënë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, me motivacionin "*për moszbatimin e dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, bazuar në nenin 1, shkronja "e", të VKM nr.306, datë 13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil"*. Kjo masë disiplinore është miratuar nga drejtori i DAP me shkresën nr.66/5 prot., datë 07.02.2014.

21. Në vijim të sa më sipër, rezulton që paditësja është liruar nga shërbimi civil (po në këtë kohë është aplikuar dhe procedura për lirimin e saj), në kohën kur kishte hyrë në fuqi lligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i cili përcaktonte rregulla dhe parashikime ligjore konkrete se kur një nëpunës

civil mund të largohej nga shërbimi civil. Në kushtet që të gjitha aktet administrative janë lëshuar nga ana e organeve të mësipërme pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe lirimi i paditëses është bërë në këtë kohë, ky Kolegj vlerëson se trajtimi i kësaj çështjeje nga ana e gjykatës do të bëhet bazuar në këtë ligj dhe jo në ligjin e vjetër, që tashmë është shfuqizuar. Kjo, pavarësisht pretendimit të anës së paditur se shkeljet ligjore të paditëses i përkasin kohës kur ishte në fuqi ligji i vjetër. Është i njohur parimi se në momentin e lindjes dhe të shqyrtimit të një konflikti, do te zbatohet ligji procedural në momentin e shqyrtimit të tij dhe ligji material në momentin e kryerjes së shkeljes.

22. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të theksojë se kërkimi i palës paditëse në këtë gjykim, është pikërisht shfuqizimi i dy akteve administrative, konkretisht vendimit nr.66/4 prot., datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit në Departamentin e Administratës Publike, si dhe shkresës me nr.66/5 prot., datë 07.02.2014 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, me të cilat paditësja është larguar nga shërbimi civil. Janë pikërisht këto akte administrative të cilat kanë shënuar përfundimin e marrëdhënieve të punës mes palëve dhe të cilat kanë sjellë dhe pasojat për të. Në këto kushte, ky Kolegj vlerëson se zgjidhja e marrëdhënies së punës mes palëve si dhe zgjidhja e pasojave që vijnë nga kjo marrëdhënie pune do të analizohet nën dritën e ligjit nr.152/2013, që ka qenë në fuqi në datën e lëshimit të këtyre akteve administrative. Kjo për faktin se, ligjvënësi kishte parashikuar që ligji nr.152/2013 do të hynte në fuqi në datën 01.10.2013, ndërsa me aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil""; Këshilli i Ministrave shtyu hyrjen në fuqi të këtij ligji edhe me 6 muaj të tjerë. Ky akt normativ është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr.161/2013 "Për miratimin e aktit normativ nr. 5, datë 30.09.2013". Këto akte normative (të përmendura më lart) rezultojnë të jenë bërë objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr.5, datë 05.02.2014, i konsideroi ato të papajtueshme me Kushtetutën, duke urdhëruar shfuqizimin e tyre, duke konfirmuar përfundimisht që ligji i mësipërm hynte në fuqi në datën 01.10.2013.

23. Ka rezultuar e provuar se ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është publikuar në fletoren Zyrtare me nr.18, datë 26.02.2014 dhe sipas parashikimeve të nenit 132, pika 2, të Kushtetutës, në të cilën pasqyrohet se: *"2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare",* ky vendim i Gjykatës Kushtetuese ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014, kohë në të cilën çështja objekt shqyrtimi nuk kishte përfunduar ende më një vendim gjyqësor të formës së prerë. Për këtë

arsye, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të theksojë se, në kushtet që Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar aktin normativ që i jepte ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" një datë tjetër të hyrjes në fuqi dhe çështja nuk kishte përfunduar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, me të drejtë Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar të zgjidhë çështjen objekt shqyrtimi, sipas parashikimeve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", që kishte hyrë në fuqi që në datën 01.10.2013, pra kohë përpara se të dilnin aktet objekt kundërshtimi në këtë gjykim. Për sa u sqarua më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i çmon të pambështetura në ligj dhe në prova pretendimet e ngritura në rekurs nga pala e paditur, në lidhje me ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.

24. Në nenin 63 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i titulluar "Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil", është parashikuar se: "*Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet: a) lirimit nga shërbimi civil; b) largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore; c) pranisë së një shkaku të parashikuar nga neni 65 i këtij ligji*", ndërsa në nenin 65 po të këtij ligji, i titulluar "*Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit", parashikohet se: "1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur: a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; c) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë; ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit; d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. 2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga: a) njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën; b) DAP-i për anëtarët e TND-së*".

25. Në analizë të dispozitave të cituara më sipër, konstatohet qartësisht se, si lirimi nga detyra i një nëpunësi civil, ashtu edhe largimi nga shërbimi civil në kuadrin e një mase disiplinore, janë forma të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shërbimin civil. Ndryshimi ndërmjet tyre, qëndron në faktin se lirimi nga shërbimi civil nuk jepet në kuadrin e një mase disiplinore siç parashikohet në nenin 63/b të këtij ligji. Pra, lirimi i një nëpunësi civil bëhet për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj, të cilat janë të ndryshme dhe të pavarura nga shkeljet disiplinore. Ndërsa, për sa i përket largimit të nëpunësit civil nga shërbimi civil, vlen të theksohet se ndërprerja e marrëdhënies së punës në këtë rast bëhet në kuadrin e dhënies së një mase disiplinore të rëndë, që merret ndaj nëpunësit civil vetëm në rastin kur ky kryen veprime të kundërligjshme, të cilat cenojnë rëndë parimet e shërbimit civil.

26. Në rastin objekt shqyrtimi, referuar aktit administrativ, vendimit nr.66/4 prot., datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit, në Departamentin e Administratës Publike, si dhe shkresës me nr.66/5 prot., datë 07.02.2014 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, pala paditëse rezulton të jetë larguar nga shërbimi civil, në kuadrin e dhënies së një mase disiplinore shumë të rëndë, të parashikuar nga neni 57, pika 2, germa "ç", të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil".

27. Kuptimi mbi shkeljet disiplinore dhe klasifikimi i tyre përcaktohet qartë në nenin 57 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të titulluar "Përgjegjësia për masat disiplinore", në të cilin është parashikuar se: "*1. Nëpunësi civil është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësit civil sipas ligjit. [...].*

28. Në analizë të dispozitave ligjore të mësipërme, del qartë se ligjvënësi ka parashikuar të gjitha rastet se kur një nëpunës civil mban përgjegjësi disiplinore, duke i kategorizuar ato sipas shkallës së rëndësisë së shkeljes, në: *i)* shkelje shumë të rënda; *ii)* shkelje të rënda dhe *iii)* shkelje të lehta. Për të gjitha këto shkelje, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë shteruese se cilat janë ato, si ndahen si dhe cilat janë pasojat që vijnë prej kryerjes së tyre, duke mos e lënë përcaktimin e tyre në dorë të organit administrativ konkret. Ligjvënësi, jo pa qëllim, ka bërë një përcaktim të tillë të qartë, duke synuar shmangien e abuzivitetit në përcaktimin e masave disiplinore, dhënien e tyre në përputhje me ligjin dhe me shkeljen e kryer, si dhe dhënien e garancive të mjaftueshme për nëpunësin civil. Në varësi të natyrës së shkeljeve, ligjvënësi ka përcaktuar edhe masën disiplinore që mund të merret ndaj nëpunësit civil, ku si masa më ekstreme e parashikuar është ajo e largimit nga shërbimi civil.

29. Ky fakt parashikohet qartësisht edhe në nenin 60 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i titulluar "Parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore", ku parashikohet se: "*1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, eprori direkt ose komisioni disiplinor bazohet në: a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj; b) shkallën e fajësisë; c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara, sipas nenit 61 të këtij ligji. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet shumë të rënda, të parashikuara në pikën 2 të nenit 57 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën "ç" të nenit 58 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e rënda të parashikuara në pikën 3 të nenit 57 jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat "b" ose "c" të nenit 58 të këtij ligji. 5. Për shkeljet e lehta të parashikuara në pikën 4 të nenit 57 jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën "a" të nenit 58 të këtij ligji. 6. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore*".

30. Përveç sa më sipër, ligjvënësi, me qëllim respektimin dhe garantimin e një prej parimeve më të rëndësishme të shërbimit civil, atë të "palëvizshmërisë nga detyra" të nëpunësve publikë të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ka parashikuar qartë dhe *(a)* organin kompetent i cili duhet të ndjekë ecurinë disiplinore ndaj një nëpunësi civil, si dhe *(b)* procedurën ligjore që duhet të respektojë ky i fundit me qëllim që largimi të jetë konform ligjit.

31. Në nenin 59 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i titulluar "Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore", është parashikuar shprehimisht se: "*1. Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën "a", të nenit 58, të këtij ligji, merret nga eprori direkt. Eprori direkt detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil. 2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç" të nenit 58 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor. [....] 7. Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të asistohet gjatë procedimit disiplinor nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, një avokat apo një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate. 8. Procedimi disiplinor fillon pa vonesë, me marrjen dijeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati 2-vjeçar nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, që mund të rezultojnë në marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil, afati është 8 vjet. 9. Masat disiplinore regjistrohen në dosjen e personelit të nëpunësit. 10. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, brenda rregullave të përgjithshme, të parashikuara nga KPA*".

32. Në analizë të dispozitës ligjore të mësipërme, ndaj një nëpunësi civil mund të fillojë ecuria disiplinore, vetëm në rast se nga veprimet që ai ka kryer në ushtrim të detyrave të tij funksionale janë konstatuar shkelje disiplinore, të cilat vetë ligji i ka zbërthyer në mënyrë të qartë dhe pa asnjë lloj ekuivoku, duke përcaktuar se cilat do të konsiderohen shkelje disiplinore, që mund të detyrojnë organin epror për të nisur një procedurë disiplinore ndaj një nëpunësi civil. Gjithashtu, në varësi të shkeljes disiplinore të

pretenduar të kryer nga një nëpunës civil, ligjvënësi ka përcaktuar qartë si organin kompetent, ashtu edhe procedurën që duhet ndjekur në çdo rast. Konkretisht, ligjvënësi ka përcaktuar se eprori i drejtpërdrejtë i një nëpunësi civil mund të japë vetëm masën disiplinore "*vërejtje*", e cila përbën edhe masën disiplinore më të lehtë në hierarkinë e masave disiplinore. Ndërsa të gjitha llojet e tjera të masave disiplinore, ligjvënësi ka përcaktuar se ato do te jepen nga Komisioni Disiplinor i cili krijohet pranë çdo organi administrativ publik dhe që përfshihet brenda sferës së shërbimit publik sipas përcaktimeve të këtij ligji.

33. Në vijim të analizës së bërë si më sipër në këtë vendim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të theksojë se, në të dyja rastet, pra si në rastin e largimit të nëpunësit civil nga shërbimi civil, ashtu edhe për lirimin e tij, ligji specifik parashikon në mënyrë strikte një procedurë ligjore të mirëpërcaktuar, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar në çdo rast. Referuar dispozitave ligjore të cituara më lart, si dhe provave shkresore që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe që janë administruar nga gjykatat me të ulëta, rezulton se pala e paditur në këtë gjykim, nuk ka respektuar procedurën që parashikon ligji për largimin e nëpunësit civil. Kjo për faktin se, referuar nenit 59, pikat 2 dhe 7, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", largimi nga shërbimi civil është masë disiplinore që merret jo nga eprori i drejtpërdrejtë (që në rastin objekt shqyrtimi ka qenë Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit, në Departamentin e Administratës Publike, pasi paditësja mbante detyrën e specialistes për politikat e rekrutimit dhe konfirmimit pranë kësaj drejtorie), por nga Komisioni Disiplinor i ngritur pranë kësaj ministrie sipas parashikimeve të ligjit për nëpunësin civil. Për këtë arsye, akti i largimit të paditëses nga shërbimi civil, është një akt absolutisht i pavlefshëm, pasi është marrë nga një organ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, si dhe në kundërshtim me procedurën që parashikon ligji. Mosrespektimi i procedurës së parashikuar në ligj, e bën aktin tërësisht të pavlefshëm.

34. Jo pa qëllim ligjvënësi ka parashikuar që në rastet e largimit të një nëpunësi civil nga shërbimi civil, duhet të zbatohet një procedurë strikte, pasi zbatimi i saj është baza e një procesi administrativ të drejtë dhe të paanshëm. Në kushtet kur rezultoi tërësisht e provuar se për paditësen nuk janë respektuar procedurat që duhen ndjekur për largimin e saj nga shërbimi civil, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e gjen tërësisht të drejtë konkluzionin e arritur nga Gjykata Administrative e Apelit, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.66/4 prot., datë 16.01.2014 të Drejtores së Drejtorisë së Zhvillimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Inovacionit, në Departamentin e Administratës Publike; si dhe rregullimin e

pasojave që vijnë nga ky akt, duke i njohur paditëses të drejtën për rikthimin në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjeve të marrëdhënieve financiare deri në rikthimin e saj në detyrë. Gjithashtu, një akt absolutisht i pavlefshëm është edhe shkresa me nr.66/5 prot., datë 07.02.2014 e Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, me të cilin është konfirmuar dhënia e masës disiplinore ndaj palës paditëse, pasi është një akt administrativ i bazuar në një akt absolutisht të pavlefshëm.

35. Referuar të gjitha dispozitave ligjore të cituara më lart në këtë vendim, si dhe provave shkresore që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe që janë administruar nga gjykatat më të ulëta, rezulton se pala e paditur në këtë gjykim, në kundërshtim me ato që pretendon në rekursin e paraqitur, nuk ka përmbushur kushtet dhe kriteret ligjore që parashikon ligji, në mënyrë që akti i nxjerrë prej tij për largimin e paditëses nga shërbimi civil të jetë marrë në përputhje me procedurën dhe kërkesat e parashikuara në ligj. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se në kushtet kur akti i largimit të palës paditëse nga shërbimi civil është bërë në kundërshtim me ligjin dhe nuk është në përputhje me procedurën e parashikuar prej tij, me të drejtë, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vlerësuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të nxjerra nga pala e paditur, si dhe rikthimin e paditësit në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës për të gjithë kohën e qëndrimit pa punë deri në rikthimin në detyrë, duke rregulluar në këtë mënyrë edhe pasojat që vinin nga nxjerrja e një akti absolutisht të pavlefshëm.

36. Për gjithë sa u pasqyrua më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se vendimi nr.1911, datë 21.09.2015 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe atij material dhe për këtë arsye, bazuar në ligjin nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", ky vendim duhet të lihet në fuqi.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-1816, datë 19.07.2017

Kundërshtimi i vendimit të Ajgencisë së Trajtimit të Pronës (ATP) për njohjen e së drejtës së pronës bëhet nga ana e palëve të interesuara pranë Gjykatës së Apelit, ndërsa ankimi kundër vendimit të njohjes/ose mosnjohjes së të drejtës së pronësisë direkt në gjykatën civile.

Gjykata Administrative nuk shqyrton mosmarrëveshje shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se, paditësi në këtë gjykim, është një ndër trashëgimtarët ligjorë të subjektit të Q.M. dhe është caktuar me prokurë të përgjithshme si përfaqësues ligjor i të gjithë trashëgimtarëve të tjerë të tij.

2. Paditësi, bazuar në cilësinë e përfaqësuesve ligjore të subjektit Q.M., i është drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronës Tiranë për t'u trajtuar në kuadrin e trajtimit të pronave që i janë shpronësuar këtij subjekti nga pushteti i kohës, pas datës 29.11.1944.

2. Me vendimin nr.404, datë 28.12.2016 të Agjencisë së Trajtimit të Pronës Tiranë është vendosur mbyllja e procedimit administrativ për shqyrtimin e dosjes nr.2748, datë 17.12.2014 të subjektit kërkues M.M. për pronën e pretenduar me sipërfaqe 67 dy, të ndodhura në fshatin Zallë, Krujë si pronë e të ndjerit Q.M., me arsyetimin se: *"...Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar në dosjen e shqyrtimit me nr.2748, datë 17.12.2014, sikurse është konstatuar nga vlerësimi i grupit të punës, konstatohet se ai nuk është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", si dhe VKM nr.222, datë 23.03.2016 "Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës dhe kompensimit të saj"..."*.

3. Në kushtet kur pala paditëse nuk ka qenë dakord me vendimin e marrë nga Agjencia e Trajtimit të Pronës Tiranë, në datën 13.02.2017 i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me padinë me objekt të sipërcituar, duke pretenduar anulimin e vendimit, si dhe njohjen e të drejtës së pronësisë dhe disponimin e saj sipas mënyrave të parashikuara në ligj.

4. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.116, datë 07.03.2017, ka vendosur: Shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes civile me nr.1091 akti, datë 20.02.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykatë kompetente. [...].

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.2544 akti, datë 28.03.2017, ka vendosur: Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shqyrtimin e çështjes civile me nr.2644 akti, datë 28.03.2017 që i përket palës paditëse M.M.. Dërgimin e vendimit dhe kopjeve të akteve të nevojshme së bashku me dosjen gjyqësore të ardhur nga Gjykata e Apelit Tiranë për zgjidhjen e saj Gjykatës së Lartë. [...].

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Vendimi nr.116, datë 07.03.2017 i Gjykatës Apelit Tiranë, me anën e të cilit, kjo gjykatë ka vendosur shpalljen e moskompetencës së saj për shqyrtimin e çështjes objekt shqyrtimi dhe dërgimin e saj për gjykim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është një vendim i marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe atij material, ndaj për këtë shkak ai duhet të prishet dhe çështja duhet të dërgohet në po këtë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson të nënvizojë se në kuptimin e së drejtës procedurale, kompetenca lëndore është një kusht i domosdoshëm procedural që bën të vlefshëm procesin gjyqësor, si dhe të gjitha aktet e marra në administrim gjatë zhvillimit të tij. Kjo në kuptimin që, një gjykatë jokompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale dhe një gjykatë jokompetente duhet të deklarojë moskompetencën e saj (neni 61 i Kodit të Procedurës Civile (KPC), neni 7 i ligjit 49/2012).

8. Kompetenca lëndore përcakton për çdo gjykatë të veçantë se, në çfarë rastesh dhe në lidhje me çfarë mosmarrëveshjesh ajo ka pushtet për të gjykuar, duke përcaktuar qartë rrethin e mosmarrëveshjeve që i është njohur e dhënë asaj për ta gjykuar. Ndarja e kompetencës është përcaktuar qartë në ligjin nr.9877, datë 18.02.2008 "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", në ligjin nr. 49/2012 *"Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", si dhe në KPC.

9. Gjykata, në përcaktimin e kompetencës lëndore, i referohet pikërisht identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes që i shtrohet për gjykim, nëse ajo është e natyrës civile apo administrative. Për këtë qëllim, gjykata i referohet

shkakut ligjor të kërkimeve të paditësit të parashtruara si në kërkesë padi ashtu dhe gjatë gjykimit, natyrës së mosmarrëveshjes, si dhe statusit juridik të palëve që kjo padi i kundrejtohet. Gjithashtu, gjykata ka detyrimin që të bëjë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë, dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në lidhje me çështjen objekt gjykimi, në shqyrtim të akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, objektit dhe shkakut ligjor të kërkimeve të paditësit, pretendimeve të parashtruara prej tij në aktet procedurale, qëndrimit të ngritur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe në interpretim të dispozitave të ligjit nr.49/2012 që janë të zbatueshme në këtë gjykim, çmon se Gjykata e Apelit Tiranë nuk e ka kuptuar drejt natyrën e vërtetë të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi.

11. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se paditësit në këtë gjykim kanë kërkuar: "*Ndryshimin e vendimit nr.404 datë 28.12.2016 të Agjencisë së Trajtimit të pronave, si i padrejtë, i pabazuar në prova dhe në ligj, për sa i përket mbylljes së procedimit administrativ për shqyrtimin e dosjes nr.2748, datë 17.12.2014 të subjektit kërkues M.M. për pronën e pretenduar me sipërfaqe 67 dy, të ndodhura në fshatin Zallë, Krujë si pronë e të ndjerit Q.M.",* kërkime të cilat i kanë mbështetur tek nenet 31 e vijues të KPC-s, ligji nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar, ligji nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", ligji nr.44/2015 KPA,si dhe VKM nr.222, datë 23.03.2016 "Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës dhe kompensimit të saj".

12. Në analizë të shkakut ligjor të kërkimeve të paraqitura në padi, rezulton se konflikti mes palëve është krijuar si pasojë e nxjerrjes nga ana e paditur e vendimit nr.404, datë 28.12.2016, ku sipas paditësit i është mohuar e drejta e tij në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të Q.M., për t'u njohur pronar mbi pasurinë me sipërfaqe 67 dy, të ndodhur në fshatin Zallë, Krujë, si dhe kompensimin fizik të saj sipas njërës nga mënyrat e parashikuara në ligj. Sa më sipër, kjo e drejtë rregullohet në mënyrë të posaçme nga parashikimet e ligjit nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave".

13. Referuar përmbajtjes së akteve të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala paditëse në këtë gjykim e ka kundërshtuar vendimin nr.404, datë 28.12.2016 të nxjerrë nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, pasi kjo e fundit nuk e ka trajtuar dhe shqyrtuar në themel kërkesën e këtyre subjekteve, kërkesë e cila konsistonte në njohjen dhe kthimin e pronës, duke mos marrë një zgjidhje përfundimtare në lidhje me të. Rezulton që me vendimin e

sipërcituar, Agjencia e Trajtimit të Pronës nuk është shprehur në mënyrë shteruese nëse pretendimi i paditësve në lidhje me njohjen e të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme tokë me zë kadastral të papërcaktuar dhe me sipërfaqe 67 dy, si dhe kthimin fizik apo kompensimin e saj në një nga format që parashikon ligji, është në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin e zbatueshëm nr.133/2015 "*Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave*" apo jo. Kjo Agjenci, me vendimin objekt kundërshtimi në këtë gjykim, është shprehur për mbylljen e procedimit administrativ për shqyrtimin e të drejtës së pronësisë të pretenduar nga subjekti i shpronësuar Q.M. (trashëgimtarët e tij ligjorë), me arsyetimin se: *"...dokumentacioni tekniko-ligjor i administruar në dosjen e shqyrtimit me nr.4806, datë 29.12.2014, nuk është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.133/2015 dhe VKM nr.222, datë 23.03.2016 "Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës dhe kompensimit të saj"..."*.

14. Referuar nenit 26 të ligjit nr.133/2015, i titulluar Agjencia e Trajtimit të Pronës, është parashikuar se: "*1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Pronave, në vijim ATP-ja, person juridik publik, në varësi të Ministrit të Drejtësisë, me seli në Tiranë. ATP-ja kryen këto detyra dhe përmbush këto përgjegjësi: a) përfundon brenda afatit ligjor shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për trajtimin e pronës, për të cilat nuk është marrë vendim, duke kontrolluar, vlerësuar e konfirmuar: i) tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në këtë ligj; ii) vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara, përmes ballafaqimit me aktet ligjore e nënligjore ose vendimet gjyqësore, në përputhje me nenin 2, të këtij ligji, të cilat kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë të pronës nga shteti. Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së shprehet me vendim brenda afatit të përcaktuar në nenin 33, të këtij ligji, për: - rrëzimin e kërkesës; - njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kompensimin fizik brenda kufijve të pronës së njohur apo kompensimin nga fondi i tokës ose kompensimin financiar të pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, sipas përcaktimeve në këtë ligj;...*".

15. Në rastin objekt shqyrtimi, ka rezultuar e provuar se Agjencia e Trajtimit të Pronës e ka marrë në shqyrtim dosjen e palës paditëse dhe ka vlerësuar se dokumentacioni nuk është i plotë dhe në përputhje me kushtet dhe kriteret e ligjit. Në kushtet që pala paditëse nuk ka qenë dakord me vendimin e mësipërm, me të drejtë e ka bërë çështjen objekt konflikti

gjyqësor, duke pretenduar nëpërmjet tij, që jo vetëm të godasë aktin e nxjerrë nga pala e paditur, por njëkohësisht nëpërmjet këtij procesi gjyqësor, ai synon që të realizojë në themel edhe të drejtën e pretenduar prej saj (në rast se ajo qëndron, pasi këtë do ta vendosë gjykata pasi të realizojë hetimin gjyqësor), që ka lidhje me njohjen e të drejtës së pronësisë dhe trajtimin e saj sipas parashikimeve të ligjit. Për këtë arsye, në themel të kërkimit të palës paditëse qëndron e drejta e pronësisë si një e drejtë reale dhe si e tillë është një mosmarrëveshje me natyrë civile e cila duhet të gjykohet nga gjykatat e zakonshme civile.

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, e shikon të arsyeshme që të arsyetojë se, pavarësisht që Agjencia e Trajtimit të Pronave është person juridik publik nën varësinë e ekzekutivit (Ministrisë së Drejtësisë), kjo nuk e bën aktin e dalë prej saj të një natyre administrative, si dhe gjykimin për kundërshtimin e këtyre akteve të natyrës administrative. Kjo pasi, natyra e veprimtarisë së ATP-së është e njëjtë me atë që kanë pasur më përpara dhe Komisioni Kombëtar i Kthim Kompensimit të Pronave (KKKP) apo Komisioni Vendor i Kthim Kompensimit të Pronave (KVKKP), institucione këto të cilat në veprimtarinë e tyre, në ushtrim të kompetencave që u dha ligji nr.7698/1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish-pronarëve", i ndryshuar, si dhe Ligji nr. 9235/2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar, u morën me trajtimin dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të pronësisë që u krijuan si pasojë e shpronësimit, shtetëzimit apo edhe konfiskimit të pronave të paluajtshme nga shteti i kohës pas datës 29.11.1944

17. Në këtë kuptim, çdo kundërshtim, ndryshim, modifikim apo saktësim i këtyre lloj akteve, të cilat lidhen me të drejtën e pronësisë së subjekteve, të drejta këto që rregullohen nga e drejta civile, mund të bëhet vetëm në rrugë gjyqësore sipas parimeve të përcaktuara nga KPC. Ky fakt është shprehur mjaft qartë në vendimin nr.27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin, kjo gjykatë është shprehur se: *"...vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, në vite, nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (strictu sensu), por akte sui generis të nxjerra nga një organ sui generis, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë..."*.

18. Qëndrimi i mësipërm është konsoliduar edhe në Vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.4, datë 10.12.2013, që ka unifikuar praktikën gjyqësore duke u shprehur se: "*Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile. ...Në këto lloj gjykimesh nuk kemi të bëjmë me një kontroll të thjeshtë të një veprimtarie administrative. Kontrolli gjyqësor në këto gjykime i kalon caqet e kontrollit të një veprimtarie administrative. Nga ana e gjykatës merret në analizë jo vetëm e drejta e pronësisë, por edhe mënyra e fitimit të pronësisë, duke iu referuar për këtë qëllim instituteve të së drejtës civile që kanë rregulluar të drejtën e pronësisë në kohë të ndryshme.... gjykimet me objekt kundërshtim të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës apo të Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk janë gjykime që përfshihen në rrethin e atyre çështjeve që i përkasin fushës administrative, por mosmarrëveshje të natyrës civile, në të cilat subjekti pretendues kërkon të drejtën e pronës mbi një send të paluajtshëm, duke paraqitur për këtë qëllim prova në mbështetje të kësaj të drejte. Në gjykimet me objekt kundërshtim të vendimit të KKK të Pronave apo AKK të Pronave kemi të bëjmë me të drejta subjektive, edhe pse enti shtetëror publik KKKP (sot AKK e Pronave) shpreh vullnetin e tij nëpërmjet vendimeve të marra pas kërkesës së bërë nga subjektet e përkatëse. Vendimet e tyre nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte të mirëfillta administrative. Subjekti kërkues në një gjykim të zakonshëm kundërshton vendimin e KKK të Pronave apo AKK të Pronave dhe kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të së drejtës së tij të pronësisë..."*.

19. Në rastin konkret, paditësi kërkon të kundërshtojë ligjshmërinë e një vendimi të dhënë nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronave, me të cilin, efektivisht kësaj pale i është rrëzuar kërkesa për njohjen e të drejtës së pronësisë, si dhe të rregullojë pasojat që rrjedhin prej saj. Në kushtet kur vendimet e marra nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, kanë lidhje me të drejta pronësie dhe përbëjnë titull pronësie, në respektim kjo edhe të nenit 163 të Kodi Civil (KC)-s, ku thuhet se: "*Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë*", këto akte do të konsiderohen me natyrë civile, dhe për rrjedhojë edhe mosmarrëveshjet e lindura për kundërshtimin e këtyre akteve do te rregullohen nga ligji specifik i KC-s, si dhe do të trajtohen si konflikte civile.

20. Për sa i përket gjykatës kompetente (qoftë nga pikëpamja lëndore dhe qoftë nga pikëpamja funksionale) që do të marrë në shqyrtim mosmarrëveshjet që krijohen si pasojë e kundërshtimit të këtyre akteve, ky Kolegj, konstaton se sa më sipër e ka zgjidhur vetë ligjvënësi, i cili në nenin 29 të ligjit nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", të titulluar "Ankimi", ka parashikuar se: "Kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara

dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit, sipas rregullave të KPC-s të Republikës së Shqipërisë". Në analizë të kësaj dispozite ligjore, ligjvënësi ka parashikuar në mënyrë shteruese, pa lënë asnjë lloj mundësie për të bërë një interpretim ndryshe, se palët e interesuara (individët e prekur dhe Avokatura e Shtetit) kanë të drejtë të bëjnë ankim kundër vendimit të njohjes/ose mosnjohjes së të drejtës së pronësisë direkt në gjykatën civile dhe konkretisht në Gjykatën e Apelit, sipas rregullave të KPC-s.

21. Ky parashikim i bërë nga ligjvënësi, nuk është bërë pa qëllim dhe në asnjë rast ai nuk cënon parimet bazë të një procesi të rregullt gjyqësor, apo shkelje të të drejtave të subjekteve që marrin pjesë në këtë proçes, duke evituar një shkallë gjykimi. Qëllimi i ligjvënësit që këto çështje të shqyrtohen drejtpërdrejt në Gjykatën e Apelit, ka konsistuar në faktin që të mos kemi më zgjatje të procedurave të shqyrtimit për këtë kategori çështjesh, si dhe mbylljen sa më të shpejtë të këtij procesi, i cili ka një historik të tejzgjatur të tij prej rreth 22 vjetësh. Ky qëndrim është pohuar qartësisht edhe në vendimin nr.1/2007 të Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur se: *"... Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (shih, vendimin nr.10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese). ...shteti nuk ka detyrim të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi, për sa kohë që ka një ankim në një gjykatë të parashikuar me ligj, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës si dhe nenit 13 të* Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) *së...*".

22. Në kushtet kur çështja objekt shqyrtimi, nuk u përket asnjë prej parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.49/2013 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", por gjen mbështetje tek neni 8, germa "b", të po këtij ligji, ku pasqyrohet se: "*Gjykata Administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet:... b) shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër",* ky Kolegj vlerëson se kjo çështje nuk është e natyrës administrative dhe si e tillë, nuk është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

23. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson të prishë vendimin nr.116, datë 07.03.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke e dërguar këtë çështje pranë kësaj të fundit për vazhdimin e gjykimit.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2017-1541, datë 26.09.2017

Udhëzimet e nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit, rregullojnë në mënyrë më të hollësishme mënyrën dhe kushtet se si duhet të evidentohen veprime të caktuara, për të arritur në përfundime përkatëse për ligjshmërinë e këtyre veprimeve nga ana e administratës zbatuese si dhe për të shmangur abuzimet e mundshme nga ana e subjekteve të ligjit.

Sipas vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, për sa u përket rrethanave të faktit rezulton se, në datën 01.03.2010, nga ana e inspektorëve të palës paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DRTTM) Tiranë është ushtruar kontroll pranë personit të tretë "VA" SHA. Objekti i kontrollit ishte zbatimi i legjislacionit tatimor në disa fusha si në atë të tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), tatimin mbi të ardhurat, derdhja e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore etj., duke filluar nga viti 2007.

Pas përfundimit të kontrollit, pala paditëse DRTTM Tiranë ka nxjerrë aktin administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.4065/16 prot., datë 20.05.2011 duke u përcaktuar detyrimet për t'u paguar nga personi i tretë VA SHA së bashku me gjobat përkatëse në lidhje me TVSH, sigurimet shoqërore dhe tatim fitimin në shumën totale prej 548.593.320 lekë.

Personi i tretë VA SHA, për kundërshtimin e aktit administrativ të sipërcituar, ka ndjekur rrugën e ankimit administrativ në Drejtorinë e Apelimit Tatimor pranë palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT Tiranë), e cila, me vendimin nr.12603 prot., datë 20.10.2011 ka vendosur të ndryshojë aktin administrativ njoftim vlerësimi tatimor me nr.4065/16 prot., datë 20.05.2011 si më poshtë: *"1. Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr.4065/16 prot., datë 20.05.2011 nxjerrë nga DRT [...] 2. Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr.4065/16 prot., datë 20.05.2011, nxjerrë nga DRT [...] 3. Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr.16/4065 prot,. datë 20.05.2011 [...] 4. Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr.4065/16 prot., datë 20.05.2011. [...] 5. Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr.4065/16 prot., datë 20.05.2011 [...] 6. Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr.4065/16 prot., datë 20.05.2011 [...] 7. Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr.4065/16 prot., datë*

*20.05.2011 nxjerrë nga DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për detyrimin për tatimin mbi fitimin e vitit 2008 për shumën 6.283 371 lekë dhe gjobës në lidhje me këtë detyrim në shumën 1.570.841 lekë. […].*Në të tilla rrethana, për të kundërshtuar pjesërisht vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor, vetëm për pikat 5, 7 dhe 9 të tij, pala paditëse DRTTM Tiranë, duke thirrur si të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) Tiranë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më padi me shkak ligjor dhe objekt anulimin pjesërisht të aktit administrativ vendimi nr.12603, datë 20.10.2011 të së padituris DPT Tiranë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, me vendimin nr.2841, datë 26.03.2012, ka vendosur të pranojë rrëzojë padinë. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pala paditëse DRTTM Tiranë ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.335, datë 12.02.2013, duke parashtruar në thelb të njëjtin arsyetim mbi analizën dhe vlerësimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm, ka ardhur në përfundimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të mbetet në fuqi.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, pala paditëse DRTTM Tiranë ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në thelb, në rekurs, për sa i përket pretendimit për zbatim të gabuar të ligjit material, parashtrohet se në raportin e kontrollit të datës 19.05.2010, lidhur me shpenzimet e kryera për vitet 2007, 2008 dhe 2009, ka rezultuar se personi i tretë "VA" SHA ka përfituar shërbime të ndryshme nga shoqëri të huaja. Në shumicën e rasteve nga kontrolli që i është bërë dokumentacionit justifikues lidhur me këto shpenzime dhe likuidimin e faturave është konstatuar se, ndryshe nga sa parashikon ligji, këto likuidime janë bërë jashtë viteve ushtrimore përkatëse. Ky veprim i personit të tretë "VA" SHA vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 21/II të ligjit nr.8438/1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" dhe prandaj këto shpenzime konsiderohen të panjohura për efekt fiskal duke lindur detyrimin e personit të tretë të shlyejë tatim fitimin përkatës sipas aktit të njoftim vlerësimin tatimor. Një shpenzim njihet si i tillë për efekt fiskal vetëm kur ai është kryer realisht, pra në rastin kur fatura është shlyer efektivisht brenda vitit ushtrimor.

Në kundërshtim me dispozitën ligjore të sipërcituar pala e paditur DPT Tiranë ka pakësuar detyrimet përkatëse me arsyetimin se personi i tretë "VA" SHA e ka paguar tatimin në burim në lidhje me shërbimet e ofruara brenda vitit kalendarik, duke u bazuar në pikën 3/6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.06.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*". Midis përcaktimit që bën ligji dhe atij që bënë udhëzimi, dispozitat e ligjit kanë prioritet.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se shkaqet e ngritura në rekursin e paraqitur nga pala paditëse DRTTM Tiranë, lidhur me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, nuk gjejnë mbështetje në ligjin material dhe procedural. Motivet e tjera lidhen me çështje të faktit për të cilat nuk mund të investohet Gjykata e Lartë. Prandaj, vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë duhet të mbetet në fuqi.

Në nenin 21/2 të ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 *"Për tatimin mbi të ardhurat",* parashikohet se: *"Për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen si shpenzime, shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe menaxhim të faturuara nga persona të tretë, por të palikuiduara brenda periudhës tatimore nga tatim paguesi".*

Ndërsa në Udhëzimin nr.5, dt.30.01.2006 të Ministrit të Financave, i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8438/1998, në pikën 3/6 të tij, parashikohet se: *"Në bazë të nenit 21/2 të ligjit nr.8438/1998, nuk do të njihen si shpenzim i lejuar vlera e faturave të pranuara për shërbimet që janë kryer nga persona jo rezidentë, që nuk janë regjistruar në organet tatimore shqiptare, nëse brenda vitit kalendarik nuk është paguar tatim në burim për ato shërbime".*

Në interpretim dhe zbatim të drejtë të këtyre dispozitave, Kolegji Administrativ vëren se me të drejtë gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë arsyetuar se nuk ka konflikt në qëllimin dhe rregullat e përcaktuara në nenin 21/2 të ligjit nr.8438/1998 dhe në pikën 3/6 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 të Ministrit të Financave, i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Për sa i përket faktit, pas vlerësimit të provave, gjykatat kanë pranuar të vërtetuar se personi i tretë "VA" SHA ka paguar tatim në burim për të gjitha shpenzimet e përfituara nga shoqëritë e huaja, pra nuk i ka fshehur asnjëherë por i ka deklaruar këto veprime pranë organit tatimor dhe ka paguar tatimin përkatës që në burim brenda vitit kalendarik duke respektuar në këtë mënyrë si ligjin nr.8438/1998 ashtu edhe Udhëzimin nr.5/2006 të Ministrit të Financave. Për këtë fakt nuk ka pasur kundërshti edhe nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse.

Sa i përket ligjit të zbatueshëm dhe interpretimit të tij, Kolegji Administrativ vëren se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë kuptuar dhe interpretuar drejt qëllimin dhe përmbajtjen e tij. Me të drejtë gjykatat kanë arsyetuar që nuk rezulton kundërshti mes nenit 21/2 të ligjit nr. 8438/1998 dhe pikës 3/6 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 të Ministrit të Financave. Ky Udhëzim, i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8438/1998, synon dhe rregullon në mënyrë më të hollësishme mënyrën dhe kushtet se si duhet të evidentohen dhe cilësohen veprime të caktuara

financiare të tatimpaguesve sipas situatave të rregulluara nga ligji për të ardhur në përfundime përkatëse nëse ata kanë kryer ose jo deklarime të rregullta tatimore, kanë kryer ose jo pagesat përkatëse të këtyre detyrimeve tatimore.

Nga ana tjetër, sikurse me të drejtë ka konkluduar në procedurën administrative dhe ka prapësuar edhe në gjykim organi epror i palës paditëse, i paditur në këtë gjykim, Udhëzimi nr.5/2006 i Ministrit të Financave ka për qëllim të shmangë abuzimet e mundshme të tatimpaguesve shqiptarë, të cilët mundet që të pranojnë fatura shërbimesh nga persona të tretë, kryesisht subjekte të lidhur dhe t'i kontabilizojnë ato duke rritur artificialisht shpenzimet e tyre për të zvogëluar në këtë mënyrë detyrimet për tatimin mbi fitimin. Pikërisht për të mënjanuar mundësinë e këtij abuzimi, udhëzimi i mësipërm kushtëzon njohjen e këtyre shpenzimeve si të lejuara me pagimin e tatimit në burim të tyre brenda vitit kalendarik.

Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ çmon se, si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë zbatuar drejt ligjin kur kanë vlerësuar si të pabazuar në prova dhe në ligj kërkesëpadinë duke e rrëzuar atë.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-2037, datë 24.10.2017

Padia e cila nuk gëzon mbrojtje nga rendi juridik, për shkak se nuk ka bazë juridike në të drejtën objektive, nuk mund të ngrihet.

Pavarësisht nga natyra juridike publike apo private, subjektet e një kontrate janë në kushte të barabarta ndaj njëri-tjetrit. Vullneti kontraktor apo pëlqimi i palës për të marrë përsipër detyrimin është një nga kushtet e vlefshmërisë së një kontrate dhe nuk mund të kushtëzohet as nga një urdhërim i gjykatës apo organit tjetër administrativ.

I. Rrethanat e çështjes

1. Siç rezulton nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, pala paditëse E.K. pretendon që para vitit 1990 në qendër të qytetit të Fushë Krujës, me fondet e shtetit kishte filluar ndërtimi i një godine me kolona parafabrikat me sipërfaqe trualli dhe ndërtimi 500 m², dykatësh, me emërtimin "Kompleksi i Ushqimit Social", me kufizimet përkatëse.

2. Paditësi pretendon se procesi i ndërtimit është ndërprerë në fazën ku godina ishte vetëm karabina dy kate dhe, nga Dega Kombëtare e Privatizimit dhe ish ndërmarrja Tregtare Fushë Krujë që e kishte objektin në administrim në vitin 1992, filluan procedurat e privatizimit.

3. Paditësi ka blerë objektin kundrejt vleftës së përcaktuar me anë të kontratës së shitjes së datës 09.04.1992, së cilës i është bashkëlidhur edhe akti i dorëzimit të objektit. Kontratën e shitblerjes së sipërcituar paditësi e ka regjistruar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Krujë, siç rezulton nga vërtetimi hipotekor nr.73, datë 13.04.1992, në të cilin gjithashtu mungon përcaktimi sa kate është godina.

4. Ndodhur në këto kushte pala paditëse E.K. i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi duke pretenduar që gabimisht, në asnjërin prej tyre nuk është pasqyruar fakti që godina është dy kate.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr.92, datë 13.03.2014, ka vendosur: Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për shqyrtimin e çështjes me nr.47/352 akti. Dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. s'ka, datë 24.06.2014, ka vendosur të ngrejë përpara Gjykatës së Lartë, çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore, në lidhje me gjykimin e çështjes nr.4379 regj. them., dhe t'i kërkojë Gjykatës së Lartë që të vendosë se kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje (mosmarrëveshjeje) është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe jo Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2014-2303, datë 15.07.2014, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.92, datë 13.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1198, datë 09.03.2015, ka vendosur: - Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi E.K.. - Detyrimin e palës së paditur që në aktin e shitjes së objektit me emërtimin "Kompleksi i Ushqimit Social" me qendër në Fushë Krujë, me sipërfaqe 500 m2, të cilësohet që ky objekt ka qenë dykatësh. Shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësja në shumën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë lihen në ngarkim të palës së paditur. [...]

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1305 (128), datë 04.06.2015 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.1198, datë 09.03.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pushimin e gjykimit të çështjes. 9.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar si më poshtë: Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të prishet dhe çështja duhet të pushohet për shkak se jemi para një padie që nuk mund të ngrihet. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se gjykata nuk mund të shprehet për detyrimin e palëve për të ndërhyrë në një marrëdhënie kontraktore. Pala paditëse ka kërkuar gjyqësisht të ndërhyjë në marrëdhënien kontraktore midis palëve duke ndryshuar objektin e kontratës midis palëve dhe duke ndërhyrë në vullnetin kontraktor të palës. Gjykata e shkallës së parë ka disponuar mbi objektin e kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Nëse paditësi pretendon se objekti ka qenë dykatësh këtë mund ta bëjë duke zgjedhur mjete të tjera juridiko civile.

10. Kundër vendimit nr.1305 (128), datë 04.06.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka ushtruar rekurs pala paditëse E.K., i cili kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke parashtruar shkaqet e prezantuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

11. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se shkaqet e parashtruara në rekurs nga ana e paditësit E.K. nuk janë të tilla që do ta bënin të cenueshëm vendimin nr.1305 (128), datë 04.06.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit.

12. Vendimi nr.1305 (128), datë 04.06.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është prishur vendimi nr.1198, datë 09.03.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe është pushuar gjykimi i çështjes, rezulton të jetë një vendim i marrë në përputhje me dispozitat që normojnë institutin e padisë që nuk mund të ngrihet.

13. Nga faktet e pranuara në gjykimin në apel rezulton se paditësi ka lidhur një kontratë privatizimi për një objekt me palën e paditur, e cila është organi i ngarkuar me procesin e privatizimit të objekteve shtetërore që nuk i shërbejnë më interesit publik ose nuk i kanë kaluar në administrim apo pronësi një organi shtetëror me qëllim kryerjen e funksioneve të tij administrative.

14. Rezulton se në këtë kontratë përcaktohet sipërfaqja e truallit dhe e objektit por nuk jepen përcaktimet për lartësinë e objektit, pra nuk përcaktohet sa kate ka qenë ai. I njëjti përshkrim për objektin rezulton të jetë bërë edhe në vërtetimin hipotekor, që pasqyron faktin e regjistrimit të sendit, duke iu përmbajtur në këtë mënyrë titullit të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

15. Ndodhur në këto kushte paditësi i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur që të ndryshojë kontratën e lidhur me të, duke e cilësuar ndërtimin objekt kontrate dy kate. Sa më sipër rezulton se paditësi kërkon ndryshimin e vullnetit të palëve në kontratën e lidhur ndërmjet tyre.

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se më të drejtë Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se ndodhemi përpara një padie që nuk mund të ngrihet, pasi një padi e tillë nuk gëzon mbrojtje nga rendi juridik, duke qenë se nuk gjen bazë juridike në të drejtën objektive.

17. Kontrata është një veprim juridik i dyanshëm. Si e tillë, ajo është një shfaqje e ligjshme e vullnetit të personave fizikë ose juridikë me të cilën krijohet ndryshohet ose shuhet një marrëdhënie juridike. Personat juridikë, si palë të një kontrate mund të jenë privatë ose publikë. Këta të fundit mund të hyjnë në raporte juridike të së drejtës private (kontrata), si të gjithë subjektet e tjerë dhe në kushte të barabarta me ta, ose të së drejtës publike, me qëllim realizimin e një interesi publik.

18. Kontratat publike, edhe pse kanë disa karakteristika në raport me

kontratat e të drejtës private, si faktin që njëra nga palët duhet të jetë në çdo rast një organ publik dhe realizimin përmes saj të një interesi publik, sërish i nënshtrohen regjimit juridik të të drejtës private në lidhje me kushtet e vlefshmërisë së tyre.

19. Një nga kushtet e vlefshmërisë së një kontrate, sipas nenit 663 të KC-s, krahas shkakut të ligjshëm, objektit të kontratës dhe formës së saj, është edhe pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, ose i thënë ndryshe, vullneti kontraktor i palës.

20. Vullneti i një subjekti të së drejtës për të hyrë në një marrëdhënie kontratore përbën një shprehje të botës së brendshme të tij, një vendim i marrë në psikikën e individit, që shfaqet më tej në botën e jashtme. Në mënyrë që ky vullnet të jetë i vlefshëm është kusht *si ne qua non* që ai të jetë i lirë dhe i pavesuar. Kjo do të thotë se vullneti për të hyrë në raporte juridike duhet të ketë lindur në mënyrë të natyrshme tek subjekti, i pandikuar nga shkaqe të tilla si mashtrimi, kanosja, dhuna apo nevoja e madhe. Ai duhet të përbëjë një perceptim të saktë të fakteve të analizuara, të cilat përbëjnë bazën e vendimit të brendshëm dhe nuk duhet të jetë i nxitur nga faktorë të jashtëm të paligjshëm, në mungesë të të cilëve përfundimi nuk do të ishte i njëjtë.

21. Në rastin e personave juridikë, qofshin privatë apo edhe publikë, vullneti i tyre është vullneti i organeve me të cilat ata veprojnë, ku këta të fundit përbëhen nga individë. Pra, në këto kushte, është vullneti i këtyre të fundit që përbën edhe vullnetin e vetë personit juridik.

22. Duke qenë një shfaqje e lirë e botës së brendshme, vullneti për të lidhur kontratë, nuk mund të kushtëzohet as nga një urdhërim i gjykatës apo organit tjetër administrativ. Këtu duhet të bëjmë dallimin ndërmjet vullnetit për të krijuar, ndryshuar apo shuar një marrëdhënie juridike me vullnetin për konfirmuar pasojat e një veprimi të kryer më parë. Pra, nëse i pari përbën një vendimmarrje të lirë të subjektit të së drejtës dhe në asnjë rast dhe për asnjë arsye të imponuar, pasi synon krijimin e një situate të re, i dyti synon rregullimin e situatës së krijuar nga veprimi i paligjshëm i vetë këtij subjekti.

23. Si rrjedhojë, nuk mund të kërkohet përmes vendimit të gjykatës krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike pasi një vendim i tillë do ta vesonte vullnetin për të krijuar, ndryshuar ose shuar këtë marrëdhënie, i cili përbën një nga kushtet e vlefshmërisë së kësaj marrëdhënieje juridike.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-01436-00-2014, datë 31.10.2017

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm, në rastet kur gjykata në cilëndo fazë të gjykimit ka mendim të kundërt me ekspertin, gjykata ka detyrimin të arsyetojë me hollësi këtë qëndrim si në vendimet e dhëna gjatë apo në përfundim të gjykimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër me datë 25.10.2010. Me vendim të ndërmjetëm gjykata ka pranuar kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se pala paditëse ka në pronësi një pasuri të paluajtshme ndërtesë me sipërfaqe [...] fituar pronësinë mbi këto dy sipërfaqe të pandara nëpërmjet kontratës së privatizimit në vitin 1992.

3. Pala paditëse ka konstatuar se dy fqinjët e saj kanë filluar të ndërtonin shtesat mbi pronat e tyre, duke cenuar gëzimin e qetë të pronës së saj. Pasi ajo ka marrë dijeni mbi pajisjen e personave të tretë me leje ndërtimi mbi këto sipërfaqe, pala paditëse ka paraqitur ankim administrativisht tek Bashkia Bulqizë. Pasi nuk ka mundur të zgjidhë problemet në rrugën administrative, pala paditëse ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, duke kërkuar anulimin e lejeve të ndërtimit të dy personave të tretë.

4. Thirrja e personave të tretë si kërkesë është paraqitur nga pala paditëse që në aktin origjinar që ka konstituuar procesin, konkretisht që në padi. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka bërë objekt gjyqësor debati këtë kërkesë, por ka proceduar me njoftimin e personave të tretë. Njëkohësisht gjykata nuk ka marrë në analizë nëse kishte legjitimitet pala paditëse të thërriste personat e tretë si ndërhyrës dytësorë që do t'i bashkëlidheshin atij në proces dhe nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës së paditësit apo jo, sikurse parashikon neni 194 i KPC-s. As gjykata e apelit nuk e ka marrë në shqyrtim këtë çështje, duke moskonkluduar mbi formimin e rregullt të ndërgjyqësisë apo jo.

5. Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë Bulqizë ka miratuar sheshin e ndërtimit dhe lejen e ndërtimit për të dy personat e tretë,

respektivisht me vendimin nr.7, datë 16.04.2010 dhe vendimin nr.1, datë 28.09.2011, duke autorizuar ato të kryejnë ndërtimin e shtesave sipas kondicioneve të saktësuara aty. Ndodhur para këtyre kushteve, pala paditëse ka paraqitur padi në gjykatë.

6. Me vendimin nr.80, datë 16.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër është vendosur: "*Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr.612 regj me palë paditëse T.D., e paditur Bashkia Bulqizë, me objekt anulimin e lejes së ndërtimit nr.7, datë 16.04.2010 dhënë personit të tretë H.D., pasi ky gjykim nuk mund të vazhdojë për shkak të mungesës së objektit të gjykimit dhe të interesit të ligjshëm të gjykimit. 2. Pushimin e gjykimit të çështjes civile me palë: paditëse T.D., e paditur Bashkia Bulqizë objekt anulimin e lejes së ndërtimit nr.2, datë 16.03.1995 dhënë personit të tretë A.C. pasi paditësja hoqi dorë nga gjykimi i kësaj pike të padisë.*".

7. Me vendimin nr.294, datë 16.06.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur: "*Prishjen e vendimit nr.80, datë 16.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.*".

8. Me vendimin nr.00-2012-2111, datë 24.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është vendosur: "*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga H.D. kundër vendimit nr.294, datë 16.06.2011 të Gjykatës së apelit Tiranë.*". Sakaq, çështja ka shkuar për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

9. Me vendimin nr.226 (471-33-2013) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër është vendosur: "*1. Pranimin e kërkesëpadisë së paditëses T.D.. 2. Anulimin e akteve administrative: Vendimi nr.7, datë 16.04.2010, leje ndërtimi të dhënë nga pala e paditur Bashkia Bulqizë në favor të personit të tretë H.D. dhe vendimi nr.1, datë 28.09.2011, leje ndërtimi dhënë nga pala e paditur në favor të personit të tretë A.C.. 3. Detyrimin e palës së paditur KRRT Bashkisë Bulqizë, të rivendosë të drejtën e cenuar të paditëses, duke prishur strukturat ndërtimore të ndërtuara nga personat e tretë me lejet e mësipërme.*"[...].

11. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim personi i tretë H.D.. Në ankim është pretenduar se afati i kundërshtimit të akteve administrative ka mbaruar dhe se padia është paraqitur jashtë afatit. Personi i tretë ka parashtruar se paditëses nuk i ka ardhur asnjë pasojë e paligjshme dhe se ndërtimet janë bërë si pasojë e lejes së ndërtimit, i cili është një akt i ligjshëm. Në ankim parashtrohet se kondicionet urbane të rregullores së urbanistikës janë respektuar dhe se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të prishet dhe të lihet në fuqi leja e ndërtimit.

12. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim

edhe personi i tretë tjetër, A.C.. Edhe ai ka parashtruar në ankim të njëjtat pretendime sikurse personi i tretë H.D.. Në përfundim të ankimit është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pushimi i gjykimit të çështjes dhe nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit, për sa i përket objektit të padisë ku kundërshtohej leja e tij e ndërtimit të shtesës.

13. Me vendimin nr.2625, datë 12.12.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka vendosur: "*Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes nr. Regj. Them. 4447, datë 10.08.2013. Dërgimin për kompetencë shqyrtimi Gjykatës Administrative të Apelit.*".

14. Më datë 13.01.2014 pranë Gjykatës Administrative të Apelit është depozituar një Memo (shtesë ankimi) nga ankimuesi, personi i tretë A.C. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka njoftuar palët për këtë akt që ka zgjeruar objektin e shqyrtimit të çështjes në shkallë të dytë. Në shtesën e ankimit parashtrohet se gjykata nuk ka formuar rregullisht ndërgjyqësinë, pasi personat e tretë duhet të thërriteshin si palë të paditura. Në shtesën e ankimit është parashtruar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur rregullat mbi ndryshimin e objektit të padisë. Në shtesën e ankimit pretendohen edhe shkelje të tjera procedurale dhe në përfundim kërkohet pavlefshmëria e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe e të gjithë procedurës së gjykimit.

15. Me vendimin nr.34, datë 16.01.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit ka vendosur: "*1. Ndryshimin e vendimit nr.226, datë 10.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. 2. Rrëzimin e padisë së paditëses T.D.. Heqjen e masës së sigurimit të padisë vendosur me vendimin e datës 13.02.2013*". Gjykata e apelit ka vendosur në dhomë këshillimi.[...].

18. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse, T.D., me datë 12.02.2014. Rekursi u është njoftuar palëve ndërgjyqëse dhe nuk rezulton të ketë kundër-rekurs. [...].

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrative të Gjykatës së Lartë

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pas shqyrtimit të akteve të fashikullit të gjykimit dhe pretendimeve të palëve, konkludon se edhe gjykata e shkallës së parë edhe gjykata e apelit kanë lejuar shkeljen e normave procedurale që kanë shkaktuar pavlefshmërinë e procesit gjyqësor në të dy shkallët. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se të dy vendimet duhet të prishen dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

20. Kolegji sjell në vëmendje se Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar ndër të tjera se gjykata e shkallës së parë ka cilësuar gabim objektin

e mosmarrëveshjes, kur ka lejuar që personat e tretë të legjitimoheshin me këtë cilësi procedurale, dhe sakaq është zbatuar gabim neni 192 i Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s. Më tej gjykata e apelit ka vlerësuar se ndërgjyqësia është ndërtuar gabim, por duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme dhe faktin që çështja është rigjykuar në shkallë të parë, gjykata e apelit ka vlerësuar se çështja nuk mund të kthehet për rigjykim. Pavarësisht këtij arsyetimi gjykata, Gjykata Administrative e Apelit e ka gjykuar çështjen si shkallë e dytë gjykimi, duke ushtruar juridiksion rishikues dhe sipas ritit të gjykimit kameral, që do të thotë në dhomë këshillimi.

21. Kolegji vlerëson se kjo mënyrë procedimi e Gjykatës Administrative të Apelit ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor të palëve ndërgjyqëse, konkretisht në elementin e gjykatës së caktuar me ligj. Neni 467/a i KPC-s, i cili është i zbatueshëm edhe për gjykimin administrativ sipas nenit 1, pika 2, të ligjit nr.49/2012, parashikon se: "*Gjykata e apelit kur prish vendimin nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë.*". Kjo do të thotë se Gjykata Administrative e Apelit, duke qenë se ka konkluduar mbi ekzistencën e një gabimi në procedim (*errores procedendo*) gjatë rigjykimit në shkallë të parë, do të duhej më parë që me vendim të prishte vendimin përfundimtar të rigjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykonte vetë më tej çështjen si gjykatë e shkallës së parë.

22. Mosformimi i rregullt i ndërgjyqësisë përbën një gabim në procedim që shkakton nulitetin e gjykimit, në bazë dhe për zbatim të nenit 467, shkronja "d", të KPC-s. Kjo e metë procedurale e procesit nuk mundet të konvalidohet, veçse duke u rigjykuar çështja nga e para dhe duke u marrë vendimet e nevojshme nga gjykata dhe duke u ushtruar kërkesat e nevojshme nga palët për të rregulluar pozicionimin e çdo ndërgjyqësi në rolin e tij natyral procedural. Ekzistenca e këtyre të metave procedurale ndalon gjykatën e shkallës së parë, gjykatën e apelit apo edhe Gjykatën e Lartë nga dhënia e një vendimi mbi meritat e çështjes, pasi mungon një ndër prezumimet procedurale të vlefshmërisë së procesit.

23. Kolegji sjell në vëmendje edhe Vendimin Unifikues nr.979, datë 29.09.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera është unifikuar praktika gjyqësore mbi zbatimin e nenit 467/a të KPC-s. Në këto raste gjykata e apelit nuk ushtron juridiksion rishikues, por ushtron juridiksion fillestar mbi çështjen, pasi gjykimi në shkallë të parë ka qenë i pavlefshëm dhe se çështja nuk kthehet dot më në gjykatën e shkallës së parë, por duhet të gjykohet si shkallë e parë nga gjykata e apelit.

24. Për rrjedhojë, gabimi i dytë i gjykatës së apelit janë mënyra se si ka proceduar me njoftimet e palëve. Në momentin që vendoset prishja në

dhomën e këshillimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe çështja duhet të gjykohet si gjykatë e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk mund të njoftojë më palët për seancën gjyqësore me shpallje, pasi njoftimi në këto raste duhet të bëhet sipas rregullave të përgjithshme, duke u bazuar në nenin 128 e vijues, të KPC-s. Gjykata e apelit në të gjitha rastet e gjykimit si gjykatë e shkallës së parë do të thotë se e mban çështjen për gjykim në fakt dhe se, edhe neni 460, pika 6, i KPC-s, edhe neni 51, pika 2, i ligjit nr.49/2012, detyrojnë gjykatën e apelit të njoftojë palët personalisht apo tek përfaqësuesit e tyre, sipas rregullave të zakonshme të njoftimit. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se gjykimi në gjykatën e apelit ka cenuar të drejtën e procesit të rregullt ligjor të palëve ndërgjyqëse, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)-së dhe neneve 33 e 42, të Kushtetutës, duke gjykuar pa u dhënë mundësi palëve të dëgjohen.

25. Gabimi tjetër procedural i gjykatës së apelit është riti i gjykimit i ndjekur në gjykimin e çështjes, duke e gjykuar atë kameralisht apo në dhomë këshillimi. Kolegji sjell në vëmendje se Gjykata Administrative e Apelit, sipas ligjit procedural, mund të gjykojë në dhomë këshillimi (*si rregull i përgjithshëm, shiko nenin 49 të ligjit nr.49/2012*) dhe në seancë gjyqësore (*si përjashtim nga rregulli, shiko nenin 51 të ligjit nr.49/2012*). Duke qenë se gjykimi në seancë gjyqësore është përjashtim nga rregulli, neni 51 i ligjit nr.49/2012 parashikon rastet se kur gjykimi në shkallë të dytë duhet të jetë plenar.

26. Neni 51 i ligjit nr.49.2012 parashikon se: "*1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. 2. Vendimi i mësipërm, data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve rregullisht nga sekretaria gjyqësore, të paktën 10 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore.*".

27. Kolegji vlerëson se në të gjitha rastet kur gjykata e apelit, në bazë të nenit 467/a të KPC-s, prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykon çështjen si gjykatë e shkallës së parë, ajo është e detyruar ta kalojë çështjen në seancë gjyqësore për gjykim dhe të procedojë me njoftimin sipas rregullave të përgjithshme të palëve. Duke mos proceduar sipas kësaj mënyre dhe riti gjykimi, gjykata e apelit ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, duke shkelur standardin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të

drejtën e palëve për t'u dëgjuar para se të gjykohen.

28. Kolegji vlerëson se arsyetimi i gjykatës së apelit mbi shkeljen e rregullave ligjore të detyrueshme mbi formimin e ndërgjyqësisë është i drejtë në thelb, por është i pamjaftueshëm dhe se nuk është pasuar nga vendimmarrja e ligjshme respektive pas konstatimit të një shkeljeje të tillë nga gjykata rishikuese. Kolegji sjell në vëmendje se ndërgjyqësia e rregullt në procesin civil dhe administrativ është një prezumim procedural për vlefshmërisë e procesit (*shiko, nenin 467/d të KPC-s*). Ndaj KPC parashikon rregulla të posaçme mbi cilësinë procedurale të palëve kryesore të procesit (*shiko, nenin 90 të KPC-s*), mbi cilësinë e ndërgjyqësve dytësorë (*shiko, nenet 191, 192 dhe 193, të KPC-s*) dhe rregulla mbi të drejtat e palëve dhe detyrat e gjykatës mbi formimin e rregullt të ndërgjyqësisë (*shiko, 154, 161/c, 194 dhe 467/d, të KPC-s*).

29. Formimi i ndërgjyqësisë në ligjin procedural më së pari parashikohet si e drejtë e palës paditëse dhe më tej rregullohet në ligj në mënyrë të detajuar, duke ngarkuar me detyra gjykatën për të legjitimuar një ndërgjyqës në gjykim apo jo. Si rrjedhojë logjike e disponibilitetit maksimal të padisë, pala paditëse në rastin e ndërgjyqësisë fakultative, mundet të përcaktojë lirisht se kush janë palët e paditura të cilëve ai do t'u kundrejtojë pretendimet e tij. Në rastin e ndërgjyqësisë së nevojshme apo të detyrueshme, palës paditëse i mbetet vetëm vlerësimi nëse do ngrejë padi apo jo, pasi rrethi i ndërgjyqësve pasivë përcaktohet nga ligji apo nga natyra juridike e marrëdhënies që lidh të padituri (*shiko, nenin 162, paragrafi i dytë, i KPC*).

30. Ndërgjyqësia në procesin gjyqësor administrativ dhe civil mundet të jetë *ndërgjyqësi kryesore*, e cila përbëhet nga rrethi i palëve në emër ose kundër të cilëve zhvillohet procesi (*shiko, nenin 90 të KPC-s*). Ndryshe, këta ndërgjyqës njihen si *palët në kuptimin e ngushtë*, pasi në mënyrë të drejtpërdrejtë ata fitojnë apo konfirmojnë të drejta dhe marrin përsipër detyrime nga vendimi gjyqësor përfundimtar. Këto palë janë paditësi, i padituri, kundërpaditësi, kërkuesi në gjykimet gracioze, apo ndërhyrësi kryesor. Duke qenë se procesi gjyqësor civil apo administrativ zhvillohet në emër apo kundër tyre, në varësi nga pozita aktive apo pasive procedurale me të cilën janë legjitimuar proceduralisht në proces, gjykata me vendim përfundimtar mundet t'i ngarkojë ato me detyrime, mundet t'u akordojë atyre të drejta dhe mundet t'i ngarkojë ato me shpenzime gjyqësore (*shiko, nenin 109 të KPC-s*). Për më tepër vetëm palët në kuptimin e ngushtë munden të disponojnë mbi objektin e mosmarrëveshjes (*shiko, nenin 195 të KPC-s*), të thërrasin palë të tjera në gjykim, të thërrasin persona të tretë në gjykim, të zgjidhin mosmarrëveshjen me pajtim apo të gëzojnë të drejtë apeli dhe rekursi të pakushtëzuar, si ndaj vendimeve të ndërmjetme, jopërfundimtare apo përfundimtare të gjykatës.

31. Nga ana tjetër, procesi gjyqësor civil apo administrativ njeh edhe bashkësinë apo kategorinë e ndërgjyqësve dytësorë, e cila njihet si *ndërgjyqësia dytësore*, të cilët kanë një pozitë procedurale të ndryshme nga ndërgjyqësit kryesorë. Ata marrin pjesë në proces në kushte të caktuara (*shiko, nenet 191, 192 dhe 193, të KPC-s*) dhe sipas skenarëve proceduralë të caktuar nga ligji, parashikime që kanë për qëllim të mundësojnë aksesin në gjykatë edhe për personat që kanë interes mbi çështjen dhe mundësi reale dhe të drejtë për t'u dëgjuar para se të gjykohen. Ndryshe nga ndërgjyqësit në kuptimin e ngushtë, ndërgjyqësit dytësorë që lidhen indirekt nga produkti përfundimtar i procesit gjyqësor, nuk mund të ngarkohen me detyrime nga vendimi përfundimtar dhe nuk mundet të ngarkohen me shpenzime gjyqësore. Ata, gjithashtu, nuk mund të disponojnë mbi objektin e mosmarrëveshjes, nuk mund të zgjidhin çështjen me pajtim, nuk mund të thërrasin ndërgjyqës të tjerë në gjykim dhe kanë të drejtë të kushtëzuar apeli apo rekursi. Gjithashtu, këta ndërgjyqës, në kuptimin e gjerë, nuk mund të paraqesin kundërpadi apo të zgjerojnë objektin e mosmarrëveshjes.

32. Nga ana tjetër, në nenin 162 të KPC-s vihen re dy kategori të tjera të ndryshme të llojeve të ndërgjyqësisë: *ndërgjyqësia e detyrueshme* dhe *ndërgjyqësia fakultative*. Në rastin e ndërgjyqësisë së detyrueshme palët, aktive apo pasive të procesit, janë së bashku në njërën apo tjetrën pozitë, jo si pasojë e disponimit maksimal të padisë apo parimit të disponibilitetit, por si pasojë e parashikimit të ligjit dhe natyrës juridike të mosmarrëveshjes apo marrëdhënies juridike civile/administrative që ato kanë me njëra-tjetrën. Në këto raste, nëse paditësi nuk ka thërritur të gjithë bashkëndërgjyqësit e nevojshëm apo të detyrueshëm, padia është me të meta, pasi ai ka detyrimin ligjor të thërrasë si të paditur këdo bashkëtitullar të së drejtës që ai pretendon të konfirmojë gjyqësisht (*shiko për analogji, saktësimin e bërë nga ligjvënësi nenin 161, të KPC-s, të ndryshuar në vitin 2017*).

33. Në këto raste disponibiliteti maksimal i padisë së paditësit kufizohet vetëm tek e drejta për të bërë të vlefshëm në emrin e tij procesin apo jo, apo thënë ndryshe e drejta për të ngritur padi apo jo. Në këto raste rrethi i ndërgjyqësve përcaktohet jo nga vullneti i palës apo nga vendimmarrja e gjykatës, por vetëm nga ligji dhe natyra juridike e marrëdhënies. Gjykata në këto raste ngarkohet nga ligji që të zbatojë ligjin procedural, në mënyrë që askush të mos lejohet që në emrin e tij të bëjë të vlefshme të drejtat e dikujt tjetër (*shiko, nenin 95 të KPC-s*) dhe nga ana tjetër të mos lejojë që askush të gjykohet pa iu dhënë mundësia për t'u dëgjuar (*shiko, nenet 33 dhe 42, të Kushtetutës*[11]).

[11] Shiko për më tepër edhe nenin 161 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar, që hyn në fuqi në datë 05.11.2017.

34. Nga ana tjetër, të gjitha marrëdhëniet e tjera që formohen ndërmjet bashkëndërgjyqësve në procesin gjyqësor civil apo administrativ janë lloji i bashkëndërgjyqësisë fakultative, ku rrethi i personave si bashkëpaditës apo bashkëtëpaditur varet nga e drejta dhe fakulteti që ligji i njeh paditësit për të vendosur se kujt ia kundrejton pretendimet në padi, apo thënë ndryshe është rrjedhojë dhe përditësim i parimit të disponibilitetit maksimal të padisë. Këtu gjykata ka rol pasiv dhe për thirrjen e palëve kryesore apo dytësore në proces iniciativën e kanë palët. Gjykata merr autoritet procedural vetëm në verifikimin e plotësimit apo jo të kritereve ligjore të krijimit dhe shtimit të ndërgjyqësisë dytësore fakultative.

35. Nisur nga ky regjim juridik procedural konkludohet se ndërgjyqësia dytësore, apo thënë ndryshe personat e tretë, nuk mund të jenë pjesë e ndërgjyqësisë së detyrueshme, pasi në këtë kategori palësh bëhet fjalë vetëm për palët në kuptimin e ngushtë, me të gjitha karakteristikat e treguara më lart. Ndërkohë mbetet që regjimi juridik i marrëdhënieve procedurale që krijohen ndërmjet palëve dhe personave të tretë dhe gjykatës nga ana tjetër të zgjidhen sipas regjimit juridik të ndërgjyqësisë fakultative.

36. Nga kjo analizë mund të konkludohet në çdo çështje nëse është respektuar apo jo një ndër prezumimet procedurale për vlefshmërinë e procesit gjyqësor civil apo administrativ, sikurse është prezumimi i ndërgjyqësisë së rregullt. Në çështjen objekt gjykimi Kolegji sjell në vëmendje se konflikti civil objekt gjykimi ka lindur nga fakti se pala paditëse, e cila pretendon se i cenohet e drejta e pronësisë, ka ngritur padi për anulimin e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Bulqizë, duke e thërritur këtë subjekt si të paditur dhe duke i kërkuar të paditurit prishjen e ndërtimeve. Njëkohësisht, pala paditëse ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar punimet e ndërtimit dhe ka thërritur me cilësinë e personit të tretë dy titullarët e lejeve të ndërtimit. Kërkesa për thirrjen e personave të tretë është ndërfutur dhe paraqitur në padi. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk e ka bërë objekt debati ligjshmërinë e kësaj kërkese, duke mos vendosur mbi legjitimimin dhe bazueshmërinë në ligj të një kërkese të tillë, por duke i legjitimuar ato me veprime konkludente, sikur mjaft të thërriten nga palët personat e tretë dhe kaq të mjaftojë për t'i legjitimuar ato në proces me këtë cilësi procedurale.

37. Kolegji vlerëson se kjo qasje nuk është ligjore dhe se vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit procedural mbi formimin e ndërgjyqësisë. Kolegji vlerëson se qëndrimi pasiv i gjykatës mbi formimin e ndërgjyqësisë mundet të pranohet vetëm në rastet kur është e drejtë e palës paditëse për të thërritur të paditurin, që do të thotë se mundet të pranohet

vetëm në rastin e ndërgjyqësisë fakultative kryesore. Në të gjitha rastet e tjera ligji procedural vendos gjykatën në pozita kontrolli dhe vendimmarrëse, që do të thotë se gjykata duhet të kujdeset për të formuar ndërgjyqësinë, duke vlerësuar ligjshmërinë e çdo kërkese të palëve.

38. Kolegji vlerëson se në procesin gjyqësor civil dhe administrativ gjykata është aktive në rolin e garantimit të procesit të rregullt ligjor dhe respektimin e ligjit procedural dhe aq më tepër kur bëhet fjalë për ndërgjyqësinë. Në këtë logjikë neni 194 i KPC-s parashikon se: "*Gjykata pranon marrjen pjesë të personit të tretë në gjykimin civil me vendim të ndërmjetëm*". Kjo do të thotë se gjykata rast pas rasti, kur ka kërkesa të tilla nga palët, kryen një proces vlerësimi dhe hulumtimi, nëse janë respektuar kërkesat ligjore për pjesëmarrjen e personave të tretë në proces apo jo. Kështu, kërkesa e paraqitur nga paditësi për thirrjen si person të tretë të një subjekti të caktuar nuk mund të pranohet kurrsesi apriori, pavarësisht se paraqitet gjatë gjykimit apo është e ndërfutur në aktin origjinar që gjeneron procesin. Përkundrazi, gjykata duhet të kryejë një operacion intelektual, një vlerësim ligjor të kushteve për të pasur një ndërhyrje dhe për të formuar një ndërgjyqësi të tillë të propozuar nga njëra prej palëve. Kjo do të thotë se më së pari palët ftohen të debatojnë mbi pranueshmërinë dhe legjitimitetin e kërkesës për thirrjen e personave të tretë, duke nënkuptuar edhe personat e tretë të kërkuar për t'u legjitimuar, dhe më tej gjykata me vendim të ndërmjetëm vendos të legjitimojë apo jo personin e tretë si ndërgjyqës dytësor në proces.

39. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar fare legjitimitetin e personave të tretë dhe duke mos hulumtuar mbi këtë çështje ka lejuar formimin e një ndërgjyqësie të gabuar. Duke pasur parasysh marrëdhënien e krijuar ndërmjet palëve del se pala paditëse fillimisht pretendon se organi i administratës publike ka shkelur ligjin, duke miratuar leje të ndërtimit që cenojnë gëzimin e qetë të pronës së saj dhe nga ana tjetër cenojnë edhe kondicionet urbane të pronës. Njëkohësisht pala paditëse kërkon të anulojë gjyqësisht lejet e ndërtimit, titullarë të të cilave janë personat e tretë të thërritur nga ajo, të cilët po ndërtojnë pjesët e ndërtimit që pala paditëse pretendon se cenohet në pronësi.

40. Kjo do të thotë se pala paditëse me personat e tretë që kërkon të thërrasë në gjykim e ka çështjen krejt të kundërt dhe se vetëm të përbashkët nuk mundet ta ketë. Kolegji vlerëson se, kërkesa e paditësit nuk gjen mbështetje ligjore në rregullat e përgjithshme të gjykimit si nenet 189, 191, 192 apo 193, të KPC-s, pasi personat e tretë në këtë proces kanë interesa të kundërt me paditësin dhe si të tillë nuk mund të thërriten nga pala paditëse, sipas mundësisë që ofron neni 192 i Kodit (*ndërhyrje dytësore e detyruar*). Duke pasur interesa diametralisht të kundërt ata nuk mund të bashkohen

me njëri-tjetrin kurrsesi në një padi të tillë.[12] Aq më shumë, nuk mund të thirret si *ndërhyrje dytësore vullnetare* (*neni 191 i Kodit*), pasi nuk ka asnjë kërkesë nga vetë subjekti që kërkohet të futet rishtazi në proces. Gjithashtu, edhe neni 193 i Kodit nuk mund të gjejë zbatim pasi do të ishte krejtësisht në kundërshtim me disponibilitetin maksimal të padisë (*shiko, nenin 6 dhe 28 i KPC-s*) dhe se gjykata do të vendoste personat e tretë në një pozitë procedurale inferiore në krahasim me palët në kuptimin e ngushtë, duke mos gëzuar të drejta dhe mjete procedurale mbrojtëse të barabarta me ato që kanë palët. Kjo do të përbënte cenim të procesit të rregullt ligjor në elementin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe barazisë së armëve.

41. Kolegji sjell në vëmendje se neni 192 i KPC-s (ndërhyrja dytësore e detyrueshme) mund të shërbejë si bazë ligjore për të legjitimuar një person të tretë vetëm kur ai e ka të përbashkët çështjen me palën që e thërret në gjykim, është i lidhur me palën kryesore me një garanci apo shpërblim që duhet t'i japë atij në fund të gjykimit. Kolegji vlerëson se, duke qenë se, thërritja si person i tretë është një e drejtë që i rezervohet vetëm asaj pale që e ka të përbashkët çështjen, apo që marrëdhënia e posaçme e së cilës i jep të drejtë asaj t'i kërkojë në fund të gjykimit personit të tretë ndonjë garanci apo shpërblim, KPC ravijëzohen sakaq një mënyrë të posaçme mbrojtjeje për këta dy ndërgjyqës. Në këtë kuptim nuk ka asnjë kuptim logjik, përveç se është një shkelje e ligjit, fakti që njëra palë t'i diktojë palës tjetër mënyrën se si duhet të mbrohet apo se cilin person duhet të ketë përkrahë proceduralisht.

42. Kolegji vlerëson se objekti i drejtpërdrejtë i mosmarrëveshjes në këtë çështje kanë qenë të drejtat e pronësisë së paditësit dhe të personave të tretë dhe se çdo vendim eventual përfundimtar i gjykatës do të mund të prekte të drejtat dhe detyrimet e tyre. Në këtë kuptim, nuk mund të lejohet nga gjykata që ndërgjyqësit që duhet të jenë palë kryesore në proces (*shiko, nenin 90 të KPC-s*) të legjitimohen në pozitën procedurale të ndërgjyqësit dytësor. Ashtu sikurse u sqarua më lart, ndërgjyqësit dytësorë nuk mund të disponojnë mbi objektin e padisë, kanë të drejtë të kushtëzuar ankimi, nuk mund të sillen të pavarur nga pala kryesore të cilës i bashkëngjiten, nuk mund të zgjidhin mosmarrëveshjen me pajtim dhe nuk mund të disponojnë mbi ndryshimin e ndërgjyqësisë apo të paraqesin kundërpadi.

43. Kolegji sjell në vëmendje se në çdo rast, para vlerësimit dhe zbatimit të nenit 467, shkronja "d", të KPC-s, gjykatës i del për detyrë për të hulumtuar e

[12] Shiko, Vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr.11111-00166-00-2005 i Regj. Themeltar, nr.00-2006-674 i Vendimit (1164), datë 7 18.10.2006; gjithashtu edhe Vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr.11243-00454-00-2007 i Regj. Themeltar, nr.00-2009-1335 i Vendimit (455), datë 22.12.2009.

më tej për të konkluduar se çfarë marrëdhënie civile ka ndërmjet subjekteve palë në proces dhe nga ky konkluzion duhet të konkludohet për llojin e ndërgjyqësisë ndërmjet tyre. Nëse konkluzioni mbi marrëdhënien materiale ndërmjet palëve është i gabuar atëherë edhe konkluzioni procedural mbi llojin e ndërgjyqësisë do të jetë i tillë dhe kjo sjell zbatimin e gabuar ndër të tjera edhe të nenit 467, shkronja "a", të KPC-s.

43. Duke pasur parasysh objektin e mosmarrëveshjes dhe pretendimet e palës paditëse gjykata e shkallës së parë duhet të kishte konkluduar personat e tretë duhet të ishin thërritur në gjykim si palë të paditura nga pala paditëse dhe se padia që në mënyrën se si ishte formuar ndërgjyqësia pasive kryesore paraqiste të meta të tilla procedurale që nuk mund të konstituonte dot proces gjyqësor të vlefshëm. Gjykata e shkallës së parë duhet të kishte konstatuar në dhomë këshillimi ose në seancë përgatitore se padia kishte të meta procedurale, duke qenë se nuk ishin përcaktuar drejt personat që kërkohen të ngarkohen me detyrime apo personat përgjegjës për nga mënyra se si ishin formuluar kërkimet nga objekti padisë (*shiko, neniet 154, 162 paragrafi i dytë, të KPC-s*). Sakaq pala paditëse duhet të kishte rregulluar të metat procedurale, duke kërkuar thirrjen me cilësinë e palës së paditur të personave të tretë, sipas nenit 161/c të KPC-s. Vetëm pas këtij rregullimi të ndërgjyqësisë gjykata do të kishte të mundur të gjykonte çështjen në mënyrë të vlefshme dhe secila prej palëve do të gëzonte të gjitha fakultetet procedurale të mjeteve të mbrojtjes. Moszbatimi i këtyre detyrimeve procedurale ka shkaktuar gëzimin e pabarabartë të mjeteve dhe të të drejtave të palëve dhe vendosjen e tyre në pozicionet e papërshtatshme procedurale, duke shkaktuar, sipas nenit 467/d të KPC-s, mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë dhe duke zhvilluar sakaq një proces të pavlefshëm.

44. Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim tek çështja e pranueshmërisë së ankimit të personit të tretë, nëse mund ai të gëzojë të drejtën e ankimit në mënyrë të pavarur dhe të pakushtëzuar nga pala kryesore së cilës i bashkëlidhet. Kolegji vlerëson se personi i tretë ndërhyrës dytësor, që i bashkëlidhet njërës nga palëve në kuptimin e ngushtë, nuk mund të gëzojë të drejtë të pavarur dhe të pakushtëzuar ankimi nga pala kryesore. Duke qenë se, bazuar në nenin 109 të KPC-s, vendimi përfundimtar i gjykatës nuk mund të ngarkojë këta ndërgjyqës me detyrime dhe pagimin e shpenzimeve gjyqësore, rrjedhimisht ligji nuk mund të lejojë ankimin e pakushtëzuar dhe të pavarur të subjekteve që nuk preken drejtpërdrejt nga vendimi, i cili as nuk mund të ekzekutohet ndaj tyre. Nga ana tjetër Kolegji vlerëson se, sikurse vetëm palët në kuptimin kryesor mund të disponojnë mbi objektin e mosmarrëveshjes, vetëm apo mund të disponojnë në mënyrë të pavarur dhe të pakushtëzuar

edhe mbi mjetet e ankimit, apel apo rekurs. Disponimi mbi padinë apo ankimet përbën një veprim disponimi të jashtëzakonshëm dhe kjo kategori veprimesh procedurale u njihet ekskluzivisht vetëm palëve në kuptimin e ngushtë në procesin gjyqësor civil dhe administrativ.

45. Kolegji konstaton se Gjykata Administrative e Apelit ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor të palës paditëse, në elementin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit, pasi ka pranuar të marrë në shqyrtim një akt procedural shtesë ankimi nga një nga personat e tretë, pa ia bërë me dije atë palës kundërshtare dhe pa lënë mundësi për këtë të fundit të mbrohet dhe të prapësojë. Fillimisht Kolegji vlerëson se gjykatat me juridiksion rishikues duhet të kenë parasysh se palët e gëzojnë të drejtën e ankimit ekskluzivisht brenda afateve të parashikuara në ligj dhe se këto afate, duke pasur natyrë prekluzive, nuk mund të zgjaten. Kjo do të thotë se gjykatat e larta, kur ushtrojnë juridiksion rishikues nuk mund të pranojnë të marrin në shqyrtim apo të bëjnë objekt të gjykimit shkaqe të reja ankimi të paraqitura me shkresa të palëve jashtë afatit 15 ditor për apelimet dhe 30 ditor për rekurset.

46. Gjykatat e larta duhet të tregohen të kujdesshme që të mos dalin jashtë kufijve të shqyrtimit mbi mjetin e ankimit të cilin janë investuar të gjykojnë, kur bëhet fjalë për shkaqe ankimi të reja, të papërfshira në ankimin e paraqitur dhe të kërkueshme vetëm mbi iniciativën e palëve. Kjo do të thotë se, edhe sikur palët të paraqesin shkaqe të reja ankimi në akte procedurale të mëvonshme se ankimi, nëse gjykata vlerëson se këto shkaqe mundet të ngrihen vetëm me iniciativën e palëve dhe nuk mund të merren parasysh kryesisht nga gjykata, atëherë gjykata duhet të kuptojë se ato shkaqe nuk mund të shqyrtohen dhe nuk mund të bëhen pjesë të objektit të gjykimit, pasi ato konsiderohet se kanë rënë në prekluzivitet (*shiko, nenin 459 të KPC-s*).

47. Nga ana tjetër, për çfarëdo shkak ankimi që palët zgjerojnë kontestin e ligjshmërisë së tyre ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, me akte procedurale të paraqitura veçmas dhe më vonë se ankimi kryesor, pavarësisht nëse këto shkaqe ngrihen vetëm me iniciativën e palëve apo mund të merren parasysh kryesisht nga gjykata, gjykata me juridiksion rishikues ka detyrimin që ato t'ia njoftojë palës kundërshtare ndërgjyqëse, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të shmanget efekti surprizë i vendimit të ndërmjetëm, jo përfundimtar apo përfundimtar i gjykatës dhe vetëm në këtë mënyrë gjykata mund të garantojë të drejtën e palës për t'u mbrojtur dhe për të mbështetur vendimet e saj vetëm në çështjet ligjore dhe faktet të cilat palët kanë pasur mundësi reale t'i debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit.

48. Gjykatat me juridiksion rishikues duhet ta kenë parasysh edhe më shumë zbatimin e këtij parimi në rastet kur gjykojnë sipas ritit të gjykimit kameral apo në dhomë këshillimi. Gjykata Administrative e Apelit, në rastin objekt gjykimi, nuk e ka zbatuar këtë detyrim ligjor në gjykimin e çështjes, duke cenuar të drejtën e palës paditëse për t'u mbrojtur dhe për të bazuar vendimin e saj përfundimtar mbi çështje juridike apo fakte mbi të cilat palët kanë pasur mundësi reale për të debatuar sipas parimit të kontradiktoritetit. Kolegji e vlerëson të bazuar në ligj këtë shkak të rekursit të palës paditëse dhe konkludon se asaj i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar para se të gjykohet (*shiko, nenin 33 të Kushtetutës*).

49. Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka plotësuar detyrimin ligjor për arsyetimin e vendimit përfundimtar, në pjesën që nuk mban parasysh mendimin e ekspertit të administruar si provë në gjykimin e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë në arritjen e konkluzionit se lejet e ndërtimit cenojnë pronën e palës paditëse dhe cenojnë kondicionet urbane, ka marrë parasysh dhe ka arsyetuar sipas mendimit të ekspertit të marrë në gjykim. Ndërkohë Gjykata Administrative e Apelit, pasi ka gjykuar çështjen në dhomë këshillimi, del apriori në konkluzionin se lejet e ndërtimit nuk provohet të kenë shkelje të kondicioneve urbane, duke mos arsyetuar fare se pse nuk do të mbahet parasysh mendimi i paraqitur në provën me ekspert.

50. Neni 224/b i KPC-s parashikon se: "*Mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe, kur kjo ka mendim të kundërt me ekspertin, duhet të arsyetojë me hollësi këtë mendim në vendimin përfundimtar ose në një vendim që jep gjatë gjykimit.*". Kjo do të thotë se, është e vërtetë që prova me ekspert është provë e zakonshme, se vlera provuese e saj i jepet gjatë vlerësimit me provat e tjera dhe se për këtë arsye mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën, por në të njëjtën kohë, për të vlerësuar një fakt të caktuar ndryshe duhet detyrimisht që gjykata e shkallës së parë apo ajo e apelit të arsyetojë me hollësi këtë mendim në vendimin përfundimtar apo në një vendim që jep gjatë gjykimit. Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka bërë këtë gjë dhe vendimi për këtë pjesë, duke munguar tërësisht arsyetimi, është i pavlefshëm, në kuptim të nenit 119 të KPC-s.

51. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i gjykatës së apelit janë marrë në shkelje të normave të rënda procedurale që kanë shkaktuar pavlefshmërinë e gjykimit. Për rrjedhojë, çështja do të kthehet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, [...]

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-44, datë 16.01.2018

Interesi për të ngritur një padi dallon nga e drejta materiale për mbrojtjen e të cilës shërben padia. Si një element dytësor apo instrumental, e drejta procedurale lind dhe presupozon si domosdoshmërinë për mbrojtje ashtu edhe njohjen e cenimit të interesit material që mund të përmbushet duke iu drejtuar gjykatës.

Gjykata ka detyrimin që të identifikojë ligjin e zbatueshëm dhe ta zbatojë atë në lidhje me mosmarrëveshjen e ngritur për zgjidhje gjyqësore me anë të padisë, si edhe në lidhje me faktet dhe rrethanat që në fund të hetimit gjyqësor gjykata i ka pranuar si të vërtetuara.

Pala paditëse N.N. ka ushtruar detyrën e Drejtores së Përgjithshme të Arkivave. Në këtë detyrë paditësja është emëruar me urdhrin nr.148, datë 07.10.2005 të Kryeministrit "*Për lirim dhe emërim në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave*". Me urdhrin nr.192, datë 21.10.2013 të Kryeministrit "*Për lirimin dhe emërim*", paditësja N.N. është liruar nga detyra.

[...] Në rrethana të tilla, pala paditëse N.N., duke thirrur si të paditur Këshillin e Ministrave, Kryeministrin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me shkak ligjor dhe objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr.192, datë 21.10.2013 të Kryeministrit, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, kthimin në detyrën e mëparshme si Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, si edhe pagimin e pagës që nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin në detyrë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me *vendimin nr.205, datë 24.01.2014*, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses N.N.. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pala paditëse N.N. ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e cila e ka zhvilluar gjykimin e çështjes mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, pasi ka shqyrtuar çështjen dhe shkaqet e ngritura në ankimin e paditëses N.N.*, me vendimin nr.1161, datë 01.04.2014,* ka vendosur prishjen e vendimit nr.205, datë 24.01.2014 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pala paditëse N.N. ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vëren se disa nga shkaqet e ngritura në rekursin e palës paditëse N.N., lidhur me zbatimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit për pushimin e gjykimit të çështjes si një padi që nuk mund të ngrihet janë të mbështetura në ligj. Prandaj është vendi që vendimi nr.1161, datë 01.04.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim po në atë Gjykatë me tjetër trupë gjykuese.

Kolegjit Administrativ, nga shqyrtimi i akteve procedurale që përmban dosja gjyqësore dhe ashtu si i kanë pranuar të vërtetuara rrethanat e faktit të dy gjykatat, i rezulton se, paditësja N.N. ka ushtruar detyrën e Drejtores së Përgjithshme të Arkivave, e emëruar me urdhrin nr.148, datë 07.10.2005 të Kryeministrit. Por, më pas, me urdhrin nr.192, datë 21.10.2013 të Kryeministrit paditësja është liruar nga detyra. Paditësja N.N. i është drejtuar me ankesë Komisionit të Shërbimit Civil, i cili, nuk e ka marrë në shqyrtim ankimin dhe e ka orientuar që të tërheqë ankimin dhe t'i drejtohet me padi gjykatës administrative.

Paditësja N.N., i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Paditësja, në objektin e padisë së saj ka përcaktuar si kërkime konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr.192, datë 21.10.2013 të Kryeministrit, si edhe rivendosjen e të drejtave subjektive që pretendon se i janë cenuar, pra kthimin në detyrën e mëparshme si Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe pagimin e pagës që nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin në detyrë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka shqyrtuar në themel padinë dhe ka disponuar rrëzimin e saj si e pabazuar në ligj. Ndërsa gjykata administrative e apelit ka prishur vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe ka pushuar gjykimin e çështjes me arsyetimin se jemi përpara një padie që nuk mund të ngrihet. Kjo gjykatë apeli arsyeton qëndrimin e saj tek motivi i paraqitjes në padi të një "shkaku ligjor" që nuk gëzon mbrojtjen gjyqësore të pretenduar dhe se për sa kohë paditësja nuk mund të mbrohet me ligjin për statusin e nëpunësit civil, kundërshtimet e saj për largim të padrejtë nga puna dhe rivendosjen e të drejtave, mund të ngrihen në një proces tjetër gjyqësor bazuar në dispozitat e Kodit të Punës.

Kolegji Administrativ vlerëson se arsyetimi i gjykatës administrative të apelit është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural civil mbi institutet juridike të shkakut ligjor dhe atij të objektit të padisë (*causa petendi* dhe *petitum*), tashmë të konsoliduara nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, duke filluar nga vendimi unifikues nr.3, datë 29.03.2012.

Po kështu, ky Kolegj, vlerëson se, arsyetimi i gjykatës administrative të

apelit mbi kuptimin e rastit të padisë që nuk mund të ngrihet është rrjedhojë e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të ligjit procedural, si edhe nuk ndjek trajtimin e këtij rasti nga jurisprudenca dhe praktika gjyqësore më e konsoliduar e Gjykatës së Lartë.

Për sa i përket ligjit të zbatueshëm, kompetenca e gjykatës të disponojë pushimin e gjykimit të çështjes me motivin se gjendet përpara një padie që nuk mund të ngrihet, parashikohet në nenin 468 të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s, ndërsa pas ndryshimeve të këtij Kodi me ligjin nr.38/2017 ky rregull parashikohet në shkronjën "c", të nenit 299, të këtij Kodi. [...].

Kolegji Administrativ vëren se jurisprudenca dhe praktika gjyqësore në mënyrë të përmbledhur ka pranuar se gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes me motivin e padisë që nuk mund të ngrihet në këto raste: kur mungojnë parakushtet procedurale si: a. ekzistenca e gjyqvarësisë; b. mungesa e zotësisë së palëve. 2) kur mungojnë kushtet themelore të padisë: a. legjitimiteti formal dhe interesi për të ngritur padi; b. kur e drejta e pretenduar të mbrohet nëpërmjet vendimit të gjykatës nuk është parashikuar në një normë të së drejtës.

Gjykata e Lartë, në praktikën e saj gjyqësore ka trajtuar më hollësisht rastet e sipërcituara mbi padinë që nuk mund të ngrihet. Kështu, në vendimin nr.262, datë 22.05.2012, ndërmjet të tjerave, Kolegji Civil ka arsyetuar se: *"Rrëzimi i padisë ka vend kur ngritja e padisë e ka një bazë juridike, një shkak ligjor, bazuar në të drejtën objektive, për t'iu parashtruar gjykatës për zgjidhje, pra është një padi që mund të ngrihet dhe i përket juridiksionit gjyqësor, por ajo që kërkohet me padi, në përfundim të gjykimit, nuk arrin të provohet. Po kështu, edhe nëse ajo që është e kërkueshme ligjërisht në rrugë gjyqësore, mbi provat e paraqitura, vërtetohet se nuk gjen mbështetje në ligj.*

Kolegji Civil vlerëson të evidentojë se, në thelb, ngritja e padisë, hartimi dhe paraqitja e kërkesëpadisë, janë mjeti procedural me të cilin paditësi vë në lëvizje gjykatën, kur pretendon se ka një të drejtë subjektive, për të njohur a mbrojtur, e cila gjen mbështetje në të drejtën pozitive, si nga pikëpamja materiale ashtu edhe nga ajo procedurale (për t'iu drejtuar gjykatës).

Nëse ajo që, konkretisht, paditësi pretendon se i është cenuar apo që duhet t'i njihet, parashikohet nga e drejta pozitive në aspektin material, e akoma më tej, nëse e drejta pozitive i njeh paditësit të drejtën që këtë të kërkojë ta realizojë nëpërmjet gjykatës, atëherë gjykata ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes për të verifikuar nëse ajo kërkohet konkretisht me padi (në objekt) është e mbështetur edhe në prova e në ligj.

E kundërta, nëse ajo që i kërkohet gjykatës nuk gjen mbështetje në të drejtën pozitive materiale, atëherë gjykata pushon çështjen si një padi që nuk mund të ngrihet (neni 468 i KPC). Por, nuk kemi të bëjmë me mungesë të së drejtës pozitive materiale, ndaj edhe gjykata nuk e pushon vetvetiu çështjen me motivin se nuk gjen një normë konkrete juridike ligjore të zbatueshme për të drejtën që pretendohet nga paditësi. Kjo sepse mund të ndodhë që ligji (norma juridike) mungon, nuk është i qartë, i plotë, apo është kontradiktor.

Gjithashtu, gjykata vendos pushimin e çështjes edhe kur, ndonëse ajo që ngrihet në padi ka mbështetje në të drejtën pozitive materiale, nga ana e së drejtës pozitive procedurale parashikohet shprehimisht detyrimi që, ai kërkim, nuk mund t'i parashtrohet (drejtpërdrejt) gjykatës, por një organi që bën pjesë në juridiksionin administrativ apo një organi tjetër të ngarkuar posaçërisht për atë qëllim nga ligji (neni 468 i KPC)".

Po kështu, në vendimin nr.264, datë 18.04.2013, ndërmjet të tjerave, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arsyeton se:*"20. Në vështrim të nenit 468 të KPC-s padia nuk mund të ngrihet në rastet e mungesës të parakushteve procedurale, si ekzistenca e gjyqvarësisë (neni 58 i KPC-s); mungesa e zotësisë së palëve (nenet 33 dhe 91 të KPC-s); dhe në raste të mungesës së kushteve themelore të padisë, të tilla si mungesa e legjitimitetit formal dhe interesit për të ngritur padi (neni 184 i KPC-s), si dhe kur e drejta e pretenduar të mbrohet nëpërmjet vendimit të gjykatës nuk është parashikuar në një normë të së drejtës. Parakushtet procedurale janë kushte për krijimin e marrëdhënies procedurale; mungesa e tyre nuk pengon inicimin e procesit, por përbën pengesë për shqyrtimin e themelit të çështjes. Mungesa e legjitimitetit procedural (formal) passjell pushimin e gjykimit të padisë, ndërsa mungesa e legjitimitetit substancial passjell rrëzimin e saj.*

21. Për rastin konkret gjykata e apelit, referuar vendimeve gjyqësore që kanë pushuar gjykimin e padive të ngritura më parë, gabon kur mohon ekzistencën e interesit të paditësit për ngritjen e padisë, që në thelb është padi rivendikimi.

21.1. Ky kolegj e gjen me vend të parashtrojë se interesi për të ngritur një padi është një element i së drejtës së padisë. Ai dallon nga interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Kjo për arsye sepse janë të dallueshme dy të drejta, ajo materiale dhe ajo procedurale, që ushtrohet për mbrojtjen e së parës. Interesi për të ngritur padi është një interes procedural, dytësor dhe instrumental në lidhje me interesin material dhe ka për objekt vendimin që i kërkohet gjykatës të japë si mjet për arritjen e përmbushjes së interesit material i cili është cenuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese. Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin

material dhe për këtë arsye, në esencë, presupozon njohjen e cenimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë.

21.2. Nuk mund të merret në shqyrtim një padi kur në situatën faktike, aktuale, nuk njihet apo nuk evidentohet cenimi i një të drejte ose i një interesi që mund të pretendohet kundrejt palës tjetër. Në këtë vështrim juridik gjen zbatim neni 468 i KPC-s dhe jo sikurse është rasti konkret ku ndodhemi para një padie rivendikimi. Mungesa e legjitimitetit substancial passjell rrëzimin e padisë dhe jo pushimin e gjykimit të saj.".

Duke pasur parasysh sa arsyetohet më sipër mbi ligjin e zbatueshëm dhe interpretimin e tij, ky Kolegj Administrativ vlerëson se gjykata administrative e apelit ka zbatuar gabim ligjin procedural kur arsyeton se në çështjen objekt gjykimi jemi përpara rastit të padisë që nuk mund të ngrihet sipas nenit 468 të KPC-s, duke disponuar prishjen e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Motivi për këtë disponim sipas gjykatës administrative të apelit është paraqitja e një padie me shkak ligjor që nuk gëzon mbrojtjen gjyqësore të pretenduar aq më tepër bazuar në ligjin për statusin e nëpunësit civil. E drejta subjektive që pretendohet se është cenuar mund të bëhet me padi tjetër bazuar në Kodin e Punës. Pra, gjykata administrative e apelit ka vlerësuar se gjendet përpara rastit të mungesës së kushteve themelore të padisë në kuptim të nenit 468 të KPC-s.

Por, Kolegji Administrativ vëren se në çështjen objekt i këtij gjykimi ekzistojnë jo vetëm parakushtet procedurale, por edhe kushtet themelore të padisë, përfshirë interesin për të ngritur padi edhe parashikimin nga një normë e së drejtës të cenimit të pretenduar që kërkohet të mbrohet dhe rivendoset nëpërmjet gjykatës. [...].

Nisur nga natyra konkrete e padisë së ngritur, qëllimit dhe kërkimeve që ajo përmban, rrethanave të faktit që pretendohen se janë të vërteta apo edhe atyre që janë pranuar se ekzistojnë nga vetë palët ose gjykata në vendimet e dhëna prej tyre, duke i ballafaquar ato me ligjin e zbatueshëm, të cilin gjykatat dhe ky Kolegj kanë detyrimin të zbatojnë, pa u lidhur me përcaktimet e palëve, Kolegji Administrativ vëren se:

Së pari, paditësja ka kërkuar me padi konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ (urdhrit të Kryeministrit). Kjo lloj padie parashikohet shprehimisht nga shkronja "c", e pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.49/2012.

Së dyti, paditësja i kërkon gjykatës me padi pavlefshmërinë absolute të një akti administrativ me të cilën palët e paditura kanë shprehur vullnetin për të zgjidhur njëanshmërisht kontratën e shërbimit publik me paditësen, duke e liruar nga detyra. Kështu, paditësja pretendon se, pikërisht nëpërmjet këtij akti, është shprehur vullneti dhe është materializuar cenimi i të drejtave të

saj subjektive, duke ia ndërprerë ushtrimin e funksionit publik, kontratën e shërbimit publik. Pra, paditësja tregon se ka interes për ngritjen e padisë objekt i këtij gjykimi.

Së treti, sipas parashtrimeve të dy pikave më sipër, paditësja ka kërkuar të mbrojë dhe rivendosë të drejta subjektive të saj, që i njeh dhe parashikon ligji, sikurse janë ato të lidhura me respektimin e të drejtave që pretendon se i takojnë sipas kontratës së shërbimit publik. Për këtë qëllim ka zgjedhur rrugën gjyqësore, duke ngritur një padi, kërkimet e së cilës, nga pikëpamja formale-juridike parashikohen si lloje kërkimi padish nga ligji, sikurse janë kërkimet për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, rikthimin në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pagës deri në rikthimin në detyrë etj.,.

Së katërti, pavarësisht nga argumentet e parashtruara apo të pretenduara nga paditësja në mbështetje të asaj që i kërkon gjykatës me anë të padisë, pra pretendimeve se nuk mund të largohej nga detyra pasi mbrohej nga legjislacioni për statusin e nëpunësit civil apo se e ka fituar këtë status apo se largimi nga detyra është i pamotivuar në ligj dhe në fakt etj., si edhe pavarësisht ligjeve apo dispozitave ligjore që paditësja ka zgjedhur a gjykuar si të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshje me palët e paditura, gjykatat administrative nuk janë të lidhura me to.

Pala paditëse ka detyrim të tregojë dhe provojë rrethanat mbi të drejtën subjektive që pretendon se i njeh ligji apo që i cenohet nga të padituri, por nuk ka barrën e provës të gjejë ligjin konkret të zbatueshëm, dispozitën konkrete të zbatueshme të së drejtës pozitive, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes që ka ngritur përpara gjykatës. Detyrimi i tyre është të qartësojnë se çfarë kërkojnë nga gjykata, ndërsa pala e paditur çfarë prapëson nga kërkimet e paditësit, pra cila është e drejta subjektive që ligji u njeh apo jo atyre dhe përse i është cenuar ose jo kjo e drejtë nga sjellja dhe veprimet a mosveprimet e palës tjetër në gjykim. Kjo sepse gjykata duhet të shprehet vetëm për atë që kërkohet dhe për aq sa i kërkohet (neni 6 i KPC-s).

Palët ndërgjyqëse, sipas barrës përkatëse të provës në varësi të natyrës së mosmarrëveshjes, padisë dhe kërkimeve, kanë detyrimin që, si rregull, të provojnë faktet, mbi lindjen dhe ekzistencën e së drejtës subjektive, cilat janë sjelljet, veprimet a mosveprimet që pretendohet se i janë kundërvënë apo jo të drejtave subjektive të paditësit, nëse nga këto sjellje ka ardhur apo jo si pasojë cenimi i këtyre të drejtave subjektive e kështu me radhë (nenet 7-12, e vijues të KPC-s).

Pikërisht, mbi faktet dhe rrethanat e vërtetuara nga gjykimi, pra pas çmimit dhe vlerësimit nga gjykata të provave të paraqitura nga palët në mbështetje të kërkimeve dhe prapësimeve përkatëse (sipas detyrimeve

reciproke mbi barrën e provës), tashmë gjykata ka detyrimin që të identifikojë ligjin e zbatueshëm dhe ta zbatojë atë në lidhje me mosmarrëveshjen e ngritur për zgjidhje gjyqësore me anë të padisë, si edhe në lidhje me faktet dhe rrethanat që në fund të hetimit gjyqësor gjykata i ka pranuar si të vërtetuara (da mihi factum, dabo tibi ius).

Në vijim, tashmë është gjykata ajo që e di ligjin (*iura novit curia*), që e identifikon ligjin e zbatueshëm, e interpreton dhe zbaton atë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete në gjykim, bazuar në rrethanat e faktit që rezultojnë të provuara në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes.

Për këtë qëllim, si një nga parimet themeltare të gjykimit civil, në nenin 16 të KPC-s përcaktohet se "*Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.*". Të njëjtin parim themeltar të procedimit gjyqësor e konfirmon edhe dispozita e pikës 2, të nenit 17, të ligjit të posaçëm nr.49/2012.

Prandaj, pavarësisht nga argumentet mbi ligjin e zbatueshëm, të zgjedhura nga palët pjesëmarrëse në gjykim, si edhe interpretimin e tij prej tyre, gjykata nuk lidhet me këto përcaktime, por e identifikon vetë ligjin që duhet të zbatohet lidhur me kërkimet e padisë dhe gjendjen e faktit që rezulton e provuar nga hetimi gjyqësor i çështjes.

Nisur nga sa arsyetohet më sipër Kolegji Administrativ vlerëson se, Gjykata Administrative e Apelit, në shqyrtimin e shkaqeve të ngritura në ankim dhe në zgjidhjen e çështjes objekt i këtij gjykimi, nuk ka mbajtur parasysh misionin e saj të përcaktuar nga parimet themeltare të procedimit gjyqësor civil, pra se cilat janë detyrimet e saj dhe cilat janë detyrimet e palëve në procesin e të provuarit, të argumentuarit dhe në fund të zgjidhjes së çështjes. Po kështu ka interpretuar dhe zbatuar gabim edhe dispozitën e ish-nenit 468 të KPC-s lidhur me rastet kur jemi përpara padisë që nuk mund të ngrihet, duke disponuar pushimin e gjykimit të çështjes.

Prandaj, Kolegji Administrativ orienton gjykatën administrative të apelit që, në rigjykim, në seancë gjyqësore, të dëgjojë pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse mbi bazueshmërinë në prova dhe në ligj të shkaqeve të ngritura në ankimin e paraqitur nga paditësja N.N. dhe drejtësinë e vendimit të dhënë nga gjykata administrative e shkallës së parë për rrëzimin e padisë.

Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, të vlerësojë vetë, nëse nevojitet përsëritja tërësore apo e pjesshme e hetimit gjyqësor dhe, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, mbi gjendjen e faktit të pranuar të vërtetuar prej saj, duke interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin e zbatueshëm, të disponojë për zgjidhjen e çështjes.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-33, datë 23.01.2018

Sipas legjislacionit tregtar, administratori i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka kompetencën të përfaqësojë subjektin tek të tretët, përfshirë edhe gjykatën, ose të caktojë përfaqësues dhe avokat për mbrojtjen e interesave të tij.

Kërkesa e palës paditëse "MP" SHPK për heqjen dorë nga rekursi i ushtruar prej saj kundër vendimit nr.62, datë 21.01.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit është e bazuar në ligj dhe e plotësuar me kushtet e parashikuara nga ligji procedural për pranimin e saj nga Gjykata e Lartë. Prandaj, Kolegji Administrativ vlerëson se është vendi për të disponuar pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

Sipas vendimit të dhënë nga gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit, për sa i përket rrethanave të faktit, rezulton se pala paditëse "MP" SHPK ka për objekt të veprimtarisë së saj tregtare ndërtimin, operimin, transferimin e hidrocentralit Nicë nga Velçani tek autoriteti kontraktues etj., [...].

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë ka nxjerrë aktin e njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore me nr.10487 prot., datë 09.07.2013, për pagesën e detyrimit të tatim fitimit për vitin 2012 në shumën 1.676.258 lekë, si detyrim i papaguar nga sistemi tatimor i informacionit për subjektin "MP" SHPK, kamatëvonesë në shumën 57.032 lekë dhe gjoba në shumën 756.817 lekë.

Meqenëse pala paditëse "MP" SHPK nuk ka qenë dakord me detyrimet tatimore të ngarkuara nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, e ka ankimuar aktin e sipërcituar administrativ të njoftim-vlerësimit tatimor pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr.19805/1 prot., datë 24.12.2013, ka refuzuar ankimin për shkak se nuk është parapaguar detyrimi tatimor i përcaktuar në aktin administrativ objekt ankimi. [...].

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr.165, datë 08.04.2014, ka vendosur pranimin e padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ njoftim vlerësimi tatimor me nr.10487, datë 09.07.2013, nxjerrë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, për periudhën tatimore viti 2012, për paditësin "MP" SHPK, përkatësisht tatim fitimi në shumën 1.676.258 lekë, kamatëvonesë

në shumën 57.032 lekë dhe gjoba në shumën 756.817 lekë, si akt i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ligji. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e ka shqyrtuar çështjen dhe në përfundim të gjykimit, *me vendimin nr.62, datë 21.01.2015*, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.165, datë 08.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe rrëzimin e padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pala paditëse "MP" SHPK ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Në dhomën e këshillimit të datës 29.06.2017, Kolegji Administrativ vlerësoi se, për të verifikuar problematikën që paraqisnin shkaqet e ngritura në rekurs, gjykimi të vijojë në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

Përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, pala paditëse "MP" SHPK, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë dhe ka depozituar në sekretarinë e saj, në datën 03.01.2018, një shkresë me objekt "*Kërkesë për heqjen dorë nga rekursi kundër vendimit nr.62, datë 21.01.2105 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*".

Në këtë gjendje të zhvillimit të procedimit, Kolegji Administrativ, në fillim të seancës gjyqësore të datës 23.01.2018, përpara relatimit të çështjes nga gjyqtari relator, lexoi dhe bisedoi përmbajtjen e kërkesës së palës paditëse "MP" SHPK për heqjen dorë nga rekursi kundër vendimit nr.62, datë 21.01.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, mjet procedural me të cilën ishte vënë në lëvizje Gjykata e Lartë për shqyrtimin e çështjes objekt i këtij gjykimi.

Lidhur me këtë kërkesë, Kolegji Administrativ vëren se ajo është paraqitur nga pala paditëse në gjykim "MP" SHPK, e cila ka ushtruar rekurs kundër vendimit nr.62, datë 21.01.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Kërkesa për heqjen dorë nga rekursi është nënshkruar nga administratorja e palës paditëse "MP" SHPK, e cila ka nënshkruar të gjitha aktet e kësaj palë gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe të dytë dhe që rezulton të jetë në këtë funksion aktualisht nisur nga përmbajtja e kartelës së subjektit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Sipas legjislacionit tregtar, administratori i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka kompetencën të përfaqësojë subjektin tek të tretët përfshirë edhe gjykatën ose të caktojë përfaqësues dhe avokat për mbrojtjen e interesave të tij. Nga ana tjetër, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë nuk ka ushtruar rekurs.

Për rastin kur kërkesa për heqje dorë nga rekursi paraqitet pas

shqyrtimit të tij në dhomë këshillimi dhe përpara relatimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në nenin 490 të Kodit të Procedurës Civile-s parashikohet se: "*Pala mund të heqë dorë nga rekursi derisa nuk është filluar relatimi në seancë gjyqësore. Heqja dorë bëhet me shkrim, e nënshkruar nga vetë pala apo avokati i saj, i pajisur me prokurë për këtë qëllim. Akti i heqjes dorë u njoftohet palëve që janë paraqitur ose u komunikohet avokatëve të palëve. Kur hiqet dorë nga rekursi dhe në gjykim kanë marrë pjesë të gjitha palët ose përfaqësuesit e tyre, nuk ka vend për shpallje të veçantë të vendimit të pushimit të gjykimit.*"

Për arsyet e parashtruara më sipër, duke qenë se kërkesa për heqje dorë nga rekursi është paraqitur dhe nënshkruar rregullisht nga pala paditëse që e ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ vlerëson se është vendi për të disponuar pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-62, datë 06.02.2018

Legjislacioni shqiptar përcakton regjime juridike doganore të veçanta në lidhje me afatin e lindjes së detyrimit dhe borxhit doganor dhe të shlyerjes së pagesës për TVSH-në në përfundim të afatit 12-mujor të miratuar me autorizim nga autoriteti doganor apo të afatit tjetër shtesë të miratuar me autorizim nga Ministri i Financave.

Masa e detyrimit doganor për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) përcaktohet nga shkalla dhe vlera tatimore në ditën e importimit dhe pranimit të deklaratës doganore. Ndërkohë, borxhi doganor lind pas përfundimit të afatit të shtyrjes së pagesës së TVSH sipas ligjit, regjimit të posaçëm favorizues doganor, pra pas përfundimit të afatit të dytë të shtyrjes miratuar me autorizim nga Ministri i Financave.

Rekursi i paraqitur nga pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nga avokati i shtetit përmbajnë shkaqe nga ato që i parashikon ligji. Prandaj, vendimi nr.527, datë 28.10.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Sipas vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, për sa u përket rrethanave të faktit, rezulton se, në periudhën tetor - nëntor 2008, pala paditëse "CDC" SHPK ka importuar aparatura spitalore në funksion të veprimtarisë së saj.

Pala paditëse "CDC" SHPK, me anë të një shkrese të datës 17.10.2008 drejtuar palës së paditur, Dega e Doganës Tiranë, i ka kërkuar kësaj të fundit shtyrjen e pagimit të TVSH për pajisjet spitalore të importuara në funksion të veprimtarisë së saj.

Në përgjigje të kësaj kërkese, duke qenë se ishte rasti i importimit të makinerive dhe pajisjeve në funksion të veprimtarisë së subjekteve tatimore e doganore, bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.559, datë 16.08.2006 "*Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH për makineritë dhe pajisjet e importuara, si edhe energjinë elektrike të importuar nga Korporata Elektroenergjetike e Shqipërisë SHA" (i ndryshuar)*, nxjerrë në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.7928/1995

"*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*", pala e paditur Dega e Doganës Tiranë, me autorizimin nr.97, datë 22.10.2008, ka miratuar shtyrjen e detyrimit të palës paditëse "CDC" SHPK për pagimin të TVSH. Sipas këtij vendimi të Këshillit të Ministrave shtyrja e afatit të pagesës ishte deri në 12 muaj.

Më tej, pala e paditur Dega e Doganës Tiranë ka nxjerrë Vendimin nr.154 prot., të datës 15.01.2010, me të cilin, bazuar në nenet 216, 236 dhe 275, të Kodit Doganor ka vendosur të detyrojë palën paditëse "CDC" SHPK të paguajë detyrimet e prapambetura të përbërë nga TVSH dhe gjoba në vlerën totale 136.055.995 lekë, si detyrime doganore të papaguara. Ky akt administrativ është nxjerrë me motivin që, ndonëse kishte kaluar afati 12 mujor i shtyrjes së pagesës së TVSH të miratuar me autorizimin e saj të sipërcituar me nr.97, datë 22.10.2008, meqenëse duke filluar nga data 25.10.2008 pala paditëse "CDC" SHPK ishte e detyruar të kryente pagesën.

Në vijim të këtij akti, pala e paditur Dega e Doganës Tiranë ka nxjerrë aktin administrativ nr.154/1 prot., datë 18.01.2010 për njoftimin e borxhit doganor palës paditëse "CDC" SHPK duke kryer edhe veprime të tjera shkresore në funksion të ekzekutimit dhe mbledhjes së detyrimit doganor.

Ndërkohë që pala e paditur Dega e Doganës Tiranë po kryente veprime në funksion të vjeljes së detyrimit doganor, pala paditëse "CDC" SHPK bënte përpjekje për të përfituar një shtyrje të mëtejshme të detyrimeve doganore dhe tatimore duke iu drejtuar me kërkesa institucioneve përkatëse.

Në përgjigje të këtyre kërkesave, mbështetur po në kriteret dhe kompetencën e përcaktuar në nenin 26 të ligjit nr.7928/1995 dhe në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Ministrave nr.559/2006, për rastet e shtyrjes së afatit të pagesës së TVSH përtej afatit 12 mujor, Ministri i Financave, me shkresën nr.2117/2 prot., të datës 09.03.2010, ka njoftuar palën e paditur Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si edhe palën paditëse "CDC" SHPK, se ka miratuar shtyrjen e mëtejshme, deri në datën 06.11.2010, të detyrimit të kësaj palë paditëse për pagesën e TVSH. Sipas shkresës së Ministrit të Financave, përcaktohet se, pas kësaj date, subjekti duhet të kryejë pagesën pranë degës doganore ku janë kryer procedurat e importit.

Pavarësisht aktit administrativ nr.2117/2 prot., të datës 09.03.2010 të Ministrit të Financave për miratimin e shtyrjes së mëtejshme deri në datën 06.11.2010 të shlyerjes së detyrimeve në ngarkim të palës paditëse "CDC" SHPK, për motive të pashpjeguara në gjykim, pala e paditur, Dega e Doganës Tiranë ka nxjerrë edhe aktin nr.2744, datë 27.05.2010 *"Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor*" në zbatim të vendimit të saj të sipërcituar nr.154 datë 15.01.2010, duke përcaktuar masat përkatëse të sekuestros që duhet të zbatoheshin mbi vlerat monetare, kreditë, sendet, etj.,.

Në të tilla rrethana, pala paditëse "CDC" SHPK me shkresat e datës 21.06.2010 dhe 24.06.2010, ka njoftuar dhe i ka kërkuar palës së paditur Dega e Doganës Tiranë që të "anulojë" vendimin nr.154 prot., datë 15.01.2010, me të cilin detyrohet të paguajë detyrimet e prapambetura të përbërë nga TVSH dhe gjoba në vlerën totale 136.055.995 lekë, si detyrime doganore të papaguara, kjo në kushtet kur Ministri i Financave ka miratuar shtyrjen e mëtejshme të detyrimit të saj për të kryer pagesat e TVSH deri në datën 06.11.2010.

Pas ardhjes në dijeni dhe verifikimit të këtyre rrethanave, pala e paditur Dega e Doganës Tiranë ka nxjerrë aktin administrativ vendim nr.3556 prot., datë 07.07.2010, me të cilin ka disponuar anulimin e vendimit nr.154 prot., datë 15.01.2010, të nxjerrë po nga ky organ administrativ. Motivi i këtij akti, bazuar në nenet 109/1 dhe 121-124, të Kodit të Procedurave Administrative (KPA)-s, është ardhja në dijeni të shkresës nr.3548/1, datë 23.03.2010 të palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për miratimin e dhënë nga Ministri i Financave me shkresën nr.2117/2, datë 09.03.2010 të shtyrjes së mëtejshme të afatit të shlyerjes së detyrimeve deri në datën 06.11.2010.

Pas datës 06.11.2010, pra në përfundim edhe të afatit të shtyrjes së dytë të detyrimit për pagesën e TVSH mbi autorizimin e Ministrit të Financave, pala e paditur Dega e Doganës Tiranë ka mbajtur procesverbalin e konstatimit nr. 6 prot., datë 18.01.2011, me të cilin konstaton se, pas verifikimit të deklaratave doganore të palës paditëse "CDC" SHPK rezultoi që ky subjekt, me mbarimin e afatit në datën 06.11.2010, përsëri nuk e ka kryer pagesën e shtyrë të TVSH.

Pala e paditur Dega e Doganës Tiranë, bazuar në procesverbalin e konstatimit të shkeljes doganore dhe shmangies nga shlyerja e detyrimeve doganore, duke pasur parasysh që, pas datës 06.11.2010, palës paditëse "CDC" SHPK i ka lindur detyrimi të paguajë detyrimet doganore për TVSH në vlerën përkatëse sipas shkallës tatimore në ditën e paraqitjes së deklaratës doganore të vitit 2008, ka nxjerrë aktin administrativ Vendimi nr.370 prot., datë 21.01.2011, me të cilin ka vendosur që kjo palë paditëse të paguajë borxhin doganor, detyrimin doganor dhe gjobën në shumën totale 136.328.995 lekë.

Mbi bazën e këtij akti administrativ, pala e paditur Dega e Doganës Tiranë, me shkresën nr.370/1 prot., datë 21.01.2011 "*Njoftim vendim borxh doganor*", e ka njoftuar palën paditëse "CDC" SHPK se është shpallur debitore për mosshlyerje të detyrimit doganor njëkohësisht duke u gjobitur për këtë motiv.

Rezulton se pala paditëse "CDC" SHPK ka marrë dijeni për shpalljen debitor dhe detyrimin e shlyerjes së borxhit doganor po atë datë, pra në datën 21.01.2011.

Në vijim, pala e paditur Dega e Doganës Tiranë, ka nxjerrë edhe aktin administrativ vendimi nr. 467 prot., datë 22.01.2011 "*Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor*", me të cilin ka vendosur mbledhjen me forcë të borxhit doganor dhe sekuestrimin e vlerave monetare, kreditë, sendet, etj., duke e njoftuar palën paditëse "CDC" SHPK me shkresën nr.467/1 prot., datë 22.01.2011 për vendimin e sipërcituar.

Pala paditëse "CDC" SHPK nuk rezulton që të ketë ushtruar ankim administrativ apo gjyqësor ndaj akteve administrative vendimi nr.370, datë 21.01.2011, me nr.370/1, datë 21.01.2011 dhe me nr.467, datë 22.01.2011 të palës së paditur Dega e Doganës Tiranë të cituara në paragrafët më sipër.

Ndërkohë, Kuvendi i Shqipërisë, në datën 21.04.2011 ka miratuar ligjin nr.10418 "*Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor*", i cili ka hyrë në fuqi në datën 18.05.2011.

Në zbatim të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, pranë secilës degë doganore, pra edhe pranë palës së paditur Dega e Doganës Tiranë, me urdhrin nr.2744/1, datë 09.08.2011 të titullarit të saj është krijuar Komisioni për Administrimin e Faljes së Detyrimeve Doganore.

Me shkresën nr.5716 prot., datë 30.09.2011, për zbatimin e detyrimeve sipas ligjit nr.10418/2011 dhe akteve nënligjore nxjerrë në zbatim të tij, pala e paditur Dega e Doganës Tiranë i është drejtuar paditësit "CDC" SHPK. Me anë të kësaj shkrese, pala paditëse njoftohet se me vendimin e palës së paditur Dega e Doganës Tiranë me nr.370 prot., datë 21.01.2011 është shpallur debitore për detyrimin doganor në shumën 136.275.995 lekë, gjobë në shumën 50.000 Lekë dhe pagesën e interesave përkatëse të ndërvarura, detyrime të cilat nuk janë shlyer. Pala paditëse mund të përfitojë nga zbatimi i nenit 26/3 të ligjit nr.10418/2011, duke iu falur vetëm gjobat dhe kamatëvonesat për këtë borxh doganor në rast se kryen pagesën në masën 100% të principalit të detyrimit të sipërcituar të papaguar së borxhit doganor.

Pala paditëse "CDC" SHPK, në formën e kërkesës për shuarjen e borxhit të prapambetur doganor dhe si përgjigje të shkresës së palës së paditur të datës 30.09.2011 të cituar në paragrafin më sipër, i është drejtuar kësaj pale të paditur me dy shkresa, njëra me nr.108 prot., datë 03.10.2011 dhe tjetra me nr.109 prot., datë 05.10.2011. Nëpërmjet këtyre shkresave kërkohet shuarja e detyrimit të prapambetur doganor dhe përfitimi i plotë nga ligji nr.10418/2011 edhe për faljen e principalit të detyrimit me pretendimin që kontabilizimi i detyrimit doganor ka ndodhur jo me vendimin e palës së paditur Dega e Doganës Tiranë me nr.370 prot., datë 21.01.2011, por me vendimin e saj të mëparshëm me nr.154, datë 15.01.2010 për një vlerë në shumën 135.055.995 Lekë. Pra importi i pajisjeve është bërë përpara

datës 31.12.2008 dhe kontabilizimi i detyrimit doganor përpara datës 31.12.2010. Për rrjedhojë, nuk duhet të zbatohet neni 26/3, por neni 26/1 i ligjit nr.10418/2011 dhe palës paditëse duhet t'i falet jo vetëm gjoba dhe interesat por edhe principali i detyrimit doganor të papaguar.

Pala e paditur Dega e Doganës Tiranë, pas vlerësimit të pretendimeve të palës paditëse "CDC" SHPK, me anë të shkresës nr.5819/1 prot., të datës 12.10.2011, përgjigjet duke shpjeguar se në zbatim të ligjit dhe udhëzimeve e sqarimeve të dërguara degëve doganore nga Ministria e Financave, edhe me shkresën nr.12802/1 prot., datë 04.07.2011, si datë e lindjes së borxhit doganor lidhur me rastet e skemave të shtyrjes së detyrimit për pagesën e TVSH do të konsiderohet data e përfundimit të afatit të autorizimit përkatës të shtyrjes. Në rastin konkret, sipas autorizimit të dytë të shtyrjes së Ministrit të Financave, data kur përfundonte shtyrja ishte data 06.11.2010 , ditë nga e cila kjo degë doganore fillon nxjerrjen e akteve për lindjen, njoftimin dhe vjeljen e borxhit doganor. Bazuar në këtë rrethanë, për palën paditëse gjen zbatim neni 26/3 i ligjit nr.10418/2011 sipas të cilit duhet të paguhet e gjithë shuma e principalit të detyrimit në mënyrë që të përfitohet falja e gjobës dhe kamatëvonesës.

Në rrethana të tilla, pala paditëse "CDC" SHPK duke thirrur si të paditur Degën e Doganës Tiranë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkak ligjor dhe objekt faljen dhe shuarjen e borxhit të prapambetur doganor të lindur në periudhën tetor-nëntor 2008 dhe të kontabilizuar me vendimin nr.154, datë 15.01.2010 të Degës së Doganës Tiranë, si edhe detyrimin e palës së paditur që të kryejë pasqyrimin e këtij fakti dhe fshirjen e këtij detyrimi doganor në regjistrat kontabël të Degës së Doganës Tiranë. Pezullimin e zbatimit të çdo akti apo veprimi të administratës doganore për mbledhjen e borxhit deri sa vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë.

Gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë, pala paditëse disa herë ka ndryshuar objektin e kërkimit të padisë dhe së fundi ajo që ka shqyrtuar dhe disponuar gjykata është padia me shkak ligjor dhe objekt kundërshtimin e shkresave të Degës së Doganës Tiranë me nr.5716 prot., datë 30.09.2011 dhe nr.5819/1 prot., datë 12.10.2011, duke vendosur detyrimin e palës së paditur që të nxjerre aktin administrativ të faljes dhe të shuarjes së borxhit të prapambetur doganor të palës paditëse të lindur në periudhën kohore tetor – nëntor 2008, të kontabilizuar me vendimin e Degës së Doganës Tiranë me nr.154 prot., datë 15.01.2010 dhe të rikontabilizuar më vonë më vendimin nr.370 prot., datë 21.01.2011, si edhe detyrimin e të paditurit që të kryejë pasqyrimin e këtij fakti dhe fshirjen e këtij detyrimi doganor nga regjistrat kontabël të Degës Doganës Tiranë. Pezullimin e zbatimit

të vendimeve të mësipërme të kontabilizimit të borxhit të prapambetur doganor, si dhe të çdo akti tjetër administrativ të dalë në bazë e në zbatim të tyre për mbledhjen e këtij borxhi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me *vendimin nr.7393 datë 12.07.2012*, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur që të nxjerrë aktin administrativ të faljes dhe të shuarjes së borxhit të prapambetur doganor të paditësit, të lindur në periudhën kohore tetor – nëntor 2008 të kontabilizuar me vendimin e Degës së Doganës Tiranë me nr.154 prot., datë 15.01.2010 dhe të rikontabilizuar më vonë me vendimin nr.370 prot., datë 21.01.2011, si dhe detyrimin e të paditurit të kryejë pasqyrimin e këtij fakti dhe fshirjen e këtij detyrimi doganor nga regjistrat kontabël të Degës Doganës Tiranë. Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë lidhur me pezullimin. [...]

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, palët e paditura Dega e Doganës Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe avokati i shtetit në mbrojtje të interesit të tyre publik, kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. *Gjykata e Apelit Tiranë*, pasi ka shqyrtuar çështjen dhe shkaqet e ngritura në ankimet e palëve të paditura dhe avokatit të shtetit, duke parashtruar në arsyetim të njëjtin qëndrim me faktin dhe ligjin e zbatueshëm lidhur me to në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim*, me vendimin nr.527, datë 28.10.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.7393, datë 12.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe avokati i shtetit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i gjen të mbështetura në ligj disa nga shkaqet e ngritura në rekurset e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe avokatit të shtetit, lidhur me zbatimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Prandaj vendimi nr. 527 datë 28.10.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Ky Kolegj Administrativ, vlerëson se, për ta bërë të cenueshëm vendimin e dhënë nga gjykata e apelit dhe rishqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, pa vijuar më tej me shkaqet e tjera, janë të mjaftueshme motivet vijuese të parashtruara në rekurse lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe zbatimin e drejtë të tij në zgjidhjen e çështjes nga të dy gjykatat e faktit.

Së pari, në rekurs parashtrohet se të dy gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin kur kanë pranuar padinë me motivin se në rastin në gjykim gjen zbatim pika

1, e nenit 26, të ligjit nr.10418/2011. Në këtë rast paditësi "CDC" SHPK nuk ka plotësuar kushtet kumulative të zbatueshme për pikën 1 të këtij neni, pra që borxhi doganor të ketë lindur përpara datës 31.12.2008 dhe të jenë evidentuar e kontabilizuar nga autoriteti doganor deri në datën 31.12.2010.

Për të pranuar padinë sipas pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr.10418/2011, gjykatat kanë zbatuar gabim kuptimin dhe përmbajtjen e dispozitave të Kodit Doganor kur shprehen se, në rastin në gjykim çasti i lindjes së borxhit është data e pranimit të deklaratës doganore referuar nenit 216 të këtij Kodi. Kjo referencë është tërësisht e gabuar pasi çështja objekt gjykimi duhej trajtuar referuar nenit 219 të këtij Kodi, në kushtet kur paditësi ka përfituar shtyrjen e afatit të pagesës së detyrimeve doganore. Borxhi doganor lind në çastin kur nuk përmbushet detyrimi dhe jo thjesht kur përcaktohet ky detyrim duke plotësuar e pranuar deklaratat doganore.

Së dyti, në këto rekurse parashtrohet se pala paditëse "CDC" SHPK, siç edhe e pranoi vetë, nuk i ka kundërshtuar aktet administrative vendimet e Degës së Doganës Tiranë sipas nenit 289 të Kodit Doganor, si edhe nuk i është drejtuar me padi gjykatës për të kundërshtuar këto akte.

Së treti, gjykatat kanë gabuar në arsyetimin mbi konstatimin kryesisht të pavlefshmërisë absolute të akteve administrative. Në referim të nenit 6 të KPC-s, gjykatat duhet të shprehen vetëm mbi gjithçka që kërkohet dhe për ato që kërkohet. Ky arsyetim i Gjykatave përbën shkelje procedurale duke dalë jashtë objektit të padisë duke u shprehur për atë që palët nuk kanë kërkuar apo pretenduar gjatë gjithë hetimit gjyqësor. Rrjedhimisht, vendimet e gjykatave në tejkalim të kompetencave të tyre janë të njëanshme duke dashur me çdo kusht të përfshijnë paditësin si përfitues i plotë i ligjit për faljen.

Së katërti, gjykatat me të padrejtë kanë arsyetuar se termi i përdorur nga palët e paditura anulim, passjell automatikisht pavlefshmërinë absolute të vendimmarrjes së organit administrativ, pasi kjo është një prerogativë vetëm e gjykatës. Pavarësisht se akti nr.3556, datë 07.07.2010 i Degës Doganore Tiranë titullohet "anulim vendimi", në të vërtetë referuar bazës ligjore të përcaktuar në të e konkretisht neneve 121, 122, 123 dhe 124, të KPA-s konstatohet se bëhet fjalë për revokim dhe jo anulim.

Në lidhje me motivin e parë të rekursit, pra të zbatimit të gabuar të nenit 26 të ligjit nr.10418/2011, mosplotësimin e kushteve kumulative të zbatueshme për pikën 1 të këtij neni nga pala paditëse, kjo në lidhje me dispozitat e neneve 216 dhe 219, të ish Kodit Doganor, Kolegji Administrativ vëren se është vendi për të analizuar dhe interpretuar përmbajtjen e atyre dispozitave të ish Kodit Doganor, tashmë i shfuqizuar por i zbatueshëm për mosmarrëveshjen në gjykim, si edhe të ligjeve të posaçme me nr.7928/1995

dhe ligjit nr.10418/2011, që janë të zbatueshme në zgjidhjen e çështjes objekt i këtij gjykimi.

Pra, në nenin 216 të këtij Kodi, përcaktohen dy rregullat e përgjithshme mbi mënyrën se si lind borxhi doganor dhe çastin kur lind ky borxh, rregulla të përgjithshme këto që ishin të zbatueshme për çdo procedurë doganore, përveç kur nga ai Kod apo me ligj të veçantë parashikohen mënyra, afate dhe kushte të tjera specifike lidhur me lindjen e borxhin doganor. Në vijim të nenit 216, që bën pjesë në kreun 2 "*Lindja e një borxhi doganor*", pra në nenet 217-221, përcaktohen pikërisht rastet, mënyrat, afatet dhe kushtet e posaçme për borxhin doganor, të ndryshme nga rregulli i përgjithshëm i nenit 216.

Ndërmjet të tjerave, sikurse citohet më sipër, neni 219 përcakton disa nga mënyrat dhe afatet e posaçme të lindjes së borxhit doganor. Në pikën 1 përcakton mënyrën e lindjes së borxhit doganor për disa rrethana të rasteve të mallrave të vendosura në regjime doganore specifike, ndërsa në pikën 2 si çasti kur lind ky borxh që për këto raste specifike nuk është ai i datës së pranimit të deklaratës doganore, por çasti kur nuk përmbushet detyrimi përkatës i lidhur me regjimin e posaçëm doganor të aplikuar në raste specifike. Në ligjin nr.7928, datë 27.04.1995 *"Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar*), sipas përmbajtjes së normave të zbatueshme lidhur me mosmarrëveshjen në gjykim, në nenin 26 të tij parashikohet se: [...] *2.1. Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht nga lloji i saj, me përjashtim të makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në shkronjat "g" dhe "gj", të nenit 26/1, të këtij ligji, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH deri në 12 muaj. Për rastet kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më i gjatë se 12 muaj, Ministri i Financave ka autoritetin ta zgjasë afatin e shtyrjes së pagesës së TVSH, në varësi të ciklit të zhvillimit të investimit të parashikuar në marrëveshje apo kontratë. Sipas kësaj skeme, TVSH nuk paguhet në doganë, në çastin e importit. Skema e re e shtyrjes së pagesës së TVSH përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. ....."*.

Ky ligj, në bazë dhe për zbatim të të cilit është miratuar edhe vendimi nr.559/2006 i Këshillit të Ministrave *"Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH SHA",* jo vetëm që përcakton rregullat e posaçme lidhur me kuptimin, kushtet dhe mënyrën e vjeljes së taksës mbi vlerën e shtuar (TVSH), por me dispozitën e nenit 26 të sipërcituar përcakton disa rregulla edhe më të posaçme, përtej rregullimeve më të përgjithshme të

legjislacionit doganor, në lidhje me rastet, kushtet dhe mënyrën e vjeljes së TVSH për mallrat dhe furnizimet e importuara.

Pra, në pikat 1 dhe 2, të nenit 26, përcakton se, për efekt të TVSH, importimi i mallit "*quhet i kryer në momentin e parashikuar në*" Kodin Doganor, autoriteti doganor ka përgjegjësinë të kryejë procedurat e *llogaritjes dhe pagesës së TVSH në importimin e mallrave njësoj sikur ka përgjegjësinë e verifikimit, llogaritjes dhe vjeljes së tarifave dhe taksave të tjera doganore të caktuara me ligj,* të evidentojë momentin e importimit edhe nëse nuk ka taksa e tarifa të tjera doganore për t'u paguar pra "*edhe në qoftë se mallrat e importuara janë apo jo të përjashtuara nga taksat doganore nga ai ligj",* të llogarisë dhe vjelë TVSH për importin e mallit a furnizimit sipas shkallës dhe vlerës së TVSH në momentin e importimit.

Por, gjithashtu, me pikat 2.1 e vijuese, të nenit 26, procedurave doganore dhe regjimeve doganore, si edhe mënyrës e çastit kur lind e shlyhet një borxh doganor, i shtohen disa kushte specifike të zbatueshme për importime mallrash dhe furnizimesh të llojeve dhe destinacioneve të caktuara, si edhe përgjegjësitë dhe procedurat e vendosjes së këtyre importeve në regjime të tilla të posaçme doganore.

Në pikën 2.1, të nenit 26, të ligjit nr.7928/1995, ky regjim doganor i posaçëm, përfshirë edhe çastin e posaçëm të lindjes së borxhit doganor të ndryshëm nga ai i përcaktuar në nenin 216 të ish-Kodit Doganor, jepet në rastin kur importimi ka të bëjë me "*makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht nga lloji i saj*". Specifika e këtij regjimi dhe dallimi nga rregullimi i përgjithshëm i nenit 216 (mbi çastin e lindjes së borxhit doganor është dita e kryerjes dhe pranimit të deklaratës doganore të importit, pra çasti në të cilin lind edhe detyrimi për të shlyer detyrimin doganor) është që vendoset një kusht të posaçëm ligjor sipas të cilit për makineritë dhe pajisjet që importohen në funksion të veprimtarisë së subjektit, masa e TVSH së pagueshme të përcaktohet në momentin e importimit, por detyrimi për të paguar detyrimin doganor për TVSH nuk lidhet me çastin e pranimit të deklaratës doganore, për shkak se ky detyrim, mbi kërkesën e subjektit shtyhet për një afat 12 mujor a më tepër sipas ligjit, për rrjedhojë, edhe borxhi doganor lind vetëm në çastin kur ka përfunduar ky afat i shtyrjes së pagesës së detyrimit dhe subjekti doganor e tatimor përfitues nuk e ka shlyer detyrimin (në këtë rast detyrimin për TVSH-në e importit në vlerën e caktueshme në çastin e importit).

Kolegji Administrativ, duke pasur parasysh sa arsyetohet më sipër mbi interpretimin dhe zbatimit e drejtë të normave të Kodit Doganor, ligjit

nr.7928/1995 dhe akteve nënligjore nxjerrë në zbatim të tyre, vlerëson se si gjykata e shkallë së parë ashtu edhe gjykata e apelit kanë zbatuar gabim dispozitat e ish-Kodit Doganor dhe nuk kanë identifikuar si ligj të zbatueshëm e zbatuar ligjin nr.7928/1995 në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim, mbi vetë rrethanat e faktit të pranuara të vërtetuara prej tyre.

Të dy gjykatat e faktit mbështeten vetëm në nenin 216 të ish-Kodit Doganor duke injoruar rregullimin e posaçëm të nenit 219 të atij Kodi, pra duke pranuar si çast të lindjes së detyrimit dhe borxhit doganor, vetëm rregullin e përgjithshëm, atë të ditës së pranimin të deklaratës doganore.

Të dy gjykatat e faktit nuk kanë identifikuar dhe nuk kanë zbatuar si ligj të posaçëm të zbatueshëm për mosmarrëveshjen në gjykim dhe faktit të pranuar prej tyre, regjimet juridike doganore të veçanta që përcakton dispozita e nenit 26 të ligjit nr.7928/1995, përfshirë atë të pikës 2.1 të këtij neni për shtyrjen e afatit të lindjes së detyrimit dhe borxhit doganor dhe të shlyerjes së pagesës për TVSH në përfundim të afatit 12-mujor të miratuar me autorizim nga autoriteti doganor apo të afatit tjetër shtesë të miratuar me autorizim nga Ministri i Financave.

Në çështjen objekt gjykimi, nëse referohemi në rrethanat e faktit të pranuara nga dy gjykatat, masa e detyrimit doganor për TVSH që duhet të paguante pala paditëse "CDC" SHPK *përcaktohet nga shkalla e vlera tatimore në ditën e importimit dhe pranimit të deklaratës doganore, pra në tetor-nëntor të vitit 2008.*

Ndërsa borxhi doganor, në zbatim të ligjit, nuk mund të pranohet se ka lindur në çastin e pranimit të deklaratës doganore, por pas përfundimit të afatit të shtyrjes së pagesës së kësaj TVSH sipas ligjit të posaçëm nga i cili përfitonte paditësi këtë regjim të posaçëm favorizues doganor, pra pas përfundimit të afatit të dytë të shtyrjes miratuar me autorizim nga Ministri i Financave dhe nëse ky kusht nuk është përmbushur nga paditësi "CDC" SHPK, ndaj tij duhet të pranohet se ka lindur edhe borxhi doganor përtej kësaj date, kur edhe në zbatim të drejtë të Kodit Doganor pala e paditur Dega e Doganës Tiranë ka kryer edhe veprimet për evidentimin dhe kontabilizimin e borxhit doganor dhe vënien në lëvizje të mekanizimit ligjor për vjeljen me forcë të borxhit doganor.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin e posaçëm me nr.10418 datë 21.04.2011 "*Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor*". Në këtë ligj, lidhur me procedurat doganore dhe detyrimet ende të pashlyera të subjekteve doganore, në nenin 26 të tij parashikohet se: [...] *1. Falen të gjitha detyrimet, gjobat dhe kamatëvonesat e debitorëve ndaj administratës doganore, të lindura deri më 31 dhjetor 2008 dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate, të*

kontabilizuara deri më 31 dhjetor 2010 dhe të papaguara, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë. 2. Të gjithë debitorëve ndaj administratës doganore që, brenda afatit të zbatimit të këtij ligji, paguajnë 50 për qind të shumës së principalit të detyrimit, të lindur gjatë vitit 2009 dhe të evidentuar nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate e të kontabilizuar dhe të papaguara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, u falen gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me këto detyrime. 3. Të gjithë debitorëve ndaj administratës doganore që, brenda afatit të zbatimit të këtij ligji, paguajnë të gjithë shumën e principalit të detyrimit, të lindur gjatë vitit 2010 dhe të evidentuar nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate dhe të kontabilizuar e të papaguar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, u falen gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me këto detyrime…".

Në interpretim dhe zbatim të drejtë të këtij neni, për të përfituar faljen e plotë a të pjesshme (50%) të principalit të detyrimit doganor dhe/ose të gjobave e kamatëvonesave, gjendja e procedimit administrativ të subjektit doganor aplikues duhet të përmbushë tri kushte kumulative: (a) kohën kur ka lindur detyrimi (borxhi) doganor, (b) kohën kur ky detyrim (borxh) doganor është evidentuar dhe kontabilizuar nga administrata doganore dhe (c) natyrisht detyrimi, gjobat dhe kamatëvonesat të mos jenë parapaguar. Koha kur ka lindur detyrimi (borxhi) doganor dhe koha kur ai është kontabilizuar nga administrata doganore janë përcaktuar në mënyrë të posaçme në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 26, për secilin nga rastet e përfitimit të faljes së borxhit doganor. Nëse nuk përmbushet, në secilin rast, qoftë edhe njëri nga dy kushtet e para kumulative subjekti nuk përfiton faljen përkatëse sipas ligjit nr.10418/2011. Për të gjitha rastet mënyra dhe koha e lindjes së detyrimit dhe borxhit doganor, si edhe evidentimit dhe kontabilizimit të tij përcaktohen sipas Kodit Doganor dhe dispozitave ligjore që përcaktojnë rregulla të tjera të posaçme për këtë qëllim.

Në rastin objekt i këtij gjykimi, nëse rrethanat e faktit mbeten të pranuara ashtu si janë vlerësuar nga gjykatat e faktit, si përpara ngritjes së padisë, por edhe me anë të padisë e gjatë gjykimit të çështjes, pala paditëse "CDC" SHPK duket se ka pretenduar se përfiton faljen tërësore të borxhit doganor të papaguar prej tij sipas ligjit nr.10418/2011 në rastin e parashikuar nga pika 1 e nenit 26, duke argumentuar se detyrimi dhe borxhi doganor kanë lindur përpara datës 31.12.2008, konkretisht në periudhën tetor-nëntor 2008, si edhe ky detyrim i papaguar është kontabilizuar nga administrata doganore në 15.01.2010, pra përpara datës 31.12.2010.

Palët e paditura Dega e Doganës Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si edhe avokati i shtetit në mbrojtje të interesit publik të tyre, gjatë gjykimit kanë prapësuar se padia duhet të rrëzohet për disa motive, ndër të tjera, për motivin sepse për importimin e pajisjeve spitalore të palës paditëse "CDC" SHPK momenti i lindjes së borxhit doganor nuk është dita e pranimit të deklaratës doganore por koha e mbarimit të afatit të shtyrjes së detyrimit doganor sipas pikës 2.1, të nenit 26, të ligjit nr.9728/1996, pra përtej datës 06.11.2010. Ndërsa kontabilizimi i këtij borxhi doganor është bërë pasi ai ka lindur, me vendimin nr.370 prot., datë 21.01.2011 të palës së paditur Dega e Doganës Tiranë. Pra, sipas prapësimit të palëve të paditura nuk gjen zbatim rasti i parashikuar nga pika 1, e nenit 26, të ligjit nr.10418/2011 që përbën arsyen thelbësore të objektit të padisë. Kjo edhe për arsyen se, gjatë procedimit administrativ, pala e paditur Dega e Doganës Tiranë e ka njoftuar palën paditëse "CDC" SHPK se mund të përfitojë vetëm sipas pikës 3, të nenit 26, faljen e gjobës dhe kamatëvonesave përkundrejt shlyerjes së plotë të detyrimit principal doganor të vlerës së TVSH për pajisjet spitalore të importuara.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes, *së pari,* sikurse ky Kolegj Administrativ ka arsyetuar më sipër në këtë vendim lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe interpretimin e tij në zgjidhjen e çështjes objekt i këtij gjykimi, gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së parë kanë interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin kur, lidhur me kushtin e parë kumulativ të përfitimit të faljes, arsyetojnë se çasti i lindjes së borxhit doganor është ai i pranimit të deklaratës doganore nga administrata doganore sipas nenit 216 të Kodit Doganor. Në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit, çasti i lindjes së borxhit doganor, edhe për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, është ai pas përfundimit të afatit të shtyrjes së pagesës së detyrimit doganor të miratuar me autorizimin më të fundit të Ministrit të Financave sipas nenit 219 të Kodit Doganor dhe pikës 2.1, të nenit 26, të ligjit nr.7928/1995.

Meqenëse, pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 dhe miratimit të ndryshimeve me ligjin nr.39/2017 Gjykata e Lartë si gjykatë kasacioni nuk zgjidh më vetë çështje por vetëm konfirmon ose prish vendimet e gjykatave më të ulëta, atëherë, në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, duke u konformuar me ligjin e zbatueshëm të identifikuar dhe interpretimin e tij nga ky Kolegj më sipër në këtë vendim, të verifikojë gjendjen e faktit dhe provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse në mosmarrëveshjen në shqyrtim ku kërkimi është falja e detyrimeve sipas pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr.10418/2011 dhe të zgjidhë drejt çështjen duke zbatuar ligjin si më sipër mbi faktin e pranuar prej saj.

Së dyti, gjithashtu, Kolegji Administrativ vlerëson se gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së parë kanë zbatuar gabim ligjin kur, lidhur me kushtin e dytë kumulativ të përfitimit sipas nenit 26 të ligjit nr.10418/2011, arsyetojnë se koha e evidentimit dhe kontabilizimit të detyrimit (borxhit) doganor nuk janë veprimet dhe aktet e administratës doganore, të kryera në janar të vitit 2011 pas përfundimit të afatit të shtyrjes së pagimit të detyrimit doganor (06.11.2010) sikurse prapësojnë palët e paditura, por është koha kur janë nxjerrë aktet nga kjo palë e paditur për kontabilizimin e borxhit doganor, vendimi nr.154, datë 15/01/2010 i palës së paditur Dega e Doganës Tiranë, sikurse pretendon pala paditëse. Të dy gjykatat kanë mbajtur këtë qëndrim ndonëse ky akt administrativ është "anuluar" më pas (në korrik 2010) po nga pala e paditur Dega e Doganës Durrës si i motivuar gabim ligjërisht dhe pa marrë parasysh autorizimin e Ministrit të Financave për shtyrjen e dytë të afatit të pagesës së principalit të detyrimit doganor objekt gjykimi.

Sikurse arsyetohet më sipër në këtë vendim të këtij Kolegji mbi ligjin e zbatueshëm dhe interpretimin e tij, në rastin në gjykim nuk gjejnë zbatim rregullimet e përgjithshme të Kodit Doganor për çastin e lindjes së borxhit doganor, pra çasti i pranimit të deklaratës doganore pas të cilit administrata doganore nxjerr aktet përkatëse për vjeljen e borxhit doganor (sipas nenit 216 të këtij Kodi), por neni 219 i tij në kombinim me ligjin e posaçëm që parashikon regjim të posaçëm doganor në rastin e importimit të pajisjeve në funksion të veprimtarisë së subjektit doganor, pra pika 2.1, e nenit 26, të ligjit nr.7928/1995 dhe VKM nr.559/20016 i nxjerrë në zbatim të këtij ligji. Sipas këtij rregullimi të posaçëm, detyrimi dhe borxhi doganor lind pas përfundimit të afatet të skemës përfituese të shtyrjes së kohës së pagimit të detyrimit për TVSH-në e pagueshme dhe akteve administrative që nxirren nga administrata doganore për njoftimin dhe vjeljen edhe forcërisht të këtij borxhi doganor.

Prandaj, edhe për këtë motiv, Gjykata Administrative e Apelit, duke u konformuar me ligjin e zbatueshëm të identifikuar dhe interpretimin e tij nga ky Kolegj më sipër në këtë vendim, të verifikojë gjendjen e faktit dhe provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse në mosmarrëveshjen në shqyrtim ku kërkimi është falja e detyrimeve sipas pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr.10418/2011 dhe të zgjidhë drejt çështjen duke zbatuar ligjin si më sipër mbi faktin e pranuar prej saj.

Së treti, ndonëse qoftë edhe njëri nga dy motivet e nënvizuara më sipër, janë të mjaftueshme për të ardhur në përfundimin se gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin në zgjidhjen e çështjes duke urdhëruar rigjykimin e çështjes në shkallë të dytë, Kolegji Administrativ vlerëson se është vendimi për të

tërhequr vëmendjen e gjykatës së apelit dhe gjykatës së shkallës së parë lidhur me zbatimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit kur ato arsyetojnë që, ndonëse nuk ka pasur kërkim padie nga ana e palës paditëse në padi, edhe kryesisht kanë pasur kompetencën dhe detyrimin për të vlerësuar dhe për t'u shprehur lidhur me pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të nxjerra nga pala e paditur Dega e Doganës Durrës, më konkretisht për aktet administrative vendimi nr.3556 prot., datë 07.07.2010 *"Mbi anulimin e vendimit nr.154 prot., datë 15.01.2010 të Doganës Tiranë";* vendimi nr. 370 prot., datë 21.01.2011 për rikontabilizimn e mëvonshëm të borxhit doganor, si edhe vendimit tjetër me nr.467 prot., datë 22.01.2011 *"Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor*".

Kolegji Administrativ vëren se të dy gjykatat e faktit kanë ngatërruar kompetencën dhe detyrimin e tyre për të vlerësuar dhe për t'u shprehur për pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik me atë të akteve administrative. Edhe Kolegjet e Bashkuara me praktikën e unifikuar, edhe kolegjet e zakonshme të Gjykatës së Lartë, janë shprehur se gjykatat, edhe kryesisht, pa kërkim të palëve, shprehen për pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, ndërkohë që nuk mund të ketë padi vetëm me objekt të tillë kërkimi nëse nuk kërkohen në padi pasa konkrete që lidhen me nulitetin e atij veprimi juridik. Ndërsa për aktet administrative, ish-dispozitat e KPC-s parashikonin një lloj më vete padie, që do të thotë se nuliteti i aktit administrativ nuk mund të vihet në bisedim nga gjykata kryesisht, pro vetëm nëpërmjet kërkimit të padisë. E njëjta qasje mbahet edhe nga ligji nr.49/2012, që, në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 17, përcakton atë si një nga llojet e padive që ngrihen në gjykatën administrative. Ndërkohë, me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurave Administrative, por që nuk është i zbatueshëm për çështjen objekt gjykimi, në pikën 2, të nenit 110, parashikohet edhe e drejta e organit administrativ, si edhe e gjykatës që të vlerësojnë e konstatojnë edhe kryesisht pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ.

Së katërti, Kolegji Administrativ vlerëson se është vendimi për të tërhequr vëmendjen e gjykatës së apelit dhe gjykatës së shkallës së parë, edhe lidhur me zbatimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit kur ato arsyetojnë që është i paligjshëm dhe absolutisht i pavlefshëm vendimi nr. 3556 prot., datë 07.07.2010, me të cilin pala e paditur Dega e Doganës Tiranë ka disponuar anulimin e vendimit nr.154 prot., datë 15.01.2010 të nxjerrë po nga ky organ administrativ për lindjen e borxhit doganor të palës paditëse "CDC" SHPK.

Këtë përfundim të dy gjykatat e mbështesin në arsyetimin se i njëjti organ administrativ që ka nxjerrë aktin nuk mund të disponojë më vonë shfuqizimin apo anulimin e tij, por vetëm revokimin e aktit nëse edhe ky disponim ka mbështetje ligjore dhe nuk cenon palët që nuk kanë përfituar

padrejtësisht nga akti që revokohet. Këtë kompetencë e ka vetëm organi epror administrativ dhe gjykatat.

Ky arsyetim i gjykatave mbi ligjin është përgjithësisht korrekt por i gabuar është interpretimi që ato gjykata i kanë bërë aktit administrativ duke e kategorizuar si akt anulimi dhe jo si akt revokimi.

Në të vërtetë, pavarësisht nga përdorimi i pavend i termit juridik anulim, nëse shqyrtohet në përmbajtje, motivim, mbështetje ligjore dhe arsyetim, akti administrativ Vendimi nr.3556 prot., datë 07.07.2010 i palës së paditur Dega e Doganës Tiranë është dukshëm e kuptueshme juridikisht se bëhet fjalë për një akt administrativ revokimi dhe jo shfuqizimi apo anulimi të një akti të mëparshëm. Ky akt bazohet pikërisht në dispozitat që rregullojnë aktin revokues dhe në përmbajtje arsyeton qartë se akti i mëparshëm ishte nxjerrë prej vetë atij organi doganor në kundërshtim me ligjin, pa marrë parasysh rrethanat që nuk sjellin ende lindjen e borxhit doganor dhe që kishte dëmtuar padrejtësisht interesat e ligjshme të një subjekti doganor përfitues rregullisht nga shtyrja e afatit të shlyerjes së detyrimit, pra ishte i favorshëm për interesin e ligjshëm të palës paditëse "CDC" SHPK.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-216, datë 13.02.2018

Organet publike, në fushën e veprimtarisë së tyre, kanë detyrimin e garantimit të drejtave si dhe moscenimin e tyre nga subjekte të tjerë duke refuzuar kryerjen e veprimeve të paligjshme, që passjellin në forma të ndryshme tjetërsimin e këtyre të drejtave.

Në këtë kuptim, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), si organe publike, kanë detyrimin që të garantojnë subjektet se, veprimet në regjistrin e pasurive të paluajtshme kryhen mbi bazën e një akti të rregullt noterial, një akti administrativ të nxjerrë sipas ligjit ose një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duke siguruar moscenimin e titujve në regjistra nga subjekte të tjerë dhe refuzuar kryerjen e veprimeve të caktuara si për shembull tjetërsimit të pronës së paluajtshme.

Rekursi i paraqitur nga pala e paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (ZQRPP Tiranë) përmban shkaqe nga ato që i parashikon ligji material i zbatueshëm për gjykimin e çështjes. Prandaj, vendimi nr.2466, datë 17.11.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të prishet dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.985, datë 15.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, për sa u përket rrethanave të faktit, rezulton se, paditësi R.H. i është drejtuar palës së paditur Zyrës Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (ZVRPP Tiranë), për regjistrimin e një pasurie të paluajtshme truall me 424 m2, bazuar në kontratën e shitblerjes me nr.674 rep. dhe nr.184 kol. të datës 30.01.1996. [...].

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.985, datë 15.02.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pala paditëse R.H. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. [...].

Gjykata e Apelit Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, *me vendimin nr.2466 datë 17.11.2011*, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 985, datë 15.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në këtë mënyrë: Shfuqizimin e urdhrit nr. 583, datë 28.07.2009 të palës së paditur ZQRPP Tiranë dhe detyrimin e saj të regjistrojë sipërfaqen truall 424 m2 e

ndodhur në rrugën "*Kongresi i Manastirit*" në favor të paditësit R.H. [...].

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, pala e paditur ZQRPP Tiranë ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. [...].

Kolegji Administrativ vëren se, për sa i përket ligjit të zbatueshëm që duhet të mbahet parasysh nga gjykatat në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative të kësaj natyre, mes të tjerash, janë dispozitat e Kodit Ccivil (KC)-s ku parashikohet se: *"Neni 192 Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji. Neni 193 Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme: a) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjesëtimin vullnetar të tyre; [...] Neni 208 Tjetërsimi i sendit të përbashkët mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve."*.

Po kështu, në ligjin nr.7843/1994 *"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme",* tashmë i shfuqizuar por i zbatueshëm në mosmarrëveshjen në gjykim, parashikohet se: *"Neni 2/1 Objekti i veprimtarisë. Objekt i veprimtarisë së zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme është regjistrimi i titujve të pronësisë dhe i të drejtave të tjera reale për pasuritë e paluajtshme në bazë të dokumenteve ligjore, që vërtetojnë pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme [...] Neni 15 Regjistrimi i pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi.* Çdo dokument që vërteton pronësinë të dy ose më shumë personave si dhe regjistrimi i tij në zyrën e regjistrimit, duhet të tregojë identitetin, pjesën e secilit bashkëpronar kur kjo e fundit është e mundshme. *Neni 22 Kalimi i pronësisë së një pjese të pasurisë së paluajtshme. Asnjë pjesë në natyrë të pasurisë së paluajtshme të përfshirë në një kartelë nuk kalohet në pronësi tjetër në qoftë se pronari nuk e ka ndarë pasurinë e paluajtshme më parë, në përputhje me ligjin dhe në qoftë se nuk janë hapur kartela të reja për çdo nënndarje të pasurisë së paluajtshme. Neni 24 Mënyra e regjistrimit fillestar. Regjistruesi, një person ose çdo grup i ngarkuar nga kryeregjistruesi kërkon që pronësia si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen duke përdorur kriteret e mëposhtme: a) Pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të KC [...]."*.

Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, në Udhëzimin nr.1, datë 31.01.2007 të Këshillit të Ministrave "*Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme*", parashikohet se: *"3. Për verifikimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes së akteve noteriale, punonjësit e ZRPP, që përpunojnë kërkesat individuale për regjistrim, procedojnë duke verifikuar, sipas shtojcës 2, të këtij udhëzimi: a) elementët e formës, në përputhje me ligjin nr.7829, datë 01.06.1994, "Për noterinë", të ndryshuar, dhe, sipas rastit, në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse; b) vërtetësinë e regjistrimit ekzistues të pasurisë së paluajtshme, objekt kërkesë për regjistrim, në emër të tjetërsuesit, të përmendur në aktin noterial; c) nëse në aktin noterial të dhënat për pronën, pasuri e paluajtshme, janë të plota dhe lejojnë regjistrimin e saj [...]. 5. Kërkesat për regjistrim refuzohen në rastet e mëposhtme: [...] f) Kur në aktet noteriale: i. nuk plotësohen elementët e formës, sipas shtojcës 2, të këtij udhëzimi; ii. tjetërsuesi nuk figuron si pronar i pasurisë në fjalë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, që administrohen nga ZRPP. [...]"*.

Ndërsa në shtojcën 2 të këtij Udhëzimi "*Pasuri e njohur ose e fituar me anën e një akti noterial"*, kur shqyrtohet kërkesa për regjistrim të pronës bazuar në një akt noterial për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme, mes të tjerash, në rubrikën 10 "*Verifikimet e aktit noterial*", në pikën 10.10, përcaktohet si element përcaktues dhe detyrues për ZRPP për pranimin e kërkesës që "*Prona e paluajtshme, objekt kërkese për regjistrim, figuron në regjistrat e ZRPP-së në emër të tjetërsuesit të përmendur në aktin noterial*".

Kolegji Administrativ duke pasur parasysh përmbajtjen e dispozitave ligjore dhe nënligjore normative të sipërcituara, për zbatimin dhe interpretimin e drejtë të ligjit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura mes palëve të një akti noterial për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vlerëson të evidentojë që gjykatat administrative kanë për objekt shqyrtimi një mosmarrëveshje të natyrës administrative dhe që nuk lidhet me pretendime të palëve mbi vlefshmërinë e aktit mbi të cilin kërkohet a pretendohet veprimi ose mosveprimi i ZRPP.

Në këtë kuptim, gjykatat duhet të verifikojnë pretendimet dhe prapësimet e palëve vetëm në lidhje me përmbushjen e rregullt ose jo nga ana e ZRPP procedurave dhe të kompetencave që u ngarkon atyre ligji për verifikimin e ekzistencës së kushteve dhe të të dhënave të dokumentacionit që lidhet me pasurinë e paluajtshme për të cilën nga subjektet e interesuara kërkohet të kryen veprimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Nëse, p.sh., ka mospërputhje ndërmjet të dhënave dhe vullneteve që përmbahen në aktet e çdo forme mbi bazën e të cilave kërkohet nga ZRPP kryerja e veprimeve në regjistrat e pasurive të paluajtshme, me të dhënat që përmbahen në këto regjistra, ZRPP- kanë detyrimin (nëse lejohet a është e mundur të plotësohen) që të orientojnë plotësimin e të kushteve dhe të dhënave të munguara apo edhe të refuzojnë kryerjen e veprimit të kërkuar nga palët pjesëmarrëse të aktit ose cilido tjetër i interesuar.

Ndërkohë që, nga njëra anë, ZRPP janë organe administrative që nuk kanë për objekt të veprimtarisë së tyre të shqyrtojnë dhe vendosin mbi vlefshmërinë a pavlefshmërinë e veprimit juridik apo akteve të tjera sipas ligjit, mbi të cilat subjektet kërkojnë kryerjen apo jo të një procedure të caktuar me regjistrin e pasurive të paluajtshme. Nga ana tjetër, këto zyra janë të ngarkuara posaçërisht nga ligji të garantojnë integritetin ligjor dhe vetë arsyen e ekzistencës së këtyre regjistrave, përfshirë, ndër të tjera edhe garancitë që kanë individët a personat juridikë që figurojnë të regjistruar si titullarë a bashkëtitullarë pronësie a të drejtash reale në këto regjistra.

Prandaj, sipas dispozitës parimore, nenit 2/1 të ligjit nr.7843/1994, është e vërtetë që ZRPP kanë kompetencën, pra të drejtën dhe detyrimin për regjistrimin e "*.... titujve të pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale për pasuritë e paluajtshme.....".* Por, në përmbushjen e këtij detyrimi, ZRPP-të nuk janë thjesht dhe vetëm depozitarë a magazinues aktesh të lidhura me prona të paluajtshme. Kjo për shkak se, njëkohësisht, ZRPP kanë edhe të drejtën/detyrimin tjetër që veprimet e regjistrimit t`i kryejnë vetëm "*... në bazë të dokumenteve ligjore, që vërtetojnë pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme...*" dhe vetëm nëse plotësohen procedurat dhe kushtet e përcaktuara me akte ligjore e nënligjore të posaçme (mes të tjerash, edhe në dispozitat vijuese të ligjit nr.7843/1993 dhe në Udhëzimin nr.1/2007 të Këshillit të Ministrave, sikurse janë cituar një pjesë e tyre, më sipër në këtë vendim). Vetëm pas verifikimit të detyrueshëm administrativ të përmbushjes së këtyre kushteve, ZRPP janë të detyruara që të kryejnë veprimet në regjistrat e pasurive të paluajtshme sipas përcaktimeve që përmbahen në aktet që sjellin lindje dhe ndryshime në tituj pronësie dhe të drejta të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme.

Pra, nga njëra anë, me të vërtetë nuk është në kompetencën e ZRPP të vlerësojnë dhe të shprehen për vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e veprimeve juridike, akteve administrative a vendimeve gjyqësore mbi bazën e të cilave kërkohet kryerja e veprimeve në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Megjithatë, nga ana tjetër, ZRPP është një organ publik që ka në objektin e veprimtarisë, përveç të tjerave, edhe detyrimin t`u garantojë të gjithë subjekteve të cilët figurojnë në regjistër me të drejta pronësore e të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme, se të gjitha veprimet në regjistra të kryhen mbi pasurinë e tyre vetëm kur ata janë palë dhe kanë shprehur vullnetin e tyre me akt të rregullt noterial apo kur veprimet në regjistra duhet të kryhen mbi bazën e një akti administrativ të nxjerrë sipas ligjit ose vendimi gjyqësor të formës së prerë. Po kështu, detyrë e ZRPP është të garantojnë të gjithë subjektet të cilët figurojnë në regjistër me të drejta pronësore e të tjera reale me pasuritë e paluajtshme që regjistrimet ekzistuese të këtyre titujve

në regjistra të mos cenohen a ndryshohen nga subjekte të tjerë, që nuk kanë të drejta pronësore dhe reale të regjistruara për atë pasuri të paluajtshme.

Në këtë kuptim, ka një numër jo të vogël rastesh kur ZRPP jo vetëm kanë të drejtën por edhe kanë detyrimin, pra kompetencën për të refuzuar kryerjen e veprimeve, p.sh. të tjetërsimit të pronës së paluajtshme kur ai bëhet me anë të aktit noterial. Kështu, nisur edhe nga përmbajtja e dispozitave ligjore e nënligjore të sipërcituara, për të kuptuar procesin administrativ të verifikimit të kërkesës, akteve dhe të dhënave që ato përmbajnë nga ana e ZRPP, për rrjedhojë edhe për të kuptuar se çfarë do të përbënte konflikt administrativ për t'u zgjidhur nga gjykata në të tilla rrethana, në vijim parashtrohen si shembuj vetëm katër nga rastet tipike kur ZRPP ka kompetencën e refuzimit të kërkesës për regjistrime të aktit të paraqitur si noterial nga ana e subjekteve kërkuese.

Së pari, kur ZRPP i paraqitet kërkesë për kryerjen e veprimeve në regjistër lidhur me tjetërsimin e një pronë të paluajtshme, pavarësisht nga detyrimet ligjore të verifikimit që i ka edhe noteri kur përpilon aktin noterial, kjo zyrë ka kompetencën që, të verifikojë dokumentin i cili i paraqitet si akt noterial e që përmban veprimin juridik mbi atë pronë, për të verifikuar nëse kemi të bëjmë apo jo me akt noterial ("akt publik"–neni 192 i KC-s). Nëse veprimi i tjetërsimit nuk është bërë me akt noterial, edhe pse aty mund të përmbahet ose në dukje përmbahet vullneti i pretenduar si i pavesuar i palëve kontraktore, ZRPP ka detyrimin të refuzojë kryerjen e veprimeve të kërkuara në regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Ligji urdhëron që tjetërsimi i sendit të paluajtshëm bëhet me akt noterial dhe jo me mënyra të tjera të shprehjes së vullnetit të palëve kontraktore. ZRPP, duke refuzuar kërkesën, nuk nuk mund të shprehet për pavlefshmërinë e aktit etj., por mjaftohet me evidentimin e faktit të dukshëm që veprimi nuk është bërë me akt noterial.

Po kështu veprohet edhe nëse dokumentit të paraqitur si akt noterial i mungojnë dukshëm elementë thelbësorë formalë të tij sipas KC-s, legjislacionit mbi noterinë etj.,. (si p.sh., nënshkrimi a vula nga noteri, nënshkrimi i palës në akt etj.,). Për këto motive specifike ZRPP ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin të refuzojë kryerjen e veprimeve të kërkuara në regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Në të gjitha këto raste nuk bëhet fjalë për vlerësim dhe gjykim nga ZRPP të (pa)vlefshmërisë së aktit noterial, por për verifikim të ekzistencës së disa prej elementëve formalë të dukshëm të aktit sikurse janë p.sh. verifikimi i autoritetit të dhënë sipas ligjit personit që rezulton të jetë noteri që ka përpiluar aktin, ekzistenca e nënshkrimit të noterit dhe vulës së tij në akt etj.,. Po kështu, për verifikimin administrativ të elementëve të tillë të

aktit noterial si identiteti i qartë dhe i saktë i palëve pjesëmarrëse në akt, ekzistenca e nënshkrimit nga ana e tyre në akt (por jo dyshimi për vullnetin e palës a falsitetin e nënshkrimit), pa të cilat ZRPP nuk mund të verifikojë të dhënat që përmbahen në regjistër lidhur me atë pronë dhe subjektet pjesëmarrëse (p.sh. të tjetërsimit), në mënyrë që të pranojë a të refuzojë kryerjen e veprimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Së dyti, nëse kemi të bëjmë me një akt noterial të tjetërsimit të pronës së paluajtshme, pavarësisht nga detyrimet ligjore që i ka edhe noteri përpara se të përpilojë aktin noterial, ZRPP ka kompetencën të verifikojë nëse kjo pronë e pretenduar se tjetërsohet me atë akt, jo vetëm ekziston apo jo, por edhe nëse është ose jo e regjistruar paraprakisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Nëse një send, i pretenduar si i paluajtshëm, nuk ekziston apo nuk është i regjistruar paraprakisht, nuk ka vend për t'u regjistruar dhe më pas për t'u tjetërsuar. Për rrjedhojë, ZRPP, jo vetëm nuk është e detyruar të kryejë veprime regjistrimi, por ka edhe detyrimin që të refuzojë kryerjen e veprimeve të kërkuara. Refuzimi i kërkesës për regjistrim nuk është e nevojshme të motivohet mbi pavlefshmërinë e aktit noterial, të veprimit juridik etj., por motivohet mbi mungesën e regjistrimit të sendit të paluajtshëm në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Së treti, nëse kemi të bëjmë me një akt noterial të tjetërsimit të pronës së paluajtshme, pavarësisht nga detyrimet ligjore që i ka edhe noteri përpara se të përpilojë aktin noterial, ZRPP ka kompetencën të verifikojë në regjistrat e saj nëse kjo pronë që kërkohet të tjetërsohet rezulton që është ose jo e regjistruar në pronësinë e palës tjetërsuese. Pra, verifikohet jo vetëm nëse në akt noterial është e identifikuar qartë prona që tjetërsohet në krahasim me të dhënat që përmban regjistri i pasurive të paluajtshme, por edhe nëse kjo pronë është e regjistruar aty në emër të subjekteve që nga ky akt noterial rezultojnë të jenë si pala tjetërsuese. Nëse jo, edhe në këtë rast, ZRPP jo vetëm nuk është e detyruar të kryejë veprime regjistrimi, por ka detyrimin që të refuzojë kryerjen e veprimeve të kërkuara. Refuzimi i kërkesës për regjistrim nuk është e nevojshme të motivohet mbi pavlefshmërinë e aktit noterial, të veprimit juridik etj., por mjafton të motivohet mbi mungesën e regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme të sendit që tjetërsohet në emër të subjekteve që nga akti noterial rezultojnë si pala tjetërsuese e atij sendi.

Së katërti, nëse kemi të bëjmë me një akt noterial të tjetërsimit të pronës së paluajtshme, pavarësisht nga detyrimet ligjore që i ka edhe noteri përpara se të përpilojë aktin noterial, në rastin e sendeve në bashkëpronësi, ZRPP ka kompetencën të verifikojë nëse në aktin noterial për tjetërsimin e sendit në bashkëpronësi rezulton që janë palë tjetërsuese dhe kanë nënshkruar

rregullisht të gjithë bashkëpronarët e sendit që tjetërsohet ashtu sikurse këta bashkëpronarë janë të pasqyruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Nëse jo, edhe në këtë rast, sikurse kanë pranuar të vërtetuar faktin gjykatat më të ulëta në çështjen objekt gjykimi, ZRPP jo vetëm nuk është e detyruar të kryejë veprime regjistrimi, por ka detyrimin që të refuzojë kryerjen e veprimeve të kërkuara. Refuzimi i kërkesës për regjistrim nuk është e nevojshme të motivohet mbi pavlefshmërinë e aktit noterial, të veprimit juridik etj., por mjafton të motivohet mbi faktin që në regjistrin e pasurive të paluajtshme sendi nuk është në pronësi të palës tjetërsuese por në bashkëpronësi të tij edhe me persona të tjerë apo mbi faktin që sendi, përveç bashkëpronarëve të rezultuar si palë tjetërsuese në aktin noterial, ka edhe bashkëpronarë të tjerë të pasqyruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kolegji Administrativ, bazuar në vetë provat e çmuara dhe rrethanat e faktit të pranuara si të vërtetuara nga gjykatat e faktit, vlerëson se edhe në çështjen objekt i këtij gjykimi, jemi përpara rastit kur pala e paditur ZQRPP Tiranë me të drejtë ka refuzuar kërkesën e palës paditëse R.H. për regjistrimin në emër të tij të një sipërfaqe trualli prej 424 m2 ndodhur në Tiranë, që pretendon se e ka fituar në pronësi nëpërmjet aktit noterial, kontratë shitblerje nr. 674 rep., 184 kol., të datës 30.01.1996 të lidhur me palë tjetërsuese, personat e tretë në gjykim, në cilësinë e bashkëpronarëve të kësaj sipërfaqeje trualli.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2018-540, datë 03.04.2018

Ndjekja e rrugës administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse e parashikon këtë shprehimisht.

Në mungesë të rregullave të parashikuara në ligjin e posaçëm, gjejnë zbatim afatet, kushtet e procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative (KPA).

Shqyrtimi administrativ i ankimit duhet të garantojë si uniformitetin e veprimtarisë administrative dhe sigurinë juridike por edhe t'u ofrojë individëve dhe subjekteve të tjerë një proces të rregullt ligjor dhe një mjet juridik efektiv.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me kërkesën nr.3450, datë 01.06.2012, paditësja i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër me kërkesë për caktim pensioni familjar. Në lidhje me këtë kërkesë, pala e paditur, me vendimin nr.181, datë 31.07.2012, ka kthyer përgjigje negative me arsyetimin se paditësja, në momentin e bërjes së kërkesës, duhet të kishte tokë në pronësi, pasi më parë ka qenë banore e fshatit Mnelë.

2. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, paditësja i është drejtuar Komisionit Rajonal të Ankimit pranë DRSSH Shkodër me kërkesë ankimore. Ky i fundit, pasi ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e disponueshëm, me vendimin nr.184, datë 29.08.2012, ka vendosur kthimin e dokumentacionit pranë kësaj dege për verifikime të mëtejshme.

3. Dega e Përfitimeve pranë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Shkodër, pasi ka marrë në rivlerësim dokumentacionin, me vendimin nr.98, datë 04.03.2013, ka refuzuar kërkesën e paditëses për caktim pensioni familjar dhe ka kaluar dokumentacionin pranë Komisionit Rajonal të Ankimit Shkodër për vendim përfundimtar.

4. Komisioni Rajonal i Ankimit Shkodër, me vendimin nr.79, datë 27.03.2013, ka lënë në fuqi vendimin e Degës së Përfitimeve, duke rrëzuar kërkesën e paditëses për caktim pensioni familjar.

5. Në vijim të ezaurimit të ankimit administrativ paditësja i është drejtuar Komisionit Qendror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, që me vendimin nr.552, datë 16.07.2013, ka kthyer për riverifikim kërkesën e paditëses, duke lënë për detyrë DRSSH Shkodër të verifikojë në ZVRPP Shkodër dhe në Komunën Mnelë nëse familja e kërkueses kishte përfituar tokë sipas ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", dhe në varësi të këtij verifikimi të shprehet me vendim për kërkesën e paditëses për pension familjar.

6. Pas rimarrjes në shqyrtim, Dega e Përfitimeve pranë DRSSH Shkodër ka bërë verifikimet e nevojshme dhe me vendimin nr.172, datë 14.10.2013, i ka dhënë përsëri përgjigje negative kërkesës së paditëses, duke argumentuar se paditësja, në momentin e kërkesës ka qenë ekonomikisht aktive, pasi kishte tokë bujqësore në pronësi.

7. Duke mos qenë dakord me vendimin e marrë dhe duke e konsideruar si vendim të kundërligjshëm, paditësja i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, më datë 12.11.2013

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr.04, datë 09.12.2013, ka vendosur: "*Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e anës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër për t'i lidhur pensionin familjar palës paditëse D.N., nga data e paraqitjes së kërkesës, datë 01.06.2012.*".

9. Kundër vendimit nr.4, datë 09.12.2013, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka paraqitur ankim pala e paditur, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

10. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.228, datë 18.02.2014, ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit nr.4, datë 09.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Pushimin e gjykimit të çështjes.*"

10.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar se lidhur me vendimin për ndërprerjen e pensionit, të datës 19.03.2012, paditësja nuk është ankuar në rrugë administrative, pra nuk rezulton t'i jetë drejtuar Komisionit Rajonal të Apelimit e më tej Komisionit Qendror të Apelimit në ISSH. Po kështu, edhe lidhur me vendimin e datës 14.10.2013, paditësja rezulton t'i jetë drejtuar gjykatës pa kaluar më parë rrugën administrative.

11. Kundër vendimit nr. 228, datë 18.02.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs paditësja, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr.4, datë 09.12.2013, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke parashtruar shkaqet e prezantuara ne pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi i paraqitur nga paditësja përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

13. Vendimi nr.228, datë 18.02.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe si i tillë ky vendim do të prishet dhe çështja do të dërgohet për rishqyrtim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues.

14. Nga gjykimi i çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar se paditësja i është drejtuar me kërkesë për caktim pensioni familjar palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër. Kjo e fundit i ka kthyer përgjigje negative paditëses, e cila më pas i është drejtuar me ankim administrativ Komisionit Rajonal të Ankimit, që e ka kthyer çështjen për rishqyrtim pranë DRSSH Shkodër. Pas marrjes së një përgjigjeje tjetër negative paditësja sërish i është drejtuar me ankim Komisionit Rajonal të Ankimit dhe më pas Komisionit Qendror të Ankimit pranë ISSH-s, për shkak të përgjigjes negative të të parit. Komisioni Qendror i Ankimit e ka kthyer çështjen edhe një herë për rishqyrtim pranë DRSSH Shkodër dhe kjo e fundit sërish e ka refuzuar kërkesën e paditëses.

15. Pasi çështja është bërë objekt i konfliktit gjyqësor nga ana e paditëses, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër e ka zgjidhur çështjen në themel duke e pranuar padinë. Mbi ankimin e palës së paditur, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes me argumentin se paditësja nuk e ka ezauruar ankimin administrativ përpara se t'i drejtohej gjykatës me padi, pra çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

16. Ky qëndrim i Gjykatës Administrative të Apelit në lidhje me zbatimin e ligjit tek rrethanat konkrete të faktit është i gabuar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se në rastin konkret paditësja nuk kishte detyrimin për të ezauruar më tej ankimin administrativ dhe se mund t'i drejtohej gjykatës me padi.

17. Në nenin 86 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", parashikohet se ankimet kundër vendimeve të përfitimeve bëhen në komisionet e ankimeve të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore dhe ankimet kundër vendimeve të këtyre të fundit, të zgjidhura në mënyrë të pafavorshme, bëhen në komisionin e ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

18. Nga ky parashikim ligjor rezulton se ligjvënësi, në rastin konkret, ka parashikuar ezaurimin e rekursit administrativ përpara se individi t'i drejtohet me padi gjykatës. Ankimi administrativ, në dallim nga padia, nuk konsiderohet një mjet i zakonshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Ndjekja e rrugës administrative të ankimit, për të realizuar një të drejtë subjektive ose interes të ligjshëm, duhet të parashikohet nga ligji në mënyrë eksplicite, në mënyrë që individi të jetë i detyruar për ta ndjekur përpara se t'i drejtohet gjykatës me padi.

19. Aksesi në gjykatë është një element i cili i jep kuptim të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Mungesa e aksesit në gjykatë e bën të paefektshme dhe një të drejtë thjesht teorike e iluzore të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Aksesi në gjykatë konsiston jo vetëm në të drejtën për t'iu drejtuar formalisht gjykatës, por për t'u dëgjuar thelbësisht në lidhje me çështjet e faktit dhe ato të ligjit. Ai nënkupton marrjen e një vendimi përfundimtar nga pushteti gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e zakonshme të ankimit.

19.1. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementët më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal.

19.2. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (shih vendimet nr.14, datë 03.06.2009; nr.41, datë 28.09.2011; nr.21, datë 29.04.2013, të Gjykatës Kushtetuese).

19.3. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (shih, vendimet nr.7, datë 11.03.2008; nr.14, datë 03.06.2009, të Gjykatës Kushtetuese).

20. Megjithatë, si çdo e drejtë e tjetër, aksesi në gjykatë mund të jetë subjekt i kufizimeve me natyrë ligjore. Gjithsesi, këto kufizime duhet të përmbushin

standardin e vendosur në nenin 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Këto kufizime duhet të bëhen me ligj, për mbrojtjen e një interesi publik ose të drejtave të të tjerëve, të jenë proporcionale, të mos cenojnë thelbin e të drejtës dhe lirisë që kufizohet si dhe të mos bien nën nivelin e kufizimeve të vendosura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

21. Një nga format në të cilat mund të kufizohet aksesi në gjykatë është nëpërmjet parashikimit me ligj të detyrimit që subjekti t'i drejtohet më parë me ankim administrativ organeve eprore të organit që ka kryer veprimin administrativ, në rastet kur ky veprim cenon të drejtat subjektive dhe interesat e tij të ligjshëm.

22. Kufizimi i aksesit në gjykatë, nëpërmjet vendosjes së filtrit paraprak të ezaurimit të juridiksionit administrativ bëhet për mbrojtjen e një interesi publik, zgjidhjen e çështjeve brenda mekanizmave administrativë, me qëllim pakësimin e numrit të çështjeve gjyqësore, duke e kthyer gjykatën në një mjet efektiv, i cili i zgjidh konfliktet në mënyrë të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm.

23. Gjithashtu, një tjetër arsye e vendosjes së këtij filtri është edhe mundësia e individëve për ta realizuar të drejtën e tyre brenda një afati sa më të shkurtër dhe me sa më pak kosto. Organet administrative, në dallim nga gjykatat, kanë një aktivizëm më të madh dhe zbatojnë një mënyrë inkuizitore të zhvillimit të procesit, duke proceduar *ex officio* në mbledhjen e provave. Si të tilla, ato prezumohen të jenë më efektive sesa gjykatat në shqyrtimin e çështjeve.

24. Megjithatë, vendosja me ligj e detyrimit për të ezauruar një ankim administrativ përpara se t'i drejtohesh gjykatës me padi, duke qenë një kufizim 'per se' duhet të interpretohet në mënyrë të kufizuar. Në këtë kuadër, ligji duhet të parashikojë të drejtën e bërjes së ankimit administrativ, si dhe organin ku paraqitet ankimi. Në këtë drejtim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr.1, datë 26.11.2010, kanë theksuar:

24.1. Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ.

24.2. Përveç detyrueshmërisë së parashikimit të ndjekjes së rrugës administrative të ankimit, të organit ku ai drejtohet dhe që ka kompetencën

për shqyrtimin e saj, eventualisht, sipas natyrës së marrëdhënieve juridike dhe asaj të mosmarrëveshjes, ligji i posaçëm mund të parashikojë ose jo edhe modalitete konkrete mbi afatet, kushtet e procedurat që duhen respektuar për të bërë të pranueshëm për shqyrtim në themel ankimin administrativ, për procedurat e shqyrtimit dhe natyrën e vendimmarrjes nga organi administrative, etj.,. Nëse rregulla të tilla eventuale nuk janë parashikuar, gjejnë zbatim afatet, kushtet e procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative (KPA).

24.3. Kjo mënyrë e shprehjes së vullnetit të ligjvënësit, nga njëra anë autorizon dhe legjitimon organin administrativ të pranojë, marrë në shqyrtim dhe vendosë lidhur me ankimin administrativ. Nga ana tjetër, jo vetëm i detyron të ndjekin rrugën administrative për efekt të respektimit të uniformitetit të veprimtarisë administrative dhe sigurisë juridike, por, mbi të gjitha, u garanton individëve dhe subjekteve të tjerë një proces të rregullt ligjor dhe një mjet efektiv juridik, pasi pretendimi i tyre për cenimin e një të drejte a interesi kushtetues dhe ligjor detyrimisht do të merret në shqyrtim dhe do të zgjidhet nga organi administrativ.

25. Nga kjo analizë arrihet në përfundimin se aksesi në gjykatë është rregull, ndërsa ndjekja e rrugës administrative përjashtim, i cili duhet të ushtrohet në mënyrë të kufizuar vetëm në ato raste dhe sipas atyre procedurave që parashikohen në mënyrë eksplicite nga ligji.

26. Në këtë logjikë, shqyrtimi i çështjes brenda hierarkisë administrative nuk ndjek të njëjtat rregulla sikurse shqyrtimi i saj përpara gjykatës. Organet administrative, duke qenë një mjet më eficient, si rregull, kanë juridiksion të plotë mbi çështjen që shqyrtojnë. Organet eprore nuk kufizohen në mënyrën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organet vartëse, por në çdo rast e vlerësojnë çështjen në themel, edhe nëse organi vartës ka shfaqur mangësi të theksuara procedurale dhe nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palës kërkuese. Për rrjedhojë, organet eprore nuk mund ta kthejnë çështjen për rishqyrtim por në çdo rast duhet të vendosin në mënyrë meritore mbi kërkimin.

27. Në çështjen në shqyrtim konstatohet se, në kundërshtim me ligjin, çështja është kthyer dy herë për rishqyrtim pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, fillimisht nga Komisioni i Ankimit pranë DRSSH Shkodër dhe herën e dytë nga Komisioni Qendror i Ankimit pranë ISSH. Pra, paditësja e ka ezauruar ankimin administrativ, pasi çështja është shqyrtuar nga të tre shkallët e këtij juridiksionit administrativ.

28. Organet eprore administrative, sikurse Komisioni Rajonal i Ankimit dhe Komisioni Qendror i Ankimit duhet ta kishin zgjidhur çështjen në themel dhe jo ta kthenin për rishqyrtim. Si organe administrative ata mund

ta kryenin vetë hetimin administrativ për të cilin kishin konstatuar mangësi. As ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe as KPA nuk e njeh të drejtën e kthimit të çështjes për rishqyrtim në organin administrativ vartës.

29. Së fundi, një tjetër arsye për të cilën konsiderohet se paditësja e ka shteruar ankimin administrativ lidhet edhe me faktin se nëse dy organet eprore do të kishin konsideruar se pasja e tokës në pronësi nuk përbën shkak për mos përfitimin e pensionit familjar, atëherë do ta kishin pranuar ankimin e paditëses për lidhjen e këtij pensioni, pa e rikthyer çështjen për rishqyrtim. Fakti që çështja është rikthyer për rishqyrtim pranë Degës së Përfitimeve për verifikime në lidhje me pasjen ose jo të tokës në pronësi të paditëses, nënkupton që këto organe e konsiderojnë këtë fakt (pasjen e tokës në pronësi) si fakt përjashtues nga e drejta e pensionit familjar. Pra, në mënyre indirekte, këto organe janë shprehur edhe për themelin e kërkesës së paditëses, duke i bërë tashmë mjete joefektive për t'u ezauruar nga paditësja në rastin konkret.

30. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, në zbatim të këtij vendimi, pasi ta konsiderojë çështjen brenda juridiksionit gjyqësor dhe pretendimet e lidhura me të si gjë të gjykuar, duhet të analizojë pretendimet dhe prapësimet e palëve si dhe bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit të shkallës së parë, duke e zgjidhur mosmarrëveshjen në themel.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2018-606, datë 24.04.2018

Gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë kanë të drejtën dhe detyrimin për të disponuar mbi kërkesën për heqje dorë nga e drejta e padisë, nëse kjo kërkesë nga ana procedurale është nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesi ligjor i pajisur me kompetencën e përfaqësimit përpara gjykatës ose përmes një avokati për mbrojtjen e interesave të subjektit, si dhe nga ana përmbajtësore ka treguar qartë dhe saktë ligjërisht vullnetin e pavesuar të palës paditëse.

E drejta e padisë bën pjesë në disponimet maksimale të paditësit, i cili mund të "tërhiqet" nga ky disponim në çdo fazë e shkallë të gjykimit, duke sjellë për pasojë rrëzimin e padisë, ndalimin për ngritur përsëri atë si dhe rënien e çdo shkaku ligjor për të vijuar gjykimin.

Kërkesa për heqjen dorë nga e drejta e padisë, e depozituar në Gjykatën e Lartë në datën 06.02.2018 dhe është nënshkruar nga N.C., në cilësinë e administratorit dhe përfaqësuesit ligjor të palës paditëse "C." SHPK, aktualisht në këtë funksion nisur nga përmbajtja e ekstraktit të kartelës së këtij subjekti pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit që gjendet bashkëlidhur, dhe mban vulën zyrtare të këtij subjekti tregtar. Sipas akteve të shoqërisë dhe legjislacionit tregtar, ky përfaqësues ligjor i shoqërisë ka kompetencën të përfaqësojë subjektin tek të tretët, përfshirë edhe gjykatën ose të caktojë përfaqësues dhe avokat për mbrojtjen e interesave të tij.

Në këtë kërkesë rezulton i treguar nga ana e palës paditëse, "C." SHPK vullneti i saj për të hequr dorë tërësisht nga e drejta e padisë në çështjen objekt i këtij gjykimi, duke treguar edhe referimin e kësaj të drejtë të saj.

Prandaj, Kolegji Administrativ e gjen të mbështetur në ligjin procedural kërkesën për heqje dorë nga e drejta e padisë sepse ajo është paraqitur nga pala paditëse në gjykim e nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesi ligjor i saj, i pajisur me kompetencën që ta përfaqësojë atë përpara gjykatës ose të caktojë avokat për mbrojtjen e interesave të subjektit, ndërsa në përmbajtje tregon qartë dhe saktë ligjërisht vullnetin e pavesuar të palës paditëse për të hequr dorë tërësisht nga e drejta e padisë në çështjen objekt gjykimi. Për rrjedhojë, bazuar në këtë kërkesë, Kolegji do të disponojë prishjen e të dy

vendimeve dhe rrëzimin e padisë.

Kolegji Administrativ e gjen të mbështetur kërkesën e palës paditëse për heqje dorë nga e drejta e padisë në nenin 201, shkronja a të Kodit të Procedurës Civile (KPC) (ish-neni 201 paragrafi i dytë i këtij Kodi), për të cilin, në vendime të mëparshme të këtij Kolegji (si p.sh. vendimi nr.7, datë 16.01.2018 B.E.kundër Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë etj.,.), ka parashtruar interpretimin dhe zbatimin e drejtë të kësaj norme dhe ligjit procedural në tërësi, në rastet e kërkesave për heqjen dorë nga e drejta e padisë apo nga e drejta e gjykimit të padisë. Kështu, ndër të tjera, në këtë vendim të Kolegjit Administrativ arsyetohet se: "*..... për rastin e kërkesës për heqjen dorë nga e drejta e padisë, në nenin 201, shkronja a, të KPC parashikohet se: "Neni 201, shkronja a, Heqja dorë nga e drejta e padisë. Paditësi, në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë krejtësisht ose pjesërisht nga e drejta e padisë. Në këtë rast padia rrëzohet dhe paditësi nuk ka të drejtë të ngrejë përsëri po këtë padi. Heqja dorë nga e drejta e padisë përpara gjykatës së apelit sjell si rrjedhojë prishjen e vendimit të gjykatës të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë.".*

Me të njëjtën përmbajtje, rasti dhe procedura për heqjen dorë nga e drejta e padisë, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KPC-s me ligjin nr. 38/2017, parashikohej nga paragrafi i dytë i nenit 201 të këtij Kodi.

Sipas dispozitës së nenit 201, shkroonja a, të KPC-s, në rast të heqjes dorë nga e drejta e padisë, gjykata e shkallës së parë vendos rrëzimin e padisë, ndërsa gjykata e apelit, në çdo rast, prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e rrëzon padinë. Me këtë disponim gjykata heq mundësinë që paditësi të ngrejë përsëri të njëjtën padi në të ardhmen.

Gjithashtu, nga leximi literal i dispozitës së nenit 201/a të KPC-s përcaktohet shprehimisht mundësia e heqjes dorë nga e drejta e padisë përpara gjykatës së shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, por dispozita nuk parashikon shprehimisht mundësinë e heqjes dorë nga e drejta e padisë përpara Gjykatës së Lartë.

Kolegji Administrativ vlerëson se, e drejta e ngritjes së padisë dhe ajo e heqjes dorë nga e drejta e padisë së ngritur në gjykatë, bën pjesë në disponimet maksimale të paditësit. Është ai që e vë në lëvizje gjykatën me anë të padisë dhe nëse ai "tërhiqet" nga ky disponim maksimal, në çdo fazë e shkallë të gjykimit, pra përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, vetvetiu bie arsyeja e investimit të gjykatës për të shqyrtuar dhe zgjidhur çështjen.

Nga ana tjetër, me heqjen dorë prej paditësit nga e drejta e padisë e që passjell, sipas ligjit, edhe rrëzimin e padisë dhe ndalimin për ta ngritur përsëri atë, pala e paditur dhe pjesëmarrësit e tjerë në gjykim nuk kanë arsye

dhe motiv të ndjehen të "rrezikuar" nga ndonjë pretendim i asaj natyre nga ana e paditësit, pra nuk kanë ndonjë motiv dhe shkak tjetër ligjor për t'ia parashtruar gjykatës për të vijuar gjykimin.

Prandaj, edhe në këtë aspekt të kuptimit dhe interpretimit të parimeve themeltare të gjykimit civil, nuk ka rëndësi dhe as dallim se në cilën fazë dhe shkallë të gjykimit gjendet shqyrtimi i çështjes kur paraqitet kërkesa për heqjen dorë nga e drejta e padisë. Gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë kanë të drejtën dhe detyrimin për të disponuar mbi këtë kërkesë dhe të disponojnë sikurse përcakton neni 201/a i KPC-s.

Po kështu, në rastin e kërkesës për heqjen dorë nga e drejta e padisë, gjykata së cilës i paraqitet kjo kërkesë, nuk ka për objekt vlerësimi as rrethanat e faktit dhe as prova për të çmuar e vlerësuar, por vetëm verifikon qartësinë e vullnetit mbi atë çfarë përbën objektin e kërkesës për heqje dorë, si edhe rregullshmërinë e mjetit procedural dhe të elementëve të tij me të cilin shprehet ky vullnet nga ana e palës paditëse për heqjen dorë nga e drejta e padisë. Edhe në këtë kuptim, nuk ka rëndësi dhe as dallim se në cilën fazë dhe shkallë të gjykimit gjendet shqyrtimi i çështjes kur paraqitet kërkesa për heqjen dorë nga e drejta e padisë. Prandaj gjykatat, përfshirë Gjykatën e Lartë, duhet ta shqyrtojnë kërkesën dhe të disponojnë sipas nenit 201/a të KPC-s.

Kolegji Administrativ, bazuar në parimet themeltare, kushtetuese dhe ligjore, për të drejtën për gjykim dhe për dëgjimin nga gjykata të kërkimeve dhe pretendimeve të tij, më posaçërisht edhe në gjykimin civil, vëren se nuk ka ndonjë motiv të posaçëm dhe as ndonjë qëllim e vullnet të ligjvënësit mbështetur në këto parime, që të përjashtojë mundësinë e paditësit për ta paraqitur kërkesën për heqje dorë nga e drejta e padisë, si e drejta ekskluzive e tij për të vënë ose jo në lëvizje gjykatën për mbrojtjen dhe realizimin e së drejtës së tij, përfshirë në Gjykatën e Lartë, si edhe këtë gjykatë për të marrë në shqyrtim, e disponuar mbi kërkesën sipas nenit 201/a të KPC.

Ndërsa në dallim nga heqja dorë nga e drejta e padisë, heqja dorë nga gjykimi i padisë (neni 201 i KPC-s) (ish paragrafi i parë i nenit 201 të këtij Kodi) nuk mund të kërkohet dhe realizohet në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë, jo thjesht për faktin se ligji nuk i cakton këto gjykata me kompetencë për të marrë në shqyrtim dhe për të disponuar për këtë kërkesë të paditësit, por nga vetë qëllimi, arsyeja e kërkimit, mënyra e disponimit dhe nevoja për të garantuar edhe interesin e të padituri dhe të pjesëmarrësve të tjerë të thirrur në gjykim me anë të padisë së paditësit.

Prandaj, kërkesa me objekt heqje dorë nga gjykimi i padisë e parashtruar përpara gjykatës së apelit ose Gjykatës së Lartë nuk gjen mbështetje në ligjin procedural. KPC i njeh mundësinë palës paditëse që të heqë dorë nga gjykimi i padisë gjatë shqyrtimit të saj vetëm në gjykatën e shkallës së parë

për shkak se edhe mjeti që e ka vënë në lëvizje gjykatën e shkallës së parë është vetëm padia. Ndërsa, për gjykimin në apel dhe në Gjykatën e Lartë, mjeti që i vë këto gjykata në lëvizje nuk është padia por, përkatësisht, ankimi dhe rekursi. Padia tashmë është gjykuar në shkallë të parë dhe gjykatat më të larta e kanë një çështje për ta shqyrtuar, ndaj edhe nuk ka më vend për të hequr dorë nga gjykimi i padisë.

Gjithashtu, qëndrimi dhe interesi i të padituri, për të vijuar ose jo gjykimi i çështjes, kur ajo është duke u gjykuar në gjykatën e shkallës së parë, nëse ai nuk ka paraqitur kundërpadi dhe nëse janë përmbushur veprimet që përcakton dispozita e nenit 201 të KPC-s, nuk është më i nevojshëm apo vendimtar. Por, nëse çështja është paraqitur për gjykim në gjykatën e apelit apo Gjykatën e Lartë, në varësi të natyrës së padisë dhe kërkimeve të saj, si edhe të mënyrës si ka disponuar gjykata e shkallës së parë me vendimin e saj për zgjidhjen e çështjes, i padituri dhe palët e tjera të thirrura në gjykim mund të kenë interesa që u cenohen apo nuk u garantohen në të ardhmen si pasojë kërkesës së paditësit për heqjen dorë nga gjykimi i padisë. Si shembull mund të evidentohet rasti kur në gjykimin në shkallë të parë është rrëzuar padia dhe çështja është në shqyrtim në gjykatën e apelit mbi ankimin e paditësit apo në rastin kur në gjykimin në shkallë të parë është rrëzuar padia, por në gjykimin në apel është ndryshuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë duke u pranuar padia. Kjo për arsyen e thjeshtë që kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi i padisë, nëse lejohet dhe pranohet, sjell prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Por, disponimi me vendim gjyqësor për pushimin e gjykimit të çështjes nuk ka efektin e gjësë së gjykuar sikurse në rastet e pranimit apo rrëzimit të padisë, për shkak se paditësi nuk ka "pengesë" të ngrejë përsëri të njëjtën padi. Ndërkohë që, për të njëjtat arsye, paditësi mund të heqë dorë nga e drejta e padisë në çdo fazë e shkallë gjykimi sepse padia mbi këtë kërkesë rrëzohet, ndërsa në gjykatat më të larta prishen vendimet dhe rrëzohet padia, për rrjedhojë për efekt të gjësë së gjykuar, paditësi nuk mund ta ngrejë përsëri atë padi.

Nga ana tjetër, Kolegji Administrativ vëren se, rasti i kërkesës për heqjen dorë nga e drejta e padisë nuk është i vetmi kur, ndonëse ligji procedural nuk e parashikon shprehimisht, sipas rastit, gjithsesi, palët e investojnë Gjykatën e Lartë apo kryesisht vetë kjo Gjykatë investohet dhe disponon sipas ligjit. Si shembull mund të evidentohet rasti i rregullimeve që përmbante ish neni 468 i KPC-s (aktualisht ky rregullim përmbahen në shkronjën "c" të nenit 299).

Dispozita e nenit 468 ishte e vendosur në pjesën e tretë, titulli I, kreu II "Paraqitja e ankimit dhe gjykimi në apel" të KPC-s. Nëse nga gjykatat vetëm do të lexohej, por pa e interpretuar dhe zbatuar këtë normë sipas

qëllimit të saj në gjykimin civil, si p.sh. për rastin e padisë që nuk mund të ngrihet, atëherë ajo duhet të gjente zbatim dhe të dispononte sipas saj vetëm gjykata e apelit. Por, praktika gjyqësore e konsoliduar ka treguar se neni 468 zbatohej edhe nëse, me kërkesë të palës apo kryesisht, Gjykata e Lartë konstatonte se gjendej përpara rastit të padisë që nuk mund të ngrihet, etj.,.

Për këto arsye, duke vërejtur se vullneti dhe qëllimi i tij për rregullat procedurale të vendosura në ish nenin 468, që në kohën e miratimit të Kodit, nuk lidheshin aspak me përcaktimin e ndonjë kompetence ekskluzive të gjykatës së apelit, por me domosdoshmërinë që lidhur me ato raste të shpreheshin të gjitha gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, vetë ligjvënësi, me ligjin nr.38/2017, e "zhvendosi" normën e nenit 468 në shkronjën "c" të nenit 299, tashmë si një kompetencë që edhe shprehimisht përcaktohet se mund të disponohet nga gjykatat në të tri shkallët e gjykimit. Me këtë ndryshim, ligjvënësi nuk ndryshoi kompetencën e gjykatave për rastet e nenit 468, por reflektoi interpretimin e drejtë dhe të saktë që i kanë bërë vullnetit dhe qëllimit të tij gjykatat me zhvillimin e praktikës gjyqësore. Gjykatat nuk bëjnë ligj dhe u ndalohet ta bëjnë këtë, por, nga ana tjetër, ato kanë detyrimin që për zbatimin e drejtë të ligjit ta interpretojnë atë, e jo vetëm literialisht, duke aplikuar mënyrat e tjera të interpretimit të njohura nga shkenca e së drejtës, në përputhje me parimet kushtetuese dhe parimet themeltare të së drejtës sipas fushave të saj, përfshire atë të procedurës civile.

Një tjetër moment që Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë është se, objekti i shqyrtimit dhe mënyra e disponimit të Gjykatës së Lartë në rastin kur ajo shqyrton dhe vendos për kërkesën e paditësit për heqjen dorë nga e drejta e padisë apo edhe për disa kërkesa, ankime të veçanta, etj., të palëve në gjykim, nuk kanë lidhje me qëllimin dhe objektin e rregullimit që përmban dispozita e nenit 485 të KPC-s, ku parashikohet se: "*Vendimet e Gjykatës së Lartë pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendosin: a) lënien në fuqi të vendimit; b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë; c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit me tjetër trup gjykues; ç) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.*".

Kjo dispozitë, duke pajtuar misionin dhe funksionet e Gjykatës së Lartë sipas nenit 141 të Kushtetutës, përcakton se cilat janë mënyrat e disponimit të kësaj Gjykate vetëm kur shqyrton shkaqet e rekursit në seancë gjyqësore, mënyra që janë shprehimisht të përcaktuara dhe që nuk lejojnë të disponohet edhe në ndonjë mënyrë tjetër. Pra, neni 485 nuk lidhet dhe

as nuk gjen zbatim për rastet e tjera kur Gjykata e Lartë ka detyrimin të disponojë sipas përcaktimeve përkatëse të ligjit, si p.sh., rastet kur Gjykata e Lartë ka detyrimin të konstatojë mungesën e juridiksionit gjyqësor në shqyrtimin e ankimeve të veçanta të kërkesave për pezullim, për rishikim, parashtrimin e mosmarrëveshjeve mes gjykatave mbi kompetencën, për rastet e përcaktuara në nenin 299, shkronja "c", të KPC, etj.. Nga ana tjetër, thelbësore dhe parimore është që Gjykata e Lartë vepron, gjykon dhe disponon si gjykatë ligji dhe jo si gjykatë fakti. Në rastet kur merr në shqyrtim kërkesën dhe duhet të disponojë, kjo Gjykatë nuk bën dhe nuk ka të nevojshme të bëjë vlerësim të faktit, të marrë e të çmojë prova, por e zgjidh çështjen mbi provat dhe faktin që rezulton sipas gjykatave më të ulëta, duke zbatuar dhe interpretuar ligjin lidhur me to, sipas natyrës së çështjes që e ka në shqyrtim..

Së fundi, Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë edhe një moment tjetër specifik procedural që lidhet me mënyrën e disponimit nga gjykata e apelit apo Gjykata e Lartë në rastet kur i paraqitet kërkesë për heqje dorë nga e drejta e padisë.

Në nenin 201/a të KPC-s përcaktohet shprehimisht se, heqja dorë nga e drejta e padisë "*sjell si rrjedhojë prishjen e vendimit të gjykatës të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë.".* Pra, kjo dispozitë që përmban rregullimet e posaçme në rastin e heqjes dorë nga e drejta e padisë, përcakton një mënyrë të posaçme disponimi për gjykatën në këtë rast, që është "prishja" e vendimit dhe rrëzimi i padisë, pavarësisht nëse gjykata më e ulët kishte vendosur pranimin ose rrëzimin e padisë apo kishte disponuar në mënyrë tjetër. Gjithashtu, kjo mënyrë disponimi është krejt e ndryshme nga rregulli i përgjithshëm i disponimit gjyqësor, sipas të cilit, gjykata më e lartë, kur disponon ndryshe nga gjykata më e ulët lidhur me pranimin apo rrëzimin e padisë, paraprakisht shprehet për "ndryshimin" e vendimit të gjykatës më të ulët.

Interpretimi i kësaj mënyre të posaçme disponimi në rastin e pranimit të kërkesës për heqjen dorë nga e drejta e padisë mund të gjendet në vetë natyrën dhe efektet që sjell heqja dorë nga e drejta e padisë. Sipas nenit 201/a të KPC "*Në këtë rast padia rrëzohet dhe paditësi nuk ka të drejtë të ngrejë përsëri po këtë padi.",* pra jemi përpara një vendimi përfundimtar me efektet e gjësë së gjykuar në kuptimin që paditësi nuk mund të ngrejë më padi me këto lloj kërkimesh në të ardhmen.

Nga ana tjetër, duhet mbajtur parasysh që, gjë e gjykuar nuk përbën vetëm ajo çfarë ka disponuar gjykata në lidhje me një padi, por rast pas rasti, edhe disa aspekte të tjera të caktuara, si p.sh. rrethana substanciale të faktit që në arsyetimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë janë pranuar si të vërtetuara. Në këtë kuptim, kur gjykata më e lartë konfirmon vendimin e gjykatës më të ulët ajo disponon lënien në fuqi të tij, ndërsa kur e zgjidh ndryshe çështjen, ajo disponon ndryshimin e vendimit dhe (sipas rastit) pranimin a rrëzimin e padisë. Gjykata e jep vendimin e saj për zgjidhjen e çështjes, duke pranuar si të vërtetuara rrethanat e faktit dhe duke zbatuar ligjin lidhur me to.

Ndërsa në rastin kur i paraqitet kërkesa për heqjen dorë nga e drejta e padisë, në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, gjykata shqyrton vetëm bazueshmërinë në ligjin procedural të kësaj kërkese dhe disponon për të. Por, në këtë rast, pavarësisht nëse ka pasur apo jo hetim gjyqësor, janë lejuar dhe debatuar prova mbi rrethanat dhe faktet e pretenduara nga palët etj., gjykata e cila disponon mbi kërkesën për heqjen dorë nga e drejta e padisë nuk mund dhe nuk duhet të arsyetojë mbi bazueshmërinë në prova dhe të shprehet nëse janë vërtetuar apo jo në gjykim rrethanat e faktit për të cilat palët janë në mosmarrëveshje, as gjykata më e lartë nuk duhet të shprehet se si i kanë pranuar të vërtetuara rrethanat e faktit në mosmarrëveshje gjykatat më të ulëta. Gjykata ku paraqitet kërkesa vetëm evidenton cila është mosmarrëveshja objekt i gjykimit, si edhe historinë e shkurtër procedurale të zhvillimit të çështjes. Më tej arsyeton nëse kërkesa për heqjen dorë nga e drejta e padisë është e bazuar ose jo në ligjin procedural.

Pikërisht, për këto arsye, ligjvënësi përcakton shprehimisht që, në rast pranimi të kërkesës për heqjen dorë nga e drejta e padisë, në çdo rast, në shkallë të parë rrëzohet padia vetëm për këtë motiv, ndërsa kur kërkesa paraqitet në shkallët e tjera të gjykimit, gjykata më e lartë prish vendimin e gjykatës më të ulët dhe e rrëzon padinë. Prishja e vendimeve ka kuptimin që të mos përdoren në të ardhmen, në gjykime të tjera, nisur nga efektet e mundshme të gjësë së gjykuar, fakte dhe rrethana të pranuara si të provuara nga gjykatat e faktit, kur kishin disponuar pranimin a rrëzimin e padisë përpara paraqitjes së kërkesës për heqje dorë nga e drejta e padisë. Ndërsa disponimi "rrëzimi i padisë" kur kërkesa është e bazuar në ligj ka kuptimin që e pengon paditësin ta ngrejë të njëjtën padi në të ardhmen.

Për arsyet e parashtruara më sipër mbi ligjin e zbatueshëm dhe interpretimin e tij, Kolegji Administrativ e gjen të mbështetur në ligjin procedural kërkesën për heqje dorë nga e drejta e padisë të paraqitur nga pala paditëse në gjykim C. shpk, e cila, është nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesi ligjor i saj, i pajisur me kompetencën që ta përfaqësojë këtë subjekt edhe përpara gjykatës në mbrojtje të interesave të tij. Kërkesa tregon qartë dhe saktë ligjërisht vullnetin e pavesuar të palës paditëse për të hequr dorë tërësisht nga e drejta e padisë në çështjen objekt i këtij gjykimi.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31001-2896-2018, datë 27.12.2018

Gjykata pritëse nuk mund të vendosë vetë deklarimin e mungesës së kompetencës, pasi i vetmi mjet ligjor që ajo ka për të kontestuar kompetencën, është vendimi i ndërmjetëm që thërret për vlerësim përfundimtar Gjykatën e Lartë.

Gjykata e Lartë është autoriteti suprem që mund të vlerësojë kryesisht dhe në mënyrë përfundimtare çështjen e kompetencës lëndore dhe tokësore së gjykatës për shqyrtimin e çështjes.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier më datë 29.12.2017. Rezulton se pala paditëse ka punuar pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në Degën Rajonale Fier. Pas inspektimit të emërimeve në këtë institucion, me urdhrin nr.312, datë 12.12.2017 titullari i palës së paditur ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit në detyrë të palës paditëse.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr.140, datë 02.02.2018 ka vendosur: "*Deklarimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*".

3. Gjykata ka vlerësuar se marrëdhënia e punës objekt konflikti gjyqësor është administrative, pasi pala paditëse pretendon të drejta që rrjedhin nga ligji i statusit të nëpunësit civil. Sakaq, gjykata ka identifikuar si gjykatë kompetente Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.2517, datë 28.06.2018 ka vendosur: "*Të shpallë moskompetencën tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*".

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka marrë në shqyrtim kryesisht çështjen e kompetencës tokësore, pa kërkesë të palëve në gjykim. Gjykata ka arsyetuar se, në bazë të nenit 11 të ligjit nr.49/2012, gjykata kompetente është gjykata që shtrin kompetencën tokësore në territorin kur kryen punën pala punëmarrëse, për të gjitha paditë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Gjykata ka individualizuar si gjykatë kompetente

Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr.1239, datë 16.10.2018 ka vendosur: "- *Të konstatojë mosmarrëveshjen në kompetencën lëndore të çështjes civile me nr.1566 akti, datë 02.08.2018 me palë..., duke urdhëruar kancelarinë e kësaj gjykate të dërgojë brenda 5 ditëve nga dhënia e këtij vendimi kopje të kërkesëpadisë me aktet që e shoqërojnë atë pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*".

7. Gjykata arsyeton se kompetente është gjykata e shkallës së parë fier, pasi pala paditëse nuk ka status nëpunësi civil. Për rrjedhojë, kërkon të zgjidhet mosmarrëveshja për kompetencën ndërmjet gjykatave.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ka nxjerrë çështjen jashtë kompetencës tokësore, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural. Kolegji vlerëson se edhe arsyet e dhëna në vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë janë të pabazuara në ligj, duke konkluduar se gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi është përfundimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe se vendimi i saj duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet atje për vazhdimin e gjykimit.

9. Kolegji vlerëson se gabimi i parë në zbatimin e ligjit procedural që konstatohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është marrja në shqyrtim kryesisht dhe disponimi mbi kompetencën tokësore të gjykatës pa prapësim procedural të palëve ndërgjyqëse, në kundërshtim me parimin e disponibilitetit dhe oficialitetit. Kolegji sjell në vëmendje se kompetenca tokësore, që me ndryshimet e vitit 2001 në KPC, është relativizuar si prezumim procedural, pasi u parashikua se edhe shkelja e kompetencës tokësore nga gjykatat mund të ishte e metë e konvalidueshme ligjore dhe si e tillë mund të korrigjohej dhe të vleftësohej nga gjykata më e lartë pas shqyrtimit të ankimit. Më tej, ligji nr.49/2012 që ka hyrë në fuqi më datë 04.11.2013 dhe ndryshimet e ligjore të KPC-s që kanë hyrë në fuqi më datë 05.11.2017, e kanë shndërruar çështjen e kompetencës tokësore në prapësim procedural në kuptimin e ngushtë, që do të thotë se gjykatat nuk mund ta shqyrtojnë kryesisht dhe se vetëm palët, sipas parimit të disponibilitetit, munden ta pretendojnë atë para gjykatës dhe njëkohësisht brenda një afati ligjor dekadent, që është përcaktuar me fazë gjykimi. Kështu neni 13, pika 2, e ligjit nr.49/2012 parashikon se kompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm

përpara se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave. Ndërkohë neni 61, i KPC-s, i ndryshuar, parashikon se, mungesa e kompetencës tokësore mund të merret parasysh vetëm me kërkesë të palëve, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

10. Kolegji vlerëson se momenti i dytë procedural në të cilin ka gabuar Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është vendimmarrja e ndërmjetme e shpalljes moskompetent në kundërshtim me urdhërimet e nenit 64 të KPC-s. Kjo dispozitë shprehimisht parashikon se: "Çështja që dërgohet për shqyrtim nga një gjykatë në një gjykatë tjetër të së njëjtës kategori ose nga një gjykatë më e lartë, duhet të pranohet dhe të shqyrtohet nga gjykata së cilës i dërgohet. Konfliktet për kompetencë midis gjykatave nuk lejohen, por gjykata, ka të drejtë t'i parashtrojë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë e cila vendos për rregullimin e kompetencës sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 63 të këtij Kodi.".

11. Kjo normë ndalon kategorikisht dhe pa ekuivok dhe pa përjashtim nga rregulli konfliktet për kompetencë ndërmjet gjykatave. Kjo dispozitë nuk duhet të lexohet dhe as të kuptohet sikur ndalon konfliktin vetëm për llojin e kompetencës së konstatuar se mungon nga gjykata e parë apo gjykata dërguese. Përkundrazi, neni 64 ndalon kontestimin dhe konfliktin e çdo lloj kompetence gjyqësore që njeh ligji, qoftë ekskluzive, kontraktore, tokësore, për shkak koneksiteti, lëndore, funksionale, alternative, etj.,. Kolegji vlerëson se çdo interpretim ndryshe i nenit 64 do të vinte në kundërshtim me *ratio*-n e vetë këtij rregullimi ligjor. *Ratio* e këtij rregullimi është parandalimi i zvarritjes së gjykimit, gjë që në çështjen objekt gjykimi konstatohet se ka ndodhur, pasi padia ka rreth një vit që nuk gjykohet sepse tre gjykata konfliktohen me njëra-tjetrën për kompetencën lëndore e më tej edhe tokësore dhe përmbyllja e pasigurisë ligjore që ekziston ndërmjet palëve dhe gjykatave mbi atribuimin e kompetencës gjyqësore sipas ligjit nga autoriteti më i lartë gjyqësor në mënyrë përfundimtare. Zbatimi i nenit 64 ndryshe nga *ratio* do të thotë se gjykatave të faktit u lejohet të konfliktohen aq herë sa lloje kompetencash ka. Ndaj Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në momentin kur ka vlerësuar se nuk ishte kompetente nga pikëpamja tokësore, kishte vetëm një mundësi ligjore, të parashtronte qëndrimin e saj në Gjykatën e Lartë. Ky qëndrim është mbajtur edhe në raste të tjera nga Gjykata e Lartë, gjë që duhet të mbahet parasysh si qëndrim jurisprudencial autoritativ nga gjykatat më të ulëta në veprimtarinë e tyre.[13]

[13] Shih, Vendimi Nr. 11243-00133-00-2018 i Regj. Themeltar, Nr. 00-2018-342 i Vendimit, datë 14.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

12. Gjykatat e faktit duhet të mbajnë parasysh se konfliktet për kompetencë nuk lejohen. Kjo do të thotë se gjykata e dytë e individualizuar si kompetente (gjykata pritëse) me vendimin e gjykatës së parë që shpallet jokompetente (gjykata dërguese), nëse ndan pikëpamje të ndryshme në lidhje me kompetencën (pavarësisht llojit të kompetencës që ajo vlerëson, lëndore, tokësore apo funksionale) ka vetëm një mundësi, atë të parashtrimit të mosmarrëveshjes në Gjykatën e Lartë, si autoriteti më i lartë gjyqësor i interpretimit të ligjit, që vendos përfundimisht në lidhje me gjykatën kompetente.

13. E drejta e gjykatës pritëse për të kontestuar kryesisht përkatësinë e kompetencës për çfarëdo lloj arsyeje para Gjykatës së Lartë, nuk përbën mjet ankimi, por një instrument procedural për rregullimin në mënyrë përfundimtare të çështjes së kompetencës së paderogueshme[14], në mënyrë që të garantohet parimi i gjykatës së caktuar me ligj dhe i gjyqtarit natyral të çështjes.

14. Kolegji vlerëson se, gjykata pritëse, ka të drejtën dhe detyrimin, qoftë edhe kryesisht, që ta shqyrtojë çështjen e kompetencës së paderogueshme. Ndryshe nga gjykata dërguese, që në çdo rast për vlerësimin e kompetencës merr vendim të ndërmjetëm, për dërgimin e çështjes në një gjykatë tjetër, gjykata pritëse të vetmin mjet ligjor që ka për të kontestuar kompetencën, ka vendimin e ndërmjetëm që vë në lëvizje Gjykatën e Lartë për vlerësim përfundimtar të saj. Kjo do të thotë se, gjykata pritëse mundet vetëm të kërkojë të shpallet jokompetente, qoftë duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së parë që e ka shpallur veten jokompetente dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë apo qoftë duke kërkuar dërgimin e çështjes në një gjykatë tjetër, që ajo e vlerëson si kompetente, por kurrsesi nuk mund të vendosë vetë deklarimin e mungesës së kompetencës për të njëjtin shkak ose për një shkak tjetër, tej kufijve të vendimmarrjes së parë[15].

15. Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata e Lartë, pavarësisht arsyes apo llojit të kompetencës të vlerësuar nga gjykata e parë dërguese që e ka shpallur veten jokompetente duke qenë autoriteti suprem dhe fundor që zgjidh çështjen e kompetencës së gjykatës mund të vlerësojë se cila gjykatë, në mënyrë përfundimtare do të jetë kompetente për gjykimin e çështjes, nga pikëpamja lëndore/funksionale dhe tokësore. Për rrjedhojë

[14] Shih, Ordinanca nr. 19792, datë 17.07.2008 e Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

[15] Shih për analogji, qëndrimin dhe interpretimin e bërë nga Gjykata Supreme e Kasacionit të Republikës së Italisë në Ordinancën nr. 14559, datë 11.10.2002; nr. 16936, datë 25.07.2006; nr. 17454, datë 23.07.2010.

gjykata kompetente për zgjidhjen e çështjes gjyqësore, sipas vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, mund të jetë e ndryshme nga gjykata gjykata që ka shpallur moskompetencën.

16. Nga ana tjetër, Kolegji e vlerëson të gabuar arsyetimin e vendimit të ndërmjetëm të parashtrimit të mosmarrëveshjes mbi kompetencën në Gjykatën e Lartë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Çështja e juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës nuk mundet të vlerësohet nga organet e dhënies së drejtësisë, duke pasur parasysh themelësinë në prova dhe në ligj të padisë objekt gjykimi, pasi ky vlerësim do të duhet të bëhet vetëm nga një gjykatë kompetente dhe vetëm pasi të ketë shqyrtuar provat, të ketë realizuar proces të rregullt dhe të disponojë me vendim përfundimtar mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Përkundrazi, çështja e juridiksionit dhe e kompetencës nga gjykatat duhet të vlerësohet ekskluzivisht vetëm duke u kufizuar tek shkaku dhe objekti i padisë, që sipas parimit të disponibilitetit, mundet të vendoset lirisht dhe në mënyrë të pakushtëzuar vetëm nga pala paditëse.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-1683-2016, datë 10.04.2019

E drejta e padisë ka jetëgjatësi të ndryshme në kuptimin material dhe procedural. Padia është mjeti juridik që ligji vë në dispozicion për titullarin e së drejtës së cenuar për të aksesuar gjykatën për herë të parë. Ky mjet shuhet për efekt gjykimi në kuptimin procedural me dhënien e një vendimi përfundimtar apo jo përfundimtar nga gjykata e shkallës së parë.

E drejta e padisë në kuptimin material lind në momentin që cenohet e drejta subjektive dhe shuhet në momentin kur vendimi përfundimtar i gjykatës merr formë të prerë, në këtë kuptim palët mundet të heqin dorë nga padia në kuptimin material në çdo fazë dhe shkallë të procesit gjyqësor.

Apeli ose rekursi, jo padia, janë mjetet juridike procedurale që aktivizojnë gjykatat me juridiksion rishikues. Në shkallët e gjykimit rishikues palët mundet të heqin dorë ekskluzivisht vetëm nga mjeti procedural që i ka vënë ato në lëvizje, që do të thotë se në gjykimin në apel mundet të hiqet dorë nga apeli dhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë mundet të hiqet dorë nga rekursi.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë më datë 16.07.2015.

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se pala paditëse ka nisur marrëdhënien e punës pranë palës së paditur më datë 01.04.2008. Marrëdhënia e punës ka qenë pa afat. Ajo ka punuar në pozicione të ndryshme pune sipas urdhrave të punëdhënësit. Me kërkesë të saj dhe me urdhrin nr.85, datë 13.06.2013 të titullarit të palës së paditur pala paditëse është liruar nga detyra.

3. Me urdhrin nr.1335, datë 21.06.2013 të Ministrit të Mbrojtjes pala paditëse është emëruar specialiste kontabiliteti në Sektorin e Financës pranë palës së paditur. Marrëdhënia e punës ka qenë pa afat dhe është ndërprerë me efekt të menjëhershëm dhe në mënyrë të njëanshme me urdhrin nr.1989, datë 01.12.2014 të Ministrit të Mbrojtjes. Arsyeja e largimit nga detyra ka qenë riorganizimi i institucionit sipas urdhrit nr.237, datë

30.09.2014 të Kryeministrit, duke qenë se pala e paditur ka konkluduar se nëpërmjet organikës së re është suprimuar vendi i punës së palës paditëse.

4. Pala paditëse nuk ka qenë dakord me vendimmarrjen e palës së paditur. Sakaq ajo ka paraqitur padi në gjykatë.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.5220 80-2015-3635, datë 20.10.2015 ka vendosur: "- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditëses Flora Bardhi. – Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditëses Flora Bardhi 10 muaj pagë dëmshpërblim për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkak të justifikuar. - Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditëses Flora Bardhi 3 muaj pagë dëmshpërblim për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. - Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditëses Flora Bardhi 2 muaj pagë dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës. – Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditëses Flora Bardhi 3 muaj pagë si shpërblim për vjetërsi në punë.*".

4. Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se marrëdhënia e punës është zgjidhur me efekt të menjëhershëm dhe pa shkaqe të justifikuara, duke konkluduar se nuk mundet të kualifikohet i ligjshëm, sipas nenit 153 të Kodit të Punës, si shkak riorganizimi i institucionit. Për rrjedhojë, gjykata ka akorduar edhe dëmshpërblimet respektive.

5. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar apel pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Inteligjencës dhe e Sigurisë së Mbrojtjes. Në ankime është pretenduar se nuk është zhvilluar një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes. Në ankime pretendohet se është respektuar edhe afati i njoftimit dhe procedura, dhe se shkaku i largimit nga detyra ka qenë i ligjshëm. Në ankimet e depozituara është kërkuar ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj dhe në prova.

6. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.2306, datë 19.07.2016 ka vendosur: "*Pushimin e gjykimit në Gjykatën e Apelit Administrativ të çështjes nr.5220 (80-2015-3635), datë 20.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*".

7. Pala paditëse me kërkesën nr.1517 prot., datë 01.06.2016 ka depozituar në Gjykatën Administrative të Apelit një kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i padisë. Ka qenë pikërisht kjo kërkesë që ka çuar në këtë vendimmarrje Gjykatën Administrative të Apelit. Gjykata e apelit ka arsyetuar se nenet 201 dhe 299, të KPC-s zbatohet në mënyrë komplementare në gjykimin administrativ dhe se gjykata në çdo fazë gjykimi, kur pala paditëse, heq dorë nga gjykimi i padisë, vendos pushimin e gjykimit të çështjes.

8. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, më datë 24.08.2016. Rekursi është njoftuar tek ndërgjyqësit dhe nuk ka kundër-rekurs të paraqitur nga pala paditëse. […].

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se, shkaqet e parashtruara në rekurs nga pala e paditur bazohen në nenin 58 të ligjit nr.49/2012. Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në shkelje të rënda të rregullave procedurale dhe është i pavlefshëm i gjithë gjykimi në shkallë të dytë dhe se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të prishet dhe se çështja duhet të kthehet për rigjykim në po atë gjykatë.

10. Kolegji vlerëson se, për nga mënyra se si është zbatuar ligji procedural dhe se si është arsyetuar vendimi nga Gjykata Administrative e Apelit, kuptohet se nuk është i qartë aspak kuptimi i padisë në kuptimin procedural dhe material, kuptimi i mjeteve ligjore që vënë në lëvizje gjykatën, kuptimi i apelit, më tej i rekursit dhe për rrjedhojë, edhe vendimit përfundimtar dhe jopërfundimtar të gjykatës sipas shkallës së gjykimit. Gjithashtu, konstatohet se Gjykata Administrative e Apelit nuk mban parasysh jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mbi të drejtën e palëve ndërgjyqëse për disponimin e padisë në kuptimin procedural dhe material.

11. E gjithë çështja juridike që shtrohet për zgjidhje në këtë çështje është: a mundet të hiqet dorë nga gjykimi i padisë në gjykatën e apelit? Më tej natyrshëm shtrohet pyetja, nëse mund të hiqet dorë nga gjykimi i padisë në gjykimin në apel, a mundet të hiqet dorë nga gjykimi i padisë në Gjykatën e Lartë? E për t'i njësuar pyetjet në një të vetme, çështja juridike që shtrohet për zgjidhje në këtë çështje është: *a mund të hiqet dorë nga gjykimi i padisë në gjykatat që sipas Kushtetutës dhe ligjit ushtrojnë juridiksion rishikues fakti apo ligji*?

12. Kolegji sjell në vëmendje se mjeti procedural që aktivizon gjyqvarësinë në gjykimin në shkallë të parë është kërkesëpadia dhe se mjeti material që aktivizon juridiksionin fillestar gjyqësor në gjykimet kontencioze është ekskluzivisht padia. Pikërisht ky është kuptimi i padisë në kuptimin procedural, kuptohet në një interpretim të thjeshtuar, të konkretizuar dhe të drejtpërdrejtë të saj, që do të thotë mjeti juridik që ligji vë në dispozicion për titullarin e së drejtës së cenuar për të aksesuar gjykatën për herë të parë.

13. Si e tillë kohëzgjatja e padisë në kuptimin procedural nis në momentin e ushtrimit të saj, apo thënë ndryshe, me depozitimin në gjykatën e shkallës së parë[16], dhe shuhet në momentin kur gjykimi në gjykatën e shkallës së parë përfundon, qoftë me vendim jopërfundimtar dhe me vendim përfundimtar. Në momentin kur vendimi përfundimtar apo jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë jepet, atëherë shuhet për efekt gjykimi padia në kuptimin procedural. Kjo do të thotë se pas vendimit përfundimtar apo jopërfundimtar të gjykatës së shkallës së parë nuk mund të disponohet më padia në kuptimin procedural, që do të thotë se pala paditëse nuk mund të heqë dorë më nga gjykimi i padisë. Thënë ndryshe, kjo periudhë kohe është jetëgjatësia e padisë në kuptimin procedural. Ndaj neni 2 në paragrafin e dytë, të KPC-s parashikon se: "Palët janë të lira që në çdo kohë të tërheqin padinë, por gjithnjë përpara shuarjes së saj për efekt gjykimi ose në bazë të ligjit."[17].

14. Nga ana tjetër, padia në kuptimin material ka një kohë jetëgjatësie të ndryshme nga padia në kuptimin procedural. Kështu padia në kuptimin material nuk përfaqëson mjetin procedural që është ushtruar në gjykatë për herë të parë. Përkundrazi, padia në kuptimin material përfaqëson të drejtën subjektive civile të palës së cenuar nga një veprim apo mosveprim i paligjshëm i një apo disa subjekteve të tjerë. Si e tillë, e drejta e padisë në kuptimin material lind në momentin që cenohet e drejta subjektive[18] dhe shuhet në momentin kur vendimi përfundimtar i gjykatës merr formë të prerë dhe njëkohësisht shndërrohet në gjë të gjykuar (res judicata)[19].

15. Ky dallim i sjellë në vëmendje më lart në mënyrë teorike, mundëson arritjen e konkluzioneve se nga e drejta e padisë në kuptimin procedural mund të hiqet dorë nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në momentin kur gjykimi në shkallë të parë nuk është përfunduar[20]. Nga ana tjetër, nga e drejta e padisë në kuptimin material mund të hiqet dorë nga momenti kur e drejta e padisë lind dhe deri në momentin kur vendimi përfundimtar i gjykatës merr formë të prerë dhe njëkohësisht shndërrohet në gjë të gjykuar.

[16] Shih, neni 153 i Kodit të Procedurës Civile.

[17] Kjo dispozitë nga është marrë nga ligjvënësi nga neni 1 i Kodit të Procedurës Civile i Republikës së Francës.

[18] Shih për analogji, neni 117 i Kodit Civil.

[19] Shih, nenet 451 dhe 451/a, të Kodit të Procedurës Civile, e interpretuar shkronja "ç" e saj në analogji me Vendimin Unifikues Penal nr.2/2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

[20] Që do të thotë se deri kur gjykata e shkallës së parë nuk është tërhequr për vendimmarrje në dhomë këshillimi.

16. Në rastin objekt gjykimi Gjykata Administrative e Apelit ka disponuar me vendim jopërfundimtar mbi padinë në kuptimin procedural kur ka gjykuar si shkallë e dytë dhe me juridiksion rishikues. Kolegji vlerëson se kjo vendimmarrje dhe mënyrë procedimi nuk mund të ndodhë ligjërisht. Kolegji vlerëson se, duke qenë se padia si mjet dhe proceduralisht aktivizon vetëm dhe ekskluzivisht gjykimin fillestar dhe shkallën e parë të gjykimit, përjashtohet apriori mundësia që në juridiksionin rishikues të hiqet dorë nga padia në kuptimin procedural dhe njëkohësisht edhe gjykata me juridiksion rishikues nuk mundet kurrsesi të disponojë mbi padinë në kuptimin procedural si pasojë e kërkesave të tilla.

17. Kolegji vlerëson se gjykatat me juridiksion rishikues fakti apo ligji duhet të mbajnë parasysh se mjeti procedural që aktivizon juridiksionin e tyre nuk mundet të jetë kurrsesi padia. Mjeti procedural që vë në lëvizje gjykatën e apelit në funksionin e saj kushtetues të juridiksionit rishikues është apeli dhe mjeti i aktivizimit të juridiksionit fillestar të Gjykatës së Lartë është rekursi. Për rrjedhojë, konkludohet se në shkallët e gjykimit rishikues palët mundet të heqin dorë ekskluzivisht vetëm nga mjeti procedural që i ka vënë ato në lëvizje, që do të thotë se në gjykimin në apel mund të hiqet dorë nga apeli dhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë mund të hiqet dorë nga rekursi. Ndërkohë, duke qenë se padia materialisht ka një jetëgjatësi tjetër dhe duke qenë se fundi i saj shënjohet në momentin e marrjes formë të prerë dhe shndërrimin në gjë të gjykuar të vendimit gjyqësor përfundimtar, palët mundet të heqin dorë nga padia në kuptimin material para dhe në çdo fazë dhe shkallë të procesit gjyqësor.

18. Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit kanë detyrimin kushtetues[21] dhe ligjor të përditësohen me jurisprudencën e autoritetit më të lartë gjyqësor. Nëse kjo do të ndodhte në rastin objekt gjykimi Gjykata Administrative e Apelit nuk do të kishte marrë vendim të paligjshëm dhe nul proceduralisht dhe se gjykimi në shkallë të dytë do të ishte përmbyllur me vendim përfundimtar. Në këtë mënyrë palëve do t'u ishte garantuar e drejta e eksesit në drejtësi dhe pushteti gjyqësor në këtë çështje do të kishte kryer funksionin natyror dhe kushtetues, dhënien e drejtësisë.

19. Kolegji sjell në vëmendje se qëndrimi i parë interpretativ gjyqësor mbi këtë çështje daton në vitin 1959, nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.[22] Më tej, ky qëndrim është mbajtur, interpretuar dhe zhvilluar më gjerë nga

[21] Shih nenin 141 në lidhje me nenin 18 të Kushtetutës.

[22] Shih vendimin nr.4, datë 21.03.1959 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku pranohej kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së ushtruar nga Prokurori i Përgjithshëm.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.[23] Më vonë ky qëndrim është mbajtur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vitin 2009[24]. Kjo do të thotë se gjykata e apelit nuk ka mbajtur parasysh në zgjidhjen e çështjes praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 58 të ligjit nr. 49/2012.

[23] Shih Vendimin Unifikues nr.6, datë 21.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndër të tjera në këtë vendim është arsyetuar se: "*Në të drejtën procedurale civile njihen dy institute në lidhje me mospranimin e padisë, ai i heqjes dorë nga gjykimi i padisë, si dhe ai i heqjes dorë nga e drejta e padisë. Paditësi sikurse rezulton nga përmbajtja e proçesverbalit gjyqësor, në gjykatën e apelit ka kërkuar zbatimin e institutit të heqjes dorë nga gjykimi i padisë. Nga përmbajtja e paragrafit të parë të nenit 201 të Kodit të Proçedurës Civile, rezulton se paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë, çka do të thotë se duke pasur parasysh fazat e gjykimit të mosmarrëveshjes civile sipas kërkesave procedurale, këtë të drejtë paditësi* mund ta ushtrojë vetë*m në gjykimin e shkallës së parë para përfundimit të hetimit gjyqësor*.".

[24] Shih vendimin nr.00-2009-850, datë 10.09.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ndër të tjera në këtë vendim arsyetohet se: "*Duke qenë se kërkesa e palës paditëse për heqje dorë nga gjykimi i padisë është paraqitur gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, kjo e fundit do të duhej ta kishte rrëzuar atë kërkese, pa sjellë kjo e fundit asnjë pasojë ligjore në ecurinë e shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Ndërkohë, paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga ankimi nga pala e paditur..., për sa kohë ky i fundit është i vetmi ankues ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, do të duhej të kish detyruar Gjykatën e Apelit Vlorë që, në zbatim të nenit 463 të KPC-s, të vendoste pranimin e saj dhe pushimin e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, duke lënë në këtë mënyrë të pacenuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.*".

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2017-315, datë 30.04.2019

Prishja e vendimit të shkallës së parë dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim mund të bëhet vetëm në rastet kur kjo gjykatë nuk ka respektuar dispozitat lidhur me ndërgjyqësinë e detyrueshme. Thirrja e personit të tretë në gjykim kupton ardhjen e pasojave të tërthorta për këtë palë dhe jo pasoja thelbësore, sikurse është cenimi i të drejtës së pronësisë.

I. Rrethanat e çështjes

Në bazë të vërtetimit të pronësisë nr.897, datë 21.04.1994, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura ka pasur në pronësi të tij tri godina, objekti "Shtëpia e Pushimit Razëm". Këtë pasuri, pala paditëse pretendon se e ka fituar në bazë të kontratës së dhurimit nr.2586 rep., nr. 1037 kol., datë 15.05.1997, të lidhur ndërmjet Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, me cilësinë e dhuruesit, dhe Sindikatës së Pavarur të Ushqimit, me cilësinë e pranuesit të dhurimit.

Këtë pronë, pala paditëse ka kërkuar ta regjistrojë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe. Mbas kërkesave të vazhdueshme të bëra pranë ZVRPP Malësi e Madhe për të regjistruar këtë kontratë dhurimi dhe mosmarrjes së asnjë përgjigjeje, paditësi, me kërkesë formale, i është drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të zgjidhur situatën e krijuar nga ana e ZVRPP Malësi e Madhe për regjistrimin e kësaj kontrate dhurimi.

Në datën 27.12.2011 paditësi është njohur me shkresën nr.1163 prot., datë 26.12.2011, të Zyrës Qendrore të Regjistrimt të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), me anë të së cilës i komunikohej "Urdhër refuzimi" nr.4625/10 (1021), datë 21.12.2011. Në këtë urdhër refuzimi arsyetohet se mungonte dokumentacioni i plotë i origjinës së pronësisë në favor të BSPSH-s. Duke mos qenë dakord me mosveprimin administrativ të Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Malësi e Madhe dhe urdhrin nr.4625/10 (1021), datë 21.12.2011, të ZQRPP-s, pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.6979, datë 20.06.2013, ka vendosur: "*1. Pranimin e kërkesëpadisë; 2. Anulimin*

e aktit administrativ, Urdhrit nr.4625/10 (1021), datë 21.12.2011, të Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; 3. Detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe të regjistrojë kontratën e dhurimit nr.2586/1037, datë 15.05.1997, të lidhur ndërmjet BSPSH-s, me cilësinë e dhuruesit dhe SPU-s, të përfaqësuar nga M.M., në cilësinë e pranuesit të dhurimit, të objektit "Shtëpia e Pushimit Razëm" (komplet); 4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të paditurit.".

Kundër vendimit nr.6979, datë 20.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur ankim Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Tiranë, si dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të cilat kanë kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë, si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2761, datë 20.06.2014, ka vendosur: "*Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë, për gjykimin e çështjes me nr.4996/2286 Regj. Themeltar, datë 21.10.2013, dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.*".

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.395, datë 03.03.2016, ka vendosur: "*Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.6979, datë 20.06.2013, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*".

Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar se në gjykimin e çështjes në apel u vendos përsëritja pjesërisht e hetimit gjyqësor, duke caktuar një ekspert topograf. Nga akti i tij i ekspertimit rezultoi se prona që kërkon të regjistrojë pala paditëse krijon në mjaft pjesë mbivendosje me prona të regjistruara më parë. Në këto rrethana, gjykata e shkallës së parë duhet të kishte thirrur, sipas nenit 193 të KPC-s, me cilësinë e subjektit të interesuar këta persona pasi vendimi i gjykatës sjell pasoja për ta. Kundër vendimit nr.395, datë 03.03.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr.6979, datë 20.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar shkaqet e prezantuara ne pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

Rekursi i paraqitur nga pala paditëse kundër vendimit nr.395, datë 03.03.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat

administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të cilat do ta bënin të cenueshëm këtë vendim.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se vendimi nr.395, datë 03.03.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit. Për këtë shkak, ky vendim do të prishet dhe çështja do të kthehet për rishqyrtim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues.

Nga përmbajtja e vendimit nr.395, datë 03.03.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me faktet e çështjes, rezulton se pala paditëse ka kërkuar regjistrimin e pronës që pretendon se e ka fituar nëpërmjet kontratës së dhurimit, pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe. Pas refuzimit të kësaj të fundit për shkak të problemeve me dokumentacionin dhe marrjes së një përgjigjeje negative edhe në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pala paditëse i është drejtuar me padi gjykatës.

Gjykata e shkallës së parë, pasi e ka gjykuar çështjen në themel, ka vendosur pranimin e padisë. Mbi ankimin e palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit, Gjykata Administrative e Apelit ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, me argumentin se nuk ishte ndërtuar drejt ndërgjyqësia, pasi në gjykim duhet të thirreshin pronarët e pronave me te cilët prona e paditësit krijonte mbivendosje.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një interpretim të gabuar të dispozitave të KPC-s lidhur me formimin e ndërgjyqësisë dhe pasojat që ajo sjell në raport me vendimin gjyqësor të një shkalle më të ulët. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka kuptuar drejt natyrën e ndërgjyqësisë si një institut i të drejtës procedurale civile.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë thekson se formimi i drejtë i ndërgjyqësisë përbën një nga elementët bazë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Gjykata duhet të marrë të gjitha masat që në proces të thirren personat që heqin të drejta nga vendimmarrja e saj. Megjithatë, jo në çdo rast, mosthirrja e një subjekti që ka interes në çështje shkakton proces të parregullt ligjor, me pasojë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim.

Në rastin e subjekteve të interesuar, sikurse kemi të bëjmë me çështjen në gjykim, thirrja e të cilëve është në disponibilitetin dhe çmimin e gjykatës, ometimi i kësaj të fundit për ta kryer këtë veprim procedural nuk shkakton zhvillimin e një procesi të parregullt gjyqësor. Ky subjekt, në çdo rast mund t'i mbrojë të drejtat e tij në një gjykim tjetër, duke u paraqitur qoftë në rolin e paditësit qoftë në atë të të paditurit. Për më tepër, vendimi i rrjedhur nga një proces gjyqësor ku ai nuk ka qenë pjesëmarrës nuk do të

ketë efekt ndaj këtij subjekti, pasi nuk plotësohen të tre elementët e gjësë së gjykuar (*res judicata*), duke qenë se mungon identiteti i palëve.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se pozita procedurale e palëve nuk është plotësisht e barabartë me atë të pjesëmarrësve të tjerë në proces, duke qenë se këtyre të fundit u mungon e drejta e disponimit mbi objektin e padisë. Është për këtë shkak që pretendimet, të cilat pjesëmarrësit (personat e tretë) nuk mund t'i ngrenë në një proces të zhvilluar ndërmjet dy palëve ndërgjyqëse, nuk përbëjnë gjë të gjykuar. Në këto kushte, ndryshe nga palët ndërgjyqëse, ata e kanë të gjithë mundësinë që pretendimet dhe kërkimet e tyre t'i ngrenë në një gjykim tjetër, duke mos pasur asnjë efekt vendimi i procesit në të cilin ata nuk kanë marrë pjesë.

E ndryshme është situata e palëve ndërgjyqëse, sidomos kur bëhet fjalë për ndërgjyqësinë e detyrueshme pasive. Në këtë rast, nuk mund të ekzistojnë procese paralele apo të ndryshme për secilin nga të paditurit, për sa kohë që baza faktike dhe juridike e padisë është e njëjtë por edhe të drejtat e tyre burojnë nga i njëjti objekt dhe e njëjta e drejtë (p.sh. bashkëpronësia). Në një situatë të tillë mund të krijoheshin vendime kontradiktore për të njëjtin objekt, shkak ligjor dhe ndërmjet të njëjtave palë në kuptimin juridik.

Në këtë logjikë kanë shkuar edhe ndryshimet e fundit të KPC-s me ligjin nr.38/2017, datë 30.03.2017, duke ndryshuar shkronjën "ç", të nenit 467, të këtij Kodi, në lidhje me rastet e prishjes së vendimit të shkallës së parë dhe kthimit të çështjes për rishqyrtim, për shkak të mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë. Tashmë vendimi i shkallës së parë prishet dhe çështja kthehet për rishqyrtim vetëm në rastin kur kemi të bëjmë me ndërgjyqësinë kryesore të detyrueshme (paditës dhe i paditur). Në këtë pikë, ligji ka reflektuar standardin doktrinal dhe jurisprudencial *(shih, vendimin nr.124, datë 03.07.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë)*.

Duke u nisur pikërisht nga kuptimi i gabuar i institutit procedural të ndërgjyqësisë ligjvënësi tashmë ka përcaktuar si urdhërim ligjor atë që rridhte nga interpretimi korrekt i kësaj dispozite të pandryshuar.

Në këtë kontekst, nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në arsyetimin e mësipërm, arrihet në përfundimin se prishja e vendimit të shkallës së parë dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim mund të bëhet vetëm në rastet kur kjo gjykatë nuk ka respektuar dispozitat lidhur me ndërgjyqësinë e detyrueshme.

Nga ana tjetër, siç me të drejtë ka parashtruar në rekurs pala paditëse çështja është e natyrës administrative dhe shkaku i refuzimit të regjistrimit

të pronës lidhet me problemet e dokumentacionit dhe jo me mbivendosjet. Thirrja si persona të tretë e pronarëve të pronave me të cilat krijon mbivendosje pasuria e palës paditëse nuk do të sillte ndonjë ndryshim në fatin e çështjes për sa kohë çështja nuk ka të bëjë me kundërshtimin e titujve të pronësisë. Thirrja e personit të tretë sipas nenit 193 të KPC-s bëhet kur nga vendimi vijnë pasoja të tërthorta për këtë palë dhe jo pasoja thelbësore, sikurse është cenimi i të drejtës së pronësisë.

Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit do të duhet ta shqyrtojë çështjen në themel, duke u mbështetur në shkakun ligjor të padisë, që ka të bëjë me të drejtën subjektive të paditësit për të regjistruar pronën e tij, të cilës i kundërvihet fakti i paligjshëm i palës së paditur dhe personit të tretë, të cilët i kanë refuzuar regjistrimin. Pra, meritat e çështjes duhet të vlerësohen në raport me veprimtarinë administrative të palës së paditur dhe personit të tretë.

Në të njëjtën kohë, Gjykata Administrative e Apelit çështjen e ndërgjyqësisë duhet ta shohë në raport me pozitën procedurale të personit të tretë, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe, nisur nga fakti se pala paditëse, në objektin e padisë, ka kërkuar detyrimin e saj që të kryejë një veprim administrativ.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-232-2020, datë 04.05.2020

Rekurset e drejtpërdrejta me objekt vendimet jopërfundimtare të gjykatave që kanë disponuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjykohen me trupa të përbëra nga tre gjyqtarë.

Kërkesat e subjekteve në juridiksionin administrativ jokompetent nuk duhet të konsiderohen si kërkesa të paparaqitura. Organi administrativ jokompetent ka detyrimin ligjor për ta dërguar kërkesën apo ankimin administrativ pranë organit kompetent.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është ngritur më datë 16.10.2018 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

2. Nga aktet e administruara në dosje rezulton se pala paditëse ka cilësinë e operatorit ekonomik në një kontratë administrative, e cila është lidhur me Bashkimin Evropian (përfaqësuar nga Komisioni Evropian), në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë, që mban cilësinë e autoritetit kontraktor. Kontrata administrative nr.2015/368-917, datë 23.11.2015 ka si objekt mbikëqyrjen e punimeve për ndërtimin e rrugës Shishtavec – Pika e Kalimit kufitar dhe rrugët e brendshme të Shishtavecit. Ajo është shoqëruar edhe nga aneks-kontrata datë 10.05.2017. Vlera e financimit është përballuar nga Bashkimi Evropian dhe përfituesi i drejtpërdrejtë është Këshilli i Qarkut Kukës.

3. Në kuadër të kësaj kontrate shoqëria "A" SHPK ka lëshuar faturat tatimore të shitjes për shërbimet objekt kontrate, duke ia dorëzuar autoritetit kontraktor, duke paguar në çdo rast edhe detyrimin respektiv të TVSH. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.139/2015 ndërmarrjet e rrugëve, të cilat kanë qenë në administrimin dhe përgjegjësinë e këshillave të qarqeve, kanë kaluar në varësi të bashkive. Për këtë arsye Këshilli i Qarkut Kukës ka kërkuar në gjykatë rrëzimin e padisë për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv.

4. Në pikën 4, të nenit 40, të marrëveshjes ndërmjet paditësit dhe Bashkimit Evropian është parashikuar se: "Çdo mosmarrëveshje që lind apo lidhet me këtë kontratë dhe nuk mund të zgjidhet miqësisht, do t'i referohet juridiksionit ekskluziv të gjykatave të Brukselit, Belgjikë.".

5. Gjykata e shkallës së parë ka marrë në shqyrtim kryesisht çështjen e juridiksionit gjyqësor. Për këtë ka lejuar palët që të debatojnë.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr.493 (706), datë 01.11.2019 ka vendosur: "*1. Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor Shqiptar*.".

7. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në themel të mosmarrëveshjes është kontrata e lidhur ndërmjet palës paditëse dhe Bashkimit Evropian dhe se sipas saj për çdo mosmarrëveshje palët duhet t'i drejtohen juridiksionit të gjykatës kompetente të Belgjikës. Pasi ka sjellë në vëmendje nenin 26 të ligjit nr.9840, datë 10.12.2007 dhe pikën e të nenit 63 të Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015, gjykata ka konkluduar se kontraktori apo sipërmarrësi Shqiptar duhet të paraqesë kërkesë për rimbursimin e TVSH-së pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Gjykata ka konkluduar se në këtë rast pala paditëse nuk e ka ezauruar rrugën administrative për paraqitjen e kërkesës për rimbursimin e TVSH-së pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe se për këtë arsye gjykata nuk ka juridiksion gjyqësor për shqyrtimin e kësaj padie.

8. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka ushtruar rekurs të drejtpërdrejtë, më datë 06.01.2020, pala paditëse. Vendimi objekt rekursi i është komunikuar rekursuesit më datë 30.12.2019. Rezulton se ndërgjyqësit kanë marrë dijeni për ankimin dhe nuk ka kundërankim.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) konstaton se, që nga data 04.11.2013, moment kur ka hyrë në fuqi ligji nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" (në vijim, ligji nr.49/2012), Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është kompozuar me trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh për të shqyrtuar rekurset e drejtpërdrejta me objekt kundërshtimin e vendimeve jo përfundimtare apo të ndërmjetme të gjykatës që deklarojnë mungesën apo jo të juridiksionit. Pasi kjo çështje u bë objekt shqyrtimi në trupë gjyqësore, u konkludua se në vijim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit të drejtpërdrejtë me objekt ankimi vendimin jo përfundimtar të gjykatës që vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit në vijim do të shqyrtohen me trupë gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë.

10. Kolegji sjell në vëmendje se vetë neni 12, pika 3, e ligjit nr.49/2012 parashikon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga 1 gjyqtar, si dhe çështjet që kanë për objekt mosmarrëveshjet

e kompetencave. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Nga ana tjetër Kolegji Administrativ mban parasysh edhe nenin 31, pika 4, të ligjit nr. 98/2016, konkretisht ligjin organik të pushtetit gjyqësor, i cili ka parashikuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave administrative. Trupat gjykues të Kolegjit Administrativ përbëhen nga tre gjyqtarë dhe për çështje që gjykojnë ligjshmërinë e akteve normative nënligjore trupat gjykues përbëhen nga pesë gjyqtarë. Interpretimi sistematik i këtyre dy dispozitave të ligjeve që hyjnë në kategorinë e atyre të rregulluara posaçërisht nga neni 81 i Kushtetutës, çon në konkluzionin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë shqyrton universalisht me tre gjyqtarë të gjitha rekurset qoftë në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore, me përjashtim të rekurseve me objekt vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit për aktet normative nënligjore.

11. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ vlerëson se në vijim, si rregull i përgjithshëm, rekurset e drejtpërdrejta me objekt vendimet jo përfundimtare të gjykatave që kanë disponuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, trupa gjyqësore do të përbëhet nga tre gjyqtarë.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pasi shqyrtoi aktet e çështjes dhe debatoi çështjen në tërësi, vlerëson se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar në ligj dhe kontrakdiktor. Për rrjedhojë, edhe zgjidhja e dhënë me vendimin jo përfundimtar të nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është e pabazuar në ligj, duke bërë që shkaqet e rekursit të drejtpërdrejtë të vlerësohen si të bazuara. Kolegji konkludoi se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim para të njëjtit trup gjykues për arsyet që vijojnë.

13. Gjykata e shkallës së parë në vendim sjell në vëmendje në pjesën arsyetuese nenin 40 të kontratës administrative të lidhur ndërmjet paditësit dhe Bashkimit Evropian, megjithëse kjo bazë juridike nuk ka lidhje me padinë dhe me gjykimin e çështjes. Kjo dispozitë lidhet me mosmarrëveshjet që lindin nga zbatimi i kontratës dhe jo me padinë objekt gjykimi, që ka lidhje me pretendimet e palës paditëse për rimbursimin e TVSH sipas legjislacionit respektiv fiskal. Nga ana tjetër disponimi në dispozitivin e vendimit për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar është i pabazuar në ligj. Apriori mund të konkludohet se çdo padi për rimbursimin e TVSH nuk mund të jetë veçse padi e detyrueshme për t'u gjykuar në juridiksionin gjyqësor të shtetit ku lind detyrimi fiskal, pasi është një gjykim administrativ dhe i lidhur me pushtetin sovran që ushtron shteti në fushën e së drejtës publike. Nga ana tjetër, padia objekt gjykimi

nuk ka element të huaj në mosmarrëveshje dhe se për rrjedhojë, nuk ka relevancë ndonjë rregullim ligjor të së drejtës ndërkombëtare private.

14. Kolegji vlerëson se në rastin konkret gjykata ka gabuar në vlerësimin e fakteve të çështjes që determinojnë edhe zgjidhjen e problematikës së juridiksionit. Pala paditëse ka kërkuar administrativisht pagesën respektive të rimbursimit të TVSH, duke mos depozituar këtë kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në interpretim edhe të Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave, por e ka depozituar pranë Këshillit të Qarkut Kukës. Ky fakt nuk përmendet në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke u kufizuar vetëm me konkluzionin se pala paditëse nuk ka depozituar kërkesë rimbursimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Gjykata e faktit ka detyrimin ligjor të paraqesë në ligj situatën e faktit sikurse provohet gjatë gjykimit, pasi nga kjo situatë varet vendimmarrja mbi zbatimin e së drejtës.

15. Kolegji sjell në vëmendje se, është tjetër gjë të konkludohet se nuk ka fare kërkesë për ribmursim të paraqitur në juridiksionin administrativ, duke konkluduar se për herë të parë ky kërkim parashtrohet me padi në gjykatë, dhe tjetër gjë të konkludohet se një kërkesë e tillë është paraqitur, por se pala kërkuese ka gabuar lidhur me organin kompetent, ku kjo kërkesë duhet të ishte dorëzuar. Në rastin e dytë organi administrativ jo kompetent ka detyrimin ligjor për ta dërguar kërkesën apo ankimin administrativ pranë organit kompetent.

16. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë duhet të mbante parasysh rregullimet e Kodit të Procedurave Administrative (KPA)-s mbi juridiksionin dhe kompetencën e organit publik gjatë një procedimi administrativ. Neni 24 i kodit ka parashikuar se, kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë. Rregullimi i mëtejshëm i kësaj dispozite ka mbrojtur palën e interesuar në një procedim administrative edhe nga humbja e afateve ligjore në ushtrimin e kërkesës tek një organ publik jo kompetent, pasi ka parashikuar se afatet për kërkuesin vlerësohen të respektuara nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent, ndërsa afatet përkatëse për organin publik kompetent fillojnë të llogariten nga data e marrjes së kërkesës.

17. Ky rregullim ligjor i KPA-s në çështjen objekt gjykimi nuk ka gjetur zbatim as nga organi administrativ palë e paditur dhe as nga gjykata në shqyrtimin e saj gjatë vlerësimit të ekzistencës së parakushteve procedurale për vlefshmërinë e procesit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se nuk mund të konkludohet se pala paditëse nuk ka ezauruar juridiksionin administrativ

para se t'i drejtohet juridiksionit gjyqësor.

18. Kolegji vlerëson se në këtë moment të analizës dhe zbatimit të nenit 24 të KPA-s gjykatës në çdo rast i lind detyrimi, në bazë dhe për zbatim të shkronjave "c" dhe "d", të sentencave nomofilatike të Vendimit Unifikues nr.3/2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë[25], që të vlerësojë dhe të konkludojë nëse plotësimi i formaliteteve për ndjekjen e rrugës administrative ka ardhur si pasojë e veprimit apo mosveprimit me faj të organit të administratës publike apo të palës paditëse. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se çka u konkludua më lart, Kolegji konkludon se mosezaurimi i rrugës administrative ka ardhur si pasojë e moszbatimit të nenit 24 të KPA-s nga organi i administratës dhe se pala paditëse nuk mund të vuajë pasojat e mohimit flagrant të drejtësisë, sikurse shkaktohen eventualisht nga vendimi jopërfundimtar i nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

[25] Këto dy sentenca nomofilatike kanë sanksionuar se:
"c) Në të kundërt, nëse gjykata konstaton se ankimi administrativ, ndryshe nga ç'pretendon organi administrativ, është ushtruar në afat dhe ka qenë i shoqëruar nga dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të ligjit, nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ.
d) Gjykata, siç theksuam më sipër, e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur paditësi, për faj të tij, nuk e ka paraqitur ankimin administrativ në afat ose nuk ka kompletuar dokumentet shoqëruese sipas ligjit (megjithëse organi administrativ e ka vënë në dijeni për të metat e ankimimit). Nëse gjykatës i rezulton se, jo për faj të paditësit (ankuesit), çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ, atëherë në zbatim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që garantojnë një proces të rregullt ligjor, është e detyruar të shqyrtojë çështjen në themel, duke qenë ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e çështjes.".

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-12, datë 11.05.2020

Ligji nuk lejon ankim të veçantë apo rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që rrëzon prapësimin apo kërkesën e një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Në këto raste, apeli apo rekursi ushtrohet bashkë me vendimin përfundimtar apo jopërfundimtar, sipas parashikimeve të KPC-s. Gjykatat administrative nuk duhet të disponojnë me vendim për pranimin e ankimit të veçantë, pasi ushtrimi i një mjeti të tillë është në kundërshtim me ligjin procedural dhe nuk mund të shkaktojë pezullimin e gjykimit të çështjes.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala paditëse "T." SHPK pretendon se i është drejtuar palës së paditur për zhdoganim, për llogari të subjektit "A.T.", mallrat me përshkrimin "veshje këmbe" dhe "çanta femra", me origjinë nga Italia, për të cilat është pranuar trajtimi tarifor preferencial, duke u përjashtuar nga taksa doganore.

2. Pala e paditur, Dega e Doganës Rinas, bazuar në nenin 261/3 të Kodit Doganor, me vendimin nr. 86, datë 07.12.2016 ka vendosur: "*1. Të refuzohet trajtimi tarifor preferencial për praktikën doganore R.6062, datë 28.03.2013. 2. Subjekti "A.T." të paguajë shumën prej 43.831 lekë detyrim doganor të papaguar. […]*".

3. Gjithashtu në vijim, pala e paditur, Dega e Doganës Rinas me vendimin nr.279 prot., datë 24.01.2017 për "Rikuperimin me forcë të borxhit doganor", ka vijuar procedurën për mbledhjen me forcë të këtij borxhi.

4. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar, se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë sipas objektit të saj.

5. Në vijim, në seancën përgatitore datë 31.05.2018, nga ana e palës së paditur është paraqitur kërkesa për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, me arsyetimin se nuk është ezauruar ankimi administrativ.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. s'ka, datë 31.05.2018 ka vendosur, rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

7. Kundër vendimit nr. s'ka, datë 31.05.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim të veçantë pala e paditur, Dega e Doganës Rinas, me anë të të cilit kërkon prishjen e vendimit.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson të theksojë paraprakisht se, nuk do të marrë në analizë themelin e çështjes [...] por do të marrë në shqyrtim shkeljet procedurale të lejuara nga gjykata e shkallës së parë dhe për këtë arsye, duhet të vendoset mospranimi i ankimit, pasi ligji procedural nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimit të rrëzimin e kërkesë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

a) *Mbi përbërjen e trupit gjykues*

11. [...] Kolegji Administrativ vlerëson se rekurset e drejtpërdrejta/ankimet e veçanta me objekt vendimet jopërfundimtare të gjykatave që kanë disponuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, do të shqyrtohen nga trupa gjyqësore me 3 (tre) gjyqtarë.

b) *Mbi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor*

12. Ky Kolegj, duke iu referuar nenit 9 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", të ndryshuar, rezulton se është parashikuar: *"1. Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent. 2. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji vendos në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve, nëse çështja përfshihet ose jo në juridiksionin gjyqësor. Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin. 3. Kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se çështja është brenda juridiksionit gjyqësor, prish vendimin dhe e dërgon çështjen për vazhdimin e gjykimit me të njëjtin trup gjykues në gjykatën që kishte vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit".*

13. Pra, në interpretim të dispozitës së sipërcituar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vëren se, nuk ka vend për të marrë në shqyrtim pretendime e ngritura nga pala e paditur, pasi ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nuk parashikohet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë.

14. Ndryshe paraqitet situata, në Kodin e Procedurës Civile (KPC), që në nenin 59 parashikon se: *"Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë".*

15. Ky Kolegj, në interpretim të KPC-s arrin në përfundimin se ndaj vendimit të gjykatës, pavar*ësisht se si është disponuar, pra me rrëzim apo pranim,* mund të bëhet ankim i veçantë n*ë Gjykatën e Lartë.* Dukshë*m, l*igji nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", ka parashikim të ndryshëm nga KPC në lidhje me konfliktin e juridiksionit, por nga ana tjet*ër këto dispozita as nuk konkurrojnë me njëra tjetrën dhe as* nuk mbivendosen.

16. Veprimtaria e gjykatave administrative rregullohet nga ligji i posaçë*m (ligji nr.49/2012) i cili është i detyrueshëm për zbatim* dhe prevalon mbi çdo ligj tjet*ër i cili ka parashikime të përgjithshme dhe/ose të posaçme, të ndryshme apo që mund të vijnë edhe në kundërshtim me parashikimet e ligjit të posaçëm. Kjo situatë është rregulluar qartësisht edhe në nenin 1 pika 2, të ligjit nr.49/2012, ku në mënyrë taksative parashikohet se: "...2. Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e KPC-s, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe".*

17. Ky Kolegj, nga interpretimi sistematik i dispozitave të sipërcituara arrin në përfundimin se i zbatueshëm dhe i aplikueshëm është parashikimi sipas nenit 9 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", të ndryshuar dhe për këtë fakt, përfundimisht, ndaj vendimit të gjykatës administrative për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, nuk mund të bëhet ankim i veçantë.

18. Si përfundim, në nenin 9 të ligjit nr.49/2012, rekurs i drejtpërdrejtë/ankimi i veçantë lejohet vetëm ndaj vendimit jopërfundimtar të gjykatës që nxjerr çështjen jashtë juridiksionit. Duke mos lejuar ligji ankim të veçantë, konkretisht rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë ndaj

vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që rrëzon prapësimin apo kërkesën e një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, do të thotë se, në këto raste, ndaj këtyre vendimeve do të zbatohet rregullimi i përgjithshëm dhe i zakonshëm ligjor për ankimin e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës (shih, nenet 125, 315 dhe 470, të KPC dhe nenin 1, pika 2, të ligjit nr.49/2012). Pra, kundër vendimit të ndërmjetëm të gjykatës administrative që rrëzon prapësimin apo kërkesën e palës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nuk mund të ushtrohet rekurs i drejtpërdrejtë/ankimi i veçantë, por do të ushtrohet ankim, domethënë apel apo rekurs, bashkë me vendimin përfundimtar (shih, neni 126 të KPC-s) apo jopërfundimtar (shih, neni 127 të KPC-s).

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në vijim vlerëson që gjykatat administrative duhet të jenë të kujdesshme në raste të ngjashme objekt shqyrtimit, pasi për sa kohë ligji procedural nuk parashikon ankim ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, atëherë nuk mund dhe nuk duhet të disponojnë me vendim për pranimin e ankimit të veçantë, pasi do të vinin në kundërshtim flagrant me urdhërimet e ligjit procedural. Mbi këtë qëndrim të mbajtur, Kolegji sjell në vëmendjen e gjykatave administrative se, ushtrimi i një mjeti të tillë të papranueshëm ankimi nuk mund të shkaktojë pezullimin e gjykimit të çështjes dhe se gjykimi duhet të vijojë normalisht në këto raste.

20. Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, për sa kohë nuk lejohet ankimi i veçantë, atëherë nuk ka vend për shqyrtimin e këtyre shkaqeve dhe shqyrtimi i çështjes nuk duhet të vazhdojë, duke proceduar me mospranimin e ankimit.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-13, datë 11.05.2020

Rekurset e drejtpërdrejta ose ankimet e veçanta me objekt vendimet jopërfundimtare që kanë disponuar për nxjerrjen e çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqyrtohen nga trupa gjyqësore me 3 (tre) gjyqtarë. Kur çështja nuk ka kaluar në seancë gjyqësore dhe nuk është marrë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave, pra gjatë verifikimit paraprak të padisë, gjykata konstaton mosplotësimin e një prej kushteve formale që lidhen me kompetencën, shterimin e mjeteve të ankimit, legjitimitetin aktiv dhe pasiv, afatet apo kërkesat e tjera të parashikuara në LGJA, duhet të disponojë me vendim për mospranimin e padisë dhe jo për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala paditëse L. SHA**,** është shoqëri tregtare dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj "*tregtim me shumicë dhe pakicë të lubrifikantëve, grasove, alkooleve për karburante, etj., ".*

2. Pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, me anë të njoftim vlerësimit tatimor me nr.12532 prot., datë 31.10.2017 ka vendosur të ngarkojë me detyrime palën paditëse në shumën 225.297 lekë dhe gjoba në shumën 394.270 lekë.

3. Pala paditëse pretendon se pasi ka rënë në dijeni të detyrimit të sipërcituar, ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor, e cila me vendimin nr. 6020/3 prot., datë 26.02.2018 ka vendosur "refuzimin e ankimit", me arsyetimin se "konfirmimi bankar i paraqitur nuk përmbush kushtet formale për t'u cilësuar garanci bankare".

4. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë sipas objektit të saj.

5. Në vijim, në seancën përgatitore të datës 07.05.2018, nga ana e palës së paditur është paraqitur kërkesa për nxjerrjen e çështjes jashtë

juridiksionit gjyqësor, me arsyetimin se nuk është ezauruar ankimi administrativ.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr.267, datë 07.05.2018 ka vendosur: Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes administrative me nr. Regj. Them.318, datë regjistrimi 10.04.2018.

7. Kundër vendimit nr.267, datë 07.05.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ka paraqitur ankim të veçantë pala paditëse L. SHA, me anë të të cilit kërkon prishjen e vendimit.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pa i hyrë analizimit të çështjes në themel për të vlerësuar nëse pretendimet e ngritura në ankimin e veçantë, të parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, kanë mbështetje ligjore ose jo, vlerëson paraprakisht se nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër janë lejuar shkelje të rënda procedurale që ndikojnë në dhënien e vendimit dhe, për këtë shkak, ky vendim duhet të prishet dhe çështja duhet të dërgohet për vazhdimin e gjykimit me të njëjtin trup gjykues në atë gjykatë.

c) *Mbi përbërjen e trupit gjykues:*

9. Paraprakisht, Kolegji vlerëson të nevojshme të theksojë qëndrimin se, nga data 04.11.2013, moment kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është kompozuar me trupë gjyqësore prej 5 (pesë) gjyqtarësh për të shqyrtuar rekurset e drejtpërdrejta/ankimet e veçanta me objekt kundërshtimin e vendimeve jopërfundimtare apo të ndërmjetme të gjykatës që deklarojnë mungesën apo jo të juridiksionit. Pasi kjo çështje u bë objekt shqyrtimi në trupë gjyqësore, u konkludua se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit të drejtpërdrejtë/ankimit të veçantë, me objekt ankimi vendimin jopërfundimtar të gjykatës që vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, në vijim, do të shqyrtohet me trupë gjykuese të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë.

10. Kolegji sjell në vëmendje se vetë neni 12, pika 3, e ligjit nr.49/2012, ndryshuar me ligjin nr.100/2014, parashikon se: *"Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon në dhomë këshillimi me 3 (tre) gjyqtarë të gjitha çështjet që në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga 1 (një) gjyqtar, si dhe çështjet që kanë për objekt mosmarrëveshjet e kompetencave. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 (pesë) gjyqtarë."* Nga ana tjetër, Kolegji Administrativ mban parasysh edhe nenin 31, pika 4, të ligjit nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", që në seksionin II titulluar "Dispozita të veçanta për Gjykatën e Lartë", ka parashikuar se: *"Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave administrative. Trupat gjykues të Kolegjit Administrativ përbëhen nga 3 (tre) gjyqtarë dhe për çështje që gjykojnë ligjshmërinë e akteve normative nënligjore trupat gjykues përbëhen nga 5 (pesë) gjyqtarë."* Interpretimi sistematik i këtyre dy dispozitave të ligjeve, që hyjnë në kategorinë e rregullimeve të posaçme, çon në konkluzionin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë shqyrton me 3 (tre) gjyqtarë të gjitha rekurset, qoftë në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore, me përjashtim të rekurseve me objekt vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit, për aktet normative nënligjore.

11. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ vlerëson se rekurset e drejtpërdrejta/ankimet e veçanta me objekt vendimet jopërfundimtare të gjykatave që kanë disponuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, do të shqyrtohen nga trupa gjyqësore me 3 (tre) gjyqtarë.

d) *Mbi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor*

12. Ky Kolegj vlerëson se e gjithë veprimtaria e gjykatave administrative rregullohet nga ligji i posaçëm *(ligji nr.49/2012), që është i detyrueshëm për zbatim* dhe prevalon mbi çdo ligj tjetër *që ka parashikime të përgjithshme dhe/ose të posaçme, të ndryshme apo që mund të vijnë edhe në kundërshtim me parashikimet e ligjit të posaçëm. Nga ana tjet*ër, kur ligji i posaçëm (ligji nr.49/2012) nuk ka parashikime p*ër një situatë apo marrëdhënie specifike, gjykata mbështetet në dispozitat e KPC-s*. Kjo situatë është rregulluar edhe në nenin 1, pika 2, të ligjit nr.49/2012, ku në mënyrë taksative parashikohet se: *"...2. Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e KPC-s, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe"*.

13. Ligji nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar, ka parashikuar qartësisht mënyrën e organizimit dhe funksionimit të gjykatave administrative dhe sidomos ka përcaktuar detyrat e gjyqtarit nga momenti i regjistrimit të një çështjeje gjyqësore, kufijtë e shqyrtimit të saj, të drejta dhe detyrimet e palëve që marrin pjesë në gjykim, si dhe deri në momentin e disponimit me vendim për zgjidhjen e konfliktit gjyqësor. Këto parime janë të zbatueshme dhe të aplikueshme për të gjithë gjyqtarët e gjykatave administrative në të gjitha nivelet dhe shkallët e gjykimit.

14. Në këto kushte, gjatë gjykimit në shkallë të parë, gjyqtari i një çështjeje konkrete përpara se të fillojë dhe marrë në shqyrtim një çështje gjyqësore, paraprakisht ka për detyrë të verifikojë kushte formale të padisë, mosplotësimi i të cilave nuk lejon gjykatën të vijojë me shqyrtimin në themel të çështjes dhe dhënien e një vendimi përfundimtar. Gjykata verifikon (*i*) nëse ka kompetencë lëndore, tokësore (kur ka kërkesë), funksionale apo nëse çështja i përket ose jo juridiksionit gjyqësor (nenet 7, 9,10, 11, të Ligjit për Gjykatat administrative (LGJA)-s); (*ii*) nëse është shteruar rruga e ankimit administrative (neni 16 i LGJA-s); (*iii*) nëse janë plotësuar kushtet e parashikuar në nenin 21 i LGJA-s, si dhe kërkesat e neneve 154 e 156, të KPC-s; (*iv*) verifikimin e legjitimitetit aktiv dhe pasiv (neni 15 i LGJA-s dhe neni 176 i KPC-s), afatin e paraqitjes së padisë (neni 18 i LGJA) etj.,. Ky Kolegj, thekson se këto verifikime paraprake, të cilat nuk janë shteruese dhe taksative, janë të domosdoshme dhe thelbësore, pasi *së pari* i shërbejnë ekonomisë gjyqësore, *së dyti* evitojnë dhe shmangin investimin e gjykatës në një çështje qartësisht pa të ardhme dhe pa një zgjidhje përfundimtare në dobi të palëve.

15. Për sa më sipër, kur gjykata konstaton mungesën e një prej elementëve të sipërcituar, neni 39, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", shprehimisht kanë parashikuar edhe mënyrën e disponimit me vendim jopërfundimtar. Konkretisht, sipas këtij rregullimi ligjor: *"1. Gjykata administrative jep vendime jopërfundimtare vetëm në rastin e mospranimit të padisë dhe të pushimit të gjykimit. 2. Gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave..."*.

16. Pra, në interpretim të dispozitës së sipërcituar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, kur gjykata gjatë verifikimit paraprak të padisë konstaton mosplotësimin e një prej kushteve formale (të sipërpërmendura në pikën 14) dhe, përderisa nuk është marrë vendim për shqyrtimin e provave (pra, çështja nuk ka kaluar në seancë gjyqësore), atëherë duhet detyrimisht të disponojë me vendim për mospranimin e padisë dhe jo për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit. Ky është një rregullim i posaçëm që parashikohet në nenin 39 të LGJAdhe nuk duhet të shmanget.

17. Kolegji vlerëson se neni 9 i LGJA, që parashikon se:*"1. Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent",*

nuk lidhet me rastin e konstatimit nga gjykata të mosplotësimit të kushteve të formale të padisë, por për rastin kur vlerësohet se çështja duhet t'i dërgohet organit administrativ.

18. Në interpretim të dispozitave të sipërcituara, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, thekson se është konsoliduar praktika në gjykimin administrativ dhe është kusht eksplicit fakti se, përpara se palët t'i drejtohen gjykatës duhet të shterojnë detyrimisht ankimin administrativ pranë organit publik të parashikuar nga ligji shprehimisht, si dhe plotësimin e kërkesave ligjore të parashikuara nga ligji material, të cilat duhet të shoqërojnë detyrimisht ankimin administrativ. Mbi bazën e këtij vlerësimi, por edhe të formulimit të ri që ka parashikuar neni 39 i lidhur me nenin 16 të LGJA, arrihet në konkluzionin se mos-shterimi i ankimit administrativ është pjesë thelbësore e kushteve formale të padisë, mosplotësimi i të cilave e bën të papranueshëm shqyrtimin në themel të saj nga ana e gjykatës.

19. [...] Kolegji konkludon se, në çdo rast që gjykata administrative do të vlerësojë se nuk plotësohet një nga kushtet formale të padisë dhe ende nuk është marrë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave, gjykatat nuk duhet të disponojnë me vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi do të vinte në kundërshtim flagrant me urdhërimet e ligjit procedural, por do t'i referohen nenit 39, pika 2, të LGJA.

20. Nga analizimi i fakteve, provave dhe ligjit të zbatueshëm, gjykatës administrative të shkallës së parë i rezulton se çështja objekt shqyrtimi nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, pasi pala paditëse nuk ka ezauruar ankimin administrativ, duke mos plotësuar kërkesat ligjore që shoqërojnë këtë ankim, siç është parapagimi i detyrimit apo vendosja garanci e kësaj shume. Në interpretim të sa më sipër, gjykata në rastin konkret, referuar nenit 39, pika 2, të LGJA, do të duhej të dispononte me vendim për mospranimin e padisë, duke qenë se nga ana e paditësit nuk janë plotësuar kushtet formale të padisë.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-8, datë 27.05.2020

Ndarja e kompetencës lëndore për kërkesat për rishikim nuk ndryshon pas datës 04.11.2013. Duke qenë se ligji për gjykimin administrativ nuk ka parashikime të posaçme, për këto kërkesa zbatohen në mënyrë përplotësuese, dispozitat respektive të KPC-s. Kërkesa për rishikim është një mjet i jashtëzakonshëm ankimi i cili ushtrohet vetëm pasi vendimi gjyqësor të ketë marrë cilësinë ligjore të formës së prerë dhe gjësë së gjykuar (res judicata). Shqyrtimi si i rekurseve ashtu edhe kërkesave për rishikim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore, bëhet me trupë gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezulton se pala paditëse Gj.Sh., ka paraqitur një padi kundrejt Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, duke kërkuar lidhjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nga data e daljes në rezervë dhe gjithashtu duke kërkuar edhe rillogariten e pensionit dhe duke kërkuar shtesat e përvitshme dhe indeksimin.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr.1155 (51-2012-3738), datë 02.05.2012 ka vendosur: "- *Pranimin e kërkesëpadisë. – Anulimin e aktit administrativ nr.376, datë 28.02.2012 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër në emër të paditësit, Gj.Sh.. – Anulimin e vendimit për shqyrtim të pensionit (të ardhurave) nr.10/1, data 13.12.2011 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër në emër të paditësit Gj.Sh.. – Anulimin e masës debitore për periudhën 01.07.2009 deri më datë 31.12.2011 në emër të paditësit Gj.Sh.. – Kthimin e diferencave të mbajtura dhe vendosjen e masës së pensionit të palës paditëse, Gj.Sh., në nivelin e përfitimit të muajit qershor 2009, duke e indeksuar ndër vite. – Rrëzimin e kërkesës për pezullimin e masës debitore deri në marrjen e formës së prerë të vendimit të gjykatës.*".

3. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 30, datë 23.01.2013 ka vendosur: "*Lënien në fuqi vendimit nr.1155, datë 02.05.2012 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër.*".

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.31003-00862-00-2013, datë 01.03.2017 ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr.30, datë 23.01.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*".

5. Nuk ka të dhëna se çfarë ka ndodhur në Gjykatën Administrative të Apelit me çështjen. Nuk rezulton që në Gjykatën e Lartë të jetë regjistruar çështje me objekt rekursin ndaj një vendimi eventual të Gjykatës Administrative të Apelit.

6. Më datë 23.05.2013 Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, përpara shqyrtimit në thelb të pretendimeve të parashtruara në kërkesën për rishikim të paraqitur dhe për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga koha e shqyrtimit të çështjes dhe marrjes së vendimit nga gjykata e apelit dhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të nevojshme të analizojë ligjin e zbatueshëm, të cilit do t'i referohet për të zgjidhur mosmarrëveshjen administrative, në rastin në shqyrtim.

8. Meqenëse çështja objekt shqyrtimi lidhet me kërkesën për rishikimin e vendimit gjyqësor, të paraqitur përpara fillimit të funksionimit të gjykatave administrative (datë 04.11.2013) dhe për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga koha e shqyrtimit të çështjes dhe marrjes së vendimit nga gjykata e apelit dhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) që paraprakisht të analizohet ligji i zbatueshëm, për sa i përket kompetencës funksionale, si dhe përbërjes së trupës gjyqësore, për këtë rast.

9. Me formulimin e parashikuar në nenin 70 të ligjit nr.49/2012 u pranua se, *"Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë fillojnë funksionimin e tyre në mënyrë të njëkohshme"*. Mbi këtë bazë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.3, datë 06.12.2013 kanë konkluduar, ndër të tjera, se Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë "janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht

në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma". Nga ana tjetër, në këtë vendim unifikues, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konkluduar se kufizimet e të drejtës së ankimit, apelit apo rekursit, të parashikuara për herë të parë në ligjin nr.49/2012, "nuk zbatohen në lidhje me ankimet apo rekurset e paraqitura përpara datës 04.11.2013", pasi e kundërta "do të cenonte parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme të individëve nga rendi juridik në fuqi".

10. Qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara është orientuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese që ka konfirmuar se "*..ligjvënësi duhet të mbajë parasysh se një situatë të rregulluar më parë, parimisht mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasoja pozitive për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve e përkeqëson situatën, pra u heq subjekteve fituese një të drejtë të fituar më parë.....*" (*shih, vendimet nr.2/2013 dhe nr.9/2007 të Gjykatës Kushtetuese).* Mbi këtë bazë, Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se palët që kanë paraqitur ankimet dhe rekurset para hyrjes në fuqi të ligjit nr.49/2012 e gëzonin të drejtën e ankimit të pakufizuar dhe si e tillë, ajo duhet të vazhdojë të respektohet nga ligjvënësi dhe gjykatat e të gjitha niveleve.

11. Nga ky qëndrim unifikues i mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se praktika gjyqësore është orientuar qartësisht në dy drejtime:

Së pari, në drejtim të ushtrimit nga gjykatat administrative në mënyrë të njëkohshme të kompetencës funksionale sipas ligjit të ri. Përderisa pjesa e rregullimeve procedurale e ligjit për gjykimin administrativ është bërë menjëherë e zbatueshme më datë 04.11.2013, shqyrtimi i çështjeve në dhomën e këshillimit dhe në seancë gjyqësore (kompetenca funksionale) do të realizohet sipas parashikimeve të ligjit për gjykimin administrativ, pavarësisht se kur ka lindur dhe kur është ushtruar e drejta e rekursit.

Së dyti, në respektim të parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërisë legjitime, shkaqet për pranueshmërinë e kërkesës për rishikim të ushtruara përpara datës 04.11.2013 do të vlerësohen sipas kritereve të parashikuara në ligjin e kohës së paraqitjes së kërkesës (neni 494 i KPC-s).

12. Megjithëse në këtë vendim unifikues nuk rregullohet në mënyrë të shprehur edhe kompetenca lëndore e kërkesës për rishikim, duke e interpretuar me analogji ratio-n e tij, Kolegji konkludon se edhe për kërkesën për rishikim do të zbatohet i njëjti rregull i ndarjes së kompetencës lëndore për të gjitha kërkesat për rishikim të paraqitura para datës 04.11.2013. Për rrjedhojë, konkludohet se kompetent nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kërkesës për rishikim objekt gjykimi është Kolegji Administrativ i Gjykatës

së Lartë. Nga ana tjetër Kolegji sjell në vëmendje se ligji për gjykimin administrativ nuk ka parashikime të posaçme që të rregullojnë kërkesën për rishikim dhe se, bazuar në pikën 2, të nenit 1, të këtij ligji, do të zbatohen në mënyrë përplotësuese dispozitat respektive të KPC-s.

13. Pjesa e rregullimit ligjor të gjykimit administrativ në Gjykatën e Lartë ka pësuar, disa vite më pas ndryshime me ligjin nr.39/2017, që kanë hyrë në fuqi më datë 05.05.2017. Në dispozitat tranzitore, konkretisht, në nenin 11 të këtij ligji, parashikohet se *"Çështjet aktualisht në gjykim në Gjykatën e Lartë do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji."*. Më një rregullim të ligjor, Kolegji vlerëson se ligjvënësi ka pasur parasysh parimin e njohur dhe të pranuar "se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe." *(shih, vendimi nr.106/2002 dhe vendimi nr.11/2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Kolegji Administrativ thekson se ky rregullim procedural nuk lejon fillimin e efekteve juridike të ligjit të ri për të gjitha rekurset e paraqitura përpara datës 05.05.2017, që është data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ky rregullim është mjaft thelbësor, sepse për mënyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë ka përcaktuar zbatimin e rregullimeve ligjore të para ndryshimeve të vitit 2017. Për shkak të këtij rregullimi ligjor, Kolegji thekson se do të duhet, rast pas rasti, të kryhet një analizë e kujdesshme për të konkluduar për çështje të rëndësishme që lidhen me kohën e paraqitjes së rekursit, a të kërkesës për rishikim (neni 494 i KPC-s), me *"shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs"*(neni 58), si dhe me mënyrën e shqyrtimit nga Kolegji Administrativ të çështjes *"në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore"* (neni 63).

15. Më tej, Kolegji sjell në vëmendje se më datë 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet e KPC-s, ku ndër të tjera ndryshohen edhe disa rregulla procedurale lidhur me gjykimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Deri në datë 05.11.2017 Gjykata e Lartë ishte gjykata me kompetencë funksionale ekskluzive për të shqyrtuar kërkesën për rishikim. Kolegji sjell në vëmendje se me ligjin nr.38/2017 ka ndryshuar ndër të tjera edhe kompetenca funksionale e gjykatave për shqyrtimin e kërkesës për rishikim, sipas parashikimit të nenit 497 të KPC-s, duke u lidhur mënyra e atribuimit të kompetencës gjyqësore funksionale me vendimin e gjykatës që kërkohet të rishikohet.

16. Kolegji sjell në vëmendje se neni 109 i ligjit nr.38/2017, që ndryshoi ndër të tjera edhe nenin 497 të KPC-s, ka parashikuar në pikën 1 se, çështjet civile që janë në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e

apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë. Nga ky parashikim dhe rregullim ligjor tranzitor do të kuptohet se për kërkesat për rishikim të ushtruara përpara datës 05.11.2017 do të zbatohen rregullat respektive të gjykimit të kërkesës për rishikim, të pandryshuara të KPC-s. Për rrjedhojë, pavarësisht se cila gjykatë e ka dhënë vendimin objekt kërkese për rishikim, kompetente nga pikëpamja funksionale për të shqyrtuar kërkesat për rishikim të paraqitura deri më datë 05.11.2017 është vetëm Gjykata e Lartë, qoftë për procesin administrativ dhe për procesin civil.

17. Ndërkohë, Kolegji vlerëson të nevojshme të ndalet edhe tek çështja ligjore e përbërjes së trupit gjykues i cili duhet të gjykojë kërkesën për rishikim në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë. Konstatohet se nga data 04.11.2013 e deri në vitin 2016 kjo çështje është rregulluar dhe ndryshuar nga ligji dhe se analiza ligjore duhet të shërbejë për të konkluduar lidhur me kompozimin e trupës gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në vijim.

18. Kolegji sjell në vëmendje se paragrafi i fundit i nenit 35 të KPC-s para ndryshimeve të vitit 2017 parashikonte ndër të tjera se Gjykata e Lartë gjykon në kolegj me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që, sipas këtij neni, në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga një gjyqtar dhe se çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Nga ana tjetër, neni 13, pika 1, i ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë*", i përditësuar, deri para hyrjes në fuqi të ligjit nr.98/2016 "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", parashikonte se kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, përveçse kur legjislacioni procedural në fuqi parashikon ndryshe.

19. Ndërkohë neni 12 në variantin fillestar të ligjit për gjykimin administrativ parashikonte se Gjykata e Lartë gjykon në Kolegj Administrativ me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe. Ky ligj, në këtë rregullim, rezulton të jetë ndryshuar me ligjin nr.100/2014, duke u riformuluar pika 3, e nenit 12. Riformulimi i kësaj pike, e cila rezulton të jetë formalisht në fuqi edhe sot, parashikon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga 1 gjyqtar, si dhe çështjet që kanë për objekt mosmarrëveshjet e kompetencave dhe se çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.

20. Kolegji sjell në vëmendje se jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin, bazuar në parashikimet e sjella në vëmendje më lart të ligjeve procedurale, se në çdo rast kërkesa për rishikim shqyrtohet me trupë

gjykuese të përbërë me pesë gjyqtarë.[26] Kolegji vlerëson se një qëndrim i Gjykatës Kushtetuese është mbajtur në kushtet kur kompetenca funksionale ekskluzive për shqyrtimin e kërkesës për rishikim, ishte e Gjykatës së Lartë dhe në kushtet kur ligjet procedurale e rregullonin si më lart kompozimin e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë.

21. Nga ana tjetër, rezulton se ligji nr.98/2016 "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*" në pikën 4, të nenit 32, parashikon se, Kolegji Administrativ shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave administrative dhe se trupat gjykues të Kolegjit Administrativ përbëhen nga tre gjyqtarë dhe për çështje që gjykojnë ligjshmërinë e akteve normative nënligjore trupat gjykues përbëhen nga pesë gjyqtarë. Në dispozitat tranzitore të këtij ligji nuk ka rregullime tranzitore për çështjen e hyrjes në fuqi të rregullimeve të kompozimit të trupit gjykues. Kjo do të thotë se ligjvënësi ka vendosur që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë universalisht të gjykojë në dhomë këshillimi dhe në seancë gjyqësore me tre gjyqtarë. Në këtë rregullim përfshihet shqyrtimi i çështjeve të ardhura me rekurse të veçanta, me rekurse të zakonshme apo me kërkesë për rishikim. Nga ky rregullim bëjnë përjashtim çështjet të cilat kanë si objekt rekurset mbi vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit mbi aktet nënligjore normative.

22. Referuar interpretimit të kryer nga Kolegji Administrativ pas ndryshimeve të pësuara në ligjin nr.49/2012, në ligjin nr.38/2017, e miratimit të ligjit nr.98/2016, si dhe praktikës së ndjekur prej tij, së fundmi është konsoliduar qëndrimi se, shqyrtimi i rekurseve dhe kërkesat për rishikim do të shqyrtohen nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me trupë gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë, qoftë në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore.

23. Lidhur me çështjen objekt gjykimi Kolegji konstaton se kërkesa për rishikim është paraqitur nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër pasi palët ndërgjyqëse kanë paraqitur rekurs. Jo vetëm kaq, por kërkesa për rishikim është paraqitur pa përfunduar shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Lartë mbi rekursin. Kjo ka shkaktuar që, gjatë pritjes për t'u shqyrtuar kërkesa për rishikim dhe paralelisht me litispendencën që ky ankim i jashtëzakonshëm kishte krijuar në Gjykatën e Lartë, para së njëjtës gjykatë po shqyrtohej edhe rekursi mbi vendimin e gjykatës së apelit. Më tej, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vitin 2017 rezulton se ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

[26] Shih, Vendimi nr. 76, datë 22.12.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

24. Kolegji sjell në vëmendje se, kërkesa për rishikim është një mjet i jashtëzakonshëm ankimi dhe se si i tillë ushtrohet vetëm pasi vendimi gjyqësor të ketë marrë cilësinë ligjore të formës së prerë dhe gjësë së gjykuar (res judicata). Kjo do të thotë se nuk mund të ushtrohet kërkesa për rishikim kur ndërgjyqësit kanë në dispozicion mjetet e zakonshme të ankimit, konkretisht apelin apo rekursin, apo kur ndërgjyqësit i kanë ushtruar ato dhe gjykata më e lartë nuk ka disponuar përfundimisht.

25. Në rastin objekt gjykimi konstatohet se paralelisht me ushtrimin e rekursit dhe paralelisht me shqyrtimin e rekursit pala kërkuese ka ushtruar kërkesën për rishikim. Shqyrtimi i rekursit ka bërë që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të prishë vendimin e gjykatës së apelit, pikërisht atë vendim që Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër ka kërkuar të rishikohet nëpërmjet kërkesës për rishikim objekt gjykimi. Kolegji konkludon se kërkesa për rishikim nuk mund të ngrihej, ajo është haptazi e pabazuar në ligj dhe abuzive.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-75, datë 27.05.2020

Shfuqizimi i çështjes objekt padie sjell për pasojë pushimin e gjykimit me përjashtim të rasteve të caktuara kur vendimi i shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese ka fuqi prapavepruese që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar dhe pasojat e tij, si dhe me çështje që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Referuar certifikatës së përbërjes familjare datë 12.07.2010, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë Bashkiake nr.6, Tiranë, rezulton paditësja E.Gj.. Mbi bazën e certifikatës së mësipërme rezulton se kombësia e të dy prindërve të paditëses është “greke”, ndërsa kombësia e paditëses dhe motrës së saj rezultojnë të shënuara shqiptare dhe jo greke, ashtu siç e kanë dhe prindërit e saj.

2. Për këtë shkak paditësja, në datën 12.10.2011, i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar korrigjimin e kombësisë, sipas asaj të prindërve të saj. Paditësja pretendon se kemi të bëjmë me një gabim material të nëpunësve të gjendjes civile.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1103, datë 10.02.2012, ka vendosur: *Rrëzimin e kërkesëpadisë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*

3.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar se ligji nr.10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, nuk ka fuqi prapavepruese. Duke qenë se paditësja ka lindur më 01.11.1987, atëherë në kohën e lindjes së saj ka qenë në fuqi një kuadër tjetër ligjor. Nga ana tjetër, koncepti për kombësinë është përdorur për herë të parë në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002, “Për gjendjen civile”, i shfuqizuar. Në të njëjtën kohë Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.52, datë 01.12.2011, ka shfuqizuar termin “kombësi” në ligjin nr.10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”.

4. Kundër vendimit nr.1103, datë 10.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e padisë, duke parashtruar këto

shkaqe: *Arsyetimi i gjykatës në lidhje me fuqinë prapavepruese të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile" është i gabuar. Vendimi i gjykatës është i gabuar edhe për faktin se në rastin kur një fëmijë ka lindur nga dy prindër të një kombësie tjetër, ai nuk mund të regjistrohet me kombësi shqiptare.[...]*

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2405, datë 12.10.2012, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr.1103, datë 10.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. [...]*

6. Kundër vendimit nr.2405, datë 12.10.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur rekurs pala paditëse që ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke parashtruar këto shkaqe: Arsyetimi i gjykatës në lidhje me fuqinë prapavepruese të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile" është i gabuar. Vendimi i gjykatës është i gabuar edhe për faktin se në rastin kur një fëmijë ka lindur nga dy prindër të një kombësie tjetër, ai nuk mund të regjistrohet me kombësi shqiptare. Kërkesëpadia është ngritur përpara marrjes së vendimit nr.52, datë 01.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese dhe në këtë rast ky vendim nuk ka fuqi prapavepruese.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

b) Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se në çështjen në shqyrtim kemi të bëjmë me një padi, gjykimi i të cilës nuk mund të vazhdojë dhe për rrjedhojë, referuar nenit 299, shkronja "c", të Kodtit të Procedurës Civile (KPC)-s, gjykimi i çështjes duhet të pushojë.

19. Nga përmbajtja e vendimit nr.1103, datë 10.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe vendimit nr.2405, datë 12.10.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se një nga shkaqet për të cilat është vendosur rrëzimi i padisë lidhet me faktin se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.52, datë 01.12.2011, ka shfuqizuar termin "kombësi" në nenet 6/1, 8, 42/2, shkronja "e" dhe në tërësi nenin 58 të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile".

20. Kolegji konstaton se përpara Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u paraqitën tri kërkesa për kontroll incidental nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt shpalljen si të papajtueshme me nenet 16/1, 17, 19, 20 dhe 35, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të termit "kombësi", të përcaktuar në nenin 6/1 dhe 8, të termit "kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve", të përcaktuar në nenin 42/2, germa "e" si dhe të nenit 58, tërësisht, në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile".

21. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.52, datë 01.12.2011, vendosi: *Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të termit "kombësi" në nenet 6/1, 8, 42/2, germa "e" dhe të nenit 58, tërësisht, të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile"*. Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare nr.163, datë 17.12.2011.

22. Në nenin 132, pika 2, të Kushtetutës, është parashikuar se: "*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare*". Pra efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese fillojnë nga dita e botimit të tyre në Fletoren Zyrtare. Një parashikim i tillë është bërë për shkak të fuqisë së përgjithshme (*erga omnes*) që vendimet e saj kanë lidhur me interpretimin e normave, parimeve dhe standardeve kushtetuese, krahas zgjidhjes së mosmarrëveshjes konkrete ndërmjet palëve në konflikt, pra krahas efektit *inter partes*. Kjo përcaktohet qartë në nenin 72, pika 7, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*".

23. Megjithatë, krahas efektit për të ardhmen (pro futuro), si rregull i përgjithshëm, siç parashikohet edhe në nenin 76, pika 2, të ligjit nr.8577/2000, dhe që në mënyrë të natyrshme është shprehje e parimit kushtetues të sigurisë juridike, në raste të caktuara, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka edhe efekte prapavepruese. Në nenin 76, pika 7, të ligjit nr.8577/2000 përcaktohen rastet kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese, duke u sanksionuar se:

"Vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm: a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;

b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë; c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar".

24. Në çështjen në shqyrtim konstatohet se në momentin kur ka hyrë në fuqi vendimi nr.52, datë 01.12.2011, i Gjykatës Kushtetuese, pra në datën 17.12.2011, kur edhe është botuar në Fletoren Zyrtare, padia ishte paraqitur dhe çështja ishte ende në shqyrtim, pa pasur një vendim përfundimtar dhe të formës së prerë për të. Për këtë shkak, vendimi nr.52, datë 01.12.2011, i Gjykatës Kushtetuese, ka efekt prapaveprues për çështjen në shqyrtim.

25. Në këto rrethana, duke qenë se termi "kombësi", i parashikuar në ligjin nr.10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile", është shfuqizuar, atëherë çështja nuk ka më objekt. Nëse padia, në momentin e ngritjes së saj

kishte objekt për të cilin pala paditëse legjitimohej për ta rivendikuar, pas hyrjes në fuqi të vendimit nr.52, datë 01.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese, gjykimi i çështjes nuk mund të vazhdojë.

26. Për çka u tha më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, referuar nenit 63, shkronja "ç", të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", duhet të prishë të dy vendimet e gjykatave të faktit dhe të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-122, datë 27.05.2020

Për të balancuar parimin e ligjshmërisë dhe atë të sigurisë juridike, shfuqizimi apo revokimi i akteve administrative të pavlefshme duhet të kryhet brenda afateve strikte, sikurse parashikohet në ligj.

Ndërprerja e një pensioni të caktuar më parë, si pasojë e gabimeve të shkaktuara nga ana e vetë organit publik, mund të bëhet brenda afatit të caktuar për kontrollin e zakonshëm të veprimtarisë së tij dhe rishikimin në dritën e fakteve të reja.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi është i datëlindjes 02.02.1959 dhe, duke pretenduar se ka punuar si minator nën tokë në minierë, ka paraqitur dokumentacionin për përfitimin e trajtimit të veçantë si minator nën tokë.

2. Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me vendimin nr.1017, datë 13.08.2001, është pranuar kjo kërkesë. Ky trajtim është përfituar deri në datën 06.11.2007, me periudhë sigurimi 23 vjet e 2 muaj, në masën 5.702 lekë në muaj.

3. Nga një auditim i realizuar nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për dosjet e trajtimit të veçantë në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë u konstatuan parregullsi dhe pensioni i paditësit u ndërpre me urdhër mbylljen nr.0511333, datë 06.11.2007. Paditësi ka marrë dijeni për këtë vendim në datën 26.11.2007.

4. Ndaj këtij vendimi paditësi ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me shkresën e datës 19.12.2007. Duke qenë se ai nuk mori përgjigje nga organi epror, paditësi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1128, datë 10.02.2012, ka vendosur: *Rrëzimin e padisë së palës paditëse* F.A..

5.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar se të dhënat e librezës së punës së paditësit, mbi të cilat ai ka përfituar pensionin e posaçëm të minatorit vijnë në kundërshtim me provat e tjera të administruara në gjykim, sikurse janë akt verifikimet. Nga këto prova rezulton që paditësi të ketë punuar njëkohësisht edhe në minierë edhe në sektorë të tjerë. Në

të njëjtën kohë, edhe me sy të lirë, shihet se libreza e punës ka ndërhyrje. Në këto rrethana, paditësi nuk plotëson kushtin e nenit 2 të ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, për pasjen e jo më pak se 11 vite e gjysmë punë nëntokë.

6. Kundër vendimit nr.1128, datë 10.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e padisë, duke parashtruar këto shkaqe: Pala e paditur ka dhënë urdhër për mbylljen e trajtimit të veçantë të paditësit pa kundërshtuar librezën e punës, e cila është një dokument zyrtar me fuqi të plotë provuese. Pala e paditur nuk mund të investohet administrativisht për anulimin e pensionit të paditësit pa iu drejtuar rrugës gjyqësore.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1736, datë 29.06.2012, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit civil nr.1128, datë 20.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

7.1. Në marrjen e këtij vendimi Gjykata e Apelit Tiranë ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe argumentim me atë të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vendimin e saj nr.1128, datë 10.02.2012, objekt ankimi.

8. Kundër vendimit nr.1736, datë 29.06.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur rekurs pala paditëse e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr.1128, datë 10.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe pranimin e padisë [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

b) Mbi përbërjen e trupi gjykues

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) konstaton se, që nga data 04.11.2013, moment kur ka hyrë në fuqi ligji nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" (në vijim, ligji nr.49/2012) dhe deri në miratimin e ligjit nr.100/2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është kompozuar me trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh për gjykimin e rekurseve kundër vendimeve të gjykatave të apelit. Pasi kjo çështje u bë objekt shqyrtimi në trupë gjyqësore u konkludua se, në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit rekurseve në dhomë këshillimi, do të gjykojë me trupë gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë. [...]

c) Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

20. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi i palës

paditëse ka shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-s që do t'i bënte të cenueshme vendimet e gjykatave të faktit. Rezulton se vendimi nr.1128, datë 10.02.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe vendimi nr.1736, datë 29.06.2012, i Gjykatës së Apelit Tiranë, janë dhënë në interpretim të gabuar të ligjit material.

21. Nga materialet e çështjes dhe hetimi gjyqësor i zhvilluar në gjykatat e faktit rezulton se paditësi ka qenë përfitues i pensionit të veçantë si minator nën tokë. Pas rishikimit të procedurave të ndjekura në caktimin e pensionit të tij, si pasojë e një auditi të zhvilluar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, më tepër se gjashtë vite pas caktimit të këtij pensioni, kanë rezultuar disa parregullsi në dosjen e paditësit dhe, për këtë shkak, atij i është ndërprerë përfitimi i mëtejshëm i pensionit. Paditësi pretendon në rekurs, ndër të tjera, se pala e paditur nuk mund të cenonte një të drejtë të fituar prej, duke evokuar sakaq parimin e sigurisë juridike.

22. "Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Aspekte të këtij parimi janë edhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe pritshmëritë e ligjshme. Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme" (shih, vendimi nr.31, datë 18.06.2010 i Gjykatës Kushtetuese).

23. Ky parim i rëndësishëm kushtetues është mbajtur në konsideratë edhe në miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, të cilët në pikëpamje të hierarkisë së burimeve të së drejtës qëndrojnë poshtë Kushtetutës dhe duhet të jenë në përputhje me të si dhe me akte të tjera me fuqi më të lartë juridike (marrëveshjet ndërkombëtare në rastin e ligjit dhe ligji në rastin e akteve nënligjore). Në këtë kuadër, edhe veprimtaria e organeve të administratës publike që udhëhiqet nga këto ligje dhe akte nënligjore duhet të përshkohet nga fryma e respektimit të parimit të sigurisë juridike.

24. Shprehje e këtij parimi kushtetues në normimin e veprimtarisë së organeve të administratës publike është edhe përmbajtja e nenit 123 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA)-s, ligj që zbatohej në atë kohë (*ligji nr.8485, datë 12.05.1999, i shfuqizuar me ligjin nr.44/2015*), në të cilin, nën titullin 'Revokimi dhe shfuqizimi i akteve të pavlefshme',

parashikohet se: "*1. Aktet administrative të pavlefshme mund të revokohen ose shfuqizohen vetëm për shkak të pavlefshmërisë dhe brenda afatit kohor të caktuar për ankimin gjyqësor. 2. Në rastet kur afatet e parashikuara nga ligji për ankimin gjyqësor janë më shumë se një, zbatohet afati më i gjatë*". Për sa i përket afatit kohor të caktuar për ankimin gjyqësor, referuar nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s (dispozitë e shfuqizuar me miratimin e ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*") ky afat është tridhjetë ditë.

25. Veprimtaria për të shfuqizuar apo revokuar aktet administrative të pavlefshme lidhet me garantimin e zbatimit të parimit të ligjshmërisë në veprimtarinë e administratës publike, siç sanksionohet në nenin 9 të këtij KPA-s, ligj i cili zbatohej në atë kohë (ligji nr.8485, datë 12.05.1999, i shfuqizuar me ligjin nr.44/2015). Megjithatë, kjo veprimtari nuk mund të shtrihet në një kohë të pafundme pasi ajo është e lidhur me një parim tjetër mjaft të rëndësishëm, me natyrë kushtetuese, parimin e sigurisë juridike. Në këto kushte, qytetarët nuk mund të jenë pafundësisht të shqetësuar për ndryshimet që mund të ndodhin në statusin e tyre financiar. Për rrjedhojë, veprimtaria shtetërore korrigjuese duhet të kryhet brenda afateve strikte, sikurse parashikohet në ligj.

26. Kolegji thekson se nën këtë frymë duhet të interpretohet edhe Rregullorja nr.1, datë 21.10.2008, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, "Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve", për sa i përket kontrollit dhe rishikimit të pensioneve të caktuara më parë ndaj përfituesve. Ndërprerja e një pensioni të caktuar më parë, si pasojë e gabimeve të shkaktuara nga ana e vetë organit publik, mund të bëhet brenda afatit të caktuar për kontrollin e zakonshëm të veprimtarisë së tij. Ndërkohë, dalja e fakteve të reja i jep jetë një instituti tjetër, atij të rishikimit (nenet 144 – 146, të ligjit nr.44/2015 KPA).

27. Kolegji konstaton se ky qëndrim mbështetet edhe në jurisprudencën më të fundit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në çështjen *Romeva kundër Maqedonisë së Veriut* (*kërkesa nr.32141/2010, vendim i formës së prerë më 12.03.2020*). Në këtë çështje rezulton se kërkuesja ishte përfituese e pensionit të pleqërisë dhe pas një rivlerësimi të akteve dhe procedurave të caktimit të pensionit të saj, nga ana e organeve përkatëse publike u bë ndërprerja e tij dhe detyrimi për të kthyer shumat e marra, vetëm mbështetur në aktet e dosjes së saj dhe pas një kohe të gjatë nga caktimi i pensionit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi, ndër të tjera, se: "*Në këtë kuadër, Gjykata i jep rëndësi të veçantë faktit se vendimi për dhënien e pensionit kërkueses nuk ishte bazuar në prova të reja por vetëm mbi një rivlerësim të të njëjtave tek të cilat ishte mbështetur vendimi administrativ, i cili u bë i formës së prerë për shkak se nuk u kundërshtua përpara gjykatave. Në këndvështrimin e Gjykatës, ky rivlerësim i provave ex proprio motu, jashtë sistemit të mjeteve të jashtëzakonshme për të prishur vendimet administrative të formës së prerë, vë në pikëpyetje sigurinë juridike në fushën e sigurimeve shoqërore*".

28. Edhe referuar çështjes në shqyrtim rezulton se organi publik, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ka vepruar tej afatit për të cilin ligji i jepte të drejtë për të shfuqizuar vendimin e organit vartës (më tepër se gjashtë vite).

29. Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara në rekurs Kolegji i gjen të pabazuara. Për sa u përket dy shkaqeve të para, ato lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave dhe, si të tilla, të papranueshme për t'u shqyrtuar në themel nga ky Kolegj, ndërsa për shkakun tjetër, atë që lidhet me dhënien nga gjykatat fuqi prapavepruese Rregullores nr.1, datë 21.10.2008, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, paditësi nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe nuk gjenden të dhëna nga vendimet e gjykatave për ta mbështetur këtë pretendim.

30. Për çka u tha më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, referuar nenit 63, shkronja "c", të igjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", duhet të vendosë prishjen e vendimit nr.1736, datë 29.06.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31001-304-2020, datë 08.06.2020

Për shkak të natyrës së ngutshme të masave të përkohshme procedurale si sigurimi i padisë, gjykata nuk mund të refuzojë shqyrtimin në rastet kur konkludon se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e çështjes.

I. Rrethana e çështjes

1. Padia është paraqitur para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës më datë 19.02.2020 me objekt dhe shkak ligjor sikur tregohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Nga fashikulli i gjykimit rezulton pala paditëse është shoqëri aksionare e themeluar në shkurt të vitit 2019 dhe se ka për objekt veprimtarie tregtare tregtimin e hidrokarbureve, naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera të tyre, etj.,. Për realizimin e veprimtarisë tregtare sipas aktit të themelimit, shoqëria ka kërkuar dhe është licencuar me licencën e transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave me datë 16.07.2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu shoqëria është pajisur me licencën për furnizimin me karburant për konsum të anijeve në porte dhe rada. Me vendimin nr.85, datë 13.02.2020 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur revokimin e licencës së palës paditëse, bazuar në shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.984/2 prot., datë 06.02.2020. Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit mbështetet në konkluzionet e policisë mbi zbatimin ndaj palës paditëse të aktit normativ nr.1, datë 31.01.2020 "*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike*". Sakaq pala paditëse ka paraqitur padinë e individualizuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr.(82-2020-62) 71, datë 03.03.2020 ka vendosur: "*1. Të shpallë moskompetencën tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës për gjykimin e çështjes nr.(00262) 1260 akti, që i përket paditësit, shoqëria "Rajan 2007" sha. 2. Të dërgojë dosjen gjyqësore për vazhdimin e gjykimit në gjykatën kompetente, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.*"...

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.2084 (31154-01376-80-2020) Regjistri Themeltar, datë 08.05.2020 ka vendosur: "*1. Të ngrejë kryesisht çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë përpara Gjykatës së Lartë për gjykimin e çështjes administrative me nr.2084 (31154-01376-80-2020) akti. 2. Të pezullojë gjykimin e nisur pranë kësaj gjykate deri sa Gjykata e Lartë të shprehet lidhur me këtë parashtresë.*".

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka nxjerrë çështjen jashtë kompetencës tokësore, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural. Njëkohësisht Kolegji vlerëson se arsyet e dhëna në vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë të bazuara në ligj dhe në praktikën gjyqësore të konsoliduar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mbi interpretimin e pikave 1 dhe 2, të nenit 13, të ligjit nr.49/2012 dhe gjithashtu është në përputhje me praktikën gjyqësore të konsoliduar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë pas ndryshimeve të nenit 61 të KPC-s në vitin 2017. Sakaq Kolegji konkludon se gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi është përfundimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës dhe se vendimi i saj duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit, para të njëjtit trup gjykues.

6. Kolegji vlerëson se gabimi i parë në zbatimin e ligjit procedural që konstatohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës është marrja në shqyrtim kryesisht dhe disponimi mbi kompetencën tokësore të gjykatës pa prapësim procedural të palëve ndërgjyqëse, në kundërshtim me parimin e disponibilitetit të palëve mbi të drejtat procedurale dhe oficialitetit të gjykatës për të marrë në shqyrtim çështjet procedurale kryesisht *(ex officio)*. Kolegji sjell në vëmendje se kompetenca tokësore, që me ndryshimet e vitit 2001 në Kodin e Procedurës Civile, është relativizuar si prezumim procedural, pasi u parashikua se, edhe shkelja e kompetencës tokësore nga gjykatat mundet të ishte e metë e konvalidueshme ligjore dhe si e tillë mundet të korrigjohej dhe të vleftësohej nga gjykata më e lartë pas shqyrtimit të ankimit (*shih, paragrafi i parë i nenit 467/b të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s*).

7. Më tej, ligji nr.49/2012, që për sa u përket rregullimeve normative me natyrë procedurale ka hyrë në fuqi më datë 04.11.2013 dhe ndryshimet e ligjore të KPC-s, që kanë hyrë në fuqi më datë 05.11.2017, e kanë shndërruar çështjen e kompetencës tokësore në prapësim procedural në kuptimin e

ngushtë, që do të thotë se gjykatat nuk munden sipas parimit të oficialitetit ta shqyrtojnë kryesisht dhe se vetëm palët, sipas parimit të disponibilitetit, munden ta reklamojnë apo prapësojnë atë para gjykatës dhe njëkohësisht brenda një afati ligjor dekadent, i cili është përcaktuar me fazë gjykimi. Fillimisht pika 1, e nenit 13, të ligjit nr.49/2012 parashikon se moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit. Nga ana tjetër, pika 2, e nenit 13, të ligjit nr.49/2012 parashikon se kompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave. Ndërkohë neni 61 i ndryshuar i KPC-s, në paragrafin e dytë parashikon se përveç kompetencës ekskluzive, funksionale apo lëndore, të gjitha llojet e tjera të kompetencave mund të mund të merret parasysh vetëm me kërkesë të palëve, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se vendimi i Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Durrës duhet të prishet dhe çështja duhet të dërgohet për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë dhe në të njëjtin trup gjykues.

8. Kolegjit i tërhoqi vëmendjen në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës paragrafi i fundit i vendimit, në të cilin gjykata ka konkluduar se një gjykatë që vlerëson se nuk është kompetente dhe që për këtë arsye e deklaron veten si të tillë nuk mund të shqyrtojë as edhe kërkesat eventuale të palës për marrjen e masave të për përkohshme procedurale. Kolegji vlerëson se një interpretim i tillë i ligjit procedural është i gabuar dhe se nuk mban parasysh natyrën juridike të masave të përkohshme procedurale, të cilat në çdo rast, sipas nenit 202 të KPC-s dhe nenit 28, pika 3, të ligjit nr.49/2012, duhet të shqyrtohen brenda 5 ditëve. Kjo mënyrë e rregullimit ligjor është e diktuar nga fakti që masa e sigurimit të padisë gjithmonë presupozon një nevojë urgjente dhe paraprake për shqyrtim në raport me shqyrtimin e çështjes në themel. Masat e sigurimit të padisë janë të lidhura integralisht dhe funksionalisht me padinë dhe se i shërbejnë gjithnjë ruajtjes së efektivitetit të padisë si mjet juridik. Nëse nuk respektohen garancitë procedurale për shqyrtimin e shpejtë të masave të sigurimit të padisë atëherë rrezikohet që vetë padia të shndërrohet në një mjet juridik joefektiv, teorik dhe iluzor dhe se kjo do të cenonte garancitë e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)-së.

9. Kolegji sjell në vëmendje të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës se gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë masën e sigurimit të padisë për arsyet që ajo lejohet nga ligji të mos shqyrtojë padinë në themel. Konkretisht, nga çështja objekt shqyrtimi si shkak i tillë ligjor është shfaqur vlerësimi i gjykatës se nuk ka kompetencë tokësore për shqyrtimin

e çështjes. Kolegji sjell në vëmendje se, në nenin 63 të KPC-s ndër të tjera parashikohet se: "*Me depozitimin e ankesës, sipas nenit 62 të këtij Kodi, pezullohet gjykimi i çështjes dhe gjykata mund të kryejë vetëm veprime procedurale që nuk presin.*".

Ky parashikim ligjor duhet të zbatohet si në rastin kur ka procedime paragjykimore në Gjykatën e Lartë të inicuara me ankesë të palëve dhe me parashtresë të gjykatës. Qëllimi i këtij parashikimi ligjor është ofrimi i mbrojtjes gjyqësore të menjëhershme mbi masat e përkohshme procedurale edhe në rastet kur gjykimi pezullohet apo ndërpritet për shkaqe procedurale apo për shkak të procedimeve paragjykimore. Të njëjtat zgjidhje ligjore ka bërë ligjvënësi edhe në rastin e nenit 88 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)-s, dispozitë që ka parashikuar mundësinë dhe kompetencën e përkohshme të gjykatës jokompetente për shkak territori apo lënde për të caktuar një masë sigurimi në procesin penal, edhe pse gjykata nuk ka kompetencë për shqyrtimin e themelit të akuzës. Me të njëjtën logjikë legjislatori ka regjuar edhe çështjen e juridiksionit gjyqësor për shqyrtimin dhe caktimin e masave të sigurimit të padisë në të drejtën ndërkombëtare private, konkretisht në nenin 81 të ligjit nr.10428/2011.

10. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë masën e sigurimit të padisë në rastet kur konkludon se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e çështjes. Masat e përkohshme procedurale futen në konceptin e veprimeve procedurale që nuk presin për shkak të urgjencës së tyre dhe se në këto raste neni 63 i KPC-s zbatohet edhe për gjykimin administrativ, sipas nenit 1, pika 2, të ligjit nr.49/2012. Kjo do të thotë se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës kishte detyrimin ligjor të dispononte mbi masën e sigurimit të padisë brenda 5 ditëve nga momenti i depozitimit të padisë në gjykatë.

11. Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës i sillet në vëmendje se gjykatat kanë për detyrë të individualizojnë drejt dhe saktë bazën ligjore të zbatueshme për sa u përket të drejtave të palëve dhe detyrimeve të gjykatës për të prapësuar dhe për të marrë në shqyrtim çështjet e së drejtës procedurale. Këto rregullime përcaktojnë mënyrën se si duhet të zhvillohet procesi gjyqësor sipas standardeve të procesit të rregullt ligjor dhe si të tilla kanë rëndësi për gjykimin e drejtë të çështjes dhe përfundimin e tij brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, gjykata duhet të jetë më e kujdesshme në analizën ligjore procedurale të zbatueshme, në mënyrë që të garantohet ligjshmëria e vendimmarrjes dhe të mos krijohen vonesa për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e gjykimeve administrative.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-377-2020, datë 15.06.2020

Marrëdhëniet e punës që lindnin dhe rregullohen sipas normave të Kodit të Punës të jenë pjesë e kompetencës lëndore të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm. Kjo vlen edhe për marrëdhëniet e punës që rregullohen me ligj të posaçëm, që nuk përcakton natyrën juridike e marrëdhënies së punës dhe statusin e punëmarrësit, siç është ligji për statusin e deputetit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse ka paraqitur një padi objekt gjykimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, më datë 04.09.2019.

2. Asnjë nga gjykatat e faktit nuk paraqesin as edhe një të dhënë mbi faktet e çështjes dhe të dyja, në vendimet e tyre arsyetojnë se çështja nuk është në kompetencën lëndore të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë për herë të parë merr përsipër të analizojë faktet e çështjes në funksion të kuptimit të shkakut ligjor dhe objektit të padisë, me qëllim për të kuptuar natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe më tej për të vendosur mbi konfliktin e kompetencës të krijuar nga gjykatat e faktit. Në kushte normale duhet të ndodhte ndryshe, pasi gjykatat e faktit duhet të parashtrojnë fillimisht faktet e çështjes dhe Gjykata e Lartë duhet t'i marrë faktet nga vendimet e tyre.

3. Pala paditëse ka qenë specialiste në zyrën e deputetëve të opozitës së Kuvendit, konkretisht pranë Zyrës së Komunikimit me Zgjedhësit në Qarkun e Fierit. Marrëdhënia e punës ka zgjatur nga data 11.05.2015 deri më datë 06.03.2019. Me shkresën 963/1 prot., datë 05.03.2019 të Kuvendit pala paditëse njoftohet se lirohet nga detyra e specialistes. Duke pretenduar se pala e paditur ka ndërprerë në mënyrë të menjëhershme marrëdhënien e punës, në kundërshtim me sa parashikon Kodi i Punës, pala paditëse ka paraqitur padinë objekt gjykimi.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr.62-2019-6339 (1743), datë 11.12.2019 ka vendosur: "*1. Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për shqyrtimin e çështjes me nr. regj. Them. 21234-02160-62-2019 (1711). 2. Dërgimin për shqyrtim të kërkesëpadisë dhe akteve shoqëruese të saj, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si gjykatë kompetente për nga pikëpamja e kompetencës lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes me nr. regj. them. 21234-02160-62-2019 (1711).*".

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parën Vlorë me vendimin nr.162, datë 04.03.2020 ka vendosur: "*1. Të deklarojë mosmarrëveshjen për kompetencë për gjykimin e çështjes civile me nr. regj. them. 524, datë regj. 24.01.2020 me palë paditëse E.L. dhe palë të paditur Kuvendi i Shqipërisë. 2. Dërgimin e akteve Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*" Gjykata administrative e shkallës së parë, pa dhënë arsyetim se pse nuk është në kompetencën lëndore të saj shqyrtimi i padisë, ka parashtruar në Gjykatën e Lartë konfliktin e kompetencës, duke kërkuar që të vendoset prishja e vendimit civil dhe dërgimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë dhe vendimet e gjykatave në mosmarrëveshje për kompetencën lëndore, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.49/2012, nenit 41 të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s, çmon se parashtresa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është e bazuar në ligj, megjithëse e paarsyetuar, dhe se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është i pabazuar në ligj. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duhet të prishet duke u vendosur kthimi i çështjes në atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

7. Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje dhe të tërheqë vëmendjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë lidhur me përmbajtjen e vendimit të shpalljes së mungesës së kompetencës dhe parashtresës së qëndrimit mbi kompetencës lëndore në Gjykatën e Lartë. Neni 142, pika 1, i Kushtetutës detyron gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre. Më tej, sipas nenit 310 të KPC-s, vendimi gjyqësor duhet të ketë detyrimisht në përmbajtjen e tij parashtrimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes. Në rastin konkret rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është katër faqe, por se në përmbajtjen e tij nuk ka të paraqitur asgjë mbi faktet dhe rrethanat e çështjes. Nga ana tjetër edhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë mbi parashtresën në Gjykatën e Lartë është pesë faqe dhe se në përmbajtjen e tij nuk ka asgjë të pasqyruar për rrethanat e çështjes. Për më tepër, arsyetimi i këtij vendimi nuk ka asgjë relevante me zgjidhjen konkrete të çështjes dhe me argumentimin konkret të parashtresës. Nga kjo mënyrë e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk kuptohet nëse gjykatat e faktit i kanë analizuar

faktet dhe rrethanat e çështjes apo jo dhe më tej nuk kuptohet se si ato kanë konkluduar mbi kompetencën lëndore të çështjes objekt gjykimi në konkluzione diametralisht të ndryshme pa analizuar objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Kolegji sjell dhe tërheq vëmendjen e gjykatave të faktit se për këtë pjesë vendimet e tyre janë të arsyetuara, duke parashtruar shkurtimisht rrethanat e çështjes, dhe se në vijim kjo mënyrë e hartimit të vendimeve nuk duhet të përsëritet. Qëllimi i kësaj pjese të vendimit mbetet analiza e drejtë e natyrës juridike të mosmarrëveshjes dhe kuptimi i drejtë i objektit dhe i shkakut ligjor të padisë objekt gjykimi. Këta elementë janë thelbësorë në konkluzionin gjyqësor mbi çështjen e kompetencës dhe të juridiksionit.

8. Lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet gjykatës civile dhe administrative, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje se neni 7, shkronja "ç", i ligjit nr.49/2012, të ndryshuar, parashikon se: "ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës;" Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e interpreton këtë dispozitë duke konkluduar se mjafton që ligji i veçantë të përmend diçka për një nga punonjësit me punëdhënës një nga organet e administratës publike dhe kompetenca lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës u atribuohet sipas ligjit gjykatave administrative. Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit është e gabuar dhe nuk ndjek aspak qëllimet e normës së prezantuar rishtazi në ligj në vitin 2017. Kolegji sjell në vëmendje se qëllimi i ligjvënësit në ndryshimin e kompetencës lëndore të gjykatave administrative për këtë pjesë ishte që marrëdhëniet e punës që lindin dhe rregullohen sipas normave të Kodit të Punës të jenë pjesë e kompetencës lëndore të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, duke qenë se në thelbin e tyre mungonin elementet e nevojshëm për t'i kualifikuar si marrëdhënie administrative të punës. Për rrjedhojë, kjo mënyrë e interpretimit duhet të shoqërojë gjykatat në çdo rast në identifikimin e gjykatës kompetente në marrëdhëniet e punës në rastet kur punëdhënës është një organ i administratës publike.

9. Në rastin konkret është paraqitur një padi me objekt kërkimin e dëmshpërblimeve për shkak të zgjidhjes së paligjshme të kontratës së punës, duke përdorur si bazë ligjore dispozitat përkatëse të Kodit të Punës, që disiplinojnë zgjidhjen individuale të kontratës së punës. Pala paditëse ka qenë specialiste e zyrës së deputetëve të grupit opozitar parlamentar dhe se ligji i statusit të deputetit ka vetëm një parashikim, i cili vendos se kush e propozon lidhjen e kësaj kontrate pune, kur e vendos lidhjen e kësaj

kontrate pune dhe çfarë arsimi duhet të ketë punonjësi. Ligji i posaçëm nuk ka asnjë normë për natyrën juridike të kësaj marrëdhënieje pune, statusin e punëmarrësit, të drejtat dhe detyrimet e tij, mënyrën e përfundimit të kontratës së punës dhe rregulla të tjera që përcaktojnë përmbajtjen e statusit të punëmarrësit. Sakaq mbetet të konkludohet nëse mjafton ky rregullim ligjor për të konkluduar se statusi i paditëses punëmarrëse rregullohet me ligj të veçantë në rastin konkret apo jo.

10. Kolegji vlerëson se një parashikim i tillë i vetëm nuk mjafton për të konsideruar se marrëdhënia e punës së këtyre punonjësve rregullohet me ligj të posaçëm në kuptim të nenit 7/ç të ligjit nr.49/2012, çka do të aktivizonte kompetencën lëndore të gjykatës administrative, në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të punës në këto raste. Termi ligj organik në dispozitë nuk përdoret në kuptimin e ngushtë (*stricto sensu*) të fjalës, konkretisht i ligjit për organizimin dhe funksionimin e institucionit kushtetues që miratohet me shumicë të cilësuar prej 3/5 sipas nenit 81 të Kushtetutës). Përkundrazi, një interpretim i tillë nuk do të kishte për qëllimet e zbatimit të drejtë të kësaj dispozite. Në funksion të kuptimit të drejtë të saj duhet të kuptohet që ligji që nga pikëpamja e përmbajtjes bën një rregullim në mënyrë organike dhe më të detajuar të marrëdhënies së punës në lidhje me subjektet e tij punëmarrëse dhe të cilët si punëdhënës kanë një organ të administratës publike.

11. Në këtë kuadër Kolegji sjell në vëmendje si shembull ligjin nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", si një ligj që rregullon në mënyrë organike dhe të detajuar marrëdhënien e punës të nëpunësve civile, që si rrjedhojë *ex legge* përbën lëndë shqyrtimi nga gjykatat administrative. Ky ligj rregullon mënyrën e përzgjedhjes, kriteret që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë, momentin juridik se kur lind statusi i nëpunësit civil, garancitë e qëndrueshmërisë në detyrë, rastet e transferimit dhe lëvizjes paralele në pozicionet e punës, garancitë për ngritjen në detyrë, masat disiplinore, të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil në marrëdhënien e punës, rastet e shkarkimit, garancitë për zgjidhjen e paligjshme të kontratës së punës dhe të drejtat që gëzon nëpunësi civil në rastet e zgjidhjes së paligjshme të kontratës së punës, etj.,.

12. Në këtë kuptim dhe nën këtë logjikë juridike, Kolegji vlerëson se ligji për statusin e deputetit nuk ka rregullime që të rregullojnë statusin e nëpunësve të zyrave të deputetëve për mbajtjen e marrëdhënieve me zgjedhësit. Në të rregullohet vetëm në mënyrë episodike një çështje e vetme dhe se për pjesën tjetër të ometimit të këtij ligji do të zbatohet në mënyrë komplementare Kodi i Punës. Ligji për statusin e deputetëve rregullon në mënyrë të tillë vetëm statusin e deputetit dhe jo të pozicionit që ka pala

paditëse. Për më tepër, duke u nisur edhe nga objekti dhe shkaku i padisë, elementë të cilat përcaktojnë lëndën e gjykimit, në rastin konkret paditësi ka pretenduar zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës nga pala e paditur pa shkaqe të justifikuara dhe për pasojë, përfitimin e dëmshpërblimeve përkatëse, bazuar në Kodin e Punës. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje nga pikëpamja lëndore është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-78, datë 18.06.2020

Në gjykimin administrativ lejohet ankim i veçantë vetëm ndaj vendimeve jopërfundimtare të gjykatës, me të cilat çështja nxirret nga juridiksioni gjyqësor, duke u pushuar gjykimi i padisë. Ndaj vendimeve të ndërmjetme të gjykatës që rrezojnë prapësimin apo kërkesën e një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, lejohet ankim apo rekurs sipas rregullave të zakonshme, pra bashkë me vendimin përfundimtar apo jo përfundimtar.

I. Rrethanat e çështjes

1. Rezulton se nga kontrolli i ushtruar nga inspektorët e palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, është mbajtur Raport Kontrolli i datës 09.06.2015, në bazë të të cilit është nxjerrë akti administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.3339/6 prot., datë 09.06.2015, ndaj palës paditëse V.A. SHA, duke i bërë të ditur këtij subjekti tatimpagues që duhet të paguajë detyrime tatimore së bashku me gjoba, në shumën e përgjithshme prej 293.595.809 lekë.

2. Ndaj aktit administrativ njoftim vlerësimi tatimor nr.3339/6 prot., datë 09.06.2015, pala paditëse V.A. SHA, ka ushtruar ankim administrativ pranë palës së paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3. Pala e paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor, me vendimin nr.21871/3 datë 12.10.2015, ka vendosur: *Refuzimin e ankimit për shkak se nuk është paguar apo nuk është vënë garanci bankare për detyrimin e plotë tatimor objekt ankimi (kamatëvonesat e TVSH-së për periudhën 2011/12 në shumën 5.075.734 lekë), sipas njoftim vlerësimit nr. 3339/6 prot., datë 09.06.2015 nxjerrë nga Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj (DRTM)",* me argumentin se në sistemin informatik konstatohet se ndaj shoqërisë është llogaritur edhe kamatëvonesë për detyrimin për TVSH-në për periudhën dhjetor 2011 në shumën 5.075.734 lekë. Referuar dokumentacionit dhe të dhënave të sistemit informatik, kamatëvonesa e mësipërme nuk është paguar nga shoqëria si dhe për të nuk është vendosur garanci bankare.

4. Në të tilla rrethana, pala paditëse V.A. SHA, ka ngritur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë padinë objekt gjykimi, me shkak ligjor dhe objekt shfuqizimin e akteve administrative njoftim vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.3339/6, datë 09.06.2015, raport kontrolli, e datës 09.06.2015, nr. 3339/5 prot., lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj për të gjitha detyrimet tatimore përkatëse (përfshirë detyrime, gjoba dhe interesa); Shfuqizimin e aktit administrativ 'Vendim i Drejtori Apelimit Tatimor' nr.21871/3 prot., datë 12.10.2015. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesës së akteve administrative të mësipërme për detyrimet përkatëse (përfshirë gjoba dhe interesa) për tatim fitimin e vitit 2013.

5. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në fazën e kërkesave paraprake, nga avokati i shtetit dhe pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, u kërkua nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke pretenduar se kjo çështje nuk mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në kushtet kur akti administrativ objekt i këtij gjykimi, njoftim vlerësimi për detyrimet, nuk është marrë më parë në shqyrtim nga organi administrativ epror, pala e paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Pala paditëse Vodafone Albania sha, i është drejtuar këtij të fundit pa plotësuar një detyrim ligjor që është ai i kryerjes së pagesës së detyrimit, kamatëvonesave për efekt të shqyrtimit administrativ nga organi epror administrativ sipas urdhërimeve të parashikuara në nenet 106,107 dhe 108, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, si dhe udhëzimit të Ministrit të Financave me nr.24, datë 02.09.2008, pikat 106 e 107.1, 107.2 të tij.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin (e pa numërtuar), datë 08.02.2016, ka vendosur: *Rrëzimin e kërkesës së ngritur nga Avokati i Shtetit dhe palët e paditura Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për nxjerrjen e çështjes administrative jashtë juridiksionit gjyqësor.*[...]

7. Kundër vendimit (i panumërtuar), datë 08.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kanë bërë ankim të veçantë pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe Avokatura e Shtetit, me të cilën ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke parashtruar këto shkaqe: Kusht themelor pra që ankimi të konsiderohet i pranueshëm nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, është që tatimpaguesi të ketë paguar vlerën e plotë të detyrimit tatimor të përcaktuar ose të ketë vënë garanci bankare të plotë të përcaktuar në Njoftim Vlerësim plus interesat, kjo në kuptim të neneve të sipërcituara. Ky parapagim nuk rezulton të jetë bërë nga paditësi.[...]

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.2904, datë 30.03.2016, ka vendosur: *Prishjen e vendimit (i panumërtuar), datë 08.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes gjyqësore administrative nr.6848/420 (31010-07196-80-2015) Regj. Themeltar, jashtë juridiksionit gjyqësor.[...]*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

11. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) konstaton se që nga data 04.11.2013, moment kur ka hyrë në fuqi ligji nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" (në vijim, Ligji nr. 49/2012), Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është kompozuar me trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh për të shqyrtuar ankimet e veçanta me objekt kundërshtimin e vendimeve jopërfundimtare apo të ndërmjetme të gjykatës që deklarojnë mungesën apo jo të juridiksionit. Pasi kjo çështje u bë objekt shqyrtimi në trupë gjyqësore u konkludua se, në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të ankimit të veçantë ndaj vendimit jopërfundimtar të gjykatës që disponon për juridiksionin do të gjykojë me trupë gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë. [...]

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se pala e paditur ka ushtruar ankim të veçantë ndaj një vendimi gjyqësor të ndërmjetëm të gjykatës administrative për të cilin ligji nuk e lejon këtë mjet të posaçëm ankimi. Për rrjedhojë, për të gjitha arsyet që do të parashtrohen në vijim të vendimit, Kolegji konkludon se duhet të vendoset mospranimi i ankimit të veçantë, në bazë dhe për zbatim të nenit 9 të ligjit nr.49/2012.

15. Kolegji vlerëson të nevojshme që paraprakisht të sjellë në vëmendje parashikimin e posaçëm ligjor të nenit 9 të ligjit nr.49/2012, dispozitë e cila rregullon çështjen e vendimmarrjes së gjykatës dhe kontestit ligjor të palëve mbi disponimet gjyqësore për juridiksionin. Kjo dispozitë parashikon se: "*1. Gjykata, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent. 2. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji vendos në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve, nëse çështja përfshihet ose jo në juridiksionin*

gjyqësor. Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin. 3. Kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se çështja është brenda juridiksionit gjyqësor, prish vendimin dhe e dërgon çështjen për vazhdimin e gjykimit me të njëjtin trup gjykues në gjykatën që kishte vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit.".

16. Kjo normë e ligjit nr.49/2012 rregullon ndryshe çështjen e ankimit të veçantë të vendimit të ndërmjetëm të gjykatës administrative që vendos rrëzimin e prapësimit apo kërkesës së një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, në raport me rregullimin e nenit 59 të KPC-s, në të cilin parashikohet se: "*Gjykata, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë.*".

17. Kështu, dallohet se në procesin civil ndaj dy llojeve të vendimeve dhe disponimeve gjyqësore mbi juridiksionin lejohet ankim i veçantë. Ndërkohë, në nenin 9 të ligjit nr.49/2012, ankimi i veçantë lejohet vetëm ndaj vendimit jopërfundimtar të gjykatës që nxjerr çështjen jashtë juridiksionit. Duke mos lejuar ligji ankim të veçantë, konkretisht rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që rrëzon prapësimin apo kërkesën e një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, do të thotë se, në këto raste, ndaj këtyre vendimeve do të zbatohet rregullimi i përgjithshëm dhe i zakonshëm ligjor për ankimin e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës (*shih, nenet 125, 315 dhe 470, të KPC-s dhe nenin 1, pika 2, të ligjit nr.49/2012*). Pra, ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës administrative që rrëzon prapësimin apo kërkesën e palës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nuk mund të ushtrohet ankim i veçantë, por do të ushtrohet ankim i zakonshëm, domethënë apel apo rekurs, bashkë me vendimin përfundimtar (*shih, nenin 126 të KPC-s*) apo jopërfundimtar (*shih, nenin 127 të KPC-s*).

18. Kolegji mban parasysh në këtë analizë edhe faktin se praktika e mëparshme e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka konkluduar ndryshe mbi këtë çështje. Kolegji Administrativ në këtë praktikë gjyqësore ka konkluduar se neni 9 i ligjit nr.49/2012, pavarësisht se ometon në ofrimin e një rekursi të drejtpërdrejtë për vendimin e ndërmjetëm të gjykatës që nuk pranon të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, do të duhet të komplementohet nga parashikimi i paragrafit të dytë të nenit 59 të KPC-s.19. Kolegji mban parasysh se, në bazë dhe për zbatim të nenit

1, pika 2, të ligjit nr.49/2012 rregullimet e posaçme ligjore të ligjit për gjykimin administrativ do të prevalojnë ndaj rregullimeve të përgjithshme ligjore të KPC-s. Këto të fundit, do të zbatohen vetëm atëherë kur ligji për gjykimin administrativ ka ometuar në rregullimet e tij apo u vetëreferohet për zgjidhje ligjore parashikimeve të përgjithshme procedurale.

20. Kolegji konkludon se praktika gjyqësore e mëparshme, duke lejuar ankim të veçantë ndaj vendimeve të ndërmjetme të gjykatës administrative që disponojnë mbi rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, ka lënë pa fuqi rregullimin e posaçëm ligjor, konkretisht nenin 9 të ligjit nr.49/2012, i cili sipas pikës 2, të nenit 1, të këtij ligji, është i detyrueshëm për t'u zbatuar në këto raste. Kolegji konkludon se rregullimi i posaçëm i nenit 9, të Ligjit nr. 49/2012, mbi këtë çështje ligjore, përjashton mundësinë e zbatimit të paragrafit të dytë të nenit 59 të KPC-s.

21. Kolegji sjell në vëmendje se ndryshimi i rregullimit ligjor ndërmjet nenit 9të ligjit nr.49/2012 dhe nenit 59 të KPC-s është vullnet i qëllimshëm i ligjvënësit, me synimin që të adresojë zgjidhje efektive dhe të shpejta ligjore për zhvillimin e gjykimit administrativ brenda afateve kohore sa më të arsyeshme. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se qëllimi i ligjvënësit ka qenë i qartë kur ka parashikuar ankimin e veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe jo për të kundërtën. Kështu, Kolegji konkludon se ka nevojë të menjëhershme për kontrollin gjyqësor nga Gjykata e Lartë në rastin e vendimeve jopërfundimtare të gjykatave administrative, me të cilat disponohet nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi kjo vendimmarrje gjyqësore potencialisht mund të shkaktojë cenimin në thelb të aksesit në drejtësi dhe, për rrjedhojë, edhe mohimin flagrant të mbrojtjes gjyqësore për individin. Ndërkohë, ndryshe paraqitet çështja e vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që e mban çështjen në juridiksionin gjyqësore. Në këto raste, nuk ka cenim dhe mohim flagrant apo në thelb të së drejtës së individit për akses në drejtësi, pasi pretendimet për mungesën e juridiksionit gjyqësor të palëve ndërgjyqëse do të shqyrtohen sërish, nëpërmjet mjeteve të ankimit të zakonshëm, në gjykatën më të lartë dhe sipas rregullave të përgjithshme.

22. Për sa u arsyetua më lart, Kolegji konkludon se në gjykimin administrativ, në bazë dhe për zbatim të nenit 9 të ligjit nr.49/2012, lejohet ankim i veçantë vetëm ndaj vendimeve jopërfundimtare të gjykatës, me të cilat çështja nxirret nga juridiksioni gjyqësor, duke u pushuar gjykimi i padisë. Nga ana tjetër, ndaj vendimeve të ndërmjetme të gjykatës, me të cilat rrëzohet prapësimi apo kërkesa e një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, lejohet ankim apo rekurs sipas rregullave

të zakonshme, që do të thotë bashkë me vendimin përfundimtar apo jopërfundimtar.

23. Lidhur me zgjidhjen e çështjes konkrete të shtruar për gjykim, Kolegji konstaton se pala ankimuese ka ushtruar ankim të veçantë ndaj një vendimi të ndërmjetëm të gjykatës administrative të shkallës së parë, nëpërmjet të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Për rrjedhojë, nisur edhe nga sa u analizua më lart, Kolegji konkludon se ankimi i veçantë është ushtruar ndaj një vendimi të ndërmjetëm kundër të cilit nuk lejohet një mjet i tillë. Për rrjedhojë, ankimi i veçantë (rekursi i drejtpërdrejtë), në bazë dhe për zbatim të nenit 60/1 të ligjit nr.49/2012, nuk mund të pranohet për gjykim.

24. Përderisa në vijimësi do të mbahet ky qëndrimi i arsyetuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë sjell në vëmendjen e gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të palëve në proces se, ankimet e veçanta për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nuk duhet të pranohen dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të lejohen të vijnë me këtë mekanizëm rekursi të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë. Mbi këtë qëndrim të mbajtur, Kolegji sjell në vëmendjen e gjykatave administrative të shkallës së parë se, ushtrimi i një mjeti të tillë të papranueshëm ankimi, nuk mund të shkaktojë pezullimin e gjykimit të çështjes dhe se gjykimi duhet të vijojë normalisht në këto raste.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-180, datë 22.06.2020

Mosmarrëveshjet që lindin si pasojë e kërkesës së shtetasve për t'u regjistruar në listën e zgjedhësve, si dhe ato për korrigjimin e pasaktësive në përbërësin e tij zgjedhor, janë në kompetencë të gjykatave të rretheve gjyqësore, ku nga pikëpamja tokësore kompetente është gjykata e vendbanimit të kërkuesit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin e datës 01.07.2017 rezulton që ndër të tjera të ketë vendosur caktimin ndaj shtetasit A.D. të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "arrest në burg".

2. Kërkuesi, me pretendimin se nuk gjendet i regjistruar në listën e zgjedhësve të Qendrës së Votimit nr. 1967/1, me adresë: IEVP "Jordan Misja", Tiranë, i ka paraqitur këtë kërkese Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.11 akti, datë Regj. 25.06.2019, datë 28.06.2019 vendimi, ka vendosur: *1. Deklarimin jokompetente nga pikëpamja lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes […]2. Kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë".*

3.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar se pretendimet e kërkuesit shtrihen ndaj mosveprimit të një organi publik sikurse janë Zyrat e Gjendjes Civile dhe për këtë shkak mosmarrëveshja është e natyrës administrative. Edhe pse neni 57 i Kodit Zgjedhor përcakton si gjykata kompetente gjykatat e rretheve gjyqësore, ky parashikim ligjor është hartuar kur ende nuk kishte hyrë në fuqi ligji nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.5 (31138-04491-80) akti, datë regjistrimi 05.07.2019, datë 23.07.2019 vendimi, ka vendosur: *"Të ngrejë përpara Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sa i takon vendimit të kësaj të fundit nr. s'ka, datë 28.06.2019, regjistruar me nr. 11 akti, datë 25.06.2019, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë".*

4.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar se neni 57 i Kodit Zgjedhor, që përcakton si gjykatë kompetente gjykatën e rrethit gjyqësor, është një dispozitë e cila sanksionon një kompetencë të karakterit ekskluziv. Një mosmarrëveshje e tillë nuk përfshihet në rrethin e mosmarrëveshjeve që gjykon gjykata administrative. Në të njëjtën kohë, kjo dispozitë ka mbetur e pandryshuar edhe pas ndryshimeve që ky Kod ka pësuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr.31/2015, datë 02.04.2015. Ligjvënësi, jo pa qëllim, nuk e ka ndryshuar këtë dispozitë edhe pse Kodi Zgjedhor ka pësuar disa ndryshime, me qëllim që e drejta për të votuar, si një e drejtë kushtetuese, të jetë sa më e aksesueshme nga qytetarët, duke qenë se gjykatat e rretheve gjyqësore janë më të shumta në numër.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se vendimi nr.11 akti, datë regj. 25.06.2019, datë 28.06.2019 vendimi, është marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale që rregullojnë çështjen e kompetencës lëndore të gjykatave dhe si i tillë duhet të prishet dhe të kthehet për rishqyrtim në këtë gjykatë, pranë të njëjtit trup gjykues.

6. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt (shih, vendimi nr.917, datë 11.05.2017, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

7. Në vijim të këtij qëndrimi, Kolegji thekson se, për të përcaktuar nëse një mosmarrëveshje është e natyrës civile apo administrative, duhet t'u referohet jo vetëm dispozitave të cilat përcaktojnë llojet e padive që bëjnë pjesë në sferën e kompetencës së njërës apo tjetrës gjykatë, por edhe kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e vetë kësaj Gjykate, duke pasur në konsideratë këtu, *së pari*, jurisprudencën nomofilatike të Gjykatës së Lartë (vendimet njësuese dhe ndryshuese të praktikës gjyqësore) dhe, *së dyti*, jurisprudencën konstante të saj.

8. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 135 të saj parashikon se pushteti gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga Gjykata e Lartë si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Nga ana tjetër, Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të

tjera për fusha të veçanta. Pra, nëpërmjet një ligji, i cili në çdo rast duhet të jetë organik (ligj i miratuar me shumicën e tre të pestave të anëtarëve të Kuvendit sipas nenit 81, paragrafi II, shkronja "a", e Kushtetutës), Kuvendi mund të krijojë gjykata me juridiksion të specializuar, për një kategori të caktuar mosmarrëveshjesh. Mund të përmendim si të tilla gjykatat e krimeve të rënda, të krijuara me ligjin nr.9110, datë 24.07.2003, ose gjykatat administrative, të krijuara me ligjin nr.49/2012, datë 03.05.2012 (shih, vendimi nr.00-2018-667, datë 08.05.2018, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se, nga mënyra e formulimit të paragrafëve I dhe III, të nenit 135 të Kushtetutës rezulton se si rregull, gjykatat kanë kompetencë lëndore të përgjithshme, pra ato gjykojnë të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve që janë bërë pjesë e juridiksionit gjyqësor, me përjashtim të atyre që Kuvendi, nëpërmjet një ligji organik ia ka rezervuar një gjykate ose një kategorie të caktuar gjykatash. Nga kjo nxirret një përfundim i rëndësishëm, se kompetenca e gjykatave të fushave të veçanta, sipas nenit 135, paragrafi III i Kushtetutës, është e kufizuar vetëm për ato mosmarrëveshje që specifikisht u janë rezervuar nga ligji i tyre organik ose edhe nga ligje të tjerë. Për të gjitha mosmarrëveshjet e tjera kompetenca u përket gjykatave me juridiksion të përgjithshëm (shih, vendimi nr.00-2018-667, datë 08.05.2018, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

10. Nga kjo analizë rezulton se kompetenca lëndore e gjykatave të specializuara, duke qenë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, është e lidhur gjithmonë me një fushë të posaçme mosmarrëveshjesh dhe si e tillë nuk mund të interpretohet në mënyrë të zgjeruar. Pra, nëse një mosmarrëveshje nuk ka karakteristikat e plota të atyre që përfshihen në grupin e mosmarrëveshjeve që gjykohen nga një gjykatë me kompetencë lëndore të veçantë, atëherë nuk do t'i përkasë kësaj të fundit, por me rend mbetës do të jetë lëndë shqyrtimi e gjykatave me kompetencë të përgjithshme (shih, vendimi nr.00-2018-667, datë 08.05.2018, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

11. Një nga kategoritë e mosmarrëveshjeve administrative që ligjvënësi e ka përjashtuar nga fusha e shqyrtimit të gjykatave administrative janë ato që burojnë nga e drejta e shtetasve për t'u regjistruar në listat e zgjedhësve, nëse ai nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, siç përcaktohet në nenin 57 të ligjit nr.10109, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

12. Në këtë dispozitë (neni 57, pika 1, të Kodit Zgjedhor) përcaktohet se: *"1. Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve".*

13. Sikurse me të drejtë ka vlerësuar Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë neni 57 i Kodit Zgjedhor është një dispozitë speciale (*lex specialis*) në raport me parashikimet e ligjit nr.49/2012, datë 03.05.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Edhe pse në pamje të parë kjo mosmarrëveshje vlerësohet se është administrative, është vetë ligji i posaçëm (neni 57 i Kodit Zgjedhor) i cili e ka përjashtuar nga sfera e kompetencës së gjykatave administrative.

14. Nga ana tjetër, ky Kod, në këtë parashikim të nenit 57 të tij, ka mbetur i pandryshuar edhe pas ndryshimeve që ka pësuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr.31/2015, datë 02.04.2015. Në këto kushte, ligjvënësi ka qenë i vetëdijshëm për përmbajtjen e ligjit për gjykatat administrative dhe nuk e ka reflektuar këtë gjë në ndryshimet që i ka bërë Kodit Zgjedhor.

15. Kompetenca lëndore e gjykatave administrative është përcaktuar në nenin 7 të ligjit nr.49/2012, datë 03.05.2012, "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", dhe çështje të kësaj natyre nuk rezulton të përfshihen ne asnjë prej rasteve të parashikuara në këtë dispozitë. Çështje me këtë objekt janë gjykime gracioze dhe për këtë shkak janë jashtë fushës së kompetencës së gjykatave administrative, të cilat, me përjashtim të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, shqyrtojnë vetëm çështje me palë kundërshtare. Në të njëjtën kohë, duke qenë një gjykatë me juridiksion të specializuar, gjykata administrative shqyrton vetëm ato lloj mosmarrëveshjesh që parashikohen në ligjin e saj të posaçëm.

16. Për çka u parashtrua më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se mosmarrëveshjet që lindin si pasojë kërkesës së shtetasve për t'u regjistruar në listën e zgjedhësve si dhe ato për korrigjimin e pasaktësive në përbërësin e tij zgjedhor, janë në kompetencë të gjykatave të rretheve gjyqësore. Për sa i përket gjykatës kompetente nga pikëpamja tokësore, duke qenë se kemi të bëjmë me një gjykim gracioz, atëherë do të zbatohen kriteret e parashikuara në nenin 388 të KPC-s, pra kompetente do të jetë gjykata e vendbanimit të kërkuesit.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-394-2020, datë 26.06.2020

Vendimi individual i shkarkimit nga detyra, marrë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë, si një masë disiplinore ndaj magjistratëve, ka natyrë administrative pavarësisht nëse kjo masë ka ardhur si pasojë e një vepre penale (nga ana e magjistratit).

Ankimet e magjistratëve ndaj masave disiplinore të dhëna nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë hyjnë në juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese.

Çdo e drejtë apo interes i ligjshëm që Kushtetuta ka parashikuar juridiksionin ekskluziv të Gjykatës Kushtetuese, është e papaditshme në juridiksionin gjyqësor të zakonshëm. Shkaqet absolute të shuarjes së gjykimit, sikurse janë juridiksioni, paditshmëria apo procedueshmëria, merren në shqyrtim nga gjykata kryesisht në çdo fazë dhe shkallë gjykimi.

Juridiksioni i organeve shtetërore kushtetuese nuk duhet të mbivendoset me juridiksionin e pushtetit gjyqësor. Në këtë kuptim, duke mos pasur juridiksion fillestar ndaj pushtetit gjyqësor, Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe Gjykata Kushtetuese nuk shqyrtojnë pasojat që rrjedhin nga kërkimet pasurore apo jo pasurore në lidhje me masën disiplinore ndaj magjistratit për të cilat juridiksionin fillestar dhe kompetencën lëndore e kanë Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse ka paraqitur një padi pranë Gjykatës Administrative të Apelit më datë 20.02.2019. Objekti i padisë në variantin fillestar të paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit ka qenë: "*1. Shfuqizimin e vendimit për shkarkimin nga detyra të prokurorit, T.D., 2. Kthimin në detyrën e mëparshme të Prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër. 3. Dhënien e pagës nga data 28.01.2019 e në vazhdim. 4. Dhënien e një shpërblimi të drejtë në shumën 30.000.000. 5. Konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit T.D.. 6. Anulimin pjesërisht të vendimit të*

Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë së anëtarëve [...] 7. Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018 për sa i përket konstituimit të Këshillit të Prokurorisë. 8. Pezullimin e vazhdimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor. 9. Pezullimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështje.".

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezulton se pala paditëse ka qenë i emëruar si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat. *[...]*

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me vendimin nr.88, datë 26.07.2018 ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin T.D. për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*", sipas nenit 319/ç të Kodit Penal (KP) dhe ka vendosur dënimin e tij me 3 vite burgim. *[...]*

4. Pas ankimit të ushtruar nga i pandehuri, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda me vendimin nr.89, datë 06.11.2018 ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit T.D. për kryerjen e veprës penale të mos kallëzimit të krimit, sipas nenit 300 të KP-s, dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Gjykata i ka dhënë dënim plotësues, duke ndaluar të pandehurin të kryejë funksione publike për 1 vit. Dënimi me burgim është pezulluar dhe i pandehuri është vënë në provë për 2 vjet.

5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pas marrjes së vendimit penal formë të prerë, me vendimin nr.22, datë 28.01.2019 ka vendosur shkarkimin e prokurorit T.D.. Duke mos qenë dakord me vendimin pala paditëse ka ushtruar të drejtën e padisë në gjykatë. Krahas padisë pala paditëse ka kërkuar edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të shkarkimit të marrë nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Gjatë gjykimit Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar shpalljen e moskompetencës së Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e akteve Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Kësaj kërkese i është bashkuar edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

6. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.229, datë 22.10.2019 ka vendosur:

"- *Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës së Apelit Administrativ për shqyrtimin e pikave 1, 2, 3 dhe 9, të objektit të kërkesë së paditësit, T.D., dhe dërgimin e akteve Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; - Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës së Apelit Administrativ, për shqyrtimin e pikave 4, 5, 6, 7 dhe 8 të objektit të kërkesëpadisë së paditësit, T.D., dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

7. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs të veçantë pala paditëse, z. T.D., me datë 07.11.2019. Rekursi rezulton të jetë komunikuar tek ndërgjyqësit dhe nuk ka kundërrekurs të paraqitur.

8. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.219 akti, datë 17.12.2019 ka vendosur: "*Mospranimin e rekursit të paditësit, T.D., kundër Vendimit nr.229, datë 22.10.2019 të Gjykatës së Apelit Administrativ*." Gjykata Administrative e Apelit ka mbështetur vendimin në nenin 13, pika 3, të ligjit nr.49/2012 dhe ka konkluduar se ndaj disponimeve të gjykatës administrative për kompetencën nuk lejohet ankim i veçantë.

9. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.5809/1173 (31155-07502-80-2019), datë 09.03.2020 ka vendosur: "*- Të ngrejë përpara Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore dhe funksionale në lidhje me gjykimin e çështjes nr. 5809/1173 (31155-07502-80-2019) regj. them., datë ardhje 19.12.2019 me palë ndërgjyqëse: palë paditëse, T.D., palë e paditur, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm. – T'i kërkojë Gjykatës së Lartë që të vendosë se kompetente nga pikëpamja funksionale për gjykimin e kërkimeve "Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë së anëtarëve [...]. Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018 për sa i përket konstituimit të Këshillit të Prokurorisë. Pezullimin e vazhdimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor*", është gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe jo Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. – T'i kërkojë Gjykatës së Lartë që të vendosë se kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e kërkimeve: "Dhënien e një shpërblimi të drejtë në shumën 30.000.000 Lekë;

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë dhe vendimet e gjykatave në mosmarrëveshje për kompetencën lëndore, gjithashtu edhe rekursin e veçantë të paraqitur nga pala paditëse në këtë çështje, konkludon se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore, parashtresa është pjesërisht e bazuar në ligj dhe se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është pjesërisht i bazuar në Kushtetutë dhe në ligj. Nga ana tjetër Kolegji vlerëson se ka vend për të ndërhyrë

edhe në mënyrën se si ka arsyetuar Gjykata Administrative e Apelit mbi deklarimin e mungesës së kompetencës funksionale dhe dërgimin e çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese.

11. Fillimisht, Kolegji vlerëson të nevojshme që të ndajë, sikurse edhe Gjykata Administrative e Apelit, konsideratat lidhur me natyrën juridike të vendimit individual të shkarkimit gjyqtarëve apo prokurorëve nga detyra të marrë respektivisht nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kolegji vlerëson se ky akt administrativ individual, si në rastet kur jepet si pasojë e një fakti që nuk përbën vepër penale dhe kur jepet si pasojë e një fakti që përbën vepër penale (shih, nenin 148/2/b të Kushtetutës), përfaqëson në vetvete një masë disiplinore ndaj magjistratëve. Sipas neneve 105 dhe 111, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në çdo rast shkarkimi nga detyra e gjyqtarëve apo e prokurorëve bëhet me akt administrativ individual të secilit prej këshillave dhe se ky akt është artikulimi i një mase disiplinore ndaj magjistratëve, konkretisht i masës disiplinore më të rëndë. Për rrjedhojë, për efektet juridike të përcaktimit të juridiksionit dhe kompetencës së institucionit që gjykon ankimet kundër këtyre vendimeve, qoftë Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe qoftë Gjykata Kushtetuese, nuk ka relevancë juridike nëse masa disiplinore e shkarkimit nga detyra ka ardhur si pasojë e një krimi apo jo.

12. Kolegji sjell në vëmendje se për sa i përket pikave 1, 2, 3 dhe 9, të objektit të padisë së paraqitur fillimisht nga pala paditëse, z. T.D., padia nuk mund të ngrihet në gjykatat e pushtetit gjyqësor dhe se për rrjedhojë, në bazë dhe për zbatim të nenit 39 të ligjit nr.49/2012, Gjykata Administrative e Apelit duhet të kishte vendosur mospranimin e padisë pasi mungon një ndër prezumimet absolute për vlefshmërinë e procesit gjyqësor, konkretisht paditshmëria e së drejtës subjektive apo e interesit të ligjshëm. Kolegji sjell në vëmendje se neni 39 i ligjit nr.49/2012, në pjesën relevante parashikon se: "*1. Gjykata administrative jep vendime jopërfundimtare vetëm në rastin e mospranimit të padisë dhe të pushimit të gjykimit. 2. Gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave.*"

13. Kjo normë është simotra e nenit 299, shkronja "c", të KPC-s dhe një ndër shkaqet e posaçme të vendimmarrjes jopërfundimtare të gjykatës sipas nenit 127 të këtij kodi. Kjo do të thotë se sa herë gjykata administrative konkludon se padia nuk mund të ngrihej apo se gjykimi nuk mund të vazhdojë duhet të vendosë menjëherë mospranimin e padisë apo pushimin e gjykimit, sipas modaliteteve të nenit 39 të ligjit nr.49/2012.

14. Në rastin konkret pala paditëse ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e tij nga detyra si prokuror, kthimin e tij në detyrën e mëparshme, dhënien e pagës deri në kthimin e tij në detyrë dhe pezullimin e aktit të shkarkimit nga detyra deri në përfundimin e çështjes. Kolegji ndan të njëjtën pikëpamje me Gjykatën Administrative të Apelit mbi kualifikimin e këtij fakti juridik objekt mosmarrëveshjen, sipas nenit 17, pika 2, të ligjit për gjykimin administrativ. Në këtë rast jemi para një vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ka marrë një masë disiplinore ndaj një prokurori dhe se kërkimet e paditësit për këtë pjesë lidhen pikërisht me themelin e ligjshmërisë së masës disiplinore të shkarkimit të prokurorit.

15. Kolegji sjell në vëmendje nenin 179, pika 7, të Kushtetutës, dispozitë e cila parashikon se:

"*7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*". I njëjti parashikim kushtetues është detajuar edhe në nenin 5, pika 3, të ligjit nr.84/2016 "*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*". Në këtë dispozitë ndër të tjera parashikohet se: "*Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë:...b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*".

Sipas këtij parashikimi të Kushtetutës, Kolegji konkludon se, nga momenti i konstituimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese e deri në mbarimin e afatit 9-vjeçar të mandatit të gjyqtarëve për të gjitha masat disiplinore të dhëna nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë ankimet e gjyqtarëve dhe të prokurorëve hyjnë në juridiksionin e këtij institucioni. Kolegji sjell në vëmendje se, vendimi nr.22, datë 28.01.2019 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin nga detyra të palës paditëse është marrë pas momentit të konstituimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe gjatë ushtrimit të mandatit 9 vjeçar të tij.

16. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon pretendimet e palës paditëse në rekurs që si moment i përcaktimit të juridiksionit gjyqësor të merret data e vendimmarrjes së Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin e paditësit nga detyra është i pabazuar në ligj. Nuk është ky momenti i përcaktimit të juridiksionit të autoritetit shtetëror për shqyrtimin e një çështje. Momenti i përcaktimit të juridiksionit të një autoriteti shtetëror është momenti kur paraqitet kërkesa apo padia dhe se faktet e mëparshme apo të mëpasshme nuk afektojnë çështjen e juridiksionit apo kompetencës, sipas nenit 36 dhe 41, të KPC-s apo nenit 23 të Kodt të Procedurave Administrative (KPA)-s.

17. Njëlloj janë të pabazuara në Kushtetutë dhe në ligj pretendimet e rekursit dhe konkluzionet e parashtresës për kompetencë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për zbatimin në këtë rast të nenit 192, pika 1, të ligjit nr.115/2016. Kjo dispozitë nuk mund të gjejë zbatim për rastet që rregullohen në pikën 7, të nenit 179, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 3, të ligjit nr.84/2016. Aktet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për marrjen e masave disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët është e vërtetë që janë akte administrative individuale, por se juridiksion për shqyrtimin e tyre ka Kolegji i Posaçëm i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese gjatë mandatit 9vjeçar dhe pas këtij mandati juridiksion do të ketë Gjykata Kushtetuese. Për rrjedhojë, neni 192 i ligjit nr.115/2016 do të jetë i zbatueshëm për të përcaktuar juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit për aktet individuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë të ndryshme nga aktet administrative që artikulojnë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

18. Nga ana tjetër, Kolegji gjen të pabazuar në Kushtetutë dhe në ligj konkluzionin e arritur nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit se nuk ka kompetencë funksionale për shqyrtimin e kësaj pjese të kërkimeve të padisë dhe për pjesën që ka disponuar për dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Gjykatat duhet të kenë parasysh në vendimmarrjet e tyre mbi juridiksionin, sipas nenit 59 të KPC-s dhe nenit 9 të ligjit nr.49/2012, dhe mbi kompetencën, sipas nenit 61 të KPC-s dhe nenit 13 të ligjit nr.49/2012, se ato nuk mund të përcaktojnë juridiksionin dhe kompetencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit apo Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të lejonte palët të ushtrojnë rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë dhe se edhe vetë Gjykata e Lartë nuk mund të përcaktojë juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit apo Gjykatës Kushtetuese. I vetmi mekanizëm që aktivizon juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet vendimmarrjes së gjykatave të pushtetit gjyqësor është kontrolli incidental kushtetues sipas nenit 145, pika 2, të

Kushtetutës, konkretisht vendimmarrja e ndërmjetme e gjyqtarit *a quo* për nisjen e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së ligjit.

19. Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje të gjykatave edhe jurisprudencën e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë[27] apo të Gjykatës Kushtetuese[28] mbi këtë çështje. Kolegji sjell në vëmendje të gjykatave se dispozitat ligjore të sjella në vëmendje më lart vlejnë vetëm kur diskutohet juridiksioni gjyqësor kundër juridiksionit administrativ apo kompetenca ndërmjet gjykatave të pushtetit gjyqësor. Këto dispozita nuk mund të zbatohen për të vënë në lëvizje Kolegjin e Posaçëm të Apelimit apo Gjykatën Kushtetuese. Vendimmarrje të tilla të gjykatave përbëjnë disponime që vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin.

20. Kolegji sjell në vëmendje se pala paditëse në këtë rast, për pikat 1, 2, 3 dhe 9, të objektit të padisë ka ushtruar padi mbi akte administrative ndaj të cilave Kushtetuta dhe ligji ka krijuar një mjet ekskluziv dhe të posaçëm juridik ankimi, konkretisht kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. Kjo do të thotë se për çdo të drejtë apo interes të ligjshëm të çështjeve që Kushtetuta në nenet 131 dhe 134 të saj, ka krijuar këtë mjet juridik, këto çështje hyjnë në juridiksionin ekskluziv të Gjykatës Kushtetuese dhe se si të tilla përjashtojnë mundësinë e aktivizimit të juridiksionit gjyqësor pasi të drejta të tilla apo interesa të tillë të ligjshëm janë të papaditshëm. Po të pranohet e kundërta atëherë do të mbivendosej juridiksioni i pushtetit gjyqësor me juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit apo Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se në këtë rast pala paditëse ka ushtruar padi ndaj një

---

[27] Shih, Vendimi nr.31001-02550-00-2010 i Regj. Themeltar, nr.00-2010-1351 i Vendimit (436), datë 02.12.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në këtë vendim ndër të tjera arsyetohet se: "*Sipas nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile gjykata, "kur konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes, kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente". Në kuptim të kësaj dispozite gjykata, pasi konstaton moskompetencën e saj lëndore apo tokësore, është e detyruar të shprehet edhe për gjykatën së cilës i dërgon aktet për zhvillimin e gjykimit. Kjo dispozitë përmban një rregullim procedural të zbatueshëm nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Rasti në shqyrtim nuk është i tillë dhe nuk ka të bëjë me kompetencën lëndore të ndonjë gjykate tjetër brenda sistemit të gjykatave të zakonshme. Po kështu, në zbatim korrekt të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", gjykata e shkallës së parë nuk mund t'i dërgojë çështjen për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, me arsyetimin se i mungon kompetenca lëndore për shqyrtimin e saj.*".

[28] Shih, Vendimi nr.39, datë 12.03.2013 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe në Vendimin nr.2, datë 14.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

akti administrativ ndaj të cilit Kushtetuta dhe ligji nuk ka lejuar të ushtrohet padi, por ka përcaktuar se ndaj tyre ushtrohet ankim/kërkesë në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe/apo Gjykatën Kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se në këtë rast jemi para një akti administrativ të papaditshëm dhe se për rrjedhojë padia nuk mund të ngrihej dhe se Gjykata Administrative e Apelit, duhet të vendoste, në bazë dhe për zbatim të nenieve 127 dhe 299, shkronja "c", të KPC-s dhe nenit 39 të ligjit nr.49/2012, mospranimin e padisë. Në kushtet kur Gjykata Administrative e Apelit ka ometuar nga detyra kushtetuese dhe ligjore për të marrë vendimin jopërfundimtar lidhur me këto kërkime të padisë, Kolegji vlerëson se kjo vendimmarrje duhet të merret nga ana e Gjykatës së Lartë në këtë gjykim. Kolegji vlerëson se shkaqet absolute të shuarjes së gjykimit, sikurse janë juridiksioni, paditshmëria apo procedueshmëria, merren në shqyrtim nga gjykata kryesisht në çdo fazë dhe shkallë gjykimi. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit për këtë pjesë duhet të prishet dhe çështja duhet të pushohet si padi që nuk mund të ngrihet.

21. Nga ana tjetër Kolegji e gjen haptazi të pabazuar në nenin 7, 13 dhe 17, të ligjit nr.49/2012 arsyetimin e bërë në parashtresë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Fillimisht kjo gjykatë arsyeton se edhe pasojat që rrjedhin nga kërkimet pasurore apo jopasurore të masës disiplinore të shkarkimit janë të lidhura drejtpërdrejt me të dhe për rrjedhojë, kompetent për shqyrtimin e tyre është Kolegji i Posaçëm i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese. Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe Gjykata Kushtetuese nuk janë gjykata me juridiksion fillestar të pushtetit gjyqësor. Përkundrazi, ato janë organe shtetërore kushtetuese për të cilat juridiksioni është i përcaktuar në mënyrë shteruese në Kushtetutë dhe se në asnjë rast juridiksioni i tyre nuk duhet të mbivendoset me juridiksionin e pushtetit gjyqësor. Për rrjedhojë, nuk mund të veprojë instituti i atribuimit të kompetencës apo juridiksionit për shkak të koneksitetit sikurse parashikohet në nenet 55, 57 dhe 159, të KPC-s në rastet e çështjeve të ngjashme që sipas Kushtetutës apo ligjit u janë atribuuar juridiksioneve të ndryshme. Në këtë kuptim, Kolegji konkludon se, edhe kërkimi i padisë për konstatimin e diskriminimit dhe kërkimi i padisë për dëmshpërblimin kundrejt Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë kërkime që aktivizojnë, sipas nenit 7 dhe 17, të ligjit nr.49/2012, juridiksionin fillestar dhe kompetencën lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata e hkallës së parë nuk duhet të ngatërrojë premisat juridike të zbatimit të institutit procedural të pezullimit të gjykimit me premisat juridike të zbatimit të institutit procedural të atribuimit të kompetencës së gjykatës për shkak të koneksitetit të çështjeve.

22. Kolegji vlerëson se nga parashtresa tjetër e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë për mosmarrëveshjen e kompetencës, për sa i përket disponimit të Gjykatës Administrative të Apelit për shpalljen e mungesës së kompetencës funksionale për shqyrtimin e dy kërkimeve të anulimit të vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe masës së sigurimit të padisë që lidhet me to, është e bazuar në ligj dhe për këtë pjesë ka vend që vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit të prishet pjesërisht dhe që çështja të dërgohet në këtë gjykatë për vazhdimin e gjykimit. Kolegji vlerëson të nevojshme të sjellë në vëmendje rregullimin e nenit 192 të ligjit nr.115/2016. Kjo dispozitë, nën titullin "*Ankimi i vendimeve të Këshillit*", parashikon se: "*1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. 2. Aktet administrative me efekt të përgjithshëm detyrues i nënshtrohen kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe kontrollit të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me ligjin.*".

23. Në rastin konkret në padi ndër të tjera është kërkuar: "*Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë së anëtarëve [...]. Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018 për sa i përket konstituimit të Këshillit të Prokurorisë. Pezullimin e vazhdimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor.*".

Kolegji konkludon se dy kërkimet e para si më lart kundrejtohen ndaj akteve administrative individuale të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Edhe masa e sigurimit të padisë e parashtruar më lart ka lidhje funksionale pikërisht me këto dy kërkime. Si të tilla, në bazë dhe për zbatim të pikës 1, të nenit 192, të ligjit nr.115/2016, janë në kompetencën funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit në këtë pjesë është i pabazuar në ligj dhe duhet të prishet duke u dërguar çështja në këtë gjykatë dhe para të njëjtit trup gjykues për shqyrtimin e çështjes.

24. Së fundmi, Kolegji vlerëson se rekursi i palës paditëse ka shkaqe ligjore papranueshmërie për gjykim dhe se Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj kur ka marrë në shqyrtim rekursin e drejtpërdrejtë të palës paditëse dhe pas shqyrtimit ka vendosur mospranimin e këtij ankimi. Neni 13 i ligjit nr.49/2012 ka parashikuar ndër

të tjera se: "*3. Gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe vendimi për rrëzimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar.*".

Në këtë rast Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur në të dy disponimet e saj mungesën e kompetencës funksionale dhe se për rrjedhojë, pala paditëse nuk ka pasur të drejtën e ankimit të veçantë sipas ligjit. Kolegji vlerëson se funksionimi i filtrit paraprak të shqyrtimit të pranueshmërisë së ankimit nga gjykatat më të ulëta duhet të jetë efektiv dhe se nuk mund të anashkalohet. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit në këtë rast është i bazuar në ligj dhe nuk mund të cenohet.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-265, datë 01.07.2020

Shterimi paraprak i ankimit administrativ nuk është i detyrueshëm por alternativ.

Punonjësi i policisë i liruar nga radhët e saj në mënyrë të paligjshme ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës me padi edhe drejtpërdrejt. Ligjshmëria e lirimit nga detyra duhet të provohet nga institucioni dhe deri në rikthimin e tij në detyrë, punonjësi duhet të trajtohet në përputhje me gradën që mbante dhe pagën që ka pasur në momentin e largimit.

Gjykata e Lartë nuk ka në juridiksion provueshmërinë e fakteve të shqyrtuara nga gjykatat më të ulëta.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi ka qenë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, në detyrën Shef i Komisariatit të Policisë Përmet, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastër, me gradën "K/Komisar".

2. Me urdhrin nr.685/3, datë 31.12.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësi është liruar nga detyra me motivacionin "*Për ndryshim të strukturës organizative të policisë dhe në pamundësi emërimi në detyrë tjetër*".

3. Njëherësh, nëpërmjet këtij akti, rezulton të jetë urdhëruar ndërprerja e marrëdhënieve financiare më datë 01.12.2013 dhe trajtimi i paditësit në vijim në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10142, datë 15.05.2009.

4. Duke mos qenë dakord me sa më sipër, paditësi e ka bërë çështjen konflikt gjyqësor sipas objektit të pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke paraqitur padi përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, më datë 04.02.2014.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr.105, datë 11.03.2014, ka vendosur: *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e anës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i paguajë paditësit A.J. 12 paga mujore si dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar rrjedhojë e lirimit të paligjshëm nga Policia e Shtetit. Llogaritja e shpërblimeve të mësipërme të bëhet në bazë të pagës që paditësi ka pasur në fund të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Rrëzimin e kërkesëpadisë*

për pjesën tjetër të objektit të saj.[...] Për sa i përket kërkimit për rikthimin në detyrë, një e drejtë e tillë nuk gjen mbrojtje në ligj, referuar Vendimit Njësues nr.2003/31, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Kundër vendimit nr.105, datë 11.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ka paraqitur ankim pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e plotë të padisë.

7. Kundër vendimit nr.105, datë 11.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ka paraqitur ankim pala e paditur, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar si shkaqe të ankimit ligjshmërinë e aktit administrativ për lirimin e paditësit nga detyra dhe mos shterimin prej tij të ankimit administrativ.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.3986, datë 29.10.2014, ka vendosur: *"- Ndryshimin e vendimit nr.105, datë 11.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. [...]* 8.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë, në thelb, ka mbajtur arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, por duke vlerësuar ndryshe pasojat që vijnë nga një interpretim i tillë. Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa ka konstatuar paligjshmërinë e largimit të paditësit nga detyra, ka arritur në përfundimin se neni 3/1 i ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", parashikon zbatimin e tij edhe për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe, si rrjedhojë, paditësi gëzon të drejtën e rikthimit në punë. *[...].*

9. Kundër vendimit nr.3986, datë 29.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi, si dhe të vendimit nr.105, datë 11.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe rrëzimin e padisë, *[...].*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

a) Në lidhje me ligjin e zbatueshëm

10. Për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural, nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin nr.3986, datë 29.10.2014, dhe deri në kohën e shqyrtimit të rekursit të palës së paditur kundër këtij vendimi, Kolegji Administrativ e vlerëson të nevojshme kryerjen e një analize mbi ligjin e zbatueshëm, të cilit do të duhet t'i referohet për të zgjidhur mosmarrëveshjen administrative, në rastin në shqyrtim. [...].

b) Në lidhje me themelin e çështjes

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr.3986, datë 29.10.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit, është marrë

në interpretim të saktë të ligjit material dhe është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor. Për këtë shkak ky vendim do të lihet në fuqi.

18. Ky Kolegj, nisur edhe nga paqartësitë që kanë ekzistuar në praktikën gjyqësore lidhur me pasojat e konstatimit të paligjshmërisë së aktit administrativ me të cilin një punonjës policie është larguar nga detyra, çmon të nevojshme që fillimisht të bëjë një parashtrim të legjislacionit të kësaj fushe në planin historik dhe, në të njëjtën kohë, të interpretojë atë në frymën e Kushtetutës si dhe në harmoni me ligjet e tjera që rregullojnë marrëdhëniet e punësimit në administratën publike.

19. Në nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet e drejta e individëve për t'u dëmshpërblyer nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve shtetërore. Kjo dispozitë, ndërsa nga njëra anë përcakton përgjegjësinë e organeve shtetërore për veprimet ose mosveprimet e tyre në raport me individët, nga ana tjetër përmban një rezervë ligjore lidhur me mënyrën se si do të realizohet ky dëmshpërblim. Në këtë kuadër, është ligji ai i cili përcakton nëse zhdëmtimi dhe/ose rehabilitimi do të jetë i plotë apo i pjesshëm.

20. Legjislacioni që rregullon fusha të ndryshme të përgjegjësisë jashtëkontraktore të organeve shtetërore sipas rastit përcakton një dëmshpërblim të plotë të dëmit që rrjedh nga veprimi ose mosveprimi i paligjshëm i këtyre organeve (*restitutio in integrum*) ose një dëmshpërblim të pjesshëm (*restitutio in partem*). Si rregull, çdo dëm i shkaktuar nga një veprim ose mosveprim i paligjshëm duhet të shpërblehet në atë formë që ta rikthejë situatën në gjendjen që ishte përpara shkaktimit të tij, për aq sa kjo është e mundur. Kjo rrjedh nga parimi i gjykimit të drejtë, në kuptimin e tij më të plotë, substancial, si element i procesit të rregullt ligjor, sikurse sanksionohet në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, në situata të caktuara, kur rivendosja e plotë e të drejtave është e pamundur, në shkencën e jurisprudencës njihet edhe instituti i shpërblimit apo rivendosjes së pjesshme të të drejtave të cenuara. Kjo mund të justifikohet me mbrojtjen e interesit publik (mbrojtja e buxhetit të shtetit, mbrojtja e sigurisë kombëtare, etj.,.) në rastin kur shkaktuesi i dëmit është një organ shtetëror ose me mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, në rastin e një personi privat. Gjithsesi, një kufizim i të drejtës për t'u zhdëmtuar dhe/ose rehabilituar plotësisht mund të bëhet vetëm bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës dhe, çka është më e rëndësishmja, duke respektuar parimin e proporcionalitetit.

21. Për sa i përket fushës së marrëdhënieve të punësimit në sektorin publik, raporte të ndryshme punësimi parashikojnë rregullim të ndryshëm të situatës lidhur me largimin e paligjshëm nga puna të një punonjësi. Në

disa raste, sikurse është p.sh., nëpunësi civil, gjyqtari, prokurori, etj., ligji i posaçëm parashikon një rivendosje të plotë të të drejtave kur konstatohet largimi i paligjshëm nga detyra, që nënkupton rikthim në detyrë dhe pagimin e pagës që nga momenti i largimit nga puna, duke konsideruar sikur ky largim të mos kishte ndodhur. Në raste të tjera, ligji i posaçëm parashikon vetëm një rivendosje të pjesshme të këtyre të drejtave e konsiston në përfitimin e një dëmshpërblimi.

22. Çështja e rivendosjes së të drejtave të një punonjësi në administratën publike ka qenë, në disa raste, objekt i rregullimit edhe nga jurisprudenca njësuese e Gjykatës së Lartë. Kështu, në vendimin nr.31, datë 14.04.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me marrëdhëniet e punës së punonjësve të Policisë së Shtetit, është njësuar praktika gjyqësore, duke u sanksionuar se: *"... me anë të ankimit në gjykatë punonjësi i policisë, ashtu si dhe një numër tjetër punonjësish publikë që kanë detyra të caktuara shërbimi ndaj shtetit, për shkak të të cilave veprojnë si përfaqësues të shtetit për mbrojtjen e interesave të tij, nuk mund të realizojnë gjyqësisht rikthimin në detyrën që kanë pasur, edhe në qoftë se provohet se janë larguar prej saj pa shkaqe të përligjura....*

E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje. Pala që dëmtohet nga një pushim i padrejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore.".

23. Nga ana tjetër, në vendimin nr.7, datë 01.06.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është njësuar praktika gjyqësore për sa i përket interpretimit të neneve 146/3 dhe 155/3, të Kodit të Punës, lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes në administratën publike që rrjedh nga zgjidhja e kontratës së punës, kur raportet e punësimit rregullohen nga Kodi i Punës, duke u shprehur se: "*Në rast të zgjidhjes së kontratës së punës, pavarësisht se organi administrativ për rastet e administratës publike shprehet me një akt të marrë nga drejtuesi i organit, kjo nuk do të thotë që jemi përpara marrëdhënieve administrative, pra shprehjes së vullnetit të organit në kuptim të marrëdhënieve administrative, por jemi përpara shprehjes së vullnetit të punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës. Pra, me këtë do të kuptojmë se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe jo më me një marrëdhënie administrative. Pra, punëmarrësi nuk mund të ngrejë padi për goditjen e aktit administrativ, por mund të ngrejë padi për kërkimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës.*".

24. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vëren se legjislacioni përkatës që rregullon marrëdhëniet e punës në Policinë e Shtetit ka pësuar

disa herë ndryshime, jo vetëm në aspektin formal (duke u miratuar disa ligje në këtë fushë, ku secili ka shfuqizuar të mëparshmin), por edhe në drejtim të standardeve të rekrutimit, karrierës dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës në këtë sektor.

25. Fillimisht, trajtimi në mënyrë integrale i marrëdhënieve të punësimit në Policinë e Shtetit, është bërë me ligjin nr.8553, datë 25.11.1999, "*Për Policinë e Shtetit*". Ky ligj rezulton të jetë shfuqizuar me ligjin nr.9749, datë 04.06.2007, "*Për Policinë e Shtetit*", i cili është edhe ligji i zbatueshëm për çështjen në shqyrtim, referuar momentit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës së paditësit pranë palës së paditur, datë 31.12.2013. Së fundi, ligji i sipërcituar është shfuqizuar me ligjin nr.108/2014, datë 31.07.2014, "*Për Policinë e Shtetit*".

26. Nga krahasimi i përmbajtjes së ligjit nr.8553, datë 25.11.1999, "*Për Policinë e Shtetit*" me ligjin nr.9749, datë 04.06.2007, "*Për Policinë e Shtetit*", lidhur me përfundimin e marrëdhënieve të punësimit pranë këtij institucioni, rezulton se ato kanë përmbajtje të ngjashme. Në të dy këto ligje parashikohet largimi/lirimi nga Policia e Shtetit si dhe e drejta për të bërë ankim në gjykatë ndaj një vendimi të tillë (neni 20/3 i ligjit nr.8553, datë 25.11.1999, si dhe neni 78 i ligjit nr.9749, datë 04.06.2007). Megjithatë, në asnjërin prej këtyre akteve nuk parashikohet pasoja e vendimmarrjes së gjykatës që konstaton paligjshmërinë e një vendimmarrjeje të tillë nga ana e autoritetit kompetent. Është për këtë shkak që qëndrimet e ndryshme në praktikën gjyqësore lidhur me pasojën e konstatimit të paligjshmërisë së përfundimit të marrëdhënieve të punës në Policinë e Shtetit u njësuan me Vendimin nr.31, datë 14.04.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke mos u njohur e drejta e rikthimit në detyrë, por vetëm e drejta për dëmshpërblim. I njëjti qëndrim vazhdoi të mbahej nga praktika gjyqësore, edhe me miratimin e ligjit nr.9749, datë 04.06.2007, "*Për Policinë e Shtetit*", duke qenë se trajtimi i problematikës së largimit të një punonjësi të Policisë së Shtetit ishte pothuaj i njëjtë dhe duke vazhduar sakaq zbatimi i këtij vendimi njësues për analogji.

27. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se një qëndrim i tillë i jurisprudencës gjyqësore, si dhe fakti se pasojat e largimit të kundërligjshëm të një punonjësi policie nga detyra nuk ishin rregulluar ndonjëherë në mënyrë shteruese, e çuan ligjvënësin që, në miratimin e ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*", të përfshinte në sferën e rregullimit të tij edhe punonjësit e Policisë së Shtetit.

28. Në nenin 3 të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*", të titulluar "*raste të veçanta*", përcaktohet se: "*1. Punonjësi i policisë dhe punonjësi i shërbimit të jashtëm është nëpunës civil, ndaj të cilëve*

zbatohet ky ligj, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm. 2. Mund të rregullohen me ligj të posaçëm elementë të marrëdhënieve të shërbimit civil, në: a) shërbimin e jashtëm; b) strukturat që, sipas ligjit, lejohen të mbajnë armë. 3. Ligji i posaçëm, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të rregullojë: a) kushte shtesë për rekrutimin; b) të drejta ose detyrime specifike të tjera nga ato të parashikuara nga ky ligj; c) pozicione të posaçme; ç) rregulla të posaçme për zhvillimin e karrierës, sipas sistemit të gradave.".

29. Nga përmbajtja e kësaj dispozite shohim se statusi dhe të gjitha garancitë që parashikohen për nëpunësit civilë janë të zbatueshme edhe për punonjësin e Policisë së Shtetit, për aq sa ligji i posaçëm që trajton marrëdhëniet e punësimit në këtë sektor (ligji nr.9749, datë 04.06.2007, "*Për Policinë e Shtetit*", referuar kohës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*" dhe kohës së lindjes së mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi) nuk parashikon ndryshe. Pikërisht, një ndër aspektet që ligji i posaçëm nuk kishte arritur asnjëherë të rregullonte në mënyrë të veçantë, ishte pasoja e shfuqizimit për shkak të paligjshmërisë së vendimit për largimin e një punonjësi policie nga detyra (përjashtim ose lirim në varësi të shkakut të përfundimit të marrëdhënieve të punës). Një fakt i tillë përmendet edhe në Vendimin Njësues nr.31, datë 14.04.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u theksuar se: "*Në këto raste e drejta e rikthimit në punë nuk konsiderohet një e drejtë themelore, në kuptimin që u jep të drejtave të tilla Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, mbrojtja gjyqësore e të cilave është e garantuar. Sidoqoftë, ligjvënësi nuk ka pengese që të miratojë një ligj për t`i dhëne mbrojtje gjyqësore edhe kësaj të drejte. Megjithatë, deri më sot, nuk e ka çmuar të sigurojë e të garantojë një mbrojtje të tillë.*". Kjo gjë u realizua pikërisht me ligjin nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*", që, siç u theksua, zbatohet edhe për punonjësit e policisë dhe garanton rikthimin në detyrë në rastin e largimit të padrejtë.

30. Ky Kolegj thekson se, qëndrimi i mbajtur në disa raste, për mosrikthimin në detyrën e mëparshme të punonjësit të policisë së larguar nga detyra në kundërshtim me ligjin, edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*", përbën një interpretim jo të saktë të legjislacionit të fushës (ligjit nr.9749, datë 04.06.2007, "*Për Policinë e Shtetit*", i parë në harmoni me ligjin nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*"). Fakti që ligji nr.9749, datë 04.06.2007, "*Për Policinë e Shtetit*", nuk e ka rregulluar në mënyrë specifike çështjen e zgjidhjes së pasojave të largimit në kundërshtim me ligjin të punonjësit të Policisë së Shtetit, nuk do të thotë se ky ligj e ka përjashtuar rikthimin në

detyrën e mëparshme të punonjësit në fjalë. Në këtë drejtim Kolegji çmon të nevojshme të japë disa konsiderata në lidhje me interpretimin korrekt të ligjit nga ana e gjykatave në rastet kur ky ligj hesht për një rregullim të caktuar (ometon).

31. Ometimi legjislativ është një situatë ku ligji nuk e rregullon në mënyrë të plotë marrëdhënien apo fushën përkatëse (ometimi relativ) ose nuk e rregullon fare atë (ometimi absolut). Detyra e gjyqtarit, në çdo rast që ndeshet me fenomenin e ometimit legjislativ, është që të japë zgjidhjen, kushtetutshmërisht më të pranueshme. Megjithatë, ai nuk duhet të kalojë kufijtë e juridiksionit që i përcakton Kushtetuta, duke marrë atributet e ligjvënësit pozitiv. Kjo gjë mund të ndodhë vetëm në rastin kur çdo zgjidhje tjetër nga pikëpamja kushtetuese nuk do të ishte e pranueshme.

32. Rendi juridik përbën një sistem harmonik normash dhe, për këtë arsye, gjyqtari duhet që, në zbatimin e tyre, të priret nga dhënia kuptim e tyre dhe jo e kundërta, lënia e pazbatueshme. Kushtetua i njeh ligjvënësit një marzh të gjerë vlerësimi në përcaktimin e zgjidhjes më oportune për rregullimin e raporteve juridike. Ligjvënësi në disa raste mund të zgjedhë të heshtë lidhur me rregullimin e detajuar të një raporti të tillë. Është detyra e gjyqtarit të zbulojë qëllimin e vërtetë të ligjvënësit (*ratio legis*), duke përdorur metodat e ndryshme të interpretimit. Gjithsesi ai nuk mund të tejkalojë këtë qëllim të tij dhe të dalë kundër një përfundimi që rezulton nga përdorimi i formave të njohura të interpretimit të ligjit.

33. Interpretimi i një norme fillon nga leximi literal i saj, pra nga kuptimi që rezulton si pasojë e ndjekjes së rregullave gramatikore. Nëse një interpretim i tillë është i pamjaftueshëm apo çon në një përfundim antikushtetues, atëherë gjyqtari u referohet metodave të tjera të interpretimit si ai sistematik, historik, teleologjik, etj.,. Një nga rregullat (kanonet) e para të interpretimit është se ometimi shpreh një mungesë vullneti nga ana e ligjvënësit për ta rregulluar një raport juridik në një mënyrë të caktuar (*casus omissus pro omisso habendus est*). Nëse një përfundim i tillë mund t'i japë zgjidhje situatës në mënyrë të arsyeshme (kushtetuese) atëherë kjo konsiderohet si zgjidhja e ligjvënësit, që të mos e parashikojë një rregullim të caktuar, por nëse ky përfundim është i paaftë për ta zgjidhur këtë situatë, atëherë gjyqtari, në zbatim të parimit të dhënies së drejtësisë, siç përcaktohet edhe në nenin 1, paragrafi i dytë, i KPC-s, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet që ometimin ta zëvendësojë me interpretimin e tij.

34. Referuar çështjes në gjykim, rezulton se ligji nr.9749, datë 04.06.2007, "*Për Policinë e Shtetit*", nuk e parashikon mënyrën e zgjidhjes së pasojave të largimit nga detyra të punonjësit të policisë. Atëherë përpara gjykatës shtrohet për shqyrtim dilema nëse ndaj këtij punonjësi do të kemi

një rivendosje të plotë të të drejtave, në rast të shfuqizimit të vendimit të largimit, duke e rikthyer në detyrë dhe duke i paguar pagat nga momenti i largimit (*restitutio in integrum*) apo do të kemi një rivendosje të pjesshme, duke i dhënë vetëm dëmshpërblimet përkatëse (*restitutio in partem*). Arritja e përfundimit *a priori* se mosparashikimi në ligj i të drejtës së rikthimit në detyrën e mëparshme shpreh vullnetin e ligjvënësit për të mos ta njohur këtë të drejtë është i gabuar pasi, në të njëjtën kohë, ligjvënësi nuk parashikon as të drejtën e dëmshpërblimit në këtë ligj. Ligji i posaçëm, duke mos parashikuar asnjë prej të dy zgjidhjeve të mundshme, do ta çojë gjyqtarin në referimin në ligje të tjera, pasi në të kundërt ai nuk do të ishte i aftë për të marrë një vendim për një çështje konkrete, gjë që nuk pajtohet me detyrimin që i buron atij nga rendi juridik.

35. Në Vendimin Njësues nr.31, datë 14.04.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, referimi u bë në Kodin e Punës, si ligji kuadër që rregullon disa aspekte të marrëdhënieve të punësimit, për aq sa ato nuk disiplinohen ndryshe në ligje të posaçme. Kjo parashikohet edhe në nenin 4 të këtij Kodi. Një referim i tillë tek ligji i përgjithshëm është bërë në mungesë të një referimi më të posaçëm. Megjithatë, në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se rregullimi pasojave të largimit nga detyra të punonjësit të policisë bëhet në një ligj të posaçëm, i cili është ligji nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*", siç përcaktohet në nenin 3 të tij. Në këtë aspekt, rregullimi i bërë në ligjin e posaçëm prevalon nga ai i bërë në ligjin e përgjithshëm (*lex specialis derogat lex generalis*). Konstatohet se i njëjti rregullim gjendet edhe në ligjin nr.108/2014, datë 31.07.2014, "*Për Policinë e Shtetit*" (neni 39), duke referuar në ligjin për nëpunësin civil.

36. Për sa më sipër, nëse punonjësi i Policisë së Shtetit është larguar nga detyra në kundërshtim me ligjin, qoftë nëpërmjet përjashtimit të tij qoftë nëpërmjet lirimit, rezultati i vetëm i një konstatimi të tillë është rikthimi i këtij punonjësi në detyrën e mëparshme dhe pagimi i pagave që nga momenti i largimit, sikurse ka vendosur Gjykata Administrative e Apelit në vendimin nr.3986, datë 29.10.2014, të rekursuar pranë Gjykatës së Lartë.

37. Në të njëjtën kohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se marrëdhëniet e punës së punonjësve të Policisë së Shtetit janë marrëdhënie pune me natyrë administrative, pasi jo vetëm rregullimi i tyre bëhet nga një ligj i të drejtës publike, por edhe mënyra e lindjes së këtyre marrëdhënieve nuk realizohet në bazë të kontratës së punës por përmes një akti unilateral të titullarit kompetent. Në këto kushte, Vendimi Njësues nr.7, datë 01.06.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk gjen zbatim në këtë rast.

38. Për të kuptuar fushën e zbatimit të një vendimi njësues të Gjykatës së Lartë, duhet që gjykatat të identifikojnë saktë rrethanat e çështjes, në

bazë të cilave ka dalë ai vendim. Përcaktimi i fakteve juridike mbi të cilat do të zbatohet ligji, sipas interpretimit të bërë nga Gjykata e Lartë, çon në zbulimin e shkakut të njësimit të praktikës gjyqësore (*ratio decidendi*) si dhe në përcaktimin në të ardhmen të çështjeve për të cilat një vendim i tillë është detyrues. Vendimet njësuese, sipas kuptimit që u jep Kushtetuta në nenin 141 të saj, nuk janë akte normative të cilat japin udhëzime të përgjithshme për përdoruesit e të drejtës. Në të kundërt, ato vendosin precedentë për mënyrën se si duhet kuptuar dhe zbatuar ligji në një rreth të caktuar faktesh. Në këto vendime mund të gjejmë edhe trajtime abstrakte dhe doktrinare të parimeve dhe instituteve të së drejtës (*obiter dicta*), por këto nuk janë të detyrueshme dhe shërbejnë vetëm për të arritur në njësimin e praktikës, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

39. Referuar rrethanave të çështjes në Vendimin Njësues nr.7, datë 01.06.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rezulton se bëhet fjalë për marrëdhënie pune për punonjës të kontraktuar në bazë të një kontrate pune, regjimi juridik i të cilës rregullohet ekskluzivisht nga dispozitat e Kodit të Punës. Nga ana tjetër, referuar fakteve të çështjes në shqyrtim, punonjësit e Policisë së Shtetit, sikurse u theksua më sipër, janë punonjës shtetërorë, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen nga një ligj i të drejtës publike dhe ku lindja e përfundimi i këtyre marrëdhënieve, çka përcakton edhe natyrën e tyre, bëhet nëpërmjet një akti të njëanshëm të një organi publik, që përmbush të gjitha kushtet për t'u cilësuar akt administrativ.

40. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se janë pikërisht raporte të tilla punësimi, sikurse ai i punonjësve të Policisë së Shtetit apo nëpunësve të tjerë civilë, me natyrë administrative, që i japin kuptim ekzistencës së parashikimit të neneve 146/3 dhe 155/3, të Kodit të Punës. Në këto dispozita përcaktohet se: "*Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.*". Në këto kushte, këto dispozita nuk mbeten të pazbatueshme .

41. Përveç sa u arsyetua më sipër, Kolegji vlerëson të analizojë edhe faktin se në çështjen në shqyrtim, nga pikëpamja e kohështrirjes së efekteve juridike (*ratione temporis*), është i zbatueshëm ligji nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*", që kishte shfuqizuar ligjin nr.8549, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*". Pikërisht, në nenin 3 të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*", të titulluar "*raste të veçanta*", është bërë një rregullim i posaçëm sipas të cilit "*1. Punonjësi i policisë dhe punonjësi i shërbimit të jashtëm është nëpunës civil, ndaj të cilëve zbatohet ky ligj, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.*".

42. Ligji nr.152/2013, datë 30.05.2013, "*Për nëpunësin civil*", në nenin 72 të tij parashikonte hyrjen në fuqi më 01.10.2013. Me aktin normativ nr.5, datë 30.09.2013, të Këshillit të Ministrave, u vendos që efektet juridike të këtij ligji të fillonin gjashtë muaj pas hyrjes së tij në fuqi dhe, deri në këtë kohë, mbetej i zbatueshëm ligji nr.8549, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil.*". Me ligjin nr.161/2013, datë 17.10.2013, u vendos miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.5, datë 30.09.2013, të Këshillit të Ministrave. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.5, datë 05.02.2014, vendosi: "*Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 30.09.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe të ligjit të Kuvendit nr. 161/2013 "Për miratimin e aktit normativ nr. 5, datë 30.09.2013.*". Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 26.02.2014, duke hyrë në fuqi në këtë datë.

43. Rezulton se pala paditëse, z. A.J., padinë e tij e ka paraqitur përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, më datë 04.02.2014. Në këto rrethana, në kohën e hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, çështja ishte ende në gjykim, pa pasur një vendim të formës së prerë. Në këtë aspekt, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se gjen zbatim parashikimi i nenit 76, pika 7, shkronja "ç", të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*", që përcakton fuqinë prapavepruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me efektet e ligjit apo aktit tjetër normativ të shfuqizuar që zbatohet për çështjet që janë në gjykim e sipër.

44. Në këtë kontekst, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë thekson se në një situatë të tillë nuk është vendi për të zbatuar nenin 37, pika 1, të ligjit nr.49/2012, datë 03.05.2012, "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*". Kjo dispozitë parashikon se: "*Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.*". Kjo normë nuk bën asgjë tjetër veçse afirmon parimin e përgjithshëm të mospasjes fuqi prapavepruese të ndryshimeve faktike dhe ligjore për zgjidhjen e çështjes. Nga ana tjetër, neni 76, pika 7, shkronja "ç", i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*" i referohet situatës kur ligji apo akti tjetër normativ është antikushtetues dhe konstatohet si i tillë nga Gjykata Kushtetuese.

45. Antikushtetutshmëria e një ligji apo akti tjetër nënligjor është e tillë që nga fillimi (*ab initio*). Megjithatë, ky ligj apo akt nënligjor ndërkohë ka

prodhuar pasoja juridike dhe individët, në mirëbesim, kanë fituar të drejta. Në këtë kontekst, rikthimi i situatës faktike në gjendjen përpara miratimit të aktit antikushtetues do të sillte kaos në marrëdhëniet juridike, çka do të përbënte shkelje të parimit kushtetues të sigurisë juridike. Është për këtë shkak që vendimi i Gjykatës Kushtetuese që shfuqizon një normë apo një akt të tërë normativ ka efekte vetëm për të ardhmen. Megjithatë, për ato pasoja të ligjit të cilat ende nuk kanë ardhur, sikurse në kuptimin e gjerë (*lato* sensu) pasoja të paezauruara janë të tre rastet e renditura në nenin 76, pika 7, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*", ky vendim do të ketë fuqi prapavepruese dhe kjo shpjegohet pikërisht me ekzistencën e antikushtetutshmërisë që nga hyrja në fuqi e normës apo e aktit normativ.

46. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se të gjitha pretendimet e tjera të parashtruara në rekurs nga ana e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, janë të pabazuara dhe nuk mund ta cenojnë vendimin nr.3986, datë 29.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit.

47. Në lidhje me pretendimin për mos-shterimin e ankimit administrativ, referuar nenit 78 të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", shterimi i këtij ankimi nuk është i detyrueshëm por alternativ, pra, punonjësi i policisë i liruar nga radhët e saj në mënyrë të paligjshme, ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës me padi edhe drejtpërdrejt.

48. Për sa i përket pretendimit për ligjshmërinë e lirimit të paditësit nga detyra, kjo është arsyetuar në mënyrë shteruese nga të dyja gjykata e faktit, që kanë arritur në përfundimin se pala e paditur nuk ka arritur të provojë ristrukturimin e institucionit dhe ofrimin e një grade më të ulët paditësit. Gjithashtu, një pretendim i tillë ka të bëjë me provueshmërinë e fakteve, çka e bën të papranueshëm shqyrtimin e tij për juridiksionin e Gjykatës së Lartë.

49. Së fundi, në lidhje me pretendimin se paditësi është duke u trajtuar me pagë kalimtare deri në momentin e krijimit të vendeve të lira ky është një pretendim që nuk e cenon thelbin e disponimit nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit dhe që ka të bëjë me rikthimin e paditësit në strukturat e Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën që mbante në momentin e largimit si dhe pagimin e pagës që ka pasur në momentin e largimit, deri në rikthimin e tij në detyrë.

50. Në këtë pikë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë thekson se, në momentin që ky vendim do të ekzekutohet në mënyrë të plotë, pala e paditur ka të drejtë të zbresë nga të ardhurat që duhet t'i japë paditësit për efekt të pagimit të pagës deri në momentin e rikthimit, si një prej disponimeve

të Gjykatës Administrative të Apelit, në vendimin e saj nr.3986, datë 29.10.2014, shumën me të cilën ai është trajtuar me pagë kalimtare, si dhe çdo përfitim tjetër të marrë për këtë qëllim. Një veprim i tillë mund të kryhet nga pala e paditur duke mbajtur në konsideratë kushtet e përcaktuara në nenin 122, pika 2, të Kodit të Punës. Duke qenë se ndaj paditësit është vendosur rikthimi i të gjitha të drejtave të cenuara me lirimin e tij nga detyra, atëherë nuk ka vend për trajtime të tjera në favor të tij.

51. Në të njëjtën kohë, lidhur me efektet financiare që do të sjellë për palën e paditur ky vendim, kjo e fundit mund të përdorë në favor të saj dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.07.1999, "*Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore*", duke kërkuar me padi regresi, çdo shumë të paguar në favor të paditësit, nëse provohet, në kushtet e nenit 4 të këtij ligji, veprimi me keqbesim i funksionarit shtetëror që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-172, datë 06.07.2020

Kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshjeje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse gjykata investohet për të vërtetuar gjyqësisht ekzistencën ose jo të një akti (që nuk ekziston) jemi para rastit të vërtetimit të një fakti juridik. Ndërsa në rastin ku objekt shqyrtimi është kërkesa për korrigjimin gjyqësisht të një dokumenti për shkak të të dhënave të gabuara ose të pasakta, gjykimi ka natyrë administrative, pasi padia i drejtohet organit publik që në zbatim të funksioneve të caktuara me ligj ka cenuar të drejtat e paditësit, duke mos vepruar apo duke refuzuar marrjen në konsideratë të kërkesave me pretendimin se nuk janë konform ligjit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se pala paditëse Sh.T., i është drejtuar palës së paditur për lidhjen e pensionit të pleqërisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore...".

2. Nga ana e palës së paditur i është caktuar pension pleqërie për 17 vite dhe 5 muaj punë vjetërsi, duke mos i njohur në këtë mënyrë vjetërsinë në punë për periudhën 01.09.1974-31.12.1991, për arsye se nuk identifikohen si ditë pune.

3. Paditësi ka ushtruar ankimin administrativ në Komisionin Rajonal të Ankimit (KRA) Tiranë, qëme vendimin nr. 803, datë 28.08.2018, ka rrëzuar kërkesën e paraqitur nga pala paditëse duke lënë në fuqi vendimin e degës së përfitimeve.

4. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë sipas objektit të saj.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1375, datë 26.02.2019 ka vendosur: *"Moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes civile me nr. 14508/3871 akti, datë*

08.11.2018 regjistri. Dërgimin e kësaj çështjeje dhe akteve bashkëlidhur, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për vazhdimin e këtij gjykimi, si gjykatë kompetente.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.31138-02923-80 akti, datë 14.05.2019 ka vendosur: *"Të ngrejë çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë para Gjykatës së Lartë për/në gjykimin e çështjes administrative nr.31138-02923-80, Me paditës: Sh.T.; me palë të paditur: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria e Arkivit Qendror Lundër; Me objekt: Njohja e vërtetësisë të dokumentit "Librezë Pune" në emër të paditëses Shqipe Mustafa Tusha, lëshuar nga Dega e Kuadrit, Koop. Bujqësore Verri, për periudhën 01.09.1974-31.12.1991, punonjëse në administratën e kësaj Kooperative, për efekt të llogaritjes të pensionit të pleqërisë. Vërtetësia e fletës nr.26 të regjistrit themeltar të vjetërsisë në punë të ish-KB Verri, që i përket Shqipe Tusha, lidhur me periudhën e punës 15.01.1980-31.12.1985, si vjetërsi pune në administratën e kësaj kooperative."*.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr.1375, datë 26.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit, prandaj çështja duhet të lihet në fuqi.

8. Kolegji Administrativ e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshjeje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

9. Kolegji Administrativ në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative. Në rastin në shqyrtim, Kolegji e vlerëson të drejtë arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata ka përcaktuar drejt natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi, duke bërë një identifikim të elementëve dhe/ose kritereve ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore.

10. Ky Kolegj vlerëson se ky qëndrim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i drejtë, pasi në interpretim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.49/2012, që çështja të gjykohet nga gjykatat administrative duhet që akti administrativ që ka cenuar interesat e palëve të ketë dalë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ose për shkak të mosveprimit të tij. Në rastin konkret, kërkimi i palës paditëse nuk është vërtetimi i faktit juridik por mosveprimi i palës së paditur për të njohur të dhënat që ka të pasqyruara në aktin administrativ (regjistrin, certifikatën, aktin e lindjes ose librezën e punës) konkret, që ka cenuar interesat e paditësit dhe për ketë arsye ka lindur nevoja e saktësimit të të drejtave apo te detyrimeve, pasi në thelb ka lindur nevoja e korrigjimit të gabimit të pasqyruar në aktin administrativ.

11. Referuar objektit të padisë, në analizë të kërkimit të palës paditëse Sh.T. dhe shkakut ligjor ku mbështetet kërkimi, rezulton se nuk jemi përpara një padie për vërtetimin e faktit juridik të aktit administrativ, për faktin se mungon akti që e provon këtë fakt. Me padinë objekt shqyrtimi, rezulton se akti ekziston dhe paditësi kërkon të saktësojë të drejtat dhe/ose të korrigjojë gjyqësisht këtë akt administrativ, të drejta këto të cilat nuk njihen për shkak të mosveprimit të organit publik në funksion të veprimtarisë së tij. Në këto kushte, kur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e këtij objekti të kërkesë padisë, pasi jemi në kushte kur kërkohet saktësimi i të drejtave/korrigjimi i aktit administrativ me pasoja juridike për palën paditëse dhe baza ligjore e cila mbron këtë marrëdhënie është ligji nr.49/2012 dhe në këtë kontekst çështja objekt gjykimi është e natyrës administrative.

12. Kolegji vlerëson të theksojë edhe njëherë qëndrimin e mbajtur dhe të konsoliduar tashmë, se në rastin kur pala paditëse kërkon të vërtetojë gjyqësisht një fakt dhe nuk kërkon detyrimin e palës së paditur për të vepruar apo për t'i njohur një të drejtë të cilën ai e disponon sipas dokumentacionit përkatës, atëherë do të jemi përpara rastit të vërtetimit të faktit juridik, pasi jemi në rastin kur "*akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër*". Por, në rastin konkret të çështjes objekt shqyrtimi, akti administrativ ekziston, pra dokumenti që vërteton të dhënat e palës së paditur ekziston dhe pikërisht për shkak të gabimeve materiale janë cenuar të drejtat e tij dhe për këtë fakt kërkohet korrigjimi i tij. Pra, është organi publik që në zbatim të funksioneve të caktuara me ligj ka vepruar duke pasqyruar të dhëna të gabuara dhe për këtë fakt kërkohet të korrigjohet gjyqësisht, pasi organi nuk vepron.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, si përfundim konstaton se, në rastin konkret është investuar gjykata jo që të vërtetohet gjyqësisht

një akt që nuk ekziston, por ky akt ekziston dhe duhet saktësuar të dhënat që ai përmban, duke i korrigjuar këto të dhëna nëpërmjet veprimit nga ana e organit publik dhe për të cilin kompetente nga pikëpamja lëndore është gjykata administrative. Me padinë objekt shqyrtimi paditësi kërkon të korrigjojë gjyqësisht se ky dokument përmban të dhëna të gabuara ose të pasakta, me qëllim përdorimin e këtij dokumenti pranë institucioneve shtetërore apo privatë. Pra, është organi publik që në zbatim të funksioneve të caktuara me ligj nuk ka vepruar, pra nuk ka pranuar të vlerësojë, saktësojë apo korrigjojë dokumentin i cili ka cenuar të drejtat e paditësit, duke refuzuar marrjen në konsideratë të tyre, duke pretenduar se nuk janë konform ligjit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson të theksojë se qëndrimi i sipërcituar, është në përputhje dhe me qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimet unifikuese nr.4, datë 10.12.2013 dhe nr.3, datë 28.04.2014, ku është përcaktuar qartësisht mënyra e gjykimit të çështjeve civile dhe atyre administrative.

15. Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi nr.1375, datë 26.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është shpallur moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes, duhet të lihet në fuqi.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-184, datë 06.07.2020

Në kërkimet me natyrë administrative dhe civile, gjykata e faktit, pasi të identifikojë kërkimet sipas natyrës, duhet të shpallë moskompetencën lëndore vetëm për ato kërkime të cilat janë me natyrë administrative të cilat i dërgohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për vazhdimin e gjykimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer auditimi në Bashkinë Maliq, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare të ushtruar në këtë bashki. Një prej objekteve të kontrollit të ushtruar nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka qenë edhe ish-Komuna Gorë, sot Njësia Administrative Gorë, pjesë e Bashkisë Maliq, për periudhën 01.01.2013 deri në 31.07.2015.

2. Nga auditimi në lidhje me procedurat e prokurimit publik nga ish-Komuna Gorë për blerjet e vogla të kryera gjatë periudhës objekt auditimi, janë konstatuar shkelje në lidhje me dy procedura për blerje të vogla lidhur me kualifikimin si fitues të operatorit ekonomik me vlerë më të lartë, duke mos dokumentuar tërheqjen e operatorit ekonomik me vlerën më të ulët.

3. Diferenca midis ofertës më të ulët dhe asaj të kontraktuar është konsideruar shkelje e disiplinës financiare dhe dëm ekonomik, ndaj, në Raportin Përfundimtar të Auditit të KLSH-së është lënë si rekomandim arkëtimi i kësaj vlere, duke ndjekur procedurat ligjore ndaj anëtarëve të Komisionit L.K. dhe P.B..

4. Po ashtu, nga auditimi i pagesave për shpenzime dhe dieta për tre punonjësit e ish-Komunës, B.S., me detyrë ish Kryetar i Komunës, L.K., me detyrë ish përgjegjës finance dhe B.B., me detyrë Sekretar i Këshillit të Komunës, është konsideruar dëm ekonomik shuma e përfituar nga secili prej tyre, pasi bashkëngjitur urdhër shërbimeve nuk ka dokumentacion vërtetues, autorizim dhe programe pune për qëllimin e shërbimit, veprim në pajtueshmëri me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, "*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit*", të ndryshuar.

5. Në Raportin Përfundimtar të Auditit të KLSH-së është lënë si rekomandim arkëtimi i kësaj shume e konsideruar si dëm ekonomik, duke

ndjekur procedurat ligjore ndaj ish punonjësve B.S., L.K. dhe B.B..

6. Pala paditëse, Bashkia Maliq, mbështetur në rekomandimet e mësipërme të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin Përfundimtar të Auditit, ka njoftuar debitorët për shkeljet e konstatuara nga auditimi i veprimtarisë së ish-Komunës Gorë, e mandej ka kërkuar gjyqësisht nëpërmjet kësaj padie dëmshpërblimin e vlerës së dëmit ekonomik të konstatuar.

7. Në lidhje me të padituri B.B. pala paditëse deklaroi gjatë gjykimit se hiqte dorë nga kërkimi për këtë të paditur, pasi detyrimi ishte shlyer prej tij në mënyrë vullnetare jashtëgjyqësisht.

8. Në seancën gjyqësore të datë 10.01.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë mori në shqyrtim kryesisht çështjen e kompetencës lëndore dhe arriti në përfundimin se çështja duhej dërguar për vazhdimin e gjykimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.41-2020-91 (32), datë 10.01.2020, ka vendosur: "*1. Të deklarojë moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në shqyrtimin e çështjes civile me nr. Regjistri Themeltar 21234-01064-41-2019 (1147), datë regjistrimi 25.06.2019.* 2. *Dërgimin e kërkesëpadisë dhe akteve që i përkasin asaj për kompetencë gjykimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.* 3. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*".

10. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se mosmarrëveshja është e natyrës administrative sepse objekti i këtij gjykimi lidhet me një mosmarrëveshje të lindur gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të organit publik, sikurse ka qenë Komuna Gorë dhe se, burimi i lindjes së detyrimit objekt i këtij gjykimi është pikërisht tek kjo veprimtari administrative.

11. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin e ndërmjetëm të seancës përgatitore të datës 09.03.2020, në çështjen me nr. Regj. Them. (226) – 00237, datë regjistrimi 12.02.2020, ka vendosur: "*1. T'i kërkojë Gjykatës së Lartë të zgjidhë mosmarrëveshjen për kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje midis Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. [...] 4. Të pezullojë gjykimin e kësaj çështje deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes për kompetencën lëndore me vendim nga Gjykata e Lartë.*".12. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se çështja ka si kërkime të natyrës civile ashtu edhe kërkime të natyrës administrative dhe, për këtë shkak, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë duhet të kishte ndarë këto

kërkime dhe të shpallte moskompetencën vetëm për kërkimet me natyrë administrative. Kështu, kërkimi për detyrimin e të padituve L.K., P.B. dhe B.B. të dëmshpërblejnë Bashkinë Maliq për dëmin ekonomik që i kanë shkaktuar, përkatësisht në shumat 257.500 lekë, 10.000 lekë dhe 5.000 lekë, është kërkim me natyrë civile sepse buron nga një mosmarrëveshje në fushën e marrëdhënieve të punës së këtyre tre të padituve pranë ish-Komunës Gorë, marrëdhënie e cila ka qenë e rregulluar me dispozitat e Kodit të Punës.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se vendimi nr.41-2020-91 (32), datë 10.01.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duhet të prishet si një vendim i marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë kompetencën lëndore të gjykatave dhe çështja duhet t'i dërgohet sërish kësaj gjykate, pranë të njëjtit trup gjykues.

14. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt (shih vendimin nr.917, datë 11.05.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

15. Në vijim të këtij qëndrimi, Kolegji thekson se, për përcaktuar nëse një mosmarrëveshje është e natyrës civile apo administrative, duhet t'u referohet jo vetëm dispozitave të cilat përcaktojnë llojet e padive që bëjnë pjesë në sferën e kompetencës së njërës apo tjetrës gjykatë, por edhe kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e vetë kësaj Gjykate, duke pasur në konsideratë këtu, *së pari*, jurisprudencën nomofilatike të Gjykatës së Lartë (vendimet njësuese dhe ndryshuese të praktikës gjyqësore) dhe, *së dyti*, jurisprudencën konstante të saj.

16. Në këtë kuadër, për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative ose jo duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron

pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (shih, vendimi nr.2, datë 10.03.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23).

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se, siç me të drejtë ka argumentuar Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, kjo çështje ka kërkime si të natyrës administrative ashtu edhe të natyrës civile. Për këtë shkak, për një pjesë të këtyre kërkimeve është kompetente Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, ndërsa për pjesën tjetër të tyre Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

18. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifkues nr.3, datë 28.04.2014, lidhur me kompetencën lëndore të gjykatave për paditë me kërkime të përbëra, të cilat janë të natyrave të ndryshme (civile dhe administrative) kanë njësuar praktikën gjyqësore në këtë mënyrë: "*Kur në objektin e gjykimit të një çështjeje ka disa kërkime si të natyrës civile dhe administrative, këto kërkime pavarësisht faktit nëse kanë një lidhje të thjeshtë në mes tyre, apo janë edhe të ndërvarura nga njëra tjetra, referuar nenit 61 dhe 159, të KPC-s dhe 13 dhe 23, të ligjit nr.49/2012, gjykata duhet të veçojë kërkimet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore, duke ia kaluar ato gjykatës kompetente.*".

19. Referuar rrethanave të çështjes në shqyrtim, sikurse janë konstatuar nga gjykatat e faktit, kërkimet që u atribuohen të padituve L.K., B.S. dhe B.B. lidhen me dëmin ekonomik të pretenduar se është shkaktuar prej tyre si pasojë e dietave dhe shpenzimeve që kanë kryer në ushtrim të funksioneve të tyre zyrtare. Rezulton se kërkimi që u është drejtuar këtyre të padituve e gjen rregullimin e tij në nenin 27 të Kodit të Punës. Në këtë dispozitë përcaktohet se: "*1. Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia.*".

20. Në këtë drejtim, veprimtaria e kryer prej këtyre të padituve normohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.329, datë 20.04.2016, "Për disa ndryshime në vendimin nr.997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit*"", të ndryshuar. Në këtë akt nënligjor normativ rregullohen raportet midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, të rrjedhura nga kontrata e punës, të cilat kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet reciproke të tyre për veprimtarinë e kryer prej punëmarrësit jashtë qendrës së punës, brenda vendit.

21. Për sa më sipër, kërkimet që lidhen të drejtat e punëdhënësit në raport me punëmarrësin, të cilat burojnë nga zbatimi i kontratës së punës, si rregull, janë kërkime me natyrë civile. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm në rastin kur marrëdhëniet e punës kanë natyrë publike, çka e bën kërkimin me natyrë administrative.

22. Referuar çështjes në shqyrtim, i padituri B.S., ka qenë me detyrë ish-kryetar i Komunës Gorë, ndërsa i padituri B.B. ka qenë me detyrë sekretar i Këshillit të kësaj komune. Në këto rrethana, këta konsiderohen si funksionarë publikë dhe marrëdhëniet e tyre të punësimit rregullohen nga ligji i posaçëm, ligji nr.8652, datë 31.07.2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", i cili ka qenë ligji në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve juridike. Për këtë shkak, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këta funksionarë do të jetë në kompetencën e gjykatave administrative.

23. Për sa i përket kërkimit tjetër, dëmit të pretenduar në lidhje me procedurat e prokurimit publik të kryera nga ish-Komuna Gorë për blerjet e vogla, gjatë periudhës objekt auditimi, kërkim për të cilin nuk ekziston ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet dy gjykatave, ai ka natyrë administrative pasi lidhet me veprimtarinë administrative të organit publik, Komuna Gorë.

24. Për çka u arsyetua më sipër, kompetente për gjykimin e kërkimit për dëmin e pretenduar në lidhje me procedurat e prokurimit publik të kryera nga ish-Komuna Gorë për blerjet e vogla, gjatë periudhës objekt auditimi, e cila lidhet me veprimet e të padituve L.K. dhe P.B., kompetenca do t'i përkasë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Kjo gjykatë do të jetë kompetente edhe për kërkimet që i atribuohen të padituit B.S. lidhur me dëmin ekonomik të pretenduar se është shkaktuar prej tij si pasojë e dietave dhe shpenzimeve që kanë kryer në ushtrim të funksioneve të tij zyrtare. Ndërsa, kërkimi që i atribuohet të padituit L.K. lidhur me dëmin ekonomik të pretenduar se është shkaktuar prej tij si pasojë e dietave dhe shpenzimeve që ka kryer në ushtrim të funksioneve të tij zyrtare, duke qenë një kërkim me natyrë civile, i përket kompetencës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Së fundi, për të padituin B.B. gjykimi është pushuar për shkak të heqjes dorë nga pala paditëse.

25. Nisur nga fakti se për të padituin L.K. ka dy kërkime, njëri me natyrë administrative dhe tjetri me natyrë civile, të cilët nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit nuk mund të individualizohen, atëherë vendimi nr.41-2020-91 (32), datë 10.01.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, nuk mund të prishet pjesërisht, vetëm për pjesën që kjo gjykatë nuk është kompetente, por do të prishet tërësisht dhe do t'i kthehet kësaj gjykate për vazhdimin e gjykimit, me të njëjtin trup gjykues. Pasi ta rimarrë çështjen në

shqyrtim, dhe pasi të identifikojë kërkimet me natyrë civile dhe ato me natyrë administrative sipas orientimit të dhënë në paragrafin 24 të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë duhet të shpallë moskompetencën lëndore vetëm për ato kërkime të cilat janë me natyrë administrative.

26. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, si një gjykatë fakti, duhet të përcaktojë shumën e kërkimit që i atribuohet të padituri L.K. për dëmin e pretenduar në lidhje me procedurat e prokurimit publik të kryera nga ish-Komuna Gorë për blerjet e vogla, gjatë periudhës objekt auditimi dhe, së bashku me kërkimet që i atribuohen të paditurve P.B. dhe B.S., duhet t'i nxjerrë jashtë kompetencës së saj lëndore, duke i dërguar për vazhdimin e gjykimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Për sa i përket kërkimit që i atribuohet të padituri L.K. lidhur me dëmin ekonomik të pretenduar se është shkaktuar prej tij si pasojë e dietave dhe shpenzimeve që ka kryer në ushtrim të funksioneve zyrtare, ky është një kërkim që duhet të vazhdojë të gjykohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi të individualizohet shuma përkatëse e kërkimit.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.11243-02916-00-2014, datë 27.07.2020

Koncepti i padisë që nuk mund të ngrihet nuk ka lidhje me të metat e padisë që mund të ndreqen si nga pikëpamja e formës ashtu edhe përmbajtjes, për të garantuar kështu aksesin në drejtësi. Këtë mundësi ligji procedural ua ka dhënë palëve ndërgjyqëse edhe për apelin, kundër-apelin, rekursin, kundërrekursin dhe kërkesën për rishikim, dhe se për çdo akt tjetër procedural të ndërgjyqësve, që në formë apo në përmbajtje nuk është perfeksionuar sipas kërkesave ligjore.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës më datë 20.08.2009.

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se Dega e Përfitimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës me vendimin nr.2135, datë 16.02.1993 ka trajtuar palën paditëse me pension të parakohshëm pleqërie. Në vitin 1997, për shkak të plotësimit të moshës së pensionit, pala paditëse është trajtuar nga Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Durrës me pension të plotë pleqërie të kategorisë minimale.

3. Në vitin 2006 pala e paditur rillogarit masën e pensionit të palës paditëse dhe në vijim vendoset të trajtohet me pension të plotë të kategorisë mesatare. Pala paditëse ka pretenduar se përllogaritja e pensionit është e gabuar dhe se masa e tij duhet të ishte më e madhe, pasi ai ishte i përndjekur politik. Për këtë arsye ai ka paraqitur padi.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.627 (1895), datë 05.03.2012 ka vendosur: "*Rrëzimin e kërkesëpadisë së ngritur nga paditësi Y.M. kundër palës së paditur DRSSH Durrës me objekt: Llogaritje jo e drejtë e pensionit.*". Gjykata e shkallës së parë, pasi ka sjellë në vëmendje konkluzionin e aktit të ekspertimit, ka vlerësuar se pretendimi i palës paditëse është i pabazuar në ligj dhe në prova, duke konkluduar se masa e pensionit është llogaritur nga pala e paditur në përputhje me ligjin.

5. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar apel pala paditëse, Y.M.. Ai ka pretenduar se vendimi i gjyqtarit të shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe se duhet të ndryshohet duke

vendosur pranimin e padisë.

6. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.10-2014-288 (86), datë 27.01.2014 ka vendosur:

"- *Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Durrës për gjykimin e çështjes. – Dërgimin e akteve në Gjykatën Administrative të Apelit.*".

7. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.1109, datë 27.03.2014 ka vendosur: "- *Prishjen e vendimit nr.627 (1895), datë 05.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pushimin e gjykimit të çështjes.*". Gjykata e apelit e ka gjykuar çështjen në dhomë këshillimi. Gjykata e apelit ka vlerësuar se padia nuk ka pasur objekt, pasi në rast se pretendimet e paditësit do të ishin të bazuara në prova, atëherë gjykata do ta kishte të pamundur të konkludonte lidhur me disponimet, duke qenë se nuk ka pasur objekt padie apo kërkime konkrete të paditësit. Gjykata e apelit ka vlerësuar se kjo padi në këto kushte është një padi që nuk mund të ngrihet. Gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë duhet të kishte zbatuar nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s, duke vendosur kthimin e padisë me të meta dhe duke kërkuar ndreqjen e tyre në një afat të caktuar.

8. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse, Y.M., më datë 23.06.2014. Pala paditëse ka marrë dijeni më datë 27.05.2014 për vendimin e gjykatës së apelit. Rekursi është njoftuar tek ndërgjyqësit dhe nuk rezulton të ketë kundërrekurs. [...]

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.14.05.2018 ka vendosur: "*1. Deklarimin e moskompetencës lëndore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes civile me nr.11243-02916-00-2014, datë 04.09.2014 regjistrimi. 2. Dërgimin e akteve Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*".

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) konkludon se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në shkelje të rënda procedurale që passjellin pavlefshmërinë e tij dhe që përbëjnë mohim flagrant të aksesit në drejtësi. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim.

11. Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar se padia nuk ka pasur objekt dhe se, në kushtet e hartimit të objektit në atë mënyrë sikurse pala paditëse ka bërë është e pamundur që gjykata të disponojë. Kolegji konstaton se këto konkluzione të Gjykatës Administrative të Apelit kanë

ardhur si pasojë e leximit vetëm të objektit të padisë dhe jo tekstit të saj dhe se kjo mënyrë e shqyrtimit të çështjes në gjykimin në apel, në vlerësimin e Kolegjit, është e papranueshme. Kolegji sjell në vëmendje se gjykatat nuk mund të mjaftohen vetëm me leximin e pjesës hyrëse të objektit të padisë, pasi kërkimet e palës paditëse mund të parashtrohen edhe gjatë tekstit të padisë. Parë në këtë këndvështrim, Kolegji konstaton se pala paditëse ka sqaruar shkurtimisht arsyen se pse i është drejtuar gjykatës dhe se çfarë kërkon ai të arrijë nëpërmjet padisë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pala paditëse ka artikuluar mjaftueshëm qartë shkakun ligjor dhe objektin e padisë sa që gjykata të ketë të qartë objektin e mosmarrëveshjes. Nuk duhet të harrohet gjithashtu se objekti i mosmarrëveshjes del në aktet procedurale që palët ndërgjyqëse ndërmarrin gjatë gjykimit, sikurse ka rregulluar neni 5 i KPC-s.

12. Kolegji vlerëson se një qëndrim i tillë ekstremisht formalist në shqyrtimin e çështjes nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit përbën mohim flagrant të aksesit në drejtësi, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj).

Nëse konstatohen të meta të padisë në gjykimin në apel nuk mund të konkludohet se padia nuk mund të ngrihet. Gjykata Administrative e Apelit duhet të mbajë parasysh se koncepti i padisë që nuk mund të ngrihet nuk ka lidhje me të metat e padisë apo me shkaqet e pavlefshmërisë së padisë si akt procedural (shih, nenet 154, 154/a dhe 467, shkronja "dh", të KPC-s).

13. Padia që nuk mund të ngrihet është një koncept juridik që ligji (shih, ish nenin 468 të KPC-s dhe sot shkronjën "c", të nenit 299, të këtij Kodi) e përdor për të konkluduar në shuarjen e gjykimit për çdo padi e cila është ngritur mbi të drejta të paditshme. Kjo do të thotë se papaditshmëria është një gjendje juridike që ka ekzistuar para se padia të ngrihet dhe që nuk mund të ndreqet as me ngritjen e padisë. Ndaj gjykata, në çdo fazë apo shkallë gjykimi, me kërkesë të palëve apo kryesisht, duhet ta konstatojë një fakt të tillë dhe menjëherë të vendosë pushimin e gjykimit, nëpërmjet një vendimi jopërfundimtar sipas nenit 127 të KPC-s. Në këtë kuptim, mungesa e mundësisë ligjore për të paditur përbën një shkak nuliteti permanent dhe të pakorrigjueshëm apo të pakonvalidueshëm. Pas shqyrtimit të çështjes së juridiksionit, gjykata ka për detyrë të shqyrtojë kryesisht nëse e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm është apo jo i paditshëm gjyqësisht.

14. Nga ana tjetër të metat e padisë sipas nenit 154 të KPC-s dhe koncepti i pavlefshmërisë së padisë sipas nenit 467, shkronja "dh", të KPC-s janë koncepte të ndryshme nga koncepti juridik i padisë që nuk mund të ngrihet. Të metat apo shkaqet e pavlefshmërisë së padisë lidhen gjithnjë

me padinë si akt procedural dhe se kanë të bëjnë ose me aspektin formal apo përmbajtësor të vetë aktit procedural ku materializohet padia që nis gjykimin sipas nenit 153 të KPC-s. Kjo do të thotë se padia, e cila është e lejueshme që të ngrihet për nga lloji i të drejtës subjektive apo interesit të ligjshëm që ajo bën të vlefshëm në procesin civil apo administrativ, paraqet të meta formale apo përmbajtësore të aktit procedural në të cilin është materializuar. Në këtë mënyrë shqyrtimi i të metave apo shkaqeve të pavlefshmërisë së padisë si akt procedural bëhet vetëm në qoftë se gjykata ka konkluduar se ajo padi mund të ngrihet gjyqësisht.

15. Duke qenë se të metat dhe shkaqet e pavlefshmërisë së padisë si akt procedural janë të korrigjueshme dhe të konvalidueshme, ligji procedural ka parashikuar një mundësi për paditësin që të ndreqë të metat, duke i dhënë atij mundësi të perfeksionojë formën dhe përmbajtjen e këtij akti procedural. Këtë mundësi ligji procedural ua ka dhënë palëve ndërgjyqëse edhe për apelin, kundër-apelin, rekursin, kundër-rekursin dhe kërkesën për rishikim dhe për çdo akt tjetër procedural të ndërgjyqësve, i cili në formë apo në përmbajtje nuk është perfeksionuar sipas kërkesave ligjore. Moskonformimi i palëve ndërgjyqëse me këto kërkesa ligjore nuk mund të çojë në konkluzionin se padia nuk mund të ngrihet dhe se pikërisht këtë gabim të rëndë procedural ka bërë në gjykimin e kësaj çështje Gjykata Administrative e Apelit.

16. Përkundrazi, mosperfeksionimi i padisë si akt procedural me elementet formalë dhe përmbajtjesore që ka parashikuar ligji passjell vendimmarrjen e ndërmjetme të gjykatës për konstatimin e këtyre të metave dhe njëkohësisht lënien kohë për palën ndërgjyqëse autor i aktit procedural për ta ndrequr dhe perfeksionuar formën dhe përmbajtjen e aktit sipas kërkesa ligjore. Vetëm pas dështimit të palës ndërgjyqëse për t'u konformuar me vendimmarrjen e ndërmjetme të gjykatës mund të përfundojë gjykimi me anën e një vendimi jopërfundimar, konkretisht duke u vendosur pushimi i gjykimit. Në këtë rast pushimi i gjykimit nuk mund të ketë si shkak paditshmërinë, por pamundësinë e gjykimit për të vijuar si pasojë e mosperfeksionimit të padisë në të gjithë elementët formalë dhe përmbajtësorë të këtij akti procedural. Mundësia që ligji procedural ka dhënë për palët për të ndrequr të metat e aktit procedural është pasojë dhe përditësim i parimit të ruajtjes dhe konservimit të vlefshmërisë së aktit procedural, parim që rrjedh nga standardi i afatit të arsyeshëm dhe parimi i ekonomizimit procedural.

17. Në rastin konkret Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi, pa u njoftuar më parë pala paditëse për këtë shkak dhe fakt ligjor të konstatuar kryesisht nga ana e gjykatës, ka vendosur prishjen e

vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke konkluduar se padia nuk mund të ngrihej pasi kishte të meta, sipas neneve 154 dhe 154/a, të KPC-s. Duke qenë se pala paditëse nuk e ka ditur dhe nuk ka pasur mundësi të dinte lidhur me këtë rezervë të gjykatës mbi formën dhe përmbajtjen e padisë si akt procedural, Kolegji konkludon se paditësi në këtë mënyrë është vendosur para efektit surprizë të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke mos pasur mundësi që të mbrohet dhe të debatojë sipas parimit të kontradiktoritetit lidhur me këtë çështje, në kundërshtim me sa parashikohet në nenet 18 dhe 20, të KPC-s.

18. Kolegji sjell në vëmendje se Gjykata Administrative e Apelit ka gabuar në interpretimin e shkronjës "c", të nenit 53, të ligjit nr.49/2012, duke gabuar për rrjedhojë në interpretimin dhe zbatimin e shkronjës "ç", të nenit 53 dhe të nenit 54, të ligjit nr.49/2012. Nuk mundet apirori që për të njëjtat shkaqe procedurale të merret vendim nga gjykata rishikuese për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim dhe prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Duke e interpretuar shkronjën "ç", të nenit 53 dhe nenit 54, të ligjit nr.49/2012, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, me shkronjën "dh", të nenit 467, të KPC-s, dhe duke pasur parasysh konsideratat jurisprudenciale të pasqyruara më lart në këtë vendim, Kolegji konkludon se të metat e padisë dhe shkaqet e pavlefshmërisë së padisë si akt procedural nuk mund të çojnë në konkluzionin se padia nuk mund të ngrihet. Këto parregullsi procedurale shërbejnë si shkak për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, me porosinë që palës paditëse t'i ofrohet mundësia e ndreqjes së të metave, nëse kjo procedurë ligjore nuk është ezauruar nga ana e gjykatës.

19. Në rastin konkret Kolegji konkludon se padia nuk ka të meta procedurale dhe se Gjykata Administrative e Apelit ka refuzuar të përmbushë detyrën për shqyrtimin në themel të çështjes dhe dhënies së drejtësisë. Kolegji, duke mbajtur parasysh çfarë u arsyetua më lart, konkludon se vendimi i Gjykatës Administrative duhet të prishet dhe se çështja duhet të kthehet për rigjykim në atë gjykatë.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-608-2020, datë 14.09.2020

Kompetenca tokësore është një prapësim procedural që mund të ushtrohet vetëm nga ndërgjyqësit dhe jo të shqyrtohet kryesisht nga gjykata.

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala kërkuese, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (referuar në vijim si, (KMD) ka paraqitur kërkesën objekt gjykimi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë më datë 20.02.2020.

2. Kërkuesi ka kryer procedurën e hetimit administrativ në bazë të ankesës nr. 192, datë 18.12.2018 të Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës, ku pretendohej diskriminimi për shkak të "aftësisë së kufizuar" dhe "përkatësisë në një grup të veçantë", nga ana e Bashkisë Shkodër. Në përfundim të hetimit dhe në bazë të ligjit nr.10221/2010, Kërkuesi ka vendosur me vendimin nr.158, datë 05.11.2019: "*Bashkia Shkodër të gjobitet me vlerën 200.000 Lekë*". Në bazë të nenit 22 të ligjit nr.10279/2010 dhe neneve 510/e dhe 511, të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv, vendimin nr.158, datë 05.11.2019 të KMD-s.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.263 (31134-00996-80), datë 03.03.2020 ka vendosur: *"1. Të deklarojë moskompetencën e vet tokësore për gjykimin e kërkesës nr.263 regjistri, datë 20.02.2020. 2. T'i dërgojë aktet për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, si Gjykatë kompetente. […].* Gjykata ka marrë çështjen në shqyrtim kryesisht në dhomë këshillimi, duke arsyetuar se për nga pikëpamja territoriale gjykata kompetente për të gjykuar çështjen është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, pasi subjekti kundërvajtës Bashkia Shkodër dhe aktiviteti i saj ndodhet në qytetin e Shkodrës. Në këto kushte, ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr.344 (31134-00460-83-2020) Regjistri Themeltar, datë 07.07.2020, ka

vendosur: "*1. T'i parashtrojë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për zgjidhje mosmarrëveshjen e kompetencës tokësore ndërmjet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në lidhje me çështjen nr. regj. them. 344 (31134-00460-83-2020) […]*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka gjykuar dhe argumentuar se Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shpalljen e moskompetencës tokësore për shqyrtimin e çështjes është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, konkretisht nenit 13 të ligjit nr.49/2012, sipas të cilit "*Moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave…*", si dhe qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për të njëjtën çështje. Për të gjitha arsyet si më lart cituar, në bazë të nenit 13/5 të ligjit nr.49/2012 dhe KPC-s, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës tokësore përpara Gjykatës së Lartë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë dhe vendimet e gjykatave në mosmarrëveshje për kompetencën lëndore, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.49/2012, çmon se parashtresa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është e bazuar në ligj dhe për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të prishet dhe të dërgohet çështja për vazhdimin e gjykimit në atë gjykatë.

6. Kolegji konstaton dhe sjell në vëmendje se në këtë çështje pala kërkuese nuk e ka ngritur si pretendim mungesën e kompetencës tokësore dhe se gjykata e ka marrë kryesisht në shqyrtim këtë çështje. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka marrë parasysh kryesisht çështjen e kompetencës tokësore gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, duke cituar nenin 13 të ligjit nr.49/2012.

7. Kolegji tërheq vëmendjen e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë se vendimmarrja kryesisht mbi çështjen e kompetencës tokësore është e pabazuar në ligj dhe se gjithashtu vendimi i ndërmjetëm për deklarimin e mungesës së kompetencës është i pabazuar në parashikimet ligjore për mënyrën se si atribuohet kompetenca tokësore e gjykatës administrative dhe civile. Kolegji sjell në vëmendjen e gjykatës

së shkallës së parë se, *së pari* duhet të lexohet dhe të interpretohet drejt ligji procedural, konkretisht neni 13 i ligjit nr.49/2012, të cilin ajo vetë e sjell në vëmendje gjatë arsyetimit të vendimit të shpalljes së mungesës së kompetencës. *Së dyti*, Kolegji sjell në vëmendjen e gjykatës së shkallës së parë se ajo është e detyruar të dijë dhe të respektojë qëndrimet jurisprudenciale të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mbi këtë çështje, pikërisht vendimmarrjet që sjell në vëmendje në parashtresën e saj Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe të tjera si ato. Nëse neni 13 i ligjit nr.49/2012 dhe jurisprudenca e qartë dhe gjithnjë koherente e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë do të respektohej, nuk do të shkaktoheshin këto vonesa në gjykimin e kësaj çështje.

8. Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje se neni 13 i ligjit nr.49/2012 dhe neni 62 i KPC-s janë formuluar në mënyrë të tillë që të përjashtojnë mundësinë e gjykatës që të marrë në shqyrtim kryesisht kompetencën tokësore. Sipas ligjeve procedurale kjo kompetencë është një prapësim procedural në kuptimin e ngushtë dhe si i tillë mundet të ushtrohet vetëm nga ndërgjyqësit dhe se gjykatat vetëm në këtë mënyrë mund ta marrin në shqyrtim dhe kurrsesi kryesisht.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-412, datë 21.09.2020

Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr.75, datë 21.04.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve të Bashkisë së qytetit Vlorë ka vendosur që t'i kthejë ish pronarit I.L. një sipërfaqe toke prej 10.000 m² truall në lagjen "Uji i Ftohtë", Vlorë.

2. Me kontratën e porosisë nr.1178 rep., nr.1067 kol., datë 23.09.2010, të Noteres, trashëgimtarët e të ndjerit I.L. kanë ngarkuar paditësin E.A. që, në cilësinë e të porositurit të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore në lidhje me këtë pronë.

3. Rezulton se paditësi ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë (ZVRPP) për t'u pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë e njohur dhe kthyer shtetasit I.L. me vendimin nr.75, datë 21.04.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve të Bashkisë së qytetit Vlorë.

4. Me shkresën nr.6291 prot., datë 05.11.2018, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë i ka kthyer përgjigje paditësit se kjo pronë është regjistruar me pasurinë me nr.37/108, vol.66, faqe 37, me sipërfaqe 8165.93 m2, duke zbritur nga sipërfaqja totale sipërfaqet e mbivendosura. Skica që shoqëron këtë vendim është skematike dhe, nëse matet grafikisht kjo skicë, sipërfaqja totale e saj është 14.597 m2. Gjatë pasqyrimit në hartë me përafërsi sipërfaqja e pasurisë 37/108 pjesërisht del jashtë titullit të

pronësisë. Ndodhur në këto kushte, ky institucion i ka sugjeruar paditësit që t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për saktësimin e skicës ligjore.

5. Në këto rrethana, paditësi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke kërkuar saktësimin e skicës ligjore bashkëlidhur vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave (KKP)-së nr.75, datë 21.04.1995, në bazë të fragmentit të hartës nr.37/108, vol.66, fq.237, të ZVRPP Vlorë dhe detyrimin e ZVRPP Vlorë ta pajisë me certifikatë pronësie për pasurinë e fituar me vendimin KKP-në nr.75, datë 21.04.1995, në emër të I.L. regjistruar që në vitin 1995 me nr. 2663 në Hipotekën Vlorë.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.1158, datë 15.02.2019, ka vendosur: *Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për shqyrtimin e çështjes. Dërgimin e akteve që i përkasin çështjes me nr.975 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 05.02.2019, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si gjykata kompetente për shqyrtimin e saj.*

6.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar se pala paditëse të dy kërkimet i ka kundrejtuar ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, e cila është një organ publik dhe për këtë shkak, mosmarrëveshja është e natyrës administrative.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.509, datë 24.04.2019, ka vendosur: *Të deklarojë mosmarrëveshjen për kompetencë për gjykimin e çështjes civile me nr. Regj. 845, datë regjistrimi 01.04.2019, me palë paditëse E.A. dhe palë të paditur Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë. Dërgimin e akteve kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*[...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se vendimi nr.1158, datë 15.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është marrë në përputhje me dispozitat procedurale që rregullojnë çështjen e kompetencës lëndore të gjykatave dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

9. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt (shih, vendimi nr.917, datë 11.05.2017, ti Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

10. Në vijim të këtij qëndrimi, Kolegji thekson se, për përcaktuar nëse një mosmarrëveshje është e natyrës civile apo administrative, duhet t'u referohet jo vetëm dispozitave të cilat përcaktojnë llojet e padive që bëjnë pjesë në sferën e kompetencës së njërës apo tjetrës gjykatë, por edhe kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e vetë kësaj Gjykate, duke pasur në konsideratë këtu, së pari, jurisprudencën nomofilatike të Gjykatës së Lartë (vendimet njësuese dhe ndryshuese të praktikës gjyqësore) dhe, së dyti, jurisprudencën konstante të saj.

11. Për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshjeje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin prima facie të saj. Ato duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të padisë, të të drejtës subjektive të pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes (shih, vendimi nr.112, datë 08.06.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

12. Përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen "objekti i padisë" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata, kur zgjidh mosmarrëveshjen, merr në shqyrtim pretendimet e paditësit që parashtrohen në kërkesëpadi si dhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 dhe 185, të KPC-s objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përmblidhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit iura novit curia, analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve (shih, Vendimi Unifikues nr.3, datë 29.03.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 28).

13. Me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative të shkallës së parë, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në datën 04.11.2013, një pjesë e mosmarrëveshjeve që më parë gjykoheshin pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apeleve dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, tashmë u kaloi këtyre organeve të reja për shqyrtim. Gjykatat administrative (duke përfshirë këtu edhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë), duke qene se ushtrojnë një juridiksion

të ndryshëm nga ai i gjykatave të zakonshme, mund të gjykojnë vetëm atë gamë mosmarrëveshjesh të cilat ligji i posaçëm ua ka ngarkuar në mënyrë eksplicite. Juridiksioni përjashtimor, pikërisht duke qenë i ndryshëm nga ai i zakonshëm duhet të interpretohet në çdo rast në mënyrë të ngushtë. Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të përfshihet në sferën e kompetencave të gjykatës administrative atëherë në çdo rast kthehet tek rregulli, pra si pjesë e kompetencave të gjykatës së zakonshme (shih, vendimi nr.112, datë 08.06.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

14. Në këtë kuadër, për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative ose jo duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (shih, vendimi nr.2, datë 10.03.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23).

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se mosmarrëveshja në shqyrtim është e natyrës administrative. Referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë rezulton se nuk ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje civile por përpara një padie përmes së cilës kërkohet detyrimi i organit publik për të kryer një veprim administrativ, siç parashikohet në nenin 17, shkronja "ç", të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

16. Të dyja kërkimet e parashtruara nga paditësi në kërkesëpadi i kundrejtohen një organi publik, sikurse është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe përmes tyre kërkohet që ky organ publik të kryejë një veprim administrativ, konkretisht korrigjimin e skicës që i bashkëlidhet titullit të pronësisë si dhe pajisjen me certifikatë pronësie për këtë pronë.

17. Në nenin 17 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" përcaktohet se: "*Padia mund të ngrihet: (ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;*". Pra, kompetencën e shqyrtimit të çështjes objekt gjykim, për të detyruar organin publik të veprojë, në raste të tilla, e kanë gjykatat administrative.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-453, datë 21.09.2020

Çështja e juridiksionit në shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje përbën një nga prezumimet procedurale për vlerësimin e themelit të pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse. Prandaj identifikimi i mungesës së tij mund të bëhet edhe kryesisht nga gjykata, në çdo shkallë të gjykimit apo fazë të procesit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi T.K. i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 13.03.2018 kundër Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke kërkuar shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr.11, datë 24.01.2018, të palës së paditur, konkretisht pikës 2, mbi dhënien e masës disiplinore "vërejtje publike". Me vendim të ndërmjetëm Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi të bëjë kalimin procedural nga Këshill i Lartë i Drejtësisë tek Këshilli i Lartë Gjyqësor për shkak të krijimit të këtij të fundit sipas ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016, "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*".

2. Me shkresën nr.2441/4 prot., datë 26.11.205, Ministri i Drejtësisë ka depozituar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan T.K.. Për fillimin e këtij procedimi është marrë shkas nga shkeljet që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka konstatuar dhe i ka paraqitur ato pranë Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë me kërkesë për shkarkimin nga detyra të paditësit T.K..

3. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për masë disiplinore KLD-ja ka vlerësuar se me vendimin nr.17, datë 25.02.2015, ILDKPKI ka marrë ndaj paditësit masën administrative duke e gjobitur në shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë, për shkak se, përveç detyrës së tij si gjyqtar, ka qenë prej shumë vitesh aksionar aktiv në dy shoqëri private dhe ka përfituar të ardhura prej tyre, në kundërshtim me përcaktimet ligjore. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.1598, datë 26.03.2015.

4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar se gjyqtari T.K. duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore për shkak se ka cenuar marrëdhënien juridike rregulluar me anë të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", të ndryshuar, fakt që është konfirmuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.1598, datë 26.03.2015, e cila ka vlerësuar se paditësi e ka kryer kundërvajtjen administrative me veprimin e tij me dashje direkte, duke mos e zgjidhur konfliktin e interesit ndërmjet detyrës së tij publike dhe interesave private me të dyja shoqëritë aksionare. Në këto kushte KLD-ja ka vlerësuar se kjo përbën akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Shkelja e një ndalimi të tillë parashikohet edhe në nenin 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.

5. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar se veprimet e gjyqtarit përbëjnë shkelje disiplinore por nuk janë të tilla që të çojnë në shkarkimin e tij nga detyra. Në proporcion me këtë shkelje KLD-ja ka vlerësuar të rrëzojë kërkesën për shkarkim nga detyra të paditësit dhe, mbi bazën e propozimit të një anëtari të Këshillit, t'i japë paditësit një masë disiplinore më të lehtë, "vërejtje publike".

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1792 (1830), datë 10.05.2018, ka vendosur: *Deklarimin e moskompetencës lëndore në gjykimin e çështjes nr.2110 (1598), datë 13.03.2018.Kalimin e akteve pranë Gjykatës Kushtetuese.* [...]

7. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.28, datë 21.01.2020: *Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Kthimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.* 7.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar:

"*7. Kolegji paraprakisht çmon të theksojë se i vetmi rast kur gjyqtari i zakonshëm gjatë gjykimit të çështjes mund t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese parashikohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, si dhe neni 68/1 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar (ligji nr.8577/2000). Sipas këtyre dispozitave, gjyqtari i zakonshëm mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese vetëm për kontroll incidental të ligjit, kur e vlerëson ligjin të vesuar nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk mund t'i drejtohet asaj për të shqyrtuar ankimin individual.*".

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1232 (1248), datë 30.06.2020, ka vendosur: *Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.[...]*8.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar: [...] *kjo gjykatë vlerëson se pavarësisht se akti që kundërshtohet nga pala paditëse nuk është një akt i KLGJ-së por një akt i ish-KLD-së, përsëri ai tashmë, në bazë të nenit 179, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është i kundërshtueshëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.[...]*

9. Kundër vendimit nr.1232 (1248), datë 30.06.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim të veçantë pala paditëse, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

a) *Mbi përbërjen e trupit gjykues.*

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) konstaton se që nga data 04.11.2013, moment kur ka hyrë në fuqi ligji nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" (në vijim, ligji nr.49/2012), Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është kompozuar me trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh për të shqyrtuar ankimet e veçanta me objekt kundërshtimin e vendimeve jopërfundimtare apo të ndërmjetme të gjykatës që deklarojnë mungesën apo jo të juridiksionit. Pasi kjo çështje u bë objekt shqyrtimi në trupë gjyqësore u konkludua se, në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të ankimit të veçantë ndaj vendimit jopërfundimtar të gjykatës që disponon për juridiksionin do të gjykojë me trupë gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë. [...]

b) *Mbi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor*

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr.1232 (1248), datë 30.06.2020, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është marrë në interpretim dhe zbatim të saktë të ligjit, referuar rrethanave të faktit dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

14. Shkaqet e parashtruara nga pala paditëse, T.K., në ankimin e veçantë të paraqitur përpara Gjykatës së Lartë, janë të tilla që nuk do ta bënin të cenueshëm vendimin nr.1232 (1248), datë 30.06.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Për sa më sipër, çështja rezulton të jetë jashtë juridiksionit gjyqësor.

15. Ky Kolegj çmon të theksojë se çështja e juridiksionit në shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje përbën një nga prezumimet procedurale për vlerësimin e themelit të pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse. Rëndësia e këtij prezumimi procedural është e tillë sa identifikimi i mungesës së tij mund të bëhet edhe kryesisht nga gjykata, në çdo shkallë të gjykimit apo fazë të procesit.

16. Më tej, Kolegji çmon të theksojë se neni 140 i Kushtetutës, që

parashikon përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe rastet e shkarkimit, apo pezullimit nga detyra të tyre, në paragrafin 4 përcakton se "*kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese*". Ndërkohë, sipas dispozitave kalimtare të Kushtetutës, në nenin 179, pika 7, fjalia e dytë, parashikohet se është Kolegji i Apelimit, i cili ka mandat 9-vjeçar, që shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

17. Duke iu referuar dispozitave kushtetuese të lartpërmendura, kompetenca për të marrë në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor (i cili ka marrë kompetencat e KLD-së), për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, për periudhën e mandatit 9-vjeçar të funksionimit të Kolegjit të Apelimit, i është dhënë këtij të fundit.

18. Në lidhje me pretendimin e paditësit, të parashtruar në ankimin e veçantë të tij se, referuar nenit 9, pika 1, të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", gjykata duhet të vendoste dërgimin e akteve organit kompetent, në këtë rast Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ky Kolegj çmon të theksojë se një kërkimi të tillë i është dhënë përgjigje në vendimin nr.28, datë 21.01.2020, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me të cilin është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe kthimi i akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë rast paditësi duhet të kishte paraqitur ankim ndaj vendimit nr.11, datë 24.01.2018, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-505, datë 12.10.2020

Organet e administratës publike veprojnë jo vetëm si mbajtëse të pushtetit publik, por ato mund të shfaqen edhe si subjekte të qarkullimit civil, në pozitë të barabartë me subjektet private të së drejtës si mbajtëse të të drejtave dhe detyrimeve juridike civile, në marrëdhëniet private me të tretët. Kur kontratave të lidhura nga organet e administratës publike i mungon njëri prej elementëve për t'u konsideruar si kontratë publike si p.sh. ekzistenca e interesit publik, atëherë këto kontrata konsiderohen të së drejtës private.

I. Rrethanat e çështjes

1. Rezulton se, ndërmjet Komunës Drenovë dhe të padituri E.K. është lidhur kontratë qiraje më datë 11.11.2013, me objekt dhënien me qira të katit të parë të Vatrës së Kulturës, në fshatin Qatrom me sipërfaqe 158 m2, në pronësi të Komunës Drenovë dhe sot të Bashkisë Korçë, vërtetuar me certifikatën e pronësisë për pasurinë me nr.282/17, kundrejt shpërblimit në vlerën 100 lekë në muaj për m2, pra 158 m2 x 100 lekë = 15.800 (pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë. Kjo kontratë është lidhur me një afat 5-vjeçar.

2. Pra, nga i padituri çdo muaj duhej të paguhej qira mujore, detyrim që nuk është përmbushur prej tij. Në datën 05.10.2015, midis paditësit Bashkisë Korçë dhe të padituri E.K., është lidhur një akt-marrëveshje për pagimin me këste të vlerës së papaguar të detyrimit.

3. Nga ana e palës së paditur është kërkuar t'i jepej një afat më i gjatë për shlyerjen e detyrimeve të tij dhe me marrëveshje verbale të arritur midis tij dhe Bashkisë Korçë, u vendos si afat përfundimtar për shlyerjen e detyrimeve data 01.02.2017.

4. Prej palës së paditur në mënyrë të përsëritur nuk janë respektuar detyrimet kontraktore dhe në datën 01.03.2017, me kërkesë të tij dhe palës paditëse është lidhur serish një akt-marrëveshje me qëllim lehtësimin e situatës financiare të të padituri dhe shlyerjen e detyrimeve me këste. Edhe pas nënshkrimit të akt-marrëveshjes i padituri nuk ka shlyer asnjë këst sipas saj dhe as detyrimet mujore të qirave.

5. Nga ana e palës paditëse, të paditurit i është lënë afat që deri më datë 31.05.2018, që të shlyente të gjitha detyrimet e tij.

6. Në kushtet kur nga ana e të paditurit nuk u paguan detyrimet që rrjedhin nga kontrata e qirasë, me kërkesë të vetë të paditurit me nr.2132 prot., datë 29.09.2017, me të cilën ka kërkuar të dorëzojë ambientin e marrë me qira, më datë 09.10.2017, është mbajtur procesverbali për lirimin e ambientit dhe për rrjedhojë, është zgjidhur kontrata e qirasë.

7. Me shkresën nr.2254 prot., datë 24.04.2018, nga pala paditëse është njoftuar i padituri për përmbushjen e detyrimeve kontraktore, shkresë e cila është përsëritur edhe në datë 17.10.2018 me nr.7224/8 prot., duke kërkuar pagimin e detyrimeve të papaguara.

8. Në kushtet kur nga i padituri E.K. nuk janë shlyer detyrimet sipas kushteve të kontratës së qirasë të lidhur me ish Komunën Drenovë dhe akt–marrëveshje të mëvonshme midis tij dhe Bashkisë Korçë, është kërkuar në rrugë gjyqësore detyrimi i të paditurit të paguajë në favor të palës paditëse Bashkia Korçë detyrimin e papaguar duke përcaktuar të gjitha zërat dhe shumat përkatëse.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.41-2020-488 (168), datë 07.02.2020, ka vendosur: *Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për shqyrtimin e çështjes civile me br.Regj. Them 21235-01633-41-2019 (264/1465). datë. 25.09.2019, që i përket paditësit: Bashkia Korçë, të paditurit: E.K., me objekt: Përmbushje detyrimi kontraktor, që rrjedh nga kontrata e qirasë së datës 11.11.2013.[...].*

9.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se kompetente nga pikëpamja lëndore është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Sipas qëndrimit të Gjykatës çështja objekt gjykimi është e natyrës administrative për shkak të kontratës së qirasë të lidhur mes palëve ndërgjyqëse, kjo në referim të nenit 7 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka arsyetuar se gjykimi i mosmarrëveshjeve që lindin nga kontratat administrative të lidhura gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik janë kompetencë lëndore e gjykatës administrative.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr.(265)–00369 Regjistri Themeltar, datë 09.03.2020/25.06.2020 regj., ka vendosur: *"1. T'i kërkojë Gjykatës së Lartë të zgjidhë mosmarrëveshjen për kompetencën lëndore midis Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për gjykimin e kësaj çështje.*

10.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se mosmarrëveshja objekt gjykimi është një mosmarrëveshje civile, kjo pasi

kontrata e qirasë e lidhur midis palëve ndërgjyqëse nuk është një kontratë administrative por një kontratë civile e lidhur mes një personi juridik publik, palë paditëse dhe shtetasit E.K., palë e paditur në gjykim. Gjykata në qëndrimin e saj arsyeton se, që një akt-marrëveshje të konsiderohet kontratë administrative duhet që objekti i kontratës të ketë lidhje me kryerjen e atyre shërbimeve që janë në interes të publikut, karakteristika që nuk i ka kontrata e qirasë e lidhur midis palëve në rastin konkret. Vendimin e saj gjykata e bazon edhe në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës, konkretisht vendimin nr.107, datë 08.06.2020.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

11. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se, vendimi nr.41-2020-488 (168), datë 07.02.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale që rregullojnë çështjen e kompetencës lëndore të gjykatave dhe si i tillë duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në këtë gjykatë, me të njëjtin trup gjykues.

12. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale, me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtaria procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt (shih, vendimi nr.917, datë 11.05.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

13. Në vijim të këtij qëndrimi, Kolegji thekson se, për të përcaktuar nëse një mosmarrëveshje është e natyrës civile apo administrative, duhet t'u referohet jo vetëm dispozitave që përcaktojnë llojet e padive që bëjnë pjesë në sferën e kompetencës së njërës apo tjetrës gjykatë, por edhe kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e vetë kësaj Gjykate, duke pasur në konsideratë këtu, së pari, jurisprudencën nomofilatike të Gjykatës së Lartë (vendimet njësuese dhe ndryshuese të praktikës gjyqësore) dhe, së dyti, jurisprudencën konstante të saj.

14. Për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshjeje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin prima facie të saj. Ato duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të padisë, të së drejtës subjektive të

pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes (shih, vendimi nr.112, datë 08.06.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

15. Përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen "objekti i padisë" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata, kur zgjidh mosmarrëveshjen, merr në shqyrtim pretendimet e paditësit të cilat parashtrohen në kërkesëpadi si dhe gjatë ushtrimit të së drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185, të Kodit të Procedurës Civile (KPC) objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përmblidhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit *iura novit curia*, analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve (shih, Vendimi Unifikues nr.3, datë 29.03.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 28).

16. Me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative të shkallës së parë, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në datën 04.11.2013, një pjesë e mosmarrëveshjeve që më parë gjykoheshin pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apeleve dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, tashmë u kaloi këtyre organeve të reja për shqyrtim. Gjykatat administrative (duke përfshirë këtu edhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë), duke qenë se ushtrojnë një juridiksion të ndryshëm nga ai i gjykatave të zakonshme, mund të gjykojnë vetëm atë gamë mosmarrëveshjesh të cilat ligji i posaçëm u ka ngarkuar në mënyrë eksplicite. Juridiksioni përjashtimor, pikërisht duke qenë i ndryshëm nga ai i zakonshëm duhet të interpretohet në çdo rast në mënyrë të ngushtë. Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të përfshihet në sferën e kompetencave të gjykatës administrative atëherë në çdo rast kthehet tek rregulli, pra si pjesë e kompetencave të gjykatës së zakonshme (shih, vendimi nr.112, datë 08.06.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

17. Në këtë kuadër, për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative ose jo duhet që kumulativisht të plotësohen tre kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative

kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (shih, vendimi nr.2, datë 10.03.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23).

18. Mosmarrëveshjet administrative, duke qenë se i përkasin një juridiksioni të specializuar, duhet të sanksionohen në mënyrë posaçme nga ligji. Nëse një mosmarrëveshje nuk përcaktohet se i përket juridiksionit të gjykatave administrative, atëherë ajo, si rregull i përgjithshëm, mbetet në juridiksionin e gjykatave të zakonshme (gjykatat me juridiksion të përgjithshëm). Ky përfundim del nga interpretimi i nenit 135/3 të Kushtetutës. Përjashtimi është i tillë për sa kohë sanksionohet, në të kundërt kthehemi tek rregulli bazë (shih, vendimi nr.152, datë 28.02.2019, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se mosmarrëveshja në shqyrtim është e natyrës civile. Referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë rezulton se nuk ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje administrative por përpara një çështjeje me natyrë juridiko–civile, që rrjedh nga një marrëdhënie private.

20. Në çështjen në shqyrtim nuk konstatohet që kontrata e qirasë e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse të jetë një kontratë publike. Në këtë rast, ajo është një kontratë e të drejtës private, edhe pse njëra nga palët është një organ i administratës publike.

21. Organet e administratës publike veprojnë jo vetëm si mbajtëse të pushtetit publik, por ato mund të shfaqen edhe si subjekte të qarkullimit civil, në pozitë të barabartë me subjektet e tjera të së drejtës (subjektet private). Pra, organet administrative mund të jenë titullare të autoritetit shtetëror dhe njëkohësisht edhe mbajtëse të të drejtave dhe detyrimeve juridike civile, në marrëdhëniet private në të cilat hyjnë me të tretët.

22. Kontrata e qirasë e lidhur ndërmjet palëve në këtë rast është një kontratë tipike e të drejtës civile, ku organi publik, Bashkia Korçë, shfaqet me atributet e një subjekti të së drejtës private. Kësaj kontrate i mungon njëri prej elementëve për t'u konsideruar si kontratë publike, ekzistenca e interesit publik.

23. Në thelb, çdo veprimtari e organit publik në analizë të fundit ka

si qëllim primar realizimin e interesit publik. Madje edhe kontratat me natyrë më të qartë private të lidhura nga autoriteti publik, siç mund të jenë kontrata për furnizimin me ujë të pijshëm apo energji elektrike, ose kontrata e punësimit të punonjësve joadministrativë, në sfond kanë interesin publik, pasi përmes tyre krijohen kushtet e nevojshme për organin publik që të realizojë veprimtarinë e tij, e megjithatë kjo nuk i bën ato kontrata publike. Që një kontratë të cilësohet publike duhet që ajo, si qëllim primar dhe të drejtpërdrejtë, të ketë realizimin e një interesi publik (si p.sh., kontratat e prokurimit ose atë të koncesionit) dhe organi administrativ, si mbajtës i interesit publik në këtë kontratë, të jetë në një status më të privilegjuar se pala tjetër.

24. Kontrata e lidhur ndërmjet palëve, në çështjen në shqyrtim, është një kontratë e mirëfilltë juridiko–civile ku të dyja palët janë në një pozitë të barabartë, me të drejta dhe detyrime ekuivalente. Nga përmbajtja e saj nuk rezulton që ajo të ketë si qëllim primar dhe të drejtpërdrejtë realizimin e ndonjë interesi publik. Objekti i saj është dhënia me qira e një pasurie të paluajtshme. Për sa më sipër, çështja në shqyrtim është një mosmarrëveshje civile.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-507, datë 12.10.2020

Kompetencën funksionale të një gjykate administrative dhe kualifikimin e duhur ligjor të pretendimeve të palës ankuese e kryen gjykata. Ajo nuk e kryen formalisht, por duke u nisur nga rrethanat e faktit dhe dinamika e çështjes.

Vendimet e Gjykatës së Lartë, në mënyrë të veçantë për përcaktimin e kompetencës në gjykimin e një mosmarrëveshjeje, janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta kur shqyrtojnë çështje që i vijnë prej saj.

I. Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet vendimit nr. 322, datë 15.04.2015, "*Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, Rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit nga ana e qytetit, Ndriçimi i trotuarit në Parkun e Viroit nga ana e qytetit*", ka vendosur: "*1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit*".

2. Rezulton se Këshilli i Ministrave, me këtë vendim, ka shpronësuar pasuritë e z. G.C., me nr.: 310/13, 310/14, 310/15, 310/16, 310/17, 310/18, 310/19, 310/20, 310/21, 310/22, 310/23, 310/24, 310/25, në total 24.608 m² (njëzetekatërmijë e gjashtëqind e tetë metër katrorë).

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, nëpërmjet vendimit të saj nr. 383, datë 09.06.2016, ka vendosur: "*1. Pranimin e padisë pjesërisht; 2. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Zhvillimit Urban të shpërblejë palën paditëse për efekt shpronësimi në bazë të VKM-së nr.322, datë 15.04.2015, në shumën 119.717.920 lekë, në pjesët si vijon [...]; 3. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit dhe të padituri Bashkia Gjirokastër dhe Shoqëria A.L.*.

4. Pala paditëse, duke pretenduar se asaj i janë cenuar interesat e ligjshme mbi pronën e fituar nëpërmjet vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si trashëgimtare ligjore e ish-pronarit, i është drejtuar me padinë objekt gjykimi, në datën 10.05.2017, Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr.443, datë 18.07.2017, ka vendosur: "*1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. 2. Të urdhërojë palën e paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastër të hedhë gjurmën e projekteve në parkun e Viroit dhe të pajisë paditësit me certifikatë pronësie për pronën e mbetur nga shpronësimi nëpërmjet VKM-së nr.322, datë 15.04.2015, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në parkun e Viroit. 3. Të shpallë moskompetencën lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër për sa i përket kërkimit të paditësve [...]", duke urdhëruar dërgimin e akteve për kompetencë gjykimi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. 4. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesët e tjera të objektit të saj.".*

6. Kundër vendimit nr.443, datë 18.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, në pjesën që ka shpallur moskompetencën lëndore, ka paraqitur ankim të veçantë pala paditëse, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e akteve kësaj gjykate për vazhdimin e gjykimit, me të njëjtin trup gjykues.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr.392 akti, datë 24.07.2017, ka vendosur: "*1. Mospranimin e ankimit të ankuesit D.Z. bërë kundër vendimit nr.443, datë 18.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. [...]* 7.1. Në marrjen e këtij vendimi, kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se ndaj vendimit për shpalljen e moskompetencës nga ana e gjykatave administrative, sipas nenit 13 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" nuk lejohet ankim i veçantë por mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

8. Kundër vendimit br. 392 akti, datë 24.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ka paraqitur ankim të veçantë pala paditëse, duke kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe marrjen në shqyrtim të ankimit të veçantë kundër vendimit nr.443, datë 18.07.2017, të kësaj gjykate, në pjesën që ka shpallur moskompetencën lëndore [...]

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.5 (144), datë 23.01.2018, ka vendosur: "*Kthimin administrativ në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër të ankimit të paraqitur nga ankuesja D.Z. kundër vendimit nr.392, datë 24.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër*".

9.1. Në marrjen e këtij vendimi, kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se, referuar shkresës nr.3293/1 prot., datë 04.09.2017, të Kancelarit të Gjykatës

së Lartë, i është bërë me dije palës paditëse se ankimi i këtij vendimi paraqitet në gjykatën që ka dhënë vendimin, e cila pasi bën komunikimet përkatëse e dërgon dosjen në Gjykatën e Lartë, duke ia përcjellë sakaq ankimin në fjalë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Në këto kushte, Kancelaria e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, pasi të bëjë komunikimet përkatëse duhet t'ia përcjellë dosjen Gjykatës së Lartë, gjykatë të cilës i është drejtuar ankimi i veçantë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se kjo çështje nuk është në kompetencën funksionale të tij, por çështja duhet të shqyrtohet nga Gjykata Administrative e Apelit, si gjykata kompetente.

11. Referuar rrethanave të çështjes, siç janë parashtruar nga gjykatat e faktit, në këtë rast, rezulton se paditësja ka bërë ankim të veçantë ndaj vendimit nr. 392 akti, datë 24.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, për mospranimin e ankimit të veçantë kundër vendimit nr.443, datë 18.07.2017, të kësaj gjykate, në pjesën që ka shpallur moskompetencën lëndore.

12. Gjykata Administrative e Apelit, në mënyrë të gabuar ka vlerësuar se mosmarrëveshja lidhet me ankimin ndaj vendimit për shpalljen e moskompetencës lëndore nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Lidhur me këtë vendimmarrje, gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk e ka lejuar ankimin e veçantë, referuar nenit 13 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*".

13. Ky Kolegj thekson se në këtë rast mosmarrëveshja nuk lidhet me shqyrtimin e ankimit të veçantë kundër vendimit nr.443, datë 18.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, në pjesën në të cilën është shpallur moskompetenca lëndore e kësaj gjykate dhe dërgimi i akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Nëse gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër do të kishte lejuar ankim të veçantë kundër këtij disponimi (çka nuk do të ishte në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*") atëherë çështja do të ishte në kompetencën funksionale të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Megjithatë, ka rezultuar se gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr.392 akti, datë 24.07.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr.443, datë 18.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, në pjesën në të cilën

është shpallur moskompetenca lëndore e kësaj gjykate.

14. Kolegji vëren se në nenin 450 të KPC-s është parashikuar se: "*1. Gjyqtari i vetëm i gjykatës që ka dhënë vendimin, në dhomë këshillimi, menjëherë pas paraqitjes së ankimit, vendos mospranimin e ankimit kur: ... c) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim. ... 2. Kundër vendimit të mospranimit të ankimit mundet të bëhet ankim i veçantë.*". Nga ana tjetër, referuar nenit 442 të KPC-s, ankimet e veçanta shqyrtohen nga gjykata e apelit.

15. Në këtë rast, rezulton se vendimi nr.392 akti, datë 24.07.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me të cilën është vendosur mospranimi i ankimit kundër vendimit nr.443, datë 18.07.2017, të kësaj gjykate, në pjesën që ka shpallur moskompetencën lëndore, është një vendim i ndërmjetëm, pasi ai disponon mbi ankimin e veçantë kundër një vendimi të ndërmjetëm, sikurse është vendimi për shpalljen e moskompetencës. Mospranimi i ankimit kundër një vendimi do të jetë një vendim jo përfundimtar ose i ndërmjetëm, në varësi të vendimit kryesor, ankimin ndaj të cilit disponon. Duke qenë një disponim i prejardhur ai do të ndjekë fatin e vendimit, ankimin kundër të cilit shqyrton. Nëse ankimi shqyrtohet kundër një vendimi përfundimtar ose jo përfundimtar, mospranimi i ankimit merr natyrën e një vendimi jo përfundimtar, por nëse shqyrton ankimin kundër një vendimi të ndërmjetëm, ai konsiderohet vendimi i ndërmjetëm. 16. Arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit është haptazi i pabazuar. Kompetencën funksionale të një gjykate administrative nuk e përcakton as përmbajtja e një shkrese të Kancelarit të Gjykatës së Lartë dhe as fakti se kujt ia drejton ankimin pala, për më tepër kur kjo palë, gjatë të gjithë përshkrimit të mësipërm, rezulton se është krejtësisht e paorientuar në lidhje me mjetet e ankimit dhe forumin kompetent pranë të cilit ushtrohen.

17. Gjykata Administrative e Apelit nuk duhet të kishte bërë një shqyrtim formal të ankimit të paraqitur nga pala ankuese, D.Z., kundër vendimit nr.392 akti, datë 24.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, por duhet ta kishte kuptuar natyrën e mosmarrëveshjes duke u nisur nga rrethanat e faktit dhe dinamika e çështjes. Ajo duhet t'u kish bërë kualifikimin e duhur ligjor pretendimeve të palës ankuese dhe të mos nisej formalisht nga ajo çfarë shkruhet në ankim.

18. Në këto kushte, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se kompetente nga pikëpamja funksionale për gjykimin e ankimit kundër vendimit nr.392 akti, datë 24.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, është Gjykata Administrative e Apelit.

19. Ky Kolegj vlerëson të theksojë se, vendimet e Gjykatës së Lartë, duke qenë kjo e fundit është forumi më i lartë gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, e në mënyrë të veçantë për përcaktimin e kompetencës në gjykimin e një mosmarrëveshje, janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta kur shqyrtojnë çështje që i vijnë prej saj, qoftë kjo edhe në një mënyrë të tillë (shpallja e moskompetencës) që përbën një disponim jo të zakonshëm për të. Pra, në këtë rast, Gjykata Administrative e Apelit është e detyruar ta shqyrtojë çështjen, duke u identifikuar përfundimisht si gjykata kompetente nga pikëpamja funksionale.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-511, datë 12.10.2020

Praktika gjyqësore ka indentifikuar tri kushte kumulative për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative dhe që kanë të bëjnë me: njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik.

Për të përcaktuar saktë natyrën e një mosmarrëveshje gjykata nuk duhet të mjaftohet me kërkimin prima facie por të analizojë me kujdes të kërkimet e padisë, të drejtat subjektive dhe faktet e paligjshëm të pretenduara përkundrejt dispozitave të së drejtës objektive.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala paditëse E.C. i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi: "*Kërkoj ndryshimin e gjendjes gjyqësore nga "i dënuar" në "i padënuar", sipas nenit 69 të Kodit Penal (KP)-s dhe fshirjen e dënimeve në regjistrat përkatës të gjendjes gjyqësore*".

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 439, datë 23.09.2019, ka vendosur: Të shpallë moskompetencën lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër për shqyrtimin e çështjes administrative Nr.Regj.Them.544, datë regjistrimi 31.07.2019 dhe dërgimin e akteve për kompetencë gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Përmet. *"Gjykata çmon se duke vlerësuar shkakun ligjor të kërkimit ndodhemi përpara një gjykimi që përbën mosmarrëveshje që rregullohet nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s, siç është vërtetimi i qenies ose mosqenies në një marrëdhënie juridike si dhe pavërtetësia ose vërtetësia e një dokumenti.*

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, me vendimin nr. 04/22-2020-12, datë 14.01.2020 ka vendosur: Deklarimin e moskompetencës lëndore të Gjykatë së Rrethit Gjyqësor Përmet, për shqyrtimin e çështjes nr. 56(261/13000-00259) Regjistri Themeltar, datë regjistrimi 16.10.2019.

Dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykatë kompetente.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. s'ka, datë 06.02.2020 ka vendosur: Të ngrejë çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë përpara Gjykatës së Lartë për gjykimin e çështjes me nr. 1631 akti, që i përket: paditës E.C., palë e paditur Zyra e Gjendjes Gjyqësore pranë Ministrisë së Drejtësisë Tiranë me objekt "Kërkoj ndryshimin e gjendjes gjyqësore nga i dënuar në i padënuar, sipas nenit 69 të KP-s dhe fshirjen e dënimeve nga regjistrat përkatës të gjendjes gjyqësore.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se vendimi nr. 04/22-2020-12, datë 14.01.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke ia dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit, prandaj duhet të lihet në fuqi.

6. Kolegji Administrativ e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshjeje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

7. Kolegji Administrativ, në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes nëse është e natyrës civile apo administrative. Në rastin në shqyrtim, Kolegji e vlerëson të drejtë arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Gjykata ka përcaktuar drejt natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi, duke bërë një identifikim të elementëve dhe/ose kritereve ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore.

8. Për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshjeje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin prima facie të saj. Ato duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të padisë, të së drejtës subjektive të

pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes (shih vendimi nr.112, datë 08.06.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

9. Përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen "objekti i padisë" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata, kur zgjidh mosmarrëveshjen merr në shqyrtim pretendimet e paditësit që parashtrohen në kërkesëpadi, si dhe gjatë ushtrimit të së drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se, konform neneve 5, 31, 154 e 185, të KPC-s objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përmblidhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesë padisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit *iura novit curia*, analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve (*shih, Vendim Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 28*).

10. Me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative të shkallës së parë, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në datën 04.11.2013, një pjesë e mosmarrëveshjeve që më parë gjykoheshin pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apeleve dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, tashmë u kaloi këtyre organeve të reja për shqyrtim. Gjykatat administrative (duke përfshirë këtu edhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë), duke qenë se ushtrojnë një juridiksion të ndryshëm nga ai i gjykatave të zakonshme, mund të gjykojnë vetëm atë gamë mosmarrëveshjesh që ligji i posaçëm u ka ngarkuar në mënyrë eksplicite. Juridiksioni përjashtimor, pikërisht duke qenë i ndryshëm nga ai i zakonshëm duhet të interpretohet në çdo rast në mënyrë të ngushtë. Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të përfshihet në sferën e kompetencave të gjykatës administrative atëherë në çdo rast kthehet tek rregulli, pra si pjesë e kompetencave të gjykatës së zakonshme (*shih, vendimi nr. 112, datë 08.06.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

11. Në këtë kuadër, për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative ose jo duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës

publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (shih, vendimi nr. 2, datë 10.03.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23).12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se mosmarrëveshja në shqyrtim është e natyrës administrative. Referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë rezulton se nuk ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje juridiko-penale (e quajtur penalo-administrative në praktikën e gjykatave shqiptare), por përpara një padie përmes të cilës kërkohet detyrimi i organit publik për të kryer një veprim administrativ, siç parashikohet në nenin 17, shkronjat "b" dhe "ç", të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*".

13. Në nenin 17 të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" përcaktohet se: "*Padia mund të ngrihet: (b) për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ; (ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;*". Pra, kompetencën e shqyrtimit të çështjes objekt gjykim apo të rasteve të tjera analoge, për të detyruar organin publik të veprojë në raste të tilla, e kanë gjykatat administrative.

14. Sa më sipër, në analizë të kërkimit të palës paditëse E.C. dhe shkakut ligjor ku mbështetet objekti i kërkimit, rezulton se jemi përpara një padie për detyrimin e organit publik të veprojë në zbatim të funksioneve të ngarkuara nga ligj për rregullimin e aktit të kërkuar, vërtetimit të gjendjes gjyqësore, duke u pasqyruar paditësi si i rehabilituar për dënimet penale të marra prej tij.

15. Edhe pse instituti i rehabilitimit është një institut juridiko – penal, në thelb, paditësi, përmes padisë së tij, kërkon që të detyrohet organi publik që të kryejë një veprim administrativ dhe/ose i cili është refuzuar, duke pasqyruar në vërtetimin e gjendjes gjyqësore faktin e pretenduar prej tij, rehabilitimin apo pasqyrimin e shënimeve si i padënuar.

16. Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet marrë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe për rrjedhojë, ky vendim duhet të lihet në fuqi, por i tërhiqet vëmendja pasi do të duhej të parashtronte vetë konfliktin e kompetencës pranë Gjykatës së Lartë.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00–2020-563, datë 12.10.2020

Sipas ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", një kategori punonjësish rregullohen me ligj të posaçëm si p.sh. ligji nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut". Për shkak të funksionit atipik që ushtrojnë, marrëdhëniet e punës për këta punonjës rregullohen nga ligji i posaçëm por brenda formës së kontratës së shërbimit publik. Është e rëndësishme që në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative që lidhen me këto kategori të shërbimit publik, gjykata në fazën e verifikimit të kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes, shqyrtimit të natyrës së mosmarrëveshjes dhe kërkimeve konkrete të padisë duhet të mbajnë parasysh referimin te legjislacioni i posaçëm.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se pala paditëse I.H. ka punuar pranë palës së paditur si Nënprefekti i Sarandës, Qarku Vlorë, prej datës 16.10.2013.

2. Me urdhrin nr.1338, datë 19.12.2017 të Ministrit të Brendshëm, është vendosur lirimi nga detyra e palës paditëse I.H..

3. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar, se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë sipas objektit të saj.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2019-89/31, datë 21.01.2019, ka vendosur: Të deklarojë moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për shqyrtimin gjyqësor të çështjes civile me nr. 21249-00707-23-2018-797/83 regjistrimi, datë 19.06.2018 regjistrimi. Dërgimin e akteve për gjykim, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, si gjykatë kompetente.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 155, datë 25.03.2019, ka vendosur: Të parashtrojë përpara Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore, midis Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se vendimi nr. 23-2019-89/31, datë 21.01.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit, prandaj ky vendim do të lihet në fuqi.

7. Kolegji Administrativ e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

8. Kolegji Administrativ në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes nëse është e natyrës civile apo administrative. Në rastin në shqyrtim, Kolegji e vlerëson të drejtë arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Gjykata ka përcaktuar drejt natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi, duke bërë një identifikim të elementeve dhe/ose kritereve ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore.

9. Kolegji Administrativ çmon se, sipas parimit *iura novit curia*, pavarësisht nga vështrimi që ka paditësi mbi ligjin e zbatueshëm, përbën detyrim për gjykatën që, për identifikimin dhe përcaktimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes, të vlerësojë vetë ligjin që është i zbatueshëm lidhur me funksionin publik të Nënprefektit, që ka mbajtur pala paditëse.

10. Në shkronjën "ç", të nenit 7, të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", parashikohet se janë mosmarrëveshje administrative dhe gjykohen nga gjykatat administrative: "*mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës*".

11. Paditësi I.H. ka mbajtur detyrën e Nënprefektit të Sarandës, prandaj, në çështjen objekt shqyrtimi, marrëdhënia juridike mbi të cilën ka lindur mosmarrëveshja rregullohet nga ligji i veçantë nr.107/2016 "Për

Prefektin e Qarkut". Ky ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra për zbatim të tij, përbëjnë rregullim të posaçëm në kuptim të nenit 7, shkronja "ç", të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

12. Referuar neneve 21 dhe 22, të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", parashikohet: *"Neni 21 Administrata e prefektit të qarkut dhe burimet e financimit [...] "Neni 22 Nënprefekti [...] 2. Nënprefekti emërohet apo lirohet, me propozim të prefektit të qarkut, nga ministri.*

13. Në interpretim të dispozitave të sipërcituara, *Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e gjen me vend të parashtrojë se ekzistojnë një kategori punonjësish, të cilët merren në punë në administratën publike sipas një procedure të veçantë, që rregullohet nga ligji i posaçëm dhe se ndodhemi përpara një marrëdhënie kontraktore në formën e kontratës së shërbimit publik, për shkak të funksionit atipik që ata ushtrojnë.*

14. Në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", parashikohet emërimi dhe lirimi nga funksioni publik i Nënprefektit dhe Prefektit. Është e kuptueshme se ligji nuk mund të bëjë një rregullim më të hollësishëm dhe, për më tepër, shterues të marrëdhënies juridike të shërbimit publik për këto dy funksione publike. Megjithatë, ky ligj, në pikat 3 dhe 4, të nenit 22, i ka përcaktuar dhe ndarë qartë dy kategoritë e punëmarrësve që janë në përbërje të administratës së Prefektit të Qarkut, që janë: "nëpunësit" e administratës që ushtrojnë funksione dhe detyra të posaçme për vetë natyrën e funksionit dhe të kompetencave që ligji i njeh Prefektit dhe që, për këtë shkak, përfshihen në kategorinë dhe statusin e "nëpunësit civil" (pika 3); "punonjësit administrativë" të administratës së prefektit të qarkut, që ushtrojnë detyra me karakter të përgjithshëm a mbështetës në veprimtarinë e prefekturës dhe që, pikërisht për këtë shkak, përfshihen në kategorinë e punonjësve të zakonshëm të administratës publike, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas Kodit të Punës.

15. Kolegji vlerëson se ligji nr. 107/2016 nuk përmban rregulla të posaçme, të shprehura lidhur me natyrën e funksionit publik të prefektit të qarkut, si edhe të nënprefektëve. Megjithatë, ky ligj qartazi, në nenin 1 të tij përcakton se prefekti i qarkut është përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku. Pra, qartazi e përcakton këtë funksion publik, si një funksion me natyrë politike.

16. Për vetë rëndësinë që paraqet nënprefekti, si një funksionar i rëndësishëm në ndihmë të prefektit, në ligjin nr. 107/2016 është evidentuar qartazi pozicioni i tij, duke e dalluar edhe nga kategoria e nëpunësve civilë dhe e punonjësve administrativë. Natyra e këtij funksioni publik evidentohet në mënyrë të shprehur në nenin 22 të këtij ligji, i titulluar "Nënprefekti", ku janë parashikuar disa elementë të rëndësishëm që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së tij shtetërore. Kolegji vlerëson se parashikimet ligjore të cilat përcaktojnë mënyrën e emërimit dhe të shkarkimit të nënprefektit, funksionin dhe misionin e tij në mbështetje të veprimtarisë së prefektit të qarkut, shtrirjen e kompetencave në një ose më shumë bashki në zbatim të ligjit për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë, llogaridhënien që evidentohet nëpërmjet varësisë hierarkike nga prefekti, si dhe strukturën administrative që ka në varësi të drejtpërdrejtë, janë rregullime ligjore, të cilat ligjvënësi ka vlerësuar, në këtë rast, për t'i sanksionuar në norma të posaçme.

17. Për këto arsye, në *kuptim të nenit 7, shkronja "ç", të ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", për shkak të funksionit dhe të rolit të nënprefektit, duhet që gjykatat në fazën e verifikimit të kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes të mbajnë parasysh referimin të legjislacioni i posaçëm, që në këtë rast është ligji nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut". Për rrjedhojë, në raste të tilla, kompetencën lëndore për të marrë në shqyrtim çështjen e ka gjykata administrative, e cila gjatë shqyrtimit të natyrës së mosmarrëveshjes dhe kërkimeve konkrete të padisë, si dhe duke pasur parasysh ligjin e zbatueshëm dhe praktikën gjyqësore për këto raste, do të duhet të vlerësojë nëse kërkesë padia, e ngritur nga një ish-funksionar i tillë, nënprefekti, për të kërkuar dëmshpërblime për lirimin nga funksioni, gjen ose jo mbështetje në ligj.*

18. Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi nr.23-2019-89/31, datë 21.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me të cilin është shpallur moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes, duhet të lihet në fuqi.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00–2020–572, datë 12.10.2020

Kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, pra nëse është me natyrë civile apo administrative. Përcaktimi i drejtë i kompetencës lëndore përmes identifikimit të elementeve dhe/ose kritereve ligjore, është shumë i rëndësishëm në garantimin e një procesi të rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/ kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala paditëse M.B. dhe Shoqëria "M" SHPK, kanë lidhur një kontratë qiraje nr.786 rep., nr.177 kol., datë 09.04.2015 dhe kontratën nr.565 rep., nr.111/1 kol., datë 12.03.2019, për pasurinë nr. 2/82-N2, ZK 8380, me sip.60 m2 e llojit dyqan, ndodhur në Rr. "Durrësit" Tiranë.

2. Pala e paditur në datën 25.01.2019, ka ushtruar kontroll pranë ambienteve të palës paditëse dhe nga ana e grupit të kontrollit është konstatuar se matësi i ujit e ka vulën e Ujësjellës Kanalizime Tiranë (UKT) të këputur dhe për këtë është mbajtur akt konstatimi nr. 000484, datë 25.01.2019.

3. Pala e paditur, për sa më sipër ka mbajtur procesverbalin nr. 000213, datë 25.01.2019 dhe është vendosur të dënohet me gjobë në masën 50.000 lekë për shkatërrim apo dëmtim me dashje, duke këputur vulën e UKT-s.

4. Pala paditëse pretendon se ka ushtruar ankim administrativ pranë UKT-s, por nga ana e saj nuk është kthyer asnjë përgjigje.

5. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar, se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë sipas objektit të saj.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2679, datë 12.04.2019 ka vendosur,shpalljen e moskompetencës lëndore të shqyrtimit të kësaj çështjeje prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e akteve për kompetencë lëndore Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.Regj. Them.2626, datë 03.05.2019 ka vendosur, të ngrejë kryesisht çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë përpara Gjykatës së Lartë për gjykimin e çështjes me nr. 2626 31154-02770-80-2019 akti, që u përket paditësve M.B. dhe Shoqëria "M" SHPK.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se vendimi nr. 2679, datë 12.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit, prandaj ky vendim do të lihet në fuqi.

9. Kolegji Administrativ e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshjeje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

10. Kolegji Administrativ, në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes nëse është e natyrës civile apo administrative. Në rastin në shqyrtim, Kolegji e vlerëson të drejtë arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata ka përcaktuar drejt natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi, duke bërë një identifikim të elementëve dhe/ose kritereve ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore.

11. Duke u rikthyer në çështjen objekt shqyrtimi, rezulton se pala paditëse kërkon shfuqizimin e masës administrative "Dënim me Gjobë" në vlerën 50.000 lekë, të vendosur me Procesverbalin nr.000213, datë 25.01.2019 nga grupi i verifikimit të Ujësjellës Kanalizime Tiranë për kontratën nr. 157211, pasi është konstatuar se matësi i ujit e ka vulën e UKT të këputur.

12. Kolegji çmon se në analizë të kërkimit të palës paditëse, duke vlerësuar shkakun ligjor të kërkimit, ndodhemi përpara një gjykimi që përbën mosmarrëveshje administrative që rregullohet nga dispozitat e ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve*

administrative", siç janë mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike. Ky fakt rezulton nga përmbajtja e nenit 7, shkronja "a", e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit: "*Gjykatat administrative janë kompetente për:a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik*".

13. Ligji nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", në nenin 2, pika 6, ka përcaktuar se, cili institucion do të cilësohet si organ publik dhe konkretisht parashikon se: *"....6."Organ publik" është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, çdo strukturë tjetër, punonjësit e së cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, që i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike....".*

14. Në interpretim të dispozitës së sipërcituar konsiderohet organ publik, ai institucion ose person fizik apo juridik, të cilit ligji i ka njohur të drejtën e ushtrimit të funksioneve publike dhe në rastin konkret, në çështjen objekt shqyrtimi, pala e paditur Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA, nuk paraqitet si shoqëri tregtare, e cila ka për qëllim vetëm realizimin e fitimeve private, por shfaqet më gjerë se kaq, në cilësinë e organit publik, pasi është duke ushtruar një shërbim publik në funksion të interesit publik, atë të furnizimit me ujë të pijshëm dhe për këtë arsye, për mbrojtjen e interesit publik merr masa administrative.

15. Gjykata Kushtetuese, në një çështje të ngjashme, midis të tjerave ka arsyetuar se "*..23. Duke pasur parasysh këto konsiderata të përgjithshme, kjo Gjykatë çmon se furnizimi me energji elektrike, si shërbim me interes të përgjithshëm meriton vëmendje dhe trajtim të posaçëm nga ligjvënësi për dy arsye: (i) për shkak të situatës monopol të CEZ SHA aktualisht; (ii) për shkak të specifikës së shërbimit. Vazhdimësia, cilësia dhe aksesueshmëria e këtij shërbimi duhet t'u ofrohet të gjithë konsumatorëve pa përjashtim, sipas kritereve specifike ligjore. Për më tepër, trajtimet specifike ligjore, me synim që të garantohet aksesi i çdo individi në mallrat dhe shërbimet bazë/jetike, janë të domosdoshme, sepse këto shërbime ndikojnë në cilësinë e jetës dhe janë një parakusht për gëzimin e shumë të drejtave të tjera themelore të individit...". (shih, vendimin nr.52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

16. Në vijim të vendimit të sipërcituar Gjykata Kushtetuese arsyeton se *"....30. ..... Në legjislacionin mbi sektorin e energjisë elektrike ka parashikime të hollësishme mbi trajtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve dhe konsumatorëve, duke i dhënë Entit Rregullator të Energjisë Elektrike kompetencën e trajtimit administrativ të ankesave të konsumatorëve, në rast të mosmarrëveshjeve mes furnizuesit dhe konsumatorëve. Po në këtë drejtim mund të theksohet dhe detyrimi i aprovimit të "Kontratës Tip" të furnizimit me energji elektrike ndërmjet konsumatorëve tarifore dhe furnizuesit, nga ERE, institucion i pavarur mbikëqyrës për ruajtjen e ekuilibrave ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike. Në këtë kontratë është parashikuar një procedurë e detajuar e verifikimit të ankesave nga furnizuesi, e pezullimit të ekzekutimit të faturës për faturime dukshëm të larta si dhe anulimit tërësisht ose pjesërisht të faturës së energjisë elektrike, në rast se ankimi qëndron, duke garantuar mbrojtje të interesave të konsumatorëve nëpërmjet një procesi administrativ...".*

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, thekson se në të njëjtën linjë arsyetimi për sa më sipër në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, pranohet dhe gjen zbatim edhe për UKT sha, i cili kontrollohet dhe mbikëqyret nga ERRU sipas ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*". Ashtu sikurse arsyetohet nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me ERE, edhe ligji për ERRU parashikon një procedurë të detajuar për verifikimit e ankesave nga çdo person i interesuar, duke garantuar mbrojtje të interesave të konsumatorëve nëpërmjet një procesi administrativ, në përputhje me KPA-n.

18. Sa më sipër, në analizë të kërkimit të palës paditëse M.B. dhe Shoqëria "M" SHPK kërkohet shfuqizimi i aktit administrativ, masa administrative e gjobës të nxjerrë nga organi publik UKT sha, i cili në rastin konkret nuk shfaqet thjesht si operator tregtar por si organ që ushtron funksionin publik.

19. Ky Kolegj, në referim të analizës së sipërcituar vlerëson se çështja konkrete përbën një mosmarrëveshje administrative dhe është e bazuar në nenet 7 dhe 17, të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", dhe për të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e çështjes.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-793-2020, datë 12.10.2020

Kriteri material i kontratës që përcakton përmbajtjen e saj, së bashku me cilësinë e subjekteve i japin veprimit juridik të ndërmarrë ndërmjet palëve karakterin e kontratës administrative. Për rrjedhojë, shërbimi publik që një kontratë siguron nëpërmjet ekzekutimit të saj bën që ky veprim juridik të kualifikohet si kontratë administrative.

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse ka paraqitur padi më datë 05.12.2016 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezulton se pala paditëse është një subjekt tregtar që e ushtron aktivitetin ekonomik në fushën tregtimit të mallrave elektrike. Ndërmjet palëve ndërgjyqëse është hartuar një kontratë huapërdorje, me anën e së cilës pala paditëse, me cilësinë kontraktore të palës huadhënëse, i ka dhënë me huapërdorje palës së paditur, me cilësinë kontraktore të huapërdoruesit, 52 copë ndriçues të tipit UCO-ECL KIT, me vlerë 591 USD. Gjithashtu me hua janë dhënë edhe 5 koka portollampash. Koha e zgjatjes së kësaj marrëdhënieje është përcaktuar të jetë 28.5 muaj dhe garancia ka qenë parashikuar 3 vjet. Për të dokumentuar dorëzimin e materialeve është hartuar edhe fatura përkatëse e administruar në dosje, në të cilën paraqitet edhe shuma respektive që detyrohej të paguante huapërdorësi. Materialet e marra në dorëzim janë përdorur për ndriçimin e rrugëve. Duke qenë se palët kanë pasur mosmarrëveshje lidhur me ekzekutimin e kontratës dhe me pagesat, pala paditëse i është drejtuar me padinë objekt gjykimi gjykatës. Në kontratën e hartuar nga palët dhe në aktet e marrjes në dorëzim të ndriçuesve pasqyrohet se ato do të përdoreshin nga Bashkia Lezhë për të ndriçuar rrugët e qytetit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr.92, datë 14.02.2017 ka vendosur:

"*1. Të deklarojë moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për gjykimin e çështjes nr.244/1137 akti. 2. Dërgimin e akteve të kësaj dosjeje gjyqësore për kompetencë gjykimi Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Shkodër.*".

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr.26/74/388/1244 (31025-00288-83-2017) Regjistri Themeltar, datë 29.07.2020 ka vendosur:

"*T'i parashtrojë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për zgjidhje mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në lidhje me çështjen gjyqësore nr.26/74/388/1244 (31025-00288-83-2017) Regjistri...*". Gjykata administrative ka vlerësuar se në këtë rast nuk jemi para një kontrate administrative pasi nuk është lidhur si pasojë e një procedure prokurimi publik. Në këto kushte gjykata administrative ka vlerësuar se kompetente për shqyrtimin e çështjes është gjykata civile dhe për rrjedhojë, ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës civile dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes në atë gjykatë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë dhe vendimet e gjykatave në mosmarrëveshje për kompetencën lëndore, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.49/2012, çmon se parashtresa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është e pabazuar në ligj dhe se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është i bazuar në ligj dhe se ai duhet të lihet në fuqi.

6. Kolegji vlerëson se kriteri ligjor për të konkluduar nëse një kontratë është civile apo administrative nuk mund të jetë vetëm fakti nëse është formësuar në bazë të një procedure prokurimi publik apo jo. Sigurisht që procedura e prokurimit publik është forma me të cilën autoriteti publik kontrakton të drejtat dhe detyrimet sipas ligjit me të tretët dhe kjo procedurë është e rëndësishme, por ajo nuk mund të jetë kriteri i vetëm për kualifikimin e një fakti juridik si kontratë administrative apo jo.

7. Një veprim juridik, që përbën kontratë administrative, mund të realizohet faktikisht edhe pa këtë procedurë ligjore të lidhjes së kontratës, qoftë sepse ligji e lejon por në rastet kur ligji nuk e lejon dhe duke e shkelur atë. Por në të dy këto raste nuk mund të konkludohet se veprimi juridik i realizuar në fakt nuk është kontratë administrative kur del e qartë për nga përmbajtja e të drejtave dhe e detyrimeve se veprimi juridik ka krijuar, ndryshuar dhe shuar një marrëdhënie juridike të së drejtës publike. Në këtë mënyrë Kolegji vlerëson se analiza juridike e kualifikimit të faktit si kontratë administrative apo jo nuk mund të fillojë dhe të mbarojë vetëm me verifikimin e këtij kriteri dhe se arsyetimi i gjykatës administrative në

parashtresë konkludohet se është i pabazuar në ligj.

8. Kolegji sjell në vëmendje të gjykatave se në çdo rast analiza e konkluzionit nëse një kontratë është apo jo administrative duhet të nisë nga përkufizimi dhe rregullimi ligjor i saj. Kështu, neni 3, pika 4, e Kodit të Procedurave Administrative (KPA) ka parashikuar se: "*Kontrata administrative është një marrëveshje e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas të drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik.*". Sipas këtij përkufizimi ligjor, që të kualifikohet saktë juridikisht, sipas nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe nenit 17 të ligjit nr.49/2012, një kontratë si administrative apo jo, për efekt të identifikimit të kompetencës lëndore gjyqësore të shqyrtimit të mosmarrëveshjes, duhet të plotësohen dy kritere në mënyrë kumulative si më poshtë: 1) *kriteri organik*; 2) *kriteri material.*

9. Kriteri organik lidhet me cilësinë e njërit prej subjekteve palë në kontratë dhe që detyrimisht duhet të jetë organ i administratës publike. Plotësimi i këtij kriteri të vetëm, sikurse deduktohet nga përkufizimi ligjor, nuk mjafton për ta kualifikuar kontratën si kontratë administrative. Ai duhet të lidhet detyrimisht me kriterin material.

10. Kriteri material ka të bëjë me natyrën juridike të kontratës dhe përmbajtjen e saj. Pra, ajo duhet të jetë e tillë, që të krijojë, ndryshojë apo shuajë një marrëdhënie juridike sipas të drejtës publike. Duke pasur parasysh elementët e marrëdhënies juridike, për të dalluar rast pas rasti nëse jemi para kontratës administrative apo jo, do të shohim objektin si dhe të drejtat apo detyrimet që ajo krijon. Ky kriter mund të paracaktohet nga ligji i cili mund të përcaktojë nominalisht se cilat janë kontrata administrative në qarkullimin civil. Por, nëse nuk paracaktohet nga ligji, i përket gjykatës, rast pas rasti, të vlerësojë dhe kualifikojë natyrën e kontratës në fjalë. Në këto raste funksioni publik do të duhet të identifikohet edhe si pasojë e marrëdhënies juridike-publike të rregulluar në këtë kontratë dhe të shërbimit komunitar apo publik që ofrohet nëpërmjet pasojave juridike që rrjedhin nga zbatimi i kontratës.

11. Kolegji vlerëson se, kriteri material, sikurse u parashtrua më sipër, ose lidhet me objektin e kontratës, i cili mund të jetë ofrimi i një shërbimi publik, ose lidhet me të drejtat dhe detyrimet e palëve, ku vihet re epërsia apo pozita e privilegjuar e palës shtet në raport me palën tjetër. Ofrimi i një shërbimi publik do të thotë përfshirje e një subjekti privat në ekzekutimin e një shërbimi publik. Ky ekzekutim duhet të jetë real, i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm. Nëpërmjet kësaj kontrate personi publik duhet të delegojë plotësisht ose një pjesë të ekzekutimit të shërbimit publik, në mënyrë të tillë që subjekti privat duhet të ketë kontribut në shërbimin publik.

12. Nga ana tjetër, nëse objekti i kontratës nuk është ofrimi i një shërbimi publik, gjykata për të vlerësuar natyrën juridike të kontratës rast pas rasti, do të marrë në analizë ato klauzola apo dispozita të kontratës që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në doktrinën juridike dhe në jurisprudencën gjyqësore[29], klauzolat e kontratës që i japin epërsi palës shtet në të drejta, ndryshe quhen klauzola të nënshtrimit të palëve ndaj të drejtës publike apo që i atribuojnë personit publik një pozicion superioriteti në raport me palën tjetër, duke i vendosur sakaq në pozita të pabarabarta. Këto klauzola janë jo të zakonshme në një kontratë klasike tipike midis dy subjekteve private dhe që rregullohet nga e drejta private (p.sh., e drejta e palës shtet për t'u tërhequr në mënyrë të njëanshme nga kontrata, kufizimi i lirisë kontraktore apo autonomisë së vullnetit etj.,). Kjo do të thotë se nëse të tilla klauzola do të ishin pjesë e një kontrate tipike midis dy subjekteve privatë dhe që rregullohet nga e drejta private, kjo e fundit do të ishte e paligjshme, sepse palët në një kontratë të tillë gëzojnë të drejta të barabarta. Kështu, nëse nga përmbajtja e kontratës del se palët janë në pozita të barabarta, apo nuk rezultojnë klauzola jo tipike që e vendosin palën publike në raport epërsie, atëherë kjo kontratë do të jetë një kontratë e zakonshme, që rregullohet nga e drejta private dhe jo një kontratë administrative.

13. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vlerëson se kontrata, nga zbatimi i së cilës ka rrjedhur mosmarrëveshja dhe padia objekt gjykimi, është një kontratë huapërdorjeje e ndriçuesve që është realizuar ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Nga ana tjetër, këto sende të kontraktuara nga Bashkia Lezhë janë përdorur si ndriçues rruge, nga ku qartë konkludohet se sendet e marra në posedim nëpërmjet kësaj kontrate janë përdorur për të siguruar ndriçimin e rrugës dhe se nga ky veprim përfiton qyteti dhe i gjithë komuniteti përdorues i rrugës. Në këtë kuptim, konstatohet se sendet e marra në posedim nga pala e paditur nëpërmjet kontratës shërbejnë për të garantuar një shërbim publik në Bashkinë e Lezhës dhe se si të tilla i japin karakterin e kontratës administrative veprimit juridik të ndërmarrë ndërmjet palëve. Për rrjedhojë, shërbimi publik që kjo kontratë siguron nëpërmjet ekzekutimit të saj bën që ky veprim juridik të kualifikohet si kontratë administrative.

[29] Shih, vendimin nr.30701, datë 31.07.1912 të Këshillit të Shtetit të Republikës së Francës. Në këtë Vendim precedent, Këshilli i Shtetit për herë të parë elaboroi kriteret jurisprudenciale për kualifikimin rast pas rasti të kontratës administrative sa herë që gjyqtarit të juridiksionit administrativ do t'i lindte çështja e kompetencës lëndore.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.31003-2224-2019, datë 12.10.2020

Gjykimi i padive që lidhen me çështjet zgjedhore është në kompetencën lëndore të Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkesa objekt gjykimi është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë më datë 30.07.2019.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr.23-2019-1522/680, datë 12.09.2019 ka vendosur: "*Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për shqyrtimin e çështjes nr. regj. them. 2126-01165-23-2019, datë 10.09.2019 regjistrimi, duke ia çuar për gjykim këtë çështje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër*.". Gjykata e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm ka vlerësuar se kërkimet në padi kanë natyrë juridike administrative. Për rrjedhojë, ajo ka deklaruar mungesën e kompetencës lëndore kryesisht dhe e ka dërguar çështjen pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me vendimin nr.506, datë 16.10.2019 ka vendosur: "*Të parashtrojë përpara Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen lidhur me kompetencën lëndore të gjykimit të çështjes midis Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër*." Gjykata administrative ka arsyetuar se nuk ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes, pasi sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kompetente për gjykimin e saj është Kolegji Zgjedhor. Për rrjedhojë, gjykata administrative i është drejtuar me parashtresë qëndrimi mbi kompetencën Gjykatës së Lartë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë dhe vendimet e gjykatave në mosmarrëveshje për kompetencën lëndore, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.49/2012 dhe

nenit 45 të Kodit Zgjedhor, çmon se parashtresa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është e bazuar në ligj. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka nevojë që të ndryshohet në pjesën e individualizimit të gjykatës kompetente.

5. Kolegji sjell në vëmendje se neni 145 i Kodit Zgjedhor në fuqi në kohën e ngritjes së padisë në gjykatë (*shih, neni 36 dhe 41 i Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s*) parashikon se: "*1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të KQZ, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor. 2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ për të marrë vendim. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat "a", "b" "c" dhe "ç" të nenit 24 të këtij Kodi. 3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ)e, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij kodi.*".

6. Kolegji vlerëson se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që të krijojë një gjykatë të posaçme me juridiksion lëndor të posaçëm dhe me juridiksion tokësor kombëtar që të shqyrtojë të gjitha mosmarrëveshjet për sa u përket pretendimeve për pavlefshmërinë e zgjedhjeve apo pavlefshmërinë e mandateve. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se një padi e tillë hyn në kompetencën lëndore të Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-00440-2015, datë 26.10.2020

Aksesi në gjykatë konsiston jo vetëm në të drejtën për t'iu drejtuar formalisht gjykatës, por për t'u dëgjuar thelbësisht në lidhje me çështjet e faktit dhe ato të ligjit, dhe respektimin me rigorozitet të dispozitave procedurale nga ana e gjykatës. Ai nënkupton marrjen e një vendimi përfundimtar nga pushteti gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e zakonshme të ankimit.

Gjykata mund të vendosë kthimin e ankimit në rrethanat kur ky i fundit nuk i plotëson elementët formalë për t'u marrë në shqyrtim, vetëm pas njoftimit të ankuesit në lidhje me këto të meta dhe përfundimit të afatit ligjor për ndreqjen e tyre.

Individi ankues duhet të ketë të njëjtat garanci procedurale pavarësisht nga shkalla e gjykimit dhe përbërja e trupës gjykuese pasi rregullimet e procesit gjyqësor administrativ janë të njëjta për sa kohë bëhet fjalë për të njëjtat pasoja.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësja A.O. ka kryer studimet e larta në Akademinë e Rendit, për periudhën 1995 – 1999.

2. Përgjatë periudhës 1999 – 2009 paditësja nuk ka marrë emërim nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Brendshme.

3. Me urdhrin nr.240/1, datë 17.09.2009 paditësja emërohet në detyrën "Ndihmës specialiste (operatore për administrimin e dokumenteve)", Seksioni për Edukimin dhe Sigurinë Rrugore, Sektori i Policisë Rrugore, në Drejtorinë e Policisë, Qarku Tiranë, duke iu dhënë me këtë akt grada policore "Inspektor".

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.4918, datë 06.05.2013, ka vendosur: *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i njohë paditëses katër vite vjetërsi shërbimi në strukturat e Policisë së Shtetit. Detyrimin e të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i japë paditëses A.O. gradën policore "N/Komisar". Detyrimin e të paditurit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i paguajë paditëses diferencat e papaguara që i korrespondojnë gradës "N/Komisar", nga data 17.01.2009 deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi. Rrëzimin e kërkesëpadisë për kërkimet e tjera.*

5. Kundër vendimit nr.4918, datë 06.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.357, datë 11.02.2014, ka vendosur: *Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes nr.2318 regj. Them, datë 22.10.2013. Dërgimin e çështjes për kompetencë shqyrtimi Gjykatës Administrative të Apelit.*

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.897, datë 19.03.2014, ka vendosur: *Mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr.4918, datë 06.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

7.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se përfaqësuesi me autorizim i palës së paditur nuk ka pasur tagër për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të shkallës së parë, por vetëm për ta përfaqësuar këtë palë në gjykim. Në kushtet kur ankimi nuk është nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar dhe nuk përmban as vulën e institucionit, ankimi është i papranueshëm.

8. Kundër vendimit nr.897, datë 19.03.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr.4918, datë 06.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, [....].

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

b) Në lidhje me themelin e çështjes

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi është paraqitur brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, të parashikuar në nenin 443/2 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) -s. Gjithashtu, rekursi i është komunikuar palës paditëse, që nuk ka paraqitur kundërrekurs.

17. Rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", që do ta bënin të cenueshëm vendimin nr.897, datë 19.03.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit.

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një interpretim të gabuar të dispozitave që lidhen me mospranimin e ankimit, që e ka çuar këtë gjykatë në shkelje

të rëndë të normave procedurale, me pasojë mosshqyrtimin në themel të ankimit të Avokaturës së Shtetit.

19. Një gjykatë e investuar nga një prej subjekteve të së drejtës, të cilat pretendojnë shkeljen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme, përpara se të marrë në shqyrtim meritat e çështjes, pra t'u japë përgjigje në themel pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse, duhet që fillimisht të verifikojë kushtet e pranueshmërisë së mjetit që e ka vënë në lëvizje, i cili, sipas rastit, mund të jetë kërkesëpadia, ankimi ose rekursi.

20. Kushtet e pranueshmërisë së mjeteve juridiko – procedurale që vënë në lëvizje secilën prej hallkave të pushtetit gjyqësor, përbëjnë ato që quhen prezumime procedurale, mungesa e të cilave e pengon gjykatën që të bëjë një shqyrtim meritor të kërkimeve të parashtruara përpara saj.

21. Ankimi, në kuptimin e ngushtë të tij, është mjeti me të cilin vihet në lëvizje gjykata e apelit, për të shqyrtuar bazueshmërinë në prova dhe në ligj të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ai përbën një prej formave në të cilën shfaqet e realizuar e drejta kushtetuese e sanksionuar në nenin 43 të saj, për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor të një gjykate më të ulët, në një gjykatë më të lartë.

22. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate, e drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (shih, vendimet nr.5, datë 02.03.2010; nr.12, datë 14.04.2010; nr.14, datë 26.03.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

23. Me paraqitjen e ankimit, palët ia nënshtrojnë optikës vlerësuese të gjykatës së apelit vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke riparashtruar pretendimet dhe prapësimet e pamarra parasysh prej kësaj të fundit. Megjithatë, përpara se gjykata e apelit të shprehet në lidhje me thelbin e këtyre pretendimeve dhe prapësimeve, duhet që më parë, nga pala që ka paraqitur ankimin, të respektohen disa parakushte, të cilat kanë të bëjnë me afatin dhe formën e paraqitjes së tij.

24. Neni 443/1 i KPC-s disponon se afati për paraqitjen e ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, në gjykatën e apelit, është 15 ditë. Më tej, neni 46/1 i ligjit nr.49/2012 "Për e gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", përcakton modalitetet formale të paraqitjes së ankimit. Mungesa qoftë edhe e njërit prej këtyre elementëve sjell si pasojë mospranimin e ankimit, pra mosshqyrtimin në themel të tij.

25. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se respektimi me rigorozitet i dispozitave procedurale që lidhen me disponimin

mbi ankimin ka një rëndësi themelore, pasi ka të bëjë me një prej të drejtave më të rëndësishme me natyrë vetjake, pjesë e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, aksesin në gjykatë.

26. Aksesi në gjykatë konsiston jo vetëm në të drejtën për t'iu drejtuar formalisht gjykatës, por për t'u dëgjuar thelbësisht në lidhje me çështjet e faktit dhe ato të ligjit. Ai nënkupton marrjen e një vendimi përfundimtar nga pushteti gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e zakonshme të ankimit.

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementët më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal.

Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (shih, vendimet nr.14, datë 03.06.2009; nr.41, datë 28.09.2011; nr.21, datë 29.04.2013, të Gjykatës Kushtetuese).

Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (shih, vendimet nr.7, datë 11.03.2008; nr.14, datë 03.06.2009, të Gjykatës Kushtetuese).

28. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga Gjykata Administrative e Apelit nuk janë ndjekur të gjitha etapat procedurale përpara se të vendosej kthimi i ankimit. Në nenin 46/2 të ligjit nr.49/2012 sanksionohet se përpara se gjykata të vendosë për kthimin e ankimit, në rrethanat kur ky i fundit nuk i plotëson elementët formalë për t'u marrë në shqyrtim, duhet që më parë të njoftojë ankuesin në lidhje me këto të meta, duke i lënë një afat prej 5 (pesë) ditësh për ndreqjen e tyre. Në rast se edhe pas këtij afati të metat nuk ndreqen atëherë mund të disponohet si më sipër.

29. Edhe pse dispozita e sipërcituar bën fjalë për shqyrtimin e kushteve

të pranueshmërisë së ankimit nga gjyqtari i vetëm në shkallë të parë, e njëjta procedurë do të zbatohet edhe për rastin kur këto të meta konstatohen nga trupi gjykues i gjykatës së apelit. Rregullimet e procesit gjyqësor administrativ janë të njëjta për sa kohë bëhet fjalë për të njëjtat pasoja. Pra, si kur disponohet nga gjyqtari i vetëm në shkallë të parë, ashtu edhe nga trupi gjykues në gjykatën e apelit, individi ankues duhet të ketë të njëjtat garanci procedurale, në të kundërt do të cenohej parimi kushtetues i barazisë së shtetasve përpara ligjit, ku një subjekti do t'i ofrohej mundësia për të ndrequr të metat e ankimit, nëse këto të meta konstatoheshin nga gjyqtari i vetëm në shkallë të parë, ndërsa subjekti tjetër do të privohej nga kjo mundësi, nëse të metat e ankimit të tij do të konstatoheshin nga trupi gjykues në gjykatën e apelit.

30. Së fundi, e njëjta procedurë ndiqet universalisht si kur bëhet fjalë për të metat e kërkesëpadisë, të konstatuara në gjykimin në shkallë të parë, si në rastin e të metave të ankimit, pavarësisht fazës dhe shkallës në të cilën ndodhet procesi, ashtu edhe të metave të rekursit.

31. Në këtë kontekst, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i tërheq vëmendjen edhe gjykatës së shkallës së parë që të bëjë një shqyrtim efektiv të kushteve të pranueshmërisë së ankimit dhe jo siç rëndom ndodh në praktikë që ankimet pranohen për shqyrtim pa u verifikuar më parë të metat formale të tyre, edhe kur këto mund të jenë të dukshme.

32. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, duhet t'i kërkojë palës së paditur ndreqjen e të metave të ankimit të konstatuara prej saj, duke i lënë edhe një afat për këtë qëllim dhe, nëse këto të meta ndreqen, të gjykojë çështjen në themel.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31001-00164-2015, datë 27.10.2020

Marrëdhënia juridike materiale civile apo administrative nga e cila dalin bashkëndërgjyqësit e detyrueshëm pasivë apo aktivë është e tillë që përjashton çdo mundësi legjitimimi në pozitat e personit të tretë, pasi bashkëndërgjyqësit e detyrueshëm duhet të jenë palë kryesore në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e tyre nën parimin e barazisë së armëve, parim i cili është element thelbësor për respektimin e procesit të rregullt ligjor.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 13.07.2012.

2. Nga fashikulli i gjykimit rezultoi se pala paditëse ka pretenduar se ishte subjekt ish-pronar i një sipërfaqeje toke të ndodhur në Himarë, Qarku Vlorë. Si i tillë, ai i është drejtuar në vitin 2007 Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të pronave për t'u njohur dhe për t'iu kthyer prona, duke dorëzuar edhe dokumentacionin përkatës.

3. Mbi sipërfaqen e pronës që pretendon pala paditëse rezulton se është ndërtuar para viteve 1990 një objekt i quajtur "Postë policie kufitare" dhe "Prozhektori", objekte të cilat kanë qenë dhe janë në administrimin e Ministrisë së Brendshme. Për të dy objektet, më datë 11.05.2012 është zhvilluar ankandi për shitjen e tyre nga ana e Komisionit të Drejtorisë së Administrimit të Pronave Publike. Pala paditëse ka kundërshtuar ligjshmërinë e zhvillimit të ankandit të shitjes, duke pretenduar se me cilësinë e ish-pronarit duhet të ishte ai blerësi i objektit, sipas parashikimeve ligjore respektive të ligjit mbi njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës që ka qenë në fuqi në atë kohë. Ai ka pretenduar shkeljen e procedurave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.428, datë 09.06.2010.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.5175, datë 10.05.2013 ka vendosur: "*1. Rrëzimin e kërkesë padisë*.". Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk u provua nga pala paditëse gjatë gjykimit se ai ishte ish-pronari i truallit ku ndodhen dy objektet për të cilat është vendosur shitja me ankand. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se procedura e ndjekur nga pala e paditur është realizuar në përputhje me ligjin dhe se nuk

ka shkaqe pavlefshmërie. Gjykata sakaq ka vendosur rrëzimin e padisë.

5. Pala paditëse ka ushtruar apel kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ai ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë sipas objektit.

6. Gjatë gjykimit gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesës së palës paditëse për sigurimin e padisë. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë për caktimin e masës së sigurimit të padisë ka ushtruar apel Ministria e Financës nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Apeli nuk është shqyrtuar nga gjykata e apelit, pasi, sipas shkresës nr.9907 prot., datë 14.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, apeli i palës së paditur nuk është bashkëlidhur me dosjen e gjykimit në apel dhe as nuk është dërguar nga gjykata e shkallës së parë në kohë. Konstatohet se kjo shkresë bashkëlidhur edhe apeli respektiv është paraqitur në Gjykatën e Lartë më datë 16.05.2018, pasi çështja ishte përfunduar në apel dhe ishte regjistruar rekursi në Gjykatën e Lartë.

7. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.1335, datë 09.04.2014 ka vendosur:

"*Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes me nr.4107/1650 regjistri themeltar, datë 16.07.2013 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.*".

8. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.3648, datë 03.10.2014 ka vendosur: "- *Prishjen e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 5175, datë 10.05.2013 dhe kthimin e çështjes për rigjykim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*".[...]

9. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave nëpërmjet Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, më datë 17.10.2014. Rekursi u është njoftuar palëve dhe nuk ka kundër-rekurs të paraqitur. [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrative të Gjykatës së Lartë

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i drejtë në mënyrën se si ka disponuar dhe për rrjedhojë, vendos ta lërë atë në fuqi. Megjithatë Kolegji konstaton se arsyetimi i vendimit për sa i përket rregullimit të ndërgjyqësisë në rigjykim është i gabuar dhe në kundërshtim me nenet 161 dhe 193, të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-s. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të lihet në fuqi por me tjetër arsyetim.

13. Kolegji vlerëson se konkluzioni i Gjykatës Administrative të Apelit shkeljen e rregullave të formimit të rregullt të ndërgjyqësisë në këtë proces

është i drejtë. Në këtë çështje pala paditëse ka kërkuar anulimin e procedurave të ankandit dhe si palë të paditur ka individualzuar në padi vetëm organin publik përgjegjës për organizimin e ankandit, duke mos thirrur në gjykim blerësin që ka prodhuar zhvillimi i procedurës së ankandit, konkretisht E.R. Në këtë rast, qoftë organi publik zhvillues i ankandit dhe qoftë blerësi që ka rezultuar nga zhvillimi i ankandit, preken nga kërkimet e padisë objekt gjykimi dhe se për rrjedhojë, për shkak të marrëdhënies juridike që ata kanë do të duhet të ishin thirrur si palë të paditura në proces.

14. Kolegji sjell në vëmendje paragrafin e parë, të nenit 162, të KPC-s, i cili parashikon se:

"*Kur, për shkak të natyrës së marrëdhënieve juridike që janë në konflikt ose për shkak të një dispozite ligjore, efekti i vendimit, që do të jepet, shtrihet në të gjithë bashkëndërgjyqësit, veprimet procedurale që janë kryer prej disa bashkëndërgjyqësve kanë efekt edhe për bashkëndërgjyqësit e tjerë që nuk janë paraqitur në gjykatë ose që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar.*". Ky parashikim ligjor procedural ka rregulluar bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme, e cila në çështjen objekt gjykimi rezulton të jetë pasive.

15. Më tej, Kolegji vlerëson të nevojshme të sjellë në vëmendje dy ndryshime ligjore të KPC-s, që hynë në fuqi në datë 05.11.2017, të cilat saktësuan rolin e gjykatës në formimin e rregullt të bashkëndërgjyqësisë të detyrueshme në procesin gjyqësor civil dhe administrativ. *Së pari*, u shtua në nenin 161 të KPC-s, shkronja "ç", me përmbajtje si vijon: "ç) nëse vendimi nuk mund të jepet përveçse kundrejt shumë personave, në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, këta të fundit duhet të thirren si të paditur në të njëjtin proces. Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të padituve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës "c", të këtij neni, dhe nenit 154/a të këtij kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit.". *Së dyti*, u riformulua shkronja "d" e nenit 467 të KPC-s me përmbajtje si vijon: "*Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kufijve të nenit 121, të këtij kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur: ... d) nuk është formuar drejt bashkëndërgjyqësia, sipas nenit 162, paragrafi i dytë, i këtij kodi;*"

16. Kjo do të thotë se qoftë organi publik dhe qoftë blerësi i ankandit në këtë çështje janë bashkëndërgjyqës pasivë të detyrueshëm dhe se pala paditëse ka pasur detyrimin që t'i thërrasë të dyja këto palë si të paditur në gjykim. Nuk mund të ketë disponibilitet maksimal të padisë në rastin kur bashkëndërgjyqësia është e detyrueshme, pasi ligji njeh disponim vetëm në

momentin e ngritjes së padisë dhe jo për përcaktim të ndërgjyqësisë pasive në këto raste. Se kush do të jenë të padituri e ka vendosur ligji dhe kjo pjesë e procesit gjyqësor nuk mund të disponohet nga pala paditëse në padi.

17. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se në këtë rast bashkëndërgjyqësia pasive ka qenë e detyrueshme dhe për rrjedhojë, padia e paraqitur ka qenë *ab initio* me të meta procedurale, pasi pala paditëse duhet të thërriste me cilësinë e palës së paditur edhe subjektin fitues të ankandit. Gjykata Administrative e Apelit gabon në dhënien e zgjidhjes procedurale për gjykatën e rigjykimit kur sjell në vëmendje se ndërgjyqësi i munguar duhet të ftohet të legjitimohet në proces përmes nenit 193 të KPC-s. Neni 193 i KPC-s duket se është i paqartë për Gjykatën Administrative të Apelit, sikurse nuk kuptohet nga gjykata se personi i tretë, për shkak të kufizimeve të nenit 195 të KPC-s, nuk mundet të jetë kurrsesi pala kryesore.

18. Marrëdhënia juridike materiale civile apo administrative nga e cila dalin bashkëndërgjyqësit e detyrueshëm pasivë apo aktivë është e tillë që përjashton çdo mundësi legjitimimi të ndërgjyqësve në proces në pozitat e personit të tretë ndërhyrës dytësor. Secili prej bashkëndërgjyqësve të detyrueshëm duhet të jetë palë kryesore në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e tyre nën parimin e barazisë së armëve, parim i cili është element thelbësor për respektimin e procesit të rregullt ligjor.

19. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se detyra e gjykatës së shkallës së parë nuk do të jetë zbatimi i nenit 193 të KPC-s për të perfeksionuar bashkëndërgjyqësinë pasive të detyrueshme. Detyrë e gjykatës së rigjykimit do të jetë zbatimi i nenit 161 të KPC-s.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-673, datë 02.11.2020

Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt.

Në përcaktimin e natyrës civile apo administrative në një mosmarrëveshje gjykata duhet t'u referohet jo vetëm dispozitave të cilat përcaktojnë llojet e padive, por edhe kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e vetë kësaj Gjykate, si jurisprudencës nomofilatike të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudencës konstante të saj.

Përmbaruesit gjyqësorë privatë janë persona fizikë ose juridikë të cilëve ligji u ka dhënë atributin për të kryer një funksion publik, sikurse është ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria përmbarimore "Tirana Bailiff's" shpk, me vendimin datë 07.02.2019, bazuar në nenin 606 të KPC-s, ka vendosur të dënojë me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë ankuesin z. A.K.. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se gjoba është vendosur pasi ankuesi në cilësinë e përfaqësuesit të përgjithshëm të shoqërisë "Copri – Aktor", nuk ka marrë masa për ekzekutimin e detyrimit që rrjedh nga vendimi nr. 9091 Regj. Them, datë 02.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Në këto rrethana, ankuesi A.K. i është drejtuar gjykatës me ankim, duke kundërshtuar veprimet e përmbaruesit për vendosjen e gjobës ndaj tij si dhe duke kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1385, datë 26.02.2019, ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore dhe t'i dërgojë aktet pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë ka arsyetuar se veprimtaria e kryer nga ana e shoqërisë përmbarimore "Tirana Bailiff's" sh.p.k, për dënimin me gjobë të paditësit, është një veprimtari administrative. Referuar nenit 2 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative", funksioni publik mund të kryhet edhe nga çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo formë tjetër, e parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike. Shoqëria përmbarimore "Tirana Bailiff's" shpk, është një shoqëri private por që në këtë rast kryen veprimtari publike.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. s'ka, datë 17.04.2019, ka vendosur t'i parashtrojë Gjykatës së Lartë gjendjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet saj dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë nuk e ka konsideruar veten kompetente mbështetur në faktin se veprimtaria e kryer nga përmbaruesi gjyqësor për vendosjen e gjobës ndaj palës paditëse është një veprimtari procedurale që buron nga një mosmarrëveshje civile dhe për këtë shkak e gjithë kjo veprimtari është në funksion të ekzekutimit të një titulli ekzekutiv me natyrë private.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se nr.1385, datë 26.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë në përputhje me dispozitat procedurale që sanksionojnë kompetencën lëndore të gjykatave administrative. Për këtë shkak, ky vendim duhet të lihet në fuqi.

10. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt (shih, vendimi nr.917, datë 11.05.2017, ii Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

11. Në vijim të këtij qëndrimi, Kolegji thekson se, për të përcaktuar nëse një mosmarrëveshje është e natyrës civile apo administrative, duhet t'u referohet jo vetëm dispozitave të cilat përcaktojnë llojet e padive që bëjnë pjesë në sferën e kompetencës së njërës apo tjetrës gjykatë, por edhe kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e vetë kësaj Gjykate, duke pasur në konsideratë këtu, së pari, jurisprudencën nomofilatike të Gjykatës së Lartë (vendimet njësuese dhe ndryshuese të praktikës gjyqësore) dhe, së dyti, jurisprudencën konstante të saj.

12. Për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshjeje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin prima facie të saj. Ato duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të padisë, të të drejtës subjektive të pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes (shih, vendimi nr.112, datë 08.06.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

13. Përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen "objekti i padisë" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata, kur zgjidh mosmarrëveshjen, merr në shqyrtim pretendimet e paditësit të cilat parashtrohen në kërkesëpadi si dhe gjatë ushtrimit të së drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185, të KPC-s objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përmblidhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit iura novit curia, analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve (shih, Vendimi Unifikues nr.3, datë 29.03.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 28).

14. Me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative të shkallës së parë, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në datën 04.11.2013, një pjesë e mosmarrëveshjeve që më parë gjykoheshin pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apeleve dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, tashmë u kaloi këtyre organeve të reja për shqyrtim. Gjykatat administrative (duke përfshirë këtu edhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë), duke qene se ushtrojnë një juridiksion të ndryshëm nga ai i gjykatave të zakonshme, mund të gjykojnë vetëm atë gamë mosmarrëveshjesh të cilat ligji i posaçëm u ka ngarkuar në mënyrë eksplicite. Juridiksioni përjashtimor, pikërisht duke qenë i ndryshëm nga ai i zakonshëm duhet të interpretohet në çdo rast në mënyrë të ngushtë. Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të përfshihet në sferën e kompetencave të gjykatës administrative atëherë në çdo rast kthehet tek rregulli, pra si pjesë e kompetencave të gjykatës së zakonshme (shih, vendimi nr.112, datë 08.06.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

15. Në këtë kuadër, për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative ose jo duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (shih, vendimi nr.2, datë 10.03.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23).

16. Mosmarrëveshjet administrative, duke qenë se i përkasin një juridiksioni të specializuar, duhet të sanksionohen në mënyrë posaçme nga ligji. Nëse një mosmarrëveshje nuk përcaktohet se i përket juridiksionit të gjykatave administrative, atëherë ajo, si rregull i përgjithshëm, mbetet në juridiksionin e gjykatave të zakonshme (gjykatat me juridiksion të përgjithshëm). Ky përfundim del nga interpretimi i nenit 135/3 të Kushtetutës. Përjashtimi është i tillë për sa kohë sanksionohet, në të kundërt kthehemi tek rregulla (shih, vendimi nr. =152, datë 28.02.2019, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

17. Mosmarrëveshja në shqyrtim është e natyrës administrative dhe për këtë shkak kompetente është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Edhe pse në pamje të parë pala e paditur ka kryer veprime procedurale të fazës së ekzekutimit për vënien në zbatim të një vendimi gjyqësor civil, rezulton se ajo ka ushtruar një pushtet administrativ në sanksionimin me gjobë të palës ankuese.

18. Pushteti për të vënë gjobë është një pushtet që u njihet vetëm organeve publike. Këto të fundit mund të jenë organet e pushtetit qendror, organet e pushtetit vendor, organet e forcave të armatosura, organet e enteve publike, për sa kohë kryejnë funksione administrative si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, e parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike.

19. Përmbaruesit gjyqësorë privatë janë pikërisht persona fizikë ose juridikë (studio përmbarimore) të cilëve ligji u ka dhënë atributin për të kryer një funksion publik, sikurse është ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë. Kjo përforcohet edhe më tepër nga fakti se një kompetencë e tillë më parë u njihej vetëm përmbaruesve gjyqësorë të organizuar në bazë shtetërore, të cilët janë konsideruar gjithnjë, në mënyrë të pa ekuivok, si organe publike.

20. Për çka u tha më sipër, vendosja e gjobës nga ana e përmbaruesit gjyqësor, në dallim nga veprimet e tjera të fazës së ekzekutimit, konsiderohet si një veprimtari me natyrë administrative, e cila mund të kryhet vetëm nga organet publike, në këtë rast përmbaruesit gjyqësorë, të organizuar si persona fizikë ose juridikë, të cilët kryejnë veprimtari administrative.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2020-778, datë 02.11.2020

Faza e ekzekutimit të detyrueshëm fillon me paraqitjen e kërkesës drejtuar shërbimit përmbarimor gjyqësor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit dhe që lidhet edhe me dijeninë e debitorit duke i lënë këtij të fundit kohën e parashikuar për ekzekutimin vullnetar të detyrimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 7, datë 04.10.2011, INUV Bashkia Durrës ka vendosur dënimin e paditësit me 2.000.000 lekë gjobë për kryerjen e kundërvajtjes në ndërtim, shtesë anësore, me konstruksion druri dhe vetrata duralumini, pa leje. Ky vendim rezulton të jetë marrë në bazë të aktit të konstatimit nr. serie 0039302, datë 03.10.2011.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi kërkesën e palës së paditur, me vendimin nr.821, datë 05.09.2013, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv, vendim nr.07, datë 04.10.2011, INUV, Bashkia Durrës.

3. Me shkresën "lajmërim për ekzekutim vullnetar", datë 20.12.2013, të Zyrës Përmbarimore Durrës, është njoftuar paditësi për të paguar detyrimin prej 2.000.000 lekë palës së paditur INUV Bashkia Durrës. Ndërkohë, kërkesa e palës së paditur për ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv është paraqitur më 15.12.2013.

4. Në këto rrethana, paditësi i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke pretenduar, ndër të tjera, faktin se ekzekutimi i titullit ekzekutiv është parashkruar.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.34, datë 21.01.2014, ka vendosur: *Pranimin e padisë së ngritur nga paditësi F.A.. Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ "ekzekutim i vendimit nr.7, datë 04.10.2011, për dënimin me 2.000.000 lekë gjobë të paditësit", pasi akti nuk prodhon pasoja juridike. Shpenzimet gjyqësore si të jenë kryer.*

5.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se ekzekutimi i titullit ekzekutiv, vendimit nr. 7, datë 04.10.2011, të INUV, Bashkia Durrës, është parashkruar, duke qenë se nga dalja e këtij akti administrativ dhe deri në fillimin e ekzekutimit të tij ka kaluar afati prej dy vitesh i parashikuar në nenin 46 të ligjit nr.10297/2010 "Për kundërvajtjet administrative".

6. Kundër vendimit nr.34, datë 21.01.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka paraqitur ankim pala e paditur, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor i Bashkisë Durrës, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë, duke pretenduar, ndër të tjera se nuk ka kaluar afati për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimit nr.7, datë 04.10.2011, të INUV, Bashkia Durrës, pasi kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është paraqitur në datën 31.07.2013, pra brenda afatit prej dy vitesh.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.3651, datë 06.10.2014, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr.34, datë 21.01.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Rrëzimin e padisë.*

7.1. Në marrjen e këtij vendimi kjo gjykatë, në thelb, ka arsyetuar se nuk ka kaluar afati për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimit nr.7, datë 04.10.2011, të INUV, Bashkia Durrës, pasi kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është paraqitur në datën 31.07.2013, pra brenda afatit prej dy vitesh.

8. Kundër vendimit nr.3651, datë 06.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, F.A., e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr.34, datë 21.01.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

b) Në lidhje me shkaqet e rekursit

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin nr.3651, datë 06.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit.

17. Gjykata Administrative e Apelit gabon kur konsideron si moment të ndërprerjes së afatit të parashkrimit të ekzekutimit të aktit administrativ që përmban një kundërvajtje administrative, atë të paraqitjes së kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

18. Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nuk është momenti i fillimit të ekzekutimit të një titulli ekzekutiv. Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit është një gjykim gracioz i cili ka për qëllim verifikimin e ekzistencës së kushteve të vlefshmërisë së një titulli ekzekutiv. Fillimi i ekzekutimit është momenti i

paraqitjes së kërkesës përmbaruesit për nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm. Mund të ndodhë që kreditori të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit për një titull ekzekutiv dhe më tej të mos kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të tij.

19. Faza e ekzekutimit të detyrueshëm, e cila është faza e dytë e realizimit të së drejtës (faza e parë është faza e njohjes së të drejtës), fillon jo me paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit por me paraqitjen e kërkesës drejtuar shërbimit përmbarimor gjyqësor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit, pasi është kjo e fundit që tregon vullnetin e kreditorit për të ekzekutuar të drejtën e tij subjektive, e cila përmbahet tek titulli ekzekutiv.

20. Ndërprerja e afatit të parashkrimit të ekzekutimit nuk mund të jetë e lidhur me paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, pasi kjo e fundit nuk i njoftohet debitorit, por me paraqitjen e kërkesës drejtuar shërbimit përmbarimor gjyqësor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, i cili më pas njofton debitorin për fillimin e ekzekutimit, duke i lënë dhe kohën e parashikuar për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Pra, ndërprerja e afatit të parashkrimit lidhet me dijeninë e debitorit. Ngjashëm, afati i parashkrimit të padisë ndërpritet me paraqitjen e kërkesëpadisë në gjykatë, e cila më pas i komunikohet të paditurit.

21. Kjo parashikohet edhe në nenin 131/ç të Kodit Civil (KC)-s, i cili përcakton se: "*Parashkrimi ndërpritet: ç) me paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor apo të arbitrazhit përkatës, si dhe të çdo titulli ekzekutiv tjetër*". Me termin kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm duhet të kuptohet kërkesa që i drejtohet shërbimit përmbarimor gjyqësor dhe jo kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Kjo vjen jo vetëm nga interpretimi literal i dispozitës, por edhe nga interpretimi i saj sistematik me shkronjat e tjera të të njëjtit nen, të cilat kanë si emërues të përbashkët dijeninë e debitorit.

22. Në këtë kontekst, vendimi nr.34, datë 21.01.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, është marrë në përputhje me ligjin. Edhe pse kjo gjykatë në dispozitiv duhet të ishte shprehur për deklarimin e titullit ekzekutiv si të paekzekutueshëm, sërish mënyra e disponimit të saj çon në të njëjtin përfundim.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00–2020–836, datë 16.11.2020

Të gjitha detyrimet dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin, që lidhet me sektorin e furnizimit me ujë, përbëjnë një regjim juridik të së drejtës publike dhe për rrjedhojë kontratat më këtë objekt kanë një karakter administrativ.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se, pala paditëse Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ka licencuar në vitin 2010 palën e paditur Ujësjellës-KAnalizime (UK) PeqinSHA, për ushtrimin e aktivitetit në sektorin e furnizimit me ujë, largimin e ujërave të ndotura dhe përpunimin e tyre.

2. Me vendimin nr.43, datë 30.07.2010, Komisioni Kombëtar Rregullator i Entit Rregullator me Ujë (ERRU) ka miratuar tarifat e ujit për konsum publik për UK Peqin SHA, respektivisht për kategorinë konsumator familjar, institucione buxhetore dhe ente private.

3. Në vijimësi, mes palëve ndërgjyqëse është lidhur kontrata "për aplikimin e tarifave të ujit të pijshëm për konsum publik", me tarifë 200.000 lekë, bazuar në nenin 22, pika 3, të ligjit nr.8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura".

4. Midis palëve është ndryshuar, përmes shtojcës së kontratës, vlera e pagesës për tarifat për konsum publik, në masën 140.000 lekë.

5. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë sipas objektit të saj.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2878, datë 23.04.2019 ka vendosur: "*Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes nr.2721 akti, datë regjistrimi 14.09.2018, me palë paditëse Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura; me palë të paditur Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA; me objekt detyrimin e të paditurit Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Peqin SHA, të*

paguajë shumën 960.000 lekë ndaj Enti Rregullator i Sektorit të Ujit, si detyrim i papërmbushur kontraktual. Dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë".

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.3336 (31140-03795-80-2019) Regj. Them., datë 26.06.2019 ka vendosur: "*Të ngrejë përpara Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore në lidhje me gjykimin e çështjes nr. 3336 (31140-03795-80-2019) Regj. Them., datë 05.06.2019. T'i kërkojë Gjykatës së Lartë që të vendosë se kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje (mosmarrëveshjeje) është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe jo Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë*".

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se vendimi nr.2878, datë 23.04.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhojë e kuptimit dhe e zbatimit të drejtë të ligjit, prandaj ky vendim duhet të lihet në fuqi.

9. Kolegji Administrativ e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

10. Kolegji Administrativ, në përcaktimin e kompetencës lëndore, i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative. Në rastin në shqyrtim, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, Kolegji e vlerëson të drejtë arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo Gjykatë ka përcaktuar drejt natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi, duke bërë një identifikim të elementëve dhe/ose kritereve ligjore që, për rastin konkret, i kanë shërbyer për përcaktimin e kompetencës lëndore.

11. Duke iu rikthyer çështjes objekt shqyrtimi rezulton se pala paditëse kërkon detyrimin e palës së paditur të paguajë shumën 960.000 lekë, që rrjedh nga kontrata "për aplikimin e tarifave të ujit të pijshëm për konsum publik", bazuar në nenin 22, pika 3, të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996 "Për

kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", pasi nga paditësi është licencuar në vitin 2010 i padituri UK Peqin SHA, për ushtrimin e aktivitetit në sektorin e furnizimit me ujë, largimin e ujërave të ndotura dhe përpunimin e tyre.

12. Kolegji vlerëson të nevojshme paraprakisht të qartësojë konceptin mbi kontratën administrative, me synimin për të bërë dallimin e saj nga një kontratë civile. Pikësëpari, Kolegji sjell në vëmendje të gjykatave se, për të arritur në konkluzionin nëse një kontratë është apo jo administrative duhet të nisë analiza nga përkufizimi dhe rregullimi ligjor që bëhet në Kodin e Procedurave Administrative (KPA). Kështu, në nenin 3, pika 4, të këtij Kodi thuhet se, "*Kontrata administrative është një marrëveshje e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas të drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik.*". Referuar doktrinës juridike, mënyrës së rregullimit nga ligji, por edhe konfirmimit që i ka bërë jurisprudenca e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është konkluduar se dy janë kriteret bazë që ndihmojnë në identifikimin e kontratës administrative dhe në dallimin e saj nga kontrata civile. Njëri është *kriteri organik*, që kërkon praninë e një organi publik në kontratë dhe, tjetri është *kriteri material*, që ka të bëjë me ekzistencën e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike.

13. Në vlerësimin e Kolegjit, çmohet e rëndësishme se, për t'u plotësuar kriteri organik në një kontratë administrative kërkohet në radhë të parë, që personi i së drejtës publike të veprojë në përmbushjen e funksioneve të tij administrative/publike. Është gjithashtu i pranueshëm për të konsideruar të plotësuar këtë kriter edhe rasti, kur një person fizik apo juridik të së drejtës private, i njihet me ligj, me akt nënligjor apo me çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga ligji, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike. Plotësimi vetëm i kriterit organik nuk mjafton për ta kualifikuar kontratën si kontratë administrative. Ai duhet të lidhet detyrimisht me kriterin material.

14. Gjithashtu, Kolegji thekson se, për të qenë i përmbushur kriteri material në një kontratë administrative kërkohet ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike, si dhe realizimi i interesit publik. Duke iu referuar elementëve të marrëdhënies juridike për të dalluar, rast pas rasti, nëse jemi para kontratës administrative, duhet të analizohet objekti, si dhe të drejtat apo detyrimet që lindin nga kontrata. Kriteri material mund të paracaktohet edhe nga ligji, nëpërmjet parashikimit nominalisht të kontratave administrative në qarkullimin civil. Megjithatë, nëse nuk paracaktohet nga ligji, i përket gjykatës të vlerësojë dhe kualifikojë, rast pas rasti, natyrën e kësaj kontrate. Në këto raste, funksioni publik do të duhet të identifikohet edhe si pasojë e marrëdhënies juridike/publike, të rregulluar

në këtë kontratë dhe të shërbimit publik, që ofrohet nëpërmjet pasojave juridike që rrjedhin nga zbatimi i saj.

15. Sidoqoftë, Kolegji vlerëson se kriteri material identifikohet më mirë, kur palët në gjykim apo vetë gjykata që shqyrton çështjen, arrijnë të bëjnë dallimin mes të drejtës private dhe të drejtës publike. Elementi kryesor që bën dallimin mes tyre është pozicioni që kanë palët në kontratë. [...] Një tjetër element dallues midis të drejtës publike e private është i lidhur me konceptin e shërbimit publik. Në të drejtën private, palët nuk kanë për objekt sigurimin e misioni të shërbimit publik, ndërsa në të drejtën publike synohet, pikërisht, përmbushja e këtij misioni. Karakteristika e tretë dalluese qëndron te prerogativat e fuqisë (pushtetit) publik, që janë atribut i administratës publike dhe që shfaqen në formën e aktit administrativ, pushtetit diskrecial dhe të privilegjit të ekzekutimit paraprak.

16. Sipas vlerësimit të Kolegjit, koncepti i marrëdhënieve juridike në fushën e të drejtës publike nënkupton ato marrëdhënie juridike që përfshijnë në mënyrë kumulative ose alternative shumë elementë, siç janë raportet e pabarazisë mes palëve, kryerjen e një misioni shërbimi publik, ushtrimin e prerogativave të fuqisë (pushtetit) publik, si dhe përmbushjen e interesit publik. Kolegji thekson se, këta elementë që karakterizojnë të drejtën publike kanë për qëllim përmbushjen e misionit thelbësor të administratës publike, që është misioni i interesit publik.

17. Kjo linjë arsyetimi që ndjek Kolegji është në përputhje edhe me qëndrimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.2, datë 10.03.2014 [...].

18. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, ky Kolegj vlerëson të domosdoshme të theksojë se, kur plotësohet kriteri organik *(një nga palët në kontratë është organ publik)*, atëherë kontrata do të konsiderohet si administrative, me kushtin që kriteri material *(ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike),* të shfaqet në një nga karakteristikat e mëposhtme, të cilat nuk kërkohet të jenë kumulative.[...] Gjithashtu, Kolegji vlerëson se, referuar ligjit, edhe një kontratë e lidhur midis dy personave juridikë të së drejtës publike, mund të jetë me karakter administrativ, nëse ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët të organeve publike.

19. Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se kriteri ligjor përcaktues për të konkluduar, nëse një kontratë është civile apo administrative orientohet kryesisht nga rastet e mësipërme dhe jo nga fakti, nëse është formësuar domosdoshmërisht në bazë të një procedure prokurimi publik. [...]. Një veprim juridik, që përbën kontratë administrative mund të realizohet faktikisht edhe pa u kryer kjo procedurë ligjore e lidhjes së kontratës.

Sigurisht që procedura e prokurimit publik është forma me të cilën autoriteti publik kontrakton, sipas ligjit, të drejtat dhe detyrimet me të tretët, por ajo nuk mund të jetë kriteri i vetëm përcaktues për kualifikimin e një fakti juridik si kontratë administrative. Janë të njohura në ligj kontrata që mund të konsiderohen si administrative, pa qenë nevoja e kryerjes së procedurave të prokurimit publik, siç janë p.sh., kontratat që lidhen sipas ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Të tilla janë kontratat e përbashkëta mes organeve të qeverisjes vendore për delegimin e kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta njëra-tjetrës, ose kontraktimit me një palë të tretë, të krijimit të një personi juridik, etj., (nenet 9/1, pikat 1.5 dhe 1.6/a, nenet 14, 21/3, 30/5).

20. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se analiza juridike e kualifikimit të faktit si kontratë administrative nuk mund të fillojë dhe të mbarojë vetëm me verifikimin e një kriteri. Prandaj, arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në parashtresën e ngritur, konkludohet se është i pabazuar në ligj. Në interpretim të ligjit nr.49/2012, të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*", si dhe mbi arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se, në çështjen objekt shqyrtimi plotësohen kriteret që shërbejnë për identifikimin qartësisht të çështjes, nëse është apo jo administrative. *Së pari*, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura është organ publik dhe i ngarkuar për të ushtruar pushtet diskrecional, në kryerjen e veprimtarisë administrative, për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të licencimit të subjekteve, që do të ushtrojnë funksionin publik, atë të furnizimit me ujë të popullatës; Së dyti, kjo është një veprimtari që rregullohet dhe i nënshtrohet një regjimi juridik të së drejtës publike. Sipas ligjit të sipërcituar, nr. 8102, datë 28.03.1996, *"Enti Rregullator përcakton metodologjinë e përllogaritjes së tarifave të shitjes, me shumicë dhe pakicë, të ujit për konsum publik, tarifat për ujërat e përdorura dhe trajtimit të tyre, duke u mbështetur në dispozitat e këtij ligji"* (neni 22.1) dhe ka për detyrë *"të garantojë që të licencuarit të veprojnë në përputhje me kushtet e licencës së tyre dhe të mbrojnë interesat e konsumatorëve në lidhje me: (i) çmimet, tarifat dhe kushtet e tjera të shërbimit; (ii) cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;"*(Neni 13, pika 1). *Së treti,* nëpërmjet veprimtarisë administrative të ofrimit të shërbimit, dhënies së licencimit për ofrimin e furnizimit me ujë, për llogari të interesit publik, organi publik ka ushtruar vullnetin e tij administrativ, duke kryer funksione administrative/publike. Pra, ai ka si bazë interesin publik dhe funksionimin normal të shërbimit, të furnizimit me ujë dhe mbrojtjen e tij.

21. Kolegji vlerëson se përderisa, në kuptim të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996, ky Ent Rregullator ushtron funksione publike dhe se, kontrata e lidhur i nënshtrohet një regjimi juridik, ku parashikohen norma tepër origjinale, që nuk janë gjë tjetër veçse norma të së drejtës publike, që nuk zbatohen në një kontratë midis dy personave të së drejtës private, atëherë kjo kontratë do të cilësohet detyrimisht si një kontratë administrative. Ashtu sikurse arsyetohet nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me Entin Rregullator të Energjisë (ERE), në vendimin nr.52, datë 05.12.2012, edhe ligji i sipërcituar, e identifikon ERRU, si organ që ushtron funksione publike, si dhe parashikon një procedurë të detajuar për verifikimin e ankesave nga çdo person i interesuar, duke garantuar mbrojtje të interesave të konsumatorëve, nëpërmjet një procesi administrativ, në përputhje me KPA. Mbi këtë arsyetim, Kolegji konkludon se natyra administrative e kësaj kontrate rezulton nga natyra e vetë normave juridike që e rregullojnë atë. Pra, natyra juridike e kontratës del e qartë edhe nga vlerësimi që gjykata duhet t'i bëjë natyrës së dispozitave ligjore konkrete. Të gjitha detyrimet dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin konkret për sektorin e furnizimit me ujë përbëjnë një regjim juridik të së drejtës publike dhe, për rrjedhojë, i japin kontratës, objekt të këtij gjykimi, një karakter administrativ.

22. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi nr.2878, datë 23.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është shpallur moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes, duhet të lihet në fuqi.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2020-903, datë 16.11.2020

Duke iu referuar doktrinës juridike, përkufizimit dhe rregullimit ligjor në Kodin e Procedurave Administrative (KPA), jurisprudencës së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, dy janë kriteret bazë në identifikimin e dallimit mes kontratës administrative nga kontrata civile. Njëri është kriteri organik, që kërkon praninë e një organi publik në kontratë, që vepron në përmbushjen e funksioneve të tij administrative/publike dhe, tjetri është kriteri material, që ka të bëjë me ekzistencën e marrëdhënieve juridike në fushën e të drejtës publike. Në këtë kuptim, kontrata e privatizimit nuk është një kontratë administrative publike.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala paditëse K.L., pretendon se është një prej anëtarëve të familjes me kryefamiljar Gj.L..

2. Pala paditëse pretendon se i padituri Gj.L., ka përfituar sipas kontratës me Ndërmarrjen Komunale Banesa, një banesë 2+1 në bazë të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore".

3. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë sipas objektit të saj.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin Nr. 882, datë 29.04.2016 ka vendosur: "*Rrëzimin e padisë së paditësit K.L. kundër palës së paditur T.L. dhe M.L.*".

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.233, datë 29.03.2018 ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr.882, datë 29.04.2016* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues".

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.738, datë 06.05.2019 ka vendosur: "*Deklarimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shqyrtimin e çështjes nr.2343 akti,*

datë regjistrimi 21.09.2018. Dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si gjykatë kompetente". [...]

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.1125, datë 29.10.2019 ka vendosur: " *Të konstatojë mosmarrëveshjen në kompetencën lëndore të çështjes civile me nr.1563 akti, datë 16.10.2019, me palë paditëse K.L., me palë të paditur: T.L., M.L. duke urdhëruar kancelarinë e kësaj gjykate të dërgojë brenda 5 ditëve nga dhënia e këtij vendimi kopje të kërkesë-padisë, së bashku me aktet që e shoqërojnë, pranë Kolegjit Administrativ pranë Gjykatës së Lartë*". Kjo gjykatë arsyeton se: "*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë fillimisht ka shqyrtuar objektin e padisë "përjashtimin e të paditurve nga pronësia e apartamentit dhe detyrim për njohje pronar". Rezulton se është bërë kërkesë për shtim objekti të padisë dhe gjykata e ka pranuar këtë ndryshim objekti kur vetë kjo Gjykatë nuk kishte kompetencë lëndore të shqyrtonte këtë objekt të ndryshuar dhe nuk duhet të pranonte një kërkesë të tillë kur nuk ishte kompetente. Edhe në vendimin për shpalljen e moskompetencës lëndore, objekti i padisë është objekti i pandryshuar dhe jo ai i ndryshuar, objekt i cili është në kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë pasi lidhet me të drejta civile të pronësisë midis personave privatë dhe jo midis personave privatë dhe organit publik. Në referencë të nenit 13 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e mosmarrëveshjeve administrative" në të cilin citohet se: '1. Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit" në referencë të nenit 7 dhe 8, të ligjit të sipërcituar, çmohet se kjo çështje ka për objekt gjykimi për sa është shënuar në objektin e padisë, objekti së cilës nuk është në kompetencën lëndore të kësaj gjykate, por të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*".

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se vendimi nr.738, datë 06.05.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke ia dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, prandaj ky vendim duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

9. Kolegji Administrativ e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshjeje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë

për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

10. Kolegji Administrativ, në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes nëse është e natyrës civile apo administrative. Në rastin në shqyrtim, Kolegji e vlerëson të gabuar arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata nuk ka përcaktuar drejt natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi, duke mos bërë një identifikim të elementeve dhe/ose kritereve ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore.

11. Duke u rikthyer në çështjen objekt shqyrtimi, -Kolegji vlerëson të theksojë se çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Vlorë. Në datë 01.04.2019, përfaqësuesi i palës paditëse referuar nenit 161 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) ka kërkuar shtimin e ndërgjyqësisë për Entin Kombëtar të Banesave, Gj.L. dhe M.L., si dhe ndryshimin e objektit të padisë, konkretisht: "Pavlefshmëri e pjesshme e kontratës së privatizimit apartament 2+1, ndodhur në lagjen '28 Nëntori në zonën kadastrale nr. 8605 të qytetit të Vlorës dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin nga kjo pavlefshmëri". Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është reflektuar ndryshimi i ndërgjyqësisë por nuk është reflektuar ndryshimi i objektit të padisë dhe për pasojë, ajo ka vijuar me shpalljen e moskompetencës me objektin e parë të padisë edhe pse nga ana e saj arsyetohet se çështja është e natyrës administrative për sa kohë kundërshtohet kontrata e privatizimit.

12. Ligji nr.49/2012, "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar, ka përcaktuar shprehimisht në nenin 7, natyrën e mosmarrëveshjeve që gjykon gjykata administrative, që janë ndër të tjera "*mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik*". Pra, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në zbatim të kësaj dispozite, pretendon se jemi përpara një kontrate administrative. Ky Kolegj thekson se ky qëndrim është i gabuar dhe se kontrata e privatizimit nuk është një kontratë administrative publike.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të evidentojë se praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrim të ndryshm në lidhje me kontratën e privatizimit, që është cilësuar si kontratë administrative publike. Për këtë arsye vlerësohet e domosdoshme një analizë e thelluar në lidhje me qëndrimin nëse kontrata e privatizimit është një kontratë administrative publike apo një kontratë civile.

14. Kolegji vlerëson të nevojshme paraprakisht të qartësojë konceptin mbi kontratën administrative, me synimin për të bërë dallimin e saj nga një kontratë civile. Pikësëpari, Kolegji sjell në vëmendje të gjykatave se, për të arritur në konkluzionin nëse një kontratë është apo jo administrative duhet të nisë analiza nga përkufizimi dhe rregullimi ligjor që bëhet në KPA. Kështu, në nenin 3, pika 4, të këtij Kodi thuhet se, "*Kontrata administrative është një marrëveshje e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas të drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik*.". Referuar doktrinës juridike, mënyrës së rregullimit nga ligji, por edhe konfirmimit që i ka bërë jurisprudenca e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është konkluduar se dy janë kriteret bazë që ndihmojnë në identifikimin e kontratës administrative dhe në dallimin e saj nga kontrata civile. Njëri është kriteri organik, që kërkon praninë e një organi publik në kontratë dhe, tjetri është kriteri material, që ka të bëjë me ekzistencën e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike.

15. Në vlerësimin e Kolegjit, çmohet e rëndësishme se, për t'u plotësuar kriteri organik në një kontratë administrative kërkohet në radhë të parë, që personi i së drejtës publike të veprojë në përmbushjen e funksioneve të tij administrative/publike. Është gjithashtu i pranueshëm për të konsideruar të plotësuar këtë kriter edhe rasti, kur një personi fizik apo juridik të së drejtës private, i njihet me ligj, me akt nënligjor apo me çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga ligji, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike. Plotësimi vetëm i kriterit organik nuk mjafton për ta kualifikuar kontratën si kontratë administrative. Ai duhet të lidhet detyrimisht me kriterin material.

16. Gjithashtu, Kolegji thekson se, për të qenë i përmbushur kriteri material në një kontratë administrative kërkohet ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike, si dhe realizimi i interesit publik [...].

17. Sidoqoftë, Kolegji vlerëson se kriteri material identifikohet më mirë, kur palët në gjykim apo vetë gjykata që shqyrton çështjen, arrijnë të bëjnë dallimin mes të drejtës private dhe të drejtës publike. Elementi kryesor që bën dallimin mes tyre është pozicioni që kanë palët në kontratë. Në të drejtën private, palët vendosen në pozita të barabarta, ndërsa në të drejtën publike, pozicionimi i tyre kushtëzohet nga një lloj marrëdhënieje dominimi e pabarazie. Në doktrinën juridike dhe në jurisprudencën gjyqësore, klauzolat e kontratës që i japin epërsi palës shtet në të drejta, apo që i atribuojnë personit publik një pozicion superioriteti në raport me palën tjetër, duke i vendosur në pozita të pabarabarta, quhen ndryshe edhe

klauzola të nënshtrimit të palëve ndaj të drejtës publike. Këto klauzola janë jo të zakonshme në një kontratë klasike tipike midis dy subjekteve private që rregullohet nga e drejta private (si p.sh., e drejta e palës shtet për t'u tërhequr në mënyrë të njëanshme nga kontrata, kufizimi i lirisë kontraktore apo autonomisë së vullnetit, etj.,). Kjo do të thotë se, nëse të tilla klauzola do të ishin pjesë e një kontrate tipike midis dy subjekteve privatë, që rregullohet nga e drejta private, ajo do të konsiderohej e paligjshme, sepse palët në një kontratë të tillë gëzojnë të drejta të barabarta. Kështu, nëse nga përmbajtja e kontratës del se palët janë në pozita të barabarta, apo nuk rezultojnë klauzola jo tipike që e vendosin palën publike në raport epërsie, atëherë kjo kontratë do të jetë një kontratë e zakonshme, që rregullohet nga e drejta private. Kjo nuk është një kontratë administrative. Një tjetër element dallues midis të drejtës publike e private është i lidhur me konceptin e shërbimit publik. Në të drejtën private, palët nuk kanë për objekt sigurimin e misionit të shërbimit publik, ndërsa në të drejtën publike synohet, pikërisht, përmbushja e këtij misioni. Karakteristika e tretë dalluese qëndron te prerogativat e fuqisë (pushtetit) publik, që janë atribut i administratës publike dhe që shfaqen në formën e aktit administrativ, pushtetit diskrecionar dhe të privilegjit të ekzekutimit paraprak.

18. Sipas vlerësimit të Kolegjit, koncepti i marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike nënkupton ato marrëdhënie juridike që përfshijnë në mënyrë kumulative ose alternative shumë elementë, siç janë raportet e pabarazisë mes palëve, kryerjen e një misioni shërbimi publik, ushtrimin e prerogativave të fuqisë (pushtetit) publik, si dhe përmbushjen e interesit publik. Kolegji thekson se, këta elementë që karakterizojnë të drejtën publike kanë për qëllim përmbushjen e misionit thelbësor të administratës publike, që është misioni i interesit publik.

19. Kjo linjë arsyetimi që ndjek Kolegji është në përputhje edhe me qëndrimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në vendimin nr.2, datë 10.03.2014, ndërmjet të tjerave citohet se, "*...disa nga kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh, nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me*

nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik".

20. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, ky Kolegj vlerëson të domosdoshme të theksojë se, kur plotësohet kriteri organik *(një nga palët në kontratë është organ publik)*, atëherë kontrata do të konsiderohet si administrative, me kushtin që kriteri material *(ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike),* të shfaqet në një nga karakteristikat e mëposhtme, të cilat nuk kërkohet të jenë kumulative. [...] Gjithashtu, Kolegji vlerëson se, referuar ligjit, edhe një kontratë e lidhur midis dy personave juridikë të së drejtës publike, mund të jetë me karakter administrativ, nëse ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët të organeve publike.

21. Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se kriteri ligjor përcaktues për të konkluduar, nëse një kontratë është civile apo administrative orientohet kryesisht nga rastet e mësipërme dhe jo nga fakti, nëse është formësuar në bazë të një procedure prokurimi publik. Ky element ka konfonduar shpesh praktikën gjyqësore. Një veprim juridik, që përbën kontratë administrative mund të realizohet faktikisht edhe pa u kryer kjo procedurë ligjore e lidhjes së kontratës. Sigurisht që procedura e prokurimit publik është forma, me të cilën autoriteti publik kontrakton, sipas ligjit, të drejtat dhe detyrimet me të tretët, por ajo nuk mund të jetë kriteri i vetëm për kualifikimin e një fakti juridik si kontratë administrative. Janë të njohura në ligj kontrata që mund të konsiderohen si administrative, pa qenë nevoja e kryerjes së procedurave të prokurimit publik, siç janë p.sh., kontratat që lidhen sipas ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Të tilla janë kontratat e përbashkëta mes organeve të qeverisjes vendore për delegimin e kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta njëra-tjetrës, ose kontraktimit me një palë të tretë, të krijimit të një personi juridik, etj., (nenet 9/1, pikat 1.5 dhe 1.6/a, nenet 14, 21/3, 30/5).

22. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se analiza juridike e kualifikimit të faktit si kontratë administrative nuk mund të fillojë dhe të mbarojë vetëm me verifikimin e një kriteri. Prandaj, arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në parashtresën e ngritur, konkludohet se është i pabazuar në ligj. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vlerëson se kontrata e privatizimit, nga zbatimi i së cilës ka rrjedhur mosmarrëveshja dhe padia objekt gjykimi, është një kontratë me natyrë të pastër civile dhe ka si qëllim fitimin e të drejtës së pronësisë që është realizuar ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Pra, nisur edhe nga kërkimi i palës paditëse për pavlefshmërinë e kontratës së shitjes, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë thekson se gjykata e rrethit gjyqësor në çështjen objekt shqyrtimi

duke konstatuar pavlefshmërinë e veprimit juridik, nuk bënë gjë tjetër vetëm se shqyrton pretendimin e paditësit për njohjen bashkëpronar mbi sendin objekt gjykimi, që është kërkim me natyrë të pastër civile. Në këtë kuptim konstatohet se sendi objekt shqyrtimi, pra apartamenti i përfituar nga pala e paditur nëpërmjet kontratës së shitjes, nuk ka për bazë interesin publik, pasi nuk shërben dhe nuk është në funksion të garantimit të një shërbim publik konkret dhe se si i tillë nuk i jep karakterin e kontratës administrative veprimit juridik të ndërmarrë ndërmjet palëve. Për rrjedhojë, për sa kohë nuk kemi një shërbimi publik që kjo kontratë siguron nëpërmjet ekzekutimit të saj, bën që ky veprim juridik të kualifikohet si kontratë civile dhe u nënshtrohet rregullimeve përkatëse të përcaktuar në Kodin Civil (KC).

23. Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e vlerëson të pambështetur në ligj arsyetimin dhe argumentet lidhur me ligjin procedural dhe material të zbatueshëm, si dhe interpretimin e tij, në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe për rrjedhojë, ky vendim duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021- 142, datë 01.02.2021

Gjykata ka detyrimin të vlerësojë për çdo rast individual nevojën e ruajtjes së sekretit shtetëror, në raport me domosdoshmërinë për të gjykuar me objektivitet dhe për të nxjerrë të vërtetën gjatë gjykimit, veçanërisht kur kjo sjell pasoja të konsiderueshme dhe të pakthyeshme për individët. Detyrimi i gjykatës për të ruajtur sekretin nuk e pengon atë të vlerësojë ligjshmërinë e aktit administrativ dhe si pasojë, edhe bazueshmërinë e padisë së ngritur para saj për zgjidhje. E drejta e palëve në gjykim për t'u njohur me aktet shkresore, provat dhe faktet që administrohen në proces është parakusht i një procesi të rregullt ligjor. Rastet e kufizimit të kësaj të drejte mund të bëhen vetëm nëse nuk cenojnë të drejtën e mbrojtjes, deri në atë masë sa ta bëjnë atë joefektive.

Sipas ligjit, organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Privimi i gjykatës nga aksesi në informacionin e kërkuar cenon vlerësimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe diskrecionit të ushtruar nga ky organ dhe për pasojë pozitat procedurale palëve në gjykim, duke i vendosur ato në kushte të pabarabarta.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia e A.I. është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 31.03.2008. Padia e H.M. është paraqitur veçmas, më datë 03.04.2008. Çështjet e shortuara para gjyqtarëve të ndryshëm janë bashkuar në një të vetme, për arsye të lidhjes që kanë mes tyre.

2. Nga fashikulli i gjykimit rezulton se palët paditëse janë bashkëshortë dhe janë shtetas egjiptianë. Ata kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në vitin 1995. Paditësit janë prindër të katër fëmijëve, të cilët në kohën e gjykimit të çështjes kanë qenë të mitur. [...] Palët paditëse kanë pasur leje qëndrimi të rregullt dhe të rinovuar, sipas procedurave ligjore respektive.

3. Leja e qëndrimit e kërkuar prej tyre në vitin 2008 nuk është miratuar. Me urdhrin e ministrit të Brendshëm nr.960/1, datë 15.03.2008 është urdhëruar largimi nga territori i Republikës së Shqipërisë së palëve paditëse, si persona të padëshiruar. [...]

6. Palët paditëse nuk kanë qenë dakord me urdhrin për të mosrinovuar lejet e qëndrimit dhe për t'u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë dhe kanë paraqitur padi në gjykatë.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7120, datë 25.07.2008, ka vendosur: "- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. – Anulimin e aktit administrativ të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.437 prot., datë 11.03.2008, që bën fjalë "Për largimin nga territori i RSh-së të dy shtetasve të huaj", si dhe shkresën nr.960/1 prot., datë 15.03.2008 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtoria Rajonale e Migracionit. Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera të objektit.*".

8. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se veprimet e palëve të paditura janë në kundërshtim me ligjin, pasi ato nuk kanë ndërmarrë asnjë masë për verifikimin e kushteve dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve të mitur, duke pasur parasysh edhe rrethanat e posaçme familjare të palëve paditëse. [...]

9. Kundër vendimit ka ushtruar ankim pala e paditur, Ministria e Brendshme. Në ankim është kërkuar ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimi i padisë, si i pabazuar në ligj dhe në prova. Në ankim është pretenduar se rinovimi i lejes së qëndrimit dhe dhënia e kësaj lejeje, qoftë për 1 vit apo për 5 vjet, është vendim diskrecional i ministrit të Brendshëm dhe në rastin objekt gjykimi kjo kompetencë është realizuar sipas ligjit. Në apel pretendohet se urdhri i ministrit të Brendshëm është marrë pas propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe Shërbimit Informativ Shtetëror që të mos rinovohet leja e qëndrimit për palët paditëse.

10. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar apel pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Pala e paditur ka pretenduar se gjykata nuk e ka shqyrtuar çështjen brenda afatit 45 ditor, sikurse parashikohet nga ligji për të huajt. Në apel pretendohet se ministri i Brendshëm e ka marrë vendimin e dëbimit, pasi Shërbimi Informativ Shtetëror nuk ka dhënë pëlqimin për të. Gjithashtu, sipas palës së paditur, gjykata ka cenuar të drejtën e saj për të realizuar një mbrojtje efektive dhe ka kapërcyer kufijtë e padisë e të objektit të gjykimit, pasi objekt i këtij gjykimi nuk kanë qenë dëbimi i fëmijëve por dëbimi i paditësve. Pala e paditur në apel pretendon se në këtë rast nuk jemi para dëbimit por para largimit, pasi urdhri i ministrit të Brendshëm nuk ka urdhëruar dëbimin, por largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë.

11. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.971, datë 20.07.2009, ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit nr.7120, datë 25.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova.*".[...]

13. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse, H.M. dhe A.I.. Rekursi rezulton të jetë njoftuar dhe pala e paditur nuk ka paraqitur kundër-rekurs. [...]

14. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2012-245, datë 08.02.2012 ka vendosur: "*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse A.I.i, H.M..*". Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar vetëm se: "*Rekursi i paraqitur nga pala paditëse A.I.i, H.M. nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-s.*".

15. Kundër këtij vendimi, palët paditëse kanë ushtruar ankim individual kushtetues në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.3, datë 26.01.2015, ka vendosur: "*- Pranimin pjesërisht të kërkesës. - Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. - Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-245, datë 08.02.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.*".

16. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se vlerësimi i provave apo interpretimi i fakteve nuk mundet të merren në shqyrtim, pasi janë jashtë juridiksionit të asaj gjykate. Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet se, cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre (shkaqeve), nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Sipas asaj Gjykate, mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës dhe se kjo mënyrë e arsyetimit të vendimit krijon dyshime edhe mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv, pasi pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë nuk ka thjesht karakter formal, por përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij. Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se vendimi i mospranimit të rekursit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

17. Gjykata Kushtetuese ka gjetur shkelje të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme nga dy gjykatat e shkallëve të para për gjykimin brenda afatit ligjor 45 ditësh. Ajo ka arsyetuar se të dy gjykatat nuk e kanë respektuar kërkesën për gjykimin e kësaj çështjeje në përputhje me standardin e procesit

të rregullt ligjor për shqyrtimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se, ndonëse cenimi i këtij standardi është pretenduar edhe në rekursin e paraqitur, kjo mangësi e procesit nuk është konstatuar dhe as është korrigjuar nga Gjykata e Lartë.

18. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 03.04.2018 ka vendosur: "*Të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në prani të palëve ndërgjyqëse.*". Rezulton se nga kjo datë nuk është zhvilluar asnjë seancë gjyqësore për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Për shkak të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji për shqyrtimin e kësaj çështjeje me procedurë të përshpejtuar, në datën 15.01.2021, palët janë njoftuar me njoftim individual dhe shpallje për zhvillimin e seancës gjyqësore. Nga njoftimet rezulton se palët ndërgjyqëse kanë marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës gjyqësore.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

a) Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues.

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me tre gjyqtarë çështjen objekt gjykimi. Në këto kushte, Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se formimi i trupit gjykues është pjesë përbërëse e parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, koncepti gjykatë e caktuar me ligj është konsideruar si element i procesit të rregullt ligjor dhe si i tillë, pjesë përbërëse e nenit 42/1 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Kjo gjykatë ka një praktikë të konsoliduar në të cilën, ndërmjet të tjerave, ka konkluduar se shprehja *"gjykatë ... e caktuar me ligj" në nenin 42/2 të Kushtetutës, mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete"* (*shih, vendimet nr.41, datë 29.12.2005, nr.14, datë 17.04.2007 dhe nr.11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese.) [...]*

b) *Në lidhje me shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse*

31. Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ka respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, duke mos u dhënë mundësi palëve paditëse të mbrohen efektivisht dhe të ushtrojnë të drejtat e garantuara nga parimi i kontradiktoritetit në gjykim. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, si gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

32. Në përcaktimin e gjykatës kompetente për vijimin e gjykimit, Kolegji mban në konsideratë se mosmarrëveshja objekt gjykimi ka nisur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.49/2012 dhe, në këto kushte, referuar nenit 7, shkronja "a", kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e mosmarrëveshjes është Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

33. Kolegji thekson se prova kryesore që ka shërbyer si shkak për propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamentit për Kufirin dhe Migracionit ka qenë shkresa nr.465/1, datë 28.02.2008, e Shërbimit Informativ Shtetëror, nëpërmjet së cilës ky organ nuk ka dhënë pëlqimin për rinovimin e lejes së qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, për dy paditësit. Mbi bazën e kësaj shkrese, ministri i Brendshëm ka nxjerrë urdhrin e largimit. Bazuar vetëm mbi këtë dokument zyrtar, Gjykata e Apelit Tiranë ka konkluduar se urdhri i ministrit të Brendshëm është i bazuar në fakt dhe në ligj. Nga gjykimi në të dyja shkallët rezulton se kjo shkresë nuk është paraqitur si provë nga pala e paditur dhe as nuk është administruar si provë. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se palët paditëse nuk kanë qenë në gjendje të mbrohen gjyqësisht dhe të ushtrojnë efektivisht të drejtën e padisë, apelit apo rekursit, pasi ato nuk kanë arritur të debatojnë mbi dokumentin kryesor që ka shërbyer si bazë për dëbimin e tyre. Mosmarrja dijeni ndaj këtij dokumenti as nga palët dhe as nga gjykata ka sjellë si pasojë pamundësinë e vlerësimit të vërtetësisë së pretendimeve të ngritura nga pala e paditur në proces. Gjykatat nuk kanë zbatuar nenin 249 të KPC-s për të konkluduar mbi vërtetësinë apo mbi drejtësinë e një fakti apo konkluzioni të organeve të administratës publike. Kolegji vlerëson se gjykata e apelit nuk e ka bazuar vendimin e saj në prova, për të cilat palët kanë qenë në gjendje të debatojnë, sipas parimit të kontradiktoritetit, në bazë dhe për zbatim të neneve 19, 20, 21 dhe 309, të KPC-s.

34. Kolegji vlerëson, gjithashtu, se gjatë gjykimit në apel nuk janë respektuar rregullimet që parashikohen në nenet 39 dhe 54, pika 1, të Kushtetutës, neni 8 i KEDNJ-së, si dhe neni 1, i Protokollit nr.7, të KEDNJ-së, ku parashikohen garanci për mosdëbimin e shtetasve shqiptarë, si dhe të shtetasve të huaj, sipas ligjit, ashtu si edhe mbrojtja e veçantë që gëzojnë fëmijët. Kolegji sjell në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim, GJEDNJ), ku ndër të tjera është mbajtur qëndrimi se mosinformimi i kërkuesit (në këtë rast, shtetas i huaj rezident) nga autoritetet kombëtare mbi shkakun e dëbimit, sipas ligjit, si dhe vlerësimi thjesht formal i shkaqeve të dëbimit nga gjykatat, përbën cenim të së drejtës së mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim. Këto situata janë analizuar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, në raport me parashikimet e nenit 8 të KEDNJ-së (e drejta për respektimin e

jetës private dhe familjare), nenit 3 (ndalimi i dëbimit të shtetasve), nenit 4, të Protokollit nr. 4, (ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve), si dhe nenit 1, të Protokollit nr.7, të KEDNJ-së (garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve). Për sa kohë që nga dëbimi i familjes, ose i prindërve, preken fëmijët, në çdo rast duhet të mbahet parasysh interesi më i lartë i fëmijës dhe mirëqenia e tij, veçanërisht shkalla e vështirësive me të cilat mund të përballet në vendin pritës (në rastin konkret, njëri prej fëmijëve, duke qenë shtetas shqiptar nuk e konsideron vendin e dëbimit si "atdhe"), si dhe lidhjet sociale, kulturore dhe familjare, si me shtetin ku qëndron, ashtu edhe me vendin e origjinës *(shih, çështja Üner k. Holandës, vendim i GJEDNJ-së, i datës 18.10.2006, si dhe çështja Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës, nr. 1615/07)*. Në raste të tilla, GJEDNJ i jep rëndësi të madhe vlerësimit, lidhur me faktin se ku kanë lindur dhe ku shkollohen fëmijët, nëse e flasin gjuhën e vendit të origjinës, nëse janë në moshë që mund të përshtaten me vendin ku po kthehen *(shih, çështja Darren Omoregie dhe të tjerë k. Norvegjisë, i datës 31.07.2008; Onur k. Mbretërisë së Bashkuar nr.27.319/07 të GJEDNJ-së)*.

35. Gjithashtu, në çështjet "*Lui k. Rusisë*", "*C.G. dhe të tjerë k. Bullgarisë*" dhe "*Lupsa k. Rumanisë*", GJEDNJ ka arsyetuar, ndër të tjera, se gjykatat kombëtare nuk ia nënshtruan një hetimi të kujdesshëm dhe të plotë pretendimin e ekzekutivit se kërkuesi përbënte rrezik për sigurinë kombëtare. GJEDNJ ka vlerësuar se, në rastet kur akti i dëbimit citon vetëm normat ligjore të zbatueshme dhe përmend faktin se kërkuesi përbën rrezik për sigurinë kombëtare dhe një konkluzion i tillë është bazuar në një informacion të paspecifikuar në përmbajtje të një dokumenti sekret të brendshëm dhe që nuk i nënshtrohet debatit gjyqësor, ka shkelje të nenit 6 dhe nenit 8 të KEDNJ-së. Njëkohësisht, GJEDNJ ka vlerësuar se, në mungesë të njohurive mbi faktet kryesore që shërbyen si bazë për këtë vlerësim, individi nuk ka qenë në gjendje të kundërshtojë çështjen në mënyrë të përshtatshme përpara Ministrit të Punëve të Brendshme dhe as në procedurat gjyqësore (*C.G. dhe të tjerë k. Bullgarisë*, paragrafi 45). GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se, ndonëse individit i është dhënë mundësia e kundërshtimit të aktit administrativ në gjykatë, ai nuk ka gëzuar minimumin e mbrojtjes kundër arbitraritetit në këto rrethana *(shih, Kaushal dhe të tjerë k. Bullgarisë, 02/12/2010, paragrafi 27)*.

36. Kolegji, i orientuar nga kjo jurisprudencë e konsoliduar e GJEDNJ-së, lidhur me rastin në shqyrtim, konstaton se Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka marrë në konsideratë faktin se njëri nga fëmijët e mitur të paditësve është shtetas shqiptar, si dhe nuk ka analizuar ndikimin dhe pasojat që do t'i vinin nga dëbimi i prindërve të tij, sipas urdhrit të ministrit të Brendshëm. Ky shtetas gëzon mbrojtje të dyfishtë, si shtetas shqiptar, ndaj të cilit nuk lejohet

dëbimi (neni 39, pika 1, i Kushtetutës), por edhe si fëmijë që gëzon mbrojtje të veçantë (neni 54, pika 1, i Kushtetutës). Mbrojtja e shtetasve shqiptarë dhe e interesit më të lartë të fëmijës janë parime të nivelit kushtetues dhe konvertor, të cilat gjykata nuk mund t'i anashkalojë, pa analizuar efektin që ka një akt administrativ tek to, mbështetur në parimin e proporcionalitetit, të ndërhyrjes së mundshme të veprimtarisë shtetërore në sferën e individit.

37. Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit duhej të analizonte edhe pretendimin e paraqitur se të dhënat e disponuara nga Shërbimi Informativ Shtetëror janë sekret shtetëror dhe nuk mund të bëhen të njohura në proces. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë për çdo rast individual nevojën e ruajtjes së sekretit shtetëror, në raport me domosdoshmërinë për të gjykuar me objektivitet dhe për të nxjerrë të vërtetën gjatë gjykimit, veçanërisht kur kjo sjell pasoja të konsiderueshme dhe të pakthyeshme për individët. Në raste të caktuara, gjykata duhet të vlerësojë mundësinë e marrjes së informacionit sekret, qoftë dhe pjesërisht, në masën që është e nevojshme për të vlerësuar ndërhyrjen e veprimtarisë shtetërore në sferën private të individit, duke respektuar detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit që ajo administron (shih, vendimin e Gjykatës Federale Administrative gjermane BVerGE 66, 233, pg.236). Në një rast të tillë, gjykata vlerëson në thelb informacionin apo të dhënat e aktit të klasifikuar sekret dhe krijon bindjen e saj të brendshme lidhur me ligjshmërinë e veprimeve administrative të palës së paditur, duke ruajtur në masën e duhur sekretin. Detyrimi i gjykatës për të ruajtur sekretin nuk e pengon atë të vlerësojë ligjshmërinë e aktit administrativ dhe si pasojë, edhe bazueshmërinë e padisë së ngritur para saj për zgjidhje. Gjatë gjithë kohës, gjykata mban parasysh raportin e drejtë dhe të arsyeshëm midis ndërhyrjes së veprimtarisë shtetërore dhe sferës së lirisë së individit. E drejta e palëve në gjykim për t'u njohur me aktet shkresore, provat dhe faktet që administrohen në proces është parakusht i një procesi të rregullt ligjor. Rastet e kufizimit të kësaj të drejte mund të bëhen vetëm nëse nuk cenojnë të drejtën e mbrojtjes, deri në atë masë sa ta bëjnë atë joefektive (shih, vendimin e Gjykatës Federale Kushtetuese gjermane BverfGE 101, 106, për të drejtën e aksesit në dokumentet shtetërore).

38. Këtë linjë qëndrimi ka ndjekur edhe GJEDNJ-ja, e cila ka theksuar se parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në gjykim janë standarde thelbësore të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ-së. Palët duhet të gëzojnë "një ekuilibër të drejtë" në procesin gjyqësor. Pala kërkuese duhet të ketë, në mënyrë të arsyeshme, mundësinë për të paraqitur çështjen, në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh thelbësor kundrejt palës kundërshtare (*Avotiņš k. Letonisë*). Megjithatë, këto të drejta nuk kanë karakter absolut. GJEDNJ-ja ka

vlerësuar se në kontekstin e të drejtave procedurale civile, parimet e nenit 6/1 të Konventës konsiderohen të përmbushura, kur gjykatat kombëtare kanë pavarësinë dhe paanësinë e nevojshme, kanë akses të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara që justifikojnë vendimmarrjen e organit, kur vlerësojnë në thelb vendimmarrjen për revokimin e certifikatës së sigurisë dhe mund të shfuqizojnë vendimmarrjen arbitrare, nëse është e nevojshme (çështja *Gulamhussein dhe Tariq k. Mbretërisë së Bashkuar, 2018* paragrafi 71). Gjykata ka vlerësuar se të drejtat që rrjedhin nga neni 6/1 i KEDNJ-së nuk janë absolute. Gjithashtu, e drejta për të zbuluar prova relevante nuk është një e drejtë absolute, megjithatë, vetëm masat kufizuese që nuk cenojnë thelbin e së drejtës janë të lejuara në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ-së. Vështirësitë që shkaktohen nga kufizimi i të drejtave duhet të jenë të balancuara mjaftueshëm nga procedurat vijuese të autoriteteve gjyqësore (po aty, paragrafi 86).

39. Gjithashtu, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së ka pranuar se aksesi i gjykatave kombëtare në rishikimin e materialit të klasifikuar mund të përbëjë garancinë kryesore për respektimin e të drejtave procedurale të palëve që nuk kanë mundësinë të njihen me këtë informacioni. Gjykata kundrejt pretendimeve të kërkuesit se është cenuar parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në gjykim, ka vlerësuar se procedura e vendimmarrjes plotësonte 'aq sa ishte e mundur' kërkesat e procesit të drejtë, kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në proces dhe, si rrjedhojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës. Gjykata në këtë përfundim ka arritur duke konsideruar, ndër të tjera, se gjykatat vendase kishin qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara, në të cilat autoriteti ishte mbështetur për të justifikuar vendimmarrjen e tij dhe se gjykatat kishin mundësi të kryenin një ekzaminim të hollësishëm të shkaqeve, në të cilat është bazuar autoriteti për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara. Gjykata ka çmuar se, duke pasur në konsideratë procedurat në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe hapësirën e vlerësimit që gëzojnë autoritetet kombëtare, kufizimet me të cilat u përball kërkuesi në raport me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve janë kompensuar në një mënyrë të tillë që ka ruajtur balancën mes palëve, pa u cenuar e drejta e kërkuesit për një gjykim të drejtë (çështja *Regner k. Republikës Çeke 2017,* paragrafi 161).

40. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, referuar edhe kësaj jurisprudence të konsoliduar, Kolegji konstaton se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Tiranë nuk është në përputhje me standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja. Rezulton se Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka respektuar rregullat mbi procesin e të provuarit dhe shpërndarjen e barrës së provës në një gjykim

civil, në kuptimin e gjerë, dhe administrativ, në kuptimin e ngushtë. Në bazë të neneve 12 dhe 213, të KPC-s, palët e paditura kishin barrën e provës për të provuar bazueshmërinë në fakt dhe në ligj të aktit administrativ të marrë prej tyre. Sipas ligjit, organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Nga aktet bashkëlidhur fashikullit të gjykimit rezulton se pala e paditur nuk e ka përmbushur këtë detyrim procedural dhe, për rrjedhojë, nuk ka arritur të provojë bazueshmërinë e aktit administrativ të dëbimit në faktin e pretenduar si të konstatuar.

41. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se privimi i gjykatës, përgjatë gjykimit, nga aksesi në informacionin e disponuar në shkresën nr.465/1, datë 28.02.2008 të Shërbimit Informativ Shtetëror, ka bërë të pamundur vlerësimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe diskrecionit të ushtruar përmes urdherit të largimit të ministrit të Brendshëm dhe, për pasojë, ka cenuar rëndë pozitat procedurale të palëve në gjykim, duke i vendosur ato në kushte të pabarabarta, në shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve. Kolegji vlerëson se gjykimi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së.

42. Kolegji konstaton gjithashtu se, vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë i mungon edhe analiza e faktorëve të tjerë që duhen marrë në konsideratë në rastin e dëbimit si: fakti se palët paditëse kishin 13 vjet që jetonin në Shqipëri, si rezidentë të ligjshëm, faktin që paditësit kishin familjen me tre fëmijë të tjerë të mitur, apo faktin se ndaj palëve paditëse nuk është nisur ndonjë procedim penal në Shqipëri dhe se në dosje nuk ka asnjë të dhënë që të provojë se ato përfshihen në ndonjërën nga hipotezat ligjore që justifikojnë dëbimin nga territori i Republikës së Shqipërisë. Të gjitha këto mangësi kanë çuar në mosmarrjen në konsideratë të garancive që ofron detyrimi për mbrojtje të së drejtës themelore për jetë të qetë familjare, mbrojtjes së veçantë që shteti duhet t'u garantojë familjes dhe fëmijëve. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor, duke mos respektuar standardet e arsyetimit të një vendimi gjyqësor.

43. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova, të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme

nga gjyqtari i faktit (*shih, vendimi nr.27, datë 24.06.2013 i Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, Kolegji thekson se Gjykata e Lartë nuk mund të ndryshojë faktet e çështjes apo të merret me vlerësimin e provave, pasi konstatimi i fakteve përmes procesit të të provuarit në gjykim është një atribut që i përket juridiksionit gjyqësor të gjykatave të faktit. Është detyrim i gjykatës së shkallës së parë, por në veçanti i gjykatës së apelit të hetojë dhe të vlerësojë të gjitha pretendimet e ngritura nga palët ndërgjyqëse, duke garantuar parimin e kontradiktoritet në gjykim dhe mbrojtjes efektive të palëve. Kryerja e këtij hetimi të plotë gjyqësor dhe dhënia përgjigje në mënyrë të qartë dhe të arsyetuar ndaj pretendimeve të palëve në proces është detyrim themelor i gjykatës, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes. Nisur nga ky fakt, Kolegji Administrativ çmon se vetëm pas administrimit dhe vlerësimit përmbajtësor të provave në masën e nevojshme që të mund të çmohet drejt mbi shkaqet e dëbimit të paditësve dhe efektit të aktit administrativ ndaj fëmijëve të mitur, mund të arrihet në përfundimin nëse padia është apo ajo e bazuar në ligj dhe në prova.

44. Nisur nga arsyetimi i mësipërm, por edhe në reflektim të jurisprudencës së konsoliduar të GJEDNJ-së, Kolegji konkludon se në gjykimin e kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit nuk ka realizuar një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin (neni 14 i KPC-s), duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të palëve në proces, si dhe, duke mos respektuar standardin e mbrojtjes efektive dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

45. Kolegji rithekson se Gjykata Administrative e Apelit, tashmë si një gjykatë kompetente, gjatë rigjykimit të kësaj çështjeje duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke pasur në konsideratë edhe veçantitë që paraqet gjykimi administrativ. Në këtë kuptim, gjykata është e detyruar të vlerësojë zbatimin e parimeve të përgjithshme mbi barrën e provës dhe mosparaqitjen e provave nga organi publik në procesin gjyqësor administrativ, në zbatim të neneve 3, 35 dhe 26/3, të ligjit nr.49/2012.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-01557-2015, datë 22.02.2021

Gjykata duhet të vendosë pushimin e gjykimit për pretendime që nuk gjejnë mbështetje në dispozitat ligjore të rendit juridik pasi ndodhet para një padie që nuk mund të ngrihet. Kjo duhet të dallohet nga rasti kur një pretendim nuk gjen mbështetje ligjore, me pasojë rrëzimin e kërkesëpadisë. Në rastin kur ligji është i paqartë, i paplotë ose mungon, por mbi bazën e parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe interpretimit të ligjit, mosmarrëveshja mund të zgjidhet, gjykata ka për detyrë t'i japë zgjidhje çështjes në themelin e saj.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi E.K. ka qenë i punësuar pranë palës së paditur, Institucioni i Ekzekutimit të endimeve penale "Jordan Misja" Tiranë, në detyrën e punonjësit të rolit bazë. Me Urdhrin nr.2625, datë 05.03.2014, "Për largim nga detyra të një punonjësi policie të rolit bazë", të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve është urdhëruar largimi nga detyra i paditësit, me motivacionin për "Shkelje të rënda të rregullave të shërbimit". Më tej, paditësi është ankuar lidhur me masën e marrë ndaj tij, pranë Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë, i cili me vendimin nr.3418 prot., datë 08.05.2014 ka vendosur lënien në fuqi të masës disiplinore "Largim nga detyra", të dhënë ndaj paditësit. Në bazë të këtij vendimi dhe të urdhrit të mësipërm është nxjerrë Urdhri i largimit nga detyra të paditësit nr. 405 prot., datë 10.03.2014 i Drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tiranë, duke vendosur, ndër të tjera, edhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare më datë 11.03.2014.

2. Në këto kushte, duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje të palës së paditur, paditësi i është drejtuar gjykatës me kërkesë padinë, objekt gjykimi.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.5595, datë 13.10.2014 ka vendosur: "*1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; 2. Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditësit E.K. 6 muaj pagë dëmshpërblim për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar në mënyre të menjëhershme dhe pa shkak të pajustifikuar. 2. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit E.K. 2 muaj pagë dëmshpërblim për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës; 3. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit E.K. 2 muaj pagë dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. […]*

4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim paditësi E.K. duke parashtruar këto shkaqe në ankim:"- *Vendimi i gjykatës është i padrejtë dhe i pambështetur në ligj e në prova dhe si i tillë duhet të ndryshohet duke u vendosur pranimi plotësisht i kërkesë padisë. […] Për gjykatën, çështja objekt gjykimi, është një marrëdhënie pune e cila rregullohet me Ligjin r.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" dhe ky fakt theksohet edhe në ligjin e posaçëm nr.10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve". […].*

5. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.526, datë 12.03.2015, ka vendosur: "*1. Prishjen e vendimit nr.5595 datë 13.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e çështjes; […] duke* arsyetuar se […] "*Për punonjësit që merren në radhët e Policisë së Burgjeve ekziston një marrëdhënie kontraktore në formën e kontratës së shërbimit publik, kjo në vështrim dhe të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë […ndërkohë që] paditësi E.K. ka parashtruar në thelb, një mosmarrëveshje pune, për të cilën pretendon se rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës dhe për pasojë, ka kërkuar rregullimin e pasojave të zgjidhjes bazuar në dëmshpërblimet që ky Kod i njeh punëmarrësit në rastin e zgjidhjes së marrëdhënies punës pa shkaqe të justifikuara nga punëdhënësi. […] Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi nr.5595, datë 13.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të prishet duke vendosur pushimin e gjykimit të padisë si padi që nuk mund të ngrihet.".*

7. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë ka ushtruar rekurs pala paditëse duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe pranimin e padisë […]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Paraprakisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe pala paditëse ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë (*shih, vendimi nr.00–2020-50, datë 27.05.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Pra, nga ana e

Kolegjit Administrativ është vlerësuar si e nevojshme analiza mbi ligjin e zbatueshëm, të cilit do të duhet t'i referohet për të zgjidhur mosmarrëveshjen administrative, në rastin në shqyrtim. [...]

10. Vendimi nr.526, datë 12.03.2015 i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është prishur vendimi nr.5595, datë 13.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes, është marrë në shkelje të dispozitave procedurale.

11. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se kërkimi i paditësit për dëmshpërblim do të legjitimohej vetëm në rast të kundërshtimit të aktit administrativ me të cilin i padituri ka dhënë masën disiplinore të largimit nga detyra. Në këtë linjë arsyetimi, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se padia objekt gjykimi, është një padi që nuk mund të ngrihet dhe në zbatim të nenit 50, shkronja "d", të ligjit nr.49/2012 ka vendosur pushimin e gjykimit.

12. Në praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë është parashtruar në vijimësi interpretimi që duhet të bëhet lidhur me institutin procedural të "padive që nuk mund të ngrihen". Në kuptim të nenit 299, shkronja c,[30] të Kodit të Procedurës Civile (KPC), padia nuk mund të ngrihet në rastet e mungesës të parakushteve procedurale, si ekzistenca e gjyqvarësisë (neni 58 i KPC-s); mungesa e zotësisë së palëve (nenet 33 dhe 91, të KPC-s); dhe në raste të mungesës së kushteve themelore të padisë, të tilla si mungesa e legjitimitetit formal dhe interesit për të ngritur padi (neni 184 i KPC-s), si dhe kur e drejta e pretenduar të mbrohet nëpërmjet vendimit të gjykatës nuk është parashikuar në një normë të së drejtës.

13. Në vendimin nr.262, datë 22.05.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndërmjet të tjerave, arsyetohet se *"Rrëzimi i padisë ka vend kur ngritja e padisë e ka një bazë juridike, një shkak ligjor, bazuar në të drejtën objektive, për t'iu parashtruar gjykatës për zgjidhje, pra është një padi që mund të ngrihet dhe i përket juridiksionit gjyqësor, por ajo që kërkohet me padi, në përfundim të gjykimit, nuk arrin të provohet. Po kështu, edhe nëse ajo që është e kërkueshme ligjërisht në rrugë gjyqësore, mbi provat e paraqitura, vërtetohet se nuk gjen mbështetje në ligj. Kolegji Civil vlerëson të evidentojë se, në thelb, ngritja e padisë, hartimi dhe paraqitja e kërkesëpadisë, janë mjeti procedural me të cilin paditësi vë në lëvizje gjykatën, kur pretendon se ka një të drejtë subjektive, për të njohur a mbrojtur, e cila gjen mbështetje në të drejtën pozitive, si nga pikëpamja materiale ashtu edhe nga ajo procedurale (për t'iu drejtuar gjykatës). Nëse ajo që, konkretisht, paditësi pretendon se i është cenuar apo që duhet t'i njihet, parashikohet nga e drejta pozitive në aspektin material, e akoma më tej, nëse e drejta pozitive i njeh paditësit të drejtën që këtë të kërkojë ta realizojë nëpërmjet gjykatës, atëherë gjykata ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes për të verifikuar nëse ajo kërkohet konkretisht me padi (në objekt) është e mbështetur edhe në prova e në ligj. E kundërta, nëse ajo që i kërkohet gjykatës nuk gjen mbështetje në të drejtën pozitive materiale, atëherë gjykata pushon çështjen si një padi që nuk mund të ngrihet (neni 468 i KPC-s). Por, nuk kemi të bëjmë me mungesë të së drejtës pozitive materiale, ndaj edhe gjykata nuk e pushon vetvetiu çështjen me motivin se nuk gjen një normë konkrete juridike ligjore të zbatueshme për të drejtën që pretendohet nga paditësi. Kjo sepse mund të ndodhë që ligji (norma juridike) mungon, nuk është i qartë, i plotë, apo është kontradiktor. Gjithashtu, gjykata vendos pushimin e çështjes edhe kur, ndonëse ajo që ngrihet në padi ka mbështetje në të drejtën pozitive materiale, nga ana e së drejtës pozitive procedurale parashikohet shprehimisht detyrimi që, ai kërkim, nuk mund t'i parashtrohet (drejtpërdrejt) gjykatës, por një organi që bën pjesë në juridiksionin administrativ apo një organi tjetër të ngarkuar posaçërisht për atë qëllim nga ligji (neni 468 i KPC-s)."*.

[30] Ndryshuar me ligjin nr.38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8116, datë 29.08.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", shtuar pika "c", përmbajtja e të cilës përkon me nenin 468, tashmë i shfuqizuar.

14. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se rasti kur e drejta e pretenduar në kërkesëpadi nuk është parashikuar në ndonjë normë pozitive të së drejtës, me pasojë pushimin e gjykimit, duhet të dallohet nga rasti kur një pretendim nuk gjen mbështetje ligjore, me pasojë rrëzimin e kërkesëpadisë.

15. *Kolegji vlerëson se në rastin e një ometimi absolut të ligjit, atëherë kur pretendimi nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore të rendit juridik, pra nuk ekziston e drejta pozitive e pretenduar që të mbështesë kërkimet e kërkesëpadisë, gjykata do të duhet të vendosë pushimin e gjykimit, ndodhur para një padie që nuk mund të ngrihet. Në rastin e një ometimi relativ, kur ligji është i paqartë, i paplotë ose mungon, por mbi bazën e parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe interpretimit të ligjit, mosmarrëveshja mund të zgjidhet, gjykata në përputhje me nenin 1, pika 2, të KPC-s ka për detyrë që, duke interpretuar ligjin, t'i japë zgjidhje çështjes në themelin e saj.*

16. Mosmarrëveshja objekt gjykimi rregullohet nga dispozitat e ligjit të posaçëm, konkretisht neni 13 i ligjit nr.10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", në të cilin parashikohet se "*Marrëdhëniet e punës në Policinë e Burgjeve për çështjet të cilat nuk parashikohen në këtë ligj, rregullohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar...".*

17. Kolegji vlerëson se, sipas parimit të disponibilitetit (*nemo iudex sine actore*) është paditësi ai që inicion procesin gjyqësor, përcakton rrethin e të drejtave të kërkuara gjyqësisht dhe palën ndaj të cilës kundrejtohen pretendimet e tij. Në kuptim të nenit 17, pika 2, të ligjit nr.49/2012 dhe nenit 2, 6, 16 e 28, të KPC-s, çmohet se mjeti juridik që gjeneron procesin civil, sikurse edhe atë administrativ, është padia, e cila vendos kufijtë juridiksionalë të shqyrtimit gjyqësor.

18. Në mosmarrëveshjen objekt gjykimi konstatohet se paditësi nuk ka kërkuar gjyqësisht të godasë aktin administrativ me të cilin është liruar nga detyra përmes urdhrit nr.2625, datë 05.03.2014 "largim nga detyra". Paditësi i është drejtuar gjykatës, duke ngritur pretendime lidhur me kërkimin e zgjidhjes së pasojave që rrjedhin nga përfundimi i marrëdhënies së punës, referuar nenit 13, pika 1 të ligjit nr.10032, datë 11.12.2008 "Për policinë e burgjeve", sipas dispozitave të Kodit të Punës.

19. Konstatohet se, ligji i posaçëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi nuk rregullon të drejtën e dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Sipas nenit 4, të Kodit të Punës, dispozitat e këtij Kodi do të gjejnë zbatim në ato raste kur mosmarrëveshja konkrete, e lindur për shkak të marrëdhënieve të punës, nuk gjen rregullim në dispozitat e ligjit të veçantë. Kodi i Punës zbatohet në mënyrë komplementare, në çdo rast që për punëmarrësin nuk mund të zbatohet ndonjë ligj tjetër i veçantë.

20. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se mosmarrëveshja objekt gjykimi, nuk përfshihet në rastet e padive që nuk mund të ngrihen dhe, për pasojë, vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit, sipas nenit 50/d të ligjit nr.49/2012 është e gabuar.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-991-2016, datë 22.02.2021

Në rastet kur ndërhyrësi kryesor në një proces gjyqësor ndodhet në kushtet e shpronësimit faktik për një objekt i cili nuk ka kaluar në pronësi të tij por mbi të cilin ai ka krijuar pritshmëri të ligjshme për përfitimin e të drejtës së pronësisë sipas legjislacionit në fuqi, gëzon mbrojtje sipas Nenit 1, të Protokollit 1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe plotëson kushtet ligjore për të përfituar dëmshpërblim për shkak shpronësimi.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Sh.Gj. është pronar i një pasurie të paluajtshme, të regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë me nr. pasurie 315/178 ZK3866, me sipërfaqe totale 540 m².

2. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.122, datë 05.03.2014 "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe e Tiranës" është vendosur shpronësimi i kësaj prone për sipërfaqen 120 m², në favor të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar, ku për këtë pronë të shpronësuar është vendosur që paditësi të dëmshpërblehet në shumën 1.221.840 lekë.

3. Sipas certifikatës së pronësisë të pronarit Sh.Gj., si dhe kartelës së pasurisë së paluajtshme për pasurinë me nr.315/178, në kolonën "lloji i pasurisë" pasuria e shpronësuar është përcaktuar si tokë "arë". Nga ana e paditësit pretendohet se, pasuria që është shpronësuar është e llojit "truall" dhe jo tokë "arë". Nisur nga regjimi juridik i pronës së shpronësuar, si tokë "truall" dhe jo tokë "arë", paditësi ka kundërshtuar çmimin e shpronësimit për m², si dhe vlerën e përgjithshme të kësaj prone, duke pretenduar për një vlerë më të madhe se ajo që është caktuar me VKM-në, objekt shqyrtimi gjyqësor.

3. Rezulton se mbi truallin e shpronësuar prej 120 m² të paditësit Sh.Gj. ka qenë ndërtuar një objekt informal me sipërfaqe faktike 246.4 m², por që ka qenë në proces legalizimi për sipërfaqen ndërtimore 164 m² dhe që nga palët e paditura nuk është përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të shpronësimit për

këtë sipërfaqe. Ky objekt është ndërtuar në truallin prej 120 m² të paditësit Sh.Gj., nga djali i tij, ndërhyrësi kryesor në këtë gjykim, H.Gj..

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.4547, date 21.09.2015, ka vendosur: "- *Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Sh.Gj.. - Ndryshimin e pjesshëm të VKM-së [...]. Detyrimin e palës së paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar që të dëmshpërblejë paditësin Sh.Gj. për sipërfaqen e truallit të shpronësuar prej 120 m2 sipas vlerës së tregut [...]. Pranimin e kërkesëpadisë së ndërhyrësit kryesor H.Gj.. - Ndryshimin e pjesshëm të VKM-së [...] duke detyruar palët e paditura të përfshijnë në procesin e shpronësimit edhe subjektin H.Gj., për objektin ndërtimor me sipërfaqe 164 m2 të ndodhur mbi truallin e shpronësuar me sipërfaqe 120 m2, me vendndodhje në Unazën e Re, [...] Detyrimin e palës së paditur, Autoriteti Rrugor Shqiptar, që të dëmshpërblejë ndërhyrësin kryesor H.Gj. sipas vlerës së tregut për sipërfaqen e objektit ndërtimor që preket nga shpronësimi [...]*

8. Kundër ankimit të Avokaturës së Shtetit ka paraqitur apel kundërshtues pala paditëse Sh.Gj. dhe ndërhyrësi kryesor H.Gj., duke kërkuar mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr.4547, datë 21.09.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë [...]

9. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.740, datë 07.04.2016, ka vendosur: *"Ndryshimin e vendimit nr.4547 datë 22.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë [...]*

10. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs pala e paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Avokatura e Shtetit duke parashtruar të njëjtat shkaqe rekursi [...]

11. Me vendimin nr.141 datë 20.03.2018 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me kërkesë të palës së paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka vendosur: "*Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.740, datë 07.04.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë e cila ka ndryshuar vendimin nr.4547, datë 21.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të paraqitur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar".*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

12. Paraprakisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe pala paditëse ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë (*shih, vendimi nr.00–2020-50, datë 27.05.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Pra, nga ana e

Kolegjit Administrativ është vlerësuar si e nevojshme analiza mbi ligjin e zbatueshëm, të cilit do të duhet t'i referohet për të zgjidhur mosmarrëveshjen administrative, në rastin në shqyrtim.[...]

16. Për sa më sipër, vlerësohet i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në prova përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë se momenti në të cilin pala paditëse është vënë në afat procedural për ngritjen e padisë është data 19.11.2014, ku me anë të shkresës nr.7659/1 prot., të datës 19.11.2014., paditësi është vënë në dijeni për VKM-në nr.122, datë 05.03.2014 për shpronësimin e pasurisë së tij.

17. Në nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: "*Shpronësimet ose kufizimet në ushtrimin e të drejtës së pronës me ligj mund të kryhen vetëm për interesa publike, të cilat duhet të lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë. Duke iu njohur subjekteve të interesuar që për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit, të bëjnë ankim në gjykatë.*".

18. Në nenin 1 të ligjit nr.7980/1995 përkufizohet termi "Truall" si toka që ndodhet brenda vijave kufizuese të qyteteve (bashkive), pavarësisht nëse përdoret për ndërtim, kopsht, arë etj., si dhe toka jashtë vijave kufizuese që në momentin e trajtimit është përdorur ose do të përdoret për ndërtim, me kusht që të jetë përfunduar dokumentacioni që vërteton tjetërsimin e saj, duke mos qenë më tokë bujqësore, livadh apo kullotë, etj.,.

19. Konstatohet se nga aktet, bashkëlidhur dosjes gjyqësore, paditësi Sh.Gj., sipas certifikatës së pronësisë, si dhe kartelës së pasurisë së paluajtshme, pasuria me nr.315/178, në kolonën "lloji i pasurisë" përcaktohet si tokë "arë". Por nga ana tjetër, gjykatat e faktit kanë konstatuar se sipërfaqja e shpronësuar përfshihet brenda vijës së verdhë, fakt ky që rezulton në bazë të vendimit nr.3, datë 18.12.2004 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e vijave kufizuese të qytetit të Tiranës", i cili bashkëlidhur ka planimetrinë dhe hartën treguese, duke përcaktuar edhe zonat që përfshihen brenda vijës së verdhë. Në përmbajtjen e këtij vendimi, pika 1 e tij përcaktohet se miratohet vija kufizuese e ndërtimit (vija e verdhë) e qytetit të Tiranës, sipas planimetrisë bashkëlidhur. Referuar hartës bashkëlidhur këtij akti dhe referuar vendndodhjes së pronës së paditësit rezulton se ajo ndodhet brenda vijës së verdhë e, për pasojë, duhet trajtuar si tokë truall. Në këtë përfundim kanë arritur edhe gjykatat e faktit, gjithashtu rezulton se ky fakt është pranuar edhe nga vetë pala e paditur, si në prapësimet e saj dhe në ankimin e depozituar dhe në procesin e vlerësimit të sipërfaqes së shpronësuar.

20. Në VKM nr.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe te përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që

shpronësohen të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", pika 1, shkronja "a", i ndryshuar me VKM-në nr.872. datë 12.12.2007 është përcaktuar se "*Vlerësimi për truallin përcaktohet, sipas çmimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për trojet urbane, brenda vijës së verdhë, trojet në qytete dhe komuna, në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar. Në rastet kur mungojnë çmimet e miratuara për zonat përkatëse, vlerësimi për truallin përcaktohet si mesatare e shitblerjeve që ka zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP).".*

21. Sa i përket pretendimit të ngritur në rekurs se është aplikuar procedura përjashtimore, parashikuar në pikën 7 të VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 vlerësohet se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe se gjykatat e faktit kanë analizuar drejt lidhur me shkaqet e mos-aplikimit të kësaj procedure. Kolegji çmon se pala e paditur ka aplikuar në mënyrë të gabuar procedurën që parashikon ligji për shpronësimet dhe VKM-ja nr.138, datë 23.03.2000. Procedura përjashtimore në të cilën referon i padituri, përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, i cili nuk mund të gjejë zbatim në mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi ekziston kuadri ligjor përkatës për përcaktimin e vlerës së shpronësimit për tokën truall në zonën ku ndodhet pasuria e paditësit, konkretisht VKM-ja nr.187, datë 06.03.2013 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë". Rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në përcaktimin e masës së shpronësimit për pasurinë objekt gjykimi i është referuar çmimit të referencës për pronën, e cila rezulton se ndodhet në zonën 7/4 të hartës së zonave të qytetit të Tiranë (tokë truall) dhe jo çmimit real të tregut të lirë të kohës së shpronësimit (në referencë të kësaj të fundit pasuria objekt gjykimi ka vlerën 42.000 Euro).

22. Nisur nga sa më sipër, konstatohet se gjykatat e faktit kanë përcaktuar drejt dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi masën e shpërblimit për pasurinë e shpronësuar të paditësit Sh.Gj..

23. Nga aktet bashkëlidhur dosjes gjyqësore rezulton e provuar se ndërhyrësi kryesor është në marrëdhënie të posaçme me paditësin. Rezulton se ndërhyrësi kryesor ka ndërtuar në tokën në pronësi të paditësit, një njësi shërbimi informale me sipërfaqe faktike 246.4 m², e cila ka qenë në proces legalizimi për sipërfaqen ndërtimore 164 m². Rezulton se kjo sipërfaqe nuk është përfshirë në procesin e vlerësimit dhe shpronësimit, si dhe në vijim, në vitin 2015 ky ndërtim informal është shembur. Ndërhyrësi kryesor ka pretenduar se duhet të përfshihet në shpronësim për njësinë e shërbimit.

24. Kolegji vlerëson se për të konkluduar mbi natyrën e këtij kërkimi duhet analizuar qasja e jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me aplikimin

e nenit 1, të Protokollit 1 të KEDNJ-së, në mënyrë që të përcaktohet, nëse e drejta e pretenduar prej ndërhyrësit kryesor për shpronësim, gëzon mbrojtën si "pasuri", në kuptim të Konventës.

25. Jurisprudenca e konsoliduar e GJEDNJ-së, kuptimin e "pasurisë" në përputhje me standardet koventore të sanksionuara në nenit 1, të Protokollit 1 të KEDNJ-së e ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar. Koncepti i pasurisë, sipas KEDNJ-së, shtrihet përtej të drejtës së pronësisë. Gjykata, përmes interpretimit të zgjeruar, ka vlerësuar nëse ekziston një situatë *de facto* që paraqet interes mbi pasurinë, rast pas rasti, e tillë që të gëzojë mbrojtje nga Konventa.

26. Përmes jurisprudencës së saj, GJEDNJ-ja ka pranuar se format e pronës që gëzojnë mbrojtje sipas nenit 1, Protokollit 1, të Konventës janë pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme, të drejtat *in rem* (*James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*) të drejtat *in personam* (*Smith Kline and French Laboratories ltd kundër Holandës*) pasuria intelektuale, të drejtat që lidhen me ushtrimin e profesionit si emri i mirë dhe klientela (*Van Marle kundër Holandës*), e drejta e përjashtimit nga taksat dhe tatimet nëse parashikohet nga e drejta e brendshme (*Van Raalte kundër Holandës*), e drejta për përfitime sociale në masën që parashikohet nga legjislacioni i brendshëm kombëtar (*Gaygusuz kundër Austrisë*), aksionet e një shoqërie tregtare (*Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*) si dhe shpresat legjitime dhe pretendimet potenciale për pronësi (*Oneryildi kundër Turqisë*).

27. "Pasuria", në kuptim të Konventës, përfaqëson një koncept autonom dhe të pavarur nga mënyrat formale dhe klasike të klasifikimit sipas të drejtës së brendshme dhe nuk kufizohet me të drejtën e pronësisë mbi të mirat materiale. Çështja që duhet ekzaminuar rast pas rasti është nëse në varësi të rrethanave konkrete, duke vlerësuar procedurat në tërësi, individi ka gëzuar një interes substancial në kuptim të Konventës. Gjykata ka theksuar se fakti që ligji kombëtar nuk e njeh interesin e pretenduar si një "të drejtë" ose "të drejtë pronësie", nuk do të thotë domosdoshmërisht së interesi në fjalë nuk konsiderohet "pasuri" në kuptim të Konventës (*Brosset Triboulet dhe të tjerë kundër Francës).* Në jurisprudencën e GJEDNJ-së është pranuar në disa raste se ndërtimet informale, në rrethana të caktuara, vlerësohen si "pasuri" në kuptim të Konventës.

28. Në çështjen *Saghanidze kundër Gjeorgjisë*, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se zotërimi i banesës, posedimi në mirëbesim i banesës dhe fakti që autoritetet kishin toleruar trajtimin e banesës së kërkuesit si të tij, për gati dhjetë vjet përbën një të drejtë të mbrojtur sipas nenit 1, të Protokolli 1 të Konventës. Në çështjen *Oneryildiz kundër Turqisë,* Gjykata ka vlerësuar se edhe pse trualli në të cilin ishte ndërtuar shtëpia nuk është pronë e kërkuesit dhe ai e

kishte ndërtuar pa leje, kërkuesi ishte *de facto* pronar i kësaj strukture.

29. Në kuptimin e "pasurisë", si një koncept autonom i mbrojtur nga Konventa, jurisprudenca e Gjykatës ka vlerësuar së ky koncept ndërlidhet më së shumti me dy kritere vlerësimi. *Së pari*, interesi ekonomik dhe *së dyti*, pritshmëria e ligjshme për përvetësim në të ardhmen.

30. Në mosmarrëveshjen objekt gjykimi, rezulton se ndërhyrësi kryesor ka ndërtuar një objekt informal në tokën në pronësi të paditësit (babait të tij). Rezulton se ndërhyrësi kryesor në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", ka aplikuar për legalizimin e këtij objekti pranë ALUIZNI-t sipas vetëdeklarimit nr.2480 prot., datë 13.11.2006. Rezulton se paditësi e ka poseduar këtë objekt prej gati dhjetë vitesh dhe se posedimi i tij ka qenë i qetë, pasi ai është lejuar nga organet shtetërore në ushtrimin e veprimtarisë tregtare për këtë objekt, duke e shfrytëzuar si njësi shërbimi të zotëruar prej tij. Rezulton se në vitin 2015, objekti është shembur dhe ndërhyrësi nuk ka përfituar asnjë lloj kompensimi financiar.

31. Sa u takon pretendimeve të ngritura në rekurs se objekti informal, sipas nenit 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", përjashtohet nga legalizimi. Kolegji vlerëson se ky pretendim është irrelevant për mosmarrëveshjen objekt gjykimi pasi përjashtimi i parashikuar në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 lidhet me procedurën e legalizimit dhe jo me procedurën e shpronësimit. Për më tepër, ndërhyrësi kryesor në kohën e shpronësimit nuk ishte përjashtuar nga procedura e legalizimit, si dhe nuk mund të parashikonte në kohën e aplikimit për legalizim (viti 2006), se me kalimin e dhjetë viteve, procedura e tij për legalizimin e objektit ende nuk do kishte përfunduar dhe se pasuria do shpronësohej në interes publik. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se ndërhyrësi kryesor ka pasur pa asnjë dyshim pritshmëri legjitime për fitimin e të drejtës së pronësisë dhe në këto kushte, të drejtat ekonomike që gëzonte nga pasuria objekt shpronësimi gëzojnë mbrojtje nga Neni 1, Protokolli 1 i KEDNJ-së.

32. VKM-ja nr.563, datë 03.08.2011 "Për një shtesë në VKM-në nr.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, në nenin 7/1 parashikon se "*Përjashtimisht për investime në akse rrugore kombëtare, shpronësohen edhe zotëruesit privatë të objekteve pasurive të paluajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë ... pas plotësimit të kushteve të mëposhtme: c) Zotëruesit e objektit janë në proces për t'u pajisur me leje legalizimi pasi: i) disponohet një akt i Këshillit të Ministrave, i botuar në Fletoren Zyrtare, në zbatim të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar, që identifikon objektin e tyre dhe këtë subjekt (person fizik/juridik) si zotërues të objektit pa leje apo shtesës në parcelën ndërtimore apo ii) subjekti zotërues ka ngritur objektin në tokë të tij/shtetit dhe nuk është skualifikuar nga procedura e legalizimit.".*

33. *Ndërhyrësi kryesor, H.Gj. ka nisur procesin administrativ për t'u pajisur me leje ndërtimi dhe ndërtimi është kryer mbi pronën e babait të tij dhe në kohën e shpronësimit, si dhe gjatë kohës së zhvillimit të gjykimit në gjykatat e faktit, ndërhyrësi kryesor nuk është skualifikuar nga procedurat e legalizimit. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se ndërhyrësi kryesor plotëson edhe kushtet ligjore të përcaktuara në VKM-në nr.563, datë 03.08.2011 për të përfituar dëmshpërblim për shkak shpronësimi, pavarësisht se objekti ende nuk kishte kaluar në pronësi të tij.*

34. Nisur nga analiza e mësipërme Kolegji vlerëson se ndërhyrësi kryesor, H.Gj. ndodhet para kushteve të shpronësimit de facto. Nisur nga rrethanat faktike të lartpërmendura, por edhe nga situata ligjore, në referim të VKM-së nr.138, datë 23.03.2000, Kolegji vlerëson se ndërhyrësi kryesor ka krijuar pritshmëri të ligjshme për përfitimin e të drejtës së pronësisë, sipas legjislacionit përkatës për ndërtesën objekt shqyrtimi gjyqësor. Në këto kushte vlerësohet se objekti informal i ndërtuar nga ndërhyrësi kryesor, gëzon mbrojtje sipas Nenit 1, të Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

35. Lidhur me vendimin nr.141, datë 20.03.2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se në kushtet ku rekursi ndaj vendimit nr. 740, datë 07.04. 2016 të Gjykatës Administrative të Apelit u gjykua nga ky Kolegj, masa e pezullimit çmohet se ka rënë *ipso iure* me dhënien e vendimit mbi themelin e mosmarrëveshjes.

36. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për këto arsye, rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" dhe çmohet se duhet vendosur mospranimi i tij.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-2135-2015, datë 16.03.2021

Në kontratën e punës me afat të pacaktuar afati i njoftimit për zgjidhje të kontratës përcaktohet nga ligji ndërsa në rastin e kontratës me afat të caktuar nga vullneti kontraktor. Prandaj ndërprerja e kontratës me afat, në mënyrë të parakohshme dhe të pajustifikuar, zgjidhja do trajtohet si zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës.

Zgjidhja e parakohshme e kontratës cenon pritshmëritë legjitime të punëmarrësit dhe për këtë arsye, kërkohet ekzistenca e një shkaku të justifikuar, përndryshe përgjegjësitë civile të punëdhënësit vazhdojnë deri në përfundimin e afatit kontraktor.

Pra, kur kontrata zgjidhet para afatit kontraktor, si dhe kur shkaku është abuziv, ka vend për aplikimin në mënyrë kumulative të dëmshpërblimit, sipas neneve 155/1 dhe 146/3, të Kodit të Punës.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi M.H. ka punuar pranë palës së paditur, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve dhe Mbrojtjes (në vijim, QKMBM), për periudhën 01.03.2011 deri në datë 28.02.2014, në pozicionin e përgjegjësit së sektorit dhe më pas si kryeredaktor në sektorin e periodikëve në Drejtorinë e Publikimeve.

2. Rezulton se palët kanë lidhur një kontratë njëvjeçare, nga data 01.04.2011 deri me datë 01.04.2012, si dhe në vijim një kontratë tjetër pune me afat të përcaktuar trevjeçar, nga data 01.04.2012 deri në datë 01.04.2015.

3. Pas propozimit të drejtorit të QKMBM-së për lirim nga detyra të paditësit, ministri i Mbrojtjes, me urdhrin nr.16, datë 09.01.2014 ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës me paditësin M.H., në datë 28.02.2014. Nisur nga përmbajtja e librezës së punës, lëshuar në emër të paditësit, evidentohet se M.H. ka punuar, nga data 01.03.2011 deri më 28.02.2014 pranë QKMBM-së.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1439, datë 04.04.2014 ka vendosur: "*1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; 2. Detyrimin e palës së paditur QKMBM për të dëmshpërblyer paditësin M.H. me pagën e 1 viti e 1 muaj e 15 ditëve punë; 2. Pushimin e gjykimit lidhur me kërkimin për pagimin e lejes vjetore të vitit 2013; 3. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj…*".

5. Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka arsyetuar: "*Sipas nenit 149/1 të Kodit të Punës, kontrata e punës me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake. Në rastin konkret, marrëdhënia e punës mes paditësit dhe të paditurit ka përfunduar në datë 28.02.2014, kur duhej të përfundonte në datë 01.04.2015 sipas parashikimeve të kontratës së punës, pra 1 vit e 1 muaj para afatit të caktuar në të. […] Lidhur me pretendimin e paditësit për dëmshpërblim me pagën e dy muajve punë për shkak se nuk ishte respektuar procedura e parashikuar nga neni 144 i Kodit të Punës, Gjykata vëren se i padituri ka respektuar këtë procedurë ligjore […]*

6. Ndaj vendimit nr.1439, datë 04.04.2014, ka ushtruar ankim pala paditëse M.H. e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plotë të padisë […] dhe […] pala e paditur duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e plotë të kërkesëpadisë.

8. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.546, datë 13.03.2015 ka vendosur: *"1. Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr.1439, datë 04.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; 2. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Mbrojtjes që të dëmshpërblejë paditësin M.H. me (një) vit e 1 (një) muaj pagë mujore deri në përfundim të kontratës së punës. 3. Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Mbrojtjes, të dëmshpërbleje paditësin M.H. për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës me 8 (tetë) paga mujore. 4. Lënien në fuqi për pjesën tjetër.[…]*

10. Kundër vendimit nr.546, datë 13.03.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs pala e paditur QKMBM […] dhe 11. […] pala paditur, Ministria e Mbrojtjes, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe vendimit të Gjykatës Administrative të Shkalës së Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë […]

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.425, datë 16.07.2015 ka vendosur: "*Pranimin e kërkesës nga Ministria e Mbrojtjes për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1439, datë 04.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.546, datë 13.03.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.*"

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

13. Paraprakisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe pala e paditur ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë (s*hih, vendimi nr.00–2020-50, datë 27.05.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Pra, nga ana e Kolegjit Administrativ është vlerësuar si e nevojshme analiza mbi ligjin e zbatueshëm, të cilit do të duhet t'i referohet për të zgjidhur mosmarrëveshjen administrative, në rastin në shqyrtim. [...]

15. Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga palët e paditura, QKMBM dhe Ministria e Mbrojtjes përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (në vijim, ligji nr. 49/2012), të cilat bëjnë të cenueshëm vendimin nr.546, datë 13.03.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit. [...]

16. Nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore, objektit dhe shkakut të padisë, pretendimeve e prapësimeve të palëve, vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe shkaqeve të rekursit, Kolegji çmon se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative Apelit dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është rrjedhojë e respektimit të gabuar të kërkesave të ligjit material, konkretisht neneve 155 dhe 149, të Kodit të Punës (në vijim, KP).

17. Rezulton e provuar se paditësi ka lidhur me punëdhënës, të padituri QKMBM, kontratën e punës nr.155/6 prot., datë 14.02.2012, me afat 3-vjeçar (nga data 01.04.2012 deri në datë 01.04.2015), për ushtrimin e detyrës së "Kryeredaktorit". Para lidhjes së kësaj kontrate, përmes urdhrit nr.400, datë 16.03.2011 të ministrit të Mbrojtjes, paditësi është emëruar në detyrën Përgjegjës/Kryeredaktor në Sektorin e Periodikëve, në Drejtorinë e Publikimeve në Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes.

18. Me anë të njoftimit nr.360, datë 10.12.2013 të QKMBM (punëdhënësi), paditësi është njoftuar për zhvillimin e bisedimeve, lidhur me vijimin e marrëdhënies së punës. Rezulton se është zhvilluar takimi rreth marrëdhënies së punës, për zgjidhje të kontratës, sipas nenit 144 të Kodit të Punës, në të cilin paditësi ka nënshkruar se nuk është dakord.

19. Me anë të shkresës nr.960/1 prot., datë 16.12.2013, paditësi është vënë në dijeni se punëdhënësi ka marrë vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës. Me shkresën nr.960/2, datë 16.12.2013, paditësi është njoftuar se marrëdhëniet e punës do të ndërpriten në datën 16.02.2014. Me shkresën nr.960/3, datë 16.12.2013, "Propozim për lirim nga detyra", rezulton se i padituri, QKMBM, ka propozuar lirimin nga detyra të paditësit. Me urdhrin nr.16, datë 09.01.2014 "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës", ministri i Mbrojtjes ka urdhëruar lirimin nga detyra të paditësit dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të tij, në datën 28.02.2014. Referuar librezës së punës së paditësit rezulton se data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës është data 28.02.2014.

20. Gjykatat e faktit, pasi kanë shqyrtuar mosmarrëveshjen objekt gjykimi, kanë vlerësuar se zgjidhja e kontratës së punës me afat, përpara përfundimit të afatit kontraktor, në kushtet kur nuk përligjet nga ekzistenca e një shkaku të justifikuar, ngarkon punëdhënësin me detyrimin e dëmshpërblimit me pagën që ai do të kish marrë deri në përfundim të afatit kontraktor (një vit e një muaj, sipas nenit 155/1 të KP-s), si dhe me dëmshpërblim, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës (neni 155/3 i KP-s), duke u ndarë në vendimmarrje vetëm për masën e dëmshpërblimit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vlerësuar se masa e dëmshpërblimit, sipas nenit 155/3 të KP-s të jetë pesëmbëdhjetë ditë, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar për tetë muaj.

21. Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave të faktit nuk është rrjedhojë e një interpretimi të drejtë të ligjit material, konkretisht nenit 155 dhe nenit 149 të KP-s. Gjykatat e faktit e kanë trajtuar mosmarrëveshjen, objekt gjykimi, si zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës me afat të caktuar dhe kanë aplikuar dhënien e pagesës, sipas nenit 155/1 të KP-s, deri në fund të afatit kontraktor, në mënyrë kumulative me dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës pa shkaqe të justifikuara, sipas nenit 155/3. Në vijim, Kolegji vlerëson të domosdoshme të ndalet në natyrën e kontratës së punës me afat të caktuar, si dhe pasojat që shoqërojnë zgjidhjen e menjëhershme të saj.

22. Pikësëpari, Kolegji vlerëson se kontrata e punës me afat të caktuar ka një regjim juridik të posaçëm (neni 149-152 i KP-s), të ndryshëm nga kontrata e punës me afat të pacaktuar dhe, për këtë arsye, nuk mund të rregullohet zgjidhja e menjëhershme e kontratës me afat, në të njëjtën mënyrë, ashtu si zgjidhja e kontratës pa afat.

23. Në kontratën me afat të pacaktuar, kuptimin e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës e jep ligji, konkretisht neni 143/3 i KP-s. Në këtë dispozitë parashikohet se, kur njëra nga palët zgjidh kontratën e punës me afat të pacaktuar, pa respektuar afatin e njoftimit, ndërprerja e marrëdhënies së punës trajtohet si zgjidhje me efekt të menjëhershëm. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.19, datë

15.11.2007 kanë vlerësuar se, *"Sipas nenit 141 të KP në kontratën e punës pa afat, ku nuk përcaktohet një afat për mbarimin e saj, normalisht që do të jetë ligji që do të parashikojë një mënyrë përfundimi, me qellim që të rregullohen pasojat e zgjidhjes për palët. Ligji ka lënë në dorë të palëve zgjidhjen, vetëm me kushtin e respektimit të afatit të njoftimit, pra palët të njoftohen në një periudhe të caktuar (paralajmërimi) përpara zgjidhjes përfundimtare të kontratës, me qëllim që të kenë mundësi të marrin masa për rregullimin e situatës së tyre personale. Gjatë afatit të njoftimit, kontrata e punës është në fuqi, me gjithë faktin që njëra palë ka bërë të ditur zgjidhjen e saj dhe ajo përfundon me përfundimin e afatit të njoftimit."*.

24. *Ndryshe nga kontrata e punës me afat të pacaktuar, ku afati i njoftimit për zgjidhje të kontratës përcaktohet nga ligji, në rastin e kontratës së punës me afat të caktuar është vullneti kontraktor ai që përcakton kohëzgjatjen e marrëdhënies juridike të punës*. Mbi këtë bazë, Kolegji çmon se nuk ka vend për aplikimin e afateve të njoftimit, sipas nenit 143 të KP-s, për të realizuar zgjidhjen paraprake të kontratës me afat të caktuar, për shkak se në këtë kontratë zgjidhja e parakohshme e saj nuk lejohet, me përjashtimin e rastit të zgjidhjes për shkaqe të justifikuara. Pra, në kontratën e punës me afat të caktuar, punëdhënësi është i detyruar të respektojë afatin kontraktor për zgjidhjen e kontratës dhe nuk mund të zbatojë afat njoftimi për zgjidhje paraprake, pasi një gjë e tillë ndalohet në mënyrë të shprehur në ligj, konkretisht në nenin 149/1 të KP-s.

25. Në rastin kur punëdhënësi e zgjidh kontratën e punës me afat të caktuar para përfundimit të afatit kontraktor, zgjidhja e kontratës së punës do konsiderohet me efekt të menjëhershëm, e cila sipas nenit 153 të KP-s mund të kryhet vetëm nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara. Kolegji çmon se ky është kuptimi i drejtë i nenit 149 të KP-s, në të cilin parashikohet shprehimisht se kontrata me afat të caktuar zgjidhet në përfundim të afatit kontraktor, *pa zgjidhje paraprake*. Për këtë arsye, vlerësohet se pretendimet e ngritura në rekurs nga palët e paditura sa i përket respektimit të afatit të njoftimit, sipas nenit 143 të KP-s, janë të pabazuara në ligj dhe me të drejtë, gjykatat e faktit e kanë kualifikuar zgjidhjen e kontratës si të menjëhershme.

26. Sa u takon pretendimeve të ngritura në rekurs se zgjidhja e kontratës është e justifikuar, Kolegji çmon se ekzistenca ose jo e shkaqeve të justifikuara është çështje e vlerësimit të provave, dhe, si e tillë, del jashtë fushës së juridiksionit rishikues që ushtron Gjykata e Lartë. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se ky pretendim mbetet në nivel faktit dhe nuk arrin të ngrihet në nivel ligjor.

27. Neni 149 i Kodit të Punës parashikon se kontrata me afat të caktuar zgjidhet në përfundim të afatit të kontratës, pa zgjidhje paraprake. Kjo do të

thotë se kontrata me afat të caktuar nuk mund të zgjidhet paraprakisht. Si garanci në favor të punëmarrësit, në rast zgjidhjeje të kontratës së punës para përfundimit të afatit kontraktor nga punëdhënësi, ligjvënësi ka parashikuar në nenin 155/1 të KP-s, lindjen e përgjegjësisë civile për punëdhënësin, në formën e pagimit të pagave, deri në përfundim të afatit kontraktor.

28. Kolegji çmon se që të lindë detyrimi i punëdhënësit për shlyerjen e pagave punëmarrësit, deri në përfundim të afatit kontraktor, për shkak të zgjidhjes së parakohshme të kontratës së punës me afat, sipas nenit 155 të KP-s duhet që zgjidhja e kontratës së punës të mos jetë kryer në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të justifikuara.

29. Sa i përket fushës së zbatimit të nenit 155/1 të KP-s, Kolegji çmon se kjo dispozitë zbatohet ndaj kontratave me afat të caktuar, si dhe ndaj kontratave me afat të pacaktuar, kur këto të fundit zgjidhen në mënyrë të menjëhershme të pajustifikuar (jo sipas nenit 153 të KP-s) dhe nuk është respektuar afati i njoftimit. Me qëllim zhdëmtimin e punëmarrësit, për shkak të ndërprerjes së menjëhershme dhe të paparashikuar të kontratës së punës, neni 155/1 i Kodit të Punës parashikon dëmshpërblimin në formën e pagës në rast se marrëdhënia e punës do të kishte përfunduar në fund të afatit të njoftimit ose në përfundim të kontratës me afat të caktuar.

30. Për sa më sipër arrihet në përfundimin se *kur ndërpritet kontrata e punës me afat, në mënyrë të parakohshme dhe të pajustifikuar, zgjidhja do trajtohet si zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës*. Për efekt të zgjidhjes së mosmarrëveshjes objekt gjykimi, Kolegji çmon të ndalet tek pasojat e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës me afat të caktuar.

31. Për të trajtuar pasojat e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës, me afat të caktuar, duhet të dallojmë disa situata faktike, të cilat sjellin aplikimin e rregullimeve të ndryshme juridike:

a) *Zgjidhja e menjëhershme e kontratës me afat, për shkaqe të justifikuara*

32. Kur zgjidhja e kontratës vlerësohet nga gjykatat e faktit si e justifikuar, për shkak të ekzistencës së kushteve të parashikuara nga neni 153 i KP-s, për punëdhënësin nuk lind përgjegjësia për shpërblimin me pagat deri në përfundim të afatit kontraktor, sipas nenit 155/1 të KP-s. Në këtë rast, zgjidhja e kontratës së punës është e ligjshme dhe shkarkon punëdhënësin nga detyrimi për shlyerjen e pagave, deri në përfundim të afatit kontraktor.

b) *Zgjidhja e menjëhershme e kontratës me afat, pa shkaqe të justifikuara*

33. Kur kontrata e punës me afat zgjidhet në mënyrë të menjëhershme dhe pa praninë e ndonjë shkaku të justifikuar nga punëdhënësi, ky

fundit do të duhet të përgjigjet ndaj punëmarrësit me pagën që do kishte përfituar ky i fundit, në rast se kontrata nuk do ishte zgjidhur me efekt të menjëhershëm. Kolegji vlerëson se *zgjidhja e parakohshme e kontratës së punës së punëmarrësit cenon pritshmëritë legjitime të tij, të cilat rrjedhin nga parashikimet kontraktore, sa i përket kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës. Cenimi i pritshmërive legjitime të punëmarrësit në kontratën me afat, pa ekzistencën e një shkaku të justifikuar, passjell lindjen e përgjegjësisë civile të punëdhënësit, deri në përfundimin e afatit kontraktor*.

34. Për Kolegjin shtrohej e nevojshme për t'i dhënë një zgjidhje rastit nëpërmjet interpretimit të çështjes, nëse, përveç dëmshpërblimit të parashikuar në nenin 155/1 të KP-s, a e përfiton punëmarrësi edhe dëmshpërblimin sipas nenit 155/3 të KP-s?

35. Neni 155/1 i Kodit të Punës parashikon: "*Punëmarrësi ka të drejtën e pagës që do kishte fituar, nëse marrëdhëniet e punës do kishin përfunduar në fund të afatit të njoftimit të parashikuar në ligj ose me kontratë ose në përfundim të kontratës me afat të caktuar*.". Në kuptim të kësaj dispozite, punëmarrësi, në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës me afat, gëzon të drejtën e shpërblimit vetëm për pagat që do kishte përfituar, nëse kontrata do kishte përfunduar në mënyrë natyrale, në përfundim të afatit kontraktor.

36. Neni 155/3 i KP-s parashikon: *"Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustifikuar të kontratës së punës nga punëdhënësi gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos detyrimin e punëdhënësit ndaj punëmarrësit me një dëmshpërblim jo më shumë se paga e një viti pune."* Kolegji çmon se nisur nga natyra juridike e kontratës së punës me afat dhe pritshmërive të palëve kontraktore në të, në rastin e zgjidhjes së saj, përpara përfundimit të afatit kontraktor, pa shkak të justifikuar, nuk mund të zbatohen në mënyrë kumulative dëmshpërblimet e parashikuara të nenit 155/1 dhe të nenit 155/3 të KP-s.

37. Kolegji vlerëson se qëllimi i ligjvënësit, i cili është reflektuar edhe përmes ndryshimeve që ka pësuar në vijim legjislacioni i punës [...] Garancitë e punëmarrësit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës me afat ezaurohen me parashikimin ligjor të së drejtës për përfitimin e dëmshpërblimit të barabartë me pagat që ai do të merrte deri në fund të afatit kontraktor. Punëmarrësi, në një kontratë me afat të caktuar, e ka ditur dhe pasur në vëmendje që në kohën e lidhjes së kontratës së punës se ajo do i ezaurojë pasojat juridike në mënyrë natyrale në përfundim të afatit kontraktor, të pranuar nga vetë palët. Garancia e punëmarrësit në këtë marrëdhënie kontraktore përmbushet nga neni 149 i KP-s, që ndalon zgjidhjen e parakohshme të kontratës me afat prej punëdhënësit dhe, për këtë

arsye, neni 155/1, sa u takon efekteve financiare të marrëdhënies së punës, rivendos punëdhënësin në gjendjen e mëparshme, përmes dëmshpërblimit në formën e pagave deri në përfundim të afatit kontraktor. Ndërsa neni 155/3, garanton dëmshpërblimin financiar të punëmarrësit për shkak të zgjidhjes së menjëhershme, të pajustifikuar të kontratës së punës pa afat, i cili u shtohet pagave që punëmarrësi përfiton gjatë afateve të njoftimit. Për këto arsye, Kolegji konkludon se neni 155/1 dhe 155/3 nuk mund të gjejnë aplikim kumulativ, në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës me afat të caktuar dhe se neni 155/3 i KP-s duhet të gjejë zbatim vetëm në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës, me afat të pacaktuar.

38. Kolegji e vlerëson të nevojshme të mbahet në vëmendje se një interpretim i tillë nuk përfshin rastin kur zgjidhja e kontratës me afat të caktuar pretendohet të jetë zgjidhur, përpara përfundimit të afatit kontraktor, për një motiv abuziv. Në një rast të tillë, ndryshe nga rasti kur kontrata e punës zgjidhet në mënyrë të pajustifikuar, punëdhënësi ngarkohet me disa dëmshpërblime kumulative në favor të punëmarrësit. Pra, *kur kontrata zgjidhet para afatit kontraktor, si dhe kur shkaku është abuziv* (sepse punëdhënësi shfaqet në ekstremitetin e shkeljeve të parashikimeve të KP-s dhe parimeve të mirëbesimit që karakterizojnë marrëdhënien e punës), *ka vend për aplikimin në mënyrë kumulative të dëmshpërblimit, sipas nenit 155/1 dhe 146/3*.

39. Nisur nga analiza dhe interpretimi i mësipërm i dispozitave ligjore, referuar rastit në shqyrtim, Kolegji konkludon se vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka vlerësuar dhënien e dëmshpërblimeve kumulative (sipas nenit 155/1 dhe 155/3 të KP-s), me pagimin e pagave deri në përfundim të afatit kontraktor, për 1 vit e 1 muaj, si edhe dhënia e dëmshpërblimit për 8 muaj shtesë, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës, është e papajtueshme me nenin 155 dhe 149 të KP-s.

40. Kolegji çmon se rekursi i palës së paditur është i bazuar në ligj edhe për sa i përket çështjes së legjitimimit pasiv substancial të palës së paditur, Ministrisë së Mbrojtjes. Rezulton se kontrata e punës dhe raportet financiare paditësi i ka me palën e paditur QKMBM dhe jo me Ministrinë e Mbrojtjes. Për këtë arsye, është QKMBM-ja pala që legjitimohet pasivisht në këtë gjykim, ndryshe nga sa ka çmuar Gjykata Administrative e Apelit në vendimin nr. 546, datë 13.03.2015.

41. Duke marrë në konsideratë se ky Kolegj e gjykoi çështjen mbi bazën e rekursit të të paditurve, pjesa e rrëzuar e padisë, sipas vendimeve të gjykatave, nuk përfshihet në kufijtë e këtij shqyrtimi. Për rrjedhojë, përderisa padia është rrëzuar nga gjykatat e faktit, sikurse edhe për kërkimin, gjykimi i të cilit

është pushuar, mbetet disponimi, siç është vendosur. Sa u përket shkaqeve të ngritura në rekurset respektive, Kolegji vlerëson se, siç u arsyetua më sipër në këtë vendim, është vendi për të aplikuar ndryshimin e vendimeve të të dy gjykatave, sipas nenit 63, shkronja "dh", të ligjit nr.49/2012, para ndryshimeve me ligjin nr.39/2017.

42. Lidhur me masën e pezullimit të vendosur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.425, datë 16.07.2015, ky Kolegj konkludon se, në kushtet e shqyrtimit të rekursit ndaj vendimit nr.546, datë 13.03.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të zgjidhjes përfundimtare të çështjes, çmohet se kjo masë ka rënë *ipso iure*.

43. Për sa u parashtrua më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi nr.546, datë 13.03.2015 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ashtu si edhe pika e dytë e vendimit nr.1439, datë 04.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material, sa u përket dëmshpërblimeve të dhëna ndaj paditësit dhe, për rrjedhojë, duhet të ndryshohen.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021- 418, datë 25.03.2021

Dënimi plotësues i pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit ka karakter sa parandalues, ashtu edhe, siç përmban në vetvete, karakter ndëshkues dhe shkurajues. Fakti se ky lloj dënimi nuk përfshihet si dënim kryesor, nuk do të thotë se zbutet natyra e tij dhe as se përfshihet te çështjet administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, për të cilën mund të kufizohet e drejta për ankim.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit, si dhe referuar fakteve të pranuara në të dyja shkallët e gjykimit, ka rezultuar se nga ana e efektivëve të Komisariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë është mbajtur procesverbali i konstatimit të shkeljes nr.0933728, datë 01.02.2014, në të cilën është përshkruar: *"Drejtuesi i mjetit tip Renault me targa TR3321R, D.A., rezultoi të kishte përdorur alkool në masën 03-04 %."*. Me vendimin nr.1040, datë 07.02.2014 të organit administrativ, pas shqyrtimit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë është vendosur gjobitja e paditësit në shumën 6.000 *(gjashtë mijë)* lekë, si dhe pezullimi i lejes së drejtimit për një afat prej 6 *(gjashtë)* muaj, me argumentin se veprimet e paditësit bien ndesh me nenin 184/3 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, paditësi ka paraqitur padinë objekt gjykimi në gjykatë me argumentin se sasia e alkoolit të konstatuar është jo e mjaftueshme për të marrë ndaj tij masën e pezullimit të lejes së drejtimit.

2.Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1281, datë 28.03.2014 ka vendosur: *"Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit D.A.. Shfuqizimin pjesërisht të vendimit nr.1040, datë 07.02.2014 të palës së paditur Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, për pjesën ku është pezulluar leja e drejtimit nr. 006569/I110085051C, duke lënë në fuqi pjesën tjetër. […] pasi* ka rezultuar e provuar se raporti i shërbimit […] Pala e paditur nuk ka mundur të provojë në gjykim se si sasia prej 0.3-0.4 % ka ndikuar në gjendjen e drejtuesit të mjetit, ndërsa ligji kërkon që përqindja e alkoolit të jetë mbi masën 0.5%. Për pasojë, akti administrativ që kundërshtohet është i anulueshëm, pasi është relativisht i pavlefshëm.

Kundër vendimit nr.1281, datë 28.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ka paraqitur ankim pala e paditur Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë për këto shkaqe: Vendimi për ndëshkimin e paditësit është marrë në përputhje me nenet 184/1/2 dhe 201, të Kodit Rrugor; të gjitha provat e paraqitura nga ana jonë në gjykim janë të plota dhe të pakontestueshme.

5. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.423, datë 04.03.2015 ka vendosur: *"Mospranimin e ankimit të paraqitur ndaj vendimit nr.1281, datë 28.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë."*.

6. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë arsyeton se, ankimi i palës së paditur nuk është paraqitur konform kërkesave të neneve 44, 45 dhe 46, të ligjit nr. 49/2012. Më konkretisht, në referim të nenit 45 të këtij ligji nuk lejohet ankim ndaj vendimeve që kanë zgjidhur mosmarrëveshje administrative, në lidhje me akte administrative që përmbajnë vlera më të ulëta se 20-fishi i pagës, dënimi kryesor që është caktuar për paditësin është ndëshkimi me gjobë, ndërsa pezullimi lejes së drejtimit është dënim plotësues, i cili nuk qëndron i pavarur. Në kushtet kur dënimi i dhënë është nën vlerën që përcakton ligji për minimumin ligjor që lejon të drejtën e ankimit, duhet të vendoset mospranimi i tij.

7. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka paraqitur rekurs pala e paditur Drejtoria e Policisë Qarku Tiranë.

8. Pala e paditur ka paraqitur rekursin [ku] paditësi kundërshton vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

9. Rekursi i të paditurit i është njoftuar paditësit, i cili nuk ka paraqitur kundër-rekurs. Me vendimin datë 25.03.2015 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur të pranojë rekursin e palës së paditur. [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

11. Paraprakisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe pala e paditur ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë (*shih, vendimi nr.00-2020-50, datë 27.05.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Pra, nga ana e Kolegjit Administrativ është vlerësuar si e nevojshme analiza mbi ligjin e

zbatueshëm, të cilit do të duhet t'i referohet për të zgjidhur mosmarrëveshjen administrative, në rastin në shqyrtim. [...]

14. Kolegji vlerëson se në rekursin e palës së paditur janë ngritur shkaqe ligjore që bazohen në nenin 58 të ligjit nr.49/2012, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin nr.423, datë 04.03.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Kjo dispozitë, para datës 05.05.2017, parashikonte ndër të tjera se, *"Vendimet e shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit dhe gjykata administrative e shkallës së parë mund të ankimohen me rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm kur: a) ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose zbatuar keq apo vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit; c) ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit."*.

15. Kolegji vlerëson të evidentojë kuadrin ligjor të zbatueshëm për çështjen objekt gjykimi. Në nenin 45 të ligjit nr.49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative* "parashikohet, ndërmjet të tjerave, se "*Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt: a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;..."*. Në nenin 184 të Kodit Rrugor, sipas ndryshimeve me ligjin nr.10488, datë 05.12.2011, parashikohej se: *"1. Është i ndaluar drejtimi i mjeteve në gjendje të dehur, si pasojë e përdorimit të pijeve alkoolike. 2. Është i ndaluar drejtimi i mjeteve pas përdorimit të pijeve alkoolike dhe nën ndikimin e alkoolit. 3. Cilido që drejton një mjet nën ndikimin e alkoolit, ndëshkohet me gjobë nga pesëmijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë. Pas verifikimit të shkeljes zbatohet masa administrative e pezullimit të leje drejtimit nga gjashtë muaj deri në një vit dhe nga një vit deri në dy vjet, kur subjekti e përsërit shkeljen brenda një viti...."*.

16. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor përbën një të drejtë procedurale, përmes së cilës mbrohet një e drejtë substanciale dhe bazohet në rregullin se "*... nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit* ..." ose "*... nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë."*. Si e tillë, e drejta e ankimit përbën një nga të drejtat themelore të njeriut dhe parashikohet edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Protokollet e saj shtesë. Referuar dispozitave konventore dhe nenit 43 të Kushtetutës është e qartë se "*të drejtën e ankimit*" për në instancat më të larta gjyqësore e gëzon çdo individ që është gjykuar nga gjykatat. Kjo garanci është konsideruar nga

jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese si një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim KEDNJ-ja. Megjithatë, sipas paragrafit të dytë të nenit 2, të Protokollit 7, të Konventës, shtetet kanë liri mjaft të gjerë vlerësimi dhe veprimi për të përjashtuar nga e drejta e ankimit vepra të lehta penale, rastet kur personi është gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, etj.,. Mbi këtë rregullim konventor, neni 43 i Kushtetutës ka pranuar kufizimin e kësaj të drejte, si për kundërvajtjet e lehta penale, ashtu edhe për çështjet civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të saj.

17. Duke iu rikthyer mosmarrëveshjes objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se, në këtë rast, merr rëndësi analiza mbi natyrën që ka dënimit administrativ, pezullimi i lejes së drejtimit të automjetit, që parashikon neni 184 i Kodit Rrugor. Pra, është e domosdoshme të përcaktohet nëse sanksioni i pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit, si një dënim plotësues ka të njëjtën natyrë dhe efekt si edhe gjoba dhe nëse konsiderohet apo jo dënim i rëndë, në kuptim edhe të standardit që ka pranuar jurisprudenca e GJEDNJ-së, sipas nenit 6, pika 1, e KEDNJ-së.

18. Kolegji thekson se në praktikën e GJEDNJ-së është argumentuar se "edhe nëse çështja nuk është për nga natyra e vet penale, mund të duket e tillë, në kuptimin e Konventës, pas marrjes në konsideratë të shkallës së saj të ashpërsisë" (*shih, Eggs kundër Zvicrës, si dhe Engel dhe të tjerë kundër Holandës"*). Sipas gjykatës "dënimi nuk ka për qëllim të kompensojë dëmin, por në thelb ai synon të shkurajojë rikryerjen e veprës. Dënimi, si rregull i përgjithshëm, ka qëllim të dyfishtë, shkurajues dhe ndëshkues" (*shih Bendenoun kundër Francës, parag. 47*). Sanksioni ka karakter penal, "në qoftë se e drejta që përbën bazën e tij gjen zbatim ndaj të gjithëve dhe jo vetëm ndaj një grupi të caktuar, me status special" *(shih, Weber kundër Zvicrës, A, 177, parag. 33)*. Edhe për sa i takon masës së dënimit dhe rëndesës së saj, Kolegji mban në vëmendje këtë jurisprudencë, e cila ka konkluduar se "është e padiskutueshme që e drejta për të drejtuar një mjet motorik është shumë e dobishme në jetën e përditshme për të ushtruar një detyrë apo profesion" (*shih, vendimi i GJEDNJ-së, Malige kundër Francës, i datës 23 shtator 1998*). Në këtë çështje, Gjykata tërhoqi vëmendjen se ulja e pikëve për shkelje të normave të trafikut rrugor megjithëse "ka karakter parandalues, ajo gjithashtu përmban në vetvete edhe karakterin ndëshkues dhe shkurajues dhe, për këtë arsye, barazohet me një dënim plotësues. Fakti që ligjvënësi ka pasur si qëllim të shkëpusë sanksionin e uljes së pikëve nga sanksionet e tjera të karakterit penal nuk do të thotë se natyra e masës është e ndryshme. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se neni 6, pika 1 gjen zbatim në këtë rast" dhe se kjo masë përbënte dënim, në kuptim të kësaj dispozite.

19. Mbi këtë analizë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, Kolegji vlerëson se edhe *dënimi plotësues i pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit ka karakter sa parandalues, ashtu siç përmban në vetvete edhe karakterin ndëshkues dhe shkurajues. Fakti se ky lloj dënimi nuk përfshihet si dënim kryesor, nuk do të thotë se zbutet natyra e tij dhe as se përfshihet te çështjet administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, për të cilën mund të kufizohet e drejta për ankim.*

20. Në një interpretim literal, Kolegji çmon se neni 184 i Kodit Rrugor i referohet ndëshkimit administrativ të subjektit përmes dy lloje dënimesh, në lidhje me të njëjtin fakt. Sipas kësaj dispozite, referuar legjislacionit edhe gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes objekt shqyrtimi, parashikohej se, "*2. Cilido që drejton mjetin pas përdorimit të pijeve alkoolike, në rastet kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga dymijë e pesëqind deri në dhjetëmijë lekë. Pas verifikimit të shkeljes zbatohet masa administrative plotësuese me pezullim të leje drejtimit për 6 muaj deri në 12 muaj, ose 1 deri në 2 vjet, kur subjekti e përsërit shkeljen brenda një viti. ...*". Nga ana tjetër, ligji nr.49/2012 kufizon të drejtën e ankimit për kundërshtimin e dënimit mbi kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi. Kolegji vlerëson se në zbatimin e drejtë të këtij kufizimi ligjor, në funksion të garantimit të të drejtave themelore kushtetuese, gjykata duhet të vlerësojë në çdo rast rëndësinë dhe pasojën konkrete të çdo dënimi administrativ. Fakti që masa e dënimit administrativ me gjobë nuk e tejkalon kufizimin minimal të përcaktuar në nenin 45 të ligjit të sipërcituar, nuk prezumon apriori shtrirjen e këtij kufizimi edhe për të drejtën e ankimit ndaj dënimit të pezullimit të lejes së drejtimit. Të dyja këto dënime duhet të vlerësohen dhe të konsiderohen se qëndrojnë të pavarur nga njeri-tjetri, pikërisht për shkak të natyrës së ndryshme që kanë, por edhe të pasojave që sjellin, të cilat nuk janë të njëllojta. Për subjektin e ndëshkuar, masa administrative e pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit mund të vlerësohet më e rëndë sesa ajo e dënimit me gjobë. Në këtë aspekt, nisur nga shkalla e ashpërsisë që mund të paraqesë ky lloj dënimi, për çdo rast konkret, nuk mund t'i ndalohet subjektit e drejta themelore e ankimit gjyqësor. Gjithashtu, Kolegji çmon se, për të përcaktuar natyrën e vërtetë të masës së pezullimit të lejes së drejtimit është e nevojshme të vlerësohet pika 3 e nenit 184 të Kodit Rrugor, me nenin 30, paragrafi i parë, 3 të Kodit Penal, ku sanksionohet si dënim plotësues, i titulluar "*... 3. Ndalimi për të drejtuar automjete. ...*". Edhe nga ky këndvështrim, masa administrative ka elementë të plotë dhe ekuivalentë me dënimin penal plotësues, për të cilin ligji penal ofron garancitë procedurale të ankimit gjyqësor, arsye për të cilën të njëjtat garanci duhet të sigurohen edhe në raport me ndëshkimin administrativ.

21. Për sa u parashtrua më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit, për zgjidhjen e drejtë të çështjes, duhet të pranojë për shqyrtim ankimin e paraqitur nga pala e paditur, si dhe të drejtojë hetimin gjyqësor në funksion të shterimit dhe arsyetimit të të gjitha pretendimeve të ngritura nga palët. Për rrjedhojë, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në këtë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-01179-2015, datë 06.04.2021

Shkaqet e rënda për të cilat mund të vendoset përjashtimi i një punonjësi nga Policia e Shtetit nuk mund të tejkalohen përmes një urdhri të dytë për ripranim në detyrë, për sa kohë nuk provohet se ekziston një akt i qartë nga organi publik për revokimin/shfuqizimin e aktit administrativ të përjashtimit nga detyra ose një vendim gjyqësor që të ketë verifikuar në themel ligjshmërinë e aktit të përjashtimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi G.N., me urdhrin nr.1200, datë 06.07.1993 të ministrit të Rendit Publik rezulton të jetë titulluar oficer, duke u emëruar Kryetar i Degës së Rendit Publik Gramsh, me gradën "Major". Paditësi ka qenë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, duke ushtruar detyra të ndryshme deri në momentin e lëshimit të urdhrit nr.1657/2, datë 08.10.1998 të ministrit të Brendshëm për lirimin e tij nga kjo strukturë, me motivacionin: "*Për shkelje të ligjit nr.7492, datë 08.06.1991 "Për departizimin dhe depolitizimin e disa organeve shtetërore*".

2. Me urdhrin nr.31, datë 04.01.2007 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësi është ripranuar në këtë strukturë. Paditësi ka kryer detyra të ndryshme, deri në momentin e lëshimit të urdhrit nr.3087/1, datë 07.12.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, që konsiston në lirimin nga detyra të N/Komisar G.N., me detyrë Specialist në Sektorin për Aktet Terroriste dhe Krimet e Renda në Departamentin për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. Lirimi nga detyra ka si motivacion: "Është ripranuar në kundërshtim me kriteret ligjore" (neni 20, pika 2 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", neni 57, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", neni 46 i Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr.804, datë 21.07.2007 të Këshillit të Ministrave), pasi është ripranuar në strukturat e Policisë së Shtetit me urdhrin nr.31/1, datë 04.01.2007, nga kategoria e të përjashtuarve me motivacionin "Shkelje e ligjit nr.7492, datë 08.06.1991 "Për depolitizimin dhe departizimin e disa organeve shtetërore". Nëpërmjet këtij akti, paditësit

i është bërë me dije ndërprerja e marrëdhënieve financiare me institucionin, më datë 09.12.2013. Duke mos qenë dakord me sa më sipër, paditësi i është drejtuar gjykatës.

4. Rezulton se në datë 11.04.2017 nga Drejtoria e Policisë Vendore Berat është lëshuar një vërtetim, përmes të cilit vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune me palën e paditur në pozicionin e Shefit Sektorit dhe Specialistit për Asetet Kriminale në Drejtorinë e Policisë Vendore Berat.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.586, datë 18.02.2014, ka vendosur: " *1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. 2. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Tiranë, t'i paguajë paditësit G.N., si dëmshpërblim, pagën e 4 (katër) muajve, për shkak të lirimit të paligjshëm nga Policia e Shtetit [...]*

7. Kundër vendimit nr.586, datë 18.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim paditësi G.N., i cili ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e padisë, duke parashtruar [ndër të tjera se] *Gjykata nuk është shprehur për të gjitha kërkimet e paditësit [... dhe] për dëmshpërblimin sipas Kodit të Punës*.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.3360, datë 11.09.2014, ka vendosur: *"1. Ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; 2. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; 3. Shfuqizimin e urdhrit nr.3087/1 datë 07.12.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm; 4. Detyrimin e palës së paditur të rikthejë paditësin G.N. në detyrën që mbante në momentin e lëshimit të urdhrit nr.3087/1, datë 07.12.2013 të Drejtorit të Policisë së Shtetit; 5. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë pagën paditësit, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në ekzekutimin e këtij vendimi; [...]*

10. Në marrjen e këtij vendimi, kjo gjykatë ka arsyetuar se, "*Lirimi nga detyra i paditësit është bërë pa shkak të justifikuar për sa kohë që nuk reflekton asnjë ndër rastet e parashikuara në nenin 57 "Lirimi dhe përjashtimi nga policia", të ligjit nr.9749/2007 "Për Policinë e Shtetit"[...], Gjykata çmon se largimi i paditësit nga strukturat e policisë së shtetit ka qenë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor [...]*

11. Kundër vendimit nr.3360, datë 11.09.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila parashtron [ndër të tjera se] *Gjykata Administrative e Apelit ka keqinterpretuar ligjin pasi ligji i posaçëm i Policisë së Shtetit parashikon se një punonjës policie largohet nga policia e shtetit në rast se dënohet me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë ose përjashtohet nga Policia e Shtetit. [...] personat e përjashtuar nga Policisë së Shtetit nuk kanë të drejtë të ripranohen në detyrë. [...]*

12. Me vendimin e datës 18.12.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: "*Pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3360, datë 11.09.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit*".

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

13. Paraprakisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe pala e paditur ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë (s*hih, vendimi nr.00–2020-50, datë 27.05.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Pra, nga ana e Kolegjit Administrativ është vlerësuar si e nevojshme analiza mbi ligjin e zbatueshëm, të cilit do të duhet t'i referohet për të zgjidhur mosmarrëveshjen administrative, në rastin në shqyrtim.

14. Konstatohet se rekursi është paraqitur brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, të parashikuar në nenin 443/2 të KPC-s. Gjithashtu rekursi i është komunikuar palës së paditur, e cila nuk ka paraqitur kundër-rekurs. [...]

17. Ligji nr.9749/2007, në nenin 11/2 parashikon se, "*Përjashtim nga Policia do të thotë një situatë, në të cilën marrëdhëniet juridike dhe administrative të punonjësit të Policisë me institucionin e Policisë së Shtetit ndërpriten pa asnjë mundësi rikthimi në Polici.*". Në nenin 57/3 të ligjit nr.9749/2007 parashikohet: *"Një punonjës i Policisë largohet nga Policia nëse dënohet me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga Policia."*. Ligji nr.7879, datë 26.07.1995 "Për forcat e armatosura në Republikën e Shqipërisë", në nenin 32 parashikon: "*.. Oficerët aktivë dalin në lirim në këto raste: a) Kur shkelin ligjet ose thyejnë rëndë e në mënyrë të përsëritur disiplinën ushtarake..".* Ligji nr.7504 datë 30.07.1991 "Për Policinë e Rendit", në nenin 43 parashikon: "*Oficerët, nënoficerët dhe policët e policisë së rendit lirohen nga detyra në rastet kur dënohen për vepra penale, kur kryejnë shkelje të rënda në detyrë dhe kur kanë mangësi të vazhdueshme në kryerjen e detyrës. Punonjësve të Policisë që lirohen nga detyra u hiqet dokumenti i identitetit si ushtarakë, arma si dhe nuk u lejohet të mbajnë uniformë.".*

18. Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.9749/2007 është miratuar VKM-ja nr.804, datë 21.11.2007 "Rregullorja e personelit të Policisë së Shtetit", në nenin 46 të tij, të titulluar "Personat e përjashtuar", parashikohet: "*Personat e përjashtuar nga policia nuk kanë të drejtë ripranimi në strukturat e policisë".*

19. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se vullneti i ligjvënësit është i qartë, për sa i përket (mos)rikthimit në Policinë e Shtetit të punonjësve të përjashtuar, si nga parashikimet e ligjit nr.9749/2007, legjislacioni në tërësi që gjejnë zbatim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, ashtu edhe nga legjislacioni dytësor që ka dalë në zbatim të tij. Legjislacioni që rregullon marrëdhënien juridike të punës së punonjësve të Policisë së Shtetit, pranon se një punonjës i Policisë së Shtetit, i përjashtuar nga detyra, nuk mund të rikthehet në Policinë e Shtetit, përveçse kur akti i përjashtimit është revokuar ose shfuqizuar nga vetë organi publik ose kur është shfuqizuar ose deklaruar absolutisht i pavlefshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se vendimet e gjykatave të faktit kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin material të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

20. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se paditësi, me urdhrin nr.1200, datë 06.07.1993 të ministrit të Rendit Publik është titulluar 'oficer'. Në vijim, marrëdhënia e punës me palën e paditur ka zgjatur deri në vitin 1998, ku përmes urdhrit nr.1657/2, datë 08.10.1998, paditësi është nxjerrë në lirim para kohe, në referim të ligjit nr.7879/1995 dhe ligjit nr.7504/1991, me motivacionin "*Për shkelje të ligjit nr. 7492, datë 08.06.1991 "Për departizimin dhe depolitizimin e disa organeve shtetërore."*. Në vijim, përmes urdhrit nr. 31, datë 04.01.2007 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësi është ripranuar në këtë strukturë. Në vitin 2013, me urdhrin nr.1/3087, datë 07.12.2013, paditësi është liruar nga detyra me motivacionin se është ripranuar pranë Policisë së Shtetit nga kategoria e të përjashtuarve.

21. Kolegji vlerëson se shqyrtimi i objektit të padisë që lidhet me ligjshmërinë e aktit të lirimit, përkatësisht urdhrit nr.3087/1, datë 07.12.2013, është pazgjidhshmërisht i lidhur me urdhrin nr.1657/2 në vitin 1998, të përjashtimit të paditësit nga Policia e Shtetit, pasi shkaku i lirimit të paditësit me urdhrin e vitit 2013 është fakti se është ripranuar pranë Policisë së Shtetit në vitin 2007, në kundërshtim me ligjin, për sa kohë ndaj tij në vitin 1998 është marrë masa disiplinore e përjashtimit nga detyra.

22. Nisur nga rregullimet e nenit 32 të ligjit nr.7879/1995 dhe nenit 43 të ligjit nr.7504/1991, si dhe nga përmbajtja, por edhe nga vlerësimi që i bëhet urdhrit nr.1675/2, datë 08.10.1998, si nga palët ndërgjyqëse, ashtu dhe nga gjykatat e faktit, konstatohet se ndonëse ky urdhër shprehet për "nxjerrjen në lirim para kohe të një oficeri", në fakt ai është një urdhër përjashtimi nga strukturat e Policisë së Shtetit për paditësin, me motivacionin e shkeljes së ligjit nr.7492 datë 08.06.1991 "Për departizimin dhe depolitizimin e disa organeve shtetërore".

23. Në bazë të nenit 11/2 të ligjit nr.9749/2007 një punonjës i përjashtuar nga radhët e Policisë së Shtetit nuk mund të rikthehet në detyrë. Nisur nga natyra e rëndë e shkeljeve, për të cilat merret masa disiplinore e përjashtimit nga Policia e Shtetit, ligjvënësi ka parashikuar pamundësinë e ripranimit në strukturat e Policisë së Shtetit. Çmohet se kjo dispozitë me natyrë urdhëruese mbart në vetvete një detyrim për organin publik, sa i përket pamundësisë së rikthimit në detyrë të kësaj kategorie punonjësish. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se ka qenë e domosdoshme të vlerësohej nga gjykatat e faktit nëse urdhri i përjashtimit nga policia është shfuqizuar/konstatuar absolutisht i pavlefshëm me një vendim gjyqësor të formës së prerë ose vetë organi administrativ ka konstatuar kryesisht pavlefshmërinë absolute të aktit të përjashtimit ose paligjshmërinë e tij konform parashikimeve të KPA-s.

24. Kolegji vlerëson se pala e paditur, *propio motu*, në ushtrim të kompetencave të dhëna me ligj, konkretisht nenit 117 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "KPA", ka pasur të drejtën dhe detyrimin të shqyrtojë ligjshmërinë e marrëdhënies së punësimit të punonjësve të punësuar pranë saj. Në rast se organi publik do kishte konstatuar se akti i përjashtimit nga Policia e Shtetit i vitit 1998 është i paligjshëm do të duhet të kishte shfuqizuar ose revokuar aktin e përjashtimit, duke ligjëruar aktin e ripranimit në detyrë. Kolegji vlerëson se, pavarësisht bazës ligjore të përdorur nga organi publik për nxjerrjen e aktit, në thelb, organi ka ushtruar detyra funksionale dhe ligjore të tij. Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, nuk gjendemi para rasteve të kapërcimit të kushteve për punësim nga ana e organit publik, sa kohë i padituri ka qenë në kushtet e pamundësisë së rikthimit në detyrë.

25. Kolegji vlerëson se nën dritën e këtij interpretimi ligjor, gjykatat e faktit nuk kanë kryer një hetim të plotë, pasi konstatohet se mungon hetimi gjyqësor në drejtim të fuqisë juridike të këtij akti. Ligji nr.9749/2007 ka sanksionuar një ndalim të natyrës absolute për ripranimin në detyrë të punonjësve të përjashtuar. *Shkaqet e rënda për të cilat mund të vendoset përjashtimi i një punonjësi nga Policia e Shtetit nuk mund të tejkalohen përmes një urdhri të dytë për ripranim në detyrë, për sa kohë nuk provohet se ekziston një akt i qartë, vullnet nga ana e organit publik për revokimin/shfuqizimin e aktit administrativ të përjashtimit nga detyra ose një vendim gjyqësor që të ketë verifikuar në themel ligjshmërinë e aktit të përjashtimit*. Nisur nga aktet, bashkëlidhur dosjes gjyqësore, rezulton se gjatë gjykimit në gjykatat e faktit shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrit të përjashtimit nuk ka qenë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe se nga aktet nuk rezulton e provuar nëse ky akt administrativ është në fuqi apo jo.

26. Në respektim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, çmohet të sillet në vëmendje jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese, e cila ndër të tjera ka theksuar se Gjykata e Lartë në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj *(shih, vendimi nr.40, datë 25.06.2015 i Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji, Gjykata e Lartë mund të vendosë mbi themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet mbi bazën e të njëjtave fakte e të njëjtave prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe përbëjnë bazën e vendimit mbi të cilin është bërë një interpretim gabim i ligjit *(shih, vendimi nr.7 datë 09.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa më sipër, vlerësohet se Gjykata e Lartë nuk mund të ndryshojë faktet e çështjes apo të merret me vlerësimin e provave. Në çdo rast, konstatimi i fakteve përmes procesit të të provuarit në gjykim është një atribut që i përket juridiksionit gjyqësor të gjykatave të faktit.

28. Në çdo rast, kontrolli i Gjykatës së Lartë duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimit të ankimuar; pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta (*shih, vendimi nr. 10, datë 03.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese)*.

29. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se, në mbështetje të nenit 63, shkronja "c", përpara ndryshimeve me ligjin nr.39/2017, duhet të prishjet vendimi nr.3360, datë 11.09.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe çështja duhet të dërgohet për rigjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me një tjetër trup gjykues.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.31003-208-2021, datë 07.05.2021

Paditë e ngritura për vërtetimin e qenies ose jo të një marrëdhënieje juridike ose një të drejte si dhe për njohjen e vërtetësisë ose jo të një dokumenti me pasoja juridike për paditësin duhet të gjykohen nga e njëjta gjykatë, pasi mosmarrëveshja është e njëjtë si në lëndë dhe në lloj. Kategorizimi procedural i padive nuk përcakton apriori kompetencën lëndore të gjykatës, kompetencë e cila përcaktohet nga natyra juridike e kërkimeve të përfshira në të.

Në fushën e pensioneve, dy janë kriteret thelbësore që përcaktojnë natyrën e gjykimit, për efekt të përcaktimit kompetencës lëndore në këto lloj mosmarrëveshjeje: Së pari, kriteri formal, nëse kërkuesi i është drejtuar gjykatës përmes një gjykimi gracioz ose kontencioz dhe së dyti, kriteri substancial, nëse e drejta e pretenduar gjyqësisht përmes padisë vepron si një çështje e ndërmjetme e të drejtës kryesore, që është njohja e të drejtës së pensionit.

Në rastet kur kundërshtohet akti administrativ apo veprimet ose mosveprimet e organit publik që kanë ndikuar në njohjen e të drejtës së pensionit, kemi kompetencë administrative. Ndërsa në rastin e kërkimit për vërtetimin gjyqësisht të faktit juridik, që ndikon në lindjen e të drejtës së pensionit, për shkak se dokumentacioni që provon faktet e pretenduara nga kërkuesi ka humbur, është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri në rrugë tjetër, përveç rrugës gjyqësore, gjendemi përpara një lloji të posaçëm gjykimi gracioz i cili përbën lëndë civile për gjykim ku prevalon kriteri formal ndaj atij substancial në identifikimin e gjykatës kompetente.

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti kërkues znj. M.Ç., pasi ka plotësuar moshën për pension pleqërie, i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Fier për t'i lidhur pension të plotë pleqërie, bazuar në vitet e vjetërisë në punë. Nga komunikimi zyrtar që ka pasur me punonjësit e DRSSH Fier,

subjektit kërkues i është bërë me dije se ka pasaktësi në dokumentet e punës, për punën e ushtruar pranë Ndërmarrjes së Bonifikimit Fier, si dhe pranë shoqërisë private "E Co" shpk. Për periudhat e pretenduara nga pala paditëse, si punë e ushtruar pranë ish-kooperativës bujqësore, DRSSH Fier ka nxjerr vërtetim negativ apo edhe akt verifikimi negativ, përmes të cilëve nuk provohej dot periudha e sigurimit, e pretenduar nga pala paditëse.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.62-2020-5101-(1279), datë 28.02.2020 ka vendosur: *"Të shpallë moskompetencën lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për gjykimin e çështjes civile [...] për kompetencë gjykimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, [duke arsyetuar se] kërkimi i palës paditëse nuk është vërtetimi i faktit juridik, por mosveprimi i palës së paditur për të njohur/korrigjuar të dhënat që ka të pasqyruara në aktin administrativ (regjistrin, certifikatën, aktin e lindjes ose librezën e punës) konkret që ka cenuar interesat e paditësit dhe për ketë arsye, ka lindur nevoja e saktësimit të të drejtave apo të detyrimeve, pasi në thelb ka lindur nevoja e korrigjimit të gabimit të pasqyruar në aktin administrativ. [...]*

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.s'ka, datë 08.02.2021 ka vendosur: "- *T'i drejtohet Gjykatës së Lartë me qëllim për t'u shprehur për kompetencën lëndore [...]*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë, çmon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është i bazuar në ligj dhe duhet të lihet në fuqi. Kolegji vlerëson se kjo gjykatë ka kualifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes, duke individualizuar, nga pikëpamja lëndore, edhe gjykatën kompetente.

9. Çështja është paraqitur për shqyrtim pranë këtij Kolegji për të zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencës që është evidentuar ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Shkaku i mosmarrëveshjes lidhet me paqartësinë që krijon objekti i padisë, në të cilin përfshihet kërkimi për vërtetësinë e dokumentit "librezë pune", me synim përfitimin e të drejtës për pension pleqërie për paditësen.

10. Nisur nga natyra juridike e kërkimit që, në rastin konkret ka investuar gjykatën, Kolegji çmon të rëndësishme të evidentojë se, praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, në çështje të ngjashme, nuk ka qenë koherente. [...]

15. Në vijim të kësaj analize, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson të domosdoshme të individualizojë kriteret bazë, që do u shërbejnë

gjykatave më të ulëta për të zgjidhur *pro futuro* dhe, rast pas rasti, çështjen e kompetencës lëndore. Kolegji vlerëson me rëndësi koherencën në praktikën gjyqësore, si mjet që garanton sigurinë juridike dhe përfundimin e gjykimeve brenda një afati të arsyeshëm. Praktika e njëjtë gjyqësore e këtij Kolegji, por edhe e Gjykatës së Lartë, në tërësi, merr një rëndësi të veçantë, në zgjidhjen e çështjeve të kompetencës dhe interpretimin e ligjit procedural relevant, pasi gjykimet nuk mund të zvarriten, për shkak se gjykatat që shqyrtojnë konflikte gjyqësore të tilla, janë të paqarta dhe të paorientuara mbi rolin që ka gjyqtari që shqyrton çështjen.

16. Për të konkluduar mbi një kriter të qartë dhe të përbashkët për ndarjen e kompetencës në mosmarrëveshje të ngjashme, Kolegji vlerëson të marrë në analizë fillimisht natyrën juridike dhe llojet e padive, sipas nenit 32 të KPC-s, dallimin midis tyre dhe raportin juridik që krijojnë me njëra-tjetrën, gjykimet e iniciuara nga padi të tilla, pozicionin ligjor përcaktues që ka organi publik (drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore) në shqyrtimin e kërkesave të të interesuarve, gjatë procedurës hetimore administrative, por edhe roli i gjyqtarit të çështjes që në fazën e kryerjes së veprimeve paraprake.

a) *Natyra juridike dhe llojet e padive, sipas nenit 32 të KPC-s, si dhe dallimi mes tyre.*

17. Në nenin 32 të KPC-s parashikohet: "*Padia mund të ngrihet: a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur; b) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte; c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin.*". Në radhë të parë, Kolegji vlerëson se kjo është një dispozitë kuadër dhe e përgjithshme që, ashtu si doktrina juridike dhe jurisprudenca gjyqësore, i kategorizon proceduralisht paditë në dy lloje: në padi detyrimi (*formulae praeiudiciales),* si dhe padi njohjeje apo deklarative. Paditë e detyrimit, të ngritura sipas nenit 32/a të KPC-s, janë mjete me të cilat paditësi investon gjykatën për të kërkuar rivendosjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm të cenuar. Padi të tilla kanë për qëllim të provokojnë nxjerrjen e një vendimi gjyqësor detyrues në përfundim të gjykimit (*kondemnator*), në kuptim të nenit 511/a të KPC-s. Nga ana tjetër, paditë e njohjes apo me natyrë deklarative, sipas shkronjës b) dhe c) të nenit 32 të KPC-s, të njohura ndryshe si padi provokatore, nuk shoqërohen në kërkim edhe me detyrimin e të paditurit për kryerjen e një veprimi të caktuar. Padi të tilla sigurojnë bazën për një padi detyrimi në të ardhmen (*formulae praeiudiciales*) dhe kanë natyrën e çështjeve paragjykimore në raport me paditë e detyrimit.

18. Arsyeja e mjaftueshme për ngritjen e padisë deklarative është pikëpamja e kundërt e palëve lidhur me llojin apo përmbajtjen e të drejtës subjektive, vërtetësisë, pavërtetësisë së një dokumenti apo të një marrëdhënieje juridiko-civile. Ndërhyrja e gjykatës me këtë lloj padie kërkohet para se të bëhet shkelja e normës juridike, në të cilën bazohet e drejta subjektive e paditësit. Rëndësia parandaluese e kësaj padie qëndron në faktin se kontribuon në shmangien e shkeljeve të të drejtave që mund të bëhen në të ardhmen. E drejta për të kërkuar mbrojtje juridike deklarative është thjesht e natyrës procedurale dhe autonome, sepse nuk mbështetet në ndonjë autorizim nga e drejta materiale.

19. Në veçanti, padia e ngritur sipas nenit 32/c të KPC-s përfaqëson instrumentin e kontrollit të vërtetësisë së një dokumenti. Ashtu sikundër edhe verifikimi i origjinalitetit të dokumentit apo goditja e shkresës për falsitet, një pretendim i tillë mund të realizohet nëpërmjet një gjykimi principal (themeli), sipas kësaj dispozite, ose nëpërmjet gjykimit incidental (paragjykimor), të investuar nga një padi detyrimi, sipas nenit 32/a të KPC-s apo edhe padi njohjeje sipas nenit 32/b të KPC-s, ku çështja e origjinalitetit, falsitetit apo vërtetësisë së dokumentit shtrohet për zgjidhje, jo më si qëllim në vetvete, por si mjet për të arritur zgjidhjen e çështjes kryesore.

20. Si gjykimi principal, ashtu edhe gjykimi incidental mbi vërtetësinë e dokumentit ka si qëllim që t'i zhveshë ose t'i njohë vlerën provuese, në mënyrë që ai të administrohet ose jo si provë në atë proces ose në një proces tjetër gjyqësor apo administrativ. Në të dyja rastet, krijohet një raport i ndërmjetëm midis gjykimit mbi vërtetësinë e dokumentit dhe gjykimit meritor apo procedimit administrativ, para të cilit do të duhet të paraqitet dokumenti, ku e para është çështje e ndërmjetme e së dytës.

21. Sipas parimit të disponibilitetit të padisë dhe të të drejtave subjektive, pala e interesuar mund të përzgjedhë të ngrejë padinë, sipas nenit 32, shkronja b ose c, që është provokatore dhe mund të jetë bazë për ngritjen e padisë së themelit në të ardhmen ose mund të ngrejë menjëherë padinë e themelit, ku pretendimi për njohjen e së drejtës, për vërtetësinë ose pavërtetësinë e dokumentit është pjesë e shkakut të padisë dhe do të gjykohet në formë paragjykimore nga gjykata që gjykon themelin e mosmarrëveshjes. Në çdo rast, të dyja llojet e padive, do të duhet të gjykohen nga e njëjta gjykatë, pasi është e njëjta mosmarrëveshje, në lëndë dhe në lloj.

b) *Lidhja ndërmjet nenit 32 të KPC dhe ligjit nr.49/2012* .

22. Në këtë aspekt, Kolegji çmon të nevojshme të sjell në vëmendje relevancën që krijohet në praktikën gjyqësore dhe, në veçanti, në fushën e sigurimeve shoqërore, ndërmjet nenit 32 të KPC-s dhe ligjit nr.49/2012. Në

nenet 7 dhe 17, të këtij ligji është përcaktuar, ndër të tjera, se në kompetencë të gjykatave administrative janë si mosmarrëveshjet që lindin nga akte administrative individuale, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të një organi publik, ashtu edhe mosmarrëveshjet që burojnë nga nevoja për saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik, apo mosmarrëveshjet që lindin për shkak të mosveprimit të organit publik.

23. Për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative, bazuar në parashikimet e nenit 7 të ligjit nr.49/2012 duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore, të cilat kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (*shih, vendimi nr.2, datë 10.03.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23*).

24. Neni 7 i ligjit nr.49/2012 nuk ka parashikuar në mënyrë ezauruese çështjet që janë në kompetencë të gjykatave administrative. Kështu, Kolegji sjell në vëmendje kompetencën e gjykatave administrative për shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit apo padive të ngritura në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, kur titull ekzekutiv është një akt administrativ apo një vendim gjyqësor i gjykatave administrative. Në praktikën gjyqësore është arritur në konkluzionin se gjykatat administrative që janë kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve që burojnë nga aktet administrative janë kompetente edhe për shqyrtimin e kërkesave apo padive gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, si çështje të prejardhura nga mosmarrëveshjet administrative. Ky konkluzion është arritur me interpretim gjyqësor nga Gjykata e Lartë kur ka zgjidhur mosmarrëveshjet e kompetencave midis gjykatave më të ulëta, duke bërë një interpretim teleologjik dhe sistematik të dispozitave të ligjit nr.49/2012, pasi në lidhje me këto çështje duket se ometon neni 7 i këtij ligji. Pra, në raste të tilla, Gjykata e Lartë ka cilësuar si kriter ndarës të kompetencës, kriterin e çështjeve të prejardhura, edhe për mosmarrëveshje që nuk janë përfshirë në mënyrë eksplicite në kompetencën e gjykatave administrative, sipas ligjit të posaçëm. Kjo do të thotë se neni 7 i ligjit nr.49/2012 parashikon një listë të hapur dhe përcakton kriteret orientuese që duhet të ketë parasysh gjykata

për të identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, sipas shkakut dhe objektit të padisë.

25. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se neni 32 i KPC-s është një dispozitë kuadër dhe e përgjithshme, e cila kategorizon proceduralisht llojet e padive. Ky kategorizim juridik është i vlefshëm për të gjitha llojet e padive dhe nuk lidhet me natyrën e kompetencës lëndore të gjykatave, që ato aktivizojnë. Kjo do të thotë se si gjykatat administrative, ashtu edhe gjykatat civile mundet të gjykojnë padi detyrimi, padi njohjeje apo padi me objekt vërtetësinë apo jo të një dokumenti. Ajo çka ndan dhe përcakton ligjërisht kompetencën lëndore të padive civile dhe administrative nuk është kategorizimi procedural i nenit 32 të KPC-s, por natyra juridike e kërkimeve të përfshira në të. Kjo dispozitë përbën burimin primar të së drejtës procedurale që rregullon në mënyrë të përgjithshme të drejtën e padisë dhe llojet e saj dhe gjen zbatim në mënyrë komplementare me çdo ligj që rregullon në mënyrë të posaçme të drejtën e padisë, sipas marrëdhënies juridike konkrete.

26. Për paditë e njohjes, sikurse parashikohen në nenin 32/b dhe 32/c të KPC-s, nuk mund të konkludohet se janë *apriori* lëndë gjykimi civil, vetëm se rregullohen nga KPC-ja. Kolegji sjell në vëmendje se KPC-ja është rregullim normativ komplementar i ligjit nr.2012/49, për sa kohë ky i fundit hesht apo ometon nga rregullimi ligjor eksplicit (*shih, nenin 1/2 të ligjit nr.49/2012*).

27. Kolegji vlerëson se gjykatat, rast pas rasti, për të vlerësuar nëse një padi e ngritur sipas nenit 32/b apo 32/c të KPC-s është në kompetencën lëndore të gjykatës civile apo administrative duhet të shqyrtojnë dhe të konkludojnë drejt mbi kriterin objektiv dhe material, që do të thotë mbi natyrën e marrëdhënies juridike të palëve, e cila ka ardhur në gjykatë si kontest gjyqësor. Gjykatat do të duhet të individualizojnë se cili është qëllimi dhe interesi i paditësit në ngritjen e padisë, shkaku që ka provokuar ngritjen e saj, kujt i kundrejtohet ajo, me çfarë lloj gjykimi apo procedimi krijon raportin paragjykimor apo të ndërmjetëm gjykimi i investuar nga një padi e tillë.

28. Për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshjeje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin *prima facie* të padisë. Ato duhet të shqyrtojnë, më tej, faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të padisë, të të drejtës subjektive, të pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet t'i kundërvihet kësaj të drejte subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes.

29. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji vlerëson se në rastet kur paditë e pavërtetësisë së një dokumenti i kundrejtohen një organi publik, sikurse

janë, në veçanti, paditë për njohjen e së drejtës së pensionit, kanë si qëllim detyrimin e organit publik të njohë ose jo vlerën provuese të një dokumenti, në mënyrë që ky i fundit të përdoret ose jo si provë në procedurën administrative.

30. Kolegji thekson se padi të tilla kanë si shkak dhe janë të provokuara, përgjithësisht në praktikë, nga një sjellje neglizhente apo mosveprim i organeve të administratës publike, të cilat nuk përmbushin detyrimet ligjore që kërkon hetimi administrativ. Kjo mund të ndodhë, herë për shkak të mungesës së kujdesit të duhur dhe, herë për shkak të keqkuptimit mbi funksionin, të drejtat dhe detyrimet që këto organe kanë në procedurën administrative.

31. Përderisa në praktikën gjyqësore konstatohen kërkesëpadi me objekte kërkimi, të larmishme për nga forma, por jo aq nga përmbajtja e tyre, si edhe qëndrime jo koherente dhe të paplota, si nga ana e drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore, gjatë procedurës së hetimit administrativ, ashtu edhe nga gjyqtari i vetëm, gjatë fazës së verifikimit të të metave të padisë e të kryerjes së veprimeve paraprake, Kolegji e vlerëson të domosdoshme të ritheksojë rëndësinë që ka zbatimi konsekuent i kërkesave të ligjit, në disa drejtime kryesore:

c) *Raporti ndërmjet padive sipas nenit 32 të KPC-s dhe kërkesës për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik.*

32. Në praktikën gjyqësore konstatohen paqartësi, nga palët ndërgjyqëse dhe përfaqësuesit profesionist të palëve, sa u përket shkaqeve për të cilat ngrihet padia në mbështetje të nenit 32 b dhe c, të KPC-s dhe shkaqeve për të cilat ngrihet kërkesa për vërtetim fakti, në mbështetje të nenit 388 të tij. Kjo paqartësi reflektohet edhe nga gjykatat e faktit në funksion të përcaktimit të gjykatës kompetente për nga pikëpamja lëndore për gjykimin e padisë/kërkimit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se është e dobishme analiza mbi natyrën e mjeteve procedurale që investojnë gjykatën, konkretisht për paditë, sipas nenit 32, shkronjat b, dhe cc, të KPC-s, me kërkesat për vërtetimin e fakti, sipas nenit 388.

33. Dallimi i parë dhe kryesor mes tyre është qëllimi për të cilin investohet mjeti procedural. Neni 388 i KPC-s ka për qëllim të garantojë ekzistencën e një fakti juridik, i cili nuk mund të provohet drejtpërdrejt nga përmbajtja e një akti. Sipas kësaj dispozite procedurale çdo palë e interesuar ka mundësi të krijojë gjyqësisht një dokument shkresor, i cili nëse ka ekzistuar, paraqet një fakt, nga i cili varet lindja, ndryshimi dhe shuarja e të drejtave personale apo pasurore për këtë palë. Vërtetimi gjyqësor i fakteve juridike konfirmon ekzistencën e këtij fakti dhe i shërben palës si mjet prove për këtë fakt. Nga ana tjetër, padia nuk

ka për qëllim konfirmimin e ekzistencës së faktit juridik, por vërtetimin e (mos) qenies së një marrëdhënieje juridike/të drejte (neni 32/b i KPC-s), ose njohjen e (pa)vërtetësisë së një dokumenti (neni 32/c i KPC-s).

34. Në gjykimet për vërtetimin gjyqësor të fakteve, kushtet e domosdoshme që duhet të provojë kërkuesi janë: *Së pari*: *i)* personi që e kërkon vërtetimin gjyqësisht të faktit juridik duhet të ketë interes të ligjshëm në inicimin e këtij procesi; *ii)* akti të jetë zhdukur; *iii)* akti që ka humbur nuk mund të bëhet përsëri; *iv)* akti nuk mund të merret me rrugë tjetër; *Së dyti*, vërtetimi i fakteve juridike është një gjykim gracioz, jo kontencioz. Vërtetimi gjyqësor i faktit proceduralisht paraqitet në formën e një gjykimi pa palë kundërshtare. Sipas nenit 390 të KPC-s, në gjykim mund të thirren me cilësinë e personit të tretë edhe persona të tjerë, ose prokurori. Padia është mjeti procedural, ku pretendimet e paditësit i kundrejtohen palës kundërshtare në një gjykim kontencioz, kontradiktor; *Së treti*, vërtetimi gjyqësor i fakteve karakterizohet nga mungesa e konfliktit, për arsye se gjykimi për vërtetimin gjyqësisht të një fakti ka për qëllim të konstatojë ekzistencën, ose mosekzistencën e një fakti të caktuar, i cili nuk mund të provohet me dokumentin e nevojshëm. Ai nuk ka për qëllim të zgjidhë një konflikt të caktuar të së drejtës. Për këtë arsye, ky gjykim nuk është kontencioz, pra pa palë kundërshtare, ndërsa gjykimi për vërtetimin e ekzistencës, ose mos ekzistencës së një marrëdhënieje juridike/të drejte ose njohjen e (pa)vërtetësisë së një dokumenti, ka për qëllim të zgjidhë një konflikt mes palëve. Në padinë sipas nenit 32/b të KPC-s, konflikti lind nga kundërshtimi rreth ekzistencës, ose mosekzistencës së marrëdhënies juridike, ose të një të drejte midis palëve ndërgjyqëse, ndërsa në padinë sipas nenit 32/c, konflikti lind për shkak të kundërshtimit të (pa) vërtetësisë së dokumentit; *Së fundmi*, vendimi për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik ka natyrë deklarative. Vendimi gjyqësor për vërtetim fakti ka fuqi provuese për kërkuesin dhe personat e tjerë të thirrur në gjykim dhe prej këtyre të fundit nuk kërkohet asgjë, sepse nuk iu është kundrejtuar asnjë kërkim i kundërshtuar prej tyre.

d) *Mbi pozicionin ligjor të organit publik gjatë procedurës hetimore administrative.*

5. Për të konkluduar mbi pozitën juridike, të drejtat dhe detyrimet e organit publik dhe palës gjatë procedurës hetimore administrative, në fushën e sigurimeve shoqërore, Kolegji vlerëson të ndalet në analizën e dispozitave të KPA-s (në vijim, KPA). Kolegji vlerëson se KPA është ligj i rëndësishëm që rregullon veprimtarinë e administratës publike dhe që zbatohet, për sa kohë ligji i posaçëm në fushën e sigurimeve shoqërore nuk bën një rregullim të ndryshëm.

36. Kështu, me qëllim verifikimin e pretendimit të palës kërkuese gjatë një procedure administrative, vetë organi publik (drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore), në radhë të parë, ka detyrimin ligjor të realizojë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Nxjerrja e një vendimi të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkon nga organi publik zbatimin e përpiktë të rregullave procedurale dhe veçanërisht të parimeve bazë, mosrespektimi i të cilave në dyshim ligjshmërinë e vendimmarrjes.

37. Në funksion të të provuarit, Kolegji thekson se çdo subjekt i interesuar mund t'i kërkojnë organit publik të marrë masat e nevojshme për të siguruar përdorimin e provave të zotëruara prej tij. Që në nenin 1 të KPA-së theksohet rëndësia që merr për një organ publik zbatimi i parimit të procesit të rregullt ligjor, me qëllim sigurimin e realizimit efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve. Që me fillimin e procedurës administrative organi publik u kërkon subjekteve të interesuar kryerjen e të gjitha veprimeve të domosdoshme që nevojiten për zhvillimin normal të procesit. Gjatë zhvillimit të procedurës administrative, organet e administratës publike, kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha palët e përfshira në proces *"të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"* (neni 10 i KPA-s). Organi publik, thuhet në nenin 77, pika 2, të KPA-s, *"përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes."*.

38. Procedura administrative kërkon respektimin e rregullave që detyron palët për paraqitjen e informacionit dhe të provave konkrete që pretendohen. Organi publik, në kuadrin e dhënies së ndihmës aktive, duhet t'u japë palëve *"të gjithë informacionin lidhur me procedurën"*, dhe t'i paralajmërojë ato *"për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre."*. Pavarësisht nga reagimi i subjektit të interesuar, organi publik, për qëllimet e të provuarit, nuk çlirohet nga detyrimi për t'i kërkuar vetë provat dhe faktet dhe për të dhënë një vendim përfundimtar. Për natyrën e veçantë që mund të paraqesë çështja konkrete dhe me qëllim arritjen e një përfundimi të saktë e të drejtë shkencor, mund të lindë nevoja të kërkohet edhe kryerja e ekspertimit.

39. Kolegji thekson se, në parim, organet publike në përgjithësi dhe organet kompetente në fushën e sigurimeve shoqërore, në veçanti, nuk ndalohen gjithashtu të pezullojnë procedurën administrative, nëse palët i drejtohen gjykatës, në rastet kur ka paqartësi mbi provat apo dokumentet e paraqitura prej tyre. Është i njohur, si një ndër parimet bazë të procedurës

administrative, ai i eficiencës dhe deburokratizimit, që nënkupton zhvillimin dhe përfundimin e kësaj procedure, sa më shpejt të jetë e mundur, brenda afateve të përcaktuara në ligj, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm (neni 14 i KPA-s). Megjithatë, sipas nenit 66 të KPA-s, organi publik mund të pezullojë procedurën administrative, në rastet kur lind nevoja për t'u shprehur në lidhje me një çështje të ndërmjetme, e cila kushtëzon marrjen e vendimit përfundimtar, nëse kjo përbën një çështje të pavarur ligjore, për të cilën është kompetent një organ tjetër, gjyqësor apo administrativ. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje nenin 79/1 të KPA-s, i cili ka parashikuar se, "*Procedura hetimore zhvillohet nga organi publik, në kompetencën e të cilit është marrja e vendimit përfundimtar.*".

40. Bazuar në këto dispozita, Kolegji vlerëson se hetimi, marrja e provave, mbledhja e fakteve dhe vlerësimi i tyre në tërësi, si çështje e ndërmjetme e procedurës hetimore administrative, nga e cila varet zgjidhja e çështjes, nuk është kompetencë dhe tagër vetëm e pushtetit gjyqësor, por është detyrim primar dhe funksional i organit publik që do të vendosë mbi kërkesën e palës së interesuar në procedurën administrative. Detyrimi për të shqyrtuar kërkesën dhe për t'u shprehur me vendim përfundimtar, nuk mund të kuptohet si një proces i shkëputur dhe i ndarë nga procesi i verifikimit të fakteve dhe provave, në themel të së drejtës subjektive të pretenduar nga pala e interesuar. Ky verifikim nuk mund të jetë i përciptë dhe mekanik, por duhet të jetë tërësor dhe i thelluar.

41. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje nenin 77 të KPA-s, ku është parashikuar se, "*Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes…Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij ose të organeve të tjera publike*". Po ashtu, neni 80 i KPA-s ka parashikuar se, *"1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët; b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira. 2. Dispozitat e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen, për aq sa është e mundur, në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod. 3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.*". Ndërsa në nenin 81 të KPA-s thuhet se, "*Organi publik çmon sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të të gjitha provave së bashku, si dhe rezultatin tërësor të hetimit administrativ.*".

42. Nëse një dokument i paraqitur nga pala në procedurën administrative, ku pasqyrohet fakti juridik i pretenduar prej tij, paraqet pasaktësi në përmbajtje, për sa u përket gjeneraliteteve të kërkuesit apo të dhënave të tjera, organi publik duhet të verifikojë burimin e kësaj pasaktësie, duke e ballafaquar me provat e tjera, me shpjegimet e palës, me informacione të marra nga gjendja civile apo subjekte të treta që administrojnë të dhënat përkatëse. Në këto raste, organi publik është i detyruar të verifikojë nëse pasaktësitë janë të natyrës materiale apo janë të tilla që rrëzojnë pretendimin e kërkuesit mbi ekzistencën e faktit të pasqyruar në të.

43. Nga ana tjetër, me përjashtim të rasteve kur një ligj i posaçëm parashikon ndryshe, sipas KPA-s, pala e interesuar mund të mos disponojë prova me shkresë apo dokumente dhe faktin e pretenduar ka të drejtë ta provojë me mjete të tjera prove, sikurse është prova me dëshmitar apo me deklarata noteriale të lëshuara prej tyre. Në mënyrë simetrike me hetimin gjyqësor, hetimi administrativ thjeshtëzohet edhe nga prezumimet ligjore apo faktet botërisht të njohura, të cilat nuk kanë nevojë të provohen.

44. Kolegji vlerëson se vetëm pas një hetimi të plotë dhe pas një analize tërësore të fakteve dhe provave të administruara, organi publik mund të krijojë bindjen, si rrjedhojë e një procesi të brendshëm intelektual, analitik, deduktiv-logjik dhe, në çdo rast, është i detyruar të pranojë ose të rrëzojë kërkesën e palës me vendim përfundimtar.

45. Të gjitha ato prova, dokumente, që vlerësohen të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi dhe arsyetohen, me objektivitet në përputhje me ligjin, në vendimin përfundimtar. Përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në ligj, organi publik është i detyruar të shprehet me vendim përfundimtar (*shih, nenin 90 të KPA-s*), duke nxjerrë aktin administrativ që refuzon ose pranon kërkesën e palës për njohjen e së drejtës subjektive të pretenduar prej saj, pasi ka analizuar dhe vlerësuar në tërësi të gjitha faktet dhe provat e administruara me iniciativë të palës ose edhe kryesisht prej tij. Pra, gjatë një procesi vendimmarrës, organi publik duhet të tregojë kujdesin maksimal për zbatimin konsekuent të të gjithë kërkesave të ligjit, që kanë të bëjnë me kryerjen e një procedure të thelluar të hetimit administrativ. Ky mbetet detyrimi parësor i çdo organi publik.

46. Në përfundim të hetimit, organi publik duhet të bëjë një analizë

tërësore të fakteve dhe provave, bazuar në arsyetime dhe deduksione, sipas rregullave të logjikës formale, cilësi që nuk mund të kuptohen se janë ekskluzivitet vetëm të magjistratit, por edhe të nëpunësit publik.

47. Në analizë të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji vlerëson *se ligjvënësi e ka pajisur organin administrativ me të njëjtin kapacitet ligjor për të hetuar, sikurse organet gjyqësore*. Ai ka të drejtën dhe detyrimin të pranojë dhe të marrë prova nga pala në procedurën administrative, sipas të gjitha burimeve të provës, të lejuara edhe në gjykimin administrativ apo civil: dokumente, prova me dëshmitar, deklarata të palëve, ekspertime etj.,. Neni 80/2 i KPA-s referon tek ligji nr.49/2012 për provat dhe mjetet e provës të lejuara në procedurën administrative dhe, si rrjedhojë, në mënyrë komplementare edhe në dispozitat e KPC-s, mbi burimet e provës, për aq sa është e mundur. Nëse përmbushen nga organi publik të gjitha detyrimet që ligji vendos për të, krijohen të gjitha kushtet që çështja të marrë një zgjidhje përfundimtare në këtë fazë, pa qenë e nevojshme të vihet në lëvizje gjykata. *Vetëm nëse organi publik (organet kompetente në fushën e sigurimeve shoqërore) nuk do kenë përmbushur këto detyrime ligjore, apo subjekti i interesuar nuk do të bindet për vendimmarrjen e tyre, atëherë kjo veprimtari administrative do të jetë objekt i kontrollit gjyqësor*.

e) *Lidhur me rolin e gjyqtarit të çështjes që në fazën e kryerjes së veprimeve paraprake.*

48. I gjithë procesi i gjykimit administrohet nga gjyqtari. Ky administrim i procesit, në kuptimin formal e procedural, do të thotë se gjyqtari, ndërsa mbetet arbitër i paanshëm, njëkohësisht kontrollon edhe veprimtarinë e pjesëmarrësve në proces, përmbushjen prej tyre të detyrimeve procedurale, me qëllim shqyrtimin dhe përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Për shkak të parimit të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, gjyqtari duhet të përgatisë çështjen për gjykim, si dhe të marrë masat e duhura për ecurinë e mëtejshme të procesit. Në këtë kuptim, para së gjithash, padia që i paraqitet gjykatës kërkohet të plotësojë të gjitha kushtet formale të saj. Verifikimi me saktësi nga gjyqtari i kushteve formale të padisë, duke filluar, në veçanti, me legjitimitetin aktiv e pasiv, përcaktimin e qartë të objektit të padisë, sikurse edhe të shkakut të saj ligjor janë thelbësore për të kuptuar natyrën e mosmarrëveshjes e, për rrjedhojë, edhe kompetencën lëndore të gjykatës, ku është paraqitur padia.

49. Kolegji thekson se kryerja e këtij verifikimi paraprak është i domosdoshëm dhe thelbësor për drejtësinë e vendimmarrjes, por edhe sepse i shërben ekonomisë gjyqësore, ashtu siç shmang investimin e gjykatës në një çështje, qartësisht, pa një të ardhme. Moskryerja me seriozitet e këtij verifikimi nga gjyqtari, që në fazën e paraqitjes së padisë dhe rregullimit të të metave të saj, është një ndër arsyet që ndikon në shtimin artificialisht të mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet gjykatave administrative e civile, në veçanti, në çështjet që lidhen me përfitimin e të drejtës për pension.

50. Një kërkesëpadi që përmban të meta të dukshme në kërkimet e ndërthurura e të shumta të objektit të padisë, apo në mospërcaktimin e saktë të shkakut ligjor prej paditësit, është e nevojshme që të rikthehet për t'u plotësuar apo saktësuar në tërësinë e saj. Në raste jo të pakta, nga Kolegji është konstatuar se një verifikim i plotë i elementëve kryesorë të padisë nuk arrihet të bëhet nga gjyqtari, ndërkohë që veprimi më i zakonshëm prej tij është nxitimi për të ngritur çështjen e kompetencës dhe marrja e një vendimi, pa u sqaruar më parë natyra e mosmarrëveshjes. Nëse gjyqtari do jetë i vëmendshëm, rast pas rasti, dhe për aq sa është e mundur, në urdhërimin e paditësit për plotësimin e të metave formale të padisë, pa cenuar aspak standardin e paanshmërisë së tij në gjykim, Kolegji vlerëson se mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet gjykatave, në veçanti, në të drejtën për përfitimin e pensionit, nuk do të jenë aq të pranishme në praktikën gjyqësore.

51. Për shkak të luhatjeve që janë vënë re në praktikën gjyqësore, në drejtim të qëndrimit të mbajtur nga gjyqtari që në veprimet përgatitore, lidhur me gjykatën kompetente që duhet të shqyrtojë çështje të kësaj natyre, Kolegji e vlerëson të nevojshme t'i rikthehet jurisprudencës së mbajtur prej tij, me synimin e shmangies së mosmarrëveshjeve të kompetencës ndërmjet gjykatave administrative dhe civile.

52. Është i konsoliduar tashmë qëndrimi i mbajtur nga ky Kolegj, se gjyqtari, në momentin e paraqitjes së padisë, duhet të bëjë mirë dallimin ndërmjet kërkimeve të palëve për njohjen e një të drejte në fushën e marrëdhënieve të sigurimeve shoqërore. Në këtë pikë, Kolegji çmon të sjell në vëmendje disa nga qëndrimet e tij:

52.1. Në vendimin nr.00-2020-567, datë 12.10.2020 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar "*... se nuk jemi përpara një padie për vërtetimin e faktit juridik të aktit administrativ, për faktin se mungon akti që e provon këtë fakt. Me padinë objekt shqyrtimi, rezulton se akti ekziston dhe paditësi kërkon të saktësojë të drejtat dhe/ose të korrigjojë gjyqësisht këtë akt administrativ, të drejta këto të cilat nuk njihen për shkak të mosveprimit të organit publik në funksion të veprimtarisë së tij.*".

52.2. Në vendimin nr.00-2020-797, datë 16.11.2020 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se, për t'u gjykuar çështja nga gjykatat administrative *"...duhet që akti administrativ që ka cenuar interesat e palëve të ketë dalë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ose për*

shkak të mosveprimit të tij. Në rastin konkret, kërkimi i palës paditëse nuk është vërtetimi i faktit juridik, por mosveprimi i palës së paditur për të njohur të dhënat që ka të pasqyruara në aktin administrativ (regjistrin, certifikatën, aktin e lindjes ose librezën e punës) konkret që ka cenuar interesat e paditësit dhe, për këtë arsye, ka lindur nevoja e saktësimit të të drejtave apo të detyrimeve, pasi në thelb ka lindur nevoja e korrigjimit të gabimit të pasqyruar në aktin administrativ.".

52.3. Në vendimin nr.31003-1094-00-2020 akti, datë 14.12.2020 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka ritheksuar "*...edhe njëherë qëndrimin e mbajtur dhe të konsoliduar tashmë, se në rastin kur pala paditëse kërkon të vërtetojë gjyqësisht një fakt, për të cilën ai nuk disponon dokumentacionin përkatës, jemi përpara rastit të vërtetimit të faktit juridik, pasi jemi në rastin kur akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër. Pra, në rastin konkret akti nuk ekziston, pra, dokumenti që vërteton marrëdhënien e punës nuk ekziston dhe nuk përmban asnjë të dhënë pranë palës së paditur dhe as nuk ekziston në ndonjë institucion tjetër.".*

53. Me qëllim përcaktimin e kompetencës lëndore në këtë kategori gjykimesh, gjykatat e faktit duhet të jenë shumë të vëmendshme në evidentimin e saktë të shkakut ligjor të padisë. Kolegji çmon të domosdoshme të nënvizojë rregullin se elementi përcaktues që evidenton kompetencën lëndore të gjykatës është natyra juridike e shkakut të padisë. Është pikërisht shkaku ligjor i padisë, elementi thelbësor që do të ndihmojë gjykatën në përcaktimin e kompetencës lëndore. Shkaku ligjor i padisë, pra, thelbi material për të cilin investohet gjykimi, ndikon dhe është pazgjidhshmërisht i lidhur me elementët formalë proceduralë të gjykimit. Në mënyrë që procesi gjyqësor të jetë i suksesshëm duhet që mjeti procedural i përzgjedhur nga paditësi/kërkuesi t'i përgjigjet natyrës materiale të së drejtës së pretenduar.

54. Në këtë drejtim, gjykatat e faktit duhet të kenë një rol aktiv në funksion të përkujdesjes për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sipas nenit 4 të KPC-s dhe efikasitetit të procesit gjyqësor në tërësi. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin nr.3, datë 29.03.2012 kanë theksuar se, "*Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit, duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast, gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.".* Për të zbuluar

shkakun e padisë, KPC-ja i ka dhënë gjykatës mjetet e duhura procedurale. Në këtë aspekt, Kolegji sjell në vëmendje edhe rregullimet e nenit 9 të KPC-s, ku parashikohet se, "*Gjykata fton palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.*", si dhe të nenit 17 të KPC-s, ku parashikohet se, *"Gjykata fton palët që të japin shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.*".

55. Në praktikën gjyqësore dallohen forma të larmishme në paraqitjen e kërkimeve/padive, me qëllim njohjen e të drejtës subjektive të pensionit. *Kolegji vlerëson se dy janë kriteret thelbësore që përcaktojnë natyrën e gjykimit, për efekt të përcaktimit kompetencës lëndore në këto lloj mosmarrëveshjesh: Së pari, kriteri formal, nëse kërkuesi i është drejtuar gjykatës përmes një gjykimi gracioz ose kontencioz dhe së dyti, kriteri substancial, nëse e drejta e pretenduar gjyqësisht përmes padisë vepron si një çështje e ndërmjetme e të drejtës kryesore, që është njohja e të drejtës së pensionit.*

56. Në reflektim të analizës së mësipërme dhe në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore, pranë gjykatave të faktit paraqiten situata të ngjashme me rastet e mëposhtme, kur: i. *Kundërshtohet akti administrativ i organit publik, me padi për njohjen e pensionit.*

57. Në këtë rast, paditësi kundërshton aktin administrativ, sipas nenit 7, shkronja a) të ligjit nr.49/2012. Në përmbushje të parashikimeve të ligjit nr.7703/1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", paditësi, pasi ka ezauruar rrugën administrative të ankimit, i drejtohet gjykatës, duke kundërshtuar vendimet e organeve të sigurimeve shoqërore, lidhur me vlefshmërinë dhe saktësinë e dokumentacionit të marrë në shqyrtim prej tyre për caktimin e masës së pensionit. Kolegji vlerëson pa asnjë dyshim se ky lloj gjykimi përbën lëndë administrative dhe kompetente për nga pikëpamja lëndore do të jenë gjykatat administrative. ii. *Kundërshtohen përmes padisë veprimet ose mosveprimet e organit publik që kanë ndikuar në njohjen e të drejtës së pensionit.*

58. Në këto raste, nuk kundërshtohet akti administrativ përfundimtar i organeve të sigurimeve shoqërore për njohjen/refuzimin e të drejtës së pensionit, por sjellja apo veprimet administrative të organit publik. Nisur nga problematika specifike që mund të ketë pasur kërkuesi në realizimin e të drejtës subjektive të përfitimit të pensionit (pasaktësi dokumentacioni që reflektohet në forma nga me të ndryshmet, si në pasqyrimin e gabuar të gjeneraliteteve, të viteve të punës, vjetërsisë në punë, llojit, kategorisë të punës etj.,.), kërkohet të konstatohet gjyqësisht se (mos)veprimet e organit publik, në funksion të hetimit administrativ të kryer prej tij, ndërhyjnë

në mënyrë të paligjshme në të drejtën e pretenduar të kërkuesit. Në këtë kategori të mosmarrëveshjeve kundërshtohet në mënyrë direkte veprimtaria administrative e organit publik, në funksion të lidhjes së pensionit. Në të gjitha këto raste, mes kërkuesit dhe organeve të sigurimeve shoqërore ekziston konflikti për plotësimin ose jo të kushteve për përfitimin e të drejtës së pensionit për shkak të mënyrës së vlerësimit të organit publik. Kolegji thekson se në këto raste, kompetente për nga pikëpamja lëndore për gjykimin e mosmarrëveshjes do jenë gjykatat administrative.

59. Kolegji vlerëson gjithashtu se kur kërkohet njohja e vjetërsisë në punë, e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti, ose saktësia/pasaktësia e tyre, kërkim ky i kundrejtuar organit, për shkak se pas hetimit administrativ organi publik ka refuzuar të njohë të drejtën e pensionit, të pretenduar nga paditësi, kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes është gjykata administrative. Në këtë rast, pavarësisht se objekti i padisë në dukje mund të paraqesë elementët e një kërkimi civil, në thelb kundërshtohet gjyqësisht veprimtaria administrative e ndërmjetme e organit publik, në funksion të çështjes kryesore, që është lidhja e pensionit. Për këto arsye, kompetente nga pikëpamja lëndore, sipas nenit 7, shkronja "b", të ligjit nr.49/2012 vlerësohet se është gjykata administrative. iii. *Kërkohet gjyqësisht vërtetimi i faktit juridik, që ndikon në lindjen e të drejtës së pensionit, për shkak se dokumentacioni që provon faktet e pretenduara nga kërkuesi ka humbur, është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri në rrugë tjetër, përveç rrugës gjyqësore.* 60. Në këtë rast, gjendemi para kushteve të nenit 388 të KPC-s, ku përmes një gjykimi të posaçëm të natyrës civile kërkohet të provohet gjyqësisht ekzistenca e një fakti krijues që në të ardhmen mund të aktivizojë njohjen e të drejtës subjektive të paditësit për përfitimin e pensionit. *Ky lloj i posaçëm gjykimi gracioz përbën lëndë civile për gjykim. Në këto raste, Kolegji vlerëson se do të prevalojë kriteri formal ndaj atij substancial në identifikimin e gjykatës kompetente, pasi ligji procedural civil ka përcaktuar si gjykatë kompetente gjykatën e vendbanimit të kërkuesit ose gjykatën e vendndodhjes së sendit të paluajtshëm për gjykimin e vërtetimit gjyqësor të faktit.* Në këtë përfundim arrihet nga vetë përmbajtja e nenit 388 të KPC-s, në të cilin parashikohet: "*Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë. Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ka banim kërkuesi. Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ndodhet sendi…".* Pra, në rastin kur ndodhemi përpara vërtetimit gjyqësor të fakteve që ndikojnë në përfitimin e të drejtës subjektive për pension, ligji ka kanalizuar rrugën e kërkimit të së drejtës subjektive, përmes inicimit të një gjykimi gracioz, të parashikuar në nenin 388 të KPC-s dhe, për rrjedhojë, edhe kompetencën lëndore të gjykatave të rretheve gjyqësore për shqyrtimin e këtij kërkimi.

61. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Kolegji pasi ka analizuar objektin e kërkesës, formën e paraqitjes së saj dhe aktet provuese, bashkëlidhur dosjes gjyqësore, vlerëson se në mosmarrëveshjen objekt gjykimi rezulton qartësisht se kërkimi është ngritur në mënyrë të gabuar nga kërkuesi dhe kjo e metë formale nuk është konstatuar nga gjykatat e faktit.

62. Rezulton se personi i tretë në gjykim nuk i ka njohur palës kërkuese periudhën e plotë të punësimit, sipas pretendimeve të saj. Sipas vendimit nr.339, datë 20.07.2020 rezulton se DRSSH Fier ka refuzuar të njohë vitet e punës për periudhën 06.04.1987 - 30.09.1993, si dhe 01.12.1993 - 31.12.1993, me arsyetimin se libreza e punës e paraqitur është dublikatë, e hapur në vitin 1996 dhe në të janë pasqyruar vula të palexueshme. Gjithashtu për vitet e punës për periudhën 25.01.1995 - 15.04.1996, subjekti nuk rezulton të ketë paguar sigurimet shoqërore.

63. Nga aktet bashkëlidhur dosjes gjyqësore, si dhe nisur nga shkaku ligjor i kërkesëpadisë konstatohet se kërkuesja, e ka bazuar kërkimin e saj në ekzistencën e dokumentacionit ligjor "librezë pune". Konstatohet se objekti i kërkimit është vërtetimi si i rregullt i dokumentit, librezë pune. Këto pretendime kërkuesja i ka ngritur në kuadër të përfitimit e plotë të pensionit të pleqërisë. Konstatohet *prima facie* se mes kërkueses dhe personit të tretë në gjykim ekziston mosmarrëveshje mbi mënyrën e vlerësimit të vërtetësisë së dokumentacionit "librezë pune".

64. Kolegji çmon se thelbi i kërkimeve lidhet me mënyrën sesi organi publik ka konkluduar mbi vërtetësinë e dokumentacionit, me anë të të cilit kërkuesja pretendon ekzistencën e viteve të punës, për efekt të lidhjes së pensionit të pleqërisë. Rezulton se kërkuesja i është drejtuar gjykatës, duke pretenduar njohjen e vërtetësisë së dokumentit, librezë pune, pasi organi e ka refuzuar të njohë përmbajtjen e këtij dokumenti. Konstatohet qartazi se për kërkimet e kësaj natyre gjen zbatim nenit 32 shkronja c dhe jo nenit 388 të KPC-s. Kolegji vlerëson të nevojshme të ritheksojë se gjykimi mbi vërtetësinë e një dokumenti është i ndryshëm, si në aspektin përmbajtësor, ashtu dhe atë formal, nga gjykimi mbi vërtetimin e një fakti juridik.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr.00-2021- 1032, datë 17.05.2021

Çdo mosmarrëveshje gjyqësore që ka lidhje me një objekt të një rëndësie të veçantë i cili administrohet apo përdoret nga organet shtetërore apo entet publike të përcaktuara me ligj, si dhe i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë publikut, përbën mosmarrëveshje administrative dhe lëndë gjykimi për gjykatat administrative.

Organet publike, në veprimtarinë e tyre, mund t'i nënshtrohen regjimit të së drejtës private, në rastet ku marrëdhënia juridike administrative ku ato janë palë, mbart elemente miks mes interesave publike dhe atyre private.

Detyrimin për të respektuar procedurat ligjore dhe formalitetin e lidhjes së kontratave publike apo për të shprehur vullnetin shtetëror prej të cilit lindin të drejta dhe detyrime, e ka organi shtetëror apo enti publik kompetent, i cili gëzon me ligj një pozicion superior ndaj çdo subjekti tjetër fizik apo juridik privat që merr pjesë në cilësinë e operatorit ekonomik, apo palës së interesuar.

Autoritetet publike nuk mund t'u shmangen detyrimeve apo përgjegjësisë ligjore, përfshirë këtu edhe shpërblimin e dëmit apo pagimin e shpenzimeve për punët apo të mirat publike, ardhur si rrjedhojë e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme të tij, për shkak të superioritetit që i ka njohur ligji në ushtrim të vullnetit shtetëror në një fushë të caktuar.

Refuzimi i organit publik për të paguar vlerën e shpenzuar për kryerjen e një punë apo vepre publike si në rastin e një shpronësimi faktik i mohon palës së interesuar çdo pretendim, si në lidhje me pronësinë mbi sendin apo me kundërshtimin gjyqësisht të pavlefshmërisë së procedurës ligjore të ndjekur nga autoriteti kompetent publik, përveç të drejtës për një shpërblim të drejtë për vlerën e sendit në momentin e shpronësimit. Në këtë kuptim, operatori privat ka të drejtë që të kërkojë kthimin e shpenzimit që ka kryer për realizimin e një vepre apo pune publike sipas përcaktimeve të së drejtës private.

I. Rrethanat e Çështjes

1. Ndërmjet palëve ndërgjyqëse në datën 09.07.2002, është lidhur një kontratë sipërmarrjeje, për realizimin e punimeve të ndërtimit dhe rikonstruksionit, në disa ambiente aeroportuale të palës së paditur në aeroportin *"Nënë Tereza"*.

2. Gjatë punimeve për realizimin e objektit sipas kontratës, paditësi pretendon se nga pala e paditur i është kërkuar të kryejë punime shtesë, të cilat janë kryer për një sipërfaqe ndërtimore prej 69.46 m2. Kjo shtesë, së bashku me punimet që përmbante kontrata, i janë dorëzuar palës paditëse.

3. Gjatë gjykimeve është debatuar rreth faktit se midis palëve nuk ka pasur marrëveshje me shkrim, por marrëveshja sipas palës paditëse ka qenë verbale.

4. Pala paditëse "Eurondërtim 2000" sha, në kushtet kur nuk është likuiduar për punimet shtesë të kryera, i është drejtuar në datën 18.01.2005 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë me objekt të sipërcituar, me të cilën ka kërkuar detyrimin e të padituri, shoqëria "Alb Transport" SHA (sot Shoqëria "Prodhim Mobilje" SHA), që t'i kthejë shpenzimet e kryera për punimet e ndërtimit (rikonstruksionit) të kërkuara nga ky i fundit, të ardhurat e realizuara nga përdorimi i objekteve të ndërtuara, si dhe dëmin e shkaktuar nga vonesa në ekzekutimin e këtij detyrimi.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3301, datë 26.05.2005, ka vendosur: Pranimin e padisë si të bazuar në ligj e në prova. [...]

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1167, datë 07.11.2006, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.3301, datë 26.05.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

7. Kundër vendimit nr.1167, datë 07.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs pala e paditur, Shoqëria "Alb Transport" SHA (sot Aeroporti "Nënë Tereza") si dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Tiranë.

8. Gjykata e Lartë Tiranë, me vendimin nr.00-2009-1054 (304), datë 06.10.2009 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.1167, datë 07.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues". [...]

9. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 843, datë 06.05.2010, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.3301, datë 26.05.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

10. Kundër vendimit nr.843, datë 06.05.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs pala e paditur, Shoqëria "Alb Transport" SHA (sot Aeroporti "Nënë Tereza"), e cila ka pretenduar [ndër të tjera] se Gjykata

e Apelit Tiranë nuk ka respektuar ligjin, si dhe ka kryer zbatim të keq të tij. [...] Gjykatës së Lartë i është kërkuar prishja e dy vendimeve të dhëna nga gjykatat më të ulëta dhe zgjidhja në themel e çështjes, duke u vendosur rrëzimi i padisë. [...]

11. Gjykata e Lartë Tiranë, me vendimin nr.00-2014-3127 (320), datë 04.06.2014, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.3301, datë 26.05.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr.843, datë 06.05.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë. [...]

12. Pala paditëse, Shoqëria "Eurondërtim" shpk, nuk ka qenë dakord me vendimin e dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe e ka ankimuar atë pranë Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u mbrojtur, barazia e armëve gjatë gjykimit dhe parimi i kontradiktoritetit. Pala paditëse ka pretenduar se një ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, avokati mbrojtës i saj ka dhënë dorëheqjen dhe për këtë arsye, kjo palë ka kërkuar shtyrjen e seancës. Gjykata e Lartë nuk e ka marrë parasysh këtë kërkesë të palës dhe ka vazhduar gjykimin në mungesë të saj. Vijimi i gjykimit në mungesë të palës së interesuar, është pretenduar si cenim i pasjes së një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, pasi i ka mohuar palës të drejtën e përfaqësimit me avokat.

13. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.73, datë 14.12.2015, ka vendosur: Pranimin e kërkesës. Shfuqizimin e vendimit nr.00-2014-3127, datë 04.06.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

13/1. Kjo gjykatë ka arsyetuar se: *"...Pjesëmarrja e avokatëve të palëve gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë parashikohet nga neni 483 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Sipas këtij neni, pas relatimit të çështjes nga relatori, avokatët e palëve paraqesin mbrojtjen e tyre dhe në të njëjtën seancë mund t'i paraqesin gjykatës mendimet e tyre, shkurtimisht, me shkrim. Ndryshe nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi, ku Kolegji i Gjykatës së Lartë vendos mbi pretendimet e paraqitura me shkrim të palëve, pa praninë e avokatëve, në rastet e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, prania e avokatëve merr rëndësi të veçantë për të paraqitur mbrojtjen e palës që përfaqësojnë, në respekt të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Këto parime i imponojnë Gjykatës së Lartë detyrimin për marrjen e të gjitha masave për garantimin e tyre në mënyrë efektive dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor. Duke pasur parasysh faktin se avokatja e kërkueses kishte dhënë dorëheqjen një ditë përpara seancës gjyqësore, Gjykata çmon se në këto kushte kërkuesja nuk kishte mundësi të siguronte avokat tjetër brenda një kohe kaq të shkurtër. Ky shkak i paraqitur nga kërkuesja ka qenë i arsyeshëm, ndaj Gjykata e Lartë duhej ta shtynte seancën gjyqësore për t'i dhënë mundësi kërkueses të përfaqësohej me avokat, aq më tepër kur edhe seanca paraardhëse ishte shtyrë dhe kërkuesja nuk kishte pasur mundësi të paraqiste mbrojtjen e saj me anë të avokates. Për pasojë, nisur nga rrethanat faktike të çështjes dhe rëndësia që ka e drejta e mbrojtjes në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Lartë nuk ka marrë të gjitha masat për të garantuar të drejtën e mbrojtjes. Rrjedhimisht, pretendimi i kërkueses është i bazuar dhe duhet pranuar..."*.

14. Në kushtet kur çështja ka ardhur për rigjykim nga Gjykata Kushtetuese, ajo ka kaluar direkt në të njëjtën fazë gjykimi që është shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.00-2014-3127 (320), datë 04.06.2014. Pra, kjo çështje është regjistruar në fazën "*seancë gjyqësore*" dhe është caktuar për t'u shqyrtuar në datën 14.12.2016, seancë e cila nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Çështja është caktuar për t'u shqyrtuar në datën 15.03.2018 dhe sërish kjo seancë gjyqësore nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues dhe papajtueshmërisë që ka pasur për shqyrtimin e kësaj çështjeje relatori i caktuar me short, i cili, ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga shqyrtimi i saj.

15. Çështja gjyqësore është riaktivizuar dhe është caktuar për t'u shqyrtuar në seancë gjyqësore në datën 03.03.2021. Në këtë seancë gjyqësore, përfaqësuesi ligjor i palës së paditur në këtë gjykim, i bëri me dije gjykatës se Aeroporti "Nënë Tereza" (ish-Shoqëria "Alb Transport" sha) nuk ekziston më dhe sipas vendimit nr.106, datë 02.09.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e këtij subjekti juridik i kanë kaluar shoqërisë "Prodhim Mobilje" SHA. Për këtë arsye, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendim të ndërmjetëm ka vendosur që të bëjë kalimin procedural të palës së paditur në këtë gjykim, duke zëvendësuar subjektin juridik Aeroporti "Nënë Tereza" SHA (ish-Shoqëria "Alb Transport" SHA) me shoqërinë "Prodhim Mobilje" SHA, sipas përcaktimeve të nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim, KPC).

16. Në seancën gjyqësore të datës 07.04.2021, pasi dëgjoi pretendimet e palëve në gjykim, si dhe diskutoi paraprakisht çështjen rreth natyrës lëndore të mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendim të ndërmjetëm vendosi ta kalojë shqyrtimin e kësaj pranë Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë

a) *Në lidhje me procedurën e gjykimit të çështjes në Gjykatë të Lartë*

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson fillimisht të theksojë faktin se, rekursi objekt shqyrtimi rezulton që të jetë ushtruar në vitin 2010, dhe nga ai moment për çështjen nuk ka pasur një vendimmarrje përfundimtare nga ana e kësaj gjykate. Kjo çështje është marrë në shqyrtim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.00-2014-3127 (320), datë 04.06.2014, vendim i cili është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.73, datë 14.12.2015, duke u kthyer sërish për rigjykim pranë Gjykatës së Lartë.

18. Nga momenti i regjistrimit të kësaj çështjeje pranë Gjykatës së Lartë në vitin 2015 dhe deri në muajin mars 2021, kohë në të cilën kjo çështje është caktuar për t'u shqyrtuar, ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe çështja ka vijuar të qëndrojë me statusin "*në gjykim*", pa një vendim përfundimtar. Për këtë arsye, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar të caktojë shqyrtimin e saj me procedurë të përshpejtuar, duke mbajtur në konsideratë se: *(i)* procedurat gjyqësore për shqyrtimin e kësaj çështjeje kanë vijuar për një periudhë kohe relativisht të gjatë; *(ii)* kjo çështje është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor pranë kësaj gjykate për tri herë radhazi, dy herë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga pala e interesuar dhe një herë nga Gjykata Kushtetuese; *(iii)* mos-shqyrtimi i çështjes me një vendim përfundimtar brenda rrugës së zakonshme të gjykimit, ka cenuar standardin kushtetues për të pasur një proces të rregullt ligjor. [...]

21. Bazuar në këto rregullime specifike [sa më sipër], Kolegji ka arritur në konkluzionin se çështja objekt shqyrtimi plotëson në mënyrë kumulative të gjitha kriteret dhe specifikat që janë përcaktuar në Vendimin nr.78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi rezulton tërësisht e provuar se: *(i)* shqyrtimi i kësaj mosmarrëveshjeje i ka kaluar të gjitha afatet e arsyeshme të gjykimit pranë të tri shkallëve të gjykimit. [...]

b) *Në lidhje me përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi dhe shqyrtimi i saj nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*

23. Kolegji vlerëson të rikonfirmojë qëndrimin e mbajtur në vijimësi se, përcaktimi i kompetencës lëndore përbën një kusht të domosdoshëm procedural për të pasur një proces të vlefshëm gjyqësor, i cili përcaktohet ekskluzivisht në Kushtetutë (neni 42), marrëveshjet ndërkombëtare (neni 6 i KEDNJ-së), si dhe nga ligji. Përcaktimi i saktë i çështjes së kompetencës

lëndore të gjykimit, ashtu si edhe përcaktimi i juridiksionit, është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i cili gjendet i sanksionuar në nenin 4, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohet se, "*E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit*". [...]

26. Bazuar në këto detyrime ligjore procedurale, Kolegji, pasi mori në shqyrtim të gjitha aktet e administruara në dosje, dëgjoi pretendimet e palëve në seancë gjyqësore, mori në vlerësim shkakun ligjor të ngritjes së padisë, identifikoi objektin e kërkimit në padi, si dhe analizoi statusin juridik të palëve ndërgjyqëse në këtë gjykim, arrin në përfundimin se mosmarrëveshja objekt shqyrtimi ka natyrë administrative dhe si e tillë, duhet të shqyrtohet nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

27. Konflikti mes palëve është krijuar, për shkak të faktit se pala e paditur në këtë gjykim, ka refuzuar t'i paguajë palës paditëse, shoqërisë "Eurondërtim 2000" SHPK, shpenzimin e kryer për ndërtimin e një sipërfaqeje totale prej 69.46 m², e cila përbën një ndërtim shtesë të ambienteve të reja aeroportuale, të përcaktuara në masën prej 163 m², për të cilat këto palë kishin lidhur kontratën e sipërmarrjes datë 09.07.2002, referuar përcaktimeve të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Refuzimi i palës së paditur për t'i paguar palës paditëse shpenzimin e kryer është bërë me argumentin se: *(i)* për këtë objekt ndërtimor shtesë, nuk është lidhur mes palëve një kontratë shtesë sipërmarrjeje, sipas përcaktimeve të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; *(ii)* ky objekt shtesë nuk është kërkuar prej palës së paditur; *(iii)* për këtë ndërtim nuk janë respektuar formalitet ligjore që përcaktonte ligji i zbatueshëm në momentin e kryerjes së këtij ndërtimi, si dhe kjo shtesë është kryer pa leje ndërtimi referuar përcaktimeve të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën".

28. Pala paditëse në këtë gjykim, ka pretenduar se nga refuzimi i kryer nga pala e paditur i është cenuar një e drejtë e ligjshme, pasi objekti ndërtimor shtesë është kryer në vijim të kontratës së sipërmarrjes që palët kishin lidhur mes tyre, si dhe me shpenzimet e saj. Ky objekt ndërtimor shtesë është pjesë e ambienteve te reja aeroportuale, e cila është marrë në dorëzim nga ana e palës së paditur, përdoret dhe administrohet prej saj, dhe se gjeneron të ardhura, pasi është dhënë me qira tek të tretët. Në kushtet kur pala paditëse ka shpenzuar burimet e saj financiare për ndërtimin e shtesës me sipërfaqe totale prej 69.46 m², ajo i është drejtuar gjykatës me padinë e mbështetur tek parashikimet e nenit 115/dh, 445, 450, 655, 656, 658, 665, 656, të Kodit Civil (në vijim, KC), për të detyruar gjyqësisht anën e paditur që t'i kthejë shpenzimet e kryera për ndërtimin shtesë, punimet shtesë për rikonstruksionin me vlerë 3.458.763 lekë, si dhe të ardhurat nga përdorimi i kësaj pasurie.

29. Kolegji, duke mos u kufizuar vetëm tek dispozitat ligjore që pala paditëse ka përcaktuar në ngritjen e padisë, por duke e marrë në shqyrtim çështjen në të gjithë tërësinë e saj, arrin në konkluzionin se shkaku ligjor i ngritjes së kësaj padie është pikërisht begatimi pa shkak, përkufizimi i të cilit gjendet tek neni 655 i KC-s, në të cilin përcaktohet se "*Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit*".

30. Pavarësisht faktit se kërkimi për begatimin pa shkak përbën në thelb një kërkim me natyrë civile, pasi gjen rregullim ligjor në përcaktimet e të drejtës private (KC), Kolegji mban në vëmendje faktin se mosmarrëveshja objekt shqyrtimi ka lindur si pasojë e refuzimit të Shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha (ish-Shoqëria "Alb Transport" SHA apo ish-Aeroporti "Nënë Tereza" sha) shoqëri aksionare me kapital tërësisht shtetëror, për t'i paguar palës së paditur vlerën që ka shpenzuar për ndërtimin shtesë me sipërfaqe totale 69.46 m². Kjo sipërfaqe është pjesë përbërëse e ambienteve aeroportuale të ndërtuara sipas kontratës administrative të sipërmarrjes të datës 09.07.2002 dhe përbën vepër (punë) publike, sepse i shërben kryerjes dhe ofrimit të një shërbimi publik ekskluziv, sikundër është transporti ajror.

31. Kontrata e sipërmarrjes e datës 09.07.2002, e nënshkruar mes palëve ndërgjyqëse në këtë gjykim, përbën në vetvete një kontratë publike, në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 4, të Kodit të Procedurës Administrative (në vijim, KPA), në të cilën përcaktohet se, "*Kontrata administrative është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik*". Po ashtu, në nenin 119, pika 1, të KPA-s, është parashikuar se, "*Organi publik, për realizmin e një interesi publik, të cilit i shërben, por pa cenuar interesat apo të drejtat e palëve të treta, mund të lidhë një kontratë administrative, nëse plotësohen këto kushte: a) forma kontraktore nuk ndalohet shprehimisht nga ligji ose nuk bie në kundërshtim me vetë natyrën e çështjes administrative; dhe b) organi publik është i autorizuar nga ligji të vendosë për çështjen me diskrecion*".

32. Edhe pse në çështjen objekt shqyrtimi nuk rezulton që mes palëve ndërgjyqëse të jetë lidhur një kontratë apo shtesë kontrate për ndërtimin e sipërfaqes prej 69.46 m², apo të jetë zhvilluar një procedurë prokurimi publik për realizimin e saj, si dhe objekti i kërkimit në padi ka në themel të tij kërkimin për begatim pa shkak, kjo nuk do të thotë që natyra e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi nuk është administrative dhe, për rrjedhojë, jashtë sferës së gjykimit administrativ. Vlen të mbahet në vëmendje

fakti se, organet e administratës publike u nënshtrohen detyrimeve të së drejtës private pa asnjë lloj kufizimi, përderisa ligji i posaçëm dhe KPA-ja nuk parashikojnë një rregullim më specifik.

33. Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, marrëdhënia juridike objekt gjykimi, ka lindur midis një subjekti privat dhe një organi publik, në bazë të një marrëveshjeje të arritur me veprime konkludente. Kriteri ligjor për të konkluduar nëse një kontratë është civile apo administrative nuk mund të jetë vetëm fakti nëse është formësuar sipas një forme të caktuar apo në bazë të një procedure prokurimi publik. Sigurisht që procedura e prokurimit publik është forma me të cilën autoriteti publik kontrakton të drejtat dhe detyrimet sipas ligjit me të tretët dhe kjo procedurë është e rëndësishme, por ajo nuk mund të jetë kriteri i vetëm për kualifikimin e një fakti juridik si kontratë administrative.

34. Një veprim juridik, që përbën kontratë administrative, mund të realizohet faktikisht në mënyrë konkludente edhe pa një formë të caktuar apo edhe pa një procedurë publike të lidhjes së kontratës, qoftë sepse ligji e lejon, por në rastet kur ligji nuk e lejon dhe duke e shkelur atë. Në të dy këto raste nuk mund të konkludohet se veprimi juridik i realizuar në fakt nuk është kontratë administrative kur del e qartë për nga përmbajtja e të drejtave dhe e detyrimeve se veprimi juridik ka krijuar, ndryshuar dhe shuar një marrëdhënie juridike të së drejtës publike (Vendim nr.00-2020-528, datë 12.10.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 00-2021-76, datë 20.01.2021 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

35. Kolegji vlerëson se, ndërtimi shtesë i kryer nga pala paditëse, me sipërfaqe prej 69.46 m², i cili përbën edhe objektin e këtij gjykimi dhe është pjesë integrale e ambienteve të reja aeroportuale me sipërfaqe prej 163 m², ka një rëndësi të veçantë publike dhe shtetërore, si dhe i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë të mirës publike. Për këtë arsye, *çdo mosmarrëveshje gjyqësore që ka lidhje me një objekt të një rëndësie të veçantë, administrohet apo përdoret nga organet shtetërore apo entet publike të përcaktuara me ligj, si dhe i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë publikut, përbën mosmarrëveshje administrative dhe lëndë gjykimi për gjykatat administrative, pavarësisht faktit nëse për të është ndjekur ose jo një procedurë e caktuar me ligj, është lidhur ose jo ndonjë kontratë administrative, apo është nxjerrë ose jo ndonjë akt administrativ i veçantë.*

36. Shprehja e vullnetit të organeve shtetërore apo enteve publike nuk realizohet vetëm nëpërmjet nxjerrjes së një akti administrativ apo lidhjes së një kontrate administrative. Ky vullnet shprehet edhe nëpërmjet kryerjes së veprimeve të tjera administrative, fakt i cili përcaktohet në nenin 3, pika 11, të KPA, në të cilën është përcaktuar se, "*Veprim tjetër administrativ*

është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, që nuk plotëson kriteret për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjell pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitimë". Po ashtu, në nenin 126 të po këtij kodi është parashikuar se "*1. Veprime të tjera administrative, nën regjimin e së drejtës administrative, janë çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, të cilat nuk plotësojnë kriteret për të qenë një akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjellin pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitimë. 2. Veprimi tjetër administrativ, nën regjimin e së drejtës publike, është i ligjshëm nëse është në përputhje me parimet e këtij Kodi dhe brenda kompetencës së organit publik*".

37. Përderisa në çështjen objekt shqyrtimi, themeli i gjykimit lidhet me një vepër publike që e ka origjinën e saj tek një kontratë e mëparshme administrative, pavarësisht se për të nuk është ndjekur procedura ligjore për formalizimin e saj, si dhe përdoret dhe shfrytëzohet nga ana e paditur për të realizuar një shërbim ekskluziv dhe që i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë publikut, mosmarrëveshja objekt shqyrtimi ka natyrë administrative, sipas përcaktimeve të nenit 7, shkronjat "a" dhe "b", të ligjit nr.49/2012 është lëndë gjykimi e gjykatave administrative dhe, për rrjedhojë, është lëndë gjykimi e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

38. Kolegji mban në vëmendje faktin se, padia për begatimin pa shkak, rregullohet nga e drejta private, konkretisht nga nenet 655 e vijues të KC-s. Megjithatë, edhe organet publike, në veprimtarinë e tyre, mund t'i nënshtrohen regjimit të së drejtës private, në rastet ku marrëdhënia juridike administrative ku ato janë palë, mund të mbartë elemente miks, që ngërthejnë sa interesin publik, ashtu edhe interesa të subjekteve në sferën private. Rasti më tipik janë marrëdhëniet juridike që krijojnë kontratat administrative.

39. Në nenin 1, paragrafi i fundit i KPA-s është parashikuar se, "*Për çështjet e parregulluara shprehimisht nga ky Kod për kontratën administrative, zbatohen dispozitat përkatëse të KC të Republikës së Shqipërisë apo të parashikimeve të posaçme ligjore*". Po ashtu, në nenin 1 të ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 "*Për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore të Organeve të Administratës Shtetërore*" është parashikuar se përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës publike rregullohet nga ky ligj dhe nga dispozitat e KC-s. Në të tilla raste, janë normat e së drejtës publike të cilat thërrasin për zbatim normat e së drejtës private, për shkak të karakterit të posaçëm të këtyre marrëdhënieve juridike. E megjithatë, zbatimi i dispozitave të KC-s për regjimin e marrëdhënies juridike, ku njëra

nga palët është organ administrativ, nuk mjafton për të konkluduar se ajo është e natyrës tërësisht private dhe se shteti sillet si subjekt i së drejtës private. Të dyja marrëdhëniet juridike të sjella në vëmendje më sipër, pavarësisht zbatimit në mënyrë komplementare të KC-s, ligji nr.49/2012 i ka përfshirë në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

40. Kolegji vlerëson se, marrëdhënia juridike e begatimit pa shkak, sipas nenit 655 të KC-s, ku njëra nga palët është organ i administratës publike, i cili ushtron veprimtarinë si subjekt i së drejtës publike, në doktrinën juridike (sikurse do të merret në analizë në vijim) është kualifikuar si quasi-kontratë administrative dhe, si rrjedhojë, mosmarrëveshjet që burojnë prej kësaj marrëdhënieje do të përbëjnë lëndë gjykimi nga gjykatat administrative.

41. Në rastin konkret, pavarësisht faktit se pala e paditur në këtë gjykim është e organizuar si një shoqëri anonime, e cila vepron sipas përcaktimeve të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ajo ka si objekt të veprimtarisë së saj "*kryerjen e shërbimeve aeroportuale, përpunimin e avionëve, shërbimin e pasagjerëve, bagazheve dhe mallrave, shërbimin e sigurisë së aeroportit, etj.,.*". Kjo veprimtari rezulton të ketë karakter ekskluziv dhe rëndësi të veçantë publike, pasi pala e paditur është ngarkuar me ligj dhe akte të tjera nënligjore që të administrojë dhe menaxhojë ambientet aeroportuale, si dhe të ofrojë shërbimet në fushën e transportit ajror në aeroportin e vetëm ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë, i cili, ka rëndësi të veçantë publike dhe strategjike për vendin. Për këtë arsye, veprimtaria e kryer nga pala e paditur në këtë gjykim, përveç përcaktimeve të ligjit tregtar, akteve ligjore mbi bazën e të cilave është krijuar dhe funksionon ajo, i nënshtrohet edhe regjimit të së drejtës administrative, në kuptim të nenit 1, paragrafët 4 dhe 5, i KPA-s në të cilin përcaktohet se, *"...Parimet e përgjithshme të këtij Kodi, me ligj, mund të bëhen të detyrueshme për zbatim edhe për veprimtarinë e subjekteve private kur këto veprimtari kanë efekte për interesat publike. Ky Kod zbatohet për personat fizikë dhe juridikë, të cilëve u është dhënë e drejta e ushtrimit të detyrave dhe kompetencave publike me ligj, akt nënligjor ose kontratë..."*.

42. Për sa më sipër, pala e paditur nuk është thirrur në këtë gjykim nën cilësinë e një personi juridik që është organizuar dhe vepron në regjimin e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Shoqëria "Prodhim Mobilje" SHA është thirrur në këtë gjykim në cilësinë e autoritetit (entit) publik kompetent, sepse nëpërmjet refuzimit për t'i shlyer palës paditëse shpenzimin që ka kryer për ndërtimin e sipërfaqes shtesë prej 69.46 m², e cila është pjesë e ambienteve aeroportuale në administrim dhe përdorim të tij, e ka cenuar palën paditëse në një të drejtë të ligjshme, pasi në kuadrin e veprimtarisë së saj tregtare, pala paditëse ka

përdorur burimet e saj financiare për kryerjen e këtij ndërtimi shtesë.

43. Shoqëria "Eurondërtim 2000" shpk ka lidhur kontratë sipërmarrjeje me palën e paditur sipas përcaktimeve të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", si dhe e ka vijuar këtë marrëdhënie juridike me palën e paditur, duke ofruar shërbimin, punën dhe mjetet e saj financiare për ndërtimin e një vepre publike, me qëllim përfitimin dhe jo për të financuar rritjen e aseteve të palës së paditur. Për këtë arsye, mosmarrëveshja objekt shqyrtimi ka natyrë administrative edhe për sa i përket statusit juridik të palës së paditur në këtë gjykim.

44. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji vlerëson të theksojë faktin se, është parim i gjithëpranuar tashmë se çështjet paragjykimore si, juridiksioni apo kompetenca lëndore janë çështje që përcaktohen që në fillim të shqyrtimit të çështjes gjyqësore dhe nuk mund të ndryshojnë deri në përfundimin e saj me një vendim përfundimtar (*in limine litis)*, pavarësisht ndryshimeve të mëvonshme që mund t'u bëhen ligjeve procedurale gjyqësore (*perpetuatio fori*).

45. Megjithatë, Kolegji, në respektim të praktikës gjyqësore tashmë të unifikuar, është i detyruar që të mbajë në vëmendje dhe të zbatojë qëndrimin unifikues që kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin nr.3/2013, në të cilin është përcaktuar se, "*Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr. 49, datë* 03.05.2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma.".*

46. Rezulton e provuar se rekursi objekt i këtij gjykimi, është paraqitur në Gjykatën e Lartë në datën 31.05.2010, pra përpara datës 04.11.2013 dhe, për këtë arsye, në kushtet kur natyra e çështjes objekt shqyrtimi është administrative, ajo duhet të shqyrtohet nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

c)*Në lidhje me shkaqet e paraqitura në rekurs dhe zgjidhjen e çështjes*

47. Në lidhje me shqyrtimin e rekursit, fillimisht Kolegji vlerëson të theksojë faktin se, në ligjin nr. 49/2012 nuk ka asnjë parashikim ligjor procedural të posaçëm, në lidhje me shqyrtimin e çështjeve administrative

të cilat kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për këtë arsye, do të zbatohen dispozitat e KPC-s, të cilat janë komplementare në raport me ligjin nr.49/2012, sa herë që ky i fundit nuk parashikon ndryshe (*shih, neni 1/2 i ligjit*). Kolegji vlerëson se rekursi do të shqyrtohet në përputhje me parashikimet ligjore procedurale që kanë qenë në fuqi në momentin e paraqitjes së tij. Ky qëndrim i Kolegjit gjen mbështetje tek parashikimet e nenit 109 të ligjit nr. 38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, "KPC i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, që ka qenë në fuqi në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga Gjykata e Lartë, në të cilin është parashikuar shprehimisht se, "Çështjet civile, që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë; 2. Çështjet civile, që shkojnë për gjykim në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të gjykohen sipas dispozitave ligjore, që janë në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit ose të rekursit".

48. Rekursi i paraqitur nga pala e paditur shoqëria "Prodhim Mobilje" sha nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-s, të cilat, i bëjnë të cenueshme vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta. Kolegji, çmon të theksojë se nga dy gjykatat është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes, është identifikuar drejtë thelbi i mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, janë identifikuar drejt dispozitat e ligjit material dhe atij procedural të zbatueshëm, si dhe është bërë interpretim i drejtë i këtyre normave ligjore.

49. Me vendimin nr.843, datë 06.05.2010, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është pranuar padia e paraqitur nga shoqëria "Eurondërtim 2000" SHPK, me arsyetimin se: *(i)* midis palëve nuk ka pasur marrëveshje me shkrim për kryerjen e ndërtimit shtesë në masën totale 69.46 m², por ka pasur marrëveshje verbale; *(ii)* pala paditëse "Eurondërtim 2000" shpk ka kryer ndërtime shtesë mbi bazën e një projekt-planimetrie të parashikuar në planin e financimit të anës së paditur, të cilat janë njohur dhe pranuar nga pala e paditur; *(iii)* shtesat e kryera nga pala paditëse janë pjesë përbërëse e ambienteve të reja aeroportuale, duke përbërë në këtë mënyrë objekt të rëndësisë së veçantë. *(iv)* bazuar tek neni 655 të KC-s, është detyrim i palës së paditur të paguajë koston për ndërtimin e këtyre ambienteve, duke mbajtur parasysh faktin se këto ndërtime shtesë janë pjesë e ambienteve aeroportuale, të cilat përbëjnë objekt të një rëndësie të veçantë; *(v)* neni 655 i KC-s nuk ka parashikuar ndonjë formë të caktuar të veprimit juridik për kthimin e humbjeve të pësuara.

50. Pala e paditur nuk ka qenë dakord me këtë vendim, duke pretenduar në rekurs se: *(i)* padia e ngritur nga pala paditëse nuk qëndron dhe nuk përbën mjetin e duhur ligjor për të drejtën që pretendon pala paditëse; *(ii)* pala e paditur nuk ka asnjë shkak ligjor që t'i paguajë shoqërisë "Eurondërtim 2000" SHPK, vlerën e shpenzuar për ndërtimin shtesë prej 69.46 m², pasi mes palëve nuk është lidhur asnjë kontratë apo marrëveshje me shkrim, si dhe nuk është ndjekur asnjë procedurë prokurimi publik, sipas përcaktimeve të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; *(iii)* kontrata e lidhur mes palëve në datë 09.07.2002, është rrjedhojë e ndjekjes së procedurave të prokurimit publik, e cila ka përfunduar së realizuar, pasi ndërtimi prej 163 m² është realizuar dhe dorëzuar nga pala paditëse, si dhe pala e paditur ka bërë likuidimin e vlerës së kësaj kontrate; *(iv)* ndërtimi shtesë i kryer nga shoqëria "Eurondërtim 2000" shpk, nuk është kërkuar prej palës së paditur, pasi nëse kjo palë do të kishte pasur një kërkesë të tillë do të kishte qenë e detyruar që të ndiqte përcaktimet e ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, duke lidhur kontratën përkatëse apo shtesë të kontratës së datës 09.07.2002, gjë e cila nuk rezulton të ketë ndodhur; *(v)* ndërtimi i kësaj shtese nga ana e palës paditëse është bërë pa leje ndërtimi, gjë e cila vjen tërësisht në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën".

51. Pala paditëse ka prapësuar pretendimet e ngritura në rekurs nga pala e paditur, duke pranuar faktin se mes palëve ndërgjyqëse nuk është formalizuar shprehja e vullnetit për kryerjen e ndërtimeve shtesë, nëpërmjet në kontrate të re apo shtese kontrate. Megjithatë, mes këtyre palëve ka pasur marrëveshje verbale për të kryer punimet shtesë, tej asaj që kishte përcaktuar në kontratën fillestare të sipërmarrjes së lidhur mes tyre në datën 09.07.2002. Këtë pretendim, pala paditëse e ka mbështetur tek këto akte shkresore të pranuara nga gjykatat më të ulëta si: *(i)* relacioni teknik mbi domosdoshmërinë e shtesës për ambiente aeroportuale të nënshkruar nga Drejtoria Inxhinierike e shoqërisë "Alb Transport" SHA, së bashku me planimetrinë e kësaj shtese, të muajit korrik 2002 (faqja 60 dhe 61 e dosjes gjyqësore); *(ii)* preventivët për ndërtimin dhe përshtatjen e ambienteve ekzistuese për shoqërinë "Alb Transport" SHA, nënshkruar nga ing. A.S., punonjës i palës së paditur dhe administratori i shoqërisë "Eurondërtim 2000" SHPK(faqja 62 dhe 63 e dosjes gjyqësore); si dhe *(iiii)* specifikimet teknike dhe preventivi i punimeve shtesë të hartuara nga ing. A.S., punonjës i palës së paditur (faqja 64-65 e dosjes gjyqësore).

52. Gjithashtu, pala paditëse ka pretenduar gjatë gjykimit se pala e paditur, edhe pse i ka marrë në dorëzim këto ndërtime shtesë dhe i ka vënë në përdorim dhe shfrytëzim ato, ka refuzuar që t'i kryejë kësaj pale

pagimin e shumës së shpenzuar për ndërtimin e ambienteve shtesë, sipas vlerës dhe përcaktimeve teknike që ka hartuar po vetë ajo. Pala paditëse parashtroi para gjykatës se qëndrimi i mbajtur nga pala e paditur vjen në kundërshtim me vetë qëndrimin që kjo palë ka mbajtur në shkresat e saj me nr.1683 prot., datë 16.08.2002 dhe me nr.1815 prot, datë 20.09.2002, drejtuar shoqërisë "Albanian Airline" (*shih, faqet 53-54 dhe 75-76 të dosjes gjyqësore*), në të cilat është përcaktuar qartë se shoqëria "Albanian Airline" nuk do t'i paguante palës së paditur qiranë për periudhën kohore shtator-tetor 2002, pasi kjo vlerë qiraje do të përdorej për likuidimin e shoqërisë "Eurondërtim 2000" SHPK, e cila kishte realizuar ndërtimin e ambienteve shtesë sipas kërkesave të anës së paditur dhe shoqërisë qiramarrëse. Për këtë arsye, shoqëria "Albanian Airline" vlerën e qirasë që duhet t'i paguante palës së paditur për këtë periudhë kohore, duhet t'ia kishte kaluar shoqërisë paditëse në këtë gjykim si likuidim për ndërtimet shtesë të kryera prej saj.

53. Në lidhje me thelbin e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, Kolegji vlerëson të ndalet në tri çështje themelore që janë të nevojshme për t'u trajtuar në këtë gjykim, të cilat konsistojnë në: *(i)* shprehja e vullnetit të organeve shtetërore apo enteve publike, nëpërmjet të cilave lindin të drejta dhe detyrime për subjektet e tretë privatë, a duhet të jetë domosdoshmërisht në formë të shkruar, me qëllim provueshmërinë e tij; *(ii)* a mund të përjashtohet organi shtetëror apo enti publik nga detyrimi për të paguar shpenzimin e kryer nga subjektet private për kryerjen e një pune, vepre apo shërbimi publik, për shkak se nuk është respektuar procedura e përcaktuar në ligjin nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, apo kjo procedurë e ndjekur është e pavlefshme; *(iii)* a duhet t'i nënshtrohen organet shtetërore apo entet publike regjimit të së drejtës private, në rastin kur gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre cenohen interesat ligjore të subjekteve privatë dhe ligji i posaçëm nuk ka të parashikuar një rregullim specifik për rregullim e këtyre pasojave.

54. Kolegji çmon të nevojshme të theksojë edhe njëherë faktin se, veprimtaria e organeve të administratës shtetërore apo enteve publike shprehet nga tërësia e veprimeve që ato kryejnë dhe përmes të cilave, ato shprehin qartë vullnetin e tyre si dhe ekzekutimin e këtij vullneti (neni 3, pika 12, e KPA-s).

55. Në rastin objekt shqyrtimi, shprehja e vullnetit të palës së paditur, pavarësisht faktit se nuk është manifestuar nëpërmjet nxjerrjes së një akti konkret administrativ apo lidhjes së një kontrate administrative (apo shtese të saj), është shprehur qartësisht me veprime të tjera administrative që kjo palë ka kryer në kuptim të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", konkretisht nenit 13, i titulluar "Procedura parakualifikuese" dhe

nenit 14 "Specifikime teknike", i ndryshuar, (dispozita ligjore në fuqi në momentin e lindjes së mosmarrëveshjes), sikundër janë: *(i)* relacioni teknik mbi domosdoshmërinë e shtesës për ambiente aeroportuale të nënshkruar nga Drejtoria Inxhinierike e Shoqërisë "Alb-Transport" SHA; *(ii)* preventivët për ndërtimin dhe përshtatjen e ambienteve ekzistuese për shoqërinë "Alb-Transport" SHA, nënshkruar nga përfaqësuesit e të dyja palëve; *(iii)* shkresat drejtuar shoqërisë "Albanian Airline" me nr.1683 prot., datë 16.08.2002 dhe me nr.1815 prot, datë 20.09.2002, përmbajtja e të cilave është pranuar në mënyrë të plotë nga palët ndërgjyqëse në këtë gjykim, si dhe nga dy gjykatat më të ulëta.

56. Për sa më sipër, pretendimi i ngritur në rekurs nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit se padia duhet të rrëzohet, pasi midis palëve nuk ka asnjë marrëveshje me shkrim apo kontratë të lidhur mes tyre dhe, për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë lloj shkaku ligjor që të kryhet pagesa e pretenduar, është i pabazuar në ligj dhe në aktet e fashikullit të gjykimit.

57. Kolegji vlerëson se kontratat administrative janë veprime juridike të dyanshme, formale (*ad substantiam*). Ligji i posaçëm, për lidhjen e tyre ka parashikuar një procedurë të caktuar dhe se forma shkresore e tyre është kusht që përcakton edhe vlefshmërinë e kontratës, në kuptim të nenit 83/2 të KC-s.

58. Kështu, në ligjin nr.7971, datë 26.07.1995 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, kontratat publike (administrative) përkufizohen si kontratat me shpërblim, të lidhura nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj.

59. Nga ana tjetër, një veprim juridik i pavlefshëm për shkak të formës apo për shkaqe të tjera të parashikuar nga ligji, mund të ketë sjellë pasoja faktike apo materiale për palët e veprimit juridik. Në raste të tilla, referuar dispozitave të përgjithshme të KC-s, mbi veprimet juridike, secila nga palët mund të kërkojë rregullimin e pasojave të pavlefshmërisë, duke u kthyer palët në gjendjen e mëparshme (*restitutio in integrum*).

60. Një nga mjetet që ka secila palë e veprimit juridik, për rikthimin e asaj që ka shpenzuar apo investuar, në favor të një pale tjetër, për një shkak, i cili në kuptimin juridik ka rënë apo nuk ekziston, është edhe padia e begatimit pa shkak, sipas nenit 655 të KC-s, si një marrëdhënie jashtëkontraktore.

61. Në doktrinën juridike shqiptare dhe ndërkombëtare, marrëdhënia juridike që rregullohet nga neni 655 i KC-s është kualifikuar si një quasi-kontratë, që përbën një burim të lindjes së detyrimit. Një padi e tillë mund të ngrihet, qoftë kur midis palëve nuk ka ekzistuar një kontratë e mëparshme, qoftë edhe kur kontrata e lidhur midis palëve është e pavlefshme.

62. Nën një vështrim krahasues, me modele ligjore që kanë shërbyer si bazë për hartimin e KC-s të Republikës së Shqipërisë, Kolegji sjell në vëmendje Kodin Civil të Republikës së Francës, i cili në nenin 1300 ka parashikuar se, "*Quasi-kontratat janë faktet juridike vullnetare të njeriut, prej të cilave lind përgjegjësia civile e atij që përfiton pa pasur të drejtë apo përgjegjësia e autorit të veprimit kundrejt një tjetri*" (përkthim i Kolegjit). Po ashtu, sipas KC-s të Republikës së Italisë, quasi-kontrata përkufizohet si një fakt juridik, veprim i vullnetshëm dhe i ligjshëm, prej të cilit rezulton detyrimi kundrejt një të treti ose një detyrim reciprok midis palëve" (*shih, neni 1140 i KC-s të Republikës së Italisë, përkthim i Kolegjit*).

63. Kodi Civil aktual i Republikës së Shqipërisë nuk jep një përkufizim të quasi-kontratës, por rregullon konkretisht tri kategori të tyre, sikurse janë: begatimi pa shkak (neni 655 i KC-s), gjerimi i punëve të tjerëve (neni 648 i KC-s) dhe pagimi i padetyruar (653 i KC-s). Të tria këto situata janë burim i lindjes së detyrimeve, në kushtet e parashikuara në to.

64. Kolegji vlerëson se, quasi-kontratat, si burim i lindjes së detyrimeve, përbëjnë një koncept miks, midis kontratës dhe shkaktimit të dëmit (*quasi-delikteve*). Në doktrinën juridike ato konsiderohen si fakte juridike të ligjshme dhe vullnetare, prej të cilave, edhe në mungesë të një kontrate, lind një detyrim, në mënyrë të ngjashme me detyrimin kontraktor. Ndryshe nga ky i fundit, i cili merret përsipër me vullnetin e debitorit dhe buron nga përputhja e vullneteve të palëve të kontratës, detyrimi nga quasi-kontrata rrjedh për shkak të ligjit. Nga ana tjetër, ndryshe nga përgjegjësia civile për shkak të dëmit jashtëkontraktor, detyrimi që buron nga quasi-kontrata, nuk e ka bazën nga një fakt i paligjshëm.

65. Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se në rastet ku një marrëdhënie e tillë, i përket fushës të së drejtës publike dhe ku palë është një organ i administratës publike, në doktrinën juridike ndërkombëtare, është vlerësuar se jemi para një quasi-kontrate administrative, si një koncept i ndërmjetëm midis kontratës administrative dhe dëmit jashtëkontraktor nga organi i administratës publike. Konkretisht, në doktrinë, evidentohen tri situata të quasi-kontratave administrative, të cilat kategorizohen përgjithësisht si begatim pa shkak i organit publik: 1) dhënia apo kryerja e diçkaje të dobishme me vullnetin fillestar të organit publik; 2) dhënia apo kryerja e diçkaje të dobishme, e miratuar apo e toleruar prej organit publik; 3) dhënia apo kryerja e diçkaje të nevojshme nën kontrollin e organit publik. Evidentimi i rrethanave të tilla passjell lindjen e detyrimit për organin publik për faktin se ka përfituar diçka apo një dobi publike në dëm të një subjekti tjetër.

66. Në vijim të kësaj analize, Kolegji vlerëson se mungesa e formës së shkruar të kontratës, si dhe mosrespektimi i procedurave të parashikuara sipas ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nuk përbën shkak të ligjshëm dhe të mjaftueshëm për të konkluduar se pala e paditur nuk ka shprehur vullnet në lidhje me kryerjen e ndërtimeve shtesë në masën totale prej 69.46 m².

67. Po ashtu, sikurse u analizua më sipër, edhe pse nuk ka një kontratë në formë shkresore midis palëve dhe, si rrjedhojë është e pavlefshme, kjo nuk e përjashton organin publik nga detyrimi për të paguar paditësin për dobinë publike të marrë prej veprimeve të kryera prej tij. Detyrimi në rastin konkret, nuk buron për shkak të kontratës, e cila mungon, por buron për shkak të marrëdhënies quasi-kontraktore që ka ekzistuar midis palëve, pasi e gjithë veprimtaria dhe punët shtesë të realizuara nga paditësi, janë kryer nën kontrollin, me tolerimin dhe vullnetin fillestar të organit publik, palë e paditur. Shprehja e vullnetit të palës së paditur për t'i hapur rrugë shoqërisë "Eurondërtim 2000" SHPK që të kryente ndërtimin shtesë, është pasqyruar qartësisht në relacionin teknik të hartuar nga Drejtoria Inxinierike, Sektori i Projektimit pranë anës së paditur, i titulluar "*Mbi domosdoshmërinë e shtesës për ambiente aeroportuale*", akt i cili është hartuar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur dhe me vullnet të njëanshëm të palës së paditur.

68. Marrëdhënia juridike mes palëve në çështjen objekt shqyrtimi ka lindur për shkak të parashikimeve të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe është një marrëdhënie juridike me rëndësi të veçantë publike, pasi në themel të saj qëndron ndërtimi i ambienteve të reja aeroportuale në aeroportin "Nënë Tereza", si dhe rikonstruksioni i ambienteve të tjera ekzistuese të tij. Këto ambiente përbëjnë vepër me rëndësi të veçantë publike, pasi janë në funksion të kryerjes së shërbimit të transportit ajror duke i shërbyer në mënyrë ekskluzive dhe të drejtpërdrejtë publikut, si dhe janë pjesë e aseteve të aeroportit të vetëm ndërkombëtar në vend, i cili për këtë fakt, përveç se i shërben të mirës publike konsiderohet si objekt me rëndësi të veçantë dhe strategjike.

69. Kolegji vlerëson se në mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, pala e paditur ka pasur pozicion superior në raport me palën paditëse, pasi ajo, pavarësisht mënyrës së organizimit të saj si një shoqëri anonime që u nënshtrohet dispozitave të ligjit "Për shoqëritë tregtare", ka vepruar në cilësinë e entit kompetent publik, të cilit, me akte të veçanta juridike (statuti i shoqërisë, ligj dhe akte nënligjore) i është njohur e drejta për të administruar, mbikëqyrur apo përdorur ambientet e aeroportit "Nënë Tereza", i cili është aeroporti i vetëm ndërkombëtar në vend. Pikërisht në këtë cilësi, kjo palë ka ndjekur procedurat e prokurimit publik për ndërtimin e ambienteve

shtesë aeroportuale, si dhe ka lidhur kontratën e sipërmarrjes së datës 09.07.2002 me palën paditëse. Për këtë arsye, Kolegji arrin në konkluzionin se, në kuptim dhe zbatim të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, detyrimin për të respektuar procedurat ligjore të këtij ligji, detyrimin për të respektuar formalitetin e lidhjes së kontratave publike apo për të shprehur vullnetin shtetëror prej të cilit lindin të drejta dhe detyrime, e ka organi shtetëror apo enti publik kompetent, i cili gëzon me ligj një pozicion superior ndaj çdo subjekti tjetër fizik apo juridik privat që merr pjesë në cilësinë e operatorit ekonomik, apo palës së interesuar.

70. Në të drejtën publike marrëdhëniet juridike lindin dhe burojnë për shkak të ligjit, jo për shkak të lirisë së vullnetit që palët kanë për të ndërvepruar mes tyre, për të krijuar, ndryshuar apo shuar një marrëdhënie juridike. Për shkak të rëndësisë apo fushës specifike që mbulojnë marrëdhëniet e ndryshme juridike që burojnë nga kontratat administrative, ligjvënësi këto marrëdhënie i ka rregulluar në mënyrë të posaçme dhe të detajuar, zbatimi i të cilave është i detyrueshëm për t'u respektuar nga organi shtetëror apo enti publik i krijuar apo i caktuar me ligj për të ndjekur zbatimet e ligjit të posaçëm, me qëllim që këto marrëdhënie të jenë të vlefshme si dhe të garantojnë mbrojtjen e interesit publik.

71. Nën regjimin e të drejtës publike dhe asaj administrative, manifestimi i shprehjes së vullnetit të autoritetit publik kompetent nëpërmjet formës shkresore (kontratës administrative, akti administrativ, apo një shkrese zyrtare që nuk plotëson kushtet për të qenë kontratë apo akt administrativ, por prej saj krijohen, ndryshohen apo shuhen të drejta dhe detyrime), nuk ka si qëllim provueshmërinë e shprehjes së vullnetit, por vlefshmërinë e shprehjes së këtij vullneti, kur ligji specifik ka parashikuar se ai duhet të shprehet në formë të shkruar. Kolegji çmon të vlerësojë faktin se, autoritetet publike shtetërore për shkak të mbajtjes dhe ushtrimit të pushtetit dhe autoritetit shtetëror të njohur me ligj, nuk kanë nevojë që ta shprehim me shkrim vullnetin e tyre, i cili për shkak të specifikave që ai ka është lehtësisht i dukshëm, i kuptueshëm dhe drejtpërdrejt i ekzekutueshëm. Formalizimi me shkrim i këtij vullneti është vetëm për shkak të vlefshmërisë së tij, në rast se ligjvënësi, për marrëdhënie juridike të posaçme, e ka ngarkuar organin që shprehjen e vullnetit ta kryejë në formë shkresore.

72. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vlerëson se, pala e paditur nuk mund të refuzojë pagimin e vlerës që shoqëria "Eurondërtim 2000" SHPK ka shpenzuar për të ndërtuar një vepër publike, e cila ka rëndësi të veçantë dhe strategjike, me faktin se nuk është respektuar procedura që përcakton ligji nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nuk është respektuar formalizimi i shprehjes së vullnetit nëpërmjet lidhjes

së një kontrate administrative apo shtesës së një kontrate të mëparshme. Mosveprimi i palës së paditur për të ndjekur me rigorozitet procedurat e prokurimit publik për kryerjen e shtesës së ambienteve të reja aeroportuale, si dhe lejimin e subjektit privat shoqëria "Eurondërtim 2000" që të kryejë punime shtesë tej vullnetit të përcaktuar në një kontratë administrative të vlefshme, pa leje ndërtimi si dhe pa nënshkruar një kontratë me shkrim për këtë fakt, nuk përbën shkak ligjor që pala e paditur të përjashtohet nga detyrimi i pagimit të vlerës së shpenzuar për ndërtimin e këtyre objekteve, me arsyen se shprehja e vullnetit nuk është bërë në formë shkresore.

73. Detyrimin për të respektuar dhe ndjekur procedurat strikte ligjore në kryerjen e prokurimit publik apo manifestimit të shprehjes së vullnetit sipas përcaktimeve të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, nëpërmjet lidhjes së kontratave administrative që kanë si objekt ndërtimin e një vepre publike apo kryerjen e një shërbimi me karakter publik sipas përcaktimeve të nenit 5, 7 dhe 10, të këtij ligji specifik, si dhe neneve 119 dhe 124, të KPA-s, e ka organi publik kompetent i përcaktuar me ligj, i cili mban cilësinë e autoritetit kontraktor, pavarësisht sjelljes apo qëndrimit që mban operatori ekonomik i interesuar në kryerjen e këtyre procedurave apo lidhjen e këtyre kontratave.

74. Ligjvënësi, detyrimin për të organizuar, ndjekur dhe respektuar procedurat e prokurimit publik, ia ka ngarkuar autoritetit publik përkatës, i cili ka cilësinë e autoritetit kontraktor, jo vetëm për faktin se këto subjekte mbulojnë në mënyrë të posaçme fushën dhe veprimtarinë ku ato ushtrojnë pushtetin shtetëror, por edhe për të garantuar mbrojtjen e interesit publik, për sa kohë këto procedura përballohen me fonde publike. Ky konkluzion, gjendet i shprehur mjaft qartë në nenin 7 të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar (dispozitë ligjore në fuqi në momentin e lindjes së mosmarrëveshjes mes palëve), i titulluar "Përgjegjësia e entit prokurues", në të cilin është përcaktuar qartësisht se, "*1. Enti prokurues është përgjegjës për prokurime me fonde publike që i vihen në dispozicion duke iu nënshtruar dispozitave të këtij ligji dhe çdo kushti tjetër që përfshihet në rregullat e prokurimit dhe udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik...; 4. Enti prokurues është i detyruar të ngrejë njësinë e prokurimit brenda strukturave të veta, detyrat e së cilës përcaktohen në udhëzimet e Këshillit të Ministrave*".

75. Në lidhje me këtë natyrë mosmarrëveshjeje, Kolegji, vlerëson të sjellë në vëmendje faktin se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Lartë, në lidhje me pagimin e punimeve shtesë të kryera nga operatorët ekonomikë gjatë marrëdhënieve kontraktore që kanë pasur me autoritetet kontraktore (organe shtetërore ose ente publike) të cilat nuk janë përcaktuar në kontratën

e lidhur mes tyre apo për të cilat nuk është ndjekur procedura ligjore sipas ligjit për prokurimin publik, nuk është konstant. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se autoriteti publik duhet të paguajë shpenzimet e kryera për shtesë punimesh edhe kur nuk është respektuar procedura për prokurimin publik të shtesës së punimeve apo lidhjes së kontratës shtesë për këto punime (*shih, vendimi nr.244, datë 09.04.2013 dhe vendimi nr.452, datë 10.09.2013*) duke iu referuar përcaktimeve të së drejtës private, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin strikt se, organi publik nuk mund të paguajë shpenzimet e kryera për punime shtesë apo të paparashikuara në kontratë, për sa kohë nuk është respektuar procedura e prokurimit publik apo nuk është lidhur kontrata sipas ligjit për shtesën e punimeve (*shih, vendimi nr.19, datë 14.01.2014; vendimi nr.227, datë 13.03.2014; vendimi nr.408, datë 25.06.2015; vendimi nr.507, datë 23.09.2015 etj.,*).

76. Bazuar sa më sipër, ky Kolegj, vlerëson se duhet të kryejë një qartësim të praktikës gjyqësore në lidhje me faktin nëse organet shtetërore apo entet publike, në cilësinë e autoritetit kontraktor, kanë detyrimin që të kryejnë pagimin e punimeve shtesë të kryera nga operatorët ekonomikë gjatë marrëdhënieve kontraktore që kanë pasur me njëri-tjetrin, të cilat nuk janë përcaktuar në kontratën e lidhur mes tyre ose për të cilat nuk është ndjekur procedura ligjore sipas ligjit për prokurimin publik. Njësimi i qëndrimit të ndryshëm që ka mbajtur Gjykata e Lartë në lidhje me trajtimin e këtyre lloj çështjeve, si dhe sqarimi i praktikës gjyqësore është jo vetëm i nevojshëm dhe detyrë funksionale e Gjykatës së Lartë, por gjen mbështetje tek qëndrimi që ka mbajtur GJEDNJ-ja, se vendimet e dhëna nga gjykatat më të larta nuk mund të përbëjnë shkak për të pasur paqartësi apo standarde të dyfishta në mënyrën sesi duhet të zbatohet ligji (*shih, çështja Beian k. Rumansië dhe Iordan Iordanov k. Bullgarisë, Remusko k. Polonisë*).

77. Fillimisht, Kolegji çmon të theksojë faktin se në shtetet demokratike, në ndryshim nga shtetet totalitare, shteti i përfaqësuar nga organet e administratës apo entet publike, nuk mund të abuzojë me superioritetin dhe ekskluzivitetin që i është njohur në shumë fusha të ndryshme të jetës publike, ekonomike, tregtare, sociale-arsimore etj., për shkak të garantimit dhe administrimit sa më të mirë të të mirës publike. Në shtetet demokratike, parimi i shtetit të së drejtës ka lidhje me garantimin dhe sanksionimin ligjor se asnjë autoritet shtetëror publik, në ushtrimin e veprimtarisë së tij të rregulluar nga ligji specifik nuk mund të veprojë në kundërshtim me ligjin apo të mos veprojë pa shkaqe të arsyeshme apo të justifikuara nga ligji, për shkak të faktit se ai ka pozicion superior në marrëdhëniet juridike administrative dhe publike ndaj çdo subjekti tjetër privat, juridik apo fizik

të njohur nga ligji themelor (Kushtetuta) apo ligji specifik. Në këtë kuptim, asnjë autoritet shtetëror publik nuk mund t'u shmanget detyrimeve apo përgjegjësisë ligjore që ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme të tij, për shkak të superioritetit që i ka njohur ligji në ushtrim të vullnetit shtetëror në një fushë të caktuar.

78. Në të drejtën tonë administrative është sanksionuar parimi se autoritetet publike në ushtrimin e funksioneve të tyre mbrojnë në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të personave privatë (*shiko, neni 10 i KPA-s*), si dhe këto organe apo punonjësit e tyre mbajnë përgjegjësi për dëmet që iu shkaktojnë personave privatë nëpërmjet (a) marrjes së vendimeve të paligjshme; (b) refuzimit të paligjshëm për të marrë vendime apo për të kryer veprime konkrete; (c) dhënies së informacioneve shkresore të pasakta për personat privatë, si (ç) për çdo shkak apo rast tjetër të parashikuar me ligj (*shiko, neni 14 i KPA-s*).

79. Parimet e mësipërme, gjejnë reflektim si tek neni 46 i ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (dispozitë ligjore në fuqi në momentin e lindjes së mosmarrëveshjes mes palëve), i titulluar "Kundërvajtjet administrative", në të cilin përcaktohet se "1. *Në rastet kur vërehen shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të prokurimit, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë: a) t'i propozojë organit qendror ose vendor marrjen e masave ndëshkuese ndaj personave përgjegjës të entit prokurues, që kanë kryer kundërvajtje administrative; b) të dënojë personat përgjegjës për kundërvajtje administrative me gjobë nga 50 mijë lekë deri në 1 milion lekë. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankesë në gjykatën e rrethit të entit prokurues brenda 5 ditëve nga njoftimi. 2. Titullari i organeve qendrore ose vendore, si dhe titullari i entit prokurues, kur vëren shkelje të këtij ligji dhe të rregullave të prokurimit, ka të drejtë: a) të dënojë personat përgjegjës të entit prokurues për kundërvajtjet administrative me gjobë nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim në Agjencinë e Prokurimit Publik, e cila shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tij; b) të largojë nga detyra personat përgjegjës për kundërvajtjet administrative….",* ashtu edhe tek neni 1 i ligjit nr.8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se: "*Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë, privatë, vendas a të huaj. Përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore rregullohet me dispozitat e këtij ligji dhe të KC-s të Republikës së Shqipërisë*".

80. Bazuar mbi parimet themelore të sipërcituara, Kolegji arrin në konkluzionin se asnjë organ publik, i cili në ushtrim të veprimtarisë së tij cenon të drejta të ligjshme të subjekteve privatë fizikë apo juridikë, nuk përjashtohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit që iu kanë shkaktuar subjekteve të tjerë privatë apo shtetërorë, fizikë apo juridikë, apo nga detyrimi për t'u paguar çdo shpenzim të kryer për realizimin e veprave publike, punëve apo shërbimeve të ndryshme që kanë ofruar në shërbim të të mirës publike.

81. Duke iu rikthyer edhe njëherë çështjes objekt shqyrtimi, Kolegji vlerëson të theksojë se, pala paditëse nuk e ka kryer ndërtimin shtesë të ambienteve aeroportuale për shkak të vullnetit të saj të njëanshëm apo për efekte filantropie. Këtë ndërtim shtesë prej 69.46 m² pala paditëse e ka bërë mbi bazën e përcaktimeve të nenit 1, të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (dispozitë ligjore në fuqi në momentin e lindjes së mosmarrëveshjes mes palëve), i titulluar "Qëllimi i këtij ligji", në të cilin përcaktohet se, "*Ky ligj përcakton rregullat për prokurimet e mallrave, të ndërtimeve dhe të shërbimeve dhe synon: a) të nxisë përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike nga entet prokuruese; b) të nxisë pjesëmarrjen e kandidatëve në procedurat e prokurimit publik; c) të nxisë konkurrencën në prokurim ndërmjet kandidatëve për furnizimin me mallra, për ndërtime dhe për shërbime; ç) të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në prokurim; d) Të sigurojë ndershmërinë, besimin publik dhe arritjen e transparencës në prokurimin publik*", si dhe të kërkesës së ofruar nga pala e paditur, pavarësisht faktit se kjo e fundit nuk ka ndjekur procedurën e përcaktuar në ligjin nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar për të lidhur shtesën e kontratës, dhe as e ka formalizuar këtë vullnet nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të re apo marrëveshjeje shkresore me palën paditëse.

82. Kolegji mban në vëmendje faktin se, manifestimi i vullnetit të organeve shtetërore apo enteve publike gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre publike apo shtetërore, është i dukshëm, i qartë dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm edhe në rastet kur ai nuk shprehet në formë të shkruar, pra nëpërmjet nxjerrjes së një akti administrativ, nënshkrimit të një kontrate administrative, apo kryerjes së një veprimi tjetër administrativ i shprehur në formën e një shkrese të thjeshtë, që nuk ka tiparet e aktit administrativ apo kontratës administrative (pra, veprimeve konkrete si prishja e ndërtimit, shpronësimi faktik, heshtja administrative, etj.,). Në kushtet kur nën regjimin e të drejtës administrative vullneti i organit shtetëror apo entit publik shprehet edhe nëpërmjet formave të njëanshme të veprimtarisë publike në ushtrim të funksionit të tij publik, të cilat nuk përmbushin

kriteret për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative, organet shtetërore apo entet publike nuk mund të shmangen nga përgjegjësia apo përmbushja e detyrimeve që rrjedhin si rezultat i veprimeve të kryera prej tyre apo vullneteve që ato shprehin, e që sjellin pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesa legjitime të subjekteve privatë.

83. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson të theksojë se në rastin objekt shqyrtimi, pala paditëse nuk ka pasur asnjë detyrim që t'i kërkonte palës së paditur kryerjen e procedurave ligjore apo lidhjen e kontratës për ndërtimin e ambienteve aeroportuale shtesë në masën prej 69.46 m², përpara se ajo të kryente realisht këtë ndërtim, gjë e cila ka qenë detyrim ligjor i palës së paditur që t'i kryente këto veprime. Pala paditëse, për shkak të pozicionit inferior që ka në këto lloj mosmarrëveshjesh, nuk ka asnjë lloj detyrimi dhe asnjë lloj mjeti ligjor shtrëngues për t'iu imponuar autoritetit publik shtetëror që të shprehë vullnetin në formën e kërkuar nga ligji, për sa kohë është qartësisht e dukshme dhe e kuptueshme se kjo veprimtari është e ligjshme, në përputhje me parashikimet ligjore të zbatueshme dhe se autoriteti publik shtetëror është duke vepruar brenda kompetencës dhe diskrecionit që i ka njohur ligji. Gjithashtu, në rastin objekt shqyrtimi, shprehja e vullnetit nga ana e shoqërisë "Prodhim Mobilije" sha është demonstruar qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa lënë asnjë lloj dyshimi se ajo do të tërhiqej nga përmbushja e detyrimit për t'i paguar paditësit vlerën e shtesës së ndërtimit në masën prej 3.458.763 lekë, vlerë e cila është përcaktuar prej vetë anës së paditur.

84. Shprehja e vullnetit të palës së paditur, edhe pse nuk përmbush formën e përcaktuar nga ligji nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, ligji mbi bazën e të cilit ka lindur mosmarrëveshja objekt shqyrtimi, përbën shprehje të vullnetit nga ana e autoritetit kontraktues publik nën regjimin e të drejtës administrative, nëpërmjet formës së veprimit tjetër administrativ si dhe ka sjellë pasoja juridike, pasi pala paditëse ka vënë në dispozicion të palës së paditur mjetet e saj financiare për të kryer një vepër dhe punë me interes publik. Kjo shprehje e vullnetit të anës së paditur, pasqyrohet qartësisht në shkresat me nr.1683 prot., datë 16.08.2002 dhe nr.1815 prot, datë 20.09.2002 drejtuar shoqërisë "Albanian Airline", relacioni teknik i hartuar nga Drejtoria Inxinierike, Sektori i Projektimit pranë anës së paditur, i titulluar "*Mbi domosdoshmërinë e shtesës për ambiente aeroportuale*", si dhe në specifikimet teknike dhe preventivin e punimeve shtesë të hartuara nga punonjësit e anës së paditur, të cilët kanë pasur si detyrë të tyre funksionale mbikëqyrjen e punimeve të porositura në kontratën e sipërmarrjes së datës 09.07.2002 për ndërtimin e ambienteve të reja aeroportuale, si dhe menaxhimin dhe administrimin e të gjitha ambienteve aeroportuale që kanë lidhje me shërbimin e udhëtarëve

në Aeroportin "Nënë Tereza".

85. Kolegji çmon të theksojë faktin se, gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor në të dy shkallët e gjykimit, këto akte nuk rezulton që të jenë kundërshtuar nga ana e paditur për pavlefshmëri të tyre apo për falsitet. Pretendimet e palës së paditur se këto akte shkresore janë të pavërteta, pa paraqitur ndonjë akt tjetër shkresor që të kundërshtojë përmbajtjen e tyre, janë të pabazuara në aktet e fashikullit të gjykimit. Për këto arsye, gjykatat me të drejtë kanë arritur në konkluzionin se, pala e paditur jo vetëm që ka pasur dijeni për kryerjen e shtesave të ambienteve aeroportuale, por edhe ka pasur vullnet të shprehur për kryerjen e tyre. Madje, pala e paditur i ka shprehur qartë kërkesat e saj rreth specifikimeve teknike mbi bazën e të cilave duhet të kryhej ndërtimi i ambienteve shtesë, duke përcaktuar: *(i)* hapësirën aeroportuale ku do të kryheshin këto ndërtime (sip. 36 m² dhe 33.75 m²); *(ii)* volumin e punimeve dhe specifikimin e këtyre punimeve; si dhe *(iii)* vlerën monetare që do duhej të paguhej për kryerjen e këtyre ndërtimeve dhe punimeve shtesë, e përcaktuar në vlerën prej 3,458,763 lekë (nga të cilat 945,661 lekë ishte vlera për shtesën prej 36 m2, ndërsa 2,557,385 lekë ishte vlera monetare për shtesën prej 33.75 m2).

86. Nga pikëpamja e doktrinës juridike administrative, Kolegji çmon të theksojë faktin se veprimi tjetër administrativ nuk mund të zëvendësojë dhe nuk mund të nënkuptojë ekzistencën e kontratës administrative apo aktit administrativ. Për këtë arsye, në rastin objekt shqyrtimi nuk ndodhemi para një marrëdhënieje juridike kontraktore mes palëve, por ndodhemi para një marrëdhënieje juridike publike e cila është krijuar si rezultat i shprehjes së vullnetit të anës së paditur nëpërmjet një veprimi tjetër administrativ, i cili ka krijuar të drejta dhe interesa të ligjshme për palën paditëse. Për këtë arsye, ky Kolegj vlerëson se, padia e ngritur nga pala paditëse për begatimin pa shkak sipas parashikimeve të nenit 658 të KC-s, në të cilin përcaktohet se "*Padia për begatimin pa shkak nuk mund të ngrihet kur i dëmtuari mund të ngrejë një tjetër padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar*", është i vetmi mjet juridik që ka pala paditëse për të mbrojtur interesat e saj të ligjshme.

87. Kolegji çmon të evidentojë faktin se, pretendimi tjetër i ngritur në rekurs nga pala e paditur se shtesa e ndërtimit të kryer prej palës paditëse është bërë në kundërshtim me ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, përveçse nuk është i mjaftueshëm për të cenuar vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, vjen edhe në kundërshtim të hapur me parashikimet e këtij ligji.

88. Është i vërtetë fakti që sipas përcaktimeve të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", të ndryshuar, konkretisht nenit 45 të tij, leja e ndërtimit duhet të merret nga subjekti i cili kryen ndërtimin, leje e cila

është e nevojshme për t'u pasur nga subjekti që kryen ndërtime me karakter publik si: impiante të ndryshme, rrugë, ura, porte, aeroporte, autostrada, hekurudha, punime infrastrukture, ujësjellës, kanalizim, tubacione gazi, nafte, avulli, varreza, etj.,. Megjithatë, në këtë rast ligjvënësi ka vendosur kushte ligjore për t'u pajisur me leje ndërtimi. Konkretisht, në nenin 45 të ligjit të sipërcituar, është përcaktuar ndër të tjera se, *"...Leja e ndërtimit i jepet personit juridik ndërtues të licencuar. Si në rastin kur toka është pronë private, ashtu dhe kur ajo është pronë publike, personi juridik ndërtues duhet të paraqesë kontratën e lidhur me pronarin e tokës ose me personin që ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja",* ndërsa në nenin 53 të tij, është përcaktuar se: *"Leja e ndërtimit i jepet kërkuesit të saj sipas formularit nr. 4, pjesë e ligjit, përveç lejeve të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore. Formulari i lejes së ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore miratohet nga ministri përgjegjës.... Për objektet që prokurohen me fonde shtetërore, lejen e ndërtimit e merr organi që miraton fondin, përpara se të japë në sipërmarrje ndërtimin e objektit*".

89. Në analizë të dispozitave ligjore të mësipërme rezulton tërësisht e provuar se ligjvënësi, detyrimin për t'u pajisur me leje ndërtimi për objekte që prokurohen me fonde shtetërore, sikundër ka ndodhur në rastin objekt shqyrtimi, ia ka ngarkuar autoritetit përkatës kontraktor, i cili duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi përpara se të jepte në sipërmarrje ndërtimin objekt shqyrtimi (shtesën e ndërtimit). Ky qëndrim mbështetet edhe në faktin se, ndërtimi i kryer nga shoqëria "Eurondërtimi 2000" SHPK nuk është bërë në kuadrin e një investimi privat mbi pronën e palës paditëse, por është ndërtuar si pjesë e ambienteve aeroportuale të aeroportit "Nënë Tereza", mbi një pronë publike, e cila ka qenë në administrim dhe mbikëqyrje të palës së paditur në këtë gjykim.

90. Kolegji vlerëson të theksojë faktin se, edhe sikur pala paditëse të ishte subjekti i cili duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi për realizimin e ndërtimit shtesë prej 69.46 m², ajo nuk do të kishte mundur dot ta siguronte këtë leje sipas përcaktimeve të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", të ndryshuar. Kjo për faktin se shoqëria "Eurondërtim 2000" SHPK duhet të kishte lidhur paraprakisht kontratën e sipërmarrjes me autoritetin kontraktues, shoqërinë "Prodhim Mobilje" sha (ish aeroporti "Nënë Tereza" SHA, ose ish-shoqëria "Alb Transport" SHA), e cila vetë, duhet që të ishte pajisur me leje për shesh ndërtimi.

91. Në këtë drejtim, refuzimi i palës së paditur për t'i paguar palës paditëse shpenzimin e kryer për një vepër publike, për të cilin nuk është lëshuar leja e ndërtimit nuk qëndron dhe si i tillë, duhet rrëzuar. Pajisja me leje ndërtimi nuk ka qenë detyrim ligjor i shoqërisë "Eurondërtim 2000" SHPK, por ka qenë detyrim ekskluziv i përcaktuar në ligj për palën e paditur, e cila, nuk e ka përmbushur atë. Për më tepër, që në rastin objekt shqyrtimi, pala paditëse nuk ka pretenduar njohjen e të drejtës së pronësisë mbi këtë objekt (ndërtimin shtesë), por ka kërkuar kthimin e vlerës monetare që ajo ka shpenzuar për kryerjen e ndërtimit shtesë, i cili përbën një kërkim që nuk kushtëzohet nga fakti nëse për këtë ndërtim ka pasur ose jo leje ndërtimi.

92. Bazuar në të gjitha argumentet e cituara më sipër në këtë vendim, Kolegji arrin në konkluzionin se mosveprimi në vijimësi i palës së paditur, duke anashkaluar zbatimin e dispozitave të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe dispozitat e ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, në pjesën e pajisjes me leje ndërtimi, janë mosveprime të cilat i kanë sjellë palës paditëse në këtë gjykim cenimin e të drejtave të tij të ligjshme. Në rastin objekt shqyrtimi, pala e paditur ka përvetësuar në mënyrë të paligjshme fondet financiare të një operatori ekonomik privat, i cili, ka shprehur vullnetin për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi publik, por që për shkak të veprimeve të kryera nga pala e paditur rezulton të jetë tërësisht e pavlefshme.

93. Pala e paditur në këtë gjykim nuk mund të pretendojë dhe të mbrohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me arsyen se jemi para një pavlefshmërie absolute të marrëdhënies juridike të krijuar mes palëve, pasi nuk janë respektuar procedurat ligjore si dhe mes tyre nuk është lidhur një kontratë me shkrim, pavlefshmëri të cilën e ka shkaktuar po ajo vetë, duke vepruar në kundërshtim me ligjin apo duke mos vepruar sipas përcaktimeve të ligjit. Shoqëria "Eurondërtim 2000" SHPK rezulton të jetë cenuar në një të drejtë të ligjshme të saj, e cila ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve apo mosveprimeve të palës së paditur në kundërshtim me ligjin, si dhe më pas e refuzimit të saj për t'i paguar kësaj shoqërie vlerën monetare të shpenzuar nga pala paditëse për një vepër apo punë publike, duke përdorur si shkak refuzimi pikërisht pavlefshmërinë e procedurave që i ka krijuar po ajo. Për këtë arsye, pala paditëse ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të saj ligjore sipas përcaktimeve të së drejtës private, në kushtet kur sipas përcaktimeve të ligjit specifik, kjo mosmarrëveshje nuk gjen rregullim.

94. Refuzimi i palës së paditur për t'i paguar palës paditëse vlerën e shpenzuar për një punë apo vepër publike, vlerësohet nga Kolegji si një shpronësim pa ligj dhe faktik i palës paditëse, duke iu mbajtur në mënyrë të paarsyeshme vlera monetare që ajo ka shpenzuar për krijimin e një vepre apo kryerjes së një pune publike, e cila i shërben publikut, përdoret dhe administrohet nga pala e paditur si dhe rezulton të jetë dhënë me qira tek të tretët duke realizuar të ardhura financiare. Në këtë drejtim, për analogji,

Kolegji mban në vëmendje faktin se, ashtu sikurse edhe gjatë procesit të shpronësimit për arsye publike, pala e interesuar nuk mund të kërkojë apo pretendojë që të ruajë pronësinë mbi sendin duke kundërshtuar gjyqësisht pavlefshmërinë e procedurës ligjore që ka ndjekur autoriteti kompetent publik për shpronësimin, por gëzon të drejtën që të kërkojë shpërblimin e drejtë të sendit, i cili përbën në vetvete vlerën e sendit në momentin e shpronësimit, ashtu edhe pala paditëse ka të drejtë që të kërkojë kthimin e shpenzimit që ka kryer për realizimin e një vepre apo pune publike sipas përcaktimeve të së drejtës private (KC), për shkak se pavlefshmëria e procedurave ligjore të përcaktuara sipas ligjit të posaçëm nuk i garantojnë mbrojtjen e kësaj të drejte.

95. Në kushtet kur gjatë gjykimit të kësaj çështje pranë dy shkallëve më të ulëta të gjykimit është provuar se: *(i)* pala paditëse ka qenë në mirëbesim ndaj palës së paditur; *(ii)* ka kryer të gjitha punimet sipas situacioneve dhe specifikimeve teknike të hartuara nga pala e paditur; *(iii)* e ka dorëzuar objektin tek pala e paditur, fakt i cili është pranuar nga palët ndërgjyqëse në këtë gjykim (referojuni edhe shpjegimeve të dhëna në seancën gjyqësore të datës 17.05.2021), Kolegji arrin në konkluzionin se, me të drejtë, të dyja gjykatat më të ulëta e kanë pranuar padinë e palës paditëse, duke e detyruar anën e paditur të paguajë shpenzimin e kryer për ndërtimin e punimeve shtesë në masën prej 4.100.019 lekë; vlerën prej 284.711 lekë, e cila përbën vlerën e dëmit të ardhur nga mosekzekutimi në afat i detyrimit për periudhën shtator-mars 2005 si dhe vlerën e përdorimit të sendeve në masën prej 25.214 $.

96. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në rekurs, Kolegji vlerëson se ato janë pretendime të cilat nuk plotësojnë standardin e përcaktuar në nenin 472 të KPC-s, pasi kanë të bëjnë me mënyrën sesi gjykatat kanë interpretuar apo duhet të kishin interpretuar provat dhe nuk lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural dhe atij material të zbatueshëm.

97. Kolegji vlerëson se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim prej tij, për sa kohë Gjykata e Lartë nuk ka si objekt të shqyrtimit të saj gjyqësor vlerësimin dhe interpretimin e provave, e cila është detyrë e dy gjykatave më të ulëta. Gjithashtu, vlerësohet të bëhet evident fakti se këto pretendime nuk janë ngritur në atë nivel që të japin argumente bindëse se kemi të bëjmë me një hetim të paplotë të çështjes, apo shkelje të rënda procedurale të gjykimit, sa ky i fundit të konstatohet si i pavlefshëm në kuptim të nenit 467 të KPC-s.

98. Për gjithë sa është arsyetuar më sipër në këtë vendim, Kolegji vlerëson se vendimi nr.843, datë 06.05.2010 i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021-1040, datë 14.06.2021

Pavarësisht nga forma, akti administrativ individual është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuar individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Si i tillë, rivlerësimi doganor është akt i qartë vullneti administrativ, është një vendimmarrje administrative me pasoja juridike ndaj subjektit të cilit i drejtohet.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se, pala paditëse Shoqëria "PMA" shpk, është shoqëri tregtare e regjistruar rregullisht në regjistrin tregtar më datë 30.10.2006, me ortak të vetëm Shoqërinë "PMA" SHPK, shoqëri e të drejtës zvicerane, që ushtron aktivitet tregtar, ndër të tjera edhe në fushën e blerjes, shitjes, eksportit dhe importit të produkteve të duhanit. [...]

4. Rezulton se pala e paditur Dega e Doganës Tiranë ka kontabilizuar detyrime importi dhe i janë njoftuar Shoqërisë PMA, sipas nenit 235 të Kodit Doganor. Pala paditëse ka pranuar deklaratat doganore të rivlerësuara si më sipër nga i padituri dhe pas vënies së mallrave të importuara nën regjimin doganor të qarkullimit të lirë, ka shlyer detyrimet e importit, e në këto kushte ka bërë edhe çlirimin e mallrave të importuara.

5. Pala paditëse, pavarësisht shlyerjes së detyrimeve të importit, nuk ka qenë dakord me vlerat doganore të përcaktuara nga Dega e Doganës Tiranë, e për këtë arsye ka paraqitur ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave. Me shkresën nr.15032/1 prot., datë 10.12.2009 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka kthyer përgjigje ndaj ankimit administrativ se *"autoriteti doganor ka respektuar procedurën si dhe ka vepruar në zbatim të legjislacionit doganor."*.

6. Pala paditëse i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë, sipas objektit të saj.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3561, datë 12.04.2012, ka vendosur: *"Rrëzimin e padisë, të palës paditëse Shoqëria "PMA" SHPK, si të pabazuar në ligj"*.

8. Gjykata ka konkluduar në vendimmarrjen e saj se, pala paditëse kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të deklaratave doganore, në një kohë kur të gjitha pretendimet e ngritura nuk rezulton të lidhen me këto dokumente, të cilat nga ana tjetër, janë akte me të cilat një person shpreh vullnetin për të vendosur mallrat nën një regjim të caktuar doganor (neni 8/17 i Kodit Doganor), pra si të tilla nuk mund të konsiderohen akte administrative. Në rastin konkret, nuk rezulton që të jemi as para rastit të parashikuar nga neni 91 i Kodit Doganor, për shpalljen e pavlefshme nga autoriteti doganor të deklaratave doganore të pranuara më parë, dispozitë kjo në të cilën parashikohet se: *"1. Me kërkesë të deklaruesit, autoritetet doganore e shpallin të pavlefshme deklaratën doganore të pranuar më parë, kur deklaruesi paraqet prova që mallrat ishin deklaruar gabimisht për regjimin doganor të treguar në deklaratë ose kur, për shkak të rrethanave të veçanta, nuk justifikohet me vendosjen e mallrave nën regjimin doganor të treguar në deklaratë...". [...]*

9. Kundër vendimit nr.3561, datë 12.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse, Shoqëria "PMA" SHPK, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e padisë , duke parashtruar këto shkaqe: Vendimi i gjykatës është marrë në kundërshtim me ligjin; Gjykata nuk ka bërë dallimin midis deklaratës doganore të përpiluar nga paditësi dhe deklaratës doganore të rivlerësimit nga organi doganor; Deklarata doganore të rivlerësimit nga autoriteti doganor janë akte administrative pasi kanë sjellë pasoja për paditësin; Gjykata ka arsyetuar gabim në lidhje me atë nëse organet doganore kanë shkelur formën dhe procedurën e nxjerrjes së aktit administrativ.

10. Gjykata Apelit Tiranë, me vendimin nr.735, datë 26.03.2013, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr.3561, datë 12.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë"*.

11. Gjykata ka konkluduar në vendimmarrjen e saj se, vendimi nr. 3561, datë 12.04.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë në përputhje të plotë me dispozitat e Kodit Doganor. Gjykata Apelit Tiranë, nuk gjen shkaqe ligjore për të cenuar vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për këtë arsye ky vendim duhet të lihet në fuqi.

12. Kundër vendimit nr.735, datë 26.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur rekurs pala paditëse, Shoqëria "PMA" SHPK, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe të vendimit nr. 3561, datë 12.04.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e padisë, [....]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) çmon të nevojshme të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe pala paditëse ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë e deri në momentin që merret ky vendim. Ndryshimet që ka pësuar së fundmi ligji nr.2012/49 janë thelbësore për rregullat që duhet të ndiqen gjatë procedurës së gjykimit që zhvillon ky Kolegj. Konkretisht, në nenin 9 të ligjit nr.2021/49 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.2012/49, datë 03.05.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", është parashikuar se "Përbërja e trupave gjykues si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.". Pikërisht rregullat e reja të gjykimit që parashikohen për procedurën e gjykimit që duhet të zhvillojë Kolegji Administrativ janë të zbatueshme edhe për rastin në shqyrtim.

14. Konstatohet se rekursi është paraqitur brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditë, të parashikuar në nenin 443, pika 2, të KPC-s. Gjithashtu rekursi i është komunikuar palës paditëse, e cila nuk ka paraqitur kundër-rekurs.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në datë 08.06.2016 ka marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative objekt gjykimi. Kolegji ka vlerësuar se është e nevojshme për shqyrtimin gjyqësor kalimi i çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve ndërgjyqëse.

16. Kolegji vlerëson se, rekursi i palës paditëse, Shoqëria "PMA" SHPK, kundër vendimit nr.735, datë 26.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

17. Kolegji konkludon se, në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë përfshihen vetëm rastet rigorozisht të përcaktuara në nenin 472 të KPC-s, që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit, si dhe me shkeljet e rënda të normave procedurale apo shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore e të administruara gjatë gjykimit, objektit dhe shkakut të padisë, pretendimeve e prapësimeve të palëve, të vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe shkaqeve të rekursit, vlerësohet se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykatat e faktit është rrjedhojë e interpretimit jo të drejtë të kërkesave të ligjit material dhe procedural.

18. Rezulton se Shoqëria "PMA" SHPK ka importuar nga shoqëria "PM Internacional Management", disa mallra, të cilat rezulton t'u jenë nënshtruar detyrimeve doganore të importit, duke përpiluar dhe paraqitur për këtë qëllim deklaratat doganore R-55512, datë 13.11.2009; R-56071, datë 16.11.2009; R-56076, datë 16.11.2009; R-56343, datë 17.11.2009; R-56346, datë 17.11.2009; R-53143, datë 02.10.2009; R-47415, datë 02.10.2009. Dega e Doganës Tiranë, pasi ka shqyrtuar praktikën doganore përkatëse të paraqitur nga ana e palës paditëse ka konstatuar se Shoqëria "PMA" shpk në cilësinë e blerësit dhe Shoqëria "PM Intemacional Management" në cilësinë e shitësit, në zbatim të pikës 55.1 të VKM-së nr.205, datë 13.4.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor" konsiderohen persona të lidhur. Për rrjedhojë, bazuar në metodën e të dhënave të disponueshme, Dega e Doganës Tiranë ka arritur në përfundimin se vlera e transaksionit e përshkruar në deklaratat doganore ishte e papranueshme, duke aplikuar për këtë qëllim vlera doganore më të larta se ato të përllogaritura dhe të përcaktuara në deklaratat doganore të paraqitura nga Shoqëria "PMA" SHPK.

19. Rivlerësimi doganor si akt i njëanshëm i autoriteti doganor, përmban vlerën doganore që sipas këtij autoriteti duhet që të paguajë deklaruesi. Kolegji vlerëson të theksojë se, rivlerësimet doganore, objekt shqyrtimi në këtë gjykim, përbëjnë akte administrative në kuptim të nenit 105 të KPA-s (i cili ka qenë në fuqi në momentin e nxjerrjes së akteve objekt shqyrtimi), në të cilin është pasqyruar se: "*Për qëllimet e këtij ligji, do të konsiderohen akte administrative të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike në raste individuale*". Këto akte, kanë dalë gjithashtu edhe në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 34 të Kodit Doganor dhe nenit 81.2 të VKM-së nr.205 datë 13.03.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor". Në vijim të sa më sipër, aktet objekt shqyrtimi përmbajnë të gjitha ekstremitetet që parashikon neni 106 dhe 107, të Kodi i Procedurës Administrative, për ta konsideruar atë si akt administrativ nga pikëpamja e formës dhe përmbajtjes së tij. Aktet, kanë të përcaktuar qartësisht autoritetin shtetëror që ka nxjerrë aktin, subjektit të cilit iu drejtohen, fakteve që janë bërë shkas për nxjerrjen e aktit, bazën ligjore të aktit nënshkrimin e punonjësit të organit që nxjerr aktin.

20. Kolegji vlerëson se rivlerësimi doganor vlerëson përfundimisht nëse ka vend për të pranuar vlerësimin doganor sipas qëndrimit fillestar të deklaruesit apo duhet të vendoset në një shumë tjetër që e çmon autoriteti doganor. Pikërisht, ky akt i fundit, do të përbënte atë që legjislacioni i sipërcituar e emërton "vendim përfundimtar". Pikërisht, ndaj këtij akti të fundit, deklaruesi ka të drejtën e ankimit administrativ në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Por, nisur nga parashikimet e dispozitave të

sipërcituara, duke pasur parasysh se kemi një "vendim përfundimtar" për t'u dhënë, interpretimi logjik juridik të sjell në përfundimin se ka dhe duhet të ketë edhe një vendimmarrje, një "vendim paraprak", i cili i komunikohet deklaruesit së bashku me arsyet e dyshimit e që sjellin në këtë qëndrim paraprak të njëanshëm të autoritetit doganor. Subjektit deklarues nuk i komunikohen vetëm arsyet e dyshimit por edhe pasojat financiare dhe detyruese për subjektin që vijnë nga ekzistenca e rrethanave të ndryshme të dyshuara përkundrejt atyre të deklaruara (*shih, vendimi nr.514 datë 14.10.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

21. Dispozitat e sipërcituara nuk shprehen për formën dhe elementët që duhet të përmbajë kjo lloj vendimmarrjeje, qoftë paraprake apo përfundimtare. Pavarësisht nga forma, gjithsesi, jemi përpara shfaqjes së vullnetit të qartë administrativ dhe që sjell pasoja juridike imediate ndaj subjektit doganor të cilit i drejtohet. Akti administrativ individual është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Në këto kushte, për sa kohë subjekti doganor ka detyrimin e pashmangshëm të shlyejë vlerën doganore që tregohet në vendimin paraprak (draftin doganor) apo në vendimin përfundimtar, rivlerësimi doganor është akt i qartë vullneti administrativ, është një vendimmarrje administrative me pasoja juridike ndaj subjektit të cilit i drejtohet. Në këtë kuptim, e shprehur në formën e një modulari rivlerësimi doganor apo në një formë tjetër rivlerësimi doganor përmban elementët e nevojshëm për t'u konsideruar akt administrativ, rrjedhimisht ai mund të kundërshtohet në rrugë administrative dhe gjyqësore, sipas procedurave që parashikon ligji.

22. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë gabuar kur kanë vlerësuar se rivlerësimi doganor nuk është akt administrativ. Nisur nga sa parashtrohet më sipër, Kolegji vlerëson se çështja duhet të prishet dhe të kthehet për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me qëllim për të vlerësuar nëse pala e paditur ka realizuar procesin e hetimit administrative në përputhje me kërkesat e ligjit.

23. Në rigjykim gjykata duhet të mbajë në vëmendje se procedimi hetimor duhet t'u përmbahet parimeve dhe standardeve të një procesi të rregullt ligjor. Për të qenë procedim i rregullt, aq më tepër kur ndërhyhet në lirinë e qarkullimit dhe tregtimit të mallrave, sikurse e parashikojnë qartësisht dhe jo rastësisht dispozitat e sipërcituara, veprimet dhe vendimet e autoritetit doganor duhet të respektojnë të drejtën e deklaruesit për t'u informuar, për t'u dëgjuar dhe për të ankimuar veprimet hetimore dhe vendimet administrative që ndërmerren nga autoriteti doganor. Nëse nuk

respektohen hapat dhe veprimet që legjislacioni doganor i parashikon lidhur me rivlerësimin doganor sipas neneve 34, pika 1 dhe pika 2, shkronja a, të Kodit Doganor apo nga pika 81.2 të VKM-së nr.205, datë 13.03.1999, atëherë cenohet në thelb rregullsia e kësaj veprimtarie administrative, duke qenë se cenohet procedura që duhej ndjekur deri në shfaqjen e vullnetit administrativ dhe të akteve të nxjerra prej autoritetit doganor.

Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin, se vendimi nr.735, datë 26.03.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021-1111, datë 12.07.2021

Subjekti i cili e ka fituar titullin e pronësisë, në bazë të një vendimi gjyqësor, akti administrativ apo çdo lloj mënyre tjetër fitimi pronësie të ligjshme, duhet të ketë garancinë që ky titull mund të kundërshtohet vetëm nga pala që legjitimohet dhe vetëm në bazë të procedurës së parashikuar në ligj. Në këtë kuptim, zyrat e regjistrimit të pasurisë nuk mund të kundërshtojnë regjistrimin e titullit të pronësisë, kur ato kryesisht konstatojnë pavlefshmëri të akteve që paraqiten për regjistrim.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet bashkëlidhur dosjes gjyqësore rezulton se, sipas vërtetimit hipotekor të datës 06.01.2011, A.Sh. është pronar i pasurisë me nr.22/55, ndodhur në zonën kadastrale 8641, tip apartament dhe i truallit me sipërfaqe prej 180 m². Këtë pasuri pronari e ka përfituar përmes kontratës së shitblerjes të datës 04.06.1998, prej Entit Kombëtar të Banesave Sarandë.

2. Me kontratën e sipërmarrjes nr.450 rep., nr.320 kol., datë 30.09.2005, A.Sh., pasurinë e mësipërme e ka vënë në dispozicion të palës paditëse për ndërtim, sipas kushteve kontraktore përkatëse.

3. Sipas vërtetimit hipotekor të rrethit Sarandë, të datës 23.09.2004, pasuria me nr.22/15 ndodhur në zonën kadastrale 8641, me sipërfaqe 300 m² truall dhe objekt banesë, rezulton në pronësi të A.M., i cili ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr.308 rep., nr.201 kol., datë 14.09.2005, duke vënë në dispozicion këtë pasuri për ndërtim në favor të palës investitore [...]

4. Pala paditëse ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim ZVRPP) Sarandë në datën 21.06.2011, për regjistrimin e objektit "Godinë banimi 7 kate", të ndodhur në lagjen nr. 4, Sarandë. Bashkëlidhur është dërguar dokumentacioni i mëposhtëm: "Leja e legalizimit nr.6844, datë 07.06.2011 e ALUIZNI-t, Vlorë, genplan, ortofoto digjitale, regjistri i parcelës ndërtimore, kartelë e pasurisë së paluajtshme të legalizuar, projekt sipas përditësimit për legalizim dhe akt kolaudimi".

5. Pala e paditur, ish ZVRPP Sarandë, me urdhrin nr.1022, datë 07.11.2011 ka refuzuar kërkesën e subjektit "I" shpk, për regjistrimin e objektit "Godinë banimi 7 kate", ndodhur në lagjen nr. 4, Sarandë.

Pala paditëse ka ushtruar ankim në ish Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Kjo fundit me urdhrin nr.1026, datë 21.12.2011 ka miratuar refuzimin e regjistrimit fillestar të objektit "Godinë banimi 7 kate", ndodhur në lagjen nr. 4 Sarandë me sipërfaqe 350 m² dhe sipërfaqe të parcelës ndërtimore 480 m². [...]

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr.23-2012-2144 (1023), datë 30.07.2012 ka vendosur*: "1. Pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse, Shoqëria "I" shpk. 2. Anulimin e urdhrit nr.1026, datë 21.12.2011, të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe urdhrit nr.1022, datë 07.11.2011 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive te Paluajtshme Sarandë të marra në kundërshtim me ligjin. 3. Detyrimin e palës së paditur ZVRP të Paluajtshme Sarandë të kryejë regjistrimin e objektit "Godinë banimi shtatëkatëshe" ndodhur në lagjen nr.4 Sarandë, përcjellë ZVRPP Sarandë në bazë të shkresës me nr. 853 prot., datë 16.06.2011 «Dërgim dokumentacioni » të ALUIZNI-t, Vlorë..."*.

8. Në marrjen e këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vlerësuar se *"Urdhrat e palëve të paditura janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 38 të ligjit nr7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme". [...]*

9. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr.56, datë 29.01.2013 ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr.*23-2012-2144 (1023), datë 30.07.2012 *të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë"*.

10. Kundër vendimit nr.56, datë 29.01.2013 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër ka ushtruar rekurs ish Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme [...],

11. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në datë 25.06.2015 ka vendosur: *"Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve ndërgjyqëse."*. Që nga kjo datë nuk rezulton të jetë kryer seancë gjyqësore për vijimin e gjykimit të mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

[...]

14. Kolegji vlerëson se vendimi nr.56, datë 29.01.2013 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër është marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Neni 192, pika 2, i KC-s parashikon: "*Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.".* Neni 38 i ligjit nr.7834, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", parashikon: *"Në rastet kur shteti, personi, fizik ose juridik, ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin, fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë.".*

15. Në analizë të dispozitave të mësipërme, Kolegji vlerëson se për të kërkuar pranë ish-ZVRPP-së regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, subjekti i interesuar duhet të disponojë akte të fitimit të pronësisë që sipas nenit 193 të KC-s të cilat janë: (a) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjesëtimin vullnetar të tyre; b) kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufrukti, përdorimi e bujtjeje, enfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale; c) aktet me të cilat hiqet dorë nga të drejta pasurore të mësipërme; ç) vendimet e gjykatave me të cilat njihet cilësia e trashëgimtarit dhe fitohet pasuria e trashëguar; d) aktet me të cilat krijohet një shoqëri ose një subjekt tjetër i së drejtës që ka në pronësi pasuri të paluajtshme ose gëzon të drejta të tjera reale mbi to; dh) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjesëtimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përmbarimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankand të tyre.

16. Detyrat e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, janë parashikuar shprehimisht në ligj dhe konkretisht këto tagra janë kryesisht të karakterit kontrollues mbi elementët e formës së akteve që paraqiten për regjistrim. Transkriptimi ose regjistrimi nuk është gjë tjetër veçse një mjet i nevojshëm për t'i dhënë publicitet titullit të pronësisë dhe për ta bërë të njohur ekzistencën e tij ndaj të tretëve. Transkriptimi ka funksionin e publikimit deklarativ. Regjimi i transkriptimit ose regjistrimit realizohet përmes mbajtjes së regjistrit publik dhe ka si objekt regjistrimin e akteve që krijojnë, ndryshojnë ose përfundojnë të drejta reale mbi pasuritë e paluajtshme dhe pasuritë e luajtshme të regjistruara. Këtë përfundim kanë arritur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.1, datë 06.01.2009.

17. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr.17/2010, në të cilin konkludohet: *"Sipas ligjit, objekt shqyrtimi, ZRPP-ja, është ngarkuar me mbajtjen e regjistrit*

publik, në të cilin pasqyrohet pronësia mbi një pronë të paluajtshme dhe transferimet e ndryshme që i bëhen asaj. Me qëllim kryerjen e transaksioneve të vlefshme të transferimit të pronësisë kërkohen elementë të natyrës publike siç janë forma noteriale dhe regjistrimi në regjistrin e pronës. Në vlerësimin e Gjykatës, regjistri publik i regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të jetë një regjistër i sigurt dhe i besueshëm. Roli i tij në sistem është i një rëndësie themelore duke pasur parasysh se përmes tij ngurtësohen të drejta subjektive. Mungesa e besueshmërisë në regjistrin publik sjellë pasiguri në qarkullimin civil. Gjykata vlerëson se krijimi i një gjendjeje pasigurie juridike në këto regjistra nuk mund të korrigjohet me zgjidhje që imponojnë veprime po aq të pasigurta, siç është fshirja e regjistrimit që kryhet nga Kryeregjistruesi. Kthimi në gjendjen e ligjshmërisë të situatës në të cilën gjendet regjimi i pronës, nuk mund të bëhet me mjete jo ligjore".

18. Lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi Kolegji vlerëson se ndonëse aktet e organeve të urbanistikës nuk përbejnë akte fitimi pronësie, ato legjitimojnë ndërtimin e ri për efekt regjistrimi, i cili në rastin konkret është legalizuar përmes lejes së legalizimit nr.6844, datë 07.06.2011 dhe për të cilën origjina e pronës provohet përmes akteve hipotekore të pronësisë dhe marrëdhënia e palës paditëse me pronarët e truallit bazohet në kontratat e sipërmarrjes të administruara në dosjen gjykimore.

19. Kolegji çmon se nëse pranë ZRPP-së paraqiten për regjistrim akte të cilat përmbajnë tituj pronësie mbi sende të paluajtshme, ato kanë detyrimin vetëm të kontrollojnë nëse aktet e paraqitura përmbajnë elementët formalë të përcaktuar nga ligji dhe, në rast se këta elementë plotësohen, janë të detyruara të kryejnë regjistrimet përkatëse. Kontrolli në këtë rast ka të bëjë vetëm me verifikimin e anës formale të akteve që paraqiten për regjistrim dhe jo të vlefshmërisë së përmbajtjes së tyre. Ky interpretim është në përputhje edhe me parashikimet e reja ligjore të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën", i cili në nenin 26 parashikon: *"1. Drejtoria vendore, kur konstaton se akti noterial, vendimi i gjykatës apo akti administrativ që përcakton kalimin e pronësisë ose ndryshimin e statutit të saj është i paqartë, pezullon procedurën dhe njofton kërkuesin. Në këtë rast kërkuesit i kërkohet të përcaktojë qartë informacionin e nevojshëm, brenda një afati 30-ditor. 2. Do të konsiderohet informacion i paqartë, për efekt regjistrimi: a) mungesa e identitetit ose mospërputhje me identitetin në kartelën e pasurisë; b) mospërcaktimi i pronës në kufij, sipërfaqe dhe në pozicion gjeografik të saktë. 3. Në rast se pronari nuk arrin të saktësojë këtë informacion, drejtoria vendore e ASHK-së, me urdhër të drejtorit, refuzon regjistrimin."*.

20. Ligji nuk u njeh zyrave të regjistrimit të drejtën për të kundërshtuar regjistrimin e titullit të pronësisë, kur ato kryesisht konstatojnë pavlefshmëri të akteve që paraqiten për regjistrim. Subjekti i cili e ka fituar titullin e pronësisë, në bazë të një vendimi gjyqësor, akti administrativ apo çdo lloj mënyre tjetër fitimi pronësie të ligjshme, duhet të ketë garancinë që ky titull mund të kundërshtohet vetëm nga pala që legjitimohet dhe vetëm në bazë të procedurës së parashikuar në ligj. Kolegji vlerëson se interpretimi i kundërt, që lidhet me dhënien e kompetencave të tilla zyrës së regjistrimit cenon parimin sigurinë juridike dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

21. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se argumenti i parashtruar nga ana e palës së paditur, se kontrata e shitjes (origjina e pronësisë) nr.167/166, datë 10.06.2002 nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 195 të KC-s dhe nenit 3 të ligjit nr.7980/1995 "Për shitblerjen e trojeve" është i pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se pala e paditur nuk ka autoritet të disponojë mbi vlefshmërinë e titullit të pronësisë, të parashtruar për regjistrim nga subjekti.

22. Gjithashtu, i pabazuar është edhe argumenti për mosregjistrim, për shkak të marrëdhënies së palës së paditur me truallin, lidhur me sipërfaqen 300 m². Nisur nga aktet, bashkëlidhur dosjes gjyqësore rezulton se pala paditëse ka përmbushur detyrimin për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim. Përmes aktit të lejes së legalizimit, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t ka kryer hetimet lidhur me dokumentacionin që provon titullin e pronësisë mbi tokën dhe konkretisht vërtetimet hipotekore nr.105, datë 09.09.2004 dhe nr.330, datë 10.06.1998. Drejtoria e ALUIZNI-t nuk ka konstatuar mangësi në ndërtimin e kryer dhe dokumentacion e paraqitur, duke legalizuar objektin. Gjithashtu konstatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 308 rep., nr. 201 kol., e datës 14.09.2005 është lidhur nga njëri prej investitorëve, konkretisht z. Ll.Zh., i cili rezulton të jetë administratori i shoqërisë paditëse. Kolegji vlerëson se përderisa palët e treta nuk rezulton të kenë kundërshtuar vlefshmërinë e kontratave të sipërmarrjes, pala e paditur nuk mund të konstatojë kryesisht (pa)vlefshmërinë e tyre.

23. Sa u përket pretendimeve të Avokaturës së Shtetit, të parashtruara në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë, për prishjen e vendimeve dhe kthimin e çështjes për rigjykim, për arsye të mosthirrjes së saj në gjykimin e shkallës së parë dhe në apel, Kolegji vlerëson se shkelje të tilla procedurale nuk është e mjaftueshme vetëm të përmenden, por nevojitet të arsyetohet se çfarë ndikimi kanë për të arritur një përfundim të ndryshëm të çështjes. Rregulli i parashikuar në nenin 40, pika 4, të ligjit nr.49/2012, sipas të cilit

"Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta", evidenton qartazi qëndrimin se jo çdo shkelje procedurale mund ta bëjë procesin të pavlefshëm. Është detyrë e palëve në gjykim që të argumentojnë natyrën e shkeljes dhe se ajo është e asaj rëndësie që nëse nuk do kishte ndodhur, çështja do kishte një përfundim të ndryshëm.

24. Për Kolegjin, ky pretendim i Avokaturës së Shtetit është një interpretim tejet formal, jo vetëm i ligjit, por edhe i Vendimit Unifikues nr.13/2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Duke qenë se pretendimet e ngritura prej saj janë të njëjta me ato të paraqitura nga pala e paditur, së cilës ajo i bashkohet në proces, në të dyja shkallët e gjykimit dhe po ashtu në rekurs, Gjykata e Lartë, nuk ka pengesë për të ushtruar juridiksionin kontrollues dhe rishikues mbi to, duke e zgjidhur përfundimisht çështjen, sipas parimit të respektimit të shkallëve të pushtetit gjyqësor, pasi në lidhje me këto pretendime janë ezauruar të dyja shkallët e pushtetit gjyqësor. Në këtë drejtim Kolegji çmon të sjellë në vëmendje edhe praktikën e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i cili në vendimin nr.1007, datë 21.06.2021 ka vlerësuar se "*Nëse do të zbatohej formalisht dhe mekanikisht, neni 467/ç i KPC-s, Vendimi Unifikues nr. 13/2004 dhe të kthehej çështja në gjykatën e shkallës së parë, në mënyrë që formalisht Avokatura e Shtetit të përsëriste edhe njëherë të njëjtat pretendime, ligji do të shndërrohej në një mjet arbitrar për zvarritjen e pajustifikuar të gjykimit.*".

25. Për sa më sipër, Kolegji konkludon se vendimi nr.56, datë 29.01.2013 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër është i drejtë dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Vendim i Kolegjit Administrativ, nr.00-2021- 1238, datë 12.07.2021

Në rastin e një ometimi relativ, kur ligji është i paqartë, i paplotë ose mungon, por mbi bazën e parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe interpretimit të ligjit, mosmarrëveshja mund të zgjidhet nga Gjykata, që ka për detyrë që, duke interpretuar ligjin në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës, t'i japë zgjidhje çështjes.

I. Rrethanat e çështjes

1. Me shkresën nr.1817, datë 13.05.2009, Komisioni Qeveritar i Tokës pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i ka kërkuar Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore pranë Prefektit të Qarkut Tiranë kryerjen e kontrollit të plotë të akteve të marrjes së tokës në pronësi (në vijim, AMTP) të dhëna në sipërfaqet e tokës jo bujqësore në zonat me përparësi turizmin.

2. Një ndër AMTP-të që i është nënshtruar procedurës së kontrollit dhe verifikimit është edhe AMTP-ja me nr.165, datë 04.01.2004, që i përket shtetases F.Xh., banuese në fshatin Spille, Komuna Kryevidh, Kavajë. Me këtë AMTP, kjo shtetase është pajisur me një sipërfaqe toke prej 6.570 m² tokë arë, të ndarë në dy parcela, e para me nr. kadastral 37, me sipërfaqe 2.860 m² dhe e dyta me numrin kadastral 73, me sipërfaqe 3.770 m². Këto pasuri, kjo shtetase, pasi i ka regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, i ka tjetërsuar tek personat e tretë.

3. Me shkresën nr.1767/2 prot., datë 08.06.2009, Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore pranë Prefektit të Qarkut Tiranë, i ka kërkuar Këshillit të Qarkut Tiranë konfirmimin e zërave kadastralë për disa pasuri. Ky i fundit, i është përgjigjur me shkresën nr.2140/1 prot., datë 24.06.2009, duke konfirmuar se një ndër parcelat tokë arë të përfituara nga e paditura, në datën 01.08.1991 nuk ka qenë e regjistruar në zërin "tokë bujqësore" por ka qenë në zërin "tokë pyll", si dhe tjetra nuk ka qenë në territorin e fshatit Spille por në territorin e fshatit Domen.

4. Ndodhur në këto rrethana, Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore pranë Prefektit të Qarkut Tiranë ka

filluar procedurën administrative për kontrollin dhe verifikimin e titullit të pronësisë të shtetases F.Xh. dhe në përfundim, ky komision ka marrë vendimin nr.81, datë 12.10.2009, duke vendosur pavlefshmërinë e plotë ligjore të titullit të pronësisë në emër të znj. F.Xh., lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Spille, të Komunës Kryevidh, Kavajë.

5. Nga sa më sipër, bazuar në nenin 10 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, "*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*", Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore pranë Prefektit të Qarkut Tiranë i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ, AMTP-së me nr.165, datë 04.01.2004, në emër të të padituërës, shfuqizimin e këtij akti, kthimin e pasurisë në pronësi shtet dhe regjistrimin e saj në emër të pronarit shtet.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.1907 (11-2011-3764), datë 18.07.2011, ka vendosur: *Pranimin e pjesshëm të padisë së palës paditëse, Prefektit të Qarkut Tiranë, kundër të padituërës F.Xh., me persona të tretë ZVRPP Kavajë [...]; Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën ku kërkohet kthimi i pasurisë në pronësi shtet si dhe regjistrimi i saj në emër të pronarit "shtet", si e pabazuar në ligj.*

7. Kundër vendimit nr.1907 (11-2011-3764), datë 18.07.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka paraqitur ankim pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e plotë të padisë. Pala paditëse ka parashtruar në shkaqet e ankimit se, neni 10 i ligjit nr. 9948/2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" parashikohet se kur KV-ja, gjatë verifikimit të dokumentacionit vëren se krijimi i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore është dhënë në kundërshtim me ligjin i paraqet gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës një kërkesë për anulimin e aktit administrativ (AMTP) si dhe objekt i kërkesës të jetë deklarimi i pavlefshmërisë, shfuqizimi i AMTP-së dhe kthimi i pronës në pronësi të shtetit.

8. Kundër vendimit nr.1907 (11-2011-3764), datë 18.07.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka paraqitur ankim Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e plotë të padisë. [...]

9. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.10-2014-251 (67), datë 27.01.2014, ka vendosur: "*Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Durrës për gjykimin e kësaj çështjeje.*".

9.1 Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1464, datë 06.05.2014, ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr.1907, datë 18.07.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pushimin e gjykimit të çështjes.*".

10. Në marrjen e këtij vendimi, në thelb, kjo gjykatë ka arsyetuar se padia vlerësohet e papranueshme në bazë të nenit 10 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, "*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*", pasi kjo dispozitë, në kohën e paraqitjes së padisë, nuk e parashikonte situatën kur prona ishte tjetërsuar tek të tretët dhe ishte në pamundësi për t'u rikthyer në pronësi shtet. Me ndryshimet e prezantuara në këtë ligj me Ligjin nr.58/2012 u parashikuara detyrimi për të përcaktuar vlerën e pronës në bazë të metodologjisë përkatëse, vlerë e cila duhet të kthehej nga përfituesi i pronës në bazë të AMTP-së kur ai e kishte tjetërsuar sendin tek të tretët. Pra, padia e Prefektit të Qarkut Tiranë nuk realizon qëllimin e ligjit. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i cenueshëm për shkak se ka pranuar pjesërisht një padi me kërkime që nuk realizojnë zbatimin e ligjit nga institucioni i Prefektit e që si të tilla çmohen të papranueshme për t'u parashtruar gjyqësisht dhe në bazë të nenit 50/d të ligjit nr. 49/2012 vendimi duhet të prishet dhe të vendoset pushimi i çështjes.

11. Kundër vendimit nr.1464, datë 06.05.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 1907 (11-2011-3764), datë 18.07.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës [....].

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

12. Paraprakisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) çmon të nevojshme të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe pala paditëse ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë e deri në momentin që merret ky vendim. Ndryshimet që ka pësuar së fundmi ligji nr.49/2012 janë thelbësore për rregullat që duhet të ndiqen gjatë procedurës së gjykimit që zhvillon ky Kolegj. Konkretisht, në nenin 9 të ligjit nr.49/2021 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, datë 03.05.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", është parashikuar se "*Përbërja e trupave gjykues si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.*". Pikërisht rregullat e reja të gjykimit që parashikohen për procedurën e gjykimit që duhet të zhvillojë Kolegji Administrativ janë të zbatueshme edhe për rastin në shqyrtim.

13. Konstatohet se rekursi është paraqitur brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, të parashikuar në nenin 443/2 të KPC-s. Gjithashtu rekursi i është komunikuar palës paditëse, e cila nuk rezulton të ketë paraqitur kundër-rekurs.

14. Rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (në vijim, ligji nr.49/2012) që bëjnë te cenueshëm vendimin nr.1464, datë 06.05.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

15. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se padia është e papranueshme, pasi ligji në kohën e paraqitjes së saj nuk e parashikonte si kërkim kthimin e pronës në pronësi shtet. Neni 50, shkronja d), i ligjit nr.49/2012 parashikon se Gjykata Administrative e Apelit vendos prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, në rastet kur çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte. Arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit i referohet rastit kur gjykimi pushohet për shkak se padia nuk mund të ngrihet.

16. Në praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë është parashtruar në vijimësi interpretimi lidhur me institutin procedural të *"padive që nuk mund të ngrihen"*. Në kuptim të nenit 299 shkronja c,[31] të Kodit të Procedurës Civile (KPC), padia nuk mund të ngrihet në rastet e mungesës të parakushteve procedurale, si ekzistenca e gjyqvarësisë (neni 58 i KPC-s); mungesa e zotësisë së palëve (nenet 33 dhe 91, të KPC-s); dhe në raste të mungesës së kushteve themelore të padisë, të tilla si mungesa e legjitimitetit formal dhe interesit për të ngritur padi (neni 184 i KPC-s), si dhe kur e drejta e pretenduar të mbrohet nëpërmjet vendimit të gjykatës nuk është parashikuar në një normë të së drejtës.

17. Në vendimin nr.262, datë 22.05.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndërmjet të tjerave, arsyetohet: *"Rrëzimi i padisë ka vend kur ngritja e padisë e ka një bazë juridike, një shkak ligjor, bazuar në të drejtën objektive, për t'iu parashtruar gjykatës për zgjidhje, pra është një padi që mund të ngrihet dhe i përket juridiksionit gjyqësor, por ajo që kërkohet me padi, në përfundim të gjykimit, nuk arrin të provohet. Po kështu edhe nëse ajo që është e kërkueshme ligjërisht në rrugë gjyqësore, mbi provat e paraqitura, vërtetohet se nuk gjen mbështetje në ligj. Nëse ajo që, konkretisht, paditësi pretendon se i është cenuar apo që duhet t'i njihet, parashikohet nga e drejta pozitive në aspektin material, e akoma më tej, nëse e drejta pozitive i njeh paditësit të drejtën që këtë të kërkojë ta realizojë nëpërmjet gjykatës, atëherë gjykata ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes për të verifikuar nëse ajo që kërkohet konkretisht me padi (në objekt) është e mbështetur edhe në prova e në ligj. E kundërta, nëse ajo që i kërkohet gjykatës nuk gjen mbështetje në të drejtën pozitive materiale, atëherë gjykata pushon çështjen si një padi që nuk mund të ngrihet (neni 468 i KPC-s). Por, nuk kemi të bëjmë me mungesë të së drejtës pozitive materiale, ndaj edhe gjykata nuk e pushon vetvetiu çështjen me motivin se nuk gjen një normë konkrete juridike ligjore të zbatueshme për të drejtën që pretendohet nga paditësi. Kjo sepse mund të ndodhë që ligji (norma juridike) mungon, nuk është i qartë, i plotë, apo është kontradiktor…".*

[31] Ndryshuar me ligjin nr.38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8116, datë 29.08.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", shtuar pika "c", përmbajtja e të cilës zëvendëson nenin 468, tashmë i shfuqizuar.

18. Kolegji vlerëson se rasti kur e drejta e pretenduar të mbrohet nëpërmjet procesit gjyqësor nuk është parashikuar në një normë pozitive të së drejtës, me pasojë pushimin e gjykimit, duhet të dallohet nga rasti kur një pretendim nuk gjen mbështetje ligjore me pasojë rrëzimin e kërkesëpadisë.

19. Kolegji vlerëson se në rastin e një ometimi absolut të ligjit, atëherë kur pretendimi nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore të rendit juridik, pra nuk ekziston e drejta pozitive e pretenduar që mbështet kërkimet e kërkesëpadisë, gjykata do të duhet të vendosë pushimin e gjykimit, ndodhur para një padie që nuk mund të ngrihet. Në rastin e një ometimi relativ, kur ligji është i paqartë, i paplotë ose mungon, por mbi bazën e parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe interpretimit të ligjit, mosmarrëveshja mund të zgjidhet, gjykata në përputhje me nenin 1, pika 2 të KPC-s ka detyrë që duke interpretuar ligjin në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës, t'i japë zgjidhje çështjes.

20. Në mosmarrëveshjen objekt gjykimi, fakti që ligji i kohës (ligji nr.9948/2008) nuk parashikonte si pasojë juridike kthimin e tokës në pronë "shtet", në rastin e tjetërsimit të pasurisë në favor të të tretëve, nuk mund të sjellë pushimin e gjykimit, me arsyetimin se kjo është një e drejtë e papranueshme për t'u parashtruar gjyqësisht. Kolegji vlerëson se një interpretim i tillë cenon të drejtën e aksesit në drejtësi. Kolegji vlerëson se gjykata, duke bërë një interpretim harmonik të ligjit nr. 9948/2008, si dhe në referim të nenit 1, pika 2, të KPC-s do të duhet të kishte zgjidhur mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

21. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi nr.1464, datë 06.05.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit është i pambështetur në ligj dhe, si i tillë, duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, me një tjetër trup gjykues.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr 00- 2021- 1215, datë 15.07.2021

Plotësimi i kritereve formale për fitimin e gradës, si vjetërsia në gradën pararendëse dhe/ose ushtrimi efektiv i funksionit në përputhje me gradën e pretenduar, nuk mund të sjellin fitimin gjyqësisht të gradës policore, pa iu nënshtruar më parë punonjësit e Policisë së Shtetit një procesi vlerësimi konkurrues nga komisioni i gradimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi L.N. me urdhrin nr.900/1, datë 31.12.2001 është bërë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, duke ushtruar detyra të ndryshme përgjatë periudhës 2001-2010, përkatësisht nën gradat "Nëntoger", "Nëninspektor", "Nënkomisar".

2. Me urdhrin nr.3052/1, datë 02.11.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësit rezulton t'i jetë njohur grada "Komisar". Me urdhrin nr.2304 prot., datë 15.10.2015 të Drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi është transferuar përkohësisht në detyrën e shefit të komisariatit, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër. Në vijim, Drejtori i Policisë Vendore Shkodër ka disponuar me urdhrin nr.1364 prot., datë 15.10.2015, përmes së cilit është konfirmuar fillimi i të drejtave administrative dhe financiare të paditësit, përkatësisht në datë 16.10.2015.

3. Me urdhrin nr.452, datë 08.02.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit, është ndërprerë transferimi i përkohshëm i paditësit L.N., duke e transferuar dhe emëruar paditësin në detyrën e shefit të komisariatit, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër. Drejtori i Policisë Vendore Shkodër ka disponuar përmes urdhrit nr.140, datë 09.02.2016 konfirmimin për fillimin e të drejtave administrative dhe financiare të paditësit, përkatësisht në datë 10.02.2016.

4. Në muajin janar të vitit 2017, paditësi i është drejtuar palës së paditur me kërkesën për njohjen e gradës policore "Kryekomisar". Në këtë kërkesë paditësi ka pretenduar se ka kaluar afati trevjeçar i qëndrimit në gradën policore "Komisar" dhe se aktualisht ushtron një funksion të cilit i takon grada "Kryekomisar". Pala e paditur, përmes shkresës nr.159/1-2 prot., datë 09.02.2017 me lëndë "kthim

përgjigje", i ka komunikuar paditësit se në mbështetje të ligjit nr.108/2014 nuk parashikohet marrja e gradës sipas pozicionit të punës dhe se fitimi i gradës së radhës bëhet përmes vlerësimit konkurrues nga Komisioni i Gradimit. Në këtë shkresë pala e paditur fton paditësin të marrë pjesë në konkurrimin e radhës në rast se plotëson kriteret ligjore.

5. Për shkak të mosnjohjes nga pala e paditur të gradës korresponduese "Kryekomisar", paditësi L.N. i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër në datë 15.03.2017, duke pretenduar nëpërmjet kërkesëpadisë objekt gjykimi, detyrimin e palës së paditur t'i njohë gradën "Kryekomisar".

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr.202, datë 05.04.2017, ka vendosur: *"1. Pranimin e kërkesëpadisë; 2. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit t'i njohë paditësit L. N. N. gradën policore "Kryekomisar"…".*

7. Në marrjen e këtij vendimi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, ka vlerësuar: "*Nga mosveprimi i palës së paditur në hapjen e procedurave të konkurrimit për gradën policore "Kryekomisar", paditësit i është mohuar një e drejtë e fituar me ligj, e drejta e mbajtjes së gradës sipas vjetërsisë dhe funksionit që kryen, dhe për këtë fakt çështja objekt shqyrtimi bën pjesë në juridiksionin gjyqësor […]*

8. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit […]

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1812, datë 28.04.2018 ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr.202, datë 05.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër…".*

10. Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka vlerësuar: *"Gjykata e Apelit Administrativ tërheq vëmendjen e palës së paditur mbi faktin se, përparimi në gradë nëpërmjet procesit të konkurrimit, brenda periudhës njëvjeçare, përbën kusht ligjor vetëm për ata punonjës të Policisë së Shtetit, "të emëruar në bazë të vendimit nr.917, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.803, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", të ndryshuar, çka nuk përkon me situatën faktike të paditësit L.N., emëruar me ligjin e ri. Në kohën e shqyrtimit administrativisht të ankesës së paditësit pala e paditur do të duhej të kishte proceduar me disponimin e aktit që i njihte ankuesit gradën "Kryekomisar", në zbatim të kuadrit ligjor ekzistues në fuqi në momentin e shqyrtimit/refuzimit, çka do të kishte shmangur investimin e mëtejshëm të gjykatës në funksion të zgjidhjes së kësaj çështjeje.".*

11. Kundër vendimit nr.1812, datë 26.04.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur brenda afatit ligjor, e cila

përfundimisht ka kërkuar prishjen e vendimit nr. 1812, datë 26.04.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe kalimin e çështjes për shqyrtim gjykatës kompetente. [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

II. Për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me sistemin e fitimit të gradave policore të punonjësve të Policisë në Republikën e Shqipërisë.

15. Pikësëpari, Kolegji sjell në vëmendje se nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore që lidhet me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me objekt njohjen e gradës policore, është konstatuar se praktika gjyqësore e gjykatave administrative për çështje të ngjashme është e ndryshme.

16. Pas shqyrtimit të akteve të fashikullit gjyqësor dhe arsyetimit të gjykatave për çështjen konkrete, pas kryerjes së një analize të plotë të kuadrit ligjor, por edhe të qasjes së praktikës gjyqësore të gjykatave administrative të shkallës së parë, si dhe të Gjykatës Administrative të Apelit në lidhje me çështje të ngjashme me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se shkaqet ligjore të ngritura në rekurs për shkelje të ligjit material e procedural nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit në vendimin nr.1812, datë 26.04.2018 dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, në vendimin nr.202, datë 05.04.2017 janë të një rëndësie themelore, të cilat në mbështetje të nenit 58, shkronja a, të ligjit nr.49/2012 (pas ndryshimeve me ligjin nr.39/2017) përligjin nisjen e procedurës gjykimore për njësimin e praktikës gjyqësore.

17. Për shkak të paqartësisë që është hasur në praktikën gjyqësore lidhur me kufijtë e shqyrtimit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative të organit publik në procesin e dhënies së gradave policore, duke marrë në konsideratë faktin se në Vendimin Unifikues nr.1, datë 29.02.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk u arrit të njësohej praktika gjyqësore, në lidhje me pyetjen e shtruar për unifikim, mbi kriteret ligjore që duhet të merren parasysh për caktimin e gradës së re, në rastin e ekuivalentimit të gradave policore, por edhe duke konstatuar se praktika e mbajtur në ndonjë rast nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nuk ka gjetur pasqyrim në praktikën gjyqësore të gjykatave administrative të të gjitha niveleve, Kolegji vlerëson të domosdoshme që të shtrohet për diskutim interpretimi përfundimtar i dispozitave të ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", konkretisht nenet 50-60 të tij, lidhur me plotësimin e kushteve dhe kritereve që nevojiten për fitimin e gradave policore për punonjësit e Policisë së Shtetit, me synim për të konkluduar me një qëndrim njësues, për këtë çështje.

18. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson të shtrojë për njësim këtë

çështje: *A mund të fitohet gjyqësisht grada policore për shkak të plotësimit të kriterit të vjetërsisë në gradë dhe/ose ushtrimit të funksionit përkatës për gradën e pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së vlerësimit konkurues nga një komision gradimi?*

a) *Analizë mbi kuadrin ligjor*

19. Në përputhje me statusin institucional që u është njohur punonjësve të Policisë së Shtetit me ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" (në vijim, ligji nr.8553/1999), u miratua ligji nr.8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit" (në vijim, ligji nr.8643/2000), në të cilin u konfiguruan rishtazi gradat policore, si shprehje e hierarkisë së punonjësve të policisë. Ligji nr.8643/2000 parashikonte se gradat policore fitohen sipas arsimit dhe kualifikimit profesional, vjetërsisë në shërbim, duke përfshirë edhe periudhën e mëparshme të shërbimit ushtarak të kohës (sipas parashikimeve të ligjit nr.8553/1999) dhe karrierës në strukturat policore. Ligji nr.8553/1999 dhe ligji nr. 8643/2000 u shfuqizuan përmes ligjit nr.9749/2007 "Për Policinë e Shtetit" (në vijim, ligji nr.9749/2007) dhe ky i fundit rezulton të jetë shfuqizuar përmes nenit 144 të ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit" (në vijim, ligji nr.108/2014), që aktualisht është në fuqi.

20. Në pasqyrim të ndryshimeve ligjore, si më sipër, ka evoluar edhe qasja e legjislatorit lidhur me njohjen dhe fitimin e gradës policore. Ligji nr.9749/2007 shënoi kalimin në një sistem të ri gradash policore, duke detajuar ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë në raport me ushtrimin e gradës. [...]

23. Në analizë të dispozitave ligjore dhe nënligjore të mësipërme Kolegji vlerëson se procedura e fitimit të gradës policore sipas ligjit nr.9749/2007, pas kalimit në sistemin e ri të gradave, realizohet ekskluzivisht përmes procesit të fitimit të gradës me konkurrim. Sipas kërkesave të ligjit, punonjësi i policisë do të duhet t'i nënshtrohej më parë procesit kualifikues dhe testimit në mënyrë që të realizohej efektivisht e drejta e ngritjes në gradë dhe vetëm në përfundim të kësaj procedure, organi kompetent do mund të merrte vendim për fitimin ose jo të gradës.

24. Sipas ligjit nr.9747/2007, ngritja në gradë nënkuptonte ngritjen në detyrë dhe jo të anasjelltën. Ngritja në detyrë nuk prezumon vetiu përfitimin e gradës vetëm për shkak të ushtrimit të funksionit. Në vështrim të dispozitave të mësipërme çmohet se ligjvënësi qartësisht ka sanksionuar se fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative, e cila, *së pari,* kërkon kalimin me sukses të procedurës konkurruese dhe, *së dyti,* ndjekjen e trajnimit korrespondues për secilën gradë policore. Në këtë kuptim, ngritja në gradë sipas ligjit nr. 4979/2007, pas sistemit të ri

të gradave, kërkon plotësimin kumulativ të kushteve vijuese: 1. Punonjësi i policisë duhet të plotësojë kushtin e vjetërsisë në gradë, sipas nenit 41/5 të ligjit nr.4979/2007, 2. Ngritja në gradë realizohet vetëm për të plotësuar vendet e lira që ka sistemi i policisë për çdo gradë dhe, për këtë arsye, ngritja në gradë sjell ngritjen në detyrë, 3. Ngritja në gradë kërkon kalimin me sukses të procesit të vlerësimit konkurrues, 4. Në vijim, punonjësit duhet të ndjekin kursin e trajnimit përkatës për gradë.

25. Një ndër risitë e ligjit nr.9747/2007 ishte përcaktimi i një sistemi të ri gradash policore. Në këtë kontekst lindi nevoja për ekuivalentimin e gradave, të fituara sipas ligjit të mëparshëm nr. 8643/2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit". Sipas nenit 126 të ligjit nr.9749/2007, kalimi në sistemin e ri të gradave realizohej përmes procesit të ekuivalentimit të tyre në mbështetje të VKM-së nr.803, datë 21.11.2007 "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre".

26. Neni 126/2 i ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 parashikonte: "*Punonjësi merr gradën* që i korrespondon funksionit që kryen vetëm nëse ka minimalisht 3/2 e vjetërsisë së shërbimit, llogaritur sipas afateve të përcaktuara në nenin 41, shkronja a) të këtij ligji. a) Punonjësit të policisë që nuk plotëson vjetërsinë për gradën që i korrespondon funksionit që kryen në çastin e kalimit i jepet grada më e lartë për të cilën plotëson minimumi 3/2 e vjetërsisë së shërbimit, duke e emëruar në një funksion që i korrespondon gradës që merr.".

27. VKM-ja nr.803, date 21.11.2007 përcaktonte funksionin korrespondues për çdo gradë në përputhje me parashikimet e ligjit të ri, si dhe ekuivalentimin e gradave të reja me ato të vjetra. [...] Punonjësit e policisë përmes ekuivalentimit të gradës përfitonin gradën në përputhje me funksionin vetëm nëse plotësohej kushti i vjetërsisë në gradën që i korrespondonte funksionit, në të kundërt punonjësi përfitonte gradën më të lartë sipas vjetërsisë përkatëse në gradë.

28. Sipas akteve ligjore dhe nënligjore të mësipërme, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm i parashikuar në nenet 41 dhe 42, të ligjit nr.9749/2007 për fitimin e gradës policore, në procesin e ekuivalentimit të gradave të vjetra me ato të reja, u ndoq parimi "funksioni përcakton gradën". Kolegji vlerëson se kjo qasje e ligjvënësit në vështrim të situatës ligjore dhe faktike të kohës ka qenë e drejtë dhe ka ardhur natyrshëm në kushtet ku ekuivalentimi i gradës nuk përbënte fitim të një gradë të re dhe as përparim në karrierë, por vetëm barasvlerësim të sistemit të gradave për shkak të ndryshimeve ligjore.

29. Për sa më sipër, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se ngritja ose ulja në gradë për shkak të ekuivalentimit të gradave, ndjek një regjim juridik të ndryshëm nga fitimi i gradës policore për shkak të përparimit në karrierën policore.

30. I njëjti regjim juridik gradimi është ruajtur edhe për punonjësit e policisë, të cilët u ripranuan në Policinë e Shtetit, pasi kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.9749/2007, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr.917, datë 04.10.2013 'Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.803 datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre".

31. Nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se në kuptim të ligjit nr.9479/2007, pas sistemit të ri të gradave, për fitimin e gradës policore nga niveli "Inspektor" deri në nivelin "Drejtues i Parë", punonjësit e policisë duhet t'i nënshtroheshin procedurës konkurruese, në përputhje me parashikimet e neneve 41 dhe 42 të ligjit.

32. Kolegji vlerëson se të njëjtën qasje për mënyrën e fitimit të gradave policore, ka edhe ligji i ri, aktualisht në fuqi, nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit". Në kreun VIII të këtij ligji titulluar "Gradat", rregullohet sistemi, hierarkia dhe llojet e gradave në Policinë e Shtetit, gjithashtu, kriteret për dhënien dhe trajnimin përkatës për fitimin e gradës, përcaktimin e funksioneve takuese për gradë, si dhe procedura administrative e ankimit për të gjitha fazat e procesit të fitimit të gradës policore. Në dispozitat përkufizuese të ligjit nr.108/2014, grada policore është konceptuar si: "*shprehje e hierarkisë policore, emërtimi i çdo shkalle dhe shenja dalluese, shprehje e cilësive individuale, eksperiencës dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve në Policinë e Shtetit, që fitohet nga punonjësi i policisë nëpërmjet një procesi konkurrues*" (neni 6).

33. Ligji nr.108/2014 përcakton se ecuria në karrierë e punonjësve të Policisë së Shtetit, bazohet në avancimin gradual dhe meritokratik në gradë policore, sipas konfigurimit të përgjithshëm të sistemit të gradave të parashikuara në të. Përmes ligjit nr.108/2014, legjislatori synon rishikimin e rolit të gradave në Policinë e Shtetit, duke ribashkuar gradën me funksionin, e më pas funksionin me trajtimin financiar.

34. Legjislatori e ka konceptuar gradën policore si një e drejtë që fitohet nëpërmjet procesit vlerësues e konkurrues, duke i njohur kompetencën ekskluzive autoritetit përkatës, komisionit të gradimit, për zhvillimin e karrierës policore të punonjësve të policisë, përmes ecurisë në gradë.

35. Neni 51 i ligjit nr.108/2014 parashikon sistemin e gradave policore në rend hierarkik: *"1. Gradat në Policinë e Shtetit, sipas rendit hierarkik rritës, emërtohen, si më poshtë: a) Inspektor; b) Nënkomisar; c) Komisar; ç) Kryekomisar; d) Drejtues; dh) Drejtues i parë; e) Drejtues i lartë; ë) Drejtues madhor. 2. Autoriteti përgjegjës për vlerësimin e përparimit të punonjësve të policisë në karrierë janë komisionet e gradimit. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të tyre përcaktohet në Rregulloren e Policisë.".*

36. Në nenet 53 dhe 54, të ligjit nr.108/2014 parashikohet procedura për fitimin e gradës, autoriteti përgjegjës për dhënien e gradës përkatëse dhe parimet e përgjithshme për fitimin e gradave policore. Në nenin 53, pika 2, të ligjit parashikohet se grada "Nënkomisar" deri "Drejtues i parë" jepet nga Drejtori i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët fitojnë gradën përmes procesit të konkurrimit sipas ligjit. Në nenin 54 të ligjit sanksionohet: "*1. Fitimi i gradës "Nënkomisar" deri në "Drejtues i parë" bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi. 2. Çdo vit evidentohen nevojat për çdo gradë për vitin pasardhës. Drejtori i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave dhe prioriteteve, miraton urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës respektive. 3. Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse. 4. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit e kanë të gjithë punonjësit e policisë që plotësojnë kriteret e vendosura në këtë ligj.*".

37. Ligjvënësi, në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, në frymë të ligjit dhe *ad litteram* ka përcaktuar se procedura e fitimit të gradës policore për punonjësit e Policisë së Shtetit kalon nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësues dhe konkurrues, i cili administrohet nga komisioni i gradimit. Ligji nr.108/2014 njeh kompetencën ekskluzive dhe diskrecionare të komisionit të gradimit për vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në procesin konkurrues për fitimin e gradës, duke përcaktuar parimet, kriteret, fazat e testimit të kandidatëve dhe ankimin për procesin administrativ të fitimit të gradës policore. Gjithashtu, ligji i njeh autoritetit përgjegjës, Drejtorit të Policisë së Shtetit, kompetencën diskrecionare për të vlerësuar nevojat e sistemit dhe në varësi të prioriteteve, të çelë procedurat për fitimin e gradës. Ligji nr.108/2014 synon që çdo pozicion brenda strukturave të Policisë së Shtetit të ushtrohet nga mbajtësi i gradës takuese dhe, për këtë qëllim, dispozitat ligjore i kushtojnë një vëmendje të veçantë procedurës së fitimit të gradës, avancimit meritokratik dhe gradual në gradë të punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këtë mënyrë, ligjvënësi garanton plotësimin e nevojave të sistemit policor me punonjës të kualifikuar, duke synuar shkrirjen e gradës me funksionin e ushtruar efektivisht.

38. Përcaktimi i funksionit korrespondues për secilën prej gradave policore ka gjetur rregullim të detajuar në VKM-në nr.892, datë 21.12.2016. Pika 3 e këtij akti normativ nënligjor nxjerr në pah nevojën e bashkimit përfundimtar të gradës me funksionin, duke parashikuar edhe zgjidhjen për rregullimin përfundimtar të situatës kur pozicioni i punës, pra funksioni që ushtron efektivisht një punonjës policie nuk përputhet me gradën e caktuar sipas ligjit. Në këtë dispozitë parashikohet: "*Punonjësit e Policisë së Shtetit, të emëruar në bazë të vendimit nr.917, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.803, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", të ndryshuar, në funksione të njëjta apo të barasvlershme me ato të parashikuara në këtë vendim, vazhdojnë të qëndrojnë në këto detyra, duke mbajtur gradën ekzistuese për një periudhë deri në 1 vit.* Nëse gjatë kësaj periudhe këta punonjës nuk fitojnë gradën korresponduese të funksionit që mbajnë, emërohen në një funksion tjetër, në përputhje me gradën që kanë.".

39. Neni 55 i ligjit nr.108/2014 rendit kriteret që duhet të përmbushin punonjësit e policisë për fitimin e gradës nga niveli "Nënkomisar" në nivelin "Drejtuesi i Parë", konkretisht: "*a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës jo më të ulët se 70 për qind të vlerësimit të përgjithshëm; b) të përmbushë kriteret për pozicionin e punës; c) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj; ç) të ketë përfunduar ciklin e parë të studimeve në arsimin e lartë; d) të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm për gradë; dh) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal; e) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë; ë) të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme: i) nga "Inspektor" në "Nënkomisar" 5 vite; ii) nga "Nënkomisar" në "Komisar" 3 vite; iii) nga "Komisar" në "Kryekomisar" 3 vite; iv) nga "Kryekomisar" në "Drejtues" 5 vite; v) nga "Drejtues" në "Drejtues i parë" 3 vite; vi) nga "Drejtues i parë" në "Drejtues i Lartë" ose "Drejtues Madhor" 2 vite.*".

40. Plotësimi i kritereve formale për fitimin e gradës, të parashikuara në nenin 55 të ligjit, nuk përbën kushtin e vetëm për përfitimin e gradës policore. Ligji nr.108/2014, në nenet 55-59 ka parashikuar të gjitha hallkat e procedurës administrative për fitimin e gradave policore. Kriteret e parashikuara në nenin 55 të ligjit kanë natyrë objektive formale, plotësimi i të cilave verifikohet nga strukturat qendrore të burimeve njerëzore gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit, deri në momentin e fitimit të gradës. Këto kritere përbëjnë vetëm kushtet formale që shoqërojnë aplikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë procedurave vlerësuese dhe konkurruese.

41. Për fitimin e gradës policore punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të kalojnë me sukses fazën e testimit me shkrim, intervistës me gojë dhe specifikisht për përfitimin e gradës "Kryekomisar" deri në "Drejtues i Parë" parashikohet edhe kryerja e ushtrimeve vlerësuese. Kufiri minimal për kalimin e testimit përkatës përcaktohet nga Drejtori i Policisë së Shtetit dhe nuk mund të jetë më i ulët se 70%. Numri i personave të shpallur fitues për përfitimin e gradës nuk mund të jenë më shumë se 30 % mbi numrin e vendeve të lira të shpallura për gradën përkatëse.

42. Konkurrentët e shpallur fitues për gradat "Nënkomisar" dhe "Drejtues" përfundojnë programin e arsimit përkatës, ndërsa për gradat e tjera duhet të kenë përfunduar programin e trajnimit përkatës sipas gradës. Në vijim të procedurës administrative hartohet lista emërore e të drejtës për gradë policore, duke filluar nga punonjësi me vlerësimin më të lartë në rend zbritës, duke u mundësuar të drejtën e përzgjedhjes së pozicionit të lirë për emërim. Në përfundim të procedurës sa më sipër, dhënia e gradës policore realizohet përmes urdhrit të Drejtorit të Policisë së Shtetit, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradës. Në këtë urdhër përcaktohet edhe funksioni që do të kryejë punonjësi.

43. Nisur nga analiza e mësipërme e kuadrit ligjor mbi fitimin e gradave policore, Kolegji vlerëson se në mbështetje të ligjit nr.108/2014, fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative që kalon nëpër disa faza dhe kuadrohet nga detyrimi i kandidatëve për plotësimin e një sërë kriteresh formale. Kolegji konkludon se procesi i dhënies së gradave policore, në mbështetje të ligjit nr.108/2014 kushtëzohet, *së pari,* me plotësimin e kritereve objektive për konkurrim, të cilat listohen në nenin 55 të ligjit dhe, *së dyti,* me kalimin me sukses të procedurës konkurruese të testimit dhe kryerjes së trajnimeve përkatëse. Gjithashtu vlerësohet se këto faza duhet të paraprihen nga ekzistenca e vendeve vakante për funksionet takuese, të cilat i korrespondojnë gradës, për të cilën zhvillohet konkurrimi. Ky proces formësohet nëpërmjet ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, në drejtim të çeljes dhe administrimit tërësor të procedurave konkurruese.

b) *Parimet kushtetuese dhe procesi i fitimit të gradave policore*

44. Kolegji, nisur nga autoriteti kushtetues që gëzon në drejtim të interpretimit dhe zbatimit përfundimtar dhe të drejtë të ligjit, në përputhje me parimet konventore dhe kushtetuese, në vështrim të problematikave që parashtron interpretimi i hasur gjerësisht nga ana e gjykatave të faktit për procesin e fitimit të gradave policore dhe në mbështetje të analizës ligjore të parashtruar sa më sipër, vlerëson se në rastin konkret implikohet zbatueshmëria e parimeve kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit dhe parimit të shanseve të barabarta.

45. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve sanksionohet në nenin 7 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet: "*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor".* Kolegji vlerëson se ky parim synon të garantojë që të gjitha pushtetet janë të kufizuara dhe i nënshtrohen një kontrolli të balancuar. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve përbën thelbin e shtetit të së drejtës.

46. Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese. Në përputhje me detyrat që i ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. (*shih, vendimi nr.19, datë 27.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese).*

47. Kolegji vlerëson se asnjë institucion pushteti nuk mund të marrë përsipër kompetenca nga një institucion tjetër e as mund të transferojë ose të heqë dorë prej tyre. Kolegji çmon se çdo vendimmarrje gjyqësore që detyron organin publik t'u njohë gradën policore punonjësve të policisë, pa lejuar zhvillimin sipas ligjit të një procedure administrative vlerësimi nga komisioni përkatës i gradimit, duke ushtruar në mënyrë të paligjshme kompetenca ekskluzive dhe ekzekutive të organit publik, në cenim të pushtetit të tij diskrecionar për të vlerësuar përmbushjen e të gjitha kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligj për fitimin e gradës, në thelb ka zëvendësuar funksionin që ka organi publik në këtë proces ligjor të rëndësishëm. Një qëndrim i tillë cenon rëndë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe parimin e ligjshmërisë.

48. Shtrirja e kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative përfshin kontrollin e ligjshmërisë së veprimit administrativ dhe veprimtarisë administrative në tërësi, në drejtim të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, i cili garantohet përmes parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Funksioni thelbësor i kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative, kryesisht synon të garantojë mungesën e arbitraritetit në ushtrimin e kompetencave administrative të organit publik. Në këtë drejtim, gjykata duhet të jetë e kujdesshme për të mos vepruar vetë si një organ administrativ, përveç rasteve kur një gjë e tillë parashikohet shprehimisht nga ligji.

49. Autoriteti publik i organeve administrative ushtrohet përmes kompetencave urdhëruese ligjzbatuese, si edhe nëpërmjet kompetencave diskrecionare. Diskrecioni konsiderohet i pashmangshëm dhe i lidhur në mënyrë të natyrshme me vetë karakterin e veprimtarisë administrative, madje i konsideruar se përbën vetë "thelbin e veprimit administrativ".

50. Kolegji vlerëson se kompetencat diskrecionare gëzojnë legjitimim kushtetues dhe janë të pajtueshme me shtetin e së drejtës, nëse ato i janë dhënë administratës publike me ligj. Pushteti diskrecionar është pushteti që i jep një autoriteti administrativ një shkallë të caktuar lirie për të marrë vendime, duke i mundësuar që të zgjedhë mes disa vendimeve të pranueshme ligjore atë që është më i përshtatshëm. Ushtrimi diskrecionar i kompetencave është antiteza e veprimtarisë së ngushtë ligjzbatuese të organit publik në zbatim të normave urdhëruese të së drejtës. Hapësira e vlerësimit të organit publik mbi zgjedhje të caktuara përbën thelbin praktik të kompetencës diskrecionare. Parimi i ligjshmërisë, vendos kufijtë negativë të sjelljes së organit publik, duke e detyruar atë të veprojë në zbatim të kërkesave urdhëruese të ligjit. Nga ana tjetër, kompetenca diskrecionare e organit duhet të jetë e parashikuar në ligj, duke deleguar gjykimin autonom për kryerjen e zgjedhjeve alternative të caktuara, për të qenë në përputhje me parimin e ligjshmërisë. Në këtë kuptim, diskrecioni është ushtrimi i pushtetit të autorizuar nga ligji, por i kufizuar nga e drejta.

51. Ligji nr. 108/2014 ka parashikuar një sërë kompetencash diskrecionare të organit publik në procesin administrativ për fitimin e gradës si: evidentimi i nevojave për çdo gradë sipas prioriteteve dhe miratimi i urdhrit për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës (neni 54, pika 1), verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve për konkurrim gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit deri në momentin e fitimit të gradës (neni 56, pikat 1 dhe 2), përcaktimi i nivelit minimal për kalimin me sukses të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë (neni 57, pika 3), si dhe dhënien e gradës përmes vlerësimit në tërësi nga ana e komisionit të gradimit (neni 59).

52. Kolegji vlerëson se ligji nr.108/2014 ka autorizuar në mënyrë të shprehur hapësirën diskrecionare për vlerësim të organit publik, përkatësisht Drejtorit të Policisë së Shtetit lidhur me vlerësimin e nevojave dhe prioriteteve për çeljen e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës, sikurse ka autorizuar komisionin e gradimit për vlerësimin dhe përparimin e punonjësve të Policisë së Shtetit në karrierë, në të cilin përfshihet edhe pjesëmarrja në procesin konkurrues për fitimin e gradës. Kolegji çmon se ka rëndësi të veçantë të sjellë në vëmendje se këto kompetenca diskrecionare nuk janë të pakufizuara, sepse përndryshe do cenohej thelbi i shtetit të së drejtës. Kolegji vlerëson se sistemi procedural i drejtësisë administrative synon vendosjen e një balance ndërmjet respektimit të kërkesave të veprimtarisë administrative, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave të individit, nga ana tjetër.

53. Qëllimi i një koncepti kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve siguron të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollet dhe ekuilibrat që njeh Kushtetuta i

japin secilës degë pushtet që të kompensojë apo zbusë ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizë të fundit asnjë pushtet më vete nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjera dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok që natyrisht nuk ndërhyn në atë masë sa të dëmtojë misionet e tyre kushtetuese (*shih, vendimi nr.11, datë 06.03.2004 i Gjykatës Kushtetuese).*

54. Kolegji vlerëson se misioni i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore që i është ngarkuar pushtetit gjyqësor mund të realizohet vetëm atëherë kur zbatimi i normës nga pushteti ekzekutiv, i cili ka ndërhyrë në sferën e të drejtave të qytetarëve, bëhet i kontrollueshëm nga gjykatat administrative. Për aq sa administratës i është lejuar hapësirë vlerësimi diskrecionar, ajo duhet të veprojë në përputhje me detyrat e veta funksionale dhe të shfrytëzojë mundësitë që i janë dhënë në përputhje me ligjin. Ky zbatim i së drejtës kryhet nën urdhërimet e parimit të shtetit të së drejtës e, sidomos, të parimit të barazisë. Ushtrimi i gabuar i vlerësimit diksrecionar nga ana e autoriteteve publike i nënshtrohet kontrollit të gjykatave administrative. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes mund të garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontrolleve dhe ekuilibrave.

55. Në këtë kuptim, shtrirja e juridiksionit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative të organeve publike ka për qëllim të garantojë parimin e ligjshmërisë dhe kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë diskrecionare të organit publik, por pa dubluar ose zëvendësuar kompetenca të cilat ekskluzivisht janë njohur organit publik, sipas ligjit. Kolegji vlerëson se ky është një qëndrim i konsoliduar që pasqyrohet gjerësisht edhe në praktikën e gjykatave supreme evropiane. Në rastin kur organi publik ka një pushtet diskrecionar ndërmjet disa zgjidhjeve, ligjshmëria e vendimmarrjes së tij mund të kontrollohet në gjykatë, por në rast se gjykata konkludon se vendimi është i paligjshëm nuk mund të vendosë vetë për thelbin. Gjykata ka të drejtën të rikthejë çështjen edhe njëherë para organit administrativ kompetent në mënyrë që ky i fundit të marrë një vendim të ri, brenda pushtetit të tij diskecionar (*shih, vendimi nr.207, datë 21.12.2004 i Gjykatës Kushtetuese të Mbretërisë së Belgjikës).*

56. Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në këtë drejtim, kur në rastin *Meltex SHPK. dhe Mesrop Movsesyan kundër Armenisë (shih, parag. 81, 2008)* mbi konstatimin e shkeljes së nenit 10 të Konventës, për shkak të ushtrimit të diskrecionit në lidhje me refuzimin për dhënien e licencës, Gjykata ka arsyetuar se me qëllim që ligji i brendshëm të përmbushë kërkesat cilësore, ai duhet të sigurojë mjete ligjore mbrojtjeje kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike lidhur me të drejtat

e garantuara nga Konventa. Në çështje që ndikojnë të drejtat themelore do të ishte në kundërshtim me shtetin e së drejtës që një diskrecion ligjor që i është njohur ekzekutivit të shfaqet në formën e një pushteti të pakontrolluar. Rrjedhimisht, ligji duhet të parashikojë mjaftueshëm qartë edhe shtrirjen e çdo diskrecioni të tillë që u është dhënë autoriteteve kompetente, si edhe mënyrën se si ushtrohet ky diskrecion *(Navalnyy kundër Rusisë 2018, prg.113*), duke pasur parasysh synimin legjitim të masës përkatëse, me qëllim që t'i japë individit mbrojtjen e duhur ndaj ndërhyrjeve arbitrare (*Maestri kundër Italisë* 2004, par.. 30).

57. Kolegji vlerëson se në këndvështrim të standardeve konventore, gjykatat administrative gëzojnë pushtetin e kontrollit të kufijve ligjor të vendimmarrjes së autoriteteve publike. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vlerëson se juridiksioni gjyqësor në kontrollin e veprimtarisë administrative të organit publik në procesin e dhënies së gradave mund të shtrihet në drejtim të vlerësimit të gabuar ligjit, konstatimit të rrethanave të pasakta ose kryerjes së gabimeve procedurale të tilla që kanë ndikuar në vlerësimin e gabuar të përmbushjes së kritereve formale për aplikimin në fazën e konkurrimit, duke përfshirë kundërshtimin e secilës prej fazave administrative për fitimin e gradës, të cilat sipas nenit 60 të ligjit nr.108/2014 i nënshtrohen paraprakisht edhe procesit të ankimit administrativ dhe veçanërisht kontrollit mbi rastet e ushtrimit *ultra vires* të pushtetit diskrecionar të organit publik lidhur me administrimin tërësor të procesit të konkurrimit për fitimin e gradës. Kolegji vlerëson se juridiksioni gjyqësor që gëzojnë gjykatat administrative në këtë proces duhet të ketë për qëllim mbrojtjen e meritokracisë për avancimin në gradë në kuadër të lirisë së ushtrimit të profesionit dhe nuk mund të zëvendësojë organin publik, konkretisht komisionin e gradimit, duke dhënë gjyqësisht gradën policore, në kushtet ku aplikanti nuk i është nënshtruar konkurrimit për fitimin e gradës.

58. Kolegji vlerëson se nënshtrimi i punonjësve të policisë në procedurën konkurruese për fitimin e gradës është në përputhje me parimet kushtetuese të sigurisë juridike, stabilitetit ligjor dhe pritshmërive legjitime, në kushtet ku legjislacioni mbi fitimin e gradave policore, që në vitin 2007, ka ofruar qartësi dhe qëndrueshmëri, në drejtim të përcaktimit të mënyrës së fitimit të gradës përmes procedurave konkurruese. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se fitimi i gradave policore gjyqësisht pa iu nënshtruar më parë punonjësit e policisë procedurës konkurruese cenon rëndë edhe parimin e shanseve të barabarta.

59. Jurisprudenca kushtetuese ka elaboruar në vijimësi parimin e barazisë, duke vlerësuar se ky parim synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore *(shih, vendimet nr.34,*

datë 10.04.2017, nr.10, datë 29.02.2016; nr.71, datë 27.11.201, nr.20 datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë drejtim, Kolegji çmon të sjell në vëmendje jurisprudencën autoritative të Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane, në të cilën është trajtuar e drejta e shanseve të barabarta në fushën e vlerësimeve konkurruese. Sipas parimit të shanseve të barabarta, e cila mbizotëron në të drejtën mbi provimet për ata që merren në provime të ngjashme, duhet të vlejnë me sa të jetë e mundur kushte të ngjashme të marrjes në provim, dhe kritere të ngjashme vlerësimi. Do të ishte e papajtueshme nëse kandidatëve të veçantë, të cilët fillojnë një proces gjyqësor administrativ, do t'u jepej shansi i një vlerësimi të pavarur e pa kuadrin e krahasimeve. Do të cenohej rëndë gjykimi i barabartë i të gjithë kandidatëve të ngjashëm. Ai është i mundur vetëm kur komisioneve të provimeve u lihet një hapësirë veprimi në vlerësimet për provime specifike dhe nëse kufizohet kontrolli gjyqësor. Provimet e shtetit, të cilat kufizojnë pranimin për profesione akademike, kërkojnë vlerësime të vështira, të cilat duhet të merren duke marrë parasysh shanset e barabarta për të gjithë kandidatët në një kontekst të përgjithshëm të procedurës së provimit, dhe të mos kryhen menjëherë në mënyrë të izoluar në proceset administrative të kandidatëve të veçantë. Vetëm vlerësime për provime specifike, shpeshherë të gërshetuara në mënyrë të pandashme me gjykime profesionale, mbeten në kompetencën e fundit vendimmarrëse të komisioneve të provimit. Por as përgjigjja për çështje të tilla vlerësimi nuk i shpëton çdo kontrolli. Hapësira e lirë e vlerësimit ka kufij, respektimi i të cilëve duhet verifikuar me rrugë gjyqësore *(shih, vendimi i Gjykatës Federale Gjermane 1 BvR 419/81 dhe 21 3/83 i Senatit të Parë datë 17.04.1991)*.

60. Së fundmi, Kolegji çmon të theksojë se procesi konkurrues synon të rrisë profesionalizmin[32] në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të garantojë meritokracinë, në kuadër të zhvillimit të tyre profesional, në përputhje me parashikimet e nenit 49 të Kushtetutës ku sanksionohet:

[32] Në vendimin nr.55/1999 Gjykata Kushtetueseka marrë në vlerësim kushtetutshmërinë e nenit 48 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku ndër të tjera ka theksuar se: *"Format për kualifikimin profesional janë nga më të larmishmet dhe një prej tyre është edhe organizimi i provimit, i cili shërben si nxitje për gjyqtarët për studim, por në të njëjtën kohë shërben edhe si një mjet për të vlerësuar shkallën e dijeve të gjithsecilit, në kuadrin e përgjithshëm të vlerësimit profesional. Në këtë aspekt, pjesëmarrja në provim përbën një detyrë ligjore që secili gjyqtar sipas kritereve të përcaktuara nga ligji, duhet t'i nënshtrohet këtij provimi. Nëse duhet zbatuar ose jo ky detyrim nuk është lënë në vlerësimin e gjyqtarëve, ndërsa përgjegjësia për mospërmbushjen e këtij detyrimi, është individuale dhe çmohet në çdo rast konkret në varësi të shkaqeve që pretendon gjithsecili.".*

"Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.".

61. Nisur nga kjo analizë e hollësishme që i bëhet çështjes në shqyrtim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon në sentencën unifikuese: *Procesi i fitimit të gradave policore nga niveli "Nënkomisar" deri në nivelin "Drejtues i Parë", duhet t'i nënshtrohet domosdoshmërisht procedurës së vlerësimit konkurrues, sipas parashikimeve të neneve 50-60, të ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit"*. Plotësimi i kritereve formale për fitimin e gradës, si vjetërsia në gradën pararendëse dhe/ose ushtrimi efektiv i funksionit në përputhje me gradën e pretenduar, nuk mund të sjellin fitimin gjyqësisht të gradës policore, pa iu nënshtruar më parë punonjësit e Policisë së Shtetit një procesi vlerësimi konkurrues nga komisioni i gradimit.

III. Në lidhje me shqyrtimin e rekursit të palës së paditur

62. Rekursi plotëson kushtet formale të pranueshmërisë dhe është ushtruar brenda afatit 30 ditor për paraqitjen e tij. Vendimi nr.1812, datë 26.04.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, përmes së cilës është lënë në fuqi vendimi nr.202, datë 05.04.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është marrë në zbatim të gabuar të ligjit.

63. Paditësit i është njohur grada "Komisar" me urdhrin nr.3052/1, datë 02.11.2010 të Drejtorit të Policisë së Shtetit. Me urdhrin nr.2304 prot., datë 15.10.2015 të Drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi rezulton të jetë transferuar përkohësisht në detyrën shef komisariati, pranë Komisariatit të Policisë Malësi e Madhe, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër e më pas me urdhrin nr.452, datë 08.02.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit paditësi është transferuar dhe emëruar në detyrën Shef Komisariati, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër.

64. Paditësi ka pretenduar se për shkak të funksionit që ushtron dhe plotësimit të viteve në vjetërsi në gradë dhe pasi pala e paditur nuk ka zhvilluar konkurrime për fitimin e gradave policore, duhet t'i njihet grada "Kryekomisar". Pala e paditur përmes shkresës nr.159/1 prot., datë 09.02.2017 ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e gradës "Kryekomisar", për shkak se ligji nr.108/2014 nuk parashikon marrjen e gradës sipas pozicionit të punës dhe se fitimi i gradës mundësohet vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në proces konkurrimi, pas plotësimit të kritereve të përcaktuara në ligj.

65. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me vendimin nr.202, datë 05.04.2017 ka pranuar padinë, duke vlerësuar se paditësit i takon përfitimi i gradës, për shkak se plotëson kushtin e vjetërsisë në detyrë dhe efektivisht ushtron funksionin në përputhje me gradën e pretenduar "Kryekomisar". Gjykata ka vlerësuar se në kuadër të parimit të sigurisë juridike dhe të të drejtave të fituara padia është e mbështetur në ligj. Vendimi nr.202, datë 05.04.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është lënë në fuqi me vendimin nr.1812, datë 26.04.2018 të Gjykatës Administrative e Apelit.

66. Në vijim të përfundimit njësues Kolegji vlerëson se plotësimi i kriterit të ushtrimit të funksionit të kërkuar për gradën e pretenduar dhe vjetërsisë në gradë, nuk mund të sjellë përfitimin gjyqësisht të gradës policore të pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së konkurrimit vlerësues nga komisioni i gradimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.108/2014.

67. Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson se pretendimet e paditësit s'i plotësojnë kushtet për fitimin e gradës dhe duhet ta fitojë atë gjyqësisht, pasi pretendimi se organi nuk ka hapur procedurën e konkurrimit vlerësohet i pabazuar në ligj. Në këtë aspekt, Kolegji çmon të theksojë se paditësi do mund të kishte orientuar gjykimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi në një tjetër drejtim, duke vlerësuar gjyqësisht ushtrimin e diskrecionit nga ana e palës së paditur në administrimin dhe çeljen e procesit të konkurrimit dhe jo duke pretenduar dhënien e menjëhershme të gradës nga gjykatat, në kushtet ku nuk është ndjekur procedura ligjore konkurruese për fitimin e gradës policore. [...]

69. Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji konkludon se vendimet e gjykatave të faktit janë dhënë në zbatim të gabuar të ligjit dhe se çështja që shtrohet për zgjidhje në mosmarrëveshjen objekt gjykimi është ekskluzivisht çështje ligji, për të cilën nuk është e nevojshme të kryhet rivlerësimi i provave apo i fakteve të vëna në themel të mosmarrëveshjes. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 63, shkronja dh) të ligjit nr.49/2012, pas ndryshimeve me ligjin nr.49/2021, Kolegji nuk pengohet të zgjidhë në themel mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

Vendim i Kolegjit Administrativ nr. 00-2021- 1317, datë 22.7.2021

Ligji nr.7703/1993, i ndryshuar në vitin 2011, nuk plotëson të gjitha standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja, në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë" dhe standardet kushtetuese të gjykatës së caktuar me ligj, mbi pavarësinë dhe patundshmërinë e anëtarëve të KMCAP Epror, sipas nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, konkludohet se KMCAP Epror, sipas rregullimit që i ka bërë ky ligj, nuk është formësuar si një organ quasi gjyqësor. Përderisa nuk plotëson këtë kusht thelbësor, nuk mundet që paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror të mos i nënshtrohen kontrollit gjyqësor dhe këto vendime nuk mund të përcaktohen nga ligji si akte administrative të pakundërshtueshme.

Posaçërisht për sa u përket vendimeve të GJEDNJ për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ. Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46, të KEDNJ.

Neni 39/1, pika 3, e ligjit nr.7703/1993, në pjesën ku parashikon se "...Vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë", vjen në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë". Si rrjedhojë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme, për aq sa rregullimi ligjor për KMCAP nuk arrin të plotësojë kushtet e një organi quasi gjyqësor. Në rastet ku kundërshtohet një vendim i KMCAP Epror, sipas këtij ligji, do të zbatohet drejtpërdrejt ky vendim i GJEDNJ, dhe dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përgjithshme që garantojnë kontrollin gjyqësor mbi aktin administrativ.

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 25.01.2011.

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se pala paditëse, prej vitesh është trajtuar për një lloj sëmundjeje dhe duke qenë e paaftë për punë, i është drejtuar palës së paditur për të njohur shkallën e invaliditetit dhe për t'i caktuar shumën e mbrojtjes shoqërore respektive.

3. Me Vendimin nr.173, datë 01.11.2010, Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë e ka përcaktuar paditësen si të paaftë për punët e lehta. Pala paditëse nuk ka qenë dakord me këtë vendim, duke pretenduar se konkluzioni i organit administrativ është i gabuar dhe se ajo duhet të përcaktohet se është e paaftë për punë sipas ligjit. Pala paditëse është trajtuar me pension invaliditeti nga viti 2004 deri në vitin 2010. Ankimi administrativ i paditëses nuk është pranuar me Vendimin nr.44, datë 21.12.2010 të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë Epror, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim, KMCAP). Në këto kushte, pala paditëse i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar anulimin e vendimit të komisionit rajonal dhe KMCAP-it dhe përcaktimin e saj si invalide e grupit të dytë.

II. Procedura gjyqësore

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr.10751, datë 09.11.2012 ka vendosur: "*Pranimin e kërkesëpadisë. Anulimin e Vendimit nr.173, datë 01.11.2010 të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Vendimit nr.44, datë 21.12.2010 të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë Epror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Detyrimin e të padituri Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë për t'i paguar paditëses pensionin e invaliditetit si person i paaftë për punë, nga data 01.11.2010 deri me datë 01.11.2011, në masën që e ka pasur kur e ka ndërprerë.*".

5. Gjykata, duke mbajtur parasysh konkluzionet e arritura në gjykim nga ekspertët dhe pasi ka sjellë në vëmendje konkluzionet e Vendimit të GJEDNJ-së në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*", ka konkluduar se nga ana e palës së paditur është zbatuar gabim ligji dhe se palën paditëse për periudhën respektive duhet ta paguanin me vlerën e pensionit të invaliditetit të plotë. Gjykata ka vlerësuar se karakteristikat e sëmundjes së paditëses janë të tilla që shkaktojnë paaftësi të plotë për punë. Nuk rezulton që gjykata e shkallës së parë të ketë analizuar në vendimin e saj ndryshimet që iu bënë

ligjit nr.7703/1993, në vitin 2011, për sa i përket zbatimit të vendimit "*Dauti kundër Shqipërisë*", të GJEDNJ-së dhe, për rrjedhojë, nuk ka arsyetuar se përse nuk zbatohet paragrafi i katërt i nenit 35 të ligjit nr.7703/1993 dhe njëherazi nuk ka arsyetuar se përse nuk zbatohet edhe pika 3 e nenit 39/1 e këtij ligji, të ndryshuar në vitin 2011.

6. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim pala e paditur. Në apel është kërkuar ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimi i padisë. Është pretenduar gjithashtu, se vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë, për sa i përket themelit të konkluzioneve dhe se nuk mund të ushtrohet padi në gjykatë, sipas nenit 35 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993. Rezulton se pas ndryshimeve ligjore të vitit 2011, ky parashikim i ligjit ndodhet në pikën 3, të nenit 39/1, të ligjit nr.7703/1993 dhe se ka të njëjtin rregullim imunitar nga kontrolli gjyqësor.

7. Gjykata e Apelit Tiranë me Vendimin nr.687, datë 04.03.2014 ka vendosur: "*Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes civile nr.223 akti, datë 01.02.2013 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.*".

8. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin nr.2318, datë 05.06.2014 ka vendosur: *Lënien në fuqi të Vendimit nr.10751, datë 09.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*".

9. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar njëlloj, sikurse gjykata e shkallës së parë, lidhur me themelin e gjykimit. Gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim çështjen nëse KMCAP Epror është apo jo gjykatë, në kuptimin material, sipas parashikimeve të nenit 35 të ligjit nr.7703/1993, nenit 6 të KEDNJ-së dhe vendimit të GJEDNJ "*Dauti kundër Shqipërisë*", duke sjellë në vëmendje edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në Vendimin nr.00-2014-555 (41), datë 21.01.2014. Gjykata e apelit ka konkluduar se KMCAP Epror nuk rezulton të jetë gjykatë në kuptimin material dhe se nuk mundet të konkludohet se vendimi ka marrë formë të prerë dhe, për rrjedhojë, të mos lejohet ankim në gjykatë. Sikurse gjykata e shkallës së parë, edhe Gjykata Administrative e Apelit nuk rezulton të ketë analizuar në vendimin e saj ndryshimet ligjore të vitit 2011, në ligjin nr.7703/1993, për sa i përket zbatimit të gjetjeve në jurisprudencën "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ dhe, për rrjedhojë, nuk ka arsyetuar se përse nuk zbatohet paragrafi i katërt i nenit 35 të ligjit nr.7703/1993 dhe njëherazi nuk ka arsyetuar as për moszbatimin e pikës 3, të nenit 39/1, të këtij ligji, të ndryshuar në vitin 2011.

10. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë [...]

11. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, më datë 19.09.2014. [...]

III. Kontrolli incidental, sipas nenit 145 të Kushtetutës.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), ka planifikuar gjykimin e kësaj çështjeje në dhomë këshillimi më datë 12.10.2020. Për këtë qëllim janë njoftuar palët, sipas parashikimeve të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (në vijim, ligji nr.49/2012).

13. Në praktikën gjyqësore të gjykatave administrative të shkallës së parë, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë janë vënë re qëndrime të kundërta mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 39/1, pika 3, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 (në vijim, ligji nr.7703/1993), në lidhje me kuptimin e formës së prerë të vendimeve të KMCAP.

14. Në çështje gjyqësore të ndryshme, nga gjykatat është marrë në analizë, nëse KMCAP, sipas ligjit nr.7703/1990, plotëson kushtet e gjykatës, në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim, KEDNJ) dhe sipas standardeve të vendosura nga GJEDNJ-ja, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*, për të konkluduar mbi juridiksionin gjyqësor mbi këto çështje. [...]

17. Në këto kushte, para Kolegjit, në rastin konkret, u shtrua për diskutim çështja e ushtrimit ose jo të së drejtës së ankimit gjyqësor ndaj vendimit të KMCAP epror, sipas rregullimit të parashikuar në nenin 39/1, pika 3, të ligjit nr.7703/1993 (të ndryshuar në vitin 2011) dhe në nenin 35/4 të ligjit, (para ndryshimeve), i cili ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë, si një nga shkaqet e rekursit të palës së paditur.

18. Kolegji vlerësoi se KMCAP epror, edhe me ndryshimet që ka pësuar ligji nr.7703/1993, në vitin 2011, nuk plotëson elementet e *quasi (pothuajse)* gjykatës, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe praktikës së GJEDNJ-së, në çështjen e referuar më sipër.

19. Nga ana tjetër, Kolegji vlerësoi se rekursi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë nuk mund të shqyrtohej dhe të vendosej për ligjshmërinë apo jo të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, në kushtet kur këto dy dispozita ligjore, nga viti 1995 e deri më sot, ndalojnë ushtrimin e kontrollit gjyqësor mbi vendimet e KMCAP Epror.

20. Kolegji vlerësoi se të dy këto parashikime ligjore, i pari i zbatueshëm

sa kohë është realizuar kontrolli administrativ (deri në vitin 2011) dhe i dyti i zbatueshëm gjatë kontrollit gjyqësor, pas ushtrimit të padisë dhe nga momenti i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr.7703/1993 të vitit 2011 e deri më sot, vijnë në kundërshtim me nenet 42 dhe 83, të Kushtetutës, por edhe me nenin 6 të KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJtë artikuluar mbi këtë dispozitë ndër vite. Për rrjedhojë, Kolegji konkludoi se asnjë vlerësim ligjor mbi rekurset objekt gjykimi nuk mund të ishte i mundur, derisa Gjykata Kushtetuese të shprehet mbi kushtetutshmërinë e dispozitës së zbatueshme për zgjidhjen e çështjes, konkretisht pika 3, e nenit 39/1, të ligjit nr.7703/1993.

21. Mbi këtë analizë, në bazë të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*", me vendimin e ndërmjetëm datë 12.10.2020, Kolegji pezulloi gjykimin dhe iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 3, të nenit 39/1, të ligjit nr.7703/1993.

22. Në argumentet për shpalljen e anti-kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore, Gjykata e Lartë shtroi para Gjykatës Kushtetuese disa çështje të natyrës kushtetuese, zgjidhja e të cilave varej nga analiza, interpretimi dhe qëndrimi që do të mbante ky autoritet i lartë kushtetues se: *i) A mundet gjykata në zgjidhjen e çështjes të refuzojë të zbatojë ligjin, duke zbatuar drejtpërdrejt Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare, duke shmangur zbatimin e nenit 145/2 të Kushtetutës, apo thënë ndryshe, duke shmangur nisjen e kontrollit incidental kushtetues të ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese? ii) Çfarë fuqie juridike kanë konkluzionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës që konstatojnë përmbushjen e masave të përgjithshme që GJEDNJ ka lënë si detyrë ndaj shtetit në një nga vendimet e saj që ka marrë formë të prerë, nëse pas rezolutës konstatohet se në të vërtetë masat ligjore të marra nga shteti nuk e kanë zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe sërish ka shkelje të dispozitave të KEDNJ-së? iii) A e kanë respektuar jurisprudencën "Dauti kundër Shqipërisë" të GJEDNJ ndryshimet e ligjit nr.7703/1993 në vitin 2011 dhe, a e kanë shndërruar ndryshimet e ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 2011 KMCAP Epror materialisht në një gjykatë me të gjithë elementët e nenit 6 të KEDNJ-së? iv) A mund të krijohen organet quasi gjyqësore me ligj me shumicë të zakonshme, duke pasur parasysh rregullimin e nenit 81 të Kushtetutës? v) A mund të rregullohet organizimi, funksionimi dhe procedurat e shqyrtimit të organeve quasi gjyqësore me ligje me shumicë të zakonshme apo me akte nënligjore normative?*

23. Me vendimin nr.55, datë 31.03.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

24. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se zgjidhja e këtyre çështjeve lidhej më së shumti me interpretimin e ligjit, çka përbën funksion natyral për Gjykatën e Lartë. Ndër të tjera, Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese ka konkluduar se, çështjet e interpretimit të ligjit i përkasin kompetencës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos Gjykatës së Lartë, si organi më i lartë i sistemit gjyqësor që ka për funksion të përgjithshëm njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Shprehja e vënë në dyshim nga gjykata referuese "*formë e prerë*" është përdorur nga legjislacioni procedural edhe në raste të tjera, pa penguar kontrollin gjyqësor deri në Gjykatën e Lartë (*shih, ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar; ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH", i ndryshuar; ligji nr.133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"*). Po ashtu, ky koncept i është nënshtruar unifikimit nga Gjykata e Lartë në procedura të tjera gjyqësore, në raport me konceptin e vendimit përfundimtar (*shih, vendimi unifikues nr.2, datë 03.11.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

25. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar se, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar në kohë, neni 86 i ligjit nr.7703/1993 parashikonte dhe vazhdon të parashikojë të drejtën e ankimit gjyqësor të individëve kundër vendimeve administrative që përcaktojnë përfitime të pafavorshme. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se ky ligj garanton aksesin në gjykatë të procesit kryesor që përcakton të drejtat e ligjshme të individit dhe për efekte të të cilit zhvillohet procesi administrativ i caktimit të shkallës së aftësisë për punë nga Komisioni Epror. Sipas Gjykatës Kushtetuese, në këtë çështje, Gjykata e Lartë duhet të ushtrojë funksionin e saj, duke vlerësuar brenda kufijve kushtetues, nëse është vendi për njësimin, zhvillimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

IV. Gjykimi njësues

26. Përderisa Gjykata Kushtetuese, për pesë çështjet e sipërcituara, të shtruara nga gjykata referuese nuk ka vlerësuar se duhet të ushtrojë përmes rrugës së kontrollit incidental, kontrollin e papajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën, atëherë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në ushtrim të së drejtës së tij kushtetuese dhe ligjore, që lidhet me funksionin nomofilatik, në respektim të standardeve të vendosura nga GJEDNJ-ja, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*, duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të

gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njëjtë në interpretimin e ligjit, në zbatim të nenet 12/3, 58/a dhe 62/a, të ligjit nr.49/2012, të ndryshuar me ligjin nr.49/2021 ka konkluduar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, për arsye se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural, të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

27. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se çështjet që duhet të shtrohen për njehsim janë:

1) A e kanë respektuar jurisprudencën "Dauti kundër Shqipërisë" të GJEDNJ-së ndryshimet e ligjit nr.7703/1993 në vitin 2011 dhe, a e kanë shndërruar ndryshimet e ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 2011 KMCAP Epror materialisht në një gjykatë me të gjithë elementët e nenit 6 të KEDNJ-së?; 2) Si duhet interpretuar dhe zbatuar neni 39/1 i ligjit nr.7703/1993, konkretisht pika 3, në pjesën ku parashikon se "…Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë", dhe *si qëndron kjo dispozitë në raport me dispozitat e tjera procedurale, ligjore dhe kushtetuese që parashikojnë të drejtën e përgjithshme të ankimit, si e drejtë themelore?*

28. Sa më sipër, Kolegji planifikoi çështjen për shqyrtim më datë 22.07.2021 dhe vijoi me procedurën e posaçme, të parashikuar në nenin 62/a të ligjit nr.49/012, të ndryshuar me ligjin nr.49/2021. […]

V. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

30. Kolegji vlerëson se çështjet e shtruara për njësim kanë një lidhje organike me njëra-tjetrën, ku zgjidhja e çështjes së parë, kushtëzon të dytën. Si rrjedhojë, edhe trajtimi analitik i tyre do të ndjekë të njëjtën renditje. Konkretisht, për të konkluduar mbi mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të nenit 39/1, pika 3, të ligjit nr.7703/1993, në pjesën ku parashikon se "*…vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë*", nëse vendimet e KMCAP epror janë përfundimtare apo duhet të ushtrohet kontrolli dhe juridiksioni gjyqësor mbi to, fillimisht do të duhet të merret në analizë nëse KMCAP Epror, sipas ligjit nr.7703/1993, pas ndryshimeve të vitit 2011, plotëson kushtet materiale të një organi *quazi* gjyqësor, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së.

A. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njehsim: A e kanë respektuar vendimin "Dauti kundër Shqipërisë" të GJEDNJ ndryshimet e ligjit nr.7703/1993, të kryera në vitin 2011 dhe, a e kanë shndërruar

ndryshimet e ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 2011 KMCAP Epror, materialisht, në një gjykatë me të gjitha elementet e nenit 6 të KEDNJ-së?

31. Për të konkluduar mbi këtë çështje, Kolegji çmon të marrë në analizë ndryshimet që ka pësuar, ndër vite, ligji nr.7703/1993, nën një vështrim historik dhe krahasimor me dispozitat ligjore në fuqi, të para këto nën dritën e jurisprudencës relevante të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim, GJEDNJ).

32. Neni 35 i ligjit nr.7703/1993 është ndryshuar fillimisht me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995. Pjesa relevante e kësaj dispozite parashikonte deri në vitin 2011 se, "*Kundër vendimit të KMCAP-it të rrethit, personi mund të ankohet në KMCAP-in epror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vendimi i të cilit, për sa i përket aftësisë për punë, është i formës së prerë. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve caktohen me rregullore të ISSH-s dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.*".

33. Pra, sipas kësaj dispozite, të zbatueshme gjatë kohës që është zhvilluar procedimi administrativ për rastin konkret, parashikohej, ndër të tjera, se KMCAP Epror është organi administrativ më i lartë që përcakton paaftësinë për punë, masën e invaliditetit dhe, për rrjedhojë, edhe masën e pensionit për shkak të paaftësisë në punë. Në këto raste, vendimi i KMCAP Epror tregon shkaqet e paaftësisë për punë, datën e fillimit dhe shkallën e paaftësisë. Në çdo rast, vendimi i KMCAP Epror nuk mund të ankimohej gjyqësisht, pasi ligji e parashikonte si një akt të formës së prerë dhe të pakundërshtueshëm gjyqësisht.

34. Në atë kohë, ligji nr.7703/1993 nuk kishte rregulla organike që të përcaktonin organizimin dhe funksionimin e KMCAP Epror. Neni 35 i ligjit, ndër të tjera, parashikonte se rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve caktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

35. Rregullorja e përbashkët e datës 13 korrik 1995 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe e Ministrisë së Shëndetësisë mbi organizimin, të drejtat dhe detyrat, si dhe funksionimin e KMCAP-ve rajonale dhe KMCAP Epror parashikonte, ndër të tjera, se këto organe raportojnë për punën e tyre para Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Lidhur me kompozimin e këtyre organeve parashikohej se komisionet rajonale përbëheshin nga tre ose pesë mjekë të specializuar nga fushat e kardiologjisë, neurologjisë, psikiatrisë, patologjisë etj., që kanë të paktën pesë vjet eksperiencë, përveç mjekut të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Anëtarët e lartpërmendur emëroheshin për një periudhë të pacaktuar kohe nga drejtoritë rajonale të sigurimeve

shoqërore. Në këto raste, emërimi miratohej nga titullari i njësisë së shëndetit, nën mbikëqyrjen e të cilit punojnë mjekët e emëruar dhe se çdo ndryshim anëtarësh duhet të merrte miratimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Rregullorja parashikonte se komisioni rajonal shqyrtonte kërkesën e ankimuesit, dokumentet mjekësore dhe financiare, paaftësinë e personit për punë dhe nivelin e paaftësisë. Ky organ vendoste për shkakun e paaftësisë, kohën e fillimit, kohëzgjatjen dhe mundësinë e rishqyrtimit/rishikimit dhe trajnimin fizik dhe në punë.

36. Ndërkohë, KMCAP Epror shqyrtonte ankimet kundër vendimeve të komisioneve rajonale. KMCAP Epror, sipas rregullores, përbëhej nga mjekë të specializuar në fushën e kardiologjisë, neurologjisë, psikiatrisë dhe patologjisë dhe anëtarësia në këtë komision duhet të merrte miratimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Rregullorja parashikonte se KMCAP kryesohej nga titullari i njësisë së shëndetit. As në ligj dhe as në aktet nënligjore nuk kishte dispozita që të parashikonin rregullime për shkaqet e largimit nga detyra apo të mbarimit të mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror. Gjithashtu, nuk kishte dispozita që të rregullonin garancitë e qëndrimit në detyrë për anëtarët e këtij komisioni apo mekanizma *restitutio in integrum,* në rast të largimit të padrejtë nga detyra.

37. Në jurisprudencën "*Dauti kundër Shqipërisë*", GJEDNJ ka marrë në analizë dhe interpretuar nëse KMCAP Epror, me karakteristikat e rregullimit ligjor dhe nënligjor si më lart, është apo jo gjykatë ose tribunal, në kuptimin autonom që jurisprudenca e saj i ka njohur nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë vendim, ndër të tjera, GJEDNJ ka arsyetuar: "*46. Ndërsa neni 6 § 1 parashikon "të drejtën për në gjykatë", ai nuk i detyron shtetet kontraktuese t'ia nënshtrojnë mosmarrëveshjet në lidhje me të "drejtat dhe detyrimet civile", një procedure të zhvilluar në të gjitha fazat e saj para "gjykatave" që përmbushin kërkesat e ndryshme të nenit. Nevoja për fleksibilitet dhe eficiencë, që janë plotësisht në pajtim me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund ta justifikojnë ndërhyrjen fillestare të organeve administrative ose profesionale dhe, aq më tepër, të organeve gjyqësore që nuk përmbushin këto kërkesa në çdo aspekt. "E drejta për në gjykatë" mbulon çështjet e faktit po aq sa edhe çështjet e ligjit (shih, Le Compte, Ven Leuven dhe De Meyere v. Belgium, 23 qershor 1981, § 51, seria A nr. 43). 47. Gjykata vëren se në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës, është e nevojshme që vendimet e organeve administrative që nuk përmbushin vetë kërkesat e këtij neni duhet t'i nënshtrohen kontrollit pasues të një "organi gjyqësor që ka juridiksion të plotë" (shih për shembull, Ortenberg v. Austria, 25 nëntor 1994, § 31, seria A nr. 295-B, dhe Crisan v. Rumania, nr. 42930/98, § 24, 27 maj 2003)... 51. Me qëllim që të përcaktohet nëse një gjykatë konsiderohet e pavarur, duhet t'i kushtohet vëmendje, ndër të tjera, mënyrës së emërimit të anëtarëve të saj dhe mandatit në detyrë, ushtrimit të garancive ndaj presioneve të jashtme dhe çështjes nëse organi ka shprehjen e pavarësisë (shih, ndër të tjera, Morris v. Mbretërisë së Bashkuar nr. 38784/97, § 58, KEDNJ 2002-I).*

52. Gjykata vëren që Komisioni i Ankimeve përbëhet tërësisht nga mjekë në detyrë, të emëruar nga ISSH-ja dhe të aprovuar së fundi nga Ministria e Shëndetësisë, nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e së cilës mjekët punojnë. Në Komisionin e Ankimeve nuk ka anëtarë të kualifikuar ligjorë apo gjyqësorë (shih, për kontrast, Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere të përmendur më sipër, § 58). 53. Ligji dhe rregulloret e brendshme nuk përmbajnë rregulla që të rregullojnë mandatin e anëtarëve në detyrë, largimin e tyre, dorëheqjen apo ndonjë garanci për patundshmërinë e tyre. Rregullat statusore nuk parashikojnë mundësinë e betimit të bërë nga anëtarët e tij. Duket sikur ata mund të largohen në çdo moment nga detyra, sipas dëshirës së ISSH-së ose Ministrisë së Shëndetësisë, që ushtrojnë diskrecion të pakufizuar. Pozicioni i anëtarëve të komisionit të ankimeve është i hapur ndaj presioneve të jashtme. Një situatë e tillë e minon pamjen e pavarësisë. 54. Nga sa më sipër, gjykata konsideron që Komisioni i Ankimeve nuk mund të konsiderohet si një "gjykatë e pavarur dhe e paanshme", siç kërkohet në nenin 6 § 1 të Konventës. 55. Duke pasur parasysh faktin që komisioni i ankimeve nuk përbën një "gjykatë të pavarur dhe të paanshme" dhe që vendimet e tij, sipas ligjit në fuqi në këtë kohë, nuk mund të kundërshtohen para një gjykate vendase, gjykata konkludon që ka pasur shkelje të së drejtës së ankimuesit për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës." (*shih, çështja "Dauti kundër Shqipërisë", kërkesa nr.19206/05, Vendim i GJEDNJ-së, datë 03.02.2009).*

38. Ky vendim i GJEDNJ ka marrë formë të prerë, me datë 03.05.2009. Thelbi i vendimmarrjes së GJEDNJ në çështjen e sjellë në vëmendje më sipër, ishte se sipas nenit 6 të KEDNJ-së, shtetet kontraktuese, duke përfshirë këtu edhe Republikën e Shqipërisë, kanë hapësirë për të krijuar edhe organe alternative *"për shqyrtimin e të drejtave dhe detyrimeve civile"*, që nuk janë gjykata në kuptimin formal, por që materialisht dhe në mënyrë ekuivalente, plotësojnë të gjithë elementët e organit të caktuar me ligj, paanësisë dhe pavarësisë. Në të kundërt, duhet domosdoshmërisht të njihet ankimi dhe aksesi në gjykatë, ndaj vendimmarrjes së tyre.

39. Nga kjo jurisprudencë e detyrueshme ndërkombëtare rezulton të jenë vendosur detyra dyplanëshe për Republikën e Shqipërisë. Në planin individual, pala paditëse në këtë proces duhet të kompensohej dhe të rishikoheshin vendimet gjyqësore vendase, që kishin refuzuar proceduralisht shqyrtimin e padisë. Në planin e përgjithshëm, Shqipëria detyrohej të ndryshonte paragrafin e katërt të nenit 35 të ligjit nr.7703/1993, që do të thotë të lejonte kundërshtimin në gjykatë të vendimeve të KMCAP Epror. Nëse kjo nuk do të ndodhte, do të duhej që Shqipëria të shndërronte me ligj, KMCAP Epror në një gjykatë apo tribunal me të gjitha karakteristikat jurisprudenciale dhe autonome të nenit 6 të KEDNJ-së, që GJEDNJ i ka elaboruar ndër vite.

40. Në vitin 2011, Kuvendi miratoi ndryshime ligjore në ligjin nr.7703/1993. Ndryshimet u destinuan dhe synuan të zbatonin detyrat e përgjithshme të vendimit "*Dauti kundër Shqipërisë*". Në mënyrë të detajuar, të gjitha ndryshimet ligjore, Kolegji do i marrë në analizë në vijim.

41. Në raportin e veprimit të datës 03.05.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, pasi bëhet një pasqyrim i ndryshimeve ligjore të vitit 2011 për adresimin e zgjidhjes mbi zbatimin e përgjithshëm të vendimit të GJEDNJ-së në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*", në pikën 10 të tij konkludohet se shqetësimi i ngritur nga GJEDNJ-ja, se KMCAP Epror nuk përbënte një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, ka gjetur zgjidhje nëpërmjet amendamenteve ligjore të miratuar në ligjin nr.7703/1993 të vitit 2011. Më tej, në pikën 11 të raportit, konkludohet se zgjidhja finale e vendimit të GJEDNJ-së, në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*" është arritur edhe në planin e përgjithshëm, edhe në planin individual (*shih, Raportin datë 03.05.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, DH-DD(2013)506, nga mbledhja e datës 4 – 6 Qershor 2013 ("Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Dauti v. Albania (19206/05), judgment of 03/02/2009, final on 03/05/2009").*

42. Në këtë pikë të analizës, për Kolegjin u shtrua për zgjidhje çështja se çfarë fuqie juridike kanë konkluzionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës që konstatojnë përmbushjen e masave të përgjithshme që GJEDNJ ka lënë si detyrë ndaj shtetit në një nga vendimet e saj që ka marrë formë të prerë, në rast se pas rezolutës konstatohet se, në të vërtetë, masat ligjore të marra nga shteti nuk e kanë zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke lejuar vijimin e shkeljeve të dispozitave të KEDNJ-së.

43. Kolegji vlerëson se, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, i përbërë si rregull nga ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të kësaj organizate është një ndër organet vendimmarrëse dhe ekzekutive kryesore të Këshillit të Evropës. Sipas nenit 20 të Statutit të Këshillit të Evropës,

Komiteti i Ministrave mund të nxjerrë vendime, rekomandime, rezoluta apo edhe kërkesa gjatë ushtrimit të detyrave që i janë caktuar. Ndërkohë neni 46 i KEDNJ i ka ngarkuar Komitetit të Ministrave detyrën e mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ nga shtetet anëtare, ndaj të cilave ato janë dhënë, qoftë për masat individuale dhe qoftë për masat e përgjithshme.

44. Neni 46 i KEDNJ ka parashikuar se vendimet e formës së prerë të GJEDNJ i kalojnë Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr përmbushjen e tyre. Nga rregullimi i pikës 5 të kësaj dispozite del se, nëse Komiteti i Ministrave vlerëson se vendimi i GJEDNJ është zbatuar në masat individuale dhe të përgjithshme, atëherë vendoset mbyllja e shqyrtimit të çështjes. Në rastin konkret, sikurse është pasqyruar më lart, del se Komiteti i Ministrave në vitin 2013, pasi ka marrë në shqyrtim cilësinë e ndryshimeve ligjore të vitit 2011, në ligjin nr. 7703/1993, ka konkluduar se masat e përgjithshme të vendimit "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ janë përmbushur dhe, mbi këtë bazë, është vendosur mbyllja e shqyrtimit të çështjes së regjistruar, si pasojë e ekzekutimit të këtij vendimi të formës së prerë.

45. Kolegji thekson se duhet të mbahet parasysh rregullimi i nenit 17 të Kushtetutës, dispozitë që i ka parashikuar standardet ndërkombëtare të KEDNJ-së, si një kufi minimum të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nga kjo konkludohet se Republika e Shqipërisë është e lirë dhe e pakondicionuar nga e drejta ndërkombëtare që të njohë standarde më të larta sesa ato që janë parashikuar në KEDNJ dhe të formësuara, ndër vite, nga jurisprudenca e GJEDNJ. Për rrjedhojë, nga neni 17 i Kushtetutës del konkluzioni se gjykatat shqiptare, sikurse edhe Gjykata Kushtetuese, janë të lira të pranojnë standarde më të larta të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut se sa ato që rrjedhin prej Këshillit të Evropës.

46. Pavarësisht rolit të rëndësishëm që i jepet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave të përgjithshme që rrjedhin nga vendimet e formës së prerë të GJEDNJ, këtij institucioni nuk mund t'i njihet edhe autoriteti gjyqësor i vetë GJEDNJ-së, i gjykatave kushtetuese apo edhe i gjykatave vendase të pushtetit gjyqësor. Kjo do të thotë se, pavarësisht konkluzioneve të arritura, rast pas rasti, nga ana e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, mbi ekzekutimin e masave të përgjithshme të vendimeve të formës së prerë të GJEDNJ prej shteteve anëtare, konkluzioni nëse këto masa përmbushin cilësisht standardet kushtetuese dhe konventore mbeten në pushtetin e natyrshëm dhe sovran të pushtetit gjyqësor, gjykatave kushtetuese dhe vetë GJEDNJ. Në këtë këndvështrim, konkludohet se nuk mund t'i njihet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës një pushtet i tillë juridik që të zëvendësojë dhe njëkohësisht t'u imponohet gjykatave të zakonshme, gjykatave kushtetuese

dhe vetë GJEDNJ.

47. Duke mbajtur parasysh sa më lart u analizua Kolegji arrin në përfundimin se, edhe në rastin konkret, nuk mund të imunizohet kontrolli i kushtetutshmërisë apo konvencionalitetit të ndryshimeve të ligjit nr.7703/1993, vetëm nga fakti se Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka konkluduar se masat e përgjithshme të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë, në vitin 2011, e kanë përmbushur jurisprudencën "*Dauti kundër Shqipërisë*". Për shkak të statusit kushtetues që ka KEDNJ, nuk mund të pengohen gjykatat e zakonshme të shmangin zbatimin e një ligji të brendshëm, kur vlerësojnë se është në kundërshtim me të.

i) *Jurisprudenca e GJEDNJ, e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës së Lartë mbi quazi gjykatat*

48. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë për organet *quazi* gjyqësore.

49. Terminologjinë e *quazi* gjykatës e ka përdorur Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, fillimisht, për të shquar kompetenca *quazi gjyqësore* të organeve kushtetuese, të cilat nuk janë pjesë e pushtetit gjyqësor, konkretisht të komisioneve hetimore parlamentare, të ngritura sipas nenit 77 të Kushtetutës, (*shih, Vendimi nr.18, datë 14.05.2003 dhe Vendimi nr.21, datë 01.08.2008 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata Kushtetuese ka pranuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e krijimit nga ligji të organeve *quasi* gjyqësore (*shih, Vendimi nr.27, datë 26.05.2010 i Gjykatës Kushtetuese)*, të cilat paraqiten me karakteristikat e qenësishme, herë të organeve administrative dhe herë të organeve gjyqësore. Kjo jurisprudencë, në vijim të qëndrimeve të mbajtura ndër vite edhe nga GJEDNJ-ja, ka njohur si organe *quasi* gjyqësore komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronës, që organizoheshin dhe funksiononin përmes ligjit të parë të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve (*shih, ligji nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve"*). Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese nuk ka njohur statusin e organit *quasi* gjyqësor të Agjencisë së Kthimit të Pronave (*shih, Vendimi nr.43, datë 06.10.2011 i Gjykatës Kushtetuese)* dhe të Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*shih, Vendimi nr.1, datë 16.01.2017 i Gjykatës Kushtetuese)*, të krijuar si institucion në vitin 2015, pasi ka konkluduar se varësia e tyre tek Ministri i Drejtësisë nuk përmbush elementin e pavarësisë së këtyre organeve. Gjykata Kushtetuese nuk ka vënë në diskutim më parë cilësinë dhe procedurën që duhet të ketë ligji organik që krijon, rregullon dhe parashikon mënyrën e

funksionimit të organeve *quasi* gjyqësore, si dhe procedurat e shqyrtimit të tyre.

50. Konceptin e organeve *quasi* gjyqësore e ka elaboruar edhe Gjykata e Lartë. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet një vendimi unifikues, kanë arritur në konkluzionin se Komisioni i Shërbimit Civil është një organ *quasi* gjyqësor (*shih, Vendimi Unifikues nr.3, datë 24.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)*. Në këtë rast Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se pavarësia që ky institucion gëzonte në ushtrimin e detyrës nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, garancitë ligjore të qëndrimit në detyrë, elementët e parashikuar në ligjin me shumicë të cilësuar prej tre të pestave të deputetëve për miratimin e strukturës organizative, të vendeve të punës dhe buxhetit i japin Komisionit të Shërbimit Civil të gjitha tiparet e një organi administrativ, të pavarur dhe të ngarkuar me zgjidhjen e ankimeve ndaj vendimeve lidhur me nëpunësin civil dhe, gjithashtu, i japin atij të gjitha tiparet e një arbitri administrativ, apo të një trupe (organi) me funksion dhe kompetenca *quasi* gjyqësore.

51. Në vazhdën e këtij arsyetimi, Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se ankimet gjyqësore të vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil nuk e shndërrojnë atë palë ndërgjyqëse, pasi palët janë punëmarrësi dhe punëdhënësi dhe se ky organ *quasi* gjyqësor nuk mund të ankimojë vendimet e gjykatës së shkallës së parë apo të apelit që cenojnë vendimet e tij. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konkluduar se edhe vendimi i pushimit të çështjes nga ana e prokurorit, para ndryshimeve të KPP-s të vitit 2017, është një vendim *quasi* gjyqësor (*shih, Vendimi Unifikues nr.2, datë 20.06.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).*

52. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk e kanë vënë në diskutim çështjen nëse aktet nënligjore me karakter normativ mund të rregullojnë çështje themelore të së drejtës procedurale mbi shqyrtimin e ankimeve apo kërkesave të individëve nga organet *quasi* gjyqësore. Për më tepër, Kolegjet e Bashkuara në këtë jurisprudencë njësuese e pranojnë pa asnjë mëdyshje zbatimin e rregullores së brendshme të Komisionit të Shërbimit Civil që parashikonte rregullat procedurale të shqyrtimit të ankimeve si organ *quasi* gjyqësor *(shih, Vendimi Unifikues nr.3, datë 24.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).*

53. Gjykata e Lartë, në disa çështje të shqyrtuara përmes ankimeve të veçanta të subjekteve paditës kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë administrative që kanë nxjerrë nga juridiksioni gjyqësor paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror, ka mbajtur qëndrimin se karakteristikat e sjella nga ndryshimet që iu bënë ligjit nr.7703/1993 në vitin 2011, e kanë bërë

KMCAP Epror një organ *quasi* gjyqësor, duke konkluduar se ndaj këtyre vendimeve nuk mund të ushtrohet padi në gjykatë, sipas pikës 3, të nenit 39/1, të ligjit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar ndër të tjera: "*...karakteristikat e përcaktuara në dispozitat e mësipërme, i japin Komisionit Epror të Caktimit të Aftësisë për Punë, natyrë quasi gjyqësore, rrjedhimisht edhe vendimet e tij janë të formës së prerë dhe nuk mund të shqyrtohen nga gjykata.*

10. Në rastin në gjykim, gjykata administrative e shkallës së parë ka zbatuar keq ligjin. Duke arsyetuar si më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se çështja objekt gjykimi nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk është kompetente në lëndë për gjykimin e saj." (shih, Vendimi nr.00-2017-1934, datë 29.06.2017 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

54. Ndërkohë, GJEDNJ-ja, sipas jurisprudencës konstante të saj, mban qëndrimin se, nëse një organ administrativ i ngarkuar për të shqyrtuar mosmarrëveshjet mbi të "*drejtat dhe detyrimet me karakter civil*" nuk përmbush të gjitha kërkesat e nenit 6, pika 1, nuk ka shkelje të Konventës nëse procedura para këtij organi ka qenë objekt kontrolli përfundimtar në një organ gjyqësor me juridiksion të plotë, i cili mbart të gjitha garancitë e kësaj dispozite (*shih, çështja "Ramos Nunes de Carvalho e Sá v. Portugal", kërkesa. nr. 55391/13 dhet 2 të tjerë, Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, datë 06.11.2018, paragrafi 132. Gjithashtu shih, çështja "Vera Fernández-Huidobro v. Espagne", kërkesa. nr.74181/01, Vendim i GJEDNJ-së, datë 06.01.2010, paragrafi 131).* Megjithatë, nëse një kontroll të tillë materialisht gjyqësor nuk lejohet nga ligji dhe organi administrativ nuk përmbush kushtet materiale për t'u kualifikuar si gjykatë, atëherë mosparashikimi i kontrollit gjyqësor passjell shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (*shih, çështja "Peleki v. Grece", kërkesa. nr.69291/12, Vendim i Seksionit i të GJEDNJ-së, datë 05.03.2020, paragrafi 60 – 59).*

55. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se edhe një organ administrativ dhe jogjyqësor klasik apo jo i integruar në pushtetin gjyqësor mund të kualifikohet si gjykatë apo tribunal në konceptin autonom të nenit 6 të KEDNJ-së (*shih, çështja "Ali Riza dhe të tjerë v. Turkey"*), edhe pse ai e ka juridiksionin e kufizuar për shkak të lëndës së gjykimit (*shih, çështja "Rolf Gustafson vc. Sedisë").* Karakteristikat kryesore që duhet të përmbushë një organ i tillë, që të kualifikohet si tribunal janë: krijimi i tyre nga pushteti ligjvënës; organizimi dhe funksionimi i tyre të rregullohet nga ligji; ligji duhet të ofrojë garanci materiale dhe procedurale për pavarësinë dhe paanësinë e trupës gjykuese, qoftë nga pushteti ekzekutiv dhe qoftë nga vetë palët *(shih, çështja "Beaumartin v. Francës",*

Vendim i GJEDNJ-së datë 24.11.1994, paragrafi 38, Series A nr. 296B dhe çështjen "Di Giovanni v. Italisë", kërkesa nr.51160/06, Vendim i GJEDNJ-së datë 09.07.2013, paragrafi 52); juridiksion i plotë mbi ligjin dhe faktin në shqyrtimin e çështjes, sikurse është në kuptimin material juridiksioni i gjykatave klasike (*shih, çështja "Cyprus v. Turqi", kërkesë. nr.25781/94, Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së datë 10.05.2001, paragrafi 233, KEDNJ 2001IV);* parashikimi i rregullave procedurale për garantimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të procedurës së gjykimit (*shih, çështja "Benthem v. Holandës", Vendim i GJEDNJ-së datë 23.10.1985, paragrafi 40, Series A nr. 97).*

56. Gjithashtu jurisprudenca e GJEDNJ-së ka konfirmuar se mungesa e presionit të jashtëm dhe të brendshëm e një tribunali apo organi *quasi* gjyqësor duhet të konkludohet në mënyrë të tillë që të përjashtojë mundësinë e cenimit të pavarësisë dhe paanësisë së trupës gjykuese, në mënyrë që të mos cenohet besimi që në një shoqëri demokratike gjykata duhet të transmetojë tek publiku (*shih, çështjen "Morice v. Francs", krkesa nr.29369/10, Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, datë 23.04.2015, paragrafi 78, KEDNJ 2015 dhe çështja "Oleksander Volkov v. Ukrahins", krkesa. nr. 21722/11, Vendim i GJEDNJ, datë 09.01.2013, paragrafi 106).* Në këtë mënyrë, vlerësohet se elementi i pavarësisë dhe paanësisë së trupës gjykuese është konstitutiv dhe thelbësor në procesin e vlerësimit, nëse një autoritet publik përbën apo jo gjykatë, në kuptimin autonom të nenit 6 të KEDNJ-së (*shih, "Guida mbi nenin 6 të KEDNJ. E drejta për një proces të rregullt (shkelje civile)", publikim zyrtar i GJEDNJ-së, përditësuar deri në 30.04.2020, faqet 37).*

57. Gjithashtu në vlerësimin e kësaj çështjeje duhet të mbahet parasysh edhe jurisprudenca relevante e Gjykatës Kushtetuese mbi nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim dhe se kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Kjo jurisprudencë vlerëson se shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih, Vendimi nr.10, datë 04.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese*) dhe se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen (*shih, Vendimi nr.10, datë 11.05.2006 i Gjykatës Kushtetuese).*

58. Për të konkretizuar këto vlerësime të përgjithshme jurisprudenciale, të parashtruara më lart, Kolegji e vlerëson të nevojshme të analizojë nëse KMCAP Epror, si një organ i administratës publike, përmbush kushtet dhe kriteret materiale për t'u konsideruar *quasi* gjykatë, për efekt të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 42 të Kushtetutës. Për këtë arsye, duhet të analizohen dhe interpretohen dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë juridiksionin, kompetencën, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

ii) *Përmbushja e elementit të paanësisë dhe pavarësisë*

59. Kolegji sjell në vëmendje sërish, disa nga konkluzionet e GJEDNJ, në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*", sipas të cilës KMCAP Epror, para ndryshimeve ligjore të vitit 2011, nuk plotësonte standardet e nenit 6 të KEDNJ për t'u kualifikuar si një gjykatë apo tribunal. Rezervat e GJEDNJ në këtë vendim ishin, ndër të tjera, se nuk ishte mirërregulluar mënyra e emërimit në detyrë e anëtarëve; mungesa e parashikimit ligjor për kohëzgjatjen e mandatit; mungesa e parashikimeve ligjore për mbarimin e mandatit; emërimi dhe vënia nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë; mungesa e anëtarit jurist në komision; mungesa e garancive nga ushtrimi i presionit dhe i ndikimit të organeve të emërtesës dhe të mbikëqyrjes; mungesa e parashikimeve në ligj apo në rregullore për patundshmërinë e anëtarëve nga detyra dhe ushtrimi i diskrecionit të pakufizuar të organeve të emërtesës dhe të mbikëqyrjes për largimin nga detyra të anëtarëve; mungesa e parashikimit në ligj për betimin e anëtarëve para marrjes në detyrë; mungesa e pavarësisë së KMCAP Epror.

60. Këto shkelje të evidentuara nga GJEDNJ-ja të çojnë paraprakisht në përfundimin se të gjitha vendimet e KMCAP Epror, që referojnë në paragrafin e katërt të nenit 35 të ligjit nr.7703/1993 (para hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të vitit 2011), janë marrë nga një organ administrativ që nuk ka garancitë kushtetuese dhe konventore të një organi *quasi* gjyqësor. Ky konkluzion është gjë e gjykuar dhe i detyrueshëm për Shqipërinë (*shih, neni 5 i Kushtetutës*) për shkak të vendimmarrjes së formës së prerë të GJEDNJ-së në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*". Në rrethana të tilla, në bazë dhe për zbatim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, do të duhet që ligji të lejojë dhe të krijojë një mjet ankimi efektiv në një gjykatë kundër vendimeve të KMCAP Epror (*shih, për analogji konkluzionet dhe arsyetimin e çështjes "Ortenberg v. Austrisë", Vendim i GJEDNJ-së datë 25.11.1994, paragrafi 31, seria A nr.295-B. Shih gjithashtu dhe çështjen "Crisan v. Rumanisë", Kërkesa nr.42930/98, Vendim i GJEDNJ-së, datë 27.05.2003, paragrafi 24).*

61. Mbi bazën e kësaj analize, mbetet të vlerësohet nga Kolegji, *nëse ndryshimet ligjore të vitit 2011 e kanë formatuar KMCAP Epror si një organ quasi gjyqësor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ, si dhe jurisprudencën e GJEDNJ e të Gjykatës Kushtetuese mbi konceptin autonom të gjykatës apo tribunalit, sipas standardeve të së drejtës për proces të rregullt ligjor?*

62. Neni 35 i ligjit nr.7703/1993, i ndryshuar, që është në fuqi aktualisht, përcakton ndër të tjera se invaliditeti caktohet nga KMCAP Epror dhe se në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij, si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë, duke konkluduar njëherazi mbi juridiksionin dhe mbi kompetencën e këtij organi. Kjo do të thotë se ligji, si akt normativ formal, i miratuar nga Kuvendi, ka përcaktuar organin, juridiksionin dhe kompetencën e tij.

63. Ligji parashikon se shqyrtimi i sëmundjes, shkalla e invaliditetit dhe koha e fillimit të invaliditetit përcaktohet në dy shkallë shqyrtimi, fillimisht nga KMCAP rajonal dhe, më tej, nga KMCAP Epror. Ky i fundit është organi që shqyrton ankimet ndaj shkallës së parë të shqyrtimit administrativ. Kjo dispozitë parashikon se rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Epror caktohen në këtë ligj, ndërsa rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP të nivelit të parë caktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

64. Neni 39/1 i ligjit nr.7703/1993, të ndryshuar në vitin 2011, i cili aktualisht është në fuqi, parashikon: "*1. Kundër Vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të nivelit të parë, personi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (më poshtë Komisioni Epror);2. Ankimi paraqitet në formën e parashikuar me Vendim të Këshillit të Ministrave;3. Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë.*".

65. Neni 39/2 i ligjit nr.7793/1993 parashikon përbërjen e KMCAP Epror me 5 anëtarë, të cilët zgjidhen në detyrë me Vendim të Këshillit të Ministrave. Kryetari dhe 3 anëtarët e Komisionit Epror zgjidhen me propozim të përbashkët të ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën shëndetësore dhe ministrit që mbulon çështjet sociale, procedurë emërimi në të cilën ministrat respektiv propozojnë dy kandidatura për çdo vend të anëtarit të Komisionit Epror. Ndërkohë dispozita parashikon se anëtari i pestë i Komisionit Epror propozohet nga ministri i Drejtësisë, me kandidaturë alternative, me profesion jurist dhe me përvojë në fushën gjyqësore.

66. Pika 3, e nenit 39/2, parashikon se anëtar i Komisionit Epror mund të emërohet shtetasi që përmbush këto kritere: a) të jetë me gradë shkencore

"Profesor", "Profesor i asociuar" ose "Doktor shkencash"; b) të ketë përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet punë në fushën e vet të ekspertizës; c) të mos jetë i dënuar penalisht; ç) të ketë një figurë të pastër morale.

67. Në ndryshim nga parashikimi i mëparshëm, KMCAP Epror, në përbërjen dhe konstituimin e tij nuk rregullohet nga aktet nënligjore normative, por nga ligji dhe për sa kohë ligji shteron në parashikime, atëherë rregullimi i organizimit dhe funksionimit të këtij organi realizohet me një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili është një akt nënligjor normativ. Kështu, pika 4, e nenit 39, të ligjit parashikon se rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e KMCAP Epror, si dhe masa e shpërblimit mujor të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

68. Më tej, në nenin 39/3 dhe 39/4, rregullohet me ligj vijueshmëria e mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror dhe lëvizshmëria e tyre nga detyra. Ligji parashikon se anëtari i KMCAP Epror ka mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje dhe se anëtari i KMCAP Epror e ushtron këtë detyrë me kohë jo të plotë. Ligji ka parashikuar se secili prej anëtarëve të KMCAP Epror e ushtron funksionin në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me bindjen e tij profesionale.

69. Me qëllim përmbushjen e një prej detyrimeve që rrjedh nga vendimi *"Dauti kundër Shqipërisë"*, neni 39 të ligjit ka rregulluar edhe procedurën e betimit të anëtarëve të KMCAP Epror. Në të parashikohet se, përpara fillimit të detyrës, anëtari i KMCAP Epror kryen betimin në një ceremoni publike, të organizuar nga Ministri i Financave, Ministri që mbulon fushën e shëndetësisë dhe Ministri që mbulon fushën e çështjeve sociale. Ligji ka parashikuar se teksti i betimit përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. [...]

72. Për të përcaktuar mënyrën se si organizohen, si funksionojnë Komisionet Eprore dhe mënyrën e shpërblimit të tyre është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.505, datë 10.06.2015 "*Për organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë*" (në vijim, VKM nr.505). [...]

82. Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se, nga problematika e evidentuar nga jurisprudenca "*Dauti kundër Shqipërisë*", ndryshimet ligjore të vitit 2011 kanë plotësuar këto masa të përgjithshme: i) parashikimin e procedurës së betimit të anëtarëve të KMCAP Epror; ii) përcaktimin e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror; iii) përcaktimin taksativ të shkaqeve për mbarimin e mandatit të anëtarit të KMCAP Epror; iv) përcaktimin taksativ të shkaqeve të shkarkimit nga detyra të anëtarit të KMCAP Epror; v) proklamimin në ligj të ushtrimit të detyrës së anëtarëve të KMCAP Epror në pavarësi dhe sipas bindjes profesionale; vi) garantimin

e anëtarësisë së një anëtari me profesion jurist dhe me përvojë gjyqësore në KMCAP Epror, i cili emërohet nga Ministri i Drejtësisë.

83. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se ka edhe çështje të tjera, të cilat, megjithëse janë lënë si detyrë në kuadër të masave të përgjithshme të vendimit "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ, nuk kanë gjetur zbatim në ndryshimet që i janë bërë ligjit në vitin 2011. Analiza e këtyre çështjeve që në fakt përbën edhe një ndër drejtimet kryesore të këtij vendimi njësues që ndihmon në nxjerrjen e konkluzionit nëse KMCAP Epror plotëson kushtet e një organi *quasi* gjyqësor dhe është e lidhur me: i. garantimin e pavarësisë materiale dhe funksionale nga presionet e organeve të emërtesës; ii. garantimin e patundshmërisë nga detyra; iii. garantimin e kthimit në detyrë në rast shkarkimi në kundërshtim me shkaqet e parashikuara në nenin 39/4 të ligjit nr.7703/1993; iv. parashikimin e garancive procedurale të procesit të rregullt ligjor gjatë shkarkimit nga detyra për anëtarët e KMCAP Epror.

84. Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje se pika 2, e nenit 39/3, të ligjit nr.7703/1993 parashikon se anëtarët e KMCAP Epror e ushtrojnë detyrën me kohë jo të plotë. Duke pasur parasysh se anëtarët e KMCAP Epror emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të linjës rezulton se këta funksionarë janë të punësuar në organikën e ministrisë respektive apo në organet e vartësisë të fushës përkatëse të veprimtarisë që ata mbulojnë. Kështu, anëtarët e KMCAP Epror mund të rezultojnë nëpunës që kanë statusin e nëpunësit civil, ashtu siç mund të ketë nëpunës që nuk e kanë përfituar këtë status.

85. Ligji, në pikën 2, të nenit 39/3, të ligjit nr. 7703/1993 është përpjekur të kryejë një rregullim të dyfishtë të statusit të anëtarit të KMCAP Epror, duke parashikuar rregullime të posaçme dhe të pavarura statutore për këtë funksionar shtetëror, që e ushtron veprimtarinë me kohë të pjesshme, në raport me pozicionin si nëpunës që ai ka jashtë kësaj detyre, detyrë kjo me kohë të plotë dhe e rregulluar nga normat ligjore respektive që përcaktojnë nëpunësinë e institucionit të emërtesës.

86. Çështja që shtrohet në këto raste ka të bëjë me faktin *nëse ky rregullim ligjor i dyfishtë, i posaçëm dhe i pavarur, a garanton anëtarin e KMCAP Epror të jetë i pavarur nga presionet që mund t'i vijnë atij nga institucioni ku është i emëruar si nëpunës?* Kolegji vlerëson se për t'iu përgjigjur në mënyrë pohuese kësaj pyetje duhet, në radhë të parë, të sanksionohen përmes parashikimeve ligjore disa garanci që arrijnë të krijojnë besimin se nëpunësit shtetërorë të zakonshëm, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet sipas Kodit të Punës ose nëpunësit shtetërorë që kanë statusin e nëpunësit civil gëzojnë një status pavarësie dhe patundshmërie me natyrë të ngjashme me gjyqtarët.

87. Është e vërtetë që ndryshimet e ligjit në vitin 2011 përcaktuan kohëzgjatjen, shkaqet e mbarimit të mandatit dhe shkaqet e shkarkimit nga detyra, por në të njëjtën kohë duhet të mbahet parasysh se as ligji nr.7703/1993, i ndryshuar dhe as aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, nuk kanë parashikuar garancitë procedurale të shkarkimit nga detyra të anëtarit të KMCAP Epror. Në ligj janë parashikuar vetëm shkaqet e shkarkimit në mënyrë taksative nga kjo detyrë, jo me kohë të plotë dhe se anëtarët e KMCAP Epror shkarkohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

88. Duke mos parashikuar asnjë garanci procedurale për shkarkimin e anëtarit të KMCAP Epror, është e pamundur të plotësohet teorikisht dhe praktikisht standardi i procesit të rregullt ligjor dhe se për rrjedhojë, diskrecioni i lënë në shkaqet e parashikuara në nenin 39/4 të ligjit, në kompetencën e Këshillit të Ministrave nuk është shoqëruar me garanci procedurale për kontrollin e ushtrimit të tij. Mungesa e këtyre garancive ligjore bën që anëtarët e KMCAP Epror të jenë fillimisht njëlloj të pambrojtur nga ushtrimi i presionit të organit punëdhënës në cilësinë e tyre të parë si nëpunës dhe, më tej, të jenë njëlloj të pambrojtur nga ushtrimi i presionit të organit që i shkarkon nga detyra si anëtar të KMCAP Epror.

89. Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh se KMCAP Epror nuk plotëson standardet e detyrueshme për t'u quajtur organ *quasi* gjyqësor, pasi ometimi i ligjit nr.7703/1993, shoqëruar me mënyrën e emërimit dhe të shkarkimit të tyre nga detyra nuk garanton parimin e pavarësisë dhe patundshmërisë, që duhet të ketë një organ shtetëror administrativ për t'u kualifikuar juridikisht si *quasi* gjykatë apo si tribunal, në kuptim të konceptit autonom që ka elaboruar jurisprudenca e GJEDNJ-së, ndër vite, mbi nenin 6 të KEDNJ-së.

90. Këtu duhet të sillet në vëmendje se anëtarët e KMCAP Epror emërohen nga ministrat respektivë të linjës dhe shkarkohen nga Këshilli i Ministrave dhe njëkohësisht, ata nuk kanë status të posaçëm punësimi që mundet t'u garantojë të drejtën e *restitutio in integrum,* në rast të shkarkimit nga detyra në kundërshtim me shkaqet e parashikuara në pikën 2, të nenit 4/39, të ligjit nr.1993/7703. Edhe sikur të jenë nëpunës civilë, në statusin si nëpunës me kohë të plotë, ky fakt nuk ka relevancë për sa i përket rregullimit ligjor të statutit të anëtarit të KMCAP Epror. Në asnjë nga dispozitat e ligjit nr.1993/7703, të ndryshuar nuk ka një parashikim për kthimin në këtë detyrë të anëtarëve të KMCAP-së, të shkarkuar në mënyrë të paligjshme nga Këshilli i Ministrave.

91. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje interpretimet e kryera në Vendimin Unifikues nr. 31/2003, në Vendimin Unifikues nr.19/2007, si dhe në Vendimin Unifikues nr.7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilat është konkluduar se e drejta e punëmarrësve të shkarkuar

pa të drejtë nga detyra, kur ligji i posaçëm nuk e parashikon të drejtën e rikthimit në punë, në mënyrë të qartë dhe eksplicite, nuk gëzon mbrojtje ligjore dhe se këto padi janë të destinuara të rrëzohen gjyqësisht.

92. Kjo do të thotë se nuk mund të bëhet fjalë për pavarësi dhe patundshmëri në ushtrimin e detyrës së anëtarëve të KMCAP Epror, kur në ligj nuk parashikohet e drejta e rikthimit në detyrë, për shkak të vendimmarrjes së paligjshme të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra. Në këtë pikë të analizës ligjore vlen të sillet në vëmendje dhe merr një rëndësi të madhe edhe natyra juridike e organit të emërtesës dhe të shkarkimit nga detyra, për të cilët janë ministritë e linjës si organe emërtese dhe si organ shkarkimi nga detyra është Këshilli i Ministrave. Duke pasur parasysh statusin në punësimin e përhershëm të tyre dhe se organi i emërtesës dhe i shkarkimit nga detyra janë institucionet kushtetuese më të larta ekzekutive në vend, së bashku me mungesën e garancive procedurale të shkarkimit dhe të garancive statutore të rikthimit në detyrë, Kolegji arrin në përfundimin se ndryshimet ligjore të vitit 2011 nuk kanë arritur ta konturojnë KMCAP Epror si një organ quasi gjyqësor.

iii) *Përmbushja e elementit formal të krijimit me ligj të quasi gjykatës.*

93. Në vijim të analizës së mësipërme, Kolegji risjell në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi aktin normativ që krijon gjykatën. Ndër të tjera, GJEDNJ-ja ka theksuar se thelbësore për garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së është që gjykata të krijohet me ligj dhe se kjo kërkesë eksplicite e nenit 6 të KEDNJ-së reflekton parimin themelor të shtetit të së drejtës, mbi bazën e të cilit është ndërtuar KEDNJ-ja dhe Protokollet e saj. GJEDNJ-ja ka konkluduar se një organi të krijuar pa vullnetin e ligjvënësit i mungon legjitimiteti i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të ushtruar juridiksion dhe kompetenca gjyqësore dhe se fraza "*e krijuar me ligj*" e nenit 6 të KEDNJ mbulon jo vetëm bazën ligjore të krijimit të tribunalit, por edhe të kompozimit të trupit gjykues në çdo çështje (*shih, çështja "Lavents v. Latvia", kërkesa nr. 58442/00, Vendim i GJEDNJ-së datë 28.11.2002, paragrafi 114)*. Në këtë mënyrë, sipas GJEDNJ, koncepti "*ligj*" i parashikuar në nenin 6 të KEDNJ-së nuk u referohet vetëm parashikimeve për themelimin dhe krijimin e gjykatave, por edhe parashikimeve të tjera që mund të shkaktojnë pjesëmarrjen e një apo më shumë anëtari në trupën gjykuese (*shih, çështja "Ali Riza and others v. Turkey", kërkesa nr. 30226/10 and 4 të tjerë, Vendimi i datës 28.01.2020 i Seksionit II të GJEDNJ-së, paragrafi 194)*.

94. Në çështjen konkrete, të shtruar për njësim, Kolegji konstaton se VKM-ja nr. 505 ka krijuar rishtazi edhe një figurë tjetër anëtari në KMCAP

Epror, konkretisht atë të anëtarit zëvendësues. Në fakt, ligji nr.7703/1993, i ndryshuar, nuk parashikon mundësinë e zgjedhjes së anëtarëve të tjerë, qoftë edhe zëvendësues. Në këtë aspekt, akti nënligjor normativ kapërcen përmbajtjen e ligjit, duke rregulluar kryesisht dhe duke krijuar një tjetër pozicion të anëtarit vendimmarrës në KMCAP Epror, të cilin ligji nuk e individualizon dhe as nuk e njeh.

95. VKM-ja nr.505 ka parashikuar gjithashtu se KMCAP Epror mund të shqyrtojë ankimet administrative të subjekteve ndaj komisioneve rajonale edhe me 4 anëtarë, ndërkohë që neni 39/2, pika 1 i ligjit nr.7703/1993 ka parashikuar pa ekuivok se KMCAP Epror përbëhen nga 5 anëtarë. Për më tepër, pika 2 e kësaj dispozite parashikon edhe mënyrën e kompozimit të trupit gjykues, duke përcaktuar se Kryetari dhe 3 anëtarët e Komisionit Epror zgjidhen me propozim të përbashkët të ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën shëndetësore dhe ministrit që mbulon çështjet sociale. Ministrat propozojnë dy kandidatura për çdo vend të anëtarit të Komisionit Epror. Anëtari i pestë i Komisionit Epror propozohet nga Ministri i Drejtësisë, me kandidaturë alternative, me profesion jurist dhe me përvojë në fushën gjyqësore. Kjo do të thotë se çdo trupë gjykuese e KMCAP Epror duhet të ketë një përbërje të larmishme të anëtarësisë, që të konformohet me ligjin. Ndërkohë, ky akt nënligjor normativ ka parashikuar se në trupën gjykuese të KMCAP Epror mund të mos jetë edhe një prej anëtarëve dhe se trupa gjykuese mund të gjykojë edhe me katër anëtarë.

96. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se në mënyrën se si krijohet dhe konstituohet trupa gjykuese e KMCAP Epror ka parashikime të tilla, të cilat në rastin më të mirë nuk janë rregullime ligjore dhe nuk janë vullnet i ligjvënësit dhe, në rastin më të keq, janë rregullime nënligjore normative, të cilat ndryshojnë vullnetin e ligjvënësit dhe parashikimet për formësimin e trupës gjykuese të KMCAP Epror.

97. Duke sjellë në vëmendje se, në rastin në shqyrtim, trupa gjykuese e KMCAP Epror nuk rregullohet vetëm nga vullneti i ligjvënësit, por edhe me akte nënligjore që tejkalojnë vullnetin e ligjvënësit, Kolegji konkludon natyrshëm se KMCAP Epror nuk përbën një *quasi* gjykatë, të caktuar me ligj, sipas konceptit autonom të nenit 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh se eventualisht trupës gjykuese mund t'i mungojë, sipas rregullimit nënligjor normativ, edhe anëtari jurist dhe sërish ankimi i individit do të shqyrtohet dhe vendimi i KMCAP Epror do të rezultojë si i pakundërshtueshëm, sipas ligjit. Evidentimi i një rasti të tillë do të konsiderohej haptazi në kundërshtim me jurisprudencën e detyrueshme "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ-së. Pikërisht, rregullime të tilla normative që janë bërë me këtë akt normativ nënligjor, ndërkohë që

vlerësohen se e kanë tejkaluar haptazi përmbajtjen e ligjit, tek i cili duhet të bazohen, konsiderohen nga Kolegji, sipas nenit 38 të ligjit nr.49/2012, si të paligjshme dhe, për rrjedhojë, të pazbatueshme.

98. Një çështje tjetër që shtrohet për diskutim, për sa i përket standardit të *quasi* gjykatës së caktuar me ligj, është edhe çështja e procedurës së miratimit të ligjit, me të cilin krijohet dhe rregullohet organizimi dhe funksionimi i organeve *quasi* gjyqësore. Kjo është një çështje që nuk lidhet drejtpërdrejt me jurisprudencën e GJEDNJ apo me detyrimet e së drejtës ndërkombëtare relevante dhe të detyrueshme për Shqipërinë. Kjo çështje lidhet ekskluzivisht me zbatimin e drejtë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në këtë pjesë të posaçme të veprimtarisë së pushtetit legjislativ.

99. Në vijim të kësaj analize, për Kolegjin u shtrua për zgjidhje *nëse, në referim të rregullit të nenit 81 të Kushtetutës, mund të krijohen organet quasi gjyqësore me një ligj me shumicë të zakonshme?* Kjo pyetje u shtrua gjithashtu për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese, e cila vlerësoi se edhe kjo çështje i përkiste funksionit nomofilatik të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, sipas nenit 132 të Kushtetutës dhe fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, mbetet detyrë e Kolegjit të marrë në analizë dhe t'i japë përgjigje kësaj çështjeje, duke interpretuar ligjin nr. 7703/1993, në raport me dispozitat respektive kushtetuese.

100. Fillimisht, Kolegji sjell në vëmendje se procedura e miratimit të ligjit me anën e së cilit krijohet, organizohet dhe funksionon një organ *quasi* gjyqësor nuk bën pjesë në rregullimet e nenit 6 të KEDNJ. Megjithatë, çështja nuk zgjidhet vetëm me këtë konstatim, pasi, sipas nenit 17 të Kushtetutës, KEDNJ-ja është detyrim minimal, përkundrejt kreativitetit të pushtetit legjislativ në mënyrën se si i rregullon normativisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kjo do të thotë se Republika e Shqipërisë është e lirë dhe sovrane që të parashikojë standarde më të larta ligjore për mbrojtjen e tyre. Kështu Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk është mjaftuar vetëm me rregullimin e nenit 42 dhe 135, sikurse ka bërë KEDNJ-ja, në nenin 6 të saj. Përkundrazi, Kushtetuta në nenin 81, ndër të tjera, ka parashikuar: "*2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit: a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta;……d) kodet;*"

101. Nga mënyra se si është formuluar neni 81 i Kushtetutës rrjedh se ligjet për organizimin dhe funksionimin e gjykatave apo edhe për krijimin e tyre (neni 135 i Kushtetutës) duhet të miratohen me shumicë prej tre të pestave të anëtarëve të Kuvendit. Kjo do të thotë se Kushtetuta nuk lejon krijimin, organizimin dhe funksionimin e gjykatave, me ligje me shumicë të zakonshme. Më tej, mbetet përmes analizës dhe interpretimit, për t'i

dhënë përgjigje pyetjes se, *në rast se gjykatat nuk mund të krijohen, të funksionojnë dhe të organizohen me ligje me shumicë të thjeshtë, a është e mundur që në zbatim të Kushtetutës, Kuvendi të krijojë, të organizojë apo të bëjë të mundur, me ligje të tilla, funksionimin e organeve quasi gjyqësore?*

102. Duhet të mbahet parasysh se, nëse kjo pyetje do të merrte një përgjigje pozitive atëherë garancitë që jep shumica e cilësuar parlamentare në krijimin e institucioneve që ushtrojnë drejtpërdrejt funksione kushtetuese dhe që i përkasin pushtetit gjyqësor apo pushtetit të dhënies së drejtësisë, nuk do të shërbenin për organet ekuivalente të tyre dhe që materialisht ushtrojnë të njëjtin juridiksion në zgjidhjen e çështjeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nëse kjo do të lejohej, atëherë do të pranohej se Kuvendi mund të miratojë edhe me procedurë të përshpejtuar ligje për krijimin, organizimin dhe funksionimin e organeve *quasi* gjyqësore, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 83, të Kushtetutës. Gjithashtu, Kolegji çmon se, nëse pyetja e shtuar më lart do të merrte përgjigje pozitive, atëherë do të konkludohej se organet *quasi* gjyqësore do të lejoheshin të krijoheshin, të organizoheshin dhe të funksiononin edhe me akt normativ të Këshillit të Ministrave, në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës.

103. Nga një analizë historike që i bëhet ligjit nr.7703/1993, i cili është miratuar dhe ndryshuar me shumicë të zakonshme parlamentare rezulton të mos u ketë shpëtuar ndërhyrjeve, qoftë nëpërmjet procedurave të përshpejtuara parlamentare, në kuptim të nenit 83, qoftë edhe me akt normativ nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 101 të Kushtetutës (*shih për shembull, ligjin nr.81/2019 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, 'Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar*). Kjo mënyrë e ndërhyrjeve ligjore që është ndjekur në të shkuarën, nuk përjashton mundësitë që eventualisht, në të ardhmen, të ndryshojnë, si me procedurë të përshpejtuar, ashtu edhe me akt normativ, edhe dispozitat që kanë të bëjnë me KMCAP Epror.

104. Duke pasur parasysh sa u përmend më lart, Kolegji vlerëson se nëse organet *quasi* gjyqësore nuk do të gëzojnë garancinë e nenit 81 të Kushtetutës, atëherë garancitë kushtetuese të dhënies së drejtësisë nga gjykatat dhe nga ana e ligjeve organike do të ishin me ndikim jo pozitiv për funksionimin e shtetit të së drejtës. Mosvendosja e pengesave ligjore për krijimin e organeve *quas*i gjyqësore do të krijonte premisat e shtimit të tyre, gjë e cila sjell shpërpjestimisht edhe zvogëlimin e efekteve të organeve të mirëfillta gjyqësore. Shfaqja e një fenomeni të tillë bën që të mos ekzistojë asnjë kufizim ndaj çdo shumice të zakonshme parlamentare, në legjislatura të ndryshme për të zbehur juridiksionin e përgjithshëm të gjykatave klasike,

nëpërmjet partikularizimit të juridiksionalizimit të organeve administrative me funksione gjyqësore. Një zgjidhje e tillë nuk duket se ndalohet shprehimisht nga Kushtetuta, por Kolegji vlerëson se ajo që Kushtetuta ka synuar të ndalojë kategorikisht është rregullimi ligjor i dhënies së drejtësisë dhe mbrojtjes juridiksionale të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me ligje me shumicë të zakonshme.

105. Vlerësohet e domosdoshme të sillet në vëmendje, në këtë rast, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese mbi elaborimin që i ka bërë respektimit të nenit 81 të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike të institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta. Sipas saj, nëse kushtetutëbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte si një standard i rëndësishëm. Pavarësisht se në formë, neni 81, pika 2, shkronja a, i Kushtetutës është normë me natyrë procedurale, hartuesit e Kushtetutës, me synim mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, e kanë përfshirë këtë rregullim, nisur nga rëndësia e fushave që rregullojnë ligjet e cilësuara, me qëllim për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme, për të kërkuar një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend dhe për të shmangur mundësinë që forca politike që ka shumicën, të mund të cenojë parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike *(shih, Vendimi nr.25, datë 05.12.2008 dhe Vendimi nr.1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*

106. Gjykata Kushtetuese në këtë drejtim ka vlerësuar se respektimi i kriterit kushtetues "*shumicë e cilësuar*" është edhe në funksion të parimit të sigurisë juridike, parim që ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligjet në tërësi duhet të garantojnë qartësi, parashikueshmëri dhe kuptueshmëri për individin *(shih, Vendimi nr.23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*

107. Kolegji çmon të mbahet parasysh se Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar vazhdimisht se respektimi i kritereve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, gjatë procedurës ligjvënëse përbën një domosdoshmëri në shtetin e së drejtës. Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve organike u jep atyre fuqi të veçantë juridike, në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit *(shih, Vendimi nr.19, datë 03.05.2007, Vendimi nr.9, datë 23.03.2010 dhe Vendimi nr.23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*

108. Në këtë linjë arsyetimi, është vlerësuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese se raporti midis ligjeve organike, të miratuara me një shumicë të cilësuar të Kuvendit dhe ligjeve të zakonshme, të miratuara sipas rregullit të

përgjithshëm, mund të shihet nga dy këndvështrime: si marrëdhënie midis burimeve të së drejtës, të vendosura në nivele të ndryshme në hierarkinë e normave - ligjet që miratohen me shumicë të cilësuar qëndrojnë më lart se ato të miratuara me shumicë të thjeshtë, ose si një marrëdhënie e bazuar mbi parimin e shpërndarjes së kompetencës legjislative. Është, pikërisht, ky raport që përcakton rregullin se Kuvendi nuk mund të miratojë me "*shumicë të thjeshtë*" një ligj të ri ose shtesa në një ligj të mëparshëm, të cilat kërkojnë "*shumicë të cilësuar*", sepse në këtë mënyrë ligjet që kërkojnë "*shumicë të cilësuar*" mund ta humbasin rëndësinë e tyre. Kjo gjë arsyetohet me faktin e thjeshtë se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barazvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e të drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë *(shih, Vendimi nr.19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

109. Mbi këtë jurisprudencë të elaboruar prej saj, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenin 81, pika 2, shkronja a) të Kushtetutës *(shih, Vendimi nr.19, datë 03.05.2007, Vendimi nr.9, datë 23.03.2010, si dhe Vendimi nr.23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese.)*.

110. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e një akti normativ, sipas kuptimit të nenit 101 të Kushtetutës, i cili ndryshonte një nga ligjet, që sipas nenit 81 të Kushtetutës, miratohen me shumicë parlamentare prej 3/5 të deputetëve *(shih, Vendimi nr.5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese.)*. Ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, përderisa ligji është pjesë përbërëse e listës shteruese të ligjeve që parashikohen në shkronjën e) të nenit 81, pika 2, të Kushtetutës, për miratimin e tij nevojiten tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Po ashtu, edhe në referim të rregullimit të nenit 83, pika 3, Kuvendit i ndalohet që një ligj të tillë ta miratojë me procedurë të përshpejtuar. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se rregullimi i statusit të nëpunësve publikë është një fushë që i rezervohet ekskluzivisht Kuvendit, i cili e realizon këtë kompetencë përmes miratimit të ligjit me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij, nëpërmjet një procedure normale legjislative. Për rrjedhojë, shqyrtimi dhe miratimi i çdo çështjeje që përfshihet në sferën e rregullimit të këtij ligji, përbën vetëm rezervë të Kuvendit.

111. Kjo jurisprudencë e zhvilluar kushtetuese ka konkluduar se ligji që miraton Kuvendi, duke vlerësuar, formalisht dhe substancialisht aktin normativ me fuqinë e ligjit sipas nenit 101 të Kushtetutës është instrumenti

konvertues i të parit si ligj material në një ligj formal dhe, ky i fundit, nuk mund të jetë veçse ligj i thjeshtë. Bazuar në këtë karakteristikë të ligjit miratues të aktit normativ, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se edhe çdo ndryshim që mund t'u bëhet ligjeve të listës së nenit 81 të Kushtetutës në tërësi, ose dispozitave të veçanta të tyre, nuk mund të arrihet nëpërmjet një ligji të thjeshtë, siç ka ndodhur në rastin konkret, por nëpërmjet një ligji të cilësuar, të miratuar në një procedurë normale nga Kuvendi, me të paktën tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se për sa kohë Kuvendi nuk mund të delegojë pushtetin e tij ligjbërës, por ka detyrimin kushtetues të përmbushë kërkesat procedurale dhe lëndore për miratimin e ligjeve të cilësuara, sipas nenit 81/2 dhe 83, të Kushtetutës, në raport me nenet 1, 2, 4, 7 dhe 116, të Kushtetutës, aq më pak Këshilli i Ministrave mund të ndërhyjë me akte normative me fuqinë e ligjit në ato fusha, rregullimi i të cilave, *expressis verbis*, përbën kompetencë ekskluzive të Kuvendit.

112. Në vijim të kësaj analize, bazuar në nenet 6, 42, 135 dhe në veçanti, në nenin 81, të Kushtetutës, Kolegji konkludon se, me qëllim ruajtjen e standardit kushtetues të mbrojtjes juridiksionale të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i gjithë procesi i dhënies së drejtësisë në Republikën e Shqipërisë krijohet, organizohet dhe funksionon, sipas ligjit që miratohet me shumicën e cilësuar të Kuvendit. Shkronja a, e nenit 81, të Kushtetutës nuk lidhet ngushtësisht me institucionin në kuptimin formal, por me përmbajtjen dhe substancën e funksioneve kushtetuese dhe ligjore që një institucion ushtron. Kjo detyron Kuvendin që sa herë miraton gjykata të posaçme të vlerësojë se ligji i përmendur në dispozitat e sipërcituara do të duhet të miratohet me 3/5 e të gjithë deputetëve, pasi dhënia e drejtësisë është një nga pushtetet kryesore të sistemit të qeverisjes *(shih, nenin 7 të Kushtetutës)*.

113. Në respektim të këtij standardi kushtetues që i shërben mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës, Kolegji vlerëson se edhe në rastin kur pushteti i dhënies së drejtësisë i besohet, jo një gjykate në kuptim të nenit 135, pika 1, të Kushtetutës, por një organi publik, që jo aq për emërtimin që mban apo klasifikimin institucional që ka në organikën shtetërore, por për funksionin e rëndësishëm *quasi* gjyqësor që kryen, do të duhet që procesi i ligjbërjes të respektojë garancitë kushtetuese të nenit 81 të Kushtetutës. Është e domosdoshme se për t'i dhënë pushtet një organi administrativ, që cilësohet apo njihet si *quasi* gjyqësor, duhet t'i jepen të paktën të njëjtat garanci pavarësie dhe paanësie, sikurse gjykatat klasike. Të dyja këto kategori organesh shtetërore e kanë njëlloj të nevojshme garancinë e nenit 81 të Kushtetutës, jo për emrin që mbajnë, por për funksionet që kryejnë.

114. Kolegji vlerëson se edhe aktet nënligjore normative nuk mund të

rregullojnë, në bazë dhe për zbatim të nenit 118 të Kushtetutës, organizimin dhe funksionimin e organeve *quasi* gjyqësore në kundërshtim me ligjin apo në rastet kur nuk ka një autorizim ligjor nga një ligj i miratuar, sipas nenit 81 të Kushtetutës.

115. Në vijim të kësaj analize vlen të interpretohet, gjithashtu, nga Kolegji, *nëse është e mundur me një ligj me shumicë të zakonshme parlamentare apo me akte nënligjore normative të rregullohet procedura apo riti i shqyrtimit të organeve quasi gjyqësore?* Në praktikën kushtetuese dhe parlamentare të Shqipërisë tradita ka formësuar konkluzionin se koncepti i organizimit dhe funksionimit të një institucioni shtrihet edhe në procedurën e shqyrtimit të çështjeve. Kështu, mjafton të sillet në vëmendje ligji organik i Gjykatës Kushtetuese apo ligji organik që krijoi gjykatat administrative për të kuptuar se si pjesë e organizimit dhe funksionimit të një institucioni kushtetues është vlerësuar edhe procedura e shqyrtimit të çështjeve. Në këtë kuptim nxirret konkluzioni se edhe vetë procedura e shqyrtimit të një çështje nga ana e organeve *quasi* gjyqësore është një aspekt i organizimit dhe funksionimit të tyre.

116. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim rezulton se procedura e shqyrtimit të KMCAP Epror, fillimisht parashikohet në disa dispozita të ligjit nr.7793/1993 dhe, më tej, detajohet, sipas pikës 4, të nenit 39/2, të këtij ligji me VKM-në nr. 505.

117. Në leximin e parashikimeve procedurale të VKM-së nr.505 konstatohet se, për herë të parë, në historinë e së drejtës procedurale civile, penale dhe administrative prezantohet një procedurë e posaçme e gjykimit në mungesë të ankuesit, në të cilën akti nënligjor normativ i jep vlerë provuese dhe vendimmarrëse vetë mungesës si fakt procedural. Ndër të tjera, ky akt nënligjor normativ parashikon se mungesa e pajustifikuar e ankuesit në proces passjell rrëzimin e ankimit apo humbjen e statusit të invaliditetit, që do të thotë edhe shuarjen e së drejtës për të përfituar nga mbrojtja shoqërore.

118. Kolegji vlerëson se çështje të tilla me rëndësi themelore të së drejtës procedurale nuk mund të prezantohen në rendin juridik, për herë të parë, nga një akt nënligjor normativ. Këtë gjë në historinë e shtetit shqiptar nuk e ka bërë as Shtojca e Dytë e Procedurës Civile, as KPC-ja i vitit 1958, as KPP-ja i vitit 1953, as KPC-ja i vitit 1981, as KPP-ja i vitit 1977, as KPC-ja në fuqi, pavarësisht ndryshimeve ligjore ndër vite, as KPP-ja në fuqi, pavarësisht ndryshimeve ligjore ndër vite, as KPA-ja i vitit 1999 dhe i vitit 2014 dhe as ligji nr.49/2012.

119. Për rrjedhojë, përmes këtij shembulli të marrë nga rregullimet procedurale me karakter nënligjor, në rastin e KMCAP Epror, Kolegji vlerëson se procedura e shqyrtimit të çështjeve ka një rëndësi themelore

për vetë të drejtën kushtetuese dhe konventore të procesit të rregullt ligjor dhe, si e tillë, ajo do të duhet të jetë objekt i rregullimeve parësore ligjore. Bazuar në shkronjën a dhe d, të pikës 2, të nenit 81, të Kushtetutës mund të konkludohet se riti i gjykimit penal, civil apo administrativ do të duhet të jetë objekt rregullimi, kryesisht i ligjeve organike apo i kodeve dhe, në çdo rast, i ligjeve me shumicë të cilësuar. Për rastin në shqyrtim, zgjidhja ligjore mund të ishte gjetur edhe në parashikimet e KPA-s, apo me një ligj tjetër, por jo të krijohej një rit i posaçëm gjykimi me akt nënligjor normativ. Sigurisht, nuk mund të përjashtohet mundësia që një ligj i tillë të zbatojë parashikimet e delegimit të rregullimit normativ, sipas nenit 118 të Kushtetutës, por në çdo rast delegime të tilla të pushtetit normativ nuk mund të bëhen për çështje kaq themelore të së drejtës procedurale. Ato do të duhet gjithnjë të jenë domen ekskluzivisht i ligjit me shumicë të cilësuar.

120. Në rastin konkret konstatohet se e gjithë procedura e shqyrtimit të rekurseve administrative e KMCAP Epror është rregulluar me ligj me shumicë të thjeshtë dhe, për më tepër, me akt nënligjor normativ, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 39/2 të ligjit. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se edhe parashikimet procedurale të procesit të shqyrtimit të rekursit administrativ të individit kundër një vendimi të komisioneve rajonale nga ana e KMCAP Epror nuk plotësojnë proceduralisht dhe materialisht garancitë e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

121. Nga analiza e mësipërme, Kolegji konkludon në sentencën e parë të këtij vendimi njësues, duke vendosur se:

Ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar në vitin 2011, nuk plotëson të gjitha standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja, në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë" dhe standardet kushtetuese të gjykatës së caktuar me ligj, mbi pavarësinë dhe patundshmërinë e anëtarëve të KMCAP Epror, sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, konkludohet se KMCAP Epror, sipas rregullimit që i ka bërë ky ligj, nuk është formësuar si një organ quasi gjyqësor. Përderisa nuk plotëson këtë kusht thelbësor, nuk mundet që paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror të mos i nënshtrohen kontrollit gjyqësor dhe këto vendime nuk mund të përcaktohen nga ligji si akte administrative të pakundërshtueshme.

B. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njehsim: Si duhet interpretuar dhe zbatuar neni 39/1 i ligjit nr.7703/1993, konkretisht pika 3, në pjesën ku parashikon se "...Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë" dhe si qëndron kjo dispozitë në raport me dispozitat e tjera procedurale, ligjore dhe kushtetuese që parashikojnë të drejtën e përgjithshme të ankimit, si e drejtë themelore?

122. Pasi u konkludua më sipër, me sentencën njësuese mbi çështjen e parë, duket se merr një zgjidhje edhe çështja e dytë. Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ, nëse organi administrativ i krijuar nga ligji për shqyrtimin e "të drejtave dhe detyrimeve civile", nuk plotëson elementet materiale të gjykatës, atëherë mosparashikimi i kontrollit gjyqësor passjell shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

123. Megjithatë, sa e thjeshtë paraqitet zgjidhja në parim e kësaj çështje, po aq ndërlikohet për shkak të parashikimeve të ligjit nr.7703/1993, sepse duhet respektuar sa detyrimi kushtetues nga çdo gjykatë, sipas nenit 145 të Kushtetutës, për zgjidhjen e një çështjeje konkrete, po ashtu edhe dhënia e arsyeve në rast të shmangies së zbatimit të ligjit, në respektim të parimit të epërsisë dhe të zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjes ndërkombëtare, sipas nenit 122 të Kushtetutës.

124. Neni 39/1 i këtij ligji, pas ndryshimeve në vitin 2011, ka parashikuar se: "*1. Kundër Vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të nivelit të parë, personi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (më poshtë Komisioni Epror); 2. Ankimi paraqitet në formën e parashikuar me Vendim të Këshillit të Ministrave; 3. Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë.*".

125. Kolegji risjell në vëmendje se Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 55, datë 31.03.2021 ka orientuar Gjykatën e Lartë për të bërë interpretim pajtues të kësaj dispozite, duke theksuar se koncepti "*formë e prerë*" mund të marrë kuptime të ndryshme sipas legjislacionit në fuqi dhe jo në çdo rast është i barasvlershëm me konceptin e vendimit final. Gjykata Kushtetuese ka sjellë si shembull, për analogji, Vendimin unifikues nr.2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku është diferencuar fuqia ekzekutive e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, nga cilësia gjë e gjykuar.

126. Kolegji ndan një qëndrim të ndryshëm nga ky orientim i Gjykatës Kushtetuese, mbi interpretimin e këtij ligji, për arsyet që do të parashtrohen në vijim.

127. Së pari, Ligji nuk ka dhënë përkufizime për të sqaruar kuptimin e frazës "vendim gjyqësor i formës së prerë". Megjithatë konceptin "formë e prerë", si cilësi dhe status ligjor të një vendimi, ligji e përmend edhe në dy dispozita të tjera. Njërin formulim e gjen në nenin 39/4, ku parashikohet se anëtari i KMCAP Epror shkarkohet nga detyra, nëse dënohet me një vendim gjyqësor penal të formës së prerë. Për të përcaktuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, sipas këtij rregullimi, do t'i referohemi parashikimit që

jepet në nenin 462 të KPP-s. Formulimin tjetër e gjen në shkronjën d) të së njëjtës dispozitë ligjore, ku parashikohet se mandati i anëtarit të KMCAP Epror përfundon kur vërtetohet paaftësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Edhe për këtë formulim do të duhet t'i referohemi parashikimit që bën neni 451 i KPC-s.

128. E përbashkëta e këtyre dy parashikimeve normative mbi konceptin "formë e prerë e një vendimi", për llogari të zbatimit të ligjit nr.7703/1993, të ndryshuar, qëndron te situata juridike e prekluzivitetit të ankimeve dhe njëherazi te finaliteti i një zgjidhjeje ligjore administrative apo gjyqësore.

129. Ligji nr.7703/1993 përmban edhe një tjetër formulim mbi formën e prerë të vendimit, në nenin 86, pika 3, ku parashikohet se ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme (duke iu referuar Komisionit të Ankimit pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore apo Komisionit të Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore), bëhen në gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar. Pra, cilësisë së vendimit të formës së prerë, sipas këtij ligji, i shtohet edhe cilësia e vendimit përfundimtar, duke konkluduar se kjo zgjidhje administrative është finale dhe e pamundur të kontestohet gjyqësisht.

130. Krahas interpretimit literal dhe sistematik, Kolegji çmon të ndalet edhe tek interpretimi teleologjik dhe se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit në përdorimin e togfjalëshit "formë e prerë", kur përcakton efektet e vendimeve të KMCAP Epror. Në këtë kuadër, Kolegji risjell në vëmendje Raportin e Veprimit, datë 03.05.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ku janë marrë në analizë, ndër të tjera, edhe masat e përgjithshme të Republikës së Shqipërisë për të adresuar zgjidhje në sistemin e brendshëm ligjor për zbatimin e vendimit të GJEDNJ në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*". Në raport pasqyrohet se në Kuvend u hodh poshtë propozimi për të lejuar ankim gjyqësor kundër vendimeve të KMCAP Epror, të pafavorshme për llogari të subjekteve kërkues, duke u miratuar norma ligjore në variantin se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë, të paankimueshme dhe të detyrueshme.

131. Nisur nga këto tri forma të interpretimit të ligjit, Kolegji vlerëson se koncepti "formë e prerë", i përdorur nga ligjvënësi në nenin 39/1, pika 3, të ligjit nr.7703/1993, pa ekuivok dhe pa dyshim është i njëjtë me konceptin e vendimit përfundimtar dhe të paankimueshëm gjyqësisht. Me këtë zgjidhje ligjvënësi ka konkluduar se çështja konsiderohet e përfunduar në procedurën administrative, pa asnjë mundësi ankimi në gjykatë

132. Së dyti, nëse ligjvënësi do të kishte pasur të konsoliduar si qëllim të këtij ligji se cilësia "formë e prerë" e vendimeve të KMCAP Epror, nuk është e njëjtë me cilësinë e "vendimit përfundimtar, të paankimueshëm

gjyqësisht", nuk do të ishte e nevojshme angazhimi i Kuvendit, në vitin 2011, që nëpërmjet ndryshimeve të ligjit nr.7703/1993, të kërkonte përmbushjen e standardeve të GJEDNJ-së, për ta konturuar KMCAP Epror si *quasi* gjykatë. Kolegji vlerëson se synimi i ligjvënësit, pavarësisht se nuk e ka përmbushur tërësisht këtë detyrim të GJEDNJ, për ta formatuar KMCAP Epror si një organ *quasi* gjyqësor, përputhet me konceptin për të mos lejuar kundërshtimin në gjykatë të këtyre vendimeve.

133. Në kushtet ku neni 39/1, pika 3, ka ndaluar shprehimisht kontrollin gjyqësor të vendimeve të KMCAP Epror, përpara Kolegjit shtrohet për zgjidhje çështja *nëse i lejohet gjykatës, në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të refuzojë apo të shmangë zbatimin e ligjit, kur vlerëson se ky i fundit vjen në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, në veçanti me KEDNJ-në, duke kërkuar zbatimin e drejtpërdrejtë të kësaj të fundit*. Kjo është një nga çështjet që Gjykata e Lartë ia shtroi për zgjidhje Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet kontrollit incidental, me qëllim shfuqizimin e nenit 39/1, pika 3, të ligjit nr.7703/1993.

134. Në mënyrë të përgjithshme, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se edhe kjo çështje i përket funksionit njësues të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, në respekt të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që nuk vlerësoi se zgjidhja e çështjes i përket atij autoriteti të lartë kushtetues, por Gjykatës së Lartë, mbetet detyrë e këtij Kolegji për të mbajtur një qëndrim përfundimtar, nëpërmjet njësimit të praktikës gjyqësore, mbi raportin juridik midis të drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare.

135. Një nga parimet bazë në marrëdhëniet ndërshtetërore, i sanksionuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është ai i zbatueshmërisë së detyrueshme të marrëveshjeve ndërkombëtare (*pacta sunt servanda*), i cili përbën një nga instrumentet bazë të globalizimit dhe unifikimit të së drejtës. Parimi *pacta sunt servanda* është sanksionuar në Kushtetutë, në nenet ,5 122 ,116, ku marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara i është dhënë një status i veçantë. Në këtë mënyrë Kushtetuta ka ofruar një qëndrim të ri për të drejtën ndërkombëtare në raport me të drejtën e brendshme, sepse aktet ndërkombëtare të ratifikuara, *së pari*, kanë efekt normues, duke i radhitur pas Kushtetutës, *së dyti*, i konsideron pjesë të sistemit të brendshëm juridik, *së treti*, i bën të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, *së katërti*, i klasifikon me epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

136. Neni 116 i Kushtetutës, i cili përcakton hierarkinë e akteve normative në Republikën e Shqipërisë i rendit marrëveshjet ndërkombëtare pas Kushtetutës dhe u jep atyre fuqi mbiligjore në sistemin e burimeve normative. Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar dhe interpretuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, që sanksionon:

"1. *Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji… 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të…".*

137. Në veçanti, KEDNJ-ja, si një nga dokumentet më të rëndësishme ligjore evropiane, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gëzon një status të privilegjuar në rendin kushtetues shqiptar kundrejt të gjitha marrëveshjeve të tjera. Kolegji sjell në vëmendje nenin 17/2 të Kushtetutës, i cili konstitucionalizon shprehimisht statusin e kufizimeve të të drejtave të parashikuara nga KEDNJ-ja, e parë kjo nën dritën e praktikës së GJEDNJ-së. Kjo është një dispozitë referuese, për sa u përket kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe, në këtë plan, KEDNJ-ja ka të njëjtin status me dokumentin themeltar të shtetit.

138. Nisur nga fakti se të drejtat dhe liritë individuale që renditen në Kushtetutën e Republikës së Shqiptare dhe në KEDNJ janë analoge dhe se kufizimet e të drejtave e lirive kanë status kushtetues, konkludohet se çdo shkelje e KEDNJ-së është njëkohësisht edhe shkelje e Kushtetutës. Për rrjedhojë, korrigjimi i shkeljeve konventore do të thotë njëkohësisht edhe korrigjim i shkeljeve të Kushtetutës.

139. Neni 46 i KEDNJ ka parashikuar fuqinë detyruese të vendimeve të GJEDNJ dhe jurisprudencës së saj, e cila është cilësuar si "konventa në veprim". Në pikën 1 të kësaj dispozite është parashikuar: *"Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë…"*. Kërkesat e këtij neni kanë gjetur zbatim gjerësisht në jurisprudencën e GJEDNJ. Kjo e fundit e ka konsideruar ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ, si burimin e përgjegjësisë ndërkombëtare të shtetit palë, i cili, në këtë rast, ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga gjykata dhe rregullimit të pasojave të shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur (*restitutio in integrum*), në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja *(Scozzari dhe Giunta kundër Italisë [DHM], nr.39221/98 dhe nr.41963/98, GJEDNJ 2000-VIII, parag. 249; Assanidze kundër Gjeorgjisë [DHM], nr.71503/01, GJEDNJ 2004-II, parag. 198).*

140. Në praktikën e saj, GJEDNJ-ja është shprehur se, nuk është detyrë e Gjykatës të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin

e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur *(shih, çështja Piersack k. Belgjikës)*.

141. Në veçanti, nëse shkelja e të drejtave dhe lirive themelore, sipas KEDNJ ka ardhur si rrjedhojë e ometimit legjislativ apo parashikimeve të ligjit të brendshëm, GJEDNJ-ja ka theksuar se është detyrë e shtetit të paditur që në sistemin e tij ligjor të brendshëm të heqë pengesat që mund të pengojnë rregullimin e mjaftueshëm të situatës së ankuesit *(shih, Karanović k. Bosnjës dhe Herzegovinës, nr.39462/03, § 28, 20 nëntor 2007)*, ose të propozojë një mjet të ri ligjor, i cili do t'i mundësonte ankuesit të rregullojë situatën.

142. Në këtë kuadër Kolegji çmon të nevojshme të sjellë në vëmendje çështjen *Xheraj kundër Shqipërisë,* ku GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6 në procesin penal nga gjykatat vendase. Rikthimi i kërkuesit në gjendjen e mëparshme nënkuptonte, ndër të tjera, sipas GJEDNJ rihapje të procesit gjyqësor dhe rishikim të vendimit penal. Në atë kohë, kishte një pengesë formale ligjore, pasi KPP-ja nuk parashikonte vendimin e GJEDNJ, si shkak për rishikim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në zbatim të ligjit të brendshëm, vendosën mospranimin e kërkesës për rihapjen e procesit gjyqësor.

143. Çështja e zbatimit të vendimit të GJEDNJ, në këtë rast, u adresua para Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr.20, datë 01.6.2011 vendosi si standard zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimit të GJEDNJ. Ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese u shpreh: [...] Posaçërisht për sa u përket vendimeve të GJEDNJ për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ. Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46, të KEDNJ. Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të ...Gjykata Kushtetuese çmon se respektimi i KEDNJ dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i saj, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore... Gjykata çmon se duke pasur parasysh edhe rolin qendror të Gjykatës së Lartë në sistemin tonë gjyqësor, lipset që kjo gjykatë, në përputhje edhe me nenin 1 të KPP-s, të mos kufizohet

vetëm në dispozitat e këtij Kodi, por të zbatojë drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ."

144. Qasja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në vendimin e sipërcituar, erdhi si rrjedhojë e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave R (2000), të miratuar më datë 19.01.2000, për shtetet anëtare mbi rishqyrtimin apo rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel vendi pas vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

145. Të njëjtën problematikë mbi ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ kishte edhe çështja *Lika dhe Laska kundër Shqipërisë*. Në këtë rast, në lidhje me nenin 46 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja u shpreh se: *"Gjykata konsideron se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse kërkohet nga ankuesi, në parim përfaqëson mënyrën e duhur të rregullimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, që në Rekomandimin nr.R (2000) 2 u kërkonte Shteteve anëtare të Konventës futjen e mekanizmave për rishqyrtimin e çështjes dhe rihapjen e procedimeve gjyqësore në nivelin e brendshëm, duke zbuluar që masa të tilla përfaqësonin "mjetin më efikas, nëse jo të vetmin për arritjen e dëmshpërblimit in integrum" (shih, paragrafin 33 më lart). Gjithashtu kjo reflekton parimet e së drejtës ndërkombëtare ku një shtet përgjegjës për një akt të paligjshëm është i detyruar të bëjë dëmshpërblimin, që konsiston në rivendosjen e situatës që ekzistonte para se të kryhej akti i paligjshëm (neni 35 i projekt-neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësitë e Shteteve për Aktet e Paligjshme Ndërkombëtare – shih paragrafin 35 më lart, dhe, mutatis mutandis, Verein gegen Tierfabriken Schëeiz (VgT) k. Zvicrës (nr. 2) [GC], nr.32772/02, §§ 85-86, GJEDNJ 2009...). 76. Gjykata vëren se sistemi ligjor penal i shtetit të paditur nuk parashikon mundësinë e rishqyrtimit të çështjeve, duke përfshirë rihapjen e procedimeve të brendshme, në rast se kjo Gjykatë konstaton shkelje të rëndë të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur (shih, Piersack k. Belgjikës (neni 50), 26 tetor 1984, § 12, seria A nr. 85), me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me përfundimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës, si dhe me të drejtat e mbrojtjes (shih, Lyons dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr.15227/03, GJEDNJ 2003-IX).77. Megjithatë, Gjykata konsideron që është detyrë e shtetit të paditur që në sistemin e tij ligjor të brendshëm të*

heqë pengesat që mund të pengojnë rregullimin e mjaftueshëm të situatës së ankuesit (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Karanović k. Bosnjës dhe Herzegovinës, nr.39462/03, § 28, 20 nëntor 2007) ose të propozojë një mjet të ri ligjor, i cili do t'i mundësonte ankuesit të rregullonte situatën. Për më tepër, shtetet kontraktuese janë të detyruara të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të plotësojnë kërkesat e Konventës. Gjithashtu ky parim zbatohet për rihapjen e procedimeve gjyqësore dhe rishqyrtimin e çështjeve të ankuesve. (shih, mutatis mutandis, Verein gegen Tierfabriken Schëeiz (VgT) (nr. 2), cituar më lart, § 97.)

146. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ-ja dhe Këshilli i Ministrave në Rekomandimin e tij 6/2004, për përmirësimin e mjeteve të brendshme të ankimit, përcaktuan se shtetet ishin të detyruara të modifikonin të drejtën e tyre të brendshme për t'u dhënë fund shkeljeve të Konventës dhe për të ekzekutuar vendimet e GJEDNJ. Modifikimi i së drejtës së brendshme nënkupton edhe krijimin e mjetit juridik nga gjykatat, në mungesë të ligjit të shprehur *(shih, çështjen Maestri kundër Italisë; Asanzide kundër Gjermanisë etj.,.).* Në interpretim dhe zbatim të nenit 46 të KEDNJ-së, në këto raste, GJEDNJ-ja është shprehur se: "*…detyrimi i shtetit për të zbatuar vendimet e GJEDNJ-së, nuk nënkupton vetëm zhdëmtimin monetar, por edhe që shteti të përzgjedhë masa të përshtatshme, individuale në rendin ligjor të brendshëm, në mënyrë që t'i jepet fund shkeljes dhe të rregullojë për sa është e mundur pasojat."* (*shih, Scozzari dhe Giunta v.* Italisë [GC], nr.*39221/98* dhe *41963/98, § 249, KEDNJ 2000-VIII, dhe Pisano v.* Italy *(striking out) [GC], nr.36732/97, § 43, 24 October 2002). … Për më tepër, nga neni 1 i Konventës në veçanti, rrjedh se shtetet, palë kontraktuese, me ratifikimin e Konventës kanë marrë përsipër, të përshtatin ligjin e brendshëm me parashikimet e Konventës. Si rrjedhojë, është detyrë e shteteve të heqin çdo pengesë ligjore që mund të pengojë rikthimin e aplikantit në gjendjen e mëparshme…*".

147. Në vijim të kësaj analize, duke u bazuar te dispozitat kushtetuese mbi statusin e posaçëm të KEDNJ-së në rendin e brendshëm, si dhe në nenet 1 dhe 46, të KEDNJ, Kolegji konkludon se vendimet dhe jurisprudenca e GJEDNJ, adreson detyrime për të gjitha pushtetet shtetërore të brendshme për të bërë të mundur zbatimin e menjëhershëm dhe të përshtatshëm të KEDNJ. Krahas pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, një rol të rëndësishëm e luajnë gjykatat, të cilat në veprimtarinë e përditshme ligjzbatuese, duhet të garantojnë zbatimin e KEDNJ dhe vendimeve të GJEDNJ, nëpërmjet teknikave të interpretimit pajtues të ligjit, interpretimeve me analogji dhe kur është rasti, në kushtet e ometimit legjislativ apo të ligjit në kundërshtim

me KEDNJ, të zbatojnë drejtpërdrejt këtë të fundit.

148. Në veçanti, refuzimi nga gjykatat për të zbatuar drejtpërdrejtë KEDNJ dhe praktikën e GJEDNJ, me argumentimin formal të mungesës së ligjit apo ekzistencës së ligjit që pengon zbatimin e saj, në pritje për reforma apo ndërhyrje nga pushteti ligjvënës apo edhe nga Gjykata Kushtetuese, nuk pajtohet me nenin 46 të KEDNJ dhe standardin e vendosur nga GJEDNJ, mbi marrjen e çdo lloj mase të shpejtë, efikase dhe të përshtatshme për rikthimin në gjendjen e mëparshme. Kështu, në çështjen *Vermeire kundër Belgjikës*, GJEDNJ është shprehur se "*Liria e zgjedhjes e lejuar një shteti lidhur me mënyrat e përmbushjes së detyrimeve të tij që burojnë nga Neni 53, nuk i japin atij të drejtën të pezullojë zbatimin e Konventës deri në përfundimin e një reforme*".

149. Nën këtë vështrim krahasues, Kolegji konstaton se zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimeve të GJEDNJ-së, edhe në kushtet e ometimit legjislativ apo të kundërshtive me sistemin e brendshëm ligjor, jurisprudenca e gjykatave të larta të vendeve evropiane e ka përdorur si një ndër mekanizmat e respektimit të nenit 46 të KEDNJ, duke zbatuar standardin e vendosur nga GJEDNJ-ja për "*heqjen e pengesave ligjore për kthimin në gjendjen e mëparshme*". Kështu, në çështjen *Barbera etj., kundër Spanjës*, Gjykata Kushtetuese Spanjolle, në mungesë të ligjit të shprehur vendosi rishikimin e vendimit përfundimtar me efekt *res judicata* me argumentin se lënia në fuqi e një vendimi me shkelje të rënda procedurale ishte në kundërshtim me rendin kushtetues. Kolegji sjell në vëmendje gjithashtu, qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Kasacionit e Republikës së Francës, pas vendimit të GJEDNJ, në çështjen *Brusco kundër Francës,* ku mohimi i së drejtës për të pasur kontakt me një avokat gjatë orëve të para të paraburgimit dhe kërkesa për të pandehurit për t'u betuar para dhënies së dëshmisë u konsideruan shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, Asambleja Plenare e Gjykatës së Lartë Franceze vendosi t'i japë efekt të menjëhershëm vendimit të GjEDNJ lidhur me te drejtën për të pasur kontakt të menjëhershëm me një avokat, megjithëse legjislacioni përkatës, nuk ishte amenduar ende. Ndër të tjera, Gjykata e Kasacionit u shpreh: "*Shtetet palë të Konventës janë të detyruar të respektojnë vendimet e GJEDNJ-së, pa pritur të paditen para saj apo pa pritur modifikimin e legjislacionit përkatës…" (shih më gjerë, vendimin e kësaj gjykate - kërkesa nr.589 i 15 prillit 2011 (10-17.049).*

150. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje Konventën e Vjenës "Për të drejtën e traktateve", e cila ka përcaktuar rregulla për zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjeve ndërkombëtare (siç është dhe KEDNJ-ja). Në këtë Konventë, Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8696, datë 23.12.2000, duke e bërë pjesë të sistemit të brendshëm juridik. Në

nenin 27 të kësaj Konvente është parashikuar se, "*Një palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e tij për të zbatuar një traktat*".

151. Në veçanti, Kolegji vlerëson se detyrimi për zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës rëndon mbi Gjykatën e Lartë, e cila nëpërmjet funksionit të saj kushtetues për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, (sipas nenit 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), arrin të garantojë zbatimin e KEDNJ dhe të vendimeve të GJEDNJ me efekt *erga omnes*, në rastet kur ka ometim legjislativ apo kur ligji vjen në kundërshtim me këtë marrëveshje ndërkombëtare. Vendimet njësuese janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta në raste të ngjashme dhe në këtë mënyrë garantohet edhe një kontroll i centralizuar i konvencionalitetit të ligjit. Në këtë mënyrë arrihet uniformiteti në zbatimin e KEDNJ, garantohet neni 5 i Kushtetutës, sipas të cilit Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, si edhe neni 122 i Kushtetutës mbi zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

152. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, për të gjitha argumentet e dhëna në pjesën e parë të këtij vendimi njësues, në kushtet ku KMCAP Epror nuk plotëson të gjitha elementët e tribunalit në kuptimin material, sipas standarteve të nenit 6 të KEDNJ, të trajtuara në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*, parashikimi i nenit 39/1, pika 3, se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë, përbëjnë mohim të pajustifikuar të aksesit në gjykatë dhe, për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të KEDNJ.

153. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se në raste të tilla gjen zbatim drejtpërdrejt vendimi i GJEDNJ-së, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*, se në rast se KMCAP Epror nuk plotëson kushtet për t'u konsideruar *quasi* gjykatë, atëherë duhet të njihet kontrolli dhe juridiksioni gjyqësor mbi vendimmarrjen e këtij organi.

154. Si rrjedhojë, Kolegji vlerëson se neni 39/1, pika 3, i ligjit nr.7703/1993 do të mbetet i pazbatueshëm, në raport me vendimin e GJEDNJ, si më sipër, dhe në raport me dispozitat e tjera me natyrë procedurale, ligjore dhe kushtetuese, që njohin të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj aktit administrativ.

155. Kolegji sjell në vëmendje, parashikimin e nenit 86/3 të ligjit nr.7703/1993, i cili ka parashikuar se *"Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar..."*. Përderisa nuk ka rregullim ndryshe, mbi procedurën, afatet, kushtet e ushtrimit të padisë ndaj aktit administrativ, do të gjejnë zbatim dispozitat e përgjithshme të ligjit nr.49/2012.

156. Kolegji vlerëson se e drejta e ankimit gjyqësor ndaj aktit administrativ është një prezumim kushtetues që buron nga e drejta e përgjithshme e

kujtdo për akses në gjykatë (neni 42), dhe e drejta kushtetuese themelore për t'u zhdëmtuar/dhe ose rehabilituar nga aktet e paligjshme të organeve publike (neni 44), përveç rasteve kur ligji në mënyrë të shprehur mund ta kufizojë, sipas kritereve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

157. Kolegji vlerëson se, parimi i shtetit të së drejtës kërkon jo vetëm që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet me ligj, por edhe që kjo veprimtari, në raport me të drejtat e shtetasve, t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Prandaj, sipas nenit 42 të Kushtetutës, individi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës edhe kur cenimi i të drejtave, i lirive dhe i interesave kushtetues e ligjorë të tij ka ardhur nga akti apo veprimtaria e organeve të administratës publike *(shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 27.07.2009)*. Aksesi në gjykatë përbën një të drejtë themelore kushtetuese dhe konventore për individin, e cila duhet të garantojë në çdo rast juridiksion fillestar apo rishikues të plotë, ligji apo fakti, me të gjitha karakteristikat e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

158. Në përfundim, Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se nevoja për fleksibilitet dhe eficiencë, që janë plotësisht në pajtim me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund ta justifikojnë shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në lidhje me të *"drejtat dhe detyrimet civile"* nga organe administrative, profesionale dhe të specializuara, në kushtet ku organet gjyqësore nuk përmbushin këto kërkesa në çdo aspekt. Në këtë kuptim, konkluzionet e Gjykatës së Lartë, nuk pengojnë ligjvënësin që në të ardhmen, nëpërmjet ndryshimeve në ligjin nr.7703/1993, të marrë masat për të konturuar KMCAP Epror si një *quasi* gjykatë, me të gjitha elementet që e karakterizojnë atë, sipas jurisprudencës së GJEDNJ, të analizuara në këtë vendim njësues. Vetëm në një eventualitet të tillë, kufizimi i aksesit në gjykatë kundër vendimmarrjes së këtyre organeve do të vlerësohet i pajtueshëm me nenin 6 të KEDNJ, si dhe me vendimin *"Dauti kundër Shqipërisë"* të GJEDNJ.

159. Në vijim, Kolegji konkludon në sentencën e dytë të këtij vendimi njësues se:

Neni 39/1, pika 3, i ligjit nr.7703/1993, në pjesën ku parashikon se "... *Vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë*", vjen në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë". Si rrjedhojë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme, për aq sa rregullimi ligjor për KMCAP nuk arrin të plotësojë kushtet e një organi quasi gjyqësor. Në rastet ku kundërshtohet një vendim i KMCAP Epror, sipas këtij ligji, do të zbatohet drejtpërdrejt ky vendim i GJEDNJ, dhe dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përgjithshme që garantojnë kontrollin gjyqësor mbi aktin administrativ.

C. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

160. Kolegji vlerëson se pretendimi themelor i palës së paditur, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në të dyja shkallët e gjykimit, pretendim i parashtruar edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ka qenë mbi mungesën e juridiksionit gjyqësor për kontrollin e vendimit të KMCAP Epror, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për shkak të parashikimit të nenit 39/1, pika 3, të ligjit nr.7703/1993.

161. Sipas analizës dhe interpretimit të kryer nga Kolegji në këtë vendim njësues, rezulton se ky pretendim i palës së paditur është i pabazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Vendimin e GjEDNJ, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"* dhe në dispozitat e tjera ligjore që njohin të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj këtij akti administrativ, sikurse janë cituar më sipër. Kolegji vlerëson se me të drejtë gjykatat më të ulëta kanë pranuar se mosmarrëveshja i përket juridiksionit gjyqësor.

162. Nga ana tjetër, pretendimet e palës së paditur në rekurs, mbi mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat më të ulëta, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë dhe si të tilla janë të papranueshme.

VENDIME TË KOLEGJIT CIVIL

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2020-211, datë 02.07.2020

Dhënia përparësi juridiksionit të gjykatave të huaja sipas rregullores së Brukselit dhe ligjit shqiptar, është e kushtëzuar dhe mund të bëhet kur plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte a) çështja gjyqësore ka filluar apo padia është regjistruar më parë në kohë në gjykatën e huaj; b) vendimi i gjykatës së huaj është i mundshëm për t'u njohur dhe/ose ekzekutuar në Republikën e Shqipërisë; c) gjykata bindet se pezullimi i shërben miradministrimit të drejtësisë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se, më datë 23.05.2018 paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt zgjidhje martese etj

2. Ka rezultuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesën më datë 29.01.2007 pranë Zyrës së Gjendjes Civile Vorë. Pas martese ata janë larguar për të jetuar në Itali dhe nga martesa kanë ardhur në jetë dy fëmijë. Aktualisht ata jetojnë në Itali, në qytetin e Bolzanos.

3. Ka rezultuar se pala e paditur i është drejtuar me kërkesë për "ndarje gjyqësore të bashkëshortëve", drejtuar Gjykatës së Bolzanos, me datë 25.10.2018. Sa më sipër, gjatë gjykimit, pala e paditur ka kërkuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, me arsyetimin se e njëjta çështje po gjykohej njëkohësisht nga Gjykata e Zakonshme e Bolzanos në shtetin italian, ku jetojnë dhe banojnë aktualisht palët ndërgjyqëse me fëmijët e tyre.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e ndërmjetëm datë 15.02.2019 ka vendosur: "*1. Mospranimin e kërkesës së palës së paditur A.M., për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, si të pabazuar në prova dhe në ligj, për faktin që çështja pranë kësaj gjykate është regjistruar me datë 23.05.2018, ndërkohë që çështja në Gjykatën e Bolzanos, Itali është regjistruar më datë 08.11.2018...Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë...*".

5. Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka arsyetuar se në analizë të përmbajtjes së nenit 20 të Ligjit nr. 10182, datë 29.10.2009 "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Konferencës së Hagës "Për

Procedurën Civile", rezulton se shtetet kontraktuese mund të refuzojnë një padi të paraqitur para tyre, kur procedime të tjera midis të njëjtave palë, bazuar në të njëjtat fakte dhe duke pasur një qëllim të njëjtë, janë duke u shqyrtuar në një gjykatë të një shteti tjetër, vetëm në rast se shtetet kontraktuese kanë lidhur një marrëveshje plotësuese për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në këto shtete kontraktuese (neni 21). Në këtë kuadër, gjykata ka vlerësuar se meqenëse midis shtetit shqiptar dhe Republikës së Italisë nuk është nënshkruar një marrëveshje e tillë për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore sipas parashikimeve të nenit 20 dhe 21 të Konventës së Hagës, atëherë këto shtete kontraktuese nuk kanë asnjë detyrim ligjor për të shmangur gjyqvarësinë ndërmjet proceseve gjyqësore, të cilat mund të zhvillohen njëkohësisht në territorin e tyre. Në rastin konkret, gjykata ka vlerësuar se gjykimi i kësaj çështjeje para gjykatës shqiptare bëhet sipas ligjit procedural shqiptar. Sipas nenit 38 të KPC-s, gjykata shqiptare nuk pushon dhe as pezullon gjykimin e një mosmarrëveshjeje, kur kjo e fundit ose një çështje tjetër që ka lidhje me të është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj.

6. Kundër këtij vendimi, më datë 19.02.2019 ka paraqitur ankim të veçantë, pala e paditur, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor duke parashtruar këto shkaqe: *Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i pabazuar në ligj; Gjykata nuk ka respektuar nenin 25 të Ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011 "Për të Drejtën Ndërkombëtare Private", sipas të cilit zgjidhja e martesës rregullohet nga ligji i shtetësisë së bashkëshortëve në kohën e paraqitjes së padisë dhe kur bashkëshortët kanë shtetësi të ndryshme, do të zbatohet ligji i shtetit në territorin e të cilit kanë vendbanimin ose vendqëndrimin e zakonshëm bashkëshortët në kohën e paraqitjes së padisë; Në rastin konkret të dyja palët kanë marrë shtetësinë italiane, pasi kanë emigruar në Itali dhe janë vendosur përfundimisht në qytetin e Bolzanos, aty ku kanë lindur edhe dy fëmijët e tyre dhe ku ato shkollohen;*

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë në shqyrtim ankimin e veçantë të palës së paditur dhe me vendimin e ndërmjetëm datë 26.02.2019 ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes derisa të shprehet Gjykata e Lartë në lidhje me ankimin e veçantë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, (në vijim, Kolegji) pasi shqyrtoi aktet e dosjes gjyqësore, vlerëson se vendimi nr. s'ka, datë 15.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës

së palës së paditur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, është i bazuar në ligj dhe duhet të lihet në fuqi.

9. Fillimisht, Kolegji rikonfirmon qëndrimin se, juridiksioni është një çështje që përcaktohet ekskluzivisht nga Kushtetuta (*shiko, p.sh. neni 42*), marrëveshjet ndërkombëtare (*shiko, p.sh. neni 6 i KEDNJ-s*) apo nga ligji. Përcaktimi i saktë i çështjes së juridiksionit dhe të kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

10. Në këtë kuptim çështja e juridiksionit është parakushti kryesor për të pasur proces dhe për t'i lindur e drejta dhe detyrimi ligjor gjykatës që të shqyrtojë gjyqësisht pretendimet objekt gjykimi. Që në momentin e ngritjes së padisë nga paditësi duhet të përmbushen detyrimisht kushtet e ngritjes së saj dhe kushtet për të ushtruar të drejtën e padisë. Një nga kushtet thelbësore për të ushtruar të drejtën e padisë është fakti se padia e ngritur i përket juridiksionit gjyqësor dhe në këto rrethana bazuar në efektet juridike të padisë në gjykatë, kjo e fundit është e detyruar që të marrë një vendim përfundimtar për të gjitha problemet e ngritura në padi dhe në asnjë rast nuk është e justifikueshme që ajo të mos shprehet për të gjitha problemet e parashtruara në padi, pasi shkelet një nga parimet themelore të procesit gjyqësor që gjen rregullim në nenin 1 të KPC-s.

11. Kështu, juridiksioni gjyqësor civil është parashikuar në nenin 36 të KPC-s, sipas të cilit janë në juridiksionin gjyqësor të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor është i përgjithshëm dhe i detyrueshëm (neni 1/2 i KPC-s). Një çështje mund të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor kur ligji në mënyrë eksplicite ka përcaktuar se subjekti pretendues, përpara se t'i drejtohet gjykatës duhet të shterojë juridiksionin administrativ ose nëse çështja nuk i përket juridiksionit gjyqësor shqiptar.

12. Në nenin 59, të KPC-s parashikohet se: *"Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor...(...).*" Në analizë të kësaj dispozite konstatohet se çdo lloj gjykate dhe në çdo shkallë gjykimi ka të drejtë të marrë në shqyrtim, të analizojë dhe të vendosë në lidhje me juridiksionin e çështjes objekt gjykimi. Kjo e drejtë e gjykatës për të vepruar edhe kryesisht është e lidhur drejtpërsëdrejti me zbatimin dhe respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor në elementin e gjykatës së caktuar me ligj.

13. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vlerëson se para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 23.05.2018 është paraqitur një padi me objekt zgjidhje martese dhe rregullimin e pasojave që vijnë nga

zgjidhja e martesës. Ka rezultuar se palët kanë shtetësi shqiptare, por kanë vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Italisë, konkretisht në qytetin e Bolzanos, ku kanë ardhur në jetë edhe dy fëmijët e tyre. Më tej, në muajin tetor të vitit 2018, e njëjta padi është ngritur nga pala e paditur në Gjykatën e Zakonshme të Bolzanos.

14. Kolegji verëson se është i drejtë konkluzioni i gjykatës se kjo çështje është në juridiksionin e gjykatës shqiptare, por me tjetër arsyetim. Gjykata e shkallës së parë nuk ka identifikuar drejt ligjin e zbatueshëm në rastin konkret dhe arsyetimi është i paqartë, jokoherent dhe i parregullt në pikëpamje të elementëve formalë dhe strukturës së vendimit gjyqësor. Shkaqet pse gjykata e ka rrëzuar kërkesën janë të ndryshme në pjesë të ndryshme të vendimit. Si fillim gjykata e nis arsyetimin se sipas Konventës së Konferencës së Hagës "Për Procedurën Civile", nuk ka marrëveshje dypalëshe me Republikën e Italisë që ta detyrojë shtetin shqiptar të respektojë gjyqvarësinë për shkak se çështja po gjykohet nga një gjykatë e huaj dhe citon si dispozitë të zbatueshme nenin 38 të pandryshuar të KPC-s sipas të cilit në asnjë rast gjykata nuk ka detyrimin të pezullojë apo të pushojë çështjen nëse e njëjta çështje është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Në përfundim, në dispozitivin e vendimit, ku ka vendosur mbi rrëzimin e kërkesës, gjykata ka ndryshuar shkakun e vendimmarrjes, në mënyrë kontradiktore dhe jokoherente me shkaqet e dhëna në pjesën arsyetuese, se padia në gjykatën shqiptare është regjistruar më parë në kohë dhe për këtë arsye, çështja është në juridiksionin e gjykatës shqiptare.

15. Kolegji sjell në vëmëndje nenin 38 të KPC-s, i cili ka ndryshuar me Ligjin nr. 38/2017, (hyrë në fuqi në 5 nëntor të vitit 2017). Më konkretisht, në këtë dispozitë është parashikuar se: *"1. Kur e njëjta padi, midis të njëjtave palë, me të njëjtin shkak dhe objekt padie është duke u shqyrtuar njëkohësisht nga një gjykatë e shtetit të huaj dhe gjykata shqiptare, kjo e fundit mund të pezullojë gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje kur: a) padia është paraqitur më parë në kohë në gjykatën e shtetit të huaj[33]; b) vendimi i gjykatës së shtetit të huaj është i mundshëm për t'u njohur dhe/ose ekzekutuar në Republikën e Shqipërisë; c) gjykata shqiptare bindet se pezullimi është i nevojshëm për administrimin e duhur të drejtësisë. 2. Gjykata shqiptare mund të vazhdojë procesin në çdo kohë nëse: a) zhduket mundësia e pasjes së dy vendimeve të papajtueshme; b) gjykimi në gjykatën e shtetit të huaj është pezulluar ose pushuar; c) gjykata shqiptare bindet se procesi në gjykatën e shtetit të huaj nuk do të përfundojë në kohë të arsyeshme; ose ç) vazhdimi i gjykimit kërkohet*

[33] Theksim i Kolegjit

për një administrim më të mirë të drejtësisë. 3. Gjykata shqiptare pushon gjykimin kur gjykata e shtetit të huaj zgjidh mosmarrëveshjen me vendim të formës së prerë, i cili mund të njihet dhe/ose ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë.". Ndërkohë neni 38 i pandryshuar i KPC-s parashikonte se: *"Gjykata shqiptare nuk pushon as pezullon gjykimin e një mosmarrëveshjeje, kur kjo e fundit ose një çështje tjetër që ka lidhje me të, është duke e gjykuar nga një gjykatë e huaj."*.

16. Nëpërmjet këtij ndryshimi në KPC, Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër detyrimin për të respektuar gjyqvarësinë (*lis pendencën*) ndërkombëtare, të kushtëzuar, në frymën e Rregullores nr. 1215/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12.12.2012, "Për Juridiksionin dhe Njohjen e Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore në Çështjet Civile dhe Tregtare" (në vijim Rregullorja e Brukselit). Detyrimi për ta përafruar legjislacionin shqiptar me të drejtën e Bashkimit Evropian, me legjislacionin parësor dhe dytësor (*soft law*), buron nga Marrëveshja e Asociim Stabilizimit që ka ratifikuar Shteti Shqiptar me Ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006 (në vijim, MSA) e lidhur me Bashkimin Evropian. Kjo marrëveshje është instrumenti nëpërmjet të cilit shteti shqiptar, një vend jo anëtar i Bashkimit Evropian, ka marrë përsipër angazhimin dhe zotimin e përmbushjes së detyrimeve dhe vendosjes së standardeve të shtetit të së drejtës të gjithëpranuara nga shtetet pjesëmarrëse të bashkësisë evropiane që kërkohen për integrimin dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

16.1. Konkretisht në nenin 70 të MSA-s është parashikuar ndër të tjera se: *"Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me acquis e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet…"*. Kolegji vlerëson se nëpërmjet kësaj dispozite shteti shqiptar ka marrë përsipër zotimin të përafrojë dhe të harmonizojë gradualisht legjislacionin shqiptar me *acquis communautaire* (ligjin evropian parësor dhe dytësor), si një nga parakushtet dhe premisat për integrimin dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Neni 70 i MSA-s është instrumenti nëpërmjet të cilit e drejta e Bashkimit Evropian brendësohet, përthithet dhe bëhet pjesë e rendit juridik shqiptar. Urdhërimi i vendosur në nenin 70 të MSA-s, *në radhë të parë* vendos detyrimin pozitiv për organin ligjbërës që gjatë procesit të nxjerrjes së ligjeve të ketë si standard bazë të drejtën e Bashkimit Evropian. *Në radhë të dytë*, neni 70 vendos detyrimin për organet gjyqësore që gjatë punës së tyre të përditshme të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, për aq sa është e mundur, ta zbatojnë dhe

interpretojnë ligjin me frymën e ligjit komunitar.

17. Kështu në nenin 33 të Rregullores së Brukselit është parashikuar se: "*1. Kur juridiksioni bazohet në nenin 4 ose në nenet 7, 8 ose 9 dhe përpara një gjykate të një shteti të tretë po zhvillohet një procedim në kohën kur një gjykatë e një shteti anëtar është vënë në lëvizje përmes një padie me të njëjtin objekt dhe midis të njëjtave palë si procedimi përpara gjykatës së shtetit të tretë, gjykata e shtetit anëtar mund të pezullojë procedimin nëse: a) pritet që gjykata e shtetit të tretë të japë një vendim gjyqësor që mund të njihet dhe, sipas rastit, të zbatohet në atë shtet anëtar; dhe b) gjykata e shtetit anëtar është e bindur se pezullimi është i nevojshëm për miradministrimin e drejtësisë. 2. Gjykata e shtetit anëtar mund të vazhdojë procedimin në çdo kohë nëse: a) procedimi përpara gjykatës së shtetit të tretë është pezulluar ose ndërprerë; b)rezulton se procedimi përpara gjykatës së shtetit të tretë nuk ka gjasa të mbyllet brenda një kohe të arsyeshme; ose c) vazhdimi i procedimit është i nevojshëm për miradministrimin e drejtësisë. 3. Gjykata e shtetit anëtar ndërpret procedimin nëse procedimi në gjykatën e shtetit të tretë është mbyllur dhe ka rezultuar në një vendim gjyqësor që mund të njihet dhe, sipas rastit, të zbatohet në atë shtet anëtar. 4. Gjykata e shtetit anëtar zbaton këtë nen me kërkesë të njërës prej palëve ose, nëse e lejon legjislacioni i tij i brendshëm, kryesisht.".*

18. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji thekson se ndryshimi i nenit 38 të KPC-s (me Ligjin nr. 38/2017) ishte detyrim që buronte nga marrëveshjet ndërkombëtare në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Europian si dhe në kuadër të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e tjera. Por nga ana tjetër, duke qënë që me këtë dispozitë cedohet nga një porcion i sovranitetit të shtetit, ligji ka paraparë disa kushte për njohjen e gjyqvarësisë apo procedurave paralele gjyqësore në shtete të tjera, për të njëjtën çështje, me të njëjtat palë, objekt dhe shkak ligjor. Kështu, gjykata shqiptare ka të drejtë fillimisht të pezullojë gjykimin nëse: a) çështja gjyqësore ka filluar apo padia është regjistruar më parë në kohë në gjykatën e huaj; b) vendimi i gjykatës së huaj është i mundshëm për t'u njohur dhe/ose ekzekutuar në Republikën e Shqipërisë; c) gjykata bindet se pezullimi i shërben miradministrimit të drejtësisë.

18.1. Kushti i parë, i parashikuar në paragrafin e parë, pika "a", e nenit 38, në fakt frymëzohet nga i njëjti parim që rregullon gjyqvarësinë kombëtare, sipas të cilit përparësi i jepet çështjes gjyqësore të regjistruar më parë në kohë (neni 58 i KPC-s). Po ashtu ky parim ka karakter universal dhe përbën premisën bazë për të gjykuar dhe vendosur mbi situatën e lispendencës. Kështu edhe në Rregulloren e Brukselit, në nenin 29 është

parashikuar se: "*Pa cenuar nenin 31, paragrafi 2, kur përpara gjykatave të shteteve anëtare nisin procedime që përfshijnë padi me objekt dhe palë të njëjta, çdo gjykatë e ndryshme nga gjykata e vënë e para në lëvizje pezullon kryesisht procedimin e saj, derisa të përcaktohet juridiksioni i gjykatës që është vënë në lëvizje e para. 2. Në rastet e përmendura në paragrafin 1, me kërkesën e një gjykate të vënë në lëvizje për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, çdo gjykatë tjetër e vënë në lëvizje i njofton pa vonesë gjykatës së mëparshme datën kur ajo është vënë në lëvizje në përputhje me nenin 32. 3. Kur është përcaktuar juridiksioni i gjykatës së vënë në lëvizje e para, çdo gjykatë e ndryshme nga ajo refuzon juridiksionin në favor të asaj gjykate.".*

18.2. Kushti i dytë frymëzohet nga fakti se faza njohëse e së drejtës dhe faza ekzekutive janë pjesë integrale e të njëjtit proces dhe aksesi në gjykatë do të ishte teorik dhe iluzor nëse palës gjyqfituese nuk do t'i ekzekutohej vendimi gjyqësor i një gjykate të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për të vlerësuar kushtin e dytë, gjykatat do t'i referohen nenit 394 të KPC-s, i cili parashikon kushtet e njohjes së vendimeve të gjykatave të huaja në Republikën e Shqipërisë. Kjo dispozitë ka parashikuar se: "*Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur: a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin; b) kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet; c) midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare; ç) është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë; d) i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij; dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.*

18.3. Kurse kushti i tretë që lidhet me miradministrimin e drejtësisë do të vlerësohet nga gjykatat rast pas rasti, pasi të jetë verifikuar plotësimi në mënyrë të detyrueshme i dy kushteve të para (*conditio sine qua non*). Në vlerësimin e kushtit të tretë, gjykatat kanë pushtet diskrecional për, për të konkluduar nëse duhet të prevalojë juridiksioni i gjykatave të huaja dhe në këtë vendimmarrje do të duhet që të mbajnë parasysh të drejtën ndërkombëtare, frymën e Rregullores së Brukselit, praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështje të ngjashme, si dhe garancitë kombëtare dhe ndërkombëtare të palës ndërgjyqëse për akses në gjykatë dhe për proces të rregullt ligjor. Kolegji vlerëson se njëlloj sikurse parashikon edhe neni 33

i Rregullores së Brukeslit, këto tri kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, në mënyrë që t'i jepet përparësi juridiksionit të gjykatave të huaja. Edhe në kushtet kur plotësohen në mënyrë kumulative këto tri kushte, përsëri dhënia përparësi e juridiksionit të gjykatave të huaja mbetet e kushtëzuar pasi gjykatat e pezullojnë gjykimin fillimisht dhe më pas mund ta vazhdojnë përsëri procesin në kushtet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 38.

19. Kolegji vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas të cilit midis Shtetit Shqiptar dhe Shtetit Italian nuk ka një marrëveshje dypalëshe që të detyrojë Republikën e Shqipërisë të njohë procedurat paralele gjyqësore për të njëjtën çështje nuk është koherent me ndryshimet e KPC-s dhe me të drejtën procedurale të Bashkimit Europian. Nga ana tjetër, përtej anës formale se shkaqet e vendimit gjyqësor duhet të jepen në pjesën arsyetuese dhe jo në pjesën dispozitive të vendimit, Kolegji vlerëson se, *ratio decidendi* i vendimit duhet të ishte pikërisht rrëzimi i kërkesës bazuar në nenin 38 të ndryshuar të KPC-s dhe nenet 71 e vijues të Ligjit nr. 10428/2011 "Për të Drejtën Ndërkombëtare Private" (në vijim, Ligji nr. 10428/2011), që përcaktojnë juridiksionin e gjykatës shqiptare në mosmarrëveshjet me elementë të huaj. Ndryshe nga sa ka pretenduar pala e paditur në ankimin e veçantë, në rastin konkret nuk gjen zbatim neni 25 i Ligjit nr. 10428/2011, pasi kjo dispozitë përcakton kriteret e ligjit material të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel, ndërkohë që dispozitat që përcaktojnë kriteret se si individualizohet juridiksioni i gjykatës shqiptare në marrëdhëniet juridike me elementë të huaj gjenden në nenet 71 e vijues të këtij Ligji.

20. Mosmarrëveshja me objekt zgjidhje martese, në rastin konkret mbart elementë të huaj, pasi palët ndërgjyqëse me shtetësi shqiptare janë me vendqëndrim të zakonshëm në Republikën e Italisë. Sipas nenit 75/a të Ligjit nr. 10428/2011 gjykata shqiptare ka juridiksion në shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje. Ndryshe nga sa ka pretenduar pala e paditur në ankimin e veçantë, në këtë rast nuk gjen zbatim neni 25 i Ligjit nr. 10428/2011, pasi kjo dispozitë përcakton kriteret e ligjit material të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel, ndërkohë që dispozitat që përcaktojnë kriteret se si individualizohet juridiksioni i gjykatës shqiptare apo i gjykatave të huaja në marrëdhëniet juridike me elementë të huaj gjenden në nenet 71 e vijues të këtij Ligji. Nga ana tjetër, mosmarrëveshja nuk përfshihet në një nga rastet e parashikuara të nenit 72 të këtij ligji që përcakton juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare. Kolegji vlerëson se neni 38 nuk zbatohet kur gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv mbi mosmarrëveshjen, pasi në një situatë të tillë në çdo rast ka përparësi juridiksioni ekskluziv.

Një rregull i tillë gjen pasqyrim në nenin 27 të Rregullores së Brukeslit, i cili ka parashikuar se: *"Kur një gjykatë e një shteti anëtar vihet në lëvizje përmes në kërkese e cila lidhet kryesisht me një çështje mbi të cilën gjykatat e një shteti tjetër anëtar kanë juridiksion ekskluziv në bazë të nenit 24, ajo deklaron kryesisht se nuk ka juridiksion."*.Po ashtu, kjo konkludohet edhe nga një interpretim sistematik i nenit 38/1/b me nenin 394/a të KPC-s. Në një rast të tillë, vendimi i gjykatës së huaj nuk do të kishte mundësi të njihej në Republikën e Shqipërisë, pasi kësaj të fundit do i mungonte kompetenca (juridiksioni) për të gjykuar çështjen dhe në këtë rast *apriori* nuk do të plotësohej kushti i dytë i parashikuar në nenin 38 për pezullimin e gjykimit. Kjo do të thotë se neni 38 gjen zbatim vetëm në situatën kur çështja është në mënyrë alternative në juridiksionin e dy gjykatave, shqiptare dhe gjykatës së huaj.

21. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, në rastin konkret padia me objekt zgjidhje martese është regjistruar më parë në kohë në gjykatën shqiptare, si rrjedhojë çështja përbën lëndë gjykimi për gjykatën shqipare. Për sa kohë nuk plotësohet kushti i parë sipas nenit 38/1/a, mbetet jorelevante për t'u marrë në analizë kushtet e tjera. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se duhet të lihet në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas arsyetimit të mësipërm.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 179/1, datë 30.09.2020

Është në diskrecion Gjykatës së Lartë që të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, i cili sjell pasoja të parikuperueshme dhe të menjëhershme, duke mbajtur në konsideratë që pasojat që ka sjellë vendimi të jenë të balancuara dhe proporcionale për të gjitha palët që preken prej tij.

I. Rrethanat e çështjes

1. Referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se paditësi H.H. i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në vitin 2016.

2. Me vendimin nr. 343, datë 01.03.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: Rrëzimin e padisë nr. 1415 regj.,, datë 07.03.2016.

3. Me vendimin nr. 1032, datë 11.12.2018, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: -Ndryshimin e vendimit nr. 343, datë 01.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në këtë mënyrë: Pranimin e padisë. Detyrimin e të paditurës Shoqëria "C." shpk t'i dorëzojë palës paditëse H.H. në objektin e ndërtuar me leje ndërtimi nr. 2/206, datë 28.09.2011 të KRRT Bashkisë Vlorë, të miratuar në emër të subjektit "C." shpk, ambientet si më poshtë [...].

4. Rezulton se ndaj vendimit nr. 1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka ushtruar të drejtën e rekursit pala e paditur në gjykimin e themelit, Shoqëria "C." shpk.

5. Me kërkesën nr. 885 prot., datë 19.03.2019, pala e paditur Shoqëria "C." shpk i është drejtuar Gjykatës së Lartë për të kërkuar vendosjen e pezullimit të ekzekutimit të vendimit nr. 1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ishte vënë në ekzekutim nga pala paditëse nëpërmjet shërbimit përmbarimor. [...]

6. Kërkesa e shoqërisë "C." shpk për pezullimin e vendimit nr. 1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, i është njoftuar palës së interesuar H.H., e cila ka prapësuar para Gjykatës së Lartë [...]

7. Me vendimin nr. 179, datë 08.04.2019, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: -Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë deri në shqyrtimin e kësaj çështje nga Gjykata e Lartë.

8. Pala paditëse në gjykimin e themelit të çështjes, H.H., përfaqësuar nga Av. T.C., i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesën nr. 968 prot., datë 21.05.2020 me të cilën ka kërkuar revokimin e vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Tiranë [...]

9. Kërkesa me nr. 968 prot., datë 21.05.2020 për revokimin e vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i është njoftuar palës së interesuar, shoqërisë "C." shpk, e cila nuk ka paraqitur asnjë parashtresë dhe asnjë argument në lidhje me qëndrimin e saj ndaj kësaj kërkese.

10. Gjatë kohës që çështja ka qenë për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë, kërkuesi H.H., i është drejtuar Gjykatës së Lartë me parashtresën nr. 1565 prot., datë 10.07.2020, me të cilën ka paraqitur disa argumente shtesë dhe prova shkresore për të mbështetur kërkesën e tij për revokimin e vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Tiranë [...]

11. Parashtresa me nr. 1565 prot., datë 10.07.2020, me të cilën subjekti kërkues H.H. ka paraqitur disa argumente shtesë dhe prova shkresore për të mbështetur kërkesën e tij për revokimin e vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Tiranë, i është njoftuar palës së interesuar, shoqërisë "C." shpk, [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

12. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa e palës kërkuese, për të revokuar vendimin nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Tiranë, me të cilin është pezulluar ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. 1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

13. Kolegji fillimisht vlerëson të theksojë se neni 479/1 i KPC-s garanton vendosjen e masës së përkohshme procedurale të pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë (në kuptimin material) në funksion të zgjidhjes së rekursit, që është ushtruar ndaj vetë vendimit të formës së prerë, sigurisht duke pasur parasysh arsyet justifikuese të zbatimit të kësaj mase, sikur mundet të jetë *dëmi i rëndë* dhe *i pariparueshëm* që mund të sjellë ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kjo e drejtë e palës ndërgjyqëse gjyqhumbëse është paraparë nga ligji procedural civil si mjet që garanton ankimin efektiv në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Por duhet theksuar se kjo është një masë e përkohshme me karakter *përjashtimor* dhe të *jashtëzakonshëm*. Kjo do të thotë se pala ndërgjyqëse gjyqhumbëse që bën kërkesën për pezullimin e

vendimit gjyqësor të formës së prerë ka barrën t'i paraqesë Gjykatës rrethanat konkrete, të bazuara në prova nga të cilat nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë, kësaj pale mund t'i vijë një dëm i rëndë në mënyrë të pakthyeshme.

14. Ndërsa, në pikën 6 të nenit 479 të KPC-s, parashikohet qartësisht se: "*Vendimi i Gjykatës së Lartë mbi kërkesën për pezullim mund të revokohet ose ndryshohet me kërkesë të palës. Për shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin ose revokimin e masës së pezullimit njoftohen palët. Brenda 3 ditëve pala tjetër ka të drejtë të paraqesë me shkrim parashtrimet. Kërkesat shqyrtohen në dhomë këshillimi*".

15. Në analizë të dispozitës ligjore të sipërcituar, Kolegji vlerëson se kërkesa për revokim të vendimit të pezullimit, duhet të lidhet ngushtësisht me shkaqet, rrethanat dhe kushtet që ka paraqitur pala kërkuese dhe ka vlerësuar gjykata, në momentin që ka dhënë vendimin për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Në këtë kuptim, në rastin e kërkesës për revokimin e pezullimit, pala që pretendon revokimin e vendimit, duhet të pretendojë para gjykatës se shkaqet dhe rrethanat që e kanë detyruar gjykatën për të vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, kanë rënë, janë shuar ose këto rrethana kanë ndryshuar në atë shkallë pas dhënies së vendimit të pezullimit, sa e bëjnë këtë vendim joaktual dhe që ka humbur qëllimin për të cilin është dhënë.

16. Ligjvënësi ka qenë i kujdesshëm, që në këto lloj gjykimesh të parashikojë qartësisht se pala që paraqet kërkesën për revokimin e vendimit të pezullimit, duhet të paraqesë edhe prova shkresore që provojnë pretendimet e saj, në mënyrë që kërkesa për revokim të respektojë jo vetëm parimin e sigurisë juridike të vendimeve gjyqësore, parimin e garantimit të proporcionalitetit të interesave të palëve që preken prej vendimit të pezullimit, por edhe të justifikohet nga pikëpamja e ligjit dhe faktit heqja e një mase të përkohshme, e cila kurrsesi nuk mund të kthehet në një mjet abuziv procedural nga palët e interesuara. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit kur e ka parashikuar mjetin procedural të kërkesës për revokimin e vendimit të pezullimit, si një risi në ndryshimet ligjore që i ka bërë KPC në vitin 2017.

17. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji pasi mori në shqyrtim dhe vlerësim pretendimet e ngritura nga pala kërkuese H.H., prapësimet e dhëna nga pala e interesuar shoqëria "C." shpk, si dhe vlerësoi provat shkresore të depozituara gjatë këtij gjykimi, arrin në konkluzionin se pas dhënies së vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Tiranë, pala kërkuese është vendosur në pozita shumë herë më të vështira, sesa shoqëria "C." shpk.

18. Referuar provave shkresore të administruara në dosje, Kolegji konstaton se të ardhurat e kërkuesit H.H., janë shumë herë më të ulëta se shpenzimet që ai duhet të kryejë për të pasur një jetesë minimale. Në këtë drejtim, Kolegji ka marrë në konsideratë vetëm shpenzimin që kërkuesi duhet të kryejë për qiranë e shtëpisë ku ai jeton, pa e shtrirë vlerësimin dhe shqyrtimin gjyqësor edhe tek shpenzimet e tjera bazike si ushqimin, veshjen, pagimin e dritave dhe të ujit, shpenzime të cilat janë të detyrueshme për një minimum jetik dhe po të merreshin në konsideratë, provojnë qartë faktin që pala kërkuese është në pamundësi për të përballuar një jetesë normale. Ky konstatim, provohet qartësisht nga vërtetimi i lëshuar nga DRSSH Vlorë, me të cilin është pasqyruar se kërkuesi përfiton pension pleqërie në masën prej 10106 (dhjetëmijë e njëqind e gjashtë) lekë, ndërsa pagesa e qirasë mujore që kërkuesi duhet të kryejë për apartamentin e banimit është në vlerën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro.

19. Nuk rezulton që gjatë këtij gjykimi, gjykatës t'i jetë bërë me dije apo t'i jetë paraqitur ndonjë provë shkresore, me të cilën të provohet fakti se kërkuesi ka të ardhura të tjera financiare, përveç pensionit të pleqërisë. Për këtë arsye, konkludohet se të ardhurat tërësore mujore të palës kërkuese në këtë gjykim janë në kufijtë minimal të jetesës. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson të theksojë faktin se, edhe nëse do ta merrte të mirëqenë pretendimin e ngritur nga shoqëria "C." shpk, se vlera e kontratës së qirasë në masën 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro nuk është reale, pasi çmimet e apartamenteve të banimit në Rrugën Transballkanike (zona ku pala kërkuese ka marrë apartamentin me qira), variojnë nga 10,000- 20,000 lekë të mobiluara, sërish pala kërkuese ndodhet në pozitë të vështirë financiare për ta përballuar këtë qira, referuar të ardhurave që ai merr aktualisht dhe që ka provuar në këtë gjykim. Për këtë arsye, pretendimin e palës kërkuese se gjendja e tij ekonomike është vështirësuar ndjeshëm nga vendosja e masës së pezullimit të ekzekutimit të vendimi, ky Kolegj e gjen të drejtë dhe të provuar.

20. Në çështjen objekt gjykimi, pala kërkuese ka pretenduar se me nxjerrjen e vendimit 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kësaj pale i është shkaktuar një dëm serioz, i konsiderueshëm dhe që do të jetë i vazhdueshëm deri sa masa e pezullimit të ekzekutimit të hiqet nga gjykata. Kërkuesi H.H., ka pretenduar se në qoftë se shoqëria "C." shpk do të kishte përmbushur detyrimin e saj dhe do t'i kishte dorëzuar atij 4 apartamentet e banimit dhe dy dyqanet respektive, kjo palë jo vetëm që do të kishte një jetesë mjaft të mirë, por ajo do të kishte mundësi që të krijonte të ardhura të konsiderueshme, pasi disa prej pasurive të saj ajo do të mund t'i jepte me qira. Këtë pretendim, pala kërkuese e ka mbështetur tek informacioni i lëshuar nga shoqëria imobiliare "Century 21 Aulona" shpk,

në të cilin janë evidentuar çmimet e qirasë që aplikohen për m² në Zonën e Lungomares.

21. Kolegji çmon të theksojë faktin se, shoqëria "C." shpk nuk rezulton t'i ketë kundërshtuar vlerat e çmimit të qirasë të pasqyruara në shkresën e lëshuar nga shoqëria imobiliare "Century 21 Aulona". Madje, kjo shoqëri ka pohuar faktin se këto çmime i referohen zonës së Lungomares dhe jo rrugës Transballkanike ku kërkuesi ka marrë shtëpinë me qira. Për këtë arsye, Kolegji, bazuar tek të dhënat që pasqyron kjo shkresë, arrin në konkluzionin se nëse pala kërkuese do të kishte në disponim të saj 2 (dy) dyqanet dhe 4 (katër) apartamentet e banimit, do të kishte mundësi që të realizonte mjaftueshëm të ardhura, të cilat jo vetëm që do t'i siguronin atij një jetesë më të mirë, por do të ndikonin në përmirësimin e ndjeshëm të të ardhurave të tij financiare. Kolegji vlerëson të theksojë faktin se, po të merret në konsideratë periudha kohore, nga momenti që është nxjerrë vendimi nr. 179, datë 08.04.2019 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Tiranë deri në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkese, si dhe statusi ligjor dhe ekonomik që kanë të dyja palët e përfshira në këtë gjykim civil, dëmi që i është shkaktuar palës kërkuese është qartësisht jo proporcional me atë që do t'i ishte shkaktuar shoqërisë "C." shpk, nëse kjo e fundit do ia kishte dorëzuar këto pasuri të paluajtshme kërkuesit.

22. Shoqëria "C." shpk, në prapësimet e dhëna para gjykatës, ka pranuar faktin se palës kërkuese i është shkaktuar dëm, por ajo ka vlerësuar se ky dëm është shumë herë më i vogël nga dëmi ekzistencial që ka pësuar kjo shoqëri, dëm i cili përllogaritet në vlerën prej 200,000 (dyqind mijë) -euro, pa marrë parasysh dëmin moral që i është shkaktuar shoqërisë. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vlerëson se shoqëria nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete se cili është dëmi ekzistencial që i është shkaktuar kësaj shoqërie, përsa kohë ajo ka mbajtur gjatë gjithë kohës në administrim apartamentet dhe dyqanet objekt shqyrtimi. Gjithashtu, i paprovuar mbetet në këtë gjykim se mbi cilat kushte dhe kritere ligjore dhe financiare është përllogaritur dëmi që i është shkaktuar kësaj shoqërie në masën prej 200,000 (dyqind mijë) euro.

23. Referuar përmbajtjes së shkresës me nr. 2376 prot., datë 25.04.2019 të lëshuar nga ZVRPP Vlorë, e cila është paraqitur nga pala kërkuese me cilësinë e provës, është pasqyruar fakti se sipas verifikimeve të kryera pranë ZVRPP Vlorë, nuk rezulton që shoqëria "C." shpk të ketë të regjistruar pasuri të paluajtshme në emër të saj. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se pala kërkuese ka të drejtë që të ketë dyshime të arsyeshme se shoqëria "C." shpk nuk do të mund që të përmbushë detyrimet e saj që i rrjedhin nga gjykimi i themelit, duke vështirësuar ndjeshëm edhe dhënien e dy apartamenteve

dhe dy dyqaneve që ajo nuk i kishte tjetërsuar tek të tretët në momentin e nxjerrjes së vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë . Shoqëria "C." shpk nuk rezulton të ketë kundërshtuar përmbajtjen e shkresës së lëshuar nga ZVRPP Vlorë, por ka pretenduar se për llogari të pronarit, nga ana e saj janë ngrirë 3 (tre) apartamente dhe 2 (dy) dyqane. Megjithatë, përtej pohimit të këtij fakti, kjo shoqëri nuk rezulton të ketë paraqitur para gjykatës ndonjë dokument shkresor, me të cilat provon se i ka në pronësi këto apartamente dhe dyqane (vërtetim pronësie), si dhe i ka bllokuar ato pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vlorë (ish-ZVRPP Vlorë) për efekt të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

24. Në vijim të sa më sipër, Kolegji e çmon të arsyeshme që të ndalet tek fakti se, referuar përmbajtjes së vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka rezultuar se Shoqëria "C." shpk ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit, me arsyetimin se dy nga apartamentet objekt i gjykimit të themelit të çështjes, janë shitur përpara fillimit të këtij gjykimi tek persona të tretë. Për këtë arsye, vendimi i gjykatës së apelit ishte i paekzekutueshëm për sa u përket këtyre dy apartamenteve dhe duhej të vendosej pezullimi i ekzekutimit të tij. Në vijim të këtij fakti, Kolegji vlerëson të theksojë se shoqëria "C." shpk nuk ka sqaruar apo saktësuar para gjykatës nëse 3 (tre) apartamentet dhe 2 (dy) dyqanet që i ka ngrirë për llogari të kërkuesit në këtë gjykim, janë objekt i gjykimit të themelit (pra objektet e cituara në dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë), apo janë pasuri të tjera të paluajtshme (asete) të cilat shoqëria i ka në pronësi të saj, si garanci për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

25. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave që kanë ekzistuar në momentin e dhënies së vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, shoqëria "C." shpk nuk ka pasur në pronësi të saj 2 (dy) nga 4 (katër) apartamentet objekt shqyrtimi gjyqësor, pasi i kishte tjetërsuar ato tek të tretët. Ndërsa në këtë gjykim, kjo shoqëri pretendon se ka në disponim të saj 3 (tre) apartamente dhe 2 (dy) dyqane, për të cilat pret të nënshkruajë marrëveshjen përkatëse me kërkuesin H.H. sipas lejes së re të miratuar në vitin 2014 ose të bëjë kontratën e shkëmbimit të truallit, fakt i cilibie ndesh me sa ka pretenduar kjo shoqëri kur ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

26. Bazuar tek të dhënat që pasqyron shkresa me nr. 2376 prot., datë 25.04.2019 lëshuar nga ZVRPP Vlorë, si dhe në kushtet kur shoqëria "C." shpk nuk ka paraqitur asnjë provë shkresore se ka të regjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë 5 (pesë) pasuritë të paluajtshme dhe i ka bllokuar ato për efekt të ekzekutimit të vendimit

gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë, Kolegji e gjen të drejtë dhe të arsyeshëm shqetësimin e palës kërkuese se nëse nuk revokohet vendimi i pezullimit, atëherë kësaj pale do t'i bëhet e pamundur ose shumë e vështirë ekzekutimi i së drejtës së fituar me vendimin e gjykatës së apelit, sidomos për 2 (dy) apartamentet e banimit dhe 2 (dy) dyqanet, të cilat në momentin e vendosjes së masës së pezullimit, janë pretenduar se nuk kanë qenë të tjetërsuara tek të tretët.

27. Mbi pretendimet e tjera të parashtruara nga shoqëria "C." shpk, në lidhje me kërkesën e subjektit H.H. për të revokuar vendimin nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ky Kolegj vlerëson se ato në tërësi nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar në rrëzimin e kërkesës, si dhe nuk mbështeten në prova shkresore. Në lidhje me pretendimet se, kontrata e qirasë e lidhur midis H.H. dhe shoqërisë "M." shpk nuk është e vlefshme, pasi ajo nuk është realizuar para noterit publik dhe nuk është deklaruar pranë organeve tatimore, duke u konsumuar vepra penale e fshehjes së të ardhurave, Kolegji vlerëson se këto pretendime nuk duhet të pranohen.

28. Kontrata e qirasë e lidhur midis palës H.H. dhe firmës "M." shpk është një kontratë qiraje me afat 3 vjeçar, e cila është kryer me shkrim dhe është nënshkruar nga palët, në përputhje me parashikimet e nenit 803/4 të KC. Legjislacioni civil në fuqi, në asnjë moment nuk ka parashikuar që kontrata e qirasë duhet të bëhet patjetër me akt noterial, në mënyrë që ajo të jetë e vlefshme nga pikëpamja e formës. Kolegji çmon të theksojë faktin se, gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim dhe të analizojë vlefshmërinë e kontratës së qirasë, nisur nga fakti nëse palët e përfshira e kanë deklaruar atë ose jo në organet tatimore, pasi vlefshmëria e kontratës së qirasë dhe fshehja e të ardhurave apo mosdeklarimi i tyre para organeve tatimore nuk janë objekt i këtij gjykimi. Kontrata e qirasë e lidhur midis kërkuesit H.H. dhe shoqërisë "M." shpk, është depozituar në këtë gjykim me cilësinë e provës dhe si e tillë, ajo mund të goditet në këtë gjykim vetëm për falsitet. Në kushtet kur shoqëria "C." shpk nuk e ka goditur kontratën e qirasë për falsitet, si dhe nuk ka paraqitur prova shkresore me të cilat të provojë këtë pretendim, ky pretendim nuk mund të pranohet.

29. Shoqëria "C." shpk, ka pretenduar gjithashtu në këtë gjykim, se pala paditëse H.H. nuk jeton në Shqipëri, por jeton në Itali, fakt i cili provohet nga të dhënat e sistemit TIMS. Në lidhje me këtë pretendim, kjo shoqëri nuk ka paraqitur asnjë të dhënë të siguruar nga sistemi TIMS, duke i lënë këto pretendime në nivel deklarativ. Kolegji e shikon të arsyeshme që të qartësojë faktin se, sistemi TIMS nuk është një sistem i aksesueshëm nga publiku apo institucionet shtetërore publike (përfshirë këtu edhe gjykatat), në mënyrë

që të dhënat e gjeneruara apo të administruara prej tij të mund të merren lehtësisht. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson të theksojë se, ishte detyra e shoqërisë "C." shpk që t'i merrte këto të dhëna pranë autoritetit përkatës dhe t'ia vinte në dispozicion gjykatës për t'i vlerësuar dhe shqyrtuar ato. Në kushtet kur pala që ka ngritur pretendimin nuk ka kryer asnjë përpjekje për të marrë apo siguruar në cilësinë e provës të dhënat nga sistemi TIMS, ky veprim nuk mund të bëhet kryesisht nga gjykata. Megjithatë, edhe sikur pala paditëse H.H. të provohet se jeton jashtë shtetit, kjo nuk e pengon atë si qytetar i Republikës së Shqipërisë që të ketë edhe një rezidencë banimi në Shqipëri, e cila i nevojitet për të banuar kur ai vjen në shtetin amë. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk mund të zhvlerësojë faktin që paditësi ka marrë një shtëpi banimi me qira në qytetin e Vlorës, apo të përbëjë një pretendim të mjaftueshëm për të rrëzuar kërkesën e kërkuesit për revokimin e vendimit objekt shqyrtimi.

30. Bazuar sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se faktet dhe rrethanat e pasqyruara nga pala kërkuese kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pretendimet e ngritura nga pala kërkuese në këtë gjykim, u përgjigjen kërkesave që parashikon neni 479, pika 6 e KPC-s dhe si të tilla, ato duhet të pranohen duke u vendosur revokimi i vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Kolegji e gjen të provuar me akte shkresore të pakundërshtuara nga pala e interesuar në këtë gjykim, se gjendja e vështirë ekonomike e palës është vështirësuar edhe më shumë nga vendosja e pezullimit të ekzekutimit të vendimit nr. 1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe dëmi që ka pësuar kjo palë nga mosmarrja në administrim e pronave të paluajtshme dhe hedhja e tyre në qarkullimin civil, është i matshëm, i konsiderueshëm dhe është vështirësuar mundësia e kësaj pale për t'i rikuperuar ato.

31. Kolegji, pa u hyrë fare pretendime të palëve që kanë lidhje me zgjidhjen e themelit të çështjes si dhe meritës së tyre për pranueshmëri ose jo, është kufizuar në këtë gjykim për të shqyrtuar dhe vlerësuar pasojat që ka sjellë vendimi objekt revokimi, faktet dhe rrethanat që kanë ndodhur pas dhënies së tij, duke mbajtur në konsideratë që pasojat që ka sjellë vendimi nr. 179, datë 08.04.2019 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të jenë të balancuara dhe proporcionale për të gjitha palët që preken prej tij. Ky Kolegj vlerëson të theksojë se ky ka qenë edhe vetë qëllimi i ligjvënësi kur ka parashikuar nenin 479 të KPC, duke i lënë diskrecion Gjykatës së Lartë që të vendosi pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, i cili sjell pasoja të parikuperueshme dhe të menjëhershme për palët që preken prej tij, përpara se rekursi i paraqitur nga palët e interesuara të marri

zgjidhje me një vendim përfundimtar.

32. Në kërkesën objekt shqyrtimi, pala kërkuese nuk ka argumentuar dhe nuk ka parashtruar se dëmi që i është shkaktuar nuk është i parikuperueshëm, por ky Kolegj referuar përmbajtjes së provave shkresore që i janë paraqitur nga pala kërkuese në këtë gjykim, por edhe gjendjes ekonomike në të cilën ndodhet kërkuesi pas dhënies së vendimit nr. 179, datë 08.04.2019, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, arrin në konkluzionin se pasojat e krijuara nga ky vendim nuk janë aspak proporcionale për të dyja palët e prekura prej tij. Dukshëm, pala kërkuese në këtë gjykim, është vendosur në një pozitë shumë herë më të vështirë se pala tjetër e interesuar, e cila ka qenë edhe pala që ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1032, datë 11.12.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Për mëtepër që gjatë këtij gjykimi, u pasqyruan fakte dhe rrethana të cilat kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit objekt revokimi, të cilat e kanë përkeqësuar ndjeshëm pozitën e palës kërkuese në këtë gjykim.

33. Për gjithë sa është pasqyruar më sipër në këtë vendim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga kërkuesi H.H. për revokimin e vendimit nr. 179, datë 08.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin është pezulluar ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. 1032, datë 11.12.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, pasi ajo është tërësisht e mbështetur në prova dhe në ligj.

Vendim i Kolegjit Civil nr. 00-2020-606, datë 18.11.2020

Pezullimi i një vendimi të formës së prerë, është një vendim i jashtëzakonshëm, i përkohshëm dhe në raste përjashtimore, të cilin Gjykata e Lartë e merr kur provohet se ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme për palën gjyqhumbëse. Njëkohësisht, marrja e një vendimi për pezullim të ekzekutimit kërkon gjykimin e themelit në mënyrë të përshpejtuar, me përparësi dhe në mënyrë përfundimtare.

Koha e gjatë e kalimit në pritje të gjykimit të çështjes, nuk ndryshon respektimin e drejtë apo jo të ligjit në kohën e gjykimit nga gjykata, vendimi i së cilës është objekt gjykimi.

I. Rrethanat e Çështjes

1. Paditësi A.P. dhe i padituri K.T. dhe personi i tretë D.T., i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me kërkesëpadinë dhe kundërpadinë, me objekt të padisë “Kthimin e fëmijës së mitur dhe ushtrimin e përgjegjësisë prindërore” dhe objekt të kundërpadisë “Heqjen e përgjegjësië prindërore ndaj shtetasit dhe caktimin e kujdestarit të fëmijës”.

2. Palët ndërgjygjëse në këtë gjykim kanë qenë në marrëdhënie krushqie ndërmjet tyre ku paditësi/i kundërpaditur ka qenë dhëndri i palës së paditur/kundërpaditëse dhe i personit të tretë në kundërpadi. Paditësi/i kundërpaditur A.P. ka qenë i martuar me shtetasen I.T. e cila është vajza e të padituri kundërpaditës dhe e personit të tretë.

3. Paditësi dhe shtetasjaI.T. kanë lidhur martesën ligjore në datën 11.08.2014 në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Athinë. Ky fakt rezultoi i provuar në bazë të certifikatës së martesës së lëshuar në datën 06.06.2016 nga Zyra e Gjendjes Civile Kurjan.

4. Në datën 08.08.2014 shtetasjaI.T. ka lindur fëmijën, A.P., atësia e të cilit është njohur nga paditësi A.P. përmes Aktit të Njohjes Vullnetare të Fëmijës Nr.2.138, datë 14.08.2014, akt ky i mbajtur nga noteri publik[...]

5. Ka rezultuar se paditësi A.P., ish bashkëshortja e tij I.T. dhe fëmija i tyre A.P. i datëlindjes 08.08.2014, të jenë regjistruar më pas në përbërjen familjare të familjes [...] me kryefamiljar [...], të atin e paditësit. [...]

6. Ka rezultuar se shtetasjaI.T. ka ndërruar jetë në datën 05.10.2015 si rezultat i një sëmundjeje të rëndë, çka evidentohet nga përmbajtja e certifikatës së vdekjes së lëshuar në datën 14.10.2015 nga Zyra e Gjendjes civile, Kurjan.

7. Pala e paditur/ kundërpaditëse në këtë gjykim në kushtet kur kërkoi me anë të kundërpadisë heqjen e përgjegjësisë prindërore për shtetasin A.P., kërkoi njëkohësisht edhe caktimin si kujdestare të shtetases D.T. që njëkohësisht është edhe gjyshja nga nëna e të miturit A.P..

8. Kjo palë i paraqiti gjykatës me cilësinë e provave shkresore vërtetimin me Nr. 1458 Regj të datës 13.05.2016, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në të cilin thuhet se: *"Sipas verifikimit në regjistrat tanë, aktualisht nuk rezulton që për znj. D.T. të ketë proces penal nga data 01.01.2016 e deri më sot"*.Në bazë të vërtetimit me nr. 1748 prot. të datës 13.05.2016 të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, rezulton se: *"Vërtetojmë se ndaj shtetases D.T., [...]nuk rezulton të ketë procedim penal të regjistruar në ngarkim të saj"*.Në bazë të Raportit Mjeko-ligjor me nr. regjistri 2931, datë 13.05.2016 të lëshuar nga Poliklinika e Specialiteteve Berat, rezulton se:*"Znj. D.T. u konstatua iklinikisht e shëndoshë prandaj komisioni vendosi "E aftë të kujdeset për A.P. nipin e vet jetim"*.Pala e paditur kundërpaditëse paraqiti si prova shkresore edhe certifikatat për vërtetim pronësie të datës 08.03.2006 në bazë të së cilave rezulton se K.T. është pronar i pasurisë me nr. 1426/1, e llojit arë me sipërfaqe prej 3320 m² e ndodhur në fshatin Dushnik të rrethit Berat, pronar i pasurisë me nr. 1450/2 e llojit arë me sipërfaqe 8733 m², e ndodhur në fshatin Dushnik, Berat.

9. Paditësi /i kundërpaditur A.P. pretendoi se: fëmija A.P. është duke u mbajtur pa të drejtë nga prindërit e ish-bashkëshortes së tij e cila është ndarë nga jeta. Si e tillë, ai po pengohet nga ana e të paditurit për të ushtruar përgjegjësinë e tij prindërore ndaj fëmijës së tij. Në të tilla kushte paditësi me anë të kësaj padie kërkon kthimin e fëmijës së mitur në mënyrë që të ketë mundësi të ushtrojë përgjegjësinë prindërore. Kjo kërkesë padi është mbështetur në nenin 218 dhe 220 të K. Familjes. [...]

10.Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 92, datë 06.02.2017, ka vendosur:

"Pranimin pjesërisht të padisë së paditësit A.P., bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, fëmija A.P [...] lejohet që të vijojë të qëndrojë me gjyshërit e tij nga nëna [...]

11. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.468, datë 24.05.2018, ka vendosur:

"Ndryshimin e vendimit nr.92, datë 06.02.2017 të Gjykatës sëRrethit Gjyqësor Berat lidhur me objektin e padisë, në këtë mënyrë: Lënien për rritje dhe edukim fëmijën A.P., paditësit të kundër-paditur (babait) A.P.. I padituri kundër-paditës K.T. dhe personi i tretë D.T. kanë të drejtë të takojnë fëmijën (nipin) A.P. [...] Lënien në fuqi të vendimit të mësipërm në lidhje me kundërpadinë."

12. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë kanë ushtruar rekurs pala e paditur kundër-paditëse K.T. dhe personi i tretë D.T., si dhe kundërrekurs paditësi A.P., të cilët respektivisht parashtrojnë shkaqet si më poshtë përmendur.

12.1 Rekursi, mbështetet në evidentimin e këtyre shkaqeve: Në kuadër të mbrojtjes së interesave më të larta të fëmijëve, shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën mbi të drejtat e fëmijëve. Në këtë akt është përcaktuar se: *"Fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi"*. Përveç sa më sipër në këtë akt është përcaktuar si ai (fëmija) për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes.[...] Pikërisht me qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe vetëm të atij, ligjvënësi në nenin 218, paragrafi 2 të Kodit të Familjes ka përcaktuar se *"...Gjykata, për rrethana të rënda, mund të mos vendosë kthimin e fëmijës, në qoftë se kjo vjen në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës.."*. Pra është pranuar ligjërisht që vetëm kur justifikohet nga interesi më i lartë i fëmijës, fëmija mund të mos qëndrojë me prindërit e tij, por me persona të cilët i afrojnë dhe garantojnë atij mbrojtjen e këtij interesi. Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin e saj ka ecur në kundërshtim me këtë detyrim që rrjedh jo vetëm nga Konventa por dhe nga Kodi i Familjes. [...]

12.2. Kundërrekursi i palës paditëse të kundërpaditur A.P., bazohet kryesisht në këto argumente: Të gjitha shkaqet e paraqitura nga palët rekursuese për prishjen e vendimit, megjithëse bëhet përpjekje që të kalohen për zbatim të gabuar të ligjit kanë të bëjnë me bindjen e krijuar nga gjykatat e shkallëve më të ulëta në vlerësimin e provave të paraqitura për shqyrtim para tyre. Gjatë gjykimit në apel, me kërkesë të paditësit/kundërpaditur konform nenit 465/3 të KPC gjykata riçeli pjesërisht hetimin gjyqësor duke kryer një akt ekspertimi me grup ekspertësh në fushën sociale dhe në fushën psikologjike, për të sheshuar pretendimet e palëve, pasi në ankim paditësi i kundërpaditur kundërshtoi konkluzionin e aktit të ekspertimit psikologjik e social kryer në gjykatën e shkallës parë. Në konkluzionin e tyre, grupi i ekspertëve analizon të gjitha kushtet sociale ekonomike të të dyja palëve në proces dhe në përfundim konkludonte që fëmija A.P. t'i lihet për rritje dhe

edukim babait pasi në kushtet kur i ka humbur një prind nuk duhet që t'i mungojë dhe prindi tjetër. [...]

13. Përveç rekursit të ushtruar nga pala e paditur K.T. dhe personi i tretë D.T., personat në fjalë i janë drejtuar Gjykatës së Lartë edhe me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 468 datë 24.05.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

20.1. Gjykata e Lartë pas shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 468 datë 24.05.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në dhomën e këshillimit të datës 04.10.2018 ka vendosur: *"Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.468 datë 24.05.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë"*.

14. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i mbledhur në dhomë këshillimi në datë 15.11.2018, pasi mori në shqyrtim rekursin e ushtruar nga pala e paditur K.T. dhe personi i tretë D.T. vendosi për kalimin në seancë gjyqësore të çështjes që u përket palëve ndërgjyqëse A.P. kundër K.T. dhe person i tretë D.T..

15. Sipas akteve të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala kërkuese A.P. me shkresën nr.4198 prot., datë 05.12.2018, i është drejtuar Gjykatës së Lartë (për herë dytë) me kërkesë për "*Revokimin e pezullimit të vendimit nr.468, datë 24.05.2018 të vendosur nga Gjykata e Lartë"*. Po kështu, rezulton se pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Lartë me disa kërkesa të ndryshme në kohë, për përshpejtimin e gjykimit.

16. Në seancën gjyqësore të datës 18.11.2020 përfaqësuesi i palës së paditur kundërpaditëse, av. V.G., pasi riparashtroi edhe një herë shkaqet e rekursit si më sipër përmendur, kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. 468, datë 24.05.2018 dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nr. 92, datë 06.02.2017.

17. Po kështu, përfaqësuesi i palës së paditur kundër-paditëse, av. V.G., parashtroi përpara gjykatës, se koha e gjatë nga marrja e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë e deri në kohën e gjykimit të këtij rekursi në fjalë (përafërsisht 2 vite e gjysmë) mund të kenë sjellë ndryshime të rrethanave, kushteve sociale dhe ekonomike të palëve, të rëndësishme për këtë lloj procesi dhe riverifikimi i tyre sipas kësaj pale është i nevojshëmdhe i domosdoshëm në arritjen e konkluzioneve të përditësuara e, për pasojë, ai kërkoi në mënyrë alternative, prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. 468, datë 24.05.2018 dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë me një tjetër trup gjykues.

18. Në përfundim, pasi përfaqësuesi i palës së paditur kundërpaditëse, av. V.G., u pyet të saktësojë qëndrimin e tij përfundimtar, ai kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. 468, datë 24.05.2018 dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë, me një tjetër trup gjykues.

19. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i palës paditëse të kundërpaditur, av. E.Sh., rikonfirmoi në proces qëndrimin e palës që ai përfaqëson të parashtruar në kundër-rekurs, duke kërkuar përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 468, datë 24.05.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

20. Kolegji Civil (në vijim, Kolegji), i cili gjykoi në seancë gjyqësore çështjen në fjalë, çmon paraprakisht që të shpjegojë shkaqet e gjykimit me përparësi të çështjes në fjalë dhe mosrespektimin e radhës së gjykimit referuar kohës së depozitimit të rekursit.

20.1. *Së pari*, një nga shkaqet e përshpejtimit të gjykimit të çështjes në fjalë është natyra e së drejtës në gjykim. Në çështjen A.P. kundër K.T. dhe person i tretë D.T., objekt gjykimi janë të drejta që kanë të bëjnë me ushtrimin e kujdestarisë ndaj një fëmije të mitur, ushtrimin e së drejtës prindërore apo heqjen e së drejtës prindërore dhe vendosjen e kujdestarisë, të drejta këto që për nga natyra e tyre prezantohen si tepër delikate dhe karakterizohen nga emergjenca në zbatim, pasi edhe ushtrimi i tyre kushtëzohet nga faktori kohë.

20.2. Ka rezultuar se Kolegji ka shqyrtuar në dhomë këshillimi kërkesën e palës së paditur kundërpaditëse K.T. dhe personi i tretë D.T., për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 468, datë 24.05.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe me vendimin nr. 548, datë 04.10.2018, vendosi: *"Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.468, datë 24.05.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë"*. Në vlerësimin e këtij Kolegji që gjykon tashmë rekursin në fjalë, gjykimi i shkaqeve të rekursit në fjalë paraqet emergjencë edhe për faktin se një vendim i një gjykate apeli, edhe pse vendim i formës së prerë, nuk prodhon efekte juridike për palët pasi efektet e tij janë pezulluar përkohësisht. *Pezullimi i një vendimi të formës së prerë, është një vendim i jashtëzakonshëm të cilin Gjykata e Lartë e merr në raste përjashtimore kur provohet se ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme për palën gjyqhumbëse. Por njëkohësisht, marrja e një vendimi për pezullimin e ekzekutimitlogjikisht "aktivizon" gjykimin me përshpejtim të themelit të rekursit, pasi kjo gjendje e pasigurt e palëve për shkak të pezullimit të efekteve të vendimit të formës së prerë, nuk mund të vazhdojë pambarimisht, pa u kufizuar në kohë edhe për arsye pse vetë vendimi i masës së pezullimit është një vendim i përkohshëm. Nëse kjo situatë nuk do të zgjidhej shpejt dhe përfundimisht, atëherë vendimi i formës së prerë është zhvleftësuar, pasi mosgjykimi me përparësi i rekursit ndërkohë që vendimi i formës së prerë nuk ekzekutohet, ka sjellë automatikisht "zhvleftësimin" e gjithë procesit. Aq më tepër që në rastin*

në fjalë ky qëndrim i kolegjit për masën e pezullimit të ekzekutimit të një vendimit të formës së prerë, kombinohet me natyrën tepër delikate dhe emergjente të çështjes në gjykim, çka përforcon qëndrimin që çështja në fjalë duhet të gjykohet më përparësi.

20.3. Referuar akteve në dosjen gjyqësore ka rezultuar se gjendja juridike e çështjes në fjalë (statusi) është "në gjykim" dhe për më tepër, rezulton të jetë zhvilluar edhe seancë gjyqësore në datë 04.12.2008. Gjendja gjyqësore e çështjes është një arsye më tepër që kolegji të shqyrtojë çështjen më përparësi.

20.4. Ka rezultuar se edhe nga ana e palës paditëse të kundër-paditur është kërkuar shkresërisht përshpejtimi i gjykimit disa herë, ku arsyeja kryesore që ajo parashtronte për përshpejtimin e gjykimit ishte natyra emergjente që paraqet e drejta në konflikt si dhe pasojat e rënda që mund të vinin nga vonesa e mosshqyrtimit të çështjes.

21. Duke iu kthyer çështjes konkrete, nga shqyrtimi në tërësi i kësaj çështjeje, i akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore e të administruara gjatë gjykimeve nga gjykatat e faktit, objektit dhe shkakut të padisë, pretendimeve të palëve, të vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe shkaqeve të rekursit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Gjykata e Apelit është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit, prandaj vendimi i kësaj gjykate duhet të lihet në fuqi. Gjykata e Lartë, pa i hyrë analizës së provave, nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore dhe pretendimeve të parashtruara në rekurs evidenton nëse nga gjykatat e faktit janë lejuar ose jo shkelje të normave procedurale dhe nëse ligji material është respektuar drejt ose jo. Në varësi të zgjidhjes së këtyre çështjeve nga gjykatat e faktit, Gjykata e Lartë, në realizim të funksionit të saj rishikues, shprehet për bazueshmërinë ose jo në ligj të vendimeve të gjykatave të faktit.

22. Pala e paditur kundërpaditëse ka parashtruar si shkak rekursi faktin se Gjykata e Apelit Vlorë nuk e ka bazuar në ligj vendimmarrjen e saj përsa i përket respektimit të kriterit "interesi më i lartë i fëmijës" që është edhe kriteri kryesor se ku duhej të bazohej gjykata. Sipas palës së paditur kundërpaditëse ajo ka gabuar në zbatimin e ligjit material, nuk ka vlerësuar drejt se cilët persona do të mund t'i ofronin fëmijës mbrojtje më të lartë të interesit të tij. Ajo, e ndikuar edhe nga përfundimet e aktit të ri të ekspertimit, i ka dhënë çështjes një zgjidhje e cila në asnjë rast nuk merr parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

23. Kolegji konstaton se interesi më i lartë i fëmijës është një parim i cili gjen shprehje qoftë në akte juridike ndërkombëtare ku Shqipëria aderon (Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, e vitit 1989, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992), qoftë në kuadrin ligjor kombëtar

(Ligji Nr.18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"), si kriter parësor ku autoriteti gjyqësor apo ai administrativ duhet të udhëhiqet në rastin e lënies së fëmijës për rritje dhe edukim.

24.Vetë ligji, parimisht (*ipso iure*) ka vlerësuar se interesi më i lartë i fëmijës realizohet pranë prindërve të tij dhe si prezumim, janë prindërit e fëmijës ata, të cilët kanë të drejtën dhe detyrimin t'i ofrojnë atij një zhvillim të plotë, të harmonishëm që garanton rritjen në një mjedis, atmosferë lumturie e dashurie dhe sigurimi i këtij standardi për fëmijën vjen si rezultat i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Sipas nenit 3, pika 14 të ligjit Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës": *"Prind është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese*". Bazuar në nenin 220 të Kodit të Familjes, ligji e lidh parimisht konceptin juridik të "prindërve" me atë të përgjegjësisë prindërore dhe ushtrimit të saj. Edhe përmbajtja e nenit 225 të KF (Kodi i Familjes) konfirmon të njëjtën lidhje prind dhe ushtrim të përgjegjësisë prindërore, në një situatë më të pazakontë: *"Në qoftë se njëri nga prindërit është para pamundësisë të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose kur njëri nga prindërit ka vdekur, përgjegjësia prindërore ushtrohet nga prindi tjetër".*

25. Neni 215 i KF , përkufizon përgjegjësinë prindërore si një tërësi apo kompleks unitar të drejtash dhe detyrimesh që kanë për qëllim *".....sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij",* që ligji ua ngarkon automatikisht prindërve të fëmijës. Përjashtimisht, ekzistojnë situata ligjore kur përgjegjësia prindërore mund të ushtrohet nga "të tretë jo prindër", por vetëm kur vërtetohen "rrethana të rënda" dhe gjithmonë me vendim gjykate.

26. Duke iu kthyer rastit konkret, shkaku i parashtruar në rekurs se Gjykata e Apelit Vlorë, nuk e ka bazuar në ligj vendimmarrjen e saj përsa i përket respektimit të kriterit "interesi më i lartë i fëmijës", nuk qëndron. Gjykata e Apelit Vlorë ka zbatuar drejt ligjin në lidhje meinteresin më të lartë të fëmijës si dhe duke pasur parasysh kërkesat e nenit 225 të KF . , moshën e fëmijës, ka vlerësuar se: *"Paditësi i kundër-paditur ka të drejtë jetë kujdestar i fëmijës, ta mbajë për rritje dhe edukim atë pasi është babai i fëmijës dhe në kushtet kur fëmijës i mungon nëna, në vlerësimin e gjykatës së apelit, nuk duhet t'i mungojë edhe babai. Për sa kohë paditësi i kundër-paditur ka kushtet për rritje dhe edukim e ato financiare, ka banesë e tregon interes për fëmijën nuk ka asnjë dënim penal, nuk ka asnjë rrethanë që vjen në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës, tregon qartë se*

fëmija duhet t'i lihet atij si baba përtej se dhe gjyshërit tregojnë interes, por gjyshërit duhet të kenë të drejtën e takimit".

27. Nga ana e palës së paditur kundër-paditëse është parashtruar gjithashtu si shkak ligjor për pranimin e rekursit edhe riçelja e hetimit nga ana Gjykatës së Apelit Vlorë, në lidhje mekryerjen e një akti të ri të ekspertimit. Pala e paditur kundërpaditëse ka pretenduar në rekurs në lidhje me këtë shkak, se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë për kryerjen e një akti të ri ekspertimit është në kundërshtim me dispozitat e KPC-s që përcaktojnë nevojën e kryerjes së një akti të ri ekspertimi (229 KPC).

28. Referuar akteve në dosje, Gjykata e Apelit Vlorë është vënë në lëvizje nga ankimi i ushtruar nga pala paditëse e kundërpaditur ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ku ndër të tjera pala paditëse e ka kundërshtuar edhe aktin,edhe konkluzionin e ekspertimit psikologjik e social, të kryer në gjykatën e shkallës parë. Duke e gjykuar këtë si një ndër shkaqet e ankimit, Gjykata e Apelit Vlorë, bazuar në nenin 465/3 të KPC-s, me kërkesë të paditësit të kundërpaditur, çeli pjesërisht hetimin gjyqësor duke kryer një akt të ri ekspertimi me grup ekspertësh në fushën sociale dhe në fushë psikologjike.

30. Referuar parimeve të përgjithshme të KPC-s, nenit 14 të tij është detyrë e gjykatës që kjo*"..... të zhvillojë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin".*

31. Gjykata e apelit, edhe pse gjykatë e shkallës së dytë, ka të drejtë të bëjë një shqyrtim të plotë të çështjes, gjithmonë brenda kufijve të shkaqeve të ankimit që e kanë investuar çështjen për shqyrtim përpara kësaj gjykate, konform përmbajtjes së nenit 465 të KPC-s. Pra, gjykata e apelit, gjithmonë brenda këtyre kufijve të ankimit, mundet të bëjë çdo gjë që do të kishte mundur të bënte gjykata e shkallës së parë (që kjo e fundit nuk e ka bërë, apo e ka bërë jo mirë - sipas diskrecionit të vetë gjykatës), duke u ndodhur përpara së njëjtës situatë ndaj çështjes në të cilën ndodhej gjykata e shkallës së parë, por gjithmonë duke mos dalë nga kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të cilat siç i përcakton edhe neni 465, pika 1 i KPC-s, përcaktohen nga kufijtë e ankimit.

32.Përmbajtja e dispozitës 465 të KPC-s, sidomos pika 3 e saj, e cila përcakton riçeljen e hetimit gjyqësor nga gjykata e apelit, jo vetëm të nxitur nga kërkesa e palës, por edhe nga vetë gjykata meiniciativë, kur kjo e fundit e vlerëson të nevojshme në funksion të hetimit të plotë dhe një vendimi të drejtë. Një kompetencë e tillë diskrecionale e gjykatës, siç e përmendëm më sipër kufizohet vetëm nga shkaqet e ngritura në ankim.

33. Rezulton se në ankimin e palës paditëse të kundërpaditur, kjo e fundit ka kundërshtuar kryerjen dhe konkluzionet e aktit të ekspertimit

duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat të bazuar mbi atë akt ekspertimi, dhe me atë rast ka kërkuar edhe ribërjen e tij.

34. Për sa më lart vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe ripërsëritjen e aktit të ekspertimit, është konform kërkesave të nenit 465 të KPC-s, e për pasojë edhe pretendimi i parashtruar nga pala rekursuese në lidhje me këtë shkak, është i pambështetur në ligj.

35. Po kështu, përfaqësuesi i palës së paditur kundërpaditëse, av. V.G., parashtroi përpara gjykatës gjithashtu, se koha e gjatë nga marrja e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë e deri në ditën e gjykimit të këtij rekursi përpara Gjykatës së Lartë (përafërsisht 2 vite e gjysmë) mund të kenë sjellë ndryshime të rrethanave, kushteve sociale, ekonomike të palëve, të rëndësishme për këtë lloj procesi, dhe riverifikimi i tyre sipas palës së paditur kundërpaditëse, është i nevojshëm dhe i domosdoshëm në arritjen e konkluzioneve të përditësuara. Për pasojë, përfaqësuesi i palës së paditur kundër-paditëse, av. V.G., kërkoi (fillimisht në mënyrë alternative), prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. 468, datë 24.05.2018 dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë, me një tjetër trup gjykues.

36. *Një pretendim i tillë, nuk është i bazuar në shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-s, për të justifikuar një vendimmarrje të Gjykatës për prishjen dhe kthimin për rigjykim të çështjes. Në rekurs, ankimi u referohet vendimeve të shkallës së parë apo atij të apelit duke evidentuar shkaqe nga ato të parashikuara në nenit 472 të KPC-s, ekzistenca e të cilave cenon qëndrueshmërinë e vendimeve të gjykatave të faktit. Koha e gjatë e kalimit në pritje të gjykimit të çështjes, nuk ndryshon respektimin e drejtë apo jo të ligjit në kohën e gjykimit nga gjykata, vendimi i së cilës është objekt gjykimi.*

43. Për më tepër, nëse një shkak i tillë do të konsiderohej i provueshëm për të justifikuar suksesin e rekursit, atëherë, parimisht çdo vendim i gjykatave të faktit do të ishte probabilisht i cenueshëm me këtë shkak, e për pasojë, kjo do të sillte jo vetëm pasiguri tek palët, por do të prodhonte procese gjyqësore që nuk do të kishin një fund.

44. Përfundimisht, referuar shkaqeve të parashtruara nga pala e paditur kundërpaditëse si në rekurs, ashtu edhe në seancë gjyqësore, Kolegji vlerëson seshkaqet ligjore të pretenduara në rekurs nuk bazohen në ligj, në kuptim të nenit 472 të KPC-s sa të motivojnë cenimin e vendimit nr. 468, datë 24.05.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2020-696, datë 25.11.2020

Instituti procedural i pezullimit nuk gjen zbatim në çështjen e falsitetit të dokumentit. Regjimi i raportit midis dy proceseve, civil dhe penal në lidhje me këtë çështje buron nga parimi i autonomisë dhe ndarjes së dy proceseve si dhe i pajisjes së secilit gjyqtar me pushtetin e plotë të njohjes së vërtetësisë së dokumentit, me qëllim zgjidhjen e çështjeve juridike apo faktike që do t'i duhet t'i vendosë në themel të vendimit të tij.

I. Rrethanat e çështjes

1. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ngritur një padi. Paditësi ka pretenduar se me datë 30.09.2017 është vënë në dijeni nga "MCA" sha se ai rezulton të jetë debitor solidar në kontratën e kredisë bankare, nr. 13045378, datë 17.02.2012 të lidhur midis kredimarrësit, shoqërisë "B" shpk dhe shoqërisë "PB" sha, për vlerën e kredisë 4.900.000 lekë. Ka rezultuar se kjo kredi i është ceduar shoqërisë "MCA" sha.

2. Paditësi ka pretenduar se nuk e ka nënshkruar këtë kontratë dhe si rrjedhojë, me datë 17.10.2017 i është drejtuar gjykatës me padinë e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv. Ka rezultuar se paralelisht me gjykimin civil ka filluar edhe procedimi penal, i regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 9372, datë 19.07.2017, për veprën penale të "Falsifikimit të dokumenteve", sipas nenit 186 të KP-s, ku objekt hetimi janë dokumentet që janë edhe objekt i padisë civile.

3. Mbi kërkesën e palës paditëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e ndërmjetëm, datë 28.02.2018, ka vendosur: "*1. Pezullimin e gjykimit të çështjes deri në përfundimin me një vendim të formës së prerë të procedimit penal të regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 9372, datë 19.07.2017. 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë...*".

3.1. Në marrjen e vendimit gjykata ka arsyetuar se, në kushtet kur vepra penale e pretenduar, "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186 i KP-s pretendohet se është konsumuar duke falsifikuar aktet objekt i shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykim. Si rrjedhojë, gjykata ka vlerësuar se jemi

në kushtet e parashikuara nga neni 297, germa "a" e KPC-s dhe se duhet të urdhërojë pezullimin e gjykimit civil deri në përfundim me vendim gjyqësor të formës së prerë, të procedimit penal.

4. Kundër këtij vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë ankim personi i tretë, shoqëria "Shërbimi Përmbarimor FS" shpk,e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës e paditësit për pezullimin e gjykimit.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1421, datë 11.12.2018, ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit Nr. 13949/3336 Regjistri Themeltar, datë 28.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*".

5.1. Kjo Gjykatë, ndër të tjera, ka arsyetuar se, është i drejtë dhe i bazuar në ligj arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se lidhur me pretendimin e ngritur në ankim nga personi i tretë, se proceset janë të pavarura, ai është i pabazuar në ligj. Nëse do të vijohej me gjykimin civil paralelisht me procedimin penal, ekziston mundësia e marrjes së vendimeve gjyqësore të kundërta. Gjykata e Apelit, ka vlerësuar se në rastin konkret dy çështjet janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe se jemi në kushtet e parashikuara në nenin 297/a të KPC-s. Kjo lidhje konsiston në faktin që pala paditëse kërkon me padinë civile pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, në një kohë që për të njëjtën kontratë, po zhvillohet një procedim penal me dyshimin se është e falsifikuar.

6. Kundër vendimit nr. 1421, datë 11.12.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 12.02.2019 dhe 13.02.2019, kanë paraqitur rekurs, pala e paditur, shoqëria "MCA" sha dhe personi i tretë, shoqëria "Shërbimi Përmbarimor FS" shpk, të cilat kanë kërkuar prishjen e vendimeve të dy gjykatave dhe rrëzimin e kërkesës për pezullimin e gjykimit [...]

6.1. Rezulton se palës së paditur, shoqërisë "MCA" sha i është njoftuar vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Apelit Tiranë më datë 28.12.2018, kurse personit të tretë, shoqërisë Shërbimi Përmbarimor FS" shpk, i është njoftuar me datë 18.03.2019.

7. Po ashtu, me datë 22.05.2019 ka paraqitur kundër-rekurs, paditësi, z. G.Q. [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

Në lidhje me ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave më të ulëta mbi pezullimin e gjykimit.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se rekursi ngre shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-s, pika "b", pasi nga

të dyja gjykatat nuk janë interpretuar drejt dispozitat e ligjit procedural në lidhje me pezullimin e gjykimit, sipas interpretimit të bërë në praktikën e mëparshme gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

9. Gjykata e Lartë, në raste të ngjashme, ka elaboruar kriteret që do të duhen mbajtur parasysh nga gjykatat e faktit në zbatim të nenit 297 të KPC-s. Në jurisprudencën e Gjykatës është theksuar vazhdimisht se, vendimi për pezullimin e gjykimit sipas nenit 297/a të KPC-s, është një vendim i ndërmjetëm përmes të cilit gjykata ngrin shqyrtimin gjyqësor, pasi vazhdimi i tij është i pamundur, pa pritur rezultatet e një procesi tjetër. Gjykata duhet të vendosë pezullimin në çdo rast në të cilin duhet që të zgjidhet një mosmarrëveshje nga rezultati i të cilës varet zgjidhja e çështjes konkrete. Në këtë rast pezullimi është i detyrueshëm dhe imponohet për shkak të raportit të varësisë logjike të mosmarrëveshjes objekt gjykimi dhe çështjes tjetër, ku rezultati i kësaj të fundit ndikon në zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, (kjo pasi duhet të shmanget rreziku që të ketë kundërshti ndërmjet dy vendimeve). Një tjetër kusht për vendosjen e pezullimit është që të dy çështjet nuk mund të trajtohen në të njëjtin proces.

10. Sa më sipër, që të mund të vlerësohet se ndodhemi përpara institutit të pezullimit duhet të plotësohen këto kushte: *së pari*, duhet të kenë filluar dy procese gjyqësore civile të ndryshme; *së dyti*, çështjet të jenë të lidhura me njëra-tjetrën; *së treti*, të ekzistojë pamundësia e vazhdimit të njërit prej gjykimeve pa pritur vendimin përfundimtar të procesit tjetër. Rezultati i çështjes tjetër duhet të ndikojë në mënyrë thelbësore në zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi (*Vendim nr. 00-2016 – 1822 (144), datë 28.04.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, etj.,.).*

11. Nga ana tjetër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 5, datë 12.12.2013, ndër të tjera, janë shprehur, se: "*Jo në të gjitha rastet procesi penal mund të jetë shkak për pezullimin e një gjykimi administrativ apo gjykimi civil. Referuar të drejtës sonë procedurale vendimi për pezullimin e një procesi (qoftë ky civil, administrativ, etj.,.), mund të merret vetëm atëherë kur ky i fundit nuk mund të zgjidhet plotësisht pa u sqaruar një fakt apo rrethanë e caktuar, e cila ndërkohë po vërtetohet apo po zgjidhet në një çështje tjetër penale, civile apo administrative. Për të vendosur pezullimin e një gjykimi, është e domosdoshme që çështja penale që po gjykohet të jetë e lidhur drejtpërsëdrejti dhe ngushtësisht me çështjen administrative objekt gjykimi. Është e domosdoshme që në të dyja proceset (si në atë që kërkohet të pezullohet dhe në procesin tjetër që është duke u zhvilluar), të trajtohen të njëjtat fakte dhe rrethana ose të jetë i njëjti shkak ligjor, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti tek secila prej çështjeve dhe pa zgjidhjen e njërës çështje nuk mund të zgjidhet tjetra.*".

12. Në nenin 272 të KPC-s Ligjvënësi i ka atribuuar gjykatës një pushtet diskrecional për të vlerësuar rast pas rasti nëse duhet të zhvillojë një gjykim incidental të falsitetit të shkresës apo ta pezullojë gjykimin dhe të presë vendimin penal. Në këtë kuadër shtrohet për diskutim çështja e raportit të këtyre procedimeve.

13. Kolegji vlerëson se procesi penal dhe civil në lidhje me falsitetin e dokumentit, bazuar në kriteret e elaboruara nga Kolegji Civil mbi interpretimin e nenit 297/a të KPC-s, si rregull mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur.

14. Gjykata civile, njëlloj sikurse gjykata penale, është e pajisur nga ligji procedural me mjetet për të hetuar në lidhje me falsitetin e dokumentit në mënyrë autonome dhe si rrjedhojë, nuk plotësohet kushti për pezullimin, që të dy çështjet nuk mund të trajtohen në të njëjtin proces. KPC në disa dispozita të tij ka parashikuar mundësinë e palëve në gjykimin civil të godasin shkresat për falsitet ashtu edhe të drejtën e gjykatës për të verifikuar vërtetësinë e tyre. Goditja e shkresave për falsitet përfaqëson instrumentin e kontrollit të vërtetësisë së dokumentit.

15. Ashtu sikundër edhe verifikimi i origjinalitetit të dokumentit, goditja e shkresës për falsitet, në procesin civil, mund të realizohet nëpërmjet një gjykimi principal (themeli) në kuptimin e nenit 32/c të KPC-s ose nëpërmjet gjykimit incidental (paragjykimor) ku çështja e falsitetit shtrohet për zgjidhje jo më si qëllim në vetvete por si mjet për të arritur zgjidhjen e çështjes. Gjykimi incidental ka si qëllim që t'ia zhveshë dokumentit të falsifikuar vlerën provuese, në mënyrë që ai të mos administrohet si provë në proces. Në këtë kuptim, gjykimi incidental zhvillohet vetëm nëse ai paraqitet si i domosdoshëm dhe influencon drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes. E thënë ndryshe krijohet një raport paragjykimor ndërmjet gjykimit të falsitetit të shkresës dhe gjykimit meritor (nenet 272 dhe 274 të KPC-s).

16. Në këtë vështrim juridik, verifikimi i çështjes nëse një shkresë është apo jo e falsifikuar ka si qëllim eliminimin e dokumenteve false nga qarkullimi civil apo zhvleftësimin dhe përjashtimin e tyre si prova nga gjykimi civil. Nëpërmjet këtij instrumenti në gjykimin civil, synohet të neutralizohen efektet e falsitetit material dhe ideologjik të dokumentit, duke u siguruar jo vetëm për prejardhjen dhe origjinën formale të tij, por edhe për përmbajtjen me besnikëri të deklaratave apo fakteve juridike që ai përfaqëson.

17. Kolegji vlerëson se, pavarësisht se neni 272 i KPC-s duket se i lejon gjykatës që ose të vijojë me gjykimin incidental të falsitetit ose të pezullojë gjykimin e çështjes penale, këto dy gjykime për nga destinimi dhe qëllimi që ndjekin, janë autonomë dhe të pavarur nga njëri-tjetri. Gjykimi civil ka karakter objektiv, pasi, si rregull, ka në qendër dokumentin dhe zhvleftësimin

e tij. Ndërsa gjykimi penal është me karakter subjektiv, me qëllim primar, identifikimin e autorit për vënien e tij para përgjegjësisë penale.

18. Kolegji vlerëson se, jo në çdo rast procesi civil kushtëzohet nga ai penal, sipas një vlerësimi *apriori*. Rast pas rasti, nga gjykatat do të duhet të vlerësohen fazat në të cilën ndodhen të dy proceset apo edhe fakti nëse në të dy proceset mund të shtrohet për zgjidhje përgjegjësia subjektive (civile dhe penale) e personit që ka kryer falsifikimin. Kolegji vlerëson se vetëm paraqitja e një kallëzimi penal në lidhje me falsitetin e dokumentit, ndërkohë që ka vijuar gjykimi civil, nuk mund të shërbejë si shkak pezullues në çdo rast sipas nenit 297/a të KPC-s. Në të kundërt, një interpretim i tillë i ligjit, do të nxiste çdo palë ndërgjyqëse që të përdorte kallëzimin penal si mjet për të zvarritur gjykimin civil.

19. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje qasjen e Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë, e cila në një çështje të ngjashme, me Vendimin nr. 13828, datë 1 Gusht 2012, duke interpretuar dispozitat analoge të KPC-s të Republikës së Italisë në lidhje me pezullimin e gjykimit, është shprehur ndër të tjera, se: "*Instituti procedural i pezullimit të nevojshëm nuk gjen zbatim në çështjen e falsitetit të dokumentit. Regjimi i raportit midis dy proceseve, civil dhe penal, sipas rendit juridik procedural në fuqi, (në lidhje me çështjen e falsitetit) inspirohet nga parimi i autonomisë dhe ndarjes së dy proceseve si dhe të pajisjes të secilit gjyqtar (penalist apo civilist) me pushtetin e plotë të njohjes së vërtetësisë së dokumentit, me qëllim zgjidhjen e çështjeve juridike apo faktike që do t'i duhet t'i vendosë në themel të vendimit të tij.*".

20. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, vendimi i ndërmjetëm i gjykatave më të ulëta me të cilin është vendosur pezullimi i gjykimit civil, me objekt falsitetin e kontratës së kredisë bankare, me arsyetimin *apriori* se ka filluar procedimi penal sipas nenit 186 të KP-s për të njëjtin dokument, pa vlerësuar konkretisht se në çfarë mënyre gjykimi civil është i kushtëzuar apo nuk mund të përfundojë pa përfunduar procesi penal, është i pabazuar në ligj.

Në lidhje me mënyrën se si duhet të vendosë Kolegji në lidhje me çështjen konkrete.

17. Në këtë rast, objekt gjykimi është një ankim i veçantë, me objekt një vendim të ndërmjetëm të gjykatës. Kolegji vlerëson të nevojshme të ndalet në risinë që sollën ndryshimet e vitit 2017 në KPC për sa i përket ritit të gjykimit rishikues në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë mbi gjykimin e ankimeve të veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetme.

18. Para datës 05.11.2017 ligji procedural nuk parashikonte rit të posaçëm gjykimi për ankimet e veçanta në gjykimin rishikues. Me ndryshimet ligjore procedurale të hyra në fuqi në këtë datë u parashikua se të gjitha vendimet e ndërmjetme të cilat ankimohen sipas ligjit në mënyrë të veçantë do të shqyrtohen nga ana e gjykatës më të lartë me juridiksion rishikues sipas ritit të gjykimit kameral dhe se gjykimi duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë.

19. Ky ndryshim u shoqërua edhe me ndryshimin e nenit 448 të KPC-s, në të cilin u ndalua gjykata rishikuese të bashkojë ankimet e llojeve të ndryshme të ushtruara nga palët mbi të njëjtin gjykim apo vendim. Më tej, me këtë qëllim u prezantua për herë të parë në ligjin procedural civil edhe një normë e posaçme për gjykimin kameral në gjykatën e apelit, konkretisht neni 465/a i KPC-s. Mesazhi i ligjvënësit ishte që ritmi i gjykimit të ankimeve të veçanta nuk mund të jetë i njëjtë me ritmin e gjykimit të ankimeve të zakonshme. Sigurisht që *ratio* e këtij ndryshimi ligjor procedural ishte garantimi i efektivitetit të ankimit të veçantë dhe njëkohësisht edhe ekonomizimi i afateve të gjykimeve të ndërmjetme të cilat janë mekanizmat proceduralë që ndikojnë thelbësisht edhe në mbarëvajtjen e gjykimit të zakonshëm.

20. Kjo do të thotë se në çdo rast gjykimi kameral i ankimeve të veçanta në gjykatën më të lartë nuk mund të njësohet me gjykimin e zakonshëm të ankimeve dhe se këto dy gjykime të posaçme zhvillohen sipas regjimeve të ndryshme juridike me qëllim garantimin e efektivitetit sipas karakteristikave të këtyre mjeteve procedurale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se nenit 470 të KPC-s nuk mund t'i imponohen në çdo rast, edhe kur janë të papajtueshme me këtë procedurë gjykimi, rregullat e gjykimit të zakonshëm. Në këtë kuptim Kolegji vlerëson se shqyrtimi në Gjykatën e Lartë i rekurseve të veçanta, njëlloj sikurse në gjykatën e apelit, i apeleve të veçanta, duhet të pasohet nga zgjidhja përfundimtare e kontestit të palëve mbi ligjshmërinë e vendimit të ndërmjetëm të ankimuar. Për rrjedhojë, do të ishte e papajtueshme me qëllimin ligjvënës të ndryshimeve ligjore të vitit 2017 që gjykata rishikuese të mos e zgjidhte ankimin e veçantë përfundimisht dhe të mundej ta kthente çështjen për rigjykim. Kjo zgjidhje nuk do të justifikohej nga nevoja e gjykimit të themelit për të pasur ecuri dhe mbarëvajtje të pandërprerë dhe të sigurt dhe as nga nevoja e garantimit të efektivitetit të mjeteve të posaçme të ankimit, sipas nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-s.

21. Kolegji vlerëson se rregullat mbi disponimin e gjykatës rishikuese mbi vendimet e ndërmjetme të cilat ankimohen me ankime të veçanta, sipas nenit 470 të KPC-s, janë të ndryshme nga rregullat qëregjojnë disponimet e gjykatës rishikuese ndaj vendimeve përfundimtare objekt ankimi, konkretisht dhe respektivisht sipas nenit 466, 480 dhe 485 të

KPC-s. Këto dispozita do të zbatohen për aq kohë sa pajtohen me gjykimin e posaçëm të ankimeve të veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetme. Ligjvënësi ka parashikuar se brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatën rishikuese do të duhet që ankimi i veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të marrë një zgjidhje me qëllim që të garantohet mbarëvajtja e procesit gjyqësor kryesor dhe se kjo mbarëvajtje mund të garantohet vetëm duke kuptuar se vendimi i ndërmjetëm objekt ankimi në çdo rast do të duhet të marrë një përgjigje përfundimtare në mënyrë që kjo çështje të jetë e zgjidhur juridikisht.

22. Në këtë kuadër Kolegji sjell në vëmendje një praktikë të Gjykatës së Lartë, ku është konkluduar se për vendimet e ndërmjetme objekt rekursi, nuk zbatohen rregullat e përgjithshme në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, për shkak se ato kanë karakter urgjent dhe do të duhet të gjykohen me shpejtësi. Këto vendime nuk mund të prishen dhe të kthehen për rigjykim sipas nenit 467 të KPC, por për to duhet të konkludohet përfundimisht nga Gjykata e Lartë.

22.1. Kështu, me vendimin nr. 00-2006-363 (849), datë 29.06.2006, në lidhje me rekursin ndaj vendimit të ndërmjetëm për masën e sigurimit të padisë, Kolegji Civil është shprehur ndër të tjera se: *"Gjykimi për sigurimin e padisë është një gjykim i veçantë që lidhet me garantimin e të drejtave të kërkuesit, të cilat do të bëheshin të pamundura, ose të vështira për t'u ekzekutuar në rastin kur atij do i pranohej padia. Ky gjykim kërkon shpejtësi për të parandaluar pasoja të cilat do ishin të pariparueshme, ose që kërkojnë më shumë kohë dhe kontribut për riparimin e tyre në qoftë se përgjigja apo vendimmarrja gjyqësore nuk do ishte në kohën e duhur. Jo pa qëllim ligjvënësi lejon sigurimin e padisë edhe përpara se të ngrihet ajo, neni 204 i KPC-s. Gjykata e apelit ka qenë përpara rastit tipik që të shprehej për pranimin ose jo të masës provizore të dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe jo të kthente aktet për rigjykim asaj gjykate. Kjo mënyrë gjykimi e kërkesës për sigurimin e padisë nuk i përgjigjet aspak kuptimit të dispozitave të kreut IV të KPC-s dhe e zvarrisin gjykimin në kohë, duke e bërë të paefektshme vetë masën e sigurimit."*.

23. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, me vendimin e ndërmjetëm të marrë nga gjykata e shkallës së parë, lënë në fuqi nga gjykata e apelit, është pezulluar në mënyrë të paligjshme vijimi i gjykimit në shkallë të parë, si rrjedhojë zgjidhja e çështjes përfundimisht nga Gjykata e Lartë, që përputhet edhe me interesin e paditësit për të bërë rekurs, do të ishte prishja e dy vendimeve dhe urdhërimi për vijimin e gjykimit në shkallë të parë.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2020-728, datë 26.11.2020

Paditë e njohjes (pronar mbi një send të paluajtshëm) nuk mund të sigurohen me masë sigurimi padie pasi natyra e vendimit është deklarative dhe nuk përbën titull ekzekutiv. Këto vendime kanë natyrë parandaluese dhe shërbejnë si bazë për dhënien e një vendimi detyrimi në të ardhmen. Sigurimi i padisë nuk garanton ekzistencën e së drejtës në kuptimin juridik, por material.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se, paditësit, E.O. etj., i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me padi me objekt njohje pronar mbi një send të paluajtshëm sipas nenit 169 të KC-s, kundrejt palës së paditur "A." sha si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Ka rezultuar se pasuria e paluajtshme objekt gjykimi, është nxjerrë nga pala e paditur në ankand për shitje, [...] nga Agjencia e Prokurimeve Publike. Sa më sipër, paditësit kanë paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, bashkë me padinë edhe një kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke kërkuar konkretisht pezullimin e procedurës së ankandit të shpallur në Buletinin nr. 10, datë 11.03.2019 për shitjen e pasurisë objekt gjykimi.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në dhomë këshillimi, me vendimin e ndërmjetëm datë 08.04.2019 ka vendosur: "*1. Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë. 2. Pezullimin e shitjes në ankand të pasurisë nr. 731/150, ZK 2648, objekt "Fjetore 5 kate", ndodhur në fshatin Mëmëlisht, Pogradec, botuar në buletinin nr. 10, datë 11.03.209 në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik. 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Urdhërohet sekretaria gjyqësore që një kopje e këtij vendimi t'u dërgohet paditësve...". [...]*

4.Kundër vendimit datë 08.04.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka paraqitur ankim pala e paditur, shoqëria "A." sha, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë si dhe Avokatura e Shtetit, të cilat kanë kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës së palës paditëse.

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 36, datë 13.06.2019, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. s'ka, datë 08.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec."*[...]

6. Rezulton se vendimi i arsyetuar i është komunikuar palës së paditur më datë 05.07.2019.

7. Kundër vendimit nr. 36, datë 13.06.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë, më datë 18.07.2019 ka paraqitur rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

Në lidhje me ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave më të ulëta mbi sigurimin e padisë.

8. Kolegji vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim, KPC), të cilat i bëjnë të cenueshme vendimet e dy gjykatave më të ulëta. Kolegji vlerëson se në rastin konkret, nuk janë interpretuar drejt dispozitat e ligjit procedural në lidhje me masën e sigurimit të padisë, sipas interpretimit të bërë në praktikën e mëparshme gjyqësore të Gjykatës së Lartë, sikurse do të analizohet në vijim.

9. KPC dhe Ligji nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*", u kanë ofruar palëve ndërgjyqëse mjete të posaçme që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të KPC-s apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të KPC-s apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas neneve 449, 469 dhe 479 të KPC-s. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet/rekurset.

10. Gjykata, në caktimin e masës së sigurimit të padisë në veçanti (sikurse është rasti konkret), u referohet kërkesave që ligji parashikon dhe kërkon, konkretisht ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës. Nga ana tjetër, kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata. Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve

përkatëse në çdo shkallë gjykimi, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

11. Nga ana tjetër, masa e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 të KPC-s, përbën kufizim të të drejtave të palës së paditur dhe si e tillë, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë proporcionale dhe e justifikuar ligjërisht, për mbrojtjen e të drejtave të palës tjetër ose nga një interes publik. Justifikimi ligjor dhe kushtetues sipas nenit 202 të KPC-s për kufizimin e të drejtave të palës së paditur, është dyshimi se e drejta e pretenduar e paditësit karshi palës së paditur ekziston dhe dyshimi i arsyeshëm se nëse kjo e drejtë nuk garantohet me masë sigurimi, ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur ose i vështirë në të ardhmen.

12. KPC ka garantuar edhe standardin e proporcionalitetit të këtij kufizimi, duke parashikuar se sigurimi i padisë mund të vendoset përkundrejt një garancie pasurore nga pala paditëse, për dëmin që mund t'i shkaktohet të padituri nga sigurimi i padisë (neni 202/b i KPC-s). Po ashtu, për të garantuar proporcionalitetin, në nenin 206/2 të KPC-s është parashikuar se sigurimi i padisë nuk mund të bëhet për një shumë më të madhe se ajo e padisë.

13. Duke iu rikthyer rastit konkret, *Kolegji vlerëson se padia objekt gjykimi është një padi njohjeje (njohje pronar) mbi një send të paluajtshëm, që eventualisht do të çojë në dhënien e një vendimi njohjeje me natyrë deklarative. Padi të tilla nuk mund të sigurohen me masë sigurimi padie, pasi në fund të gjykimit nuk do të shkaktojnë nxjerrjen e një titulli ekzekutiv.* Pavarësisht se neni 203/1 i KPC-s parashikon se sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive, kjo dispozitë duhet interpretuar në mënyrë sistematike dhe teleologjike, në raport me nenin 202 të KPC-s,në kuptimin dhe qëllimin pse vendoset masa e sigurimit të padisë si dhe në raport me nenin 510/a të KPC-s.

13.1. Sikurse u analizua më sipër, sipas nenit 202 të KPC-s, masa e sigurimit të padisë ka për qëllim të garantojë të drejtën objekt gjykimi, kur ekziston rreziku se ekzekutimi i vendimit në përfundim të gjykimit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sipas nenit 510/a të KPC-s, vendime me efekte ekzekutive apo tituj ekzekutivë janë vetëm vendimet civile të formës së prerë që përmbajnë një detyrim. Vendimet deklarative (të njohjes) nuk janë tituj ekzekutivë. Ato kanë natyrë parandaluese dhe shërbejnë si bazë për dhënien e një vendimi detyrimi në të ardhmen.

14.Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se edhe sikur të ishim para një padie detyrimi, në thelb paditësi nëpërmjet kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, ka synuar të pezullojë kryerjen e veprimeve juridike

të tjetërsimit mbi sendin e paluajtshëm objekt gjykimi, deri në përfundim të procesit gjyqësor, duke pretenduar se nëse e drejta objekt gjykimi do të kalonte tek persona të tretë, ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

15. Kolegji vlerëson se, ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, *sigurimi i padisë nuk garanton ekzistencën e së drejtës në kuptimin juridik, por material*. Qëllimi i synuar nga pala në rastin konkret arrihet nëpërmjet regjistrimit të padisë sipas nenit 197/b të KC-s, i cili ka parashikuar se duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme kërkesëpaditë për fitimin, njohjen, ndryshimin ose pushimin e të drejtave të pronësisë ose të drejtave të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme. Regjistrimi i padisë, nuk mbron palët, por mbron të tretët që kryejnë veprime juridike në lidhje me atë send, për shkak se sipas neneve 451/a dhe 200 të KPC-s vendimi gjyqësor është i detyrueshëm, jo vetëm për palën, por edhe për personat që kanë fituar të drejta nga palët gjatë gjykimit.

16. Nga ana tjetër, sipas nenit 603 të KPC-s, nëse e drejta dhe posedimi i sendit është fituar nga personi i tretë gjatë gjykimit, vendimi është i detyrueshëm dhe i ekzekutueshëm menjëherë dhe drejtpërdrejt ndaj këtij të fundit. Kjo do të thotë se në momentin e regjistrimit të padisë, kushdo që kryen veprime juridike mbi sendin në konflikt prezumohet se ka dijeni se po e ble me barrë dhe merr përsipër riskun, sipas vlerësimit të interesave të tij vetjake dhe disponibilitetit mbi të drejtat e tij, që në përfundim të gjykimit mund ta humbasë të drejtën mbi atë send. Si rrjedhojë Kolegji vlerëson se është pa bazë ligjore arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i gjykatës së apelit, se po të tjetërsohet sendi gjatë gjykimit, palës paditëse do t'i duhet të iniciojë procese të tjera gjyqësore për rivendosjen e së drejtës.

17. Kolegji vlerëson se ekzistenca e një procesi gjyqësor me objekt të drejtat reale mbi një send të paluajtshëm nuk legjitimon *apriori* kufizimin e qarkullimit civil mbi atë send dhe pezullimin e kryerjes së veprimeve juridike mbi të, por se të tretët, të cilët prezumohet se kanë dijeni mbi procesin për shkak të regjistrimit të padisë, në regjistrat e pasurive të paluajtshme, marrin përsipër riskun që po kryejnë veprime tjetërsimi mbi një send me barrë (sikurse mund të jetë rasti që sendi është vendosur në hipotekë), sipas parimit se e drejta reale ndjek sendin dhe kjo e dallon nga e drejta relative e detyrimit që i kundrejtohet një personi të caktuar.

18. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se vendimi i ndërmjetëm me të cilin është vendosur masa e sigurimit të padisë është i papërligjur dhe i pajustifikuar, pasi të drejtat e paditësit, janë në çdo rast të garantuara *ex lege*, sipas dispozitave të analizuara më sipër, pa qenë e nevojshme të vendoset masë sigurimi padie. Si rrjedhojë, nuk plotësohet premisa bazë ligjore e masës së sigurimit të padisë, rreziku se ekzekutimi i vendimit gjyqësor në të ardhmen do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

19. Kolegji vlerëson se kjo vendimmarrje e gjykatave më të ulëta, përbën kufizim pa ligj dhe në mënyrë të pajustifikuar, të së drejtës së pronës së palës paditur. Ky interpretim i gabuar i ligjit nga gjykatat nuk është në pajtim me nenet 11 dhe 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me nenin 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim, KEDNJ).

Në lidhje me mënyrën se si duhet të vendosë Kolegji

20. Në këtë rast objekt gjykimi është një ankim i veçantë me objekt një vendim të ndërmjetëm të gjykatave më të ulëta që kanë vendosur në lidhje me kërkesën e paditësit për sigurimin e padisë. Kolegji vlerëson të nevojshme të ndalet në risinë që sollën ndryshimet e vitit 2017 në KPC për sa i përket ritit të gjykimit rishikues në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë mbi gjykimin e ankimeve të veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetme.

21. Para datës 05.11.2017 ligji procedural nuk parashikonte rit të posaçëm gjykimi për ankimet e veçanta në gjykimin rishikues. Me ndryshimet ligjore procedurale të hyra në fuqi në këtë datë u parashikua se të gjitha vendimet e ndërmjetme të cilat ankimohen sipas ligjit në mënyrë të veçantë do të shqyrtohen nga ana e gjykatës më të lartë me juridiksion rishikues sipas ritit të gjykimit kameral dhe se gjykimi duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë. Ky ndryshim u shoqërua edhe me ndryshimin e nenit 448 të KPC-s, në të cilin u ndalua gjykata rishikuese të bashkojë ankimet e llojeve të ndryshme të ushtruara nga palët mbi të njëjtin gjykim apo vendim.

22. Më tej me këtë qëllim u prezantua për herë të parë në ligjin procedural civil edhe një normë e posaçme për gjykimin kameral në gjykatën e apelit, konkretisht neni 465/a i KPC-s. Mesazhi i ligjvënësit ishte që ritmi i gjykimit të ankimeve të veçanta nuk mund të jetë i njëjtë me ritmin e gjykimit të ankimeve të zakonshme. Sigurisht që *ratio* e këtij ndryshimi ligjor procedural ishte garantimi i efektivitetit të ankimit të veçantë dhe njëkohësisht edhe ekonomizimi i afateve të gjykimeve të ndërmjetme të cilat janë mekanizmat proceduralë që ndikojnë thelbësisht edhe në mbarëvajtjen e gjykimit të zakonshëm.

23. Kjo do të thotë se në çdo rast gjykimi kameral i ankimeve të veçanta në gjykatën më të lartë nuk mund të njësohet me gjykimin e zakonshëm të ankimeve dhe se këto dy gjykime të posaçme zhvillohen sipas regjimeve të ndryshme juridike me qëllim garantimin e efektivitetit sipas karakteristikave

të këtyre mjeteve procedurale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se nenit 470 të KPC-s nuk mund t'i imponohen në çdo rast, edhe kur janë të papajtueshme me këtë procedurë gjykimi, rregullat e gjykimit të zakonshëm. Në këtë kuptim, shqyrtimi në Gjykatën e Lartë i rekurseve të veçanta, njëlloj sikurse në gjykatën e apelit, i apeleve të veçanta, duhet të pasohet nga zgjidhja përfundimtare emosmarrëveshjeve të palëve mbi ligjshmërinë e vendimit të ndërmjetëm të ankimuar. Për rrjedhojë, do të ishte e papajtueshme me qëllimin ligjvënës të ndryshimeve ligjore të vitit 2017 që gjykata rishikuese të mos e zgjidhte ankimin e veçantë përfundimisht dhe të mundej ta kthente çështjen për rigjykim. Kjo zgjidhje nuk do të justifikohej nga nevoja e gjykimit të themelit për të pasur ecuri dhe mbarëvajtje të pandërprerë dhe të sigurt dhe as nga nevoja e garantimit të efektivitetit të mjeteve të posaçme të ankimit, sipas nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-s.

24. Në këtë logjikë juridike, Kolegji vlerëson se rregullat mbi disponimin e gjykatës rishikuese mbi vendimet e ndërmjetme të cilat ankimohen me ankime të veçanta, sipas nenit 470 të KPC-s, janë të ndryshme nga rregullat që regjojnë disponimet e gjykatës rishikuese ndaj vendimeve përfundimtare objekt ankimi, konkretisht dhe respektivisht sipas neneve 466, 480 dhe 485 të KPC-s. Këto dispozita do të zbatohen për aq kohë sa pajtohen me gjykimin e posaçëm të ankimeve të veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetme. Ligjvënësi ka parashikuar se brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatën rishikuese do të duhet që ankimi i veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të marrë një zgjidhje me qëllim që të garantohet mbarëvajtja e procesit gjyqësor kryesor dhe se kjo mbarëvajtje mund të garantohet vetëm duke kuptuar se vendimi i ndërmjetëm objekt ankimi në çdo rast do të duhet të marrë një përgjigje përfundimtare në mënyrë që kjo çështje të jetë e zgjidhur juridikisht.

25. Në këtë kuadër Kolegji sjell në vëmendje një praktikë të Gjykatës së Lartë, ku është konkluduar se për vendimet e ndërmjetme objekt rekursi, nuk zbatohen rregullat e përgjithshme në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, për shkak se ato kanë karakter urgjent dhe do të duhet të gjykohen me shpejtësi. Këto vendime nuk mund të prishen dhe të kthehen për rigjykim sipas nenit 467 të KPC-s, por për to duhet të vendoset përfundimisht nga Gjykata e Lartë.

25.1. Konkretisht, me vendimin nr. 00-2006-363 (849), datë 29.06.2006, në lidhje me rekursin ndaj vendimit të ndërmjetëm për masën e sigurimit të padisë, Kolegji Civil është shprehur ndër të tjera se: *"Gjykimi për sigurimin e padisë është një gjykim i veçantë që lidhet me garantimin e të drejtave të kërkuesit, të cilat do të bëheshin të pamundura, ose të vështira për t'u ekzekutuar në rastin kur atij do i pranohej padia. Ky gjykim kërkon shpejtësi për të parandaluar pasoja të cilat do ishin të pariparueshme, ose që kërkojnë më shumë kohë dhe kontribut për riparimin e tyre në qoftë se përgjigja apo vendimmarrja gjyqësore nuk do ishte në kohën e duhur. Jo pa qëllim ligjvënësi lejon sigurimin e padisë edhe përpara se të ngrihet ajo, neni 204 i KPC-s. Gjykata e apelit ka qenë përpara rastit tipik që të shprehej për pranimin, ose jo të masës provizore të dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe jo të kthente aktet për rigjykim asaj gjykate. Kjo mënyrë gjykimi e kërkesës për sigurimin e padisë nuk i përgjigjet aspak kuptimit të dispozitave të kreut IV të KPC-s dhe e zvarrit gjykimin në kohë, duke e bërë të paefektshme vetë masën e sigurimit."*.

26. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, me vendimin e ndërmjetëm të marrë nga gjykata e shkallës së parë, lënë në fuqi nga gjykata e apelit, është vendosur sigurimi i padisë në kundërshtim me ligjin, si rrjedhojë zgjidhja e çështjes përfundimisht nga Gjykata e Lartë, që përputhet edhe me interesin e palës së paditur për të bërë rekurs, do të ishte prishja e dy vendimeve dhe anulimi i masës së sigurimit të padisë.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-204, datë 06.01.2021

Kohëzgjatja nga regjistrimi, kategoria si çështje e kthyer nga Gjykata Kushtetuese, si dhe gjendja "gjyqësore" e çështjes përbëjnë arsye për shqyrtimin e saj me përparësi.

Heqja dorë si veprim juridik i njëanshëm ka efekte të menjëhershme për titullarin (subjektin e së drejtës së pronësisë) pasi kjo e drejtë do të konsiderohet si e humbur dhe marrëdhënia e pronësisë ndërmjet subjektit të së drejtës dhe sendit do të konsiderohet juridikisht e shkëputur që nga momenti i shfaqjes së vullnetit për heqjen dorë. Revokimi i mëpasshëm i veprimit juridik të heqjes dorë nga e drejta e pronësisë, nuk do të ketë efekt rikuperues të pozitës juridike të mëparshme.

I. Rrethanat e çështjes

1. Palët ndërgjyqëse në këtë gjykim kanë qenë bashkëshortë për një periudhë prej gati 12 vitesh. Martesa e tyre ligjore është lidhur në vitin 1997 dhe është zgjidhur me vendimin nr. 271, datë 05.02.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

2. Nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. 4209 rep.,nr.1077 kol., datë 23.08.2002, palët ndërgjyqëse në këtë gjykim, gjatë kohës që kanë qenë të lidhur në martesë, kanë blerë pasurinë e paluajtshme të ndodhur në [...]

3. Gjithashtu, po në të njëjtën datë, nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. 4210 rep.,nr. 1078 kol., palët ndërgjyqëse në këtë gjykim kanë blerë nga shtetasit Ll. D., etj., pasurinë e paluajtshme, apartament banimi me sipërfaqe 52.72 m² [...]

4. Midis palës paditëse në këtë gjykim E.N. dhe shtetasit A.L., është lidhur para noteres L.C., kontrata e shitblerjes paraprake me nr. 1779 rep., dhe nr. 1050 kol., datë 21.07.2008, nëpërmjet të cilës paditësja, kundrejt vlerës prej 4.700.000 (katër milion e shtatëqind mijë lekë) ka blerë nga shitësi (A.L.) pasurinë e paluajtshme apartament banimi të tipit "3A", me sipërfaqe 81.97 m² së bashku me ambientet e përbashkëta, në katin e tretë të banimit. [...]

5. Po në datën 21.07.2008, përpara të njëjtës notere (L.C.), pala paditëse E.N. ka hartuar deklaratën noteriale, ku deklaron ndër të tjera s*enga këto dy pasuri, unë E.N.., heq dorë, duke mos pasur asnjë pretendim më për*

këto prona, për arsye se sot bashkëshorti im K.K., sot në datën që po bëj deklaratën, më ka blerë mua, një apartament në lagjen "29 Nëntori", në pallatin e ndërtuar nga z. A.L., sipas kontratës me nr. 1779 rep., dhe nr. 1050 kol., datë 21.07.2008 dhe ka paguar të gjithë vlerën e blerjes së apartamentit, po sot në datën 21.07.2008. Ky apartament që u ble sot në datën 21.07.2008, është vetëm në emrin tim, E.N.. Apartamenti është i përfunduar por i paregjistruar në hipotekë dhe procedurat do të vazhdohen nga ana ime me palën shitëse për ta regjistruar pronën në emrin tim në hipotekë...".

6. Në datën 23.07.2008, pala paditëse E.N. është paraqitur para noteres L.C. dhe ka hartuar deklaratën noteriale me nr. 1811 rep. dhe nr. 1067/2 kol., me të cilën ndër të tjera ka deklaruar se[...]*nga pajisjet e përbashkëta shtëpiake do të marr këto sende: hekurin, fshesën me korrent, të gjithë pajën time dhe nga pajisjet e tjera heq dorë, pasi kam lënë djalin që të jetojë me bashkëshortin. Pasi t'i marr të gjitha pajisjet e mësipërme për 2-3 ditë do të largohem nga banesa bashkëshortore. Këtë deklaratë e bëj para noterit që për ato ç'ka kontribuar bashkëshorti im K.K., unë jam e ndërgjegjshme...".*

7. Në datën 07.01.2009, pala paditëse E.N. është paraqitur para noteres L.C. dhe ka hartuar deklaratën noteriale me nr. 60 rep. dhe nr. 19/2 kol., me të cilën ndër të tjera ka deklaruar se: [...] *kërkon të anulojë dhe të quajë të pavlefshëm deklarimin e bërë dhe të nënshkruar prej saj para meje në datën 21.07.2008. Znj. E.N., deklaron se të gjitha disponimet që kam bërë në këtë deklaratë noteriale, duke mos njohur asnjë lloj pasoje juridike që mund të ketë ardhur nga kjo deklaratë, i anuloj dhe e quaj të pavlefshëm deklarimin tim në datën 21.07.2008, para noteres L.C.. Gjithashtu, deklaroj se revokoj çdo vullnet të mëparshëm timin, në cilëndo deklaratë noteriale, që lidhet me pasurinë e vënë gjatë martesës, si dhe në lidhje me kontributin e dhënë nga unë dhe nga bashkëshorti im K.K....".*

8. Rezulton se me vendimin gjyqësor të formës së prerë me nr. 271, datë 05.02.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur zgjidhjen e martesës midis palëve ndërgjyqëse në këtë gjykim [...]

9. Pas zgjidhjes së martesës me vendim të formës së prerë, pala paditëse në këtë gjykim në datën 13.04.2009 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për të bërë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të vënë gjatë jetës bashkëshortore [...]

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1755 Regj., datë 07.09.2009, ka vendosur: *"Pranimin e padisë për fazën e parë të pjesëtimit. Lejimin e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët vënë gjatë martesës së paditëses E.N. dhe të paditurit K.K., duke caktuar pjesë të barabarta nga ½ secili mbi sendet që do të pjesëtohen [...]*

11. Kundër vendimit nr. 1755 Regj., datë 07.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka ushtruar ankim pala e paditur. Në ankimin e saj pala e paditur pretendon se sipas saj nuk ekziston bashkëpronësia mbi këto pasuri, pasi pala paditëse me anë të deklaratës nr. 1782 rep., e nr. 1052 kol., datë 21.07.2008, ka hequr dorë nga pasuritë objekt gjykimi e për pasojë, vendimi i gjykatës është i pabazuar në ligj e në prova.

12. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 95, datë 23.04.2010, ka vendosur: *"Ndryshimin e vendimit nr. 1755 Akti, datë 07.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke e gjykuar çështjen në fakt. Rrëzimin e padisë së paditëses E.N."* .

12.1. Kjo gjykatë ka arsyetuar se, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është marrë në interpretim e zbatim të gabuar të ligjit. Në vendimin e saj Gjykata e Apelit Vlorë mban qëndrimin se përmes deklaratës noteriale nr. 1782 rep. dhe nr. 1053/3 kol., datë 21.07.2008, paditësja E.N. ka hequr dorë nga bashkëpronësia mbi pasuritë objekt pjesëtimi, duke hequr dorë vullnetarisht kështu nga pjesa takuese në këtë bashkëpronësi [...]

13. Kundër vendimit nr. 95, datë 23.04.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs pala paditëse [....]

14. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 2245, datë 01.11.2012, ka vendosur: "*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse E.N. kundër vendimit nr.95, datë 23.04.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë".*

14.1. Kjo gjykatë ka arsyetuar se rekursi i paraqitur nga pala paditëse E.N. nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPCs.

15. Pala paditëse E.N., nuk ka qenë dakord me vendimin e dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe e ka ankimuar atë pranë Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se i është cenuar e drejta për të pasur një proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të parimit të paanësisë, si dhe parimit për të pasur akses në gjykatë (pra për të marrë përgjigje në lidhje me çështjet ligjore që i ka adresuar gjykatës).

16. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 42, datë 07.07.2014, ka vendosur: "*Pranimin pjesërisht të kërkesës. Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.00-2012-2245, datë 01.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë". [...]*

17. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 2555, datë 01.10.2014, ka vendosur: *"Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse E.N. kundër vendimit nr.95, datë 23.04.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë".*

17.1. Kjo gjykatë ka arsyetuar se: *"Referuar nenit 472 të KPC-s, vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji, kur ka shkelje të rënda të normave procedurale (sipas nenit 467 të KPC-s), si dhe për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet në rekurs të paditëses, në kuptim të neneve 472 dhe 485 të KPC-s, nuk konstaton mosrespektimin e ligjit ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, ndaj provave të administruara në gjykimin e faktit dhe që i janë nënshtruar debatit gjyqësor, si pretendime me natyrë kushtetuese nëçështjen objekt rekursi. Përfundimisht, Kolegji Civil në dhomën e këshillimit vlerëson se rekursi i paraqitur nga paditësja E.N. nuk duhet pranuar".*

18. Pala paditëse E.N., sërish e ka kundërshtuar vendimin e dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë pranë Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se asaj i është cenuar e drejta për të pasur një proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të parimit të paanësisë, parimit për të pasur akses në gjykatë (pra për të marrë përgjigje në lidhje me çështjet ligjore që i ka adresuar gjykatës), si dhe cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë.

19. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 44, datë 29.06.2015, ka vendosur:"Pranimin pjesërisht të kërkesës.Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.00-2014-2555, datë 01.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë".

19.1. Kjo gjykatë ka arsyetuar se: *"...Në rastin konkret, siç rezulton nga përmbajtja e vendimit nr. 00-2014-2555, datë 01.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e rekursit. Për nga vetë natyra seleksionuese e dhomës së këshillimit është i pranuar fakti se vendimet që finalizojnë këto gjykime kanë një arsyetim të kufizuar, megjithatë jo në çdo rast ky arsyetim mund të përmbushë kriteret përcaktuese të procesit të rregullt ligjor, veçanërisht kur në rekurs ngrihen pretendime me natyrë kushtetuese. Nëse më parë GJK-ja ka vlerësuar (shih më lart vendimin nr. 42/2014) se kërkueses i është cenuar e drejta e aksesit në kuptimin substancial nga Kolegji Civil i Gjykatës ë Lartë, Gjykata çmon se edhe rigjykimi i çështjes në dhomë këshillimi nuk ia ka garantuar kërkueses këtë të drejtë (kupto: e drejta aksesit).[...]. Si përfundim, Gjykata çmon se kërkesa duhet pranuar".*

20. Gjykata e Lartë, me vendimin e dhomës së këshillimit në datë 31.05.2018, ka vendosur kalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike me prani të palëve.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

A - Në lidhje me procedurën.

21. Bazuar në përmbajtjen e nenit 482 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ku thuhet se:*" ... sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit,* njoftimi i palëve ndërgjyqëse për datën dhe orën e gjykimit të çështjes është bërë rregullisht nga ana e sekretarisë gjyqësore përmes shpalljes. Ka rezultuar se në datën dhe orën e caktuar palët ndërgjyqëse janë konstatuar nga Kolegji Civil në mungesë.

22. Kolegji Civil, duke vlerësuar faktin se Gjykata e Lartë doli në seancë publike për herë të parë pas një ndërprerjeje të gjatë dhe kjo mungesë e gjatë e zhvillimit të seancave publike mund të ketë shkaktuar edhe mosmarrjen dijeni për datën dhe orën e gjykimit për palët ndërgjyqëse, përjashtimisht vendosi të shtyjë seancën dhe të vijojë njoftimin e palëve për datën dhe orën e gjykimit sipas procedurave të zakonshme të thirrjes në gjykatë, parashikuar nga nenet 129 e vijues të KPC-s.

23. Ka rezultuar se paditësja, edhe pas njoftimit me fletëthirrje dhe më pas, edhe pas njoftimit me shpallje publike (shkak për shtyrjen e seancës së datës 09.12.2021), është konstatuar në mungesë në seancë. Kolegji Civil, në seancën e datës 06.01.2021, pasi konstatoi mungesën e prezencës së palës paditëse / përfaqësuesit të saj në seancë, pasi i mori mendimin edhe palës së paditur në lidhje me vijueshmërinë e procesit, si dhe pasi vlerësoi se përpjekjet e Kolegjit Civil për njoftimin e paditëses ishin ezauruar konform kërkesave të KPC-s, vendosi të zhvillojë procesin gjyqësor në mungesë të palës paditëse.

24. Kolegji Civil vlen të përmendë edhe arsyet ligjore që nxitën gjykimin e çështjes me përparësi. Rekursi objekt shqyrtimi rezulton që të jetë ushtruar në vitin 2010, dhe nga ai moment çështja rezulton ende pa një vendimmarrje nga Gjykata e Lartë. Vetë kohëzgjatja nga regjistrimi i rekursit e deri më tash pa një vendimmarrje nga Gjykata e Lartë është një shkak më se i përligjur dhe i mjaftueshëm për Kolegjin që ta shqyrtojë këtë çështje me përparësi. Për më tepër, shkak për gjykimin e çështjes me përparësi është edhe kategoria e saj si çështje e kthyer nga Gjykata Kushtetuese (dy herë) referuar këtu për analogji, përcaktimeve të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pikës 3.2,germa c)*"çështje që duhen shqyrtuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese"*. Shkak tjetërligjor për gjykimin me

përparësi të kësaj çështjeje ka qenë edhe gjendja juridike e saj (statusi) si çështje "në gjykim", kjo e vendosur nga Kolegji Civil me vendimin e datës 31.05.2018. Gjendja gjyqësore e çështjes është një arsye më tepër që Kolegji Civil të shqyrtojë çështjen me përparësi.

B- Në lidhje më shkaqet e rekursit.

25. Kolegji vlerëson të evidentojë faktin se vendimet e gjykatave më të ulëta janë të kundërta përsa i përket përcaktimit të objekteve të cilat duhet t'i nënshtrohen regjimit pasuror dhe për rrjedhojë fazës së pjesëtimit të pasurisë. Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se të dyja pronat objekt të këtij gjykimi janë pjesë e regjimit martesor, ndërsa Gjykata e Apelit ka vlerësuar se këto pasuri nuk janë pjesë e regjimit të bashkësisë martesore, pasi pala paditëse ka hequr dorë nga e drejta e pronësisë mbi këto pasuri, nëpërmjet deklaratës noteriale me nr.1782 rep., dhe nr.1052 kol., datë 21.07.2008, pasi ajo ka përfituar për këtë veprim një apartament 1+1, në vlerën e 4.700.000 lekësh, të cilat janë likuiduar tërësisht përpara zgjidhjes së martesës ligjore me palën e paditur. Gjithashtu, të dyja gjykatat janë ndarë përsa i përket zbatimit të ligjit në lidhje me faktin nëse deklarata noteriale për heqjen dorë nga e drejta e pronësisë, është një veprim juridik i cili mund të revokohet më vonë, në kushtet kur pala paditëse e ka revokuar deklaratën e parë noteriale, nëpërmjet deklaratës së dytë noteriale me nr. 60 rep. dhe nr. 19/2 kol., datë 07.01.2009, para të njëjtës notere publike, në kushtet kur nga deklarata e parë nuk ishte prodhuar asnjë efekt juridik.

26. Paditësja në rekursin e paraqitur, mban qëndrimin se ajo nuk ka hequr dorë nga bashkëpronësia me deklaratën noteriale me nr. 1782 rep., datë 21.07.2008. Sipas paditëses deklarata noteriale me nr. 1782 rep., datë 21.07.2008 nuk mund të përbëjë një mënyrë kalimi pronësie të sendit të paluajtshëm; deklarata për heqjen dorë nga pronësia është një akt i njëanshëm dhe si i tillë ai është i revokueshëm në çdo kohë nga subjekti i cili e ka bërë atë, përsa kohë nuk rezulton që ky akt të ketë prodhuar pasoja juridike, sikundër mund të ishte shitja e pasurisë, dhënia me qira apo tjetërsimi i të drejtave mbi sendin tek subjektet e tretë. Po sipas paditëses nuk rezulton që ajo të ketë hequr dorë nga pronësia, duke përcaktuar konkretisht se pjesa e saj duhet t'i kalojë në pronësi të paditurit K.K. apo ndonjë personi tjetër. Kush do të jetë pronar i pjesës takuese të paditëses, referuar përcaktimeve të KC-s? Kjo deklaratë nuk rezulton të ketë përmbushur këtë kusht që parashikon neni 191 i KC-s. Për paditësen forma e veprimit juridik është një nga kushtet e vlefshmërisë së tij. Deklarata noteriale nuk është një akt noterial për kalimin e pronësisë së paluajtshme, pasi ky veprim juridik duhet të bëhet me kontratë noteriale.

27. Kolegji vlerëson se shkaqet e ngritura në rekurs nuk justifikojnë ligjërisht ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, e për pasojë ky vendim duhet të lihet në fuqi.

28. KC duke e konsideruar veprimin juridik si një mjet për lindjen, ndryshimin apo për shuarjen e marrëdhënieve juridiko-civile, në nenin 79 të tij, thotë shprehimisht se: *"Veprimi juridik, është shfaqje e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose shuajë të drejta dhe detyrime civile. Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm ose i dyanshëm"*.

29. Pra, sipas kësaj dispozite, subjekti i së drejtës përmes veprimit juridik, qoftë duke e shfaqur vullnetin në mënyrë reciproke të ndërsjellë, qoftë në mënyrë të njëanshme mund të ndikojë në një marrëdhënie juridike civile, edhe duke e shuar atë nëse ekziston.

30. Duke iu kthyer Kreut të II të KC-s, e pikërisht mënyrave të fitimit dhe humbjes së pronësisë, janë përkufizuar e rregulluar në këtë kre, vetëm mënyrat e fitimit të pronësisë, ndërkohë që lihet të kuptohet që fitimi i pronësisë për një subjekt, nënkupton humbjen e pronësisë për një subjekt tjetër, me ndonjë përjashtim si p.sh. *res nullius*.

31. Neni 163 i KC-s mund të identifikohet si një dispozitë e përgjithshme përsa u përket mënyrave të fitimit të pronësisë, të njohura dhe të lejuara sipas legjislacionit tonë. Në përmbajtjen e tij thuhet se: *"Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë",* ndërsa në vijim, ai ndiqet nga dispozita të cilat më në veçanti përcaktojnë disa nga mënyrat me të cilat fitohet pronësia sipas këtij Kodi.

32. Po në këtë kre, në vijim të evidentimit të mënyrave të fitimit të pronësisë sipas këtij Kodi, pozicionohet edhe neni 191, i cili, pavarësisht se është në vijueshmërinë e evidentimit kronologjik të mënyrave të fitimit të pronësisë, ndryshe nga dispozitat e tjera të këtij kreu, emërtohet "humbja e pronësisë" dhe i kushton më shumë vëmendje humbjes së pronësisë sesa fitimit të saj, duke e parë marrëdhënien e pronësisë nga këndvështrimi i shuarjes së saj. Neni 191 i KC-s thotë shprehimisht se: *"Pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër ose kur hiqet dorë prej saj [...]."*.Pra, referuar kësaj dispozite, në mënyrë të shprehur, heqja dorë nga e drejta e pronësisë pranohet si një mjet me anë të cilit shuhet një marrëdhënie pronësie.

33. Marrëdhënia e pronësisë si marrëdhënie juridike shfaqet në marrëdhënien që ka pronari me sendin në pronësi, për shkak të ushtrimit të së drejtës subjektive të pronësisë. Pronari, sipas nenit 149 të KC-s ka të drejtën për të gëzuar e disponuar lirisht sendet e tij, brenda kufijve të caktuar me ligj. Koncepti i së drejtës së pronarit për disponim juridik shkon

deri aty sa pronari është i lirë të disponojë edhe mbi fatin e marrëdhënies së tij të pronësisë, nëse do ta ruajë vazhdimësinë e kësaj marrëdhënieje apo nëse do t'i japë fund asaj. Në marrjen e këtij vendimi pronari është i lirë dhe i pakushtëzuar që të vendosë ai vetë, me vullnetin e tij, pa pasur nevojë të ndërhyrjes së ndonjë të treti, me ndonjë rast përjashtimor kur humbja e pronësisë vjen për ndonjë arsye madhore siç është ai për interes publik (p.sh. për shkak të shpronësimit të pronës).

34. Duke qenë se mbarimi i marrëdhënies së pronësisë varet nga vullneti i pronarit, atëherë pranohet se një nga mjetet/mënyrat e mbarimit të marrëdhënies së pronësisë është përmes veprimit juridik. Përsa më lart, heqja dorë nga e drejta e pronësisë, e parashikuar nga neni 191/1, në një interpretim literal, është veprim juridik i njëanshëm, ku manifestohet vullneti i titullarit për t'i dhënë fund marrëdhënies së pronësisë. Dispozita 191 e KC-s e sheh marrëdhënien e pronësisë nga pozicioni i pronarit, e për pasojë në një lexim literal të këtij neni, mjafton vetëm shfaqja e njëanshme e vullnetit nga ana e titullarit që ky i fundit t'i ketë dhënë fund marrëdhënies së tij të pronësisë duke humbur me atë rast edhe cilësinë e pronarit.

35. Po në një lexim literal të dispozitës në fjalë, heqja dorë nga e drejta e pronësisë sipas paragrafit të parë të nenit 191 të K.C, nuk kërkohet detyrimisht që ajo duhet të realizohet përmes një veprimi të dyanshëm dhe as nuk kërkohet detyrimisht që për të qenë e vlefshme si veprim juridik, duhet të bëhet në dobi të një personi të tretë.

36. *Po kështu, heqja dorë si veprim juridik i njëanshëm, ku vullneti i titullarit shprehet në mënyrë të njëanshme dhe nuk kushtëzohet nga kryerja e ndonjë veprimi tjetër nga vetë titullari apo nga ana e një të treti, efektet juridike për titullarin e veprimit do të jenë të menjëhershme. Për titullarin (subjektin e së drejtës së pronësisë), nga momenti i shfaqjes së vullnetit për heqjen dorë nga e drejta e pronësisë, ajo do të konsiderohet e humbur dhe marrëdhënia e pronësisë ndërmjet subjektit të së drejtës dhe sendit, juridikisht do të jetë e shkëputur. Revokimi i mëpasshëm i veprimit juridik të heqjes dorë nga e drejta e pronësisë, nuk do të ketë efekt rikuperues të pozitës juridike të mëparshme, kjo pasi heqja dorë (nga e drejta e pronësisë) ka efekt të menjëhershme dhe subjekti i së drejtës tashmë e ka humbur të drejtën subjektive.*

37. Duke u kthyer në rastin konkret, paditësja, përmes Deklaratës Noteriale nr. 1782 rep., datë 21.07.2008, e cila është një veprim juridik i njëanshëm, heqje dorë nga e drejta e pronësisë, ka disponuar për pjesën e saj takuese, duke i dhënë fund marrëdhënies së saj të pronësisë mbi sendet objekt gjykimi. Efekti juridik i humbjes së pronësisë ka qenë i menjëhershëm, ndërsa revokimi i këtij veprimi i kryer më pas në kohë, i paefektshëm përsa

i përket së drejtës së pronësisë së disponuar me Deklaratën Noteriale nr. 1782 rep., datë 21.07.2008. Po kështu, në lidhje me Deklaratën Noteriale nr. 1782 rep., datë 21.07.2008 nuk ekzistojnë shkaqe pavlefshmërie të natyrës së pavlefshmërisë absolute, parashikuar nga neni 92 i KC-s.

38. Është fakt që palët ndërgjyqëse, në kohën e kryerjes së veprimeve juridike të sipërcituara në pjesën e fakteve, kanë qenë të lidhur me martesë. Duke qenë se ndërmjet tyre nuk ka pasur kontratë martesore, për pasurinë e vënë prej tyre gjatë martesës, ka ekzistuar regjimi pasuror martesor. Por po kështu, është fakt i provuar në proces se ndërmjet palëve ndërgjyqëse gjatë vijueshmërisë së martesës janë kryer edhe këto veprime juridike: (a) Kontrata e shitblerjes paraprake me nr. 1779 rep., dhe nr. 1050 kol., datë 21.07.2008; (b) Deklaratën noteriale me nr.1782 rep. dhe nr. 1053/3 kol., datë 21.07.2008; (c) Deklarata noteriale me nr. 1811 rep. dhe nr.1067/2 kol., datë 23.07.2008, veprime këto të cilat, referuar përmbajtjes së tyre nuk mund të merren dhe interpretohen të shkëputura njëra nga tjetra.

39. Duke iu kthyer Kodit të Familjes (KF), nenit 66 të tij i cili thotë se*: "Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë ...".* Fakti që palët ndërgjyqësenuk kanë lidhur marrëveshje të veçantë për të rregulluar pasurinë e tyre bashkëshortore, sipas ligjit, i përfshin këto në regjimin pasuror martesor. Por, fakti që palët janë përfshirë në regjimin pasuror martesor nuk do të thotë që ato, në vijueshmërinë e marrëdhënies martesore, të mos e ndryshojnë këtë regjim, me marrëveshje dhe në kushtet e parashikuara nga KF. Një situatë e tillë parashikohet edhe nga neni 72 i KF-s, sipas të cilit: *"Bashkëshortët mund të bien dakord, në interes të familjes, për ta ndryshuar pjesërisht ose tërësisht regjimin pasuror martesor, vetëm pas kalimit të 2 vjetëve të zbatimit të tij. Ndryshimet në këtë rast duhet të bëhen në të njëjtën formë që kërkohet për kontratën fillestare të martesës ...".* Ndërsa sipas nenit 69 të KF-s, forma e kontratës fillestare të martesës është me akt noterial dhe kërkon pëlqim të të dy bashkëshortëve.

40. Siç e përmendëm më sipër, rezultojnë të jenë kryer nga pala paditëse këto veprime juridike: (a) Kontrata e shitblerjes paraprake me nr. 1779 rep., dhe nr. 1050 kol., datë 21.07.2008; (b) Deklaratën noteriale me nr. 1782 rep. dhe nr. 1053/3 kol., datë 21.07.2008 dhe (c) Deklarata noteriale me nr. 1811 rep. dhe nr. 1067/2 kol., datë 23.07.2008. Këto veprime juridike nuk duhet të trajtohen të shkëputura më njëra-tjetrën, pasi qëllimi i realizimit të tyre është i përbashkët. Referuar përmbajtjes së këtyre veprimeve, sikundër e pranon shprehimisht pala paditëse që i ka kryer ato, pala e paditur ka pasur jo vetëm dijeni për kryerjen e tyre, por i ka miratuar ato e shfaqur vullnet aprovues edhe përmes veprimeve konkrete.

41. Qëllimi i përbashkët i këtyre veprimeve juridike është mbarimi i regjimit pasuror martesor, përmes marrëveshjes ndërmjet bashkëshortëve. Referuar përmbajtjes së Deklaratën noteriale me nr. 1782 rep. dhe nr. 1053/3, datë 21.07.2008, ka rezultuar se ndërmjet paditëses dhe të paditurit është arritur marrëveshja për të individualizuar përkatësinë mbi pronat deri në këtë moment në bashkëpronësi. Rezulton se një fakt i tillë nuk është kundërshtuar nga ana e palës së paditur.

42. Për sa më lart, provohet se palët ndërgjyqëse i kanë dhënë fund me marrëveshje regjimit pasuror martesor. Neni 73 i KF-s thotë shprehimisht se: *"Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor".* Kjo nënkupton senë rastin e regjimit juridik të sendeve në bashkëpronësi për shkak të martesës, mbizotëronvullneti i palëve ndaj vullnetit të ligjit, ku vullneti i palëve shuan pjesërisht ose plotësisht regjimin pasuror martesor, për llogari të regjimit të pronësisë së individualizuar. Për pasojë është i drejtë konkluzioni i Gjykatës së Apelit Vlorë se sendet objekt gjykimi nuk bëjnë pjesë në regjimin pasuror martesor, pra edhe kërkimi për pjesëtimin e tyre në fazën e parë është një kërkim i pabazuar në ligj dhe në prova.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-61, datë 20.01.2021

Në zbatim të parimit të sigurisë juridike, afatet e ankimit kundër vendimit gjyqësor nuk mund të jenë të papërcaktuara dhe nuk mund të jenë të pafundme. Pretendimet e palëve kundër vendimit gjyqësor që ka zgjidhur mosmarrëveshjen midis palëve ndërgjyqëse, bien në prekluzivitet nëse nuk ngrihen brenda afateve sipas neneve 443 dhe 459 të KPC. Në çdo rast, palët që kanë humbur afatin e ankimit, për shkaqe të arsyeshme mund të rivendosen në afatin e ankimit por gjithsesi, rivendosja në afat duhet të realizohet brenda afatit prekluziv të parashikuar në nenin 445 të KPC, i cili as nuk mund të shtyhet, as nuk mund të zgjatet dhe as nuk mund të rivendoset.

I. Rrethanat e çështjes

1. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur një padi, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ dhe bazë ligjore Kodin e Procedrave Administrative, Kodin Civil dhe legjislacionin për të drejtën e autorit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8224, datë 17.09.2012, ka vendosur: "*1. Rrëzimin e padisë…"*.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2507, datë 15.11.2013, ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr. 8224, datë 17.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."*.

4. Kundër vendimit nr. 2507, datë 15.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 13.12.2013 paditësi, N.B.ka paraqitur rekurs "Për zënie afati"[...]. Në përmbajtje të rekursit thuhet se duke qenë se vendimi i kundërshtuar nuk është arsyetuar ende, paditësi (nëpërmjet përfaqësuesit të tij) rezervon të drejtën të plotësojë rekursin me shkaqet pse kundërshton vendimin në një moment tjetër.

5. Rezulton se me shkresën me lëndë "Njoftim për plotësim rekursi", datë 19.03.2014, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rekursi i paditësit është konstatuar me të meta dhe ai është njoftuar për plotësimin e të metave, konkretisht për parashtrimin e shkaqeve të rekursit sipas nenit 475/ç të KPC, brenda 10 ditëve nga njoftimi. Rezulton se kjo shkresë u është njoftuar përfaqësuesve të paditësit më datë 24.03.2014. Pas përfundimit të afatit të caktuar për rregullimin e të metave dhe pas njoftimit të rekursit

palëve të tjera ndërgjyqëse, dosja i është përcjellë Gjykatës së Lartë nga gjykata e shkallës së parë dhe është regjistruar pranë Gjykatës së Lartë më datë 03.11.2014.

6. Rezulton se paditësi, më datë 16.09.2016, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë rekursin e plotësuar me shkaqet e tij, duke parashtruar se: [...] Vepra që ka krijuar N.B. ishte një vepër pantonime, e realizuar në emisionin [...] , më datë 28.03.2008, e krijuar prej tij, e mbrojtur nga ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të lidhura me të", që është një vepër dramatike, që shprehet me gjeste, lëvizje ose mimike, e në thelb të kësaj loje aktoriale qëndron mesazhi të cilin përcjell; Pala e paditur, shoqëria "BKT" sHA pas disa muajsh ka tjetërsuar këtë ide të paditësit dhe e ka pasqyruar në një reklamë që reklamonte shërbimet e saj; Pala paditëse i është drejtuar fillimisht Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, e cila ka rrëzuar kërkesën e tij; Gjykata e ka keqinterpretuar ligjin për të drejtat e autorit, pasi në rastin konkret nuk jemi para një interpretimi në kuptim të ligjit, por jemi para një vepre pantonime; Ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat e shkallëve më të ulëta për simbolet kombëtare, si flamuri kombëtar etj., paditësi nuk ka kërkuar shkelje të të drejtave të autorit në lidhje me këto simbole, por sepse është përdorur pantonima e tij, duke përdorur këto simbole; Po ashtu, ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat, nuk jemi para një ideje që nuk gëzon mbrojtje nga ligji për të drejtën e autorit, por jemi para një vepre pantonime.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji),vlerëson se rekursi i paditësitN.B. kundër vendimit nr. 2507, datë 15.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile (në vijim, KPC), sipas dispozitave që do të merren në analizë në vijim. Si rrjedhojë, Kolegji në bazë të nenit 480 të KPC duhet të vendosë mospranimin e tij.

8. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se në një shoqëri demokratike, e drejta për administrim të mirë të drejtësisë zë një vend të dallueshëm dhe asnjë interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNj. nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*Vendim Nr. 14, dt. 03.06.2008 i Gjykatës Kushtetuese; Çështja "Mateos e Silva Lda dhe të tjerë kundër Portugalisë", Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të*

Njeriut, i datës 16.09.1996 RJD 1996-IV, paragrafi 64).

9. Nga ana tjetër, e drejta e aksesit në gjykatë, pavarësisht gjykatës me juridiksion fillestar apo gjykatës me juridiksion rishikues, nuk është absolute. Pa dyshim që edhe e drejta e aksesit në gjykatë mund të jetë objekt kufizimesh ligjore dhe këto të fundit janë në diskrecionin e ligjvënësit. Gjithsesi, ky lloj diskrecioni i njohur nga Kushtetuta dhe KEDNj duhet të ushtrohet prej ligjvënësit në mënyrë të tillë që, kufizimet e së drejtës së aksesit në gjykatë të mos jenë të tilla që të pamundësojnë realizimin e së drejtës (*shiko, çështja "Domazyan v. Armenia", nr. 22558/07, Vendim i Seksionit i të GjEDNj-s, dt. 25.02.2016. Shiko gjithashtu edhe çështjen "Miragall Escolano and Others v. Spain", Ap. nos. 38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 and 41509/98, paragrafi 33, ECHR 2000I*).

10. Në të njëjtën kohë këto kufizime duhet të ndjekin një qëllim të drejtë dhe legjitim dhe mjetet nëpërmjet të cilave arrihet ligjërisht kufizimi dhe qëllimi i ligjvënësit duhet të jenë në një marrëdhënie proporcionaliteti (*shiko, çështja "Levages Prestations Services v. France", Vendim i GjEDNj-s, dt. 23 tetor 1996, paragrafi 40, "Reports of Judgments and Decisions" 1996V; çështja "Ashingdane v. the United Kingdom", Vendim i GjEDNj-s dt. 28 Maj 1985, paragrafi 57, Series A no. 93; çështja "Tolstoy Miloslavsky v. the United Kingdom", Vendim i GjEDNj dt. 13 Korrik 1995, paragrafi 59, Series A no. 316B; çështja "Stanev v. Bulgaria", Dhoma e Madhe e GjEDNj-s[GC], Ap. no. 36760/06, paragrafi 230, ECHR 2012*).

11. Një nga mjetet kufizuese që përdor ligji për kufizimin e së drejtës së aksesit në gjykatën me juridiksion fillestar dhe gjykatën me juridiksion rishikues është koha. Pikërisht kalimi i kohës së mosngritjes së padisë apo mosushtrimit të një ankimi mund të shkaktojë ligjërisht pamundësimin eushtrimit të juridiksionit tutelues gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

12. Nga mënyra se si është regjuar koha si element i procesit gjyqësor civil rezulton se ligji procedural ka krijuar edhe institutin juridik të afateve procedurale. Afatet janë një segment kohe i mirëpërcaktuar qartë dhe saktë në momentin e nisjes (*a quo*) dhe të përfundimit (*a quem*) brenda së cilës subjektet procedurale duhet të kryejnë një apo disa veprime të caktuara. Afatet procedurale caktohen nga KPCose nga ligje të veçanta. Kohëzgjatja në të cilën një akt procedural duhet të realizohet është shprehur sipas rastit në ditë, muaj apo vite.

13. Vendosja e afateve procedurale, nga njëra anë, do të duhet të synojë të bëjë të mundur dhe efektive realizimin e të drejtave subjektive materiale dhe procedurale të palës aktive ndërgjyqëse. Nga ana tjetër, afatet duhet të

synojnë që të garantojë parimin e sigurisë juridike dhe standardin e gjykimit të arsyeshëm të palës pasive ndërgjyqëse.

14. Kolegji vlerëson se sipas KPC-s afatet për kryerjen e veprimeve procedurale janë ligjore ose gjyqësore. Nga ana tjetër, afatet ligjore kategorizohen në afate të zakonshme ose të prera dhe prekluzive kur ligji e parashikon shprehimisht (nenet 145 dhe 146 të KPC-s). Afatet e prera nuk mund të shkurtohen apo të shtyhen, qoftë edhe me pëlqimin e palëve. Nga ana tjetër afatet prekluzive nuk mund të zgjaten dhe as nuk mund të rivendosen sipas nenit 151 e vijues të KPC.

15. Kolegji vlerëson se afate të prera janë afatet e ankimit të parashikuara në nenin 443 të KPC-s. Më konkretisht, në këtë dispozitë është parashikuar ndër të tjera se afati i rekursit në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit është 30 ditë. Kurse në nenin 444 të KPC(në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit) është parashikuar se ky afat fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, ndërsa për palën në mungesë nga e nesërmja e njoftimit të vendimit (*shiko, Vendim Unifikues nr. 14, datë 16.02.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

16. Nga ana tjetër, në nenin 445 të KPC, në titullin "Prekluziviteti i ankimit" është parashikuar se ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim për palën që nuk ka qenë në dijeni të procesit për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve.

17. Kolegji vlerëson se në zbatim të parimit të sigurisë juridike, afatet e ankimit kundër vendimit gjyqësor nuk mund të jenë të papërcaktuara dhe nuk mund të jenë të pafundme. Pretendimet e palëve kundër vendimit gjyqësor që ka zgjidhur mosmarrëveshjen midis palëve ndërgjyqëse, bien në prekluzivitet nëse nuk ngrihen brenda afateve sipas neneve 443 dhe 459 të KPC-s. Në çdo rast, palët që kanë humbur afatin e ankimit, për shkaqe të arsyeshme mund të rivendosen në afatin e ankimit, që është i prerë sipas ligjit, por gjithsesi rivendosja në afat duhet të realizohet brenda afatit prekluziv të parashikuar në nenin 445 të KPC-s, i cili as nuk mund të shtyhet, as nuk mund të zgjatet dhe as nuk mund të rivendoset.

18. Kolegji çmon të marrë në analizë nenin 444 të KPC, i cili para ndryshimeve me Ligjin nr. 38/2017, parashikonte dy momente të ndryshme të nisjes së afatit të ankimit (*diem a quo*). Për palën në mungesë ky afat fillonte nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, ndërsa për palën prezent nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

19. Nga nevoja për të kompensuar këtë pabarazi në të drejta dhe për të garantuar akses të barabartë të palëve në juridiksionin rishikues, ka lindur në praktikë fenomeni procedural i paraqitjes së "ankimit të shkurtuar" ose

të ankimit "për zënie afati", i cili ishte një mekanizëm ekstraligjor, me të cilin pala paraqiste ankimin/rekursin, por nuk pasqyronte shkaqet apo nuk ngrinte pretendimet kundër vendimit gjyqësor të kundërshtuar sipas parashikimeve të neneve 454/c të KPC-s apo 475/ç të KPC-s. Ankime të tilla të paplota dhe me të meta janë pranuar nga gjykatat, për të garantuar efektivitetin e mjetit të ankimit për palën që ende nuk kishte në dispozicion vendimin e arsyetuar të gjykatës dhe si rrjedhojë, nuk mund t'i kundrejtohej rënia në prekluzivitet e pretendimeve, për shkaqe që nuk lidhen me sjelljen apo fajin e saj, por lidhen me detyrimin e gjykatës për të njoftuar vendimin e arsyetuar (sot, me ndryshimet që pësoi neni 444, me ligjin nr. 38/2017, u unifikua momenti i nisjes së afatit të ankimit dhe si për palën prezent edhe për palën në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar).

20. Por nga ana tjetër, Kolegji thekson se e drejta e palës ndërgjyqëse për të rregulluar këtë të metë të ankimit/rekursit, për ta plotësuar atë me tërësinë e pretendimeve kundër vendimit gjyqësor të kundërshtuar, nuk mund të zgjasë pafund dhe nuk mund të jetë e papërcaktuar në kohë. Ankimi nuk është akti formal i titulluar si i tillë nga pala, por është tërësia e shkaqeve dhe pretendimeve mbi ligjshmërinë e vendimit gjyqësor të kundërshtuar, dhe paraqitja e tyre nuk mund të kalojë afatin 15 ditor të ankimit apo afatin 30 ditor të rekursit sipas nenit 443 të KPC, nga momenti kur pala ka ardhur apo duhet të kishte ardhur në dijeni të pjesës arsyetuese të vendimit gjyqësor të kundërshtuar. Kolegji vlerëson se, nuk është ankimi formal i palës që bie në prekluzivitet sipas nenit 459 të KPC, por është tërësia e shkaqeve dhe pretendimeve mbi ligjshmërinë e vendimit gjyqësor të kontestuar prej saj. Po ashtu, për palën që ka qenë prezent në gjykim, plotësimi i ankimit/rekursit, me shkaqet e tij, nuk mund të bëhet gjithsesi jashtë afatit njëvjeçar prekluziv të parashikuar në nenin 445 të KPC. Një interpretim i kundërt do të sillte një efekt "boomerang", pasi përsëri do të çonte në situatën e pabarazisë anasjelltas për palën tjetër ndërgjyqëse që afatin e ankimit/rekursit e ka pasur 15 ditë apo 30 ditë nga data kur i është komunikuar vendimi i arsyetuar.

21. Në këtë pikë të arsyetimit, shtrohet për zgjidhje çështja nëse gjen zbatim instituti i konstatimit me të meta të ankimit apo të rekursit sipas neneve 450, 455 dhe 476 të KPC, në situatën ku pala ndërgjyqëse, e cila ka aktivizuar juridiksionin rishikues, brenda afatit ligjor të ankimit ka paraqitur fillimisht ankimin e shkurtuar, kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo të gjykatës së apelit pa pasqyruar shkaqet.

22. Nga njëra anë, ankimi konsiderohet jashtë afatit me kalimin e afatit ligjor të prerë të parashikuar në nenin 443 të KPC-s apo të afatit prekluziv

tërësor sipas nenit 445 të KPC-s dhe për zbatimin e neneve 450 apo 480 që parashikojnë pasojat e këtij fakti procedural, i cili passjell mospranimin e ankimit, duhet që pala ndërgjyqëse të mos ketë ushtruar ankim.

23. Nga ana tjetër, ndreqja e të metave formale të apelit apo rekursit, sipas shkronjës "b" të nenit 450 dhe nenit 476 të KPC, sikurse ndreqja e kërkesëpadisë si akt procedural, sipas nenit 154/a të Kodit, paraqesin mundësi ligjore të perfeksionimit të formës dhe përmbajtjes së aktit procedural në të cilin ato materializohen. Kjo do të thotë se fillesa e aktit të secilit prej këtyre mjeteve të ankimit është tashmë në fashikullin e gjykimit dhe se përmes plotësimit të të metave ato marrin *ab initio* vlefshmërinë e tyre, njëlloj sikur të ishte paraqitur pa asnjë të metë nga momenti i depozitimit të tij në sekretari. Kolegji vlerëson se, instituti i konstatimit me të meta të këtyre akteve procedurale ka synuar rregullimin e të metave që janë të konvalidueshme me vullnetin e palës ndërgjyqëse që ka aktivizuar juridiksionin fillestar apo rishikues dhe që e perfeksionojnë aktin sikur të ishte paraqitur si i tillë, pa të meta që në fillim. Ndryshe nga situata e parë, në ankimin me të meta pala ndërgjyqëse ka depozituar ankim të metë në formë apo përmbajtje.

24. Formalisht mund të konkludohet se këto dy institute procedurale nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin. Megjithatë, Kolegji vlerëson se materialisht ekziston një ekuivalencë në pasojat juridike midis mosushtrimit të ankimit dhe mosperfeksionimit të ankimit në përmbajtje pas përfundimit të afateve ligjore të prera apo prekluzive të tij. Kjo pasi, sikurse u analizua më sipër, ankimi nënkupton tërësinë e shkaqeve dhe pretendimeve mbi ligjshmërinë e vendimit gjyqësor të kontestuar.

25. Kolegji vlerëson se nëse afati njëvjeçar i nenit 445 të KPC për ushtrimin e ankimit nga momenti i shpalljes së vendimit është parashikuar si një afat tërësor prekluziv për ushtrimin e ankimit, ku palës ndërgjyqëse që nuk i është komunikuar vendimi i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet për t'u njohur me përmbajtjen e vendimit, nuk mundet që të mos ketë afat tërësor prekluziv për plotësimin e të metave përmbajtësore të ankimit, sikurse nuk mundet që ky afat të jetë i përjetshëm teorikisht. Kështu, nëse një ankim është ushtruar në kushtet kur vendimi gjyqësor është shpallur por nuk është arsyetuar, dhe kjo situatë është më shumë relevante për apelet dhe rekurset e paraqitura para datës 5 nëntor 2017, kur është ndryshuar neni 444 i KPC-s, atëherë kuptohet se ankimi nuk ka në përmbajtjen e tij shkaqet e apelit apo rekursit. Sipas interpretimit formal të shkronjës "b" të nenit 450 dhe nenit 476 të KPC, konkludohet se plotësimi i shkaqeve të ankimit nuk ka afat, që do të thotë se do të bëhet brenda afatit që gjykata e apelit apo Gjykata e Lartë do të lënë si detyrë, megjithëse konstatimi i të metave të ankimit nga gjykata mund të vijë jashtë afatit një vjeçar nga momenti i shpalljes së vendimit.

26. Por, Kolegji rithekson se qëllimi i afatit tërësor prekluziv të ankimit dhe vetë justifikimi kushtetues i ekzistencës së një parashikimi të tillë ligjor është pikërisht parimi i sigurisë juridike të qarkullimin civil. Askush nuk duhet të rrijë përjetësisht i shqetësuar mbi gjendjen e të drejtave dhe të detyrimeve në qarkullimin civil, aq më tepër kur mbi ato të drejta dhe detyrime është disponuar gjyqësisht. Për këtë arsye, ligji procedural vendos afate për kontestimin e vendimeve gjyqësore dhe modalitete për mënyrën e ushtrimit të ankimit.

27. Kjo do të thotë se për të njëjtën arsye se pse ekziston afati i prerë apo afati tërësor prekluziv i ankimit sipas nenit 445 të KPC-s për paraqitjen e ankimit brenda 15, 30 ditëve apo një viti nga dita e shpalljes së vendimit, për të njëjtën arsye duhet të ekzistojë një afat prekluziv tërësor për palën apeluese apo rekursuese për plotësimin e të metave përmbajtësore të ankimit tashmë të ushtruar por të paperfeksionuar si akt procedural.

28. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se afati i posaçëm, respektivisht 5 ditor dhe 10 ditor për rregullimin e të metës, sipas neneve 455 dhe 476 të KPC-s, sipas detyrave të lëna nga gjykata ku është paraqitur ankimi, e cila mund të konstatojë të metën edhe tej afatit prekluziv, nuk mund të dublojë, të zgjasë të ndryshojë apo të shkurtojë afatin e prerë të ankimit/rekursit 15 ditor apo 30 ditor sipas nenit 443 të KPC-s apo edhe afatin njëvjeçar të parashikuar në nenin 445 të KPC-s. Kolegji vlerëson se është detyrim i palës, e cila ka paraqitur ankimin e paplotë, që brenda afatit ligjor të ankimit, nga data kur ka ardhur në dijeni të arsyetimit të vendimit apo kur duhet të kishte ardhur në dijeni për shkak të depozitimit të vendimit në sekretari, të paraqesë ankimin/rekursin e plotësuar me shkaqet e tij, brenda afateve të parashikuara nga ligji për paraqitjen e pretendimeve kundër vendimit gjyqësor të kontestuar.

29. Kolegji vlerëson se konstatimi me të meta i ankimit, sipas neneve 455 dhe 476 të KPC-s duhet të gjejë zbatim për të metat formale të ankimit, të cilat mund të lidhen me nënshkrimin e palëve, akteve të përfaqësimit, dokumentet të cilat i bashkëlidhen ankimit etj., dhe të cilat janë të konvalidueshme, *ab initio*, brenda afateve të përcaktuara nga gjykata sipas këtyre dispozitave. Në të kundërt, kur apeli apo rekursi do të konstatohen me të meta të paplotësuara, për shkak të përmbajtjes së aktit procedural, që përbën thelbin e ankimit, në çdo rast dhe maksimalisht deri në një periudhë pas afatit njëvjeçar të shpalljes së vendimit të arsyetuar të gjykatës apo depozitimit të vendimit të arsyetuar në sekretari, atëherë do të duhet të konkludohet se apeli apo rekursi është një akt procedural i pavlefshëm dhe si i tillë dhe në këto kushte, me nulitet të pakonvalidueshëm, për shkak të kalimit të afatit prekluziv të paraqitjes së pretendimeve kundër vendimit gjyqësor.

30. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vlerëson se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuesit të palës paditëse i është njoftuar konstatimi i të metave të rekursit dhe i është kërkuar të pasqyrohen shkaqet e rekursit, brenda afatit 10 ditor sipas nenit 476 të KPC. Ka rezultuar se kjo shkresë i është njoftuar përfaqësuesit të paditësit me datë 24.03.2014, ndërkohë paditësi nëpërmjet përfaqësuesit ka paraqitur rekursin e plotësuar me datë 16.09.2016, pra pas dy vitesh nga njoftimi i të metave dhe pas tre vitesh nga shpallja e vendimit. Kolegji vlerëson se nga momenti kur paditësit i është komunikuar nga sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrimi për të plotësuar të metat e rekursit, çka prezupozon që pranë kësaj gjykate ishte depozituar edhe vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Apelit Tiranë objekt rekursi, pala paditëse ka patur detyrimin të njihet me përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar dhe të plotësojë rekursin me shkaqet e tij brenda afatit të prerë 30 ditor të rekursit dhe në çdo rast brenda afatit prekluziv një vjeçar sipas nenit 445 të KPC-s.

Vendim i Kolegjit Civil, Nr. 00-2021-181, datë 10.02.2021

Në vendosjen e masës së sigurimit të padisë, gjykatat më të ulëta duhet marrin në analizë të gjitha kushtet themelore të parashikuara nga ligjvënësi për identifikimin e qartë të rrezikut konkret që i shkakton palës paditëse një dëm i paripareshëm, deri në momentin e shqyrtimit të çështjes me vendim përfundimtar (periculum in mora).

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësit në këtë gjykim janë trashëgimtarë ligjorë të subjektit të shpronësuar S.P..

2. Ka rezultuar se i ndjeri S.P., ka ndërruar jetë në datën 04.04.1967 dhe me vendimin nr. 980, datë 22.02.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të, duke u caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, fëmijët Zh.Xh., L.P. dhe T.P..

3. Nëpërmjet vendimit gjyqësor nr. 5302, datë 14.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar dëshmia testamentare për të ndjerën T.P., e cila rezulton të ketë ndërruar jetë në datën 01.02.2007, duke përcaktuar si trashëgimtarë testamentarë paditësit G.Xh. dhe I.Xh.. Ndërsa, me vendimin [...]të noterit publik, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerën L.P., e cila ka ndërruar jetë në datën 06.11.1991, duke përcaktuar si trashëgimtare të vetme paditësen Zh.Xh..

4. Paditësit në këtë gjykim, kanë pretenduar se janë bashkëpronarë të një pasurie të paluajtshme "Truall", me nr. 3/246 pasurie, [...]. Këtë fakt, pala paditëse e vërteton me certifikatën për vërtetim pronësie lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë, më datë 23.01.2018.

5. Origjina e pronësisë mbi pronën objekt gjykimi, pala paditëse ka pretenduar se rrjedh nga vendimi nr. 7, datë 03.04.1997 i ish-K.K.K.Pronave pranë Bashkisë së Tiranës, me të cilin, është vendosur: "*Të njohë Z. S.P., ish-pronar të pronës së tij, të përbërë nga një tokë me sipërfaqe 1299 m², e ndodhur në Tiranë[...].*

6. Ka rezultuar se për pasurinë e paluajtshme prej 1299 m2 të trajtuar në vendimin e dhënë nga KKKP Bashkia Tiranë në favor të trashëgimtarëve ligjorë të subjektit ish-pronar S.P., në vitin 2001 është lidhur kontrata e qirasë me nr. 1862 rep. dhe nr. 125 kol., midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (në cilësinë e qiradhënësit) dhe shoqërisë"SC" shpk (referuar ekstraktit tregtar është ndryshuar emri tregtar nga "M." shpk në "SC" shpk).

7. Trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar S.P., i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë me objekt: "*Kundërshtimin e vendimit nr. 7, datë 03.04.1997 të ish-K.K.K.Pronave pranë Bashkisë së Tiranës. Sigurimin e padisë dhe pezullimin e çfarëdolloj veprimi të shoqërisë "M." shpk dhe Ministrisë së Ekonomisë mbi sipërfaqen prej 1650 m²* të përcaktuar më poshtë". Në këtë gjykim, pala paditëse ka thirrur si palë të paditur Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe si persona të tretë në gjykim, Shoqërinë "M." shpk, Ministrinë e Ekonomisë dhe Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

8. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes së mësipërme, me vendimin nr. 3820, datë 07.10.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur: "*Pranimin e kërkesë padisë. Anulimin e vendimit nr. 7, datë 03.04.1997 të K.K.K.Pronave. Detyrimin e të padituri K.K.K.Pronave të njohë pronësinë mbi sipërfaqen prej 1650 m², të trashëgimtarëve të S.P. si dhe t'u kthejë atyre sipërfaqen prej 1299 m². Sip. prej 365 m² t'i kompensohet".* Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 794, datë 22.06.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

9. Pas marrjes formë të prerë të vendimit të gjykatës, ndërmjet palëve është nënshkruar aneks kontrata me nr. 1797 rep., nr. 731 kol., datë 31.03.2009 nëpërmjet së cilës për sipërfaqen prej 1299 m² truall, e drejta e qiradhënësit u ka kaluar pronarëve të ligjshëm. Në këtë akt palët kanë parashikuar se: "*Marrëdhëniet ndërmjet qiradhënësit të ri (Zh.Xh.) dhe qiramarrësit për sipërfaqen prej 1299 m² rregullohen me marrëveshje të veçantë ndërmjet tyre".*

10. Ka rezultuar se për pronën objekt të këtij gjykimi, ndërmjet paditëses Zh. Xh. dhe të paditurit A. A. janë nënshkruar disa kontrata qiraje me afate të përcaktuara, e konkretisht, kontrata e datës 18.02.2006 me afat deri në 30.09.2006, kontrata e datës 11.11.2006 me afat deri në datën 05.03.2007.

11. Pas mbarimit të afatit të qirasë, paditësit kanë kërkuar që i padituri t'u lirojë dhe dorëzojë sendin, pasi nuk ka më asnjë titull të ligjshëm për gëzimin e tij, si dhe po u shkakton një dëm të rëndë pasuror. Referuar palës paditëse, pala e paditur ka treguar shenja të shmangies nga detyrimi dhe në mënyrë të paligjshme, vazhdon edhe sot të përdorë pasurinë duke nxjerrë të

ardhura dhe duke mohuar të drejtën ligjore të pronarëve të ligjshëm të saj për të nxjerrë të ardhura nga ky send. Për këtë fakt paditësit kanë paraqitur edhe 2 kuponë tatimorë të lëshuar nga pala e paditur shoqëria "SC" shpk në tetor të vitit 2018, ku me anë të tyre provojnë se pala e paditur vazhdon të ushtrojë aktivitet në pronën e tyre për qëllime fitimprurëse, duke përfituar edhe nga fakti që paditësit jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

12. Në kushtet kur mes palëve nuk është zgjidhur mosmarrëveshja në rrugë jashtëgjyqësore, në datën 02.11.2018, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë me objekt të sipërcituar duke kërkuar lirimin dhe dorëzimin e pasurisë së tyre të paluajtshme, tokë truall, si dhe shpërblimin për përdorimin e këtij sendi pa asnjë lloj tagri deri në momentin e lirimit të tij.

13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 14256 regj. them, datë 09.11.2018, ka vendosur: *Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë*. Marrjen e masës provizore për sigurimin e padisë, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të truallit objekt gjykimi [...]

14. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 277, datë 20.03.2019, ka vendosur:-Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. 14256 akti, datë 09.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afateve ligjore. [...]

15. Kundër vendimit nr. 277, datë 20.03.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar të drejtën e rekursit pala e paditur A.A., përfaqësuar nga Av. [...] kjo palë ka kërkuar para Gjykatës së Lartë: *Prishjen e vendimit nr. 277, datë 20.03.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate, me një tjetër trup gjykues.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

16. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala e paditur A.A. përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-s (në vijim: KPC), të cilat i bëjnë të cenueshme vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta. Kolegji çmon të theksojë se nga ana e dy gjykatave më të ulëta nuk janë interpretuar drejt dispozitat e ligjit procedural që kanë lidhje me vendosjen e masës së sigurimit të padisë, si dhe nuk është respektuar qëndrimi i mbajtur në praktikën e unifikuar gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

17. Kolegji, fillimisht vlerëson të theksojë faktin se, çështja objekt shqyrtimi, e cila rezulton të jetë regjistruar pranë Gjykatës së Lartë në vitin 2019, është marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi me procedurë të përshpejtuar, nisur nga fakti se, rekursi është ushtruar ndaj një vendimi

të ndërmjetëm të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, në përputhje me parashikimet e nenit 209 të KPC-s, në të cilin pasqyrohet se: "*Kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankim i veçantë. Ankimi i vendimit të sipërm nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të padisë.*".

18. Gjykata e Apelit Tiranë e ka marrë këtë çështje në shqyrtim bazuar në ankimin e veçantë që ka kryer pala e paditur A.A. ndaj vendimit nr. 14256 Akti, datë 09.11.2018 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Të dyja vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, janë vendime të ndërmjetme në kuptim të parashikimeve ligjore të nenit 125 të KPC, në të cilin parashikohet se: "*Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'u përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi*", si dhe nenit 315 të KPC-s, i titulluar "Vendimet e ndërmjetme", në të cilin parashikohet qartësisht se: "*Vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë përfundimtare, mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveç kur në këtë Kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë*".

19. Për këtë arsye, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, me të cilin është ndryshuar vendimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, është një vendim i ndërmjetëm, pasi me të nuk është shqyrtuar në themel mosmarrëveshja mes palëve, por i është dhënë përgjigje palës paditëse për të siguruar padinë objekt shqyrtimi, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të truallit objekt gjykimi, pasuri e paluajtshme tokë truall me sip.1299 m^2. Për këtë arsye, në kushtet kur pala e paditur A.A. ka ushtruar të drejtën e rekursit ndaj një vendimi të ndërmjetëm të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim atë me procedurë të përshpejtuar, në përputhje me parashikimet e nenit 470 të KPC-s, në të cilin është pasqyruar se: "*Ankimet e veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë*".

20. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji, konstaton se të dyja gjykatat më të ulëta nuk e kanë kuptuar drejt natyrën e kërkesës objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë, e kanë zgjidhur atë në kundërshtim me dispozitat ligjore të zbatueshme. Këto gjykata nuk rezulton të kenë bërë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, nuk kanë bërë një interpretim të drejtë të fakteve dhe rrethanave, nuk rezulton t'u kenë dhënë të dyja palëve pjesëmarrëse në këtë gjykim përgjigje në lidhje me kërkesat e tyre, si dhe nuk kanë bërë një

interpretim të drejtë të ligjit të zbatueshëm dhe praktikës gjyqësore tashmë të unifikuar.

21. Pavarësisht se shkeljet procedurale që kanë kryer gjykatat më të ulëta, nuk janë të asaj shkalle sa ta bëjnë nul procesin e zhvilluar pranë tyre, Kolegji vlerëson se duhet t'i marrë në shqyrtim ato dhe t'u japë përgjigje të arsyetuara, me qëllim që t'i ndreqë këto të meta në shkallën më të lartë të gjykimit. Kështu, Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka respektuar parashikimet ligjore për t'i garantuar palës së paditur një proces të rregullt ligjor, pasi nuk rezulton që kjo gjykatë t'i ketë dhënë përgjigje të padituri A.A., i cili ka pretenduar shkelje të rregullave procedurale të gjykimit që kanë të bëjnë me formimin e trupit gjykues, sipas përcaktimeve të nenit 35 të KPC, në të cilin parashikohet se: "*Gjykata e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar ose tre gjyqtarë. Me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykohen këto çështje: a) paditë me vlerë më shumë se 50 milionë lekë...*".

22. Pala e paditur A.A., ka pretenduar para Gjykatës së Apelit Tiranë faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur rëndë parashikimet e nenit 35, pika 1, shkronja "a" të KPC-s, pasi nuk rezulton që të ketë formuar trupin gjykues me tre gjyqtarë në shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, duke kryer kështu një shkelje të rëndë procedurale. Këtë pretendim, pala e paditur e ka ngritur në kuadër të faktit që padia e paraqitur për shqyrtim ka një vlerë mbi 50 milionë lekë dhe si e tillë, duhet të ishte gjykuar nga një trupë gjykuese e përbërë prej tre gjyqtarësh dhe jo nga një gjyqtar i vetëm sikundër ka ndodhur në fakt.

23. Kolegji, vlerëson se ky pretendim i palës së paditur nuk përbën shkelje procedurale të asaj shkalle, sa ta bëjë gjykimin në shkallë të parë të pavlefshëm në këtë fazë në të cilën ndodhet gjykimi, duke iu referuar si shkak mosformimit të trupit gjykues me tre gjyqtarë. Është tashmë një praktikë e gjithëpranuar se formimi i drejtë i trupit gjykues është garanci për të pasur një proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye, ligjvënësi, formimin e drejtë të trupit gjykues e ka kategorizuar në ato lloj çështjesh, të cilat çmohen kryesisht nga gjykata, pavarësisht fazës apo shkallës ku ndodhet gjykimi.

24. Në këtë drejtim, formimi i drejtë i trupit gjykues është një çështje që nuk kërkon domosdoshmërisht që të ketë kërkesë nga palët, pasi ajo duhet të vlerësohet kryesisht nga gjykata, për shkak të garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Ky ka qenë edhe thelbi i ndryshimit të kësaj dispozite në vitin 2017, kur ligjvënësi e ndryshoi nenin 35 të KPC-s, duke e bërë shkronjën "a" të këtij neni me karakter urdhërues, në ndryshim nga parashikimi i mëparshëm, për të cilin, ligjvënësi kishte parashikuar që për padi me vlerë më të madhe se 20 milionë lekë, gjykata mund ta shqyrtonte çështjen me trupë gjykuese të

përbërë me tre gjyqtarë, vetëm nëse një nga palët në gjykim, e kërkonte këtë gjë në seancë përgatitore, sipas nenit 158/a të këtij Kodi.

25. Në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje (padia është depozituar në datën 02.11.2018), formimi i trupit gjykues me tre gjyqtarë për shqyrtimin e padive me vlerë mbi 50 milionë lekë është detyrim ligjor, i cili garanton kryerjen e një procesi të rregullt ligjor. Rezulton se në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga një gjyqtar i vetëm, ka marrë në shqyrtim në datën 09.11.2018, në seancë përgatitore, kërkesën e palës paditëse për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, në përputhje me parashikimet e nenit 158/a të KPC-s, i titulluar "Vendimet e gjyqtarit gjatë veprimeve paraprake", në të cilin parashikohet se: "*2. Gjyqtari me vendim, pa caktuar seancë përgatitore, kryen këto veprime: ... ç) vendos për marrjen e masave për sigurimin e padisë, në raste të veçanta ose të ngutshme, sipas nenit 205 të këtij Kodi;...*".

26. Kolegji, çmon të evidentojë faktin se, shqyrtimi i kërkesës për vendosjen e sigurimit të padisë, përbën një kërkesë që ka karakter emergjent dhe duhet të shqyrtohet nga gjykata brenda afatit 5 ditor, referuar këtu parashikimeve të nenit 202 të KPC-s, në të cilin parashikohet se: "*Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë*". Në kushtet kur pala paditëse ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë së bashku me paraqitjen e padisë së themelit, gjykata ka pasur si detyrim që të marrë në shqyrtim këtë kërkesë në dhomë këshillimi, sipas parashikimeve të nenit 185/a të KPC-s, të cilat përbëjnë veprime procedurale që kryhen nga gjyqtari i vetëm (relator).

27. Fakti që gjykata ka vlerësuar që të mos e shqyrtojë kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë në dhomë këshillimi, por ka vlerësuar që ta shqyrtojë në seancë përgatitore me prani të palëve, nuk përbën shkelje procedurale, pasi është gjyqtari ai që vlerëson nëse shqyrtimi i kërkesave të tilla mund të bëhet vetëm mbi bazë aktesh, apo edhe duke u dëgjuar pretendimet e palëve në proces. Ky veprim vjen tërësisht në përputhje me parashikimet e nenit 158/b i titulluar "*Seanca përgatitore*", pika 2 e tij, në të cilin parashikohet se: "*2. Për vendimet e tjera që merren nga gjyqtari gjatë veprimeve paraprake mund të kryhet seancë përgatitore kur çmohet prej tij nevoja e thirrjes dhe dëgjimit të palëve, si dhe në raste të tjera të parashikuara në ligj*".

28. Për sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se në shqyrtimin e kërkesës së palës paditëse për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka pasur detyrimin që të formojë

trupin gjykues me tre gjyqtarë për shqyrtimin e kësaj kërkese (edhe pse padia objekt shqyrtimi dukshëm rezulton të ketë një vlerë mbi 50 milionë lekë, duke iu referuar vetëm objektit të padisë për detyrimin e të paditurve që t'u paguajnë paditësve shumën prej 568.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) usd), pasi shqyrtimi i këtyre lloj kërkesave për shkak të karakterit emergjent që ato kanë, janë kërkesa që shqyrtohen nga gjykata brenda afateve shumë të shkurtra (5 ditë) dhe përbëjnë veprime të ngutshme që kryhen nga gjyqtari i vetëm, në kuptim të nenit 158/a të KPC-s. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se pretendimi që ka ngritur pala e paditur se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kryer një shkelje të rëndë procedurale e cila e bën nul procesin e gjykimit në këtë shkallë, nuk qëndron, dhe si i tillë duhet rrëzuar.

29. Gjithashtu, Kolegji çmon të theksojë se edhe pretendimi tjetër me karakter procedural që ka ngritur pala e paditur në këtë gjykim, A. A., i cili lidhet me mosnjoftimin e tij për zhvillimin e seancës përgatitore të 09.11.2018 (seancë në të cilën, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur masën e sigurimit të padisë), nuk qëndron dhe si i tillë duhet të rrëzohet. Kolegji, çmon të theksojë se, mosmarrja dijeni e palës së paditur A.A. për zhvillimin e seancës përgatitore në të cilën gjykata ka marrë vendimin për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, nuk përbën shkelje të rëndë të procedurës së gjykimit, e cila ta bëjë të pavlefshëm gjykimin apo të ketë ndikuar në dhënien e vendimit objekt gjykimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

30. Në kushtet kur ligjvënësi ka parashikuar se kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi (pa praninë e palëve) nga gjyqtari i vetëm për shkak të karakterit emergjent të saj, Kolegji vlerëson se, mosnjoftimi i palës së paditur për shqyrtimin e kësaj kërkese nuk e cenon procesin e rregullt ligjor, përsa kohë vendimi për caktimin e masës së sigurimit të padisë është i ankimueshëm sipas parashikimeve të nenit 209 të KPC-s dhe si i tillë, ai është i detyrueshëm për t'iu komunikuar palëve ndërgjyqëse, në mënyrë që ato të kenë mundësi mbrojtjeje, nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit të veçantë ndaj tij.

31. Kolegji, çmon të evidentojë faktin se, edhe sikur në rastin objekt shqyrtimi do të konstatohej se dy gjykatat më të ulëta kanë kryer shkelje të rënda procedurale gjatë shqyrtimit të kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, këto shkelje nuk do të përbënin shkak për të prishur dy vendimet dhe për ta kthyer çështjen sërish për rigjykim. Kjo për faktin se, këto lloj çështjesh kanë karakter emergjent dhe janë vendime të ndërmjetme, të cilat mund të ndryshohen deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes me vendim përfundimtar. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë ka detyrimin që t'i shqyrtojë këto çështje në themel të tyre, kur ato i paraqiten me ankim (rekurs) të veçantë duke i dhënë zgjidhje në themel çështjes, si dhe duke rregulluar të

gjitha gabimet në procedim që mund të kenë kryer gjykatat më të ulëta, kur ato kanë mundësi të rregullohen në një shkallë më të lartë gjykimi.

32. Ky qëndrim përbën tashmë një qëndrim konstant të Gjykatës së Lartë (referojuni vendimit nr. 00-2006-363 (849), datë 29.06.2006 të Gjykatës së Lartë), me të cilin është konkluduar se për vendimet e ndërmjetme objekt rekursi, nuk zbatohen rregullat e përgjithshme në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, për shkak se ato kanë karakter urgjent dhe do të duhet të gjykohen me shpejtësi. Këto vendime nuk mund të prishen dhe të kthehen për rigjykim sipas nenit 467 të KPC, por për këto lloj vendimesh duhet të konkludohet përfundimisht nga Gjykata e Lartë. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson të marrë në shqyrtim të dyja vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta, për të vlerësuar në themel nëse vendosja si masë e sigurimit të padisë objekt shqyrtimi, për lirimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të pasurisë së paluajtshme, tokë truall me sip. 1299 m², nga ana e palës së paditur në favor të palës paditëse deri në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, është bërë ose jo në përputhje me dispozitat ligjore materiale e procedurale të zbatueshme.

33. Në lidhje me shqyrtimin e kësaj çështjeje, Kolegji çmon të evidentojë faktin se, në caktimin e masës së sigurimit të padisë, gjykata u referohet kërkesave që parashikon dhe kërkon ligji procedural, konkretisht neni 202 i KPC-s, në të cilin parashikohet se: "*Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur: a) padia mbështetet në prova me shkresë; b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni*".

34. Në analizë të dispozitës ligjore të mësipërme, rezulton se ligjvënësi ka parashikuar dy kushte themelore për të vendosur masën e sigurimit të padisë: *(i)* ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës; *(ii)* të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata. Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve përkatëse në çdo shkallë gjykimi, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

35. Nga ana tjetër, masa e sigurimit të padisë, përbën kufizim të të drejtave të palës së paditur dhe si etillë në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë proporcionale dhe të justifikuara ligjërisht, për mbrojtjen e të drejtave të palës tjetër ose nga një interes publik. Justifikimi ligjor dhe kushtetues sipas nenit 202 të KPC-s për kufizimin e të drejtave të palës së paditur, është dyshimi se e drejta e pretenduar e paditësit karshi palës së paditur nëse nuk garantohet me masë sigurimi, ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur ose i vështirë në të ardhmen.

36. Gjithashtu, KPC ka garantuar edhe standardin e proporcionalitetit të këtij kufizimi, duke parashikuar se sigurimi i padisë mund të vendoset përkundrejt një garancie pasurore nga pala paditëse, për dëmin që mund t'i shkaktohet të padituri nga sigurimi i padisë (neni 202/b e KPC-s). Po ashtu, për të garantuar proporcionalitetin, në nenin 206/2 të KPC-s është parashikuar se sigurimi i padisë nuk mund të bëhet për një shumë më të madhe se ajo e padisë.

37. *Në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se asnjë nga gjykatat më të ulëta që është përfshirë në shqyrtimin e kësaj çështjeje, nuk rezulton të ketë kryer një analizë ligjore të mirëfilltë në vendimet e dhëna prej tyre, në të cilin të identifikohet qartësisht se cili është rreziku konkret i momentit që i shkakton palës paditëse një dëm të pariparueshëm, deri në momentin e shqyrtimit të çështjes me vendim përfundimtar (periculum in mora). Në asnjë nga vendimet objekt të këtij gjykimi nuk rezulton që gjykata të ketë marrë në analizë dhe shqyrtim të gjitha kushtet themelore që ka parashikuar ligjvënësi për të vendosur masën e sigurimit të padisë, apo të ketë arsyetuar ligjërisht nëse përdorimi i pasurisë së paluajtshme tokë truall të përbëjë një rrezik konkret, e cila mund të pamundësojë ose të vështirësojë përmbushjen e një detyrimi monetar.*

38. Të dyja gjykatat më të ulëta janë mjaftuar me faktin se pala paditëse është pronare legjitime e pronës, ndërsa të padituri në këtë gjykim e përdorin këtë pasuri pa asnjë titull të ligjshëm, duke i shkaktuar palës paditëse një dëm të konsiderueshëm, i cili, do të bëhet edhe më i madh, nëse pala e paditur vijon të mbajë në posedim truallin prej 1299 m² dhe të sigurojë të ardhura prej tij. Asnjë prej gjykatave më të ulëta, nuk ka analizuar se cili është dyshimi i arsyeshëm që e ka detyruar gjykatën për të vendosur si masë sigurimi padie lirimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të truallit prej 1299 m². Gjithashtu, në asnjë prej vendimeve objekt shqyrtimi në këtë gjykim, nuk është analizuar se sa proporcionale dhe e justifikuar ligjërisht është vendosja e kësaj mase për sigurimin e padisë, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të palës paditëse ose të një interesi publik. Referuar përmbajtjes së dy vendimeve objekt shqyrtimi, nuk rezulton që gjykatat më të ulëta të kenë marrë në shqyrtim situatën financiare dhe ekonomike të palës së paditur në lidhje me mundësinë e saj për të përmbushur detyrimin monetar të kërkuar në padi.

39. Pala paditëse në këtë gjykim ka pretenduar se trualli prej 1299 m² është përdorur nga pala e paditur për gati 10 vjet pa përmbushur detyrimet monetare, pra, pa paguar qiranë për të cilën kishin lidhur edhe aneks kontratën me nr. 1797 rep., nr. 731 kol., datë 31.03.2009. Në këtë drejtim, përdorimi i sendit nga ana e palës së paditur pa përmbushur detyrimet ligjore, nuk përbën një të dhënë të re, e cila të identifikohet si një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm, me qëllim që gjykatat të vendosnin si masë të sigurimit të padisë lirimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të truallit me sipërfaqe 1299 m², pa u zgjidhur çështja me vendim përfundimtar. Në këtë kuptim, pretendimi i palës paditëse për t'u vendosur si masë e sigurimit të padisë lirimi dhe dorëzimi i truallit objekt shqyrtimi, me arsyetimin se, vijimi i mbajtjes së tij nga pala e paditur do të rriste vlerën e dëmit të shkaktuar dhe të kërkuar në padi, duke sjellë si pasojë pamundësinë e ekzekutimit të tij, nuk rezulton të jetë i provuar dhe i mbështetur në ligj.

40. Pamundësia financiare e palës së paditur për të paguar detyrimin në masën prej 568.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) USD, nuk mund të gëzojë mbrojtje ligjore në kuptim të nenit 202 të KPC-s, duke u vendosur si masë sigurimi padie lirimi dhe dorëzimi i menjëhershëm i sipërfaqes së truallit objekt gjykimi. Për këtë arsye, pala paditëse por edhe gjykatat më të ulëta, duhet të kishin mbajtur në vëmendje faktin se, për të siguruar shlyerjen e detyrimit monetar objekt të këtij gjykimi, duhet të ishte hetuar dhe provuar në gjykim se cilat ishin pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që dispononin palët e paditura në këtë gjykim si: *(i)* llogari bankare; *(ii)* asete të ndryshme të regjistruara në regjistrat publikë (aksione në shoqëri të ndryshme, pasuri të paluajtshme në emër të tij etj.,), të cilat, mund të kishin një vlerë të tillë që mund të siguronin përmbushjen e detyrimit në masën e kërkuar nga pala paditëse në këtë gjykim.

41. Të dyja gjykatat më të ulëta duhet të kishin analizuar faktin nëse, dyshimi i arsyeshëm i palës paditëse në këtë gjykim, se pala e paditur nuk do të mund ta përmbushte detyrimin monetar në vlerën prej 568.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) USD për shkak të vlerës së lartë që ajo përfaqëson, por edhe të dhënave që ofronte ekstrakti historik i shoqërisë "SC" shpk, mund të gjente mbrojtjen e nevojshme ligjore nëpërmjet lirimit dhe dorëzimit të sendit si masë sigurimi padie. Për sa kohë në këtë gjykim, nuk është pretenduar se veprimet e kryera nga pala e paditur cenojnë pronën objekt shqyrtimi, duke rrezikuar që ajo të dëmtohet, të prishet, të

shkatërrohet apo të humbasë vlerën e saj nga përdorimi, kërkesa për lirimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të saj në formën e masës së sigurimit të padisë, nuk plotëson kushtet dhe kriteret ligjore që kërkon neni 202 i KPC-s për t'u pranuar nga ana e gjykatës.

42. Përveç sa është analizuar më sipër, Kolegji, çmon të evidentojë edhe faktin se, në padinë objekt gjykimi, një nga kërkimet themelore të palës paditëse në padi është kërkimi që lidhet me "*Detyrimin e të paditurve që t'u lirojnë dhe t'u dorëzojnë paditësve pasurinë e paluajtshme "Truall", në pronësi të palës paditëse, pasuri me nr. 3/246, me sipërfaqe 1299 m², volumi 33, faqe 177, zona kadastrale 18270, e ndodhur në rrugën "V.P.", Tiranë*". Në të njëjtën kohë, kjo palë ka kërkuar edhe sigurimin e kësaj padie duke pretenduar: "*lirimin e menjëhershëm të objektit për të ndaluar rrezikun që u shkaktohet paditësve nga mospërdorimi i pronës së tyre dhe zhvillimi i saj*", masë e cila rezulton të jetë pranuar nga të dyja gjykatat më të ulëta.

43. Bazuar sa më sipër, rezulton e provuar se të dyja gjykatat, në momentin që kanë pranuar kërkesën e palës paditëse për sigurimin e padisë dhe kanë urdhëruar lirimin e menjëhershëm të pronës objekt i këtij gjykimi, kanë dhënë konsiderata për zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi, përsa i takon kërkimit të padisë që ka lidhje me lirimin dhe dorëzimin e sendit të paluajtshëm "*truall*" me sipërfaqe 1299 m², duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me sa parashikon ligji procedural, si dhe praktika gjyqësore e konsoliduar në trajtimin e çështjeve të ngjashme. Kolegji, vlerëson se me këtë lloj vendimmarrjeje, të dy gjykatat më të ulëta kanë paragjykuar zgjidhjen në themel të çështjes për atë pjesë të kërkimit në padi që ka të bëjë me lirimin dhe dorëzimin e truallit prej 1299 m², duke e bërë të panevojshëm vijimin e gjykimit të themelit për këtë kërkim.

44. Vendimet e dhëna nga të dyja gjykatat më të ulëta, vijnë në kundërshtim të hapur me qëndrimin që kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 10/2004, në të cilin është shprehur se: "*Gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi sipas të cilit, gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim... Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohshme të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri. E thënë ndryshe, masa e përkohshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërkimit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë...*".

45. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e ngritura në rekurs nga pala e paditur, përsa i takon themelit të gjykimit të kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë janë të drejta dhe si të tilla duhet të pranohen. Vendimi i ndërmjetëm me nr. 14256 regj. T-them, datë 09.11.2018 marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me të cilin është marrë masa e sigurimit të padisë, si dhe vendimi nr. 277, datë 20.03.2019 i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor, janë vendime të marra në kundërshtim me ligjin procedural dhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, të dyja këto vendime duhet të ndryshohen dhe duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

Vendim i Kolegjit Civil, Nr. 00-2021-139, datë 03.03.2021

Shqyrtimi në dhomën e këshillimit i ankimeve të veçanta, përbën rregullin e përgjithshëm të shqyrtimit nga gjykata me juridiksion rishikues me qëllim garantimin e shpejtësisë dhe efektivitetit të mjetit të ankimit.

Gjëja e gjykuar dhe gjyqvarësia janë institute të së drejtës procedurale të cilat ndonëse ndryshojnë nga faza procedurale në të cilën ndodhet çështja ndjekin të njëjtin qëllim që është ndalimi i 'ne bis in idem'. Këto dy institute sjellin të njëjtën pasojë juridike që është pushimi i çështjes me vendim nga gjykata e cila konstaton pengesën apo shqyrton mosmarrëveshjen menjëherë, që në veprimet paraprake. Çdo vendim i ndërmjetëm i gjykatës, përfshirë edhe masat e sigurimit bëhet nul me vendimin e pushimit të gjykimit.

Në marrëdhënien juridike të bashkëpronësisë, vepron rregulli i unitetit që do të thotë se në raport me të tretët, bashkëtitullarët veprojnë si një palë e vetme pasi edhe e drejta e tyre mbi sendin është e përbashkët dhe e pandarë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se shtetasit, I.B., i janë konfiskuar pronat, si i dënuar politik, sipas vendimit datë 14.04.1945 të Gjykatës Speciale të Tiranës. Konkretisht, i është konfiskuar trualli me sipërfaqe 1428 m², ndodhur në vendin e quajtur "B.K.", Elbasan.

2. Ka rezultuar se trashëgimlënësi, I. B. ka ndërruar jetë në vitin 1977 dhe nuk rezulton të ketë pasur fëmijë apo të ketë lënë testament. Ai ka qenë i martuar me znj. D. B., bashkëshortja pasjetuese.

3. Rezulton se paditësi, z. S. M. është trashëgimtar ligjor i të ndjerës, Sh. M., e cila ishte vajza e znj. S.B., motrës së paravdekur të trashëgimlënësit, I. B.. Nga ana tjetër, ka rezultuar se pala e paditur, z. E.R. është vëllai i bashkëshortes pasjetuese të trashëgimlënësit, znj. D. B., e cila ka ndërruar jetë me datë 03.01.1988.

4. Sipas kërkesës së palëve të interesuara, nga noteri, znj. M.L., janë

lëshuar dy dëshmi trashëgimie të ndryshme, për të ndjerin I. B., duke u përcaktuar trashëgimtarë ligjorë të ndryshëm. [...]

5. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 9225/2004 "Për Kthimin dhe kompensimin e pronave". Z. E.R. i është drejtuar me kërkesë, Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, Elbasan, për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarit, I. B.. Kjo e fundit me vendimin nr. 76/2007, ka rrëzuar kërkesën, vendim i cili është lënë në fuqi nga Agjencia Qendrore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës.

6. Në vijim, mbi padinë e kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur anulimin e këtyre vendimeve, duke i njohur të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen truall prej 1428 m², të ndodhur në vendin e quajtur "B.K.". Me vendimin nr. 1173, datë 30.04.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës është ndryshuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë, duke iu njohur pronësia paditësit E. R., për sipërfaqen 1391 m², dhe është vendosur kthimi fizik për sipërfaqen 1333 m² dhe kompensimi për sipërfaqen 58 m².

7. Sa më sipër, z. E.R. ka regjistruar në emër të tij, pasurinë me sipërfaqe 1333 m2 sipas vendimeve të mësipërme gjyqësore pranë ZVRPP Elbasan, e cila është regjistruar si pasuri e ndarë në dy pjesë, pasuria me nr. 11/91, me sipërfaqe 132 m2 dhe pasuria me nr. 11/92, me sipërfaqe 1201 m2.

8. Në vijim, ka rezultuar se znj. E. Sh., bashkë me z. Z. B. (trashëgimtar i të ndjerës A.B.), duke pretenduar qenien trashëgimtar ligjor të të ndjerit I.B., i janë drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kundër të paditurve z. E. R. dhe znj. M. L.,[...]

8.1. Rezulton se znj. E. Sh., së bashku me paditësin në këtë gjykim, z.S. M., janë motër dhe vëlla, trashëgimtarë ligjorë të znj. Sh. M..

9. Me vendimin nr. 269, datë 08.03.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur rrëzimin e padisë dhe heqjen e masës së sigurimit të padisë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 10-2018-2069 (808), datë 12.11.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga paditësja, znj. E.Sh.. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me datë 08.02.2018 dhe ende nuk është shqyrtuar.

10. Në vijim, paditësi, z. S. M., duke pretenduar se është trashëgimtar ligjor i të ndjerit I.B., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Paditësi ka pretenduar se pasuritë objekt gjykimi janë regjistruar në emër të palës së paditur, z. E. R., si trashëgimtar i të ndjerit I. B., pa e pasur një cilësi të tillë. Sa më sipër paditësi, i është drejtuar gjykatës me padinë e kërkimit të trashëgimit, sikurse përcaktohet në pjesën hyrëse. Ndër të tjera, paditësi ka kërkuar edhe masën e sigurimit të padisë, me objekt mostjetërsimin e truallit objekt gjykimi derisa vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë.

11. Paditësi ka shpjeguar se pasuria me nr. 11/91, ZK 8524, e ndodhur në

Lagjen "*Kala*" Elbasan, është ndarë në dy pasuri, konkretisht në pasurinë me nr. 11/91, ZK 8524 dhe në pasurinë me nr. 11/92, ZK 8524. Ka rezultuar e provuar se pasuria me nr. 11/91, ZK 8524 është shitur nga i padituri, si rrjedhojë paditësi ka kërkuar vendosjen e sekuestros konservative vetëm mbi pasurinë me nr. 11/92, ZK 8524. Në lidhje me kërkesën për sigurimin e padisë, pala e paditur ka prapësuar se kjo duhet të rrëzohet pasi çështja përbën gjë të gjykuar.

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin e ndërmjetëm datë 13.02.2019, ka vendosur: *1. Pranimin e kërkesës. 2. Marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë, duke vendosur sekuestron konservative mbi: pasurinë e ndodhur në ZK 8524, nr. pasurie 11/92, me sipërfaqe 1201 m2, e llojit "truall", e ndodhur në lagjen "Kala", Elbasan, në pronësi të E.R., duke ndaluar tjetërsimin e kësaj pasurie derisa vendimi gjyqësor në lidhje me këtë çështje të marrë formë të prerë. 3. Ky vendim bëhet titull ekzekutiv dhe ekzekutohet drejtpërdrejt nga zyra e përmbarimit, pas njoftimit të vendimit.".*

12.1. Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka arsyetuar se, ka për objekt kontrolli vetëm kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit të padisë dhe në lidhje me pretendimin mbi gjënë e gjykuar do të shprehet me vendim përfundimtar.

12.2. Në lidhje me kushtin e parë për sigurimin e padisë, nuk është e domosdoshme që të jetë vërtetuar plotësisht ekzistenca e së drejtës objekt gjykimi, por vetëm të ekzistojë mundësia e të drejtës që kërkohet të rivendoset. Në rastin konkret, meqë pala paditëse i është drejtuar gjykatës me padi për kërkimin e trashëgimit, duke qenë se kjo çështje po gjykohet në gjykatë, ekziston mundësia potenciale që kjo padi të pranohet nga gjykata dhe të plotësohet kushti i parë. Së dyti, në rastin konkret padia mbështetet në prova me shkresë. Së treti, tjetërsimi i një pjese të pasurisë nga pala e paditur krijon dyshimin e një rreziku real se ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Së katërti, lloji i masës së sigurimit të padisë, i kërkuar nga paditësi, është i parashikuar në nenin 206 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim, KPC), konkretisht bllokimi i pasurisë së paluajtshme nr. 11/92 në ZVRPP Elbasan. Sa më sipër, plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet për marrjen e masës së sigurimit të padisë, të parashikuara në KPC dhe të elaboruara nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

13.Kundër vendimit datë 13.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka paraqitur ankim pala e paditur, z. E.R., i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës së palës paditëse [...]

14. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2019-698/101, datë 16.04.2019, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit "Për sigurimin e padisë" datë 13.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar"[...]*

15. Kundër vendimit nr. 10-2019-698/101, datë 16.04.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, me datë 12.06.2019, ka paraqitur rekurs i padituri, E.R., e i cil ka kërkuar ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë [...]

16. Po ashtu, më datë 08.07.2019 ka paraqitur kundërrekurs pala paditëse, S. M. duke parashtruar se: Rekursi i palës së paditur nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 480 të KPC-s [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

A. Procedura

17. Kolegji konstaton se në cilësinë e palës së paditur është thirrur fillimisht Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" është krijuar Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK), e cila është bashkim i AITPP-së, ALUIZNI-t dhe ZRPP-së. Me anë të këtij ligji, ASHK-së, i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet, që sipas ligjit i ushtronin më parë këta persona juridikë publikë. Sa më sipër, në zbatim të nenit 199 të KPC-s, Kolegji ka vendosur të kryejë kalimin procedural të palës së paditur, ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, me ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan.

18. Po ashtu, rezulton se çështja e regjistruar në Gjykatën e Lartë, më datë 02.09.2019, ka si objekt rekursi vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me të cilin është vendosur marrja e masës së sigurimit të padisë. Sipas nenit 209 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim, KPC), ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm, lejohet ankim i veçantë.

19. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pavarësisht datës së regjistrimit, në zbatim të nenit 470 të KPC-s, të ndryshuar me Ligjin nr. 38/2017, ka vlerësuar të shqyrtojë me përparësi këtë çështje.

20. Në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit Civil dhe Kolegjit Administrativ, pika 3 e nenit 470 të KPC-s është interpretuar në mënyrë teleologjike dhe të zgjeruar edhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se, për çështjet për të cilat lejohet ankim i veçantë, kriteri përcaktues, me të cilin ligji ka lidhur ritin e posaçëm kameral të gjykimit në juridiksionin rishikues dhe gjykimin me përparësi të tyre, qoftë në gjykatën e apelit

apo në Gjykatën e Lartë, nuk është lloji i vendimit të ankimuar, por lloji i ankimit të lejuar për tu ushtruar. Në këtë rast togfjalëshi "*gjykata më e lartë*" vlerësohet nga ana e Kolegjit të jetë përdorur jo pa qëllim nga ana e ligjvënësit. Qëllimi ka qenë që të ruhet riti i posaçëm kameral i gjykimit të ankimeve të veçanta, si në gjykatën e apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë.

21. Për shkak të karakteristikave thelbësisht dhe përgjithësisht procedurale, Gjykata e Lartë ka konkluduar në praktikën e saj se, të gjitha llojet e vendimeve, ndaj të cilave ligji lejon ankim/rekurs të veçantë, duhet të shqyrtohen, si nga gjykata e apelit, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi dhe brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit në gjykatë.

22. Sa më sipër, Kolegji mori në shqyrtim fillimisht çështjen në dhomë këshillimi. Duke u bazuar tek shkaqet e rekursit dhe tek parashtrimet e paditësit në kundër-rekurs, para Kolegjit u shtrua për diskutim çështja, nëse gjykatat më të ulëta kanë pasur pengesë procedurale për shqyrtimin në themel të çështjes, çka kushtëzon edhe vlerësimin e kërkesës së paditësit mbi sigurimin e padisë.

23. Në kushtet ku prapësimi i palës së paditur mbi gjënë e gjykuar nuk është marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta, Kolegji ka vlerësuar të rëndësishëm dëgjimin e palëve dhe me vendim të ndërmjetëm ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Një gjë e tillë është e lidhur me garantimin e standardit të vendosur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), se respektimi i parimit të kontradiktoritetit dhe i të drejtës për t'u dëgjuar merr rëndësi, sidomos në çështjet ku gjykata investohet kryesisht, me qëllim parandalimin e dhënies së vendimeve gjyqësore me efekt "surprizë" (*shih, çështja "Duraliyski v. Bulgaria", Nr. 45519/06, paragrafi 33-35, Vendim i GJEDNJ-s, datë 04.03.2014*).

24. Në rastin konkret, prapësimi mbi gjënë e gjykuar është ngritur nga pala dhe jo me iniciativë të gjykatës. Megjithatë, standardi i GJEDNJ-s, i sjellë në vëmendje më sipër, i cili përbën një standard minimum, në kuadër të garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse për proces të rregullt, është i aplikueshëm në rastin konkret, përsa kohë, mbi arsyetimin e gjykatave më të ulëta, tek palët ndërgjyqëse janë krijuar pritshmëritë se në lidhje me këtë pretendim të palës së paditur, gjykatat (qoftë me juridiksion fillestar apo edhe me juridiksion rishikues) do të duhet të shprehen në përfundim të gjykimit me vendim përfundimtar dhe jo gjatë shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë.

25. Kolegji vlerëson se riti kameral i shqyrtimit të ankimeve të veçanta, sipas nenit 470/3 të KPC-s, përbën një rregull të përgjithshëm të shqyrtimit të tyre nga gjykata më e lartë, me juridiksion rishikues, për të garantuar

shpejtësinë dhe efektivitetin e mjetit të ankimit. Kjo nuk do të thotë se për gjykatën rishikuese nuk është i zbatueshëm riti plenar i dëgjimit të palës në seancë gjyqësore, nëse sipas rastit, një gjë e tillë vlerësohet e domosdoshme *(shih, për analogji, nenin 465/a të KPC-s; nenin 51 të Ligjit nr. 49/2012; nenin 610 të KPC-s etj.,)*. Kolegji vlerëson se edhe në kushtet kur përjashtimisht ankimi i veçantë është shqyrtuar në seancë gjyqësore, ai do të ndjekë regjimin e posaçëm, sipas nenit 470 të KPC-s, për shpejtësinë e gjykimit dhe mënyrën se si do të disponojë Gjykata e Lartë, sikurse do të analizohet në vijim.

B. Në lidhje me prapësimin e palës së paditur mbi gjënë e gjykuar dhe ligjshmërinë e vendimeve të ndërmjetme të gjykatave më të ulëta mbi sigurimin e padisë.

26. Kolegji vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-s, konkretisht, shkronja "b" dhe "c", të cilat bëjnë të cenueshme vendimmarrjen e ndërmjetme të gjykatave më të ulëta.

27. Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, nuk janë interpretuar drejt dispozitat e ligjit procedural në lidhje me pengesat procedurale dhe parakushtet për vlefshmërinë e gjykimit, sipas interpretimit të bërë në praktikën e mëparshme gjyqësore të Gjykatës së Lartë *(shih, Vendim nr. 00-2020-670, datë 02.10.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë)*. Ky interpretim i gabuar i ligjit nga gjykatat më të ulëta ka ndikuar edhe në marrjen e një vendimi të pabazuar në ligj, në lidhje me kërkesën e paditësit mbi sigurimin e padisë.

28. Kolegji sjell në vëmendje se procesi gjyqësor civil apo administrativ kërkon ekzistencën e disa prezumimeve procedurale pozitive apo negative, në mënyrë që të mos shfaqen pengesa ligjore paprocedueshmërie *(shih nenin 299 të KPC-s)*. Prezumimet procedurale pozitive janë ato kushte ligjore, pa të cilat procesi gjyqësor civil apo administrativ shuhet, si p.sh., vullneti i palëve për të proceduar. Nga ana tjetër, prezumimet procedurale negative janë ato kushte ligjore, të cilat nëse vërtetohen se ekzistojnë e shuajnë procesin.

29. Ndryshe nga sa kanë konkluduar gjykatat më të ulëta, Kolegji vlerëson se, elementë të tillë të vlefshmërisë së procesit gjyqësor, sikurse janë gjëja e gjykuar, juridiksioni, kompetenca lëndore/funksionale, litispendenca etj., janë çështjet që duhet të verifikohen paraprakisht dhe të zgjidhen nga gjykatat, në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, si parakushte për gjykimin në themel të çështjes.

30. Kolegji sjell në vëmendje nenin 451/a/2 të KPC-s, i cili parashikon se, *"...Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të*

gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe…"

31.Nganjë interpretim literal i kësaj dispozitemund të konkludohet se,nëse do të verifikohet situata e gjësë së gjykuar, rigjykimi i çështjes është i ndaluar. Si rrjedhojë, padia e ngritur rishtazi mund të kualifikohet si një padi që nuk mund të ngrihet, pasi e drejta e padisë në kuptimin procedural dhe material është shuar për efekt gjykimi. Në bazë dhe për zbatim të nenit 299/c të KPC-s, gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen, në këtë rast, është e detyruar të pushojë menjëherë gjykimin, sapo vërtetohet një rrethanë e tillë.

32. Nën një parashikim ligjor eksplicit, të njëjtën pasojë juridike ka vërtetimi i situatës së gjyqvarësisë (*litispendentia*). Në nenin 58 të KPC është parashikuar:

"*Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë.*".

33. Kolegji vlerëson se gjyqvarësia (*litispendentia*) është një ndër kushtet ligjore dhe prezumimet negative të procesit gjyqësor civil. Ajo nuk duhet të ekzistojë përgjatë procesit, pasi nëse vërtetohet se ekziston gjykimi i nisur, i dyti në kohë (*primus tempore potior est iure*) duhet të pushohet menjëherë. Ligji procedural nuk mundet të lejojë gjykimin e së njëjtës mosmarrëveshje, në të njëjtën kohë, nga dy trupa gjykues të ndryshëm.

34. Kolegji vlerëson se, gjëja e gjykuar dhe gjyqvarësia janë dy institute të së drejtës procedurale, të cilat në aspektin substancial ndjekin të njëjtin qëllim, që është ndalimi i gjykimit më shumë se një herë i së njëjtës çështje (*ne bis in idem*). Në themel të tyre qëndron marrëdhënia midis dy mosmarrëveshjeve gjyqësore me identitet të njëjtë juridik, sipas objektit, shkakut dhe palëve ndërgjyqëse.

35. Të dyja këto institute kanë si bazë sigurinë juridike dhe ndalimin e dhënies së vendimeve të ndryshme, për të njëjtën çështje. Qëllimi i tyre është qartësia juridike e titujve që formësohen në qarkullimin civil nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe gjë e gjykuar. Njëkohësisht përmes këtyre instituteve synohet të ruhet koherenca jurisprudenciale dhe e zgjidhjes gjyqësore të çështjeve. Ligjvënësi ka synuar të garantojë në qarkullimin civil parimin e sigurisë juridike të të drejtave dhe detyrimeve, duke synuar gjithashtu edhe eliminimin e krijimit fiktivisht të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimeve gjyqësore, gjë të gjykuar, sipas nenit 494 të KPC-s.

36. Kolegji vlerëson se ndryshimi midis këtyre instituteve është vetëm formal dhe qëndron tek faza procedurale, në të cilën ndodhen dy çështjet gjyqësore. Në rastin kur çështja përbën gjë të gjykuar, gjykimi i parë ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me të cilin janë

përcaktuar me efekt prekluziv, të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqëse në marrëdhënien juridike materiale, objekt gjykimi. Ndërkohë, në situatën e gjyqvarësisë, mosmarrëveshja gjyqësore është ende në proces dhe, si rrjedhojë, ndalohet nisja e një gjykimi të dytë të çështjes me të njëjtat palë, me të njëjtin objekt dhe shkak ligjor, në të njëjtën gjykatë ose në gjykata të ndryshme.

37. Neni 451/a/2 i KPC-s, si dispozitë e posaçme që rregullon institutin e gjësë së gjykuar, në ndryshim nga neni 58 i KPC-s, nuk e parashikon në mënyrë të shprehur se cila është pasoja që passjell për gjykimin, vërtetimi i kësaj rrethane penguese. Megjithatë, nëse ligjvënësi e ka parashikuar në mënyrë eksplicite në nenin 58 të KPC-s, se litispendeca është shkak për pushimin e gjykimit, akoma më tepër, të njëjtën pasojë juridike do të duhet të sjellë për gjykimin, rrethana e gjësë së gjykuar, si një fazë më e avancuar procedurale e gjykimit të parë, i cili tashmë ka përfunduar.

38. Mbi bazën e kësaj analize, Kolegji vlerëson se nga pikëpamja e teknikës legjislative, KPC ka rregulluar në mënyrë të posaçme disa nga prezumimet procedurale absolute, si parakushte për vlefshmërinë e gjykimit, duke parashikuar shprehimisht edhe pasojën që sjell vërtetimi i tyre për procesin gjyqësor, sikurse është litispendenca, sipas nenit 58 të KPC-s, mungesa e juridiksionit gjyqësor, sipas nenit 59 e vijues të KPC-s, etj,.

39. Ndërkohë, nën një rregullim më të përgjithshëm, neni 299 i KPC-s ka parashikuar të gjitha pengesat e tjera procedurale për shqyrtimin meritor të çështjes, të cilat kategorizohen, përgjithësisht, si rrethana që pengojnë ngritjen e padisë (padi që nuk mund të ngrihen) apo si rrethana që pengojnë vazhdimin e gjykimit. Në një kuptim të përgjithshëm, gjyqvarësia apo mungesa e juridiksionit etj., janë rrethana që pengojnë ngritjen e padisë. Pra, paditë në të tilla rrethana mund të kualifikohen, përgjithësisht, si padi që nuk mund të ngrihen (*lato sensu*), por për to, ligjvënësi ka bërë një rregullim të posaçëm. Për të gjitha rastet e tjera, kur nuk ka një rregullim të posaçëm (*lex specialis*), do të gjejë zbatim neni 299 i KPC-s, (*lex generalis*). Pasoja që passjell për gjykimin vërtetimi i rrethanave të tilla është vetëm pushimi i gjykimit me vendim jo përfundimtar, sipas nenit 127 të KPC-s.

40. Përsa i përket fazës në të cilën gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen duhet të konstatojë rrethana të tilla penguese, Kolegji vlerëson se ky operacion vlerësues i gjyqtarit që shqyrton mosmarrëveshjen duhet të jetë i menjëhershëm dhe, nëse është e mundur, që në veprimet paraprake. Kështu, sipas nenit 158/a/2/e të KPC-s, gjyqtari me vendim, pa caktuar seancën përgatitore, vendos pushimin e gjykimit, nëse vërtetohet një nga rrethanat e parashikuara në nenin 299 të KPC-s. Në të njëjtën mënyrë, edhe gjykata me juridiksion rishikues që shqyrton mosmarrëveshjen, nëse nuk ka

vepruar gjykata e shkallës së parë, menjëherë duhet të konstatojë pengesën dhe të disponojë me vendim jo përfundimtar mbi çështjen.

41. Kolegji vlerëson se për të verifikuar rrethana të tilla penguese për gjykimin e mosmarrëveshjes, sikurse janë, gjëja e gjykuar apo gjyqvarësia, sipas rastit, nuk është e domosdoshme të shqyrtohet çështja në themel, por mjafton të verifikohet identiteti juridik i dy çështjeve, bazuar në elementët e dy padive që kanë konstituuar dy proceset gjyqësore (sipas shkakut, objektit dhe palëve). Kjo arrihet nëpërmjet një vlerësimi *prima facia,* pa qenë e nevojshme të gjykohet në themel padia e dytë.

42. Kolegji vlerëson se, nëse gjykata që gjykon mosmarrëveshjen gjendet para një pengese procedurale për shqyrtimin meritor të çështjes, *apriori* nuk mund të marrë në shqyrtim asnjë kërkesë të palëve gjatë gjykimit dhe nuk mund të marrë asnjë vendim të ndërmjetëm të vlefshëm, që i shërben zgjidhjes përfundimtare të çështjes. Sipas nenit 300 të KPC-s, nëse do të vërtetohej një nga prezumimet procedurale absolute që do t'i jepte shkak pushimit të gjykimit, çdo vendim i ndërmjetëm i gjykatës do të bëhej nul me vendimin e pushimit të gjykimit.

43. Akoma më tepër merr rëndësi një vlerësim i tillë nga gjykatat, kur bëhet fjalë për kërkesat e palës paditëse për sigurim padie, sipas neneve 202 e vijues të KPC-s. Vendimi i gjykatës që pranon kërkesa të tilla përbën kufizim të drejtave substanciale, kushtetuese dhe ligjore të palës së paditur, gjatë gjykimit, sikurse mund të jetë e drejta e pronës etj., në varësi të llojit të masave kufizuese.

44. Në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, një kufizim i tillë me ligj justifikohet nga mbrojtja e interesave të personave të tjerë, konkretisht nga dyshimi i arsyeshëm apo ekzistenca e mundshme e të drejtës së pretenduar të paditësit dhe nga rreziku se ekzekutimi i vendimit përfundimtar të gjykatës do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Masa të tilla kanë si qëllim të bëjnë efektive padi, jo vetëm që mund të ngrihen në kuptimin procedural dhe që mund të gjykohen në themel, por për të cilat ekziston dyshimi i arsyeshëm mbi bazueshmërinë e tyre edhe në aspektin material.

45. Në këtë kuptim, mund të sigurohen me masë sigurimi, në kushtet e neneve 202 e vijues të KPC-s, vetëm paditë që janë të afta ligjërisht të provokojnë nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar, që mund të shndërrohet në titull ekzekutiv. Nëse një padi nuk mund të ngrihet *ab initio* dhe të jetë e aftë të shndërrohet në një vendim gjyqësor përfundimtar, e më tej në titull ekzekutiv, nëpërmjet gjykimit, nuk plotësohen parakushtet themelore për vendosjen e masës së sigurimit.

46. Në këtë kuptim, nuk mund të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm mbi bazueshmërinë e kësaj padie në kuptimin material, nëse ajo nuk mund

të shqyrtohet në kuptimin procedural. Si rrjedhojë *apriori* nuk ekziston rreziku eminent se ekzekutimi i vendimit përfundimtar të gjykatës do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Çdo lloj mase sigurimi e marrë nga gjykatat, në lidhje me padi që nuk mund të ngrihen, përbën kufizim pa ligj dhe të pajustifikuar të të drejtave kushtetuese apo ligjore të palës së paditur, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

47. Duke iu kthyer rastit konkret, para Kolegjit, u shtruan për diskutim disa çështje:

Së pari, nëse ka identitet juridik të njëjtë, midis çështjes konkrete dhe çështjes së mëparshme gjyqësore, me paditës znj. E.Sh. etj., kundër palës së paditur, z. E.R., shqyrtimi i të cilës ka përfunduar me vendimin nr. 808, datë 12.11.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës; Nëse është ky vendim i detyrueshëm për paditësin, z. S.M., në kushtet kur ai nuk është legjitimuar formalisht si palë në këtë gjykim;

Së dyti, nëse çështjet janë identike, a ka marrë vendimi nr. 808, datë 12.11.2018 i Gjykatës së Apelit Durrës statusin *"gjë e gjykuar"*, në kushtet kur ndaj tij është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, apo jemi në situatën e gjyqvarësisë (litispendencës), sipas nenit 58 të KPC-s.

48. Për të konkluduar mbi këto çështje të shtruara për diskutim, Kolegji vlerësoi të marrë në analizë identitetin juridik të dy padive, sipas elementëve karakterizues të tyre, shkakut, objektit dhe palëve ndërgjyqëse.

49. Në çështjen e mëparshme, paditësit, znj. E.Sh. dhe z. Z.B. kanë kërkuar nëpërmjet padisë njohjen bashkëpronar (bashkëtrashëgimtar) dhe kthimin fizik të sendit të paluajtshëm, pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit I.B. (i njëjtë me objektin material të këtij gjykimi), duke vepruar në emër dhe për llogari të paditësit z. S.M. (objekti i padisë). Paditësit në këtë gjykim kanë pretenduar qenien bashkëpronar (bashkëtrashëgimtar ligjor) të trashëgimlënësit I.B. dhe përjashtimin si trashëgimtar ligjor të palës së paditur z. E.R., i cili sipas tyre, ka fituar pasurinë trashëgimore me cilësinë e trashëgimtarit ligjor, pa qenë i tillë (shkaku i padisë). Si rrjedhojë ato kanë kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së dëshmisë së trashëgimisë përkatëse ligjore të noteres dhe rregullimin e çdo pasoje që ka ardhur nga kjo dëshmi. Kolegji vlerëson se në thelb padia e mëparshme ka pasur për objekt kërkimin e trashëgimit, sipas nenit 349 të KC-s.

50. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se me të njëjtën padi, sipas shkakut dhe objektit, në lidhje me të njëjtën pasuri trashëgimore që i përkiste trashëgimlënësit I.B., i është drejtuar gjykatës paditësi, z. S.M., në çështjen konkrete, kundrejt të njëjtës palë të paditur, z. E.R..

51. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson të marrë në analizë edhe identitetin juridik të paditësve në dy çështjet gjyqësore, në kushtet kur padia

e parë nuk është ngritur nga paditësi z. S.M., në çështjen konkrete.

52. Kolegji vlerëson se, edhe pse paditësi, z. S.M. nuk ka qenë fizikisht palë në gjykimin e mëparshëm, ai ka qenë juridikisht i tillë, për shkak të ligjit (*ipso legge*).

53. Sikurse ka rezultuar nga aktet e fashikullit të gjykimit, në procesin e mëparshëm, padia është ngritur nga dy prej bashkëpronarëve (bashkëtrashëgimtarëve) pretendentë, me qëllim që sendet objekt gjykimi t'u ktheheshin të gjithëve. Pra, në padinë e parë, paditësit znj. E. Sh. etj., kanë vepruar edhe në emër dhe për llogari të bashkëpronarit tjetër pretendent, z.S.M..

54. Fillimisht Kolegji sjell në vëmendje, konceptin e bashkëpronësisë sipas nenit 199 të KC, i cili e përkufizon si një gjendje juridike kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave. Në këtë marrëdhënie juridike, midis bashkëpronarëve vepron rregulli i unitetit. Kjo do të thotë se në raport me të tretët, bashkëtitullarët e së drejtës reale, juridikisht veprojnë si një palë e vetme, pasi e drejta mbi sendin ose sendet është e përbashkët dhe e pandarë.

55. Në të njëjtën logjikë, edhe në marrëdhënien juridike procedurale apo në konfliktet gjyqësore me të tretët, ato veprojnë juridikisht dhe unanimisht si një palë e vetme. Kjo është *ratio* e parashikuar në nenin 162 të KPC-s, ku thuhet se në bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme, ku të gjitha palët për shkak të ligjit konsiderohen si një e vetme e pandarë, veprimet e njërit bashkëndërgjyqës sjellin efekte për të gjithë.

56. Në vijim të kësaj analize, Kolegji sjell në vëmendje nenet 200/d dhe 296 të KC-s, ku parashikohet se, një nga të drejtat e secilit bashkëpronar është të ngrejë padinë e kërkimit të sendit të përbashkët, kundrejt çdo poseduesi të paligjshëm, me kushtin që t'ua kthejë të gjithëve. Një e drejtë e tillë i përket edhe çdo bashkëtrashëgimtari për të ngritur padinë e kërkimit të trashëgimit sipas nenit 349 të KC-s.

57. Kolegji vlerëson se këto dy dispozita kanë pasur si qëllim të garantojnë të drejtën për pronë dhe mbrojtjen e saj gjyqësore, nga secili prej bashkëpronarëve, kundrejt çdo poseduesi të paligjshëm, edhe në kushtet ku bashkëpronarët e tjerë janë neglizhentë apo nuk tregojnë diligjencën e duhur në mbrojtjen e saj.

58. Nga ana tjetër, secili bashkëpronar në këtë padi, nuk vepron në emër dhe për llogari të interesave vetjake; në të kundërt nuk do të kishte legjitimitet të kërkonte pjesën e bashkëpronarëve të tjerë, sipas neneve 31 dhe 95 të KPC-s. Kjo parashikohet në mënyrë literale në nenin 200/d të KC-s, në togfjalëshin: "*...me kusht që ky t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve",* dhe, po ashtu, në nenin 296, fjalia e dytë, "*Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkëpronar për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t'u dorëzohetgjithë bashkëpronarëve".*

59. Ky togfjalësh, në të dyja dispozitat, nënkupton se ligji nuk i jep legjitimitet të pavarur gjithsecilit prej bashkëpronarëve për të ngritur padi për kthimin e sendit sa herë që janë të pakënaqur nga vendimi gjyqësor (në eventualitetin e rrëzimit të padisë). Kolegji sjell në vëmendje, në mënyrë hipotetike situatën ku ka shumë bashkëpronarë dhe teorikisht do të kishte padi, aq sa bashkëpronarët janë në numër. Në këtë situatë, pala e paditur do të ishte e destinuar përjetësisht të qëndronte në procese gjyqësore, duke pasur pasiguri absolute mbi të drejtën e pronës.

60. Në të njëjtën mënyrë, në situatën e kundërt, vendimi gjyqësor që është i favorshëm (në eventualitetin e pranimit të padisë), përbën titull ekzekutiv për të gjithë dhe secili mund të vejë në lëvizje ekzekutimin e detyrueshëm të tij edhe pse nuk është legjitimuar formalisht si palë në gjykim, pa qenë e nevojshme të iniciojë një proces tjetër gjyqësor, kundrejt poseduesit të sendit. Në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet se vendimi gjyqësor është gjë e gjykuar dhe detyrues për bashkëpronarët, vetëm nëse është i favorshëm për ta.

61. Kolegji vlerëson se këto dy dispozita të KC-s do të duhet të interpretohen në mënyrë sistematike me nenin 162/2 të KPC-s dhe, po ashtu, në mënyrë pajtuese me të drejtat kushtetuese dhe konventore të palës kundërshtare për siguri juridike mbi të drejtën e pronës. Nëse mosmarrëveshja është konkluduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ajo nuk mund të rivihet në diskutim.

62. Sipas nenit 162/2 të KPC-s, në bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme, sikurse është rasti i bashkëpronësisë, veprimet procedurale të kryera nga njëri bashkëndërgjyqës sjellin efekte për të gjithë, qoftë kur favorizojnë apo qoftë kur rëndojnë pozitën e atyre që nuk kanë vepruar. Si rrjedhojë, nëse padia e kthimit të sendit (padia e rivendikimit sipas nenit 296 të KC-s, ashtu edhe padia e kërkimit të trashëgimit sipas nenit 349 të KC-s) është ngritur nga njëri bashkëpronarët, ajo sjell efekte për të gjithë, marrëdhënia juridike procedurale me gjykatën dhe palën kundërshtare ka lindur për të gjithë dhe vendimi gjyqësor do të jetë i detyrueshëm për të gjithë, për shkak të ligjit.

63. Në këtë kuptim, Kolegji konkludon se, rasti i parashikuar në nenin 200/d të KC-s është një nga rastet e përfaqësimit ligjor, ku njëri nga bashkëpronarët mund të ngrejë padinë e kthimit të sendit edhe për llogari të bashkëpronarëve të tjerë dhe tagri për të ngritur padi i buron nga ligji.

64. Sa më sipër, duke interpretuar nenet 200/d dhe 296 të KC-s, në pajtim edhe me të drejtën për proces të rregullt të secilit bashkëpronar, sipas nenit 6 të KEDNJ-s dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

për tu dëgjuar para se të gjykohet, Kolegji vlerëson se çdo bashkëpronar në këtë lloj procesi, edhe në kushtet ku padia nuk është ngritur prej tij, por në emër dhe për llogari të tij, ka të gjitha të drejtat procedurale që i njihen palës ndërgjyqëse në këtë pozicion, për t'u paraqitur në atë gjykim, për të parashtruar mbrojtjen, për të bërë kërkesa, për të ankimuar vendimin gjyqësor, për ta ekzekutuar atë, në kushtet e parashikuara në nenet 161 dhe 162 të KPC-s.

65. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se, çështja e parë, me paditës E.Sh. etj., gjendet për shqyrtim para Gjykatës së Lartë.

66. Duke pasur parasysh konkluzionet e Vendimit Unifikues nr. 2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara, se çështja merr statusin gjë e gjykuar, pasi të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë, Kolegji vlerëson se, gjykata që po shqyrton mosmarrëveshjen e dytë me paditës S.M., nuk gjendet para pengesës procedurale të gjësë së gjykuar, por para situatës së gjyqvarësisë (litispendencës), sipas nenit 58 të KPC-s.

67. Në këtë linjë arsyetimi para Kolegjit u shtrua për diskutim çështja nëse neni 58 i KPC-s gjen zbatim për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në gjykatat e të njëjtit nivel apo edhe në shkallë të ndryshme të gjykimit.

68. Kolegji risjell edhe një herë në vëmendje *ration* e nenit 58 të KPC-s dhe të institutit të gjyqvarësisë, si një ndalesë ligjore e zhvillimit të proceseve gjyqësore paralele dhe të njëjta njëkohësisht, përmes së cilës ligjvënësi synon të garantojë në qarkullimin civil parimin e sigurisë juridike të të drejtave dhe detyrimeve.

69. Litispendenca apo gjyqvarësia lind në momentin që paraqitet padia në gjykatë në mënyrë të vlefshme, padi e cila është e pranueshme për gjykim dhe që prodhon proces gjyqësor në kushtet e vlefshme të procedueshmërisë, sipas nenit 153 të KPC-s. Si e tillë ajo zgjat për sa kohë zgjat vetë procesi gjyqësor. Ky i fundit nuk përfundon me vendimmarrjen përfundimtare apo jopërfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, pasi neni 43 i Kushtetutës dhe neni 442/a dhe 443 i KPC-s kanë ofruar në disponibilitetin e palëve ndërgjyqëse mjete të zakonshme ankimi. Mjetet e zakonshme të ankimit, konkretisht apeli dhe rekursi, synojnë dhe kanë aftësinë që të parandalojnë marrjen e cilësisë të gjësë së gjykuar (*res judicata*) të vendimit gjyqësor mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt konflikti gjyqësor. Për rrjedhojë konkludohet natyrshëm se, për sa kohë ekzistojnë në ligj mjetet e zakonshme të ankimit dhe ato mund të ushtrohen apo janë ushtruar, gjendja juridike e litispendencës e krijuar me paraqitjen e padisë në gjykatë do të ekzistojë aktive.

70. Ky institut procedural, nëpërmjet garantimit të pavarësisë së brendshme gjyqësore, mbron edhe parimin e gjyqtarit natyral të çështjes

dhe e ruan këtë figurë në çdo fazë dhe shkallë gjykimi. Si e tillë, nuk mund të pretendohet se kjo gjendje apo këto parime mbrohen vetëm në shkallën e parë të gjykimit. Përkundrazi, këto parime dhe ky rregull zbatohen në mënyrë identike në çdo fazë dhe shkallë gjykimi.

71. Sa më sipër, në rastin konkret, Kolegji konkludon se gjykata e shkallës së parë, para se të merrte në shqyrtim kërkesën për sigurimin e padisë, duhet të verifikonte pretendimin e palës së paditur mbi gjënë e gjykuar, nëse mosmarrëveshja e parë kishte përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjë e gjykuar apo nëse ishte në situatën e gjyqvarësisë. Me verifikimin e këtij parakushti për vlefshmërinë e procesit gjyqësor, duhet të vendoste pushimin e gjykimit. Në të njëjtën mënyrë, edhe gjykata e apelit, gabimisht ka vlerësuar se ky element verifikohet në përfundim të gjykimit, duke lënë në fuqi vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë, mbi sigurimin e padisë.

72. Sikurse rezultoi nga verifikimi i Kolegjit, nëpërmjet sekretarisë gjyqësore, tashmë gjykimi në shkallë të parë i mosmarrëveshjes ka vijuar dhe ka konkluduar me vendim përfundimtar të gjykatës, ku është vendosur rrëzimi i padisë, për shkakun se çështja përbën gjë të gjykuar. Gjykata e shkallës së parë, ka disponuar edhe për heqjen e masës së sigurimit të padisë, ndërkohë që ky vendim, sipas nenit 211 të KPC-s, sjell efektet pasi të marrë formë të prerë. Mbi ankimin e ushtruar ndaj tij, tashmë shqyrtimi i mosmarrëveshjes gjendet në Gjykatën e Apelit Durrës.

73. Kolegji vlerëson se në kushtet kur objekt rekursi është vetëm vendimi i ndërmjetëm i gjykatës së shkallës së parë mbi sigurimin e padisë, nuk mund të disponohet me vendim jo përfundimtar mbi çështjen e themelit, duke prishur edhe vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, sepse kjo detyrë, sipas parimit të respektimit të shkallëve të pushtetit gjyqësor, i mbetet Gjykatës së Apelit Durrës, si gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen, në bazë të nenit 466/c të KPC-s.

C. Në lidhje me mënyrën se si duhet të disponojë Kolegji.

74. Në këtë rast, objekt rekursi është një ankim i veçantë mbi një vendim të ndërmjetëm të gjykatave më të ulëta, me të cilin është vendosur në lidhje me kërkesën e paditësit për sigurimin e padisë.

75. Tashmë në praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë (Kolegjit Civil dhe Kolegjit Administrativ) është mbajtur qëndrimi se ankimet e veçanta që shqyrtohen sipas nenit 470 të KPC-s, ndjekin një regjim të posaçëm mbi ritin e gjykimit, kohën e shqyrtimit të tyre dhe për mënyrën e disponimit nga Gjykata e Lartë *(shih, Vendimin nr. 00-2021-16, datë 08.01.2021 dhe Vendimin nr. 00-2021-15 (4), datë 18.01.2021 të Kolegjit Administrativ*

të Gjykatës së Lartë, si dhe Vendimin nr. 00-2020- 728, datë 26.11.2020, Vendimin nr.00-2020-704, datë 26.11.2020, Vendimin nr. 00-2020- 696, datë 25.11.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.).

76. Në këto vendime të Gjykatës së Lartë janë marrë në analizë risitë që sollën ndryshimet e vitit 2017 në KPC, për sa i përket ritit të gjykimit rishikues në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë, mbi gjykimin e ankimeve të veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetme.

77. Para datës 05.11.2017, ligji procedural nuk parashikonte rit të posaçëm gjykimi për ankimet e veçanta në gjykimin rishikues. Me ndryshimet ligjore procedurale që hynë në fuqi në këtë datë, u parashikua se të gjitha vendimet e ndërmjetme, të cilat ankimohen sipas ligjit në mënyrë të veçantë do të shqyrtohen nga ana e gjykatës më të lartë me juridiksion rishikues, sipas ritit të gjykimit kameral dhe se gjykimi duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë. Ky ndryshim u shoqërua edhe me ndryshimin e nenit 448 të KPC-s, në të cilin u ndalua gjykata rishikuese të bashkojë ankimet e llojeve të ndryshme, të ushtruara nga palët mbi të njëjtin gjykim apo vendim.

78. Më tej, me këtë qëllim, u prezantua për herë të parë në ligjin procedural civil edhe një normë e posaçme për gjykimin kameral në gjykatën e apelit, konkretisht neni 465/a i KPC-s. Qëllimi i ligjvënësit është që të diferencojë ritmin e gjykimit të ankimeve të veçanta nga ritmi i gjykimit të ankimeve të zakonshme. Sigurisht që *ratio* e këtij ndryshimi ligjor procedural është garantimi i efektivitetit të ankimit të veçantë dhe njëkohësisht edhe ekonomizimi i afateve të gjykimeve të ndërmjetme, të cilat janë mekanizmat proceduralë që ndikojnë thelbësisht edhe në mbarëvajtjen e gjykimit të zakonshëm.

79. Kjo do të thotë se në çdo rast gjykimi kameral i ankimeve të veçanta në gjykatën më të lartë nuk mund të njësohet me gjykimin e zakonshëm të ankimeve dhe se këto dy gjykime të posaçme zhvillohen sipas regjimeve të ndryshme juridike, me qëllim garantimin e efektivitetit, sipas karakteristikave të këtyre mjeteve procedurale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për çështjet që shqyrtohen sipas nenit 470 të KPC-s, nuk mund të gjejnë zbatim rregullat e zakonshme mbi shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, edhe kur janë të papajtueshme me këtë procedurë gjykimi.

80. Në këtë kuptim, shqyrtimi në Gjykatën e Lartë i rekurseve të veçanta, njëlloj sikurse edhe shqyrtimi i apeleve të veçanta në gjykatën e apelit, duhet të pasohet nga zgjidhja përfundimtare e kontestit të palëve mbi ligjshmërinë e vendimit të ndërmjetëm të ankimuar. Për rrjedhojë, do të ishte e papajtueshme edhe me qëllimin që kanë ndryshimet ligjore të vitit 2017, që gjykata rishikuese të mos e zgjidhte në mënyrë përfundimtare

ankimin e veçantë. Kjo zgjidhje nuk do të justifikohej nga nevoja që paraqet gjykimi i themelit për të pasur ecuri dhe mbarëvajtje të pandërprerë dhe të sigurt dhe as nga nevoja e garantimit të efektivitetit të mjeteve të posaçme të ankimit, sipas nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-s.

81. Mbi këtë analizë juridike, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se rregullat e disponimit të gjykatës rishikuese mbi vendimet e ndërmjetme, të cilat ankimohen me ankime të veçanta, sipas nenit 470 të KPC-s, janë të ndryshme nga rregullat që regjojnë disponimet e gjykatës rishikuese ndaj vendimeve përfundimtare, objekt ankimi, respektivisht sipas nenit 466, 480 dhe 485 të KPC-s. Këto dispozita do të zbatohen për aq kohë sa pajtohen me gjykimin e posaçëm të ankimeve të veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetme. Ligjvënësi ka parashikuar se brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatën rishikuese do të duhet që ankimi i veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të marrë një zgjidhje, me qëllim që të garantohet mbarëvajtja e procesit gjyqësor kryesor dhe se kjo mbarëvajtje mund të garantohet vetëm duke kuptuar se vendimi i ndërmjetëm, objekt ankimi, në çdo rast do të duhet të marrë një përgjigje përfundimtare, në mënyrë që kjo çështje të jetë e zgjidhur juridikisht.

82. Në këtë kuadër Kolegji sjell në vëmendje një praktikë edhe më të hershme të Gjykatës së Lartë, kur është konkluduar se për vendimet e ndërmjetme objekt rekursi, nuk zbatohen rregullat e përgjithshme në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, për shkak se ato kanë karakter urgjent dhe do të duhet të gjykohen me shpejtësi. Këto vendime nuk mund të prishen dhe të kthehen për rigjykim, sipas nenit 467 të KPC-s, por për to duhet të konkludohet përfundimisht nga Gjykata e Lartë.

82.1. Konkretisht, me vendimin nr. 00-2006-363 (849), datë 29.06.2006, në lidhje me rekursin ndaj vendimit të ndërmjetëm për masën e sigurimit të padisë, Kolegji Civil është shprehur ndër të tjera se:

"Gjykimi për sigurimin e padisë është një gjykim i veçantë që lidhet me garantimin e të drejtave të kërkuesit, të cilat do të bëheshin të pamundura, ose të vështira për t'u ekzekutuar në rastin kur atij do i pranohej padia. Ky gjykim kërkon shpejtësi për të parandaluar pasoja të cilat do ishin të pariparueshme, ose që kërkojnë më shumë kohë dhe kontribut për riparimin e tyre në qoftë se përgjigja apo vendimmarrja gjyqësore nuk do ishte në kohën e duhur. Jo pa qëllim ligjvënësi lejon sigurimin e padisë edhe përpara se të ngrihet ajo, neni 204 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykata e apelit ka qenë përpara rastit tipik që të shprehej për pranimin ose jo të masës provizore të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe jo të kthente aktet për rigjykim asaj gjykate. Kjo mënyrë gjykimi e kërkesës për sigurimin e padisë nuk i përgjigjet aspak kuptimit të dispozitave të kreut

IV të Kodit të ProcedurësCivile dhe e zvarrit gjykimin në kohë, duke e bërë të paefektshme vetë masën e sigurimit.”.

83. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, me vendimin e ndërmjetëm të marrë nga gjykata e shkallës së parë, lënë në fuqi nga gjykata e apelit, është vendosur sigurimi i padisë në kundërshtim me ligjin, pasi është siguruar një padi që nuk mund të ngrihet, për shkak të pengesës procedurale të gjyqvarësisë. Si rrjedhojë, zgjidhja e çështjes përfundimisht nga Gjykata e Lartë, që përputhet edhe me interesin e palës së paditur për të bërë rekurs, do të ishte ndryshimi i vendimeve dhe anulimi i masës së sigurimit të padisë.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-597, datë 04.03.2021

Nëse objekti i padisë është marrëdhënia juridike administrative e krijuar ndërmjet subjekteve të së drejtës, atëherë edhe kompetenca lëndore për gjykimin e asaj çështjeje, qoftë padi njohje, detyrimi apo transformuese, është e gjykatës administrative.

Paditë e ngritura në kushtet ku organi publik nuk vepron, ndërkohë që e ka për detyrë të veprojë, duhet të konsiderohen si lëndë e gjykimit administrativ.

Në këtë kuptim, paditë e ngritura sipas nenit 32/b dhe 32/c të KPC-s, që u kundrejtohen organeve të administratës së sigurimeve shoqërore, me qëllim njohjen e së drejtës së pensionit, kriteri i përbashkët në përcaktimin e kompetencës lëndore është kriteri i çështjes së ndërmjetme apo paragjykimore, në raport me çështjen themelore.

I. Rrethanat e çështjes:

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se, paditësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me padi. Me qëllim përfitimin e pensionit të pleqërisë, paditësja ka kërkuar të rregullojë pasaktësitë që rezultojnë në dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen vitet e punës. Ajo ka pretenduar se regjistrat themeltarë të Ndërmarrjes Bujqësore “Çlirim” nuk pasqyrojnë vjetërsinë e plotë në punë të paditëses, për shkak të pasaktësive në gjeneralitetet e saj, emër, mbiemër, etj.,.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e ndërmjetëm nr. 62-2021-616 (194), datë 03.02.2021 ka vendosur: “*1. Të shpallë moskompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes civile nr. Regj., 21266-01546-62-2020 (1547/368) regjistri, datë 16.09.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me palë paditëse H.K., me palë të paditur DRSSH, me objekt: Njohjen e pavërtetësisë së dokumentit zyrtar, regjistër themeltar, nr. 8, faqe 32, të ish-Kooperativës Bujqësore, Konispol, Fshati Konispol, përsa u përket të dhënave të identitetit nga i pavërteti H.K. pa vitlindje, në të vërtetin H.K., i vitlindjes 11.02.1959, me pasoja juridike për paditësen…; 2. T’i dërgojë aktet…në gjykatën kompetente, e cila është Gjykata Administrative e*

Shkallës së Parë Vlorë.”.

2.1. Gjykata e ka mbështetur vendimin në një praktikë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (vendim nr. 00-2020-172, datë 06.07.2020, etj.,), në raste të ngjashme, ku është arsyetuar se në rastin konkret, paditësja nuk ka kërkuar vërtetimin e faktit juridik, por i është drejtuar gjykatës, si rrjedhojë e mosveprimit të palës së paditur, organ i administratës publike, për të njohur vërtetësinë e të dhënave të pretenduara prej saj. Si rrjedhojë, paditësja i është drejtuar gjykatës për korrigjimin e dokumenteve objekt gjykimi, me qëllim përdorimin e tyre, pranë institucioneve shtetërore.

3. Kundër këtij vendimi, më datë 22.02.2021 ka ushtruar ankim të veçantë pala paditëse, duke parashtruar se: Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit; Duke u bazuar tek objekti dhe shkaku i padisë, mosmarrëveshja është me natyrë civile dhe jo administrative; Vendimi nr. 567, datë 12.10.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është njësues i praktikës gjyqësore; Nga ana tjetër, rasti i referuar në vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka pasur për objekt kontrolli pavërtetësinë e aktit administrativ. Ndërkohë, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me një akt administrativ të mirëfilltë, por me dokumente të lëshuara nga organe të sigurimeve shoqërore. Nëpërmjet këtyre dokumenteve nuk ka shprehje të vullnetit të organit administrativ; Dokumentet që pasqyrojnë vjetërsinë në punë, sikurse janë regjistri themeltar, listë-pagesat dhe libreza e punës, u kanë kaluar sigurimeve shoqërore në ruajtje dhe administrim, për shkak të qëllimit që ato përmbushin, por nuk janë hartuar prej këtyre organeve. Ato nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë tek këto dokumente. Rregullimi i pasaktësive të këtyre dokumenteve bëhet në rrugë gjyqësore, sipas neneve 388/c dhe 32/c të KPC-s; Padi të tilla janë në kompetencë të gjykatave administrative vetëm nëse kërkohet të korrigjohet një dokument, i cili është lëshuar nga organi administrativ që thirret si palë e paditur.

4. Rezulton se vendimi i arsyetuar i është komunikuar palës paditëse më datë 15.02.2021.

I. Vlerësimi i Kolegjit Civil

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë, çmon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është i bazuar në ligj dhe duhet të lihet në fuqi. Kolegji vlerëson se kjo gjykatë ka kualifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes dhe ka individualizuar drejt gjykatën kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e saj.

6. Nisur nga natyra juridike e padisë që në rastin konkret ka investuar gjykatën, Kolegji çmon të rëndësishme të evidentojë se, praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, në çështje të ngjashme, nuk ka qenë koherente. Në vendime të ndryshme të Kolegjit Civil dhe Administrativ që kanë shqyrtuar mosmarrëveshjet midis individit dhe organit publik, në fushën e sigurimeve shoqërore, lidhur me paditë e njohjes apo të pavërtetësisë së dokumentit, sipas nenit 32, shkronja b) dhe c) të Kodit të Procedurës Civile (në vijim, KPC), janë elaboruar kritere jo të njëjta që nuk kanë ndihmuar gjykatat në individualizimin, rast pas rasti, të kompetencës lëndore.

7. Në disa vendime të Gjykatës së Lartë, duke u bazuar te një kriter i thjeshtë formal ligjor, është mbajtur qëndrimi se paditë e ngritura sipas nenit 32/b apo 32/c të KPC-s, në çdo rast, do të shqyrtohen nga gjykatat me juridiksion të zakonshëm, për arsye se neni 7 dhe 17 i Ligjit nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve Administrative*” (në vijim Ligji nr. 49/2012), nuk ka përfshirë shqyrtimin e tyre në kompetencën lëndore të gjykatave administrative me juridiksion të posaçëm (*shih, vendimi nr. 00-2019-36, datë 31.01.2019; vendim nr. 00-2018-1095, datë 27.11.2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë,etj.,.*). Në këto qëndrime të mbajtura nga Gjykata e Lartë është argumentuar se neni 7 i Ligjit nr. 49/2012 përmban një listë shteruese të mosmarrëveshjeve që mund të gjykojnë gjykatat administrative dhe, për rrjedhojë, të gjitha çështjet e tjera që nuk përfshihen në të, i përkasin kompetencës lëndore të gjykatave civile me juridiksion të zakonshëm.

8. Në disa vendime të tjera, duke iu referuar një kriteri substancial dhe derivativ, padi të tilla janë kualifikuar si çështje të ndërmjetme dhe me natyrë paragjykimore të mosmarrëveshjeve administrative në fushën e sigurimeve shoqërore. Si rrjedhojë, është mbajtur qëndrimi se neni 32 i KPC-s dhe nenet 7 dhe 17 të Ligjit nr. 49/2012 nuk janë dispozita përjashtuese, por komplementare të njëra-tjetrës dhe që së bashku parashikojnë aftësitë e subjekteve të së drejtës për të ushtruar të drejtën e padisë, në varësi të cenimit të së drejtës subjektive, objekt gjykimi (*shih,vendim* nr. *00-2019-33, datë 31.01.2019; vendim nr. 00-2018- 1231, datë 27.12.2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, etj.,.).*

9. Sipas një praktike tjetër gjyqësore, si kriter ndarës për kompetencën lëndore, në raste të tilla kanë shërbyer elementë sasiorë dhe cilësorë në përmbajtjen e dokumenteve të kundërshtuara apo të fakteve juridike, të cilat kërkohen të provohen gjyqësisht. Në vendime të tilla, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se, nëse dokumentacioni që pasqyron faktin juridik (p.sh., vitet e punës), me pasoja për kërkuesin, mungon plotësisht, nëpërmjet

padisë së njohjes kundrejt organit publik synohet vërtetimi i këtij fakti, nga i cili lind e drejta subjektive e pretenduar (e drejta e pensionit). Duke e kualifikuar në thelb si një gjykim mbi vërtetimin e faktit, sipas nenit 388 të KPC-s, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se padi të tilla të ngritura sipas nenit 32/b të KPC-s janë me natyrë civile. *(shih,vendim nr. 00-2020-975, datë 14.12.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, etj.,.*).

10. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, sipas këtij kriteri, ka vlerësuar se nëse ekziston dokumentacioni që pasqyron faktin juridik me pasoja për paditësin, por ka pasaktësi apo vërtetësia e të cilit nuk njihet nga organi publik, padia e ngritur sipas nenit 32/c nga subjekti që pretendon njohjen e së drejtës së pensionit, ka si shkak mosveprimin e organit publik dhe, për këtë arsye, ka lindur nevoja e korrigjimit të gabimit të pasqyruar në aktin administrativ. Si rrjedhojë, në raste të tilla, është mbajtur qëndrimi se kompetente për këto mosmarrëveshje janë gjykatat administrative (*shih,vendim nr. 00-2020-797, datë 16.11.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, etj.,.*).

11. Në vijim të kësaj analize, Kolegji vlerëson së është momenti për individualizimin e një kriteri të përbashkët dhe të njëjtë në çështje të tilla, që do u shërbejë gjykatave më të ulëta *pro futuro* për të zgjidhur çështjen e kompetencës lëndore, rast pas rasti. Kolegji vlerëson me rëndësi koherencën në praktikën gjyqësore, si mjet që garanton sigurinë juridike dhe përfundimin e gjykimeve brenda një afati të arsyeshëm. Praktika e njëjtë gjyqësore e Gjykatës së Lartë merr një rëndësi të veçantë në zgjidhjen e çështjeve të kompetencës dhe interpretimin e ligjit procedural relevant, pasi gjykimet nuk mund të zvarriten, për shkak se gjykatat që shqyrtojnë konflikte gjyqësore të tilla, janë të paqarta dhe të paorientuara mbi rolin që ka gjyqtari që shqyrton çështjen.

12. Për të konkluduar mbi një kriter të qartë dhe të përbashkët për ndarjen e kompetencës në mosmarrëveshje të ngjashme, Kolegji vlerëson të marrë në analizë fillimisht natyrën juridike dhe llojet e padive, sipas nenit 32 të KPC-s, dallimin midis tyre dhe raportin juridik që krijojnë me njëratjetrën, gjykimet e iniciuara nga padi të tilla.

13. Në nenin 32 të KPC-s parashikohet: "*Padia mund të ngrihet: a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur; b) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte; c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin*.".

14. Kolegji vlerëson se kjo është një dispozitë kuadër dhe e përgjithshme, e cila kategorizon proceduralisht llojet e padive. Në doktrinën juridike dhe në jurisprudencën gjyqësore paditë, sipas kësaj dispozite, janë kategorizuar në dy lloje: 1) padi detyrimi (*formulae praeiudiciales);* 2) padi njohjeje apo

deklarative. Paditë e detyrimit, të ngritura sipas nenit 32/a të KPC-s, janë mjete me të cilat paditësi investon gjykatën për të kërkuar rivendosjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm të cenuar. Padi të tilla kanë për qëllim të provokojnë nxjerrjen e një vendimi gjyqësor detyrues në përfundim të gjykimit (*kondemnator*), në kuptim të nenit 510/a të KPC-s. Nga ana tjetër, paditë e njohjes apo me natyrë deklarative sipas shkronjës b) dhe c) të nenit 32 të KPC-s, të njohura ndryshe si padi provokatore, nuk shoqërohen në kërkim edhe me detyrimin e të padituri për kryerjen e një veprimi të caktuar. Padi të tilla sigurojnë bazën për një padi detyrimi në të ardhmen (*formulae praeiudiciales*) dhe kanë natyrën e çështjeve paragjykimore në raport me paditë e detyrimit.

15. Arsyeja e mjaftueshme për ngritjen e padisë deklarative është pikëpamja e kundërt e palëve lidhur me llojin apo përmbajtjen e të drejtës subjektive, vërtetësisë, pavërtetësisë së një dokumenti apo të një marrëdhënieje juridiko-civile. Ndërhyrja e gjykatës me këtë lloj padie kërkohet para se të bëhet shkelja e normës juridike në të cilën bazohet e drejta subjektive e paditësit. Rëndësia parandaluese e kësaj padie qëndron në faktin se kontribuon në shmangien e shkeljeve të të drejtave që mund të bëhen në të ardhmen. E drejta për të kërkuar mbrojtje juridike deklarative është thjesht e natyrës procedurale dhe autonome, sepse nuk mbështetet në kurrfarë autorizimi nga e drejta materiale.

16. Në veçanti, padia e ngritur sipas nenit 32/c të KPC-s, përfaqëson instrumentin e kontrollit të vërtetësisë së një dokumenti. Ashtu sikundër edhe verifikimi i origjinalitetit të dokumentit apo goditja e shkresës për falsitet, një pretendim i tillë mund të realizohet nëpërmjet një gjykimi principal (themeli) sipas kësaj dispozite ose nëpërmjet gjykimit incidental (paragjykimor), të investuar nga një padi detyrimi, sipas nenit 32/a të KPC-s apo edhe padi njohjeje, sipas nenit 32/b të KPC-s, ku çështja e origjinalitetit, falsitetit apo vërtetësisë së dokumentit shtrohet për zgjidhje, jo më si qëllim në vetvete, por si mjet për të arritur zgjidhjen e çështjes kryesore.

17. Si gjykimi principal, ashtu edhe gjykimi incidental, mbi vërtetësinë e dokumentit ka si qëllim që t'i zhveshë ose t'i njohë vlerën provuese, në mënyrë që ai të administrohet ose jo si provë në atë proces, ose në një proces tjetër gjyqësor apo administrativ. Në të dyja rastet, krijohet një raport i ndërmjetëm midis gjykimit mbi vërtetësinë e dokumentit dhe gjykimit meritor apo procedimit administrativ, para të cilit do të duhet të paraqitet dokumenti, ku e para është çështje e ndërmjetme e së dytës.

18. Sipas parimit të disponibilitetit maksimal të padisë dhe të të drejtave subjektive, pala e interesuar mund të përzgjedhë të ngrejë padinë, sipas nenit 32, shkronja b) ose c), e cila është provokatore dhe mund të jetë

bazë për ngritjen e padisë së themelit në të ardhmen ose mund të ngrejë menjëherë padinë e themelit, ku pretendimi për njohjen e së drejtës, për vërtetësinë ose pavërtetësinë e dokumentit është pjesë e shkakut të padisë dhe do të gjykohet në formë paragjykimore nga gjykata që gjykon themelin e mosmarrëveshjes. Në çdo rast, të dyja llojet e padive, do të duhet të gjykohen nga e njëjta gjykatë, pasi është e njëjta mosmarrëveshje, në lëndë dhe në lloj.

19. Kolegji sjell në vëmendje Ligjin nr. 49/2012, nenet 7 dhe 17 të tij, ku është përcaktuar, ndër të tjera se në kompetencë të gjykatave administrative janë ato mosmarrëveshje, që lindin nga akte administrative individuale të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të një organi publik; mosmarrëveshjet që lindin për shkak të mosveprimit të organit publik; mosmarrëveshjet që burojnë nga kontratat administrative,etj.,.

20. Kolegji thekson se për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative, bazuar në parashikimet e nenit 7 të Ligjit nr. 49/2012, duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore, të cilat kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet mes palëve buron nga një ligj i të drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (*shih, vendimi nr. 2, datë 10.03.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23*).

21. Kolegji vlerëson se neni 7 i Ligjit nr. 49/2012 nuk ka parashikuar në mënyrë shteruese çështjet që janë në kompetencë të gjykatave administrative. Kështu, Kolegji sjell në vëmendje kompetencën e gjykatave administrative për shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit apo padive të ngritura në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, kur titull ekzekutiv është një akt administrativ apo një vendim gjyqësor i gjykatave administrative. Në praktikën gjyqësore është arritur në konkluzionin se gjykatat administrative që janë kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve që burojnë nga aktet administrative janë kompetente edhe për shqyrtimin e kërkesave apo padive gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, si çështje të prejardhura nga mosmarrëveshjet administrative.

22. Ky konkluzion është arritur me interpretim gjyqësor nga Gjykata e Lartë kur ka zgjidhur mosmarrëveshjet e kompetencave midis gjykatave më të ulëta, duke bërë një interpretim teleologjik dhe sistematik të dispozitave të Ligjit nr. 49/2012, pasi në lidhje me këto çështje duket se ometon neni 7 i këtij ligji.

23. Pra, në raste të tilla, Gjykata e Lartë ka cilësuar si kriter ndarës të kompetencës, kriterin e çështjeve të prejardhura, edhe për mosmarrëveshje që nuk janë përfshirë në mënyrë eksplicite në kompetencën e gjykatave administrative, sipas ligjit të posaçëm. Kjo do të thotë se neni 7 i Ligjit nr. 49/2012 parashikon një listë të hapur dhe përcakton kriteret orientuese që duhet të ketë parasysh gjykata për të identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, sipas shkakut dhe objektit të padisë.

24. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se neni 32 i KPC-s është një dispozitë kuadër dhe e përgjithshme, e cila kategorizon proceduralisht llojet e padive. Ky kategorizim juridik është i vlefshëm për të gjitha llojet e padive dhe nuk lidhet me natyrën e kompetencës lëndore të gjykatave, të cilat ato aktivizojnë. Kjo do të thotë se edhe gjykatat administrative edhe gjykatat civile mundet të gjykojnë padi detyrimi, padi njohjeje apo padi me objekt vërtetësinë apo jo të një dokumenti. Ajo ç'ka ndan dhe përcakton ligjërisht kompetencën lëndore të padive civile dhe administrative nuk është kategorizimi procedural i nenit 32 të KPC-s, por natyra juridike e kërkimeve të përfshira në të.Kjo dispozitë përbën burimin primar të së drejtës procedurale që rregullon në mënyrë të përgjithshme të drejtën e padisë dhe llojet e saj dhe gjen zbatim në mënyrë komplementare me çdo ligj që rregullon në mënyrë të posaçme të drejtën e padisë sipas marrëdhënies juridike konkrete.

25. Paditë e njohjes, sikurse parashikohen në nenin 32/b dhe 32/c të KPC-s, nuk mund të konkludohen se janë *apriori* lëndë gjykimi civil, vetëm se rregullohen nga KPC. Kolegji sjell në vëmendje se KPC është rregullim normativ komplementar i Ligjit nr. 49/2012, për sa kohë ky i fundit hesht apo ometon nga rregullimi ligjor eksplicit (shih nenin 1/2 të Ligjit nr. 49/2012).

26. Kolegji vlerëson se gjykatat, rast pas rasti, për të vlerësuar nëse një padi e ngritur sipas nenit 32/b apo 32/c të KPC-s është në kompetencën lëndore të gjykatës civile apo administrative duhet të shqyrtojnë dhe të konkludojnë drejt mbi kriterin objektiv dhe material, që do të thotë mbi natyrën juridike të marrëdhënies juridike të palëve, e cila ka ardhur në gjykatë si kontest gjyqësor. Gjykatat do të duhet të individualizojnë se cili është qëllimi dhe interesi i paditësit në ngritjen e padisë; shkaku që ka provokuar ngritjen e saj; kujt i kundrejtohet ajo; me çfarë lloj gjykimi apo procedimi krijon raportin paragjykimor apo të ndërmjetëm, gjykimi i investuar nga një padi e tillë.

27. Për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshjeje, nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin *prima facie* të padisë. Ato

duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të padisë, të të drejtës subjektive të pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes.

28. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji vlerëson se në rastet kur paditë e pavërtetësisë së një dokumenti i kundrejtohen një organi publik, në ushtrim të veprimtarisë së tij publike, sikurse janë në veçanti, paditë që burojnë nga mosmarrëveshjet në fushën e sigurimeve shoqërore, për njohjen e së drejtës së pensionit, kanë si qëllim detyrimin e organit publik të njohë ose jo vlerën provuese të një dokumenti, në mënyrë që ky i fundit të përdoret ose jo si provë në procedurën administrative.

29. Kolegji vlerëson se padi të tilla kanë si shkak dhe janë të provokuara përgjithësisht në praktikë nga një sjellje neglizhente apo nga një mosveprim i organeve të administratës publike, të cilat nuk përmbushin detyrimet ligjore që kërkon hetimi administrativ. Kjo mund të ndodhë herë për shkak të mungesës së kujdesit të duhur dhe herë për shkak të keqkuptimit mbi funksionin, të drejtat dhe detyrimet që këto organe kanë në procedimin administrativ.

30. Për të konkluduar mbi pozitën juridike, të drejtat dhe detyrimet e organit publik dhe palës në procedimin administrativ, edhe në fushën e sigurimeve shoqërore, Kolegji vlerëson të ndalet në analizën e dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative (në vijim, KPA). Kolegji vlerëson se KPA është ligj i rëndësishëm që rregullon veprimtarinë e administratës publike dhe që zbatohet, përsa kohë ligji i posaçëm në fushën e sigurimeve shoqërore nuk bën një rregullim të ndryshëm.

31. Me qëllim verifikimin e pretendimit të palës kërkuese gjatë një procedure administrative, organi publik ka detyrimin ligjor të realizojë hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në ligj, organi publik është i detyruar të shprehet me vendim përfundimtar (*shih, neni 90 i KPA-s*), duke nxjerrë aktin administrativ që refuzon ose pranon kërkesën e palës për njohjen e së drejtës subjektive të pretenduar prej saj, pasi ka analizuar dhe vlerësuar në tërësi të gjitha faktet dhe provat e administruara me iniciativë të palës ose edhe kryesisht prej tij.

32. Në parim, organet publike në përgjithësi dhe organet kompetente në fushën e sigurimeve shoqërore në veçanti, nuk legjitimohen të pezullojnë procedimin administrativ dhe të orientojnë palët t'i drejtohen gjykatës sa herë kanë paqartësi mbi provat apo dokumentet e paraqitura prej tyre. Një ndër parimet bazë të procedimit administrativ është parimi i eficiencës dhe

deburokratizimit, që nënkupton zhvillimin dhe përfundimin e procedimit administrativ sa më shpejttë jetë e mundur, brenda afateve të përcaktuara në ligj, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm (neni 18 i KPA-s).

33. Sipas nenit 66 të KPA-s, organi publik mund të pezullojë procedimin administrativ vetëm në rastet kur lind nevoja për t'u shprehur në lidhje me një çështje të ndërmjetme, e cila kushtëzon marrjen e vendimit përfundimtar, nëse kjo përbën një çështje të pavarur ligjore, për të cilën është kompetent një organ tjetër, gjyqësor apo administrativ.

34. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje nenin 79/1 të KPA, i cili ka parashikuar se: "*Procedura hetimore zhvillohet nga organi publik, në kompetencën e të cilit është marrja e vendimit përfundimtar.*".

35. Bazuar në këto dispozita, Kolegji vlerëson se, hetimi, marrja e provave, mbledhja e fakteve dhe vlerësimi i tyre në tërësi, si çështje e ndërmjetme e procedimit administrativ, nga e cila varet zgjidhja e çështjes, nuk është kompetencë dhe tagër vetëm i pushtetit gjyqësor, por është detyrim primar dhe funksional i organit publik që do të vendosë mbi kërkesën e palës së interesuar në procedimin administrativ. Detyrimi për të shqyrtuar kërkesën dhe për t'u shprehur me vendim përfundimtar, nuk mund të kuptohet si një proces i shkëputur dhe i ndarë nga procesi i verifikimit të fakteve dhe provave, në themel të së drejtës subjektive të pretenduar nga pala e interesuar. Ky verifikim nuk mund të jetë i përciptë dhe mekanik, por duhet të jetë tërësor dhe i thelluar.

36. Kolegji sjell në vëmendje nenin 77 të KPA, ku është parashikuar se: "*Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes…Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrative, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij ose të organeve të tjera publike*".

37. Po ashtu, neni 80 i KPA ka parashikuar se: *"1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë; b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira. 2. Dispozitat e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.*

3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.”.

38. Ndërsa në nenin 81 të KPA thuhet se: “*Organi publik çmon sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të të gjitha provave së bashku, si dhe rezultatin tërësor të hetimit administrativ*.”.

39. Në analizë të këtyre dispozitave, Kolegji vlerëson se ligjvënësi e ka pajisur organin administrativ me të njëjtin kapacitet ligjor për të hetuar, sikurse organet gjyqësore. Ai ka të drejtën dhe detyrimin të pranojë dhe të marrë prova nga pala në procedurën administrative, sipas të gjitha burimeve të provës të lejuara edhe në gjykimin administrativ apo civil: dokumente, prova me dëshmitar, deklarata të palëve, ekspertime, etj.,. Neni 80/2 i KPA-s referon tek Ligji nr. 49/2012 për provat dhe mjetet e provës të lejuara në procedurën administrative dhe si rrjedhojë, në mënyrë komplementare, edhe në dispozitat e KPC-s mbi burimet e provës për aq sa është e mundur.

40. Në përfundim të hetimit, organi publik duhet të bëjë një analizë tërësore të fakteve dhe provave, bazuar në arsyetime dhe deduksione sipas rregullave të logjikës formale, cilësi që nuk mund të kuptohen se janë ekskluzivitet vetëm i magjistratit, por edhe i nëpunësit publik.

41. Nëse një dokument i paraqitur nga pala në procedimin administrativ ku pasqyrohet fakti juridik i pretenduar prej tij, paraqet pasaktësi në përmbajtje, përsa u përket gjeneraliteteve të kërkuesit apo të dhënave të tjera, organi publik duhet të verifikojë burimin e kësaj pasaktësie, duke e ballafaquar me provat e tjera, me shpjegimet e palës, me informacione të marra nga Gjendja Civile apo subjekte të treta që administrojnë të dhënat përkatëse. Në këto raste, organi publik është i detyruar të verifikojë nëse pasaktësitë janë të natyrës materiale apo janë të tilla që rrëzojnë pretendimin e kërkuesit mbi ekzistencën e faktit të pasqyruar në të.

42. Nga ana tjetër, me përjashtim të rasteve kur një ligj i posaçëm parashikon ndryshe, sipas KPA, pala e interesuar mund të mos disponojë prova me shkresë apo dokumente dhe faktin e pretenduar ka të drejtë ta provojë me mjete të tjera prove, sikurse është prova me dëshmitar apo me deklarata noteriale të lëshuara prej tyre. Në mënyrë simetrike me hetimin gjyqësor, hetimi administrativ thjeshtëzohet edhe nga prezumimet ligjore apo faktet botërisht të njohura, të cilat nuk kanë nevojë të provohen.

43. Kolegji vlerëson se vetëm pas një hetimi të plotë dhe pas një analize tërësore të fakteve dhe provave të administruara, organi publik mund të krijojë bindjen, si rrjedhojë e një procesi të brendshëm intelektual, analitik, deduktiv-logjik dhe, në çdo rast, është i detyruar të pranojë ose të rrëzojë

kërkesën e palës me vendim përfundimtar.

44. Kolegji konstaton se në praktikë, në veçanti në marrëdhëniet e sigurimeve shoqërore, për organet publike kompetente, mjafton një pasaktësi në dokumentet e paraqitura nga pala e interesuar, qoftë kjo edhe dukshëm e natyrës materiale, për të pezulluar procedimin administrativ, duke e orientuar palën, të verifikojë vërtetësinë e dokumentit në rrugë gjyqësore.

45. Kolegji vlerëson se aksesi në gjykatë sipas nenit 32/c të KPC është mjet alternativ, e drejtë dhe garanci e palës së interesuar, por jo rrugë e detyrueshme për t’u ndjekur, kusht pa të cilin nuk mund të vijojë procedura administrative. Organet publike nuk mund të ometojnë në përmbushjen e detyrimeve të tyre në procedurën administrative, me arsyetimin se në çdo rast janë organet gjyqësore që garantojnë të drejtat subjektive të palëve në këtë procedurë. E drejta e palës për akses në gjykatë duhet të vlerësohet prej tyre si subsidiare, si mjet i fundit (*ultima ratio*), ku gjykata “*thotë fjalën e fundit*”. Garancinë primare për të drejtat kushtetuese dhe ligjore të individit, kur njohja e tyre varet nga shprehja e vullnetit administrativ, duhet ta ofrojë organi i administratës publike, i cili vepron sipas parimeve të ligjshmërisë, paanësisë, transparencës dhe procesit të rregullt ligjor.

46. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje se koncepti i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përfshin jo vetëm procedurat gjyqësore, por edhe ato administrative. Një garanci e tillë kushtetuese, e detajuar në ligj, mbetet iluzore nëse administrata publike i koncepton kompetencat që ka në lidhje me të drejtat kushtetuese dhe ligjore të individit, si të karakterit tërësisht formal dhe mekanik.

47. Duke analizuar detyrimet e organit publik dhe garancitë që i njihen palës në procedurën administrative, për t’u dëgjuar, për hetim të plotë dhe të gjithanshëm, për të marrë një përgjigje përfundimtare, qëllimi i ligjvënësit ka qenë që njohja e të drejtave subjektive nga pala e interesuar, të përmbyllet para organit administrativ, sipas parimit të deburokratizimit, eficiencës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligj. Nëse organet publike kuptojnë rolin e tyre dhe ushtrojnë pushtetin administrativ sipas ligjit dhe me përgjegjësi, nuk do të lindë nevoja për procese gjyqësore. Zvarritja e çështjeve administrative dhe adresimi i tyre në çdo rast para organeve gjyqësore, si qëllim në vetvete, shpesh herë mund të sjellë edhe humbjen e së drejtës subjektive apo cenimin e saj në thelb, sikurse mund të jetë e drejta e pensionit.

48. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje se më datë 23.12.2020, është miratuar Ligji nr. 169/2020 “*Për Njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-*

kooperativat bujqësore". Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 08.01.2021dhe ka hyrë në fuqi më datë 23.01.2021.56. Në këtë ligj është sanksionuar se fakti i qenies në punë në ish-kooperativat bujqësore nga krijimi deri në shpërbërjen e tyre, përfshihet në kategorinë e fakteve botërisht të njohura, për shkak të detyrimit të kujtdo për të punuar në atë periudhë, sipas legjislacionit të kohës. Në nenin 2 të këtij ligji thuhet:*"1. Njihet si periudhë e sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, nga mosha për punë në kooperativat bujqësore e përcaktuar në legjislacionin e kohës, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën"…".*

49. Kolegji vlerëson se, nëpërmjet këtij ligji, fakti juridik i viteve të punës në ish-kooperativat bujqësore, nga i cili varet e drejta e pensionit është ngritur në nivelin e një prezumimi dhe nuk ka nevojë të provohet, mjafton të provohet baza e prezumimit se: a) kërkuesi nuk ka vuajtur dënimin me heqje lirie në atë kohë; b) nuk ka përfituar nga sigurimet shoqërore, pension për invaliditet të plotë; c) ka qenë pjesëtar i kooperativës përkatëse.

50. Ndërhyrja e ligjvënësit ka si qëllim thjeshtëzimin e hetimit administrativ dhe shmangien e procedurave të panevojshme dhe të zgjatura gjyqësore për të vërtetuar fakte që nuk kanë nevojë të provohen dhe që mund të verifikohen lehtësisht nga organi administrativ. Miratimi i këtij ligji u imponua për shkak të praktikave abuzive të administratës publike në fushën e sigurimeve shoqërore, që në çdo rast të mungesës së dokumentacionit i adresonin subjektet që pretendonin të drejtën e pensionit të vërtetonin gjyqësisht faktin e vjetërsisë në punë në ish-kooperaivat bujqësore. Nga ana tjetër, proceset e gjata gjyqësore, në të gjithë shkallët e gjykimit dhe të pajustifikuara, për provueshmërinë e fakteve botërisht të njohura, rrezikonin humbjen në thelb të së drejtës së pensionit, si e drejtë themelore kushtetuese me rëndësi jetike për shtresa vulnerabël të shoqërisë.

51. Kolegji vlerëson se zvarritja e procedurave hetimore, administrative apo gjyqësore, në raste të tilla, nuk ka ardhur si rrjedhojë e ometimit legjislativ, por të moskuptimit si duhet të të drejtave dhe detyrimeve të organeve publike në marrëdhëniet juridike të sigurimeve shoqërore. Kolegji vlerëson se edhe në mungesë të këtij ligji, organet kompetente në fushën e sigurimeve shoqërore, në raste të tilla, e kanë pasur të drejtën dhe detyrimin të bënin një vlerësim të tillë të këtij fakti juridik, sipas parashikimeve të nenit 80/3 të KPA.

52. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji konkludon se, edhe në raste të tjera të ngjashme, që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Ligjit nr.169/2020, për të shmangur nevojën e ndërhyrjes me ligj nga pushteti ligjvënës, sa herë

që organet publike kanë të paqarta kompetencat e tyre, është e rëndësishme që këto të fundit të orientohen drejt interpretimit dhe zbatimit të ligjit, me diligjencë dhe përgjegjshmëri, duke e vlerësuar pushtetin e tyre publik administrativ, si garantin e parë të lirive dhe të drejtave të individit.

53. *Përsa i përket çështjes së kompetencës lëndore të gjykatave, në shqyrtimin e padive sipas nenit 32/b dhe 32/c të KPC, që u kundrejtohen organeve të administratës së sigurimeve shoqërore, me qëllim njohjen e së drejtës së pensionit, Kolegji konkludon se kriteri përbashkues që do u shërbejë gjykatave më të ulëta, për të individualizuar kompetencën lëndore, rast pas rasti, është kriteri i çështjes së ndërmjetme apo paragjykimore, në raport me çështjen themelore. Padi të tilla, duke qenë zgjatim i hetimit administrativ apo i paraprijnë atij, në kushtet ku organi publik nuk vepron, ndërkohë që e ka për detyrë të veprojë, do të duhet të konsiderohen si lëndë e gjykimit administrativ.*

54. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vlerëson se, paditësja ka ngritur padinë e pavërtetësisë së dokumenteve, ku pasqyrohet vjetërsia në punë e saj, pranë ish-Ndërmarrjes Bujqësore "Çlirim", Fier. Ajo ka kërkuar të rregullojë pasaktësitë që rezultojnë në dokumentacionin përkatës, përsa u përket gjeneraliteteve të saj, vendlindjes, kohës së largimit nga puna, etj.,. Ajo ka pretenduar se regjistrat themeltarë të Ndërmarrjes Bujqësore "Çlirim" nuk pasqyrojnë vjetërsinë e plotë në punë të paditëses, për shkak të këtyre pasaktësive.

55. Kolegji vlerëson se kjo është një padi e ngritur sipas nenit 32, shkronjës "b" dhe "c" të KPC-s. Konflikt,i në rastin konkret, buron nga pavërtetësia e dokumentave të pretenduara nga paditësi, në lidhje me vitet e punës, të cilat për këtë shkak nuk njihen nga pala e paditur për efekt të njohjes së të drejtës së pensionit. Kërkimet që lidhen me njohjen e marrëdhënies së punës për vitet e pretenduara nga paditësi janë pasojë e kërkimeve të para. Sipas analizës së mësipërme, *nëse objekti i padisë së njohjes është marrëdhënia juridike administrative e krijuar ndërmjet subjekteve të së drejtës atëherë edhe kompetenca lëndore për gjykimin e asaj çështjeje, qoftë padi njohje, detyrimi apo transformuese, është e gjykatës administrative.*

56. Sa më sipër, Kolegji konkludon se kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje është gjykata administrative.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1007, datë 21.06.2021

Mosgarantimi i së drejtës për t'u dëgjuar në një shkallë gjykimi, mund të përbëjë shkak për prishjen e vendimit, nëse ky element ka ndikuar në dhënien e vendimit. Por pala që është gjykuar në mungesë në një shkallë të gjykimit, nuk mund të pretendojë pavlefshmëri të gjykimit dhe të vendimit përfundimtar, nëse pretendimet që ngre në gjykimin rishikues për thelbin e mosmarrëveshjes janë marrë në shqyrtim nga gjykata më e ulët dhe rezultati final i procesit gjyqësor, edhe duke u dëgjuar formalisht kjo palë, do të ishte i njëjtë.

Parashkrimi fitues me titull mbulon çdo lloj pavlefshmërie, si atë relative ashtu edhe atë absolute, sepse ai përbën një mënyrë primare të fitimit të pronësisë me anë të posedimit dhe jo një mënyrë të prejardhur të fitimit të pronësisë. Në këtë kuptim elementi "veprim juridik për kalimin e pronësisë", është vetëm një konvencion që justifikon mirëbesimin e poseduesit dhe nuk do të thotë që ky titull duhet të jetë i perfeksionuar sipas të gjitha kushteve ligjore për vlefshmërinë e tij. Poseduesi do të konsiderohet se është në mirëbesim mjafton që si në ndërgjegjen e tij ashtu edhe për shkak të rrethanave, të besojë se e drejta i ka kaluar nga pronari.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se paditësit T.K. dhe L.Q. (në cilësinë kontraktore të blerësit), kanë lidhur kontratën e shitjes datë 05.02.1996, me Ndërmarrjen e Grumbullimit dhe Përpunimit të Drithit si dhe Degës së Agjencisë së Privatizimit Gjirokastër (në cilësinë kontraktore të shitësit), sipas autorizimit për blerje objekti nr. 12, datë 04.01.1996, për objektin "Depo Drithi nr. 3" plus shesh betoni sofratike", me sipërfaqe 813 m2.

2. Ky objekt i është dorëzuar paditësve, sipas aktit të dorëzimit, datë 31.01.1996, ku është përcaktuar edhe vlera e derdhur për objektin e blerë, të cilit i është bashkëngjitur edhe skica planimetrike e objektit dhe e truallit.

3. Së bashku me objektin, paditësve iu është dorëzuar edhe trualli nën objekt me sipërfaqe 813 m2 dhe për këtë është përpiluar formulari

për llogaritjen e vleftës së truallit, kategoria e zonës B, në vlerën 130.080 lekë. Sipas mandat arkëtimit nr. 0166579, datë 20.05.1996, paditësit kanë derdhur për llogari të Agjencisë së Privatizimit Gjirokastër në Degën e Thesarit Gjirokastër, vlerën e truallit të përcaktuar si më sipër, për blerjen e truallit, sipas formularit të plotësuar nga seksioni i financës pranë Ministrisë së Financave. Nga ana tjetër, ka rezultuar se midis palëve ndërgjyqëse nuk është lidhur kontrata e shitjes së truallit.

4. Sa më sipër, paditësit i janë drejtuar gjykatës me padi, me objekt njohje pronar mbi truallin si më sipër, në bazë të neneve 168 dhe 170 të KC-s, duke pretenduar se që prej 15 vitesh janë sjellë si pronar mbi truallin, me qëllim regjistrimin e truallit në emër të paditësve.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 973, datë 05.11.2012, ka vendosur: "*1. Pranimin e kërkesëpadisë; 2. Njohjen pronar të paditësve mbi një sipërfaqe trualli 813 m2, në fshatin Duvjan Gjirokastër, me kufizime: Veriu-rrugë e fshatit Dhuvjan, perëndimi-depo nr. 4, jugu-depo nr. 5, lindja-truall i lirë; 5. Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer.*".

5.1. Gjykata ka arsyetuar se në rastin konkret plotësohen kushtet për fitimin e pronësisë mbi truallin objekt gjykimi, sipas nenit 168 të KC-s. Pala paditëse e posedon sendin prej 15 vitesh, me mirëbesim, në bazë të një titulli për kalimin e pronësisë nga pala e paditur. Trualli në kohën e kryerjes së veprimit juridik, në vitin 1996 ishte në pronësi të palës së paditur. Kalimi i pronësisë tek paditësit në lidhje me objektin mbi truall, është bërë sipas kontratës së shitjes së objektit, aktit të dorëzimit, autorizimit për blerje objekti, vlerësimit të truallit, mandatit të arkëtimit për pagesën e vlerës së truallit, si dhe sipas ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura të privatizimit" si dhe VKM-s nr. 203, datë 03.05.1995.

6. Kundër Vendimit Nr. 973, datë 05.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar se: Paditësi nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie, pasi trualli është shtetëror dhe gjykata ka shkelur dhe keqinterpretuar ligjin, duke ndërhyrë në kompetenca dhe marrëdhënie që rregullohen me ligj dhe akt nënligjor; Nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është hetuar se në juridiksion dhe administrim të kujt është trualli nën objekt, pasi shitja e truallit të objekteve shtetërore në procedurë privatizimi bëhet në zbatim të VKM-s nr. 738, datë 09.09.2010; Gjykata nuk ka hetuar pranë ZVRPP Gjirokastër për statusin e truallit objekt gjykimi, në pronësi të kujt rezulton i regjistruar trualli.

7. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 177, datë 21.03.2013, ka

vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr. 973, datë 05.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.*".

7.1. Gjykata ka arsyetuar se, sikurse ka rezultuar gjatë gjykimit, trualli nën objektin e privatizuar, është poseduar qetësisht dhe pa ndërprerje nga paditësit, për një afat 15 vjet, të cilët janë sjellë si pronarë mbi të, pasi së bashku me objektin e privatizuar, iu është dorëzuar edhe trualli duke paguar edhe vleftën e tij pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit. Paditësit e kanë poseduar mbi bazën e një titulli për kalimin e pronësisë nga ana e palës së paditur, konkretisht mbi bazën e kontratës së shitjes së objektit mbi truall, mandat-arkëtimit për pagesën e vlerës së truallit, por edhe sipas Ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991 dhe VKM-s nr. 203, datë 03.05.1995. Sikurse ka rezultuar, prona objekt gjykimi nuk është pronë publike, që nuk mund të fitohet sipas nenit 168 të KC-s. Sa më sipër, nuk ka asnjë shkak që të bëjë të cenueshëm vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

8. Kundër Vendimit Nr. 973, datë 05.11.2012 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, më datë 30.04.2013 ka paraqitur rekurs, pala e paditur, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e padisë. Ka rezultuar se kjo palë është gjykuar në mungesë gjatë gjykimit në apel dhe vendimi gjyqësor i është komunikuar më datë 15.04.2013. [...]

9. Rezulton se me vendim të ndërmjetëm, datë 09.12.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, pasi ka vlerësuar pranueshmërinë e rekursit, sipas afatit (*ratione temporis)* dhe legjitimimit formal të palës rekursuese *(ratione personae*), ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Kolegji ka arsyetuar se rekursi i paraqitur nga pala e paditur, përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-s (*ratione materiae*).

10. Sipas relacionit bashkëlidhur vendimit, çështja që është ngritur për diskutim para Kolegjit, është nëse plotësohen kushtet ligjore për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues sipas nenit 168 të KC-s apo paditësit do të duhet të ngrinin padi të një lloji tjetër për fitimin e pronës.

11. Rezulton se çështja është rishortuar në vitin 2020 dhe gjyqtari relator ka planifikuar çështjen për gjykim në seancë gjyqësore më datë 21.06.2021. Nga sekretaria e gjykatës është realizuar njoftimi me shpallje më datë 02.06.2021.

12. Në seancën gjyqësore të datës 21.06.2021, para Gjykatës së Lartë, palët ndërgjyqëse janë gjykuar në mungesë, ndërkohë është paraqitur Avokatura e Shtetit. Nga njoftimi me shpallje, Avokatura e Shtetit ka marrë dijeni për procesin gjyqësor dhe është njohur paraprakisht me aktet e fashikullit të gjykimit. Në seancë gjyqësore Avokatura e Shtetit ka

paraqitur pretendimet e saj me shkrim, ku është argumentuar se: Avokatura e Shtetit nuk është njoftuar për të marrë pjesë në këtë proces gjyqësor, as në gjykimin në shkallë të parë dhe as në apel; Gjykatat më të ulëta nuk kanë garantuar kontradiktoritetin dhe të drejtën për t'u dëgjuar të Avokaturës së Shtetit, referuar pikës b, të nenit 5 të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" si dhe në bazë të nenit 79/a të KPC; [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

13. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se rekursi i palës së paditur nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim, KPC), të cilat bëjnë të cenueshme vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta.

14. Fillimisht Kolegji çmon të marrë në analizë pretendimet e Avokaturës së Shtetit për proces të parregullt, pasi nuk është njoftuar për të marrë pjesë në të dyja shkallët e gjykimit.

15. Kolegji çmon të theksojë se e drejta për akses në gjykatë, e drejta për t'u dëgjuar, parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit, sipas nenit 6 të KEDNJ-s dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë janë disa nga elementët thelbësorë për një proces të rregullt ligjor. Këto të drejta janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shiko, Vendimi nr. 39, datë 16.03.2017 i Gjykatës Kushtetuese*).

16. Aksesi në gjykatë dhe e drejta për t'u dëgjuar nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih, vendimi nr. 28, datë 15.3.2016 i Gjykatës Kushtetuese*). Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera.

17. Për rëndësinë që kanë tek drejtësia e vendimit gjyqësor, garancitë për proces të rregullt janë paraparë si një e drejtë themelore, konventore dhe kushtetuese. KPC, në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, ka parashikuar si parim të përgjithshëm se askush nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar dhe se gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi duhet të garantojë parimin e kontradiktoritetit (*shih, nenet 4, 18 dhe 20 të KPC*-s). Po ashtu,

mosrespektimi i të drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata më e ulët, është shkak për nulitetin e akteve të gjykimit dhe një nga shkaqet për të cilën gjykata më e lartë prish vendimin dhe e kthen çështjen për rigjykim (*shih, neni 467/ç i KPC-s*).

18. Por nga ana tjetër, Kolegji çmon të theksojë se garantimi i një procesi të rregullt ligjor nga gjykatat e të gjitha niveleve, nuk është qëllim në vetvete, por është një mjet që synon dhënien e një vendimi meritor të drejtë, të bazuar në fakte, prova dhe ligj (*shih, Vendimi nr. 14, datë 01.03.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Ai synon në thelb mbrojtjen e individit ndaj arbitraritetit dhe dhënien e një vendimi të drejtë, jo të njëanshëm, të bazuar mbi të vërtetën e marrëdhënies juridike objekt konflikti gjyqësor dhe në normën juridike që rregullon këtë marrëdhënie. Synimi kryesor i këtyre parimeve është realizimi i një debati real ndërmjet palëve ndërgjyqëse, çka ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi *(shih, vendimet e Gjykatës Kushtetuesenr.13, datë 21.07.2008; nr.19, datë 18.09.2008, nr. 10, datë 02.04.2009 nr. 23, datë 23.07.2009)*

19. Në këtë kuptim, Kolegji konkludon se e drejta për proces të rregullt ligjor, është e drejtë-garanci me natyrë procedurale, për ruajtjen e të drejtave subjektive materiale. Ajo nuk është një e drejtë abstrakte dhe formale, që qëndron e shkëputur nga përmbajtja. Për palën që pretendon një të drejtë subjektive apo interes të ligjshëm të shkelur, e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata, sipas parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, është mundësi që ajo të ndikojë tek rezultati final i procesit gjyqësor, që është vendimi përfundimtar i gjykatës.

20. GJEDNJ në praktikën e saj, ka elaboruar konceptin e procesit të rregullt substancial. Kontradiktoriteti dhe barazia e armëve në jurisprudencën e kësaj gjykate, është përkufizuar si mjet që secila palë të ketë mundësi të mbrohet dhe të ndikojë ligjërisht në përmbajtjen e vendimit gjyqësor (*shih gjithashtu, çështja "Nideröst-Huber v. Switzerland", Vendim i GJEDNJ-s, datë 18.02.1997, paragrafi 24 dhe çështja "K.S. v. Finland", Nr. 29346/95, paragrafi 21, Vendim i GJEDNJ-s, datë 31.05.2001*).

21. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se mosgarantimi i së drejtës për t'u dëgjuar në një shkallë gjykimi, mund të përbëjë shkak për prishjen e vendimit, nëse ky element ka ndikuar në dhënien e vendimit. Kolegji vlerëson se edhe pse nuk ka një parashikim eksplicit të tillë në nenin 467 të KPC-s, kjo dispozitë duhet interpretuar në mënyrë pajtuese me praktikën e GJEDNJ-s, në proporcion edhe me të drejtën për proces të rregullt të palës kundërshtare dhe përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Po ashtu, kjo dispozitë duhet zbatuar dhe interpretuar në harmoni me nenin 121 të KPC-s, i cili ka parashikuar se pavlefshmëria e një pjese të aktit nuk prek pjesët e tjera që janë të pavarura. E thënë ndryshe, pala që është gjykuar në mungesë në një shkallë të gjykimit, nuk mund të pretendojë pavlefshmëri të gjykimit dhe të vendimit përfundimtar, në kuptim të nenit 467 të KPC-s, nëse pretendimet që ngre në gjykimin rishikues, për thelbin e mosmarrëveshjes janë marrë në shqyrtim nga gjykata më e ulët dhe rezultati final i procesit gjyqësor, edhe duke u dëgjuar formalisht kjo palë, do të ishte i njëjtë.

22. Duke iu rikthyer rastit konkret, nga fashikulli i gjykimit, nuk rezulton të jetë njoftuar Avokatura e Shtetit, as në gjykimin në shkallë të parë dhe as në gjykimin në apel. Për herë të parë, ajo është paraqitur në Gjykatën e Lartë, ku i është dhënë mundësia të njihet edhe me aktet e fashikullit të gjykimit dhe të parashtrojë mbrojtjen e saj. Pretendimet që Avokatura e Shtetit ka ngritur mbi thelbin e mosmarrëveshjes, krahas pretendimeve për proces të parregullt, janë të njëjta me ato që ka paraqitur pala e paditur në të dyja shkallët e gjykimit dhe që janë marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta kur kanë vendosur mbi çështjen konkrete.

23. Kolegji vlerësoi se pretendimi i Avokaturës së Shtetit për prishjen e vendimeve dhe kthimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, është rrjedhojë e një interpretimi tejet formal të ligjit dhe po ashtu të Vendimit Unifikues nr. 13/2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Duke qenë se pretendimet e ngritura prej saj janë të njëjta me ato të paraqitura nga pala e paditur, së cilës ajo i bashkohet në proces, në të dyja shkallët e gjykimit dhe po ashtu në rekurs, Gjykata e Lartë, nuk ka pengesë për të ushtruar juridiksionin kontrollues dhe rishikues mbi to, duke e zgjidhur përfundimisht çështjen, sipas parimit të respektimit të shkallëve të pushtetit gjyqësor, pasi në lidhje me këto pretendime janë ezauruar të dyja shkallët e pushtetit gjyqësor.

24. Nëse do të zbatohej formalisht dhe mekanikisht, neni 467/ç i KPC-s, Vendimi Unifikues nr. 13/2004 dhe të kthehej çështja në gjykatën e shkallës së parë, në mënyrë që formalisht Avokatura e Shtetit të përsëriste edhe njëherë të njëjtat pretendime, ligji do të shndërrohej në një mjet arbitrar, për zvarritjen e pajustifikuar të gjykimit. Duke pasur parasysh se çështja gjyqësore ka filluar që në vitin 2012 dhe ende nuk është përmbyllur me një vendim përfundimtar nga pushteti gjyqësor, ky interpretim nuk i shërben parimit të dhënies së drejtësisë në mënyrë eficiente.

25. Përsa u përket pretendimeve që lidhen me zgjidhjen e çështjes në themel, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatave më të ulëta janë të bazuara në ligj dhe në praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme. Si rrjedhojë, Kolegji duhet të vendosë lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër sipas nenit 485 të KPC-s.

26. Fillimisht, Kolegji vlerëson se është haptazi i pambështetur në aktet e fashikullit të gjykimit, pretendimi i Avokaturës së Shtetit se në vlerën e llogaritur për t'u paguar nga blerësi nuk është llogaritur vlera e truallit, por vetëm sheshi i betonit, i cili përbën hapësirën e jashtme të depos së drithit në funksion të ndërmarrjes. Në dosjen gjyqësore gjendet i administruar formulari për llogaritjen e vleftës së truallit, sipas VKM-s nr. 562, datë 09.10.1995 dhe udhëzimit përkatës të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (në vijim AKP), i formuluar nga seksioni përkatës i Financës, në vlerën 130.080 lekë dhe po ashtu mandati i arkëtimit që pasqyron faktin se paditësit kanë derdhur këtë vlerë për llogari të Degës së Thesarit,për Agjencinë e Privatizimit Gjirokastër. Ky fakt dhe provat në lidhje me të, janë debatuar në të dyja shkallët e gjykimit dhe janë pranuar si të tilla nga gjykatat më të ulëta.

28. Po ashtu, është i pabazuar në ligj pretendimi i palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit se paditësit nuk i është shitur trualli, por vetëm objekti mbi truall, se për blerjen e truallit paditësit duhet t'i nënshtroheshin procedurës së privatizimit sipas ligjit të posaçëm dhe si rrjedhojë, nuk mund të njihej pronar. Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk ka bazë ligjore dhe vjen si rrjedhojë e paqartësisë mbi shkakun e padisë dhe të pretendimit të paditësve.

29. Në rastin konkret, paditësit kanë kërkuar njohjen pronar mbi truallin, nën objektin e privatizuar, jo për shkak të kontratës së privatizimit, si një mënyrë e prejardhur e fitimit të pronësisë, por për shkak të parashkrimit fitues me titull sipas nenit 168 të KC-s, si një mënyrë tjetër, primare dhe origjinale e fitimit të pronësisë. Baza e fitimit të pronës sipas kësaj dispozite, nuk është titulli apo veprimi juridik për kalimin e pronësisë, por është posedimi i qetë, i pandërprerë, me mirëbesim, për një periudhë prej 10 vitesh i sendit të paluajtshëm (sikurse është rasti konkret).

30. Elementi "veprim juridik për kalimin e pronësisë", sipas nenit 168 të KC-s, është vetëm një konvencion që justifikon mirëbesimin e poseduesit dhe nuk do të thotë që ky titull duhet të jetë i perfeksionuar sipas të gjitha kushteve ligjore për vlefshmërinë e tij, në të kundërt nuk do të ishim para një mënyre origjinale, por para një mënyre të prejardhur të fitimit të pronësisë. Si rrjedhojë, mirëbesimi justifikon afatin më të shkurtër në raport me parashkrimin fitues pa titull. Që poseduesi të konsiderohet se është në mirëbesim mjafton që në ndërgjegjen dhe psikikën e tij, të besojë se e drejta i ka kaluar nga pronari dhe se nga rrethanat nuk kishte se si të besonte ndryshe.

31. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje, në një vështrim krahasimor me KC-neRepublikës së Francës, se në nenin 2272, i cili ka rregulluar parashkrimin fitues mbi sendet e paluajtshme, është parashikuar se: *"Afati i parashkrimit për të fituar pronësinë mbi sendet e paluajtshme është 30 vjet. Megjithatë, për atë që e fiton pronësinë me mirëbesim dhe në bazë të një titulli të përshtatshëm, afati është 10 vjet."*.

32. Në praktikën e Gjykatës së Kasacionit të Republikës Franceze është mbajtur qëndrimi se për efekt të parashkrimit fitues me titull, poseduesi do të konsiderohet në mirëbesim mjafton që në momentin që ka fituar posedimin të besojë se sendin e ka fituar nga pronari. (*Civ 3, 18.01.1972; Bull Civ III nr. 39, 15.01.2005; Bull Civ III nr. 133*). Nga ana tjetër, sipas praktikës gjyqësore dhe doktrinës franceze, titulli duhet të jetë i aftë të kalojë pronësinë, qoftë edhe nga ai që nuk është pronari (*Civ III, 30.10.1972; Bull Civ III, nr. 575, datë 13.12.2000*).

33. Po ashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në çështje të ngjashme, ka mbajtur qëndrimin se parashkrimi fitues me titull mbulon çdo lloj pavlefshmërie, si atë relative ashtu edhe atë absolute, sepse ai përbën një mënyrë primare të fitimit të pronësisë me anë të posedimit dhe jo një mënyrë të prejardhur të fitimit të pronësisë (me anë të veprimit juridik) (*shiko, Vendimi nr. 290, datë 04.06.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

34. Po ashtu, Ky Kolegj, nën një praktikë gjyqësore të konsoliduar të tij, ka theksuar se është e rëndësishme kryerja e diferencimit ndërmjet një veprimi juridik të pavlefshëm dhe një veprimi juridik të ndaluar nga ligji, në kuptim të nenit 168 të KC-s. Rastet e pavlefshmërisë absolute apo relative të veprimit juridik janë të përcaktuara qartë në nenet 92 e vijues të KC-s, sikurse është veprimi juridik që vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit.

35. Pavarësisht kësaj, Kolegji Civil ka mbajtur qëndrimin se jo çdo veprim juridik absolutisht i pavlefshëm për shkak se vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, do të konsiderohet gjithashtu edhe një veprim juridik i ndaluar nga ligji, pasi ky i fundit i referohet rastit kur norma urdhëruese ndalon shprehimisht kryerjen e vetë llojit apo kategorisë së veprimit juridik, pavarësisht nga forma dhe përmbajtja e tij (*shih, Vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.11111-00655-00-2007 i Regj. Themeltar, Nr.00-2009-1329 i Vendimit (456), dt. 24.12.2009; Vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.11111-00639-00-2006 i Regj. Themeltar, Nr.00-2008-544 i Vendimit (214), dt. 18.03.2008; Vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.11115-01734-00-2007 i Regj. Themeltar, Nr.00-2010-973 i Vendimit (307), dt. 29.06.2010. Vendimin i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil Nr.11211-00165-00-2005 i Rregj. Themeltar, Nr.00-2007-584 i Vendimit (417), dt. 05.04.2007*).

36. Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata e Lartë, në mënyrë të përsëritur, ka mbajtur qëndrimin se parashkrimi fitues sipas nenit 168 të KC-s, është rasti

klasik që e mbulon pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik për shkak të mungesës së formës, por në çdo rast duhet që të provohet ekzistenca e veprimit juridik ndonëse i bërë jo në formën e kërkuar nga ligji (*shih, Vendim nr. 456, datë 27.12.2009; Vendim nr. 214, datë 18.03.2008; Vendim nr. 214, datë 18.03.2008; Vendim nr. 307, datë 29.06.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, etj.,.*).

37. Në rastin konkret, para Kolegjit u shtrua për diskutim, nëse ka pasur një veprim juridik për kalimin e pronësisë, nëse ka qenë si rrjedhojë në mirëbesim paditësi dhe nëse veprimi juridik ka qenë apo jo i ndaluar nga ligji.

38. Sikurse ka rezultuar nga dosja gjyqësore, midis palëve ndërgjyqëse ka pasur një veprim juridik me qëllim kalimin e pronësisë së truallit, por ky veprim është i paperfeksionuar, pasi nuk është formalizuar në një kontratë me shkresë.

39. Kështu, ka rezultuar se paditësit kanë privatizuar objektin mbi truall mbi bazën e autorizimit për blerje objekti dhe ka vijuar procedura për privatizimin e truallit. Është përpiluar formulari i përllogaritjes së vlerës së truallit, sipas VKM-s nr. 562, datë 09.10.1995, është paguar e gjithë vlera e truallit nga paditësit në llogarinë përkatëse të caktuar nga AKP-ja dhe trualli është vënë në dispozicion të blerësit.

39.1. Sipas pikës 3 të VKM-s si më sipër, shitja e truallit është pjesë e kontratës së shitjes së objektit apo ndërmarrjes. Po ashtu, sipas pikës 4, në rast të privatizimit të objektit, mbi kërkesën e pronarit, lidhet kontratë shitjeje për truallin e ndërmarrjes. Ndërkohë që në pikën 1 të saj parashikohet se shitja e truallit për veprimtarinë e objekteve që privatizohen, bëhet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj nëpër rrethe, sipas përcaktimit në autorizimin e lëshuar për këtë qëllim për ndërmarrjen apo objektin përkatës.

40. Pra, në rastin konkret paditësi ka plotësuar të gjitha kushtet materiale për të fituar pronësinë mbi truallin, por mungon forma e veprimit juridik të shitjes, pra formalizimi i procedurës së privatizimit, tashmë të përfunduar, në një kontratë shkresore, që përbën edhe aktin përmbyllës të kësaj procedure. Vullneti i të dyja palëve për kalimin e pronësisë mbi truallin është i qartë, porse veprimi juridik i shitjes është i metë për mungesë të formës. Si rrjedhojë, ky veprim është i pavlefshëm për këtë shkak, por është i aftë për të passjellë fitimin e pronësisë sipas nenit 168 të KC-s prej paditësit. Ky i fundit ka qenë në mirëbesim pasi në kuadër të procedurës së privatizimit të objektit dhe në vijim të saj ka paguar gjithë vlerën e sendit dhe ka besuar se sendi i ka kaluar nga pronari, i cili në këtë rast ka qenë shteti. Ky i fundit është një entitet abstrakt, person juridik publik, i cili vepron nëpërmjet organeve të tij, kompetencat e të cilëve përcaktohen në ligj apo akte nënligjore.

41. Në një rast të ngjashëm Gjykata e Lartë është shprehur se: *"...Vërtet mund të mungojë akti noterial për kalimin e pronësisë, por kjo nuk do të thotë se mungon veprimi juridik si i tillë. Veprimi juridik për kalimin e pronësisë mund të jetë kryer, ndonëse jo në formën e kërkuar nga ligji e për këtë shkak është i pavlefshëm....Fakti që nuk ka kontratë për kalimin e pronësisë nuk do të thotë se nuk ka veprim juridik. Veprimi juridik për kalimin e pronësisë...nuk kërkon detyrimisht ekzistencën e një forme të caktuar, por është pikërisht mungesa e formës e cila e bën veprimin juridik të pavlefshëm, për pasojë të paaftë që si i tillë të sjellë pasojën e synuar nga palët e veprimit juridik. Ky është shkaku pse neni 91, ekzistencën e një veprimi të pavlefshëm për shkak të formës të shoqëruar dhe me elementë të tjerë si posedimi në mirëbesim dhe për një kohë të caktuar e përmend si element përbërës të parashkrimit fitues. ...Është i gabuar konkluzioni i gjykatës që mungesa e një kontrate të shkruar vlerësohet automatikisht si mungesë veprimi juridik. Veprimi juridik, sipas nenit 13 të Kodit Civil vitit 1981 (edhe sipas nenit 80 të Kodit Civil në fuqi), mund të kryhet "me gojë ose me shkresë. Kur veprimi juridik bëhet me shkresë, kjo mund të jetë ose e thjeshtë, ose e vërtetuar, ose e përpiluar nga noteri".*(*shih, Vendim nr. 456, datë 27.12.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

42. Sikurse është pranuar nga gjykatat, prona nuk ka qenë pronë publike, e ndaluar për t'u fituar sipas nenit 168 të KC-s. Kolegji vlerëson se pretendimet e Avokaturës së Shtetit janë kontradiktore dhe po ashtu të pambështetura në aktet e fashikullit të gjykimit. Nga njëra anë ajo e pranon se prona objekt gjykimi nuk përfshihet në kategorinë e pronës publike të patjetërsueshme dhe nga ana tjetër ka pretenduar se gjykatat më të ulëta nuk kanë hetuar mbi këtë fakt.

43. Po ashtu, shitja e truallit në favor të paditësit jo vetëm nuk ka qenë veprim juridik i ndaluar, por paditësit kanë pasur të drejtën ekskluzive për të privatizuar truallin, duke qenë se kanë privatizuar objektin mbi truall, sipas, VKM-s nr. 203, datë 03.05.1995; Ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve"; VKM-s nr. 562, datë 09.10.1995; VKM-s nr. 738/2010 dhe në bazë të prezumimit mbi pronësinë, të parashikuar në nenin 150 të KC-s, sipas të cilit pronarit të sendit, i takon pronësia edhe mbi pjesët përbërëse të tij.

Vendim i Kolegjit Civil, Nr. 00-2021-1179, datë 23.06.2021

Moskryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ndikon drejtpërdrejt në mohimin e palëve ndërgjyqëse për të pasur një proces të rregullt ligjor, pasi një çështje gjyqësore e pa hetuar mirë dhe plotësisht, nuk mund të zgjidhet drejt dhe në mënyrë përfundimtare nga gjykata me juridiksion rishikues.

Arsyetimi i vendimit gjyqësor, është detyrim kushtetues dhe një garanci që çështja është shqyrtuar me hollësi dhe përgjegjshmëri nga ana e gjykatës, e cila pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm ka dhënë një vendim të bazuar në ligj. Arsyetimi i vendimit është një kusht i domosdoshëm edhe për shqyrtimin që do t'i bëjnë çështjes gjykatat me të larta, në rastin konkret Gjykata e Lartë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësja në këtë gjykim S.L., si dhe të paditurit e tjerë janë trashëgimtarë ligjore të radhës së parë të të ndjerit Se.L. sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Se.L..

2. Gjatë gjykimit është provuar se, e ndjera L.L. ka ndërruar jetë në datën 06.10.2010 dhe me vendimin gjyqësor nr. 4032, datë 24.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për të, duke u caktuar si trashëgimtare e vetme e saj e radhës së parë, e bija S.L., e cila trashëgon të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënëses së saj, kudo ku ajo ndodhet.

3. Pala paditëse në këtë gjykim ka pretenduar se është bashkëpronare me palët e paditura në këtë gjykim, mbi pasurinë e paluajtshme apartament banimi [...] fituar si rezultat i trashëgimisë ligjore nga prindërit e saj, Se.L. dhe L.L..

4. Referuar përmbajtjes së kontratës së shitblerjes, rezulton se shtetasi Se.L. ka blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa nr. 1 në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për Privatizimin e Banesave Shtetërore" një apartament banimi [...]. Në përmbajtje të kësaj kontrate shitblerje janë përcaktuar si bashkëpronarë mbi këtë pasuri të paluajtshme trashëgimlënësit Se.L. dhe L.L., si dhe paditësja S.L..

5. Referuar përmbajtjes së vërtetimit të lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në vitin 2014, pasuria e paluajtshme, apartament banimi, objekt i këtij gjykimi, rezulton të jetë në bashkëpronësi të: (i) S.L. me 7/10 pjesë; dhe trashëgimtarëve të tjerë me 1/10 pjesë.

6. Pala paditëse ka pretenduar se shtëpia objekt gjykimi përdoret si banesë nga ana e saj dhe e të paditurve. Konkretisht një dhomë, kuzhina dhe banja përdoren nga pala paditëse dhe dhoma tjetër përdoret nga të paditurit. Pavarësisht faktit se dhoma që përdoret nga të paditurit në këtë gjykim, është më e madhe sesa pjesa takuese e tyre e bashkëpronësisë, palët ndërgjyqëse nuk kanë mundur dot të bëjnë pjesëtimin vullnetar të kësaj pasurie.

7. Në kushtet kur palët ndërgjyqëse nuk kanë mundur që të dakordësohen për të pjesëtuar në mënyrë vullnetare pasurinë e paluajtshme, apartament banimi në bashkëpronësi të tyre, pala paditëse i është drejtuar në datën 27.11.2012 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, [...]

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...], ka vendosur: *Pranimin e pjesshëm të padisë të paditëses S.L. lidhur me fazën e parë të pjesëtimit.[...]*

8/1. Kjo gjykatë në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar se:*"...Referuar përcaktimeve të nenit 9 dhe nenit 20 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", rezulton që krahas përbërjes familjare të datës 01.12.1992, në privatizimin e banesave shtetërore do të merrej parasysh edhe gjendja e strehimit që rezultonte në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 01.12.1992, duke iu referuar për këtë qëllim gjendjes reale të strehimit së personave që jetonin në banesat shtetërore objekt privatizimi, si dhe përfitues nga procesi i privatizimit, krahas qiramarrësit do të ishin edhe personat madhore të familjes së tij. [...]*

9. Kundër vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë pala paditëse S.L., [...]

10. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 5, datë 13.01.2015, ka vendosur: *-Lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

11. Kundër vendimit nr. 5, datë 13.01.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs pala paditëse S.L. duke i kërkuar para Gjykatës së Lartë: *Prishjen e vendimit nr. 5, datë 13.01.2015të Gjykatës së Apelit Tiranë [...], si dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me një trupë tjetër gjykuese.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

A) Procedura e gjykimit në Gjykatë të Lartë

12. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala paditëse S.L. përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-s, të cilat, e bëjnë të cenueshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë. Kolegji çmon të theksojë se nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes, nuk janë identifikuar mangësitë në hetim që ka lejuar gjykata e shkallës së parë, si dhe nuk i ka dhënë palës paditëse përgjigje për të gjitha çështjet që ajo ka ngritur gjatë këtij gjykimi, të cilat janë pretendime të cilat evidentohen se kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi.

13. *Moskryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ndikon drejtpërdrejt në mohimin e palëve ndërgjyqëse për të pasur një proces të rregullt ligjor, krijon problematikë që një gjykatë rishikuese si Gjykata e Lartë të ketë mundësi për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes, duke u fokusuar tek interpretimi fundor dhe përfundimtar që duhet t'u bëhet çështjeve të ligjit të aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe ndikon dukshëm në dhënien e drejtësisë, pasi një çështje gjyqësore e pahetuar mirë dhe plotësisht, nuk mund të zgjidhet drejt dhe në mënyrë përfundimtare*. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi ka vend që të prishet vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe çështja të kthehet sërish për rigjykim pranë kësaj gjykate, por me një trupë tjetër gjykuese.

14. Kolegji, fillimisht vlerëson të theksojë faktin se, çështja objekt shqyrtimi, e cila rezulton të jetë regjistruar pranë Gjykatës së Lartë në vitin 2015, është marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi me procedurë të përshpejtuar, nisur nga fakti se, rekursi është ushtruar ndaj një vendimi të ndërmjetëm të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, në përputhje me parashikimet e nenit 370 të KPC-s, në të cilin pasqyrohet se: "*Gjykimi për pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi dhe në trashëgim, në fazën e parë të tij, ka për qëllim të hetojë e të përcaktojë të drejtën e bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre, si dhe sendet që do të pjesëtohen. Pasi të ketë marrë provat e nevojshme, gjykata, me vendim të ndërmjetëm, lejon pjesëtimin dhe përcakton rrethin e bashkëpjesëtarëve, sendet që do të pjesëtohen, si dhe pjesët takuese të secilit prej tyre. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë, paraqitja e të cilit pezullon vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit*".

15. Gjykata e Apelit Tiranë e ka marrë këtë çështje në shqyrtim bazuar në ankimin e veçantë që ka kryer pala paditëse S.L. ndaj vendimit nr.1770 akti, datë 14.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Të dyja vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, janë vendime të ndërmjetme në kuptim të parashikimeve ligjore të nenit 125 të KPC-s, në të cilin parashikohet se: "*Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'u përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi*", si dhe nenit 315 të KPC-s, i titulluar "Vendimet e ndërmjetme", në të cilin parashikohet qartësisht se: "*Vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë përfundimtare, mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveç kur në këtë Kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë"*.

16. Për këtë arsye, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për lejimin e fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë, është një vendim i ndërmjetëm, pasi me të nuk është shqyrtuar në themel mosmarrëveshja mes palëve, pra nuk i është dhënë fund gjendjes së bashkëpronësisë e cila merr fund pas fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë, por janë përcaktuar nga gjykata çështjet themelore që do të shqyrtohen në fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë: *(i)* subjektet bashkëpronar; *(ii)* objektit që i nënshtrohet regjimit të bashkëpronësisë (në rastin konkret regjimit të bashkësisë ligjore) dhe *(iii)* pjesët ideale të çdo subjekti bashkëpronar.

17. Për sa më sipër, në kushtet kur pala paditëse S.L. ka ushtruar të drejtën e rekursit ndaj një vendimi të ndërmjetëm të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim atë me procedurë të përshpejtuar, në përputhje me parashikimet e nenit 470 të KPC-s, në të cilin është pasqyruar se: "*Ankimet e veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë*".

B) Në lidhje me shkaqet e paraqitura në rekurs dhe zgjidhjen e çështjes

18. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji, konstaton se të dyja gjykatat nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes si dhe nuk kanë dhënë përgjigje në lidhje me çështjet thelbësore për zgjidhje të drejtë dhe përfundimtare të padisë objekt shqyrtimi. Kolegji vlerëson se, pavarësisht faktit se të dyja gjykatat kanë identifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes si dhe normat ligjore mbi bazën e të cilave rregullohet ajo, nuk kanë arritur të argumentojnë zgjidhjen e drejtë të saj, për shkak të mangësive thelbësore që kanë të bëjnë me hetimin e çështjeve thelbësore që kanë të bëjnë me themelin e këtij gjykimi. Për këtë arsye, të dyja këto vendime duhet të prishen dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me një trupë tjetër gjykuese.[...]

19. Konflikti mes palëve në këtë gjykim, qëndron në mënyrën se si duhet të ndahen pjesët përkatëse të secilit prej tyre, mbi pasurinë objekt shqyrtimi.

20. Pala paditëse ka pretenduar në gjykim se pjesët takuese të secilit prej ndërgjyqësve në këtë gjykim duhet të përcaktohen sipas të dhënave që pasqyrohen në ZVRPP Tiranë dhe dëshmive përkatëse të trashëgimisë së trashëgimlënësve Se.L. dhe L.L.. Ndërsa pala e paditur [...] ka pretenduar se kontrata e privatizimit me nr. 586 rep. dhe nr. 516 kol, datë 17.01.1993, me të cilën është privatizuar apartamenti objekt shqyrtimi, është pjesërisht e pavlefshme në pjesën ku është përjashtuar nga privatizimi i apartamentit me 1/3 pjesë ideale.

21 Për këtë arsye, ky i paditur ka pretenduar se pjesët e apartamentit objekt shqyrtimi nuk duhet të përcaktohen sipas të dhënave që pasqyron ZVRPP Tiranë, por duhet të mbahet në vëmendje se ai ka të drejtën e 1/3 pjesë takuese të këtij apartamenti që në origjinën e tij, për shkak të përcaktimeve ligjore të kohës kur është privatizuar ky apartament. [...]

22. Të dyja gjykatat kanë pranuar pretendimet e të padituritt [...] dhe kanë vendosur të lejojnë pjesëtimin e pasurisë së apartamentit objekt gjykimi sipas pjesëve të pretenduara nga kjo palë [...] në kushtet kur i padituri ka qenë madhor dhe ka qenë pjesë e trungut familjar të të ndjerit Se.L. në datën 01.12.1992, ai duhet të përfitonte nga privatizimi i apartamentit objekt shqyrtimi në 1/3 pjesë ideale së bashku me dy bashkëpronarët e tjerë.

23. Konkluzionet e arritura nga të dyja gjykatat si dhe argumenti i dhënë prej tyre në vendimet përkatëse, vlerësohen nga ky Kolegj se janë rrjedhojë e një hetimi jo të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, si dhe vijnë në kundërshtim me aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore.

24. Kolegji, fillimisht vlerëson të theksojë faktin se, mosmarrëveshja objekt shqyrtimi rregullohet sipas përcaktimeve të nenit 207 të KC-s, si dhe përcaktimeve të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar. Në këto lloj gjykimesh, në mbështetje edhe të përcaktimeve të kryera në nenin 370 të KPC-s, gjykata ka detyrimin që gjatë fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë të përcaktojë saktësisht tri çështje kryesore të cilat kanë lidhje me: *(i)* cilat sende (pasuri) do t`i nënshtrohen pjesëtimit; *(ii)* kush janë bashkëpronarët (apo bashkëtrashëgimtarët); *(iii)* cilat janë pjesët takuese (ideale) të tyre në bashkëpronësi. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson të evidentojë faktin se, vendimet e fazës së parë të pjesëtimit, nuk janë vendime me karakter thjesht procedural, d.m.th. nuk jepen vetëm për të siguruar normalitetin e zhvillimit të gjykimit brenda kërkesave të normave procedurale. Nisur nga karakteri i posaçëm i gjykimit të çështjeve me objekt pjesëtim pasurie dhe i ndarjes së tij në dy faza të veçanta, ligjvënësi e ka çmuar të nevojshme dhe të dobishme që disa probleme t`i zgjidhë në

themel dhe në mënyrë përfundimtare me vendim të ndërmjetëm në mbyllje të fazës së parë.

25. Për sa më sipër, me të drejtë në këtë fazë të gjykimit, gjykatat më të ulëta kanë marrë fillimisht në shqyrtim pretendimin e ngritur nga pala e paditur për të vlerësuar pavlefshmërinë absolute të pjesshme të kontratës së privatizimit me nr. 586 rep. dhe nr. 516 kol., datë 17.01.1993, si një veprim juridik i dyanshëm, me qëllim që të përcaktojë drejt pjesët takuese të subjekteve bashkëpronarë që kanë të drejta bashkëpronësie mbi pronën objekt gjykimi. Titulli i pronësisë mbi apartamentin objekt shqyrtimi, edhe pse nga pikëpamja formale është mbështetur tek kontrata e privatizimit me nr. 586 rep. dhe nr. 516 kol, datë 17.01.1993, nuk është krijuar për shkak të vullnetit të lirë të palëve nënshkruese të kontratës së privatizimit, por ajo është lidhur për shkak të përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar.

26. Gjykatat kanë pasur detyrimin që të merrnin në shqyrtim pretendimin e palës së paditur në lidhje me pavlefshmërinë e pjesshme të kontratës së privatizimit, e cila, është kundërshtuar me prapësim nga pala e paditur si një veprim juridik i pavlefshëm, referuar përcaktimeve të nenit 92 të KC-s në të cilën përcaktohet se: "*Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; ....*". Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se, marrja në shqyrtim e pretendimit të ngritur nga i padituri [...] për konstatimin e pavlefshmërisë juridike të pjesshme të kontratës së privatizimit të datës 17.01.1993 vetëm mbi bazën e prapësimit, është proceduralisht një veprim i rregullt, pasi ky pretendim ka lidhje me zgjidhjen e pasojës që është kërkuar në këtë gjykim, pra pjesëtimit të sendit në bashkëpronësi sipas pjesëve takuese të secilit bashkëpronar.

27. Pavlefshmëria juridike e veprimit juridik është një çështje të cilën gjykata mund ta konstatojë në çdo kohë edhe kryesisht, referuar këtu edhe qëndrimit të mbajtur në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 5/2012, në të cilin është mbajtur qëndrimi se: "*Veprimi juridik që është i pavlefshëm mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht, pa u kërkuar nga pala e interesuar, madje edhe kundër vullnetit (dëshirës) të saj. Për të konsideruar një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm nuk është e nevojshme paraqitja e një kërkese të posaçme, qoftë kjo padi apo kundërpadi, pasi kjo lloj pavlefshmërie konstatohet pavarësisht nga paraqitja në gjykatë e kërkesës. Pavlefshmëria absolute mund të parashtrohet nga çdo palë ndërgjyqëse që ka interes. Forma e parashtrimit mund të jetë edhe prapësimi, kjo për faktin se veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet*

i vlefshëm me asnjë veprim të mëparshëm. Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik nuk mund të bëhet si kërkim i mëvetësuar; ai gjithnjë duhet të bëhet gjatë gjykimit në themel të një çështjeje nga gjykata, ose të paktën si kërkim që shoqëron zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i tij".

28. Në nenin 1 të Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", është përcaktuar se: "*Ky ligj ka si qëllim të realizojë privatizimin e banesave shtetërore, të krijojë tregun e lirë të banesave private dhe të përmirësojë përdorimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e banesave duke iu dhënë të drejtën qiramarrësve të banesave shtetërore të bëhen pronarë të tyre. Pronarët do të kenë të drejtë ta tjetërsojnë, ta lëshojnë me qira dhe ta hipotekojnë banesën e tyre*", ndërsa në nenin 5 të po këtij ligji është parashikuar se: "*Me hyrjen në fuqi të këtij ligji qiramarrësit e banesave shtetërore mund të kërkojnë pranë ndërmarrjeve administruese të banesave kryerjen e veprimeve për njohjen e pronësisë. Pronësia mbi banesën fitohet me kryerjen e veprimeve përkatëse, shlyerjen e vlerës së plotë të tarifës dhe regjistrimin e aktit të pronësisë në zyrat e hipotekës...*".

29. Në analizë të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton e provuar se ligjvënësi ka shprehur vullnetin që banesat shtetërore, të cilat ishin në përdorim dhe me qira nga ana e qytetarëve (shtetasve) shqiptarë në cilësinë e qiramarrësve, t'u kalonin këtyre të fundit në pronësi, kundrejt përmbushjes së disa detyrimeve ligjore që konsistojnë në tri drejtime kryesore: *(i)* kryerjen e veprimit juridik të lidhjes së kontratës së privatizimit (kalimit të pronësisë) me Entin Kombëtar të Banesave; *(ii)* shlyerjen e vlerës së plotë të tarifës së banesës përcaktuar sipas kërkesave të nenit 4 të këtij ligji; si dhe *(iii)* regjistrimin e aktit të pronësisë në zyrat e hipotekës. Gjithashtu, ligjvënësi ka përcaktuar në këtë ligj edhe kriteret përkatëse dhe kushtet që duhet të plotësonin qiramarrësit për të bërë privatizimin e banesave shtetërore në kuptim të këtij ligji, duke përcaktuar qartësisht se kush ishin subjektet që duhet të përfitonin nga privatizimi, kushtet dhe kriteret konkrete që ata duhet të plotësonin për të përfituar nga procesi i privatizimit të banesave ku jetonin.

30. Sa më sipër, gjen mbështetje tek përcaktimet e nenit 9 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", në të cilin është përcaktuar se: "*Banesat që privatizohen, do të regjistrohen në emër të qiramarrësit, anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij. Banesa që përdoret nga disa qiramarrës kalon në pronësi të çdo qiramarrësi, në bazë të pagesës që ka në kontratën e qirasë. Kur qiramarrësit bien dakord midis tyre, banesa mund të kalojë tërësisht në pronësi të njërit qiramarrës",* si dhe në nenin 20 të tij, është përcaktuar se: *"Për efekt të zbatimit të këtij ligji, të merret për bazë përbërja familjare, gjendja e strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 01.12.1992".*

31. Referuar dy dispozitave të sipërcituara, ligjvënësi në momentin e hartimit të këtij ligji ka pasur si qëllim jo vetëm privatizimin e banesave shtetërore, pra kalimin e tyre kundrejt shpërblimit nga pronari shtet tek subjektet private, por edhe ruajtjen e ekuilibrave socialë që kanë të bëjnë me strehimin, si një nga detyrimet kryesore që shteti shqiptar mbarti pas viteve '90. Për këtë arsye, në hartimin e këtij ligji ligjvënësi përcaktoi rregulla strikte që duhet të plotësoheshin nga subjektet që përfitonin nga ky ligj, duke përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në ligj se, pavarësisht se regjistrimi i banesave që do të privatizoheshin do të regjistroheshin në emër të kryefamiljarit, nga privatizimi i tyre do të përfitonin të gjithë anëtarët madhorë të familjes, të cilët bënin pjesë në trungun familjar të qiramarrësit të banesës. Për të përcaktuar trungun familjar dhe personat që do të përfitonin nga ky privatizim, ligjvënësi përcaktoi përbërjen familjare dhe gjendjen e strehimit të shtetasve sipas regjistrimeve të datës 01.12.1992.

32. Bazuar në dispozitat ligjore të mësipërme, pala e paditur në këtë gjykim ka pretenduar se pavarësisht faktit se kontrata e privatizimit e datës 17.11.1993 është lidhur në formën e kërkuar nga ligji si dhe është regjistruar në regjistrat përkatës hipotekorë, ajo është pjesërisht e pavlefshme përsa i takon përcaktimit të subjekteve që kanë përfituar nga privatizimi i saj, përsa kohë ai në datën 01.12.1992 ka qenë madhor dhe pjesë përbërëse e trungut familjar të të ndjerit Se.L., duke e mbështetur këtë pretendim të tij në certifikatën e trungut familjar të lëshuar nga Njësia Bashkiake nr. 4, Tiranë, me gjendjen familjare të datës 23.12.1992, ku ai rezulton të jetë në trungun familjar të të ndjerit Se.L., së bashku me L.L. dhe motrën e tij S.L., e cila ka qenë minorene. Për këtë arsye, ai ka pretenduar se pavarësisht faktit se nuk është pasqyruar si nënshkrues i kësaj kontrate, ai ka të drejtë që të pretendojë bashkëpronësinë e apartamentit objekt shqyrtimi që në origjinë të tij, si rezultat i të drejtave që i burojnë drejtpërdrejt nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore".

33. Referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se në të është administruar praktika e plotë e privatizimit të apartamentit objekt shqyrtimi, i cili është dorëzuar pranë ZVRPP Tiranë në momentin e regjistrimit të apartamentit objekt shqyrtimi. Sipas këtyre akteve, rezulton se trungu familjar i të ndjerit Se.L. përbëhej nga: *(i)* Se.L. kryefamiljar; *(ii)* L.L. e datëlindjes 1945, bashkëshortja; si dhe *(iii)* S.L. e datëlindjes 1982, e bija. Bashkëlidhur kësaj praktike është vendosur edhe certifikata e përbërjes

familjare të shtetasit A.L., i datëlindjes 1960, i cili rezulton të jetë në përbërje familjare më vetë dhe me cilësinë kryefamiljar [...]

34. Gjithashtu, gjatë zhvillimit të debatit gjyqësor të kryer nga palët në dy gjykatat më të ulëta, apo edhe nga pretendimet e evidentuara në vendimet objekt shqyrtimi, nuk rezulton që palët të kenë pasur pretendime në lidhje me falsitetin e akteve shkresore që kanë shërbyer për lidhjen e kontratës së privatizimit. Pra, nuk rezulton të ketë asnjë kundërshtim për pavërtetësi të dokumentit sipas nenit 256 të KPC-s apo falsitet të tij sipas përcaktimeve të nenit 257 të KPC-s rreth certifikatës së trungut familjar të të ndjerit Se.L., e cila ka shërbyer për privatizimin e apartamentit, në të cilën nuk figuron që i padituri A.L. të ketë qenë pjesë e trungut familjar të tij [...]

35. Në dosjen gjyqësore rezultojnë të administruara në të njëjtën kohë edhe dy certifikata të trungut familjar që tregon gjendjen familjare të të ndjerit Se.L. në datën 23.12.1992. Konkretisht në dosje gjendet e administruar certifikata e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia nr. 4, Tiranë në datë 21.04.2014, në të cilën pasqyrohet se kryefamiljari Se.L. në datën 23.12.1992 ka në përbërje të trungut familjar: *(i)* të birin A.L. i vitlindjes 1960, beqar; *(ii)* bashkëshorten L.L. e vitlindjes 1945; *(iii)* të bijën S.L. e vitlindjes 1982 (referoju faqes 60 dosjes gjyqësore). Gjithashtu, gjendet e administruar edhe certifikata e trungut familjar të të ndjerit Se.L. në datën 23.12.1992, lëshuar po nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia nr. 4, Tiranë në datë 21.04.2014, sipas të cilës pasqyrohet se kryefamiljari Se.L., në datën 23.12.1992, ka në përbërje të trungut të tij familjar vetëm të birin A.L., i vitlindjes 1960, me gjendje civile beqar (referoju faqes 61 dosjes gjyqësore);

36. Bazuar sa më sipër, rezulton e provuar se të dyja gjykatat më të ulëta kanë pranuar faktin se i padituri A.L. duhet të përfitonte nga privatizimi i apartamentit objekt shqyrtimi, pasi në datën 01.12.1993 ai ka qenë në trungun familjar të të ndjerit Se.L., duke iu referuar vetëm certifikatës së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia nr. 4, Tiranë, në datë 21.04.2014, duke përjashtuar të dhënat që pasqyrojnë certifikatat e trungut familjar që kanë qenë pjesë e praktikës së privatizimit të apartamentit objekt shqyrtimi, si dhe vetë certifikatës tjetër që ka lëshuar Zyra e Gjendjes Civile, Njësia nr. 4, Tiranë në datë 21.04.2014, në të cilën nuk pasqyrohen si pjesë e trungut familjar shtetaset L.L. dhe S.L.. Për këtë arsye, Kolegji, këtë konkluzion të këtyre dy gjykatave e gjen të pabazuar dhe rrjedhojë të një hetimi të paplotë të çështjes.

37. Kolegji vlerëson të theksojë faktin se asnjë prej gjykatave më të ulëta nuk ka arsyetuar apo nuk ka bërë evident faktin se përse ka marrë të

mirëqenë dhe ka pranuar si të vërteta, vetëm të dhënat e përcaktuara në certifikatën e trungut familjar të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia nr. 4, Tiranë, në datë 21.04.2014, ku në përbërjen familjare të të ndjerit Se.L. bën pjesë edhe i biri A.L., ndërkohë që të dhënat e këtij dokumenti bien ndesh me të dhënat që pasqyron certifikata tjetër familjare e të ndjerit Se.L. lëshuar nga e njëjta Zyrë e Gjendjes Civile, Njësia nr. 4, Tiranë po në datën 21.04.2014. Një tjetër dokument zyrtar, i cili rezulton të japë të dhëna krejt të ndryshme nga ato që kanë pranuar të dyja gjykatat në këtë gjykim, është edhe praktika e privatizimit të apartamentit objekt shqyrtimi, në të cilin janë administruar dy certifikata të trungut familjar në emër të të ndjerit Se.L. dhe të paditurit A.L., të cilat tregojnë në gjendje krejt të ndryshme familjare nga ajo që kanë pranuar të dyja gjykatat dhe që nuk rezulton të jenë kundërshtuar nga palët si të pavërteta (253 i KPC-s) apo të falsifikuara (254 i KPC-s).

38. Në kushtet kur aktet e administruara në dosje përbëjnë akte zyrtare të lëshuara nga organi kompetent, Zyra e Gjendjes Civile, dhe jepen të dhëna që kundërshtojnë tërësisht njëra-tjetrën, si dhe për to nuk rezulton që të ketë pasur pretendime nga palët për pavërtetësi apo falsifikim të tyre, ishte detyrim ligjor i gjykatave që të merrnin në shqyrtim dhe në analizë se si ka mundësi që në të njëjtën datë 23.12.1992, i ndjeri Se. L. të kishte tri trungje familjare me përbërje jo të njëjtë, duke arsyetuar qartësisht se cila është arsyeja që ato kanë marrë të mirëqenë vetëm të dhënat e pasqyruara nga një prej certifikatave të trungut familjar të administruara në dosje, duke anashkaluar të dhënat e certifikatave të tjera. Në këtë drejtim, gjykatat duhet të kishin mbajtur në vëmendje përcaktimet e ligjit të kohës "Për gjendjen civile" kur është kryer privatizimi i apartamentit objekt shqyrtimi, ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar, i cili ka qenë në fuqi në momentin e lëshimit të certifikatave të trungut familjar në datën 21.04.2014 nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia nr. 4, Tiranë, si dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tyre, duke evidentuar qartësisht se mbi bazën e cilave të dhëna përcaktohet gjendja e trungut familjar të një familjeje, në një datë të caktuar.

39. *Dhënia, nga gjykatat më të ulëta,njërës prej provave shkresore të administruara në dosje, vlerë më të madhe provueshmërie se aktet e tjera shkresore, që kundërshtojnë dukshëm të dhënat e kësaj prove dhe mungesa e arsyetimit se pse gjykatat kanë vlerësuar t'i japin vlerë asaj ndaj akteve të tjera, vlerësohet nga Kolegji si moskryerje e një shqyrtimi të plotë dhe të thelluar të çështjes, mosrespektim i parimeve të kontradiktoritet (neni 20), mosrespektim i parimit që gjykata duhet të marrë vendimin mbi bazën e provave të paraqitura nga palët dhe vlerësimit të tyre në tërësinë*

e tyre (neni 29 i KPC-s), si dhe mosrespektim i përcaktimeve të nenit 253 dhe 254 të KPC-s, duke bërë paragjykimin e zgjidhjes së çështjes dhe mosgarantimin e palëvë ndërgjyqëse për të pasur një proces të rregullt ligjor (neni 42/2 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-s, neni 4 i KPC-s).

40. Gjithashtu, nuk rezulton që gjykatat më të ulëta të kenë hetuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme nëse i padituri A.L. ka privatizuar ndonjë banesë tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", kërkesë themelore kjo e përcaktuar në nenin 23 të këtij ligji, në të cilën është pasqyruar se: "*Në zbatim të këtij ligji, në asnjë rast qytetari nuk mund të bëhet njëkohësisht pronar i dy banesave shtetërore...*".

41. Në dosjen gjyqësore është administruar shkresa me nr. 605 prot., datë 13.06.2014, me të cilin është pasqyruar se shtetasi A.L. nuk ka përfituar nga privatizimi i banesës së ndodhur në Rrugën "Aleksandër Moisiu", ap. 52, shkalla 3, ap. 3, Tiranë, i cili në të vërtetë përbën edhe sendin objekt të këtij gjykimi. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se asnjë nga gjykatat nuk ka kryer hetim të plotë dhe të gjithanshëm në përcaktimin e faktit nëse A.L. ka privatizuar ose jo ndonjë banesë tjetër shtetërore nga ana e Ish-Ndërmarrja Komunale e BanesaveTiranë, pasi fakti që i padituri nuk ka përfituar nga privatizimi i apartamentit objekt gjykimi, është një fakt i provuar referuar përmbajtjes së kontratës së privatizimit me nr. 586 rep. dhe nr. 516 kol, datë 17.01.1993, i cili është objekt shqyrtimi në këtë gjykim.

42. Kolegji vlerëson të evidentojë fatin se, pretendimet e ngritura nga pala paditëse në rekurs, që kanë lidhje me faktin se: *(a)* gjykatat më të ulëta nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes; *(b)* nuk kanë respektuar rregullat procedurale të gjykimit për vlerësimin e provave dhe debatimin e tyre para gjykatës (neni 20, 28,29 të KPC-s); si dhe *(c)* nuk i kanë dhënë përgjigje palës në lidhje me pretendimet që ajo ka adresuar para saj, kanë qenë pretendime që kjo palë i ka parashtruar edhe në ankimin drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilën kjo palë nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar nga kjo gjykatë.

43. Referuar të dhënave të administruara në dosje, por edhe arsyetimit të vendimeve të dhëna nga të dyja gjykatat më të ulëta, nuk rezulton që këto gjykata të kenë hetuar dhe të kenë evidentuar faktin se: *(i)* cila është gjendja familjare e të ndjerit Se.L. në datën 01.12.1992; *(ii)* cila është gjendja familjare e të paditurit A.L. në datën 01.12.1992; *(iii)* pse certifikatat e lëshuara nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile në kohë të ndryshme përcaktojnë përbërje familjare të ndryshme për të ndjerin Se.L. dhe të paditurin A.L.; *(iv)* cili është shkaku i mospërputhjes së të dhënave që tregojnë aktet e lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile në kohë

të ndryshme, por që i referohen përbërjes familjare të shtetasve Se.L. dhe A.L. në të njëjtën datë 01.12.1992; *(v)* a ka privatizuar ndonjë banesë tjetër shtetërore i padituri A.L. sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore".

44. Bazuar sa më sipër, arrihet në konkluzionin se asnjë prej gjykatave më të ulëta në shqyrtimin e kësaj çështjeje, jo vetëm që nuk i kanë dhënë përgjigje paditëses rreth pretendimeve që ajo ka ngritur para tyre dhe që kanë lidhje me themelin e gjykimit, por këto gjykata as nuk rezulton që të kenë hetuar në lidhje me këto çështje për të dhënë argumente ligjorë shterues në lidhje me mënyrën se si duhet të zgjidhet çështja objekt shqyrtimi, mangësi të cilat kanë sjellë cenimin e të drejtës së palës paditëse për të pasur një proces të rregullt ligjor, brenda kufijve të pretendimeve të saj. Për këtë arsye, Kolegji arrin në konkluzionin se, në rekursin e paraqitur nga pala paditëse S.L. janë ngritur shkaqe nga ato që parashikon neni 472, shkronja "c" e KPC-s, të cilat i bëjnë të cenueshme vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta.

45. Të dyja gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe materiale për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, duke anashkaluar sqarimin plotësisht të rrethanave ligjore që lidhen me gjykimin e çështjes, si dhe nuk kanë analizuar dhe nuk u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të paraqitura nga palët në proces, pretendime të cilat kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi. Fakti që gjykatat më të ulëta nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ka sjellë si pasojë edhe mungesën e arsyetimit të vendimeve dhe zgjidhjen përfundimtare të saj.

46. Kolegji vlerëson të evidentojë faktin se, *sipas të drejtës procedurale civile, vendimi gjyqësor duhet të jetë rrjedhojë e një analize të qartë, të plotë e të gjithanshme të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, në përputhje me provat e administruara gjatë procesit gjyqësor për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Një rëndësi të madhe në hartimin e vendimit gjyqësor ka pikërisht pjesa përshkruese arsyetuese e tij. Kjo pjesë e vendimit gjyqësor, nisur dhe nga rëndësia që paraqet, duhet të përmbajë qartë zhvillimin e procesit, çështjet e diskutuara, pretendimet e palëve, paraqitjen e plotë dhe të saktë të fakteve, të cilat kanë rëndësi për çështjen, provat e administruara dhe të debatuara gjatë gjykimit, që kanë çuar në formimin e bindjes së brendshme të gjykatës, analizën juridike të përdorur nga gjykata dhe mbi të cilën ajo është bazuar për të arritur në përfundimin përkatës, parimet e së drejtës që janë përdorur prej saj, etj.,. Arsyetimi i vendimit gjyqësor, në kuptimin formal dhe material, nënkupton pikërisht trajtimin e të gjithë elementëve të trajtuar më sipër.*

47. *Arsyetimi i vendimit gjyqësor është detyrim kushtetues i përcaktuar qartë në nenin 142, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin, shprehimisht thuhet se: "Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara". Ky detyrim kushtetues, përbën një garanci për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor nga ana e gjykatave. Arsyetimi i vendimit është një garanci kushtetuese që çështja është shqyrtuar me hollësi dhe përgjegjshmëri nga ana e gjykatës, dhe se kjo e fundit, pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm ka dhënë një vendim të bazuar në ligj. Arsyetimi i vendimit është një kusht i domosdoshëm edhe për shqyrtimin që do t'i bëjnë çështjes gjykatat me të larta, në rastin konkret Gjykata e Lartë.*

48. Mungesa e një hetimi të plotë të çështjes në dy shkallët më të ulëta të gjykimit, e vë Gjykatën e Lartë si një gjykatë ligji, në pamundësi për ta zgjidhur këtë çështje në themel të saj, brenda kufijve të saj të gjykimit, duke u fokusuar në një interpretim përfundimtar të mënyrës sesi duhet të aplikohet dhe të zbatohet ligji në këtë rast si dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me përcaktimet e nenit 485, shkronja "a" "b" dhe "ç". Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se vendimet e dhëna nga dy gjykatat duhet të prishen dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila duhet të përsërisë hetimin gjyqësor dhe të plotësojë të gjitha të metat në hetim që janë evidentuar në paragrafët 44, 45, 46, 47 dhe 49 të këtij vendimi.

49. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet t'u bëjë të qartë palëve se është detyrë e secilës prej tyre, që në përputhje me ligjin të provojnë faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet për të drejtat që kërkojnë. Palët, ashtu siç kanë të drejta kanë dhe detyrime që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara me ligj. Gjykata duhet të lejojë palët që të paraqesin prova shkresore me anën e të cilave, ato të provojnë pretendimet e tyre bazuar në nenin 12 dhe 19 të KPC-s dhe t'i lejojë palët që t'ia nënshtrojnë këto prova hetimit e debatit gjyqësor. Gjithashtu, gjykata duhet të mbajë në vëmendje dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me përcaktimet e bëra në nenet 5, 6, 95, 120 të KPC-s, duke i dhënë zgjidhje çështjes në përputhje me praktikën gjyqësore që ka lidhje me shqyrtimin e kësaj natyre mosmarrëveshjeje. Kryerja e veprimeve të përmendura më sipër, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të lindin gjatë rigjykimit, do të lejojnë gjykatën të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Vendim i Kolegjit Civil, Nr. 00-2021-1279, datë 23.06.2021

Sipas dispozitave procedurale civile, jo çdo vendim i ekzekutueshëm është automatikisht vendim i formës së prerë, ashtu sikurse jo çdo vendim i formës së prerë, është detyrimisht i ekzekutueshëm (vendimet deklarative).

Arsyetimi i vendimit gjyqësor, në kuptimin formal dhe material, nënkupton trajtimin e të gjithë elementëve që lidhen me zhvillimin e procesit, çështjet e diskutuara, pretendimet e palëve, paraqitjen e plotë dhe të saktë të fakteve, të cilat kanë rëndësi për çështjen, provat e administruara dhe të debatuara gjatë gjykimit, që kanë çuar në formimin e bindjes së brendshme të gjykatës, analizën juridike të përdorur nga gjykata dhe mbi të cilën ajo është bazuar për të arritur në përfundimin përkatës, parimet e së drejtës që janë përdorur prej saj, etj.,.

I. Rrethanat e çështjes

1. Palët ndërgjyqëse në këtë gjykim, E.B. dhe F.K. janë lidhur në martesë ligjore në datën 25.10.1993 dhe nga kjo martesë kanë lindur dy fëmijë [...]

2. Me vendimin nr. 617, datë 28.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është zgjidhur martesa ligjore e palëve ndërgjyqëse në këtë gjykim.

3. Pala paditëse ka pretenduar se gjatë martesës ligjore me palën e paditur, kanë fituar pasurinë e paluajtshme të përbërë nga një banesë dykatëshe me sipërfaqe 105.5 m2 dhe trualli nën të me sipërfaqe 123.3 m2, e ndodhur në lagjen "Kala", Elbasan.

4. Origjina e pronës për këtë pasuri të paluajtshme, sipas palës paditëse vjen nga kontrata e shitjes e datës 10.10.2003, të lidhur midis shitësit S.K. dhe blerësve F.M. dhe L.K.. Nëpërmjet kësaj kontrate, blerësit kanë blerë një shtëpi dykatëshe me sipërfaqe prej 105.5 m2 dhe truallin në të, me sipërfaqe prej 123.3 m2.

5. Bazuar sa më sipër, në kushtet kur martesa ligjore mes palës paditëse E.B. dhe të padituri F.K. është zgjidhur me një vendim të formës së prerë, pala paditëse në datën 03.05.2007 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me padi [...]duke kërkuar pjesëtimin e pasurisë martesore.

6. Gjatë shqyrtimit të kësaj padie, është pranuar fakti se shtetasja K.K.

etj., kanë pasur pretendime në lidhje me kontratën e shitblerjes së lidhur midis shitësit S.K. dhe blerësve F.M. dhe L.K. në datë 10.10.2003 dhe për këtë arsye, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me padinë me objekt "*Njohje bashkëpronari mbi një shtëpi dy-kate dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes me nr. 2237 rep. dhe nr. 826 kol., datë 10.10.2003*". Kësaj padie i është bashkuar në cilësinë e ndërhyrëses kryesore në padi, shtetasja E.B., e cila ka pretenduar se duhet të njihet bashkëpronare për pasurinë e paluajtshme të përbërë nga shtëpi dy-kate dhe truall, e ndodhur në lagjen "Kala", Elbasan.

7. Me vendimin nr. 1259 Regj. Them., datë 05.11.2007 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasanka vendosur: *"Pezullimin e gjykimit të padisë së ngritur nga paditësja E.B. deri në përfundim të gjykimit të çështjes civile me objekt: 1-Njohje e bashkëpronësisë mbi një shtëpi 2-kate me nr. pasurie 15/27. 2-Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes me nr. 2237 rep. dhe nr. 826 kol., datë 10.10.2003, si dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme…".*

8. Me vendimin nr. 667, datë 11.03.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka rrëzuar padinë e paditëses K.K. si të pambështetur në prova dhe në ligj, si dhe ka pranuar padinë e ndërhyrëses kryesore E.B., duke detyruar L.dhe F.M. të njohin bashkëpronësinë e saj mbi pasurinë e paluajtshme të përbërë nga shtëpi dykatëshe me sipërfaqe ndërtimore 105.5 m² dhe truallin nën të me sipërfaqe 123.3 m², të ndodhur në lagjen "Kala", Elbasan.

9. Me vendimin nr. 10-2011-640/327, datë 04.05.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 667, datë 11.03.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan përsa i përket disponimit të padisë. Përsa i përket padisë së paditëses kryesore, është ndryshuar ky vendim duke u vendosur pranimi pjesërisht i padisë dhe detyrimin e të paditurve L. dhe F.K. që të njohin ndërhyrësen kryesore E.B. bashkëpronare mbi truallin me sipërfaqe 123.3 m², të ndodhur në lagjen "Kala", të qytetit Elbasan, duke arsyetuar ndër të tjera se: "*…Fillimisht babai i të paditurve S.K. ka qenë pronar i vetëm një shtëpie me një dhomë e hajat dhe truall me sipërfaqe 83.5 m²* në lagjen "Kala", Elbasan. Ky ndërtim i vjetër është prishur dhe në vend të tij është ndërtuar në vitin 1996-1995 një ndërtim i ri, banesë dykatëshe me sipërfaqe 105.5 m² *mbi truallin 123 m². Në kushtet kur kjo ndërtesë është ndërtuar pa leje ndërtimi nga autoritet përkatëse administrative sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8405/1998 "Për urbanistikën", përbën një ndërtim të paligjshëm dhe si i tillë nuk mund të përfshihet si pasuri bashkëshortore, me qëllim pranimin e padisë së ndërhyrëses kryesore E.B. për pasurinë ndërtesë dykatëshe…".*

10. Në kushtet kur çështja civile për njohjen e bashkëpronësisë mbi

pasurinë e paluajtshme të përbërë nga shtëpi dykatëshe me sipërfaqe ndërtimore 105.5 m² dhe truallin nën të, me sipërfaqe 123.3 m², të ndodhur në lagjen "Kala", Elbasan, është përfunduar së shqyrtuari me vendimin nr. 10-2011-640/327, datë 04.05.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka riçelur gjykimin dhe ka vijuar me fazën e parë të pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore. […]

11.Kundër vendimit nr. 1259 akti, datë 17.07.2012 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Apelit Durrës E.B.[…]

12. Gjykata e Apelit Durrës, […] *Lënien në fuqi të vendimit nr. 1259 akti, dt. 17.07.2012 "Mbi lejimin e pjesëtimit" të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

13. Kundër vendimit nr. 10-2014-2976 (768), datë 04.11.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs pala paditëse [duke] kërkuar para Gjykatës së Lartë: *Prishjen e vendimit nr. 2976, datë 04.11.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit të ndërmjetëm nr. 1259, datë 17.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

A) Procedura e gjykimit në Gjykatë të Lartë

1-4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala paditëse E.B. përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim: KPC), të cilat, e bëjnë të cenueshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës. Kolegji çmon të theksojë se nga ana e Gjykatës së Apelit Durrës nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes, nuk janë identifikuar mangësitë në hetim që ka lejuar gjykata e shkallës së parë, si dhe nuk i ka dhënë palës paditëse përgjigje për të gjitha çështjet që ajo ka ngritur gjatë këtij gjykimi, të cilat janë pretendime të cilat evidentohen se kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi.

15. Moskryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ndikon drejtpërdrejt në mohimin e palëve ndërgjyqëse për të pasur një proces të rregullt ligjor, krijon problematikë që një gjykatë rishikuese si Gjykata e Lartë, të ketë mundësi për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes, duke u fokusuar tek interpretimi fundor dhe përfundimtar që duhet t'u bëhet çështjeve të ligjit të aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe ndikon dukshëm në dhënien e drejtësisë, pasi një çështje gjyqësore e pahetuar mirë dhe plotësisht, nuk mund të zgjidhet drejt dhe në mënyrë

përfundimtare. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se në rastin objekt shqyrtimi ka vend që të prishet vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe çështja të kthehet sërish për rigjykim pranë kësaj gjykate, por me një trupë tjetër gjykuese.

16. Kolegji, fillimisht vlerëson të theksojë faktin se, çështja objekt shqyrtimi, e cila rezulton të jetë regjistruar pranë Gjykatës së Lartë në vitin 2015, është marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi me procedurë të përshpejtuar, nisur nga fakti se, rekursi është ushtruar ndaj një vendimi të ndërmjetëm të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës, në përputhje me parashikimet e nenit 370 të KPC-s, në të cilin pasqyrohet se: "*Gjykimi për pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi dhe në trashëgim, në fazën e parë të tij, ka për qëllim të hetojë e të përcaktojë të drejtën e bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre, si dhe sendet që do të pjesëtohen. Pasi të ketë marrë provat e nevojshme, gjykata, me vendim të ndërmjetëm, lejon pjesëtimin dhe përcakton rrethin e bashkëpjesëtarëve, sendet që do të pjesëtohen, si dhe pjesët takuese të secilit prej tyre. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë, paraqitja e të cilit pezullon vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit*".

17. Gjykata e Apelit Durrës e ka marrë këtë çështje në shqyrtim bazuar në ankimin e veçantë që ka kryer pala paditëse E.B.ndaj vendimit nr.1259, datë 17.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Të dyja vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, janë vendime të ndërmjetme në kuptim të parashikimeve ligjore të nenit 125 të KPC-s, në të cilin parashikohet se: "*Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'u përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi*", si dhe nenit 315 të KPC-s, i titulluar "Vendimet e ndërmjetme", në të cilin parashikohet qartësisht se: "*Vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë përfundimtare, mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveç kur në këtë Kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë*".

18. Për këtë arsye, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për lejimin e fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë, është një vendim i ndërmjetëm, pasi me të nuk është shqyrtuar në themel mosmarrëveshja mes palëve, pra nuk i është dhënë fund gjendjes së bashkëpronësisë, e cila merr fund pas fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë, por janë përcaktuar nga gjykata çështjet themelore që do të shqyrtohen në fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë: *(i)* subjektet bashkëpronar; *(ii)* objektit që i nënshtrohen regjimit të bashkëpronësisë (në rastin konkret regjimit të bashkësisë ligjore) dhe *(iii)* pjesët ideale të çdo subjekti bashkëpronar.

19. Për sa më sipër, në kushtet kur pala paditëse E.B. ka ushtruar të drejtën e rekursit ndaj një vendimi të ndërmjetëm të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim atë me procedurë të përshpejtuar, në përputhje me parashikimet e nenit 470 të KPC-s, në të cilin është pasqyruar se: "*Ankimet e veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë*".

B) Në lidhje me shkaqet e paraqitura në rekurs dhe zgjidhjen e çështjes.

20. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji, konstaton se Gjykata e Apelit Durrës pavarësisht faktit se ka pasur të gjitha mundësitë që të evidentonte mangësitë në gjykim që ka lejuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk i ka evidentuar ato dhe ka vijuar shqyrtimin e çështjes duke mos u dhënë përgjigje çështjeve të ngritura në ankim nga pala paditëse dhe duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Nuk rezulton që Gjykata e Apelit Durrës në përputhje me kompetencat dhe funksionet e saj ligjore, si dhe në respektim të përcaktimeve të nenit 467 të KPC-s, të ketë evidentuar saktë faktetdhe rrethanat e çështjes, duke krijuar papajtueshmëri midis të dhënave që kjo gjykatë ka pranuar në vendimin e saj, me aktet shkresore të administruara në dosje.

21. Gjatë gjykimit të çështjes në të dy shkallët e gjykimit, është pranuar fakti se palët ndërgjyqëse në këtë gjykim kanë qenë të lidhur në martesë ligjore që nga viti 1993 deri në vitin 2007, kohë në të cilën kjo martesë ligjore është zgjidhur me vendimin nr. 617, datë 28.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Gjithashtu, është pranuar fakti se, palët ndërgjyqëse gjatë martesës së tyre ligjore kanë pasur dy fëmijë, të cilët, i përkasin vitlindjes 1997 dhe 2002 dhe që kanë qenë të mitur në momentin që palët ndërgjyqëse kanë zgjidhur martesën e tyre ligjore.

22. Pala paditëse në këtë gjykim, pas zgjidhjes së martesës ligjore me të padituri, po në vitin 2007 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me padinë për pjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi me të padituri F.M., pasuri e cila është vendosur gjatë kohës që ata kanë qenë të lidhur në martesë ligjore me njëri-tjetrin. Një ndër pasuritë e pretenduara për pjesëtim në këtë gjykim dhe që është objekt mosmarrëveshjeje dhe kundërshtimi në Gjykatën e Lartë, është edhe pasuria shtëpi dy-kate me sipërfaqe 105.5 m2, e cila ndodhet mbi truallin me sipërfaqe prej 123.3 m2, të ndodhur në lagjen "Kala", Elbasan. Kjo pasuri e paluajtshme rezulton të ketë si burim të origjinës së saj kontratën e shitjes me nr. 2237 rep.dhe nr. 826 kol., datë 10.10.2003, të lidhur midis shitësit S.K. dhe blerësve F.M. dhe L.K..

23. Në kushtet kur kontrata e shitblerjes është lidhur nga ish-bashkëshorti i paditëses gjatë kohës që ka ekzistuar martesa ligjore mes tyre, pala paditëse ka pretenduar se kjo pasuri i nënshtrohet regjimit të bashkësisë ligjore sipas përcaktimeve të nenit 74 të Kodit të Familjes. Për këtë arsye, pala paditëse ka kërkuar pjesëtimin e kësaj pasurie të paluajtshme të përbërë nga pasuri truall dhe ndërtesë, duke thirrur si të paditur në këtë gjykim për këtë pjesë të kërkimit, edhe të paditurin L.K., vëllai i ish-bashkëshortit të saj, i cili figuron si blerës së bashku me F.M. në kontratën e shitblerjes së datës 10.10.2003.

24. Gjatë kohës që kjo çështje ka qenë duke u shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, pranë kësaj gjykate ka filluar një tjetër proces gjyqësor, ku paditësja K.K. ka paditur shtetasit S.K., F.M. dhe L.K., me padinë me objekt "*Njohje e bashkëpronësisë mbi një shtëpi dy-kat, me nr. 15/27 pasurie. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes me nr. 2237 rep. dhe nr. 826 kol., datë 10.10.2003"*. Në këtë gjykim, ka marrë pjesë edhe pala paditëse E.B., e cila ka pasur pozicionin procedural të ndërhyrësit kryesor, në të cilin ka paraqitur padinë me objekt*: "Njohje e bashkëpronësisë mbi pasurinë me nr. 15/27, të ndodhur në Lagjen Kala"*. Për këtë arsye, me vendimin nr. 1259 Regj. Them., datë 05.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur p*ezullimi i gjykimit të padisë objekt konfliktit në këtë gjykim, deri sa të përfundonte shqyrtimi i çështjes tjetër gjyqësore të paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt "Njohje e bashkëpronësisë mbi një shtëpi dy-kat, me nr. 15/27 pasurie. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes me nr. 2237 rep. dhe nr. 826 kol., datë 10.10.2003"së ngritur nga paditësja E.B. deri në përfundim të gjykimit të çështjes civile me objekt të sipërcituar*.

25. Ka rezultuar se me vendimin nr. 667, datë 11.03.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur rrëzimi i padisë së ngritur nga paditësja K.K., si dhe është pranuar padia e ngritur nga ndërhyrësja kryesore E.B., të cilës, i është njohur e drejta e bashkëpronësisë me të paditurit L.K. dhe F.M. në ¼ pjesë, mbi pasurinë ndërtesë me sipërfaqe 105.5 m² dhe truall me sipërfaqe 123.3 m², të ndodhur në lagjen "Kala", Elbasan. Ky vendim rezulton të jetë lënë në fuqi me vendimin nr. 10-2011-640/327, datë 04.05.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës, përsa i takon rrëzimit të padisë, dhe është ndryshuar përsa i përket pranimit të padisë së ndërhyrëses kryesore E.B., në pjesën që i është njohur e drejta e bashkëpronësisë vetëm për truallin me sipërfaqe 123.3 m², duke i rrëzuar padinë për pjesën e ndërtesës.

26. Sipas akteve të administruara në dosje, është bërë me dije se vendimi nr. 10-2011-640/327 datë 04.05.2011 i Gjykatës së Apelit Durrës ka marrë formë të prerë në po të njëjtën datë 04.05.2011, kohë në të cilën është

shpallur nga gjykata (*referojuni fq. 22 të dosjes gjyqësore*), në prezencë të palës E.B. përfaqësuar në gjykim nga Av. B.S. dhe në mungesë të palëve të tjera në këtë gjykim (referojuni fq. 69 të dosjes gjyqësore). Në lidhje me këtë çështje, asnjë prej gjykatave që është investuar në këtë gjykim nuk rezulton të ketë bërë një analizë ligjore nëse vendimi nr. 10-2011-640/327 datë 04.05.2011 i Gjykatës së Apelit Durrës, është vendim i formës së prerë në kuptim të përcaktimeve ligjore të nenit 451 të KPC-s apo jo, pavarësisht shënimit të kryer nga sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për dhënien formë të prerë të këtij vendimi.

27. Në nenin 451 të KPC-s, i titulluar "Vendimi i formës së prerë", është përcaktuar qartësisht se: "*Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij; b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar; ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë*", ndërsa në nenin 451/a po të KPC-s është pasqyruar se: "*Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe*".

28. Në analizë të nenit 451 të KPC-s, Kolegji vlerëson se vendimi nr. 10-2011-640/327, datë 04.05.2011 i Gjykatës së Apelit Durrës, nuk mund të merrte formë të prerë në datën 04.05.2011, pra brenda të njëjtës datë edhe kur është shpallur nga Gjykata e Apelit Durrës. Ligjvënësi ka parashikuar disa raste ligjore kur vendimi merr formë të prerë. Një nga këto raste, është edhe ai i parashikuar në shkronjën "b" të nenit 451 të KPC-s, i cili lidhet me të drejtën e ankimit ndaj vendimit sipas afateve që përcakton ligji. Konkretisht, në nenin 443 të KPC-s, i titulluar "Afati i ankimit" është pasqyruar se: "*Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë. Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë. Afati për të kërkuar rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kundërshtimin e të tretit është 30 ditë. Afati i ankimeve të veçanta është 5 ditë*". Pra, bazuar në pikën 2 të kësaj dispozite, palët të cilat kanë qenë pjesëmarrëse në çështjen civile për të cilën është dhënë vendimi nr. 10-2011-640/327, datë 04.05.2011 i Gjykatës së Apelit Durrës, prezente apo në mungesë në momentin e shpalljes së vendimit, kishin 30 ditë kohë për ta

rekursuar këtë vendim pranë Gjykatës së Lartë.

29. Gjithashtu, ka rezultuar e provuar se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës me nr. 10-2011-640/327, datë 04.05.2011, nuk është një vendim nga ata që përcakton ligji se ndaj tij nuk lejohet ankim. Pavarësisht faktit se në dispozitivin e këtij vendimi, i cili rezulton të jetë administruar në dosjen gjyqësore në formë fotokopjeje, Gjykata e Apelit Durrës nuk është shprehur në dispozitivin e tij për të drejtën e ankimit (pra ushtrimit të rekursit në Gjykatë të Lartë), ky vendim nga natyra e tij është i ankimueshëm pranë një gjykate më të lartë, sipas përcaktimeve të nenit 443, paragrafi i dytë i tij.

30. Në referim të akteve të administruara në dosje, si dhe arsyetimit të vendimeve të dhëna nga të dy gjykatat më të ulëta, rezulton se asnjë prej tyre nuk ka kryer një hetim nëse vendimi me nr. 10-2011-640/327, datë 04.05.2011 i Gjykatës së Apelit Durrës është ankimuar ose jo në një shkallë më të lartë gjykimi, apo nëse palët janë tërhequr nga ankimi që kanë ushtruar. Për këtë arsye, ky Kolegj vlerëson se, vendimi i sipërcituar nuk mund të merrte formë të prerë në datën 04.05.2011, në të njëjtën datë që edhe është shpallur nga gjykata dhe sikurse e kanë pranuar të dy gjykatat më të ulëta. Kolegji vlerëson se, shënimi i vënë nga sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës se vendimi ka marrë formë të prerë në të njëjtën ditë kur ai është shpallur nga gjykata, vjen në kundërshtim flagrant me ligjin konkretisht me përcaktimet e nenit 443, paragrafi i dytë dhe 451, shkronja "b" të KPC-s.

31. Kolegji vlerëson të theksojë faktin se ka *një ndryshim të madh midis cilësimit të një vendimi gjyqësor si "i formës së prerë" në kuptim të nenit 451 të KPC-s, si dhe cilësimit të këtij vendimi si "i ekzekutueshëm" në kuptim të nenit 469 dhe 479 të KPC-s. Pra, referuar përcaktimeve të këtyre dispozitave ligjore, jo çdo vendim i ekzekutueshëm është automatikisht vendim i formës së prerë në kuptim të KPC, ashtu sikurse është qartësisht e provuar se jo çdo vendim i formës së prerë, është detyrimisht i ekzekutueshëm (vendimet deklarative).* Për këtë arsye, me qëllim zgjidhjen e drejtë të çështjes objekt shqyrtimi, si dhe respektimit të parimit për të pasur një proces të rregullt ligjor, të dyja gjykatat më të ulëta duhet të kishin hetuar dhe të kishin analizuar nëse: *(i)* vendimi nr. 10-2011-640/327 datë 04.05.2011 i Gjykatës së Apelit Durrës plotësonte kushtet ligjore për t'u cilësuar si vendim i formës së prerë; *(ii)* në çfarë mënyre ky vendim ndikon në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi, e cila lidhej me pjesëtimin e pasurisë tokë truall me sipërfaqe 123.3 m² dhe ndërtesën dy-kate me sipërfaqe 105.5 m².

32. Qëndrimi i mësipërm i Kolegjit gjen mbështetje edhe në qëndrimin që ka mbajtur Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)

në çështjen *Gjyli kundër Shqipërisë, me nr. 32907/07*, në të cilin është përcaktuar se: "*33. Në këto rrethana, Gjykata është e mendimit se vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit i datës 24 tetor 2006 nuk mund të konsiderohet përfundimtar dhe detyrues, pasi ai ishte i hapur për ankim. Në fakt, procesi i apelimit është pezull para Gjykatës së Lartë. Edhe nëse një ankesë në Gjykatën e Lartë nuk ka efekt pezullues automatik dhe pavarësisht nga kompetencat e Gjykatës së Lartë sipas nenit 479 të KPC-s, Gjykata kujton se neni 6 mbron zbatimin e vendimeve përfundimtare dhe detyruese, dhe jo vendimeve të cilat mund të jenë objekt i kontrollit të mëpasshëm të një gjykate të një niveli më të lartë, dhe, eventualisht, mund të rrëzohen (shih, për shembull, Ouzounis dhe të tjerë kundër Greqisë, nr. 49144/99, § 21, 18 prill 2002; Ioannis Karahalios kundër Greqisë (ven.), nr. 62499/00, 26 shtator 2002; Xheraj kundër Shqipërisë, nr. 37959/02, § 70, 29 korrik 2008). 33. Duke pasur parasysh proceset pezull në Gjykatën e Lartë, çfarë do të thotë që vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës nuk ka efekt res judicata, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është e pranueshme, pasi është e parakohshme dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës…*".

34. Kolegji vlerëson se pretendimi i ngritur nga pala paditëse në rekurs se, gjykatat më të ulëta nuk kanë lejuar pjesëtimin e banesës dy-kate me sipërfaqe 105.5 m² në kundërshtim me ligjin, pasi kjo pasuri figuron ende e regjistruar në regjistrat hipotekorë dhe është vënë në sekuestro nga Zyra e Përmbarimit, është një pretendim që është paraqitur nga pala paditëse edhe në ankimin drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës, për të cilin, kjo palë nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar nga kjo gjykatë. Referuar të dhënave të administruara në dosje, por edhe arsyetimit të vendimeve të dhëna nga të dyja gjykatat më të ulëta, nuk rezulton që këto gjykata të kenë hetuar dhe të kenë evidentuar faktin nëse: *(i)* prona e paluajtshme objekt i këtij gjykimi, ndërtesë me sipërfaqe prej 105.5 m², figuron e regjistruar në regjistrat hipotekorë: *(ii)* cili është titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit është regjistruar kjo pronë; *(iii)* a është deklaruar titulli i pronësisë i pavlefshëm, është ndryshuar ose shfuqizuar në mënyrë të plotë apo të pjesshme të tij; *(iv)* a ka barrë kjo pasuri dhe a është vënë në sekuestro nga ana e Zyrës së Shërbimit Përmbarimor?

35. Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se titulli i pronësisë mbi sipërfaqen ndërtimore, banesa dy-kate me sipërfaqe 105.5 m², është fituar mbi bazën e kontratës së shitblerjes me nr. 2237 rep. dhe nr. 826 kol., datë 10.10.2003, e cila figuron të jetë regjistruar në ZVRPP Elbasan, referuar shkresës me nr. 66/1 prot., datë 19.4.2007 (*shiko faqen 6 të dosjes gjyqësore*) dhe vërtetimit hipotekor datë 11.11.2003 (*shiko faqen 9 të dosjes*

gjyqësore). Gjithashtu, nuk rezulton që nga aktet e administruara në dosje, por edhe nga përcaktimet e vendimit nr. 10-2011-640/327 datë 04.05.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës, të jetë deklaruar pavlefshmëria e kontratës së shitblerjes, apo të jetë ndryshuar në mënyrë të plotë apo të pjesshme të saj, në mënyrë që gjykata të shprehej për përjashtimin e kësaj pasurie nga faza e parë e pjesëtimit të pasurisë, e cila nga pala paditëse është pretenduar sipas përcaktimeve të nenit 74 të Kodit të Familjes.

36. Në këto kushte, nuk rezulton që të jetë arsyetuar nga Gjykata e Apelit Durrës, se përse pasuria shtëpi 2-kate banimi, e cila është fituar gjatë kohës që palët kanë qenë të martuar, nëpërmjet një kontrate të rregullt shitblerjeje e cila edhe është regjistruar në hipotekë, të përjashtohet nga faza e parë e pjesëtimit të pasurisë. Si ndikojnë përcaktimet e vendimit nr. 10-2011-640/327, datë 04.05.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës në çështjen objekt shqyrtimi, përsa kohë ky vendim ka rrëzuar pretendimin për konstatimin pjesërisht të pavlefshëm të kontratës së shitblerjes me nr. 2237 rep. dhe nr. 826 kol., datë 10.10.2003, (e cila përbën titullin e fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri për subjektet L. dhe F.M.), kur nga ana tjetër ka rrëzuar pretendimin e ndërhyrëses kryesore E.B. për njohjen e bashkëpronësisë në ¼ pjesë të kësaj shtëpie 2-kat banimi, bazuar në përcaktimet e nenit 74 të Kodit të Familjes? Nëse vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës është vendim i formës së prerë, a përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) kërkimi për pjesëtimin e shtëpisë së banimit dy-kat me sipërfaqe 105.5 m²?

37. Në dosje është administruar vendimi me nr. 756/07 Regj., datë 17.10.2007 i përmbaruesit gjyqësor "Për pushimin e urdhrit të ekzekutimit të ekzekutuar tërësisht", me të cilin është pasqyruar se është bërë sigurimi i padisë, duke u vendosur sekuestrimi në regj. e pronësisë 8524, me nr. rendor 183, datë 11.11.2003 për pasurinë me nr. 15/27, me sipërfaqe ndërtese 2 kate 105.5 m2 dhe truall 123.3 m², ndodhur në lagjen "Kala", në pronësi të L. dhe F.M.. Asnjë prej gjykatave nuk rezulton që të jetë shprehur në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk e ka analizuar atë se a mund të vijojë e sekuestruar një pasuri, e cila është përjashtuar nga rrethi i pasurive që duhet t'i nënshtrohen fazës së parë të pjesëtimit.

38. Në lidhje me këtë çështje gjykatat nuk kanë bërë asnjë lloj hetimi, duke e anashkaluar tërësisht pretendimin e palës paditëse, megjithëse ky pretendim rezulton të jetë ngritur edhe në ankimin e bërë para Gjykatës së Apelit Durrës dhe të jetë mbështetur në përcaktimet e nenit 74 të Kodit të Familjes. Pala paditëse pretendon pjesëtimin e një pasurie, e cila është vendosur gjatë kohës që palët kanë qenë të lidhur në martesë si dhe figuron e regjistruar në regjistrat publikë. Madje kjo pasuri është vënë në sekuestro nga Shërbimi Përmbarimor për llogari të këtij gjykimi. Për këtë arsye, gjykata duhet të vlerësonte këtë rrethanë në raport me të gjitha faktet dhe rrethanat e tjera të çështjes, dhe t'i jepte përgjigje palës paditëse në lidhje me këtë pretendim, nëse ndikon në zgjidhjen e themelit të çështjes apo jo.

39. Kolegji evidenton faktin se, Gjykata e Apelit Durrës nuk rezulton t'i ketë dhënë përgjigje palës paditëse, edhe në lidhje me pretendimin se, kjo palë duhet të përfitonte nga pjesëtimi i pasurisë së bashkësisë ligjore 5% më shumë se i padituri F.M., referuar përcaktimeve të nenit 103 të Kodit të Familjes, i titulluar "Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi", për sa kohë dy fëmijët e mitur i janë ngarkuar asaj për rritje dhe edukim. Vlen të mbahet në vëmendje fakti se, përcaktimet e Kodit të Familjes në lidhje me pjesëtimin e bashkësisë ligjore, marrin prioritet në zbatim ndaj gjithë dispozitave të tjera ligjore me karakter të përgjithshëm, pasi janë si dispozita me karakter të posaçëm.

40. Konkretisht, në nenin 103 të Kodit të Familjes, është përcaktuar se: "*Pjesëtimi i pasurisë në bashkësinë ligjore bëhet duke u nisur nga barazia e aktivit dhe pasivit të saj. Pasi të jenë zbritur nga bashkësia detyrimet që ajo ka ndaj bashkëshortëve ose të tretëve, pasuria që mbetet ndahet në pjesë të barabarta midis bashkëshortëve. Gjykata, në bazë të nevojave të fëmijëve dhe nga fakti se kujt do t'i besohen ata, mund të vendosë në favor të një bashkëshorti kalimin e një pjese të pasurisë së bashkësisë që i takon bashkëshortit tjetër*". Në analizë të kësaj dispozite, Kolegji vlerëson se, ligjvënësi kur ka përcaktuar në Kodin e Familjes se njëri nga bashkëshortët mund të marrë nga bashkësia ligjore një pjesë më të madhe sesa bashkëshorti tjetër, pasi të jenë zbritur detyrimet që ajo ka ndaj të tretëve, ka pasur në vëmendje pikërisht nevojat e fëmijëve që i janë ngarkuar njërit prej prindërve për rritje dhe edukim.

41. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se gjykata duhet ta kishte marrë në shqyrtim këtë çështje, nisur nga fakti se fëmijët e ndërgjyqësve E.B. dhe F.M. kanë qenë minorenë në momentin e paraqitjes së kësaj padie dhe dhënies së vendimit objekt kundërshtimi në rekurs. Gjykatat kishin detyrimin ligjor që të hetonin rreth nevojave të fëmijëve të mitur që i janë lënë paditëses në ngarkim, si dhe të argumentonin se në çfarë mënyrë ndikonin këto nevoja për të bërë ndarjen e pasurisë mes dy ish bashkëshortëve, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve të mitur. Në këtë drejtim, konstatohet se asnjë prej gjykatave më të ulëta jo vetëm që nuk i kanë dhënë përgjigje paditëses për këtë pretendim, i cili lidhet me themelin e gjykimit, por këto gjykata as nuk kanë hetuar në lidhje me të, duke mos i garantuar palës paditëse të drejtën për të pasur një proces të rregullt ligjor, brenda kufijve të pretendimeve të saj.

42. Bazuar sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se, në rekursin e

paraqitur nga pala paditëse E.B. janë ngritur shkaqe nga ato që parashikon neni 472, shkronja "c" e KPC-s, e cila e bën të cenueshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës.

43. Gjykata e Apelit Durrës, ndonëse i ka pasur të gjitha mundësitë ligjore që të konstatonte të metat e gjykimit në shkallë të parë dhe t'i ndreqte ato, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe materiale për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, duke anashkaluar sqarimin plotësisht të rrethanave ligjore që lidhen me gjykimin e çështjes, si dhe nuk ka analizuar dhe nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve të paraqitura nga palët në proces, pretendime të cilat kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi. *Fakti që gjykatat më të ulëta nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ka sjellë si pasojë edhe mungesën e arsyetimit të vendimeve dhe zgjidhjen përfundimtare të saj.*

44. *Kolegji vlerëson të evidentojë faktin se, sipas të drejtës procedurale civile, vendimi gjyqësor duhet të jetë rrjedhojë e një analize të qartë, të plotë e të gjithanshme të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, në përputhje me provat e administruara gjatë procesit gjyqësor për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Një rëndësi të madhe në hartimin e vendimit gjyqësor, ka pikërisht pjesa përshkruese arsyetuese e tij. Kjo pjesë e vendimit gjyqësor, nisur dhe nga rëndësia që paraqet, duhet të përmbajë qartë zhvillimin e procesit, çështjet e diskutuara, pretendimet e palëve, paraqitjen e plotë dhe të saktë të fakteve, të cilat kanë rëndësi për çështjen, provat e administruara dhe të debatuara gjatë gjykimit, që kanë çuar në formimin e bindjes së brendshme të gjykatës, analizën juridike të përdorur nga gjykata dhe mbi të cilën ajo është bazuar për të arritur në përfundimin përkatës, parimet e së drejtës që janë përdorur prej saj etj.,. Arsyetimi i vendimit gjyqësor, në kuptimin formal dhe material, nënkupton pikërisht trajtimin e të gjithë elementëve të trajtuar më sipër.*

45. Arsyetimi i vendimit gjyqësor, është detyrim kushtetues i përcaktuar qartë në nenin 142, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin, shprehimisht thuhet se: "*Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara*". Ky detyrim kushtetues, përbën një garanci për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor nga ana e gjykatave. Arsyetimi i vendimit është një garanci kushtetuese që çështja është shqyrtuar me hollësi dhe përgjegjshmëri nga ana e gjykatës, dhe se kjo e fundit, pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm ka dhënë një vendim të bazuar në ligj. Arsyetimi i vendimit është një kusht i domosdoshëm edhe për shqyrtimin që do t'i bëjnë çështjes gjykatat me të larta, në rastin konkret Gjykata e Lartë.

46. Mungesa e një hetimi të plotë të çështjes në dy shkallët më të ulëta të gjykimit, e vë Gjykatën e Lartë si një gjykatë ligji, në pamundësi për ta

zgjidhur këtë çështje në themel të saj, brenda kufijve të saj të gjykimit, duke u fokusuar në një interpretim përfundimtar të mënyrës sesi duhet të aplikohet dhe të zbatohet ligji në këtë rast si dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me përcaktimet e nenit 485, shkronja "a" "b" dhe "ç". Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se çështja duhet të kthehet për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit Durrës, e cila duhet të riçelë shqyrtimin gjyqësor të saj në përputhje me përcaktimet e nenit 467 të KPC-s dhe të plotësojë të gjitha të metat në hetim që janë evidentuar në paragrafët 33, 35, 36, 37, 38, 39, 40 dhe 41 të këtij vendimi, në përputhje me përcaktimet e 465 të KPC-s, në të cilin përcaktohet se: "*Në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e apelit mbahen parasysh për aq sa janë të zbatueshme dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë*".

47. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Durrës duhet t'u bëjë të qartë palëve se është detyrë e secilës prej tyre që, në përputhje me ligjin, të provojnë faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet për të drejtat që kërkojnë. Palët, ashtu siç kanë të drejta, kanë dhe detyrime që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara me ligj. Gjykata duhet të lejojë palët që të paraqesin prova shkresore me anën e të cilave, ato të provojnë pretendimet e tyre bazuar në nenin 12 dhe 19 të KPC-s dhe t'i lejojë palët që t'ia nënshtrojnë këto prova hetimit e debatit gjyqësor. Gjithashtu, gjykata duhet të mbajë në vëmendje dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 5, 6, 95, 120 të KPC-s dhe brenda kufijve ligjore që përcaktohen në nenin 467 të KPC-s, si dhe t'i japë zgjidhje përfundimtare asaj në përputhje edhe me praktikën gjyqësore të konsoliduar në shqyrtimin e kësaj natyre mosmarrëveshjeje. Kryerja e veprimeve të përmendura më sipër, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të lindin gjatë rigjykimit, do të lejojnë gjykatën të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes.

48. Për sa më sipër, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk i hyn analizës së provave, gjë që duhet ta bëjnë dy gjykatat e tjera të niveleve më të ulëta, por ajo vetëm evidenton shkeljet ligjore që kanë lejuar këto dy gjykata, qoftë të normave procedurale apo atyre materiale, duke kërkuar respektimin e tyre. Në rrethanat kur gjykata e apelit i ka të gjitha mundësitë ligjore të marrë në shqyrtim dhe të zgjidhë mosmarrëveshjen objekt gjykimi, Kolegji, vlerëson të prishë vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës dhe të dërgojë çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me një trupë tjetër gjykuese.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1082 (38), datë 05.07.2021

Gjykata e apelit ka juridiksion të plotë rishikues ligji dhe fakti dhe si rrjedhojë, nuk mund të kthejë çështjen për rigjykim për hetim të paplotë apo për vlerësim të gabuar të rrethanave të faktit dhe provave, por duhet ta gjykojë vetë çështjen në themel dhe nëse vlerëson ndryshe provat e administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, mund të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur një padi me objekt përmbushje detyrimi dhe shpërblim dëmi.

2. Palët ndërgjyqëse janë në një marrëdhënie të posaçme midis tyre, marrëdhënie krushqie. Paditësi, Xh.B. ka pretenduar se në periudha të ndryshme kohe, që prej vitit 2008 e në vijim, për shkak të marrëdhënieve të miqësisë, i ka dhënë të padituri M.C.një shumë të hollash që arrin në vlerën 58.000 euro. [...] Paditësi ka pretenduar se, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të tij, pala e paditur nuk ia ka kthyer këtë shumë.

3. Paditësi i është drejtuar fillimisht organit të prokurorisë me anë të një kallëzimi penal ndaj shtetasit M.C. për veprën penale të mashtrimit, sipas nenit 143/1 të KP.

4. Në kuadrin e verifikimit të kallëzimit, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i padituri, para oficerit të policisë gjyqësore ka pohuar dhe ka pranuar detyrimin që ka ndaj paditësit, por në vlerën 40000 euro. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me vendimin e vitit 2010. Në vendimin e prokurorit janë pasqyruar deklarimet e palës së paditur e cila e njeh detyrimin.Është vlerësuar se fakti nuk përbën vepër penale, por është marrëdhënie juridiko-civile.

5. Po ashtu gjatë gjykimit në shkallë të parë, pala e paditur, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka pohuar të njëjtin fakt, se ka detyrim ndaj paditësit, por detyrimi është në një masë më të vogël nga sa ka pretenduar paditësi, konkretisht në vlerën 40000 euro. Ai ka argumentuar se për shkak të vështirësive ekonomike, nuk ka mundur dot të shlyejë detyrimin që ka ndaj paditësit.

6. Gjykata e shkallës së parë ka administruar si prova dosjen penale dhe aktet e fashikullit të hetimit penal janë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit civil.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8299, datë 02.11.2015, ka vendosur: "*1. Pranimin e padisë; 2. Detyrimin e të padituri M.C. që të paguajë në favor të paditësit Xh.B. shumën prej 58260 euro; [...]*

9. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim, pala e paditur, M.C., i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. [...]

10. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 283, datë 08.02.2017, ka vendosur: "*1.Prishjen e vendimit [...]dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.*".

11. Gjykata e Apelit e ka bazuar vendimin e saj në nenin 467/e të KPC. Ajo ka arsyetuar se, gjykata e shkallës së parë ka lejuar shkelje procedurale lidhur me vlerën monetaredhe mënyrën e marrjes së provave. Po ashtu, vendimi i kësaj gjykate është i paarsyetuar, pasi nuk janë marrë në analizë faktet dhe provat, si dhe nuk del se ku bazohet konkluzioni i saj. Gjithashtu, në vendimin e gjykatës nuk cilësohen se cilat janë aktet shkresore të administruar dhe që kanë çuar në këtë përfundim, që në fakt nuk e pretendohet as nga vetë paditësi.

12. Gjykata e shkallës së parë e ka bazuar vendimin në prova që nuk janë të lejueshme dhe të përdorshme në gjykimin civil, sikurse janë deklarimet e dhëna para oficerit të policisë gjyqësore. Sipas nenit 70 të KPP, vetëm vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën civile përsa i përket faktit se vepra penale është kryer dhe është kryer nga i gjykuari. Në rastin konkret, procedimi penal nuk ka përfunduar me një vendim penal të formës së prerë, por me mosfillim të procedimit penal. Veprimi hetimor, i deklarimit të palës së paditur para oficerit të policisë gjyqësore, nuk ka vlefshmërinë e provës në gjykimin civil, madje nuk mund të përbënte provë as në procesin penal, pasi ajo formësohet gjatë gjykimit, pas debatit të palëve. KPC ka parashikuar saktësisht se cilat janë provat në gjykimin civil dhe deklarimet e palëve para oficerit të policisë gjyqësore nuk janë të parashikuara në ligj.

13. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs pala paditëse [...], ecila ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.[...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

14. Kolegji Civil (në vijim, Kolegji), fillimisht çmon të marrë në analizë faktin se rekursi është regjistruar pranë Gjykatës së Lartë më datë 26.05.2017.

Mbi kërkesën e palës rekursuese, gjyqtari relator ka miratuar shqyrtimin e çështjes me përshpejtim, pasi ka vlerësuar se plotësohen me analogji kriteret sipas Vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim,Vendimi nr. 78). Në marrjen e këtij vendimi të ndërmjetëm gjyqtari relator mbajti parasysh faktin se në rastin konkret nuk ka një vendimmarrje përfundimtare nga gjykata e apelit mbi mosmarrëveshjen dhe plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 3.1/e të Vendimit nr. 78, për gjykimin me përparësi të saj.

15. Në këto kushte, çështja u planifikua për t'u shqyrtuar në dhomë këshillimi më datë 05.07.2021 dhe si rrjedhojë, Gjykata e Lartë procedoi me njoftimin individual të palëve, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, bazuar në parashikimet e nenit 460 të KPC, të ndryshuar.

16. Kolegji vlerëson se rekursi i paditësit ngre shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-s, të tilla që e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë. Ky vendim është marrë në shkelje të ligjit procedural dhe si i tillë është i pavlefshëm. Nuk ka asnjë shkak të ligjshëm në refuzimin e Gjykatës së Apelit Tiranë për zgjidhjen e çështjes në themel. Në këto kushte, Gjykata e Lartë duhet të vendosë prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit pranë kësaj gjykate.

17. Kolegji vlerëson se pamjaftueshmëria e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk mund të jetë shkak për prishjen e vendimit objekt ankimi dhe, për rrjedhojë, nuk mund të jetë shkak për kthimin e çështjes për rigjykim. Gjykata e apelit nuk mund të krijojë vetë shkaqe për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë tej atyre që parashikon neni 467 i KPC. Në rastet kur, gjykata më e lartë konstaton arsyetim të metë dhe të pamjaftueshëm të gjykatës më të ulët, duhet ta ndreqë vetë këtë të metë procedurale të vendimit e cila është e konvalidueshme.

18. Qëllimi i ligjvënësit në parashikimet e nenit 467 të KPC, është të garantojë parimin e ekonomisë procedurale dhe të ruajtjes së veprimeve procedurale që nuk varen nga shkaqet e pavlefshmërisë. Megjithatë, parimi i kthimit të akteve gjykatës së shkallës së parë është taksativ vetëm për sa u takon shkaqeve të parashikuara shprehimisht në këtë dispozitë. Prandaj disponimi i gjykatës së apelit sipas shkaqeve që parashikohen në nenin 467 të KPC, duhet të arsyetohet në mënyrë të detajuar, duke shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme rastin e pavlefshmërisë të parashikuar nga norma, si dhe llojin dhe regjimin e kësaj pavlefshmërie, eventualisht aktet e mëpasshme që varen nga akti që është deklaruar i pavlefshëm dhe përsëritjen e tyre, kur është e nevojshme (*shih për analogji vendimin nr. 00-2016-449 (52), datë 23.03.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, etj.,.*).

19. Gjykata e Apelit Tiranë e ka bazuar vendimin e saj në pikën "e" të nenit 467 të KPC, por nuk arsyeton konkretisht se cila provë është e pamundur të merret në gjykimin në apel. Po ashtu, nga kjo gjykatë nuk është zbatuar drejt KPC, duke konkluduar gabimisht mbi papranueshmërinë e deklarimeve para oficerit të policisë gjyqësore, në cilësinë e provës në gjykimin civil. Sigurisht, që nuk është në juridiksionin e Gjykatës së Lartë të gjykojë mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat më të ulëta, por është detyrimi i kësaj të fundit të bëjë interpretimin përfundimtar të ligjit procedural në lidhje me procedurën e formimit të provave e kualifikimin juridik të tyre dhe po ashtu, të orientojë gjykatat më të ulëta se cilat janë kriteret ligjore mbi të cilat do të bazohen për të bërë vlerësimin e tyre (*shih vendimin nr. 23, datë 15.03.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

20. Procesi i të provuarit sipas KPC kalon nëpër dy faza: 1) lejueshmërinë e provës në gjykim dhe debatin e palëve mbi to; 2) vlerësimin e tyre nga gjykata, sipas neneve 29 dhe 309/2 të KPCProvat pranohen dhe mund të bëhen pjesë e shqyrtimit gjyqësor vetëm nëse plotësojnë dy kushte: 1) ligjshmërinë; 2) relevancën.

21. Kushtet e lejueshmërisë së provave, në çdo rast, vlerësohen nga gjykata e cila me vendim të ndërmjetëm (sipas neneve 183 dhe 213 të KPC), vendos t'i bëjë pjesë të procesit gjyqësor ose t'i refuzojë ato. Ligjshmëria e mjeteve të provës, nënkupton jo vetëm ligjshmërinë e procedurës së formimit të provës por edhe ligjshmërinë e përmbajtjes së saj, e cila nuk duhet të cenojë të drejtat dhe liritë e palëve dhe të të tretëve në procesin gjyqësor civil, interesin publik, sekretin shtetëror etj.,.

22. Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Apelit Tiranë, KPC nuk ka sanksionuar parimin e tipicitetit të provës. Ai nuk ka parashikuar në mënyrë shteruese mjetet e provës që mund të përdorin palët në gjykimin civil, në kuadër të paraqitjes së çështjes së tyre para gjykatës. Çdo lloj prove që nuk është përjashtuar në mënyrë të shprehur nga ligji, pranohet kur ka lidhje me objektin e gjykimit.

23. Një interpretim i tillë rezulton nga parashikimi i nenit 11 të KPC, i cili me ndryshimet e vitit 2017, theksoi se burimet e formimit të provës në gjykimin civil nuk gjenden të rregulluara vetëm nga KPC, por edhe në ligje të tjera. Konkretisht, në këtë dispozitë thuhet se: "*Provat janë të dhëna që merren prej burimeve dhe sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod dhe ligje të tjera, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces*".

24. Nga ana tjetër, përgjithësisht provat atipike, më shumë se prova të paparashikuara nga ligji, janë prova që mbartin elementë miks të provave tipike. Kështu, duke pasur parasysh se, tipiciteti i mjetit provues ka të bëjë jo

vetëm me formën por edhe me përmbajtjen, (elemente këto që përcaktojnë statusin ligjor të provës), provat atipike mund të kenë formën e një prove të caktuar, ndërsa në përmbajtje ka elemente të një prove tjetër. Kështu p.sh., deklaratat e shkruara të të tretëve jo pjesëmarrës në proces, kanë formën e shkresave private, por në përmbajtje kanë elemente të dëshmisë, për sa kohë mund të jenë deklarime të personave të painteresuar në përfundimin e çështjes mbi faktet për të cilat ata kanë dijeni. Si rrjedhojë, mund të thuhet se, për provat atipike do të zbatohen rregullat ligjore të zbatueshme për provat tipike korresponduese. Në praktikën e Gjykatës së Lartë, prova të tilla janë kualifikuar si kuazi-dëshmi (*shih vendimin nr.136, datë 21.03.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendim nr. 23, datë 15.03.2018 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.,.*).

25. Ndër provat atipike mund të renditen provat e formuara në procese të tjera gjyqësore, civile, penale apo administrative. Në KPCitalian, parashikohet se kanë vlerën e indicieve provat e mbledhura në proceset e tjera, (*shih nenin 310 të KPC të Republikës së Italisë*), duke iu nënshtruar vlerësimit të lirë të gjykatës (*shih vendimin nr. 9902, dt. 6 tetor 1998 i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë*).

26. Sipas Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë, (shih vendimin nr. 13619, dt. 11 Qershor 2007; vendimin nr. 21115, dt. 31 tetor 2005 i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë etj.,), në thelb gjyqtari ka një diskrecion të gjerë në lidhje me marrjen e provave të formuara në një proces tjetër civil, penal apo administrativ, midis atyre palëve apo midis personave të tjerë. Pra, provat e formuara në procese të tjera i nënshtrohen vlerësimit kritik të gjyqtarit. Kështu p.sh. akti i ekspertimit i realizuar gjatë procesit penal, mund t'i shërbejë gjykatës civile si ekspertizë jashtëgjyqësore, për të vlerësuar aktin e ekspertimit të realizuar në procesin civil. Po ashtu, pohimet e bëra gjatë procesit penal kanë vlerën e pohimeve jashtëgjyqësore në gjykimin civil etj.,.

27. Së fundi, Kolegji vlerëson se duhet bërë dallimi midis provave atipike dhe provave të paligjshme. Të parat janë prova të paparashikuara nga ligji, por burimi i formimit të tyre nuk është në vetvete i paligjshëm. Ndërsa të dytat janë prova të parashikuara nga ligji, por të marra në shkelje të kufijve të vendosur nga normat e së drejtës materiale apo procedurale. Mund të jenë të paligjshme provat e krijuara me mjete penalisht të dënueshme apo në shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Të tilla mund të jenë provat të cilat *ex se* janë marrë sipas një procedure të parregullt dhe të paligjshme (*p.sh. regjistrimet në shkelje të privatësisë etj.,.*).

28. Një nga mjetet tipike të provës të lejueshme në gjykimin civil janë pohimet e palëve. KPC, në nenin 214 ka parashikuar se: "*Pohimet e bëra në gjykatë prej palëve apo prej përfaqësuesve të tyre, çmohen nga gjykata pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes*".

29. Në doktrinën juridike, pohimi në procesin gjyqësor civil është përkufizuar si deklarata me anë të së cilës pala pranon si të vërteta faktet që janë të disfavorshme për të dhe të favorshme për palën tjetër. Objekt i pohimit janë faktet juridike, ato që në thelb përbëjnë *thema probandum* gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat themelojnë objektin e mosmarrëveshjes në kuptim të nenit 5 të KPC-s, të kontestueshme dhe relevante për zgjidhjen e çështjes.

30. Pohimet, nga doktrina dhe nga ligji, ndahen në pohime jashtëgjyqësore dhe në pohime gjyqësore. Kjo ndarje merr si kriter faktin se ku formësohet apo ku është formësuar pohimi gjyqësor. Pohimet jashtëgjyqësore formësohen jashtë procesit gjyqësor dhe mund të bëhen në mënyrë verbale apo mund të fiksohen në shkresa. Barrën e provës për pohimin jashtëgjyqësor, e ka pala në dobi të së cilës ai është bërë, sipas parimit të sanksionuar në nenin 12 të KPC-s.

31. Në varësi të burimit apo mënyrës se si artikulohet pohimi jashtëgjyqësor, ai mund të provohet në proces nëpërmjet mjeteve të tjera provuese të parashikuara nga KPC si: shkresat, dëshmia indirekte, e cila lidhet me informacione apo të dhëna, për të cilat dëshmitari ka marrë dijeni prej njërës palë të procesit (*de relato ex parte actoris)*,etj.,. Sakaq, në lidhje me të, do të zbatohen rregullat për pranueshmërinë dhe formimin e mjetit provues, ku pohimi është fiksuar. Pohimi jashtëgjyqësor merr vlerë relative provuese dhe gjykata e vlerëson lirisht një pohim të tillë duke e bashkuar në tërësinë e të gjitha provave dhe rrethanave të tjera të çështjes.

32. Nga ana tjetër, pohimi gjyqësor formohet para gjykatës. Pohimi gjyqësor mund të jetë i rastit ose i nxitur. Pohim i nxitur është ai që bëhet nëpërmjet pyetjeve të bëra në mënyrë zyrtare nga gjykata për një qëllim të tillë (neni 281 i KPC-s). Është rasti i pohimit që del përgjatë shpjegimeve të palëve në seancë përgatitore ose gjyqësore, nëpërmjet veprimeve dhe akteve procedurale të kryera prej palëve gjatë procesit (nenet 182 dhe 282 të KPC-s). Pohimi gjyqësor i nxitur, del gjatë pyetjes të organizuar qëllimisht për të nxjerrë pohimin nën një procedurë formale solemne gjyqësore (neni 283 i KPC-s).

33. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vlerëson se është i pabazuar në ligj arsyetimi i Gjykatës së Apelit Tiranë se gjykata e shkallës së parë e ka bazuar vendimin në prova të palejueshme në gjykimin civil.

34. *Deklarimet që ka bërë pala e paditur para oficerit të policisë gjyqësore, në kuadër të procedimit penal duhet të kualifikohen si pohime jashtëgjyqësore.Burimi i formimit të tyre nuk është i paligjshëm, pasi ato janë dhënë para një funksionari publik në ushtrim të detyrave të tij*

ligjore. Aktet e fashikullit penal dhe po ashtu vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, ku janë fiksuar pohimet jashtëgjyqësore të palës së paditur, në gjykimin civil, janë të lejueshme në cilësinë e provës me shkresë. Në rastin konkret jemi para një prove me elementë miks, të provës shkresore në formë dhe pohimit jashtëgjyqësor në përmbajtje. Të dyja këto janë burime prove tipike të parashikuara në KPC.

35. Shkresat ku janë fiksuar pohimet jashtëgjyqësore të palës së paditur në rastin konkret, sipas neneve 253 dhe 254 të KPC kanë fuqi të plotë provuese për mënyrën se si është deklaruar para organeve të procedimit penal, por jo për përmbajtjen e deklaratës, e cila i nënshtrohet vlerësimit të lirë të gjykatës.

36. Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Apelit Tiranë mbi vlerën provuese që ka vendimi i mosfillimit të procedimit penal nga prokurori, në praktikën e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, është pranuar se ky vendim as nuk ka vlerë të paracaktuar, por as nuk mund të përjashtohet *apriori* në gjykimin civil (*shih vendimin nr. 23, datë 15.03.2018 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

37. *Një vendimmarrje e tillë e prokurorit, ndryshe nga vendimi penal i formës së prerë sipas nenit 70 të KPPnuk ka fuqi detyruese për gjykatën civile, për kualifikimet juridike dhe konkluzionet e arritura nga prokurori mbi ekzistencën e faktit objekt mosmarrëveshje, por është burim informacioni dhe ka vlerë provuese për të dhënat e grumbulluara nga prokurori në fazën e hetimit paraprak në kushtet e parashikuara në nenin 253 dhe 254 të KPC.*

38. E thënë ndryshe, për rastin konkret, vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal sipas nenit 254 të KPC-s, është shkresë me fuqi të plotë provuese për mënyrën se si ka deklaruar pala e paditur, para organeve të procedimit penal, konkretisht se e njeh detyrimin karshi paditësit, por jo për vërtetësinë e kësaj deklarate, nëse e ka marrë apo jo vërtet këtë shumë nga pala paditëse. Ky fakt do debatohet në gjykimin civil dhe do i nënshtrohet vlerësimit të lirë nga gjykata civile, duke u kualifikuar deklarata e palës së paditur para oficerit të policisë gjyqësore si pohim jashtëgjyqësor dhe do të vlerësohet si i tillë.

39. E njëjtë do të ishte situata nëse një deklaratë e tillë do të ishte bërë nga pala e paditur para noterit publik. Akti noterial në rastin konkret do të përbënte shkresë me fuqi të plotë provuese sipas nenit 253 të KPC-s, në procesin gjyqësor, për elementët e parashikuar në këtë dispozitë, për mënyrën se si kanë deklaruar palët, datën, faktet e ngjara para funksionarit publik, por jo për vërtetësinë e deklaratës.

40. Për më tepër, që në rastin konkret, pala e paditur të njëjtin fakt, e ka pohuar edhe gjyqësisht gjatë gjykimit në shkallë të parë, se e njeh detyrimin që ka ndaj paditësit, duke kontestuar vetëm vlerën e detyrimit të pretenduar prej tij. Edhe në mungesë të deklarimeve para oficerit të policisë gjyqësore, një deklaratë e tillë e palës së paditur, duhet të kualifikohej si pohim gjyqësor nga Gjykata e Apelit Tiranë.

41. Në doktrinën juridike shqiptare, është pranuar se nuk nevojitet prova për faktet e pranuara njëzëri nga të dyja palët ose të parashtruara nga një palë, por të pranuara nga pala tjetër. Në sistemin akuzator, pohimi i palës kundërshtare e çliron palën e detyruar për të provuar faktet nga barra e provës dhe faktet e pranuara nuk përbëjnë objekt prove. Në këtë sistem, e vërteta gjyqësore është një e vërtetë relative, probabël, siç serviret nga palët në proces, sipas vlerësimit që ato u bëjnë interesave të tyre ngushtësisht private. Në këtë aspekt, nëse palët nuk kanë kontestime në lidhje me disa fakte, nuk ka mosmarrëveshje për t'u zgjidhur nga gjykata dhe për gjykatën faktet e pranuara nga palët duhet të konsiderohen si të vërteta. Natyra akuzatore dhe parimi i disponibilitetit të të drejtave rrjedh nga neni 11 i Kushtetutës, apo nga filozofia kushtetuese individualiste dhe liberaliste e qarkullimit civil.

42. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se shqyrtimi gjyqësor dhe hetimi duhet të orientohej nga gjykata vetëm për pjesën e kontestuar të vlerës së detyrimit. Nëse paditësi nuk përmbush barrën e provës për vlerën e kontestuar të detyrimit nga pala e paditur, padia eventualisht duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova.

43. *Kolegji vlerëson se çdo gjykatë apeli është me juridiksion të plotë rishikues ligji dhe fakti dhe si rrjedhojë, nuk mund të kthejë çështjen për rigjykim për hetim të paplotë apo për vlerësim të gabuar të rrethanave të faktit dhe provave, por duhet ta gjykojë vetë çështjen në themel dhe nëse vlerëson ndryshe provat e adminstruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, mund të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë* (*shih, Vendim nr. 00-2015-1350 i Vendimit (183) dt.08.04.2015; Vendim nr.160, datë 06.04.2010; Vendim nr. 00-2015-1589 i Vendimit (225), dt. 29.04.2015; Vendim nr.00-2015-1350 i Vendimit (183) dt.08.04.2015; Vendim nr.00-2013-1388 i Vendimit (329), dt. 28.05.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.,.*).

44. Sa më sipër u arsyetua, Kolegji konkludon se Gjykata e Apelit Tiranë duhet të marrë çështjen në shqyrtim dhe të zgjidhë mosmarrëveshjen në themel. Në rigjykim Gjykata e Apelit Tiranë duhet të mbajë parasysh orientimet e Gjykatës së Lartë mbi interpretimin e dispozitave të KPC, në lidhje me kualifikimin juridik të provës dhe kriteret ligjore mbi vlerësimin e tyre.

45. Përsa i përket ritit të gjykimit dhe mënyrës së disponimit nga Gjykata e Lartë, Kolegji vlerëson se me Ligjin nr. 44/2021, nenet 482/1 dhe nenet 485 të KPC pësuan ndryshime, duke i njohur të drejtën Gjykatës së Lartë që si rregull të shqyrtojë dhe të vendosë përfundimisht mbi çështjet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh. Për rastin konkret, edhe pse rekursi është paraqitur para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 44/2021, sipas dispozitave kalimtare të tij, mbi përbërjen e trupës gjykuese dhe procedurën e gjykimit në Gjykatën e Lartë do të zbatohet ligji procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të rekursit.

Vendim i Kolegjit Civil, Nr. 00-2021-1085, datë 05.07.2021

Një gjykatë me juridiksion rishikues duhet të marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur nga palët e paditura, brenda kufijve të tij dhe sipas parimeve të disponibilitetit dhe të prekluzitivitetit të pretendimeve.

Vetëm ndërgjyqësi drejtpërdrejt i legjitimuar mund të ushtrojë ankim ndaj çdo vendimi gjyqësor. Nga ana tjetër gjykata, në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, është pasive, me përjashtim të rasteve kur ligji i ka dhënë pushtet në mënyrë të shprehur.

Jo çdo parregullsi e procesit, e lejuar nga gjykata më e ulët, mund të shkaktojë pavlefshmërinë e gjykimit. Gjithashtu, vendimi gjyqësor nuk ka efekt për të tretët që janë jo pjesëmarrës dhe mosthirrja e tyre në gjykim nuk është shkak për prishjen e vendimit të gjykatës më të ulët.

Paanshmëria objektive e gjyqtarit lidhet me qëllimin dhe natyrën e veprimeve që ai /ajo kryen gjatë procesit gjyqësor. Vendimmarrjet e mëparshme apo njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk mjaftojnë për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij.

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësit M.B. dhe I.B. janë trashëgimtarë ligjorë të subjekteve të shpronësuar. Këta të fundit janë vëllezër dhe trashëgimtarët e vetëm të babait të tyre [...] Këto pasuri u janë shtetëzuar në vitin 1945, bazuar në Ligjin nr. 108 datë 01.08.1945 "Për reformën agrare". Për këtë arsye trashëgimtarët ligjorë të tyre, kanë aplikuar për t'u trajtuar në kuadër të Ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish-pronarëve".

2. Pas ezaurimit të rrugës administrative dhe gjyqësore si dhe për shkak se ligji i kohës lejonte vetëm kthimin fizikisht të pasurisë "truall", deri në një sipërfaqe të caktuar, me vendimin nr. 8 datë 01.04.1999 Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur: "*Anulimin e vendimit nr. 388, datë 18.12.1995 të KKKP Vlorë dhe njohjen e bashkëpronësisë të trashëgimtarëve [...]. Pushimin e gjykimit përsa i përket njohjes së pronësisë mbi kullotat...*".

3.Për këtë arsye, trashëgimtarët ligjorë të subjekteve të shpronësuar [...] janë bërë pronarë (në formën e bashkëpronësisë) mbi një pasuri të paluajtshme të përbërë nga një ndërtesë prej 48 m2 dhe një sipërfaqe trualli prej 1150 m2, duke kryer edhe regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat përkatës hipotekorë pranë ZVRPP Vlorë. [...]

4. Po ashtu, ka rezultuar se me vendimin nr. 2762, datë 19.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur vërtetimi i faktit juridik i bashkëpronësisë së trashëgimlënësve S.B., J.B. dhe Sh.B. mbi sipërfaqet prej 188 ha dhe 315 ha, sikurse individualizohen më sipër.

5. Sa më sipër, trashëgimtarët ligjorë të subjekteve S. dhe J.B., bazuar në dispozitat e ligjit nr. 7699, datë 21.04.1993 "Për kompensimin në vlerë të ose me troje të ish-pronarëve të tokave bujqësore, livadheve, kullotave, tokave pyjore dhe pyjeve", i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" (me të gjitha ndryshimet në kohë), kanë kërkuar brenda juridiksionit administrativ (pranë ish-KKKP pranë Këshillit të Qarkut Vlorë; ish-KVKK Pronave Qarku Vlorë dhe së fundi AKKP-së Tiranë), për t'u trajtuar në lidhje me pronat tokë pyll dhe kullotë të emërtuar "Shën-Vasi" dhe "Shën-Jan".

6. Me vendimin nr. 234, datë 28.07.2006 të KVKKP Qarku Vlorë, është vendosur: *"Njohja e të drejtës së pronësisë subjektit të shpronësuar [...]; Njohjen e të drejtës së kompensimit për këtë pronë..."*.

7. Me vendimin nr. 235, datë 28.07.2006 të KVKKP Qarku Vlorë, është vendosur: *"Njohja e të drejtës së pronësisë subjektit të shpronësuar [...] Njohjen e të drejtës së kompensimit për këtë pronë..."*.

8. Të dy këto vendime të dhëna nga ish-KVKKP QarkuVlorë janë kundërshtuar në rrugë administrative nga trashëgimtarët ligjorë të subjektit S.B., bashkuar në këtë ankim edhe trashëgimtarët ligjorë të subjektit J.B., duke u pretenduar kthimi fizik i këtyre sipërfaqeve si dhe rregullimi i rrethit të përfituesve si subjekte të shpronësuar, pasi KVKKP/Vlorë ishte shprehur vetëm për subjektin S.B. dhe jo edhe për subjektin J.B., i cili ishte bashkëpronar në ½ pjesë me të, në të gjitha pasuritë trashëgimore që vinin nga trashëgimlënësi i tyre.

9. Nga viti 2006, kohë në të cilën janë kundërshtuar këto vendime në rrugë administrative e deri në momentin e ngritjes së padisë, paditësit kanë pretenduar se nuk kanë marrë asnjë vendim përfundimtar nga AKKP-ja në lidhje me të drejtën e pronësisë dhe kthimin fizik të pasurive objekt gjykimi, pavarësisht kërkesave të shumta të tyre për të marrë zgjidhje në lidhje me to. Pala paditëse ka pretenduar se ka plotësuar të gjitha kërkesat ligjore dhe hartografike që parashikonte Ligji nr. 9235/2004 i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari. Megjithatë, të gjitha aktet

e nxjerra në formën e vendimeve apo urdhrat nga ana e AKKP-së në lidhje me këtë çështje, kanë qenë akte me karakter të ndërmjetëm, të cilat nuk i kanë dhënë zgjidhje shteruese pretendimeve të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar.

10. Nga ana tjetër, ka rezultuar se me vendimin Nr. 100, dt.19.04.1996 të Ish/KKKPronave, Bashkia Vlorë është vendosur të njihetsi ish/pronar z. J.M.[...]

11. Ka rezultuar se, prona që i është njohur z. J.M., e kthyer edhe fizikisht me vendimin Nr. 1360, dt. 29.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i regjistruar në ish-ZVRPP/Vlorë, krijonte mbivendosje me pronën e pretenduar nga pala paditëse dhe të trajtuar me vendimin Nr. 234, datë 28.07.2006 të KVKKP/Qarku Vlorë.

12. Po ashtu, ka rezultuar se midis palës së paditur, R.M. (trashëgimtar i të ndjerit J.M.) është lidhur një kontrate shitblerjeje, me dy të paditurit në gjykim "D" shpk dhe "HoA" shpk, për pasurinë me sipërfaqe 90 ha, pjesë e pasurisë 220 ha të fituar me vendimin nr. 1360, datë 29.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ka rezultuar se kontrata e shitblerjes është regjistruar në ZVRPP/Vlorë.

13. Sa më sipër, me datë 29.01.2016 paditësit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me padi, duke parashtruar disa kërkime sikurse pasqyrohen në pjesën hyrëse.

14. Pala paditëse ka kërkuar kthimin fizik të dy sipërfaqeve të njohura me vendimet Nr. 234 dhe nr. 235 të KVKKP Qarku Vlorë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi që lejon kthimin fizik pa limit të pronës së lirë. Konkretisht paditësit kanë kërkuar kthimin fizik të sipërfaqes së lirë prej 188 ha, sipas vendimit Nr. 235 si dhe të sipërfaqes prej 315 ha, sipas vendimit Nr. 234, brenda së cilës ndodhet edhe trualli i kthyer fizikisht prej 1150 m2. Nga kjo sipërfaqe, 90 ha posedohen sipas saj në mënyrë të paligjshme nga dy shoqëritë e paditura "D" shpk dhe "HoA" shpk dhe diferenca nga i padituri, R.M..

15. Në lidhje me pjesën e sipërfaqes së disponuar nga këta të fundit, pala e paditësve ka kundërshtuar titullin e tyre të pronësisë deri në origjinë duke pretenduar falsitetin e notës së transkriptimit mbi të cilën ka dalë vendimi Nr. 100 dt. 19.04.1996 i K.K.K.Pronave Bashkia Vlorë për subjektin e shpronësuar J.M..

16. Paditësit kanë kërkuar të realizojnë të drejtën e pronësisë, mbi pasuritë e paluajtshme të individualizuara më sipër, në formën e bashkëpronësisë në ½ pjesë ideale midis subjekteve S. dhe J.B. (trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar).

Procedura para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

17.Në seancën përgatitore të datës 09.03.2016 pala paditëse ka kërkuar para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që për shkak të vlerës së padisë, e cila rezultonte të ishte mbi 20.000.000 lekë, bazuar tek vlera prej 180.000 euro me të cilin ishin shitur vetëm 90 ha nga prona e pretenduar, dy palëve të paditura "D" shpk dhe "HoA" shpk, çështja të shqyrtohej me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

17.1. Në këtë seancë përgatitore, nga palët e paditura, kanë qenë prezent vetëm përfaqësuesja e ZVRPP/Vlorë dhe ai i të paditurve "D" shpk dhe "HoA" shpk. Përfaqësuesi i të paditurve "D" shpk dhe "HoA" shpk ka pretenduar se padia ishte me të meta dhe nuk duhej të pranohej kërkesa për gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, ndërsa përfaqësuesja e ZVRPP/Vlorë nuk është shprehur në lidhje me kërkesën për gjykimin e çështjes me tre gjyqtarë.

18. Në këtë seancë përgatitore gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë dhe ka shtyrë seancën përgatitore me qëllim që pala paditëse të vinte provat në dispozicion të palëve. Në vazhdim janë zhvilluar disa seanca përgatitore dhe më tej gjykata e shkallës së parë ka vendosur që çështja të kalojë për gjykim në seancë gjyqësore, pa u shprehur në lidhje me kërkesën e palës paditëse për gjykimin e çështjes me tre gjyqtarë, pa u përcaktuar qoftë edhe një vlerë paraprake e padisë. Për pasojë gjykimi ka filluar e ka vazhduar me gjyqtar të vetëm.

19. Gjatë hetimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë ka disponuar për kryerjen e një ekspertimi grafik të dokumenteve të pretenduara të falsifikuara. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka disponuar edhe për kryerjen e aktit të ekspertimit topografik, në lidhje me pasqyrimin grafik të pronave të pretenduara dhe sipërfaqes së pretenduar si të mbivendosur, pas së cilit pala paditëse ka saktësuar përsëri objektin e padisë duke kërkuar përfundimisht kthimin fizik të sipërfaqes prej 404 ha sipas vendimit Nr. 234 dhe 188 ha sipas vendimit Nr. 235.

20. Në aktin e ekspertimit topografik është konfiguruar prona objekt gjykimi si dhe mbivendosjet që ajo krijon. Është konfiguruar sipërfaqja e mbivendosjes prej 98 ha, nga të cilët 88 ha rezultojnë në pronësi të të paditurve "HoA" shpk dhe "Digitalnetwork" shpk, ndërsa sipërfaqja 11 ha ka rezultuar në pronësi të shtetasit A.Sh. [...]

22. Gjatë gjykimit në shkallë të parë, palët e paditura, shoqëria "HoA" shpk dhe shoqëria "D" shpkjanë përfaqësuar nga av. B.G dhe av. E.M..

23. Përfaqësuesit e palëve të paditura kanë bërë disa kërkesa gjatë gjykimit në shkallë të parë, për shtyrje të seancave gjyqësore, për përjashtim gjyqtari dhe për shpalljen e moskompetencës. [...]

27. Po ashtu, përfaqësuesi i palëve të paditura ka kërkuar shpalljen e moskompetencës lëndore pasi sipas ligjit nr. 133/2015 tashmë gjykatë kompetente është Gjykata e Apelit Vlorë. Kjo kërkesë është rrëzuar nga gjykata me arsyetimin se padia është paraqitur para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

28. Pas këtij momenti përfaqësuesi i palëve të paditura "HoA" shpk dhe "D" shpkka deklaruar se heq dorë nga mbrojtja dhe është larguar nga seanca. Gjykata ka vijuar gjykimin në mungesë të palëve të paditura pasi ka vlerësuar se ato kanë dijeni për seancën dhe përfaqësuesi i tyre është larguar pa shkaqe të arsyeshme. Në këtë seancë ka vijuar gjykimi dhe janë paraqitur konkluzionet përfundimtare.

29. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 713, datë 26.04.2017 ka pranuar tërësisht padinë sipas kërkimeve të parashtruara në të.

Procedura para Gjykatës së Apelit Vlorë

30. Ka rezultuar se kundër vendimit nr. 713, datë 26.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kanë paraqitur ankim palët e paditura: A) Avokatura e Shtetit, e cila ka paraqitur fillimisht një akt për zënie të afatit ligjor të ankimit dhe nuk e ka plotësuar më tej me shkaqet pse kundërshton vendimin e gjykatës së shkallës së parë; B) Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë [...]

31. Ka rezultuar se një nga anëtarët e trupës gjykuese në gjykimin në apel, ka qenë i njëjtë me atë që ka marrë pjesë në gjykimin që ka konkluduar me vendimin nr. 8 datë 01.04.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

32. Ka rezultuar se palët e paditura, shoqëria "D" shpk dhe shoqëria "HoA" shpk, gjatë gjykimit në apel, janë përfaqësuar nga i njëjti avokat që i ka përfaqësuar gjatë gjykimit në shkallë të parë.

33. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1187, datë 16.11.2017, ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr.713, datë 24.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë së njëjtës gjykatë me tjetër trup gjykues*.".

34. Gjykata e Apelit Vlorë ka vlerësuar se nga gjykata e shkallës së parë janë lejuar shkelje të rënda procedurale që lidhen me: 1) mosformimin e rregullt të trupës gjykuese; 2) mohimin e të drejtës së palës së paditur, shoqëria "HoA" shpk dhe shoqëria "D" shpk, që të dëgjohet për thelbin e pretendimeve e prapësimeve në konkluzionet përfundimtare; 3)

mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë. [...]

44. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë kanë ushtruar rekurs paditësit, z. I.B. dhe z. M.B., më datë 21.11.2017, të cilët kanë kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Po ashtu, ato kanë kërkuar ligjërimin e masës provizore të pezullimit të veprimeve juridike të tjetërsimit mbi pronën objekt gjykimi derisa çështja të zgjidhet me vendim përfundimtar nga Gjykata e Lartë. [...]

45. Po ashtu, ka rezultuar se kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë kanë ushtruar rekurs palët e paditura, "D" shpk dhe "HoA"shpk. Më datë 01.07.2021 këto palë kanë hequr dorë nga rekursi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

[...]

52. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se megjithëse rekursi kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, është paraqitur me datë 26.03.2018, para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 44/2021, sipas dispozitës tranzitore të ligjit nr. 44/2021, Kolegji vlerësoi ta shqyrtojë atë në dhomë këshillimi, duke vendosur sipas neneve 482/1 dhe 485 të KPC-s, të ndryshuar.

53. Përsa i përket rekursit të paditësve, Kolegji vlerëson se ai ngre shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-s, shkronja "c", të tilla që e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë. Kolegji vlerëson se nga Gjykata e Apelit Vlorë nuk është zbatuar drejtë neni 467 i KPC-s.

54. Në lidhje me formimin e trupës gjykuese, Kolegji vlerëson se KPC në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë, para ndryshimeve me Ligjin nr. 38/2017, parashikonte se gjykohen me tre gjyqtarë paditë me vlerë mbi 20.000.000 lekë, vetëm nëse kërkohet nga njëra prej palëve në seancë përgatitore. Ligjvënësi, çështjen e formimit të trupës gjykuese në shkallë të parë, e kishte vlerësuar si një çështje në disponibilitetin e palës, që u nënshtrohej afateve dekadente dhe prekluzivitetit (sipas nenit 459 të KPC-s). Pretendimi mbi formimin e trupës gjykuese, ishte një prapsim në kuptimin e ngushtë (që mund të ngrihej vetëm nga pala), sipas parimit të përgjithshëm procedural civil, të disponibilitetit.

55. Në rastin konkret, sikurse rezulton nga aktet e fashikullit të gjykimit, kërkesën për gjykimin e çështjes në shkallë të parë me tre gjyqtarë e ka parashtruar paditësi në seancë përgatitore, ndërkohë që palët e paditura, shoqëria "D"shpkdhe "HoA"shpk, kanë kërkuar që kjo kërkesë të rrëzohej. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se vetëm pala paditëse legjitimohej të ankimonte vendimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës, bashkë me

vendimin përfundimtar. Për palët e paditura një pretendim i tillë ka rënë në prekluzivitet sipas nenit 459 të KPC-s, përsa kohë nuk e kanë parashtruar një kërkesë të tillë në seancë përgatitore gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke shprehur vullnetin për vijimin e gjykimit me një gjyqtar. Si rrjedhojë, ato nuk mund të bënin të vlefshme në emër të tyre, në ankim, të drejta që u përkisnin paditësve.

56. Jo çdo palë në gjykim mundet të ushtrojë ankim ndaj çdo vendimi gjyqësor (i ndërmjetëm, jopërfundimtar apo përfundimtar qoftë), por një të drejtë të tillë dhe akt të tillë procedural në mënyrë të vlefshme mund ta përdorë vetëm ndërgjyqësi drejtpërdrejt i legjitimuar. Kjo përbën konceptin e legjitimitetit për të ankimuar. Edhe pse ligji nuk e ngushton në këtë mënyrë çështjen e legjitimitetit aktiv në ankim, kjo rezulton nga norma të tilla si ato që rregullojnë institutin procedural të pavlefshmërisë së akteve, që frymëzohen vetëm nga parimi i disponibilitetit maksimal (neni 2 i KPC-s) dhe ekskluziv (*shih, neni 95 i KPC-s*), të së drejtave materiale dhe procedurale të palëve.

57. Kolegji vlerëson se as palët e paditura nuk legjitimoheshin të ngrinin një pretendim të tillë dhe as gjykata nuk mund ta vlerësonte kryesisht. Kolegji e gjen të pabazuar në ligj arsyetimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, se shkaqet e parashikuara në nenin 467 të KPC-s, të cilat nulizojnë aktet e gjykimit, gjykata i vlerëson kryesisht, pavarësisht se kush nga palët i pretendon, madje edhe në mungesë të ankimit nga to. Kolegji vlerëson se kjo ka qenë një mendësi e gabuar e zbatimit të ligjit procedural në gjykimin rishikues në përgjithësi, i shkëputur nga parimet e përgjithshme të gjykimit civil dhe nga gjykata akuzatore dhe përgjithësisht pasive. Dispozitat e KPC-s në lidhje me rolin e gjykatës dhe detyrimet që ajo ka në procesin civil, nuk mund të interpretohen të shkëputura dhe duhet të ketë një koherencë në zbatimin e tyre, si në gjykimin në shkallë të parë, ashtu edhe në gjykimin rishikues.

58. Sipas parimit të disponibilitetit maksimal, vetëm palët mund të venë në lëvizje gjykatën (neni 2 i KPC-s). Po ashtu, ato me vullnetin e tyre mund t'i japin fund gjykimit; mund të kërkojnë pezullimin e tij (neni 297 i KPC-s); mund të kërkojnë ta zgjidhin çështjen me pajtim; kanë barrën e paraqitjes së provave dhe të fakteve (nenet 8 dhe 12 të KPC-s); janë palët që ngrenë kërkimet dhe pretendimet dhe gjykata është e detyruar të shprehet vetëm për atë që kërkohet (neni 6); janë palët që ankimojnë vendimin e gjykatës (neni 443/a), janë palët ato që individualizojnë shkaqet e ankimit, sipas parimit të prekluzivitetit (nenet 454 dhe 459 të KPC-s), ashtu sikurse në çdo kohë mund të heqin dorë nga ankimi (neni 450/d), etj.,.

59. Në nenin 120 të KPC-s, si shprehje e parimit të disponibilitetit, në

lidhje me aktet e gjykimit, është parashikuar se: "*Nuk mund të shpallet pavlefshmëria e një akti procedural pa kërkesën e palës, përveç kur ligji parashikon ndryshe…*".

60. Nga ana tjetër, në paragrafin e dytë është parashikuar se: "*Vetëm pala në interes të së cilës ligji parashikon një element të aktit procedural, mund të prapësojë pavlefshmërinë e aktit për mungesë të atij elementi. Prapësimi duhet të ngrihet në seancën më të parë pas njoftimit, ose menjëherë, kur dijenia merret gjatë gjykimit.*".

61. Sipas këtyre dispozitave, si rregull gjykata, në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, është pasive, me përjashtim të rasteve kur ligji në mënyrë të shprehur i ka dhënë pushtet oficial.

62. Në praktikën e mëparshme gjyqësore, është mbajtur qëndrimi se gjykata rishikuese merr në shqyrtim edhe kryesisht të gjitha shkaqet e pavlefshmërisë së akteve të gjykimit, sipas rasteve të parashikuara në nenin 467 të KPC-s. Duke qenë se një interpretim i tillë deformonte rolin e gjykatës në procesin civil sipas parimit të disponibilitetit dhe paanësisë, me Ligjin nr. 38/2017 u riformuluan disa dispozita për gjykimin në apel dhe në Gjykatën e Lartë. Në nenin 465 u parashikua se gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda kufijve të ankimit. I njëjti parashikim u vendos në nenin 473/a të KPC-s, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se gjykata rishikuese vlerëson kryesisht pavlefshmërinë e akteve procedurale sipas nenit 467 të KPC-s, përjashtimisht dhe vetëm në rastet kur ligji ia ka njohur shprehimisht një të drejtë të tillë. Si rregull, vlen parimi i sanksionuar në nenin 120 të KPC-s.

63. Për rastin konkret, ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Apelit Vlorë, nuk mundet që një prapsim në kuptimin e ngushtë (që është në disponibilitetin e palës) gjatë gjykimit në shkallë të parë, të shndërrohet në prapsim në kuptimin e gjerë (në disponibilitetin e gjykatës), në gjykatën më të lartë. E thënë ndryshe, nëse sipas KPC-s, në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë, formimi i trupës gjykuese është lënë në vullnetin e palëve gjatë gjykimit në shkallë të parë, nuk mund të ketë pushtet oficial mbi këtë çështje, gjykata rishikuese.

64. Përsa i përket arsyes së dytë, për të cilën është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i çështjes për rigjykim, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka kualifikuar drejt sjelljen e palëve të paditura dhe sjelljen e përfaqësuesve ligjorë të tyre, duke e parë në dinamikë, në gjithë aktivitetin procedural të realizuar prej tyre.

65. Sikurse rezulton nga aktet e fashikullit të gjykimit, palët e paditura janë përfaqësuar në gjykim nga dy avokatë. Këta të fundit kanë bërë disa kërkesa gjatë gjykimit në shkallë të parë, të cilat kanë rezultuar të pabazuara

në ligj dhe janë rrëzuar nga gjykata.Ata kanë përsëritur vazhdimisht kërkesën për shtyrje të gjykimit apo për pezullimin e tij dhe në momentin që kjo ka rezultuar e pasuksesshme kanë deklaruar se heqin dorë nga përfaqësimi duke u larguar nga seanca për këtë shkak.

66. Kolegji mban parasysh faktin se palët e paditura kanë caktuar të njëjtin avokat edhe gjatë gjykimit në apel, i cili edhe pse formalisht para gjykatës së shkallës së parë, ka deklaruar se heq dorë nga përfaqësimi, ka pranuar t'i përfaqësojë ato në gjykimin në apel.

67. Duke vlerësuar në tërësi dhe në dinamikë marrëdhënien e palëve të paditura në raport me përfaqësuesin e tyre, gjatë dhe pas gjykimit në shkallë të parë; faktin se ato i kanë besuar mbrojtjen e interesave të tyre, në vijueshmëri të procesit gjyqësor, pavarësisht sjelljes procedurale të tij gjatë gjykimit në shkallë të parë, nuk jemi para situatës ku avokati ka shkelur detyrimet e tij në marrëdhënien e përfaqësimit për mbrojtjen e klientit të tij dhe si rrjedhojë, nuk mund të penalizohej pala e përfaqësuar nga veprimet e tij. Vetëm në një situatë të tillë, gjykata do të duhet t'ia njoftonte aktin e heqjes dorë, palës së përfaqësuar, për t'i garantuar kësaj të fundit të drejtën për të marrë pjesë në proces, personalisht apo nëpërmjet një avokati tjetër të zëvendësuar.

68. Vijimi i marrëdhënies së përfaqësimit nga i njëjti avokat edhe gjatë gjykimit në apel, të çon në konkluzionin se veprimet e përfaqësuesit kanë qenë në dijeni të palës së përfaqësuar dhe janë miratuar prej saj. Si rrjedhojë Kolegji konkludon se nuk jemi para heqjes dorë nga përfaqësimi. Veprimi i kryer nga përfaqësuesi i palëve të paditura në seancën gjyqësore të datës 24.04.2016, ku janë paraqitur konkluzionet përfundimtare, duhet të kualifikohej nga Gjykata e Apelit Vlorë, si braktisje e seancës gjyqësore nga palët e paditura, veprim i realizuar përmes përfaqësuesit të tyre.

69. Në kushtet ku palët e paditura nuk kanë pasur vullnet për të qenë prezent në atë seancë gjyqësore dhe nuk kanë pasur shkak të arsyeshëm për të mos marrë pjesë në atë seancë, vijimi i gjykimit në mungesë nga gjykata e shkallës së parë ka qenë i ligjshëm.

70. Palët e paditura, përmes të njëjtit përfaqësues, në ankimin drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë kanë kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndër të tjera për shkak të sjelljes së shkaktuar prej tij.Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje parashikimin e nenit 120/3 të KPC-s, ku thuhet se: "*Pavlefshmëria nuk mund të prapësohet nga pala që e ka shkaktuar atë dhe as nga ajo që ka hequr dorë heshtazi*".

71. Kolegji vlerëson se Vendimi Unifikues nr. 4, datë 01.02.2006, nuk mund të gjejë zbatim me analogji dhe nuk është relevant për rastin konkret, pasi rrethanat mbi të cilat kanë konkluduar Kolegjet e Bashkuara në atë rast

janë të ndryshme dhe specifike. Para Kolegjeve të Bashkuara është shtruar për diskutim nëse largimi nga salla i palës, jo me vullnet të tij, por me urdhër të gjykatës, mund të kualifikohej si heqje dorë nga gjykimi dhe si rrjedhojë, lënia e seancës në vijueshmëri edhe nga përfaqësuesja e paditësit mund të konsiderohej heqje dorë nga gjykimi, në kushtet ku vullneti i palës paditëse të përfaqësuar, ishte i paqartë. Kolegji vlerëson se ky vendim unifikues nuk mund të gjejë zbatim jashtë kontekstit dhe rrethanave specifike në të cilët ai është marrë.

72. Po ashtu, Kolegji vlerëson se edhe sikur të konkludohej se ka vijuar gjykimi në mungesë i palëve të paditura në mënyrë të paligjshme, Gjykata e Apelit Vlorë, duhet të mbante në konsideratë parimin se jo çdo parregullsi e procesit, e lejuar nga gjykata më e ulët, mund të shkaktojë pavlefshmërinë e gjykimit. Kolegji sjell në vëmendje nenin 121/1 të KPC-s, i cili ka parashikuar se: "*1. Pavlefshmëria e një akti nuk ka rëndësi për aktet e mëparshme, kur këto janë të pavarura prej tij. Pavlefshmëria e një pjese të aktit nuk prek pjesët e tjera që janë të pavarura…*".

73. Nga ana tjetër, neni 467, i riformuluar me ndryshimet e vitit 2017, referon pikërisht në dispozitën e cituar më sipër, ku konkretisht është parashikuar se: "*Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kufijve të nenit 121, të këtij Kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur…*".

74. Në rastin konkret, palët e paditura janë gjykuar në mungesë vetëm në fazën e paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare, pasi ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor. Në këtë fazë të procesit, palët e paditura nuk kanë humbur të drejta procedurale që mund t'i ushtrojnë ekskluzivisht para juridiksionit fillestar të gjykatës së shkallës së parë dhe në faza të caktuara të tij, sipas parimit të prekluzivitetit (paraqitje provash; ushtrimi i prapësimeve në kuptimin e ngushtë në kuptim të nenit 158/7 të KPC-s; të kërkojë thirrjen e personave të tretë; të paraqesë kundërpadi; të kërkojë zëvendësimin procedural, etj.,.).

75. Konkluzionet përfundimtare nuk janë vazhdim apo zgjatim i shqyrtimit gjyqësor, por një përmbledhje sintetike dhe përmbyllëse e procesit të zhvilluar, në këndvështrimin e secilës palë. Kjo do të thotë se tashmë objekti i mosmarrëveshjes është përcaktuar (sipas nenit 5 të KPC-s) dhe në këtë fazë palëve u kërkohet ose kërkojnë të përmbledhin historikun e zhvillimit të procesit gjyqësor dhe të japin qëndrimin përfundimtar mbi të. Duke qenë një përmbledhje e shqyrtimit gjyqësor, mosparaqitja e tyre, nuk mund të bëjë të pavlefshëm gjithë procesin, i cili është zhvilluar pavarësisht nga ky akt.

76. Në këtë akt nuk mund të zgjerohen pretendimet dhe prapësimet në disponibilitetin e palëve, nuk mund të paraqiten prova të reja dhe as

nuk mund të bëhen kërkime të tjera të ndryshme nga ato që janë bërë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në konkluzione përfundimtare, mundet që palët të pasurojnë mbrojtjen e tyre, me argumente të tjera juridike, duke sjellë në vëmendje të gjykatës raste të jurisprudencës, duke interpretuar ligjin ndryshe, duke interpretuar provat në mënyrë të ndryshme apo duke interpretuar faktet objekt mosmarrëveshjeje në mënyrë të ndryshme. I gjithë ky aktivitet procedural i palëve hyn në konceptin e mbrojtjes së thjeshtë dhe si i tillë mund të realizohet në çdo fazë dhe shkallë gjykimi.

77. Në këtë kuptim, për rastin konkret, të gjitha argumentet mbi gjykimin e zhvilluar në shkallë të parë që palët e paditura nuk kanë mundur t'i parashtrojnë para gjykatës së shkallës së parë, në formën e konkluzioneve përfundimtare, nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore për t'i parashtruar në ankimin drejtuar gjykatës së apelit.

78. Përsa i përket formimit të rregullt të ndërgjyqësisë së detyrueshme, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka kualifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes, sipas shkakut dhe kërkimeve të paditësve dhe si rrjedhojë, nuk ka identifikuar drejt rrethin e ndërgjyqësve. Po ashtu, Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka mbajtur parasysh në vendimmarrje se sipas parimit të disponibilitetit, edhe ndërgjyqësia (kryesore apo dytësore) formohet nga palët dhe gjykata, si rregull, është pasive.

79. Kolegji vlerëson se ndërgjyqësia në procesin gjyqësor administrativ dhe civil ndahet në ndërgjyqësi kryesore, e cila përbëhet nga rrethi i palëve në emër ose kundër të cilëve zhvillohet procesi (*shih, neni 90 i KPC-s*). Ndryshe këta ndërgjyqës njihen si palët në kuptimin e ngushtë, pasi në mënyrë të drejtpërdrejtë ato fitojnë apo konfirmojnë të drejta dhe marrin përsipër detyrime nga vendimi gjyqësor përfundimtar. Këto palë janë paditësi, i padituri, kundërpaditësi, kërkuesi në gjykimet gracioze, apo ndërhyrësi kryesor. Duke qenë se procesi zhvillohet në emër apo kundër tyre, nga pozita aktive apo pasive procedurale me të cilën janë legjitimuar proceduralisht në proces, gjykata, me vendim përfundimtar mundet t'i ngarkojë ato me detyrime, mundet t'u akordojë atyre të drejta dhe mundet t'i ngarkojë ato me shpenzime gjyqësore (*shiko, neni 109 i KPC-s*). Për më tepër, vetëm palët në kuptimin e ngushtë munden të disponojnë mbi objektin e mosmarrëveshjes (*neni 195 i KPC-s*).

80. Nga ana tjetër, procesi gjyqësor civil apo administrativ njeh edhe bashkësinë apo kategorinë e ndërgjyqësve dytësorë, të cilët kanë një pozitë procedurale të ndryshme nga ndërgjyqësit kryesorë. Ata marrin pjesë në proces në kushte të caktuara (*shiko, nenin 191, 192 dhe 193 të KPC-s*). Ndryshe nga ndërgjyqësit në kuptimin e ngushtë, ndërgjyqësit dytësorë lidhen indirekt nga produkti përfundimtar i procesit gjyqësor, nuk mund

të ngarkohen me detyrime nga vendimi përfundimtar dhe nuk mund të ngarkohen me shpenzime gjyqësore. Ata gjithashtu nuk mund të disponojnë mbi objektin e mosmarrëveshjes.

81. Në nenin 162 të KPC-s vihen re dy kategori të tjera të ndryshme të llojeve të ndërgjyqësisë: ndërgjyqësia e detyrueshme dhe ndërgjyqësia fakultative. Në rastin e ndërgjyqësisë së detyrueshme palët, aktive apo pasive të procesit, janë së bashku në njërën apo tjetrën pozitë jo si pasojë e disponimit maksimal të padisë apo parimit të disponibilitetit, por si pasojë e parashikimit të ligjit dhe natyrës juridike të mosmarrëveshjes. Në këto raste, nëse paditësi nuk ka thirrur të gjithë bashkëndërgjyqësit e nevojshëm apo të detyrueshëm, padia është me të meta, pasi ai ka detyrimin ligjor të thërrasë si të paditur këdo bashkëtitullar të së drejtës që ai pretendon të konfirmojë gjyqësisht.

82. Në këto raste disponibiliteti maksimal i padisë së paditësit kufizohet vetëm tek e drejta e tij për të bërë të vlefshëm në emrin e tij procesin apo jo, apo thënë ndryshe, për të ngritur padi apo jo. Në këto raste rrethi i ndërgjyqësve përcaktohet jo nga vullneti i palës apo nga vendimmarrja e gjykatës, por vetëm nga ligji dhe natyra juridike e marrëdhënies. Gjykata në këto raste ngarkohet nga ligji që të zbatojë ligjin procedural në mënyrë që askush të mos lejohet që në emrin e tij të bëjë të vlefshme të drejtat e dikujt tjetër (*shiko, neni 195 i KPC-s*) dhe nga ana tjetër, të mos lejojë që askush të gjykohet pa iu dhënë mundësia për t'u dëgjuar (*shiko, neni 33 dhe 42 të Kushtetutës*).

83. Nga ana tjetër, të gjitha marrëdhëniet e tjera që formohen ndërmjet bashkëndërgjyqësve janë lloji i bashkëndërgjyqësisë fakultative, ku rrethi i personave si bashkëpaditës apo bashkë të paditur varen nga e drejta dhe fakulteti që ligji i njeh paditësit për të vendosur se kujt ia kundrejton pretendimet në padi, apo thënë ndryshe, është rrjedhojë dhe përditësim i parimit të disponibilitetit maksimal të padisë. Këtu gjykata ka rol pasiv.

84. Nisur nga ky regjim juridik procedural konkludohet se ndërgjyqësia dytësore, apo thënë ndryshe personat e tretë, nuk mundet të jenë pjesë e ndërgjyqësisë së detyrueshme, pasi në këtë kategori palësh bëhet fjalë vetëm për palët në kuptimin e ngushtë, me të gjitha karakteristikat e treguara më lart.

85. Nga kjo analizë mund të konkludohet natyrshëm se neni 467, shkronja "d", i KPC-s, që ka zbatuar Gjykata e Apelit Vlorë, nuk ka lidhje me mënyrën se si gjykata ka marrë apo nuk marrë vendimet e ndërmjetme për të formuar ndërgjyqësinë dytësore, por vetëm dhe ekskluzivisht me ndërgjyqësinë kryesore dhe të detyrueshme. Kjo është logjika procedurale dhe mënyra se si duhet të kuptohet, fillimisht dhe më tej, se si duhet të zbatohet neni

467, shkronja "d",i KPC-s nga gjykatat me juridiksion rishikues (*shih edhe shkronjën "d" të nenit 467, të ndryshuar në vitin 2017 të KPC-s*).

86. Kjo do të thotë se gjykata me juridiksion rishikues mundet të prishë një vendim të një gjykate më të ulët vetëm kur nga ajo është lejuar të zhvillohet gjykimi pa respektuar ligjin dhe natyrën e marrëdhënies juridike objekt gjykimi, e cila e krijon ndërgjyqësinë kryesore të detyrueshme. Për të gjitha rastet e tjera neni 467, "d", i KPC-s është i pazbatueshëm. Vetëm kjo parregullsi dhe paligjshmëri është shkak i jashtëm pavlefshmërie që është i aftë të nulizojë të gjithë gjykimin në atë shkallë ku është lejuar të ndodhë kjo shkelje (*shiko, nenin 119, 120 dhe 121 të KPC-s*).

87. Në këtë kuptim, nëse një subjekt plotëson kushtet të thirret si ndërgjyqës apo bashkëndërgjyqës në proces, në pozitën e palës paditëse apo palës së paditur, në kuptimin e ngushtë, ai nuk mund të thirret në cilësinë e personit të tretë në mënyrë alternative, për shkak të efekteve që passjell vendimi gjyqësor në përfundim të gjykimit. Pozita e secilit ndërgjyqës, në raport me gjykimin, në varësi të të drejtave që ata tërheqin nga gjykimi, si më sipër, është e ndarë dhe mirëpërcaktuar nga kriteret ligjore të analizuara më sipër. Nga ana tjetër, nëse plotëson kushtet sipas nenit 192 e vijues të KPC-s që një subjekt të thirret si person i tretë, nuk është shkak për prishjen e vendimit të gjykatës më të ulët mosthirrja e tij në gjykim. Asnjë vendim gjyqësor nuk ka efekt për të tretët që janë jopjesëmarrës.

88. Së fundi, përsa u përket trashëgimtarëve të subjektit Sh.B., Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka argumentuar në pjesën arsyetuese se në çfarë pozite procedurale duhet të thirren këto subjekte. Kolegji vlerëson se gjykata e apelit nuk e ka pasur të qartë natyrën e mosmarrëveshjes, cili është shkaku i padisë, objekti i saj dhe se kujt ia kanë kundrejtuar pretendimet paditësit.

89. Sikurse ka rezultuar nga gjykimi, nga pohimet dhe parashtrimet e paditësve, para gjykatës së shkallës së parë, gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, këto të fundit nuk janë në mosmarrëveshje me bashkëpronarët e tjerë të njohur me vendim gjyqësor të formës së prerë, konkretisht me vendimin nr. 8/1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në lidhje me pasurinë prej 1.150 m2 truall dhe 48 m2, e cila iu është kthyer sipas legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronës dhe rezulton e regjistruar në emër të tyre. Bashkëpronësinë në lidhje me këtë pasuri ata nuk e kundërshtojnë dhe as nuk iu është mohuar nga bashkëpronarët e tjerë.

90. Objekti i kërkimeve të padisë, janë pasuritë e njohura në emër të trashëgimtarëve të paditësve, në cilësinë e ish-pronarit, me vendimet nr. 234, datë 28.07.2006 dhe nr. 235, datë 28.07.2006 të KVKKP Qarku Vlorë, por të pakthyera nga shteti, të llojit pyll dhe kullotë. Këto pasuri, pjesërisht rezultojnë me pronar shtet dhe pjesërisht në emër të palëve të

tjera të paditura. Shkaku i padisë është e drejta subjektive e pronësisë së pretenduar prej paditësve, sipas legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave, të cilës i kundërvihet fakti i paligjshëm, refuzimi i shtetit për t'i kthyer ato dhe veprimtaria e paligjshme e palëve të tjera të paditura, të cilat rezultojnë pronare pjesërisht mbi këto pasuri, sipas paditësve, mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara. Edhe pse pasuria prej 1.150 m2 truall dhe 48 m2, bie brenda sipërfaqes prej 414 ha që kërkohet të kthehet fizikisht, paditësit nuk e kundërshtojnë qenien bashkëpronarë në lidhje me këtë pasuri dhe secili nga bashkëpronarët, sipas nenit 296 dhe 200/d të KC-s ka të drejtën të kërkojë kthimin e sendit nga kushdo që e posedon në mënyrë të paligjshme, me kushtin që t'ua kthejë të gjithëve. Secili nga bashkëpronarët ka tagrat e përfaqësimit ligjor për të ngritur një padi të tillë.

91. Përsa u përket pretendimeve të paditësve në rekurs mbi papajtueshmërinë e njërit prej anëtarëve të trupës gjyqësore në gjykatën e apelit, Kolegji vlerëson se nuk është në kushtet e papajtueshmërisë gjyqtari, i cili gjykon çështje të karakterit ngushtësisht procedural dhe nuk shprehet për themelin e çështjes. Në këtë linjë arsyetimi Kolegji sjell në vëmendje se, si Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim, GJEDNJ), lidhur me paanshmërinë objektive, kanë mbajtur qëndrimin se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel (*shih, Vendim nr. 2, datë 22.01.2014* të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; shih, çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 31 mars 2005 etj.,.).

92. Sa më sipër u arsyetua, Kolegji konkludon se nuk ka pasur asnjë shkak të ligjshëm në refuzimin e Gjykatës së Apelit Vlorë për zgjidhjen e çështjes në themel, pasi nga gjykata e shkallës së parë nuk janë lejuar shkelje të rënda procedurale, të tilla që sipas nenit 467 të KPC-s bënin nul aktet e gjykimit në shkallë të parë. Si rrjedhojë, Gjykata e Lartë duhet të vendosë prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate. Në rigjykim, *Gjykata e Apelit Vlorë duhet të marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur nga palët e paditura, brenda kufijve të tij, sipas parimeve të analizuara më lart, të disponibilitetit dhe të prekluzitivitetit të pretendimeve*, referuar nenit 459 të KPC-s.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1194, datë 05.07.2021

Pavarësisht se testamenti përbën veprim juridik të njëanshëm dhe ligji civil nuk ka norma se si interpretohen këto lloj veprimesh juridike, kriteret ligjore për interpretimin e tyre do të huazohen mutatis mutandis nga normat juridike që rregullojnë kriteret për interpretimin e kontratave. Veprimet juridike të njëanshme do të duhet të interpretohen sipas qëllimit të vërtetë të autorit të tyre, pa u ndalur në kuptimin letrar dhe të ngushtë të fjalëve dhe duke vlerësuar sjelljen e mëparshme dhe të mëvonshme e tij dhe të përfituesit të së drejtës.

I. Rrethanat e çështjes

1.Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se, paditësi shoqëria "V.B"SHPK , me seli në Korçë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me padi duke kërkuar pjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi me të padituri [...] etj.,. Objekt i pjesëtimit janë dy pasuri të paluajtshme të ndodhura në qytetin e Korçës, të cilat janë të regjistruara dhe individualizuara pranë ish-ZVRPP Korçë.

2. Ka rezultuar se me vendimin nr. 224, dt. 18.10.2007 të ish-KKKP Qarku Korçë, i ndryshuar më pas me vendimin nr. 1647, dt. 01.06.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 33, datë 01.02.2010 të Gjykatës së Apelit Korçë, janë njohur bashkëpronarë palët ndërgjyqëse [...] mbi pasuritë e paluajtshme objekt gjykimi.

3. Me kontratën e dhurimit nr. 2753 rep., dhe nr. 2538 kol., datë 03.10.2013 bashkëpronarët [...] ia kanë dhuruar pjesët e tyre takuese prej 36/72 pjesë të pandara, pranuesit të dhurimit, shoqërisë tregtare "V.B" SHPK . Si rrjedhojë, në seancën gjyqësore të datës 06.01.2014 u bë zëvendësimi procedural i paditësve si më sipër me shoqërinë "V.B" SHPK .

4. Po kështu, ka rezultuar se e paditura V.S. ka ndërruar jetë më datë 13.04.2013 dhe gjykata ka kryer kalimin procedural të saj duke bërë edhe kalimin e pjesës takuese të pronësisë në favor të trashëgimtarëve ligjorë [...], sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore.Në përfundim, gjykata ka arritur në konkluzionin se paditësi "V.B" ka në pronësi 36/72 pjesë ideale, ndërsa gjithë bashkëpronarët e tjerë në cilësinë e të padituve gëzojnë secili nga

4/72 pjesë ideale në të dy pasuritë objekt gjykimi.

5. Nga ana tjetër, ka rezultuar se e ndjera V.S. ka disponuar në favor të trashëgimlënësit, djalit të saj, me testamentin nr. 465, datë 30.10.2012 mbi pasurinë e saj [...]

6. Pala e paditur [...], gjatë gjykimit, ka pretenduar se sipas testamentit duhet të përjashtohet nga pjesa takuese e të ndjerës V.S., trashëgimtarja tjetër ligjore, [...], për qëllime të përcaktimit të pjesës takuese të tij.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. s'ka, datë 12.02.2014 ka vendosur: "*1. Lejimin e fazës së parë të pjesëtimit të sendeve të përbashkëta pasuri të paluajtshme me: 1. Nr. 8/530 ZK 8562, vol. 30, faqe 23 e llojit truall me sipërfaqe totale 196324 m2 e ndodhur në Korçë, me kufizime...; 2. Nr. 8/226 ZK 8562, vol. 21, faqe 175 me sipërfaqe totale 3670.89 m2 e ndodhur në Korçë, me kufizime...ndërmjet palëve ndërgjyqëse [...] 2. Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë...*".

8. Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka arsyetuar se është i pabazuar në aktet e fashikullit të gjykimit, pretendimi i palës së paditur R.S., në lidhje me pjesën takuese të tij në raport me trashëgimtaren S.S. dhe se nuk ka vend për zbatimin e trashëgimisë ligjore, pasi ai është trashëgimtari i vetëm testamentar i të ndjerës V.S..

9. Në lidhje me këtë pretendim gjykata ka analizuar përmbajtjen e testamentit noterial, nr. 465, datë 30.10.2012 të trashëgimlënëses V.S.. Gjykata ka vlerësuar se kjo e fundit fillimisht ka disponuar për pasurinë e individualizuar që ndodhet në qytetin e Pogradecit dhe më pas për pasuritë që asaj mund t'i vijnë në të ardhmen. Kjo do të thotë se disponimi i trashëgimlënëses për sendin e individualizuar do të konsiderohet si trashëgimi me titull të posaçëm, ndërsa pasuritë që do t'i vijnë më vonë do të trajtohen si trashëgimi me titull universal në favor të trashëgimlënësit R.S.. Në kushtet kur pasuritë objekt pjesëtimi, trashëgimlënësja i ka pasur në pronësi në kohën e hartimit të testamentit, më datë 30.10.2012 në pozitën e bashkëpronares, sipas vendimit nr. 224, datë 18.10.2007 të ish-KKKPronave, Qarku Korçë, ndryshuar me vendimin nr. 1647, datë 01.06.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, këto pasuri nuk mund të konsiderohen si pasuri që mund të vijnë në të ardhmen dhe të trajtohen si të disponuara me testament, sikurse ka pretenduar pala e paditur R.S..

10. Në kushtet kur pasuritë objekt gjykimi nuk janë disponuar me testament, as me titull të posaçëm dhe as me titull universal, në lidhje me to do të zbatohen dispozitat mbi trashëgiminë ligjore. Në rastin konkret, bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore, të lëshuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënëses V.S., janë R.S. dhe S.S., të cilët trashëgojnë secili 1/2 e 4/72 pjesë të saj në pasuritë objekt gjykimi.11. Kundër vendimit nr. s'ka, datë 12.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka paraqitur ankim të veçantë pala e paditur, R.S., e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit në lidhje me përcaktimin e pjesëve takuese midis bashkëpronarëve, [...]

12. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 12, datë 03.04.2014, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit të fazës së parë të pjesëtimit, datë 12.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë*" [...]

15. Kundër vendimit nr. 12, datë 03.04.2014, më datë 05.05.2014 (rezulton se data 03.05.2014, sipas kalendarit ka rënë ditë e shtunë) ka paraqitur rekurs pala e paditur, R.S., e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit, [...]

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

17. Kolegji Civil (në vijim, Kolegji), fillimisht çmon të marrë në analizë disa ndryshime thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti kur Gjykata e Apelit Korçë ka marrë vendimin dhe pala ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë e deri në momentin që merret ky vendim.

18. Në ndryshimet që ka pësuar së fundmi KPC, me Ligjin nr. 44/2021, sipas nenit 483/1, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

19. Në dispozitën tranzitore të Ligjit nr. 44/2021, është parashikuar se: "*1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre."[...]*

23. Kolegji vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC, të cilat bëjnë të cenueshme vendimet e dy gjykatave më të ulëta. Kolegji vlerëson se si gjykata e shkallës së parë, ashtu edhe gjykata e apelit nuk kanë interpretuar drejt testamentin e të ndjerës V.S., palë e paditur fillimisht në këtë gjykim, duke zbatuar gabimisht regjimin e trashëgimisë ligjore, në përcaktimin e pjesëve takuese midis të ndjerit R.S. dhe znj. S.S..

24. Sipas burimit, marrëdhënia e trashëgimisë është ligjore nëse përcaktohet nga ligji dhe testamentare nëse përcaktohet nga veprimi juridik i njëanshëm, sikurse është testamenti.

25. Duke u nisur nga një tjetër kriter, ai i objektit të pasurisë trashëgimore, marrëdhënia e trashëgimisë, mund të jetë, trashëgimi universale; trashëgimi me titull universal; trashëgimi me titull të posaçëm.

26. Në vijim të këtij arsyetimi, në trashëgiminë universale dhe atë me titull universal, shtrirja e të drejtës së trashëgimisë i referohet një situate pasurore gjenerike, të papërcaktuar të subjektit që do të përfitojë, duke e vënë atë në kushtet e një vazhdimësie (suksedimi) mbi të gjitha marrëdhëniet që do të transferohen në çastin e çeljes së trashëgimisë, me përjashtim të të drejtave ngushtësisht personale të trashëgimlënësit apo që përcaktohen ndryshe nga testamenti.

27. Nga ana tjetër, dallimi ndërmjet trashëgimisë universale dhe asaj me titull universal është vetëm sasior. Në trashëgiminë universale, thirrja në trashëgimi, e përcaktuar nga ligji apo testamenti, i referohet të gjithë pasurisë së *de cuius*. Kjo situatë do të ndeshet në ato raste kur ka vetëm një trashëgimtar ligjor, apo testatori përcakton në testament që e gjithë pasuria e tij i kalon vetëm një personi. Në trashëgiminë me titull universal, thirrja në trashëgimi nuk i referohet të gjithë pasurisë së lënë, por një pjese të saj, e cila shprehet në formën e një fraksioni aritmetik ose përcaktimit të kuotave, ndërsa në trashëgiminëme titull të posaçëm, thirrja në trashëgimi i referohet një ose disa sendeve apo të drejtave të përcaktuara nga trashëgimlënësi, duke caktuar gjithashtu personin që do të ketë përfitimin pasuror.

28. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, para Kolegjit u shtrua për zgjidhje interpretimi i testamentit të lëshuar nga trashëgimlënësja V.S., sipas vullnetit të saj, nëse ky testament ka krijuar një marrëdhënie trashëgimie universale, me titull universal apo me titull të posaçëm në raport me trashëgimtarët e saj, R.S. dhe S.S.. Kolegji vlerëson se vetëm cilësia e trashëgimtarit universal do të mund t'i japë të drejtën trashëgimtarit të përcaktuar në testament të përfitojë nga e gjithë pasuria e testamentlënësit, ashtu siç gjendet ajo në momentin e çeljes së trashëgimisë. Përcaktimi i karakterit të testamentit lidhet ngushtësisht me thirrjen,*vocazione*, që trashëgimlënësi përcakton nëpërmjet testamentit, dhe jo me sasinë e sendeve që përfitohen efektivisht (*shih, vendim unifikues nr. 1, datë 24.03.2005 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

29. Nga pikëpamja e ligjit material, pavarësisht se testamenti përbën veprim juridik të njëanshëm dhe ligji civil nuk ka norma se si interpretohen këto lloj veprimesh juridike, kriteret ligjore për interpretimin e tyre do të huazohen nga normat juridike që rregullojnë kriteret për interpretimin e kontratave, konkretisht nenet 681-689 të KC. Sigurisht, kjo bazë ligjore do të zbatohet përsa mund të zbatohet dhe përsa është e përshtatshme (*mutatis mutandis*). Legjitimiteti i këtij interpretimi me analogji buron nga neni 1 i KPC, i cili ndër të tjera, shprehet se: "*Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.*".

30. Referuar këtyre dispozitave, edhe veprimet juridike të njëanshme do të duhet të interpretohen sipas qëllimit të vërtetë të autorit të tyre, pa u ndalur në kuptimin letrar dhe të ngushtë të fjalëve dhe duke vlerësuar sjelljen e mëparshme dhe të mëvonshme e tij dhe të përfituesit të së drejtës (neni 681 i KC). Kolegji mban parasysh që interpretimin e veprimit juridik të njëanshëm ta bëjë duke nxjerrë kuptimin që vjen nga tërësia e aktit (neni 682 i KC). Gjithashtu, Kolegji mban parasysh se gjatë interpretimit të veprimeve juridike kushdo dhe sidomos gjykata duhet të pranojë si të vlefshëm vetëm variantin e interpretimit që e bën të efektshëm veprimin juridik dhe jo atë që e mohon atë (neni 683 i KC).

31. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit, në interpretimin e testamentit të të ndjerës V.S., nuk janë bazuar në kriteret ligjore të interpretimit të kontratave, me analogji, të parashikuara në nenet 681 e vijues të KC-s, të zbatueshme *mutatis mutandis* edhe për veprimet juridike të njëanshme sikurse është testamenti. Kolegji vlerëson se gjykatat kanë bërë një interpretim të ngushtë, literal dhe të pjesshëm të testamentit, duke lexuar pjesë të caktuara të tij, dhe jo në harmoni me pjesët e tjera. Gjykatat e faktit nuk e kanë vlerësuar në tërësi qëllimin e testatores, duke e deformuar sakaq vullnetin e vërtetë të saj. Nga një lexim në tërësi i testamentit objekt gjykimi, del se qëllimi i vërtetë i testatores ka qenë që të nominojë si trashëgimtar universal, për pasuritë e tashme dhe të ardhshme të saj, të ndjerin R.S., duke përjashtuar çdo trashëgimtar tjetër ligjor.

32. Edhe pse në pjesën e parë duket sikur trashëgimlënësja ka individualizuar pasurinë që synon t'i kalojë palës së paditur R.S., me titull të posaçëm dhe e nominon trashëgimtar me titull universal për pasurinë e ardhshme, të ndryshme nga pasuritë objekt gjykimi, gjykatat nuk kanë vlerësuar dy paragrafët e fundit të testamentit ku trashëgimlënësja është shprehur se:

"*...Unë V.S. kam qenë e martuar me P.S. dhe nga martesa kemi dy fëmijë, R.S. e S.S, të dy të martuar dhe unë jetoj me djalin R.S.. Me hartimin e këtij testamenti testatorja deklaron se përjashton të gjithë trashëgimtarët e tjerë ligjorë, duke i kaluar sipërfaqen e truallit prej 188.1 m2 si dhe çdo pasuri tjetër të paluajtshme që mund të vijë më vonë e më takon mua t'i kalojë si dhuratë vetëm djalit të saj R.S. ...*".

33. Sipas interpretimit që kanë bërë gjykatat më të ulëta, testamenti në tërësi nuk ka kuptim, pasi me logjikën e ndjekur prej tyre, testatorja ka nominuar z. R.S. një herë si trashëgimtar me titull të posaçëm për pasurinë me sipërfaqe 188.1 m2 të ndodhur në qytetin e Pogradecit dhe një herë me titull universal vetëm për pasurinë e ardhshme, duke përjashtuar pasurinë e tashme. Ato kanë vlerësuar se duke qenë që pasuria objekt gjykimi ka qenë pasuri ekzistuese, sipas interpretimit literal të testamentit, për këtë

pjesë të pasurisë, zbatohet trashëgimia ligjore. Në këtë kuptim, gjykatat nuk kanë vlerësuar në tërësi shkakun se pse trashëgimlënësja ka disponuar me testament mbi pasurinë në favor të të ndjerit R.S., që lidhej me faktin se ai kujdesej për të. Po ashtu, gjykatat nuk kanë mbajtur në konsideratë se testatorja në testament pranon se nga martesa me bashkëshortin e saj kanë ardhur në jetë dy fëmijë, z. R.S. dhe znj. V.S., e megjithatë në pjesën fundore të testamentit ajo është shprehur se përjashton gjithë trashëgimtarët e tjerë ligjorë nga pasuria e saj.

34. Sipas një interpretimi logjik, arsyeja se pse testatorja nuk e ka individualizuar konkretisht pasurinë objekt gjykimi, ka qenë për faktin se, në kohën e hartimit të testamentit, e ka pasur në bashkëpronësi me palët e tjera ndërgjyqëse dhe në testament ajo u referohet pasurive në pronësi të saj.Në këtë logjikë, pasuria objekt gjykimi përfshihet në kategorizimin e përgjithshëm të formuluar në testament: *"...si dhe çdo pasuri tjetër të paluajtshme që mund të më vijë më vonë e më takon mua..."*, duke nënkuptuar këtu pjesën që do t'i takonte nga ndarja e sendit në bashkëpronësi.

35. Nga leximi i testamentit në tërësi, Kolegji konkludon se qëllimi i testatorit nuk ka qenë që të individualizojë konkretisht çdo pasuri që ajo disponon me testament, ku pjesërisht e individualizon konkretisht dhe pjesërisht i referohet në mënyrë të përgjithshme, por që të përcaktojë personin në favor të të cilit do të kalojë pasuria e saj. Në mënyrë deklarative, qëllimi ka qenë që ajo të përjashtojë trashëgimtarët e tjerë ligjorë, konkretisht vajzën e saj S.S., duke u shprehur se njeh si trashëgimtar të vetëm për pasuritë e tashme dhe të ardhme djalin e saj, të ndjerin R.S..

36. Sa më sipër, Kolegji konkludon se me testament, trashëgimlënësja V.S. ka cilësuar si trashëgimtar universal, për pasurinë e saj, të ndjerin R.S.. Kolegji vlerëson se nga zbatimi i gabuar i kritereve ligjore për interpretimin e testamentit, gjykatat e faktit kanë individualizuar gabim pjesët takuese të palëve të paditura, R.S. (të zëvendësuar në gjykim nga trashëgimtarët ligjorë të tij), duke zbatuar dispozitat mbi trashëgiminë ligjore. Bazuar tek testamenti objekt gjykimi, e gjithë pjesa takuese e të ndjerës V.S. mbi pasurinë objekt gjykimi, konkretisht prej 4/72 pjesë, nuk duhet të ndahej, por duhet t'i shtohet pjesës takuese të të ndjerit R.S.. Nga ana tjetër, e paditura S.S., me testament, është përjashtuar nga pjesa takuese e nënës së saj.

37. Kolegji vlerëson se identifikimi i gabuar i pjesëve takuese të palëve të paditura, nga gjykatat më të ulëta, si një përllogaritje e thjeshtë matematikore, ka ardhur si rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material. Sipas nenit 485/dh të KPC, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, Gjykata e Lartë nuk ka asnjë pengesë ligjore për ta zgjidhur çështjen përfundimisht, duke ndryshuar pjesërisht vendimet e tyre.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1299, datë 21.07.2021

Ashtu siç është detyrim i gjykatës të japë vendime të arsyetuara, është detyrë e palëve në gjykim që në përputhje me ligjin të provojnë faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet për të drejtat që kërkojnë. Palët, ashtu siç kanë të drejta, kanë dhe detyrime që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara me ligj. Gjykata duhet të lejojë palët që të paraqesin prova shkresore me anën e të cilave, ato të provojnë pretendimet e tyre dhe t'i lejojë palët që t'ia nënshtrojnë këto prova hetimit e debatit gjyqësor.

I. Rrethanat e çështjes

1. Në gjykim është pretenduar se shtetasi M.R., ka qenë një nga tre bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme tokë truall [...] mbështetur [tek] akti i pronësisë i lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme [...], ndodhur në Ishull-Lezhë, me kufizimet përkatëse.

2. Gjithashtu, në bashkëpronësi të subjekteve [...] figurojnë të regjistruara edhe disa objekte të ish ndërmarrjes Bujqësore Lezhë (Qendër), të cilat janë blerë prej tyre dhe janë regjistruar pranë ZVRPP Lezhë. [...]

3-. Pala paditëse ka pretenduar se i padituri Gj.N. dhe D.N. kanë zënë pa asnjë lloj titulli një sipërfaqe prej 2.500 m², e cila përfshihet në sipërfaqen e truallit që është në bashkëpronësi të tij dhe dy shtetasve të tjerë [... dhe] kanë filluar edhe ndërtimin e dy objekteve të kundërligjshme brenda kësaj sipërfaqeje prone, të cilën paditësi pretendon se e ka në pronësi të tij.

4. Në kushtet kur paditësi M.R. nuk ka mundur të gjejë zgjidhje jashtëgjyqësisht me palët e paditura në datën 26.12.2008 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me padinë me objekt lirimin dhe dorëzimin e sendit, si dhe vendosjen e masës së sigurimit të padisë për të ndaluar palët e paditura që të vijojnë ndërtimin e objekteve pa leje brenda pronës së pretenduar se ka qenë në pronësi të tij.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 906, datë 18.09.2009, ka vendosur: - *Kthimin e tokës [...]. Sigurimin e objektit të padisë, duke pezulluar të padituri të mos vazhdojnë të ndërtojnë në tokën e paditësit derisa vendimi të marrë formë të prerë.*

6. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 210, datë 14.04.2010, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. 906, datë 18.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në këtë mënyrë: - Detyrimin e palës së paditur [...] t'i kthejë palës paditëse [...]një sipërfaqe toke prej 2577 m², e cila ndodhet në zonën kadastrale nr. 1966, me nr. pasurie 331/16, e ndodhur në fshatin Ishull-Lezhë [...]*

7.Kundër vendimit nr. 210, datë 14.04.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka ushtruar të drejtën e rekursit pala e paditur Gj.N., e cila ka kërkuar prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë [...]

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 118, datë 03.04.2014 ka vendosur: - Prishjen e vendimit nr. 210, datë 14.04.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.[pasi, ndër të tjera] *Gjykata nuk ka analizuar rrethanat konkrete që kanë të bëjnë me ekzistencën ose jo të kushteve ligjore për pranimin e padisë. [...]*

9. Gjatë rigjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të palës paditëse M.R., është kërkuar që të bëhet kalimi procedural sipas përcaktimeve të nenit 199 të KPC-s, nga paditësi M.R. i cili ka ndërruar jetë në datën 12.04.2015, tek trashëgimtari i vetëm i tij testamentar z. A.R. [...]

10. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 49, datë 04.02.2016, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. 906, datë 18.9.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe rrëzimin e padisë. - Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditësit A.R.[...]

11.Kundër vendimit nr. 49, datë 04.02.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar të drejtën e rekursit pala paditëse [...]Përfundimisht, pala paditëse ka kërkuar: -Prishjen e vendimit nr. 49, datë 04.02.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 906, datë 18.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

12.Kundër rekursit të paraqitur nga pala paditëse A.R. ka ushtruar të drejtën e kundërrekursit pala e paditur Gj.N. [...]duke kërkuar -*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse A.R. kundër vendimit nr*. 49, datë 04.02.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

C) Procedura e gjykimit në Gjykatë të Lartë.

13. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se rekursi

i paraqitur nga pala paditëse A.R. përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim, KPC), të cilat, e bëjnë të cenueshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Shkodër. Kolegji çmon të theksojë se nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër nuk janë zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 118, datë 03.04.2014, nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes, si dhe linja e arsyetimit që ka ndjekur kjo gjykatë rezulton të jetë kontradiktore, se ka elementë të cilët e bëjnë të pavlefshëm procesin e zhvilluar në gjykatën e apelit dhe vendimin objekt shqyrtimi të cenueshëm në kuptim të standardit kushtetues për të pasur një proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Shkodër duhet prishur dhe çështja duhet rikthyer sërish për rigjykim pranë kësaj gjykate. [...]

D) Në lidhje me shkaqet e paraqitura në rekurs dhe zgjidhjen e çështjes

14. Kolegji, konstaton se Gjykata e Apelit Shkodër pavarësisht faktit se ka pasur detyrimin që të fokusonte shqyrtimin gjyqësor në përputhje me detyrat e lëna në vendimin nr.118, datë 03.04.2014 të Gjykatës së Lartë, ajo jo vetëm që nuk rezulton që t'i ketë përmbushur ato, por ka kryer një arsyetim kontradiktor në dhënien e vendimit.

15.Nuk rezulton që Gjykata e Apelit Shkodër në përputhje me kompetencat dhe funksionet e saj ligjore, në respektim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë dhe brenda kufijve të gjykimit të përcaktuar sipas nenit 465 dhe 467 të KPC-s, të ketë identifikuar saktë çështjet që duhet të hetonte dhe të vlerësonte në këtë fazë të gjykimit, të ketë bërë një hetim të thelluar të tyre, si dhe një interpretim përfundimtar dhe të harmonizuar të provave dhe fakteve të pranuara gjatë hetimit gjyqësor, duke arritur në një konkluzion të qartë dhe përfundimtar në lidhje me zgjidhjen e themelit të çështjes objekt shqyrtimi.

16. Gjatë fazës së rigjykimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit Shkodër në përmbushje të detyrave të lëna nga gjykata më e lartë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka arritur ne konkluzionin se: *(i)* paditësi titullin e pronësisë mbi truallin objekt shqyrtimi, e ka fituar nëpërmjet vendimit nr. 22/2, datë 12.12.1995 të KKKP Lezhë; *(ii)* vendimi nr. 22/2, datë 12.12.1995 i KKKP Lezhë nuk është një titull i ligjshëm pronësie, pasi ai është marrë mbi bazën e dokumenteve të falsifikuar; *(iii)* skica "Toka e shpronësueme e Q.Xh...", e cila është përdorur për dhënien e vendimit 22/2, datë 12.12.1995 i KKKP Lezhë, është deklaruar i falsifikuar me vendimin penal nr. 186, datë 19.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; *(iv)* i padituri Gj.N. nuk është posedues i paligjshëm; *(v)* Gj.N. ka fituar posedimin e ligjshëm të pronës objekt shqyrtimi, në bazë të kontratës së shitjes të pronës me kusht

me nr. 2534 rep.,nr. 1776 kol., datë 24.05.2010; *(vi)* posedimi i ligjshëm i palës së paditur provohet edhe nëpërmjet deklaratës noteriale nr. 175 rep., nr. 78 kol., datë 08.04.2010, me të cilën është deklaruar se i ndjeri S.R. i ka shitur shtetasit Gj.N. sipërfaqen prej 2.500 m²*; (vii)* paditësi duhet të gjejë mjetin e duhur ligjor për të kërkuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e shitjes së pronës me kusht, por nuk mund të pretendojë se është në kushtet e nenit 296 të KC-s.

17. Këto konkluzione të Gjykatës së Apelit Shkodër, Kolegji i gjen tërësisht kontradiktore, rrjedhojë të një hetimi të paplotë të çështjes, si dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të unifikuar të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

18. Mosmarrëveshja objekt shqyrtimi ka filluar në vitin 2008 dhe deri në vitin 2016, kur ajo është shqyrtuar me vendimin objekt shqyrtimi nga Gjykata e Apelit Shkodër, kanë ndodhur disa veprime juridike mes palëve, të cilat, duhet të merren në vlerësim dhe shqyrtim nga ana e këtij Kolegji.

19. Në çështjen objekt shqyrtimi, pala paditëse ka ngritur padinë e rivendikimit, e cila është padi reale dhe me të mbrohet e drejta e pronësisë mbi sendet individualisht të përcaktuara, qofshin të luajtshme apo të paluajtshme. Në këtë kuptim, bazuar në përcaktimet e nenit 296 të KC-s, për ngritjen e padisë së rivendikimit, kusht i domosdoshëm është që paditësi të provojë se është pronar i sendit që kërkon dhe nga ana tjetër, i padituri të jetë posedues i paligjshëm i sendit.

19.1 Për këtë arsye, Gjykata e Lartë në vendimin nr. 118, datë 03.04.2014, i ka lënë detyrë gjykatës së apelit që *(i)* të hetonte në origjinë ligjshmërinë e titullit të pronësisë së palës paditëse, i cili buronte nga një vendim komisioni i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të përcaktimeve të ligjit të posaçëm me nr. 1993/7698 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", i ndryshuar; si dhe *(ii)* të hetonte dhe të arrinte në përfundimin nëse posedimi i pronës objekt gjykimi nga ana e palës së paditur është një posedim i ligjshëm apo është i paligjshëm.

20. Gjykata e Apelit Shkodër, gjatë shqyrtimit të çështjes në fazën e rigjykimit, ka pranuar faktin se origjina e pronësisë për këtë palë ndërgjyqëse rrjedh nga vendimi nr. 22/2, datë 12.12.1995 i KKKP Këshilli i Rrethit Lezhë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor kjo gjykatë ka pranuar faktin se, ky vendim komisioni është marrë mbi bazën e një dokumenti të falsifikuar, konkretisht skica*"Toka e shpronësueme e Q.Xh.",* e cila është deklaruar si e falsifikuar me vendimin penal nr. 186, datë 19.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

20.1 Këtë konkluzion të Gjykatës së Apelit Shkodër, Kolegji e gjen të pambështetur në ligj, pasi kjo gjykatë për arritjen e këtij konkluzioni

nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, por është mbështetur tërësisht vetëm tek vendimi nr. 186, datë 19.11.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, i cili, është prishur nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 205, datë 11.05.2015.

21. Nga aktet e administruara në dosje rezulton se me vendimin nr. 186, datë 19.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehurit M.R. për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, si dhe deklarimin e falsitetit të skicës "*Toka e shpronësueme e Q.Xh..*", [...].

22.1 Ky vendim, rezulton të jetë ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër nga ana e organit të akuzës për pjesën që është deklaruar i pafajshëm i pandehuri M.R., si dhe nga i pandehuri M.R., për pjesën ku gjykata është shprehur për deklarimin si të falsifikuar të dokumentit, skicë *Toka e shpronësueme e Q.Xh..*", i cili, është përdorur në dhënien e vendimit nr. 22/2, datë 12.12.1995 i KKKP Këshilli i Rrethit Lezhë.

22.2. Në përfundim të shqyrtimit të këtyre ankimeve, Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr. 205, datë 11.05.2015 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 186, datë 19.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M.R., për shkak se ai ka ndërruar jetë (*referojuni faqes 237 të dosjes gjyqësore*).

23. Në referim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se, me prishjen e vendimit penal të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka rënë edhe fuqia juridike e disponimit të kryer prej saj, si përsa i përket pafajësisë së të pandehurit, ashtu edhe përsa i përket deklarimit të dokumentit të falsifikuar brenda procesit penal me një vendim të formës së prerë.

23.1 Në kushtet kur vendimi penal i dhënë nga gjykata e shkallës së parë, është ankimuar në tërësi të tij, prishja e plotë e këtij vendimi dhe pushimi i gjykimit të çështjes nuk mund të japë efekte detyruese për çështjen objekt shqyrtimi, pasi në lidhje me deklarimin e falsitetit të shkresës nuk ka një gjykim penal themeli dhe një vendim penal të formës së prerë që të ketë deklaruar këtë fakt. Për këtë arsye, Kolegji e gjen të pambështetur në prova dhe ligj konkluzionin e nxjerrë nga Gjykata e Apelit Shkodër se skica "*Toka e shpronësueme e Q.Xh..*" është dokument i falsifikuar, e për rrjedhojë, edhe vendimin nr. 22/2, datë 12.12.1995 të KKKP Këshilli i Rrethit Lezhë një titull pronësie të pavlefshëm.

24. Gjykata e Apelit Shkodër me qëllim përmbushjen e detyrës së lënë nga Gjykata e Lartë për të hetuar në origjinë titullin e pronësisë së palës paditëse, kishte detyrimin që të hetonte se cila ishte prejardhja e titullit të pronësisë së palës paditëse, në mënyrë që të konkludonte nëse njohja e të drejtës së pronësisë mbi pronën objekt shqyrtimi nëpërmjet një vendimi të

komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës ishte marrë në përputhje me përcaktimet e ligjit të zbatueshëm nr. 7698/1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronareve", i ndryshuar apo jo.

24.1. Në vijim të sa më sipër, Gjykata e Apelit Shkodër kishte detyrimin që të shqyrtonte në themel ligjshmërinë e vendimit nr. 22/2, datë 12.12.1995 të KKKP Lezhë, duke përcaktuar qartësisht këta elementë ligjorë dhe hartografikë: *(i)* cila ka qenë prona që i është shpronësuar subjektit të interesuar në mënyrë të padrejtë; *(ii)* cilët janë kufijtë e pronës së shpronësuar në mënyrë të padrejtë; *(iii)* si konfigurohet kjo pronë nga pikëpamja hartografike; *(iv)* çfarë zëri kadastral ka pasur kjo pronë në momentin e shpronësimit dhe cili është zëri kadastral në momentin e shqyrtimit të çështjes; *(v)* cila është sipërfaqja konkrete e pronës; *(vi)* a krijohet përputhshmëri midis hedhjes dhe konfigurimit të pronës në sistemin e vjetër hartografik me sistemin aktual koordinativ (hartografik); *(vii)* pasuria tokë truall e këtij gjykimi, si konfigurohet nga pikëpamja hartografike në lidhje me pronën që iu është njohur dhe kthyer subjekteve të shpronësuar në raport me pronën e njohur dhe kthyer me vendimin nr. 22/2, datë 12.12.1995 të KKKP Lezhë.

24.2. Për të realizuar hetimin gjyqësor të kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit Shkodër kishte detyrimin që të kërkonte të gjithë praktikën dokumentare pranë ATP Tiranë (e cila ka përthithur arkivin e ish-KKKP pranë Këshillit të Rrethit Lezhë), duke hetuar se cilat kanë qenë dokumentet ligjore dhe hartografike bazë, mbi të cilat, subjekteve të shpronësuar Xh. e G.R. (trashëgimtarëve të tyre ligjorë), iu është njohur prona me vendimin nr. 22/2, datë 12.12.1995 të KKKP Lezhë.

24.3. Në funksion të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të kësaj çështjeje, Kolegji vlerëson se, gjykata e apelit ka pasur detyrimin që gjatë ekspertimit të pronës nga pikëpamja grafike, të vlerësonte nëpërmjet mendimit të kualifikuar të një specialisti fushe (eksperti inxh. gjeodet), se në çfarë mënyre dhe në çfarë shkalle ka ndikuar përdorimi i dokumentit skicë "*Toka e shpronësueme e Q.Xh*", në pozicionimin apo në njohjen e pronës subjekteve të shpronësuar Xh. e G.R. me vendimin nr. 22/2, datë 12.12.1995 të KKKP Lezhë.

24.4. Në varësi të konkluzioneve që do të rezultonin nga hetimi në lidhje me këtë çështje, pra nëse ky dokument ka qenë një dokument thelbësor për njohjen e pronësisë së palës paditëse, si dhe në dhënien e vendimit nr. 22/2, datë 12.12.1995 të KKKP Lezhë, Gjykata e Apelit Shkodër kishte detyrimin që brenda procesit gjyqësor civil, në kushtet kur kishte të dhëna se skica "*Toka e shpronësueme e Q.Xh..*" ishte e falsifikuar, duhet të kishte urdhëruar kryerjen e një akti ekspertimi kriminalistik, me qëllim vlerësimin

gjyqësor të tij, nëse ky dokument ishte i falsifikuar apo jo, në përputhje me përcaktimet e neneve 270, 273 dhe 274 të KPC-s.

24.5. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, Kolegji vlerëson se, vetëm nëpërmjet shqyrtimit dhe krahasimit të: (i) akteve shkresore mbi bazën e të cilave është dhënë vendimi nr. 22/2, datë 12.12.1995 i KKKP Lezhë; (ii) akteve shkresore të administruara në ish-ZVRPP Lezhë, që tregojnë gjendjen juridike dhe kadastrale të pronës objekt shqyrtimi; (iii) konkluzioneve të arritura nga verifikimi dhe matjet në terren të pronës objekt shqyrtimi; si dhe (iv) të gjitha akteve të tjera shkresore që janë administruar dhe debatuar nga palët gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata do të kishte mundësi që të konkludonte drejt dhe në mënyrë përfundimtare nëse titulli i pronësisë së palës paditëse është i ligjshëm ose jo.24.6. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka bërë asnjë lloj hetimi gjyqësor dhe as nuk ka bërë një argumentim ligjor bindës të vendimit të dhënë prej saj, duke konkluduar *apriori* se titulli i pronësisë së paditësit, pra vendimi nr. 22/2, datë 12.12.1995 i KKKP Lezhë është i pavlefshëm, pasi njëri nga dokumentet që është përdorur për nxjerrjen e tij ka rezultuar i falsifikuar me një vendim gjyqësor penal, i cili është prishur në një shkallë më të lartë gjykimi.

25. Në lidhje me çështjen e dytë të lënë për zgjidhje nga Gjykata e Lartë në vendimin nr. 118, datë 03.04.2014, e cila ka lidhje me vlerësimin nëse posedimi i pronës objekt shqyrtimi nga pala e paditur Gj.N. është i ligjshëm apo jo, Kolegji vlerëson se, konkluzioni i gjykatës së apelit që ky posedim i palës së paditur është i ligjshëm, është rrjedhojë e një analize ligjore të gabuar, kontradiktore dhe që nuk është analizuar në përputhje me përcaktimet e nenit 92/a të KC-s, në të cilin parashikohet se: "*Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluara).*

26. Gjatë fazës së rigjykimit të çështjes, ka rezultuar e provuar se midis të ndjerit M.R. dhe të paditurit në këtë gjykim Gj.N. është lidhur kontrata e shitblerjes me kusht me nr. 2536 rep. dhe nr. 1776 kol., datë 24.05.2010, nëpërmjet të cilës, i ndjeri M.R. i ka shitur palës së paditur në këtë gjykim Gj.N. pronën e paluajtshme tokë truall me sipërfaqe prej 2.577 m², kundrejt çmimit prej 5,500,000 (pesëmilionë e pesëqindmijë) lekë (*referojuni faqes 129-131 të dosjes gjyqësore*).

26.1. Në referim të përmbajtjes së kësaj kontrate, ka rezultuar se pala e paditur në këtë gjykim, në cilësinë e blerësit i ka likuiduar palës paditëse në cilësinë e shitësit vlerën prej 500.000 (pesëqind mijë) lekë, duke i mbetur

për t'i paguar vlerën prej 5.000.000 (pesëmilionë) lekë, e cila do t'i shlyhej shitësit deri në datën 31.12.2010, kohë në të cilën ai do ta pajiste palën blerëse me certifikatën e pronësisë nga ZVRPP Lezhë.

27. Gjithashtu, nga shqyrtimi gjyqësor në fazën e rigjykimit, ka rezultuar se trashëgimtarët ligjorë të shtetasit S.R. (vëllai i të ndjerit M.R. dhe njëri prej bashkëpronarëve të pronës objekt shqyrtimi), kanë lëshuar deklaratën noteriale me nr. 175 rep. dhe nr. 78 kol., datë 08.04.2010, nëpërmjet së cilës, kanë deklaruar se trashëgimlënësi i tyre S.R., në vitin 1993 i ka shitur shtetasit Gj. sipërfaqen e tokës truall prej 2.500 m², me kufij të përcaktuar, të ndodhur në ish-NB Qendër, fshati Ishull Lezhë, Komuna Shëngjin kundrejt vlerës 2,000,000 (dy milionë) lekë. Nga ky veprim juridik i shitjes, trashëgimlënësi S.R. ka marrë shumën prej 1,600,000 (njëmilion e gjashtëqindmijë) lekë, duke i mbetur pa marrë për këtë shitje edhe vlera prej 400.000 (katërqindmijë) lekësh.

28. Bazuar në aktet e sipërcituara, Gjykata e Apelit Shkodër ka vlerësuar se posedimi i palës së paditur është i ligjshëm dhe për këtë arsye, padia e ngritur nga pala paditëse duhet të rrëzohet. Ky vlerësim i gjykatës së apelit nuk rezulton të jetë rrjedhojë e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, të jetë rrjedhojë e një analize të mirëfilltë ligjore dhe tërësore e të gjitha fakteve, rrethanave dhe akteve shkresore që kanë shërbyer për arritjen e tij. Madje, ky konkluzion vjen tërësisht në kundërshtim me konkluzionin tjetër të arritur nga kjo gjykatë brenda të njëjtit gjykim, vjen në kundërshtim me përcaktimet e një dispozite urdhëruese (neni 92 iKC-s), si dhe praktikën gjyqësore të njësuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

29. Gjykata e Apelit Shkodër nuk rezulton që të ketë analizuar dhe të ketë vlerësuar në mënyrë të plotë dhe shteruese këto çështje: *(i)* me cilin veprim juridik (kontratë shitje) ka fituar titullin e pronësisë pala e paditur në këtë gjykim Gj.N., *(a)* me kontratën e shitjes së vitit 1993 (e cila nuk rezulton që të jetë administruar në dosjen gjyqësore), apo *(b)* me kontratën e shitjes me kusht të vitit 2010; *(ii)* a është plotësuar kushti i parashikuar në kontratën e shitjes me kushte të vitit 2010, në mënyrë që të konkludohet se palës së paditur i ka kaluar titulli i pronësisë mbi pronën objekt shqyrtimi; *(iii)* a mund të konsiderohet i ligjshëm veprimi juridik i shitjes së vitit 1993, kur në dosje nuk rezulton të jetë administruar kontrata e shitjes në formën e kërkuar nga ligji për efekt vlefshmërie dhe provueshmërie; *(vi)* a konsiderohet e lidhur dhe e vlefshme kontrata e shitjes e vitit 1993 midis subjekteve S.R. dhe Gj.N. përsa kohë ky i fundit nuk ka paguar vlerën e plotë të çmimit të shitjes; *(vi)* cila është origjina e pronës që ka shitur i ndjeri S.R. tek i padituri Gj.N. referuar deklaratës noteriale me nr. 175 rep. dhe nr. 78 kol., datë 08.04.2010, si dhe cila është origjina e pronës që i ka shitur i ndjeri M.R. të padituri Gj.N. nëpërmjet kontratës së shitjes me kusht të vitit 2010; *(vii)* a është prona e shitur në vitin 1993 nga subjekti S.R. tek i padituri Gj.N. e njëjtë me pronën që i ndjeri M.R. i ka shitur më kusht të padituri Gj.N. në vitin 2010 *(viii)* a janë veprime juridike të kryera mes palëve ndërgjyqëse në këtë gjykim, veprime juridike absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 92 të KC-s?30. Pa iu dhënë përgjigje çështjeve të mësipërme, të cilat, kanë lidhje me hetimin e çështjes si dhe vlerësimin e provave dhe fakteve që kanë rezultuar nga gjykimi, Kolegji vlerëson se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Shkodër nuk është i drejtë dhe është i cenueshëm nga pikëpamja e ligjit, pasi është kontradiktor në tërësinë e arsyetimit të tij.

30.1. Gjatë fazës së rigjykimit, gjykata e apelit ka pranuar faktin se, shtetasit Mehmet dhe Suljeman R., së bashku me Q.R. janë bashkëpronarë të pronës objekt shqyrtimi, titullin e pronësisë mbi të cilën e kanë përfituar me vendimin 22/2, datë 12.12.1995 të KKKP Lezhë. Nuk ka rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor që këta subjekte të kenë pjesëtuar mes tyre pronën që iu është njohur dhe kthyer me vendimin e sipërcituar të KKKP Lezhë, nëpërmjet një vendimi gjyqësor të formës së prerë (*referojuni 167-173 të dosjes gjyqësore*), apo nëpërmjet pjesëtimit vullnetar para noterit.

30.2. Në kushtet kur gjykata ka arritur në konkluzionin se titulli i pronësisë për trashëgimtarët e subjekteve të shpronësuar Xh. e G.R. (pra M.R., S.R. dhe Q.R.), nuk është i ligjshëm, pasi vendimi nr. 22/2, datë 12.12.1995 i KKKP Lezhë nuk është një titull i ligjshëm pronësie, për arsye se është marrë mbi bazë të dokumenteve të falsifikuara, atëherë nuk mund të pranohet as fakti se posedimi i të padituri Gj.N. është i ligjshëm në kuptim të nenit 92 të KC-s, për sa kohë ai e ka fituar këtë tagër nga veprimet juridike që ka kryer në kohë të ndryshme me subjektet R.. Nëse subjektet R. nuk kanë qenë pronarë të ligjshëm të pronës objekt shqyrtimi, ata nuk mund t'i kalonin të padituri në këtë gjykim tagra të ligjshme pronësie mbi pronën objekt shqyrtimi dhe asnjë lloj tagri tjetër pronësie siç është posedimi.

30.3. Ky konkluzion i Gjykatës së Apelit Shkodër, vjen në mënyrë të hapur në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur në vendimin unifikues nr. 5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është arritur konkluzioni se: "*Veprimi juridik që është i pavlefshëm mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht, pa u kërkuar nga pala e interesuar, madje edhe kundër vullnetit (dëshirës) të saj. Për të konsideruar një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm nuk është e nevojshme paraqitja e një kërkese të posaçme, qoftë kjo padi apo kundërpadi, pasi kjo lloj pavlefshmërie konstatohet pavarësisht nga paraqitja në gjykatë*

e kërkesës. Pavlefshmëria absolute mund të parashtrohet nga çdo palë ndërgjyqëse që ka interes. Forma e parashtrimit mund të jetë edhe prapësimi, kjo për faktin se veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëparshëm Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik nuk mund të bëhet si kërkim i mëvetësuar; ai gjithnjë duhet të bëhet gjatë gjykimit në themel të një çështjeje nga gjykata, ose të paktën si kërkim që shoqëron zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i tij".

31. Bazuar sa më sipër, ishte detyrim i Gjykatës së Apelit Shkodër që të analizonte në mënyrë të hollësishme ligjshmërinë e veprime juridike të kryera në kohë midis trashëgimtarëve R. dhe të paditurit Gj.N. si dhe ndikimin që këto veprime juridike të kryera mes tyre, kanë në lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi. Anashkalimi i këtyre fakteve dhe rrethanave nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër, moskryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të titullit të pronësisë së palës paditëse që në origjinë të saj, si dhe moskryerja e një analize të plotë dhe të gjithanshme të të gjitha çështjeve ligjore dhe faktike të ngritura si më sipër në këtë vendim, ka sjellë si pasojë mungesën e arsyetimit të këtij vendimi dhe zgjidhjen e gabuar të çështjes objekt shqyrtimi.

32. Për këtë arsye, Kolegji arrin në konkluzionin se, në rekursin e paraqitur nga pala paditëse A.R janë ngritur shkaqe nga ato që parashikon neni 472, shkronja "c" e KPC, e cila e bën të cenueshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Shkodër.

33. Kolegji vlerëson të evidentojë faktin se, arsyetimi i vendimit gjyqësor, është detyrim kushtetues i përcaktuar qartë në nenin 142, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin, shprehimisht thuhet se: "*Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara*". Ky detyrim kushtetues, përbën një garanci për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor nga ana e gjykatave. Arsyetimi i vendimit është një garanci kushtetuese që çështja është shqyrtuar me hollësi dhe përgjegjshmëri nga ana e gjykatës, dhe se kjo e fundit, pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm ka dhënë një vendim të bazuar në ligj. Arsyetimi i vendimit është një kusht i domosdoshëm edhe për shqyrtimin që do t'i bëjnë çështjes gjykatat me të larta, në rastin konkret Gjykata e Lartë.

34. Mungesa e një hetimi të plotë të çështjes dhe mospërmbushja e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë në fazën e rigjykimit të çështjes, e vë Gjykatën e Lartë si një gjykatë ligji, në pamundësi për ta zgjidhur këtë çështje në themel të saj, brenda kufijve të saj të gjykimit, duke u fokusuar në një interpretim përfundimtar të mënyrës sesi duhet të aplikohet dhe të zbatohet ligji në këtë rast si dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me

përcaktimet e nenit 485, shkronja "a" "b" dhe "ç".

34.1 Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se çështja duhet të kthehet për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila duhet të riçelë shqyrtimin gjyqësor të saj në përputhje me përcaktimet e nenit 467 të KPC-s dhe të plotësojë të gjitha të metat në hetim që janë evidentuar në paragrafët 28 (me gjithë nënpikat), 33 dhe 35 të këtij vendimi, në përputhje me përcaktimet e nenit 465 të KPC-s, në të cilin përcaktohet se: "*Në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e apelit mbahen parasysh për aq sa janë të zbatueshme dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë*".

35. *Në rigjykim, Gjykata e Apelit Shkodër duhet t'u bëjë të qartë palëve se është detyrë e secilës prej tyre që, në përputhje me ligjin, të provojnë faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet për të drejtat që kërkojnë. Palët ashtu siç kanë të drejta kanë dhe detyrime që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara me ligj. Gjykata duhet të lejojë palët që të paraqesin prova shkresore me anën e të cilave, ato të provojnë pretendimet e tyre bazuar në nenin 12 dhe 19 të KPC-s dhe t'i lejojë palët që t'ia nënshtrojnë këto prova hetimit e debatit gjyqësor.*

35.1 Gjithashtu, gjykata duhet të mbajë në vëmendje dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me përcaktimet e bëra në nenet 5, 6, 95, 120 të KPC-s dhe brenda kufijve ligjore që përcaktohen në nenin 467 të KPC-s, si dhe t'i japë zgjidhje përfundimtare asaj në përputhje edhe me praktikën gjyqësore të konsoliduar në shqyrtimin e kësaj natyre mosmarrëveshjeje. Kryerja e veprimeve të përmendura më sipër, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të lindin gjatë rigjykimit, do të lejojnë gjykatën të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes.

36. Për sa më sipër, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk i hyn analizës së provave, gjë që duhet ta bëjnë gjykatat e niveleve më të ulëta, por ajo vetëm evidenton shkeljet ligjore që kanë lejuar gjykatat e ulëta, qoftë të normave procedurale apo atyre materiale, duke kërkuar respektimin e tyre. Në rrethanat kur gjykata e apelit i ka të gjitha mundësitë ligjore të marrë në shqyrtim dhe të zgjidhë mosmarrëveshjen objekt gjykimi, Kolegji, vlerëson të prishë vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe të dërgojë çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me një trupë tjetër gjykuese.

Vendim i Kolegjit Civil, nr. 00-2021-1253, datë 28.07.2021

Parimi i perpetuatio iurisdictionis nënkupton se kur një subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor, ligji procedural i garanton shqyrtimin e çështjes përmes një gjyqtari/trupe gjykuese, ku juridiksioni dhe kompetenca e përcaktuar sipas ligjit nuk ndryshon, modifikohet apo humbet ex ante factum, me përjashtim të rasteve kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite nëpërmjet dispozitave tranzitore ndryshe.

I. Rrethanat e çështjes:

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se, paditësi D.P., më datë 13.07.2020, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesë për vërtetimin e faktit juridik të viteve të punës, pranë ish-Ndërmarrjes Bujqësore (NB) [..]. Ai ka pretenduar se dokumentacioni përkatës që provon këtë fakt juridik është djegur gjatë trazirave të vitit 1997 dhe nuk mund të ribëhet më. Për këtë arsye i është drejtuar gjykatës me kërkesë, sipas nenit 388 të KPC-s.

2. Në seancën gjyqësore të datës 29.01.2021, nga gjykata është ngritur kryesisht çështja e juridiksionit gjyqësor për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 169/2020 "Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore" (në vijim, Ligji nr. 169/2020). Në lidhje me këtë çështje kërkuesi është shprehur se ky ligj rregullon njohjen e viteve të punës pranë ish-kooperativave bujqësore dhe jo pranë ish-ndërmarrjeve bujqësore, sikurse është rasti konkret.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 29, datë 29.01.2021 ka vendosur: "*1.Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile me nr. 85/342 regjistri themeltar, datë 13.07.2020 regjistrimi, me kërkues D.P., me palë të tretë DRSSH Durrës...; 2. Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer; 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*".

4. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kjo çështje, me hyrjen në fuqi të dispozitave të Ligjit nr. 169/2020, nuk i përket më juridiksionit gjyqësor. Qëllimi i Ligjvënësit nëpërmjet këtij ligji ka qenë njohja e vjetërsisë në punë të punonjësve pranë ish-Kooperativave Bujqësore, automatikisht dhe administrativisht, nëpërmjet depozitimit të një liste dokumentacioni që vërteton banimin, faktin që kërkuesi nuk ka qenë i dënuar dhe që nuk ka përfituar pension invaliditeti.

4.1. Ky ligj pati si qëllim t'i jepte fund investimit gjyqësor për çështje të kësaj natyre, duke ofruar një zgjidhje më të shpejtë nga ana e administratës publike. Në këtë mënyrë, Ligjvënësi ka synuar të eliminojë dy kategori çështjesh, fillimisht proceset gjyqësore për njohjen e periudhës së punësimit dhe më tej proceset e tjera për detyrimin e organeve publike për lidhjen e pensionit në këto raste.

4.2. Pavarësisht se Ligji nr. 169/2020 i referohet nocionit të ish-kooperativave bujqësore, ai duhet të gjejë zbatim edhe për dokumentacionin e ish-ndërmarrjeve bujqësore. Këto të fundit, sikurse ish-kooperativat bujqësore, kanë qenë ekonomi kolektive të krijuara nga bashkimi vullnetar i punonjësve të një fshati apo të disa fshatrave, të cilat kishin bashkuar tokat dhe mjetet e tjera të prodhimit dhe punonin së bashku për të ndarë të ardhurat, sipas sasisë dhe cilësisë së punës në bujqësi. Referuar VKM nr. 452/1992 "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore" ndërmarrjet bujqësore i krijuan nga toka e ish-kooperativave bujqësore.

4.3. Gjykata ka vlerësuar se ky qëndrim nuk përbën devijim nga parimi *juridistionis perpetuatio* sipas nenit 36/2 të KPC-s, por një përpjekje e Ligjvënësit që me ligj special t'u ofrojë akses dhe zgjidhje të menjëhershme administrative pretendimeve të palëve për njohjen e faktit të vjetërsisë në punë, kur dokumentacioni përkatës është djegur, pa qenë e nevojshme kryerja e një procesi të mëvetësishëm gjyqësor.

5. Kundër këtij vendimi, me datë 24.05.2021 ka ushtruar ankim të veçantë paditësi z.D.P., duke parashtruar se: Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është i pabazuar në ligj; Sipas nenit 36/2 të KPC-s, juridiksioni përcaktohet në momentin fillestar të paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëvonshme të ligjit apo të faktit; Në rastin konkret nuk jemi para një konflikti administrativ, ku ezaurimi i rrugës administrative është kusht për aktivizimin e juridiksionit gjyqësor, por para një kërkese sipas nenit 388 të KPC-s; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka keqzbatuar Ligjin nr. 169/2020, i cili ka rregulluar njohjen e vjetërsisë në punë pranë ish-Kooperativave Bujqësore, dhe jo pranë ish-Ndërmarrjeve Bujqësore, sikurse është rasti konkret.

6. Nuk rezulton i dokumentuar në dosje se kur i është komunikuar kërkuesit vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

7. Kolegji Civil (në vijim, Kolegji), fillimisht vlerëson se kërkuesi. z. D.P., prezumohet në afat për paraqitjen e ankimit të veçantë, kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me të cilin është nxjerrë çështja jashtë juridiksionit gjyqësor, përsa kohë në dosjen gjyqësore nuk rezulton i dokumentuar momenti se kur i është komunikuar vendimi i arsyetuar i gjykatës, moment nga i cili fillon të ecë afati i ankimit sipas nenit 444 të KPC-s.

8. Në vijim, Kolegji vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë nuk ka kualifikuar drejt çështjen e juridiksionit në shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 388 të KPC-s në rastin konkret. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës duhet të prishet dhe çështja të dërgohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për vazhdimin e gjykimit.

9. Juridiksioni gjyqësor civil është parashikuar në nenin 36 të KPC-s, sipas të cilit janë në juridiksionin gjyqësor të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor është i përgjithshëm dhe i detyrueshëm (neni 1/2 i KPC-s). Një çështje mund të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur ligji në mënyrë eksplicite ka përcaktuar se subjekti pretendues, përpara se t'i drejtohet gjykatës duhet të shterojë juridiksionin administrativ. Në këto raste mosndjekja e juridiksionit administrativ pengon marrjen në shqyrtim të çështjes nga ana e gjykatës.

10. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje praktikën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ku është pranuar se juridiksioni gjyqësor prezumohet, për sa kohë ligji i posaçëm në mënyrë eksplicite nuk e ka kushtëzuar me ndjekjen e rrugës administrative. Në Vendimin Unifikues nr. 1, datë 26.11.2010, është konkluduar se: "*Ndjekja e rrugës administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative para se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, pranon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët, eventualisht dhe sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ…".*

11. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Ligji nr. 169/2020 "*Për Njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore*", është miratuar më datë 23.12.2020. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 08.01.2021 dhe ka hyrë në fuqi më datë 23.01.2021.

12. Në nenin 1 të Ligjit ku përcaktohet qëllimi i tij, është parashikuar se: *"Logjika për qëllim njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitim nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore, për të cilat është djegur dokumentacioni arkivor i vjetërsisë në punë, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991,"Për tokën", të ndryshuar.".*

13. Po ashtu, në nenin 2 të këtij ligji thuhet se: *"1. Njihet si periudha e sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, nga mosha për punë në kooperativat bujqësore e përcaktuar në legjislacionin e kohës, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën"; 2. Njohja e periudhës së sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore sipas paragrafit të parë të këtij neni, në varësi të periudhës së deklaruar nga vetë personat kërkues, bëhet respektivisht me ditë, muaj ose vite të plota pune vetëm kur vërtetohet se gjatë periudhës së deklaruar: a) nuk ka qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie; b) nuk ka qenë përfitues i pensionit të invaliditetit të plotë; c) ka qenë banor i territorit në të cilin ka shtrirë aktivitetin e saj ish-kooperativa bujqësore.".*

14. Ligji ka gjithsej 6 dispozita dhe në asnjërën prej tyre, nuk parashikon në mënyrë të shprehur se për njohjen e faktit të vjetërsisë në punë, në kushtet e përcaktuara në të, duhet të shterohet rruga administrative, si kusht për të aktivizuar juridiksionin gjyqësor sipas nenit 388 të KPC-s.

15. Kolegji vlerëson se ndërhyrja e ligjvënësit, ka pasur si qëllim thjeshtëzimin e hetimit administrativ dhe shmangien e procedurave të panevojshme dhe të zgjatura gjyqësore për të vërtetuar fakte që nuk kanë nevojë të provohen dhe që mund të verifikohen lehtësisht nga organi administrativ. Miratimi i këtij ligji u imponua për shkak të praktikave abuzive të administratës publike në fushën e sigurimeve shoqërore, që në çdo rast të mungesës së dokumentacionit i adresonin subjektet që pretendonin të drejtën e pensionit të vërtetonin gjyqësisht faktin e vjetërsisë në punë në ish-kooperativat bujqësore. Nga ana tjetër, proceset e gjata gjyqësore, në të gjithë shkallët e gjykimit dhe të pajustifikuara, për provueshmërinë e fakteve botërisht të njohura, rrezikonte humbjen në thelb të së drejtës së pensionit, si e drejtë themelore kushtetuese me rëndësi jetike për shtresa vulnerabël të shoqërisë.

16. Zvarritja e procedurave hetimore, administrative apo gjyqësore, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së këtij ligji, por të moskuptimit si duhet të të drejtave dhe detyrimeve të organeve publike në hetimin administrativ (*shih, Vendim nr. 00-2021-597, datë 14.04.2021; Vendim nr. 00-2021-565, datë 14.04.2021; Vendim nr. 00-2021-562, datë 14.04.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, etj.,*.).

17. Me qëllim verifikimin e pretendimit të palës kërkuese gjatë një procedure administrative, organi publik ka detyrimin ligjor të realizojë hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në ligj, organi publik është i detyruar të shprehet me vendim përfundimtar (*shih, nenin 90 të KPA-s*), duke nxjerrë aktin administrativ që refuzon ose pranon kërkesën e palës për njohjen e së drejtës subjektive të pretenduar prej saj, pasi ka analizuar dhe vlerësuar në tërësi të gjitha faktet dhe provat e administruara me iniciativë të palës ose edhe kryesisht prej tij.

18. Hetimi, marrja e provave, mbledhja e fakteve dhe vlerësimi i tyre në tërësi, si çështje e ndërmjetme e procedimit administrativ, nga e cila varet zgjidhja e çështjes, nuk është kompetencë dhe tagër vetëm i pushtetit gjyqësor, por është detyrim primar dhe funksional i organit publik që do të vendosë mbi kërkesën e palës së interesuar në procedimin administrativ.

19. Duke iu referuar neneve 77, 78, 79, 80 dhe 81 të KPA-s, ligjvënësi e ka pajisur organin administrativ me të njëjtin kapacitet ligjor për të hetuar, sikurse organet gjyqësore. Ai ka të drejtën dhe detyrimin të pranojë dhe të marrë prova nga pala në procedurën administrative, sipas të gjitha burimeve të provës të lejuara edhe në gjykimin administrativ apo civil: dokumente, prova me dëshmitar, deklarata të palëve, ekspertime, etj.,. Neni 80/2 i KPA-s referon tek Ligji nr. 49/2012 për provat dhe mjetet e provës të lejuara në procedurën administrative dhe si rrjedhojë, në mënyrë komplementare edhe në dispozitat e KPC-s mbi burimet e provës për aq sa është e mundur. Në mënyrë simetrike me hetimin gjyqësor, hetimi administrativ thjeshtëzohet edhe nga prezumimet ligjore apo faktet botërisht të njohura, të cilat nuk kanë nevojë të provohen.

20. Nga ana tjetër, aksesi në gjykatë sipas neneve 32, pika "b" dhe "c" apo sipas nenit 388 të KPC-s, është mjet alternativ, e drejtë dhe garanci e palës së interesuar, por jo rrugë e detyrueshme për t'u ndjekur, kusht pa të cilin nuk mund të vijojë procedura administrative. Po ashtu, për ngritjen e një padie me karakter deklarativ sipas nenit 32 të KPC-s apo për të investuar gjykatën sipas nenit 388 të KPC-s, nuk është e detyrueshme ezaurimi paraprakisht i juridiksionit administrativ. Mbetet në disponibilitetin e palës për të përzgjedhur mjetin se si do të rivendosë më shpejt dhe në mënyrë më eficiente të drejtat subjektive.

21. Në këtë kuptim, Ligji nr. 169/2020 nuk solli risi në atribuimin për herë të parë të juridiksionit administrativ mbi hetimin e fakteve juridike me pasoja për palën në procedurën administrative, por e thjeshtëzoi atë dhe kufizoi diskrecionin e organeve vendimmarrëse (administrative apo gjyqësore), mbi vlerësimin e faktit juridik të vjetërsisë në punë, duke i hequr palës që pretendon të drejtën e pensionit, një barrë të paarsyeshme për të paraqitur prova në procedimin administrativ dhe gjyqësor (Vendim nr. 00–2021-706, datë 10.05.2021 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

22. Sipas nenit 80/3 të KPA-s: "*3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.*".

23. Duke qenë se prezumimet formalisht parashikohen nga ligji, arsyeja e daljes së Ligjit nr. 169/2020 ishte shkarkimi nga barra e provës të kërkuesit, në mënyrë të tillë që fakti juridik i viteve të punës në ish-kooperativat bujqësore, nga i cili varet e drejta e pensionit, në raste kur dokumentacioni është djegur, të ngrihej në nivelin e një prezumimi, para cilitdo juridiksioni që do të merrej në shqyrtim (administrativ apo gjyqësor), i cili njihet *ex legge*, mjafton të provohet baza e prezumimit se: a) kërkuesi nuk ka vuajtur dënimin me heqje lirie në atë kohë; b) nuk ka përfituar nga sigurimet shoqërore pension për invaliditet të plotë; c) ka qenë pjesëtar i kooperativës përkatëse.

24.Prezumimi, si çlirim nga barra e provës, konsiston në atë që disa fakte mund të deduktohen nga ekzistenca e fakteve të tjera me të cilat të parat kanë një lidhje shkakësore të domosdoshme dhe të drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë, duke operuar me instrumentin e prezumimeve ligjore, Ligjvënësi synon të përshpejtojë procesin e të provuarit dhe të ekonomizojë procedurën e hetimit administrativ apo gjyqësor.

25. Përcaktimi me ligj i këtij prezumimi ka si bazë detyrimin që ka pasur çdo pjesëtar i ish-kooperativës bujqësore për të punuar sipas legjislacionit të kohës dhe puna si detyrim ligjor në atë periudhë përbën fakt botërisht të njohur. Për shkak të këtij detyrimi, ekziston një lidhje shkakësore e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme midis mungesës së rrethanave penguese për të punuar, sikurse përcaktohen në nenin 2/2 të Ligjit nr. 169/2020 dhe ekzistencës së marrëdhënies së punës së kujtdo, në këto organizime kolektive publike. E thënë ndryshe, mungesa e tri rrethanave përjashtuese të parashikuara në ligj, në mënyrë të domosdoshme passjell faktin se kushdo ka punuar sipas normës dhe ligjit të kohës në ish-kooperativat bujqësore. Kjo është rrjedhojë logjike për shkak të eksperiencës dhe

marrëdhënieve shoqërore të asaj kohe.

26. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se në çdo eventualitet, edhe në situatën hipotetike ku ligji do të parashikonte juridiksionin administrativ për shqyrtimin e kërkesave të tilla, çështja konkrete ka qenë në juridiksionin gjyqësor sipas nenit 36/3 të KPC-s. Kërkesa është regjistruar në gjykatë më datë 13.07.2020, ndërkohë që ligji nr. 169/2020 ka hyrë në fuqi gjatë gjykimit, konkretisht më datë 23.01.2021.

27. Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, parimi i sanksionuar në këtë dispozitë, (*perpetuatio iurisdictionis*), nënkupton se, kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij Republika ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet (*translatio iudicii*) apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pajuridiksion apo jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu vetëm rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite nëpërmjet dispozitave tranzitore ndryshe (*shih, Vendim Njehsues nr. 13, datë 04.04.2018 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, paragrafi 55 i vendimit*).

28. Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka pasur detyrimin të shqyrtojë dhe t'i japë zgjidhje me vendim përfundimtar, kërkesës së kërkuesit, z. D.P., sipas nenit 388 të KPC-s, duke u bazuar, për aq sa është e mundur, në kriteret e vendosura në Ligjin nr. 169/2020, në vërtetimin e faktit juridik të viteve të punës të pretenduar prej tij.

Vendim i Kolegjit Civil, Nr. 00-2021-1311, datë 28.7.2021

Në kontratat e punësimit pranë agjencive apo subjekteve me imunitet juridiksional, raporti juridik midis palëve duhet analizuar rast pas rasti; nëse ky raport rregullohet nga e drejta publike, (acta iure imperii) apo i përket fushës së zbatimit të së drejtës private (acta iure gestionis) duke analizuar nëse veprimtaria e realizuar nga punëmarësi konsiderohet si një veprimtari e lidhur direkt me kryerjen e misionit dipomatik; nëse punëmarrësi ka pasur shtetësinë e shtetit punëdhënës; mundësia efektive dhe jo vetëm teorike e punëmarrësit për të pasur akses në gjykatë në shtetin tjetër, etj.,.

Juridiksioni gjyqësor i gjykatës në vendin ku kryen punën punëmarrësi prezumohet dhe pala që pretendon se përfiton nga imuniteti juridiksional ka barrën e provës dhe të argumentimit se pse nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor vendas.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se paditësja ka qenë e punësuar pranë palës së paditur në bazë të kontratës së punës, pa afat të caktuar, datë 19.08.2019. Paditësja është punësuar në pozicionin e asistentes administrative [...].

2. Paditësja ka pretenduar se më datë 16.04.2020, pala e paditur ka zgjidhur kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustifikuar. Sa më sipër, paditësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi [...].

3. Sipas shkresës nr. 12909, datë 30.10.2020 të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, referuar notës verbale nr. 00301/20, datë 21.10.2020 të Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, kjo e fundit nuk ka pranuar juridiksionin gjyqësor shqiptar.

4. Në nenin 13 të kontratës së punës, nën titullin "zgjidhja e kontesteve", është parashikuar se:

"*Çfarëdo kundërshtimi ose kontesti lidhur me këtë kontratë duhet të zgjidhen nga gjykata përkatëse e juridiksionit të parë, në bazë të ligjit vendor të punës*".

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2067, datë 06.04.2021 ka vendosur:

"*1. Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të çështjes civile nr. 6509 regjistri themeltar, me datë regjistrimi 25.06.2020, me palë paditëse D.R. dhe palë të paditur Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës.*[*] *Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë sipas ligjit.".*

6. Kundër këtij vendimi, më datë 04.05.2021 ka ushtruar ankim të veçantë pala paditëse [...]

7. Rezulton se vendimi i arsyetuar i është komunikuar palës paditëse më datë 29.04.2021.

8. Kolegji Civil (në vijim Kolegji), fillimisht mori në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi më datë 16.06.2021, sipas nenit 63 të Kodit të Procedurës Civile(në vijim, KPC).

9. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se gjykata e shkallës së parë nuk kishte hetuar mbi detyrat konkrete të paditësit në marrëdhënien e punës, fakt juridik procedural, nga i cili varej zgjidhja e çështjes së juridiksionit, sipas analizës që do të bëhet në vijim.

10. Në këto kushte, Kolegji konkludoi se kjo çështje nuk mund të zgjidhej në dhomë këshillimi. Sipas neneve 473/a dhe 482/a të KPC-s, Kolegji vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, për t'u dëgjuar palët, mbi detyrat konkrete të paditësit në marrëdhënien e punës, nëse këto detyra, sipas përshkrimit të pozicionit të punës, lidheshin direkt me ushtrimin e sovranitetit të shtetit të [...] (*acta iure imperii*) (*shih për analogji vendim nr.18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).[...]

12.1. Pala e paditur, Konsullata e Republikës së Kosovës në Shqipëri, nuk u paraqit në seancën gjyqësore të datës 28.7.2021 para Gjykatës së Lartë, megjithëse ishte njoftuar rregullisht, me njoftim individual sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit. Në përputhje me parashikimin e nenit 473/a dhe 482 të KPC-s, kësaj pale iu njoftua edhe vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit, ku ishte pasqyruar edhe shkaku pse ishte vendosur kalimi i çështjes në seancë, konkretisht për të sqaruar pozitën e paditëses dhe detyrat konkrete të saj në kontratën e punës objekt gjykimi. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i paditëses argumentoi se pozicioni i punës së paditëses nuk ishte i tillë që të përfshinte kryerjen e veprimeve të lidhura direkt me ushtrimin e sovranitetit të Republikës së Kosovës.

[*] Ky shënim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

13. Duke u bazuar në aktet e fashikullit të gjykimit, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është në përputhje me Kushtetutën, KPC-n, të drejtën ndërkombëtare, me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), me praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe praktikën e Gjykatës së Lartë në çështje të ngjashme.

14. Fillimisht është e rëndësishme të theksohet se vendimi nr. 8/2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e ka fushën e zbatimit shumë të kufizuar, vetëm për konfliktet e punës ku punëdhënës është një subjekt i së drejtës së SHBA, që gëzon mbrojtje sipas marrëveshjes dypalëshe të lidhur midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së SHBA-ve, datë 10.06.1992. Si rrjedhojë mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i akteve ndërkombëtare apo i marrëveshjeve dypalëshe duhen dalluar rast pas rasti (*shih.Vendim nr. 18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*).

15. Po ashtu, krahas zbatimit të Konventës së Vjenës "Për marrëdhëniet diplomatike" (në vijim, Konventa e Vjenës) dhe nenit 39 të KPC-s, gjykata duhet të kishte në vëmëndje edhe KEDNJ-n dhe praktikën e GJEDNJ-s, për raste të ngjashme si dhe doktrinën e imunitetit juridiksional të kufizuar, në kontratat e punës, e cila është bërë pjesë edhe e parimeve të gjithëpranuara dhe praktikës moderne ndërkombëtare. Kolegji thekson se KEDNJ ka një status të privilegjuar në rendin juridik shqiptar, në raport me aktet e tjera ndërkombëtare, duke pasur status të njëjtë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përsa i përket kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore.

16. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje Vendimin e GJEDNJ-s (Dhoma e Madhe), në çështjen *Cudak Kundër Lituanisë, aplikimi 15869/02, datë 23.03.2010*, ku GJEDNJ ka cituar Konventën e Kombeve të Bashkuara datë 02.12.2004 mbi imunitetet juridiksionale, në veçanti nenin 11 të saj, e cila ka kufizuar imunitetin juridiksional në kontratat e punës, të aplikueshëm vetëm në rrethana të caktuara. GJEDNJ në këtë vendim është shprehur se:

"*Parimet e vendosura në Konventën e Kombeve të Bashkuara datë 02.12.2004 duhen konsideruar si parime të gjithëpranuara ndërkombëtare...Edhe në kushtet ku një shtet nuk e ka ratifikuar atë, duhet të konsiderohet i lidhur nga parashikimet e kësaj konvente, përsa kohë ato reflektojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare...*" (*shih, paragrafin 66 të vendimit*).

17. Në nenin 11 të kësaj Konvente është parashikuar se, në parim, përsa kohë nuk ka një marrëveshje ndryshe, një shtet nuk mund të kërkojë

imunitet juridiksional nga gjykatat e një shteti tjetër, që janë njëkohësisht kompetente, për të shqyrtuar mosmarrëveshjet që burojnë nga kontratat e punës midis një individi dhe këtij shteti, kur puna do të realizohet pjesërisht apo tërësisht në territorin e shtetit pranues.

18. Sipas Konventës, bëjnë përjashtim kontratat e punës, ku punëmarrësi është rekrutuar të realizojë një funksion publik të shtetit dërgues; kur i punësuar është një agjent diplomatik, konsullor etj, që gëzon imunitet diplomatik sipas parashikimeve të Konventës së Vjenës; nëse mosmarrëveshja para gjykatës lidhet me pretendime që kanë të bëjnë me rekrutimin, rinovimin e kontratës së punës apo rikthimin në detyrë; nëse mosmarrëveshja përfshin apo lidhet me interesat e sigurisë së atij shteti; punëmarrësi ka shtetësinë e shtetit punëdhënës etj.,.

19. GJEDNJ ka theksuar sakaq se, KEDNJ ka si synim të garantojë të drejta që janë praktike dhe efektive, dhe jo teorike dhe iluzore. Në këtë kuptim, GJEDNJ ka theksuar se nuk do të ishte në përputhje me shtetin e së drejtës dhe në përputhje me të drejtën për një gjykatë sipas nenit 6, nëse një shtet do të mënjanonte pa kufizim, nga juridiksioni gjyqësor një tërësi çështjesh ku pretendohen të drejta civile duke referuar tek imuniteti i kategorive të caktuara të personave. Në çdo rast, kufizimi i aksesit në gjykatë duhet të jetë proporcional dhe i justifikuar nga një qëllim legjitim, duke gjetur një balancë të drejtë midis parimit të barazisë së sovrantitetit të shteteve dhe nga ana tjetër të drejtës për akses në gjykatë të kujtdo që kërkon mbrojtje gjyqësore për të drejtat e tij.

20. Si rrjedhojë, në rastet ku lind nevoja e zbatimit të imunitetit juridiksional dhe kufizohet aksesi në gjykatë, do të duhet të merren në analizë rrethanat konkrete, nëse janë të tilla që e justifikojnë një kufizim të tillë (*shih, paragrafin 59 të vendimit*).

21. Duke iu referuar çështjes konkrete të cituar më sipër para GJEDNJ-s, një shtetase lituaneze, ishte punësuar pranë Ambasadës së Polonisë në Vilnius, në pozicionin e sekretares, ku ndër të tjera kishte edhe disa detyra administrative si organizimi i takimeve, fotokopjimi i dokumenteve, marrja dhe dërgimi i fakseve etj.,. Pasi ishte zgjidhur kontrata e punës, ajo u ishte drejtuar gjykatave vendase për dëmshpërblimet përkatëse. Gjykatat vendase e kishin nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, për shkak se pala e paditur, Ambasada Polake gëzonte imunitet juridiksional. GJEDNJ në këtë rast e gjeti me shkelje Lituaninë pasi nuk kishte garantuar nenin 6 të KEDNJ-s. Ndër të tjera GJEDNJ u shpreh se:

"...Rasti konkret nuk rezulton të përfshihet në një nga përjashtimet e parashikuara në nenin 11 të Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 2004; Nuk rezulton që aplikuesja të ketë performuar një funksion të veçantë, ngushtësisht të lidhur me ushtrimin e autoritetit qeveritar; Nuk rezulton që ajo të ishte agjent diplomatik apo konsullor dhe as nuk rezulton të ketë shtetësinë e shtetit punëdhënës...As Gjykata Supreme e Lituanisë dhe as qeveria nuk dhanë argumente mjaftueshëm se në çfarë mënyre detyrat e aplikueses mund të lidheshin objektivisht me interesat e sovranitetit të shtetit polak...Gjykata Supreme i është referuar vetëm titullit të pozicionit të saj dhe kërkesës së palës së paditur për të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit..." (*shih paragrafët 69-74 të vendimit*).

22. Ky qëndrim i GJEDNJ-s është mbajtur edhe në çështjen *Sabeh El Leil kundër Francës,* vendimi i Dhomës së Madhe, i datës 29.06.2011 dhe është rikonfirmuar prej saj edhe në vendimmarrjen në vijimësi (*Wallishauser kundër Austrisë*, vendim i datës 17.07.2012 dhe *Oleynikov kundër Rusisë*, vendim i datës 14.03.2013).

23. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në një mosmarrëveshje pune midis një shtetasi shqiptar dhe Ambasadës së Katarit. Kështu, në vendimin nr.18, datë 15.03.2016, Gjykata ka arsyetuar se: *"Lidhur me zbatimin e parimit të imunitetit absolut të shtetit, GJEDNJ-ja ka vërejtur se nëpër vite ai është zbehur në mënyrë të qartë, në veçanti me miratimin e konventës për imunitetet juridiksionale të shteteve dhe të pronave të tyre nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2004. Kjo konventë u bazua në projekt-nenet e vitit 1991, neni 11 i të cilave kishte të bënte me kontratat e punës, dhe krijoi një përjashtim të rëndësishëm në çështjet e imunitetit shtetëror, parim i cili nënkupton se rregulli i imunitetit diplomatik nuk zbatohet në kontratat e punësimit të shtetit me stafin e përfaqësive të tij diplomatike jashtë vendit, me përjashtim të situatave të përcaktuara në mënyrë shteruese në paragrafin 2 të nenit 11 (shih Sabeh El Leil të cituar më lart, paragrafi nr. 53)....Në të gjitha çështjet e lartpërmendura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së theks i veçantë i vihet natyrës së mosmarrëveshjes dhe natyrës së pozicionit të punës së aplikantit. Në këtë kontekst, GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se edhe pse imunitetet sovrane mund ta justifikojnë deri diku kufizimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, pengesa e të punësuarve nëpër ambasada për të paditur punëdhënësit e tyre përbën një kufizim joproporcional të së drejtës së aksesit në gjykatë, sidomos në rastet kur këta punonjës nuk kanë qenë pjesë e stafit konsullor ose diplomatik apo shtetas të shtetit të huaj dhe kur nuk kanë kryer funksione që lidhen me sovranitetin e shtetit të huaj..."*.

24. Nën dritën e parimeve të trajtuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, Kolegji vlerëson se qëllimi i konventës së Vjenës nuk është t'u japë

misioneve diplomatike imunitet të pakufizuar për çdo lloj përgjegjësie civile, por vetëm për ato veprime që çmohen se janë përmbushje e objektit të veprimtarisë së tyre. Në këtë kuptim, jo çdo veprim juridiko-civil i kryer nga ana e subjekteve që pretendojnë gëzimin e imunitetit diplomatik, për më tepër kur kemi të bëjmë me lidhje të kontratave të punësimit me shtetas të vendit ku ndodhet përfaqësia diplomatike, përbën vetvetiu veprim "të lidhur direkt" me kryerjen e veprimtarisë së saj.

25. Në zgjidhjen e çështjeve të juridiksionit, në këto raste, gjykatat duhet t'u përmbahen edhe normave dhe parimeve të njohura të së drejtës ndërkombëtare, lidhur me qëllimin dhe zbatimin e "imunitetit të kufizuar" nga juridiksioni. Në këtë vlerësim, duhet mbajtur parasysh nëse objekt i gjykimit është një akt (veprim) publik, apo një akt privat, që nuk cenon sovranitetin e shtetit tjetër, sikurse mund të jenë kontratat e punësimit.

26. I njëjti qëndrim në çështje të ngjashme është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë (*shih Vendimin nr. 00-2016-2012 (218), datë 22.06.2016; Vendimin nr. 00-2010-472 (60), datë 09.02.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*,).

27.*Sipas doktrinës së imunitetit juridiksional të kufizuar, për të konkluduar mbi juridiksionin gjyqësor në kontratat e punësimit pranë agjencive apo subjekteve me imunitet juridiksional, në raste të ngjashme, duhet analizuar rast pas rasti, raporti juridik midis palëve; nëse ky raport rregullohet nga e drejta publike, (acta iure imperii) apo i përket fushës së zbatimit të së drejtës private (acta iure gestionis); duhet analizuar pozicioni që ka pasur punëmarrësi dhe përshkrimi i detyrave të tij; nëse ka ushtruar një pjesë të sovranitetit të shtetit të huaj të atashuar në shtetin pritës apo nëse ka pasur një kontratë pune rutinë; nëse veprimtaria e realizuar nga punëmarësi konsiderohet si një veprimtari e lidhur direkt me kryerjen e misionit dipomatik; nëse punëmarrësi ka pasur shtetësinë e shtetit punëdhënës; mundësia efektive dhe jo vetëm teorike e punëmarrësit për të pasur akses në gjykatë në shtetin tjetër etj.,.*

23. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se as Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe as pala e paditur që pretendon se përfiton nga imuniteti juridiksional, nuk kanë argumentuar se në çfarë mënyre, pozicioni i punës së punëmarrësit lidhet ngushtësisht dhe objektivisht me ushtrimin e sovranitetit të shtetit të Kosovës apo se pse raporti i krijuar midis palëve hyn në sferën e së drejtës publike (*acta jure imperii*). Po ashtu, nga aktet e fashikullit të gjykimit, përshkrimi i punës dhe detyrat që ka pasur paditësja jepen në mënyrë të përgjithshme. Në kontratë thuhet se ajo ka pasur pozicionin e asistentes administrative, sipas shtojcës bashkëlidhur, e cila nuk është administruar në dosjen gjyqësore.

24. Kolegji sjell në vëmendje, se pala e paditur, nuk iu përgjigj thirrjes nga gjykata, për të marrë pjesë në seancë gjyqësore, për të sqaruar pozicionin e punës së paditëses dhe për të argumentuar konkretisht se pse kjo palë gëzon mbrojtje nga imuniteti juridiksional. Ky ishte shkaku pse Kolegji vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe ky vendim iu bë me dije palës së paditur.

25. *Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se doktrina e imunitetit të kufizuar juridiksional, e analizuar më sipër, nënkupton se juridiksioni gjyqësor i gjykatës vendase ku kryen punën punëmarrësi dhe ku ka selinë përfaqësia diplomatike përkatëse prezumohet. Përjashtimi është i kushtëzuar me rrethana të caktuara dhe pala e paditur, që pretendon se përfiton nga imuniteti juridiksional, ka barrën e provës dhe të argumentimit se pse nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor vendas.*

26. Kolegji vlerëson se, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është nxjerrë çështja jashtë juridiksionit, është i paarsyetuar. Gjykata është mjaftuar vetëm tek fakti që pala e paditur është një subjekt që gëzon imunitet sipas Konventës së Vjenës dhe se nuk rezulton sipas nenit 39 të KPC-s që pala e paditur të ketë pranuar shprehimisht në kontratë juridiksionin gjyqësor. Po ashtu, gjykata në mënyrë të gabuar i është referuar Vendimit nr. 8/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kolegji vlerëson se ky vendim nuk përmbush standardet e përmendura më lart, si dhe nuk ka marrë parasysh evolucionin e jurisprudencës së GJEDNJ-s lidhur me zbatimin e parimit të imunitetit diplomatik.

27. Po ashtu, Kolegji vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka mbajtur parasysh faktin se paditësja është shtetase shqiptare, me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, mundësia për t'i parashtruar pretendimet civile që burojnë nga zgjidhja e kontratës së punës, para gjykatave të shtetit të Kosovës vështirëson së tepërmi aksesin në gjykatë, duke e shndërruar gati në një të drejtë teorike dhe jo praktike sikurse e ka theksuar në vazhdimësi GJEDNJ në jurisprudencën e saj.

28. Sa më sipër u arsyetua, Kolegji konkludon se shqyrtimi i kësaj mosmarrëveshjeje është në juridiksionin gjyqësor shqiptar.

Vendim i Kolegjit Civil, datë 18.10.2021

Në përputhje me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara, për të drejtën e ankimit/rekursit, lejueshmërinë e tij dhe për shkaqet e parashtruara në të, do të gjejë zbatim ligji procedural i kohës kur është paraqitur ai. Ndërkohë rregullat mbi procedurën e shqyrtimit të rekurseve, mbi ritin e gjykimit, përbërjen e trupës gjykuese, apo mënyrën e disponimit mbi çështjen nga Gjykata e Lartë, përcaktohen sipas ligjit procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të tij.

Në kuadrin e ekonomizimit procesual dhe arritjen e standardit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, pavarësisht nga shkalla e gjykimit ku konstatohet pavlefshmëria, çështja do të rikthehet në gjykatën e apelit. Në rastet kur konstatohen nga Gjykata e Lartë pavlefshmëri të akteve të gjykimit në shkallë të parë, gjykata e apelit do e shqyrtojë mosmarrëveshjen me juridiksion fillestar, duke rregulluar të metat e gjykimit sipas detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Palët ndërgjyqëse, janë në një marrëdhënie të posaçme familjare me njëri-tjetrin. Paditëset janë motrat e të padituri A.G..

2. Ka rezultuar se palët ndërgjyqëse janë bashkëpronarë, ku paditësja znj. M.G. ka në pronësi 3/8 pjesë, znj. E.G. 3/8 pjesë, ndërsa i padituri A.G. 2/8 pjesë, mbi një apartament me sipërfaqe 62.4 m2, dy dhoma dhe një kuzhinë, të ndodhur në qytetin e Tiranës me kufizimet përkatëse, të ndërtuar në vitin 1969.

3. Ka rezultuar se paditëset dhe i padituri, së bashku me nënën e tyre, të ndjerën H. G. janë bërë bashkëpronarë në pjesë të barabarta secili, në kontratën e privatizimit datë 19.03.1994, të lidhur midis Ndërmarrjes Komunale Banesa nr. 04, në cilësinë e qiramarrësit të banesës shtetërore, në zbatim të Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore".

4. Në praktikën e privatizimit bashkëlidhur kontratës (*shih, faqe 14 të fashikullit të gjykimit*) thuhet se numri i frymëve sipas certifikatës së lëshuar nga zyrat e gjendjes civile më 1.12.1992 është 6, ndërsa numri i familjeve

që banojnë në apartament është 2. Po ashtu, sipas certifikatës familjare, ku pasqyrohet gjendja familjare më datë 31.12.1992, rezulton se në trung familjar, ka qenë znj. H. G. në cilësinë e kryefamiljares dhe z. A. G., znj. M. G., znj. E. G., znj. El. G. (bashkëshortja e të padituri A. G.) dhe z. Er. G., i datëlindjes 06.05.1991, (i biri i palës së paditur, z. A. G.).

5. Nga ana tjetër, ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes ne nr. 297 rep., dhe nr. 93 kol., datë 23.01.2008, e ndjera H.G.u ka shitur paditëseve (vajzave të saj), Majlinda dhe E. G., pjesën e saj në bashkëpronësi prej 1/4 të apartamentit të sipërcituar, secilës në 1/8 pjesë. Rezulton se e ndjera H. G., dhe paditëset kanë qenë në konflikt me palën e paditur, z. A. G.. Rezulton se ndaj këtij të fundit është lëshuar urdhër mbrojtjeje me vendim gjyqësor, ndaj nënës dhe motrave të tij.

6. Sa më sipër, paditëset i janë drejtuar gjykatës me padinë e pjesëtimit të sendit të identifikuar në pjesën hyrëse.

7. Gjatë gjykimit në shkallë të parë ka bërë kërkesë për ndërhyrje kryesore, bashkëshortja e të padituri A. G., znj. El. G. Në këtë kërkesë ajo ka kërkuar që paditëset ta njohin edhe atë si bashkëpronare mbi sendin objekt gjykimi në 1/5 pjesë. Ajo ka pretenduar se është bashkëpronare mbi sendin objekt gjykimi, së bashku me bashkëshortin dhe dy fëmijët e saj. Ajo ka pretenduar se kontrata e privatizimit, në pjesën që nuk e ka përfshirë atë, vjen në kundërshtim me ligjin nr. 4652/1992, pasi ajo ka qenë në përbërjen familjare dhe gjendjen e strehimit me datë 01.12.1992, në cilësinë e qiramarrëses me palët ndërgjyqëse, që prej datës së martesës së saj, konkretisht që prej 29.12.1988. Kjo kërkesë u refuzua nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk rezulton të jetë ushtruar ankim i veçantë ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6163, datë 17.07.2014, ka vendosur:

"*1. Zhdukjen e bashkëpronësisë midis paditësve M.G., E.G. dhe të padituri A. G. mbi pasurinë apartament [...], duke i takuar paditëses M. G. 3/8 pjesë ideale, paditëses E. G. 3/8 pjesë ideale dhe të padituri A. G 2/8 pjesë ideale.*".

9. Në marrjen e vendimit gjykata ka arsyetuar se sipas vërtetimit të pronësisë të lëshuar nga ZVRPP Tiranë rezulton se bashkëpronarë janë palët ndërgjyqëse, përkatësisht paditëset në 3/8 pjesë ideale, kurse pala e paditur në 2/8 pjesë ideale. Sipas kontratës së privatizimit datë 19.03.1994, palët ndërgjyqëse janë bërë bashkëpronare në ¼ pjesë, bashkë me nënën e tyre, të ndjerën H.G. Nga ana e saj, e ndjera H.G., pjesën e vet të pandarë ua ka shitur paditëseve.

10. Kundër Vendimit nr. 6163, datë 17.07.2014, të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë ka bërë ankim, pala e paditur, z. A.G.. Në ankim është parashtruar se: Vendimi i gjykatës është i pabazuar në ligj; Gjykata e shkallës së parë ka lejuar shkelje të rënda procedurale; Gjykata nuk ka realizuar hetim të plotë në lidhje me rrethin e bashkëndërgjyqësve dhe bashkëpronarëve; Në cilësinë e bashkëpronarit duhet të thirret edhe bashkëshortja, El.G.. Sikurse vërtetohet nga certifikata e gjendjes familjare të datës 31.12.1991, ajo ka qenë pjesë e familjes në momentin e privatizimit, për shkak të lidhjes së martesës në vitin 1988 dhe i takon 1/5 pjesë sipas Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992; Gjykata nuk ka hetuar mbi sipërfaqen objekt gjykimi. Apartamenti objekt privatizimi ka qenë me sipërfaqe 62.4 m2, kurse aktualisht sipërfaqja e tij është shtuar me kontribut të përbashkët;

11. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 906, datë 09.12.2015, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit civil Nr. 6163, datë 17.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë."[...]*

15. Kundër vendimit nr. 906, datë 09.12.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, me datë 07.01.2015, ka paraqitur rekurs pala e paditur, z. A. G. [...].

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

A) Në lidhje me shkaqet e rekursit

16. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), se rekursi është paraqitur brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, të parashikuar në nenin 443/2 të KPC-s. Gjithashtu, rekursi u është njoftuar palëve ndërgjyqëse. Nuk rezulton të jetë paraqitur kundër-rekurs.

17. Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala e paditur, ngre shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-s, të zbatueshëm në momentin e paraqitjes së tij.

18. Padia e pjesëtimit të sendit sipas neneve 371 e vijues të KPC-s, është një padi transformuese që i jep fund gjendjes së bashkëpronësisë dhe krijon marrëdhëdhënie të reja pronësie midis bashkëpronarëve, pas ndarjes së pjesëve.

19. Sipas nenit 371 të KPC-s, ky gjykim zhvillohet në dy faza. Në fazën e parë, gjykata ka për detyrë të hetojë dhe të verifikojë rrethin e bashkëpronarëve, sendet që i nënshtrohen pjesëtimit dhe pjesët takuese të secilit. Përcaktimi i drejtë i rrethit të bashkëpronarëve kushtëzon edhe rrethin e ndërgjyqësve, pjesëmarrës në gjykim. Së fundi, nga hetimi dhe verifikimi i drejtë i rrethit të bashkëpronarëve kushtëzohet edhe përcaktimi i drejtë dhe në përputhje me ligjin, i pjesëve respektive takuese.

20. Në çështjen konkrete, Gjykata e Apelit Tiranë, edhe pse ka pranuar në pjesën arsyetuese të vendimit se bashkëshortja e palës së paditur, znj. El.G., prezumohet se ka qënë bashkëpronare për shkak se sipas praktikës së privatizimit ka qënë qeramarrëse në banesën objekt gjykimi, më datë 31.12.1992, nuk ka pranuar pretendimin e palës së paditur mbi pjesëmarrjen e saj në këtë proces.

21. Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Apelit Tiranë, se ky pretendim ka rënë në prekluzivitet sepse nuk është ushtruar ankim i veçantë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka refuzuar kërkesën e znj. El.G. për ndërhyrje kryesore, vlerësoj se në rastin konkret, jemi para situatës së bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, e cila nuk formohet vetëm si rrjedhojë e vullnetit të palës, por buron për shkak të ligjit dhe natyrës juridike të marrëdhënies objekt gjykimi. Në gjykimin e iniciuar nga padi të tilla, pjesëmarrës duhet të jenë të gjithë bashkëpronarët, pasi vendimi në përfundim të gjykimit sjell efekte për të gjithë. Pjesëmarrja e të gjithë bashkëpronarëve është e detyrueshme në këtë lloj procesi, sipas nenit 162/2 të KPC-s.

22. Në rastin e ndërgjyqësisë së detyrueshme, palët, aktive apo pasive të procesit, janë së bashku në njërën apo tjetrën pozitë, jo si pasojë e disponimit maksimal të padisë apo parimit të disponibilitetit, por si pasojë e parashikimit të ligjit dhe natyrës juridike të mosmarrëveshjes.

Në këto raste, nëse paditësi nuk ka thirrur të gjithë bashkëndërgjyqësit e nevojshëm apo të detyrueshëm, padia është me të meta, pasi ai ka detyrimin ligjor të thërrasë si të paditur cilindo bashkëtitullar të së drejtës që ai pretendon të konfirmojë gjyqësisht.

23. Në këto kushte, disponibiliteti maksimal i padisë së paditësit kufizohet vetëm tek e drejta e tij për të bërë të vlefshëm në emrin e tij procesin, apo thënë ndryshe për të ngritur padi apo jo. Ndërkohë, rrethi i ndërgjyqësve përcaktohet jo nga vullneti i palës apo nga vendimmarrja e gjykatës, por vetëm nga ligji dhe natyra juridike e marrëdhënies.

24. Gjykata ngarkohet nga ligji që të zbatojë ligjin procedural në mënyrë që askush të mos lejohet që në emrin e tij të bëjë të vlefshme të drejtat e dikujt tjetër (*shiko, neni 195 i KPC-s*) dhe nga ana tjetër të mos lejojë që askush të gjykohet pa iu dhënë mundësia për t'u dëgjuar (*shiko, neni 33 dhe 42 të Kushtetutës*). Si rrjedhojë, në kuadër të detyrimit për të garantuar një proces të rregullt gjyqësor (neni 4 i KPC-s), në formimin e rregullt të ndërgjyqësisë së detyrueshme gjykata ka rol aktiv dhe investohet kryesisht, edhe në mungesë të kërkesës nga pala. Formimi i rregullt i ndërgjyqësisë së detyrueshme përbën një nga prezumimet procedurale absolute, si kusht për vlefshmërinë e gjykimit.

25. Këtu Kolegji sjell në vëmëndje nenin 161/c të KPC-s, ku është parashikuar se: "ç)nëse vendiminuk mundtë jepetpërveçse kundrejt shumë

personave, në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, këta të fundit duhet të thirren si të paditur në të njëjtin proces. Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të padituve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës "c", të këtij neni, dhe nenit 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

26. Ndërsa sipas nenit 467/ç të KPC-s, mosformimi i drejtë i ndërgjyqësisë së detyrueshme, referuar nenit 162/2 të KPC-s, përbën shkak për pavlefshmërinë e gjykimit në shkallë të parë.

27. Nga ana tjetër, të gjitha marrëdhëniet e tjera që formohen ndërmjet bashkëndërgjyqësve janë lloji i bashkëndërgjyqësisë fakultative, ku rrethi i personave si bashkëpaditës apo të bashkëtëpaditur varen nga e drejta dhe fakulteti që ligji i njeh paditësit për të vendosur se kujt ia kundrejton pretendimet në padi, apo thënë ndryshe, është rrjedhojë dhe përditësim i parimit të disponibilitetit maksimal të padisë. Këtu gjykata ka rol pasiv.

28. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se pavarësisht nëse ka pasur apo jo kërkesë për ndërhyrje në proces, nga znj. El.G., bashkëshortja e palës së paditur, z. A.G., në cilësinë e bashkëpronarit pretendent, gjykata duhet ta kishte konstatuar kryesisht si të metë të padisë, faktin që nuk ishin thirrur si të paditur të gjithë bashkëpronarët. Në vijueshmëri, pavarësisht mosankimimit të vendimit të ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë, për refuzimin e kërkesës për ndërhyrje kryesore nga njëri prej bashkëpronarëve pretendent, gjykata e apelit, edhe kryesisht duhet ta kishte konstatuar si të metë dhe parregullsi të akteve të gjykimit të realizuara nga gjykata e shkallës së parë, faktin që nuk ishin thirrur në gjykim të gjithë bashkëpronarët pretendentë.

29. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se nga gjykatat nuk është përcaktuar drejt rrethi i bashkëpronarëve. Duke pasur parasysh ligjin material të zbatueshëm, konkretisht Ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", gjykatat u janë referuar të drejtave të bashkëpronësisë, sikurse rezultojnë formalisht në kontratën e shitjes dhe sikurse rezultojnë të pasqyruara në dokumentet hipotekorë. Pavarësisht se kontrata e privatizimit formalisht është nënshkruar vetëm nga palët ndërgjyqëse, në praktikën e privatizimit, pjesë integrale e kontratës (fakt i pranuar nga gjykata e apelit), rezulton se në gjendjen familjare të qiramarrësve të banesës shtetërore, ndër personat madhorë, më datë 31.12.1992, ka qenë edhe znj. El.G., bashkëshortja e palës së paditur, z. A.G.. Në një çështje të ngjashme, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se: *"...ky Kolegj çmon se nga ana e Gjykatës se Apelit Vlorë ishte e domosdoshme të hetohej jo vetëm mënyra e kalimit dhe e fitimit te pronësisë mbi sipërfaqen truall prej 34.238 m2 nga pikëpamja formale (pra faktin se kush ka nënshkruar kontratën e shitblerjes), por në mënyrë të veçantë duhej të hetohej dhe analizohej e drejta dhe kuadri ligjor që lejonte këtë kalim pronësie, që përcaktonte subjektet që përfitonin nga ky lloj privatizimi, dhe në harmoni me të gjitha provat që ndodheshin në dosjen gjyqësore, të zgjidhte konfliktin në përputhje me ligjin..."* (*shih, vendimi nr.00-2010-302 i Vendimit (5), datë 12.01.2010 i Kolegjit Civil*).

30. Identifikimi i gabuar i rrethit të bashkëpronarëve, eventualisht ka sjellë si rrjedhojë edhe një identifikim të gabuar të pjesëve takuese. Kjo rrethanë kushtëzon edhe verifikimin e vlefshmërisë së pjesshme të kontratës së shitjes nga e ndjera H.G., e cila nuk mund të dispononte në favor të paditëseve, një pjesë ideale më të madhe nga sa i përkiste.

B) Mbi mënyrën se si duhet të disponojë Gjykata e Lartë

31. Fillimisht Kolegji sjell në vëmendje se pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, legjislacioni procedural civil, penal dhe administrativ, pësoi disa ndryshime thelbësore, në kuadrin e përgjithshëm të reformës në sistemin e drejtësisë. Ndryshimet ligjore synuan në ekonomizimin e procesit gjyqësor, garantimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit, eficiencën në dhënien e drejtësisë, në përputhje me standardet e përgjithshme ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

32. KPC ka pësuar ndryshime me Ligjin nr. 38/2017 dhe së fundmi, me Ligjin nr. 44/2021. Një pjesë e konsiderueshme e ndryshimeve ligjore kanë përfshirë edhe dispozitat që rregullojnë gjykimin në Gjykatën e Lartë. Krahas qëllimit të përgjithshëm për një sistem drejtësie eficient, ato synuan përshtatjen e procedurës së gjykimit me rolin thelbësor kushtetues të reformuar të Gjykatës së Lartë, sikurse është roli nomofilatik mbi zhvillimin, njësimin apo unifikimin e praktikës gjyqësore. Në përputhje me të, janë rikonceptuar, shkaqet për të cilat palët ndërgjyqëse mund t'i adresohen nëpërmjet rekursit, gjykimi i çështjeve si rregull në dhomë këshillimi (*de plano*) dhe po ashtu edhe kompetencat vendimmarrëse të Gjykatës së Lartë në çështjet konkrete.

33. Kolegji sjell në vëmendje nenin 485 të KPC-s, i cili përbën një listë shteruese të vendimmarrjes të Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, në çështjet civile, sikurse është në mënyrë analoge neni 63 i Ligjit nr. 49/2012 për çështjet administrative dhe neni 441 i KPP, për çështjet penale. Konkretisht, Kolegji do të marrë në analizë rastet e parashikuara në shkronjën "c" dhe "ç" të kësaj dispozite, ku është parashikuar se: "*Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil ose*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin: "...c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;ç) prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit...".

34. Kolegji vlerëson të bëjë një interpretim historik dhe sistematik të kësaj dispozite me dispozitat e tjera të KPC-s, për të konkluduar mbi qëllimin e Ligjvënësit në riformulimin e saj me Ligjin nr. 44/2021.

35. Para ndryshimeve me Ligjin nr. 38/2017, neni 485 i KPC-s, rregullonte mënyrën e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, në çështjet civile, shqyrtimi i të cilave kishte kaluar në seancë gjyqësore. Kjo dispozitë, ndër të tjera, parashikonte edhe të drejtën dhe kompetencën e Gjykatës së Lartë për prishjen e vendimeve dhe rikthimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, sa herë që nga gjykatat më të ulëta ishin lejuar shkelje të tilla procedurale të cilat e bënin të pavlefshëm gjykimin në shkallë të parë, referuar rasteve të parashikuar në nenin 467 të KPC-s.

36. Me ndryshimet që pësoi KPC, në vitin 2001, për herë të parë u prezantua kufizimi i gjykatës së apelit për ta rikthyer vazhdimisht çështjen në gjykatën e shkallës së parë, pavarësisht shkeljeve dhe pavlefshmërisë së akteve të gjykimit sipas nenit 467 të KPC-s. Kështu, u shtua neni 467/a ku u parashikua se: "*Gjykata e apelit, kur prish vendimin, nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë.*".

37. Kjo dispozitë kishte si synim ekonomizimin e procesit gjyqësor dhe projektoi gjykimin dyshkallësh, pasi shqyrtimi i mosmarrëveshjes në themelin e saj ishte realizuar dy herë në gjykimin në shkallë të parë, duke eliminuar një shkallë gjykimi. Por legjislatori në këtë rast, nuk vlerësoi të parashikonte një përjashtim nga ky rregull, konkretisht rastin kur vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë nuk ka qenë përfundimtare dhe nuk është zgjidhur në themel mosmarrëveshja. Në këtë rast nuk ka pasur asnjë gjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe se, për rrjedhojë, çështja duhet të kthehet në këtë gjykatë për rigjykim, për të respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj (neni 42 i Kushtetutës) dhe parimin e shkallësisë së gjykimit në Republikën e Shqipërisë (neni 135 i Kushtetutës).

38. Një rregullim analog mungonte në rastet kur çështja shqyrtohej në Gjykatën e Lartë, pasi gjykimi i mosmarrëveshjes në themelin e saj kishte kaluar dy shkallë gjykimi, pavarësisht situatave të njëjta, pra kur çështja ishte shqyrtuar dy herë, por tashmë në linjë vertikale. Në këtë rast,

ndryshe nga rregullimi i mësipërm, ndërsa gjykata e apelit ishte e kufizuar ta kthente çështjen në gjykatën e shkallës së parë për të dytën e herë, për Gjykatën e Lartë nuk vepronte ky kufizim. Sërish neni 485 i KPC-s në atë kohë parashikonte mundësinë e Gjykatës së Lartë ta kthente çështjen në gjykatën e shkallës së parë, sa herë që konstatoheshin pavlefshmëri të akteve në këtë shkallë të gjykimit, të cilat nuk ishin konstatuar nga gjykata e apelit.

39. Ndryshimet ligjore të vitit 2017 sollën një risi në mënyrën e disponimit në Gjykatën e Lartë, në rastet kur ajo konstatonte gabime në procedim (*errores in procedendo*), që shtriheshin si në vendimin e gjykatës së apelit ashtu edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, referuar nenit 467 të KPC-s. Me ndryshimet e nenit 485, Gjykata e Lartë nuk e kishte më tagrin të vendoste prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, por iu la kompetenca të shfuqizonte vetëm vendimin e gjykatës së apelit dhe ta dërgonte çështjen për rigjykim pranë kësaj gjykate, pavarësisht se në cilën shkallë gjykimi konstatoheshin shkeljet dhe pavlefshmëritë e akteve. I njëjti ndryshim ligjor u bë edhe në nenin 63 të Ligjit nr. 49/2012, për sa u përkiste kompetencave të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në çështjet administrative.

40. Në lidhje me këto rregullime ligjore ka pasur disa interpretime nga praktikantët e së drejtës dhe nga Gjykata e Lartë.

41. Sipas një qëndrimi, në bazë të parimeve të përgjithshme të procesit të rregullt ligjor, të gjykatës së caktuar me ligj, respektimit të shkallëve të gjykimit sipas nenit 135 të Kushtetutës dhe pamundësisë për të konvaliduar qoftë edhe me ligj, pavlefshmërinë e akteve procedurale në një shkallë gjykimi, ometimi i Ligjvënësit në nenin 485 të KPC-s, duhet të interpretohej në mënyrë pajtuese.

Kjo duke pasur parasysh se kishte mbetur i pandryshuar neni 493 i KPC-s, i cili parashikonte se: "*Gjykata e shkallës së parë apo gjykata e apelit, kur dërgohet çështja për rigjykim, zbaton të njëjtat rregulla procedurale*.". Sipas këtij qëndrimi Gjykata e Lartë, pavarësisht ometimit të nenit 485 të KPC-s, kishte të drejtën ta kthente çështjen në atë gjykatë ku konstatohej pavlefshmëria e akteve në mënyrë të pakonvalidueshme.

42. Sipas një qëndrimi të dytë, neni 485 i KPC-s duhet të interpretohej se rregullonte në mënyrë analoge situatën e parashikuar në nenin 467/a të KPC-s, ku gjykata e apelit nuk ka të drejtë ta kthejë çështjen për herë të dytë, por duhet ta gjykojë me juridiksion fillestar. Sipas këtij interpretimi ometimi i Ligjvënësit nuk ishte antikushtetues dhe nuk ishte i paqëllimshëm, përsa kohë gjykata ishte caktuar me ligj dhe ofrohen garancitë për proces të rregullt. Për më tepër që ligji në këtë rast ka pasur

për bazë ekonomizimin e procesit gjyqësor dhe përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ligjvënësi, i nxitur nga arsye të tilla të përligjura, mund ta kufizojë shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në dy shkallë gjykimi (p.sh.: neni 467/a i KPC-s; kompetenca funksionale e Gjykatës Administrative të Apelit për shqyrtimin me juridiksion fillestar të aktit normativ; kompetenca funksionale e gjykatave të apelit për të shqyrtuar me juridiksion fillestar paditë ndaj vendimeve të Agjencisë së Trajtimit të Pronës sipas Ligjit nr. 133/2015, etj.,.).

43. Sipas një interpretimi tjetër gjyqësor të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit kishte vetëm mundësinë ta kthente çështjen në gjykatën e apelit, duke i lënë si detyrë kësaj të fundit të konstatonte pavlefshmërinë e akteve të gjykimit në shkallë të parë dhe ta dërgonte çështjen për rigjykim në shkallë të parë (*shih, vendim nr.00-2017-2704 (823), datë 31.10.2017 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendim nr. 163, datë 07.12.2017 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, etj.,.*).

44. Duke qenë se neni 485 i KPC-s shkaktonte interpretime të ndryshme, ai u riformulua me Ligjin nr. 44/2021. Në mënyrë të qartë në këtë dispozitë u parashikua se, pavarësisht se në cilën shkallë gjykimi konstatohet pavlefshmëria, çështja do të rikthehet në gjykatën e apelit. Në rastet kur konstatohen nga Gjykata e Lartë pavlefshmëri të akteve të gjykimit në shkallë të parë, gjykata e apelit do e shqyrtojë mosmarrëveshjen me juridiksion fillestar, duke rregulluar të metat e gjykimit sipas detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë (neni 485/c). Kolegji vlerëson se ky rregullim ligjor dhe moskthimi i çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë nga ana e Gjykatës së Lartë është një risi pozitive në kuadrin e ekonomizimit procesual dhe arritjen e standardit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke marrë si shembull modelin e nenit 467/a të KPC-s.

45. Neni 485 ishte risi edhe në raport me nenin 467/a, pasi saktësoi mangësinë e kësaj dispozite, duke e parashikuar në mënyrë eksplicite se Gjykata e Lartë mund ta kthejë çështjen në gjykatën e shkallës së parë, vetëm kur ka pasur një vendimmarrje jopërfundimtare nga gjykataeshkallës së parë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit (neni 485/ç).

46. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se nga gjykata e shkallës së parë janë lejuar shkelje procedurale sipas nenit 467/d të KPC-s, në lidhje me formimin e rregullt të ndërgjyqësisë së detyrueshme. Gjykata e Apelit nuk e ka konstatuar këtë parregullsi por ka vijuar me shqyrtimin në themel të çështjeve që zgjidhen në fazën e parë të pjesëtimit të sendit.

47. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, referuar nenit 485/c të KPC-s, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të prishet

dhe çështja duhet të kthehet pranë kësaj gjykate, e cila duhet të gjykojë si shkallë e parë.

48. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë ka detyrimin të garantojë thirrjen në gjykim të znj. El.G., në kushtet e parashikuara në nenet 161 dhe 162 të KPC-s si dhe të realizojë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm në lidhje me rrethin e bashkëpronarëve, pjesëve takuese dhe sendeve që do i nënshtrohen pjesëtimit. Garantimi i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm do të duhet të bazohet jo vetëm referuar formalisht kontratës së privatizimit, por edhe shkresave bashkëlidhur saj dhe akteve ku pasqyrohet gjendja familjare e qiramarrësve të banesës objekt gjykimi, mëdatë 31.12.1992, sipas Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992.

49. Së fundi, Kolegji çmon të theksojë se, pavarësisht se rekursi është paraqitur para ndryshimeve të KPC-s me Ligjin nr. 44/2021, në dispozitën tranzitore të Ligjit nr. 44/2021, është parashikuar se: "*1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.*".

50. Referuar dispozitës tranzitore, *në përputhje me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara, për të drejtën e ankimit/rekursit, lejueshmërinë e tij dhe për shkaqet e parashtruara në të, do të gjejë zbatim ligji procedural i kohës kur është paraqitur ai. Ndërkohë rregullat mbi procedurën e shqyrtimit të rekurseve, mbi ritin e gjykimit, përbërjen e trupës gjykuese, apo mënyrën e disponimit mbi çështjen nga Gjykata e Lartë, përcaktohen sipas ligjit procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të tij.*

Vendim i Kolegjit Civil, datë 18.10.2021

Mungesa e legjitimitetit për ushtrimin e ankimit është shkak papranueshmërie dhe për rrjedhojë edhe paprocedueshmërie për procesin gjyqësor rishikues. Ankimet janë mjete juridike aksesi për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave subjektive dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm në gjykatat me juridiksion rishikues që do të thotë se subjekti do të duhet të bëjë të vlefshme në apel apo në rekurs një të drejtë subjektive civile apo një interes personal të mbrojtur nga ligji. Përndryshe, sipas shkronjës "ç" të nenit 450 të KPC, apeli apo rekursi nuk mund të pranohet në gjykim si i ushtruar nga një subjekt që nuk ka legjitimitet.

I. Rrethanat e çështjes

1. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është paraqitur një padi me objekt njohje pronari.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1257, datë 24.04.2012 ka vendosur: "*1. Pranimin pjesërisht të padisë; 2. Detyrimin e të padituve të njohin pronar paditësin A.Sh. mbi sipërfaqen prej 258 m2 të regjistruar në emër të Gj.M. në regjistrin hipotekor me nr. 106 datë 25.11.2004 (sipas aktit të ekspertimit);3. Detyrimin e të padituve të njohin pronar paditësin A.Sh. mbi sipërfaqen prej 519 m2 të regjistruar në emër të D.Sh. në regjistrin hipotekor me nr. 106, datë 25.11.2004 (sipas aktit të ekspertimit); 4. Detyrimin e ZVRPP Vlorë të pajisë paditësin A.Sh. me certifikatë pronësie përsa i përket pasurisë të njohur në këtë vendim; 5. Pushimin e gjykimit për sipërfaqen prej 46 m2 regjistruar në emër të Gj.M. (sipas plotësimit të aktit ekspertimit); 6. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë;7. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur*.".

3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, më datë 06.06.2012, pala e paditur Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë. Ka rezultuar se ish-ZVRPP, Vlorë ka qenë në mungesë në momentin e shpalljes së vendimit dhe ky i fundit i është komunikuar më datë 22.05.2012. Në ankim, pala e paditur, ZVRPP Vlorë ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar këto shkaqe:

Vendimi është i pambështetur në prova dhe në ligj. Për pasurinë objekt gjykimi ka një procedim penal në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dokumentacioni origjinal i regjistrimit të kësaj pasurie është sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit; Pas regjistrimit fillestar sistematik të ZK, kjo pasuri rezulton e regjistruar në vol. 5, faqe 231, me nr. pasurie 2/280, me sipërfaqe trualli 985 m2, e cila me kontratë shkëmbimi i ka kaluar në bashkëpronësi firmës "B" dhe firmës "J".

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1301, datë 10.07.2014, ka vendosur:"*Mospranimin e ankimit.*".

5. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se ankimi i paraqitur nga pala e paditur ZVRPP Vlorë, është jashtë afatit ligjor. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala e paditur ZRPP Vlorë, ka qenë në mungesë në shpalljen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kopja e vendimit nr. 1257, datë 24.02.2012 i është komunikuar palës më datë 22.05.2012. Rezulton gjithashtu se ankimi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë është paraqitur më datë 06.06.2012, pra jo në afatin e caktuar brenda 15 ditëve nga data e komunikimit të vendimit.

6. Rezulton se pala e paditur, ish-ZVRPP Vlorë ka qenë në mungesë gjatë gjykimit në apel dhe se ky vendim i është komunikuar më datë 11.08.2014.

7. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, më datë 15.08.2014 është ushtruar rekurs nga pala e paditur, ish-ZVRPP Vlorë, në Gjykatën e Lartë. Në rekurs është parashtruar se: *[...] Për pasurinë objekt gjykimi ka një procedim penal në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dokumentacioni origjinal i regjistrimit të kësaj pasurie është sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit; Pas regjistrimit fillestar sistematik të ZK, kjo pasuri rezulton e regjistruar në vol. 5, faqe 231, me nr. pasurie 2/280, me sipërfaqe trualli 985 m2, e cila me kontratë shkëmbimi i ka kaluar në bashkëpronësi firmës "B" dhe firmës "J"*.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji), fillimisht konstatoi se në gjykim është thirrur në cilësinë e palës së paditur Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.

9. Në zbatim të nenit 199 të KPC, dhe ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", Kolegji realizoi kalimin procedural të palës së paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë me Agjencinë Shtetërore, Zyra Rajonale e Kadastrës, Vlorë (në vijim ASHK). Në këtë mënyrë, u realizua njoftimi me shpallje pranë Gjykatës së Lartë, më datë 01.10.2021,

për subjektin e ri të thirrur në proces si më sipër, për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi më datë 18.10.2021.

10. Rezulton se rekursi i ASHK është paraqitur brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 443 iKPC-s. Po ashtu, rezulton se palët janë njoftuar për rekursin dhe nuk është paraqitur kundërrekurs.

11. Kolegji vlerëson se shkaqet e rekursit janë jorelevante për vendimin e kundërshtuar. Objekt rekursi dhe kontrolli nga Gjykata e Lartë është vendimi jopërfundimtar i Gjykatës së Apelit Vlorë, mbi mospranimin e ankimit, ndërkohë pretendimet e palës së paditur në rekurs lidhen vetëm me thelbin e mosmarrëveshjes. Megjithatë, Kolegji vlerëson se procedueshmëria e ankimit dhe kushtet formal-procedurale vlerësohen edhe kryesisht nga gjykata, në çdo fazë dhe shkallë gjykimi (neni 450/3 i KPC). Si rrjedhojë, Gjykata e Lartë mund të vlerësojë edhe kryesisht me juridiksion rishikues ligjshmërinë e vendimit të mospranimit të ankimit nga Gjykata e Apelit.

10. Kolegji vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Gjykatës së Apelit Vlorë mbi mospranimin e ankimit, por me tjetër argument ligjor.

11. Në rastin konkret, gjykata e apelit ka vlerësuar se ankimi i palës së paditur është paraqitur jashtë afatit 15 ditor të parashikuar nga neni 444 të KPC, duke e llogaritur ditën e komunikimit të vendimit si moment *a quo* nga nis afati i ankimit. Në këtë rast, nuk është mbajtur në konsideratë Vendimi Unifikues nr. 2, datë 23.03.2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ku është konkluduar se: "*Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njërës palë, afati i ankimimit (apel, rekurs), për këtë palë fillon të llogaritet përkatësisht nga e nesërmja e komunikimit të vendimit, sipas rregullave të përcaktuara në dispozitat e neneve 316 dhe 148 të KPC*".

12. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë i është komunikuar palës së paditur, ASHK (të gjykuar në mungesë), më datë 22.05.2012. Ankimi është paraqitur më datë 06.06.2012. Duke llogaritur nisjen e afatit nga e nesërmja e komunikimit, ankimi është brenda afatit 15 ditor të parashikuar në nenin 443 të KPC-s.

13. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Vlorë duhet të kishte vendosur mospranimin e ankimit të ASHK për mungesë legjitimiteti substancial, sipas nenit 450/ç të KPC

14. Padia në rastin konkret ka për objekt njohjen pronar. Në këtë lloj padie, legjitimiteti aktiv dhe pasiv u përket subjekteve që pretendojnë qenien pronar mbi sendin në konflikt. Pavarësisht se në rastin konkret, është thirrur formalisht si palë e paditur, ASHK nuk ka kapacitetin ligjor të nevojshëm për të gëzuar cilësinë e legjitimitetit pasiv në këtë proces gjyqësor, pasi nuk mbron asnjë interes të vetin dhe as nuk mund t'i kundrejtohet ndonjë detyrim. ASHK është institucion publik që ka detyrimin ligjor dhe kushtetues të zbatojë dhe të regjistrojë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Ky detyrim buron nga ligji, edhe në kushtet kur nuk ka një urdhërim të tillë në vendimin gjyqësor.

15. Në mbështetje të këtij arsyetimi, Kolegji sjell në vëmendje për analogji Vendimin 1121/2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera është argumentuar se: "*Në këtë këndvështrim thirrja e ZRPP në cilësinë e personit të tretë dhe vendosja e detyrimit për të është e gabuar. Për më tepër, ZRPP nuk merr cilësinë procedurale të personit të tretë në kuptim të neneve 189-193 të KPC. Kjo zyrë është institucion administrativ dhe ekzekutimi dhe në gjykime të këtij lloji, ajo as nuk ka interesa të vetat për të mbrojtur, as nuk mund të bashkohet me njërën prej palëve. Për rrjedhojë, praktika e thirrjes së ZRPP në gjykime të këtij lloji është e gabuar...*".

16. Në ankimin drejtuar gjykatës së apelit, ASHK ka ngritur pretendime që lidhen me mbrojtjen e të drejtave subjektive të palëve të tjera në proces mbi të drejtën e pronës. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se ASHK nuk ka legjitimitet aktiv për ushtrimin e apelit, sipas paragrafit të dytë të nenit 90, nenit 95 dhe nenit 442/a. Për rrjedhojë, apeli objekt gjykimi nuk duhet të pranohej për këtë shkak. Jo çdo palë në gjykim mundet të ushtrojë ankim ndaj çdo vendimi gjyqësor (i ndërmjetëm, jopërfundimtar apo përfundimtar qoftë), por një të drejtë të tillë dhe akt të tillë procedural në mënyrë të vlefshme mund ta përdorë vetëm ndërgjyqësi drejtpërdrejt i legjitimuar. Kjo përbën konceptin e legjitimitetit për të ankimuar. Edhe pse ligji nuk e ngushton në këtë mënyrë çështjen e legjitimitetit aktiv në ankim, kjo rezulton nga norma të tilla si ato që rregullojnë institutin procedural të pavlefshmërisë së akteve, që frymëzohen vetëm nga parimi i disponibilitetit maksimal (*neni 2 i KPC)* dhe ekskluziv (*shih, neni 95 i KPC-s*), të së drejtave materiale dhe procedurale të palëve.

17. Sipas nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 442/a dhe 442/b të KPC, *ankimet janë mjete juridike aksesi për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave subjektive dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm në gjykatat me juridiksion rishikues. Kjo do të thotë se subjekti apelues apo rekursues do të duhet të bëjë të vlefshme në apel apo në rekurs një të drejtë subjektive civile apo një interes personal të mbrojtur nga ligji. Përndryshe, sipas shkronjës "ç" të nenit 450 të KPC, apeli apo rekursi nuk mund të pranohet në gjykim si i ushtruar nga një subjekt që nuk ka legjitimitet. Kjo do të thotë se mungesa e legjitimitetit për ushtrimin e ankimit është shkak*

papranueshmërie dhe për rrjedhojë, edhe paprocedueshmërie për procesin gjyqësor rishikues.

18. Në rastin konkret, ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë është ushtruar nga ana e ASHK. Ky institucion, në zbatimin e vendimit gjyqësor objekt apeli, kryen një funksion publik sikurse ligji e ngarkon, konkretisht sipas nenever 193 dhe 196 të KC. Për rrjedhojë, institucioni i kadastrës nuk mund të legjitimohet aktivisht të ushtrojë mjetet procedurale juridike të ankimit që ligji i ka krijuar ekskluzivisht për palët në këtë fazë të procesit civil, në bazë dhe për zbatim të nenit 95 dhe 442/a të KPC, pasi gjykimi nuk është zhvilluar as në emër dhe as kundër palës apeluese.

19. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë duhet të lihet në fuqi me arsyetim tjetër.

VENDIME TË KOLEGJIT PENAL

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-145, datë 15.05.2020

Në kushtet kur vetë ligji procedural penal nuk lejon ankim ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake që e dërgon çështjen në gjyq edhe nëse gjyqtari i seancës gjyqësore konstaton parregullsi lidhur me njoftimin e të pandehurit në seancë paraprake, ligji procedural penal i ka dhënë hapësirë gjykatës që gjatë shqyrtimit të çështjes në themel t'i korrigjojë ato, duke kryer njoftimet e të pandehurit sipas rregullave të parashikuara në nenet 140-142, 352 të KPP, pa cenuar vendimin gjyqësor të dhënë nga gjyqtari i seancës paraprake, gjyqtar i po të njëjtës shkallë gjykimi.

I. Rrethanat e çështjes

1. Në datën 13.10.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka paraqitur kërkesën për gjykim në ngarkim të të pandehurve Sh.Xh., në cilësinë e administratorit të personit juridik të shoqërisë (...) SHPK dhe Shoqërisë (...) SHPK, të akuzuar për veprën penale "Mospagimi i taksave dhe tatimeve", të parashikuar nga neni 181 i KP.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (gjyqtare e seancës paraprake E.K.), me vendimin nr. 923, datë 21.12.2018, ka vendosur: Pranimin e kërkesës së prokurorit. Dërgimin e çështjes për gjykim në ngarkim të të pandehurve Sh.Xh. dhe Shoqërisë (...) SHPK, të akuzuar për veprën penale "Mospagimi i taksave dhe tatimeve" të parashikuar nga neni 181 i KP. Dosja gjyqësore pas depozitimit në sekretari, do t'i nënshtrohet shortimit elektronik për gjykimin e themelit. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (gjyqtar P.Ç.), me vendimin nr. (671) 23, datë 07.02.2019, ka vendosur: Pavlefshmërinë e vendimit nr. 923, datë 21.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të seancës paraprake, duke urdhëruar përsëritjen e kësaj seance *me këtë arsyetim: "... seanca paraprake e çështjes është zhvilluar në mungesë të të pandehurve; Konkretisht, në fletëthirrjen për datën 31.10.2018, ka rezultuar e pasaktë adresa e të pandehurit Sh.Xh.; Sipas shkresës së Komisariatit të Policisë Durrës, nga verifikimi lidhur me këtë të pandehur ka rezultuar se është larguar jashtë shtetit. Pas kësaj, gjykata ka vendosur njoftimin me shpallje dhe gjykata ka caktuar avokatë kryesisht për përfaqësimin e tyre. Sipas nenit 332/e, pika "2"*

të KPP, "Elementët e vendimit", parashikohet se : "Vendimi është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk identifikohet me saktësi, ose kur mungojnë ose janë të pamjaftueshme kërkesat e parashikuara në shkronjën "c", pika 1, të këtij neni.". Nisur nga kjo dispozitë vendimi i seancës paraprake është i pavlefshëm pasi janë shkelur dispozitat procedurale penale, sipas të cilave procesi nuk mund të zhvillohet në mungesë të të pandehurit, pa e njoftuar më parë atë. Sipas nenit 332/b, pika "4","Verifikimi i paraqitjes së palëve", parashikohet se: "Kur i pandehuri, në gjendje të lirë apo i paraburgosur, nuk është paraqitur pa shkaqe të arsyeshme, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, gjykata deklaron me vendim mungesën e tij. Në këto raste i pandehuri quhet i pranishëm, me kusht që të përfaqësohet nga mbrojtësi. Quhet i pranishëm edhe i pandehuri që, pasi është paraqitur, largohet nga seanca ose i pandehuri i pranishëm në një seancë, por që nuk paraqitet në seancat vijuese.". Në këto rrethana, çështja duhet t'i kthehet përsëri gjykatës së seancës paraprake për të bërë ndreqjet e nevojshme të njoftimit të të pandehurit, në respektim të procedurës së njoftimit sipas dispozitave përkatëse.".

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (gjyqtar P.Ç.), me vendimin nr. akti 342, datë 22.02.2019, ka vendosur: Ngritjen e çështjes së mosmarrëveshjes se kompetencës lëndore/funksionale për gjykimin e çështjes penale që ka lidhje me procedimin penal nr. 801, viti 2018, në ngarkim të të pandehurve Sh.Xh. dhe Shoqërisë (...) SHPK, të akuzuar për veprën penale "*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*", të parashikuar nga neni 181 i KP. Dërgimin e kopjes së akteve Gjykatës së Lartë. Një kopje e vendimit i dërgohet për njoftim gjyqtarit P.Ç., pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me këtë arsyetim:*...Në seancën dt. 22.02.2019, prokurori ka deklaruar se nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 23, datë 07.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në Gjykatën e Apelit Durrës, pasi kjo e drejtë i është mohuar... Gjykata, pasi u konsultua me vendimet nr. 923 dhe nr. 23 të gjykatës, si dhe me dispozitat procedurale që rregullojnë seancën paraprake, çmon se duhet të investohet Gjykata e Lartë për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje funksionale, pasi gjyqtari i seancës paraprake nuk ka kompetencën funksionale/lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkese pasi është shprehur një herë me vendimin nr. 923 datë 21.12.2018, për arsyet si vijon:*

Së pari: Çështja ka kaluar në themel dhe është ajo trupë gjykuese që duhej të vazhdonte gjykimin ose ta pezullonte atë, sipas parashikimeve të nenit 352 të KPP. Ky kod nuk parashikon se çështja mund të pezullohet në seancë paraprake, por, parashikon se gjyqtari i seancës paraprake vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj. Pezullimin e gjykimit deri në 1 vit, ligjvënësi e ka vendosur në gjykimin e themelit të çështjes (neni 352) dhe jo në seancë paraprake. Së dyti: Në asnjë dispozitë të KPP nuk është përcaktuar që gjykata e themelit, në të njëjtën gjykatë, të ketë kompetencën që të bëjë të pavlefshëm një vendim të seancës paraprake, të urdhërojë përsëritjen e tij me tjetër trup gjykues, apo për të vajtur më tutje, që kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim. Rastet e vendimmarrjes për gjyqtarin e seancës paraprake janë parashikuar në nenin 332/dh të KPP, ndërsa në nenin 332/e të këtij kodi janë përcaktuar se cilat janë elementet e vendimit për dërgimin në gjyq, duke përcaktuar se ky vendim do të jetë i pavlefshëm kur i pandehuri nuk identifikohet me saktësi, ose kur mungon ose është i pamjaftueshëm parashtrimi i faktit penal, rrethanat e tij apo nuk janë treguar dispozitat përkatëse të ligjit. Në asnjë rast tjetër nuk përmendet pavlefshmëri, por edhe në këtë rast nuk përcaktohet se gjykata e themelit ka kompetencë për të bërë të pavlefshëm atë. Kthimin e akteve në seancë paraprake me tjetër trup gjykues, ligjvënësi ia ka dhënë një gjykate më të lartë dhe jo të njëjtës gjykatë. (Vendimi nr. 11, datë 02.4.2008, i Gjykatës Kushtetuese.). Së treti: Ligjvënësi, ka parashikuar se ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake nuk lejohet ankim. Duke qenë kështu, ky vendim do të konsiderohet i formës së prerë dhe ai mund të rishikohet vetëm sipas rasteve të parashikuara nga ligji, por kurrsesi nuk mund të bëhet "nul" nga e njëjta gjykatë, por tashmë me pozicionin e gjykatës së themelit.".

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, paraprakisht konstaton se në praktikën e tij, ky Kolegj ka pranuar ekzistencën e konfliktit për kompetencë edhe ndërmjet gjyqtarëve të së njëjtës gjykatë, si në rastin objekt gjykimi, kur në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim një çështje të caktuar, duke kërkuar nga Gjykata e Lartë të zgjidhë mosmarrëveshjen e kompetencës mes tyre. Në çështjen në shqyrtim, ka mosmarrëveshje për kompetencën funksionale/lëndore të shqyrtimit të çështjes penale ndërmjet gjyqtarit të seancës paraprake të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe gjyqtarit të seancës gjyqësore në të njëjtën gjykatë.

6. KPP në Kreun II, seksionin V, titulluar "*Mosmarrëveshjet për kompetencat*", nenet 89, 90, 91, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë.

7. Referuar ndryshimeve të KPP me ligjin nr. 35/2017, rezulton se, në Kreun IX është shtuar "Seanca paraprake" si procedurë gjyqësore në procesin gjyqësor penal, rregullat e zhvillimit të së cilës parashikohen në nenet 332- 332/gj, ndërsa "Gjykimi" i çështjes penale parashikohet në Kreun I, nenet 333 e vijues të këtij kodi.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, lidhur me çështjen në shqyrtim

konstaton se: *Parashtrimi nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake i mosmarrëveshjes për kompetencën funksionale/lëndore të gjykimit të çështjes është i drejtë. Kërkesa objekt gjykimi e prokurorit lidhur me çështjen në ngarkim të të pandehurve Sh.Xh., në cilësinë e administratorit të personit juridik të shoqërisë (...) SHPK dhe Shoqërisë (...) SHPK, është shqyrtuar nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake dhe në zbatim të nenit 332/dh, pika 1, të KPP, me vendimin nr. 923, datë 21.12.2018, është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq.*

9. Sipas nenit 332/gj, pika 1 të KPP, kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, për dërgimin e çështjes në gjyq, nuk lejohet ankim. Në interpretim të kësaj dispozite, vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për kalimin e çështjes në gjykim është vendim i formës së prerë dhe si i tillë nuk mund të cenohet nga gjyqtari i seancës gjyqësore, i cili është gjyqtar i të njëjtës gjykatë.

10. Në çështjen në shqyrtim, gjyqtari i seancës gjyqësore pasi ka arsyetuar se ai ka konstatuar pavlefshmërinë e vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, ka urdhëruar dërgimin e kësaj çështjeje pranë të njëjtit gjyqtar për korrigjimin e shkeljeve procedurale lidhur me njoftimin e të pandehurit në gjendje të lirë, duke urdhëruar përsëritjen e kësaj seance.

11. Lidhur me këtë vendim, Kolegji Penal vlerëson se është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal. *Në kushtet kur vetë ligji procedural penal nuk lejon ankim ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake që e dërgon çështjen në gjyq edhe nëse gjyqtari i seancës gjyqësore konstaton parregullsi lidhur me njoftimin e të pandehurit në seancë paraprake, ligji procedural penal i ka dhënë hapësirë gjykatës që gjatë shqyrtimit të çështjes në themel t'i korrigjojë ato, duke kryer njoftimet e të pandehurit sipas rregullave të parashikuara në nenet 140-142, 352 të KPP, pa cenuar vendimin gjyqësor të dhënë nga gjyqtari i seancës paraprake, gjyqtar i po të njëjtës shkallë gjykimi.*

Edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 11, datë 02.04.2008, ka theksuar se:*"...pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë."*.

12. Për sa më lart, arsyetohet se, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se kompetenca funksionale/lëndore e shqyrtimit të kësaj çështjeje i përket gjykatës së themelit (gjyqtarit të seancës gjyqësore) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-144, datë 29.05.2020

Gjyqtari i seancës paraprake nuk ka asnjë pengesë për të shqyrtuar më shumë se një herë kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës/çështjes edhe kur ka vendosur më parë kthimin e akteve prokurorisë apo edhe kur gjykata e apelit ka prishur vendimin e tij dhe ka kthyer aktet prokurorisë.

I. Rrethanat e çështjes.

1. Me kërkesën e paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, prokuroria pranë kësaj gjykate ka kërkuar pushimin e çështjes penale nr. 1383, viti 2016, për veprën penale "*Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave te zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257/a/2 i KP.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtar i hetimeve paraprake A.B.), me vendimin nr. 1430, datë 04.04.2018, ka vendosur: Pushimin e çështjes penale nr. 1383, viti 2016, për veprën penale "*Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257/a/2 i KP. (*Mbi ankimin e palës kallëzuese, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)).*

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1585, datë 11.6.2018, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. 1430, datë 04.04.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në këtë mënyrë: Kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket procedimit penal nr. 1383, viti 2016, dhe vazhdimin e hetimeve rreth këtij procedimi. Kryerja e hetimeve të përfundojë brenda afatit dy mujor.

4. Pasi janë kryer veprimet hetimore përkatëse të urdhëruara me vendimin nr. 1585, datë 11.06.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, mbi kërkesën e prokurorit është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesa për pushimin e procedimit penal nr. 1383, viti 2016.

Çështja i është caktuar për gjykim gjyqtarit L.S., i cili ushtron funksionin në shqyrtimin e çështjeve penale (të themelit) në seancë gjyqësore.

5. Në seancën gjyqësore datë 24.04.2019, prokurori i çështjes ka kërkuar që çështja t'i dërgohet për gjykim gjyqtares së seancës paraprake të kësaj çështjeje, gjyqtares A.B., e cila ka gjykuar kërkesën për pushimin e të njëjtës çështje.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtar L.S.), me vendimin nr. regj. 5721/427, datë 24.4.2019, ka vendosur: Konstatimin e moskompetencës së këtij trupi gjykues për gjykimin e kësaj kërkese penale me objekt "Pushimin e procedimit penal nr. 1383, viti 2016, dhe dërgimin për gjykim gjyqtares A.B., e cila është gjyqtare e seancës paraprake të kësaj çështjeje, pasi ka shqyrtuar më përpara këtë kërkesë dhe është shprehur me vendimin nr. regj. them 1430, datë 04.04.2018.

Urdhërohet sekretaria gjyqësore për dërgimin e akteve gjyqtares A.B. me arsyetimin se *"...kërkesa e prokurorit për dërgimin e akteve gjyqtares A.B. është e drejtë dhe e bazuar në ligj, pasi është ajo gjyqtare, e cila ka gjykuar kërkesën për pushimin e të njëjtës çështjeje dhe ka dhënë vendimin më datë 04.04.2018... Në këto rrethana, aktet duhet t'i kalojnë gjyqtares A.B. për gjykim, si gjyqtare e seancës paraprake të kësaj çështjeje, e caktuar më përpara në bazë të shortit elektronik dhe e cila gëzon këtë status deri në kalimin e çështjes për gjykim ose përfundimin e saj në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji."*.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtar i hetimeve paraprake A.B.), me vendimin nr. 2529 regj. them., datë 07.05.2019, ka vendosur: 1. Ngritjen e çështjes së mosmarrëveshjes së kompetencës për gjykimin e çështjes penale nr. regj. 5721/427, datë regjistrimi 17.12.2018, para Gjykatës së Lartë, me objekt: Pushimin e çështjes penale nr. 1383, viti 2016, për veprën penale "Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", parashikuar nga neni 257/a/2 i KP. 2. Dërgimin e kopjes së akteve Gjykatës së Lartë.

3. Ky vendim iu komunikua palëve, *me këtë arsyetim: (...) Së pari: Në nenin 74 të KPP por edhe në dispozitat e tjera të këtij kodi, nuk njihet shpallja e moskompetencës nga një trup gjykues i një gjykate duke i dërguar aktet një trupi tjetër gjykues brenda të njëjtës gjykatë. Së dyti: Gjyqtari ka shpallur moskompetencën duke argumentuar kërkesën e tij në referim të parashikimeve ligjore të nenit 278 të KPP (...) Gjykata, vlerëson se, në frymën e kësaj dispozite, të gjithë kërkesat që parashtrojnë subjektet e procedimit penal drejtuar gjykatës, në fazën e hetimeve paraprake do të gjykohen nga i njëjti gjyqtar. Gjykata, çmon se, në referim të nenit 329/a të KPP, vendimi i pushimit të procedimit penal, është një mënyrë për përfundimin e hetimeve paraprake dhe në këtë këndvështrim, kërkesa e prokurorisë drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit penal nuk është kërkese që lind gjatë hetimeve paraprake, por kërkesë që lind si nevojë, pasi kanë përfunduar hetimet paraprake të çështjes. Së treti: Gjykata, çmon se, ndodhet në kushtet e pamundësisë për të gjykuar çështjen përkatëse pasi për të është shprehur me vendimin nr. 1430, datë 04.04.2018, duke vendosur pushimin e çështjes, vendim i cili është prishur nga ana e Gjykatës së Apelit me vendimin nr. 1585, datë 11.6.2018. Në këto kushte, dhënia e një vendimi të dytë për të njëjtën çështje është e papajtueshme me kërkesat e nenit 15 të KPP."*.

II. Vlerësim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, paraprakisht konstaton se në praktikën e tij, ky Kolegj ka pranuar ekzistencën e konfliktit për kompetencë edhe ndërmjet gjyqtarëve të së njëjtës gjykatë, si në rastin objekt gjykimi, të cilët njëkohësisht kanë pranuar ose jo të shqyrtojnë një çështje të caktuar, duke kërkuar nga Gjykata e Lartë të zgjidhë mosmarrëveshjen e kompetencës mes tyre.

Në çështjen në shqyrtim, ka mosmarrëveshje për kompetencën lëndore të shqyrtimit të çështjes penale ndërmjet gjyqtarit të seancës paraprake dhe gjyqtarit të seancës gjyqësore në të njëjtën gjykatë.

9. KPP në Kreun II, seksioni V, titulluar "*Mosmarrëveshjet për kompetencat*", nenet 89, 90, 91, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë.

10. Referuar ndryshimeve të KPP me ligjin nr. 35/2017, rezulton se, në Kreun IX është shtuar "*Seanca paraprake*" si procedurë gjyqësore në procesin gjyqësor penal, rregullat e zhvillimit të së cilës parashikohen në nenet 332- 332/gj, ndërsa "Gjykimi" i çështjes penale parashikohet në Kreun I, nenet 333 e vijues të këtij kodi. Nga shqyrtimi i dispozitave procedurale penale që rregullojnë procedurën e gjykimit të çështjeve penale në seancë paraprake, ligjvënësi në çdo rast parashikon "gjyqtarin e seancës paraprake", i cili referuar nenit 329/a të KPP shqyrton në dhomë këshillimi kërkesat e prokurorit, duke përfshirë dhe kërkesën për pushimin e akuzës ose të çështjes penale, në rastet e parashikuara në paragrafin e parë të nenit 328 të këtij kodi. Nga ana tjetër, neni 278 i KPP ka parashikuar kompetencat e gjykatës së shkallës së parë në hetimet paraprake:*"1. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.*

2. Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit "1" të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar.".

11. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji konstaton se:

Në parashtrimin e mosmarrëveshjes para Kolegjit Penal, gjyqtarja e

seancës paraprake (A.B.) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, argumenton moskompetencën e saj për shqyrtimin e kërkesës nr. 5721/427 regj., datë regjistrimi 17.12.2018, pasi për të njëjtën kërkesë ka disponuar me vendimin nr. 1430, datë 04.04.2018, vendim i cili është prishur nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë me vendimin nr. 1585, datë 11.6.2018. Në këto kushte, dhënien e një vendimi të dytë për të njëjtën çështje e konsideron të papajtueshme me kërkesat e nenit 15 të KPP. Po kështu, në interpretim të nenit 278 të KPP, kërkesën e prokurorit drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit penal nuk e konsideron si kërkesat që parashtrojnë subjektet e procedimit penal në fazën e hetimeve paraprake (*për rrjedhoje në kompetencë të gjyqtarit të seancës paraprake*) por, si kërkesë e paraqitur pasi kanë përfunduar hetimet paraprake të çështjes dhe sipas nenit 278 të KPP gjyqtari i seancës gjyqësore nuk duhet të shpallte moskompetencën për gjykimin e kësaj çështjeje penale.

12. Kolegji Penal, referuar parashikimeve të KPP, në nenet 278, 329/a, 329/b e vijues, vlerëson se kërkesa e prokurorit për pushimin e procedimit penal shqyrtohet vetëm nga gjyqtari i seancës paraprake, në përputhje me procedurën e parashikuar nga nenet 332- 332/gj të KPP.

Në këtë këndvështrim, është i drejtë vendimi i gjyqtarit të seancës gjyqësore L.S., i cili ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit me objekt pushim procedimi penal dhe ia ka dërguar çështjen gjyqtarit të seancës paraprake A.B..

13. Pretendimi i gjyqtares për moskompetencën e saj duke u referuar në nenin 15 të KPP nuk qëndron, pasi paragrafi i dytë (fjalia e dytë) trajton rastet e papajtueshmërisë midis gjyqtarit që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake (masa sigurimi, deklarim ikjeje, zgjatje afati hetimi etj.,) me gjyqtarin e seancës paraprake, i cili shqyrton ndërmjet të tjerash kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes, si në rastin objekt shqyrtimi. Pra, nuk ndalon shqyrtimin për herë të dytë të çështjes në seancë paraprake dhe nuk ndalon të njëjtin gjyqtar të shqyrtojë të njëjtën çështje në seancë paraprake kur ajo vjen përsëri me kërkesë nga prokurori.

Në të njëjtën kohë, gjyqtari i hetimeve paraprake që ka ngritur mosmarrëveshjen për kompetencë, në qoftë se do të bazohej tek neni 15 i KPP, kish të drejtën t'i drejtohej kryetarit të gjykatës, bazuar në nenin 17/1, "e" të po këtij kodi.

14. Sa sipër, *vlen të mbahet parasysh nga ana e gjyqtarëve gjatë veprimtarisë së tyre se gjyqtari i seancës paraprake nuk ka asnjë pengesë për të shqyrtuar më shumë se një herë kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës/çështjes edhe kur ka vendosur më parë kthimin e akteve prokurorisë apo edhe kur gjykata e apelit ka prishur vendimin e tij dhe ia ka kthyer aktet prokurorisë.*

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-175, datë 12.06.2020

Gjyqtari i hetimeve paraprake duhet që, në referim të parashikimit të kësaj dispozite, bashkë me kërkesën për vleftësimin e masës së sigurimit dhe caktimin e masës së sigurimit, njëherazi, të vazhdonte me gjykimin e çështjes në themel.

I. Rrethanat e çështjes.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër i ka paraqitur asaj gjykate kërkesën me objekt "*Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të bërë në datë 21.09.2019*"; *Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në burg"*; Gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes me nr. 1419/2019, me të pandehur Gj.H., akuzuar për kryerjen e veprës penale "Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt".

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (gjyqtari i hetimeve paraprake), me vendimin nr. 656 (4678), datë 24.9.2019, ka vendosur: Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të të pandehurit Gj.H., kryer më 21.09.2019, ora 23.30. Caktimin ndaj këtij të pandehuri të masës së sigurimit personal shtrëngues "*Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" (...) Konstatimin e moskompetencës lëndore për t'u shprehur lidhur me kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë, duke ia kaluar aktet përkatëse në ngarkim të të pandehurit Gj.H. seksionit penal të kësaj gjykate, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2/1. Me këtë arsyetim: "*...Ndryshimet e KPP nuk e bëjnë më kompetente këtë gjykatë, konkretisht në nenin 15 të KPP parashikohet se: "Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim. Gjyqtari që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit të seancës paraprake në të njëjtin procedim". Në nenin 332 KPP parashikohet* se: "*Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake cakton datën e zhvillimit të saj; Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj." Gjithashtu, në vijim gjykata referon në nenin 334 të KPP, konkretisht mundësinë e prokurorit për të kërkuar gjykim drejtpërdrejtë apo të të*

pandehurit për gjykim të shkurtuar deri në përgatitjen e fashikullit për gjykim.

Në vlerësim të kësaj gjykate "Gjyqtari i hetimeve paraprake" është i ndryshëm nga "Gjyqtari i seancës paraprake", deri aty sa kodi në mënyrë të qartë u ka vendosur shkak papajtueshmërie në rast se i njëjti gjyqtar kryen këto dy apo tre role, referuar nenit 15 të KPP Gjithashtu në mbështetje të nenit 400 e vijues të KPP, parashikohet detyrimi i prokurorit për të dërguar "fashikullin e gjykimit" në gjykatën kompetente, për kryerjen e njoftimeve përkatëse me urdhër të posaçëm, i cili duhet të përmbajë, me pasojë pavlefshmërinë, të dhënat e "vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq"... Përgatitja e fashikullit të gjykimit dhe vendimi i dërgimit të çështjes në gjyq, janë kompetencë e "gjyqtarit të seancës paraprake", i cili nuk duhet të jetë i njëjtë me atë të hetimeve paraprake, në zbatim të nenit 15 KPP.".

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (gjyqtari i seancës gjyqësore), me vendimin nr. akti 582 (00227), datë 24.02.2020, ka kërkuar para Gjykatës së Lartë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore/ funksionale në çështjen objekt gjykimi dhe t'ia kalojë aktet për vazhdimin e gjykimit gjyqtares së hetimeve paraprake pranë kësaj gjykate.

3/1. Me këtë arsyetim:"...Kompetente për shqyrtimin e kërkesës objekt gjykimi është gjykata që ka vlerësuar kërkesën e prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake. Gjykata referon në parashikimet e nenit 400 dhe 401 të KPP, duke arsyetuar se anashkalimi i kërkesës së prokurorisë për gjykimin e drejtpërdrejtë dhe dërgimin e çështjes për gjykim në seksionin e themelit nuk është në përputhje me parashikimet ligjore të mësipërme dhe as me qëllimin e legjislatorit. Qëllimi i legjislatorit në rastin e gjykimit të drejtpërdrejtë ka qenë shmangia e fazës së hetimeve duke u gjykuar kërkesa penale në themel, kur plotësohen kushtet dhe kriteret e sipërcituara. Kjo gjykatë, arsyeton se legjislatori ka përcaktuar në mënyrë të qartë se gjyqtari i hetimeve paraprake duhet të shprehet lidhur me pranimin ose jo të gjykimit të drejtpërdrejtë dhe nëse e pranon atë të vijojë me gjykimin e themelit të çështjes. Nga gjyqtarja e hetimeve paraprake, nuk është marrë vendim lidhur me pranimin apo jo të gjykimit të drejtpërdrejtë dhe çështja ka kaluar drejtpërdrejt në seksionin penal të themelit.".

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, paraprakisht konstaton se në praktikën e tij, ky Kolegj ka pranuar ekzistencën e konfliktit për kompetencë

edhe ndërmjet gjyqtarëve të së njëjtës gjykatë, si në rastin objekt gjykimi, kur në të njëjtën kohë marrin ose kur ata nuk pranojnë të marrin për shqyrtim një çështje të caktuar, duke kërkuar nga Gjykata e Lartë të zgjidhë mosmarrëveshjen e kompetencës mes tyre. Në çështjen në shqyrtim, ka mosmarrëveshje për kompetencën lëndore të shqyrtimit të çështjes ndërmjet gjyqtarit të hetimit paraprak të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe gjyqtarit të seancës gjyqësore në të njëjtën gjykatë. KPP në Kreun II, seksioni V, titulluar "*Mosmarrëveshjet për kompetencat*", nenet 89, 90 dhe 91 KPP ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë. (...)

Neni 89/1 i KPP parashikon: "*Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person.*"

Neni 90 në vijim, parashikon parashtrimin e mosmarrëveshjes në këtë mënyrë:

1. Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, të cilës i bashkohet dokumentacioni i nevojshëm.

2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes, merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit.

3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje.".

5. Lidhur me çështjen në shqyrtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, konstaton se:

Neni 400/1 i KPP "*Rastet e gjykimit të drejtpërdrejtë*" (Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 1 dhe 3, e ndryshuar fjalia në pikën 2 me ligjin nr. 35, datë 30.3.2017), parashikon shprehimisht: *1. Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe hetohet për kryerjen e një vepre penale që gjykohet nga një gjyqtar, prokurori paraqet në gjykatë brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi, kërkesën për vleftësimin e tij dhe gjykimin e njëkohshëm, kur çmon se nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme. 2. Në qoftë se arrestimi vleftësohet i ligjshëm dhe nuk ka nevojë për hetime të tjera, procedohet menjëherë në gjykim, ndërsa kur ai nuk gjendet i bazuar aktet i kthehen prokurorit. Por edhe në rastin e fundit, kur i pandehuri dhe prokurori japin pëlqimin gjykata procedon*

në gjykimin e drejtpërdrejtë. 3. Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe ai vleftësohet i ligjshëm, si dhe kur gjykata vendos njërën nga masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237, 238 ose 239, të Kodit, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për gjykimin e drejtpërdrejtë, jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e arrestimit, me përjashtim të rastit kur duhet të kryhen hetime të mëtejshme. 4. Kur vepra penale për të cilën kërkohet gjykimi i drejtpërdrejtë lidhet me vepra penale të tjera, për të cilat mungojnë kushtet për këtë lloj gjykimi, procedohet ndaras për veprat e tjera dhe ndaj të pandehurve të tjerë, përveçse kur kjo ndarje dëmton hetimet. Kur bashkimi është i domosdoshëm zbatohen rregullat e gjykimit të zakonshëm.".

6. Kërkesa e paraqitur në datë 23.09.2019, nga prokurori pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të bërë në datë 21.09.2019; caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "*arrest në burg*" dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes me nr. 1419/2019, me të pandehur Gj.H., akuzuar për kryerjen e veprës penale "*Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt*", bazohet dhe është në kushtet e nenit 400, pika "1" e KPP, prandaj ajo *gjykatë (gjyqtari i hetimeve paraprake) duhej që në referim të parashikimit të kësaj dispozite, bashkë me kërkesën për vleftësimin e masës së sigurimit dhe caktimin e masës së sigurimit, njëherazi, të vazhdonte me gjykimin e çështjes në themel.*

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-300, datë 09.10.2020

Gjyqtari i seancës paraprake që ka disponuar më parë lidhur me kërkesën e prokurorit për pushimin e gjykimit të çështjes sipas nenit 329 të KPP është i njëjti gjyqtar që shqyrton më pas kërkesat sipas nenit 331 e vijues të tij, përfshirë edhe vlerësimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim sipas nenit 332/dh të KPP. Pa vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake çështja nuk mund t'i kalojë gjyqtarit që shqyrton çështjen në themel.

I. Rrethanat e çështjes

1. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, kërkuesi V.M. në datën 01.07.2020, ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë ose përjashtimin e gjyqtarit I.P., nga shqyrtimi i çështjes penale nr. Akti 314, të vitit 2020, me kërkues Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe objekt, dërgimin e çështjes në gjyq, me të pandehur V.M., për veprën penale "*Goditje për shkak të detyrës*", të parashikuar nga neni 237 i KP.

2. Kërkuesi V.M. ka pretenduar si shkak të përjashtimit të gjyqtarit faktin që i njëjti gjyqtar ka gjykuar kërkesën e prokurorisë për pushimin e çështjes duke vendosur në datën 29.01.2020, kthimin e akteve të procedimit penal nr. 576 të vitit 2018, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhe urdhëruar që kjo e fundit të formulojë akuzë dhe paraqesë kërkesë për gjykim ndaj shtetasit V.M. për veprën penale të parashikuar nga neni 237 i KP.

3. Në zbatim të nenit 21/1 të KPP, ndryshuar me ligjin nr.35/2017, sipas të cilit: *"Gjyqtari për të cilin është kërkuar përjashtimi paraqet me shkrim mendimin në lidhje me kërkesën për përjashtim",* gjyqtari për të cilin është kërkuar përjashtimi nga gjykimi i çështjes, ka paraqitur mendimin në lidhje me këtë kërkesë duke çmuar se nuk ka shkaqe ligjore dhe arsye si për dorëheqjen ashtu dhe përjashtimin e tij nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 91, datë 02.07.2020, ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës.

4.1 Duke arsyetuar ndërmjet të tjerash se: *"....Në lidhje me pretendimet e palës kërkuese se gjyqtari I.P. nuk ka pranuar kërkesën e prokurorisë për pushimin e hetimeve ndaj shtetasit V.M., por ka urdhëruar që ndaj tij të ngrihet akuzë dhe se një vendimmarrje e tillë sjell si pasojë që gjyqtari të ketë*

shfaqur mendimin e tij dhe e ka paragjykuar çështjen, gjykata vlerëson se nuk qëndron. Kështu, nga kërkesa rezulton se gjyqtari I.P. është gjyqtari i seancës paraprake për rastin objekt gjykimi, kjo në përputhje edhe me nenin 329/b/2 dhe 332/1 të KPP dhe si rrjedhojë, nuk mund të pretendohet se dhënia e një vendimi në raste të tilla përbën pengesë për të gjykuar në vijim kërkesën/at e prokurorit, duke qenë se vetë KPP ka parashikuar këtë rregullim. Për sa u përket pretendimeve për vendimmarrjen e gjyqtarit që nuk ka pranuar kërkesën e prokurorisë për pushimin e hetimeve etj., këto pretendime nuk mund të jenë objekt i kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, por objekt i ankimit në një gjykatë më të lartë. Fakti që disa vendime të gjykatës apo orientime procedurale për hetimin gjyqësor nuk i pëlqejnë njërës palë apo tjetrës, nuk tregon asgjë me rëndësi sa i përket ecurisë së mëtejshme të gjykimit, në pikëpamje të paanësisë së gjyqtarit. Ky i fundit i merr vendimet bazuar në bindjen e tij të brendshme të formuar në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit e kjo është shfaqja me e mirë e pavarësisë së gjyqtarit e cila është e paprekshme në një shoqëri që kërkon të funksionojë sipas parimeve më të mira të shtetit të së drejtës. Pala nuk ka të drejtë "të zgjedhë" gjyqtarin që do i gjykojë çështjen, e për rrjedhojë, në mungesë të shkaqeve të arsyeshme e të mbështetura në prova, nuk mund të kërkojë përjashtimin e tij. Vendimet e marra prej tij për sa kohë që do të jenë objekt shqyrtimi nga një gjykatë më e lartë në eventualitet të një ankimi të kryer, nuk mund të shqyrtohen apo të përbëjnë shkak për përjashtimin e gjyqtarit. Ndërsa, në lidhje me pretendimin se ka humbur besimin tek gjyqtari I.P. si rrjedhojë e disa vendimeve që gjyqtari ka dhënë në raste të ndryshme, gjykata çmon se nuk janë të bazuara në ligj dhe në prova. Ligji procedural penal e ka të përcaktuar në mënyrë të qartë se në cilat raste gjyqtari duhet të japë dorëheqjen apo pala mund të kërkojë përjashtimin. Gjykata çmon se nuk mund të abuzohet me kërkesa të tilla, por kërkesa duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe rregullat që ka parashikuar shprehimisht KPP dhe që janë të cituara edhe më sipër, duke sjellë si pasojë që kërkesa që është depozituar nga ana e palës kërkuese të mos plotësojë as kushtet formale. Në këto kushte, Gjykata duke u bazuar tek analiza e mësipërme, çmon se nuk ka shkak ligjor (nuk provohet nga kërkuesi ekzistenca e ndonjë shkaku të tillë) për përjashtimin e gjyqtarit I.P. nga gjykimi i çështjes penale."

5. Kundër vendimit me nr. 91, datë 02.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka paraqitur rekurs më datë 08.07.2020, kërkuesi V.M., me të cilin ka kërkuar: *Ndryshimin e vendimit me nr. 91, datë 02.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit,* duke parashtruar si shkaqe: Gjyqtari I.P. ka gjykuar kërkesën e prokurorisë për pushimin e çështjes duke vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. 576, të vitit 2018, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë,

dhe urdhëruar që kjo e fundit të formulojë akuzë dhe paraqesë kërkesë për gjykim ndaj shtetasit V.M. për veprën penale të parashikuar nga neni 237 i KP. Me vendimin e dhënë, gjyqtari jo vetëm ka paragjykuar çështjen por ka cenuar pavarësinë e prokurorisë në marrjen e vendimeve, duke e trajtuar atë si të paaftë, vendimin e saj të gabuar dhe si organ në varësinë subjektive të gjyqtarit. Gjyqtari nuk ka vlerësuar mungesën time në atë seancë për arsye objektive. Gjithashtu, gjyqtari nuk ka vlerësuar një deklaratë noteriale të kallëzuesit me të cilën ka tërhequr kallëzimin dhe me vendimin e dhënë në emër të ligjit krejtësisht të njëanshëm, ka mbrojtur paligjshmërinë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë thekson se, sipas rregullimeve procedurale penale, gjykata që shqyrton kërkesën për përjashtim të gjyqtarit në procesin penal, në zbatim të parashikimeve të nenit 22/1 të KPP duhet të verifikojë më parë nëse proceduralisht kërkesa është ose jo e bazuar. Për këtë duhet të verifikohet nëse kjo kërkesë është bërë nga ai që e ka këtë të drejtë, është bërë në respektim të afateve dhe formës së kërkuar nga neni 19 i KPP dhe nëse shkaqet e paraqitura janë të bazuara në ligj.

7. Kur gjykata konstaton se kërkesa për përjashtim është proceduralisht jo e rregullt, pra nuk plotësohen parashikimet e nenit 22/1 të KPP, është e detyruar që me vendim ta shpallë këtë kërkesë të papranueshme.

8. Kur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit është e pranueshme për t'u shqyrtuar, atëherë gjykata shqyrton themelin e saj, pra nëse në kërkesën e paraqitur janë ose jo rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim. Nëse gjykata krijon bindjen se në kërkesën për përjashtim të gjyqtarit ekziston një apo më shumë prej rasteve që parashikohen në nenet 15, 16, 17 e 18 të KPP, duhet të vendosë pranimin e kërkesës dhe në të kundërt kërkesa duhet të rrëzohet.

9. Gjykata Kushtetuese, sa i takon paanshmërisë objektive është shprehur në vendimet e saj se testi objektiv kërkon që të përcaktohet nëse pavarësisht sjelljes personale të gjyqtarit, ka fakte të vërtetueshme, të cilat mund të ngrenë dyshime lidhur me paanshmërinë e tij/saj. Në këtë drejtim, edhe dukja mund të ketë një farë rëndësie. Ajo që është e rëndësishme është besimi që publiku, dhe mbi të gjitha i akuzuari, duhet të kenë te gjykatat në një shoqëri demokratike. Kjo nënkupton që në vendimmarrje, nëse ka një arsye legjitime që një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm, por nuk është vendimtar. Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet se është objektivisht e justifikueshme.

10. Kolegji thekson se, në KPP me ndryshimet në ligjin 35/2017, janë

parashikuar kompetencat dhe veprimet që kryen gjyqtari i seancës paraprake. Qëllimi kryesor i parashikimit të kësaj figure për kontrollin e veprimeve të prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe forcimi i fazës së hetimit, si fazë delikate e procesit penal edhe përpara decentralizimit të prokurorisë, realizohet nëpërmjet kompetencave konkrete që i janë dhënë këtij gjyqtari. Kështu, përveç rastit të shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes, gjyqtari i seancës paraprake ka për detyrë të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq sipas nenit 331 të KPP është e bazuar në prova dhe ligj si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë së tyre dhe vlefshmërisë se akteve. Në rast se gjyqtari i seancës paraprake çmon se çështja mund të kalojë për gjykim, pranon kërkesën e prokurorit, duke e kaluar atë për gjykim. Ndërkaq, kur çmon se hetimet paraprake janë të paplota, gjykata urdhëron plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtimet e hetimeve shtese dhe kur është rasti, edhe aktet që duhet të kryhen. Gjithashtu e drejta e gjyqtarit të seancës paraprake për kontrollin e cilësimit juridik të faktit si dhe formulimin e qartë dhe të saktë të akuzës është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 332/d. Në këto raste gjyqtari fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos kthimin e akteve në prokurori, duke ia njoftuar këtë vendim drejtuesit të prokurorisë. Nenet 332/dh dhe 332/e përcaktojnë llojet e vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake si dhe elementet e këtij vendimi.

11. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, në referim të shkaqeve të rekursit dhe për sa më lart arsyetuar, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, gjyqtari i seancës paraprake që ka disponuar më parë lidhur me kërkesën e prokurorit për pushimin e gjykimit të çështjes sipas nenit 329 të KPP është i njëjti gjyqtar që shqyrton më pas kërkesën e prokurorit sipas nenit 331 e vijues të tij. Prokurori, sipas nenit 331 të KPP, kërkon vetëm dërgimin e çështjes në gjyq dhe është gjyqtari i seancës paraprake ai që vendos mbi kërkesën e prokurorit, në zbatim të neneve 332 e vijues të KPP. Thënë më qartë, nëse gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar mbi kërkesat e prokurorit sipas nenit 329 të KPP është i njëjti gjyqtar që do të vlerësojë dhe kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim, sipas nenit 332/dh të këtij kodi, pa vendimin e të cilit çështja nuk mund t'i kalojë gjyqtarit që shqyrton çështjen në themel, procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj *(neni 332/dh pika 3 e KPP).*

12. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, vlerëson se rekursi i paraqitur nga kërkuesi V.M. kundër vendimit nr. 91, datë 02.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 22 dhe 432 i KPP dhe për rrjedhojë, nuk duhet pranuar.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-336, datë 06.11.2020

Për të mos cenuar parimin e paanshmërisë së gjykatës, gjyqtari që ka shqyrtuar më parë një çështje me të njëjtat palë, pavarësisht natyrës civile apo penale të çështjes, nuk mund të gjykojë sërish çështjen aktuale nëse faktet e shqyrtuara dhe vlerësuara prej tij në çështjen e mëparshme kanë lidhje me çështjen në të cilën kërkohet përjashtimi dhe që përbëjnë bazën e zgjidhjes së konfliktit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Referuar akteve të administrura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë rezulton se, me shortin elektronik nr. 76002-01334-41-2020 (510sp), dt. regj. 27.07.2020, është caktuar gjyqtari M.K. pranë kësaj gjykate, për gjykimin e kërkesës penale me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe objekt: Pushimin e çështjes penale nr. 131 të vitit 2019, të regjistruar për veprën penale "*Falsifikimi i dokumenteve*", parashikuar nga neni 186 i KP, me kallëzuese F.M.. Në datën 17.09.2020, kërkuesja F.M. ka depozituar kërkesën me objekt përjashtimin e gjyqtarit M.K. që i përket kërkesës penale të sipërcituar.

2. Në kërkesën e paraqitur për përjashtimin e gjyqtarit, nga kërkuesja F.M. pretendohet se, *gjyqtari M.K. ka qenë në përbërje të trupit gjykues në një çështje civile ku palë paditëse ka qenë L.N. dhe bashkëpronarët si dhe palë e paditur F.M., me objekt "Lirim dorëzim sendi" (truall).*

Pavarësisht se çështja është pushuar për shkak të heqjes dorë nga paditësja L.N., ku (në përbërje të të cilës ka qenë dhe gjyqtari M.K.), gjatë shqyrtimit gjyqësor është kryer Raporti i Vlerësimit nga vlerësuesi R.B. dhe Akti Teknik i Ekspertimit nga eksperti topograf R.P..

Gjyqtari është në dijeni të konfliktit që ajo ka me palën e akuzuar V.N. dhe bashkëpronaret, në atë gjykim dhe se çështja penale që aktualisht ai ka për shqyrtim ka lidhje me të njëjtën pronë dhe me të njëjtën palë në konflikt.

3. Gjyqtari M.K., për të cilin kërkohet përjashtimi, ka dhënë mendimin në lidhje me kërkesën e përjashtimit *(neni 21 pika 1/1 të KPP),* duke u shprehur ndër të tjera se, *në kërkesën e përjashtimit kërkuesi i referohet si shkak*

përjashtimi, ekzistencës së vendimit nr. 2979, datë 30.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka disponuar me pushimin e gjykimit të çështjes, me shkak ligjor nenin 299/b të KPC. Ky shkak referon si fakt i deklaruar prej kërkuesit, në qënien në dijeni të gjyqtarit të rrethanave të çështjes, apo konfliktit civil nga shqyrtimi gjyqësor i saj edhe pse çështja gjyqësore ka përfunduar me vendim jo përfundimtar. Duke mbajtur parasysh se kemi të bëjmë me një vendimmarrje të vitit 2009, si gjyqtar nuk kam asnjë memorizim të situatës faktike dhe në përmbajtje të ketij procesi gjyqësor civil dhe për më tepër, nëse kjo situatë ka ose jo lidhje me faktet që do parashtrohen në seancën paraprake të gjykimit aktual, pasi mungon një relatim/analizë e tyre në qëndrimin e kërkesës së perjashtimit. Ndërkohë, nuk kam mundësi të njihem me përmbajtjen e dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. 2979, datë 30.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për arsyen se pas interesimit arkivistja e gjykatës nuk rezulton e paraqitur në detyrë para dhe në momentin e përpilimit të këtij akti gjyqesor. Lidhur me këtë aspekt nuk mund të investohem për të identifikuar dhe vlerësuar rrethana për çmuarjen e paraqitjes së dorëheqjes ose jo. Nuk jam në dijeni të asnjë rrethane që cenon testin objektiv dhe atë subjektiv, për të cilin lind detyrimi për të dhënë dorëheqjen, si dhe të asnjë arsyeje që cilëson papajtueshmëri për pjesëmarrjen në këtë gjykim penal.

Për sa është parashtruar, vendos nën vërejtjen tuaj, vlerësimin dhe çmuarjen e situatës kërkimore për përjashtim.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. akti 304, datë 18.09.2020, ka vendosur:

"Rrëzimin e kërkesës penale me nr. regj. them. 71000-01521-41-2020 (304 prot), datë 17.09.2020, që i përket kërkueses F.M., me objekt perjashtimin e gjyqtarit M.K..

5. Kundër vendimit me nr. akti 304, datë 18.09.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka paraqitur rekurs më datë 29.09.2020 kërkuesja F.M., me të cilin ka kërkuar: *Prishjen e vendimit me nr. akti 304, datë 18.09.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pranimin e kërkesës, përjashtimin e gjyqtarit.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

6. Kolegji Penal, në dhomë këshillimi pasi shqyrtoi shkaqet e rekursit, çmon se rekursi i paraqitur nga kërkuesja F.M. nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 22 i KPP, e si i tillë nuk duhet të pranohet. Vendimi me nr. akti 304, datë 18.09.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural penal.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë thekson se, sipas rregullimeve procedurale penale, gjykata që shqyrton kërkesën për përjashtim të gjyqtarit në procesin penal, në zbatim të parashikimeve të nenit 22/1 të KPP, duhet të verifikojë më parë nëse proceduralisht kërkesa është ose jo e bazuar. Për këtë, duhet të verifikohet nëse kjo kërkesë është bërë nga ai që e ka këtë të drejtë, është bërë në respektim të afateve dhe formës së kërkuar nga neni 19 i KPP dhe nëse shkaqet e paraqitura janë të bazuara në ligj.

8. Kur gjykata konstaton se kërkesa për përjashtim është proceduralisht jo e rregullt, pra nuk plotësohen parashikimet e nenit 22/1 të KPP, është e detyruar që me vendim ta shpallë këtë kërkesë të papranueshme.

9. Kur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit është e pranueshme për t'u shqyrtuar, atëherë gjykata shqyrton themelin e saj, pra nëse në kërkesën e paraqitur janë ose jo rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim. Nëse gjykata krijon bindjen se në kërkesën për përjashtim të gjyqtarit ekziston një apo më shumë prej rasteve që parashikohen në nenet 15, 16, 17 e 18 të KPP, duhet të vendosë pranimin e kërkesës dhe në të kundërt kërkesa duhet të rrëzohet.

10. Gjykata Kushtetuese, sa i takon paanshmërisë objektive, është shprehur në vendimet e saj se testi objektiv kërkon që të përcaktohet nëse pavarësisht sjelljes personale të gjyqtarit, ka fakte të vërtetueshme, të cilat mund të ngrenë dyshime lidhur me paanshmërinë e tij/saj. Në këtë drejtim, edhe dukja mund të ketë një farë rëndësie. Ajo që është e rëndësishme është besimi që publiku, dhe mbi të gjitha i akuzuari, duhet të kenë te gjykatat në një shoqëri demokratike. Kjo nënkupton që në vendimmarrje, nëse ka një arsye legjitime që një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm, por nuk është vendimtar. Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet se është objektivisht e justifikueshme *(shih çështjen Fey kundër Austrisë, 24 shkurt 1993, § 30; çështjen Fatullayev kundër Azerbajxhanit, 22 prill 2010*).

11. Në çështjen Gjon Boçari kundër Shqipërisë, GJEDNJ ka arsyetuar ndërmjet të tjerash se, *Lidhur me paanësinë objektive, gjykata tashmë ka konkluduar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel. Së fundmi, as shqyrtimi paraprak i një informacioni të disponueshëm nuk do të thotë që paragjykon shqyrtimin përfundimtar të çështjes (shih mutatis mutandis, Hauschildt v Denmark, vendimi i datës 24 maj 1989, Series A nr. 154, fq. 22 paragrafi 50; Norties v Neitherlands*

(Neriter v Holland), vendimi datë 24 gusht 1993, Series A nr.267, fq. 15 paragrafi 33; dhe Saraiva de Carvalho v Portugal, vendimi i datës 22 prill 1994, Series A nr. 286-B, fq.38, paragrafi 35).

12. Neni 432 i KPP, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

13. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në referim të shkaqeve të rekursit, konstaton se kërkuesja F.M. nuk ka arritur të provojë koneksitetin ndërmjet çështjes civile me nr. vendimi 2979, dt. 30.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë *(në përbërje të trupit gjykues ka qenë gjyqtari M.K.),* me çështjen penale me nr. 76002-01334-41-2020 (510sp), dt. regj. 27.07.2020, që po shqyrtohet nga i njëjti gjyqtar.

14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka një qëndrim të konsoliduar lidhur me faktin që i njëjti gjyqtar ka shqyrtuar më parë çështje me të njëjtat palë me natyrë civile apo penale, duke pranuar se, do të kemi cenim të parimit të paanshmërisë së gjykatës kur faktet e shqyrtuara dhe vlerësuara në çështjen e mëparshme prej tij, kanë lidhje me çështjen në të cilën kërkohet përjashtimi dhe që përbëjnë bazën e zgjidhjes së konfliktit. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se, në çështjen civile me nr. vendimi 2979, dt. 30.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë *(në përbërje të trupit gjykues ka qenë gjyqtari M.K.)* është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes duke mos disponuar gjykata lidhur me themelin e gjykimit. Referuar pjesës përshkruese dhe arsyetuese të vendimit, nuk rezulton të kemi një vlerësim të provave të marra në atë gjykim nga gjyqtari M.K..

15. Në përfundim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në tërësi rekursi nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenet 432 dhe 22 të KP dhe për rrjedhojë nuk duhet pranuar.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2020-473, datë 22.12.2020

Për të siguruar kuptimin dhe zbatimin e ligjit; njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, shqyrtimi i rekurseve ndaj vendimeve të Gjykatës së Lartë në rastet kur gjykatat e niveleve më të ulëta japin vendime në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara, nuk mund të bëhet në dhomë këshillimi por në seancë gjyqësore. Në rastet kur një vendim njësues tashmë ekziston, vendimet në rastet e mësipërme nuk mund të quhen njësuese. Për këtë arsye, shqyrtimi i rekurseve në seancë gjyqësore për çështje të cilat nuk përbëjnë njësim ose zhvillim të praktikës gjyqësore, do të bëhet nga trupa gjyqësore të përbëra nga 3 (tre) gjyqtarë.

E njëjta situatë krijohet edhe në rastet e mosrespektimit ose zbatimit të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave. Të tilla janë edhe kërkesat për ekstradim marrë në kundërshtim me qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës Kushtetuese sa i përket parimit 'ne bis in idem', si dhe të ligjit procedural penal lidhur me shkaqet që bëhen pengesë për ekstradimin. Prania e një procedimi penal apo vuajtja e një dënimi në Shqipëri nuk duhet vlerësuar si një nga ato rrethana të cilat nuk lejojnë pranimin e një kërkese ekstradimi, por vetëm si një rrethanë e cila mund të çojë në pezullimin e ekzekutimit të një ekstradimi të pranuar nga gjykata, diskrecion ky i Ministrit të Drejtësisë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e dosjes, ka rezultuar e provuar se: Me shkresën nr. 1412/44 prot., G.K., datë 09.10.2018, të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, është përcjellë kërkesa e autoriteteve italiane të drejtësisë, si dhe dokumentacioni përkatës për ekstradimin e shtetasit shqiptar M.H. (E.M.), (...)

2. Kërkesa është e bazuar në urdhër arrestin nr. 976/15 RGNR-1306/15 RG GIP, datë 05.02.2014, të Gjyqtarit për Hetimet Paraprake të Gjykatës së

Katanias, për veprën penale "Organizata kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike", të parashikuar nga legjislacioni penal italian, kryer nga shtetasi shqiptar M.H. (E.M.) në Itali nga janari deri ne tetor të vitit 2014.

3. Me shkresën nr. 230/26, datë 08.10.2018, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ka dërguar pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, kërkesën për ekstradim si dhe dokumentacionin e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Italisë, në lidhje me shtetasin shqiptar M.H. (E.M.).

4. Nga përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se, shtetasi shqiptar M.H. (E.M.) ka qenë pjesë e dy organizatave kriminale që kishin për qëllim trafikun e lëndëve narkotike midis Shqipërisë dhe Italisë, si dhe i kishte dhënë sasi të mëdha marijuane grupit mafioz me në krye shtetasin A.N., grupit të kryesuar nga vëllezërit M. dhe grupit të kryesuar nga A.L.. Këto furnizime kryheshin nëpërmjet detit dhe në dy raste janë sekuestruar edhe sasi të konsiderueshme të lëndëve narkotike. Gjithashtu, rezulton se shtetasi M.H. (E.M.), së bashku me persona të tjerë shqiptarë ka organizuar raporte me krimin e organizuar në Katania për sasi të mëdha marijuane si dhe transportimin e saj.

5. Në lidhje me këto fakte, Gjyqtari i Hetimeve Paraprake në Katania ka nxjerrë urdhër arrestin për shtetasin shqiptar M.H. (E.M.), pasi dyshohet për kryerjen e veprës penale "*Organizata kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike*", të parashikuar nga nenet 56, 110 të KP Italian, si dhe nenet 73 e 80 të Dekretit Presidencial nr. 309/90, ku parashikohet dënimi në maksimum deri në 20 vjet.

6. Ka rezultuar se, me vendimin nr. 1986, datë 16.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është vendosur fillimisht caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Arrest në burg*", ndaj shtetasit M.H. *alias* E.M. dhe shpallja e moskompetencës nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në lidhje me shqyrtimin e kërkesës penale si më sipër, duke ia kaluar aktet për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

7. Ka rezultuar se, në zbatim të vendimit të mësipërm, aktet i janë dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila, me vendimin nr. 328, datë 23.11.2018, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Arrest në burg*", për efekt ekstradimi *(sipas urdhër arrestit nr. 976/15 RGNR-1306/15 RG GIP, datë 05.02.2014, të Gjyqtarit për Hetimet Paraprake të Gjykatës së Katanias)* ndaj shtetasit shqiptar M.H. (E.M.).

8. Në lidhje me sa më sipër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, konform Konventës Evropiane të Këshillit të Evropës "*Për Ekstradimin*", nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më 19.05.1998 dhe ratifikuar më datë 02.04.1998, Konventës së Këshillit të Evropës "Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale", nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më 19.05.1998 dhe ratifikuar më datë 04.04.2000, Marrëveshjes dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë "Për Ekstradimin" dhe "Për Ndihmën e Ndërsjellë në Fushën Penale", neneve 493 e vijues të KPP, ka paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesën për lejimin e ekstradimit të shtetasit M.H. *alias* E.M., nga Republika e Shqipërisë në drejtim të Republikës së Italisë.

9. Mbrojtësi i personit të arrestuar M.H. *alias* E.M., ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe moslejimin e ekstradimit të shtetasit shqiptar M.H. *alias* E.M., nga Republika e Shqipërisë në drejtim të Republikës së Italisë, me arsyetimin se, ndodhemi përpara institutit të parimit të gjësë së gjykuar "*ne bis in idem",* pasi shtetasi M.H. *alias* E.M. është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për të njëjtin fakt për të cilin është duke u proceduar penalisht në shtetin Italian dhe aktualisht është duke vuajtur dënimin me burgim në territorin e Republikës së Shqipërisë në masën 9 (nëntë) vjet e 4 (katër) muaj burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 337, datë 21.01.2019, (ndër të tjera), ka vendosur: "Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me ekstradimin nga Republika e Shqipërisë në drejtim të Republikës së Italisë të shtetasit shqiptar M.H. *alias* E.M., (...) Pezullimin e ekstradimit deri në përfundimin e periudhës kohore të vuajtjes së dënimit penal me burgim në territorin e Republikës së Shqipërisë, caktuar ndaj shtetasit shqiptar M.H. *alias* E.M., me vendimin nr. 69, datë 18.05.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 109, datë 31.10.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.(...)

11. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 225, datë 25.04.2019, ka vendosur: "Ndryshimin e vendimit nr.337, datë 21.01.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (...). Rrëzimin e kërkesës për ekstradimin e shtetasit M.H. (...)

12. Duke arsyetuar ndër të tjera se: *"... Duke analizuar kriteret që pengojnë ekstradimin e një personi nga Republika e Shqipërisë drejt territorit të shtetit kërkues të ekstradimit, në respekt të dispozitave urdhëruese që parashikon neni 491 i KPP, rezulton në rastin konkret i plotësuar një prej kushteve ndaluese të parashikuara në nenin 491/1/c të KPP, sipas të cilit: "nuk mund të jepet ekstradimi... c. kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri.". Kështu, rezulton se me vendimin nr. 69, datë 18.05.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 109, datë 31.10.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi me 9 (nëntë) vjet e 4 (katër) muaj burgim i shtetasit M.H. alias*

E.M., për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/a/2 në raport me nenin 22 të KP. Në këto rrethana, vendimi i dënimit me burgim dhënë në ngarkim të shtetasit M.H. alias E.M., është bërë i ekzekutueshëm dhe për këtë shkak, aktualisht ky shtetas është duke vuajtur dënimin me burgim pranë IEVP Fier. Është e vërtetë se vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor dhe është dënuar shtetasi shqiptar M.H. alias E.M., në shtetin shqiptar ka një cilësim të ndryshëm juridik nga ajo për të cilën është lëshuar urdhër arresti nga Gjykata e Katanias (Itali), por fakti penal është i njëjtë. Neni 7 i Konventës Evropiane të Ekstradimit të 13 Dhjetorit 1957, aderuar me ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998, parashikon se pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin e një personi që është kërkuar për një vepër penale e cila është kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj ose në një vend të përafërt me territorin e saj. Në nenin 2 të ligjit nr. 8322, datë 02.04.1998, është parashikuar se "lidhur me nenin 7, pika 1, pala shqiptare nuk lejon ekstradimin e personave që kanë kryer vepra penale në territorin shqiptar ose edhe jashtë tij, kur vepra është kryer në dëm të interesave të shtetit ose shtetasve, përveç rastit kur arrihen marrëveshje të ndryshme me palën e interesuar. Në marrëveshjen mes shtetit Shqiptar dhe atij Italian të cituar në këtë vendim, nuk është parashikuar ndonjë përcaktim ndryshe që të mund të lejojë ekstradimin edhe në këtë rast. Në dhënien e këtij vendimi Gjykata e Apelit Vlorë i është referuar dhe vendimit nr. 4, datë 05.02.2014, të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimit nr. 77, datë 19.05.2015, të Gjykatës së Lartë të cilat kanë prishur vendimin me nr. 93, datë 05.07.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kanë lënë në fuqi vendimin me nr. 279, datë 18.06.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ku kjo Gjykatë ka vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradim ndaj shtetasit E.S., në një çështje analoge. Nga sa më sipër, ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e shkallës së parë, Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se, vendimi i dënimit penal me burgim nr.69, datë 18.05.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 109, datë 31.10.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhënë në ngarkim të shtetasit M.H. alias E.M., përbën pengesë për lejimin e ekstradimit, pasi është vërtetuar një nga kushtet ndaluese të nenit 491 të KPP, prania e të cilit e ndalon gjykatën të japë ekstradimin, e konkretisht pika "c", kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri….".

13. Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, me anë të të cilit ka kërkuar*: Prishjen e vendimit nr. 225, datë 25.04.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 337, datë 21.01.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

14. Paraprakisht, Kolegji vlerëson të nevojshme të ndalet dhe të trajtojë çështjen ligjore të përbërjes së trupit gjykues, i cili duhet të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore për rastet kur nuk jep një vendim njësues ose zhvillues të praktikës gjyqësore.

15. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në Pjesën e Nëntë të saj, të titulluar "Gjykatat", në nenin 141, pika 1, parashikon se: "1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.". Ndërsa, në pikën 2 të po këtij neni parashikon se "2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.". Pra, Kushtetuta, për shqyrtimin e çështjeve, përcakton si trupa gjykues Kolegjet e Bashkuara dhe kolegjet, sipas ligjit. *Për të mbërritur në kuptimin dhe zbatimin e ligjit për sigurimin e njësimit ose zhvillimit të praktikës gjyqësore, në morinë dhe shumëllojshmërinë e çështjeve që shqyrton, Gjykata e Lartë vendoset objektivisht përpara situatave kur shqyrtimin gjyqësor nuk mund ta bëjë në dhomë këshillimi por duhet ta bëjë në seancë gjyqësore, e detyruar të zbatojë nenin 441, shkronja "c" dhe 443 të KPP, për të prishur vendimin dhe kthyer aktet për rishqyrtim. Një shembull i thjeshtë i situatave të tilla është rasti kur nga gjykatat e niveleve më të ulëta janë dhënë vendime në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara (Shkronja "c" e pikës 1, të nenit 432 të KPP). Shqyrtimi i rekurseve ndaj vendimeve të tilla dhe zgjidhja e çështjes nuk mund të bëhet në dhomë këshillimi por duhet të bëhet në seancë gjyqësore. Ndërkohë, vendimi i Gjykatës së Lartë që zgjidh një çështje të tillë nuk mund të jetë dhe as të quhet më ose përsëri njësues ose "rinjësues" për faktin e thjeshtë se një vendim njësues tashmë ekziston. E njëjta situatë krijohet edhe në rastet kur gjykatat e niveleve më të ulëta kanë dhënë vendime duke mos respektuar ose zbatuar gabim ligjin procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave (Shkronja "b" e pikës 1, të nenit 432 të KPP). Në këtë situatë, shtrohet pyetja se cila do të jetë përbërja numerike e trupit gjykues që do të shqyrtojë çështje të tilla në seancë gjyqësore? A do të jetë një trupë gjykuese e përbër**ë** nga 3 apo nga 5 gjyqtarë?*

16. Për të sqaruar përbërjen e trupave gjykues dhe kolegjeve, u referohemi ligjeve përcaktuese për organizimin e gjykatave, të trupave gjykues dhe të procedurave gjykuese dhe konkretisht, në fillim KPP, miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, të ndryshuar dhe, më pas, ligjit nr. 98, datë 6.10.2016,

"Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

17. Duke iu referuar fillimisht KPP, në ndryshimet që i janë bërë këtij Kodi, me ligjin nr. 35, datë 30.03.2017, në pikën 7 të dispozitës kalimtare, shtuar Kodit me këtë ligj, gjejmë parashikimin se, "Përbërja e trupave gjykues rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.". Pra, meqenëse kjo dispozitë referon përbërjen e trupave gjykues në KPP, le të shohim parashikimet konkrete që ky Kod përmban për trupat gjykues.

18. Në KPP gjejmë parashikimet mbi përbërjen e trupave gjykues në Gjykatën e Lartë dhe kompetencën lëndore. Në Seksionin I, ku parashikohen funksionet dhe përbërja e gjykatave, që bën pjesë në Kreun I, "Gjykatat", si pjesë e titullit, "Subjektet", gjendet neni 14/a, me titull, "Gjykata e Lartë dhe përbërja". Ky nen parashikon se, "Gjykata e Lartë shqyrton rekurset në dhomë këshillimi me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, gjykon njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara. Pra, në këtë nen gjendet e shprehur konkretisht përbërja e trupit gjykues për shqyrtimin e rekurseve në dhomë këshillimi (me tre gjyqtarë) dhe përbërja e trupit gjykues për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje (me pesë gjyqtarë). Vërehet se, as në këtë nen dhe as në ndonjë nen tjetër të KPP, nuk gjendet e parashikuar dhe e shprehur konkretisht përbërja e trupit gjykues për gjykimet në seancë gjyqësore kur Gjykata e Lartë nuk merr vendime njësuese ose zhvilluese. Ndërkohë, Gjykata e Lartë në mjaft raste gjendet përpara detyrimit për të shqyrtuar/gjykuar në seancë publike çështje/rekurse të cilat nuk përbëjnë njësim ose zhvillim të praktikës gjyqësore.

19. Për të analizuar parashikimet ligjore në fuqi të legjislacionit procedural penal, le t'u referohemi edhe formulimeve të mëparshme të KPP. Në legjislacionin procedural penal aktualisht në fuqi, konkretisht në Seksionin I, që bën fjalë për "Kompetencën lëndore", pjesë e Kreut II, "Kompetencat", të Titullit II, "Juridiksioni dhe kompetencat", neni 75/b ka këtë formulim: "Gjykata e Lartë shqyrton rekurset për shkelje të ligjit, për të siguruar njësimin, zhvillimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, si dhe ushtron kompetenca të tjera, sipas parashikimeve të këtij Kodi.". Ndërsa formulimi i mëparshëm i këtij neni, i shtuar me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002, ka qenë: *"1. Gjykata e Lartë shqyrton rekurset për shkelje të ligjit dhe kërkesat për rishikimin e vendimeve të formës së prerë. 2. Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë, me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit*". Pra, kur ka dashur ta shprehë konkretisht, legjislacioni procedural penal e ka pasur të parashikuar dhe të shprehur konkretisht përbërjen numerike të trupit gjykues (me pesë gjyqtarë), ndërsa në legjislacionin procedural penal në fuqi aktualisht nuk e gjejmë të shprehur konkretisht përbërjen numerike të trupit gjykues për shqyrtimin e çështjeve në të cilat Gjykata e Lartë jep vendime jonjësuese ose jozhvilluese, duke mos i dhënë kështu zgjidhje çështjes së shtruar nga Kolegji.

20. Për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje i referohemi një ligji tjetër në fushën e gjyqësorit që trajton përbërjen e trupave gjykues në Gjykatën e Lartë dhe pikërisht ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i cili, ashtu si edhe KPP, është një ligj që bën pjesë në ligjet të cilat, në bazë të nenit 81, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratohen me shumicë të cilësuar prej tre të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

21. Kolegji sjell në vëmendje se ligji nr. 98, datë 6.10.2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ka një seksion të veçantë për Gjykatën e Lartë dhe pikërisht Seksionin II, të titulluar "Dispozita të veçanta për Gjykatën e Lartë". Në pikën 1, të nenit 31 të këtij ligji, të titulluar "Kolegjet dhe trupat gjykues të Gjykatës së Lartë", parashikohet se: "Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ.". Në pikën 3 të po këtij neni parashikohet se "Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar për çështje penale, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. Ai gjykon në trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë." Ndërsa në vijim të po kësaj pike të po këtij neni parashikohet se: "Çështjet penale të gjykuara nga gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar gjykohen nga një trup gjykues i përbërë nga pesë gjyqtarë.". Pra, vetë ligji, për përbërjen numerike të trupave gjykues, shprehet konkretisht dhe e përcakton se Kolegji Penal gjykon me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Duke parashikuar përbërjen e trupave gjykues me pesë gjyqtarë për shqyrtimin e rekurseve ndaj vendimeve të gjykatave të posaçme, ligji i veçon këto lloj gjykimesh nga gjykimet e rekurseve ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm. Meqenëse në fjalinë e mëparshme të po kësaj pike ligji përcakton se Kolegji Penal gjykon përgjithësisht në trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, vjen si rrjedhojë logjike që shqyrtimi në seancë gjyqësore i rekurseve ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm do të bëhet nga trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Sigurisht, për çështje të cilat nuk përbëjnë njësim ose zhvillim të praktikës gjyqësore.

22. *Nga sa më sipër, pasi kjo çështje u vlerësua dhe u diskutua duke interpretuar dispozitat ligjore të mësipërme, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë u arrit në përfundimin se shqyrtimi i rekurseve në seancë gjyqësore për çështje të cilat nuk përbëjnë njësim ose zhvillim të praktikës gjyqësore, do të bëhet nga trupa gjyqësore të përbëra nga 3 (tre) gjyqtarë.*

23. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se shtetasi shqiptar M.H. *alias* E.M. është person i cili ka qenë i shpallur në kërkim ndërkombëtar për efekt të vendimit nr. SIEP 571/2017, datë 22.08.2017, të Gjykatës së Barit Itali, për kryerjen e veprës penale të "Pjesëmarrjes në organizatë kriminale me qëllim trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike", parashikuar nga neni 110 i KP dhe Ligji nr. 309/1990, të Shtetit Italian me të cilin është dënuar me 16 vite burgim.

24. Më pas, ka qenë shteti kërkues që ka hequr dorë nga kërkesa për ekstradim, për shkak të rivendosjes në afat të ankimit kundër vendimit të formës së prerë *(bëhet fjalë për fakte penale të ndodhura përpara dhe mbas vitit 2008, të ndryshme nga fakti penal për të cilin po kërkohet ekstradimi sipas urdhër arrestit nr.976/15 RGNR-1306/15 RG GIP, datë 05.02.2014, të Gjyqtarit për Hetimet Paraprake të Gjykatës së Katanias-Itali).*

25. Rezulton se, me vendimin nr. 69, datë 18.05.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 109, datë 31.10.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi me 9 (nëntë) vjet e 4 (katër) muaj burgim i shtetasit M.H. *alias* E.M., për kryerjen e veprës penale *"Trafikim i narkotikëve" kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë,* parashikuar nga neni 283/a/2 në raport me nenin 22 të KP. Në këto rrethana, vendimi i dënimit me burgim dhënë në ngarkim të shtetasit M.H. *alias* E.M., është bërë i ekzekutueshëm dhe për këtë shkak, aktualisht ky shtetas është duke vuajtur dënimin me burgim pranë IEVP Fier.

26. Referuar përmbajtjes së vendimit nr. 69, datë 18.05.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 109, datë 31.10.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, rezulton e provuar se, fakti penal për të cilin është deklaruar fajtor dhe është dënuar shtetasi M.H. *alias* E.M. nga gjykatat shqiptare *(i cili i referohet ngjarjes së datave 29 shtator dhe 1 tetor 2014)* është i ndryshëm nga ato për të cilat është lëshuar urdhër arresti nga ana e Gjyqtarit të Hetimeve Paraprake në Gjykatën e Katanias (Itali), për veprën penale "Organizatë kriminale me qëllim trafikimin e substancave narkotike" të cilat i referohen periudhës janar - tetor të vitit 2014.

27. Me vendimin nr. 109, datë 31.10.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda në Shqipëri, është dënuar me 9 vite e 4 muaj burgim, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2, 22 dhe 23 të KP për faktin penal të datës 30 shtator 2014, sipas të cilit, në këtë datë, në vendin e quajtur Rrjoll Velipojë, në afërsi të bregut është bërë kapja e 7 çantave me pako material bimor si ajo e lëndës narkotike ..., dënim i cili është duke u vuajtur në shtetin shqiptar.

28. Ekstradimi i këtij shtetasi kërkohet bazuar në urdhër arrestin nr. 976/15 RGNR-1306/15 RG GIP, datë 05.02.2014, të Gjyqtarit për Hetimet Paraprake të Gjykatës së Katanias, për veprën penale "Organizata kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike", të parashikuar nga legjislacioni penal italian, kryer nga shtetasi shqiptar M.H. (E.M.) në Itali nga janari deri në tetor të vitit 2014.

29. *Sa i përket kërkesës për ekstradim, referuar dhe vendimmarrjeve të gjykatave të faktit, Kolegji vlerëson se vendimi nr. 225, datë 25.04.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë në kundërshtim me qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Kushtetuese sa i përket parimit 'ne bis in idem', si dhe të ligjit procedural, e më konkretisht nenit 491 të KPP (shkak procedural, pengesë për ekstradim).*

30. Lidhur me parimin (*ne bis in idem), është shprehur si GJEDNJ, ashtu dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë*[35], të cilat kanë mbajtur qëndrimin se: Parimi (*ne bis in idem),* është njohur nga e drejta jonë e brendshme dhe nga e drejta ndërkombëtare penale si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga instrumentet kryesorë juridikë të brendshëm e ndërkombëtarë që rregullojnë marrëdhëniet në fushën penale si dhe përgjegjësinë për kundërvajtje. Sipas këtij parimi, "individi nuk mund të ndiqet e nuk mund të gjykohet nga juridiksionet e të njëjtit shtet për një shkelje, për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm apo është dënuar në bazë të një vendimi gjyqësor përfundimtar të ligjshëm.".[36] Pranimi i parimit të mësipërm në gjykimin dhe vendimmarrjen për një çështje penale, kërkon përmbushjen e dy kritereve që janë, ai i veprës penale "të njëjtë" me të mëparshmen dhe ai i kryerjes së saj "përsëri". Kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të saj, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Në këtë rast, është fjala kur si sjellja ashtu edhe krimi bëhen për të

[35] Vendimi nr. 5, datë 08.03.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

[36] (Vendimi i datës 14.09.1999, Dhoma (Seksioni) i III i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ankimet nr. 36855/97 dhe 41731.98).

njëjtat fakte të ndodhura në të njëjtën kohë dhe që cilësohen njëlloj nga ligji.

31. Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme, rezulton se ky parim nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dy veprat penale nuk kanë elementë të njëjtë. Nëse gjenden elementë të njëjtë, parimi *(ne bis in idem),* ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm. Sipas kuptimit të mësipërm, kur me vendim të formës së prerë është vendosur për një çështje, atëherë ajo nuk mund të gjykohet përsëri. Ky rregull është i vlefshëm edhe për të gjitha gjykatat e tjera brenda kufijve të të njëjtit juridiksion. Nga ana tjetër, parimi (*ne bis in idem*), që ndalon rigjykimin e ridënimin për të njëjtën vepër, nuk gjen zbatim në rastet kur i njëjti veprim përbën dhunim të dy dispozitave të ndryshme ligjore. Për të njëjtat shkelje mund të zhvillohen procese me karakter të ndryshëm, penal dhe disiplinor. I njëjti veprim mund të konsiderohet si në shkelje të dy ligjeve (normave) edhe në rastet kur njëri prej tyre kërkon provën e një fakti shtesë që ligji (norma) tjetër nuk e ka të nevojshme. Në këtë rast, pafajësia apo dënimi në bazë të njërit ligj nuk e përjashton ndëshkimin sipas tjetrit."[37].

32. Sa i përket çështjes objekt shqyrtimi, sipas akteve të përcjella në rrugë zyrtare nga Autoritetet Italiane të Drejtësisë, konstatohet lehtësisht se faktet për të cilat është nxjerrë urdhri i arrestit ndërkombëtar i referohen periudhës janar - tetor 2014 dhe bëjnë fjalë për përfshirjen e këtij shtetasi në dy organizata kriminale që kishin për qëllim trafikun e lëndëve narkotike midis Shqipërisë dhe Italisë, duke e identifikuar personin në fjalë edhe si një nga personat anëtarë të grupit që i kishte dhënë sasi të mëdha marijuane grupit mafioz me në krye shtetasin A.N., grupit të kryesuar nga vëllezërit M., si edhe grupit të kryesuar nga A.L.. Sipas të njëjtave akte, furnizimet me lëndë narkotike kryheshin nëpërmjet detit, dhe se gjatë këtij aktiviteti, në dy raste ishin sekuestruar edhe sasi të konsiderueshme të lëndëve narkotike. Gjithashtu, nga dokumentacioni i përcjellë si më sipër, rezultonte se shtetasi M.H. (E.M.), së bashku me persona të tjerë shqiptarë, kishte krijuar raporte me krimin e organizuar në Katania për furnizimin me sasi të mëdha marijuane si dhe transportimin e saj, fakt për të cilin autoritetet gjyqësore kanë nxjerrë edhe urdhrin e arrestit nr. 976/15 RGNR-1306/15 RG GIP, datë 05.02.2014.

33. Ndërkohë që, referuar materialeve të marra nga aktet e procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, ka rezultuar se fakti për të cilin ky shtetas është proceduar dhe vënë nën akuzë i referohet një informacioni të dërguar nga Shërbimi Informativ i

[37] (Vendimi 282 US. 299/1932) për çështjen "*Blochburger - Shteteve të Bashkuara"*.

Shtetit (Drejtoria për Narkotikët dhe Trafiqet) në datë 14.11.2013, me anë të të cilit informohej lidhur me një veprimtari kriminale në fushën e trafikimit të narkotikëve, në të cilin ishte përfshirë një grup i gjerë personash. Sipas atij informacioni, rezultonte se shtetasit F.D (...) kishin siguruar një sasi të konsiderueshme lënde narkotike (...) dhe po ndërmerrnin veprime konkrete për transferimin e sasisë së lëndëve narkotike jashtë territorit shqiptar, konkretisht në Itali.

34. Në rastin objekt gjykimi, Kolegji, vlerëson se nuk ndodhemi përpara zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar (*ne bis in idem*), sikurse arsyeton Gjykata e Apelit, përderisa nuk kemi të bëjmë me të njëjtin fakt penal, pasi fakti penal për të cilin është dënuar nga Gjykata për Krime të Rënda Tiranë nuk përfshihet në faktet penale që përbëjnë veprat penale për të cilat kërkohet ekstradimi për shtetasin M.H. *alias* E.M..

35. Edhe nga një krahasim i thjeshtë i fakteve dhe veprave penale konkrete që rëndojnë mbi të arrestuarin M.H., ka dalë e qartë se ato nuk janë të njëjta, për arsye se nga Autoritetet Italiane të Drejtësisë i arrestuari M.H. *alias* E.M. akuzohet për vepra të kryera dhe të konsumuara plotësisht, siç janë pjesëmarrja në dy organizata kriminale që kishin për qëllim trafikun e lëndëve narkotike midis Shqipërisë dhe Italisë, si dhe krijimin e raporteve me krimin e organizuar në Katania me qëllim trafikimin e narkotikëve.

36. Ndërkohë që, fakti penal për të cilin ai është deklaruar fajtor nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është një i vetëm, dhe bën fjalë për tentativën për trafikim të një sasie lënde narkotike në datën 29 shtator 2014, drejt Italisë, pra për një vepër penale e cila nuk kishte përfunduar por kishte mbetur në tentativë, dhe që është e ndryshme nga episodet për të cilat ky shtetas po procedohet në shtetin Italian.

37. Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka marrë në konsideratë praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimin nr. 143, datë 22.11.2017, ku në çështjen e ekstradimit të shtetasit të kërkuar G.G., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. akti 1023, datë 21.07.2017, ka pranuar kërkesën dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 909, datë 09.08.2017, e ka lënë atë në fuqi. Gjykata e Lartë, në vendimin nr. 00-2017-899 (143), datë 22.11.2017, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit, ka rrëzuar pretendimet e mbrojtjes, me arsyetimin se: "*... Nëse shtetasi G.G., për të cilin është lejuar ekstradimi ende po gjykohet apo është në vuajtje e sipër të një dënimi në Republikën e Shqipërisë, në parim, është Ministri i Drejtësisë, subjekti që ligji procedural shqiptar i ka njohur tagrin për të vlerësuar eventualisht pezullimin e ekzekutimit të ekstradimit, derisa gjykimi apo dënimi i personit të ketë mbaruar, apo të vendosë dorëzimin e përkohshëm të personit në fjalë, ose nëse e*

vlerëson oportune të kërkojë që dënimi i dhënë në Shqipëri të njihet apo të vijojë të ekzekutohet në shtetin kërkues, sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara nga neni 500 i KPP...".

38. Nga interpretimi sistematik i neneve 491 dhe 500 të KPP, arrihet në konkluzionin se në ato raste kur shtetasi shqiptar për të cilin është paraqitur kërkesa për ekstradim, rezulton të ketë kryer një vepër penale në territorin e shtetit shqiptar, përpara ose pas kërkesës për ekstradim, por e cila është e ndryshme nga vepra penale për të cilën është paraqitur kërkesa për ekstradim, kjo rrethanë nuk përbën pengesë për lejimin e ekstradimit, në kuptimin e nenit 491/1/c të KPP, por në këtë situatë ekstradimi në shtetin kërkues mund të pezullohet deri në përfundimin e gjykimit ose vuajtjes së dënimit penal të dhënë në shtetin shqiptar.

39. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë për rrëzimin e kërkesës për ekstradim është marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar si të Konventës Evropiane "Për ekstradimin" neni 19 e vijues të saj dhe nenit 18 të Marrëveshjes dypalëshe me shtetin Italian për zbatimin e kësaj Konvente, të neneve 489, 450 e vijues të KPP, ashtu dhe të neneve 32, 33, 41 e vijues të ligjit nr. 10193/2009.

40. *Prania e një procedimi penal apo vuajtja e një dënimi në Shqipëri nga shtetasi M.H. alias E.M. nuk duhet vlerësuar si një nga ato rrethana të cilat nuk lejojnë pranimin e një kërkese ekstradimi, por vetëm si një rrethanë e cila mund të çojë në pezullimin e ekzekutimit të një ekstradimi të pranuar nga gjykata, diskrecion ky i Ministrit të Drejtësisë. Nëse do të pranohej e kundërta, atëherë do të mbetej pa u hetuar, gjykuar apo vuajtur dënimin personi i cili ka kryer vepër penale në shtetin kërkues, për shkak të një tjetër procedimi në shtetin e kërkuar.*

41. Në përfundim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është i pabazuar si në rrethanat e faktit, ashtu dhe në kushtet dhe kriteret e akteve ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm, të analizuara, vlerësuara dhe argumentuara më sipër dhe si i tillë duhet prishur dhe duhet lënë në fuqi vendimi nr. 337, datë 21.01.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si vendim i marrë në plotësim të kushteve procedurale për pranimin e kërkesës në lidhje me ekstradimin e shtetasit shqiptar M.H. *alias* E.M., nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Italisë, për efekt të urdhër arrestit nr. 976/15 RGNR-1306/15 RG GIP, datë 05.02.2014, të Gjyqtarit për Hetimet Paraprake, të Gjykatës së Katanias (Itali).

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-6, datë 15.01.2021

Në fazën e hetimit paraprak mosmarrëveshjet ndërmjet prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm zgjidhen nga prokurori më i lartë. Në varësi të rrethanave të hetimit, do të jetë prokuroria kompetente ajo që do të disponojë në gjykatën kompetente për çdo kërkesë në fazën e hetimit paraprak, përfshirë dhe kërkesat për masat e sigurimit për shkak të humbjes së fuqisë së tyre të vendosura nga gjykata jo kompetente.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes në gjykatat më të ulëta ka rezultuar se vepra penale mund të jetë kryer në këto rrethana: Në dt. 03.12.2020, rreth orës 20 e 25, shërbimet e policisë të Komisariatit të Policisë Librazhd kanë organizuar shërbimin e tyre në vendin e quajtur "Kryqëzimi i Përrenjasit".

2. Gjatë shërbimit nga punonjësit e policisë është konstatuar se mjeti i tipit 'Benz' me targa AA....TE po vinte drejt tyre dhe i kanë bërë shenjë ndalimi. Pasi është ndaluar mjeti është konstatuar se drejtohej nga shtetasi E.H., ndërsa personi nën hetim H.Em. ishte në sediljen e pasagjerit. Në sediljen e pasme ishin ulur 3 shtetas me kombësi siriane. Pas pyetjes së personave nën hetim dhe shtetasve të huaj ka rezultuar se shtetasi H. ia kishte marrë me qira mjetin e mësipërm shtetasit K.Ll., kundrejt shumës 3.000 lekë. (...)

4. Referuar fakteve sa më sipër Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kërkuar pranë kësaj gjykate vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i KPP për shtetasit H.Em. dhe E.H. si të dyshuar për kryerjen e veprës penale "*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit*" të parashikuar nga neni 298/2 i KP.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. (5895) 1075, datë 05.12.2020, ka vendosur: Moskompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për gjykimin e kësaj çështjeje. (...) Urdhërohet dërgimi i akteve të kësaj çështjeje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. akti 349, datë 22.12.2020, ka vendosur:

Ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës tokësore, pasi çështja bën

pjesë në juridiksionin territorial të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Dërgimin e akteve Gjykatës së Lartë për t'u shprehur me vendim në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës. Vijimin e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar me vendimin nr. (5895) 1075, datë 05.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për personat nën hetim E.H. dhe H.Em.. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Prokurorisë së Rrethit Pogradec.

7. Duke arsyetuar ndërmjet të tjerash se, *"....Prokuroria paraqiti kërkesën për ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe aktet t'i dërgohen Gjykatës së Lartë për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Kjo pasi gjyqtari i hetimeve paraprake, konkretisht gjyqtari pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk ka kompetencë në këtë fazë të procedimit penal, që u përket hetimeve paraprake, që të deklarojë moskompetencën, pasi kjo kompetencë në këtë fazë i përket organit të akuzës. Po kështu parashtroi se, prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe si rrjedhim do të viheshim përpara një përplasjeje të vendimmarrjeve eventualisht të ndryshme. Gjykata vlerëson se, shpallja e moskompetencës do të deklarohet jo për arsyen e parashtruar nga prokuroria, pasi gjyqtari në fazën e hetimeve paraprake në çastin që cakton masën e sigurimit ka të drejtë të vlerësojë dhe kompetencën tokësore dhe lëndore, në të kundërt nuk do të ekzistonte nevoja që ligjvënësi të parashikonte nenin 88 në KPP. Kjo është edhe një praktikë e njohur jo vetëm në Gjykatën e Rrethit Pogradec. Gjykata vlerëson se, duhet të ngrejë mosmarrëveshjen e kompetencës tokësore në referim të nenit 89 të KPP, referuar rrethanave të faktit penal, që rezulton se personat nën hetim E.H. dhe H.Em., janë kapur në flagrancë nga punonjësit e policisë të Komisariatit të Policisë Librazhd, në kryqëzimin e Përrenjasit, duke transportuar klandestinë, shtetas të huaj me origjinë siriane, i cili përfshihet në juridiksionin territorial ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Fakti që vepra penale, pra transportimi i klandestinëve ka nisur që nga Rrethi i Korçës dhe ka vazhduar më tej në Rrethin e Pogradecit, nuk do të konsiderohet vend i kryerjes së veprës penale rrethi Pogradec, në kuptim të nenit 76//1 të KPP. Nëse vendi i kryerjes së veprës penale duhet të përcaktohet në gjithë segmentin rrugor që udhëtojnë mjetet e transportit të klandestinëve, atëherë kompetencë tokësore mund të kenë të gjitha gjykatat, prandaj ky arsyetim nuk është i pranueshëm...."*.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vëren se dispozitat e KPP, parashikojnë në mënyrë të detajuar rregullat për përcaktimin e kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës kompetente për gjykimin e themelit të çështjes si dhe të kërkesave në fazën e hetimit paraprak.

9. Konflikti për kompetencën ekziston atëherë kur dy ose më shumë gjykata konsiderojnë se kanë kompetencë lëndore apo tokësore (konflikt pozitiv) dhe në të kundërt, kur konsiderojnë se u mungon kompetenca për të vendosur lidhur me një çështje penale (konflikt negativ).

10. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec që ka rivlerësuar masën e sigurimit të vendosur më parë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka parashtruar pranë Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen ndërmjet dy gjykatave lidhur me kompetencën tokësore në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

11. Në nenin 88 të KPP parashikohet në mënyrë të shprehur për sa i përket vlefshmërisë së masave të sigurimit të marra nga gjykata jo kompetente, duke disponuar se: "masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila në të njëjtën kohë ose më vonë shpallet jo kompetente për çdo lloj shkaku, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit".

12. Në fazën e hetimit paraprak, për kompetencën tokësore të Gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, Kolegji vlerëson se duhet t'i referohemi parashikimit të nenit 76/1 të KP, sipas të cilit, kompetenca tokësore përcaktohet në radhë të parë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, ose, vendi ku ka ardhur pasoja. Në rastin në shqyrtim, vepra penale "*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit*" ka filluar në qytetin e Pogradecit (Qafë-Plloçë), nga i cili janë transportuar klandestinët me destinacion qytetin e Tiranës.

13. Duke qenë se në fazën e hetimit paraprak masa e sigurimit bazohet në ekzistencën e dyshimit të bazuar në prova, referuar faktit të mësipërm si dhe deklarimit të shtetasve sirianë (...), të cilët kanë pohuar se janë nisur nga Qafë Plloça për në Tiranë me automjetin e drejtuar nga i dyshuari E.H., duke paguar secili prej tyre nga 150 euro, kompetenca tokësore i mbetet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec si vendi ku ka filluar të kryhet vepra penale.

14. Për rrjedhojë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal për shkak të mosekzistencës së konfliktit të

kompetencës së gjykatës në këtë fazë të shqyrtimit të kërkesës së organit të prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit.

15. Nga ana tjetër, në referim të nenit 89, pika 2 të KPP, në fazën e hetimit paraprak, mosmarrëveshjet ndërmjet prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm zgjidhen nga prokurori më i lartë. Në varësi të rrethanave në hetimin e mëpasshëm të kësaj ***çështjeje do të rezultojë mungesa e kompetencës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe do të jetë prokuroria kompetente që do të disponojë në gjykatën kompetente për çdo kërkesë në fazën e hetimit paraprak, përfshirë dhe kërkesat për masat e sigurimit për shkak të humbjes së fuqisë së atyre të vendosura nga gjykata jo kompetente.***

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-483, datë 06.07.2021

Klasifikimi i veprave penale si kundërvajtje nuk mund të lidhet automatikisht me masën e dënimit me burgim që parashikon KP. Vepra "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP, përbën krim dhe jo kundërvajtje penale.

Me ndryshimet e KPP me ligjin nr. 35/2017, në rastin e procedimit për një kundërvajtje penale, vendimi i pushimit të çështjes ose akuzës merret nga prokurori dhe ankimi ndaj këtij vendimi shqyrtohet në dhomë këshillimi nga gjyqtari i seancës paraprake. Ndërsa, në rastin e procedimit për krime, pushimi i çështjes ose akuzës kërkohet nga prokurori dhe vendimi merret nga gjyqtari i seancës paraprake.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se më datë 27.08.2016 shtetasja T.S. ka paraqitur kallëzim penal për dhunën e ushtruar nga shtetasi O.O., nipi i saj (djali i motrës).

2. Organi procedues ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor. Kallëzuesja ka shkuar për të kontaktuar mjekun e përcaktuar si ekspert, por është vënë në dijeni se ai është larguar dhe në këto kushte është paraqitur pranë një mjeku-ligjor tjetër i cili ka kryer dhe aktin e ekspertimit. Akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. 155, datë 30.08.2016, ka konstatuar se tek shtetasja T.S. janë vërejtur 3 ekimoza në kofshën e majtë dhe një ekimozë në kërcirin e majtë, dëmtime këto të shkaktuara me mjet mprehtës, të cilat hyjnë në kategorinë e rrahjes, pasi kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme për punë në masën deri në 9 ditë.

3. Në kushtet kur akti i ekspertimit nuk është realizuar nga mjeku-ligjor i përcaktuar si ekspert, prokuroria e ka shpallur aktin relativisht të pavlefshëm dhe ka urdhëruar kryerjen e riekspertimit.

4. Eksperti mjeko-ligjor i caktuar për riekspertimin nuk ka arritur të realizojë aktin e ekspertimit pasi shtetasja T.S. nuk është paraqitur dhe aktualisht ndodhet jashtë shtetit.

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin e datës 17.11.2016, ka vendosur pushimin e procedimit penal në bazë të

nenit 328 pika 1, shkronja "dh" të KPP.

6. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim viktima T.S..

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1257, datë 05.01.2017, ka vendosur*: "Pranimin e ankimit. Prishjen e vendimit të datës 17.11.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për pushimin e procedimit penal nr. 1600 të vitit 2016. Urdhërohet prokuroria të vazhdojë hetimet për këtë procedim".*

8. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në përfundim të hetimeve më datë 10.03.2017, ka vendosur pushimin e procedimit penal regjistruar me nr. 1600/2016, për veprën penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP, bazuar në nenin 328/1, shkronja "f" dhe 329/a të KPP, me arsyetimin se nuk provohet që shtetasi O.O. (nipi i saj) të ketë konsumuar elementët e veprës penale "Dhuna në familje", të parashikuar nga neni 130/a/l i KP, e si rrjedhojë, nuk provohet se vepra penale është kryer nga ky shtetas.

9. Viktima T.S. ka paraqitur ankim ndaj vendimmarrjes së prokurorisë për pushimin e procedimit penal.

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 371, datë 14.02.2018, ka vendosur: "*Shfuqizimin e vendimit datë 10.03.2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan që lidhet me procedimin penal nr. 1600, dt. 01.09.2016, si një vendim që vjen në kundërshtim me ligjin...".*

11. Gjykata ka arsyetuar se prokuroria ka kryer të gjithë veprimet në *bazë të ligjit procedural penal. Marrëdhënia teze-nip nuk mund të konsiderohet për efekt të veprës penale "Dhuna në familje", si marrëdhënie e gjinisë së afërt e trajtuar nga neni 3 i ligjit 20006/9669. Veprimet e të kallëzuarit mund të përmbushin elementët e ndonjë vepre tjetër penale por do të duhej të ishin vlerësuar nga prokuroria. Gjykata nuk mund të urdhërojë formulimin e akuzave të reja gjatë fazës së hetimeve paraprake apo në përfundim të saj. Ajo gjykon akuzën e ngritur nga ana e prokurorit gjatë gjykimit në themel të saj, duke vendosur nëse qëndron ose jo akuza e ngritur. Në këto kushte, i vetmi disponim që mund të ketë gjykata, në këtë moment të procesit gjyqësor, mbetet ai për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes, meqenëse nuk ka se çfarë veprimesh të tjera hetimore të kryhen. Në këtë rast, gjykata duhet të konstatojë vetëm paligjshmërinë e vendimit te pushimit të prokurorit.*

12. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka paraqitur kërkesën për pushimin e procedimit penal me nr. rregjistrimi 1600/2016, për veprën penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP, bazuar në nenin 328/1, shkronja "f" dhe 329/a të KPP. Prokuroria, duke marrë në konsideratë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe

në kushtet kur fakti i kallëzuar nga shtetasja T.S. nuk përmban elementët e veprës penale të "Dhunës në familje", si dhe nuk ka elementë të ndonjë vepre tjetër, vendos se plotësohen kushtet për pushimin e procedimit penal.

13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2435, datë 26.06.2018, ka vendosur: "*Kthimin e akteve prokurorit duke e urdhëruar të formulojë akuzën në ngarkim shtetasit O.O. për veprën penale të "Dhunës në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP....".*

14. Gjykata, ka arsyetuar se, me ndryshimet që pësoi KPP në lidhje me vendimmarrjen në rastet e pushimin të procedimit, përcakton se nuk është më kompetencë e prokurorit, por e gjykatës e cila verifikon ligjshmërinë e hetimeve paraprake. (...)

15. Kundër vendimit ka bërë ankim prokurori, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit duke pranuar kërkesën e organit të prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. 1600, datë 01.09.2016, për veprën penale të "Dhuna në Familje", parashikuar nga neni 130/a i KP...

16. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 293, datë 03.10.2018, ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr. 2435, datë 26.06.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe pushimin e çështjes për shkak të mungesës së juridiksionit. Urdhërohet sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan të kthejë aktet prokurorit në rrugë administrative ...".*

17. Gjykata e Apelit, vlerëson se, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit, pasi gjykatës i mungon juridiksioni për të vendosur mbi pushimin e procedimit penal për kundërvajtjet penale (neni 72/1 i KPP). (...)

18. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs më datë 07.11.2018 viktima T.S., e cila ka kërkuar prishjen e vendimin nr. 293, datë 03.10.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2435, datë 26.06.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. (...)

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

19. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), vlerëson se, rekursi i viktimës T.S. është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 435 të KPP. Rekursi i është komunikuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe shtetasit O.O..

20. Kolegji, vlerëson se, neni 432 i KPP, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

21. Kolegji, çmon se, rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP, të cilat do të bënin të cenueshëm vendimin nr. 293, datë 03.10.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës pasi vendimi i gjykatës është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural.

22. Rezulton se, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan kërkesën për pushimin e procedimit penal me nr. regjistrimi 1600/2016, për veprën penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP, bazuar në nenet 328/1, shkronja "f" dhe 329/a të KPP. Gjykata e Apelit ka gabuar kur ka mbajtur qëndrimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet prishur dhe aktet i duhen dërguar prokurorit, pasi është në kompetencën e tij të vendosë në lidhje me pushimin e procedimit për një kundërvajtje penale. Gjykata e Apelit gabon në interpretimin e ligjit material, pasi arsyeton se vepra penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP, përbën kundërvajtje penale, për sa kohë parashikon dënim me burgim deri në dy vjet.

23. *Kolegji, vlerëson se, KP i Republikës së Shqipërisë është i ndërtuar duke u bazuar në frymën e parimit të ligjshmërisë, i cili ka natyrë kushtetuese. Parimi i ligjshmërisë kërkon që legjislatori të përcaktojë në mënyrë precize dënimin, sanksionin për çdo figurë të veprës penale. Sipas këtij parimi, është vetëm ligji, ai që përcakton veprat penale, sipas tipareve të specifikës, të plotësisë (përcaktimit të rasteve), dhe fuqisë jo prapavepruese, duke identifikuar të mirat juridike që duhet të mbrohen nga sanksioni penal, nëpërmjet përcaktimit të veprimeve ose mosveprimeve që i cenojnë ato. Në këto kushte, klasifikimi i veprave penale si kundërvajtje nuk mund të lidhet automatikisht me masën e dënimit me burgim që parashikon vepra penale. Në interpretim sistematik të KP, rezulton se në mënyrë taksative, Kodi, ka parashikuar se cila nga figurat e veprave penale është kundërvajtje, pa e lidhur këtë klasifikim domosdoshmërisht me masën e dënimit me burgim të parashikuar për veprën penale. Në këto kushte, ndryshe nga sa arsyeton Gjykata e Apelit Durrës, vepra "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP, përbën krim dhe jo kundërvajtje penale.*

24. Kolegji, vlerëson të theksojë se KPP, me ligjin nr. 35/2017, pësoi ndryshime thelbësore lidhur me institutin e pushimit të çështjes ose akuzës.

Konkretisht, neni 327/6/a (shtuar me ndryshimet me ligjin nr. 35/2017), parashikon se: "6. *Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori procedon si më poshtë: a) vendos pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, ose i kërkon gjykatës pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga neni 329/a i Kodit;…". Ndërsa më tej, në nenin 329/a të KPP, parashikohet se: "1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes…".*

25. Normat procedurale penale në fuqi, në mënyrën sesi janë rregulluar nuk pajtohen me normat e mëparshme të KPP. *Me ndryshimet e KPP me ligjin nr. 35/2017, në rastin e procedimit për një kundërvajtje penale, vendimi i pushimit të çështjes ose akuzës merret nga prokurori dhe ankimi ndaj këtij vendimi shqyrtohet në përputhje me nenin 329 në dhomë këshillimi nga gjyqtari i seancës paraprake. Ndërsa, në rastin e procedimit për krime, siç është dhe rasti objekt gjykimi, pushimi i çështjes ose akuzës kërkohet nga prokurori dhe vendimi merret nga gjyqtari i seancës paraprake. Aktualisht, është gjykata, e cila me dyer të mbyllura dhe në prani të palëve, në përputhje me nenin 329/b, merr në shqyrtim në seancë paraprake kërkesën e prokurorisë për pushimin e akuzës ose të çështjes.*

26. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është i pabazuar dhe çështja duhet të prishet dhe të kthehet për të vijuar gjykimi i ankimit të prokurorisë. Gjykata e Apelit duhet të shqyrtojë themelësinë dhe bazueshmërinë e pretendimeve të ngritura në ankim nga organi i akuzës.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 1, datë 01.06.2021

Gjykata e Lartë nuk ka më juridiksion fillestar për të shqyrtuar akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pasi që prej ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe nr. 35/2017, kompetencën për të shqyrtuar këto akuza penale e ka Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo gjykatë ka kompetencën lëndore për t'u shprehur edhe në lidhje me kërkesën për revokim të vendimit të pushimit, e cila do të duhet të shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake pranë kësaj gjykate.

I. Rrethanat e çështjes

1. Në datën 15.03.2008, në ambientet e ish Brigadës së Tankeve, në fshatin Gërdec, Tiranë, ku ushtronte aktivitetin e çmilitarizmit dhe çmontimit të municioneve luftarake shoqëria "A." SHPK, ndodhën një seri shpërthimesh masive që sollën pasoja të rënda. Si rezultat i kësaj ngjarjeje u shkaktua vdekja e 26 personave, plagosja e rëndë e 27 personave, plagosja e lehtë e 109 personave, dëmtime të parëndësishme në 67 persona, si dhe dëmtime të tjera të paklasifikuara të 61 personave që janë trajtuar në spitale e qendra shëndetësore. Nga kjo ngjarje u shkaktua dëm në pasuri shtetërore e private ne vlerën 2.243.843.616 lekë.

2. Në kuadër të kësaj ngjarjeje, Prokuroria e Përgjithshme regjistroi procedimin penal nr. 3, të vitit 2008, në ngarkim të të pandehurit F.M., duke e akuzuar për veprat penale "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga nenent 248 dhe 25 të KP dhe "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, me subjekt ushtarak-kuadër komandues, parashikuar nga nenet 70/2 e 2 të KP Ushtarak dhe 25 i KP, si dhe në ngarkim të të pandehurve (...)

3. Në fazën e hetimeve paraprake, Prokurori i Përgjithshëm kërkoi nga Kuvendi autorizimin për procedim penal ndaj shtetasit F.M., i cili në atë kohë ushtronte funksionin e Ministrit të Mbrojtjes dhe njëherazi deputet në legjislaturën e XVII të Kuvendit të Shqipërisë, autorizim që u dha me vendimin nr. 185, datë 16.06.2008, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

4. Me vendimin e datës 22.05.2009, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së Lartë për gjykimin e akuzave penale në ngarkim të të pandehurve (...) dhe Shoqëria "A." SHPK dhe dërgimin e çështjes në ngarkim të tyre për kompetencë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Po sipas këtij vendimi, Kolegji Penal vendosi të vazhdojë gjykimin e të pandehurit F.M. nga Gjykata e Lartë, për shkakun se ai ishte subjekt i gjykimit të akuzave penale nga ky Kolegj, konform dispozitës së nenit 141/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

6. Gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, i pandehuri F.M. u rizgjodh deputet në Kuvendin e Shqipërisë në zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në datën 28.06.2009.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 6, datë 14.09.2009, me shumicë votash ka vendosur: *"Pushimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit F.M., për shkak se ndjekja penale ndaj tij nuk mund të vazhdojë."(...)*

13. Në Prokurorinë e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është depozituar kërkesa me nr. 175 prot, datë 26.02.2021, me kërkues F.D. dhe Z.D., trashëgimtarë të viktimës E.D., i cili ka humbur jetën në moshën 7 vjeçare, në ngjarjen e datës 15.03.2008. Në kërkesë kërkohet ndjekja penale e shtetasit F.M., ish Ministër i Mbrojtjes së Shqipërisë.

14. Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit F.M., e pushuar me vendimin nr. 6, datë 14.09.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Prokuroria pretendon se ekzistojnë të gjitha shkaqet ligjore për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale ndaj shtetasit F.M., pushuar me vendimin nr. 6, datë 14.09.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. (...)

22. Në lidhje me kompetencën lëndore, prokuroria ka argumentuar se kompetencën për të shqyrtuar këtë kërkesë e ka Gjykata e Lartë, si gjykata që ka dhënë vendimin e pushimit. Duke qenë se vendimi i pushimit është dhënë nga Gjykata e Lartë dhe dosja gjyqësore ndodhet pranë kësaj gjykate, ajo ka kompetencën për t'u shprehur në lidhje me kërkesën për pushim. Në intepretim logjik të nenit 329/c të KPP, pavarësisht faktit se në përmbajtje të dispozitës përmendet gjyqtari i seancës paraprake, kërkesa për revokimin e vendimit të pushimit, duhet të paraqitet në gjykatën që ka dhënë vendimin e pushimit, pasi mundësia e rifillimit të ndjekjes penale parashikohej edhe në legjislacionin në kohën e dhënies së vendimit, në nenin 292 të KPP ekzistues, ku nëse do të paraqitej një kërkesë e tillë, do të shqyrtohej nga gjykata që kishte dhënë vendimin.

23. Megjithatë, pavarësisht qëndrimit që do të mbajë Gjykata e Lartë lidhur me kompetencën për shqyrtimin kërkesës në themel, prokuroria ka parashtruar se kjo gjykatë ka kompetencën për të verifikuar elementët e nevojshëm proceduralë formalë të kërkesës për revokimin e vendimit për pushimin e çështjes, ka kompetencën për të vlerësuar bazueshmërinë në ligj nga ana formale procedurale të kërkesës, duke pranuar nga ana formale shqyrtimin e saj. Vlerësimi i kompetencës lëndore të Gjykatës së Lartë për t'u shprehur lidhur me themelin e kërkesës, lidhet me një moment më të mëvonshëm procedural, pas pranimit të kërkesës për shqyrtim.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

24. Së pari, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) thekson se, para se të marrë në shqyrtim kërkesën në aspektin material, fillimisht duhet të vlerësojë ligjin procedural të zbatueshëm në çështjen objekt gjykimi, përbërjen e trupit gjykues, mënyrën e gjykimit të kërkesës penale si dhe të vlerësojë nëse ka apo jo kompetencë lëndore, në shqyrtimin e kërkesës, referuar ligjit të zbatueshëm.

25. Fillimisht, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë, për shqyrtimin e kësaj kërkese penale do t'u referohet dispozitave procedurale penale të gjykimit në shkallë të parë, konkretisht atyre që rregullojnë veprimtarinë e gjyqtarit të seancës paraprake. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se ligji i zbatueshëm në lidhje me kërkesën objekt gjykimi është Kodi i Procedurës Penale i ndryshuar me ligjin nr. 35, datë 30.03.2017 dhe me ligjin nr. 41, datë 23.3.2021. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk është parashikuar ndonjë dispozitë kalimtare, e cila të rregullonte ligjin procedural të zbatueshëm për çështjet penale që kishin nisur para hyrjes në fuqi të ndryshimeve. Parimi i përgjithshëm i të drejtës procedurale (*tempus regit actum)* përcakton se ligji i zbatueshëm është ligji që është në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes penale. Për këto arsye, kërkesa për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale do të rregullohet nga ligji procedural që është në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, që është neni 329/c i Kodit të Procedurës Penale, ndryshuar me ligjin nr. 35, datë 30.03.2017 dhe me ligjin nr. 41, datë 23.3.2021, që parashikon: *"1. Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj. Kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës. 2. Kërkesa shoqërohet me provat e reja me pasojë mospranimi. 3. Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi.*

Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet.

4. Në përfundim të hetimeve, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 406/a ose 406/dh, të këtij Kodi, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq."

26. Në vijim, Kolegji vlerëson të nevojshme të ndalet dhe të trajtojë çështjen ligjore të përbërjes së trupit gjykues i cili duhet të shqyrtojë çështjen. Duke i'u referuar Kodit të Procedurës Penale, në ndryshimet që i janë bërë këtij Kodi, me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, në pikën 1 të dispozitës kalimtare, gjejmë parashikimin se: *"Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera."* Pra, meqenëse kjo dispozitë referon përbërjen e trupave gjykues në Kodin e Procedurës Penale, le të shohim parashikimet konkrete që ky Kod bën për trupat gjykues.

27. Në Kodin e Procedurës Penale gjejmë parashikimet mbi përbërjen e trupave gjykues në Gjykatën e Lartë dhe kompetencën lëndore. Në Seksionin I, ku parashikohen funksionet dhe përbërja e gjykatave, që bën pjesë në Kreun I "Gjykatat", si pjesë e Titullit "Subjektet", gjendet neni 14/a, me titull "Gjykata e Lartë dhe përbërja". Ky nen parashikon se: *"Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara."*. Pra, në këtë nen gjendet e shprehur konkretisht përbërja e trupit gjykues për shqyrtimin e rekurseve në dhomë këshillimi (me tre gjyqtarë) dhe përbërja e trupit gjykues për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje (me pesë gjyqtarë).

28. Gjithashtu, përbërja e trupit gjykues do të përcaktohet referuar objektit të kërkesës objekt gjykimi. Neni 329/c/3 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: "*Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi. Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet.*". Vetë dispozita e zbatueshme parashikon se kërkesa për pushimin e procedimit penal revokohet në dhomë këshillimi nga gjyqtari i seancës paraprake, që në interpretim të dispozitave është gjyqtari i seancës paraprake që ka disponuar për vendimin e pushimit. Kolegji vlerëson se ndodhemi në një situatë të pazakontë procedurale, pasi sipas ligjit procedural në fuqi vendimi i pushimit dhe rrjedhimisht dhe i revokimit të vendimit të pushimit, është kompetencë e gjyqtarit të seancës paraprake, ndërsa vendimi i pushimit për të cilin kërkohet revokimi është marrë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me

trupë prej pesë gjytarësh, si gjykata që kishte kompetencën lëndore dhe funksionale në kohën e marrjes së vendimit, por që vepronte si gjykatë e juridiksionit fillestar, duke e gjykuar çështjen në shkallë të parë.

29. Kolegji Penal vlerëson se gjykimi i kërkesës në dhomë këshillimi përcaktohet shprehimisht nga neni 329/c i KPP, prandaj kërkesa objekt gjykimi do të shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi. Ndërkohë në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, kjo rregullohet nga parashikimi i nenit 14/a të KPP sipas të cilit: *"Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë."*. Pavarësisht se në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë me një rekurs, por me një kërkesë për revokim të vendimit të pushimit, Kolegji vlerëson se në kushtet kur shqyrtimi prej tij në dhomë këshillimi bëhet nga një trupë prej tre gjyqtarësh, edhe kërkesa objekt gjykimi do të shqyrtohet në dhomë këshillimi me tre gjyqtarë.

30. Kolegji Penal vlerëson se ky përfundim rezulton nga leximi i nenit 329/c të KPP që rregullon kërkesën për revokim vendimi pushimi në raport me dispozitat që rregullojnë mënyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Pavarësisht se vendimi i pushimit për të cilin kërkohet revokimi i pushimit është marrë nga një trupë prej pesë gjyqtarësh, sepse kështu rregullohej nga ligji i zbatueshëm i kohës, aktualisht sipas ligjit procedural në fuqi, kjo kërkesë shqyrtohet në dhomë këshillimi. Nga ana tjetër, shqyrtimi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë bëhet nga një trupë prej tre gjyqtarësh, ndërsa me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë shqyrtohet njësimi dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore.

31. Bazuar në argumentimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se kërkesa për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit F.M., e pushuar me vendimin nr. 6, datë 14.09.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi nga një trupë e përbërë prej tre gjyqtarësh.

32. Në vijim, Kolegji Penal çmon të ndalet në verifikimin e një parakushti të rëndësishëm procedural për të marrë në shqyrtim kërkesën objekt gjykimi, që është ai i kompetencës lëndore.

33. Kolegji rikonfirmon qëndrimin se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia ose masa e juridiksionit që i është dhënë çdo gjykate në ushtrimin e funksioneve të saj. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet

nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të sistemit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt *(shih vendimin nr. 917, datë 11.05.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë)*.

34. Rezulton se procedimi penal për të cilin është vendosur pushimi është procedimi nr. 3, i vitit 2008. Në kohën e regjistrimit dhe shqyrtimit të këtij procedimi penal nga Gjykata e Lartë, sipas nenit 73/2 të Kushtetutës së Shqipërisë, parashikohej: *"Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit. Autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohet."*. Sipas kësaj dispozite kushtetutese, një person nuk mund të ndiqej penalisht nëse ai provonte ekzistencën e dy kushteve. Së pari, që ai ishte i zgjedhur deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe së dyti, Kuvendi nuk kishte lëshuar autorizim për ndjekjen penale të tij. Gjithashtu, neni 288/1 i KPP parashikonte: *"Kur parashikohet autorizimi për procedim, prokurori bën kërkesë në organin* përkatës.", duke përcaktuar prokurorinë si organin kompetent për të kërkuar dhe marrë autorizim nga Kuvendi.

35. Nga ana tjetër, neni 73/2 i Kushtetutës, ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.9.2012 dhe me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, që është dispozita në fuqi, parashikon: *"Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdolloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit."*.

36. Neni 288/1 i KPP parashikon: *"Kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi."*.

37. Neni 329/c i KPP parashikon: "*Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj. Kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës."*

38. Në kohën e dhënies së vendimit nr. 6, datë 14.09.2009, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, neni 141 i Kushtetutës parashikonte: *"Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese."*. Ndërkohë, rezulton se aktualisht neni 135 i Kushtetutës, ndryshuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, parashikon: *"Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër*

Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.".

39. Edhe neni 75/a i KPP, i ndryshuar me ligjin nr. 41/2021, parashikon se: *"Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të KP; b) çdo vepër penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të KP; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.".*

40. Referuar kuadrit ligjor të mësipërm, Kolegji vlerëson se *Gjykata e Lartë nuk ka më juridiksion fillestar për të shqyrtuar akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pasi që prej ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe nr. 35/2017 kompetencën për të shqyrtuar këto akuza penale e ka Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*. Gjithashtu, referuar ndryshimeve që ka pësuar neni 329/a e vijues i KPP, *rezulton se kërkesa për pushim si dhe revokimi i vendimit të pushimit janë kompetencë e gjyqtarit të seancës paraprake. Duke qenë se kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes penale në themel e ka Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Kolegji vlerëson se kjo gjykatë ka kompetencën lëndore për t'u shprehur edhe në lidhje me kërkesën për revokim të vendimit të pushimit, e cila do të duhet të shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake pranë kësaj gjykate.*

41. Kolegji e gjen të pabazuar arsyetimin e paraqitur nga prokuroria se Gjykata e Lartë ka kompetencën lëndore të shprehet për kërkesën meqenëse vendimi i pushimit është dhënë prej kësaj gjykate. Kolegji vë

në dukje se që nga dhënia e vendimit nr. 6, datë 14.09.2009, ka ndryshuar në mënyrë thelbësore kuadri kushtetues dhe ligjor duke bërë që Gjykata e Lartë të mos ketë më juridiksion fillestar për akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë. Kompetencën në lidhje me shqyrtimin e akuzave penale ndaj këtyre subjekteve e ka Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila do të duhet të shqyrtojë edhe kërkesën objekt gjykimi.

42. Gjithashtu, Kolegji vëren se që prej momentit që ka rënë pengesa për ushtrimin e ndjekjes penale ndaj subjektit F.M., prokuroria nuk ka pasur ndonjë pengesë që të ushtronte funksionin e saj si përfaqësues i akuzës, konform ligjit, situatë procedurale kjo e transferuar si kompetencë te Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

43. Kolegji e gjen të pabazuar edhe argumentimin e prokurorisë se Gjykata e Lartë është kompetente për shqyrtimin e kërkesës meqenëse në këtë gjykatë ndodhet dosja. Vendndodhja e dosjes penale fizikisht në një gjykatë, nuk është kriter përcaktues për kompetencën lëndore të një gjykate, aq më tepër kur ligji parashikon shprehimisht të kundërtën.

44. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë nuk ka kompetencë lëndore për të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me objekt revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit F.M., e pushuar me vendimin nr. 6, datë 14.09.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, prandaj Kolegji vendos të shpallë moskompetencën lëndore dhe t'ia dërgojë aktet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-492, datë 06.07.2021

Parimi i përgjithshëm që çdo provë paraqitet në prani të të akuzuarit gjatë një seance publike, sipas parimit të kontradiktoritetit dhe në respektim të 'barazisë së armëve', është pjesë e procesit të rregullt ligjor me qëllim që të mundësohet paraqitja e argumenteve dhe një baraspeshë e drejtë mes palëve si në fushën civile ashtu edhe në atë penale.

Gjykata e apelit është gjykatë ligji dhe fakti, që do të thotë se ajo në përgjigje të shkaqeve të ankimit, ka detyrimin të çmojë provat dhe ligjin, për të konkluduar në lidhje me ekzistencën e faktit penal dhe fajësinë e të pandehurit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga gjykimi i çështjes me procedurën e gjykimit të zakonshëm ka rezultuar se në datën 04.12.2014, është paraqitur pranë shërbimeve policore shtetasja E.Z. e cila është me detyrën e menaxheres së shoqërisë I.M.S. Group SHPK. Ajo ka paraqitur një kallëzim penal ndaj të pandehurit R.J., administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë "A." SHPK, ndodhur në Bajram Curri -Tropojë, duke kallëzuar se ajo dhe bashkëshorti i saj A.Z., kanë hyrë në një marrëdhënie juridike me të pandehurin, i cili kishte në pronësi një stabiliment në qytetin e Bajram Currit, që merrej me grumbullimin dhe tregtimin e gështenjave. I pandehuri i ka propozuar shitje të kuotave të shoqërisë së tij "A." SHPK, përkundrejt investimeve që shoqëria IMS Group SHPK do të bënte në shoqërinë "A." SHPK, për përpunimin dhe grumbullimin e gështenjave. Duke e parë si biznes me interes, kallëzuesja i ka propozuar përfaqësueses ligjore të shoqërisë I.M.S Group SHPK, E.B., të investonin në këtë shoqëri, çka është mbështetur nga kjo e fundit. Në funksion të këtij qëllimi, kallëzuesja ka mbajtur marrëdhëniet e biznesit me të pandehurin ndërkohë që kontratat në lidhje me këtë veprimtari janë nënshkruar nga i pandehuri dhe përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë E.B., Gj.P., të cilët kanë shprehur vullnetin e tyre para noterit. Sipas kallëzueses, në zhvillim të aktivitetit me objektin si më sipër, i pandehuri R.J., nëpërmjet shpërdorimit të besimit, fiktivitetit dhe mashtrimit, ka vjedhur një shumë prej 9 082 652 lekë, që është shuma e pakthyer prej të pandehurit ndaj Shoqërisë IMS Group SHPK, e në të njëjtën kohë përbën edhe faktin penal, objekt të shqyrtimit gjyqësor.

7. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi kallëzimin e shtetases E.Z., ka regjistruar procedimin penal në lidhje me faktin penal të "mashtrimit", me pasoja të rënda. Pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe procedurale, është regjistruar edhe emri i personit që i atribuohet fakti penal, i pandehuri R.J., duke e akuzuar atë për veprën penale të "Mashtrimit", kryer me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/2 i KP.

8. Organi i akuzës, në datë 27.03.2015, ka marrë vendim për caktimin e ekspertëve për kryerjen e një akti ekspertimi kontabël, vendim i cili i është njoftuar mbrojtësit të personit nën hetim. Prokuroria ka paraqitur para gjykatës së shkallës së parë aktin e ekspertimit kontabël, datë 06.04.2015, nga ku bëhet me dije se shuma e parave që IMS Group SHPK i ka dhënë shtetasit R.J. është gjithsej 19.654.000 lekë, nga të cilat ajo ka marrë (duke përfshirë edhe 55.000 euro që i ka tërhequr nga Raiffeisen Bank) 10.571.348 lekë. Shuma e pakthyer ndaj IMS Group SHPK është 9.082.652 lekë. Gjithashtu, sipas aktit arrihet në konkluzionin se shuma e likuiduar nga blerësit e produktit gështenjë në favor të "A." SHPK është gjithsej 156.792 euro, duke ekzistuar në këtë mënyrë mundësia financiare për shlyerjen e detyrimit ndaj IMS Group SHPK. Nga dokumentacioni i dërguar nga Raiffeisen Bank, rezulton se ky shtetas gjatë periudhës 08 tetor - 21 nëntor 2014, ka *tërhequr cash* nga Banka Raiffeisen, mbi 154.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro, të cilat kanë qenë likuidimet e klientëve që i kanë blerë gështenjat, ndërkohë që i ka kthyer kallëzueses 70.000 euro.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 956 datë 30.03.2016, ndër të tjera ka vendosur: *"Deklarimin fajtor të të pandehurit R.J. për kryerjen e veprës penale "Mashtrimi" dhe në bazë të nenit 143/2 të KP e dënon atë me 10 vjet burgim."*.

14. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1384, datë 22.05.2018, ka vendosur: *"Prishjen e vendimit penal nr. 956, datë 30.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues."*.

15. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se, pasi shqyrtoi shkaqet e ankimit të paraqitur, rrethanat në tërësi të çështjes dhe argumentet e vendimit gjyqësor, konkludon se shkaqet e parashtruara në ankim janë të bazuara në ligj pjesërisht. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, objekt ankimi, nuk është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, e si i tillë ka vend të cenohet. Rezulton se, vendimi i organit të akuzës për caktimin e ekspertit nuk i është njoftuar të pandehurit R.J.. I pandehuri nuk ka pasur dijeni mbi vendimin e caktimit të ekspertëve,

nuk i janë bërë të ditura të drejtat që ka si person nën hetim, në lidhje me të drejtën për të propozuar ekspertë, për të marrë pjesë vetë në kryerjen e ekspertimit, për t'iu parashtruar pyetje ekspertëve apo për të kërkuar përjashtimin e tyre nga ekspertimi. Ka rezultuar se ekspertët nuk e kanë kontaktuar të pandehurin dhe nuk kanë marrë dhe nuk kanë kërkuar ndonjë informacion nga i pandehuri.

18. Gjatë rigjykimit, në respektim të plotë të një procesi të rregullt ligjor, gjykata e shkallës së parë duhet të çmojë ligjërisht provat dhe më pas të konkludojë nëse jemi para konsumimit të elementëve të veprës penale të "Mashtrimit", apo të një konflikti civil midis kallëzuesve dhe të pandehurit në proces, nisur dhe nga konkluzioni i ekspertimit që nuk i është njoftuar të pandehurit në proces e i cili përcakton se shuma e likuiduar nga blerësit e produktit gështenjë në favor të "A." SHPK është gjithsej 156.792 euro, duke ekzistuar në këtë mënyrë mundësia financiare për shlyerjen e detyrimit ndaj IMS Group SHPK. Nga dokumentacioni i dërguar nga Raiffeisen Bank, rezulton se ky shtetas gjatë periudhës 8 tetor - 21 nëntor 2014, ka tërhequr *cash* nga Banka Raiffeisen, mbi 154.000 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë) euro, të cilat kanë qenë likuidimet e klientëve që i kanë blerë gështenjat, ndërkohë që i ka kthyer kallëzueses 70.000 euro. Veç të tjerash, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh të drejtën kushtetuese të çdo shtetasi, parashikuar në nenin 27 pika 3 të Kushtetutës: *"Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor"*.

19. Ndaj këtij vendimi, ka ushtruar rekurs në datën 03.07.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, me anë të së cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit penal nr. 1384, datë 22.05.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 956, datë 30.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit R.J. për veprën penale të "Mashtrimit", parashikuar nga neni 143/3 i KP dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim.*

21. Ndaj këtij vendimi, ka ushtruar rekurs në datën 28.06.2018, i gjykuari R.J., me anë të së cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit penal nr. 1384, datë 22.05.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të gjykuarit R.J..*

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

23. Paraprakisht, vlen të evidentohet fakti i ndryshimeve ligjore që ka pësuar KPP me ligjin nr. 41, hyrë në fuqi në datën 29.05.2021. Në nenin 38 të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore parashikohet se:

"1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre". Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

24. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), vlerëson se, rekursi nga prokuroria dhe nga i gjykuari është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të KPP (sipas parashikimit të kësaj dispozite në kohën e depozitimit të rekurseve). Rekursi i të gjykuarit R.J. është nënshkruar prej tij dhe mbrojtësit së tij. I gjykuari R.J. dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë janë njoftuar për rekurset respektive.

25. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikes gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

26. Kolegji vë në dukje se, pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në të gjitha rastet, kur rekursi nuk u përmbahet shkaqeve të përcaktuara nga neni 432/1 i KPP, Kolegji Penal vendos mospranimin e rekursit. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

27. Në lidhje me rekursin e paraqitur nga prokuroria, Kolegji vlerëson se ai përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP, prandaj çmon se vendimi nr. 1384, datë 22.05.2018, i Gjykatës së Apelit Tiranë, duhet prishur dhe çështja duhet kthyer për rigjykim pranë asaj gjykate, me tjetër trup gjykues. Kolegji, vlerëson se, gjykata e apelit ka zbatuar gabim ligjin procedural penal, konkretisht nenin 428 pika '1', shkronja 'ç' të KPP,

e lidhur me nenin 178 e vijues të tij, ku parashikohet ekspertim, si një nga provat e procesit penal. Nga aktet e fashikullit të gjykimit, rezulton se të pandehurit R.J. nuk i janë cenuar të drejtat procedurale dhe as procesi i rregullt ligjor, ndryshe nga çfarë ka vendosur gjykata e apelit. Gjithashtu, nuk rezulton që të jenë cenuar të drejtat procedurale të të gjykuarit R.J., të tilla që të shkaktonin shkelje të procesit të rregullt ligjor as në gjykimin në shkallë të parë.

28. Shkaku për të cilin është prishur vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe është dërguar çështja për rigjykim nga gjykata e apelit, është mosnjoftimi i vendimit për caktimin e ekspertëve dhe akti i ekspertimit të pandehurit R.J.. Nga verifikimi i akteve të përfshira në fashikullin e gjykimit, rezulton se mbrojtësi i të pandehurit R.J. është njohur me vendimin 'Për caktim eksperti', në datë 27.03.2015, dhe nuk rezulton që ai të ketë pasur pretendime në lidhje me ekspertët. Gjykata e apelit ka arsyetuar se, i pandehuri nuk ka pasur dijeni mbi vendimin e caktimit të ekspertëve dhe nuk është njohur me konkluzionet e aktit të ekspertimit, duke iu cenuar në këtë mënyrë procesi i rregullt ligjor. Kolegji, e gjen të pabazuar këtë përfundim të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe jo në përputhje me provat që ndodhen në fashikullin hetimor.

29. Rezulton se, në bazë të nenit 179 të KPP, organi procedues i ka komunikuar vendimin për caktimin e ekspertëve dhe kryerjen e ekspertimit kontabël avokatit mbrojtës (...) në datën 27.03.2015 (shiko faqen 190-191 të dosjes hetimore), duke e njoftuar njëkohësisht edhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e ekspertit dhe të marrë pjesë në ekspertim etj.,. Nga ana tjetër, konkluzionet e aktit të ekspertimit si dhe të gjitha provat e tjera, i janë komunikuar të pandehurit së bashku me aktin e njoftimit të akuzës (shiko faqen 175-183 të dosjes hetimore). Gjithashtu, i pandehuri është njohur me aktin e ekspertimit kontabël dhe përfundimet e tij, pasi rezulton se ka nënshkruar procesverbalin datë 07.04.2015, për njohjen me aktet e procedimit penal në ngarkim të tij. Në lidhje me këtë akt të ekspertimit, nuk rezulton se i pandehuri gjatë gjykimit në shkallë të parë të ketë parashtruar pretendime në lidhje me rezultatet e arritura. Çdo provë i është nënshtruar debatit gjyqësor dhe i pandehuri R.J. ka pasur të gjithë mundësitë dhe hapësirën procedurale për të kundërshtuar si rezultatin e aktit të ekspertimit, ashtu edhe paraqitjen e provave të kundërta. Ai është mbrojtur nga një mbrojtës i besuar, i zgjedhur personalisht prej tij, ndaj, Kolegji nuk konstaton as cenim të së drejtës së mbrojtjes. Të gjitha pretendimet në lidhje me aktin e ekspertimit i pandehuri i ka ngritur si shkaqe ankimi pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

30. *Kolegji vë në dukje se, pjesë e procesit të rregullt ligjor është dhe parimi i përgjithshëm që çdo provë paraqitet në prani të të akuzuarit gjatë një seance publike, sipas parimit të kontradiktoritetit dhe në respektim të 'barazisë së armëve', me qëllim që të sigurohet dhe të mundësohet paraqitja e argumenteve nga pala kundërshtare. 'Barazia e armëve' është një prej elementëve të pandashëm nga nocioni i procesit të rregullt. Ajo kërkon që secilës palë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për t'i parashtruar argumentet e veta në kushte të cilat nuk e vënë atë në një situatë të pavolitshme në krahasim me kundërshtarin e vet (Foucher kundër Francës, § 34; Bulut kundër Austrisë; Bobek kundër Polonisë, § 56; Klimentyev k. Rusisë, § 95). Ajo kërkon që të ruhet një baraspeshë e drejtë midis palëve dhe zbatohet po aq në fushën civile sa edhe në atë penale.*

31. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), në jurisprudencën e saj ka theksuar se, e drejta për një proces me ballafaqim, nënkupton në parim që palëve t'u jepet mundësia për të marrë dijeni e për të bërë komente për të gjitha provat e paraqitura dhe të gjitha vërejtjet e parashtruara, me synimin për të ndikuar mbi vendimin e gjykatës. Ajo është e lidhur ngushtë me parimin e barazisë së mjeteve dhe, ç'është e vërteta, GJEDNJ ka dalë nganjëherë në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1, duke i shqyrtuar së bashku të dyja nocionet.

32. Duke pasur në konsideratë parimet e mësipërme, Kolegji, çmon se, në çështjen objekt gjykimi nuk rezulton që të gjykuarit R.J. t'i jetë cenuar procesi i rregullt ligjor dhe asnjë nga elementët e kësaj të drejte. I gjykuari është përfaqësuar nga mbrojtësi i tij në të gjitha shkallët e gjykimit, ku ka pasur mundësi të njihet me aktet e provat e paraqitura nga organi i akuzës, ka debatuar mbi to, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. I pandehuri, gjithashtu ka pasur një mbrojtje efektive në të gjitha shkallët e gjykimit. Nuk rezulton që të pandehurit t'i jetë cenuar ndonjë nga të drejtat e procesit të rregullt ligjor.

33. Gjykata e apelit, në argumentimin e saj thekson se, fakti që vendimi për caktimin e ekspertit nuk i është komunikuar të pandehurit, cenon të drejtat e tij dhe standardet e një procesi të rregullt ligjor. Ndërkohë që lë si detyrë për gjykatën e shkallës së parë, 'të çmojë ligjërisht provat dhe më pas të konkludojë nëse jemi para konsumimit të elementëve të veprës penale të 'mashtrimit' apo para një konflikti civil midis kallëzuesve dhe të pandehurit në proces'. Në lidhje me këtë konstatim, Kolegji së pari thekson se, *gjykata e apelit është gjykatë ligji dhe fakti, që do të thotë se ajo në përgjigje të shkaqeve të ankimit, ka detyrimin të çmojë provat dhe ligjin, për të konkluduar në lidhje me ekzistencën e faktit penal dhe fajësinë e të pandehurit.*

34. Së dyti, neni 428 pika '1', shkronja 'ç' e KPP, parashikon rastet kur gjykata e apelit mund të cenojë/të prishë vendimin e shkallës së parë. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon: "*Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos: (...) ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në* çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij, ose përfaqësuesit të viktimës akuzuese, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit". Në rastin konkret, gjykata e apelit ka referuar si shkak për cenimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, nenin 179 të KPP, 'caktimi i ekspertit', duke vlerësuar se jemi në shkelje të rregullave procedurale.

35. Kolegji, gjen me vend të theksojë se, ligjvënësi nuk ka sanksionuar me pavlefshmëri çdo shkelje të rregullave procedurale. Në rastin konkret, neni 179 që citon gjykata e apelit, në pikën '1' të tij, vetëm fjalia e dytë parashikon: '*kur ekspertimi shpallet i pavlefshëm ...*', që në vlerësim të këtij Kolegji, referon në rastet e pavlefshmërisë relative, për kundërshtimin e të cilave ligji procedural penal parashikon afate taksative të cilat nuk mund të zgjaten (pika 5 e nenit 129 KPP, ku për pavlefshmëritë që lidhen me akte të hetimit paraprak ligji parashikon se duhen kundërshtuar para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor). Ndërkohë, pika '2' e nenit 179 të KPP, që rregullon procedurën e njoftimit të të pandehurit me vendimin për caktimin e ekspertit, nuk parashikon asnjë pasojë procedurale në rast të mosrespektimit të kësaj dispozite. Kjo nuk do të thotë se prokuroria nuk duhet të zbatojë këtë detyrim ligjor të saj, pasi njoftimi i çdo akti, përfshi aktin e ekspertimit të pandehurit, ka rëndësi në funksion të realizimit të një mbrojtjeje efektive.

36. Duke u kthyer në rastin konkret, siç u theksua edhe më lart, si vendimi për caktimin e ekspertit, ashtu edhe akti i ekspertimit i janë komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Gjatë gjykimit të çështjes penale në shkallë të parë, i pandehuri ka pasur kohën dhe mundësitë për të kundërshtuar konkluzionet e aktit të ekspertimit, madje në seancë gjyqësore të datës 15.10.2015, ai është shprehur dakord me provat e paraqitura nga prokuroria, duke kërkuar vetëm thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve. Kolegji, çmon se, në kushtet kur gjykata e apelit ka vlerësuar me rëndësi aktin e ekspertimit dhe mënyrën e caktimit të ekspertëve, mund të dispononte për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, në përputhje

me pikën 3 të nenit 427 të KPP (duke pyetur ekspertët apo duke disponuar për ripërsëritjen e aktit, nëse e çmon të nevojshme). Në analizë të rasteve të parashikuara në nenin 428, pika '1', shkronja 'ç' të KPP, Kolegji çmon se, secila nga shkeljet që përcaktohen në këtë dispozitë, referon tek rastet e pavlefshmërisë absolute (neni 128/a i KPP), të cilat konstatohen edhe kryesisht nga gjykata, si dhe në dispozitat e veçanta ku është parashikuar pavlefshmëria e vendimit. Në rrethanat e parashtruara, Kolegji vlerëson se, rekursi i prokurorisë është i drejtë, e si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit duhet prishur për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit procedural.

37. Kolegji, çmon se, gjykata e apelit në rigjykim duhet të rishqyrtojë çështjen brenda shkaqeve të ankimit (sipas pikës 1 të nenit 425 të KPP). Në këtë moment, vlerësohet me rëndësi edhe fakti i ndryshimit që ka pësuar neni 143 i KP. Rezulton se në kohën e shqyrtimit të rekursit, neni 143 i KP, që është dispozita që parashikon veprën penale të mashtrimit, ka ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 30.3.2017. Neni 3/3 i KP parashikon se, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Zbatimi i ligjit penal favorizues është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton çështjen.

38. Në lidhje me rekursin e paraqitur nga i gjykuari R.J., Kolegji Penal vlerëson se, asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk u referohet shkaqeve të rekursit të parashikuara nga 432 i KPP. Kolegji, vlerëson se, pretendimi i ngritur në rekurs në lidhje me pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit, është i pabazuar referuar shkaqeve të argumentuara më lart. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga rekursuesi, ato i referohen mënyrës së vlerësimit të fakteve dhe provave, çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

39. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, duhet vendosur prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimi i çështjes për rigjykim, në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-514, datë 12.07.2021

Në kushtet e gjykimit të shkurtuar, nuk mund të bëhet ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale në një vepër më të rëndë për të pandehurin. Në të kundërt, çështja mund të gjykohet në kushtet e gjykimit të shkurtuar nëse si pasojë e zbatimit edhe të kësaj procedure të posaçme gjykimi kemi ndryshim të cilësimit juridik të veprës penale me pasojë lehtësimin e pozitës së të pandehurit.

Nga ana subjektive, që të jemi para veprës penale të "Vrasjes me dashje", veprimet e autorit duhet të kryhen me dashje direkte, me qëllim vdekjen e personit. Për këtë arsye, duhet të ekzistojnë njëkohësisht si momenti intelektual, pra parashikimi se veprimet e ndërmarra do të shkaktojnë vdekjen, ashtu edhe elementi volitiv i dëshirimit nga autori i ardhjes së kësaj pasoje.

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka dërguar për gjykim çështjen penale nr. 180, datë 04.02.2012, në ngarkim të të pandehurit L.R., duke e akuzuar për kryerjen e veprave penale të "Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese" mbetur në tentativë dhe "Shkatërrim i pronës me zjarr", parashikuar nga nenet 79/ë-22 e 151/2 të KP.

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i ka njoftuar të pandehurit L.R. akuzën për veprat penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese" mbetur në tentativë dhe "Shkatërrim i pronës me zjarr", parashikuar nga nenet 79/ë-22 e 151/2 të KP. Gjykimi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, ku mbrojtja e të pandehurit ka kërkuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese" mbetur në tentativë në "Plagosje të lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i KP.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 815, datë 28.12.2012, ndër të tjera ka vendosur: *"Deklarimin fajtor të të pandehurit L.R. për kryerjen e veprës penale të "Shkatërrimit pronës me zjarr", parashikuar nga neni 151/2 i KP dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 4 vjet e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPP, dënimin përfundimisht të pandehurit L.R. me 3 vjet burgim. Pushimin e çështjes për veprën penale "Plagosje e lehte me dashje", parashikuar nga neni 89 i KP për shkak se vepra penale është amnistuar."*.

10. Për sa i përket veprës penale "Plagosje e lehtë me dashje", gjykata çmon se çështja penale në ngarkim të tij duhet të pushohet pasi vepra penale është amnistuar. Gjykata çmon se akuza për veprën penale "Shkatërrim i pronës me zjarr", provohet se është konsumuar nga i pandehuri L.R..

11. Ndaj këtij vendimi, ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet të cilit ka kërkuar ndryshimin e vendimit, duke deklaruar fajtor të pandehurin L.R. për veprat penale sipas akuzës së ngritur nga prokuroria.

12. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 378, datë 11.07.2013, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit penal nr.(11-2012-9236) 815, datë 28.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës."*.

18. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, ka bërë rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, me të cilin ka kërkuar: *"Prishjen e Vendimeve dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës, me një trup tjetër gjykues."*.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

20. Paraprakisht, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka në vëmendje ndryshimet ligjore që ka pësuar KPP me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi në datën 29.05.2021. Në nenin 38 të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore parashikohet se: *"1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre"*. Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

21. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (*në vijim Kolegji*), vlerëson se, rekursi nga prokuroria është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të KPP. I gjykuari L.R. është njoftuar për rekursin.

22. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikes gjyqësore; kur nuk është respektuar ose

është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

23. Për sa i përket qëndrimit të prokurorit në seancën e sotme gjyqësore, në lidhje me heqjen dorë nga rekursi i paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Kolegji Penal vlerëson se në shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë, në interpretim të frymës kushtetuese shprehur në nenin 148 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar me ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, si dhe referim të nenit 415 të KPP, nga ankimi mund të heqë dorë vetëm prokurori që ka ushtruar ankimin, në këtë rast Prokurori i Apelit Durrës. Përderisa nuk ka heqje dorë nga ankimi nga prokurori që ka ushtruar ankimin, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në vendimin për kalimin për shqyrtim të rekursit, do të vijojë me shqyrtimin e tij.

24. Nga shqyrtimi i pretendimeve të ngritura në rekurs, e të verifikuara gjatë shqyrtimit të tij në seancën e sotme gjyqësore të paraqitur nga prokuroria, nuk rezulton që të ketë shkaqe për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës. Kolegji, vlerëson se, gjykatat kanë arsyetuar drejt që cilësimi i drejtë ligjor për veprimet e të pandehurit L.R. është vepra penale "Plagosje e lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i KP.

25. Në lidhje me pretendimin e prokurorisë se vendimet e gjykatave nuk kanë arsyetuar se përse janë elementët e veprës penale të *"plagosjes së lehtë"*, parashikuar nga neni 89 i KP dhe përse nuk janë elementët e veprës penale *"vrasje në rrethana cilësuese"*, të mbetur në tentativë, e rrezikshme për jetën e shumë personave, parashikuar nga nenet 79/e e 22 të KP, Kolegji e gjen të pabazuar këtë pretendim. Të dyja gjykatat kanë arsyetuar elementët e veprës penale për të cilën kanë ndryshuar cilësimin juridik. Nga gjykatat më të ulëta janë arsyetuar në mënyrë shteruese elementët e të dyjave veprave penale dhe arsyetimi i tyre se veprimet e të pandehurit L.R. përbëjnë konsumim të veprës penale "Plagosje e lehtë me dashje", është i drejtë.

26. Veprimet e anës objektive të konsumuar nga i pandehuri L.R. provojnë pikërisht elementin volutiv të tij si dhe qëllimin, si pjesë e anës subjektive. Rezulton se, veprimet e anës objektive të konsumuara nga i pandehuri, tregojnë se veprimet e tij janë drejtuar kundër shëndetit të të dëmtuarës H.S.. Këto veprime janë konsumuar në fillim të hyrjes së tij në banesë, ku ai ka marrë një palë gërshërë dhe e ka qëlluar këtë shtetase, duke i shkaktuar dëmtime që kategorizohen si plagosje e lehtë me dashje. Veprimet e kryera në vijim, ku i pandehuri ka spërkatur me benzinë divanin e kësaj shtetaseje dhe më pas i ka hedhur një shkrepëse të ndezur, nuk janë drejtuar më kundër jetës së saj, por kundër pasurisë, ku del se i pandehuri ka pasur si qëllim shkatërrimin e

banesës së të dëmtuarës dhe jo marrjen e jetës.

27. Kolegji, vlerëson se, është i drejtë arsyetimi i gjykatave më të ulëta, se nga veprimet konkrete të të pandehurit, krijohet bindja e plotë se ai është drejtuar nga ndjenja e hakmarrjes ndaj të dëmtuarës, e cila ka shërbyer si motiv për kryerjen e veprës penale, ka marrë me vete lëndë djegëse me qëllimin e posaçëm për t'i djegur asaj banesën, siç dhe ka bërë më tej. Në kohën e përdorimit të lëndës djegëse, i pandehuri ka pasur të gjitha mundësitë që lëndën djegëse t'ia hidhte direkt dhe të gjithën në trup të dëmtuarës dhe fëmijëve të saj, të cilët kanë qenë shumë afër tij, por nuk e ka bërë një gjë të tillë, pasi nuk ka qenë ky qëllimi kriminal. I pandehuri, pasi ka goditur me dashje në masën e plagëve të lehta shtetasen H.S., duke konsumuar në dëm të saj veprën penale të "Plagosjes së lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i KP, me lëndën djegëse që kishte marrë me vete, ka spërkatur orenditë shtëpiake në një vend të caktuar në divanin pranë dritares dhe i ka vënë flakën, pasi ai njëkohësisht ndiqte dhe qëllimin kriminal për t'i shkatërruar banesën shtetasve Redi dhe H.S., në ato pasoja që në fakt kanë ardhur.

28. Kolegji, vlerëson se, në veprimet e të pandehurit nuk ekzistojnë elementët e veprës penale "Vrasje me dashje", mbetur në tentativë, pasi tentativa konsiston në mosardhjen e pasojave dhe ndërprerjen e pasojës për shkaqe të pavarura nga vullneti i të pandehurit. Në rastin konkret, jo vetëm që pasojat nuk janë ndërprerë për shkaqe të pavarura nga vullneti i të pandehurit, por nga veprimet e anës objektive të tij del e qartë se qëllimi i tij nuk ka qenë marrja e jetës së të dëmtuarës, por dëmtimi i shëndetit të saj dhe shkatërrimi i banesës me zjarr. Nëse do të kishte si qëllim marrjen e jetës së të dëmtuarës, i pandehuri i kishte të gjitha mundësitë për të kryer një veprim të tillë. Nuk rezulton që i pandehuri të ketë ndërmarrë të gjitha veprimet për vrasjen e të dëmtuarës dhe pasoja të mos ketë ardhur për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij, duke plotësuar në këtë mënyrë elementët e tentativës si fazë paraprake që sjell përgjegjësi penale. Veprimet e drejtpërdrejta të të pandehurit janë drejtuar për dëmtimin e shëndetit të të dëmtuarës kur e ka qëlluar atë me gërshërë. Ndërsa veprimet e mëtejshme të të pandehurit nuk kanë qenë veprime të drejtpërdrejta të drejtuara kundër jetës, por kundër pasurisë së saj.

29. Nga ana subjektive, që të jemi para veprës penale të "Vrasjes me dashje", veprimet e autorit duhet të kryhen me dashje direkte, me qëllim vdekjen e personit. Autori duhet ta parashikojë se, me veprimet e tij do t'i shkaktojë vdekjen një personi të caktuar - momenti intelektual, si dhe duhet ta dëshirojë këtë pasojë - momenti volitiv. Kolegji thekson se, këto dy momente duhet të ekzistojnë njëkohësisht në veprimet e autorit të veprës penale dhe në këtë mënyrë përcaktojnë dashjen e autorit për arritjen e pasojës së dëshiruar.

Nëse nuk ekziston njëri prej këtyre momenteve, nuk mund të flasim për dashje direkte për arritjen e pasojës së ardhur. Motivi nuk është element përbërës i veprës penale të "Vrasjes me dashje" por, merret në analizë nga gjykata për të arritur në një përfundim të drejtë, sa i përket ekzistencës së njërit prej momenteve të dashjes, në veprimet e autorit të kësaj vepre, e konkretisht të momentit volitiv. Ky moment është i lidhur shumë ngushtë me motivin/et dhe qëllimin që udhëheq autorin e veprës penale gjatë veprimeve të tij.

30. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Kolegji, vlerëson se, veprimet e të gjykuarit L.R. përbëjnë elementët e anës objektive të veprës penale "Plagosje e lehtë me dashje" dhe jo "Vrasje me dashje", mbetur në tentativë. Cilësimi juridik i bërë nga gjykatat më të ulëta është i drejtë dhe vendimet janë të arsyetuara, prandaj nuk ka shkaqe për cenimin e tyre.

31. Në lidhje me pretendimin e ngritur në rekurs se gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe më pas ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, duke vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 4/2012 të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji e gjen të pabazuar edhe këtë pretendim pasi në këtë rast kemi të bëjmë me lehtësim të pozitës së të pandehurit gjatë gjykimit të tij me procedurën e gjykimit të shkurtuar.

32. Prokuroria ka ngritur si shkak të rekursit dhe çështjen e zbatimit të gabuar të rregullave për gjykim të shkurtuar sipas nenit 404 të KPP, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, duke referuar në shkelje të jurisprudencës kushtetuese, sipas vendimit nr. 4/2012, të Gjykatës Kushtetuese. Këtë pretendim, Kolegji Penal e analizoi në frymën e interpretimit të rregullave të kohës së zbatimit të legjislacionit procedural mbi gjykimin e shkurtuar, gjithashtu dhe duke pasur parasysh detyrimin për respektimin e fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në vendimin nr. 5, datë 02.02.2001, të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera thuhet se: "*Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj*. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale". I njëjti qëndrim është mbajtur në vendimin nr. 20, datë 04.04.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

33. Gjithashtu, gjykata çmon të evidentojë disa nga veçoritë/elementet e "*gjykimit të shkurtuar*", që janë vënë në dukje në vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: *a)* Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton

dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në 1/3 e masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm; *b)* Ky përfitim nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë dhe as të pozitës së të pandehurit. Pra, kërkesën e të pandehurit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë, kur ajo praktikisht bindet se mund të përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtimin gjyqësor. Gjykata, çmon gjithashtu se, në pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, gjykata është e detyruar të mbajë në konsideratë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka marrë në analizë institutin e gjykimit të shkurtuar. Kështu, në vendimin nr. 4, datë 10.02.2012, Gjykata Kushtetuese ndër të tjera shprehet se: *"Në këndvështrimin kushtetues, Gjykata Kushtetuese çmon se, gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet, për të përfituar një ulje dënimi. Për këtë arsye, legjislatori, për këtë lloj gjykimi, ka parashikuar rregulla të veçanta në kreun IV të titullit VII të KPP (nenet 403-406), të cilave gjyqtarët duhen t'u përmbahen gjatë zbatimit të këtij gjykimi të posaçëm."*. Më tej, në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese shprehet se: *"...ndonëse, gjatë gjykimit të zakonshëm, është kompetencë ekskluzive e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, në gjykimet e posaçme, siç konsiderohet dhe gjykimi i shkurtuar, kjo e drejtë duhet të ushtrohet në përputhje me veçoritë e këtij gjykimi, e në veçanti me faktin se për të proceduar me këtë lloj gjykimi, përveç kërkesës së të pandehurit, kërkohet detyrimisht edhe vendimi/miratimi i gjyqtarit (shih paragrafin 18 të këtij vendimi). E thënë ndryshe, gjyqtari, në momentin e marrjes së vendimit, në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar të të pandehurit, duhet të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ekonomisë gjyqësore (shih paragrafin 19 të këtij vendimi), por duhet të vendosë, kryesisht, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive. Kjo do të thotë që ai, ndër të tjera, duhet të marrë në konsideratë edhe cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori. Si pasojë, nëse ka dyshime mbi këtë cilësim, ky element mjafton që gjyqtari të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar kështu të gjitha parimet e procesit të rregullt ligjor, si kontradiktoriteti, e drejta e mbrojtjes, etj.,"*. (I njëjti qëndrim është mbajtur dhe me vendimin nr. 24, datë 30.04.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

34. Më tej, në vendimin nr. 4/2012, Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

"...Gjykata Kushtetuese çmon se, nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm edhe në rastin kur procedohet me gjykim të shkurtuar, njësoj si në gjykimin e zakonshëm, do të mund të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe të dënojnë të pandehurin me një masë dënimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, instituti do të humbiste çfarëdolloj justifikimi kushtetues, për arsye se i pandehuri, duke hequr dore në mënyrë të vullnetshme nga disa parime kushtetuese si parimi i barazisë së armëve dhe nga parimi i kontradiktoritetit, do të sakrifikonte të drejtat e tij kushtetuese jo vetëm pa pasur asnjë lloj përfitimi, por edhe duke marrë një dënim më të lartë nga ai që priste.". Nisur nga ky interpretim i bërë nga Gjykata Kushtetuese del se *nuk mund të bëhet ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale në një më të rëndë për të pandehurin në kushtet e gjykimit të shkurtuar. Në të kundërt, çështja mund të gjykohet në kushtet e gjykimit të shkurtuar, nëse si pasojë e zbatimit edhe të kësaj procedure të posaçme gjykimi kemi ndryshim të cilësimit juridik të veprës penale, me pasojë lehtësimin e pozitës së të pandehurit.*

35. Kolegji, vlerëson se, nuk rezulton që nga Gjykata e Apelit Durrës të jenë shkelur urdhërimet e vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese. I pandehuri është gjykuar në kushtet e gjykimit të shkurtuar për akuzën e kryerjes së veprës penale të "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", mbetur në tentativë, cilësim juridik ky që është ndryshuar nga gjykata e shkallës së parë gjatë gjykimit në fakt në atë të "Plagosjes së lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i KP, që është një vepër penale shumë më e lehtë se ajo për të cilën është akuzuar. Në këto kushte, nuk jemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor e se ky pretendim nuk përbën shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit.

36. Nga ana tjetër, pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

37. Sa më sipër, Kolegji Penal vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është marrë në vlerësim të drejtë të ligjit material dhe procedural, prandaj bazuar në nenin 441/1/e të KPP, vendos lënien në fuqi të vendimit nr. 378, datë 11.07.2013, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-643, datë 15.07.2021

Ligji shqiptar për ekzekutimin e vendimeve penale apo/ dhe për trajtimin e të dënuarve e të paraburgosurve, referojnë ekzistencën e një institucioni të posaçëm mjekësor. Fakti që shteti shqiptar që nga viti 2000, kur është konstatuar për herë të parë kjo problematikë nga KPT (Komisioni i Pritjes së të Trajtuarve), vijon me të njëjtën gjendje, nuk mund të justifikojë vijim e cenimit të jetës dhe shëndetit të kërkuesit (por edhe të personave të tjerë për të cilët ka një vendim gjykate për caktim mase mjekësore, për shkak të problemeve me shëndetin mendor), përmes vijimit të situatës të trajtimit çnjerëzor, degradues e poshtërues të tij.

I. Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2009, ndaj shtetasit A.S. ka filluar gjykimi për veprën penale "Vrasje me paramendim", mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 78 dhe 22 të KP (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 435, datë 25.03.2009, ndër të tjera, ka vendosur: "*Caktimin e masës mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" ndaj shtetasit A.S., i dtl. 22.02.1973, parashikuar nga neni 46 i KP, për shkak të kryerjes së veprës penale "Vrasje me paramendim" mbetur në tentativë", parashikuar nga nenet 78/1 dhe 22 të KP".*

3. Gjykata ka arsyetuar se është e drejtë kërkesa e mbrojtjes për mosfillimin apo mosvazhdimin e çështjes penale, pasi është provuar se i pandehuri, në momentin e kryerjes së veprës vuante nga një sëmundje mendore, që e bënte të paaftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tij. Referuar aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. 117, datë 23.05.2008, të kryer nga ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML), si dhe aktit tjetër të realizuar në datë 09.09.2008 [...], ka rezultuar se i pandehuri A.S. vuan nga sëmundja e "skizofrenisë së formës paranoide", sëmundje nga e cila vuante prej vitesh dhe që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor.

4. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datë 04.04.2009, ndërkohë që në datë 08.04.2009, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit. Me vendimet e mëvonshme gjyqësore për rishqyrtimin e kësaj

mase mjekësore, përkatësisht me vendimin nr. 774, datë 27.10.2010, si dhe vendimin datë 16.01.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur vazhdimin e masës mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor". Në datë 10.07.2013, shtetasi A.S., nëpërmjet avokatit të tij, ka paraqitur kërkesë për të rishqyrtuar masën mjekësore me argumentin se gjendja e tij shëndetësore kishte ndryshuar dhe se ndaj tij mund të zbatohet masa më e lehtë mjekësore "Mjekim i detyruar ambulator", parashikuar nga neni 46/2, 3 i KP (KP).

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 15 Akti, datë 03.02.2014, ka vendosur përsëri vazhdimin e masës mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor". Ky vendim është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 610, datë 11.06.2014, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Kërkuesi A.S. në datën 17.09.2014 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën me objekt: *"Ndërprerje e trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues ndaj shtetasit A.S., ndërprerje e kufizimit të lirisë personale në këndvështrim me ligjin si dhe trajtimi i tij në një institucion mjekësor të posaçëm, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë."*. Kërkuesi ka pretenduar se, nga koha e dhënies së vendimit të parë gjyqësor për caktimin e masës mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" ndaj shtetasit A.S., më datë 25.03.2009 dhe deri më sot, ai është trajtuar në vazhdimësi, në institucione të vartësisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) dhe jo në institucione mjekësore, ndonëse ndaj tij nuk ekziston ndonjë vendim penal i formës së prerë, që të përcaktojë fajësinë e tij dhe ta dënojë me burgim.

7. Kërkuesi ka pretenduar se ai nuk është as i paraburgosur dhe as i dënuar me burgim, por është person me aftësi të kufizuar mendore, që vuan nga sëmundja 'skizofreni paranoide', ndaj të cilit duhet të zbatohet masa mjekësore e mjekimit të detyruar në një institucion shëndetësor e përcaktuar nga një vendim gjyqësor i formës së prerë. Në rastin në fjalë, gjykata ka vendosur vetëm mjekim të detyruar pranë një institucioni shëndetësor dhe jo burgim në sistemin e burgjeve, për rrjedhojë, kufizimi i lirisë së shtetasit A.S. si pasojë e burgimit është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin, vendimet e Gjykatës dhe me statusin e tij si i sëmurë.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1395 akti, datë 20.11.2014, ka vendosur: *"Rrëzimin e kërkesës, si të pabazuar në prova dhe në ligj." (...)*

15. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2206, datë 22.12.2015, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 1395 Akti, datë 20.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."*.

16. Gjykata e Apelit në marrjen e vendimit, pasi ka marrë në shqyrtim dhe shkaqet e ankimit, ka arsyetuar ndër të tjera (duke mbështetur argumentimin e gjykatës së shkallës së parë): "*...omissis... Kërkuesi nuk paraqiti asnjë provë apo fakt se, po trajtohet në mënyrë çnjerëzore apo poshtëruese. Përkundrazi, sipas informacionit të dhënë nga DPB dhe IVSHB Tiranë rezulton se: "...shtetasi A.S. është shtruar dhe vazhdon të qëndrojë për një trajtim më të specializuar në IVSHB, nga ku merr rregullisht terapinë përkatëse sipas diagnozës.... ju sqarojmë se të gjithë personat me masë mjekësore "mjekim i detyruar", Drejtoria e IVSHB është kujdesur për trajtimin e tyre duke i akomoduar në një pavijon të veçantë, vetëm për këtë kategori. Kjo për arsyen se kjo kategori nuk mund të qëndrojë me personat e tjerë, të cilët vijnë për arsye shëndetësore dhe qëndrojnë përkohësisht, deri në rehabilitimin apo përmirësimin e gjendjes së tyre. Pavarësisht se kjo kategori qëndron në një pavijon të veçantë, nga ana e administratës së institucionit tonë u janë krijuar të gjitha kushtet, duke respektuar të drejtat e tyre, që rrjedhin nga rregullorja e IVSHB-së, miratuar nga MD. Kështu përmendim, të drejtën e tyre për ajrim në ambiente të veçanta nga ambientet e të burgosurve dhe të paraburgosurve të tjerë; të drejtën për kështillim individual dhe në grup: përfshirja në aktivitete të ndryshme social-kulturore; të drejtën për të bërë kërkesë-ankesa për të interesuarit; ofrohet edhe puna me librin, përmes bibliotekës; këshillime ligjore, etj...*".

17. Kundër vendimit nr. 2206, datë 12.12.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs në datën 08.01.2016, kërkuesi A.S., (...), me të cilin ka kërkuar: *Prishjen e vendimit nr. 2206, datë 12.12.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 1395 Akti, datë 20.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. (...)*

20. GJEDNJ me vendimin e datës 21.01.2020 (çështja Strazimiri kundër Shqipërisë), ka vendosur se nga shteti shqiptar ka pasur shkelje të neneve 3 dhe 5 të KEDNJ-s. (...)

26. Gjithashtu, GJEDNJ ka vijuar se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë i datës 22 dhjetor 2015 ishte i formës së prerë. Gjykata vëren se ky vendim ishte i hapur për apelim, një mundësi të cilën kërkuesi e shfrytëzoi, dhe rezulton se është pezull përpara Gjykatës së Lartë. Në mbështetje të konstatimeve të saj në *Gjyli kundër Shqipërisë (nr. 32907/07, §§ 33-34, 29 Shtator 2019)*, Gjykata konstaton se ky vendim nuk ishte bërë (*res judicata)* dhe për këtë arsye, kundërshton vërejtjet e Qeverisë. Megjithëse në të vërtetë neni 5 § 4 nuk garanton asnjë të drejtë, si të tillë, për një apelim ndaj vendimeve që urdhërojnë ose zgjasin ndalimin, sipas qëllimit dhe synimit të kësaj dispozite kërkesat e saj duhet të respektohen nga gjykatat e apelit, në rast se një apelim është kundër një vendimi *(shih, Hutchison Reid kundër*

Mbretërisë së Bashkuar, nr. 50272/99, §§ 78, GJEDNJ 2003-IV).

27. Asgjë nuk sugjeron se kërkuesi, i cili ka paraqitur apelimin e tij në Gjykatën e Lartë, më 11 janar 2016, shkaktoi vonesa në shqyrtimin e tij. Gjykata është e mendimit se në mungesë të arsyeve të parashtruara nga Qeveria, vonesa prej më shumë sesa tre vitesh për këtë grup procedimesh përpara Gjykatës së Lartë u atribuohet plotësisht autoriteteve. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se periudha përpara Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet e pajtueshme me kërkesën për "shpejtësi" në nenin 5 § 4, e cila kërkon shqyrtim të posaçëm për procedimet. Në këtë mënyrë, ka pasur një shkelje të këtij neni.

28. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 § 1, neni 268 i KPP dhe kompensimi për aktin për burgim të padrejtë parashikon të drejtën e një personi për kompensim sipas shkallëve specifike. Ky i fundit nuk rezulton të parashikojë kompensim për ndalim të paligjshëm të personave të gjendur në situatën specifike të kërkuesit. Nuk rezulton se një e drejtë e tillë u sigurua sipas ndonjë parashikimi tjetër të legjislacionit shqiptar dhe Qeveria nuk ka parashtruar praktikë gjyqësore për të kundërtën e kësaj.

29. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 § 4, Gjykata vëren se Qeveria nuk iu referua parashikimeve ligjore për të drejtën e kompensimit. Gjykata vëren se në nëntor 2017, në fuqi hyri një mjet i ri në lidhje me një shkelje të pretenduar të kërkesës për kohë të arsyeshme, sipas parashikimit të nenit 6 § 1 të Konventës (*shih, paragrafin 52 më sipër*). Edhe pse mjeti i ri u bë efikas pas hyrjes në fuqi të zbatimit më 11 qershor 2016, Gjykata, duke pasur parasysh mungesën e praktikës ligjore, nuk mund të arrijë në përfundimin se mjeti i ri do të zbatohej për kërkesën e "përshpejtimit" sipas nenit 5 § 4 të Konventës, sipas të cilit kërkuesit nuk mund t'i kërkohet ta shterojë atë. Për këtë arsye, nuk rezulton që të jetë siguruar e drejta për kompensim sipas legjislacionit shqiptar.

30. GJEDNJ arrin në përfundimin se kërkuesi nuk kishte një të drejtë të zbatueshme, sipas parashikimit të nenit 5 § 5 të Konventës, në lidhje me shkeljet e neneve 5 §§ 1 dhe 4. Për këtë arsye, ka pasur një shkelje të nenit 5 § 5 të Konventës.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

33. Kolegji sjell në vëmendje se, pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në të gjitha rastet, kur rekursi nuk u përmbahet shkaqeve të përcaktuara nga neni 432/1 i Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal vendos mospranimin e rekursit. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në

shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

34. Kolegji, para se të vlerësojë nëse pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, çmon të nevojshme të trajtojë kuadrin ligjor në fuqi, që rregullon mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale që kanë disponuar në lidhje me masën mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" dhe të drejtat e personave që i nënshtrohen kësaj mase, referuar kuadrit të brendshëm ligjor.

35. Neni 25 i Kushtetutës parashikon: *"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues."*

36. Neni 46 i KP parashikon: *"Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Masat mjekësore janë: 1. Mjekimi i detyruar ambulator 2. Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor. Masa edukuese është: 1. Vendosja e të miturit në një institucion edukimi. Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj."*.

37. Neni 56 i ligjit nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" (ligji në fuqi në momentin e shqyrtimit të rekursit), parashikon mënyrën e ekzekutimit të vendimeve në lidhje me masat mjekësore në këtë mënyrë: *"1. Për personin e papërgjegjshëm që ka kryer një vepër penale, masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet sipas vendimit të gjykatës në institucionin mjekësor të specializuar të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. 2. Me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, dërgimi në institucionin mjekësor i personit që dyshohet se ka kryer një vepër penale kryhet: a) nga institucioni mjekësor që e ka në trajtim; b) nga institucioni mjekësor me ndihmën e Policisë së Shtetit, kur kërkohet nga mjekët që e kanë në trajtim; c) nga Policia e Shtetit në rast se i dyshuari i lirë nuk ekzekuton urdhrin vullnetarisht. 3. Masa mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohet në institucionet mjekësore të vendbanimit të të detyruarit. Kur në to nuk ka specialistë përkatës, shoqërohet në çdo rast nga këto institucione në rrethin më të afërt ku ka të tillë. 4. Kur gjatë ekzekutimit të kësaj mase sillen pengesa nga i detyruari, prokurori*

urdhëron ekzekutimin e detyruar nga Policia e Shtetit dhe, kur është vendi, i paraqet kërkesë gjykatës për ndryshimin e masës në mjekim të detyruar në një institucion mjekësor të specializuar." Edhe ligji i mëparshëm për ekzekutimin e vendimeve penale, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shqyrtimit të kësaj kërkese nga gjykatat e faktit, ka parashikuar që 'masat mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohen në një institucion mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë, me kërkesë të prokurorit' (neni 45 i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 – i ndryshuar).

38. Gjithashtu, neni 15 i ligjit 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve" (ligji në fuqi në momentin e shqyrtimit të rekursit) parashikon: *"Institucionet e kujdesit shëndetësor për personat për të cilët gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme administrohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor, për sa i takon ofrimit të shërbimeve. Masat e sigurisë për ruajtjen e këtyre institucioneve ofrohen nga Ministria e Drejtësisë."*. Edhe në këtë rast, ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve, që ka qenë në fuqi në kohën e shqyrtimit të kërkesës për ndërprerjen e trajtimit çnjerëzor e degradues të A.S., nga gjykatat e faktit, parashikonte trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor në institucione mjekësore të posaçme jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (neni 16 i ligjit 8328, datë 16.04.1998 – i ndryshuar).

39. Neni 28 i ligjit nr. 44/2012, "Për shëndetin mendor" (i ndryshuar) parashikon: *"Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale. 2. Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."*.

40. Neni 29 i ligjit të mësipërm parashikon: *"1. Të dënuarit dhe të paraburgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë këtyre institucioneve ose në Qendrën Spitalore të Burgjeve. 2. Trajtimi dhe përkujdesja për shëndetin mendor, sipas pikës 1 të këtij neni, ofrohet në mënyrë jodiskriminuese dhe sipas standardeve shëndetësore që zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me çrregullime të shëndetit mendor. 3. Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet shërbimeve të shëndetit mendor, ofron, sipas nevojave, të gjithë asistencën e nevojshme për diagnostikimin, kurimin dhe rehabilitimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, sipas pikës 1 të këtij neni."*.

41. Kolegji vlerëson se, vendimmarrja e GJEDNJ e vë theksin tek mospërmbushja e detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të Konventës për të ndaluar që çdo shtetas shqiptar të mos i nënshtrohet torturës apo trajtimit çnjerëzor dhe degradues, detyrim që referuar përmbajtjes së Konventës përbën një ndalim absolut. Në vendimmarrjen e saj, GJEDNJ vë theksin që gjykatat dhe autoritetet e brendshme, veçanërisht prokuroria dhe Ministria e Drejtësisë, kanë pranuar mungesën e një institucioni të posaçëm mjekësor për personat e sëmurë mendërisht që i janë nënshtruar një trajtimi mjekësor të detyruar me urdhër gjykate. Pavarësisht këtij konstatimi, nga institucionet përgjegjëse nuk janë marrë masat e nevojshme për riparimin e kësaj situate. Mungesa e një institucioni të përshtatshëm për trajtimin e personave të përjashtuar nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes së tyre mendore dhe ndaj të cilëve është caktuar masa mjekësore "mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" është shkaku i vendimmarrjes së GJEDNJ dhe konstatimi i shkeljes së KEDNJ nga shtetit shqiptar.

42. GJEDNJ ka arsyetuar se, efektet kumulative të përkeqësimit të kushteve të jetesës në Qendrën Spitalore të Burgut, ku kërkuesi është mbajtur në izolim që prej vitit 2011, si dhe trajtimi i pamjaftueshëm psikiatrik dhe terapeutik i tij në Qendrën Spitalore të Burgut, kanë sjellë trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues e, për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

43. Ky vendim vjen pas vendimit datë 18.12.2007 *Dybeku kundër Shqipërisë*, ku GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se në rastin në fjalë, për një të burgosur me probleme shëndetësore specifike, masa të përshtatshme duhet të merren nga autoritetet shqiptare që të mos ketë shkelje të nenit 3 të Konventës dhe masa të tilla duhet të parashikohen për të gjithë të burgosurit në situata të ngjashme. Në këtë vendim GJEDNJ shprehet se: *"Gjykata nuk e nënvlerëson rëndësinë e vështirësive financiare të referuara nga pala shqiptare (shih paragrafin 33 më sipër). Megjithatë, ajo vëren se shumë prej mangësive të identifikuara më sipër mund të ishin ndrequr edhe në mungesën e mjeteve financiare të konsiderueshme. Në çdo rast, mungesa e*

burimeve financiare nuk mundet të justifikojë kushte të tilla vuajtje dënimi, të cilat janë kaq të varfra sa prekin nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të parashikuar nga neni 3, duke bërë që ai të zbatohet në këtë rast, (shih Poltoratskly, § cituar më sipër, dhe Iovchev v. Bulgaria, no. 41211/98, § 136, 2 shkurt 2006).

51. Duke pasur parasysh efektet në tërësi të të gjitha kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit, të cilave iu ishte nënshtruar ankuesi, të cilat kishin pasur efekt të dëmshëm në shëndetin dhe mirëqenien e tij (shih Kalashnikov, cituar më sipër, § 98), konstatimet e KPT në raportet më të fundit në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare, në veçanti për sa i përket të burgosurve të sëmurë mendërisht (shih paragrafët 19-20 më sipër), dhe precedentin e saj në këtë fushë (shih paragrafin 41 më sipër), Gjykata konsideron se natyra, kohëzgjatja dhe vuajtja e dënimit sa i takon keqtrajtimit të të cilit ankuesi i ishte nënshtruar, si dhe efektet që kanë pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t'u kualifikuar si çnjerëzore dhe degraduese (shih Egmez v. Cyprus, no. 30873/96, § 77, ECHR 2000-XII; Labzov v. Russia, no. 62208/00, § 45, 16 qershor 2005; dhe Mayzit v. Russia, no. 63378/00, § 42, 20 janar 2005). Pra është shkelur neni 3 i Konventës.".

44. Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave për vijimin e zbatimit të masës "Mjekim i detyruar në një institucion të posaçëm mjekësor" ka qenë e drejtë, pasi ka rezultuar se gjendja e kërkuesit nuk është përmirësuar gjatë qëndrimit në institucion. Në zbatim të nenit 46 të KPP, gjykatat kanë verifikuar gjendjen shëndetësore të kërkuesit, ku nga raportet e mjekëve ekspertë ka rezultuar se ai vazhdon të vuajë nga sëmundja mendore "skizofreni paranojake". Gjithashtu, duke marrë në konsideratë se kërkuesi është akuzuar për një vepër të rëndë penale, si "Vrasje me paramendim" mbetur në tentativë, rezulton se rrezikshmëria e tij shoqërore është e lartë. Gjykatat e faktit kanë kryer një hetim të plotë gjyqësor dhe kanë vlerësuar drejt që ndaj kërkuesit duhet të caktohej masa mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor". Nga ana tjetër, Kolegji vë në dukje se rrëzimi i kërkesës objekt shqyrtimi, për ndërprerje të trajtimit çnjerëzor, e paraqitur nga kërkuesi, është vendosur dhe arsyetuar nga gjykata për shkak të pamundësisë që kërkuesi të akomodohej/sistemohej në një institucion tjetër, duke qenë se në Shqipëri nuk ka një institucion të përshtatshëm për personat ndaj të cilëve është caktuar masa mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor".

45. Mospërmbushja e detyrimeve nga shteti shqiptar për ngritjen e institucioneve të përshtatshme, ku do të qëndrojnë personat ndaj të cilëve është caktuar një masë mjekësore nga gjykata është dhe shkaku

i vendimmarrjes të GJEDNJ të trajtuar më lart. Sipas ligjit, mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë ka detyrimin për të garantuar masat e sigurisë për ruajtjen e këtyre institucioneve, sipas ligjit "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Kolegji konstaton se, që në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkese nga gjykata e faktit, kuadri ligjor i brendshëm ka parashikuar detyrimin për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, në institucione mjekësore të posaçme.

46. Kolegji thekson se, duhet vënë në dukje që mungesa e institucioneve të përshtatshme është ngritur edhe nga gjykatat shqiptare që kanë pasur vështirësi në disponimin në lidhje me masat mjekësore, pasi në fakt institucionet e përshtatshme në lidhje me ekzekutimin e këtyre masave mjekësore, mungojnë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 171, datë 14.07.2014, është shprehur se: *"Zbatimi i masave mjekësore bazohet në nenin 46 të KP, i cili përcakton se masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale, pra, kriter i rëndësishëm për zbatimin e kësaj dispozite është fakti se kemi të bëjmë me rastin e personave të cilët janë totalisht të papërgjegjshëm nga pikëpamja penale, dhe ndaj tyre nuk mund të diskutohet rreth aftësisë së tyre për përgjegjshmëri penale. Në lidhje me përcaktimin e kësaj kategorie personash referon neni 17 i KP. Në bazë të nenit 17 të KP, nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale.*

47. Në këto kushte, sipas ligjit penal, i nënshtrohen procedimit penal dhe eventualisht ekzekutimit të dënimit, vetëm personat plotësisht të "përgjegjshëm", si dhe personat "pjesërisht të përgjegjshëm", pra personat që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk vuanin nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik, apo personat që vuanin nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që kanë ulur ekuilibrin e tyre mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tyre në raport me faktin e veprës penale.

48. Në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, është parashikuar se (...) të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohet trajtim i barabartë, jodiskriminues, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre bëhet

sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Po kështu, në bazë të nenit 16 të këtij ligji, parashikohet se vendosja të paraburgosurve dhe e të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor për mjekim në institucionet mjekësore të veçanta, jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës.".

49. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e mësipërme e GJEDNJ në çështjen "*Strazimiri kundër Shqipërisë"*, tregon përgjegjësinë e shtetit shqiptar për marrjen e masave të domosdoshme dhe të menjëhershme në lidhje me ekzekutimin e tij. Pavarësisht rekomandimeve të një sërë institucioneve të brendshme dhe ndërkombëtare, në lidhje me mungesën e përshtatshmërisë së institucioneve ku qëndronin dhe vijojnë të qëndrojnë personat ndaj të cilëve ishin caktuar masa mjekësore nga gjykata, nuk rezulton të jenë marrë masa për të rregulluar situatën nga institucionet përgjegjëse (fakt ky që u konstatua edhe gjatë shqyrtimit të këtij rekursi në prani të palëve, në Gjykatën e Lartë).

50. Kolegji, nisur nga vendimmarrja e GJEDNJ në rastin e kërkuesit A.S., ku është gjetur me shkelje shteti shqiptar, çmoi të nevojshme kalimin e çështjes në seancë gjyqësore në mënyrë që të dëgjohen palët. Ky moment procedural u vlerësua më rëndësi nga Kolegji Penal, në funksion të një vendimmarrjeje të drejtë dhe koherente, referuar rrethanave të çështjes. Në këto rrethana, sipas nenit 437/1/b të Kodit të Procedurës Penale që parashikon: *"1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se: b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Penal thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes në rastet e përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 432 të këtij Kodi*", Kolegji disponoi për shqyrtimin e kësaj çështje në seancë gjyqësore, duke çmuar me rëndësi praninë dhe dëgjimin e palëve.

51. Mbrojtësi i kërkuesit A.S. sqaroi gjykatën se, kërkuesi vijon të trajtohet në IEVP Zaharia, Krujë. Në lidhje me zbatimin e vendimit të GJEDNJ, mbrojtësi nuk kishte informacion, por nga komunikimi me familjarët trajtimi i kërkuesit vijon të jetë i njëjtë, ashtu siç GJEDNJ ka konstatuar trajtim çnjerëzor dhe poshtërues. Prokurori i çështjes nga ana e tij, ndonëse pranoi që duhet konstatuar nga gjykata ndërprerja e trajtimit çnjerëzor e poshtërues, në zgjidhjen e pasojave kërkoi rrëzimin e kërkesës. Prokurori theksoi se vendimi i GJEDNJ lidhet vetëm me kushtet dhe trajtimin e kërkuesit pranë Qendrës Spitalore të Burgjeve, ndërkohë që rekursuesi po trajtohet pranë IEVP Zaharia, Krujë. Në mungesë të një institucioni të përshtatshëm/të posaçëm mjekësor, kjo strukturë IEVP Zaharia, Krujë, ofron kushtet optimale për trajtimin e duhur të personave me probleme të shëndetit mendor që kanë kryer një vepër penale e për të cilët gjykata ka caktuar një masë mjekësore, sipas nenit 46 të KP.

52. Kolegji, në analizë të provave të marra e të verifikuara në këtë gjykim, vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të drejta e të bazuara në ligj. Fakti që institucionet e posaçme mjekësore mungojnë, nuk mund të cenojë të drejtat legjitime të kërkuesit. Nga përmbajtja e vendimit të GJEDNJ rezulton se, jo vetëm Qendra Spitalore e Burgjeve, por edhe IEVP Zaharia, Krujë, nuk plotëson kushtet për tu konsideruar institucion i posaçëm mjekësor. Ky fakt është konstatuar edhe në raportet e KPT, ku i fundit është përpiluar në vitin 2019. Në ndryshim nga sa parashtroi prokurori në Gjykatën e Lartë, ky Kolegj çmoi se trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues i kërkuesit A.S. është konstatuar nga GJEDNJ për disa arsye: (i) IEVP Zaharia, Krujë, ashtu si dhe Qendra Spitalore e Burgjeve janë në varësi të DPB dhe Ministrisë së Drejtësisë; (ii) ka mungesë të kushteve minimale higjienike; (iii) ka mungesë të personelit mjekësor; (iv) ligji përcakton se trajtimi i personave ndaj të cilëve është caktuar një masë mjekësore duhet bërë në institucione të posaçme, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërkohë që Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse vetëm për sigurinë; (v) ligji ka parashikuar që personat ndaj të cilëve është caktuar një masë mjekësore nga gjykata, duhet të trajtohen si çdo person tjetër me probleme të shëndetit mendor (neni 28 i ligjit për shëndetin mendor).

53. *Kolegji konstatoi se jo vetëm ligji i kohës së paraqitjes së kërkesës objekt gjykimi, për ekzekutimin e vendimeve penale apo/dhe për trajtimin e të dënuarve e të paraburgosurve, por edhe ligjet aktualisht në fuqi, referojnë ekzistencën e një institucioni të posaçëm mjekësor. Fakti që shteti shqiptar që nga viti 2000, kur është konstatuar për herë të parë kjo problematikë nga KPT, vijon me të njëjtën gjendje, nuk mund të justifikojë vijimin e cenimit të jetës e shëndetit të kërkuesit (por edhe të personave të tjerë për të cilët ka një vendim gjykate për caktim mase mjekësore, për shkak të problemeve me shëndetin mendor), përmes vijimit të situatës të trajtimit çnjerëzor, degradues e poshtërues të tij.*

54. Në rrethanat e parashtruara më lart, Kolegji vlerëson se vendimi nr. 2206, datë 22.01.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe vendimi nr. 1394, datë 20.11.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhen ndryshuar, duke disponuar për pranimin e kërkesës së kërkuesit A.S. për ndërprerjen e trajtimit çnjerëzor e poshtërues. Zbatimi i masës mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" ndaj shtetasit A.S., nënkupton vendosjen e tij në një institucion të specializuar, sipas ligjit nr. 79/2020," Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Vendim i Kolegjit Penal nr. 23, datës 27.07.2021

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese, të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale.

I. Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi L.B, me cilësinë procedurale penale të viktimës akuzuese, i është drejtuar Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dy kërkesa penale, duke kërkuar gjykimin e të akuzuarit E.V., për veprën penale "Shpifja" kryer botërisht, parashikuar nga neni 120, paragrafi i dytë i KP, konkretisht me kërkesën penale nr. 115/11 Akti, datë 05.10.2020 dhe kërkesën penale nr. 117 Akti, datë 06.10.2020. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 26.10.2020, ka vendosur bashkimin e këtyre dy kërkesave penale, në bazë të neneve 79 dhe 92 të Kodit të Procedurës Penale dhe gjykimin e tyre në një të vetme.

2. Nga aktet rezulton se, viktima akuzuese L.B është kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ndërsa i akuzuari E.V. është Kryetar i Bashkisë Tiranë. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari, në datën 24.09.2020, ka qenë i ftuar në emisionin "Opinion" në televizionin kombëtar "Klan", dhe aty ka shpifur për viktimën akuzuese duke pretenduar edhe se ka prova për to. Gjithashtu, në datën 02.10.2020, ka qenë duke drejtuar fushatën elektorale në Tiranë dhe ka vijuar të thellojë shpifjen në drejtim të viktimës akuzuese. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari ka konsumuar veprën penale "Shpifja", duke deklaruar një sërë thëniesh të pavërteta, prandaj i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. akti 11, datë 02.02.2021, ka vendosur: *"Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes penale nr. 11 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 05.10.2020 me viktimë akuzuese L.B, të akuzuar E.V., për veprën penale "Shpifja", parashikuar nga neni 120/2 i KP. Dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si gjykatë kompetente për gjykimin e kësaj çështje penale."*.

4. (...) Gjykata arsyeton se, nga faktet që viktima akuzuese i atribuon të akuzuarit, rezulton se ky i fundit, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë ka shpifur ndaj viktimës akuzuese. Ndodhur në këto kushte, kompetente për ta gjykuar këtë çështje sipas nenit 75/a, germa "c" të KPP është Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. (...)

6. Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me vendimin nr. 27, datë 11.03.2021, ka vendosur: *"Ngritjen para Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë të çështjes së mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore në shqyrtimin e çështjes penale nr. 77 Regj. Themeltar, datë 26.02.2021 me viktimë akuzuese L.B, të akuzuar E.V. për veprën penale "Shpifja" të parashikuar nga neni 120/2 i KP midis Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."*

13. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, meqenëse ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm (GJKKO) si dhe Gjykatës së Lartë kishte qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e datës 04.05.2021, vendosi kalimin e çështjes penale me nr. 52810-227-2021, datë regjistrimi 30.03.2021, për shqyrtim në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen: *Cila është gjykata kompetente për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale?*

14. Në seancë gjyqësore, mbrojtësit e viktimës akuzuese L.B. kërkuan nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente (...) bazuar në nenet 91, 438 dhe 441/2 të Kodit të Procedurës Penale, kërkojmë njësimin e praktikës gjyqësore duke formuluar rregullin e së drejtës për çështjen e shtruar për zgjidhje: *"Në rastet e gjykimit të akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, gjykatë kompetente është Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar."(...)*

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim, Kolegji) vlerëson se në çështjen në shqyrtim ekziston konflikti për kompetencë, pasi dy gjykata të ndryshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim GJKKO), nuk pranojnë të gjykojnë çështjen e paraqitur, konkretisht kërkesën e paraqitur nga viktima akuzuese L.B. kundër të akuzuarit E.V., sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP).

19. Kodi i Procedurës Penale, në Kreun II, seksionin V, titulluar "Mosmarrëveshjet për kompetencat", nenet 89, 90 dhe 91 Kodit të Procedurës Penale, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë. Neni 89/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: *"Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person."*.

20. Neni 90 i këtij Kodi parashikon parashtrimin e mosmarrëveshjes në këtë mënyrë: *"Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, të cilës i bashkohet dokumentacioni i nevojshëm. 2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes, merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit. 3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje."*.

21. Neni 91 në vijim i Kodit parashikon: *"1. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Gjykata e Lartë me vendim. Gjykata merr të dhënat, aktet dhe dokumentet që i çmon të nevojshme. 2. Vendimi u komunikohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje, prokurorive përkatëse, të pandehurit dhe palëve private."*.

22. Kolegji vlerëson se parashtrimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk është i drejtë, prandaj aktet duhet t'i kthehen kësaj gjykate, me qëllim vazhdimin e gjykimit të çështjes, referuar argumentimit që do të trajtohet në vijim. Gjithashtu, Kolegji Penal, në dhomën e këshillimit të datës 04.05.2021, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale. Fillimisht, Kolegji çmon me vend të sqarojë se përse lindi nevoja për njësim të praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe përse është e nevojshme të përcaktohet/n çështja/çështjet që do të shtrohen për njësim nga Kolegji.

23. Kolegji vlerëson se vendimmarrja e tij në lidhje me çështjen e mësipërme duhet të shërbejë si vendimmarrje njësuese, pasi është konstatuar se ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO) si dhe Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale.

24. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 254, datë 19.03.2021, ka vendosur: *"Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës se Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke përcaktuar si Gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar"*. Nga ana tjetër, konstatohet se në Gjykatën e Lartë janë paraqitur një sërë çështjesh për mosmarrëveshje kompetence ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm (GJKKO) në lidhje me çështjen e mësipërme. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale.

25. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se jemi në kushtet që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të shprehet me një vendimmarrje njësuese, konform nenit 438/1 të KPP që parashikon: *"Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore."*.

26. Kolegji Penal, në dhomë këshillimi, vendosi që çështja e shtruar për njësim të praktikës gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të jetë si më poshtë: - *Cila është gjykata kompetente për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale?*

27. Pasi trajtoi arsyen e njësimit të praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen e mësipërme dhe çështjen e shtruar për njësim, Kolegji vendos të ndalet në trajtimin e pyetjes njësuese dhe në vijim në zgjidhjen e çështjes

konkrete. Në çështjen objekt gjykimi, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes penale, me argumentimin se kemi të bëjmë me një akuzë penale të ngritur ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Ky është një subjekt i posaçëm dhe referuar nenit 75/a të KPP kompetencën lëndore për gjykimin e akuzave penale të ngritur ndaj tij, sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka Gjykata e Posaçme.

29. Nga ana tjetër, GJKKO, në parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës, ka parashtruar se neni 75/a i KPP kur i referohet akuzës penale nuk përfshin akuzën e ngritur nga viktima akuzuese, sipas nenit 59 të KPP. Sipas GJKKO kjo është akuza private e njohur në të drejtën procedurale penale, e cila nuk përfshihet në kuptimin e akuzës penale që përcakton neni 75/a i KPP si kompetencë lëndore e Gjykatës së Posaçme. Kompetencë e saj është gjykimi vetëm i akuzave penale ndaj subjekteve të posaçëm, akuza që përfaqësohen në gjykim nga Prokuroria e Posaçme, ndërsa akuzat e tjera të ashtuquajtura private, janë kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

30. Neni 75/a i KPP (i ndryshuar me ligjin nr. 41/2021) përcakton kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në këtë mënyrë: *"Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të KP; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të KP; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës."*

31. Në çështjen objekt gjykimi, para Kolegjit shtrohet detyra e interpretimit të termit "akuzë penale" parashikuar nga pika c) dhe ç) e nenit 75/a të KPP. Në kuadër të zgjidhjes drejt të çështjes objekt gjykimi nga ky Kolegj, lind nevoja për përcaktimin, nëse tek akuza penale e përcaktuar nga neni 75/a i Kodit përfshihen edhe kërkesat e paraqitura nga viktima akuzuese kundër subjekteve të posaçëm, sipas nenit 59 të KPP.

32. Kolegji vlerëson të nevojshëm rikonfirmimin e qëndrimit se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt *(shih vendimin nr. 917, datë 11.05.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë)*.

33. Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili determinon konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. "Gjykata e krijuar me ligj" është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka trajtuar kuptimin e "gjykatës së krijuar me ligj" duke përcaktuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës që është pjesë e pandarë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut parashikuar nga KEDNJ dhe Protokollet e saj.[38] Një organ i pakrijuar me ligj, do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar ankesat e individëve.[39]

34. Termi "ligj", në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, përfshin, në veçanti, jo vetëm legjislacionin që përcakton krijimin dhe funksionimin (kompetencën) e organeve gjyqësore por edhe çdo dispozitë ligjore të legjislacionit të brendshëm që, nëse shkelet, do ta shndërronte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një çështjeje konkrete në një pjesëmarrje të paligjshme.[40] Shprehja

[38] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Jorgic v Germany* nr. kërkesa 74613/01, datë 12. 07. 2007, paragrafi i 64; *Richert v Poland,* nr. kërkesa 54809/07, datë 25.01.2012, paragrafi 41;

[39] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Lavents v Latvia* nr. kërkesa 58422/00, datë 28.02.2003, paragrafi 114; *Gorgiladze v Georgia;* Nr. kërkesa 4313/04, datë 20.10.2009, paragrafi 67; *Kontalexis v Greece* nr. kërkesa 59000/08, datë 21.11.2011, paragrafi 38.

[40] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Pandjikidzeandothers v Georgia* nr. kërkesa 30323/02 datë 27.01.2010 paragrafi 104.

"e caktuar me ligj" përfshin bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me normat e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e saj, si dhe përbërja (kompozimi) e gjykatës në çdo rast që ajo merr në shqyrtim.[41]

35. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete[42] dhe ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet. Megjithëse në të drejtën pozitive procedurale penale në fuqi në Republikën e Shqipërisë nuk parashikohet në mënyrë eksplicite parimi i gjyqtarit natyral të çështjes, dispozitat ligjore në frymën e tyre, parimet kushtetuese dhe sidomos jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar se rendi juridik një ndër elementet kryesore të gjykatës së caktuar me ligj ka standardin e gjyqtarit natyral, standard[43] i cili është nga ana tjetër edhe e drejtë themelore e individit. Qëllimi i krijimit dhe mbrojtjes kushtetuese të kësaj figure shtetërore është tek nevoja për të qenë tej çdo dyshimi dhe mundësie e paanshme përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Nëpërmjet këtij parimi dhe kësaj figure ligjore të autoritetit shtetëror kompetent për të zgjidhur një mosmarrëveshje shteti i së drejtës siguron garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nëpërmjet një gjyqtari kompetent, të pavarur dhe të paanshëm.

36. Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij Republika ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet *(translatio iudicii)* apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pa juridiksion ose jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite nëpërmjet dispozitave

[41] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Posokhov v Russia,* nr. kërkesa 63486/00, datë 04.06.2003, paragrafi 39; *Fatullayev v Azerbaijan* Nr. kërkesa 40984/07, datë 04.10.2010, paragrafi 144.

[42] Shiko vendimin nr. 3, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

[43] Shiko vendimin nr. 3, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

tranzitore ndryshe *(shih vendimin njësues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2018-148, datë 04.04.2018).*

37. Duke iu rikthyer çështjes së shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se për të përcaktuar në mënyrë që qartë kuptimin e akuzës penale të përcaktuar nga neni 75/a i KPP, është e nevojshme të ndalet në interpretimin historik, logjik, sistematik e së fundi në interpretimin literal të dispozitës.

38. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e miratuar në vitin 1998, në nenin 141, parashikonte: *"Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.".* Gjykata e Lartë, sipas këtij parashikimi kushtetues, kishte juridiksion fillestar të gjykonte akuzat penale kundër funksionarëve të lartë shtetërorë. Gjykata e Lartë gjykonte të gjitha akuzat penale të ngritura ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pavarësisht faktit nëse akuza përfaqësohej në gjykim nga Prokuroria e Përgjithshme, apo nëse ishte akuzë me të dëmtuar akuzues sipas nenit 59 të KPP. Në juridiksionin fillestar që Kushtetuta i kishte dhënë Gjykatës së Lartë nuk është vënë ndonjëherë në diskutim fakti nëse akuzat e ngritura nga viktima/i dëmtuari akuzues ishin apo jo në kompetencë të saj, pasi çdo akuzë penale e ngritur ndaj subjekteve të posaçme shqyrtohej nga Gjykata e Lartë. Një parashikim i tillë lidhej me garancitë e nevojshme që Kushtetuta ofronte për gjykimin e këtyre subjekteve, për shkak të cilësive të tyre të posaçme dhe funksionit që ushtronin, të lidhur ngushtësisht me interesin publik. Parashikimi kushtetues nuk bënte dallim nëse akuza përfaqësohej nga Prokuroria e Përgjithshme apo nga një subjekt privat, sipas nenit 59 të KPP.

39. Nga ana tjetër, neni 75/b i KPP, para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017, parashikonte: *"Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë, me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit."*

40. Më datë 11.08.2016 hyn në fuqi ndryshimet e Kushtetutës në kuadër të paketës normative të Reformës në Drejtësi. Referuar këtyre ndryshimeve, rezulton se, aktualisht neni 135 i Kushtetutës parashikon: *"Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të*

Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur."

41. Me ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, në dallim nga sa parashikohej më parë në nenin 135 të Kushtetutës së pandryshuar, ndryshimet e kësaj dispozite në pikën 2 parashikuan krijimin e një gjykate të posaçme penale, kompetenca lëndore e së cilës parashikohej drejtpërdrejtë në Kushtetutë, njëlloj sikurse parashikohej juridiksioni fillestar penal i Gjykatës së Lartë në nenin 141 pika 1 të Kushtetutës së pandryshuar. Më tej ndryshimet kushtetuese prekën edhe nenin 148 të Kushtetutës, ku ndër të tjera u përcaktua edhe kompetenca lëndore e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq për prokurorinë. Pika 4 e kësaj dispozite kushtetuese parashikon se: *"Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme."*.

42. Ndryshimet kushtetuese prekën edhe juridiksionin fillestar penal të Gjykatës së Lartë, duke e hequr këtë atribut të ushtrimit të pushtetit gjyqësor nga kjo gjykatë dhe duke e bërë pjesë integrale të juridiksionit të specializuar penal të gjykatës së posaçme, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës. Gjithashtu, juridiksioni fillestar i ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq i Prokurorisë së Përgjithshme, sipas nenit 141, pika 1 të pandryshuar të Kushtetutës, i kaloi Prokurorisë së Posaçme.

43. Ky ndryshim i Kushtetutës është pasqyruar edhe në nenin 75/a të KPP, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 dhe me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, i cili parashikon se: *"Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të KP; c) akuzat penale kundër Presidentit te Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose*

në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.".

44. Nga tërësia e dispozitave të mësipërme, arrihet në përfundimin se juridiksioni fillestar që Kushtetuta parashikonte për Gjykatën e Lartë u suprimua, duke i dhënë asaj të drejtën vetëm të gjykimit të çështjeve lidhur me zbatimin dhe interpretimin e ligjit, referuar nenit 141/1 të Kushtetutës që parashikon: *"Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit."*.

45. Kolegji vë në dukje se pas ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, Gjykata e Lartë nuk ka më juridiksion fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë. Kompetencën lëndore për gjykimin e subjekteve të posaçëm e ka Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kompetencë lëndore që përcaktohet në nenin 75/a të KPP-s. Pra, pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, rezulton se kompetenca që kishte Gjykata e Lartë për të gjykuar: *..."akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ...",* i ka kaluar Gjykatës së Posaçme e cila ndër të tjera gjykon *..."akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave"*.

46. Nga interpretimi i mësipërm historik, Kolegji arrin në përfundimin se juridiksioni fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë i ka kaluar në bllok Gjykatës së Posaçme e cila, sipas të njëjtit parashikim ligjor, ka të drejtë të gjykojë po akuzat penale të ngritura ndaj këtyre funksionarëve apo akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës. Në këtë linjë arsyetimi, në kushtet kur Gjykata e Lartë gjykonte çdo akuzë penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pavarësisht nëse ajo përfaqësohej nga Prokuroria e Përgjithshme apo ngrihej nga i dëmtuari akuzues edhe Gjykata e Posaçme aktualisht ka kompetencë lëndore të gjykojë të gjitha akuzat penale të ngritura ndaj këtyre funksionarëve të lartë shtetërorë, pa u bërë një diferencim në lidhje me akuzat e ngritura nga viktima akuzuese sipas nenit 59 të KPP.

47. Përfundimi i mësipërm arrihet nga Kolegji edhe po të bëhet interpretimi logjik i dispozitave të mësipërme, duke identifikuar qëllimin e ligjvënësit në bërjen e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rregullohet me ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në

Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i krijimit të kësaj gjykate ishte krijimi i një gjykate të juridiksionit të posaçëm e cila do të gjykonte një kategori të caktuar veprash penale që kanë një rrezikshmëri të theksuar shoqërore, për të cilat lindi nevoja për t'u gjykuar nga një gjykatë e posaçme, në kuadër të nevojës për të luftuar korrupsionin dhe veprat penale në fushën e krimit të organizuar, prioritet i shtetit shqiptar në kuadër të paketës ligjore për reformimin e drejtësisë.

48. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar u krijua në radhë të parë si një gjykatë veprash, pra me qëllimin për të gjykuar një kategori të caktuar veprash penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe që cenojnë dukshëm rendin publik; krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të KP si dhe *çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të KP.*

49. Së dyti, Gjykata e Posaçme u krijua si një gjykatë subjektesh, pasi kjo gjykatë ka kompetencë të gjykojë të gjitha akuzat penale të kryera nga funksionarët e lartë shtetërorë ose ish-funksionarët e lartë, në rast se veprat penale për të cilat akuzohen janë kryer gjatë kohës që ata kanë qenë në ushtrim të detyrës. Ligjvënësi ka përcaktuar gjykimin e akuzave penale ndaj këtyre subjekteve të posaçëm dhe nuk rezulton të ketë bërë dallim në varësi të faktit se kush e përfaqëson akuzën në gjyq, Prokuroria e Posaçme apo viktima akuzuese, pasi qëllimi i ligjvënësit ka qenë që Gjykata e Posaçme të gjykonte funksionarët e lartë shtetërorë. Kolegji çmon që në kushtet kur ligjvënësi nuk ka bërë dallim në këtë drejtim, atëherë një dallim i tillë nuk mund të bëhet as nga gjykatat, pasi një interpretim i tillë do të ishte tejkalim i parashikimit ligjor dhe gjithashtu i qëllimit që ka pasur ligjvënësi në ndryshimet thelbësore që miratoi me paketën e Reformës në Drejtësi.

50. Së fundmi, Kolegji çmon të nevojshme të kalohet tek interpretimi sistematik dhe literal i dispozitave procedurale penale, për të arritur në një konkluzion të qartë se çfarë do të konsiderohet akuzë penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 75/a të KPP-s.

51. Neni 148/1 i Kushtetutës parashikon: *"Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj."* Nga ana tjetër, paragrafi 4 i kësaj dispozite parashikon se: *"Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme."*.

52. Neni 24/1 i KPP parashikon: *"Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod."* Neni 25 i KPP parashikon se: *"Për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme."*.

53. Neni 4 i ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" parashikon: *"Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe Gjykatës së Lartë, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj."*.

54. Neni 8 i ligjit të mësipërm parashikon se: *"Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës. 2. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji, ose nëse ai zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit."*.

55. Referuar parashikimeve të mësipërme, Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson në gjyq akuzën penale për veprat penale që janë në kompetencë të GJKKO sipas përcaktimit të bërë në nenin 75/a të KPP. Nga ana tjetër, ligjvënësi për një kategori të caktuar veprash penale parashikon të drejtën e viktimës akuzuese për të paraqitur kërkesë në gjykatë me qëllimin për të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, sipas nenit 59 të KPP që parashikon: *"1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119,119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të KP ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për*

të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

2. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij."

56. Ligjvënësi parashikon se, për një kategori të caktuar veprash penale, viktima akuzuese ka të drejtë të paraqitet vet në gjykim duke pasur si barrë prove vërtetimin e akuzës së ngritur prej tij. Veprat penale për të cilat parashikohet paraqitja e kërkesës nga viktima akuzuese janë vepra penale me një rrezikshmëri më të ulët shoqërore, prandaj ligji parashikon se për këto kategori veprash penale është vetë viktima akuzuese që paraqitet në gjyq dhe provon akuzën e ngritur prej saj. Nga ana tjetër, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

57. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të KPP-s, rezulton se procesi gjyqësor penal fillon në bazë të depozitimit në Gjykatë:

- Të kërkesës së prokurorit, i cili në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës, ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit (neni 24/1 KPP); për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme (neni 25 i këtij Kodi);

- Me kërkesë të viktimës akuzuese (në referim të nenit 60 KPP) për kategorinë e veprave penale të parashikuara shprehimisht në nenin 59 të këtij Kodi.

58. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga viktima akuzuese, sipas nenit 59 KPP, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 3, datë 6.2.2008, me objekt: "Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale", ka vendosur: "*Rrëzimin e kërkesës*".

59. Në arsyetimin e këtij vendimi, ndër të tjera, theksohet se: *" ... si akuza publike ashtu edhe akuza private të parashikuara nga legjislacioni procedural penal janë dy mekanizma që shërbejnë për ndjekjen penale të autorit të veprës penale dhe në asnjë rast ato nuk kanë për qëllim eliminimin e njëra-tjetrës. Ato bashkëveprojnë dhe, në raste të caktuara, gjejnë zbatim veçmas. Gjykata Kushtetuese rithekson se në asnjë rast akuza publike nuk mund të shmanget. Ajo ushtrohet sa herë që prokuroria krijon bindjen se vepra e kryer cenon rendin publik apo interesin e shoqërisë. Këtë prokuroria e bën edhe duke ndërhyrë në procesin e iniciuar nga i dëmtuari akuzues (neni 59/2 i Kodit të Procedurës Penale).*

.... në rastet e parashikuara nga neni 59/1, nuk përjashtohet tërësisht pjesëmarrja e prokurorit. Ai ka të drejtë që gjatë gjykimit të këtyre çështjeve të marrë pjesë duke kërkuar, sipas rastit, fajësinë ose jo të të pandehurit. Përjashtimi i hetimit paraprak nga këto çështje dhe lejimi i të dëmtuarit akuzues për të ngritur akuzë nuk është marrje e kompetencave të prokurorit, por thjesht dhënie e mundësisë të dëmtuarit për të qenë aktiv në një proces ku ai është i interesuar drejtpërdrejtë.

... Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se përmbajtja e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale nuk bie ndesh me nenin 148/1 të Kushtetutës. Ato plotësojnë njëri-tjetrin në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Megjithatë, edhe në këto raste, ligji procedural penal nuk e shmang pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimin e këtyre çështjeve. Prokurori jo vetëm merr pjesë në gjykimin e të pandehurit, por sipas rastit, kërkon dënimin ose pafajësinë e tij".

60. Kolegji, çmon të nevojshëm edhe trajtimin e mjetit procedural, kërkesën e viktimës akuzuese, parashikuar nga neni 59 i KPP. Së pari, Kolegji vë në dukje se termi akuzë private nuk është një term i parashikuar nga Kushtetuta dhe as nga ligji. Ky term është zhvilluar dhe përpunuar në doktrinën dhe teorinë e të drejtës procedurale penale dhe i referohet kërkesës që paraqitet në gjykim nga viktima/i dëmtuari akuzues, i cili ka detyrimin të përfaqësojë akuzën e ngritur prej tij si dhe barrën e provës për ta provuar atë. Referuar nenit 59 të KPP, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Nga ana tjetër, prokurori në këtë gjykim nuk përfaqëson akuzën dhe as ka barrën e provës për ta provuar atë. Arsyeja e një parashikimi të tillë ligjor lidhet me kategorinë e veprave penale që parashikohen nga neni 59 i KPP, të cilat më shumë se interesin publik cenojnë interesin privat të viktimës akuzuese, në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Me anë të këtij mjeti procedural, ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre *(shih vendimin më sipër të Gjykatës Kushtetuese)*.

61. Neni 59 i KPP ka për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Ligjvënësi, me parashikimin e institutit të akuzës private, është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuara dhe të mbrojtura nga prokuroria dhe interesave privatë nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij.

62. Neni 59 i KPP zbatohet vetëm për veprat penale që parashikohen nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 *të KP, të cilat përmenden në mënyrë taksative në paragrafin e parë të nenit 59. Këto vepra penale karakterizohen nga mungesa e rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe interesi i vogël publik në çështjen konkrete. Sa më serioze të jetë vepra penale ose sa më i madh të jetë rreziku për vepra penale të përshkallëzuara, aq më tepër duhet që ndjekja penale të vazhdojë kryesisht, në interes publik, edhe sikur viktimat t'i kenë tërhequr kallëzimet e tyre*.

63. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që normojnë ushtrimin e funksioneve të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme pranë kësaj gjykate në gjykimin e akuzës penale ndaj funksionarëve publike, nuk e kufizojnë gjykimin e tyre vetëm me shqyrtimin e "akuzës publike" dhe as përjashtojnë "akuzën private", siç parashtrohet nga GJKKO në mosmarrëveshjen për kompetencë, por kanë përcaktuar në kompetencë lëndore të asaj gjykate të gjitha "akuzat penale", pa përjashtim, në ngarkim të funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas përcaktimit të nenit 75/a të Kodit, natyrisht kur vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

64. Kolegji çmon se pavarësisht rrezikshmërisë më të ulët shoqërore që kanë veprat penale të parashikuara nga neni 59 i KPP, këto vepra penale do të gjykohen nga Gjykata e Posaçme, pikërisht për shkak të faktit se janë akuza penale që ngrihen ndaj subjekteve të posaçëm, me funksione të larta shtetërore, të lidhura drejtpërdrejt me interesin publik. Kompetencën Gjykata e Posaçme në rastin e pikës c) dhe ç) të nenit 75/a të Kodit e merr pikërisht për shkak se i akuzuar është subjekti i posaçëm dhe nuk kushtëzohet nga lloji i veprës penale apo ndaj faktit se kush e përfaqëson akuzën në gjykim. Në rast se ligjvënësi do të kishte pasur një qëllim të tillë, ai do e kishte parashikuar, siç ka bërë ndarjen në varësi të llojit të veprës penale në pikën a) të nenit 75/a të KPP.

65. Kolegji çmon se është e vërtetë se GJEDNJ në çështjen *Deweer kundër Belgjikës*, është shprehur se "akuza", në kuptimin e nenit 6 § 1, mund të përkufizohet si *"njoftimi zyrtar i një individi, nga ana e autoritetit kompetent, që mendohet që ka kryer një vepër penale"*. Megjithatë ky vendim duhet të interpretohet sipas kontekstit të dhënë nga kjo Gjykatë. GJEDNJ në këtë vendim, por edhe në vendime të tjera, ka mbajtur qëndrimin se një person i ndaluar dhe i detyruar për t'u betuar përpara se të merrej në pyetje në cilësi dëshmitari ishte tashmë objekt i një "akuze penale" dhe përfitonte nga e drejta për të heshtur (*Brusco kundër Francës, §§ 46-50*). Sipas GJEDNJ, nuk është përfaqësimi i akuzës nga prokuroria

që kushtëzon faktin nëse ka një akuzë të ngritur ndaj të akuzuarit apo jo. Akuza është e tillë, pavarësisht se përfaqësohet nga organi publik apo një subjekt privat. Akuza i referohet atribuimit ndaj të akuzuarit të kryerjes së një vepre penale, e cila sjell pasoja ndaj të akuzuarit në lidhje me të drejtat apo liritë e tij personale.

66. Për sa i përket kuptimit autonom të termit "penal", sipas GJEDNJ, Konventa nuk u kundërvihet prirjeve për "depenalizim" që hasen brenda shteteve kontraktuese. Megjithatë, veprat që pas depenalizimit klasifikohen si "shkelje administrative" mund t'i përkasin kuptimit autonom të veprës "penale". Lënia në dorë të shteteve e kompetencës për t'i përjashtuar këto vepra mund të sillte rezultate të papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës (Öztürk k. Gjermanisë, § 49).

67. Gjithashtu, GJEDNJ ka arsyetuar se pikënisja e shqyrtimit të zbatueshmërisë së pjesës penale të nenit 6 të Konventës mbështetet tek kriteret e parashtruara në vendimin *Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulëta*, §§ 82-83, kritere që janë: 1. cilësimi në të drejtën e brendshme; 2. natyra e veprës; 3. ashpërsia e dënimit që rrezikon t'i jepet personit të interesuar.

68. Kriteri i parë është me peshë relative dhe shërben vetëm si pikënisje. Vendimtare është të shihet nëse një vepër klasifikohet apo jo si vepër penale nga e drejta e brendshme. Në mungesë të këtij klasifikimi, Gjykata do të shohë se çfarë ka prapa klasifikimit kombëtar duke marrë në shqyrtim realitetin substancial të procedurës në fjalë. Kriteri i dytë dhe ai i tretë që parashtrohen në vendimin *Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulëta* janë alternativë dhe jo medoemos të bashkueshëm; që neni 6 të gjykohet i zbatueshëm, mjafton që vepra në fjalë të konsiderohet, për vetë natyrën e saj, si "penale" nga këndvështrimi i Konventës ose që vepra ta bëjë personin subjekt për një sanksion i cili, për vetë natyrën dhe shkallën e tij të ashpërsisë, i takon përgjithësisht sferës "penale" *(Lutz k. Gjermanisë, § 55; Öztürk k. Gjermanisë, § 54)*.

69. Sipas GJEDNJ, fakti që një vepër mund të mos jetë e dënueshme me masë burgimi nuk është në vetvete vendimtar, sepse dobësia relative e masës së parashikuar të dënimit nuk e zhvesh një vepër nga karakteri i saj i brendshëm penal *(po aty, § 53; Nicoleta Gheorghe k. Rumanisë, § 26)*. Megjithatë, mund të zgjidhet një qasje bashkuese në qoftë se një analizë më vete e secilit kriter nuk jep mundësi për të arritur në një përfundim të qartë për sa i përket ekzistencës së një akuze në fushën penale *(Bendenoun k. Francës, § 47)*. Duke përdorur shprehjet "akuzë penale" dhe "i akuzuar për një vepër", tre paragrafët e nenit 6 u referohen situatave identike. Për rrjedhojë, sipas GJEDNJ-s kriteri i zbatueshmërisë së nenit 6 në pjesën e tij penale është i njëjti për të tre paragrafët.

70. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ si të rëndësishme në përcaktimin nëse kemi një akuzë penale, në kuptim të nenit 6 të Konventës, arrihet në përfundimin se edhe kërkesa me të dëmtuar akuzues përfshihet në konceptin e akuzës penale. Prandaj, edhe në vështrim të praktikës së GJEDNJ, Kolegji vlerëson se akuza penale përfshin si koncept si akuzën e përfaqësuar në gjykim nga prokuroria, ashtu edhe kërkesën e paraqitur nga viktima akuzuese, sipas nenit 59 të KPP.

71. Duke iu rikthyer kuadrit ligjor shqiptar, referuar interpretimit historik të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale penale para ndryshimeve të vitit 2016-2017, rezulton se juridiksioni fillestar për akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë iu suprimua Gjykatës së Lartë dhe i kaloi një gjykate të posaçme, Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kjo gjykatë u krijua si një gjykatë e posaçme për gjykimin e veprave penale të parashikuar nga neni 75/a, paragrafi 1 dhe 2 i KPP, si dhe një gjykatë që do të gjykonte subjekte të posaçëm, konkretisht ata të parashikuar në paragrafin 3 të nenit 75/a të Kodit.

72. Pra, rezulton se pas ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, të pasuara me ndryshimet ligjore, juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë i kaloi Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në kushtet kur Gjykata e Lartë gjykonte të gjitha akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pa u bërë dallimi nëse akuza përfaqësohej nga prokuroria apo nga viktima akuzuese, Kolegji çmon se nuk ka arsye pse një dallim i tillë të bëhet tani që kompetencën lëndore për gjykimin e subjekteve të posaçëm e ka Gjykata e Posaçme. Për më tepër, ky dallim nuk mund të bëhet për aq kohë sa nuk e bën vetë ligji.

73. Pranimi i interpretimit të bërë nga Gjykata e Posaçme do të cenonte garancitë e vendosura nga vetë Kushtetuta dhe ligji që një kategori e subjekteve të posaçëm të gjykoheshin jo nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por nga një gjykatë e juridiksionit të posaçëm, e krijuar enkas për të ofruar garanci shtesë në drejtim të garantimit të procesit të rregullt ligjor dhe një vendimmarrje të drejtë. Në kushtet kur vetë ligjvënësi nuk ka bërë një dallim të tillë, interpretimi tej parashikimit kushtetues dhe ligjor do të cenonte jo vetëm parimin e ligjshmërisë, por edhe atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

74. Në mbështetje të këtij arsyetimi të Kolegjit vjen edhe interpretimi logjik, sipas qëllimit që ka pasur ligjvënësi kur ka bërë ndryshimet kushtetuese dhe ato ligjore. Krijimi i Gjykatës së Posaçme, si një gjykatë subjekti, që do të gjykonte funksionarët e lartë shtetërorë kishte si qëllim ofrimin e garancive shtesë që një kategori e veçantë subjektesh, për shkak të funksionit që mbajnë, e lidhur kjo drejtpërdrejtë me interesin publik, të gjykohen nga një gjykatë e

posaçme, që ofron garanci shtesë si për sa i përket përbërjes së saj, mënyrës së zgjedhjes së gjyqtarëve ashtu dhe në funksion të rritjes së standardit të procesit të rregullt ligjor. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë që juridiksioni fillestar që ushtronte Gjykata e Lartë t'i kalonte një gjykate të posaçme dhe nuk rezulton që ligjvënësi të ketë bërë diferencim tek kompetenca lëndore e Gjykatës së Posaçme, në varësi të faktit se kush e përfaqësonte akuzën në gjykim. Në kushtet kur vetë ligjvënësi nuk ka bërë një dallim të tillë, Kolegji vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Posaçme në ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës është një tejkalim i parashikimit ligjor.

75. Kolegji çmon se Gjykata e Posaçme ka interpretuar në mënyrë të ngushtuar duke i dhënë nenit 75/a paragrafi 3 dhe 4 një kuptim të ndryshëm nga ai që i ka dhënë ligjvënësi. Ligjvënësi ka përcaktuar se gjykata e posaçme gjykon akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë dhe nuk përcakton se kompetenca i referohet vetëm akuzës që përfaqëson në gjykim prokuroria e posaçme. Në kushtet kur Kodi i Procedurës Penale parashikon se akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, por mund të ketë edhe kërkesë nga viktima akuzuese, Kolegji vlerëson se kur i akuzuar është një nga subjektet e posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP, kompetenca lëndore për gjykimin e këtyre akuzave i përket Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

76. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që në lidhje me pyetjen e shtruar për njësim, duhet të arrihet në këtë përfundim njësues: *Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese, të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të KPP-s.*

77. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, referuar përfundimit të mësipërm njësues, Kolegji Penal vendos zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për shqyrtimin e çështjes penale me nr. 227-2021 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 30.03.2021, me viktimë akuzuese L.B, kundër të akuzuarit E.V. për veprën penale "Shpifja", parashikuar nga neni 2/120 i KP, duke përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-639, datë 07.09.2021

Kërkesa e prokurorit për rëndimin e masës së sigurimit duhet t'i paraqitet gjykatës në formë të shkruar ku të pasqyrojë rrethanën apo faktin e ri të dalë, veprën penale të re për të cilën dyshohet personi nën hetim. Kjo kërkesë për rëndimin e masës së sigurimit/in peius, nuk mund të paraqitet në seancën e verifikimit të masës së sigurimit të dhënë më parë nga gjykata, por duhet të bëhet me një kërkesë të veçantë në formë të shkruar, ku të argumentojë nevojën për një masë sigurimi më të lartë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Më datë 9.2.2021, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka depozituar në Kryesekretarinë e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kërkesën (...) për caktimin e masës së sigurimit personal ndër të tjerë, ndaj shtetasve të sipërpërmendur, të cilët kanë paraqitur rekurs, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 319/ç, 244, 245/1/2, 259 dhe 287 të KP.

2. Konkretisht, Organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i KPP, për personin nën hetim M.M. dhe masën e sigurimit personal me karakter ndalues "Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", të parashikuar nga neni 242 i KPP, për personat nën hetim E.P. dhe T.F..

3. Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 14, datë 10.2.2021, ndër të tjera, ka vendosur: "*...Të caktojë ndaj shtetases M.M. masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i KPP, si e dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë" dhe "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuara nga neni 319/ç dhe neni 244 të KP. Të caktojë ndaj shtetases T.F., masën e sigurimit "Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik", parashikuar nga neni 242 i KPP, duke i ndaluar plotësisht të drejtën e ushtrimit të detyrës së infermieres, si e dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm të funksionarëve publikë", parashikuar nga neni 319/ç dhe neni 245/1/2 i KP. Të caktojë ndaj shtetasit E.P., masën e sigurimit personal me karakter ndalues "Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik", parashikuar nga neni 242 i KPP, duke i ndaluar plotësisht të drejtën e ushtrimit të detyrës së mjekut, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 319/ç dhe neni 259 i KP...*".(...)

9. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pas verifikimit të kushteve të masave të sigurimit, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 15, datë 13.2.2021, ndër të tjera, ka vendosur: "*...Vazhdimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në burg", (...) ndaj personit nën hetim M.M., si e dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë" dhe "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuara nga neni 319/ç dhe neni 244 të KP. Vazhdimin e masës së sigurimit "Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik", (...), ndaj personit nën hetim T.F., duke i ndaluar plotësisht të drejtën e ushtrimit të detyrës së infermieres, si e dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm të funksionarëve publikë", parashikuar nga neni 319/ç dhe neni 245/1/2 i KP. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter ndalues "Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik", parashikuar nga neni 242 i KPP, e caktuar me vendimin nr. 14, datë 10.2.2021, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ndaj personit nën hetim E.P., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga 259 dhe 287 të KP, me masën e sigurimit personal "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i KPP. (...)*

18. Në rrethana të tilla, duke qenë tashmë i dyshuar për dy vepra penale, si dhe duke vlerësuar se qëndrimi i lirë i personit nën hetim mund të vërë në rrezik marrjen, apo vërtetësinë e provës, gjykata vlerëson të drejtë kërkimin e prokurorit për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, nga ajo e parashikuar në nenin 242 të KPP, në "Arrest në burg", parashikuar në nenin 238 të KPP. Gjykata vlerëson edukimin dhe nivelin intelektual të personit nën hetim E.P., por këto të dhëna duhet ta bëjnë atë më diligjent ndaj veprimtarisë së paligjshme e, për më tepër, kriminale.

19. Kundër këtij vendimi, ndër të tjerë, kanë paraqitur ankim personat nën hetim M.M., T.F. dhe E.P. (...)

22. Nëpërmjet ankimit të depozituar më datë 17.2.2021, shtetasi nën hetim E.P., nëpërmjet mbrojtësve të tij, (...) ka parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimeve nr. 14, datë 10.2.2021 dhe nr. 15, datë 13.2.2021: *Termi zëvendësim nuk mund të interpretohet në sensin rëndues. Në rast se prokurori do të kishte pretendime për një fakt të ri penal, rregullat e procedurës parashikojnë dy mundësi: procedimin me anën e arrestimit në flagrancë të kryerjes së veprës penale të re, paraqitjen e një kërkese të re, të argumentuar dhe të mbështetur në prova, në bazë të nenit 244 të KPP. Mënyra se si veproi prokurori dhe vendimmarrja e gjykatës për pranimin e kërkesës së tij, e asgjësojnë vullnetin e ligjvënësit lidhur me qëllimin dhe natyrën garantuese të seancës së marrjes në pyetje, të materializuar në normën e parashikuar nga neni 248 i KPP. Për këto arsye, vendimi i gjykatës për zëvendësimin in peius të masës së sigurimit ndaj të hetuarit E.P., është proceduralisht i pambështetur në ligj.(...)*

23. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 8, datë 2.3.2021, ndër të tjera, ka vendosur: "*1. Miratimin e vendimeve nr. 14, datë 10.2.2021 dhe nr. 15, datë 13.2.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar* për personat nën hetim M.M., T.F.. 2. *Miratimin e Vendimit nr. 14, datë 10.2.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar* për të hetuarin E.P. 3. Shfuqizimin e vendimit nr. 15, datë 13.2.2021 të *Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar* për të hetuarin E.P. 4. Urdhërohet lirimi i të hetuarit E.P. nga ambientet e paraburgimit, nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër.".

24. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, çmon se shkaqet e parashtruara nga mbrojtësit e personave nën hetim M.M. dhe T.F. dhe E.P. mbi ankimet e depozituara dhe pretendimet e paraqitura në gjykimin në apel, nuk gjejnë mbështetje në ligj e në prova mbi ankimin ndaj vendimit nr. 14, datë 10.2.2021; ndërsa gjen të mbështetur pretendimin e mbrojtësit të personit në hetim E.P. në lidhje me shfuqizimin e vendimit nr. 15, datë 13.2.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. (...)

43. Kundër vendimit nr. 8, datë 2.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka depozituar rekurs më datë 2.4.2021 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me të cilin kërkon prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 15, datë 13.2.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sa i takon të hetuarit E.P..

(...)

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

51. Në tërësi, Kolegji vlerëson se rekurset e paraqitur nga M.M. dhe T.F. në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr. 8, datë 2.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me shkaqet e ngritur në rekurs, nuk mund të pranohen.

52. Në lidhje me rekurset e paraqitura nga prokurori dhe personi nën hetim E.P., rezulton se, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka çmuar se gjykata mund të caktojë një masë më të rëndë se ajo e caktuar më herët, por, e ka prishur vendimin e shkallës së parë, për shkak se kërkesa e prokurorit për rëndimin e masës në seancën e marrjes në pyetje të personit të arrestuar, nuk është depozituar më shkrim, por është kërkuar verbalisht në gjykatë dhe kjo gjykatë nuk ka vlerësuar në themel kushtet e caktimit të masës së sigurimit. Në vijim, edhe të çështjeve të ngritura në rekursin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me zbatimin e neneve 248 dhe 260 të KPP, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson të nevojshme t'u japë përgjigje çështjeve ligjore, si vijon: - *Kërkesa e prokurorit për rëndimin e masës së sigurimit duhet t'i paraqitet gjykatës në formë të shkruar, apo mjafton të paraqitet verbalisht në seancë? - A mund të paraqitet kërkesa e prokurorit për rëndimin e masës së sigurimit në seancën e verifikimit të masës së sigurimit të dhënë më parë nga gjykata, të parashikuar nga neni 248 i KPP?*

53. Lidhur me pyetjen e parë të shtruar për diskutim, Kolegji çmon të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo gjykatë me të drejtë ka arsyetuar se, lidhur me institutin e "Zëvendësimit të masës së sigurimit", në adoptim të parimit të përshtatshmërisë së masës me nevojat e sigurimit kërkohet zbutje/rëndim, për ndryshim të situatës, e shkaktuar nga fakte apo veprime të reja, shprehja "*masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet*" (paragrafi 2 i nenit 260 të KPP), tregon nevojën, apo kërkesën e ekzistencës së përhershme të raportit të drejtë të masës përkundrejt rëndësisë së faktit dhe dënimit që mund të caktohet, kërkesë, verifikimi i së cilës, përveçse kur befasojnë fakte apo veprime të reja, përmbushet në procedimin e rishqyrtimit të ekzistencës së mëparshme/*ex ante* mbi faktet paraekzistues, me mundësinë e një riçmuarjeje të ndryshme nga ajo që ka bërë gjykata në momentin që ka caktuar masën. Mundësia e rishqyrtimit nga e para (*ex novo)*, qoftë vetëm e drejtuar në adoptimin e raportit të drejtë të masës të caktuar përkundrejt rëndësisë së faktit dhe dënimit që mund të caktohet, tregon pamundësinë

e krijimit të gjësë së gjykuar siguruese "në gjendjen që janë faktet/aktet gjërat qëndrojnë kështu (*rebus sic standibus)* edhe kur është rasti i "zëvendësimit" të masës, njëlloj si në rastin e "revokimit" të saj. Ndërsa në rastin e revokimit dhe të zëvendësimit të masës së sigurimit në favor të të hetuarit (*pro reo),* për shkak të funksionit sigurues të mbrojtjes, të të drejtave dhe lirisë së të hetuarit/pandehurit që ka gjykata, një kërkesë nga ana e prokurorit nuk është e domosdoshme. Gjykata mund të aktivizohet edhe kryesisht. Përkundrazi, kur është fjala për zëvendësimin e masës së sigurimit me një më të rëndë (*in peius)*, kërkesa e prokurorit është e vetmja që vë në lëvizje gjykatën. Siç edhe në rastin e caktimit të masës, gjykata është e penguar të procedojë kryesisht në zëvendësimin me një masë më të rëndë. Po ashtu, domosdoshmërisht vihet në lëvizje apo procedon mbi bazën e kërkesës së të pandehurit.

54. Me të drejtë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka arsyetuar se, në rastin kur prokurori kërkon zëvendësimin e një mase më të lehtë me një masë më të rëndë (*in peius)*, citimi se kërkesa është bërë me gojë e zë nga prokurori në seancë nuk është provë e ekzistencës së saj. Kërkesa e prokurorit për zëvendësimin e masës së sigurimit në një më të rëndë (*in peius)*, si çdo kërkesë e tij, nga pikëpamja formale është e materializuar me shkrim, pa të cilën gjykata nuk mund të vihet në lëvizje. Në këtë rast, në ndryshim nga rasti i zëvendësimit me një masë më të lehtë, gjykatës i mungon detyrimi ligjor për të zëvendësuar në një më të rëndë kryesisht. Për këtë është i qartë parashikimi i nenin 315 të KPP, i cili normon dokumentimin e veprimeve të prokurorit, e lidhur me parashikimin e nenit 59 të Ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", se: "*Sekretaria e prokurorisë ... vërteton aktet e prokurorisë...*". Nëse përpara gjyqtarit të vetëm që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake nuk është paraqitur kërkesë nga prokurori, e tillë siç kërkon ligji, transformon zëvendësimin e masës si të marrë kryesisht nga ai. Ligji nuk e lejon, madje e ndalon gjyqtarin që kryesisht të caktojë një masë sigurimi personale më të rëndë për të hetuarin.

55. Në mbështetje të këtij arsyetimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çmon të marrë në analizë nenin 260 "*Revokimi, zëvendësimi dhe bashkimi i masave të sigurimit*" të KPP, i cili rregullon rastet e revokimit, zëvendësimit dhe bashkimit të masave të sigurimit. Në pikën 3 të këtij neni parashikohet se: "*Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë caktimin e një mase ndaluese shtesë ose zëvendësimin e saj me një masë shtrënguese.*". Ndërsa në fjalinë e parë të pikës 4 të kësaj dispozite parashikohet se: "*Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj...*". Ky parashikim nuk lë vend për paqartësi. Depozitimi i aktit kërkon pashmangshmërisht ekzistencën e një akti të formalizuar me shkrim.

56. Kjo ka të bëjë me garancinë për mbrojtjen ndaj rrethanës së re, faktit të ri dhe dyshimit se personi për të cilin verifikohen kushtet e masës së sigurimit të dhënë ka kryer një vepër penale tjetër. Jurisprudenca e GJEDNJ ka konsideruar se në rastin e daljes së rrethanave të reja, fakteve të reja, organet proceduese duhet t'i bëjnë të qarta ato dhe t'i japin palës kohën e nevojshme për t'u përgatitur e mbrojtur. (*Gregacevick. Kroacisë, &51, Pelissier e Sassi k.Francës, {DHM}&62, &69-70, Goddi k. Italisë, &31*). Seanca e verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit është një seancë e cila ka si qëllim kontrollin gjyqësor të respektimit të garancive procedurale të të drejtave të personit të dyshuar/hetuar/ personit nën hetim gjatë zbatimit të masës së sigurimit, e një interpretim pajtues të dispozitave tona procedurale me frymën e nenit 5 të KEDNJ, kjo seancë e garancisë që duhet të ofrojë paraqitja para gjyqtarit, nuk mund të shndërrohet në një seancë të vijimit të caktimit të një mase më të rëndë sigurimi pa u bërë të ditura shkaqet, arsyet, rrethanat si dhe pa u bërë shënimet përkatëse të cilësimit juridik të ri apo rrethanës së re dhe emrit të personit në regjistrin e njoftimit të veprës penale, sipas parashikimit të nenit 1&2 të nenit 287 të KPP. Po për këtë, është i nevojshëm hartimi i një kërkese të re për caktim mase sigurie.

57. Sa më lart, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin *se kërkesa e prokurorit për rëndimin e masës së sigurimit duhet t'i paraqitet gjykatës në formë të shkruar ku të pasqyrojë rrethanën apo faktin e ri të dalë, veprën penale të re për të cilën dyshohet personi nën hetim.*

58. Lidhur me pyetjen e dytë të shtruar për diskutim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që ka të bëjë me mundësinë e paraqitjes së kërkesës së prokurorit për rëndimin e masës së sigurimit në seancën e verifikimit të masës së sigurimit të dhënë më parë nga gjykata, të parashikuar nga neni 248 i KPP, Kolegji, çmon të analizojë më parë rolin e seancës së verifikimit të masës së sigurimit të dhënë më parë nga gjykata dhe qëllimin e saj. Seanca e verifikimit të masës së sigurimit të dhënë më parë nga gjykata mbahet pasi është dhënë më parë një masë sigurimi nga gjykata. Kjo dispozitë parashikon se: "*1. Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës,*

gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese, gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës. Mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre. 2. Nëpërmjet marrjes në pyetje, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në të kundërt, gjykata vendos vazhdimin e zbatimit të saj. Gjykata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 48 orëve. 3. Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës. 4. Gjatë debatit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë. 5. Kur pyetja e të arrestuarit duhet të bëhet në gjykatën e një rrethi tjetër, gjykata kërkon që pyetja të bëhet nga një gjyqtar i asaj gjykate. 6. Prokurori nuk mund të marrë në pyetje personin e arrestuar përpara se gjykata të procedojë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.". Nga leximi literal i dispozitës është shumë i qartë roli garantues që legjislatori ka dashur t'i ofrojë personit ndaj të cilit është vendosur masë sigurimi, duke parashikuar një seancë për verifikimin e kësaj mase. Nëpërmjet marrjes në pyetje, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të KPP. Dhënia e masës së sigurimit, për shkak të urgjencës dhe të nevojave për ruajtjen e sekretit hetimor, si rregull bëhet në dhomë këshillimi, pa praninë e personit ndaj të cilit vendoset. Për këtë arsye, është e domosdoshme që gjykata të verifikojë kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit. Kjo, në përputhje të plotë me garancitë e parashikuara në Kushtetutë dhe në Kartat e të drejtave të njeriut, të cilat sanksionojnë të drejtën e qytetarëve për të qenë të lirë dhe që kjo liri t'u hiqet, apo kufizohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj, me një vendim gjyqësor, rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor. Jo më kot legjislatori ka parashikuar të drejtën e mbrojtjes të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre (pika 1 e nenit 248 të KPP); praninë e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje nga gjykata të personit ndaj të cilit është dhënë masa (pika 3 e nenit 248 të KPP); parashikimin e debatit gjyqësor, gjatë të cilit palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë (pika 3 e nenit 248 të KPP). Në këtë mënyrë, legjislatori ka parashikuar zhvillimin e një seance në kontradiktoritet të palëve, duke garantuar barazinë e armëve ndërmjet tyre, me qëllim verifikimin nga gjykata të nevojave të masës së sigurimit të dhënë. Seanca e verifikimit e parashikuar nga neni 248 është një garanci për qytetarin ndaj të cilit

është dhënë masa, e cila nuk mund të zhbëhet. Kjo seancë ka për qëllim verifikimin e kushteve të masës së dhënë më parë nga gjykata dhe nuk mund të shërbejë për dhënien e një mase të re. Për caktimin e një mase të re, më të rëndë, organi i akuzës duhet t'i drejtojë gjykatës një kërkesë të re me shkrim dhe nëse gjykata do të disponojë zëvendësimin e masës me një masë tjetër më të rëndë, duhet t'i ofrojë personit nën hetim garancitë e parashikuara nga neni 248 i KPP, duke i dhënë mundësinë mbrojtjes të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre, të jetë e pranishme gjatë marrjes në pyetje nga gjykata të personit ndaj të cilit është dhënë masa, si dhe mundësinë e zhvillimit të debatit gjyqësor, gjatë të cilit palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë.

59. Në vijim të këtij arsyetimi, lidhur me pyetjen e dytë të shtruar për diskutim, Kolegji *çmon se kërkesa e prokurorit për rëndimin e masës së sigurimit (in peius), nuk mund të paraqitet në seancën e verifikimit të masës së sigurimit të dhënë më parë nga gjykata, të parashikuar nga neni 248 i KPP, por duhet të bëhet me një kërkesë të veçantë në formë të shkruar, ku të argumentojë nevojën për një masë sigurimi më të lartë.*

60. Po të kthehemi në rastin konkret, objekt shqyrtimi, referuar edhe shkaqeve të ngritura në rekurs nga organi i akuzës dhe personi nën hetim E.P., Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon të drejtë vendimarrjen e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si një vendim të drejtë dhe në përputhje me ligjin. Nuk konstatohet që kjo Gjykatë të mos ketë respektuar ose zbatuar gabim ligjin material ose procedural, i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, apo të mos ketë respektuar ose zbatuar gabim ligjin procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave. Ky vendim nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

61. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, vendimi nr. 8, datë 2.3.2021, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet të lihet në fuqi, si vendim i marrë në përputhje me ligjin.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021, datë 14.09.2021

Për cilësimin e drejtë ligjor, apo konkurrueshmërinë e veprave penale në rastin e të njëjtit objekt grupor të veprave penale, e drejta jonë materiale penale i përmbahet parimit të "lex specialis derogat legi generali", dhe më pas parimeve të tjera të përpunuara nga doktrina. Në rastin e disa veprave penale të tjera, ku krahas subjektit të posaçëm, të njëjtën rëndësi ka dhe mbrojtja sa më e madhe e pasurisë së veçantë, objekti i marrëdhënies juridike ka të njëjtën rëndësi si subjekti i saj i veçantë.

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur për gjykim para asaj gjykate çështjen penale në ngarkim të të pandehurit të akuzuar për kryerjen e veprave penale të "*Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën*", të kryer 6 herë, të parashikuar nga neni 135 i KP dhe "*Falsifikimit të dokumenteve të kryer nga personi që ka për detyrë lëshimin e dokumentit, më shumë se një herë, në bashkëpunim*", parashikuar nga neni 186/3 i KP; si dhe në ngarkim të dy të pandehurve të tjerë të akuzuar për veprën penale: "*Falsifikim i dokumenteve i kryer nga personi që ka për detyrë lëshimin e dokumentit, më shumë se një herë, në bashkëpunim*", parashikuar nga neni 186/3 i KP.

1.1. Në gjykim është pranuar dhe paditësi civil në procesin penal, pala e dëmtuar (bankë) në Tiranë, ku është pranuar dhe është gjykuar padia civile.

1.2. Gjykatat kanë pranuar këto rrethana të çështjes: I pandehuri G.M., me detyrë ish-Drejtor (... i bankës) gjatë ushtrimit të detyrës, duke përfituar nga detyra, ka vjedhur paratë e klientëve, (...) si dhe ka vjedhur shuma të hollash në arkën dhe bankomatin e kësaj dege të bankës.

1.3. Në bazë të akuzës së ngritur, rezulton se, në disa raste, për mbulimin e veprimeve të kryera nga të pandehurit, kanë përpiluar dokumente të falsifikuara. (...) Sipas prokurorisë, nga ana subjektive, veprat penale nga i pandehuri G.M. janë kryer me formë faji me dashje direkte dhe me qëllim përfitimin e paligjshëm material, ndërsa nga dy të pandehurit e tjerë me dashje direkte por, nën ndikimin e të pandehurit të parë (...).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (...) ka vendosur: "*1. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.M.* për kryerjen e veprës penale të "*Vjedhjes për shkak të detyrës", e parashikuar nga neni 135 i KP dhe në bazë të këtij neni, dënimin e të pandehurit me 5 (pesë) vjet burgim. 2. Në aplikim të nenit 406 të KPP i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht e pandehura G.M.* dënohet me *3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim. (...) 4. Deklarimin fajtore të të pandehurës E.J. për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve" e parashikuar nga neni 186/3 i KP dhe në bazë të këtij neni, dënimin e të pandehurës me 1 (një) vit burgim. 5. Në aplikim të nenit 406 të KPP i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht e pandehura dënohet me 8 (tetë) muaj burgim. 6. Në aplikim të nenit 59 të KP urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurën në provë, për një periudhë kohore prej 3 (tre) vjetësh me kusht që, gjatë kësaj kohe, e pandehura të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. (...) 8. Deklarimin fajtore të të pandehurës E.C., me të njëjtën akuzë dhe masë dënimi si E.J..*

13. Detyrimin e të padituri-të pandehur G.M. të dëmshpërblejë paditësin civil – i dëmtuar nga vepra penale në shumën (...).

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendin nr. 2173, datë 16.12.2015, ka vendosur: "Lënien në fuqi të vendimit nr. 1487, datë 13.06.2014, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë.".

4. Kundër këtij vendimi, ka ushtruar rekurs Prokurori pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili kërkon prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues, duke parashtruar se gjykata ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale të kryer nga i pandehuri, nga "Vjedhje për shkak të detyrës", 6 herë dhe "Falsifikim i dokumenteve", të parashikuar nga nenet 135 e 186/3 të KP, në "Vjedhje për shkak të detyrës", vetëm një herë, (...) duke e cilësuar veprën penale të kryer, si një krim i vetëm vazhdues.(...)

5. Kundër vendimit, kanë ushtruar rekurs e gjykuara E.C., e cila kërkon prishjen e vendimeve dhe pushimin e çështjes penale pasi veprimet e saj janë kryer me autorizim, nën ndikim dhe shtytjen e drejtorit të bankës dhe gjykata nuk mbajti parasysh nenin 21 të KP, sipas të cilit *"Nuk ka përgjegjësi penale personi që vepron për të ushtruar të drejta apo përmbushur detyra të caktuara me ligj ose nga një urdhër i dhënë nga personi kompetent..."*. *Së dyti*: Cilësimi ligjor i veprës penale sipas nenit 186/3 të KP, është i gabuar, pasi dokumenti që plotëson arkëtarja, nuk përmban asnjë vlerë pasi eliminohet kur mbaron veprimi, nuk përmban cilësitë e vulës, stampës apo formularit, për t'u vlerësuar vepra sipas nenit 186/3 të KP. *Së treti*: Dënimi i të pandehurës është bërë pa marrë parasysh anën subjektive të veprës penale, e cila në rastin konkret provohet se nuk ekziston.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim kolegji), konstaton se, rekurset e paraqitura nga Prokurori dhe nga e gjykuara E.C. janë paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me parashikimet e nenit 435 të KPP. Rekursuesit parashtrojnë pretendime lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal, neni 152 i KPP dhe për zbatim të gabuar të ligjit material penal, e cila ka çuar gjykatën në zbatim të gabuar të nenit 135 të KP për të pandehurin G.M.. I gjykuari G.M. është akuzuar dhe deklaruar fajtor për veprën penale të "Vjedhjes për shkak të detyrës", e parashikuar nga neni 135 i KP dhe në bazë të këtij neni, i pandehuri është dënuar me 5 (pesë) vjet burgim. Për këtë pjesë të vendimit është ushtruar rekurs nga Prokuroria e Apelit Tiranë. Ndërsa e gjykuara E.C., nëpërmjet mbrojtjes së saj, ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit që e ka deklaruar fajtore për veprën penale të "Falsifikimit të dokumenteve", e parashikuar nga neni 186/3 i KP dhe në bazë të këtij neni, e pandehura është dënuar me 1 (një) vit burgim, duke kërkuar prishjen e vendimeve dhe pushimin e çështjes penale.

7. Gjykata e Lartë, sipas ndryshimeve kushtetuese, të nenit 141, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*ligji nr. 76, datë 22.07.2016*), shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, për të siguruar njehsimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Ky parashikim në Kushtetutë është shoqëruar me ndryshime procedurale në Kodin e Procedurës Penale. Neni 432 i KPP, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural, i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

8. Një ndër shkaqet kryesore për të cilat lejohet rekursi është zbatimi i gabuar i ligjit material ose procedural (*errores in iudicando / errores in procedimendo*), që ka një rëndësi themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Qëllimi (*ratio*) i kësaj pjese të dispozitës është që të kushtëzojë proceduralisht ushtrimin e rekursit vetëm për arsye të shkeljeve të ligjit material apo procedural penal, që të mund të krijojë premisë për zhvillim të jurisprudencës dhe të së drejtës gjyqësore në përgjithësi.

9. Shkronja c) e nenit 432 të KPP, ka parashikuar rastin kur ushtrohet rekursi me shkakun se vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me

praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kjo garanton kontrollin gjyqësor në njëtrajtshmërinë e interpretimit gjyqësor. Interpretimi i ligjeve gjyqësisht është kompetencë e gjykatave të zakonshme të juridiksionit të zakonshëm, por në veçanti, e Gjykatës së Lartë, pasi Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin që të njehsojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë një qëndrim në çështje të veçanta me qëllim unifikimin e qëndrimeve nga gjykata e zakonshme.

10. GJEDNJ, në disa vendime, ka vlerësuar se uniformiteti i zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike, që është elementi thelbësor i shtetit të së drejtës{çështja Chapman v. United Kongdom, Vendimi i GJEDNJ datë 18.01.2001}, duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë me garancitë e nenit 6 të KEDNJ. Ky parim, synon të garantojë një stabilitet të caktuar të rendit juridik dhe që të favorizojë besimin e publikut në pushtetin e drejtësisë, i cili sërish është një element thelbësor i shtetit të së drejtës.

11. Gjykimi unifikues është i një kategorie më të veçantë sesa ai njehsues, pasi përbën në një kuptim një cilësi tjetër të gjykimit në Gjykatën e Lartë, të dhënë nga paneli i të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, një "legjislacion gjyqësor" që ka për bazë interpretimin e thellë gjyqësor uniform, që ka rrjedhur si analizë e gjerë e praktikës gjyqësore ndër vite. Vendimet mbi praktikën gjyqësore të unifikuar (*nomofilachia*) janë vendime të detyrueshme për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera dhe për praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (*erga omnes*). Në këtë këndvështrim, gjykatat e zakonshme duhet të jenë të vëmendshme që të ndjekin praktikën e unifikuar dhe atë të njehsuar të Gjykatës së Lartë e t'i përmbahen asaj në vendimmarrjen e tyre.

12. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore të kësaj çështjeje, konstatoi se dy vendime të gjykatave, ai i shkallës së parë dhe i apelit, janë marrë në shkelje të ligjit penal, si dhe në kundërshtim me praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë.

13. E drejta jonë penale materiale, në rastin e veprave penale të kryera nga një subjekt i posaçëm i veprës penale, që ka cilësi të veçanta (*delictum proprium*) në përcaktimin e cilësimit ligjor të faktit, referon tek mbizotërimi i subjektit në këtë rast, për veprën penale që duhet t'i atribuohet autorit të veprës penale. Kolegji Penal, në këtë rast, i referohet teorisë së të drejtës penale, parimeve të përgjithshme juridike mbi të cilat bazohet cilësimi i drejtë ligjor i veprës penale, konkurrimi i veprave penale e normave penale, me qëllim identifikimin e një rendi për zbatimin e dispozitave penale që parashikojnë vepra penale të ndryshme në lidhje me faktin penal të vjedhjes, duke u udhëhequr nga parimi i sigurisë ligjore dhe ai i parashikueshmërisë

së pasojave ligjore. (Shih rastin *Alimuçaj k. Shqipërisë*, nr. 20134/05, datë 07.02.2012, § 150-151, *Baskaya dhe Okçuoglu k. Turqisë,* datë 08.07.1999).

14. Rrethanat që kanë të bëjnë me përcaktimin e subjektit të veprës penale, subjektin aktiv (autorin), ose atë pasiv të veprës penale, referojnë në një subjekt të posaçëm që mban disa cilësi të veçanta. Në këtë rast, kemi të bëjmë me vepra penale të veçanta, domethënë vepra penale që kryhen nga subjekte specifike (*delicta propria*), ndërsa për disa vepra të tjera penale nuk ka ndonjë përcaktim të cilësisë së subjektit që kryen veprën penale dhe parashikohet ose kuptohet se "kushdo" mund të kryejë një vepër penale të caktuar. Në këtë rast, kemi të bëjmë me vepra penale të përgjithshme (*delicta impropria*), domethënë, vepra penale që kryhen nga subjekte të çfarëdoshme, ku cilësimi i subjektit aktiv nuk ka të bëjë me cilësimin e veprës penale. *Për cilësimin e drejtë ligjor apo konkurrueshmërinë e veprave penale në rastin e të njëjtit objekt grupor të veprave penale, e drejta jonë materiale penale i përmbahet parimit të "lex specialis derogat legi generali", dhe më pas parimeve të tjera të përpunuara nga doktrina. Në rastin e disa veprave penale të tjera, ku krahas subjektit të posaçëm, të njëjtën rëndësi ka dhe mbrojtja sa më e madhe e pasurisë së veçantë, objekti i marrëdhënies juridike ka të njëjtën rëndësi si subjekti i saj i veçantë.*

15. Në rastin e veprës penale të "*Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën*", neni 135 i KP, vepra cilësohet e tillë për shkak të subjektit. Në rastin kur objekt i vjedhjes janë "paratë në bankë" dhe vjedhja kryhet nga subjekti i posaçëm, në rastin tonë punonjës i bankës, në këtë rast në Kodin tonë Penal është parashikuar vepra penale e nenit 136 të KP, "vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit". Kjo pasi në këtë rast qëllimi i rrethanës cilësuese të parashikuar në nenin 136 të KP është mbrojtja e pasurisë së bankës në momentin e ndodhjes së faktit të vjedhjes, për shkak të rëndësisë së posaçme të pasurisë së bankës, që kryesisht konsiston në paratë e mbledhura nga publiku dhe për të cilat, garantohet një mbrojtje dhe një besueshmëri e lartë e tyre, ku edhe siguria e ruajtjes duhet të jetë maksimale. Vjedhja në këto kushte, është një sjellje që shkakton një pasojë, e cila tregon një rrezikshmëri më të madhe e të veçantë të personit që kryen veprën, duke vendosur kështu norma theksin në objektin material, që është pasuria e bankës dhe jo vetëm për shkak të vendit ku ndodh vepra. Ndërsa, në rastin e veprës penale të parashikuar nga neni 135 i KP, qëllimi i parashikimit ligjor është mbrojtja e pasurisë nga personi që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë; pra, norma parashikon një subjekt të posaçëm, si element të figurës së veprës penale dhe jo objektin e saj, që mund të konsistojë në çfarëdolloj marrëdhënieje pasurore, përveç asaj të bankave.

16. Në veprën penale të vjedhjes së bankës, duke pasur parasysh qëllimin e dispozitës penale, për shkak të rëndësisë së posaçme të marrëdhënies juridike dhe institucionit të cilit i referohet rrethana cilësuese, që është "banka" dhe rrethana cilësuese për qëllim të zbatimit të normës, duhet kuptuar në një mënyrë më të gjerë se ai që lë të kuptohet termi "bankë". Kjo për faktin se rëndësia e posaçme e marrëdhënies, qëllimi (*ratio)* i parashikuar nga norma, konsiston në vlerësimin e ekzistencës së një risku të shtuar, që vendos në rrezik më të madh vetëm pasurinë e bankës. Kjo edhe për shkak të një komplikimi dhe rëndimi të mundshëm të situatës që do të vinte si rezultat i zbulimit eventual të personit që kryen vjedhjen, nga prania e rojeve të armatosura në bankë, dhe nga një zhvillim i pritur i shtimit të egërsisë së veprimeve të personit (subjekt aktiv të vjedhjes) që futet në një ambient të tillë dhe që mund të sjellë si pasojë edhe përballjen direkte dhe të rrezikshme të këtij personi me të gjithë personat që ndodhen në bankë.

17. Kriteri bazë për individualizimin e kritereve mbi bazën e të cilave mund të konkludohet për zbatueshmërinë e dispozitës në fjalë, nëse një vend duhet të hyjë në fushëzbatimin e nenit 136 të KP, është ai material sipas të cilit kërkohet përkatësia e mjedisit ku konsumohet vepra penale që duhet të jetë bankë, në kuptimin persona juridikë që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji "*Për bankat në Republikën e Shqipërisë*". Në rastin në shqyrtim, i gjykuari G.M., me detyrë ish-Drejtor i Degës (...), është gjykuar për vjedhje të parave të këtij filiali banke gjatë ushtrimit të detyrës, thënë ndryshe, "Pasuria" e bankës, që ligjërisht ka të drejtë ta disponojë banka si person juridik sipas organeve përkatëse, në emër dhe për llogari të saj, dhe jo punonjësit e saj në mënyrë të paligjshme. Duke vënë theksin në rëndësinë e posaçme të objektit të veprës penale, në bazë të parimit të specialitetit, vërehet se specialiteti i objektit të veprës penale të vjedhjes së bankave, është më i posaçëm sesa specialiteti i subjektit pasiv të veprës penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën. Në rastin e nenit 135 të KP, personi i posaçëm vjedh një pasuri që e ka në disponim atë, por jo atë bankare. Kësisoj, në bazë të parimit të subsidiaritetit, përparësi duhet të gjejë neni 136 i KP, pavarësisht cilësisë së personit punonjës ose jo, që ka vjedhur pasurinë e bankës. Ligjvënësi ka dashur t'i sigurojë një mbrojtje të veçantë pasurisë së bankës, si një institucion që ushtron veprimtarinë e pranimit të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku, duke i përdoruar ato për dhënie kredie dhe vendosur në emër dhe për llogari të saj.

18. Në referim të nenit 135 të KP që parashikon veprën "vjedhje duke shpërdoruar detyrën", me nocionin "ruajtje të pasurisë", do të kuptojmë mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e pasurisë, me qëllim që të mos e sulmojnë, dëmtojnë apo vjedhin atë. Kurse, personi që ruan pasurinë, është ai i cili

është ngarkuar për ta mbajtur apo për t'u kujdesur për atë pasuri. Ndërsa me nocionin "administrim" të pasurisë do të kuptojmë kujdesin e treguar për pasurinë, që ajo të përdoret mirë sipas rregullave ose sipas nevojave për ruajtjen e asaj pasurie, në bazë të drejtimit dhe organizimit të punës në një fushë të caktuar, në bazë të rregullave teknike dhe ligjeve përkatëse të shtetit.

19. Në lidhje me veprën e vjedhjes së bankës nga ana e punonjësit të bankës, nëse do t'i cilësonim veprimet kriminale të punonjësit të bankës, sipas nenit 135 të KP, duke i dhënë përparësi subjektit të posaçëm, kjo normë nuk do përmbante të gjitha elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 136 i KP, për faktin se kjo normë nuk ka si objekt material pasurinë e bankës, por një objekt të përgjithshëm, që konsiston në çdo pasuri që është nën ruajtjen dhe administrimin e subjektit aktiv të posaçëm, përveç pasurisë së bankës për të cilën ligjvënësi ka parashikuar enkas një vepër penale të posaçme.

20. Në lidhje me diskutimin nëse "Personi, i cili vjedh pasurinë e bankave apo të arkave të kursimit, gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave për administrimin apo ruajtjen e kësaj pasurie, do të përgjigjet për veprën penale të "Vjedhjes së bankave apo arkave të kursimit" parashikuar nga neni 136 i KP apo "Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën", parashikuar nga neni 135 i KP, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me Vendimin nr. 3, datë 02.11.2015, kanë arritur në përfundimin unifikues se: personi, i cili vjedh pasurinë e bankave, gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave për administrimin apo ruajtjen e kësaj pasurie, do të përgjigjet për veprën penale të "Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit", parashikuar nga neni 136 i KP.".

21. Në këtë linjë argumentimi, vepra penale e kryer nga i pandehuri G.M., ndryshe nga sa kanë konkluduar gjykatat, në referim të vendimit nr. 3, datë 02.11.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet të cilësohet si "Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit" me pasoja të rënda, në bazë të nenit 136/2 të KP. Për rrjedhojë, vendimi nr. 2173, datë 16.12.2.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr. 1487, datë 13.06.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material si dhe janë dhënë në kundërshtim me praktikën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

22. Në këto kushte, rekursi i ushtruar nga Prokuroria e Apelit Tiranë është i bazuar, e për pasojë, duhen prishur vendimi nr. 2173, datë 16.12.2.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr. 1487, datë 13.06.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe çështja dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me tjetër trup gjykues.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-53, datë 07.10.2021

Në rastet e riekstradimit, gjykatat duhet të mbajnë parasysh detyrimet që burojnë nga neni 14 dhe 15 i Konventës Evropiane të Ekstradimit, të cilat kërkojnë marrjen e pëlqimit nga ana e shtetit që ka kërkuar ekstradimin nga shteti shqiptar përpara vijimit me procedurën e vlerësimit të kushteve për ekstradim.

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur për shqyrtim, në datë 21.12.2020, para asaj gjykate, kërkesën me objekt: Miratimin e ekstradimit të shtetasit norvegjez (...) nga Republika e Shqipërisë për në Norvegji. Mbajtjen në paraburgim me masë sigurimi "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, deri në ekstradimin e shtetasit G.I., për në Norvegji.

2. Ka rezultuar se ndaj shtetasit G.I., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me vendimin me nr. (55-2019-1395)111, datë 26.11.2019, ka caktuar masën e sigurimit personal "arrest në burg", në mungesë, parashikuar nga neni 238 i KPP-s, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Trafikim i mjeteve motorike", parashikuar nga neni 141/a/1 i KP dhe aktualisht çështja penale në ngarkim të tij po gjykohet në themel. Në bazë të këtij vendimi është bërë edhe shpallja për kërkim ndërkombëtar të shtetasit G.I..

3. Me shkresën nr. 213/7prot./M.I, datë 09.10.2020, nga Prokuroria e Përgjithshme është përcjellë njoftimi i ZQK Interpol Tirana, me të cilën është njoftuar se më datë 16.10.2020 do të kryhet ekstradimi nga Danimarka në Shqipëri i shtetasit G.I., në zbatim të vendimit nr.(55-2019-1395)111, datë 26.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës e cila kishte caktuar masë sigurimi "arrest në burg" në mungesë.

4. Në datë 16.10.2020, ora 17:30 nga oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë Vendore Kukës, është mbajtur procesverbali i ekzekutimit të urdhrit të prokurorit dhe dërgimi i tij në Institutin e Ekzekutimeve Vendore Penale Kukës. Me vendimin nr.(1015)98, datë 19.10.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur: *"Vleftësimin e ligjshëm të zbatimit të masës së sigurimit të "arrest në burg", caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës*

me vendimin nr.(1595)111, datë 26.11.2019, ndaj shtetasit G.I.. Vazhdimin e masës sigurimit "arrest në burg" caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me vendimin nr.(1595)111, datë 26.11.2019 ndaj shtetasit G.I..".

5. Me shkresën nr.14288/3 KL.Prot/KA/2020, datë 13.11.2020, Zyra Qendrore Kombëtare (ZQK) Interpol Tirana ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë së shtetasi norvegjez G.I., lindur më 12.12.1978, rezulton i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Autoritetet Norvegjeze të Drejtësisë.

6. Rezulton se në ngarkim të shtetasit G.I., Gjykata e Distriktit të Oslos/Norvegji, ka lëshuar urdhrin e arrestit ndërkombëtar (...), datë 05.11.2020, për veprën penale "Shkelje e ligjit për lëndët narkotike", për të cilën maksimumi i dënimit është 21 vjet burg.

7. Referuar kërkesës për verifikim shtetësie, ZQK Interpol Tirana me shkresën nr.14288/5vlProt/KA/2020, datë 24.11.2020 ka informuar se ky subjekt nuk ka shtetësi shqiptare.

8. Me shkresën nr.1536/3Prot.B.SH., datë 23.11.2020, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të "Konventës Evropiane të Ekstradimit", të vitit 1957, nenit 489 të KPP, si dhe neneve 32 e 33 të ligjit Nr.10193, datë 03.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", i komunikon Prokurorisë së Përgjithshme shkresën nr.14288/3KL.Prot/KA/2020, datë 13.11.2020, e ardhur nga Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana me të cilën është transmetuar kërkesa e autoriteteve kompetente në Norvegji për ekstradimin e Shtetasit G.I..

Me shkresën nr.213/19, prot.G/K/M.I, datë 14.12.2020, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës kërkesën dhe dokumentacionin përkatës të Autoriteteve Norvegjeze të Drejtësisë, për ekstradimin nga Shqipëria në Norvegji të shtetasit norvegjez G.I..

9. Për efekt të procedurave për ekstradim, me vendim të datës 23.12.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur: "*Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Të caktojë ndaj G.I., masën shtrënguese "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i KPP-s për efekt ekstradimi. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë Tiranë*".

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me vendimin Nr.(172) 1, datë 02.03.2020 ka vendosur: Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Të miratojë ekstradimin e shtetasit G.I.. (...)

11. Gjykata ka arsyetuar se ekstradimi i një personi nga Republika e Shqipërisë në shtetin kërkues, si dhe kushtet ligjore për ekstradimin e një personi në shtetin kërkues parashikohen nga nenet 488, 489, 490 e vijues të KPP, si dhe Konventa Evropiane "Për ekstradimin", neni 11 i KP, Ligji nr.10193, datë 03.12.2010 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale". Këto dispozita, përveç sa më sipër, parashikojnë rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur për paraqitjen e kërkesës për ekstradim, organet kompetente që shqyrtojnë kërkesat për ekstradim, etj.,. Për shkak të natyrës dhe objektit të kësaj kërkese, këto kërkesa janë pjesë e marrëdhënieve juridiksionale ndërshtetërore. Për pasojë, dispozitat e mësipërme aplikohen nga autoritetet gjyqësore shqiptare pasi të jetë shprehur interes për ekstradimin e shtetasit të kërkuar.

12. Në rastin konkret, nga administrimi i akteve shkresore dhe përgjigjet e dhëna nga palët pjesëmarrëse në këtë proces gjykata vëren se vepra penale për të cilën kërkohet është në proces, pa u dhënë një vendim përfundimtar dhe i cili është duke u kërkuar për ekstradim për veprën penale të parashikuar nga legjislacioni norvegjez "Shkelja e ligjit për lëndët narkotike" parashikuar me dënim deri në 21 vjet burgim. Një vepër penale e tillë parashikohet dhe është e dënueshme në mënyrë të ngjashme edhe sipas legjislacionit penal shqiptar, "Prodhimi dhe shitje të lëndëve narkotike", e parashikuar nga neni 283 i KP. Nuk ka asnjë hetim të nisur apo të përfunduar nga autoritetet e drejtësisë shqiptare kundër shtetasit G.I. për këtë vepër penale. Nuk është në fuqi asnjë amnisti e dhënë nga shteti shqiptar për llojin e veprës penale për të cilën kërkohet shtetasi G.I.. Nuk rezultoi të jetë dhënë amnisti për këto vepra penale nga shteti norvegjez. Po ashtu, nuk rezulton të jetë parashkruar ndjekja penale për këtë vepër.

13. Një ndër kushtet kryesore për pranimin e kërkesës së ekstradimit është parimi i specialitetit. Konventa e ka normuar në nenin 14 të saj e ndërsa KPP në nenin 490. Thelbi i parimit është që personi që do të ekstradohet nuk do të ndiqet, nuk do të procedohet, nuk do të dënohet dhe nuk do të mund të ekstradohet në ndonjë vend tjetër për vepra penale që kanë ndodhur para kërkesës për dorëzimin dhe që janë të ndryshme nga vepra apo veprat e përmendura në kërkesën fillestare. Më rastin konkret gjykata akordon ekstradimin e shtetasit G.I. me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën eshtë dhënë ekstradimi, por vetëm për ekzekutimin e vendimit për të cilin jepet ekstradimi.

14. Fakti që shtetasi G.I. është duke u proceduar në shtetin shqiptar për llogari të hetimit të nisur prej autoritetve të drejtësisë shqiptare nuk e pengon miratimin e kërkesës për ekstradim me kusht që ai të ekzekutohet pasi të ketë përfunduar procesin e gjykimit apo të dënimit në shtetin shqiptar, kjo në kuptim të nenit 500 të KPP.

15. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka ushtruar ankim shtetasi G.I. i cili kërkon: "Ndryshimin e vendimit Nr. (172) 1, datë 02.03.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe refuzimin e ekstradimit të shtetasit norvegjez G.I. drejt Mbretërisë së Norvegjisë.". Ankuesi pretendon se gjykata ka dhënë një vendim në kundërshtim me ligjin procedural penal. Gjykata nuk duhet ta pranonte kërkesën për ekstradim pasi ndaj tij është duke u gjykuar nga autoritete gjyqësore akuza për kryerjen e veprës penale "Trafikim i mjeteve motorike", parashikuar nga neni 141/a i KP dhe për pasojë, kjo përbënte shkak për mospranimin e kërkesës në kuptim të nenit 491/a i KPP. Gjithashtu në kuptim të nenit 501/1 i KPP duhet t'i ishte marrë pëlqimi shtetit të Danimarkës nga i cili është ekstraduar shtetasi G.I., fakt i cili përbën pengesë për të kryer riekstradim drejt Mbretërisë së Norvegjisë.

16. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 156, datë 09.06.2021, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. (172) 1, datë 02.03.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.(...)*

17. Kundër vendimit nr. 156, datë 09.06.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka paraqitur rekurs, më datë 23.07.2021, G.I., nëpërmjet mbrojtësit të tij (...), me të cilin kërkon: *Prishjen e vendimit nr.* (172) 1, datë 02.03.2021*, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës lënë në fuqi me vendimin nr. 156, datë 09.06.2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Refuzimin e ekstradimit të shtetasit norvegjez G.I. nga Republika e Shqipërisë drejt Mbretërisë së Norvegjisë,* duke parashtruar të njëjtat shkaqe si në ankimin drejtuar Gjykatës së Apelit (...)

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

20. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (*në vijim Kolegji*), në dhomë këshillimi çmoi se rekursi i paraqitur plotëson kriteret formale për të shqyrtuar çështjen, duke vlerësuar se përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP. Në këto rrethana procedurale, Kolegji bazuar në nenin 436, pika "2" e KPP vendosi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, për të analizuar shkaqet e paraqitura nga prokurori në këtë rekurs. Kjo bazuar në nenin 426/a të KPP-s, i ndryshuar me ligjin nr. 41/2021 ku thuhet se: "Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomë këshillimi".

21. Kolegji, duke iu rikthyer çështjes në fjalë, në fillim evidenton faktin se gjykata e faktit nuk ka përcaktuar drejt karakterin e kërkesës për të cilën është vënë në lëvizje nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Nga aktet e administruara në dosje rezulton e provuar se shtetasi norvegjez G.I., është ekstraduar në datë 16.10.2020 nga Danimarka për në Shqipëri, në zbatim

të vendimit nr.(55-2019-1395)111, datë 26.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës e cila kishte caktuar për të masë sigurimi "arrest në burg", në mungesë. Ky fakt është pranuar në analizimin e rrethanave të çështjes nga Gjykatat e faktit por nuk është vlerësuar në vijim të vendimmarrjes së tyre. Fakti që ky shtetas ndodhet në Shqipëri për shkak të procedurave të ekstradimit, e vendos kërkesën e Mbretërisë Norvegjeze për ekstradim në planin e një kërkese për riekstradim ndaj shtetasit të saj G.I..

22. Rezulton se në datë 13.11.2020, Zyra Qendrore Kombëtare (ZQK) Interpol Tirana ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë se shtetasi norvegjez G.I., lindur më 12.12.1978, rezulton i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Autoritetet Norvegjeze të Drejtësisë dhe është lëshuar urdhri i arrestit ndërkombëtar (...), në datë 05.11.2020, për veprën penale "Shkelje e ligjit për lëndët narkotike", për të cilën maksimumi i dënimit është 21 vjet burg. Pra referuar këtyre të dhënave rezulton se shteti norvegjez e ka shpallur në kërkim më vonë se është ekstraduar nga Danimarka për në Shqipëri shtetasi G.I.. (...)

24. Nga tërësia e këtyre akteve Kolegji arrin në vlerësimin se kërkesa e bërë nga Autoritetet e Drejtësisë Norvegjeze drejtuar shtetit Shqiptar është një kërkesë riekstradimi, pasi prej Autoriteteve të Drejtësisë Norvegjeze kërkohet ekstradimi i një shtetasi i cili ndodhet përpara Autoriteteve të Drejtësisë Shqiptare si pasojë e ekstradimit të tij nga shteti i Danimarkës.

25. Kolegji evidenton se instituti i riekstradimit në një shtet të tretë gjen rregullim si në legjislacionin e brendshëm ashtu edhe atë ndërkombëtar. Konkretisht, Konventa Euvopiane e Ekstradimit e datës 13.12.1957, e ratifikuar me ligjin Nr.8322, datë 02.04.1998 nga Republika e Shqipërisë. Neni 14 i Konventës Evropiane për Ekstradimin (ETS Nr. 24) (Ekstradimi për vepra penale të kryera para ekstradimit) *(Rule of speciality*), Paragrafi 1 i këtij neni parashikon parimin që një person i ekstraduar nuk mund të procedohet ose të dënohet ose të ndalohet për një vepër të ndryshme nga ajo çfarë përbën bazën e ekstradimit. Nënparagrafët (a) dhe (b) të këtij paragrafi parashikojnë përjashtimet e mëposhtme ndaj këtij parimi: Nënparagrafi (a): Nëse Pala të cilës i kërkohet ekstradimi bie dakord, ekstradimi mund të shtrihet dhe për vepra të tjera të kryera para ekstradimit. Për të arritur një pëlqim të tillë, pala kërkuese duhet të parashtrojë një kërkesë të shoqëruar nga të njëjtat dokumente siç kërkohet në Nenin 12, në mbështetje të kërkesës për ekstradim dhe me anë të një dosjeje zyrtare të deklaratave të personit të ekstraduar, të përpiluar nga një autoritet gjyqësor. Në disa vende, deklarata e personit të ekstraduar që lidhet me një vepër të re për të cilën ai akuzohet është pjesë e proceseve gjyqësore, dhe kështu mund të konsiderohet se cenon parimin e gjykimit për vepra penale të cilat nuk lidhen me arsyen

e ekstradimit. Gjithsesi, mund të duket e domosdoshme që personit të ekstraduar t'i jepet mundësia e bërjes së një deklarate në lidhje me një çështje të re para se të merret ndonjë vendim për zgjatjen e ekstradimit të tij në lidhje me veprën e re. Pra sipas frymës së Konventës pëlqimi i personit që kërkohet të ekstradohet nuk e pengon ekstradimin.

26. Në nenin 15 "Riekstradimi në një shtet të tretë" ka përcaktuar se "*Me përjashtim të rastit të parashikuar në paragrafin 1, kryerreshti "b" i nenit 14, pëlqimi i palës së kërkuar do të jetë i nevojshëm për t'i dhënë mundësi palës kërkuese t'i dorëzojë një pale tjetër apo një shteti të tretë individin që i është kthyer dhe është kërkuar nga pala tjetër apo një Shteti të tretë individin që i është kthyer dhe është kërkuar nga pala tjetër ose nga shteti i tretë për shkelje të kryera para dorëzimit.....*". Pra ky nen parashikon se pala së cilës i kërkohet ekstradimi mund ta çojë personin e ekstraduar tek një Shtet i tretë vetëm nëse pala të cilës i kërkohet ekstradimi bie dakord ose nëse personi i ekstraduar nuk është larguar nga territori i palës kërkuese, megjithëse ka pasur mundësi të largohet, brenda një periudhe të caktuar pas lirimit të tij përfundimtar ose është kthyer në të njëjtin territor pas largimit prej tij.

27. Ndërsa në nenin 14 "Rregulla e specialitetit" të Konventës, ka përcaktuar në mënyrë taksative se: "*1 - Individi që dorëzohet nuk duhet të ndiqet, as të gjykohet dhe as të burgoset për vuajtjen e një dënimi ose të një mase sigurimi; as duhet t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale për çfarëdo veprimi që është kryer para dorëzimit dhe që nuk hyn në motivet e ekstradimit, me përjashtim të këtyre rasteve: a) kur pala që e ka dorëzuar jep pëlqimin e vet. Për këtë qëllim bëhet...*". Këto rregullime të Konventës Evropiane të Ekstradimit janë materializuar në legjislacionin e brendshëm që ka të bëjë si me moszgjerimin e veprave penale për të cilin mund të ndiqet penalisht, dënohet apo të vuajë dënim tjetër të ndryshëm nga ai i lejuar në vendimin e miratimit të ekstradimit, por si edhe riekstradimin e të ekstraduarit në një shtet palë të konventës apo shtet tjetër i cili nuk është palë e konventës por mund të ketë marrëveshje dypalëshe për ekstradim.

28. Këto parime kanë gjetur materializim në nenin 490 të KPP, "Kushtet për ekstradim" dhe në nenin 501të KPP, "Zgjerimi i ekstradimit të dhënë dhe riekstradimi". Neni 501 i Kodit të Procedurës Penale (Zgjerimi i ekstradimit të dhënë dhe riekstradimi) parashikon se: "Në rast kërkese të re ekstradimi, të paraqitur pas dorëzimit të të ekstraduarit dhe që ka si objekt një vepër penale të ndodhur para dorëzimit, të ndryshme nga ajo për të cilën ekstradimi është dhënë, respektohet për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat e këtij kreu (*Kreu 1. Ekstradimi*). Ndërsa paragrafi 4 parashikon se: "Dispozitat e sipërme zbatohen edhe në rastin kur shteti, të cilit i është dorëzuar personi, kërkon pëlqimin për riekstradimin e po këtij personi në një shtet tjetër".

29. Kyqëndrimmbështetetedhenëshkresënmenr.RA-2020-1900221-9, datë 23.10.2020, të Drejtorit të Prokurorisë Publike të shtetit të Danimarkës, i cili konfirmon miratimin e kërkesës për ekstradimin e bërë nga Autoritetet e Drejtësisë prej Gjykatës së Rrethit të Kopenhagës, vendim i cili është marrë në datë 22.07.2020. Në këtë akt Autoritetet e Drejtësisë Daneze kanë përcaktuar dhe vendosur kushtin që sipas "Aktit Danez mbi Ekstradimin e Kundërvajtësve", në nenin 29, për shtetin shqiptar, lind detyrimi që *personi për të cilin lejohet ekstradimi nuk duhet të konsiderohet përgjegjës ose të ri-ekstradohet në një shtet të tretë në lidhje me ndonjë vepër tjetër penale të kryer para ekstradimit të tij, përveçse në rrethanat kur gjykata daneze e ka lejuar atë në përputhje me nenin 41.*

30. Kolegji thekson se gjykatat e faktit duhet të shqyrtonin dhe vlerësonin kërkesën e Mbretërisë Norvegjeze në zbatim të këtyre dispozitave ligjore në fillim, pastaj duke vijuar me tej me analizimin e kushteve dhe ndalimeve për pranimin ose mospranimin e kërkesës për ekstradim, siç edhe kanë vepruar në analizimin e tyre gjatë shqyrtimit të kërkesë për ekstradim. Kolegji thekson se kushti i shprehur në neni 490 i KPP dhe në nenin 14 të Konventës Evropiane të Ekstradimit duhet vlerësuar si një kusht i cili Shteti Shqiptar jo vetëm duhet të kërkojë që ta respektojnë shtetet ndaj të cilit lejon një shtetas të ekstradohet por edhe duhet ta respektojë kur ka ekstraduar nga një shtet tjetër, me pasojë cenimin e reputacionit dhe besueshmërisë në rangun ndërkombëtar të shtetit shqiptar në respektimin e detyrimeve ndërkombëtare për të cilat ka marrë angazhim për t'i zbatuar dhe respektuar.

31. Kolegji vlerëson se nga tërësia e akteve kërkesa e Autoriteteve të Drejtësisë Norvegjeze është në përputhje me nenin 491 të KPP dhe se fakti që i kërkuari për ekstradim është duke u gjykuar për një vepër penale në shtetin shqiptar nuk përbën pengesë për ekstradim pasi në këtë moment gjen zbatim neni 500 i KPP që pezullon ekstradimin derisa i ekstraduari të gjykohet dhe të vuajë dënimin në territorin shqiptar, vepër penale për të cilën ai është ekstraduar. *Në rigjykim, Gjykata e Apelit duhet të veprojë në përputhje me detyrimet që burojnë nga neni 14 dhe 15 i Konventës Evropiane të Ekstradimit dhe neni 501 i KPP dhe vetëm pasi të marrë pëlqimin e shtetit të Danimarkës prej nga shteti shqiptar ka marrë nëpërmjet procedurave të ekstradimit shtetasin G.I., atëherë mund të vijojë me procedurën e vlerësimit të kushteve për ekstradim.*

32. Në përfundim, Kolegji çmon se, rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga shtetasi norvegjez G.I. përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP, e si i tillë duhet të pranohet, duke disponuar për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021-670, datë 26.10.2021

Ekzistenca e një mase të mëparshme të largimit nga detyra, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, është një kriter përjashtues për t'u emëruar në pozicione të caktuara publike. Periudha kohore brenda të cilës masa disiplinore duhet të jetë në fuqi, në asnjë rast nuk lidhet me masën disiplinore të largimit apo shkarkimit nga detyra, por lidhet me masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji.

Objekti i veprës penale të falsifikimit të dokumenteve është marrëdhënia juridike konkrete që garanton veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike, si dhe të personave privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumenteve nga veprimet kriminale. Në këtë kuptim, objekt i falsifikimit janë si aktet zyrtare ashtu edhe ato private.

Ndonëse Kodi Penal nuk jep përkufizim, nga jurisprudenca kuptohet se falsifikimi ka të bëjë me paraqitjen në një dokumenti të rrethanave të rreme, që kryhet nëpërmjet ndryshimit mekanik të dokumentit ekzistues, falsifikimit material, ose përpilimit të një dokumenti krejtësisht të falsifikuar, ndryshe falsifikimi intelektual. Falsifikimi ideologjik ose intelektual quhet i realizuar edhe në rastin kur hartuesi i një dokumenti është i ngarkuar nga ligji për të deklaruar të vërtetën në dokumentin e tij.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi i kësaj çështjeje me procedurën e gjykimit të zakonshëm rezultoi se Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në datën 07.02.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. 56, të vitit 2020, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i KP, në ngarkim të personit nën hetim L.D..

2. Me vendimin nr. 82, datë 17.06.2017[44], të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë shtetasi L.D. është zgjedhur Gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të

[44] Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 133, datë 19.06.2017

Apelimit, një nga institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aneksi "Rivlerësimi Kalimtar i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve", neni C "Dispozita të Përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit" dhe ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Zgjedhja e tij në përbërje të këtij institucioni kushtetues ka ardhur si pasojë e një procesi të administruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

3. Në datën 03.02.2017 shtetasi L.D. ka paraqitur kërkesë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me objekt "Për aplikimin, emërimin e kërkuesit në vendet vakante të shpallura në bazë të ligjit nr. 84/2016", dhe ka aplikuar për t'u emëruar në vendin vakant a) Gjyqtar i Kolegjit të Apelimit; b) Anëtar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; c) Komisioner publik. Kjo kërkesë për aplikim, është paraqitur në dy kopje; një kopje në gjuhën shqipe dhe një kopje në gjuhën angleze, të nënshkruara prej tij. Në kërkesën për aplikim, i pandehuri L.D., ndër të tjera, ka deklaruar se "*...kam ushtruar profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë, i regjistruar në këtë dhomë në datën 27.03.2000, jam vlerësuar për aftësitë e mia profesionale dhe me rekomandime të profesorëve të këtij fakulteti për jetën akademike, ndaj meje nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit".*

6. (...), nga një kallëzim i paraqitur në Prokurorinë e Posaçme dhe materialet bashkëngjitur atij, ka rezultuar se shtetasi L.D. deri në vitin 1997 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 6, datë 24.12.1997, pas propozimit të Ministrit të Drejtësisë, në nenin 1, ka vendosur: *"z. L.D., largohet nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjës dhe paaftësi në detyrë".* Sipas përmbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë të datës 24.12.1997 ka rezultuar se shtetasi L.D. ka qenë i pranishëm personalisht në këtë mbledhje dhe ka parashtruar qëndrimin dhe shpjegimet e tij ndaj kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për largimin nga detyra. Gjithashtu, shtetasi L.D. ka paraqitur në vitin 2016 kërkesë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë për emërimin në detyrën e gjyqtarit, kërkesë që është marrë në shqyrtim në mbledhjen e datës 15.11.2016, por ai është skualifikuar me arsyetimin se është larguar nga detyra me vendimin nr. 7, datë 24.12.1997, të KLD.

7. Mbi këto fakte, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e kallëzimit penal nr. 36, datë 27.01.2020,

datë 07.02.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. 56 të vitit 2020, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i KP. Me vendimin e prokurorëve të datës 15.07.2020, personit nën hetim L.D. i është komunikuar akuza duke u marrë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186/1 i KP. (...)

18. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 32, datë 01.12.2020, ndër të tjera, ka vendosur: *"1. Deklarimin fajtor të të pandehurit L.D., për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", të parashikuar nga neni 186/1 i KP dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale brenda një afati prove prej 12 muajsh" (...)*

30. Si konkluzion, Gjykata vlerëson se në këtë rast jemi para ekzistencës së faktit penal, se i pandehuri L.D. ka konsumuar elementët e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve" të parashikuar nga neni 186/1 i KP e se ai duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale.

31. Ndaj vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim i pandehuri L.D., me të cilin ka kërkuar ndryshimin/prishjen e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit L.D. për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186/1 i KP, për shkak se del qartë se fakti penal nuk përbën vepër penale dhe në thelb as nuk ekziston.(...)

33. Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka paraqitur apel kundërshtues me të cilin ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

34. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 5, datë 08.03.2021, ndër të tjera, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 32, datë 01.12.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar."(...)*

35. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar në të njëjtën linjë me gjykatën e shkallës së parë, *(omissis),* duke argumentuar ndër të tjera se i çmon të pabazuara pretendimet e ngritura në ankimin e kërkuesit. (...)

47. I pabazuar në prova vlerësohet nga ky kolegj edhe pretendimi tjetër se nuk ka qenë në dijeni të masës disiplinore "largim/shkarkim nga detyra" dhënë ndaj tij nga KLD në vitin 1997, kur provohet se ai ka qenë i pranishëm në mbledhje dhe ka kundërshtuar kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për largimin e tij nga detyra. Edhe pretendimi tjetër, se në vitin 2016 nuk është njoftuar për arsyen e mospranimit të kërkesës së tij për t'u riemëruar gjyqtar, nuk qëndron.

48. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs, në datën 20.04.2021, kërkuesi L.D. me anë të së cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit nr. 5, datë 08.03.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim duke vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të të dënuarit L.D. dhe deklarimin e tij të pafajshëm për veprën penale "Falsifikimi dokumenteve" të parashikuar nga neni 186/1 të KP, për shkak se del qartë se fakti penal nuk përbën vepër penale dhe në thelb as nuk ekziston.(...)*

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit

50. Në lidhje me çështjen e përshpejtimit të shqyrtimit të rekursit janë paraqitur dy kërkesa të veçanta, njëra prej Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe tjetra prej të gjykuarit L.D.. Të dy kërkuesit parashtrojnë në kërkesë nevojën që kjo çështje të gjykohet me përparësi nga Gjykata e Lartë, për shkaqe që lidhen me mos pengimin e veprimtarisë dhe funksionimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në drejtim të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Të njëjtin mendim ka shprehur edhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit në kërkesën drejtuar Gjykatës së Lartë.

51. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (referimi i mëposhtëm, Kolegji) ka vlerësuar që çështjen objekt gjykimi ta marrë në shqyrtim me përparësi dhe tej rregullit të përgjithshëm që parashikon shqyrtimin e rekurseve, referuar datës së regjistrimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të rëndësisë dhe të interesit publik që ajo mbart. Pa lënë mënjanë rëndësinë që ka çdo çështje e depozituar në Gjykatën e Lartë, vlerësohet se një çështje e tillë paraqet në vetvete një nevojë të madhe publike për shpejtësi gjykimi, për arsye se kërkuesi L.D. ka qenë në detyrën e Gjyqtarit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, një nga institucionet e parashikuara nga Kushtetuta, për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Për shkak të rëndësisë dhe rolit të pazëvendësueshëm që ka Kolegji i Posaçëm i Apelimit në mbarëvajtjen e reformës në drejtësi, që është një proces thelbësor për ecurinë e sistemit gjyqësor shqiptar dhe që ky proces të përmbyllet sa më shpejt, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja e punës në sistemin gjyqësor në vend dhe të realizohet në kohë dhënia e drejtësisë, Kolegji Penal vendosi të shqyrtojë

këtë çështje me përparësi. (...)

60. Kolegji çmon se në rastin konkret nuk rezulton që kërkuesi të ketë argumentuar nëse nga gjykatat më të ulëta ka pasur zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, apo nëse vendimet e gjykatave më të ulëta bien në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal apo Gjykatës së Lartë *(shih, vendimin nr. 70003-551-2021 regjistri themeltar, datë 23.07.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*.

61. Pavarësisht sa më sipër, Kolegji çmon t'i kthejë përgjigje disa prej pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi L.D., duke veçuar ato pretendime që meritojnë vëmendje të veçantë prej Kolegjit.

Për pretendimin për masën ndaluese

62. Në lidhje me pretendimin e ngritur për masën ndaluese të dhënë ndaj kërkuesit, Kolegji vlerëson se ajo nuk përbën çështje objekt të këtij gjykimi, por të një gjykimi tjetër me objekt caktimin e masës ndaluese ndaj shtetasit L.D., që do të shqyrtohet sipas radhës nga trupa e Kolegjit Penal caktuar me short për këtë qëllim. Ndaj vendimit të Gjykatave të Posaçme për caktimin e masës së sigurimit me natyrë ndaluese për shtetasin L.D. është ushtruar rekurs i veçantë prej tij, i cili shqyrtohet nga një trupë tjetër gjyqësore e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Për pretendimin e shuarjes së masës disiplinore të "shkarkimit nga detyra"

63. Në lidhje me pretendimin se masa disiplinore "shkarkim nga detyra" dhënë ndaj subjektit L.D. është shuar, Kolegji, ashtu si gjykatat më të ulëta, e gjen të pabazuar. Kolegji mbështet tërësisht arsyetimin e gjykatave më të ulëta se ekzistenca e një mase të mëparshme të largimit nga puna, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, është një kriter përjashtues për t'u emëruar në pozicione të caktuara publike. Periudha kohore brenda të cilës masa disiplinore duhet të jetë në fuqi, në asnjë rast nuk lidhet me masën disiplinore të largimit apo shkarkimit nga detyra, por lidhet me masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji. *Ekzistenca e një mase të mëparshme të largimit nga detyra, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, është një kriter përjashtues për t'u emëruar në pozicione të caktuara publike. Periudha kohore brenda të cilës masa disiplinore duhet të jetë në fuqi, në asnjë rast nuk lidhet me masën disiplinore të largimit apo shkarkimit nga detyra, por lidhet me masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji.* Ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi, kanë theksuar pikërisht këtë përfundim, ku më konkretisht në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"[45], në nenin 150, pika 3 të tij, parashikohet shprehimisht që: "*masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri*".

64. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se interpretimi i bërë nga kërkuesi se masa disiplinore e dhënë ndaj shtetasit L.D. është shuar, pasi kjo masë disiplinore sipas nenit 33 të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" shuhej brenda 3 viteve nga data e dhënies së saj, nëse pas saj nuk është dhënë masë tjetër disiplinore, është i pabazuar në ligj. Neni 33 i ligjit të mësipërm parashikon shuarjen brenda 3 viteve të masave disiplinore të rënda, ndërsa për masat disiplinore shumë të rënda siç është ajo e shkarkimit nga detyra nuk parashikohej shuarja. Rrjedhimisht pretendimi i kërkuesit për shuarjen e masës disiplinore "shkarkim nga detyra si gjyqtar" të dhënë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë më datë 24.12.1997, është i pambështetur në ligj.

Për pretendimin e mungesës së elementit të fajit

65. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se mungon elementi faj, Kolegji vlerëson se gjykatat më të ulëta kanë arsyetuar në mënyrë bindëse dhe shteruese ekzistencën jo vetëm të fajit, por të të gjitha elementeve të veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186 i KP. Faji, si element i anës subjektive, ekziston në rastin konkret, pasi ka rezultuar e provuar se kërkuesi ka pasur dijeni për masën disiplinore të "shkarkimit nga detyra e gjyqtarit" dhënë ndaj tij nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Njëkohësisht kërkuesi L.D. ka pasur dijeni që kjo masë përbënte kriter skualifikues nga pozicioni i punës ku ai po aplikonte dhe me dashje dhe vetëdije të plotë e ka fshehur atë në kërkesën e tij për aplikim me shkrim drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit duke paraqitur në kërkesë rrethanën e rreme se ndaj tij nuk është marrë asnjë masë e largimit të tij nga detyra.

66. Nga tërësia e fakteve të vlerësuara si të provuara nga gjykatat më të ulëta, ka rezultuar se kërkuesi L.D. ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë përgjatë viteve 1993-1997. Ky shtetas është larguar nga detyra për shkak se ndaj tij është dhënë masa disiplinore

[45] Botuar në fletoren zyrtare nr. 208, datë 07/11/2016, që ka hyrë në fuqi në datën 23/11/2016.

"Shkarkim nga detyra si gjyqtar", masë disiplinore për të cilën kërkuesi ka pasur dijeni të plotë. Rezulton se një fakt të tillë, pra funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ky shtetas e ka deklaruar në një aplikim të bërë në vitin 2016 pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për t'u emëruar gjyqtar. Në atë kohë shtetasi L.D. është skualifikuar në aplikimin e tij për t'u emëruar gjyqtar, pikërisht për shkak të faktit se më parë Këshilli i Lartë i Drejtësisë kishte marrë masën disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra si gjyqtar.

67. Për të vijuar më tej, në datën 02.03.2017 shtetasi L.D. ka paraqitur kërkesë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me objekt "Për aplikimin, emërimin e kërkuesit në vendet vakante të shpallura në bazë të ligjit nr. 84/2016". I gjykuari ka aplikuar për t'u emëruar në vendin vakant a) Gjyqtar i Kolegjit të Apelimit; b) Anëtar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; c) Komisioner publik. Në jetëshkrimin e tij ky shtetas nuk ka deklaruar faktin që ka qenë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa është detyruar ta deklarojë këtë fakt kur është pyetur në intervistën e dhënë pranë Komisionit të ngritur nga Kuvendi për verifikimin e kandidaturave. Në këtë Komision ky kandidat edhe pse ka pranuar se ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka fshehur shkakun e largimit nga ky pozicion duke u shprehur se: "*Unë kam ikur me dorëheqje, sepse nuk na lejuan të regjistroheshim".*

68. Kolegji vlerëson se kërkuesi në këtë mënyrë, me dashje ka parashtruar një rrethanë të rreme në kërkesën e tij për shprehje interesi, rrethanë që i referohet situatës që ai nuk kishte marrë asnjëherë masën disiplinore të largimit nga detyra. Duke paraqitur rrethanën e rreme në kërkesën e tij, i gjykuari L.D. ka përfituar prej saj, pasi me vendimin nr. 82/2017, datë 17.06.2017, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ai është zgjedhur Gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, një nga institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

69. Sa më sipër, Kolegji e gjen të drejtë arsyetimin e gjykatave më të ulëta se i gjykuari L.D. ka paraqitur me vetëdije të plotë të dhëna të rreme në aplikimin e tij si kandidat për pozicionin gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pozicion në të cilin u kualifikua dhe u emërua pikërisht për shkak të të dhënave të pavërteta që ai paraqiti në kërkesën e tij. Nëse kërkuesi do ta kishte paraqitur në kërkesë rrethanën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit në vitin 1997, ai do të rrezikonte skualifikimin për shkak të ligjit nga kandidimi si anëtar i Organeve Kushtetuese të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Kolegji vlerëson se i gjykuari ka vepruar me faj kur ai ka paraqitur rrethanën e rreme në

kërkesën për shfaqje interesi se ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna.

70. Mungesa e veprimit të organeve të ngarkuara nga ligji nr. 84/2016, "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" në drejtim të verifikimit të kushteve që duhet të plotësonin kandidatët për anëtarë të institucioneve të rivlerësimit, nuk përjashton përgjegjësinë e kërkuesit për deklarimin e të dhënave të rreme në kërkesën për kandidim të paraqitur prej tij. Në rastin konkret paraqitja e rrethanave të rreme në kërkesën drejtuar Avokatit të Popullit, shkakton përgjegjësi penale për të gjykuarin.

Për pretendimin se kërkesa nuk përbën akt zyrtar

71. Në lidhje me pretendimin se aplikimi/kërkesa e kërkuesit L.D. nuk përbën akt zyrtar dhe mungon objekti i veprës penale të falsifikimit, Kolegji vlerëson se edhe në lidhje me këtë pretendim kërkuesi ka marrë përgjigje të plotë dhe të qartë nga vendimet e gjykatave më të ulëta, arsyetim që gjendet i drejtë dhe shterues nga Kolegji.

72. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vlerëson të evidentojë elementet e objektit dhe anës objektive të veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve" të parashikuar nga neni 186 i KP, për sa kohë këto elemente janë parashtruar në mënyrë implicite në rekursin e të gjykuarit që i referohet pretendimit se kërkesa e tij nuk përbën akt zyrtar.

73. *Objekti veprës penale të falsifikimit të dokumenteve është marrëdhënia juridike konkrete që garanton veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike, si dhe të personave privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumenteve nga veprimet kriminale. Në këtë kuptim, objekt i falsifikimit sipas nenit 186 të KP nuk mund të jenë vetëm aktet zyrtare sikundër pretendon kërkuesi, por janë dokumentet ku përfshihen si aktet zyrtare ashtu edhe ato private.*

74. Dokumenti në vetvete përfaqëson aktet zyrtare dhe aktet private, të cilat jo vetëm që duhet të plotësojnë disa elemente minimale formale si identiteti i përpiluesit dhe i të pranishmëve, data, përmbajtja dhe nënshkrimi, por që më tej në përmbajtjen e tyre, duhet të dokumentojnë juridikisht ekzistencën e ngjarjes apo marrëdhënies së caktuar, të cilën përpiluesi i saj në rrethana të parashikuara nga ligji ka detyrimin ligjor të pasqyrojë të vërtetën. Është e vërtetë që kërkesa/aplikim e hartuar nga i gjykuari L.D. nuk është akt zyrtar pasi ajo nuk është nxjerrë nga një organ publik apo institucion shtetëror, por në kuptim të nenit 186 të KP ajo është dokument për sa kohë kërkesa/aplikim është shprehje e një kriteri ligjor

dhe sjell pasoja juridike në bazë të nenit 6 dhe 7 të Ligjit nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

75. *Në lidhje me nocionin e "falsifikimit" në Kodin Penal nuk jepet përkufizim, por përgjithësisht është pranuar nga jurisprudenca se me falsifikim në vetvete do të kuptojmë paraqitjen në një dokument të rrethanave të rreme, që kryhet nëpërmjet ndryshimit mekanik të dokumentit ekzistues, falsifikimit material, ose përpilimin e një dokumenti krejtësisht të falsifikuar, ndryshe falsifikimi intelektual.*

76. Nga ana objektive falsifikimi i dokumenteve, mund të kryhet në dy forma: (*i*) nëpërmjet "falsifikimit të dokumenteve", ose *(ii*) nëpërmjet "përdorimit të dokumenteve të falsifikuara" nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij. Në formën e parë të kryerjes së kësaj vepre, është i domosdoshëm zbulimi i autorësisë së veprimit të falsifikimit për konfigurimin e kësaj forme të kryerjes së veprës penale, ndërsa në formën e dytë, rëndësi ka identifikimi i përdoruesit të dokumentit të falsifikuar.

77. *Falsifikimi ideologjik ose intelektual mbi një dokument quhet i realizuar në rastin kur një rregull i caktuar i parashikuar në ligj i atribuon autorit të veprës penale detyrimin e vërtetimit të fakteve në dokumentin që duhet të hartohet prej tij. Në këtë rast hartuesi i dokumentit është i ngarkuar nga ligji për të deklaruar të vërtetën në dokumentin e tij.*

78. Neni 6, paragrafi i parë, germa "dh" i ligjit nr. 84/2016, "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" përcaktonte kriterin ligjor që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit përzgjidheshin personat ndaj të cilëve organet disiplinore nuk kishin marrë më parë masa të largimit nga puna. Përcaktimi ligjor i parashikuar në nenin të 6 të këtij ligji për mospasjen e masës disiplinore të largimit nga puna ishte një kriter kualifikimi për kandidatët që kishin shfaqur interesin e tyre për anëtarë të institucioneve të rivlerësimit. Është e kuptueshme se ligji "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" në kriteret e parashikuara në nenin 6 të tij synonte të përzgjidhte anëtarët e institucioneve të rivlerësimit që gëzonin integritet të lartë moral dhe profesional.

79. Kërkesa e paraqitur nga i gjykuari L.D. ku ai kishte shprehur interesin e tij për të kandiduar si anëtar i institucioneve të rivlerësimit është dokument ligjor në kuptim të nenit 186 të KP. Me të drejtë gjykatat më të ulëta e kanë vlerësuar kërkesën e paraqitur nga i gjykuari L.D. si dokument ligjor në të cilin janë paraqitur rrethana të rreme nga i gjykuari. Paraqitja e kërkesës për shfaqje interesi nga kandidatët, si dhe ndër të

tjera, përfshirja e rrethanës që ndaj tyre nuk ishte marrë masa e largimit nga puna, ishte një kriter ligjor që nuk mund të shmangej nga kandidatët. I gjykuari L.D. jo vetëm që i është shmangur këtij detyrimi, por ai ka shkuar edhe të tej, pasi në kërkesë ai ka paraqitur rrethanën e pavërtetë që ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga detyra.

80. Kolegji, duke konfirmuar qëndrimin e mbajtur nga gjykatat më të ulëta, arrin në përfundimin se kërkesa për shfaqe interesi e hartuar dhe paraqitur nga i gjykuari L.D. është një dokument ligjor në kuptim të nenit 186 të KP. Në këtë kërkesë i gjykuari ka paraqitur rrethanën e rreme se ndaj tij nuk ishte marrë masa disiplinore e largimit nga puna. Rrjedhimisht kërkesa si dokument ligjor është e falsifikuar nga i gjykuari.

Për pretendimin e dënimit të kërkuesit pa ligj

81. Kërkuesi, në rekurs, është shprehur se legjislacioni penal nuk e parashikon rastin e falsifikimit intelektual ose ideologjik në veprën penale të falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i KP. Në lidhje me këtë pretendim Kolegji konfirmon qëndrimin e mbajtur nga gjykatat më të ulëta të cilat janë shprehur se kërkesa për shprehje interesi e hartuar nga i gjykuari është dokument i falsifikuar në kuptim të nenit 186 të KP në mënyrën e falsifikimit intelektual ose ideologjik. Jurisprudenca e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka njohur dhe analizuar metodën e falsifikimit intelektual si një nga mënyrat e kryerjes së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i KP. Për falsifikimin intelektual Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2017-581 (111), datë 12.07.2017, shprehet se: *"...Falsifikimi intelektual kryhet me anë të krijimit tërësisht të aktit, dokumentit, me anë të të cilit një subjekt fizik apo juridik, publik ose privat, shpreh vullnet, merr përsipër të drejta dhe detyrime, të cilat realisht nuk i ka shprehur..."*.[46]

...

"...Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve si njëra nga format e kryerjes të përmendura më sipër, mund të bëhet në dy mënyra: ose duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi dokumentin, duke i bërë shtesa a tjetërsime të paligjshme, apo me çdo veprim tjetër material një dokumenti ekzistues të mëparshëm. Në këtë rast, do të ndodhemi përpara falsifikimit "material"; apo në mënyrën tjetër që konsiston në falsifikimin e përmbajtjes së dokumentit, pa prekur formën e tij, duke ndryshuar konceptin dhe brendinë e dokumentit. Në këtë rast, kemi të bëjmë me falsifikim

[46] Faqe nr. 8, paragrafi i 3-të, i Vendimit të Gjykatës së Lartë

"intelektual" që cenon pjesën përshkruese-dëftuese të dokumentit…".[47]

82. Rrjedhimisht, pretendimi i të gjykuarit se ai është i dënuar pa ligj nuk qëndron pasi ai nuk gjen mbështetje në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë në praktikën e saj gjyqësore ka pranuar metodën e falsifikimit intelektual si një nga mënyrat e realizimit të veprës penale të falsifikimit të dokumentit të parashikuar nga neni 186 i KP.

Për pretendimin për cënim të procesit të rregullt ligjor

83. Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit i ka cenuar kërkuesit procesin e rregullt ligjor, pasi nuk u ka kthyer përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesit dhe nuk ka arsyetuar vendimmarrjen e saj, Kolegji e gjen të pabazuar. Kolegji vlerëson se Gjykata e Posaçme e Apelit ka shqyrtuar dhe analizuar në vendimin e saj të gjitha pretendimet e ngritura në ankim nga kërkuesi, pretendime që edhe pse kanë marrë përgjigje, janë ngritur sërish si shkaqe rekursi në Gjykatën e Lartë. Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e ngritur në rekurs se gjykata e apelit ka përsëritur arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit ka arsyetuar në të njëjtën linjë si gjykata e shkallës së parë, duke konfirmuar argumentimin dhe përfundimin e arritur nga gjykata e shkallës së parë. Për këto arsye, edhe pretendimi për cenim të procesit të rregullt ligjor nga kjo gjykatë nuk qëndron.

84. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga kërkuesi L.D. kundër vendimit nr. 5, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk përmban ndonjë shkak ligjor të kërkuar nga neni 432 i KPP dhe për rrjedhojë, ai nuk pranohet.

[47] Faqe nr. 9, paragrafi i -4ët i Vendimit të Gjykatës së Lartë

Vendim i Kolegjit Penal nr. 00-2021, datë 02.11.2021

Pavlefshmëria e vendimit për shkak të mosarsyetimit të tij është një rrethanë që sjell si pasojë prishjen e vendimit të paarsyetuar dhe dërgimin e çështjes sërish për rigjykim në gjykatën ku është konstatuar shkelja procedurale.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga gjykimi i çështjes me procedurën e gjykimit të shkurtuar, ka rezultuar se një punonjës në pozicionin e saldatorit (…) ka rënë nga skela prej një lartësie 8-9 metra ku ka gjetur dhe vdekjen e menjëhershme. Sipas deklarimeve të personave që ishin në vendngjarje, i ndjeri, po kryente saldimin e montimeve brenda në rezervuar, ku duke punuar me një levë hekuri, i rrëshqet leva nga dora dhe rrëzohet poshtë në dysheme.(..)

3.(…). Të gjithë deklaruesit para organit procedues kanë shpjeguar se i ndjeri, në momentin e rënies, nuk ishte i pajisur me rrip sigurimi. Për shkak se shtetasi F.H. në raport me shoqërinë "P." ishte pronar si dhe drejtues teknik i saj, ndaj tij prokuroria nisi një hetim penal për aksidentin me pasojë vdekje të viktimës (…) që punonte si saldator në këtë shoqëri. (…)

9. Në vijim të hetimit, nga prokuroria është vendosur kryerja e ekspertimit teknik në punë (…). Sipas aktit të ekspertimit teknik të ekspertit të pavarur, datë 23.05.2014, rezulton se, nga pronari dhe drejtuesi teknik i firmës nuk është zbatuar "Rregullorja e sigurimit teknik për punët në ndërtim" e Institutit të Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit, e muajit Shtator, të vitit 2000, (më poshtë referimi "Rregullorja") Kreu XI, paragrafi "Punimet e saldimit dhe të prerjes së detaleve". (…) Fakti i mosvendosjes së brezit të sigurimit nga ana e saldatorit, ka sjellë si pasojë aksidentin e tij në punë. Në këtë pikë, drejtuesi teknik së bashku me pronarin nuk kanë kryer kontrollin e duhur gjatë punës. Në Kreun e II me titull "Detyrat të drejtat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen në punë" të "Rregullores", faqja nr. 15, në pikën 2.2 (…)

10. Në datën 10.06.2014, nga prokuroria është vendosur kryerja e një akti shtesë ekspertimi nisur nga fakti se mbrojtësit e të pandehurit kishin paraqitur pyetje për ekspertim (…)

12. Në përfundim të hetimeve, prokuroria i njoftoi të pandehurit F.H. akuzën për kryerjen e veprës penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në

punë", parashikuar nga neni 289/1 i KP. I pandehuri gjatë gjykimit ka mohuar akuzën dhe ka kërkuar deklarimin e pafajshëm.

13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, (...) ka vendosur ndërmjet të tjerash: *"Deklarimin fajtor të të pandehurit F.H., për kryerjen e veprës penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289/1 i KP dhe dënimin e tij me 1,500.000 (një milionë e pesëqind mijë) lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri F.H. dënohet me 1,000.000 (një milion) lekë gjobë."(...)*

15. Ndaj vendimit të mësipërm, ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rritjen e masës së dënimit për këtë të pandehur.

16. Ndaj vendimit të mësipërm, ka paraqitur ankim i pandehuri F.H., me të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe deklarimin e pafajshëm për veprën penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289/1 i KP.

17. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 475, datë 21.07.2016, ka vendosur: *"Prishjen e vendimit nr. 35, datë 25.01.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F.H.."*.

18. Gjykata e Apelit Vlorë, ka arsyetuar ndërmjet të tjerash se, i gjen të bazuara shkaqet e ngritura në ankimin e të pandehurit F.H., pasi gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar dhe interpretuar drejtë ligjin, duke dhënë një vendim të pambështetur në prova, për rrjedhojë ka vend për cenimin e këtij vendimi. (...)

22. (...) në përfundim, rezulton se kushtet e punës kanë qenë në zbatim të rregulloreve teknike të sigurimit. Mjetet e punës dhe ato të sigurimit teknik janë dhënë, si dhe kanë qenë në dispozicion të punëtorëve, në ushtrimin e detyrave të tyre. Instruktimet e sigurimit teknik të mbrojtjes në punë janë dhënë prej drejtuesit teknik F.H. në fillim të operacionit (punimeve). Personeli punëtor në ngjarje ka qenë i kualifikuar për llojin e punës (punime saldimi), brenda vendit të punës, si dhe ka marrë instruktimin mbi zhvillimin e operacionit dhe sigurimin teknik përkatës. (...)

24. Kundër vendimit (...) të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka paraqitur rekurs (...), Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë (...).

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

29. Kolegji, vlerëson se, nga Gjykata e Apelit Vlorë nuk është zbatuar drejt ligji material në raport me ligjin procedural penal, në lidhje me përfundimin

e arritur. Për më tepër, Kolegji vlerëson se vendimmarrja në lidhje me pushimin e çështjes penale për të gjykuarin F.H. nuk është e arsyetuar. Gjykata e Apelit, Vlorë në këtë rast ka shkelur dispozitat procedurale penale, që parashikojnë detyrimin për arsyetim të vendimit gjyqësor, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor. Shkaku i mosarsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë është ngritur në rekursin e prokurorit, sipas të cilit, vendimi i dhënë është më tepër një kopje e ankimit të paraqitur nga i pandehuri, sesa një analizë e drejtë dhe objektive e provave të shqyrtuara. Kolegji, konstaton se arsyetimi i vendimit nga Gjykata e Apelit Vlorë nuk është shterues dhe fakti penal i parashtruar prej saj nuk rezulton të jetë në përputhje me faktet dhe provat e administruara nga dosja gjyqësore.

30. Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji vlerëson të ndalet në dy momente të rëndësishme vendimtare për përcaktimin e elementëve thelbësorë të veprës penale "Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289, paragrafi i parë i KP. Së pari, a ka qenë viktima (...) person i kualifikuar si saldator, punë që po e kryente për llogari të shoqërisë "P." SHPK, në momentin që ndodhi aksidenti, me pasojë vdekjen e tij? Së dyti, i gjykuari F.H., si drejtues teknik i firmës "P.", përveç instruksionit dhe pajisjes me mjetet e punës për punëtorët e tij, a ka kontrolluar dhe mbikëqyrur veprimet e punonjësve gjatë orarit të punës nëse ato kanë qenë në përputhje me zbatimin e rregullores së sigurimit teknik në punë?

31. "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289 i KP, është një dispozitë e bardhë (blanket) pasi përcaktimin e rregullave që kanë të bëjnë me punën, prodhimin ose shërbimin ua referon akteve ligjore, akteve të nxjerra për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave, rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri. Në të njëjtën kohë e njëjta dispozitë ligjore ngarkon me përgjegjësi penale personat përgjegjës të cilët jo vetëm duhet të kontrollojnë respektimin e këtyre rregullave, por duhet gjithashtu të marrin masa konkrete për zbatimin e tyre.

31. Referuar momentit të parë të përmendur më lart, për shkak të profilit të punës si saldator nga viktima ka qenë i nevojshëm konstatimi i situatës me pasojë ligjore nëse viktima e kishte marrë kualifikimin e duhur teknik për të kryer punën e ngarkuar nga shoqëria "P.". Profili i saldatorit, ligjërisht, kërkon kualifikimin e duhur teknik të punëtorit që dëshiron të punojë në këtë pozicion pune. Parashikimi ligjor i kualifikimit të një punëtori si saldator është i përcaktuar shprehimisht në "Rregulloren e sigurimit teknik për punët në ndërtim" të Institutit të Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit, të vitit 2000, referuar pikës 1. 23 të Kreut I dhe pikës 1.1 të Kreu XI, paragrafi "Punimet e saldimit dhe të prerjes së detaleve", si dhe

në nenin 43 të Kodit të Punës. Viktima (...) mund të punonte në pozicionin e saldatorit vetëm nëse duhet të kishte përfunduar kualifikimin e duhur teknik për këtë punë. Kualifikimi i duhur i një punëtori në profilin e saldatorit përmendet edhe në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, referuar aktit të riekspertimit teknik mbi të cilin kjo gjykatë ka mbështetur vendimin e saj. Gjithsesi, elementi ligjor i kualifikimit të një punëtori si saldator i parashikuar nga "Kodi i Punës" dhe "Rregullorja", të cilat janë referenca normative për veprën penale "Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë", ka mbetur pa u verifikuar prej Gjykatës së Apelit Vlorë.

32. Sipas aktit të riekspertimit të hartuar nga eksperti Gëzim Ajazi, ka rezultuar se punëmarrësi (...) kishte kualifikimin e duhur për të ushtruar punën e saldatorit pasi ka ndjekur një kurs formimi profesional të certifikuar (...). Në fakt, në dosjen e gjykuar, nuk ekziston certifikata e kualifikimit si saldator për viktimën (...). Gjykata e Apelit, nuk ka administruar si provë asnjë certifikatë kualifikimi të viktimës. Në ndryshim nga ajo se çfarë është pasqyruar në aktin e riekspertimit, si pjesë e integruar e akuzës së ngritur nga prokuroria, në fashikullin e gjykimit është e përfshirë e gjithë praktika e inspektimit administrativ të kryer nga Inspektorati Shtetëror i Punës në shoqërinë "P.", pas aksidentit të ndodhur. Nga procesverbali "Mbi inspektimin e subjektit P.", datë 24.02.2014, Inspektorati ka konstatuar veç të tjerash se: *"Punëmarrësit (dhe ish punëmarrësi i aksidentuar), nuk janë pajisur me dëshmi të saldatorit dhe janë pa kualifikimin e duhur."*.

33. Referuar kësaj situate, Kolegji vlerëson se përfundimet e arritura nga Gjykata e Apelit Vlorë për kualifikimin e viktimës në profilin e saldatorit janë të pambështetura. Në rastin konkret, kualifikimi i viktimës në profilin e saldatorit është një detyrim ligjor që duhet të ishte konstatuar nga Gjykata e Apelit Vlorë për shkak të natyrës së veprës penale "Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289 i KP, si një dispozitë e bardhë (blanket). Moskonstatimi i kualifikimit të duhur të viktimës në profilin e saldatorit në gjykim prej Gjykatës së Apelit Vlorë, e bën vendimin e saj të paarsyetuar sipas nenit 112, paragrafi 3 i KPP.

34. Në lidhje me momentin e dytë, Kolegji konstaton se i gjykuari ka pasur cilësinë e drejtuesit teknik të shoqërisë "P.". Në veprën penale "Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë", parashikuar nga neni 289 i KP, drejtuesi teknik si person përgjegjës ka detyrimin t'iu bëjë të njohur punonjësve respektimin e rregullave të punës dhe të marrë masa konkrete në drejtim të zbatimit të tyre. Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin e saj ka arritur në përfundimin se nga i gjykuari janë zbatuar dispozitat përkatëse të sigurimit teknik, pasi janë plotësuar detyrat në lidhje me instruktazhin përkatës, u janë dhënë detyra konkrete punëtorëve të tij si dhe janë dhënë

mjetet e punës, përfshirë dhe ato të sigurimit teknik. Gjykata e Apelit Vlorë e mbështet vendimin e saj të pushimit të çështjes penale, ndër të tjera, edhe në konkluzionet e aktit të riekspertimit, i cili në përgjigje të pyetjes nr. 3 ka sqaruar se: *"...nuk është detyrë e drejtuesit teknik apo personit të ngarkuar me instruktimin teknik të jetë në çdo vend pune dhe në çdo kohë, detyrat jepen dhe kontrollohen..."*.

35. Gjykata e Apelit nuk ka argumentuar në lidhje me faktin nëse i gjykuari F.H. në ditën e aksidentit ka kryer kontrollin përkatës të zbatimit të rregullave të sigurimit teknik. Edhe në konkluzionin e nxjerrë nga eksperti në aktin e riekspertimit teknik, rezulton se detyrat e dhëna nga drejtuesi teknik apo personi i ngarkuar prej tij, jepen dhe më tej ato kontrollohen. Gjykata e Apelit Vlorë ka mbështetur në vendimin e saj, konkluzionet e aktit të riekspertimit teknik, pa u thelluar në përfundimet e tij.

36. Sipas "Rregullores" së përmendur në paragrafët 9 dhe 14 të këtij vendimi, i ngarkuari nga subjekti për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë duhet: - *Të organizojë dhe të përgjigjet për kryerjen e punimeve në objekt, në fabrika, linjë prodhimi, në mbështetje të zbatimit të rregullave të sigurimit teknik. - T'u caktojë detyra konkrete vartësve të tij për forcimin e kontrollit dhe marrjen e masave për parandalimin e aksidenteve. - Kur vë re se punimet në një objekt, ose në një linjë prodhimi zhvillohen në kundërshtim me rregulloren e sigurimit teknik, ndalon vazhdimin e punimeve deri ne zbatimin e masave përkatëse që do t'i përcaktojë ai vetë.*

37. Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka arsyetuar në mënyrë kronologjike veprimet e të gjykuarit F.H., që lidhen me rregullin e kontrollit të zbatimit të masave të sigurimit teknik. Viktima ka gjetur vdekjen për shkak se ai nuk kishte lidhur brezin (rripin) e sigurimit duke rënë nga një lartësi prej 8-9 metrash. Gjykata e Apelit, pavarësisht përfundimeve të ndryshme të dy akteve të ekspertimit teknik, referuar nenit 383, paragrafi 1, germa "ç" i KPP, në vendimin e saj duhej të paraqiste të gjithë faktin penal që rezultonte nga tërësia e të gjitha provave të marra në gjykim dhe në arsyetimin e vendimit, gjykata ka pasur detyrimin ligjor të argumentonte se pse nuk i merrte për bazë përfundimet e dhëna nga akti i parë i ekspertimit teknik për çështjen konkrete.

38. Vetëm duke respektuar këto kritere gjykata do të përmbushte standardin e një vendimi gjyqësor penal të arsyetuar. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në gjetjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin

procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim *(shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 7, datë 09.03.2009, të Gjykatës Kushtetuese)*.

39. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore, nuk është një element fakultativ apo diskrecional i gjykatave, përkundrazi, detyrimi për arsyetim është i parashikuar në Kushtetutë dhe në Kodin e Procedurës Penale referuar nenit 112 pika 3, në lidhje me nenin 432, pika 1, germa "b" të tij. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe t'u japë atyre mundësinë ligjore për të kundërshtuar vendimin nëpërmjet mjeteve të ankimit. Shkaqet që i referohen mosarsyetimit të Gjykatës së Apelit Vlorë me pasojë pavlefshmërinë e tij, janë të paraqitura në rekursin e depozituar nga prokuroria.

40. Në përfundim, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është i paarsyetuar në drejtim të përcaktimit nëse viktima ka qenë apo jo i kualifikuar si saldator në kohën që ai ka punuar pranë shoqërisë "P." si dhe nëse i gjykuari F.H. ka ushtruar kontroll ditën e aksidentit në drejtim të marrjes së masave në përputhje me rregulloren e sigurimit teknik në punë. *Pavlefshmëria e vendimit për shkak të mosarsyetimit të tij është një rrethanë që sjell si pasojë prishjen e vendimit të paarsyetuar dhe dërgimin e çështjes sërish për rigjykim në gjykatën ku është konstatuar shkelja procedurale*. Rrjedhimisht, Kolegji vendos që kjo çështje penale të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë, në bazë të nenit 441/1/c të Kodit të Procedurës.

41. Në përfundim, Kolegji vendos prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim, në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Neni 4
Ponsetti dhe Chesnel k. Francës – nr. 36855/97, 41731/98, datë 14/09/1999

Vendimi për *Ponsetti dhe Chesnel k. Francës* është marrë nga Gjykata (Dhoma) më 14 shtator të vitit 1997 dhe fokusohet te parimi i *'ne bis in idem'*, parashikuar në Nenin 4 Protokolli nr.7 i KEDNJ-së. Vendimi ka të bëjë gjithashtu me të drejtën për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së.

Dy kërkuesit apeluan kundër dënimit për mashtrim tatimor nga gjykatat penale pasi u gjobitën nga autoritetet administrative në kuadrin e të njëjtit rast. Të dy kërkuesit nuk i plotësuan deklaratat e tyre tatimore. Mospërfshirja e tyre çoi në vendosjen e ndëshkimeve administrative ndaj tyre nga autoritetet tatimore në formën e një rritjeje të administratës tatimore të pagueshme sipas nenit 1738 të Kodit të Përgjithshëm të Taksave Franceze. Autoritetet hapën edhe procedime penale kundër tyre, në fund të të cilave ata u dënuan për mashtrim tatimor sipas nenit 1741 të Kodit të Përgjithshëm Tatimor Franceze. Gjykata penale vendosi se ata e kishin shmangur qëllimisht pagesën e taksës. Kërkuesit apeluan - pa sukses - kundër dënimit të tyre, duke deklaruar se ata ishin ndëshkuar dy herë në bazë të të njëjtave fakte.

GJEDNJ konstatoi se ankesa është e papranueshme.

Neni 4.1 Protokolli nr. 7 thotë se, *"Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti."*

Gjykata vendosi që ankuesit të mos ndëshkohen dy herë në bazë të fakteve të njëjta. Dënimi administrativ dhe ai penal u bazuan në dy dispozita të ndryshme të Kodit të Përgjithshëm Tatimor në fuqi në lidhje me veprat krejtësisht të ndara me elemente përbërëse të ndryshme. Vepra tatimore ishte bërë për të ndëshkuar vetëm mosdeklarimin e detyrimit tatimor brenda afatit kohor. Nga ana tjetër, vepra penale ishte bërë për të ndëshkuar vendimin e qëllimshëm për të mos deklaruar:

> *"Sipas jurisprudencës së Divizionit Penal të Gjykatës së Kasacionit, nuk parashikohet që të jenë përdorur mjete mashtrimi për kryerjen e veprës penale sipas nenit 1741 të Kodit të Përgjithshëm Tatimor,*

megjithatë i akuzuari nuk i ka bërë "qëllimisht" deklarimet brenda afatit të caktuar. Ndaj, elementët përbërës të veprës janë të ndryshëm nga ata të "veprës fiskale", sipas nenit 1728 të Kodit të Përgjithshëm Tatimor, e cila konsiston në moskryerjen e deklarimeve brenda afatit të përcaktuar. Me fjalë të tjera, nenet 1741 dhe 1728 të Kodit të Përgjithshëm Tatimor nuk lidhen me të njëjtën shkelje, kështu që nuk mund të lindë asnjë pyetje për rastin konkret sipas Nenit 4 të Protokollit Nr. 7.".

Neni 5
Eggs k. Zvicrës – nr. 10313/83, datë 12/07/1984

Vendimi *Eggs k. Zvicrës*, i dhënë më 12 korrik 1984 nga ish-Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut, fokusohet në të drejtën për gjykim të drejtë, në veçanti të drejtën për kompensim, Neni 5 § 5 KEDNJ-së, si dhe prezumimin e pafajësisë, Neni 6 § 2 KEDNJ-së.

Kërkuesi, një shtetas zviceran i lindur në 1955, banonte në Bazel në kohën e vendimit. Në vjeshtën e vitit 1975, kërkuesi shërbeu një periudhë shërbimi ushtarak në një shkollë trajnimi të rekrutëve. Në nëntor 1975, kapiteni përgjegjës caktoi ndaj kërkuesit një dënim disiplinor me 5 ditë arrest për mosbindje. Ankesat e kërkuesit drejtuar komandantit të shkollës stërvitore dhe kryeprokurorit ushtarak u hodhën poshtë. Nën një urdhër arresti, të lëshuar nga autoriteti ushtarak i kantonit në dhjetor 1975, kërkuesi e vuajti dënimin e tij nga 16 deri në 20 janar 1976 në seksionin ushtarak të burgut të Bazelit. Tashmë në dhjetor 1975, kërkuesi kishte paraqitur një kërkesë në Komisionin Evropian të të Drejtave të Njeriut. Në raportin e tij, të miratuar më 4 mars 1978, në përputhje me Nenin 31 të Konventës, Komisioni arriti në përfundimin se kishte pasur një shkelje të Nenit 5 § 1 të KEDNJ-së sepse kërkuesi ishte ndaluar në kushtet që nuk përfshiheshin në asnjë prej nën-paragrafëve (a) deri (f) të Nenit 5 të KEDNJ-së, veçanërisht pasi ndalimi nuk ishte urdhëruar nga një "gjykatë kompetente". Ky Raport iu dërgua Komitetit të Ministrave, i cili miratoi një Rezolutë (DH (79) 7) në dhjetor 1979, në të cilën "merrte parasysh" gjetjet e raportit. Në nëntor 1979, ankuesi kërkoi dëmshpërblim nga Zvicra prej 100 frangash zvicerane për shkelje të Konventës dhe 3.000 frangash zvicerane për shpenzimet e tij ligjore në procesin para Komisionit. Në dhjetor 1979, Departamenti Federal i Drejtësisë e hodhi poshtë këtë pretendim. Kërkuesi çeli një proces administrativ pranë Gjykatës Federale duke u mbështetur, ndër të tjera, në Nenin 5 § 5 të KEDNJ-së. Në tetor 1982, Gjykata Federale hodhi poshtë kërkesën e kërkuesit. Pas ankimit pranë Komisionin Evropian për të Drejtat

e Njeriut në mars 1983, i cili dha vendimin përkatës në korrik 1984, kërkuesi dhe qeveria zvicerane arritën në një zgjidhje miqësore në janar 1985 dhe ankimi u hodh poshtë.

Komisioni e deklaroi kërkesën për aq sa ishte e pranueshme pasi ankuesi ngriti një shkelje të Nenit 5 § 5 të KEDNJ-së dhe të papranueshme në lidhje me shkeljen e pretenduar të Nenit 6 § 2 të KEDNJ-së.

Lidhur me Nenin 5 § 5 të KEDNJ-së, Komisionet vërejnë se në gjendjen konkrete të ankesës së kërkuesit bazuar në Nenin 5 § 5 KEDNJ-së ngre çështje, të cilat janë mjaft të ndërlikuara për të justifikuar shqyrtimin e themelit.

Sa i përket themelit të kërkesës në këtë drejtim, Komisioni risjell në vëmendje jurisprudencën e vet,

"sipas të cilës një person, të cilit i është refuzuar kompensimi mund të paraqesë çështjen e shkeljes së Nenit 5, parag. 5 para Komisionit, kur një shkelje e paragrafëve nga 1 deri në 4 të Nenit 5 është përcaktuar në themel nga një gjykatë kombëtare (Nr. 6821/74 përmendur më lart).

[...] E drejta për kompensim e përfshirë në Nenin 5, paragrafi 5 nuk varet nga ekzistenca e dëmit. Në fakt "ekzistenca e një shkeljeje është e konceptueshme edhe në mungesë të paragjykimit" (GJEDNJ, Gjykimi Artico i 13 majit 1980, Seria A nr. 35, parag. 35)".

Në lidhje me Nenin 6 § 2 të KEDNJ-së, Komisioni vëren se ankesa nga kërkuesi nuk është e natyrës penale dhe për këtë arsye nuk mbulohet nga fushëveprimi i saj.

"Komisioni konstaton se kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin konkret. Ndëshkimi i marrë ndaj kërkuesit nuk është vendosur sipas legjislacionit penal. Në lidhje me këtë Komisioni i referohet Raportit të tij në rastin e Eggs (D.R. 15 fq. 35, paragrafi 79), në të cilin arriti në përfundimin se kërkuesi nuk kishte qenë subjekt i ndonjë akuze penale sipas kuptimit të Nenit 6 parag. 1 (po aty, parag. 80). Në fakt, kërkuesi po kërkonte kompensim në Gjykatën Federal për të njëjtin dënim disiplinor."

Neni 6

Zimmermann dhe Steiner k. Zvicrës - nr. 8737/79, datë 13/07/1983

Vendimi për *Zimmermann dhe Steiner k. Zvicrës*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 13 korrik 1983, fokusohet te parimi i procesit të rregullt i parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së, në veçanti te kohëzgjatja e arsyeshme

e një procedimi që zhvillohet në një nivel të vetëm juridiksional.

Dy ankuesit, të lindur në 1907 dhe 1937, kundërshtuan kohëzgjatjen e procedimeve, në të cilat ata kërkuan kompensim për dëmet e pretenduara nga ndotja e ajrit të shkaktuara nga funksionimi i aeroportit në qytetin e Cyrihut, Zvicër. Të dy ankuesit depozituan një ankesë ndaj vendimit negativ administrativ para Gjykatës Federale më 18 prill 1977. Deklarata u mbyll më 24 maj 1977. Më 29 qershor 1980, avokati i kërkuesve i kërkoi për herë të tretë Gjykatës Federale informacione në lidhje me gjendjen e procedimeve. Më 11 korrik gjyqtari, teksa raporton duke shprehur keqardhjen e tij në lidhje me vonesën në shqyrtimin e çështjes, u përgjigj se vendimi gjyqësor do të merret pas pushimeve të gjykatës. Gjykata Federale hodhi poshtë apelimin më 15 tetor 1980. Sa i përket pamjes së përgjithshme të situatës së Gjykatës Federale, sipas statistikave të dhëna nga Qeveria, numri i përgjithshëm i apelimeve u rrit nga 1,629 në 3,037 (86%) nga viti 1969 në vitin 1979. Në vitin 1973, Gjykata Federale i paraqiti Qeverisë së Shtetit të paditur propozime urgjente të projektuara për reduktimin e kësaj ngarkesë të tepërt pune. Në vitin 1978, u morën vendime për të përmirësuar strukturën e Gjykatës Federale, për të rishikuar Rregulloren e Punës dhe për të rritur numrin e gjyqtarëve dhe të personelit të shërbimit. Në vitin 1980, ngarkesa me çështje të prapambetura ishte rreth 1.500 çështje.

Gjykata konstatoi se Zvicra ka shkelur të drejtën për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

Neni 6 § 1 i KEDNJ-së thotë: *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme […]"*

Gjykata deklaron shkurtimisht se "të drejtat" e pretenduara nga kërkuesit - të drejtat personale ose pronësore - ishin private, rrjedhimisht "civile" sipas kuptimit të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Më pas, gjykata përcakton periudhën që do të merret në konsideratë nga data 18 prill 1977, kur kërkuesit bënë ankesën e tyre, deri më 15 tetor 1980, kur Gjykata Federale dha vendimin, pra rreth tre vjet e gjysmë.

Sipas Gjykatës, një periudhë e tillë është "e konsiderueshme" dhe bën thirrje për "kontroll të imtësishëm" pasi procedurat po zhvilloheshin vetëm në një nivel të vetëm juridiksional. Gjykata rithekson kriteret e parashikuara në Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së:

"Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedimeve […] duhet të vlerësohet në secilin rast sipas rrethanave të veçanta […] për të pasur parasysh, ndër të tjera, kompleksitetin e çështjeve faktike ose juridike të ngritura nga rasti, sjelljen e kërkuesit dhe autoritetet kompetente dhe atë çka ishte në rrezik për të parët; përveç kësaj, vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të justifikojnë konstatimin e mosrespektimit të kriterit të "kohës së arsyeshme".

Në rastin aktual, Gjykata konstaton se çështja nuk ishte tepër komplekse pasi "*nuk u kërkua asnjë hetim mbi faktet dhe çështjet ligjore që dalin e nuk duket se kanë qenë me vështirësi të jashtëzakonshme*." Ajo thotë se nuk pati asnjë sjellje nga kërkuesit që të justifikonte shtyrjen.

Si aspekt vendimtar, Gjykata i drejtohet sjelljes së autoriteteve të shtetit të paditur. Ajo konstaton se shteti nuk i ka përmbushur kriteret e Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Në veçanti, ngarkesa e tepërt e punës së Gjykatës përkatëse nuk mund të justifikojë vetëm kohëzgjatjen konkrete nëse kjo ngarkesë pune nuk është rezultat i një deficiti të përkohshëm, por i një strukture të caktuar në sistemin gjyqësor:

"Gjykata do të theksonte, në radhë të parë, se Konventa u vë një detyrë Shteteve Kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre juridike në mënyrë që t'u mundësojnë gjykatave të respektojnë kriteret e Nenit 6 § 1, përfshirë atë të gjykimit brenda një "afati të arsyeshëm". Sidoqoftë, ngarkesa e përkohshme me çështje nuk përfshin përgjegjësi nga ana e shteteve kontraktuese me kusht që ata të ndërmarrin, me shpejtësinë e duhur, veprime përmirësuese për trajtimin e një situate të jashtëzakonshme të këtij lloji […]

Metodat që mund të konsiderohen, si mjete të përkohshme, pa dyshim përfshijnë zgjedhjen për t'i trajtuar çështjet sipas një rendi të caktuar, që bazohet jo vetëm në datën kur janë sjellë, por në shkallën e tyre të urgjencës dhe rëndësisë dhe, në veçanti, në atë çka është në rrezik për personat në fjalë. Megjithatë, nëse kjo gjendje zgjatet dhe bëhet çështje organizimi strukturor, metoda të tilla nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti nuk do të jetë në gjendje të shtyjë më tej miratimin e masave efektive."

Në rastin konkret, Gjykata konstaton përgjegjës shtetin e paditur, megjithëse ka treguar gatishmëri, ai nuk ka arritur t'i trajtojë problemet strukturore aq sa duhet. Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe personelit mbështetës, si dhe ndryshimi i Rregullores së Punës nga vetë Gjykata Federale nuk ishin të mjaftueshme pasi statistikat tregonin rritje të

vazhdueshme të ngarkesës së prapambetur. Ky ishte edhe më shumë rasti pasi vetë Gjykata Federale kërkoi vendime urgjente për të ndryshuar strukturën e përgjithshme të sistemit të Gjykatës në mënyrë të përsëritur, por ato u morën vetëm në vitin 1981 - një vit pasi apeli aktual u rrëzua. Si rezultat, kohëzgjatja e procedurave të kërkuesve nuk mund të justifikohej nga ngarkesa e punës e Gjykatës Federale si problem i përkohshëm.

Poiss kundër Austrisë – nr. 9816/82, datë 24/03/1987

Vendimi *Poiss kundër Austrisë*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 24 mars 1987, fokusohet tek e drejta për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së, në veçanti në parimin e procesit të rregullt ligjor brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Kërkuesi kundërshtoi procedurat e konsolidimit ("Zusammenlegungsverfahren") të marra në lidhje me tokën e tyre. Kërkuesit, Leopold Poiss - i cili vdiq më 30 prill 1984 - dhe fëmijët e tij, Josef dhe Anna, ishin fermerë austriakë, banues në Palterndorf, Austri e Poshtme. Më 13 shtator 1965, Autoriteti Bujqësor i Qarkut të Poshtëm Austriak nxori një plan konsolidimi që kishte miratuar në shtator. Ai tashmë kishte urdhëruar, në prill të vitit 1963, transferimin e përkohshëm të parcelave të tokës në fjalë. Skema preku 530 persona, përfshirë 428 pronarë të tokës bujqësore. Kërkuesit vërejtën se toka e tyre ishte superiore në cilësi ndaj parcelave të ofruara për kompensim dhe në përputhje me rrethanat ata apeluan kundër planit, por Bordi Provincial i Reformës së Tokës e la atë në fuqi në korrik të vitit 1968. Kërkuesit u ankuan brenda dy javësh kundër vendimit të Bordit Provincial, duke pretenduar në mënyrë specifike se disa nga tokat e tyre fillestare - vreshtat e vendosura pranë fermës - duhet të ishin planifikuar si tokë ndërtimi. Në maj të vitit 1971, apeli i tyre u hodh poshtë nga Bordi Suprem i Reformës së Tokës, i cili deklaroi se toka në fjalë ishte caktuar në planin e zonimit të Bashkisë Palterndorf për përdorim bujqësor. Ky vendim u dha në shtator të vitit 1971. Kërkuesit më pas bënë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila hodhi poshtë ankesën e tyre në shkurt të vitit 1972; vendim i cili iu paraqit atyre në maj. Më 7 shtator 1971, pra në ditën para se vendimi i Bordit Suprem iu është paraqitur Kërkuesve, autoriteti i planifikimit bashkiak kishte miratuar, por pa u publikuar, një plan të përkohshëm zonimi, ku vreshtat e kërkuesve janë përcaktuar si tokë ndërtimi. Të nesërmen, kërkuesit aplikuan në Bordin Suprem për rihapjen e procedurave dhe për kompensim. Bordi Suprem pranoi aplikimin e tyre në tetor 1975. Ky vendim iu paraqit kërkuesve në dhjetor. Në prill të vitit 1976, Autoriteti i Qarkut refuzoi të pranonte se toka në fjalë ishte tokë me vlerë të veçantë, pasi plani i zonimit provincial të bashkisë i 7 shtatorit 1971 nuk ishte miratuar përfundimisht nga autoriteti përkatës provincial. Familja Poiss apeloi në Bordin Provincial të Reformës së Tokës më 3 maj 1976, por ky i fundit nuk arriti të marrë një vendim brenda gjashtë muajve të përcaktuar në ligjin përkatës dhe kërkuesit aplikuan përkatësisht në Bordin Suprem të Reformës së Tokës në janar të vitit 1977 për të marrë juridiksionin. Kërkesa u depozitua në korrik të vitit 1977 dhe kërkuesit u njohën në gusht 1977. Autoriteti i Qarkut refuzoi sërish respektimin. Me apelin e Kërkuesit, Bordi Krahinor i Reformës së Tokës e anuloi këtë vendim në prill 1979. E njëjta procedurë ndodhi sërish dy herë. Në vitin 1985, u miratua plani i ri i konsolidimit nga Bordi Suprem. Plani u mbështet pjesërisht nga Gjykata Administrative në korrik 1986, vendim i cili iu paraqit kërkuesve në tetor të atij viti.

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ -së [linku me tekstin], si dhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Sa i përket nenit 6 § 1 të KEDNJ-së nuk kishte pasur procedura brenda "afatit të arsyeshëm" brenda kuptimit të asaj dispozite.

Gjykata përcakton periudhën që do të merret parasysh sipas standardeve të saj të përcaktuara në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore.

"Në procedimet civile, "afati i arsyeshëm" i përmendur në nenin 6 § 1 (neni 6-1) fillon normalisht nga momenti i paraqitjes së veprimit para "gjykatës "(shih, si autoriteti më i fundit, vendimi gjyqësor i Deumeland i 29 majit 1986, Seria A nr. 100, f. 26, § 77) dhe, në rastin aktual, në provat e paraqitura nuk gjendet asnjë gjë që do ta çonte Gjykatën të vërente se mosmarrëveshja ("kontestimi") ka lindur në data të mëparshme. [...] Ajo ka konstatuar vazhdimisht në lidhje me zbatimin e Nenit 6 § 1 (neni 6-1) se periudha e arsyeshmërisë që rishikohet konsiderohen të gjitha procedurat në fjalë, përfshirë çdo ankesë. Prandaj, kjo periudhë shtrihet deri në vendimin që zgjidh mosmarrëveshjen.".

Faza e parë, që zgjat gjashtë vjet e shtatë muaj, filloi në mes të 27 dhe 30 shtatorit të vitit 1965 kur kërkuesit apeluan kundër planit të konsolidimit të 1 shtatorit 1965 dhe përfundoi më 23 maj 1972, kur kërkuesit pranuan nocionin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Faza e dytë filloi më 6 shtator 1974 kur kërkuesit kërkuan rihapjen e procesit dhe, sipas Gjykatës, nuk përfundoi në momentin e vendimit të Gjykatës, duke zgjatur kështu rreth dymbëdhjetë vjet e gjysmë.

Për të përcaktuar nëse kohëzgjatja e procedimit është "e arsyeshme", Gjykata thekson jurisprudencën e saj gjyqësore e cila thotë se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta dhe duke pasur parasysh veçanërisht shkallën e kompleksitetit të rastit, sjelljen e kërkuesve dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse.

Sa i përket kompleksitetit të çështjes, Gjykata konstaton se proceset e konsolidimit janë zakonisht mjaft komplekse dhe se në rastin aktual ishin 530 persona të përfshirë, si dhe në momente të caktuara, u përfshi edhe detyra e autoriteteve për të hartuar plane të reja pas vendimeve të gjykatës. Sa i përket sjelljes së ankuesve, Gjykata pohon dhe thekson se kërkuesit nuk mund të fajësohen për përdorimin e plotë të mjeteve juridike në dispozicion të tyre. Sidoqoftë, sjellja e ankuesve përbënte fakt objektiv, i cili nuk mund t'i atribuohet shtetit përgjegjës dhe i cili duhet të merret parasysh me qëllim që të përcaktohet nëse koha e arsyeshme e përmendur në nenin 6 § 1 të KEDNJ-së është tejkaluar ose jo. Sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata vëren se, në përputhje me ligjin, ato e kishin filluar procesin e konsolidimit me lëvizjen e tyre dhe se ato ishin përgjegjëse për kryerjen e tij. Për më tepër, ka pasur një detyrë të veçantë për të vepruar në mënyrë të shpejtë, detyrë e cila përfshinte transferimin e përkohshëm të tokës. Gjithashtu, procesi ka pasur shumë mangësi, si për shembull koha prej rreth dhjetë vitesh para se kërkuesit të marrin njoftimin për planin e dytë të ri të konsolidimit.

Weber k. Zvicrës – nr. 11034/84, datë 22/05/1990

Vendimi për *Weber kundër Zvicrës*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 22 maj 1990, fokusohet tek e drejta për një proces të rregull gjyqësor, e parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së, në veçanti në çështjen e aksesit në gjykatë në kontekstin e natyrës së një sanksioni, si dhe në Nenin 10 të KEDNJ-së.

Kërkuesi kundërshtoi vendimin dhe procedurën gjyqësore pasuese për një gjobë të vendosur ndaj tij për shkelje të dyshuara konfidencialiteti të procedurave gjyqësore. Z. Franz Weber është gazetar zviceran dhe ka jetuar në Clarens, në Kantonin Vaud, Zvicër, në kohën e gjykimit të GJEDNJ-së. Në prill të vitit 1980, Kërkuesi dhe një nga shoqatat që ai drejton, Helvetia Nostra, paraqiti një padi duke pretenduar shpifje kundër R.M., që kishte shkruar një letër shpifje të botuar në kolonën e letrave të gazetës "L'Est vaudois". Pas hetimit, në nëntor të vitit 1980, gjykatësi hetues urdhëroi zbulimin e artikujve të shoqatës Helvetia Nostra dhe Fondacionit Franz

Weber dhe llogarive të tyre, por iu desh ta rinovonte atë në prill të vitit 1981, pasi kërkuesi nuk e kishte respektuar. Në maj 1981, Kërkuesi ra dakord pjesërisht. Po ashtu, ai, në mars të vitit 1982, paraqiti një kallëzim penal kundër gjyqtarit duke pretenduar keqpërdorimin e autoritetit zyrtar dhe detyrim. Ndërsa gjyqtari hetues i Kantonit Vaud refuzoi të ndërmerrte veprime, z. Weber e kundërshtoi Gjykatën Kantone. Më 2 mars 1982, në një konferencë për shtyp, kërkuesi e informoi publikun se kundër R.M-së ishte hapur procedura për shpifje, se ishte urdhëruar gjenerimi dhe më pas sekuestrimi i llogarive të shoqatave, se këto ishin dorëzuar me vulë dhe se ai kishte paraqitur kundërshtim dhe ankesë kundër gjyqtarit hetues. Zoti Weber tashmë kishte zbuluar tre artikujt e parë të informacionit në një konferencë shtypi në Bernë në maj të vitit 1981. Sipas nenit 185 § 3 të Kodit Vaud të Procedurës Penale, Kryetari i Divizionit të Kasacionit Penal të Gjykatës Kantone Vaud nisi vetë një hetim përmbledhës për shkeljen e konfidencialitetit të hetimit gjyqësor, dhe vendosi, në prill 1984, një gjobë prej 300 franga zvicerane për kërkuesin, së bashku me një periudhë prove prej një viti me qëllim fshirjen e gjobës nga regjistri kantonal. Në tetor 1982, apelimi kundër këtij vendimi u hodh poshtë unanimisht nga Divizioni i Kasacionit Penal. Ai vuri në dukje, se sipas ligjit Vaud dhe pavarësisht se ishin të konvertueshme në ditë burgimi, gjobat për "veprat procedurale", të tilla si shkelja e konfidencialitetit të një hetimi gjyqësor, ishin të natyrës disiplinore, pasi ato ishin krijuar për të siguruar ecurinë normale të hetimit. Kundër këtij vendimi, z. Weber paraqiti një apel për të drejtën publike në Gjykatën Federale, i cili u hodh poshtë në nëntor 1983.

Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 6 dhe 10 të KEDNJ-së [linku me tekstin].

Sa i përket Nenit 6 të KED-së dhe çështjes vendimtare të zbatueshmërisë së tij në dënimin e Kërkuesit, Gjykata vlerëson se ky sanksion përbën dënim dhe për këtë arsye është sanksion penal sipas kuptimit të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Ajo i referohet praktikës gjyqësore të mëparshme në lidhje me tri kriteret vendimtare:

"Ndërsa njeh të drejtën e shteteve për të bërë dallimin mes ligjit penal dhe ligjit disiplinor, ai ka rezervuar pushtetin për të garantuar që kufiri i vendosur midis tyre nuk paragjykon objektin dhe qëllimin e nenit 6 (neni 6). Në rastin aktual, ai do të zbatojë kriteret që janë përcaktuar vazhdimisht në këtë çështje në vendimet e tij të mëparshme [...] [klasifikimi në ligjin kombëtar, natyra e veprës penale, natyra dhe shkalla e ashpërsisë së dënimit të shkaktuar]."

Sa i përket klasifikimit në të drejtën kombëtare, Gjykata konstaton se fjala *"peine"* (dënim) në nenin 185 jep një indikacion, por nuk është vendimtar."

Në lidhje me kriterin e dytë, natyrën e veprës, Gjykata thekson:

"Komisioni konsideroi se [vepra penale] Neni 185 zbatohej për një numër të kufizuar njerëzish që ndanin karakteristikat e pjesëmarrjes në një hetim gjyqësor [dhe për këtë arsye nuk është" penal"]; [...] Gjykata nuk e pranon këtë parashtrim. Sanksionet disiplinore janë krijuar në përgjithësi për të siguruar që anëtarët e grupeve të veçanta të jenë në përputhje me rregullat specifike që rregullojnë sjelljen e tyre. Për më tepër, në shumicën dërrmuese të shteteve Kontraktuese, zbulimi i informacionit të lidhur me një hetim ende në pritje përbën akt të papajtueshëm me këto rregulla dhe akt të dënueshëm sipas një sërë dispozitash. Si persona që mbi të gjithë të tjerët janë të lidhur me konfidencialitetin e një hetimi, gjyqtarët, avokatët dhe të gjithë ata që janë të lidhur ngushtë me funksionimin e gjykatave janë përgjegjës në një ngjarje të tillë, pavarësisht çdo sanksioni penal apo masave disiplinore për shkak të profesionit të tyre. Palët, nga ana tjetër, marrin pjesë vetëm në procese si njerëz që i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave, dhe për këtë arsye ata nuk hyjnë në sferën disiplinore të sistemit gjyqësor. Meqenëse neni 185, prek potencialisht të gjithë popullsinë, vepra penale që ajo përcakton dhe së cilës i jep sanksionin ndëshkues, është "penale" për qëllimet të kriterit të dytë.".

Sa i përket kriterit të tretë - natyra dhe shkalla e ashpërsisë së dënimit të shkaktuar - Gjykata vëren se gjoba mund të arrijë në 500 franga zvicerane (*shih, paragrafin 20 më lart*) dhe të konvertohet në një afat burgimi në rrethana të caktuara.

Sa i përket përputhshmërisë me Nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata thotë se ajo ishte shkelur pasi nuk pati seanca dëgjimore ku kërkuesi mund të paraqiste argumentet e tij. Edhe pse ligji përkatës e parashikonte këtë mundësi, Kryetari i Divizionit të Kasacionit Penal, si dhe Gjykatat pasuese nuk mbajtën seanca dëgjimore.

Smith Kline dhe French Laboratories Ltd k. Holandës – nr. 12633/87, datë 04/10/1990

Vendimi për *Smith Kline and French Laboratories Ltd. kundër Holandës*, i marrë më 4 tetor 1990 nga ish-Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, fokusohet tek e drejta për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta për mbrojtje të pronës, Neni 1, Protokolli Nr. 1, si dhe tek e drejta për zgjidhje efektive juridike, Neni 13 i KEDNJ-së.

Kërkuesi është një kompani e regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar. Kërkuesi është pronar i Patentës Holandeze nr. 162073, e cila lidhet

me cimetidinën, një lloj medikamenti i ri në atë kohë, i cili ishte i pari që u tregtua. Një kompani holandeze, Centrafarm BV mori nga patenta holandeze nr. 171054 patentën për procesin e prodhimit të një grupi përbërësish, përfshirë cimetidinën. Patenta nr. 171054 ka datë prioriteti më të vonë se Patenta Nr. 162073 dhe nuk mund të punohet pa licencë sipas Patentës Nr. 162073. Kërkuesi nuk ishte i gatshëm ta jepte një licencë të tillë. Në nëntor të vitit1983, Centrafarm BV bëri kërkesë për dhënien e një licence të detyrueshme sipas patentës së kërkuesit në përputhje me Aktin Holandez të Patentave. Peticioni u shqyrtua nga Divizioni Special i Zyrës së Patentave, i krijuar nga Divizioni Qendror dhe që përfshin një anëtar të kualifikuar ligjërisht dhe dy anëtarë të tjerë ekspertë në fushën kimike. Këta anëtarë nuk ishin përfshirë në procedurën në lidhje me çështjen e patentës së kërkuesit ose Centrafarm. Kërkuesi kërkoi në procedime të veçanta para Gjykatës së Qarkut në Hagë që patenta Centrafarm BV nr. 171054 të deklarohej e pavlefshme sipas Aktit të Patentave. Gjykata e Qarkut kërkoi këshillën teknike të Zyrës së Patentave, e cila krijon një Divizion të Veçantë i cili përmbush detyrimin sipas Aktit të Patentave për t'i dhënë gjykatës çdo informacion të nevojshëm dhe këshilla teknike. Divizioni Special përbëhej nga të njëjtët anëtarë, si ata të emëruar për të shqyrtuar kërkesën e Centrafarm për licencë. Në shtator të vitit 1984, Divizioni Special i Zyrës së Patentave i dha Centrafarm licencën e detyrueshme bazuar në numrin e saj të patentës 171054 lidhur me patentën e kërkuesit, me kusht që anulimi nga Gjykata e Rrethit do të sillte përfundimin e licencës. Kushtet e licencës së detyrueshme i jepnin të licencuarit të drejta mbi shpikjen e një substance të re kimike nga Kërkuesi dhe përdorimin e saj në forma dozimi medicinale, si dhe mbi procesin e kërkuesit. Divizioni Special i Zyrës së Patentave, në opinionin e tij për gjykatën, shprehu një pikëpamje që mbështet pjesërisht vlefshmërinë e patentës së Centrafarm. Në prill të vitit 1986, Gjykata e Rrethit miratoi një pjesë të kërkesës për pavlefshmëri, por një pjesë të patentës e la në fuqi. Kërkuesi e apeloi këtë në Gjykatën e Apelit të Hagës. Me një vendim të shtatorit të vitit 1986, Divizioni i Apelit i Zyrës së Patentave hodhi poshtë apelimin e kërkuesit. Për apelimin e ankuesit në Gjykatën e Apelit të Hagës nuk u mor kurrë një vendim, pasi kërkuesi pranoi ofertën e Centrafarm për të paguar 50,000 Gulden holandezë për dorëzimin e patentës së Centrafarm. Pas aplikimit në Komisionin Evropian për të Drejtat e Njeriut në dhjetor 1986, i cili dha vendimin aktual në fuqi në tetor 1990, palët arritën një marrëveshje miqësore në qershor 1991 dhe kërkesa u hodh poshtë.

Komisioni e kishte shpallur kërkesën të pranueshme për aq sa kërkuesi ngriti shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 13 të KEDNJ-së dhe të

papranueshme për sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 1, të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Sa i përket nenit 6 të KEDNJ-së, Komisioni nuk e sheh dukshëm të pabazuar faktin që Kërkuesi u ankua se i ishte hequr e drejta ekskluzive e shfrytëzimit të barit të tij të patentuar si rezultat i dhënies së një licence të detyrueshme për Centrafarm dhe u ankua se Zyra e Patentave, kishte përcaktuar në fakt të drejtat e tij civile në lidhje me patentën, por nuk kishte qenë një gjykatë të pavarur ose e paanshme brenda kuptimit të Nenit 6 të KEDNJ-së.

Sa i përket Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Komisioni konstaton dukshëm si të pabazuar që kërkuesi u ankua se dhënia e një licence të detyrueshme për Centrafarm ka ndërhyrë në të drejtat e tij sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. *Së pari*, patenta do të ishte brenda fushës së veprimit të termit "*zotërime*" në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1: *"Komisioni vëren se sipas ligjit holandez, mbajtësi i një patente referohet si pronari i një patente dhe se patentat konsiderohen, në varësi të dispozitave të Aktit të Patentave, të jenë pronë personale e transferueshme dhe e caktueshme për të tjerë."*.

Së dyti, Komisioni konstaton se vendimet e Zyrës së Patentave, duke i dhënë Centrafarm-ës të drejtën e një licence të detyrueshme në lidhje me patentën e kërkuesit, përbënin kontroll të përdorimit të pronës pasi *"patenta i jep fillimisht pronarit të saj të drejtën e vetme të shfrytëzimit [dhe] dhënia e mëvonshme e të drejtave për të tjerët nën atë patentë nuk është pasojë e pashmangshme ose automatike."*.

Sa i përket justifikimit të tij, Komisioni është i kënaqur që dhënia e licencës së detyrueshme ishte e ligjshme dhe ndoqi një qëllim legjitim për të inkurajuar zhvillimin teknologjik dhe ekonomik. *"Komisioni kujton se të drejtat ekskluzive të një patentuesi janë të kufizuara në shumë prej shteteve kontraktuese dhe se dispozita që personat e tjerë të përdorin një produkt ose proces të veçantë të patentuar bëhet zakonisht me qëllim parandalimin e pengimit afatgjatë të progresit teknologjik dhe të aktivitetit ekonomik. Komisioni vëren se Centrafarm-ës iu dha një licenca e detyrueshme sipas patentës së kërkuesit pasi, në të kundërt ajo nuk do të mund të punonte në bazë të patentës tjetër që kishte. Sipas Aktit të Patentave, patenta vartëse do të ishte dhënë vetëm nëse konsiderohej se do të prezantonte një produkt ose proces të ri që nuk ishte një zhvillim i dukshëm duke pasur parasysh gjendjen aktuale të artit dhe që mund të përdorej për aplikim industrial."*.

Sa i përket proporcionalitetit të justifikimit, Komisioni konstaton *"se kontrolli i përdorimit në rrethanat e këtij rasti nuk ka arritur të arrijë një ekuilibër të drejtë mes interesave të kompanisë kërkuese dhe interesit të përgjithshëm dhe është në përputhje me Kriteret e nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Ai vëren se dispozita hyn në fuqi vetëm kur një licencë e tillë është e nevojshme për funksionimin e një patente të së njëjtës datë ose të një date të mëvonshme dhe se licenca duhet të kufizohet në atë çka kërkohet për funksionimin e patentës. Për më tepër, zotëruesi i patentës dominuese ka të drejtën e honorarëve për çdo licencë të detyrueshme të dhënë sipas legjislacionit dhe ka të drejta reciproke sipas patentës vartëse. Ndërsa Komisioni kujton se Zyrës së Patentave nuk i kërkohet të hetojë në çdo rast specifik nëse dhënia e licencës së detyrueshme është e nevojshme për interesin e përgjithshëm, atëherë Komisioni konstaton se kuadri i vendosur nga legjislacioni ka për qëllim parandalimin e abuzimit të situatave monopol dhe inkurajimin e zhvillimit, dhe se kjo metodë për përmbushjen e këtij qëllimi bie brenda kufirit të vlerësimit të akorduar për Shtetin Kontraktues."*.

Sa i përket nenit 13 të KEDNJ -së, Komisioni e konsideron të pranueshme padinë e kërkuesit pasi ishte e lidhur ngushtë me padinë e nenit 6 të KEDNJ -së, të cilën ai e konsideronte të pranueshme.

Vocaturo k. Italisë - nr. 11891/85, datë 24/04/1991

Vendimi për *Vocaturo k. Italisë*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 24 prill 1991, fokusohet te parimi i procesit të rregullt, i parashikuar në nenin 6 të KEDNJ-së, në veçanti te kohëzgjatja e arsyeshme e procedurës, duke përfshirë tri nivelet e juridiksionit, ndryshimin e ligjit të zbatueshëm gjatë procedurave dhe kërkesat e veçanta nga procedurat që fokusohen te punësimi.

Kërkuesi kundërshtoi kohëzgjatjen e procedimit të përgjithshëm gjyqësor. Më 26 qershor 1973, kërkuesi u padit në Gjykatën e Qarkut në Romë, Itali. U kërkua njohja e statusit të kundërshtarit si punonjës për kompaninë ku Kërkuesi punonte dhe shpërblimi në lidhje me punën e kryer nga kundërshtari në zyrën e kompanisë. Dy seancat u zhvilluan para gjyqtarit hetues më 2 tetor dhe 4 dhjetor 1973. Një seancë e tretë, e përcaktuar për në 30 prill 1974, nuk u realizua pasi shqyrtimi i çështjes u pezullua pas hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri. Kjo reformoi rregullat përkatëse të juridiksionit përderisa Gjykata e Qarkut nuk do të ishte më gjykatë e shkallës së parë, por përgjegjëse për apelimet. Ai parashikoi që çështjet në pritje të trajtohen dhe mbyllen nga Gjykata e Qarkut përkatëse si gjykatë e shkallës së parë. Shqyrtimi i rastit të kërkuesit rifilloi vetëm më 6 shkurt 1978. Më 25 shtator 1978 ai u urdhërua të paguajë dëmshpërblimin. Më 17 tetor 1979, kërkuesi apeloi në Gjykatën e Apelit në Romë. Më 28 mars 1980, Gjykata e hodhi poshtë apelin e tij. Më 20 mars 1981, Kërkuesi apeloi në Gjykatën

e Kasacionit. Seanca në Gjykatën e Kasacionit u zhvillua më 29 prill 1985. Teksti i vendimit që hodhi poshtë ankesën u depozitua më 27 nëntor 1985.

Gjykata konstatoi se Italia kishte shkelur të drejtën për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

Neni 6 § 1 i KEDNJ-së thotë: *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme […]"*.

Duke iu referuar kushteve dhe kërkesave të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së siç thuhet në praktikën e saj të mëparshme (*shiko më sipër, përmbledhjen e çështjes "Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës"*), Gjykata përcakton periudhën që do të merret parasysh. Ndryshe nga rastet e tjera, Gjykata vendosi që *"periudha që duhet marrë në konsideratë filloi jo më 26 qershor 1973 kur filloi veprimi kundër ankuesit […] në Gjykatën e Rrethit të Romës, por më 1 gusht 1973 kur deklarata italiane që njihte të drejtën e peticionit individual hyri në fuqi."*. Ajo përfundoi me depozitimin e vendimit të Gjykatës së Kasacionit më 27 nëntor 1985, pra në total rreth 11 vite e gjysmë.

Si aspekt vendimtar, Gjykata rithekson kërkesën e Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së ku shtetet duhet të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që secili të marrë vendime përfundimtare për të drejtat dhe detyrimet e tij civile brenda një afati të arsyeshëm. Për më tepër, Gjykata pohon se:

> "*Mosmarrëveshjet e punësimit për nga natyra e tyre kërkojnë në përgjithësi vendime të shpejta […].*"

Sipas Gjykatës, ndryshimet e ligjit themelor procedural nuk mund të justifikojnë tejzgjatjen e procedimeve. Përkundrazi:

> *"Autoritetet italiane pranuan [nevojën për procedura të përshpejtuara në çështjet e punësimit] duke ndryshuar procedurën speciale të përdorur në raste të tilla në vitin 1973; ndryshimet e paraqitura përfshinin një shkurtim të afateve që zbatohen zakonisht në procedurat civile. Në rastin konkret asnjë prej tyre nuk është respektuar. Kjo ka ndodhur veçanërisht në shkallën e parë dhe në Gjykatën e Kasacionit; në të dyja ato nivele pati periudhë stanjacioni mbi katër vjet."*.

Gjykata konstaton se autoritetet e shtetit të paditur nuk i kanë përmbushur këto kritere.

Cappello k. Italisë – nr. 87/12783, datë 1992/02/27

Vendimi *Cappello k. Italisë*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 27 shkurt 1992, fokusohet në parimin e gjykimit të drejtë, të mishëruar në Nenin 6 të KEDNJ-së, veçanërisht në kohëzgjatjen e arsyeshme të një procesi që përfshin dy nivele juridiksioni, ndryshimet e gjyqtarëve hetues dhe ndërprerje të tjera.

Kërkuesi kundërshtoi kohëzgjatjen e procesit në përgjithësi. Më 16 maj 1980, kërkuesi paditi një person të tretë, prindërit e tij dhe pronarin e motoçikletës së përfshirë për dëmin që rezultoi nga një aksident. Seanca e parë, e caktuar për në 2 tetor 1980, nuk u mbajt deri më 2 tetor 1981 për shkak të transferimit të gjyqtarit përgjegjës për çështjen. Më 16 shkurt 1984, çështja ishte gati për seancë dëgjimore dhe iu caktua dhomës përkatëse të gjykatës, para së cilës palët do të paraqiteshin më 22 nëntor 1984. Megjithatë, seanca u shty për një kohë të pacaktuar për shkak të një transferimi tjetër të gjyqtarit hetues. Gjyqtari hetues u zëvendësua në janar 1987 dhe seanca para dhomës së gjykatës u caktua për 19 shkurt 1987, por në atë datë procesi u ndërpre pas vdekjes së avokatit të një të pandehuri. Gjykimi u rihap më 24 mars 1987. Seanca para trupës gjyqësore, e caktuar fillimisht për në 11 qershor 1987, nuk u mbajt deri më 19 nëntor 1987. Më 16 dhjetor 1987, Gjykata e Qarkut dha vendimin, duke i pranuar pretendimet e kërkuesit. Gjykata e apelit e konfirmoi vendimin më 26 shtator 1990.

Gjykata vërejti se Italia kishte shkelur të drejtën për gjykim të drejtë, Neni 6 § 1 KEDNJ-së.

Neni 6 § 1 i KEDNJ-së thotë: *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, secili ka të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj […]"*

Duke iu referuar kushteve dhe kërkesave nga Neni 6 § 1 i KEDNJ-së siç thuhet në praktikën e saj të mëparshme (*shiko më sipër, përmbledhjen e çështjes "Zimmermann dhe Steiner k. Zvicrës"*), Gjykata përcakton periudhën që duhet të merret parasysh: Zgjati për rreth 11 vjet, duke filluar me paraqitjen e kërkesës nga paditësi në gjykatën e shkallës së parë në maj 1980 dhe përfundimin me vendimin përfundimtar të çështjes nga Gjykata e Apelit në shtator 1991.

Gjykata vëren se kjo periudhë nuk është e arsyeshme në kuptim të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së dhe thekson, si tipar vendimtar, se një ngarkesë e lartë

e punës së Gjykatës së Rrethit dhe transferimi i dy gjyqtarëve nuk mund të justifikojnë kohëzgjatjen. Shtetet duhet të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që secili të marrë një vendim përfundimtar për të drejtat dhe detyrimet e tij civile brenda një kohe të arsyeshme:

"Megjithatë, siç theksoi zonja Cappello, çështja ishte e thjeshtë. Sidoqoftë, u deshën gati katër vjet për të përfunduar hetimin (16 maj 1980 - 16 shkurt 1984) dhe pati një periudhë të gjatë ndërprerjeje për seancat në trupën kompetente të Gjykatës së Rrethit (22 nëntor 1984 - 19 shkurt 1987) para se të vazhdonin me një ritëm më normal.

Qeveria u ankua për çështjet e prapambetura në Gjykatën e Rrethit Tempio Pausania dhe transferimin e dy gjyqtarëve, por Neni 6 parag. 1 (N. 6-1) u imponon Shteteve Kontraktore detyrën për të organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të plotësojnë secilën nga kërkesat e saj (shih, ndër të tjera, vendimin Vocaturo k. Italisë të 24 majit 1991, Seria A nr. 206-C, fq. 32, paragrafi 17).

Dosja e çështjes nuk jep shumë hollësi mbi procedurat në Gjykatën e Apelit të Cagliari-t. Shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për periudhën disa mujore të cilën të pandehurit e apeluan, por mund të vërehet se kanë kaluar afërsisht tre muaj midis miratimit të vendimit dhe paraqitjes së tekstit të tij në sekretari (29 qershor - 26 shtator 1990).

Në çdo rast, Gjykata nuk mund ta konsiderojë si të "arsyeshëm" kalimin e kohës në çështjen në fjalë.".

X k. Francës - nr. 18020/91, datë 31/10/1992

Vendimi *X. kundër Francës*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 31 janar 1992, fokusohet te parimi i procesit të rregullt, i parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së, në veçanti te kohëzgjatja e arsyeshme e procedimit gjyqësor, duke përfshirë dy nivele jurisprudence dhe rreth katërqind raste paralele të ngjashme në të njëjtën gjykatë.

Ankuesi kundërshtoi kohëzgjatjen e procedimeve, përfshirë vendimet administrative dhe, në kohën e vendimit të Gjykatës, procedimin në pritje në shkallën e dytë. Me procedimet gjyqësore, ai kundërshtoi vendimet administrative negative për kompensimin e kërkuar nga Shteti i Francës për dëmin e pësuar nga infeksioni HIV i supozuar i shkaktuar nga transfuzionet e gjakut të marra nga ai si trajtim për hemofilinë. Më 1 dhjetor 1989, kërkuesi iu drejtua autoriteteve administrative përkatëse me një kërkesë paraprake për kompensim. Gjashtëqind e dyzet e nëntë kërkesa të tjera të tilla u paraqitën në të njëjtën kohë. Më 30 mars1990, Drejtori i Përgjithshëm i Shëndetësisë refuzoi kërkesën e Z. X. Më 30 maj të vitit 1990, zoti X paraqiti një kërkesë në Gjykatën Administrative të Parisit. Rreth katërqind kërkesa të ngjashme u paraqitën dhe iu caktuan asaj gjykate. Ata ngritën pyetje nga të cilat disa ishin të zakonshme për të gjitha rastet dhe disa ishin të veçanta për secilin rast individual. Seanca në Gjykatën Administrative të Parisit u mbajt më 18 dhjetor 1991, vendimi u dha më 20 dhjetor 1991, duke hedhur poshtë pretendimet e zotit X., pasi qeveria kishte kërkuar disa shtyrje të afateve në mënyrë që të bëhej mbrojtja e duhur dhe mbledhja e materialeve të nevojshme. Më 20 janar të vitit 1992, Z. X apeloi në Gjykatën e Apelit. Ky procedim, i vazhduar nga prindërit e tij për shkak të vdekjes së zotit X. ishte ende në pritje në kohën e gjykimit të GJEDNJ-së.

Gjykata konstatoi se Franca ka shkelur të drejtën për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

Neni 6 § 1 i KEDNJ-së thotë: *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme […]".*

Gjykata deklaron shpejt se çështja aktuale bie brenda objektit të veprimit të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së ku vëren se *"nocioni i "të drejtave dhe detyrimeve civile" nuk duhet të interpretohet vetëm duke iu referuar ligjit të brendshëm të shtetit të paditur dhe neni 6 paragraf 1 (neni 6-1) zbatohet pavarësisht statusit të palëve, qoftë ai privat apo publik, dhe pavarësisht nga natyra e legjislacionit që rregullon mënyrën në të cilën do të përcaktohet mosmarrëveshja; mjafton që rezultati i procedurës të jetë vendimtar për të drejtat dhe detyrimet private.".*

Ai u referohet kushteve dhe kërkesave të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, siç zbatohen në praktikën e tij të mëparshme (*shih më lart, përmbledhjen e çështjes "Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës"*).

Sipas Gjykatës, periudha që duhet marrë në konsideratë ka filluar me kërkesën paraprake në 1 dhjetor 1989, kur ankuesi e ka paraqitur kërkesën e tij pranë autoritetit administrativ përgjegjës. Ajo nuk kishte përfunduar në kohën e gjykimit për shkak të procedimit të apelit që ishte ende në vazhdim e sipër dhe rrjedhimisht tashmë *"zgjati më shumë se dy vjet"*.

Gjykata vëren se kompleksiteti i çështjes, megjithëse ekziston, nuk mund të justifikojë kohëzgjatjen e procedimeve nëse qeveria si palë dështon të përgatitet në përputhje me rrethanat edhe pse kjo është e mundur.

"Sipas mendimit të Gjykatës, rasti ishte i një kompleksiteti të caktuar dhe hetimet mund të ishin të nevojshme për përcaktimin e përgjegjësisë së shtetit dhe shtrirjen e saj. Megjithatë, qeveria ndoshta kishte qenë në dijeni për një kohë të gjatë se procedimet ishin të pashmangshme. Do të ishte e mundur që ata të merrnin një pjesë të madhe të informacionit përkatës dhe duhet të kishin komisionuar raportin objektiv për çështjen e përgjegjësisë menjëherë pas fillimit të çështjeve kundër tyre.".

Gjithashtu, sjellja e kërkuesit nuk do të përjashtonte shkelje të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së nëse ai thjesht ushtron të drejtat e tij. Ishte e parëndësishme që Kërkuesi zgjodhi një metodë rregullimi që kërkon hetime më komplekse nga gjykatat sesa metoda më pak komplekse në fjalë, pasi kjo ishte vetëm për vendimin e kërkuesit.

Gjykata thekson se gjykatat kombëtare duhet të marrin parasysh atë çka është në rrezik për kërkuesin dhe të përshtatin shpejtësinë e procedimeve në përputhje me rrethanat. Ajo pohon se në rastin konkret ata nuk arritën ta bëjnë këtë, edhe sepse nuk përdorën çdo mjet në dispozicion të tyre.

"Gjykata vlerëson se ajo çka ishte në rrezik në procedimet kundërshtuese ishte e një rëndësie vendimtare për kërkuesin, duke pasur parasysh sëmundjen e pashërueshme nga e cila vuante dhe jetëgjatësinë e tij të reduktuar [...] Ekzistonte rreziku që çdo vonesë të bënte që çështja të zgjidhej nga gjykata pa qëllim.

Shkurtimisht, në këtë rast kërkohej një kujdes i jashtëzakonshëm, pavarësisht numrit të çështjeve që ishin në pritje, veçanërisht pasi faktet me të cilat qeveria ishte njohur prej disa muajsh dhe rëndësia e të cilëve duhet të ishte e dukshme ishin polemike.

48. Megjithatë, gjykata administrative nuk i përdori fuqitë e saj për të dhënë urdhra për përshpejtimin e ecurisë së procedimit, megjithëse nga 29 tetori 1990 ishte në dijeni të përkeqësimit të shëndetit të z. X (shih paragrafin 40 më lart). Në mënyrë të veçantë, ajo kishte për detyrë që, sapo t'i referohej çështja, të kryente hetime për përgjegjësinë e shtetit dhe të urdhëronte me forcë Ministrin të prodhonte memorialin e tij të mbrojtjes ose të jepte gjykimin pa të.

Bendenoun k. Francës – nr. 12547/86, datë 24/02/1994

Vendimi *Bendenoun k. Francës*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 24 shkurt 1994, fokusohet në të drejtën për një gjykim të paanshëm si pjesë e një gjykimi të drejtë, Neni 6 i KEDNJ-së, veçanërisht në çështjen e zbatueshmërisë në kuadrin e natyrës së masave të vendosura.

Kërkuesi, z. Michel Bendenoun, sfidoi sanksionet dhe procedurat e mëvonshme në gjykata në lidhje me evazionin fiskal. Ankuesi është një shtetas francez i cili jetonte në Cyrih dhe ishte një tregtar i monedhave në kohën e gjykimit nga GJEDNJ-ja Në 1973, ai krijoi një shoqëri publike të kufizuar sipas ligjit francez, ARTSBY 1881, me seli në Strasburg. Ai zotëronte pjesën më të madhe të kapitalit të saj dhe veproi si kryetar dhe drejtor administrativ. Si rezultat i veprimtarive të tij, tri lloje procesesh - doganore, tatimore dhe penale - u çelën kundër tij dhe ato u zhvilluan pak a shumë paralelisht. Sa u përket procedurave doganore, kërkuesi u hetua për shkelje të ndryshme doganore dhe shkelje gjatë kontrollit të shkëmbimit. Një përfundim u arrit në janar 1978. Kërkuesi i pranoi shkeljet, pagoi një gjobë prej 300,000 franga franceze (FRF) dhe dogana i ktheu sendet që i ishin sekuestruar atij. Gjatë procesit, kërkuesi kishte qasje në të gjitha dokumentet e dosjes doganore, të cilat përmbanin 24 raporte dhe 353 dokumente të tjera. Në një kohë të caktuar - sipas Qeverisë - para gushtit 1976 dhe në bazë të Nenit 1987 të Kodit të Përgjithshëm të Tatimeve, doganat i dërguan të gjitha dokumentet tek të Ardhurat. Sa u përket procedurave tatimore, pas inspektimeve në 1976, kërkuesit iu desh të paguante për gjobat një shtesë prej 841,366 FRF. Shoqërisë iu kërkua të paguante taksa dhe gjoba shtesë në shumën 157,752 FRF, si dhe 309,738 FRF në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar, 270,312 FRF, si dhe 260,660 FRF në lidhje me taksën për korporata. Inspektori tatimor përpiloi një raport duke përfunduar me një kërkesë për procedime penale, që realisht filluan në nëntor 1977. Në dhjetor 1977, ARTSBY 1881, në cilësinë e kryetarit dhe drejtorit administrativ të saj, paraqiti dy ankesa pranë Komisionerit Rajonal të të Ardhurave në Strasburg në lidhje me taksën e korporatës dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Ankuesi paraqiti një ankesë të tretë, në emrin e tij, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat. Të tria iu refuzuan. Në qershor 1978, kërkuesi, duke vepruar në emër të ARTSBY 1881, bëri dy kërkesa në Gjykatën Administrative të Strasburgut në lidhje me taksën e korporatës dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Në qershor 1979, ai bëri një kërkesë tjetër në të njëjtën gjykatë, këtë radhë në emrin e tij, duke kundërshtuar vlerësimin shtesë të tatimit mbi të ardhurat e tij. Në

kuadrin procedural pati kundërshtime në lidhje me një dosje të hapur ndaj kërkuesit nga autoritetet doganore, e cila, sipas kërkuesit nuk i ishte dërguar as atij, as avokatit të tij nga autoritetet dhe/ose prokurori publik pavarësisht kërkesave të Gjykatave përkatëse. Ankimet u hodhën poshtë, sikundër edhe ankesat e mëvonshme. Sa i përket procesit penal, Gjykata Penale e Strasburgut dha dy vendime në lidhje me kërkuesin në nëntor 1980, i pari në cilësinë e kryetarit dhe drejtorit administrativ të ARTSBY 1881 (taksa e korporatës dhe tatimi mbi vlerën e shtuar), i dyti në cilësinë e tij personale (tatimi mbi të ardhurat). Në secilin vendim atij iu dha një dënim me kusht me pesëmbëdhjetë muaj burg për evazion fiskal, të dy dënimet të ekzekutoheshin njëkohësisht, si dhe u urdhërua të burgosej për një vit në rast të mospagimit të shumave për të cilat detyrohej të paguante. Apelimet e mëtejshme u hodhën poshtë. Përsëri, pati mosmarrëveshje për qasjen e kërkuesit ndaj dosjes doganore dhe të paraqitur para Gjykatave përkatëse.

Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 6 të KEDNJ-së.

Sa i përket Nenit 6 të KEDNJ-së dhe çështjes vendimtare të zbatueshmërisë së tij në procedurat kundër kërkuesit, Gjykata vlerëson se shtesat e taksave mbi kërkuesin duhet të konsideroheshin si një dënim penal në kuptim të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Ato ishin aq thelbësore saqë Neni 6 i KEDNJ-së ishte i zbatueshëm tashmë pa marrë parasysh akuzat e tjera kundër kërkuesit.

Në arsyetimin e saj, Gjykata u referohet kritereve të përcaktuara në praktikën e saj gjyqësore të mëparshme për të përcaktuar një "akuzë penale":

"Në dritën e jurisprudencës së saj dhe në veçanti të gjykimit të cituar më parë, Öztürk, ajo vë në dukje, sërish, se katër faktorë dëshmojnë për në drejtim të kundërt. Në radhë të parë, veprat penale për të cilat u akuzua z. Bendenoun bazohen në nenin 1729, paragrafi 1 i Kodit të Përgjithshëm Tatimor (*shih, paragrafin 34 më lart*). Ky parashikim përfshin të gjithë qytetarët në cilësinë e tyre si tatimpagues dhe nuk i drejtohet një grupi të caktuar me një status të veçantë. Ai përcakton kërkesa të caktuara, për të cilat jepen dënime në rast se nuk përmbushen. Së dyti, shtesat e taksave nuk synohen si kompensim material për dëmin, por në thelb si një ndëshkim për të penguar përsëritjen e shkeljes. Së treti, ato bëhen të detyrueshme sipas një rregulli të përgjithshëm, qëllimi i të cilit është si parandalues, ashtu edhe ndëshkues. Së fundmi, në rastin konkret, tarifat shtesë ishin shumë të konsiderueshme, duke arritur në 422,534 FRF në lidhje me z.Bendenoun personalisht dhe 570,398 FRF në lidhje me kompaninë e tij (*shih, paragrafin 13 më lart*) dhe në rast mospagese ai ishte përgjegjës për t'u dënuar me burgim nga gjykatat penale (*shih, paragrafin 35 më lart*).

Duke peshuar aspektet e ndryshme të çështjes, Gjykata vëren mbizotërimin e atyre që kanë një kuptim penal. Asnjëra prej tyre nuk është vendimtare më vete, por të marra së bashku dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse e kthyen "akuzën" në fjalë në një "penal" sipas kuptimit të Nenit 6 paragrafi 1 (neni 6-1), i cili u bë i zbatueshëm për këtë arsye."

Sa i përket rastit në fjalë, për pajtueshmërinë e vërejtur me Nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se nuk dukej nga informacioni në dispozicion se dështimi për të hartuar dokumente shkelte të drejtat e kërkuesit për t'u mbrojtur apo parimin e barazisë së armëve. Provat para Gjykatës nuk treguan që kërkuesi të kishte paraqitur ndonjëherë ndonjë argument të saktë për të mbështetur pohimin e tij se, pavarësisht nga pranimi i shkeljeve doganore dhe pohimet e tij gjatë hetimit penal, ai nuk mund ta kishte kundërshtuar akuzën e evazionit fiskal pa pasur një kopje të duhur dhe të plotë të dosjes doganore. Ky anashkalim ishte akoma më i dëmshëm për çështjen e kërkuesit pasi ai kishte qenë në dijeni të ekzistencës dhe përmbajtjes së shumicës së dokumenteve dhe si ai, ashtu edhe avokati i tij kishin pasur qasje në dosjen e plotë në çdo rast gjatë hetimit penal.

Bulut k. Austrisë - nr. 17358/90, datë 22/02/1996

Vendimi i çështjes *Bulut k. Austrisë*, i shpallur nga gjykata në 22 shkurt 1996 fokusohet në parimin e barazisë së armëve sipas nenit 6-1 të Konventës.

Ankuesi u përball me akuzën për dhënie ryshfeti dy nëpunësve të zyrës së punës në Insbruk në këmbim të lëshimit të një certifikate të false. Pasi çështja kaloi të gjitha fazat e gjykimit deri në Gjykatën Supreme, i dënuari iu drejtua Komisionit Evropian për të Drejtat e njeriut me pretendimin se në shkelje të nenit 6 parag. 1 (neni 6-1) të Konventës, gjykata e Insbrukut kishte lejuar në gjykim një gjyqtar të skualifikuar për shkak të ligjit, pra pjesëmarrja në gjykim e një gjyqtari që kishte marrë pjesë më parë në hetimin paraprak. Ai më tej u ankua se nuk ishte mbajtur asnjë seancë dëgjimore në Gjykatën e Lartë, se Prokurori i Përgjithshëm i kishte paraqitur Gjykatës së Lartë vërejtje të cilat nuk i ishin vënë në dispozicion mbrojtjes dhe se Gjykata e Lartë i kishte komunikuar emrin e gjyqtarit relator Prokurorit të Përgjithshëm në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse.

Gjykata arrin në përfundimin se parimi i barazisë së armëve nuk është respektuar dhe se ka pasur shkelje të nenit 6 parag. 1 (neni 6-1) për shkak të

paraqitjes së vërejtjeve nga Prokurori i Përgjithshëm në Gjykatën e Lartë pa dijeninë e kërkuesit, duke arsyetuar si vijon:

46. Komisioni, [...], konsideroi se është në thelb e padrejtë që prokuroria të bëjë parashtresa në gjykatë pa dijeninë e mbrojtjes dhe për të cilat mbrojtja nuk ka mundësi të komentojë. 47. Gjykata kujton se sipas parimit të barazisë së armëve, si një nga tiparet e konceptit më të gjerë të një gjykimi të drejtë, secilës palë duhet t'i ofrohet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh përballë kundërshtarit të tij (shih, vendimin Dombo Beheer BV kundër Holandës të 27 tetorit 1993, Seria A nr. 274, f. 19, para. 33). Në këtë kontekst, rëndësi i kushtohet paraqitjes, si dhe rritjes së ndjeshmërisë ndaj administrimit të drejtë të drejtësisë (shih, mutatis mutandis, vendimi Borgers kundër Belgjikës, 30 tetor 1991, Seria A nr. 214-B, f. 31, paragrafi 24, dhe autoritetet e cituara aty).

49. Sa i përket pretendimit të Qeverisë se vërejtjet e Prokurorit të Përgjithshëm thjesht kërkonin që çështja të trajtohej sipas nenit 285d të Kodit të Procedurës Penale pa dhënë asnjë arsye [..] vlen të theksohet se në Çështjen Lobo Machado e cituar më sipër, Gjykata, në kontekstin më pak të rreptë të një mosmarrëveshjeje sociale, nuk e konsideroi të pranueshme që përfaqësuesi i Prokurorit të Përgjithshëm të paraqiste një deklaratë përfundimtare, e cila kërkonte shkurtimisht që vendimi i gjykatës së apelit të lihej në fuqi. Në apelin aktual penal, dorëzimi i vëzhgimeve i lejoi Prokurorit të Përgjithshëm të mbante një qëndrim të qartë në lidhje me ankesën e kërkuesit, një qëndrim i cili nuk iu komunikua mbrojtjes dhe të cilit mbrojtja nuk mund t'i përgjigjej. Në çdo rast, siç vuri në dukje me të drejtë Komisioni, parimi i barazisë së armëve nuk varet nga një padrejtësi e mëtejshme e matshme që rrjedh nga një pabarazi procedurale. Është çështje e mbrojtjes që të vlerësojë nëse një parashtresë meriton apo jo një reagim. Prandaj është e padrejtë që prokuroria të bëjë parashtresa në gjykatë pa dijeninë e mbrojtjes.

Foucher k. Francës – nr. 22209/93, datë 18/03/1997

Vendimi *Foucher k. Francës* u shpall nga Gjykata (Dhoma) në 18 mars 1997, duke u përqendruar në të drejtën për t'u mbrojtur gjatë një procedimi penal, mbështetur në Nenin 6 -1 marrë së bashku me nenin 6 par. 3 të KEDNJ-së, veçanërisht në të drejtën për të pasur mundësi të kishte akses në dosjen e tij të çështjes.

Ankuesi dhe babai i tij u thirrën për t'u paraqitur para Gjykatës së Argentanit pasi u akuzuan për përdorimin e sjelljeve fyese dhe fjalëve kërcënuese ndaj punonjësve të shërbimit publik - dy rojeve kombëtare të mbrojtjes së kafshëve të egra, vepër kjo e klasifikuar si kundërvajtje penale e klasës së pestë sipas Kodit Penal Francez, e dënueshme me burgim nga dhjetë ditë deri në një muaj dhe me gjobë nga 2.500 deri në 5.000 franga franceze. Kërkesat e nënës së të akuzuarit për të konsultuar dosjen e çështjes dhe për të siguruar kopjet e dokumenteve që përmbante, u mohuan nga një prokuror publik i cili deklaroi se kopjet nuk mund t'u jepeshin individëve përveçse nëpërmjet një avokati ose një kompanie sigurimesh. Pasi çështja u shqyrtua nga Gjykata e Apelit dhe ajo e Kasacionit, ankuesi iu drejtua Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut i cili e referoi çështjen pranë GJEDNJ-së duke pretenduar shkeljen e nenit 6, parag. 3 të Konventës dhe duke u ankuar veçanërisht në lidhje me shkeljen e të drejtës së mbrojtjes të cilën ai do të ishte në gjendje ta ushtronte nëse do të kishte akses në dosjen penale ose të kishte një kopje të dokumenteve që gjendeshin në të.

Gjykata arriti në përfundimin se garancitë e parashikuara në nenin 6 – 1 dhe 3 të marra së bashku në lidhje me aspekte specifike të së drejtës për një proces të rregullt ishin shkelur, duke theksuar se kërkuesi mund të ankohej si për refuzimin për t'i dhënë akses në dosjen e tij penale ashtu edhe për t'i lëshuar kopjet e dokumenteve në të, pavarësisht nga fakti se ai nuk kishte bërë një kërkesë të tillë në Gjykatën e Apelit apo nuk kishte marrë pjesë në seancën e mbajtur në pranë kësaj gjykate - i ishte mohuar qasja në shkallë të parë nga prokurori publik - Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Kasacionit e kishin marrë si të mirëqenë se kërkuesi nuk kishte pasur mundësi të kishte akses në dosjen e tij të çështjes ose të merrte një kopje të dokumenteve në të.

Parimi i barazisë së armëve kupton se "secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh përkundrejt kundërshtarit të tij".

Malige k. Francës - nr. 27812/95, datë 23/09/1998

Vendimi *Malige k. Franc*ës, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 23 shtator 1998, fokusohet tek e drejta për proces të rregullt e nenit 6 të KEDNJ-së, në veçanti sa i përket aksesit në gjykatë në kontekstin e natyrës së një sanksioni.

Kërkuesi kundërshtoi vendimin dhe procedimet e mëpasshme gjyqësore për heqjen e pikëve nga leja e tij e drejtimit. Z. Jérôme Malige është shtetas francez, i cili ka lindur në vitin 1974 dhe jeton në Morangis, Francë. Më 28 qershor të vitit 1993, në orën 4:25 pasdite, ai po udhëtonte me motoçikletë

përgjatë rrugës nacionale pranë Millemont, Francë, kur policia regjistroi shpejtësinë e tij 172 km/h në një shtrirje rruge ku kufiri në fuqi i shpejtësisë ishte 110 km/orë. Kjo sjellje bie ndesh me Nenin R. 10 2-2 të Kodit të Trafikut Rrugor, i cili përcakton kufirin e shpejtësisë prej 110 km/orë. Neni R. 232 1-2 parashikon që tejkalimi i kufirit me mbi 30 kilometra në orë dënohet me gjoba të përcaktuara për veprat penale të kategorisë 4. Neni R. 266/4 parashikon që kur kufiri i shpejtësisë tejkalohet me më shumë se 30 km/orë, atëherë shkelësi mund të përjashtohet përkohësisht nga leja e drejtimit. Kërkuesi refuzoi ta paguajë gjobën e vendosur dhe, në shtator të vitit 1993, u zgjodh për t'u gjykuar. Në një vendim gjyqësor në nëntor të vitit 1993, Gjykata e Policisë e shpalli z. Malige fajtor për veprën e tejkalimit të kufirit të shpejtësisë me të paktën 30 km/orë. Gjykata e gjobiti kërkuesin me 1.500 franga dhe e përjashtoi atë nga drejtimi i automjetit për pesëmbëdhjetë ditë në përputhje me Kodin e Trafikut Rrugor. Në lidhje me dekretet që zbatojnë sistemin e pikëve për lejet e drejtimit, Gjykata e Policisë vendosi se gjykatat penale kishin juridiksion të përcaktojnë ligjshmërinë e masave rregullatore administrative vetëm për aq kohë sa këto masa ishin baza e ndjekjes penale ose kishin sanksione penale. Gjithashtu, nga Kodi i Trafikut Rrugor rezultoi se zbritja e këtyre pikëve nuk ishte sanksion dytësor penal i shkaktuar nga dënimi dhe rezultati ishte se baza e tij ligjore binte jashtë juridiksionit të gjykatave penale. Z. Malige apeloi në Gjykatën e Apelit të Versajës, e cila e pezulloi vendimin. Ajo vërejti se "humbja e pikëve nuk është një sanksion penal pasi nuk ka karakteristikat e nevojshme dhe nuk është as sanksion dytësor penal i shkaktuar nga dënimi penal." Pas apelimit, në një vendim gjyqësor të 11 janarit 1995, Divizioni Penal i Gjykatës së Kasacionit e hodhi poshtë çështjen.

Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 6 të KEDNJ -së [linku me tekstin].

Sa i përket çështjes vendimtare të zbatueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së për zbritjen e pikëve, Gjykata vërejti se ky sanksion përbën dënim dhe për këtë arsye, është sanksion penal brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

> *„Gjykata thekson se koncepti i "dënimit" në nenin 7 të Konventës, si nocioni i "akuzës penale "në nenin 6 § 1 të Konventës, është koncept autonom. Në analizën e saj, nuk është kufizuar nga klasifikimet në të drejtën e brendshme, të cilat kanë vetëm vlerë relative […]*
>
> *Për të përcaktuar nëse ka "akuzë penale", Gjykata ka parasysh tri kritere: klasifikimin ligjor të veprës në fjalë në ligjin kombëtar, vetë natyrën e veprës dhe natyrën dhe shkallën e ashpërsisë së dënimit (shih, mes autoriteteve të tjera, vendimin Pierre-Bloch kundër Francës të 21 tetorit 1997, Raportet 1997-VI, f. 2224, § 53).".*

Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vepra që çoi në zbritjen e pikëve për tejkalim të kufirit të shpejtësisë, ishte e natyrës kriminale. Lidhur me klasifikimin në ligjin francez të zbritjes së pikëve, masa në fjalë, e konsideruar e izoluar, u pa si një sanksion administrativ që nuk lidhet me të drejtën penale. Megjithatë, sa i përket natyrës së dënimit, pikët u zbritën në kontekstin e ndjekjes penale dhe pas rezultatit të dhënë nga ajo, dhe, më e rëndësishmja, kjo ishte pasojë automatike e dënimit të dhënë nga gjykata penale. Sa i përket nivelit të ashpërsisë, zbritja e pikëve mund të sjellë zhvleftësimin në kohë të lejes së drejtimit, ku e drejta për drejtimin e automjeteve motorike ishte shumë e dobishme në jetën e përditshme dhe për punën. Prandaj, zbritja e pikëve kishte karakter ndëshkues dhe pengues dhe ishte e ngjashme me një dënim dytësor.

Gjykata nuk vërejti shkelje të së drejtës për akses në gjykatë. Kërkuesi kishte pasur një mjet për ta kundërshtuar ligjshmërinë e zbritjes së pikëve. Në Gjykatën Policore të Versajës dhe Gjykatën e Apelit e Versajës, të cilat, sipas Gjykatës, janë gjykata penale që përmbushin kriteret e Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, kërkuesi ishte në gjendje të mohonte kryerjen e veprës penale të tejkalimit të kufirit të shpejtësisë. Për më tepër, masa nuk mund të përshkruhej si joproporcionale, pasi nuk çoi në përjashtim të menjëhershëm dhe kërkuesi mund t'i rifitonte sërish pikët. Rishikim i mjaftueshëm për përmbushjen e kritereve të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së u përfshi në vendimin që dënoi kërkuesin, ndaj të cilit ishte hapur për të kërkuar rishikim gjyqësor në gjykatat administrative për të konstatuar nëse autoriteti kishte vepruar pasi kishte ndjekur një procedurë ligjore.

Morris k. Mbretërisë së Bashkuar **– nr. 38784/97, datë 26/02/2002**

Vendimi i çështjes *Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, i shpallur nga gjykata më 26 shkurt 2002 fokusohet në konceptin e pavarësisë së gjykatës në përputhje me kërkesat e nenit 6 *§* 1 të Konventës.

Kërkuesi, një ushtar, u arrestua në vitin 1996 pasi kishte munguar nga shërbimi pa leje. Ai u dërgua në gjyq dhe komandanti i tij caktoi një kapiten ushtrie pa trajnim ligjor si "oficer mbrojtës". Kërkuesi aplikoi për ndihmë juridike për t'i mundësuar që të përfaqësohej nga një avokat dhe iu ofrua ndihma juridike me një pagesë paraprake prej 240 £. Avokati i tij kërkoi që ky kusht të rishqyrtohej, por para se të merrej një përgjigje, kërkuesi refuzoi ofertën e ndihmës juridike dhe nënshkroi një dokument në të cilin

deklaronte se dëshironte të përfaqësohej vetëm nga oficeri mbrojtës. Gjyqi ushtarak u zhvillua në maj 1997. Gjykata përbëhej nga një Kryetar (një kryetar i përhershëm i gjykatave ushtarake), dy kapitenë ushtrie dhe një avokat civil i kualifikuar ligjërisht. Kërkuesi u deklarua fajtor dhe u dënua me nëntë muaj paraburgim dhe shkarkim nga ushtria. Më pas ai udhëzoi një avokat, i cili paraqiti një peticion pranë "autoritetit rishikues". Kërkesa u refuzua dhe një gjyqtar i vetëm i Gjykatës së Apelit Ushtarak refuzoi apelimin.

Gjykata arrin në përfundimin në lidhje me disa nga ankesat e ankuesit për strukturën e përgjithshme të sistemit të gjykatës ushtarake, se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, duke argumentuar se 58. [...] *për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet si "e pavarur", duhet pasur parasysh, ndër të tjera, mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe mandati i tyre, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe nëse trupa paraqet një pamje të pavarur. Sa i përket çështjes së "paanësisë", kjo kërkesë ka dy aspekte. Së pari, gjykata duhet të jetë subjektivisht e lirë nga paragjykimet. Së dyti, duhet të jetë gjithashtu e paanshme nga pikëpamja objektive, domethënë, duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë aspekt (shih Findlay, cituar më lart). Konceptet e pavarësisë dhe paanshmërisë objektive janë të lidhura ngushtë dhe, si në Findlay, Gjykata do t'i shqyrtojë ato së bashku me çështjen në fjalë.*

***Crisan k. Rumanisë* - nr. 42930/98, datë 27/05/2003**

Vendimi i çështjes *Crisan k. Rumanisë* i shpallur nga gjykata më 27 maj 2003 fokusohet në kontrollin gjyqësor mbi vendimet e organeve administrative në përputhje me kërkesat e nenit 6 *§* 1 të Konventës.

Në vitin 1990 dhe në vazhdim, kërkuesi i kërkoi Komisionit zbatimin e dekretit legjislativ nr. 118/90 pasi ai kishte qenë i persekutuar për arsye politike gjatë regjimit komunist dhe ai u jep të drejtat që rrjedhin në bazë të atij dekreti. Ai argumentoi se midis viteve 1973 dhe 1980 dhe midis viteve 1977 dhe 1987 ai ishte hetuar nga policia dhe ishte shkarkuar për arsye politike dhe se midis viteve 1973 dhe 1981 kishte qenë i mbyllur në mënyrë të padrejtë në një institucion psikiatrik. Gjykata e Qarkut hodhi poshtë kërkesat si të pavlefshme meqë, sipas dekretit, personi i interesuar nuk mund të kundërshtojë në gjykatë vendimin të Komisionit. Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e gjykatës së qarkut.

Gjykata arriti në përfundimin se ishte shkelur neni 6 – 1 i Konventës pasi, ndërsa qëllimi i reformës legjislative nuk ishte të ndikonte në rezultatin gjyqësor të mosmarrëveshjes së ngritur nga kërkuesi përpara gjykatave kombëtare, mbetet fakti se procedura e re dhe zbatimi i saj e bënë të pamundur që kërkuesi t'i paraqiste vendimet e marra nga një autoritet administrativ që nuk përmbush kërkesat e një "gjykate" sipas kuptimit të nenit 6 në kontrollin e mëvonshëm të një organi gjyqësor me juridiksion të plotë. Pamundësia që gjykatat të shqyrtojnë ligjshmërinë e vendimeve të autoritetit administrativ në lidhje me të drejtat civile të kërkuesit për shkak të modifikimit, gjatë procesit, të legjislacionit mbi juridiksionin e gjykatave ndikoi në thelbin e të drejtës së ankuesit për akses në gjykatë.

24 . Gjykata rithekson se, në lidhje me vendimet për të drejtat dhe detyrimet civile, neni 6 § 1 i Konventës kërkon që vendimet e marra nga autoritetet administrative, të cilat vetë nuk përmbushin kërkesat e kësaj dispozite, t'i nënshtrohen kontrollit të mëpasshëm nga një organ gjyqësor me juridiksion (shih Ortenberg kundër Austrisë, vendimi i 25 nëntorit 1994, seria a, nr. 295-B, f. 49-50, § 31; Stallinger & Kuso kundër Austrisë, ndalesa 23 prill 1997, Raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1997-II , f. 679–680, § 51).

***Bobek k. Polonisë* - nr. 68761/01, datë 17/08/2007**

Vendimi i çështjes *Bobek k. Polonisë*, i shpallur nga gjykata më 17 korrik 2007 fokusohet në parimin e barazisë së armëve sipas nenit 6-1 të Konventës.

Kërkuesja, e cila ishte avokate, bëri një deklaratë sipas dispozitave të Ligjit të Lustracionit të vitit 1997 se ajo nuk kishte bashkëpunuar kurrë në fshehtësi me shërbimin sekret komunist. Ajo pranoi vetëm se midis viteve 1945 dhe 1953 kishte punuar në Zyrën e Sigurisë (Urząd Bezpieczeństëa) në Rzeszóë si asistente zyre, por në vitin 1953 ajo e kishte lënë punën. Komisioneri i Interesit Publik iu drejtua Gjykatës së Apelit të Varshavës e cila ishte e caktuar sipas ligjit për lustracionin si Gjykatë e shkallës së parë, për të filluar procedimin me arsyetimin se kërkuesja kishte gënjyer në deklaratën e saj duke mohuar bashkëpunimin e saj me shërbimet sekrete pas vitit 1953. Gjykata i dërgoi kërkueses dispozitivin e vendimit të saj ku kishte konstatuar paraqitjen e një deklarate të pavërtetë lustracioni duke e informuar atë se arsyetimi me shkrim i vendimit sipas nenit 100 § 5 të Kodit të Procedurës Penale mund të konsultohej në zyrën e regjistrit sekret

(kancelaria tajna). Duke qenë se ajo nuk kishte caktuar përfaqësim ligjor, arsyetimin e plotë me shkrim mund ta lexonte vetëm ajo, duke përjashtuar të gjithë personat e tjerë, përveç Komisionerit të Interesit Publik. Çështja u apelua në shkallën e dytë dhe në Gjykatën e Kasacionit e cila lejoi kërkesën e Komisionerit për shqyrtimin e ankimit të kërkuesit me dyer të mbyllura, duke pasur parasysh nenin 360 § 1 (3) të Kodit të Procedurës Penale. Me një vendim të së njëjtës datë, Gjykata hodhi poshtë ankesën e ankuesit për kasacion.

Gjykata arrin në përfundimin se parimi i gjykimit të drejtë sipas nenit 6 par. 1 të Konventës nuk është respektuar për shkak të konfidencialitetit të dokumenteve dhe kufizimeve të aksesit në dosjen e çështjes nga personi i lustruar - veçanërisht krahasuar me pozitën e privilegjuar të Komisionerit të Interesit Publik në të tilla procedime - aftësia e kërkueses për të shqyrtuar çështjen e saj në mënyrë të drejtë u kufizua rëndë. Duke pasur parasysh kontekstin e veçantë të procedurës së lustracionit dhe zbatimin kumulativ të këtyre rregullave, Gjykata vlerëson se ato i vendosën një barrë joreale kërkuesit në praktikë dhe nuk plotësonin kërkesat e një gjykimi të drejtë ose të barazisë së armëve ndërmjet palëve në procedurë.

Në arsyetimin në lidhje me pajtueshmërinë me nenin 6 të Konventës, *56. Gjykata rithekson se sipas parimit të barazisë së armëve, si një nga tiparet e konceptit më të gjerë të një gjykimi të drejtë, secilës palë duhet t'i ofrohet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj ose të saj në kushte që nuk vendosin individ në një disavantazh të konsiderueshëm kundrejt kundërshtarit (shih, për shembull, Jespers kundër Belgjikës, nr. 8403/78, vendimi i Komisionit i 15 tetorit 1980, Vendimet dhe Raportet (DR) 27, f. 61; Foucher v. Francë, vendimi i 18 marsit 1997, Raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1997-II, § 34; Bulut kundër Austrisë, vendimi i 22 shkurtit 1996, Raportet 1996-II, f. 380-81, § 47). Gjykata rikujton më tej se, për të siguruar që i akuzuari të ketë një gjykim të drejtë, çdo vështirësi që i shkaktohet mbrojtjes nga kufizimi i të drejtave të saj duhet të kundërpeshohet mjaftueshëm nga procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore (shih Doorson kundër Holandës, aktgjykimi i 26 marsit 1996, Raportet 1996-II, f. 471, § 72; Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës, vendimi i 23 prillit 1997, Raportet 1997-III, f. 712, § 54).*

***Beian k. Rumanisë* - nr. 30658/05, datë 6/12/2007**

Vendimi i çështjes *Beian k. Rumanisë*, i shpallur nga gjykata më 6 dhjetor 2007 fokusohet në parimin e sigurisë juridike sipas nenit 6-1 të Konventës.

Ankuesi i cili gjatë viteve `50 ishte rekrutuar me punë të detyruar në vend të shërbimit ushtarak, pretendon në gjykatë kompensim dhe përfitime financiare sipas ligjit. Në këtë kuptim, ai pretendoi një shkelje të dyfishtë të nenit 6 § 1 të Konventës duke u ankuar për shkelje të parimit të sigurisë juridike për shkak të jurisprudencës kontradiktore të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë, bazuar në faktin që në raste të ngjashme, gjykatat vendase kishin vendosur në favor të ish-rekrutëve të tjerë në situata të krahasueshme me atë të kërkuesit duke i dhënë atij pritshmërinë e ligjshme për një përfundim në favor të tij. *Së dyti*, ai parashtroi se veprimi i tij nuk ishte përcaktuar nga një "gjykatë e pavarur dhe e paanshme", pasi gjykatat vendase i kishin dhënë peshë vendimtare informacionit të dhënë nga njësia ushtarake Piteşti, megjithëse kjo e fundit ishte kufizuar në riprodhimin e informacionit që përmbante një listë të hartuar nga i pandehuri.

Gjykata arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6 - 1 të Konventës pasi mungesa e sigurisë juridike në lidhje me praktikën gjyqësore kishte si pasojë privimin e kërkuesit nga çdo mundësi për të përfituar përfitimet e parashikuara nga ligji nr. 309-2002, ndërsa personave të tjerë në një situatë të ngjashme iu dhanë ato përfitime.

Në rastin në fjalë gjykata argumentoi se 32. [...] *Konventa nuk imponon asnjë detyrim specifik për Shtetet Kontraktuese për të siguruar kompensim për gabimet ose dëmet e shkaktuara përpara ratifikimit të Konventës nga ana e tyre (shih, mutatis mutandis, Kopecký kundër Sllovakisë [GC], nr. 44912/98, § 38, GJEDNJ 2004 IX). 33. Megjithatë, kur shtetet vendosin të miratojnë legjislacion për të kompensuar viktimat e padrejtësive të së kaluarës, ai duhet të zbatohet me qartësi dhe koherencë të arsyeshme në mënyrë që të shmanget, për aq sa është e mundur, pasiguria ligjore dhe paqartësia për personat juridikë në fjalë. Në këtë kontekst, duhet theksuar se pasiguria – qoftë legjislative, administrative apo gjyqësore – është një faktor i rëndësishëm që duhet marrë parasysh në vlerësimin e sjelljes së shtetit (shih, mutatis mutandis, Broniowski k. Polonisë [GC], nr. 31443 /96, § 151, GJEDNJ 2004 V, dhe Păduraru kundër Rumanisë, nr.63252/00, § 92, GJEDNJ 2005 XII).*

***Oleksander Volkov k. Ukrainës* - nr. 21722/11, datë 9/1/2013**

Vendimi i çështjes *Oleksander Volkov k. Ukrainës*, i shpallur nga gjykata më 9 janar 2013 fokusohet në parimin e gjykatës së pavarur dhe të paanshme

në përputhje me kërkesat e nenit 6 *§* 1 të Konventës.

Kërkuesi u ankua për shkelje të të drejtave të tij sipas Konventës gjatë shkarkimit të tij nga posti i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Në veçanti, ai pretendoi, sipas nenit 6 të Konventës, se (i) çështja e tij nuk ishte shqyrtuar nga një "gjykatë e pavarur dhe e paanshme"; (ii) procedimet përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë ("KLD") kishin qenë të padrejta, pasi ato nuk ishin kryer në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji i brendshëm që siguron garanci të rëndësishme procedurale, duke përfshirë afatet e parashkrimit për dënimet disiplinore; (iii) parlamenti kishte miratuar një vendim për shkarkimin e tij në një mbledhje plenare pa shqyrtimin e duhur të çështjes dhe duke abuzuar me sistemin elektronik të votimit; (iv) çështja e tij nuk ishte dëgjuar nga një "tribunal i themeluar me ligj"; (v) vendimet në rastin e tij ishin marrë pa një vlerësim të duhur të provave, dhe argumente të rëndësishme të ngritura nga mbrojtja nuk kishte qenë i adresuar siç duhet; (vi) mungesa e kompetencave të mjaftueshme nga ana e Gjykatës së Lartë Administrative ("GjLA") për të shqyrtuar aktet e miratuara nga KLD-ja kishte drejtuar kundër të tij "të drejtën në gjykatë"; dhe (vii) nuk ishte respektuar parimi i barazisë së armëve. Ankuesi u ankua gjithashtu se shkarkimi i tij nuk ishte në përputhje me nenin 8 të Konventës dhe se ai nuk kishte pasur një mjet juridik efektiv në këtë drejtim, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës.

Gjykata arriti në përfundimin se dhoma e cila shqyrtoi rastin e kërkuesit nuk u ngrit dhe nuk është e përbërë në mënyrë legjitime për të kënaqur kërkesën e një "gjykatë e caktuar me ligj". Prandaj ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në këtë aspekt.

Në këtë çështje gjykata përpunoi disa orientime të rëndësishme në lidhje me zbatimin e nenit 6 *§* 1 të konventës në fushën civile.

87. Gjykata vëren se mosmarrëveshjet e punës ndërmjet nëpunësve civilë dhe shtetit mund të bien jashtë detyrimit civil të nenit 6 me kusht që të plotësohen dy kushte kumulative. *Së pari*, shteti në legjislacionin e tij kombëtar duhet të ketë përjashtuar shprehimisht aksesin në gjykata për postin ose kategorinë e personelit në fjalë. *Së dyti*, përjashtimi duhet të justifikohet mbi baza objektive në interesin e shtetit (*shih Vilho Eskelinen dhe të tjerët k. Finlandës. [GC], nr. 63235/00, § 62, ECHR 2007 - I I*). 88. Në kuadrin e kushtit të parë, Gjykata nuk pengohet të kualifikojë një organ të caktuar vendas, jashtë gjyqësorit, si "gjykatë" për qëllimin e testit *Vilho Eskelinen* . [...] 91. Duke pasur parasysh sa më sipër, nuk mund të konkludohet se ligji kombëtar kishte "përjashtuar shprehimisht qasje në gjykatë" për aplikuesit

e kërkesës. Prandaj, kushti i parë i testit *Vilho Eskelinen* nuk është përmbushur dhe neni 6 zbatohet nën *titullin e* tij civil (*krahaso Olujiq k. Kroacisë, nr. 22330/05, § § 31* 5 ,45 shkurt 2009).

Për sa u përket parimeve të një "gjykate të pavarur dhe të paanshme" 103. Për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet "e pavarur" sipas kuptimit të nenit 6§1, duhet pasur parasysh, ndër të tjera, mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe mandati i tyre, ekzistenca e masave mbrojtëse kundër presioneve të jashtme dhe pyetja nëse gjykata shfaqet si e pavarur. [...]106. Në këtë aspekt, edhe paraqitjet mund të kenë një rëndësi të caktuar ose, me fjalë të tjera, "drejtësia jo vetëm duhet të vendoset, por edhe të shihet se bëhet". Ajo që është në rrezik është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë publikun (shih, De Cubber k. Belgjikës, 26 tetor 1984, § 26, Seria A nr. 86).

***Avotiņš k. Letonisë* – nr. 17502/07, datë 25/02/2014**

Vendimi *Avotiņš k. Letonisë* u shpall nga Gjykata (Dhoma) në 25 shkurt 2014, duke u përqendruar në të drejtën për një gjykim të paanshëm, Neni 6 i KEDNJ-së, veçanërisht në të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme.

Kërkuesi u ankua kundër vendimeve gjyqësore të gjykatave letoneze, të cilat ekzekutuan vendimet gjyqësore të gjykatave qipriote të konsideruara të paligjshme nga kërkuesi për shkak të mospërputhjes së tyre me Nenin 6 të KEDNJ-së. Kërkuesi, Peteris Avotiņš, është një shtetas letonez, i cili ka lindur në 1954 dhe jeton në qarkun e Rigës (Letoni). Në maj 1999, kërkuesi dhe F.H. shpk, një shoqëri tregtare e regjistruar në Qipro, nënshkruan para noterit një njohje formale të detyrimit të tij për të shlyer një hua. Kërkuesi deklaroi se ai kishte marrë hua 100,000 dollarë amerikanë nga F.H. shpk dhe mori përsipër ta shlyente atë shumë me interes para korrikut 1999. Dokumenti përfshinte deklarimin se do t'i nënshtrohej "në të gjitha drejtimet" legjislacionit të Qipros dhe se gjykatat qipriote do të ishin kompetente për shqyrtuar të gjitha mosmarrëveshjet që do të rridhnin prej tij. Në vitin 2003, F.H. shpk e paditi kërkuesin në gjykatën e Limasolit (Qipro), duke pretenduar se ai nuk e kishte shlyer borxhin e tij dhe kërkoi nxjerrjen e një vendimi kundër tij. Më 24 maj 2004, duke marrë një vendim në mungesë, gjykatat qipriote e urdhëruan kërkuesin ta shlyente borxhin e tij së bashku me interesin, kostot dhe shpenzimet. Sipas vendimit, kërkuesi ishte njoftuar

siç duhej për datën e seancës, por nuk ishte paraqitur. Në shkurt 2005, F.H. shpk paraqiti një kërkesë në gjykatën e rrethit Latgale (Riga) duke kërkuar njohjen dhe zbatimin e gjykimit qipriot të 24 majit 2004. Gjithashtu, shoqëria bëri kërkesë për një masë të ndërmjetme mbrojtjeje. Më 27 shkurt 2006 gjykata letoneze shpalli njohjen dhe zbatimin e vendimit qipriot të 24 majit 2004 dhe regjistrimin e një barre kundër pronës së kërkuesit në regjistrin e tokës. Kërkuesi pretendoi se kishte marrë dijeni, rastësisht, më 16 qershor 2006, për ekzistencën si të vendimit qipriot, ashtu edhe të urdhrit të ekzekutimit të gjykatës letoneze. Ai nuk u përpoq ta kundërshtonte vendimin qipriot para gjykatave qipriote, por apeloi në Gjykatën Rajonale të Rigës urdhrin e ekzekutimit të Letonisë. Me një vendim përfundimtar të 31 janarit 2007, Senati i Gjykatës së Lartë të Letonisë la në fuqi kërkesën e F.H. shpk. Bazuar në këtë vendim, gjykata e Latgale nxori një urdhër ekzekutimi, të cilit, kërkuesi përfundimisht iu bind. Në një gjykim të 25 shkurtit 2014, një nga Dhomat e GJEDNJ-së vendosi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1. Çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit.

Gjykata arriti në përfundimin se Letonia nuk e kishte shkelur Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

Së pari, Gjykata vëren se Neni 6 i KEDNJ-së është i zbatueshëm. Vendimi i gjykatës qipriote që e urdhëronte kërkuesin të paguante një borxh kontraktor kishte të bënte me thelbin e një detyrimi "civil" nga ana e kërkuesit.

Lidhur me pyetjen nëse Neni 6 i KEDNJ-së ishte shkelur apo jo, Gjykata vendosi se prezumimi i mbrojtjes së barabartë brenda Bashkimit Evropian (*prezumimi i Bosforit*) ishte i zbatueshëm në rastin konkret, pasi Senati i Gjykatës së Lartë nuk kishte bërë më shumë sesa zbatimin, nga ana e Letonisë, e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian dhe ky prezumim nuk u hodh poshtë pasi mbrojtja e të drejtave themelore, përkatësisht e Nenit 6 të KEDNJ-së, nga gjykatat letoneze kishte qenë e mjaftueshme.

Zbatimi i prezumimit iu nënshtrua dy kushteve, mungesës së çdo ndryshimi në manovrim nga ana e autoriteteve vendase dhe zbatimit të fuqisë së plotë të mekanizmit mbikëqyrës të parashikuar nga legjislacioni i Bashkimit Evropian. Lidhur me kushtin e parë, dispozita, të cilës i kishte dhënë efekt Senati i Gjykatës së Lartë ishte e përfshirë në një Rregullore (Brukseli I), e zbatueshme drejtpërdrejt në Shtetet Anëtare në tërësinë e saj. Dispozita në fjalë lejoi refuzimin e njohjes ose zbatimit të një gjykimi të huaj vetëm në bazë të kufizimeve të mirëpërcaktuara. Ishte e qartë

nga interpretimi i dhënë nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GjDBE) se kjo dispozitë nuk i linte hapësirë diskrecioni gjykatës, nga e cila kërkohej urdhri i ekzekutimit. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se Senatit të Gjykatës së Lartë të Letonisë nuk i takonte asnjë hapësirë manovrimi në këtë rast. Për sa i përket kushtit të dytë, përkatësisht zbatimit të plotë të mekanizmit mbikëqyrës të parashikuar nga legjislacioni i Bashkimit Evropian, Senati i Gjykatës së Lartë nuk kishte kërkuar një vendim paraprak nga GjDBE-ja në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e nenit përkatës të Rregullores. Gjithashtu, kërkuesi nuk kishte paraqitur ndonjë argument të veçantë në lidhje me interpretimin e dispozitës përkatëse të Rregullores dhe pajtueshmërinë e saj me të drejtat themelore të tilla që të garantonin përcaktimin se duhet të ishte kërkuar një vendim paraprak nga GjDBE-ja, si dhe as nuk kishte paraqitur ndonjë kërkesë për këtë qëllim në Senatin e Gjykatës së Lartë të Letonisë.

Sa i përket kundërshtimit, Gjykata mori në shqyrtim nëse mbrojtja e të drejtave themelore të ofruara nga Gjykata Supreme kishte qenë dukshëm e mangët në lidhje me dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe zbatimit të tij në rastin konkret të kërkuesit. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se nuk paraqiste ndonjë problem që dispozita përkatëse e Rregullores i kërkonte ankuesit që të shteronte të gjitha mjetet juridike në vendin në të cilin procedura ka origjinën, në mënyrë që të mbështeste me sukses bazën e mosnjohjes të vendimit origjinal. Dispozita deklaroi shprehimisht se ishte e nevojshme që procedurat në vendin e origjinës të kishin filluar më herët me kundërshtimin e gjykimit, për aq sa ishte e mundur për ta bërë këtë. Fakti që ankuesi ishte mbështetur në atë dispozitë pa e kundërshtuar gjykimin në Qipro siç kërkohej, dhe shqyrtonte çështjen e ekzistencës së atij mjeti juridik në Qipro nisur nga rrethanat e çështjes në fjalë. Këtu, Gjykata vëren se, në një gjendje të tillë, Gjykata e Lartë nuk duhet të kishte kritikuar thjesht kërkuesin për mos apelimin e vendimit në fjalë, ndërsa të heshtte për çështjen e barrës së provës në lidhje me ekzistencën dhe vënien në përdorim të mjetit juridik në Qipro. Në fakt, Neni 6 § 1 i KEDNJ-së, kërkon që të verifikohet se ky kusht është përmbushur me të vërtetë, në mungesë të të cilit nuk mund të refuzohet shqyrtimi i ankesës së kërkuesit për mosdijeni për shkak të problemeve me të drejtat themelore në Qipro. Sipas Gjykatës, përcaktimi i barrës së provës duhet të ishte shqyrtuar në mënyrë të shprehur dhe përmes një procesi kundërshtues duke rezultuar në gjetje të arsyetuara. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë më mirë të kishte prezumuar në mënyrë të heshtur se barra e provës ishte mbi kërkuesin ose që një mjet juridik i tillë kishte qenë në fakt në dispozicion të tij. Kjo gjë, e cila pasqyroi një zbatim të

drejtpërdrejtë dhe automatik të dispozitës përkatëse të Rregullores, në teori mund të çojë në një konstatim të Gjykatës që mbrojtja e ofruar kishte qenë dukshëm e mangët.

Sidoqoftë, në rrethanat e posaçme të kërkesës konkrete, Gjykata nuk konstatoi të kishte qenë ky rast. Legjislacioni qipriot i kishte dhënë kërkuesit, pasi ai kishte mësuar për ekzistencën e gjykimit, një mundësi krejtësisht reale për të apeluar pavarësisht kohës që kishte kaluar që nga dhënia e vendimit. Në periudhën midis qershorit 2006 (kur atij i ishte dhënë qasja në të gjithë dosjen e çështjes në mjediset e gjykatës së shkallës së parë dhe kishte qenë në gjendje të njihej me përmbajtjen e gjykimit qipriot) dhe janar 2007 (kur ishte zhvilluar seanca e Senatit të Gjykatës së Lartë), kërkuesi kishte pasur kohë të mjaftueshme për të kërkuar një zgjidhje në gjykatat qipriote. Sidoqoftë, për arsye të njohura vetëm prej tij, ai nuk kishte bërë asnjë përpjekje për ta bërë këtë gjë. Fakti që në gjykimin qipriot nuk ishte bërë asnjë referencë tek mjetet juridike në dispozicion nuk ndikoi në gjetjet e Gjykatës. Ishte e vërtetë që Ligji i Procedurës Civile Letoneze kërkonte që gjykatat të tregonin në tekstin e vendimeve të tyre përcaktime të hollësishme dhe afate kohore për ankesat kundër tyre. Gjithsesi, pavarësisht se një kërkesë e tillë ishte e lavdërueshme për aq sa siguronte një garanci shtesë që lehtësonte ushtrimin e të drejtave të palëve ndërgjyqëse, ekzistenca e saj nuk mund të nxirret nga Neni 6 § 1 i Konventës. Prandaj, i takonte vetë kërkuesit, nëse ishte e nevojshme duke marrë këshillat e duhura, të pyeste për mjetet juridike të disponueshme në Qipro pasi kishte marrë dijeni për gjykimin në fjalë. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkuesi, i cili ishte një konsulent investimesh, duhet të ishte në dijeni të pasojave ligjore të njohjes së borxhit të cilin ai e kishte nënshkruar. Dokumenti përmbante një parashikim që u jep juridiksion gjykatave qipriote. Në përputhje me rrethanat, kërkuesi duhej të sigurohej se ishte njohur me mënyrën në të cilën do të zhvilloheshin procedurat e mundshme para gjykatave qipriote. Duke lënë mënjanë marrjen e informacionit mbi çështjen, ai kishte kontribuar në një masë të konsiderueshme, si rezultat i mosveprimit të tij dhe mungesës së zellit, në gjendjen për të cilën ai tani po ankohej para Gjykatës.

Duralivski k. Bullgarisë – nr. 06/45519, datë 2014/03/04

Vendimi *Duralivski k. Bullgarisë*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 4 mars 2014, fokusohet në të drejtën për gjykim të drejtë, Neni 6 § 1 KEDNJ-së.

Kërkuesit apeluan një vendim gjyqësor, i cili ishte kundër kërkuesve që paditën një shoqëri të sigurimit të jetës për pagesa. Kërkuesit janë dy

vëllezër, Atanas Duraliyski dhe Nikolai Duraliyski, shtetas bullgarë, të cilët kanë lindur respektivisht në 1973 dhe 1983 dhe kanë jetuar në Plovdiv, Bullgari, në kohën e gjykimit. Babai i kërkuesve, i cili i kishte bërë ata përfitues sipas policave të tij të sigurimit të jetës dhe aksidenteve, vdiq në 2004 pas një reagimi alergjik ndaj pickimit të grerëzës. Shoqëria e sigurimeve më pas i informoi kërkuesit se pickimi i grerëzës nuk ishte një rrezik i mbuluar nga polica e sigurimit të aksidentit dhe refuzoi të paguante. Më pas, kërkuesit paditën shoqërinë e sigurimeve në Gjykatën e Rrethit të Sofjes. Gjatë një seance gjyqësore, kërkuesit e informuan gjykatën se, pas vdekjes së babait të tyre, ata ia kishin dorëzuar dokumentet origjinale të policës së sigurimit shoqërisë së sigurimit, me kërkesën e saj. Megjithëse ankuesit kishin kërkuar t'i rimerrnin ato dokumente nga shoqëria, kjo e fundit u kishte kthyer atyre vetëm "kushtet shtesë". Gjatë së njëjtës seancë, me kërkesë të ankuesve, gjykata urdhëroi shoqërinë e sigurimeve të prodhojë dosjen e plotë të policës së sigurimit, duke iu referuar Nenit 152 të Kodit të Procedurës Civile 1952, në fuqi në atë kohë. Shoqëria e dorëzoi dosjen gjatë një seance në maj 2005 dhe gjykata e pranoi atë si provë. Me një vendim në korrik 2005, gjykata e pranoi kërkesën e ankuesve. Shoqëria e sigurimeve apeloi kundër vendimit. Në apelin e saj ajo pranoi, ndër të tjera, se ekzistenca e një kontrate të vlefshme nuk ishte e diskutueshme. Më 16 maj 2006, Gjykata e Qytetit të Sofjes lejoi apelimin dhe hodhi poshtë kërkesën e ankuesve në një vendim përfundimtar. Gjykata deklaroi se asnjë kopje e policës së sigurimit nuk ishte dorëzuar nga palët. Më tej ajo deklaroi se në mungesë të një kopje të policës nuk ishte në gjendje të përcaktonte saktë rrethanat e çështjes. Së fundi, ajo vërejti se, ndonëse fakti i rënies dakord mbi kontratën e sigurimit nuk ishte subjekt i mosmarrëveshjes midis palëve, kjo nuk provoi në vetvete ekzistencën e saj.

Gjykata vërejti se Bullgaria kishte shkelur të drejtën për një gjykim të drejtë, të mishëruar në Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

Sa i përket mungesës së pretenduar të procedurave kundërshtuese si pjesë e së drejtës për një gjykim të drejtë, Gjykata vëren se, në rastin konkret, dështimi i Gjykatës së Qytetit të Sofjes si shkallë e fundit për të shqyrtuar një proces kundërshtues një pikë vendimtare për rezultatin e çështjes dhe marrjen parasysh të një prove të rëndësishme në vendimin përfundimtar, shkelën të drejtën e kërkuesve për një gjykim të drejtë.

Gjykata nënvizon jurisprudencën e saj mbi Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së si:

"Koncepti i një seance të paanshme nënkupton të drejtën për proces gjyqësor kundërshtues, në përputhje me të cilën palët duhet të kenë mundësinë jo vetëm të paraqesin prova në mbështetje të pretendimeve

të tyre, por edhe të kenë njohuri dhe të komentojnë për të gjitha provat ose vëzhgimet paraqitur, me qëllim ndikimin në vendimin e gjykatës. […] Për më tepër, Gjykata ka vlerësuar më parë se vetë gjyqtarët duhet të respektojnë parimin e procesit gjyqësor kundërshtues, veçanërisht kur ata refuzojnë një apel ose vendosin mbi një kërkesë në bazë të një çështjeje të ngritur nga gjykata me kërkesën e saj. […] Gjykata vëren në lidhje me këtë se është e rëndësishme për ata që paraqesin pretendimet e tyre në gjykatë të mbështeten në funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë: kjo mbështetje bazohet, ndër të tjera, në sigurinë që një palë në një mosmarrëveshje do të dëgjohet në lidhje me të gjitha pikat në çështje. Me fjalë të tjera, është legjitime që palët në mosmarrëveshje të presin që të konsultohen nëse një dokument i caktuar, apo argument siç mund të jetë rasti, kërkon komentet e tyre […]".

Duke iu kthyer rrethanave të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se nga palët nuk ishte kundërshtuar ekzistenca e policës së sigurimit dhe se shoqëria e sigurimeve, dhe jo kërkuesit, kishin pasur në zotërim policën gjatë procesit gjyqësore. Për më tej, as nuk u diskutua që polica të ishte paraqitur para Gjykatës së Rrethit. Sipas Gjykatës, megjithatë, përkundër faktit se ky dokument ishte pranuar në dosjen e gjykatës në shkallë të parë, Gjykata e Qytetit të Sofjes ka vendosur në aktgjykimin e saj përfundimtar të apeluar se një kopje e vetë policës nuk ishte dorëzuar, kështu "*ishte shpërfillur plotësisht një pjesë e rëndësishme të provave në dispozicion*." Gjykata vëren se nuk ishte argumentuar ose demonstruar në asnjë mënyrë që, para se të arrinte në këtë përfundim, Gjykata e Qytetit të Sofjes kishte ngritur me kërkuesit pyetjen nëse polica e sigurimit ishte ofruar në mënyrë të tillë që t'u jepte atyre mundësinë për të komentuar.

Për sa i përket mungesës së pretenduar të paanësisë së gjykatës dhe mungesës së arsyeve të dhëna prej saj, Gjykata vëren se "*kjo pjesë e kërkesës duhet të refuzohet si e pabazuar në mënyrë të dukshme, në përputhje me Nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konvent*ës.".

„Gjykata i ka shqyrtuar këto ankesa të parashtruara nga kërkuesit. Sidoqoftë, në dritën e të gjithë materialit në zotërim të tij dhe përderisa çështjet për të cilat është ankuar nuk janë përfshirë në shqyrtimin e ankesës së mëparshme, Gjykata vëren se ato nuk nxjerrin në pah ndonjë shkelje të të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose Protokollet e saj."

***Brusco k. Francës* - nr. 1466/07, datë 2010/10/14**

Vendimi i çështjes *Brusco k. Francës*, i shpallur nga gjykata më 14 tetor 2021 fokusohet [ndër të tjera] në parashikimet e konventës nenit 6 § 1 për gjykimin e drejtë në kushtet e akuzës penale dhe të drejtat e mbrojtjes të personit të paraburgosur sipas nenit 6 § 3 të Konventës.

I sulmuar në vitin 1998 nga dy persona me kapuç, një burrë paraqiti një ankesë kundër kërkuesit, i cili më vonë u mor në pyetje edhe nga një prej autorëve të dyshuar. Si pjesë e një letërporosie, kërkuesi u ndalua dhe u arrestua nga policia. Para se të merrej në pyetje nga policia, ai duhej të bënte betimin e përcaktuar për dëshmitarë. Ai pranoi se kishte rekrutuar dy individët për të trembur viktimën, por mohoi të kishte urdhëruar një sulm fizik. Ndaj tij u ngrit aktakuzë dhe iu caktua masa e paraburgimit. Në vitin 2002 ai u dënua me burgim, një vendim që më vonë u la në fuqi në apel. Gjykata e Kasacionit rrëzoi ankesat e tij.

Gjykata arriti në përfundimin se kishte shkelje të nenit 6 të Konventës në lidhje me shkeljen e pretenduar e të drejtës për të mos u vetë-inkriminuar dhe të drejtën e aksesit në gjykatë të pranueshme pasi personit iu mohuan si e drejta për të pasur kontakt me një avokat gjatë orëve të para të paraburgimit, ashtu edhe iu kërkua të betohet para dhënies së dëshmisë.

Sipas vlerësimit të gjykatës: *44 . […] e drejta për të mos inkriminuar vetveten dhe e drejta për të heshtur janë standarde ndërkombëtare të njohura që janë në qendër të konceptit të një gjykimi të drejtë. Ato synojnë veçanërisht të mbrojnë të akuzuarit kundër detyrimit nga autoritetet dhe në këtë mënyrë të shmangin gabimet e drejtësisë si dhe të realizojnë qëllimet e nenit 6 të Konventës (shih, Bykov k. Rusisë [DhM], nr. 4378/02, § 92, 10 mars 2009, dhe John Murray, § 45). E drejta që të mos fajësojë veten dhe respektimi i përcaktimit të të akuzuarit për të heshtur presupozon që prokuroria të provojë akuzën pa nevojën e provave të marra nëpërmjet shtrëngimit ose presionit, si dhe në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit (shih, Saunders k. Mbretërisë së Bashkuar 17 dhjetor 1996, §§ 68-69, Reports 1996-VI, Allan k. Mbretëria e Bashkuar, nr. 48539/99, § 44 , GJEDNJ 2002 - IX ; Jalloh k. Gjermanisë [GC], nr. 54810/00, §§ 94-117, GJEDNJ 2006 - IX, dhe O ' Halloran dhe Francis k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM] nr. 15809/02 dhe 25624/02, §§ 53-63, ECHR 2007 - VIII).*

45. Gjykata gjithashtu vëren se personi që vendoset në paraburgim ka të drejtë "të ndihmohet nga "një avokat nga fillimi dhe gjatë marrjes në pyetje, edhe më tepër kur ai/ajo nuk është informuar nga autoritetet në

lidhje me të drejtën për të heshtur (shih parimet e shfaqura veçanërisht në çështjen Salduz k. Turqisë [GC], nr. 36391/0 2, §§ 50-62, 27 nëntor 2008, Dayanan k.Turqisë , n. 7377/03, § § 30-34, 13 tetor 2009, Boz k. Turkey, Nr. 2039/04, §§ 33-36, 9 shkurt 2010, dhe Adamkiewicz k. Polonisë, nr. 54729/00 §§ 2 ,92-82 mars 2010).

Regner k. Republikës Çeke – nr. 35289/11, datë 19/09/2017

Vendimi për *Regner k. Republikës Çeke*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 19 shtator 2019, fokusohet tek e drejta për proces të rregullt, e parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së, në veçanti tek e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, që përfshin parimet e procedimeve kundërshtuese dhe barazisë së krahëve.

Kërkuesi apeloi kundër vendimeve të gjykatave vendore që mbështesin vendimet e autoritetit për të revokuar certifikatën e tij të sigurisë bazuar në informacione konfidenciale. Kërkuesi, Vaclav Regner, është shtetas çek, i lindur në vitin 1962 dhe jeton në Pragë. Në shtator të vitit 2006, Autoriteti i Sigurisë Kombëtare vendosi t'i tërhiqte certifikatën e sigurisë që i ishte dhënë z. Regner për t'i mundësuar atij kryerjen e detyrave përkatëse si zëvendës i një zëvendësministri të Mbrojtjes, me arsyetimin se përbënte rrezik për sigurinë kombëtare. Vendimi nuk përmendi informacionin konfidencial në të cilin u bazua dhe zbulimi i informacionit konfidencial nuk është kusht ligjor. Rrjedhimisht, z. Regner u largua nga detyra në tetor të vitit 2006 dhe nënshkroi një marrëveshje që mbyllte kontratën e punës me pëlqim të ndërsjellë dhe e cila hynte në fuqi nga 31 janari 2007. Në janar të vitit 2007, Z. Regner kërkoi shqyrtim gjyqësor në Gjykatën Komunale të Pragës për vendimin për tërheqjen e certifikatës së tij të sigurisë. Ai dhe avokati i tij u lejuan të konsultonin dosjen, përveç dokumenteve konfidenciale që ishin dërguar në gjykatë. Në shtator të vitit 2009, gjykata hodhi poshtë kërkesën e Z. Regner për rishikim gjyqësor, duke konstatuar se Autoriteti, i cili nuk i zbulonte kërkuesit informacionin mbi bazën e të cilit ishte tërhequr certifikata e sigurisë, nuk ishte i paligjshëm, pasi zbulimi i një informacioni të tillë ishte i ndaluar me ligj. Në korrik të vitit 2010, Gjykata e Lartë Administrative hodhi poshtë kërkesën për pikat ligjore të paraqitura nga Z. Regner, duke konstatuar se zbulimi i informacionit të klasifikuar mund të kishte sjellë zbulimin e metodave të punës së shërbimit inteligjent, zbulimin e burimeve të tij të informacionit ose rrezikun e ndikimit te dëshmitarët e mundshëm. Kërkuesi e paraqiti pa sukses ankesën në Gjykatën Kushtetuese, duke u ankuar për procedime të padrejta. Në mars të vitit 2011, prokuroria e

akuzoi kërkuesin dhe 51 persona të tjerë për ndikim në dhënien e kontratave publike në Ministrinë e Mbrojtjes nga viti 2005 deri në 2007. Në mars 2014, Gjykata Rajonale České Budějovice e dënoi z. Regner me tre vjet burg. Kërkesa në GJEDNJ u depozitua në maj të vitit 2011. Në vendimin e saj gjyqësor të Dhomës, më 26 nëntor 2015, Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Në shkurt të vitit 2016, kërkuesi kërkoi referim në Dhomën e Madhe, në bazë të Nenit 43 i KEDNJ-së.

Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Kufizimet e parimeve kundërshtuese dhe barazia e krahëve, siç zbatohen në procedurat civile, ishin balancuar mjaftueshëm me masa të tjera procedurale.

Gjykata sqaron me konsiderata të dukshme se Neni 6 § 1 i KEDNJ-së është i zbatueshëm në çështje si rasti konkret. Vendimet e autoriteteve dhe procedimet e mëvonshme kishin prekur "të drejtat civile" të tij, pasi heqja e certifikatës së sigurisë kishte ndikim vendimtar për situatën e tij personale, konkretisht kishte qenë vendimtare për zgjedhjen e posteve të disponueshme për kërkuesin si nëpunës civil (*shih, testin e Vilho Eskelinen nga KEDNJ*).

Për sa u përket përshkrimeve të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së në lidhje me parimet e procedimeve kontradiktore dhe të barazisë së palëve, Gjykata rithekson jurisprudencën e mëparshme, ku thekson veçanërisht nevojën për kundërbalancim me garancitë procedurale nëse ato janë të kufizuara:

"Parimi i kontradiktorialitetit dhe parimi i barazisë së palëve, që janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin, janë përbërës themelorë të konceptit të një "seance të drejtë dëgjimore" brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Ato kërkojnë "ekuilibër të drejtë" mes palëve: secilës palë duhet t'i jepet mundësia e arsyeshme e paraqitjes së çështjes së tyre në kushte që nuk e vendosin palën në disavantazh thelbësor kundrejt kundërshtarit ose kundërshtarëve të tij [...] Megjithatë, të drejtat që rrjedhin nga këto parime nuk janë absolute. [...] Shtetet kontraktuese gëzojnë marzh të caktuar vlerësimi në këtë aspekt [...]

[...] as e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është e drejtë absolute. Në çështjet penale është konstatuar se mund të ketë interesa konkurruese, të tilla si siguria kombëtare ose nevoja e mbrojtjes së dëshmitarëve në rrezik hakmarrjeje ose e mbajtjes sekret e metodave policore për hetimin e krimit, të cilat duhet të peshohen kundrejt të drejtave të palës në procedim. Megjithatë, vetëm masat që kufizojnë të drejtat

e një pale në procedim, të cilat nuk prekin thelbin e këtyre të drejtave, janë të lejueshme sipas Nenit 6 § 1. Për këtë, çdo vështirësi që i shkaktohet palës paditëse nga kufizimi i saj ose i të drejtave të saj duhet të balancohen mjaftueshëm nga procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore […]

Në rastet kur dëshmitë fshihen nga pala kërkuese për arsye të interesit publik, Gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, të përmbushen kriteret e garantimit të procedurave kundërshtuese dhe barazia e palëve dhe të përfshijë masat e duhura mbrojtëse për mbrojtjen e interesave të personit në fjalë.".

Me zbatimin e këtyre parimeve në rastin aktual, Gjykata konstaton se janë siguruar masa të mjaftueshme procedurale nga ligji përkatës vendas, si dhe në rastin aktual, ato janë respektuar nga gjykatat vendase. Ndër të tjera, gjykatat kanë pasur pavarësinë dhe paanësinë e nevojshme, kanë pasur akses të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara, kanë qenë në gjendje të vlerësojnë arsyet që justifikonin moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara dhe urdhërimin e zbulimit të atyre që nuk garantonin klasifikimin, kanë qenë në gjendje të vlerësojnë bazueshmërinë e vendimit për tërheqjen e certifikatës së sigurisë së kërkuesit dhe të anulonin, sipas nevojës, një vendim arbitrar. Juridiksioni i gjykatës vendase kishte përfshirë të gjitha faktet e çështjes, nuk ishte kufizuar në bazat e mbështetura nga kërkuesi dhe këtij të fundit i ishte dhënë mundësia për kërkesa me shkrim. Megjithatë, sipas Gjykatës, do të kishte qenë më e përshtatshme të informohej kërkuesi të paktën me përmbledhje të rregullta mbi gjendjen e procedimit gjyqësor. Po ashtu, është respektuar procesi i rregullt, pasi gjykatat kishin ushtruar siç duhet kompetencat e kontrollit në dispozicion të tyre për këtë lloj procedimi, si në lidhje me nevojën për të ruajtur konfidencialitetin e dokumenteve të klasifikuara, ashtu edhe në lidhje me arsyetimin për vendimin për tërheqjen e certifikatës së sigurisë, dhënien e arsyeve për vendimet e tyre në lidhje me rrethanat specifike të rastit në fjalë.

***Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë* - nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, datë 6/1/2018**

Vendimi i çështjes *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, i shpallur nga gjykata (Dhoma e Madhe) më 6 nëntor 2018 fokusohet në kontrollin gjyqësor ndaj mosmarrëveshjeve të shqyrtuara nga organi administrativ në përputhje me kërkesat e nenit 6 *§* 1 të Konventës.

Tri grupe procedimesh disiplinore u ngritën kundër kërkueses, e cila ishte gjyqtare në atë kohë. Këshilli i Lartë i Gjyqësorit e urdhëroi atë të paguante një gjobë dhe vendosi dy dënime me pezullim nga detyra. Ankesat e paraqitura nga kërkuesi për një rishikim të vërtetimit të fakteve ishin të pasuksesshme. Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë la në fuqi vendimet e Këshillit, duke konstatuar, në veçanti, se detyra e tij nuk ishte të shqyrtonte faktet, por vetëm të shqyrtonte nëse vërtetimi i fakteve kishte qenë i arsyeshëm. Gjykata e Lartë grupoi së bashku gjobat e vendosura ndaj kërkuesit dhe urdhëroi një dënim të vetëm prej 240 ditësh pezullim. Në procedimet përpara Gjykatës Evropiane, kërkuesja pretendoi shkelje të së drejtës së saj për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, të drejtën e saj për një rishikim të fakteve dhe të drejtën e saj për një seancë dëgjimore publike.

134. Dhoma e Madhe thekson se Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës vetëm për shkak të efektit kumulativ të mangësive të ndryshme që konsistojnë në mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë së Këshillit, shtrirjes së pamjaftueshme të shqyrtimit të kryer nga Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë, dhe mungesa e seancës dëgjimore publike (shih paragrafin 113 më lart).

132. […] Gjykata rithekson praktikën e saj gjyqësore të vendosur sipas së cilës, edhe kur një organ administrativ që vendos mosmarrëveshjet mbi "të drejtat dhe detyrimet civile" nuk është në njëfarë mënyre në përputhje me nenin 6 § 1, nuk mund të gjendet asnjë shkelje e Konventës nëse procedurat përpara atij organi i nënshtrohen kontrollit të mëvonshëm nga një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë dhe siguron garancitë e nenit 6 § 1" (shih Albert dhe Le Compte, § 29, dhe Tsfayo k. Mbretërisë së Bashkuar, nr.60860/00,§42,14nëntor2006),domethënë, nëse ka mangësi strukturore apo procedurale të identifikuara në procedurat para një autoriteti administrativ evitohen në rrjedhën e kontrollit të mëvonshëm nga një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë (shih Bistrović k Kroacisë, nr. 25774/05, §§ 51 - 53, 31 maj 2007 në lidhje me defekte strukturore; shih gjithashtu Schuler- Zgraggen k. Zvicrës, 24 qershor 1993, § 52, Seria A nr. 263 dhe. Letinčić k Kroacisë, nr. 7183/11, §§ 46 dhe 55-67, 3 maj 2016, në lidhje me defektet procedurale).

***Gulamhussein dhe Tariq k. Mbretërisë së Bashkuar* – nr. 46538/11 dhe 3960/12, datë 03/04/2018**

Vendimet *Gulamhussein dhe Tariq k. Mbretërisë së Bashkuar*, të dhëna nga Gjykata (Dhoma) në 3 prill 2018, fokusohen në të drejtën për një gjykim

të drejtë, Neni 6 i KEDNJ-së, veçanërisht në të drejtën për një gjykim të paanshëm, që përfshin parimet e procesit gjyqësor kundërshtues dhe barazinë e armëve.

Kërkuesit apeluan vendimet e gjykatave vendase dhe vendimet e një autoriteti tjetër që mbështeste vendimet e administratës shtetërore për të anuluar certifikatën e sigurisë bazuar në informacion konfidencial. Kërkuesi për kërkesën nr. 46538/11 ishte Bilal Gulamhussein, një shtetas me shtetësi të dyfishtë britanike dhe jemenase, i lindur në vitin 1967. Kërkuesi në kërkesën nr. 3960/12 ishte Kashif Tariq, një shtetas britanik, i cili kishte lindur në 1979. Të dy kërkuesit jetonin në Londër në kohën e gjykimit të GJEDNJ-së dhe punonin për shërbimin e emigracionit të Home Office (Ministrisë së Brendshme). Certifikatat e tyre të sigurisë u shfuqizuan respektivisht në maj 2005 dhe dhjetor 2006. Z. Gulamhussein u njoftua se ai ishte identifikuar si një bashkëpunëtor i ngushtë i një rrjeti ekstremistësh të dyshuar si islamikë që mbështetën kryengritjen që po ndodhte në atë kohë në Irak. Pastërtia e figurës së zotit Tariq u anulua pasi anëtarë të familjes së tij dyshoheshin për komplotimin e një sulmi terrorist, duke e vënë atë në rrezik të nënshtrimit të ndikimit të panevojshëm. Z. Gulamhussein dhe z. Tariq u ankuan kundër anulimit të lejeve të tyre në Kolegjin e Apelimit të Pastërtisë të Sigurisë. Të dy rastet u hodhën poshtë përkatësisht në janar 2011 dhe nëntor 2010. Z. Tariq më pas çeli një çështje pranë Tribunalit të Punësimit në mars 2007, duke pretenduar diskriminim në bazë të racës dhe fesë, përfshirë këtu mbështetjen e Ministrisë së Brendshme në hamendësime stereotipe për të, myslimanët dhe individët me origjinë pakistaneze si të ndjeshëm ndaj ndikimit të panevojshëm. Procesi para trupit gjykues dhe gjykatës u bazuan në material të hapur dhe të mbyllur. Gjatë procesit, z. Tariq u ankua në Tribunalin e Apelit të Punësimit me arsyetimin se një material i caktuar nuk duhej të ishte zbuluar. Pas një përjashtimi të pjesshëm, procesi i mëtejshëm në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë rezultuan në vënien në dispozicion të provave më të hapura. Çështja pranë Tribunalit të Punësimit u hodh poshtë përfundimisht në korrik 2014. Përgjatë të gjitha proceseve, të dy kërkuesit u përfaqësuan nga avokatë të posaçëm gjatë pjesës së seancave të mbyllura, në të cilat ata vetë nuk u lejuan të merrnin pjesë.

Gjykata i shpall të dyja kërkesat të papranueshme. Lidhur me kërkesën e z. Gulamhussein, Gjykata arsyeton se Neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohet pasi asnjë e drejtë civile në kuptimin e saj nuk ishte shkelur. Ankimi i z. Tarik u gjykua të ishte qartazi i pabazuar. Ishte e qartë se seancat e mbyllura të procesit si kufizime për parimin e procesit gjyqësor kundërshtues dhe

atë të barazisë së armëve ishin mjaftueshëm të baraspeshuar me garanci të tjera procedurale. Pjesëmarrja e avokatëve të posaçëm ishte një mbrojtje e mjaftueshme, e cila funksiononte mirë në përgjithësi, sikundër edhe në rastin konkret.

Gjykata përsërit rekomandimet e Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së në lidhje me parimet e procesit gjyqësor kundërshtues dhe barazinë e armëve në rastet që përfshijnë prova konfidenciale, gjykime të mbyllura dhe qasje të kufizuar në bazë të sigurisë kombëtare. Ajo e bën këtë duke iu referuar praktikës së mëparshme gjyqësore, veçanërisht *Regner k. Republikës Çeke (shih, përmbledhjen e Regner k. Republikës Çeke),* posaçërisht duke nënvizuar nevojën për kundërpeshë me garancitë procedurale nëse ato janë të kufizuara. Sa u përket përfaqësuesve të veçantë të përfshirë në rastet e tanishme, Gjykata përcakton veçoritë si më poshtë:

> *"Në I.R. dhe G.T. k. Mbretërisë së Bashkuar ([dhjetor] nr. 14876/12 dhe 63339/12, 28 janar 2014) Gjykata shprehej e kënaqur që përfshirja e avokatëve të posaçëm në gjykimet me dyer të mbyllura para Komisionit të Posaçëm të Apelit të Emigracionit (SIAC) siguronte garanci të mjaftueshme sipas Neni 8 më vete dhe i marrë së bashku me Nenin 13 të Konventës (§ 65). Në vendimin e saj, Gjykata kishte parasysh pavarësinë e SIAC; fakti që SIAC i sheh të gjitha provat mbi të cilat bazohet vendimi i Sekretarit të Shtetit; dhe është kompetent për të refuzuar vendimin e Sekretarit të Shtetit. Ajo nënvizoi se përdorimi i avokatëve të posaçëm siguron gjithashtu një formë të procesit gjyqësor kundërshtues - të kufizuar në mënyrë të përshtatshme - për përdorimin e informacionit të klasifikuar."*

Sa u përket rasteve të tanishme, Gjykata vëren se çështja e z. Gulamhussein (Kërkesa nr. 46538/11) është qartazi e pabazuar. Procesi para Panelit të Apelimit të Pastërtisë të Sigurisë (SVAP) nuk i njeh kërkuesit të drejta civile siç përcaktohet në Nenin 6 të KEDNJ-së. Ky ishte rasti sepse "*SVAP nuk ishte në gjendje të merrte një vendim që do të ishte "drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën e [kërkuesit] në fjalë*", pasi vendimet e tij nuk ishin ligjërisht detyruese, por thjesht rekomandime për kreun përkatës të organit administrativ, që do të merrte vendimin përfundimtar, detyrues.

Sa i përket rastit të z. Tariq, Gjykata e gjen atë haptazi të pabazuar. Ajo e hedh poshtë pretendimin e kërkuesit se ai nuk ishte në gjendje të kundërshtonte vendimin për anulimin e certifikatës së tij të sigurisë, sepse provat kundër tij ishin të klasifikuara dhe përdorimi i avokatëve të posaçëm

nuk mund të kundërshtonte këtë padrejtësi, pasi avokatët e posaçëm morën udhëzime nga qeveria, përdoret në rrethana të "domosdoshmërisë së padiskutueshme" dhe çështja e tij nuk ishte një rast i tillë. Gjykata vëren se sistemi i Avokatëve të Posaçëm në procese sekrete mund të ketë të meta, siç ka ndodhur me praktikën e mëparshme gjyqësore, megjithatë këto raste nuk ishin të krahasueshme me atë të tanishmet. Në përgjithësi, sistemi funksionoi dhe kërkuesi nuk kishte paraqitur ndonjë argument tjetër që ta sfidonte atë. Mangësitë e përgjithshme të proceseve gjyqësore sekrete u kundërpeshuan mjaftueshëm me kërkesat e përcaktuara në rastin Regner. *"Së pari, kërkuesi ishte në gjendje të dinte thelbin e vendimit për anulimin e lejes së tij të sigurisë, edhe pse ai bazohej në informacion të klasifikuar (shih paragrafët 21 dhe 25). Në të vërtetë, Gjykata e Lartë pohoi se ishte në gjendje të trajtonte çështjen kundër tij sipas parashikimeve të përgjithshme (shih paragrafin 38, më lart). Më tej dhe përsëri ndryshe nga kërkuesi në Regner, arsyetimet u paraqitën në emër të kërkuesit mbi provat të klasifikuara prej avokatit të posaçëm që vepronte në seancat e mbyllura.". "Së dyti, Tribunali i Punësimit kishte qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara që justifikonin vendimet e tyre [...]." "Së treti, në lidhje me pyetjen nëse Tribunali i Punësimit i ka ushtruar në mënyrë të duhur kompetencat në dispozicion e vet, Gjykata vëren se Tribunali i Punësimit zhvilloi një sërë seancash dëgjimore duke lejuar parashtrime nga palët mbi përshtatshmërinë e përdorimit të seancave me dyer të mbyllura dhe masën sipas të cilës provat të mund të paraqiteshin vetëm në seancat e mbyllura, të cilat i shqyrtoi me hollësi [...]". "Së katërti, nëse përdorimi i seancave të mbyllura nga Tribunali i Punësimit nuk ishte në asnjë mënyrë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, Gjykata vëren se Tribunali i Punësimit veproi me seanca me dyer të mbyllura mbi arsyetimin se ishte "e përshtatshme në interes të sigurisë kombëtare" (shih, paragrafin 28 më lart). Në lidhje me këtë, ajo vëren se Tribunali i Punësimit shqyrtoi me hollësi arsyen e paraqitur për anulimin e certifikatës së sigurisë dhe hapat e ndërmarrë nga Ministria e Brendshme para dhe pas anulimit të lejes së sigurisë dhe analizoi vendimet e zyrtarëve në fjalë."*

***Ali Riza dhe të tjerët k. Turqisë* - nr. 30226/10, 17880/11, 17887/11, 17891/11 dhe 5506/16, datë 28/1/2020**

Vendimi i çështjes *Ali Rıza dhe të tjerët k. Turqisë,* i shpallur nga gjykata më 28 janar 2020 fokusohet në konceptin e gjykatës së pavarur dhe të paanshme në përputhje me kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës.

Të pesë aplikantët u ankuan se procedurat para komiteteve ligjore të Federatës Turke të Futbollit (*Türkiye Futbol Federasyonu* – "TFF") nuk kishin përmbushur kërkesat e pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Përveç kërkuesit të parë, ata u ankuan më tej sipas të njëjtit nen se procedurat nuk ishin të drejta, duke iu referuar mangësive të ndryshme procedurale. Kërkuesit e dytë, të tretë dhe të katërt u ankuan gjithashtu se procedimet kishin shkelur të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të pronës sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, i marrë vetëm dhe në lidhje me nenin 13 të Konventës.

Gjykata arriti në përfundimin se neni 6 nuk është i zbatueshëm për procedurat e kundërshtuara as nën drejtimin e tij penal apo civil. Por ajo u shpreh për disa parime dhe kritere të rëndësishme që përcaktojnë aplikueshmërinë e nenit 6 të Konventës.

> *150. Gjykata rithekson se koncepti i "të drejtave dhe detyrimeve civile" është një koncept autonom që rrjedh nga Konventa e cila nuk mund të interpretohet vetëm duke u referuar në të drejtën e brendshme. Neni 6 § 1 i Konventës zbatohet pavarësisht nga palët, karakteri i legjislacionit që rregullon se si "mosmarrëveshje" është që të përcaktohet dhe karakteri i autoritetit që ka juridiksion në këtë çështje (shih, Nait-Liman v Zvicër [GC], nr.51357/07 , § 15 ,106 mars 2018).*
>
> *153. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse neni 6, sipas detyrimit të saj penal, është i zbatueshëm në ato procese. Sipas gjykatës në jurisprudencë, tri kritere, të njohura zakonisht si "kriteret Engel", duhet të merren parasysh në përcaktimin nëse ka pasur apo jo një "akuzë penale" në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës (shih, Engel dhe të tjerët kundër Holandës, 8 qershor 1976, § 82, Seria A nr. 22). Kriteri i parë është klasifikimi ligjor i veprës sipas ligjit kombëtar, i dyti është vetë natyra e veprës penale dhe i treti është shkalla e ashpërsisë së dënimit që rrezikon të pësojë personi në fjalë. Kriteri i dytë dhe i tretë janë alternativë dhe jo domosdoshmërisht kumulative. Megjithatë, kjo nuk përjashton një qasje kumulative ku analiza e veçantë e secilit kriter nuk bën të mundur arritjen e një përfundimi të qartë për ekzistencën e një akuze penale (shih, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë [GC], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, § 6 ,122 Nëntor 2018 për referenca të mëtejshme).*

Në lidhje me çështjen, a është Komiteti i Arbitrazhit "i pavarur" dhe "i paanshëm", GJEDNJ hartoi disa vlerësime të përgjithshme si më poshtë:

194. Gjykata rithekson se sipas nenit 6 § 1 një "tribunal" duhet gjithmonë të "krijohet me ligj". Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës, i cili është i natyrshëm në sistemin e mbrojtjes të vendosur nga Konventa dhe Protokollet e saj. Një organi i cili nuk është krijuar në përputhje me vullnetin e legjislativit do t'i mungonte domosdoshmërisht legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar çështjet e individëve. Shprehja "e krijuar me ligj" mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e një "tribunali", por edhe përbërjen e trupit gjykues në secilin rast (shih, Lavents kundër Letonisë, nr. 00/58442, § 114, 28 nëntor 2002). Prandaj, "ligji" i përmendur në këtë dispozitë nuk është vetëm legjislacioni për krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore, por edhe çdo dispozitë tjetër e ligjit të brendshëm, shkelja e së cilës do të shkaktonte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimi e që rasti të jetë i paligjshëm.

195. Gjykata rithekson më tej se një autoritet i cili nuk klasifikohet si një nga gjykatat e shtetit, për qëllimet e nenit 6 § 1, mund të bjerë në konceptin e një "gjykate" në kuptimin përmbajtësor të kësaj shprehjeje (shih, Sramek kundër Austrisë, cituar më lart, § 36). Një gjykatë ose tribunal karakterizohet në atë kuptim thelbësor nga funksioni i vet gjyqësor, domethënë përcaktimi i çështjeve brenda kompetencës së saj në bazë të rregullave ligjore, me juridiksion të plotë dhe pas procedurave të kryera në një mënyrë të përcaktuar (shih, po aty, dhe Qipro kundër Turqisë [GC], nr. 25781/94, § 233, ECHR 2001- IV). Fuqia e vendimit është e natyrshme në vetë nocionin e "tribunalit". Procedura përpara saj duhet të sigurojë "përcaktimin e çështjeve në mosmarrëveshje" siç kërkohet nga neni 6 § 1 (shih, Benthem kundër Holandës, 23 tetor 1985, § 40, Seria A nr. 97). Për qëllimet e nenit 6 § 1, një gjykatë nuk duhet të jetë një gjykatë ligjore e integruar brenda makinerisë standarde gjyqësore. Ajo mund të krijohet për të trajtuar çështje specifike që mund të administrohen në mënyrë të përshtatshme jashtë sistemit të zakonshëm të gjykatës (shih, Rolf Gustafson kundër Suedisë, 1 korrik 1997, § 45, Raportet 1997 - IV). Përveç kësaj, vetëm një institucion që ka juridiksion të plotë dhe plotëson një sërë kërkesash, të tilla si pavarësia nga ekzekutivi dhe gjithashtu nga palët, meriton emërtimin "tribunal" sipas kuptimit të nenit 6 § 1 (shih, Beaumartin kundër Francës, 24 nëntor 1994, § 38, Seria A nr. 296 B, dhe Di Giovanni kundër Italisë, nr. 06/51160, § 52, 9 korrik 2013).

196. Për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet e "pavarur" sipas kuptimit të nenit 6 § 1, duhet pasur parasysh, ndër të tjera, mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe mandati i tyre,

ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe pyetja nëse organi paraqet një pamje të pavarësisë (shih, Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 shkurt 1997, § 73, Raportet 1997-I, dhe Brudnicka dhe të tjerët kundër Polonisë, nr. 54723/00, § 38, GJEDNJ 2005-II).

197. Paanshmëria zakonisht nënkupton mungesën e paragjykimeve. Sipas gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6 § 1, duhet të përcaktohet në bazë të një testi subjektiv, që lidhet me bindjen personale dhe sjelljen e një gjyqtari të caktuar, pra, nëse gjyqtari kishte ndonjë paramendim apo paragjykim personal në një çështje të caktuar; dhe gjithashtu sipas një testi objektiv, domethënë duke konstatuar nëse vetë gjykata dhe, ndër të tjera, përbërja e saj, ofronin garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanshmërinë e saj (shih, ndër autoritetet e tjera, Fey k. Austrisë, 24 shkurt 1993, §§ 27, 28 dhe 30, Seria A nr.255-A, dhe Wettstein k. Zvicrës, nr. 33958/96 , § 42, GJEDNJ 2000 - XII).

198. Megjithatë, nuk ka ndarje të ngushtë midis dy nocioneve pasi sjellja e një gjyqtari jo vetëm që mund të shkaktojë dyshime objektive për paanshmërinë nga këndvështrimi i vëzhguesit të jashtëm (testi objektiv), por mund të shkojë edhe në çështjen e tij ose bindjen e saj personale (testi subjektiv) (shih Kyprianou k. Qipros [GC], nr. 73797/01, § 119, GJEDNJ 2005-XIII).

Thënë ndryshe, "drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por edhe të shihet se po bëhet". Ajo që është në rrezik është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në publik (shih, Morice kundër Francës [GC], nr. 29369/10, § 78, GJEDNJ 2015, dhe Oleksandr Volkov kundër Ukrainës, nr. 21722/11, § 106, GJEDNJ 2013).

200. Së fundi, konceptet e pavarësisë dhe paanshmërisë objektive janë të lidhura ngushtë dhe, në varësi të rrethanave, mund të kërkojnë shqyrtim të përbashkët (shih, Sacilor-Lormines kundër Francës, nr. 65411/01, § 62, ECHR 2006-XIII).

222. Në dritën e sa më sipër, duke pasur parasysh gjetjet sa u përket mangësive strukturore të Komitetit të Arbitrazhit për shkak të fuqive të mëdha dhënë Bordit të Drejtorëve mbi organizimin dhe funksionimin e tij, Gjykata konsideron se parashtruesit kishin një arsye legjitime për të dyshuar se anëtarët e Komitetit të Arbitrazhit, në mungesë të garancive adekuate për t'i mbrojtur ata nga presionet e jashtme, veçanërisht nga Bordi i Drejtorëve, do t'i qasen çështjes së tyre me pavarësinë dhe paanshmërinë e nevojshme.

223. Nga kjo rezulton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Peleki k. Greqisë - nr. 69291/12, datë 5/3/2020

Vendimi i çështjes *Peleki k. Greqisë*, i shpallur nga gjykata më 5 mars 2020 fokusohet në kontrollin gjyqësor ndaj mosmarrëveshjeve të shqyrtuara nga organi administrativ në përputhje me kërkesat e nenit 6 *§* 1 të Konventës.

Pas një hetimi disiplinor, më 23 tetor 2008, zëvendësprokurori në Gjykatën e Shkallës së Parë të Athinës filloi një procedim disiplinor kundër kërkueses përpara Bordit Disiplinor të Shkallës së Parë të Noterëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Athinës, për shkelje të neneve 42 § 1, 43 § 1b-d. Kërkuesja akuzohej se: (a) kishte hartuar kontratat kur ajo e dinte se zona e diskutueshme ishte klasifikuar si një zonë arkeologjike dhe se ishte pjesë e një zone të mbrojtur që nga vendimi i ministrit të vitit 1965; me ligjin nr. 3028/2002 "Për mbrojtjen e monumenteve historike dhe të trashëgimisë kulturore në përgjithësi" (neni 59 i ligjit të lartpërmendur); dhe (b) të ketë krijuar, me bashkëshortin e saj, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Gjykata e Kasacionit prishi vendimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me krijimin nga kërkuesja të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, sepse vendimi në fjalë nuk specifikonte se në çfarë mënyre ky krijim do të ishte i papajtueshëm me cilësinë e saj si notere. Megjithatë, ajo hodhi poshtë ankesën e ankuesit në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara prej saj.

Duke u mbështetur në nenin 6 të Konventës, kërkuesja konsideron se disa nga kërkesat e kësaj dispozite janë shpërfillur në kontekstin e procedimeve disiplinore dhe gjyqësore në lidhje me dënimet e vendosura ndaj saj. Neni 6 § 1 parashikon në pjesët përkatëse në rastin konkret se: "Çdokush ka të drejtë që kauza e tij të dëgjohet në mënyrë të drejtë (...) nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë (...) për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre civile (.. .)".

59. Në çështjen në fjalë [...] Gjykata e Apelit kishte juridiksion për të shqyrtuar çështjen pa u detyruar nga vendimi për referim në shkallë të parë, i cili në fakt konfirmohet edhe nga neni 57 i kodit të noterëve. Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Apelit dëgjoi dëshmitarët dhe shtyu seancën për të marrë prova dhe se kërkuesja kishte mundësinë të paraqiste argumentet që ajo i konsideronte të rëndësishme për mbrojtjen e çështjes së saj, të cilat u shqyrtuan pikë për pikë nga Gjykata e Apelit [...] Gjykata vëren se kërkuesja nuk ngre asnjë ankesë në lidhje me procedurat që u zhvilluan përpara Gjykatës së Apelit. Prandaj, nuk kontestohet, në rrethanat e veçanta të çështjes dhe duke pasur parasysh ankesat e ngritura në mënyrë të vlefshme përpara Gjykatës, se Gjykata e Apelit është një organ gjyqësor me juridiksion të plotë në kuptimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës, duke respektuar garancitë e nenit 6 të Konventës.

60. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se është kryer një shqyrtim gjyqësor i fushës së mjaftueshme nga Gjykata e Apelit dhe se kjo e fundit ka korrigjuar mangësitë e pretenduara të procedurës para Bordit Disiplinor.

Neni 8

Lupsa k. Rumanisë - nr.10337/04, datë 08/06/2006

Vendimi për çështjen *Lupsa k. Rumanisë*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 8 qershor 2006, fokusohet tek e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare, neni 8 i KEDNJ-së, si dhe te masat mbrojtëse procedurale për dëbimin e të huajve, të parashikuara nga Neni 1. Protokolli nr. 7 i Konventës.

Kërkuesi apeloi kundër urdhrit të dëbimit. Kërkuesi është një shtetas i Serbisë që jeton në Beograd. Ai jetoi në Rumani për 14 vjet deri në momentin që u dëbua në gusht të vitit 2003. Në vitin 1989, ai mbërriti në Rumani dhe u vendos aty e ku më pas në vitin 1993 themeloi një shoqëri tregtare rumune, aktiviteti i së cilës ishte shitja e kafesë. Ai bashkëjetoi me një shtetase rumune që nga viti 1994 dhe kishin një djalë tre vjeç në kohën e gjykimit të GJEDNJ-së, i cili ishte tashmë shtetas i Rumanisë dhe i Serbisë. Më 6 gusht të vitit 2003, kërkuesi, i cili kishte qenë jashtë vendit, u fut në Rumani pa u penguar nga policia kufitare. Por, ditën e nesërme oficerët e policisë kufitare i shkuan në shtëpi dhe e dëbuan. Avokati i kërkuesit apeloi kundër masës së dëbimit. Në një seancë dëgjimore para Gjykatës së Apelit të Bukureshtit më 18 gusht të vitit 2003, avokatit të kërkuesit i ishte dhënë një kopje e urdhrit të datë 28 maj 2003, i cili ishte lëshuar nga prokuroria, ku, me kërkesë të Shërbimit të Inteligjencës Rumune dhe në përputhje me Urdhrin Emergjent nr. 194/2002 për rregullat që rregullojnë të huajt në Rumani, kërkuesi ishte shpallur "person i padëshirueshëm" dhe ndalohej nga Rumania për dhjetë vjet me arsyetimin se kishte "inteligjencë të mjaftueshme dhe serioze që ai ishte i përfshirë në aktivitete që mund të rrezikonin sigurinë kombëtare". Gjykata e Apelit refuzoi bërjen e kërkesës për shtyrje të çështjes nga avokati i kërkuesit dhe hodhi poshtë apelimin e tij.

Gjykata konstatoi se Rumania kishte shkelur të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës private dhe familjare, Neni 8 i KEDNJ-së,, si dhe masat procedurale për dëbimin të Nenit 1, Protokolli nr. 7.

Sa i përket shkeljes së nenit 8 të KEDNJ -së, Gjykata rithekson specifikimet e nenit 8 të KEDNJ-së dhe konstaton se, pasi Kërkuesi nuk

kishte gëzuar para autoriteteve administrative ose para Gjykatës së Apelit shkallën minimale të mbrojtjes kundër arbitraritetit nga ana e autoriteteve, ndërhyrja në jetën e tij private nuk ishte në përputhje me "ligjin" që përmbushte kriteret e Konventës.

Gjykata thekson se ka pasur ndërhyrje në jetën private dhe në atë familjare të kërkuesit. Meqenëse Kërkuesi ishte integruar në mënyrë të padiskutueshme në shoqërinë rumune dhe kishte jetë të mirëfilltë familjare, Gjykata gjykoi se dëbimi dhe përjashtimi i tij nga territori rumun kishte prishur rrënjësisht jetën e tij private dhe familjare aq sa nuk mund të rikuperohej nga vizitat e rregullta të së dashurës dhe fëmijës në vendin e tij tashmë aktual të qëndrimit.

Sa i përket arsyetimit të kësaj ndërhyrjeje, Gjykata theksoi praktikën e saj gjyqësore:

"'Në përputhje me ligjin" kërkon [...] masa e kundërshtuar duhet të bazohet në ligjin e brendshëm, por edhe t'i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai të jetë i aksesueshëm nga personat në fjalë dhe i formuluar me saktësi të mjaftueshme që t'u mundësojë atyre - nëse lind nevoja, këshilla të përshtatshme - për të parashikuar në përputhje me rrethanat, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar.

33. Duhet pranuar se kur bëhet fjalë për kontekstin e veçantë të masave që ndikojnë në sigurinë kombëtare, kriteri i parashikueshmërisë nuk mund të jetë i njëjtë si në shumë fusha të tjera [...] Megjithatë, ligji i brendshëm duhet të sigurojë masat mbrojtëse ligjore kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike tek të drejtat e garantuara nga Konventa. Për çështjet që prekin të drejtat themelore, do të ishte në kundërshtim me shtetin e së drejtës [...] që diskrecioni ligjor i dhënë ekzekutivit të shprehej me terma të një pushteti të pakufizuar [...] Ekzistenca e masave të duhura mbrojtëse dhe efektive kundër abuzimit, përfshirë veçanërisht procedurat për kontrollin efektiv nga gjykatat, janë edhe më të rëndësishme pasi sistemi i mbikëqyrjes sekrete [...] përfshin rrezikun e minimit apo shkatërrimit të demokracisë [...]

37. Sa i përket kushtit të parashikueshmërisë, Gjykata rithekson se niveli i saktësisë së kërkuar nga legjislacioni vendas varet, në një masë të konsiderueshme, nga fusha që është projektuar për të mbuluar. Kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare ndryshojnë në karakter dhe në kohë, ndaj dhe për këtë arsye janë të vështira për t'u përcaktuar paraprakisht [...] Megjithatë, personi që i nënshtrohet një mase të bazuar mbi konsideratat e sigurisë kombëtare nuk duhet të privohet nga të gjitha garancitë kundër arbitraritetit. Ndër të tjera, atij duhet t'i shqyrtohet masa në fjalë nga një organ i pavarur dhe i paanshëm kompetent me qëllim shqyrtimin e të gjitha pyetjeve përkatëse të fakteve dhe ligjit, në mënyrë që të përcaktojë ligjshmërinë e masës dhe të dënojë abuzimin e mundshëm nga autoritetet. Para atij organi shqyrtues, personi në fjalë duhet të përfitojë nga procedimet kundërshtuese në mënyrë që të paraqesë pikëpamjen e tij dhe të hedhë poshtë argumentet e autoriteteve [...]".

Sa i përket çështjes në fjalë, shkelja rezultoi veçanërisht nga fakti se nuk ishte ngritur asnjë procedim kundër kërkuesit për përfshirje në vepra të tjera penale në Rumani apo në vende të tjera. Gjithashtu, autoritetet nuk i kishin dhënë kërkuesit asnjë detaj tjetër. Për më tepër, në shkelje të ligjit të brendshëm, kërkuesit nuk i ishte dhënë urdhri i dëbimit deri pasi ishte dëbuar. Sa u përket procedurave në gjykata, GJEDNJ-ja nënvizon se Gjykata e Apelit ishte kufizuar në ekzaminimin e thjeshtë formal të urdhrit të prokurorisë, pa kërkuar të konfirmonte nëse kërkuesi paraqiste vërtet rrezik.

Sa i përket shkeljes së Nenit 1, Protokolli Nr. 7 të Konventës, Gjykata konstatoi se kërkuesi ishte privuar nga të drejtat e tij, sepse ligji në fuqi nuk siguronte garancitë minimale kundër veprimeve arbitrare të autoriteteve dhe Gjykata e Apelit ishte kufizuar në vetëm një rishikim thjesht formal. Gjykata vërejti se autoritetet kishin shkelur garancitë për të cilat Kërkuesi duhej të kishte të drejtë sipas Nenit 1 Protokolli Nr. 7. Ata nuk kishin arritur t'i jepnin kërkuesit as treguesin më të vogël të veprës penale dhe prokuroria nuk ia kishte dërguar urdhrin atij paraprakisht. Duke pasur parasysh shqyrtimin thjesht formal nga Gjykata e Apelit, kërkuesi nuk kishte pasur vërtet mundësi që ta shqyrtonte çështjen nga pikëpamja e arsyeve që kundërshtonin dëbimit të tij. Gjykata e Apelit kishte hedhur poshtë të gjitha kërkesat për shtyrje, duke parandaluar studimin e urdhrit nga avokati i kërkuesit dhe dhënien e provave në mbështetje të çështjes së tij.

Uener k. Holandës – nr. 46410/99, datë 19/10/2006

Vendimi për *Uener k. Holandës*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 18 tetor 2006, fokusohet tek e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, e parashikuar në Nenin 8 të KEDNJ-së.

Kërkuesi apeloi kundër urdhrit që tërhiqte lejen e tij të qëndrimit dhe vendosi urdhrin e përjashtimit dhjetëvjeçar. Kërkuesi është shtetas turk i lindur në vitin 1969 dhe jeton në Eskişehir (Turqi). Ai erdhi në Holandë në

moshën 12 vjeç me nënën dhe dy vëllezërit për t'iu bashkuar babait të tij dhe, në vitin 1988, mori leje qëndrimi të përhershme. Në ose rreth qershorit të vitit 1991, ai filloi të jetojë me një shtetase holandeze. Çifti kishte një djalë, i lindur në shkurt 1992. Kërkuesi u largua në nëntor të vitit 1992, por mbeti në kontakt të ngushtë me partneren dhe djalin e tij. Kërkuesi u dënua për vrasje pa paramendim dhe sulm në janar të vitit 1994 dhe u dënua me shtatë vjet burg. Partnerja e tij, djali dhe djali i dytë (i lindur nga kërkuesi dhe partnerja e tij në qershor të vitit 1996) e vizituan atë në burg të paktën një herë në javë. Të dy djemtë e tij kanë kombësi holandeze dhe janë njohur nga ai. As partnerja e as fëmijët e tij nuk flasin turqisht. Më 30 janar të vitit 1997, zëvendësministri i Drejtësisë tërhoqi lejen e përhershme të qëndrimit të kërkuesit dhe vendosi një urdhër përjashtimi dhjetëvjeçar ndaj tij për shkak të dënimit të tij në janar 1994. Kërkuesi apeloi pa sukses. Ai u deportua më pas në Turqi më 11 shkurt 1998. Dukej se ai, kërkuesi, u kthye në Holandë menjëherë më pas dhe u deportua edhe një herë në Turqi më 4 qershor 1998. Ai përsëri apeloi pa sukses.

Gjykata (Dhoma e Madhe) konstatoi se Holanda nuk kishte shkelur të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës private dhe familjare, Neni 8 i KEDNJ-së.

Sa i përket mos-shkeljes së Nenit 8 të KEDNJ-së, Gjykata fillon duke theksuar specifikimet e Nenit 8 të KEDNJ-së në lidhje me situatën e fëmijëve:

"Konventa nuk garanton të drejtën e një të huaji për të hyrë ose për të banuar në një vend të caktuar dhe, në zbatim të detyrës së tyre për të ruajtur rendin publik, Shtetet Kontraktuese kanë fuqinë ta dëbojnë një të huaj të dënuar për vepra penale. Sidoqoftë, vendimet e tyre në këtë fushë duhet, për aq sa mund të ndërhyjnë tek e drejta e mbrojtur sipas paragrafit 1 të nenit 8, të jenë në përputhje me ligjin dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike, pra të justifikohen nga një shoqëri urgjente në nevojë dhe, në veçanti, proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur [...]

këto parime zbatohen pavarësisht nëse i huaji ka hyrë në vendin pritës si i rritur ose në një moshë shumë të re apo ndoshta edhe ka lindur atje. [...] Në Boultif, Gjykata shtjelloi kriteret përkatëse që do të përdorte për të vlerësuar nëse një masë dëbimi ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur [...]: natyra dhe serioziteti i veprës penale të kryer nga kërkuesi; kohëzgjatja e qëndrimit të kërkuesit në vendin nga i cili do të dëbohet; koha e kaluar që nga kryerja e veprës penale dhe sjellja e kërkuesit gjatë asaj periudhe; kombësitë e personave të ndryshëm në fjalë; situata familjare e kërkuesit, siç është kohëzgjatja e martesës dhe faktorë të tjerë që shprehin efektivitetin e jetës familjare të një çifti; nëse bashkëshorti ka ditur për veprën penale në kohën kur ai ose ajo ka hyrë në një lidhje familjare; nëse ka fëmijë të martesës, dhe nëse po, mosha e tyre; seriozitetin e vështirësive me të cilat bashkëshorti ka hasur në vendin në të cilin kërkuesi duhet të dëbohet. [...]

Gjykata do të dëshironte të bënte të qarta dy kritere [...]: interesin më të mirë dhe mirëqenien e fëmijëve, në veçanti rëndësinë e vështirësive me të cilat çdo fëmijë i kërkuesit do të ndeshet në vendin në të cilin kërkuesi duhet të dëbohet; qëndrueshmëria e lidhjeve shoqërore, kulturore dhe familjare me vendin pritës dhe me vendin e destinacionit.".

Sa i përket arsyetimit të ndërhyrjes së padiskutueshme në të drejtën e kërkuesit të Nenit 8 të KEDNJ-së në rastin aktual, Gjykata konstaton se ishte arritur ekuilibri i drejtë dhe dëbimi e përjashtimi i kërkuesit nga Holanda ishte proporcional me qëllimet e ndjekura dhe rrjedhimisht i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Duke pasur parasysh natyrën dhe rëndësinë e shkeljeve të kërkuesit dhe urdhrin e përjashtimit të kufizuar në dhjetë vjet, Gjykata nuk konstatoi se autoritetet u kishin dhënë shumë peshë interesave të vetë Shtetit, përkatësisht interesit të sigurisë publike dhe parandalimit të çrregullimit ose krimit, kur vendoset të merret ajo masë.

Prandaj, edhe në lidhje me nevojat e fëmijëve, në rrethanat e veçanta të rastit, interesat e familjes u tejkaluan nga arsyetimet e lartpërmendura. Gjykata mori parasysh faktin se kërkuesi kishte jetuar me partneren dhe djalin e tij të parë të lindur vetëm për një periudhë relativisht të shkurtër dhe se ai kurrë nuk kishte jetuar së bashku me djalin e tij të dytë. Gjykata nuk ishte e përgatitur të pranonte kërkesën e kërkuesit që ai kishte kaluar kaq pak kohë në Turqi saqë, në kohën kur u kthye në atë vend, ai nuk kishte më asnjë lidhje shoqërore ose kulturore (përfshirë ato gjuhësore) me shoqërinë turke. Veprat penale të vrasjes dhe sulmit ishin të një natyre shumë të rëndë dhe duke pasur parasysh dënimet e tij të mëparshme, mund të thuhet se ai kishte shfaqur prirje kriminale. Kur urdhri i përjashtimit mori formë të prerë, fëmijët e kërkuesit ishin ende shumë të vegjël - përkatësisht gjashtë dhe një vjeç e gjysmë - dhe rrjedhimisht në një moshë të përshtatshme. Duke pasur parasysh se ata kishin kombësi holandeze - nëse do të ndiqnin babanë e tyre në Turqi - ata do të kishin mundësi të ktheheshin rregullisht në Holandë për të vizituar anëtarët e tjerë të familjes që jetonin atje.

Liu k. Rusisë - nr. 42086/05, datë 06.12.2007

Vendimi i *Liu k. Rusisë*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 6 dhjetor 2007, fokusohet tek e drejta e respektimit të jetës private dhe asaj familjare - Neni 8 i KEDNJ-së - veçanërisht për shkak të mungesës së masave mbrojtëse procedurale në procedurat e dëbimit. Vendimi përfshin gjithashtu edhe të drejtën për liri dhe siguri - Neni 5 i KEDNJ-së.

Të dy kërkuesit apeluan kundër urdhrit të dëbimit. Kërkuesi i parë, një shtetas kinez dhe Kërkuesi i dytë, një shtetas rus të martuar që prej vitit 1994 dhe me dy fëmijë. Kërkuesi i dytë së bashku me të dy fëmijët kanë jetuar në Rusi gjatë gjithë jetës së tyre. Kërkuesi i parë ka jetuar ligjërisht në Rusi deri në gusht 2003 në bazë të lejeve të punës. Në nëntor të vitit 2002, ai aplikoi për leje qëndrimi, por kërkesa e tij u refuzua përfundimisht pa iu dhënë asnjë arsye. Kërkuesit apeluan në gjykatat ruse, por pa sukses. Në nëntor të vitit 2004, gjykata kompetente e qarkut konstatoi se, në bazë të informacioneve të caktuara të klasifikuara, kërkuesi i parë paraqiste rrezik për sigurinë kombëtare. Megjithatë, ky informacion ishte sekret shtetëror dhe nuk u bë publik. Në vendim nuk kishte asnjë të dhënë që të tregonte se gjykata ka pasur ndonjëherë akses në informacionin e klasifikuar në fjalë. Në mars të vitit 2005, autoritetet refuzuan kërkesën e re për leje qëndrimi. Përpjekjet e kërkuesve për ta anuluar vendimin nuk rezultuan të suksesshme. Në nëntor të vitit 2005, gjykata kompetente vendosi që Kërkuesi i parë kishte shkelur rregullat e qëndrimit dhe urdhëroi ndalimin e tij, deri në pritje të dëbimit. Ai u dërgua në një qendër paraburgimi në po të njëjtën ditë dhe u lirua më 13 dhjetor 2005, kur vendimi për ndalimin e tij u anulua për shkak të mungesës së arsyetimit. Procedurat administrative kundër tij u mbyllën përfundimisht si procedura me afat të kufizuar. Në nëntor të vitit 2005, Kreu i Shërbimit Federal të Migracionit urdhëroi dëbimin e kërkuesit të parë. Nuk u dha asnjë arsye tjetër. Në dhjetor të vitit 2006, gjykata urdhëroi pozicionimin e tij në një qendër paraburgimi me qëllim dëbimin e tij. Urdhri i dëbimit duket se nuk u zbatua në kohën e vendimit gjyqësor të GJEDNJ-së.

Gjykata konstatoi se Rusia shkeli të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës private dhe familjare - Neni 8 i KEDNJ -së. Gjykata nuk konstatoi shkelje të së drejtës së tyre për liri dhe siguri - Neni 5 i KEDNJ.

Sa i përket shkeljes së nenit 8 të KEDNJ -së, Gjykata përsërit specifikimet e nenit 8 të KEDNJ -së dhe konstaton se nuk kishte mbrojtje të mjaftueshme procedurale në procedimet gjyqësore para gjykatave vendase. " *Ndërhyrja [...] u bazua në dispozita ligjore, të cilat nuk përmbushnin kriteret e Konventës për "cilësinë e ligjit"* pasi" *dispozitat ligjore në bazë të të cilave u urdhërua dëbimi i kërkuesit të parë nuk siguronin shkallën e duhur të mbrojtjes kundër ndërhyrjeve arbitrare*".

Refuzimi i lejes së qëndrimit për kërkuesin e parë dhe urdhërimi i dëbimit të tij përbënte ndërhyrje në të drejtën e respektimit të jetës familjare. Kjo mbështetej në të drejtën e brendshme.

Megjithatë, së pari, gjykatat vendase nuk ishin në gjendje të vlerësonin me efikasitet nëse vendimet për refuzimin e kërkesës së kërkuesit të parë për leje qëndrimi ishin të justifikuara pasi ato bazoheshin në informacione të klasifikuara. Por megjithatë, gjykata vërejti,

> *"se kur siguria kombëtare është në rrezik, konceptet e ligjshmërisë dhe sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike kërkojnë nënshtrimin e masave për të drejtat themelore të njeriut ndaj disa formave të caktuara kundërshtimi para një organi të pavarur kompetent për të shqyrtuar arsyet e vendimit dhe dëshmitë përkatëse, nëse do të ishte është e nevojshme edhe me kufizimet e duhura procedurale në përdorimin e informacionit të klasifikuar. Individi duhet të jetë në gjendje të kundërshtojë pohimin e ekzekutivit se siguria kombëtare është në rrezik. Ndërsa vlerësimi i ekzekutivit për atë çka paraqet kërcënim për sigurinë kombëtare do të ketë peshë të konsiderueshme, autoriteti i pavarur duhet të jetë në gjendje të reagojë në rastet kur thirrja e këtij koncepti nuk ka bazë të arsyeshme në fakte ose zbulon interpretimin e "sigurisë kombëtare", gjë që është e paligjshme ose në kundërshtim me kuptimin e shëndoshë dhe arbitrar. Nëse nuk merren këto masa mbrojtëse, atëherë policia ose autoritetet e tjera shtetërore do të jenë në gjendje të shkelin në mënyrë arbitrare të drejtat e mbrojtura nga Konventa."*

Shteti i paditur ishte i detyruar të gjente mënyra të ndryshme për trajtimin e shqetësimeve legjitime të sigurisë në lidhje me natyrën dhe burimet e informacionit të inteligjencës, duke i dhënë individit masën thelbësore të drejtësisë procedurale. Moszbulimi i informacionit përkatës për gjykatat i kishte privuar ata nga fuqia e vlerësimit të mjaftueshëm të akuzave.

Së dyti, Gjykata arriti në përfundimin se deportimi i kërkuesit të parë ishte urdhëruar në bazë të dispozitave ligjore që nuk siguronin shkallën e duhur të mbrojtjes kundër ndërhyrjeve arbitrare. Dispozitat përkatëse të ligjit për shtetasit e huaj i mundësuan Ministrisë së Punëve të Brendshme të refuzojë lejet e qëndrimit dhe t'i kërkojë një shtetasi të huaj të largohet nga vendi për arsye sigurie kombëtare pa dhënë asnjë arsye dhe pa kontroll efektiv nga një autoriteti i pavarur. Ligji i brendshëm i vendit ngriti dy procedura

paralele për dëbimin e shtetasve të huaj, qëndrimi i të cilëve në Rusi u bë i paligjshëm. Në njërën prej procedurave, dëbimi i shtetasit të huaj mund të urdhërohej nga ekzekutivi pa asnjë formë rishikimi të pavarur ose pa procedura kundërshtuese, ndërsa procedura tjetër (largimi administrativ) parashikonte kontrollin gjyqësor. E drejta e brendshme e lejoji ekzekutivin të zgjedhë mes procedurave sipas gjykimit të tij. Prandaj, përfitimi i shtetasit të huaj nga masat mbrojtëse procedurale ishte në duart e ekzekutivit.

Sa i përket mos-shkeljes së nenit 5 § 1, Gjykata thekson se vendimi për arrestimin e kërkuesit të parë ishte "procedurë e përcaktuar me ligj" brenda kuptimit të nenit 5 § 1 të KEDNJ-së, pavarësisht se nuk ishin dhënë arsye për justifikimin e domosdoshmërisë së arrestimit. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ishte se vetëm një "parregullsi e madhe ose e dukshme" mund ta bënte vendimin të paligjshëm. Megjithatë, kërkuesit nuk e kundërshtuan faktin që Gjykata e Qytetit veproi përtej juridiksionit të saj.

C.G. dhe të Tjerë k. Bullgarisë – nr. 1365/07, datë 24/4/2008

Vendimi *C.G. & të Tjerë kundër Bullgarisë*, dorëzuar nga Gjykata (Dhoma) në 24 prill 2008, fokusohet në të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, Neni 8 i KEDNJ-së, e drejta për një mjet efektiv, Neni 13 i KEDNJ-së dhe garancitë për mbrojtje procedurale në procedurat e dëbimit, Neni 1, Protokolli nr. 7.

Kërkuesit apeluan kundër vendimit të dëbimit të kërkuesit të parë, një shtetas turk, bashkëshort dhe baba i një fëmije. Kërkuesi i parë është një shtetas turk, i lindur në 1968, që jeton në Turqi pas dëbimit të tij nga Bullgaria në kohën e gjykimit. Kërkuesit e dytë janë gruaja dhe vajza e tij, të dyja shtetase bullgare, të lindura në Bullgari respektivisht në 1968 dhe 1996, që jetonin në Plovdiv, Bullgari, në kohën e gjykimit. Kërkuesi i parë u vendos në Bullgari në 1992. Ai u martua me kërkuesen e dytë në prill 1996 dhe pak më vonë iu dha një leje qëndrimi e përhershme. Para dëbimit të tij ai punonte si shofer për një kompani në Plovdiv. Më 8 qershor 2005, leja e qëndrimit e kërkuesit të parë u revokua dhe ndaj tij u shpall një urdhër dëbimi duke deklaruar se ai përbënte një kërcënim për sigurinë kombëtare. Vendimi, duke u mbështetur në parashikimet përkatëse të Aktit për të Huajt të vitit 1998, iu referua një raporti të klasifikuar nga Punët e Brendshme të Plovdivit, por nuk përmbante asnjë bazë faktike për dëbimin. Në orën 6.30 të mëngjesit të 9 qershorit 2005, kërkuesi i parë u thirr në një stacion policie në Plovdiv, ku atij iu dha urdhri dhe u ndalua me qëllimin për t'u dëbuar. Ai u dëbua në Turqi në të njëjtën ditë, pa u lejuar të kontaktonte një avokat ose gruan dhe vajzën e tij. Ankesa e mëvonshme e kërkuesit të parë

drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme u rrëzua. Në seancat e rishikimit gjyqësor që pasuan, gjykatat vendase gjithashtu hodhën poshtë kërkesat e kërkuesit të parë në lidhje me paligjshmërinë e dëbimit të tij. Vendimet e tyre u bazuan në informacionin e përfshirë në raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili deklaroi se, pas mbikëqyrjes sekrete, ishte vërtetuar se kërkuesi i parë ishte i përfshirë në trafik droge. Mbi atë bazë, gjykatat refuzuan të bëjnë ndonjë hetim të mëtejshëm në faktet e çështjes së kërkuesit ose të shqyrtojnë ndonjë dëshmi tjetër. Që prej deportimit të tij, kërkuesi i parë i sheh gruan dhe vajzën e tij në Turqi disa herë në vit. Ata mbajnë kontakte me telefon.

Gjykata vërejti se Bullgaria kishte shkelur të drejtat për respektimin e jetës private dhe familjare, Neni 8 i KEDNJ-së, e drejta për një mjet efektiv, Neni 13 KEDNJ-së dhe garancitë procedurale të parashikuara nga Neni 1 Protokolli Nr. 7.

Sa i përket Nenit 8 të KEDNJ-së, së pari, Gjykata vëren se dëbimi dhe vendimet e gjykatave për lënien e tij në fuqi përfshihen në fushën e zbatimit të tij, pasi ankuesi kishte banuar ligjërisht në Bullgari dhe ishte në gjendje të shihte familjen e tij vetëm herë pas here pas dëbimit. Duke iu kthyer arsyetimit të kësaj ndërhyrjeje, Gjykata, duke iu referuar praktikës së saj të mëparshme (*shiko, përmbledhja e Lupsa k. Rumanisë*), vuri në dukje se, edhe aty ku ishte në rrezik siguria kombëtare, masat e dëbimit duhet t'i nënshtrohen një forme kundërshtimi procedural para një autoriteti ose gjykate të pavarur, e cila të jetë kompetente për të shqyrtuar në mënyrë efektive arsyet për ato masa dhe për të shqyrtuar provat përkatëse, nëse është e nevojshme me kufizimet e duhura në përdorimin e informacionit të klasifikuar. Lidhur me rastin konkret, Gjykata vëren, ndërkohë që binte vërtet në sy, se vendimi për të dëbuar kërkuesin e parë nuk ishte dhënë mbi bazë faktesh dhe thjesht kishte cituar dispozitat përkatëse ligjore në lidhje me kërcënimet serioze ndaj sigurisë kombëtare. Ky përfundim ishte bazuar në informacione të papërcaktuara saktë të përfshira në një raport të klasifikuar. Meqenëse kërkuesit të parë nuk i ishte ofruar as e dhëna më e pakët pse ai paraqiste një kërcënim të tillë, ai nuk kishte qenë në gjendje ta paraqiste çështjen e tij në mënyrë të përshtatshme në apelin e tij drejtuar ministrit të Punëve të Brendshme ose në proceset e rishikimit gjyqësor që pasuan. Në procesin e rishikimit gjyqësor, vendimi i gjykatave vendase ishte thjesht formal. Ato kishin refuzuar të shqyrtonin provat që do të konfirmonin ose kundërshtonin pretendimet kundër kërkuesit dhe, si në çështjen *Lupsa kundër Rumanisë*, ishin mbështetur vetëm në informacione të pambështetura në një raport të klasifikuar të hartuar si rezultat i

mbikëqyrjes të fshehtë. Për më tepër, legjislacioni i brendshëm në lidhje me një mbikëqyrje të tillë nuk siguronte garancitë minimale të kërkuara sipas Nenit 8, të tilla si sigurimi që regjistrimi i shkruar origjinal i mbikëqyrjes së posaçme të riprodhohej me besnikëri ose të përcaktonte procedurat e duhura për ruajtjen e integritetit të këtyre të dhënave. Në fakt, në rastin e kërkuesve, dosja nuk përmbante asnjë informacion nëse masat e vëzhgimit sekret ishin urdhëruar dhe ekzekutuar në mënyrë të ligjshme ose nëse ky aspekt ishte marrë parasysh nga gjykatat në procedurat e rishikimit gjyqësor. Së fundi, Gjykata vëren se gjatë procedurave të rishikimit gjyqësor baza e vetme për vlerësimin se kërkuesi i parë kishte paraqitur një kërcënim për sigurinë kombëtare ishte përfshirja e tij e pretenduar në trafikun e drogës. Gjykata vëren se një pretendim i tillë kundër tij, sado i rëndë që të jetë, nuk mund të jetë i arsyeshëm për të kërcënuar sigurinë kombëtare të Bullgarisë. Prandaj, gjykatat bullgare nuk kishin zbatuar një kontroll kuptimplotë ndaj akuzave kundër kërkuesit të parë.

Sa i përket Nenit 13 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se është shkelur kryesisht nga i njëjti arsyetim sa i përket shkeljes së Nenit 8 të KEDNJ-së. Gjykata përsëriti se autoritetet nuk kishin shqyrtuar siç duhet mbi çfarë baze faktike ishte marrë vendimi për dëbim ose, në të vërtetë, nëse ishte marrë për arsye të vërteta të sigurisë kombëtare. Për më tepër, kërkuesit të parë fillimisht nuk i ishte dhënë asnjë informacion se pse autoritetet kishin bërë një vlerësim të tillë për të dhe, më pas, as që i ishte dhënë as një mundësi e drejtë dhe e arsyeshme për të kundërshtuar pretendimin kundër tij. Për më tepër, gjykatat kombëtare nuk i kishin kushtuar vëmendje pyetjes nëse ndërhyrja në jetën familjare të kërkuesve i ishte përgjigjur një nevoje të ngutshme shoqërore dhe ishte proporcionale me qëllimet legjitime të ndjekura.

Lidhur me Nenin 1, Protokolli Nr. 7, Gjykata përsërit praktikën e saj gjyqësore dhe thekson se të huajt, të cilët ishin rezidentë të ligjshëm në territorin e një shteti që kishte ratifikuar Protokollin Nr. 7, përfitonin disa garanci procedurale në rast dëbimi të tyre, gjithashtu për arsye të sigurisë kombëtare, të tilla si njohja e arsyeve të dëbimit të tyre dhe shqyrtimi i çështjes së tyre. Gjykata kujtoi se dëbimi nuk ishte "në përputhje me ligjin". Gjithashtu, gjykatat vendase kishin refuzuar të mblidhnin prova për të konfirmuar pretendimet dhe vendimi i tyre kishte qenë formal, duke rezultuar në atë që kërkuesi i parë nuk kishte qenë në gjendje të dëgjonte ose shqyrtonte çështjen e tij, siç kërkohet nga paragrafi 1(b) i Nenit 1 të Protokollit Nr. 7. Për më tepër, meqë dëbimi ndodhi pikërisht ditën kur ai kishte marrë urdhrin e dëbimit, ai kishte qenë në gjendje të kundërshtonte

masat kundër tij vetëm kur u gjend jashtë Bullgarisë. Neni 1 i Protokollit Nr.7 e lejon këtë rrethanë, por vetëm nëse dëbimi do të ishte "i nevojshëm në interes të rendit publik" ose "i bazuar në arsye të sigurisë kombëtare". Gjykata përsërit se dëbimi nuk ishte bazuar në arsye të vërteta të sigurisë kombëtare. Gjithashtu, nuk kishte asgjë për të sugjeruar në dosjen e çështjes, si dhe Qeveria nuk kishte paraqitur ndonjë argument bindës se ishte vërtet e nevojshme të dëbohej menjëherë në interes të rendit publik.

Darren Omoregie dhe të tjerë k. Norvegjisë – nr. 265/07, datë 31/07/2008

Vendimi *Darren Omoregie dhe të tjerë k. Norvegjisë*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 6 korrik 2010, fokusohet në të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, të mishëruar në Nenin 8 të KEDNJ-së.

Kërkuesit apeluan kundër vendimeve për dëbimin dhe vendosjen e një urdhri përjashtimi. Kërkuesi i parë, një shtetas nigerian, hyri në Norvegji në 2001 dhe aplikoi për azil. Kërkesa e tij u refuzua në maj 2002. Në pritje të apelimit të tij kundër këtij vendimi, atij iu dha një leje pune e përkohshme dhe një pezullim i ekzekutimit, por në asnjë çast nuk iu dha qëndrimi i ligjshëm në Norvegji. Ai u takua me kërkuesen e dytë, një shtetase norvegjeze, në tetor 2001 dhe çifti filloi të bashkëjetonte në mars 2002. Në shtator 2002, Bordi i Apelit të Emigracionit hodhi poshtë ankimin e tij dhe atij iu kërkua të largohej nga vendi deri në fund të muajit. Nga ai çast, qëndrimi i tij i vazhduar në Norvegji ishte i paligjshëm sipas legjislacionit vendas. Në shkurt 2003, kërkuesi i parë u martua me kërkuesen e dytë dhe bëri kërkesë për të drejtën për të qëndruar bazuar në këtë arsye. Ajo kërkesë gjithashtu u refuzua. Në gusht 2003, Drejtoria e Emigracionit lëshoi një urdhër dëbimi të shoqëruar me një urdhër përjashtimi pesëvjeçar për kërkuesin e parë për qëndrim tej afatit dhe punë pa leje. Ai vazhdoi të jetonte me kërkuesen e dytë në Norvegji. Në shtator 2006, çifti u bë me një fëmijë, kërkuesin e tretë. Në mars 2007, kërkuesi i parë u dëbua në Nigeri.

Gjykata vërejti se Norvegjia nuk i kishte shkelur të drejtat e kërkuesve për respektimin e jetës private dhe familjare, Neni 8 i KEDNJ-së.

Së pari, Gjykata vërejti se urdhrat e autoriteteve dhe vendimet e gjykatave hyjnë në fushëveprimin e Nenit 8 të KEDNJ-së, veçanërisht të së drejtës për respektimin e jetës familjare. Në mënyrë të pakundërshtueshme ato përbënin një ndërhyrje në të drejtën sipas kuptimit të Nenit 8 të KEDNJ-së.

Duke iu kthyer arsyetimit, nëse vendimet ishin "në përputhje me ligjin", ndiqnin një ose më shumë qëllime legjitime dhe ishin "të nevojshme në

një shoqëri demokratike" për të përmbushur ato qëllime, Gjykata përsërit praktikën e saj gjyqësore mbi përcaktimet e Nenit 8 të KEDNJ-së dhe arsyeton ndër të tjera:

"Një shtet ka të drejtë, bazuar në të drejtën ndërkombëtare në zbatim dhe u nënshtrohet detyrimeve të veta sipas traktatit, të kontrollojë hyrjen e të huajve në territorin e tij dhe vendbanimin e tyre atje […] Konventa nuk garanton të drejtën e një të huaji për të hyrë ose për të banuar në një vend të caktuar. […]

Shteti duhet të krijojë një ekuilibër të drejtë midis interesave konkurruese të individit dhe të bashkësisë në tërësi dhe në të dyja rastet, shteti gëzon një hapësirë të caktuar vlerësimi. Për më tepër, Neni 8 nuk përfshin një detyrim të përgjithshëm për një shtet që të respektojë zgjedhjen e emigrantëve për vendin e vendbanimit të tyre dhe të autorizojë bashkimin familjar në territorin e tij. Sidoqoftë, në një rast që ka të bëjë me jetën familjare si dhe emigracionin, shtrirja e detyrimeve të një shteti për të pranuar në territorin e tij të afërm të personave që banojnë atje do të ndryshojë sipas rrethanave të veçanta të personave të përfshirë dhe interesit të përgjithshëm […].

Faktorët që duhen marrë parasysh në këtë kuadër janë shkalla në të cilën jeta familjare është prishur realisht, shtrirja e lidhjeve në Shtetin Kontraktues, nëse ka pengesa të pakapërcyeshme në rrugën e familjes që jeton në vendin e origjinës së njërit ose më shumë prej tyre dhe nëse ka faktorë të kontrollit të emigracionit (për shembull, një histori shkeljesh të ligjit të emigracionit) ose konsiderata të rendit publik që peshojnë në favor të përjashtimit […]

Një konsideratë tjetër e rëndësishme është nëse jeta familjare u krijua në një kohë kur personat e përfshirë ishin të vetëdijshëm se statusi i emigrimit të njërit prej tyre ishte i tillë që qëndrueshmëria e asaj jete familjare brenda shtetit pritës do të ishte e rrezikshme […] Kur është ky rast, largimi i anëtarit të familjes jo shtetas do të ishte e papajtueshme me Nenin 8 vetëm në rrethana të jashtëzakonshme […].".

Sa i përket justifikimit në rastin konkret, Gjykata vëren se ndërhyrja kishte pasur një bazë ligjore në ligjin kombëtar dhe kishte ndjekur qëllimin legjitim për të parandaluar "prishjen e rendit ose krimin" dhe mbrojtjen e "mirëqenies ekonomike të vendit".

Autoritetet kombëtare nuk kishin vepruar në mënyrë arbitrare ose me fjalë të tjera nuk e kishin shkelur kufirin e tyre të vlerësimit. Ndërhyrja në të drejtën e kërkuesve për të respektuar jetën e tyre familjare ishte në përputhje

me ligjin dhe ndoqi qëllimet legjitime të parandalimit të çrregullimeve ose krimeve dhe mbrojtjen e mirëqenies ekonomike të vendit. Sa i përket domosdoshmërisë së masave, Gjykata vëren se kërkuesi i parë ishte një i rritur kur mbërriti për herë të parë në Norvegji dhe lidhjet e tij me kërkuesit e dytë dhe të tretë u formuan vetëm më vonë. Kushti themelor për dëbimin e tij - shkelje serioze dhe të përsëritura të rregullave të emigracionit - ishte përmbushur. Sa i përket marrëdhënies së tij me kërkuesin e dytë, çifti në asnjë fazë para martesës së tyre nuk kishin arsyetuar se çdo kërkuesi të parë do t'i jepej leja për të qëndruar në Norvegji dhe ata nuk kishin të drejtë të prisnin që kërkuesit të parë do t'i jepej një leje qëndrimi në përballjen me autoritetet norvegjeze me praninë e tij në vend si një *fait accompli* (çështje fakti). Ashtu si konsideratat e zbatuara për lindjen e kërkuesit të tretë, të cilat në vetvete nuk mund të krijojnë ndonjë të drejtë të tillë. Ndërsa lidhjet e kërkuesit të parë me Nigerinë ishin veçanërisht të forta, lidhjet e tij me Norvegjinë ishin relativisht të dobëta, përveç lidhjeve familjare që ai kishte krijuar atje me kërkuesit e dytë dhe të tretë në pritje të procedurave. Kërkuesi i tretë ishte ende në një moshë përshtatshmërie dhe ndërsa kërkuesi i dytë ndoshta do të përjetonte disa vështirësi dhe papërshtatshmëri me vendosjen në Nigeri, nuk kishte pengesa të pakapërcyeshme në rrugën e zhvillimit të jetës familjare të kërkuesve atje, qoftë edhe përmes vizitave periodike nga kërkuesit e dytë dhe të tretë. Sa i përket urdhrit pesë-vjeçar të përjashtimit, qëllimi i tij ishte të siguronte që emigrantët e përkohshëm të mos minonin zbatimin efektiv të rregullave mbi kontrollin e emigracionit. Për më tepër, për kërkuesin e parë ishte e hapur mundësia që të bënte kërkesë për ri-hyrje pas dy vjetësh.

Onur k. Mbretërisë së Bashkuar **- nr. 27319/07, datë 17/02/2009**

Vendimi për *Onur k. Mbretërisë së Bashkuar*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 17 shkurt 2009, fokusohet tek e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare, e parashikuar në Nenin 8 të KEDNJ-së.

Kërkuesi, një shtetas turk dhe babai i tre fëmijëve, apeloi kundër vendimit për dëbimin e tij. Kërkuesi është me origjinë kurde dhe i lindur në vitin 1978. Në vitin 1989, kur ishte njëmbëdhjetë vjeç, ai mbërriti në Mbretërinë e Bashkuar me babanë, vëllain dhe katër motrat për t'iu bashkuar nënës së tij, e cila kishte ardhur gjashtë javë më parë. Familjes iu dha leje e jashtëzakonshme qëndrimi dhe më vonë edhe leje pa afat. Në një datë të pacaktuar, nënës, babait dhe tre motrave të kërkuesit iu dha

shtetësia britanike. Njëra nga motrat e kërkuesit u largua nga Mbretëria e Bashkuar. Babai i kërkuesit vdiq në vitin 2006. Nëna, vëllai dhe tre motrat e tij vazhduan të banonin në Mbretërinë e Bashkuar në kohën e vendimit gjyqësor të GJEDNJ-së. Kërkuesi pohoi se nuk ishte kthyer në Turqi që prej largimit të tij në vitin 1989. Ai mund të fliste ende turqisht. Kërkuesi ishte kuzhinier me profesion, ndonëse informacionet e disponueshme në lidhje me historinë e tij të punësimit janë të pakta. Në vitin 1994, ai filloi një marrëdhënie me një shtetase britanike. Gjatë kësaj kohe, kërkuesi ishte dënuar për shtatë raste për disa vepra penale, ndër të cilat vjedhja ishte më e rënda. Në qershor të vitit 2000, kërkuesi u dënua për grabitje në një rast të rëndë. Marrëdhënia e kërkuesit me partneren e tij përfundoi kur ai u burgos. Menjëherë pas kësaj, partnerja e tij lindi një vajzë. Kërkuesi nuk u emërua si babai në certifikatën e lindjes. Pas lirimit të kërkuesit në janar të vitit 2003, avokatët e tij i shkruan Zyrës së Brendshme Britanike për të kërkuar sqarime në lidhje me dëbimin pasi kjo i ishte thënë kërkuesit gjatë burgosjes së tij, por nuk ishte marrë asnjë veprim formal. Në maj të vitit 2005, kërkuesi u dënua për shkelje të trafikut rrugor dhe mosdorëzim dhe u dënua me 30 ditë burg dhe gjobë. Në të njëjtën kohë, ai nisi një marrëdhënie me një shtetase britanike. Në prill të vitit 2006, Sekretari i Shtetit për Zyrën e Brendshme pranoi se rreth një mijë kriminelë të huaj, të cilët duhej të konsideroheshin për dëbim ose largim, kishin përfunduar dënimet e tyre me burg dhe u liruan pa marrë parasysh veprimet e largimit. Lajmi u raportua gjerësisht në mediat britanike. Në shtator të vitit 2006, çifti lidh martesë, jodetyruese për nga pikëpamja ligjore e ritit kurd dhe fëmija i tyre i parë lindi në mars të vitit 2007. Në janar të vitit 2008 lindi fëmija i dytë. Në verën e vitit 2006 dhe sërish në tetor të vitit 2006, kërkuesi mori një letër dëbimi të paralajmëruar për në tetor të vitit 2006. Ankesa e tij në gjykatën përgjegjëse u hodh poshtë në shkurt 2007, ashtu si edhe kërkesa për rishqyrtim në mars 2007 dhe ajo për shqyrtim ligjor nga Gjykata e Lartë në maj 2007. Ai u deportua në Turqi më 12 korrik 2007. Më 11 korrik 2007, kërkuesi depozitoi kërkesën për rishikim gjyqësor në Gjykatën e Lartë. Kërkesa për rishikim u hodh poshtë në tetor të vitit 2007.

Gjykata konstatoi se Mbretëria e Bashkuar nuk kishte shkelur të drejtat e kërkuesit për respektimin e jetës private dhe familjare, Neni 8 i KEDNJ-së.

Gjykata, *së pari*, vëren se urdhrat e autoriteteve për dëbimin dhe vendimet përkatëse të gjykatës bien brenda fushës së zbatimit të Nenit 8 të KEDNJ-së. Jeta me partneren aktuale të kërkuesit dhe fëmijën e dytë më të madh përbënin "jetën familjare". Gjykata, pas shqyrtimeve të ndryshme, konstaton këtë gjë edhe për marrëdhënien me fëmijën më të madh. Ndonëse

marrëdhënia me nënën e fëmijës më të madh ishte prishur para se fëmija të lindte, fëmija nuk ka jetuar kurrë me kërkuesin dhe ndonëse bashkëjetesa ishte një nga faktorët vendimtarë në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore, Gjykata ishte në gjendje të gjente faktorë të tjerë si p.sh. kohëzgjatja e madhe e marrëdhënies para lindjes së fëmijës që shërbejnë për të demonstruar se marrëdhënia e tyre ka qëndrueshmëri të mjaftueshme për të krijuar lidhje *de facto* familjare të mjaftueshme brenda kuptimit të Nenit 8 të KEDNJ-së. Gjykata nuk konstaton se kërkuesi kishte jetë familjare me nënën dhe vëllezërit e motrat e tij, pasi ai nuk kishte demonstruar elementin shtesë të varësisë, normalisht të domosdoshëm, për të krijuar jetë familjare mes dy prindërish të rritur dhe fëmijëve të rritur. Sa i përket "jetës shoqërore" brenda kuptimit të Nenit 8 të KEDNJ-së, Gjykata kujton " *se, pasi Neni 8 mbron gjithashtu të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qenie të tjera njerëzore dhe botën e jashtme dhe ndonjëherë mund të përfshijë aspektet e identitetit shoqëror të individit, [...] dëbimi i një emigranti të vendosur përbën ndërhyrje në të drejtën e tij ose të saj për respektimin e jetës private.*"

Duke iu kthyer arsyetimit, pra nëse vendimet ishin «në përputhje me ligjin», zbatonin një ose më shumë qëllime legjitime dhe ishin «të nevojshme në një shoqëri demokratike» për përmbushjen e atyre qëllimeve, Gjykata rithekson praktikën e saj gjyqësore për specifikimet e Nenit 8 të KEDNJ-së për interesin e fëmijëve të përfshirë, duke iu referuar çështjes historike *Üner kundër Hollandës* (shih përmbledhjen përkatëse).

Lidhur me arsyetimin e rastit aktual, Gjykata konstaton se ndërhyrja bazohej në ligjin kombëtar dhe kishte ndjekur qëllimet legjitime. Ndërhyrja në të drejtën e kërkuesve për të respektuar jetën e tyre familjare ishte në përputhje me ligjin dhe respektonte qëllimet legjitime të parandalimit të prishjes së rendit ose krimit. Ekuilibri i drejtë ishte arritur mes interesave personale dhe atyre publike. Autoritetet kombëtare nuk kishin vepruar në mënyrë arbitrare dhe as nuk kishin shkelur marzhin e tyre të vlerësimit. Krimet e kryera ishin të rënda dhe mbartnin mundësinë e veprimtarive të mëtejshme kriminale, veçanërisht pasi kërkuesi u zbulua se ishte kryetar i grupit. Gjykata vëren se kërkuesi kaloi kohë të konsiderueshme në Mbretërinë e Bashkuar, nuk ishte kthyer në Turqi dhe nuk kishte lidhje të konsiderueshme shoqërore atje, pasi ato ekzistonin me familjen, partnerin dhe fëmijët e tij që jetonin në Mbretërinë e Bashkuar. Duke balancuar interesat, Gjykata vëren të kundërtën - kërkuesi nuk e kaloi pjesën më të madhe të fëmijërisë dhe rinisë së tij në Mbretërinë e Bashkuar. Mund të ketë vështirësi praktike, sociale dhe mjekësore për t'u kthyer në Turqi, megjithatë kërkuesi nuk siguroi asnjë provë jashtëzakonisht të vështirë që

të kapërcehej nga ai apo partnerja e tij. Sa u përket interesave të partneres së tij aktuale dhe fëmijëve më të vegjël, Gjykata vëren:

"Po ashtu, ndonëse partnerja e kërkuesit është britanike, nuk ka rrethana që do ta përjashtonin atë natyrshmërisht nga të jetuarit në Turqi. Fëmijët e çiftit janë ende shumë të vegjël - më i madhi është pak më pak se dy vjeç dhe më i vogli vetëm nën një - pra rrjedhimisht në moshë të përshtatshme. Duke pasur parasysh se ata kanë nënshtetësi britanike, nëse partnerja dhe fëmijët e ndiqnin kërkuesin në Turqi, ata do të ishin në gjendje të ktheheshin rregullisht në Mbretërinë e Bashkuar për të vizituar anëtarët e tjerë të familjes që banonin atje."

Sa u përket fëmijëve më të mëdhenj, Gjykata vërejti:

"Megjithëse ajo kurrë nuk ka jetuar me kërkuesin, Gjykata tashmë ka konstatuar se marrëdhënia e tyre përbënte jetë familjare pasi ajo kishte marrëdhënie të ngushtë me të para dëbimit të tij, duke kaluar mesatarisht dy deri në tre ditë në javë së bashku. Sidoqoftë, pa nënvlerësuar efektin përçarës që dëbimi i kërkuesit ka sjellë, dhe do të vazhdojë të sjellë, në jetën e saj, nuk ka gjasa të ketë pasur të njëjtin ndikim si nëse kërkuesi dhe vajza e tij do të kishin jetuar së bashku si familje. Kontakti me telefon dhe e-mail mund të mbahet lehtësisht nga Turqia dhe asgjë nuk do ta pengonte vajzën e tij të udhëtonte në Turqi për ta vizituar atë."

Neulinger & Shuruk k. Zvicrës – nr. 41615/07, datë 06/07/2010

Vendimi *Neulinger & Shuruk k. Zvicrës*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 6 korrik 2010, fokusohet tek e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare e që sanksionohet nga Neni 8 i KEDNJ-së.

Kërkuesit apeluan kundër një urdhri për kthimin e një fëmije në vendin e banimit të babait nga ku ishte hequr padrejtësisht. Kërkuesit, nëna dhe fëmija, janë shtetas zviceranë të cilët kanë lindur përkatësisht në vitin 1959 dhe 2003 dhe jetojnë në Lozanë, Zvicër. Në vitin 1999, nëna u vendos në Izrael ku u martua me babanë e ardhshëm në 2001. Djali i tyre, kërkuesi i dytë, lindi në Tel Aviv në vitin 2003. Nga frika se kërkuesi i dytë do të çohej nga babai i tij në një komunitet "Chabad-Lubavitch" - të cilin ajo e përshkruante si lëvizje ultra-ortodokse, radikale dhe e njohur për

prozelitizmin e devotshëm - kërkuesi i parë aplikoi në Gjykatën e Familjes në Tel Aviv, e cila në vitin 2004 vendosi ndalimin e largimit të Noam nga vendi, derisa ai të arrinte moshën e tij madhore. Nënës iu dha kujdestaria e përkohshme, pasi do të ushtrohej nga të dy prindërit së bashku. Në shkurt të vitit 2005, prindërit u divorcuan dhe në qershor, kërkuesja e parë u largua fshehurazi nga Izraeli për në Zvicër me djalin e saj. Në vendimin e 30 majit 2006, Gjykata e Familjes në Tel Aviv vërejti se largimi i fëmijës nga Izraeli pa pëlqimin e babait ishte i gabuar brenda kuptimit të nenit 3 të Konventës së Hagës. Në vendimin e gushtit të vitit 2006, kërkesa e babait për kthimin e djalit të tij në Izrael u hodh poshtë nga Drejtësia e Qarkut në Lozanë me arsyetimin se kishte rrezik të madh që kthimi i fëmijës në Izrael do ta ekspozonte atë ndaj dëmtimeve fizike ose psikologjike ose do ta vendoste në situata të patolerueshme. Gjykata Kantonale hodhi poshtë apelin e babait, duke konfirmuar se ky përbënte përjashtim nga parimi i kthimit të shpejtë të fëmijës, në përputhje me nenin 13, nën-paragrafi (b), të Konventës së Hagës. Në gusht të vitit 2007, Gjykata Federale Zvicerane pranoi apelimin e babait, me arsyetimin se neni në fjalë ishte zbatuar gabimisht dhe urdhëroi kërkuesin e parë që ta kthente fëmijën në Izrael. Me urdhër të masës së përkohshme në qershor të vitit 2009, Gjykata e Qarkut në Lozanë vendosi që Noam të jetonte në adresën e nënës së tij në Lozanë, pezulloi të drejtën e aksesit të babait në lidhje me djalin e tij dhe i dha autoritetin prindëror nënës, në mënyrë që t'i mundësonte asaj të rinovojë dokumentet e identitetit të fëmijës. Aplikimi në GJEDNJ u depozitua më 26 shtator 2007. Në vendimin gjyqësor të 8 janarit 2009, Dhoma konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8. Në shkurt të vitit 2009, kërkuesit paraqitën në Gjykatë certifikatën e mjekut, i cili e kishte ekzaminuar Noam në vitin 2005 dhe disa herë të tjera më pas e kishte dalë në rezultatin se "kthimi i papritur në Izrael pa nënën e tij do të përbënte traumë të madhe dhe shqetësim serioz psikologjik për këtë fëmijë". Më 5 qershor të vitit 2009 rasti iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesve.

Gjykata (Dhoma e Madhe) konstatoi se Zvicra do të shkelte të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës private dhe familjare, pra Nenin 8 të KEDNJ-së, nëse urdhri për kthim do të zbatohej.

Së pari, Gjykata vëren se mundësia e vazhdimësisë së jetesës së bashku është konsideratë themelore që bie në mënyrë të qartë brenda kuadrit të jetës së tyre familjare brenda kuptimit të Nenit 8 të KEDNJ-së. Po ashtu, që urdhri i Gjykatës Federale për kthimin përbënte «ndërhyrje» brenda kuptimit të nenit 8 të KEDNJ-së nuk ishte pikë në të cilën nuk binin dakord.

Duke iu kthyer arsyetimit, nëse urdhri i kthimit ishte «në përputhje me ligjin», shërbente për arritjen e një ose më shumë qëllimeve legjitime

dhe ishte «i nevojshëm në një shoqëri demokratike" për përmbushjen e këtyre qëllimeve, Gjykata së pari vëren baza ligjore e urdhrit është neni 12 i Konventës së Hagës. Së dyti, Gjykata ndan mendimin e Dhomës me vendimin e Gjykatës Federale për kthimin e fëmijës që zbatonte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të Noamit dhe babait të tij.

Sa i përket aspektit vendimtar, nëse urdhri ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike, Gjykata konstaton se zbatimi i urdhrit të kthimit do të ishte joproporcional. Nuk do të ishte në interesin më të mirë të fëmijës që ai të kthehej. Sa i përket nënës, ajo do të pësonte ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e saj të dhënë nga neni 8 i KEDNJ-së.

Sa u përket parimeve të përgjithshme të nenit 8 të KEDNJ-së, Gjykata deklaron se në rastin e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, detyrimet sipas nenit 8 duhet të interpretohen edhe duke marrë parasysh veçanërisht Konventën e Hagës. Prandaj, Neni 8 i KEDNJ-së parashikon:

> *se [duhet] të mbahet parasysh një "ekuilibër i drejtë mes interesave konkurrues në rrezik - ato të fëmijës, të dy prindërve dhe të rendit publik - brenda kufirit të vlerësimit që u është dhënë Shteteve në çështje të tilla […], duke pasur parasysh se interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë përparësore, ashtu siç është vërtet e dukshme nga Parathënia e Konventës së Hagës, e cila parashikon se "interesat e fëmijëve janë të një rëndësie parësore në çështjet që lidhen me kujdestarinë e tyre". Interesat më të mira të fëmijës, në varësi të natyrës dhe rëndësisë së tyre, mund të tejkalojnë interesat e prindërve. Interesat e prindërve, veçanërisht sa i përket mbajtjes së kontaktit të rregullt me fëmijën e tyre, mbeten faktor kur balancohen interesat e ndryshme në rrezik. […]*
>
> *Interesi i fëmijës përfshin dy degë. Nga njëra anë, ai dikton që lidhjet e fëmijës me familjen e tij duhet të ruhen, përveç rasteve kur familja ka rezultuar veçanërisht e papërshtatshme. Nga kjo rrjedh se lidhjet familjare mund të ndërpriten vetëm në rrethana shumë të jashtëzakonshme dhe se gjithçka duhet bërë për të ruajtur marrëdhëniet personale dhe, nëse dhe kur është e përshtatshme, për të "rindërtuar" familjen. Nga ana tjetër, është gjithashtu në interesin e fëmijës të sigurojë zhvillimin e tij në një mjedis të shëndoshë dhe një prind nuk mund të ketë të drejtë, sipas nenit 8, të marrë masa që do të dëmtonin shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës. E njëjta filozofi ndiqet natyrshëm edhe në Konventën e Hagës […]*
>
> *Interesat më të mirë të fëmijës, për nga perspektiva e zhvillimit personal, do të varen nga një sërë rrethanash individuale, në veçanti mosha dhe niveli i pjekurisë së tij, prania ose mungesa e prindërve të tij dhe mjedisi dhe përvojat e tij. […] Për këtë arsye, interesat më të mira duhet të vlerësohen në çfarëdolloj rasti individual. Kjo detyrë u takon kryesisht autoriteteve vendase, të cilat shpesh përfitojnë nga kontakti i drejtpërdrejtë me personat në fjalë. Për këtë qëllim, ata gëzojnë një marzh të caktuar vlerësimi, i cili, i nënshtrohet një mbikëqyrjeje evropiane, sipas së cilës Gjykata shqyrton në përputhje me Konventën vendimet që autoritetet kanë marrë në ushtrimin e kësaj kompetence.".*

Sa i përket arsyetimit të çështjes në fjalë, Gjykata merr parasysh se kërkuesi i dytë, fëmija, ka nënshtetësi zvicerane, ka mbërritur në këtë vend në moshën dy vjeç dhe që atëherë jeton atje vazhdimisht, është rregulluar mirë, aktualisht ndjek shkollën në Zvicër, flet frëngjisht dhe shpërngulja nga mjedisi i tij i zakonshëm ndoshta do të kishte pasoja serioze për të siç tregohet në raportet mjekësore edhe pse ai është në një moshë ku ka ende kapacitete të caktuara për përshtatje. Rrjedhimisht, rikthimi i tij në Izrael nuk konsiderohet si i dobishëm. Prandaj, kjo do të duhej të peshohej kundrejt çdo përfitimi që ai mund të përfitonte prej tij. Në lidhje me këtë, Gjykata i kushton vëmendje të veçantë situatës së babait, të cilin e konsideron si situatë të lëkundur jetësore, jo të besueshme sa u përket marrëdhënieve, si dhe u nënshtrohet kufizimeve që në fakt pengojnë vështrimin e kërkuesit të dytë. Sa u përket problemeve që kthimi i nënës do të sillte për të, ajo mund të ishte e ekspozuar ndaj rrezikut të sanksioneve penale. Në rastin kur aftësia e babait për përkujdesjen e fëmijës u vu në dyshim nga Gjykata, atëherë do të lindje problemi se kush do të kujdesej për fëmijën.

***Kaushal & të Tjerë k. Bullgarisë* – nr. 1537/08, datë 02/09/2010**

Vendimi *Kaushal & të Tjerë k. Bullgarisë*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 2 shtator 2010, fokusohet në të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, Neni 8 i KEDNJ-së, e drejta për një mjet efektiv, Neni 13 i KEDNJ-së dhe garancitë për mbrojtje procedurale në procedurat e dëbimit, Neni 1 Protokolli Nr. 7.

Kërkuesit apeluan një vendim për dëbimin e kërkuesit të parë, një shtetas indian, bashkëshort dhe baba i dy fëmijëve. Kërkuesi i parë, i lindur në 1967, u vendos në Bullgari në 1990. Menjëherë pasi ai u takua me kërkuesen e dytë, të lindur në 1974. Vajza e tyre e parë dhe e dytë, kërkuesja e tretë dhe e katërt, lindën në 1994 dhe 1998. Në një datë të pacaktuar, kërkuesit të parë iu dha një leje qëndrimi e përhershme. Ai mësoi bullgarisht dhe hapi

biznesin e tij. Ai zotëronte një hotel dhe një restorant në Sofje në kohën e gjykimit nga GJEDNJ-a. Më 28 nëntor 2005, autoritetet, duke cituar një "kërcënim serioz për sigurinë kombëtare", urdhëruan dëbimin e kërkuesit të parë, si dhe heqjen e së drejtës së qëndrimit dhe përjashtimit nga territori bullgar për një periudhë dhjetëvjeçare. Asnjë arsye tjetër faktike nuk u dha. Urdhri ishte i zbatueshëm menjëherë. Në të njëjtën ditë, kërkuesi i parë u arrestua dhe më 1 dhjetor 2005, u deportua në Indi. Ai u vendos në Greqi, ku familja e tij e vizitonte herë pas here. Ndërsa ishte jashtë vendit, kërkuesi paraqiti një kërkesë të pasuksesshme në Gjykatën e Qytetit të Sofjes. Në proces gjykata pranoi si provë propozimin e klasifikuar të përmendur në urdhrin e deportimit që po kundërshtohej. Propozimi me sa duket paraqiste të dhëna se kërkuesi i parë dyshohej për lidhje me grupet ekstremiste dhe trafikim të qenieve njerëzore. Ishte e paqartë nëse avokatit të tij iu dha një mundësi për t'u njohur me dokumentin. Gjykata vlerësoi se faktet e dhëna në propozimin e cituar ishin të mjaftueshme, të mbledhura në mënyrë të ligjshme dhe nga autoritetet kompetente. Ajo nuk ndërmori hetime të mëtejshme mbi faktet. Pas apelit të tij, Gjykata Supreme Administrative në qershor 2007 la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët. Ajo vërejti se të dhënat në lidhje me veprimtarinë e paligjshme të pretenduar të kërkuesit të parë ishin mbledhur në përputhje me ligjin dhe se urdhri i kundërshtimit të dëbimit ishte "*i lidhur në mënyrë të arsyeshme me faktet e përcaktuara në propozim*". Ajo vendosi se "*barra për të hedhur poshtë këto fakte i takonte [Z. Kaushal], i cili nuk ka paraqitur prova në mbështetje të argumenteve të tij*". Masat kundër tij ishin bazuar në bazën e sigurisë kombëtare, e cila kërkonte "kufizime të caktuara të mundësive për të mbrojtur veten".

Gjykata vërejti se Bullgaria kishte shkelur të drejtat e kërkuesve për respektimin e jetës private dhe familjare, Nenin 8 të KEDNJ-së dhe për një mjet efektiv, Nenin 13 të KEDNJ-së si dhe garancitë procedurale të kërkuesit të parë të parashikuar për nga Neni 1 Protokolli Nr. 7.

Sa i përket Nenit 8 të KEDNJ-së, Gjykata së pari vëren se vendimet, i dëbimit dhe vendimet për lënien në fuqi të tij janë brenda fushës së vet të veprimit, pasi ankuesi kishte banuar ligjërisht në Bullgari dhe ishte në gjendje të shihte familjen e tij vetëm herë pas here pas dëbimit. Duke iu kthyer arsyetimit të kësaj ndërhyrjeje, Gjykata, duke iu referuar praktikës së saj të mëparshme (*shiko përmbledhjen e çështjes shumë të ngjashme C.G. k. Bullgarisë dhe Lupsa k. Rumanisë*), vuri në dukje se, edhe atje ku siguria kombëtare ishte në rrezik, masat e dëbimit duhet t'i nënshtrohen një forme të procesit gjyqësor kundërshtues para një autoriteti ose gjykate të pavarur, e cila të jetë kompetente për të shqyrtuar në mënyrë efektive arsyet për këto masa dhe për të shqyrtuar provat përkatëse, nëse është e nevojshme me

kufizimet e duhura në përdorimin e informacionit të klasifikuar. Lidhur me rastin në fjalë, Gjykata vëren se ndërhyrja në të drejtat e kërkuesve nuk ishte "në përputhje me ligjin" (Neni 8 § 2 i KEDNJ-së) pasi,

> *"pavarësisht se ishte në gjendje të kërkonte rishikim gjyqësor të urdhrit të dëbimit kundër tij, [kërkuesi i parë] nuk kishte gëzuar shkallën minimale të mbrojtjes kundër arbitraritetit.*
>
> *Gjykata arriti në atë përfundim për dy arsye kryesore. Së pari, gjykatat kombëtare e kishin lejuar ekzekutivin të shtrinte kuptimin e sigurisë kombëtare përtej kuptimit të tij natyror, pasi dëbimi i C.G. ishte justifikuar në bazë të përfshirjes së tij të pretenduar në trafikimin e paligjshëm të narkotikëve. Së dyti, gjykatat nuk kishin shqyrtuar nëse ekzekutivi kishte qenë në gjendje të provonte ekzistencën e fakteve të caktuara që shërbenin si bazë për vlerësimet e tyre se z. C.G. kishin paraqitur një rrezik për sigurinë kombëtare, ndërkohë që në vend të këtyre i kishin mbështetur vendimet e tyre vetëm mbi shprehjet e pavërtetuara të Ministrisë së Brendshme. [...]*
>
> *Ndryshe nga rasti i C.G. dhe të Tjerë, [...] Gjykata është gati të pranojë [...] të paktën një nga veprimtaritë e pretenduara ndaj z. Kaushal, përkatësisht pjesëmarrja në grupe ekstremiste, mund të përbëjë një kërcënim të vërtetë për sigurinë kombëtare. [...] Megjithatë, [...] Gjykata konsideron se kërkuesve nuk iu ishte ofruar [...] mbrojtje nga arbitrariteti [...]. Ajo e konsideron veçanërisht të papranueshëm faktin që vendimi për dëbimin e zotit Kaushal nuk përmend bazat faktike mbi të cilat u mor. Ai thjesht iu referua dispozitave ligjore në fuqi dhe deklaroi se prania e tij në Bullgari përfaqësonte një "kërcënim serioz për sigurinë kombëtare" [...]. Në mungesë edhe të parashtrimit të përgjithshëm të fakteve që kishin shërbyer si bazë për këtë vlerësim, kërkuesi i parë nuk ishte në gjendje ta paraqiste çështjen e tij në mënyrë përshtatshme në proceset e rishikimit të vendimit gjyqësor që pasuan. 31. Për më tepër, pasi z. Kaushal i filloi këto procedura gjyqësore, gjykatat pranuan se ai ishte përfshirë në veprimtari të paligjshme, duke iu referuar propozimit të Ministrisë së Brendshme dhe duke dështuar në kryerjen e ndonjë hetimi të mëtejshëm mbi faktet. Gjykata e Qytetit të Sofjes thjesht vuri në dukje se të dhënat mbi veprimtaritë e pretenduara të paligjshme të zotit Kaushal ishin mbledhur në përputhje me ligjin dhe "brenda kompetencave të Shërbimit të Sigurisë Kombëtare të Ministrisë së Brendshme" (shih paragrafin 11 më lart). Gjykata e Lartë Administrative vuri në dukje se urdhri për dëbimin e zotit Kaushal ishte "i lidhur në mënyrë të arsyeshme" me faktet e përcaktuara në propozimin*

e Ministrisë së Brendshme, por nuk arriti të shtjellonte bazën provuese të këtij propozimi, dhe deklaroi, në vend të kësaj, se barra për të hedhur poshtë pretendimet e Ministrisë ishte mbi z. Kaushal dhe se ai nuk i kishte hedhur poshtë ato në mënyrë të kënaqshme (shih paragrafin 14 më lart). Kështu, në mënyrë të ngjashme me rastin e C.G. dhe të Tjerë, gjykatat vendase nuk arritën të shqyrtojnë një aspekt kritik të çështjes, përkatësisht nëse ekzekutivi ishte në gjendje të provonte ekzistencën e fakteve të caktuara që shërbenin si bazë për vlerësimin e tyre se z. Kaushal kishte paraqitur një rrezik për sigurinë kombëtare.".

Për sa i përket Nenit 13 të KEDNJ-së dhe Nenit 1 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se ajo është shkelur kryesisht me të njëjtin arsyetim sa i përket shkeljes së Nenit 8 të KEDNJ -së. Sa i përket Nenit 13 të KEDNJ-së, ajo vëren se *"proceset gjyqësore nuk përfaqësonin një mjet juridik me të cilin kërkuesit mund të kërkonin në mënyrë të përshtatshme të drejtën[at] e tyre". "Gjykata e Lartë Administrative nuk arriti të marrë parasysh rrethanat shumë të rëndësishme, siç është fakti që kërkuesit e dytë, të tretë dhe të katërt kishin lindur në Bullgari dhe me sa duket kishin jetuar atje gjatë gjithë jetës së tyre, [lidhjet shoqërore dhe ekonomike të kërkuesit të parë që kishte punë, fliste bullgarisht, etj.]. Gjykata ka deklaruar vazhdimisht se faktorë të tillë si këta duheshin marrë parasysh [...] Qasja e Gjykatës së Lartë Administrative nuk ishte në përputhje me këto kërkesa dhe Gjykata e Qytetit të Sofjes dështoi plotësisht të shqyrtonte proporcionalitetin e masave [...]."*

Neni 10

Meltex Shpk dhe Mesrop Movsesyan k. Armenisë - nr. 32283/04, datë 17/06/2008

Vendimi i çështjes *Meltex Shpk dhe Mesrop Movsesyan k. Armenisë* i shpallur nga gjykata më 17 qershor 2008 fokusohet në parimin e diskrecionit të ndërhyrjes së autoriteteve publike sipas nenit 10 të Konventës.

Kompanisë kërkuese, një kompani e pavarur televizive (A1+), iu pezullua licenca nga autoritetet për shkak të refuzimit të transmetimit vetëm të materialit pro-qeveritar në prag të zgjedhjeve presidenciale të 1995. Në janar 1997, kompanisë kërkuese iu dha një licencë transmetimi pesëvjeçare dhe A1+ u rihap brenda kësaj strukture. Në tetor 2000, qeveria nxori një legjislacion të ri (Akti i Transmetimit të Televizionit dhe Radios) duke

krijuar Komisionin Kombëtar të Televizionit dhe Radios (KKTR), një organ publik i përbërë nga nëntë anëtarë të emëruar nga Presidenti i Armenisë, të cilit iu besua licencimi dhe monitorimi i kompanive private televizive dhe radiofonike. Ligji prezantoi gjithashtu një procedurë të re licencimi, ku licencat e transmetimit jepeshin nga KKRT-ja në bazë të thirrjeve për tender. Në shkurt 2002, KKTR shpalli thirrje për tender për frekuenca të ndryshme transmetimi, duke përfshirë brezin në të cilin operonte kërkuesi. Në një seancë publike në prill 2002, ajo ia dha tenderin një kompanie tjetër, pa dhënë arsye. Kompania kërkuese më pas bëri oferta për shtatë grupe të tjera, por nuk pati sukses në çdo rast. Edhe pse ajo i kundërshtoi vendimet në gjykata, kërkesat e saj u hodhën poshtë me arsyetimin se procedura e tenderit ishte kryer në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Refuzimi i KKRT-së për t'i dhënë kompanisë aplikuese një licencë transmetimi, në fakt përbën një ndërhyrje në lirinë e saj për të dhënë informacion dhe ide. Edhe pse Akti i Transmetimit përcaktoi kriteret mbi të cilat KKRT-ja do të bënte zgjedhjen e saj, ai nuk kërkonte në mënyrë eksplicite që ajo të jepte arsye, kështu që përderisa KKRT-ja kishte mbajtur seanca publike, ajo nuk i kishte shpallur arsyet e vendimeve të saj. Rrjedhimisht, as kompania kërkuese dhe as publiku nuk ishin në dijeni të bazës mbi të cilën KKRT-ja kishte ushtruar diskrecionin e saj për të refuzuar një licencë. Gjykata vuri në dukje se udhëzimet e Komitetit të Ministrave për rregulloret e transmetimit kërkuan zbatim të hapur dhe transparent të rregulloreve që rregullojnë procedurat e licencimit dhe rekomandoi në mënyrë specifike që të gjitha vendimet e marra nga autoritetet rregullatore duhet të arsyetohen siç duhet. Po kështu, në një Rezolutë të datës 27 janar 2004, Asambleja Parlamentare kishte arritur në përfundimin se KKRT-së i ishin dhënë në mënyrë efektive kompetenca të drejtpërdrejta diskrecionale si rezultat i "paqartësisë së ligjit". Sipas mendimit të Gjykatës, një procedurë e cila nuk kërkonte që autoriteti licencues të jepte arsyet për vendimet e tij, nuk ofronte mbrojtjen e duhur kundër ndërhyrjeve arbitrare nga një autoritet publik. Prandaj, ndërhyrja nuk përmbushi kërkesat e Konventës për ligjshmërinë.

Në vlerësimin e gjykatës, [...] 80. Hapi i parë është për të përcaktuar nëse mohimi i licencës së transmetimit është "parashikuar me ligj", në kuptim të nenit 10. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur, kjo shprehje, e cila përdoret gjithashtu në nenet 9 dhe 11 të Konventës, dhe shprehja "në përputhje me ligjin", e përdorur në nenin 8 të Konventës, jo vetëm që kërkojnë që një ndërhyrje në të drejtat e parashikuara në këto nene duhet të ketë një bazë në të drejtën e brendshme, por edhe t'i referohet cilësisë së ligjit në fjalë. Ai ligj duhet të jetë i aksesueshëm për personat e interesuar dhe i formuluar me

saktësi të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre – nëse është e nevojshme, me këshillat e duhura – të parashikojnë, në një shkallë që është e arsyeshme për rrethanat, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (*shih, mes shumë autoriteteve të tjera, Maestri kundër Italisë [GC], nr.39748 / 98 , § 30, GJEDNJ 2004-I*).

81. Për më tepër, ligji i brendshëm duhet të ofrojë një masë mbrojtjeje ligjore kundër ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve publike në të drejtat e garantuara nga Konventa. Në çështjet që prekin të drejtat themelore, do të ishte në kundërshtim me shtetin e së drejtës, një nga parimet bazë të një shoqërie demokratike të sanksionuar në Konventë, që një diskrecion ligjor që i jepet ekzekutivit të shprehet në terma të një pushteti të pakufizuar. Për rrjedhojë, ligji duhet të tregojë shtrirjen e çdo diskrecioni të tillë që u jepet autoriteteve kompetente dhe mënyrën e ushtrimit të tij me qartësi të mjaftueshme, duke pasur parasysh qëllimin legjitim të masës në fjalë, për t'i dhënë individit mbrojtjen e duhur kundër ndërhyrjeve arbitrare (shih, Rotaru k. Rumanisë [GC], nr. 28341/95 , § ... , GJEDNJ 2000 - V, dhe Hasan dhe Chaush k. Bullgarisë [GC], nr. 30985/96 , § 84, GJEDNJ 2000-XI). Për sa u përket procedurave të licencimit në veçanti, Gjykata rithekson se mënyra në të cilën zbatohen kriteret e licencimit në procesin e licencimit duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit, duke përfshirë arsyetimin e duhur nga autoriteti licencues të vendimeve të tij që mohojnë një licencë transmetimi (shih, Glas Nadezhda EOOD dhe Anatoliy Elenkov k. Bullgarisë, cituar më lart, §§ 49-51).

Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) k. Zvicrës **(nr. 2) [DhM] - nr. 32772/02, datë 30/6/2009**

Vendimi i çështjes *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) k. Zvicrës* (nr. 2) i shpallur nga Dhoma e Madhe e gjykatës më 30 qershor 2009 fokusohet [ndër të tjera] në përmbushjen e detyrimeve të shteteve sipas nenit 10 të Konventës.

Kërkuesi është një shoqatë për mbrojtjen e kafshëve. Në një vendim të 28 qershorit 2001 mbi një kërkesë të mëparshme (24699/94), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi shkelje të nenit 10 për shkak të refuzimit të autoriteteve zvicerane për të lejuar një reklamë televizive që shpreh kundërshtimin për transmetimin e saj. Në mbështetje të vendimit të Gjykatës, shoqata kërkuese aplikoi në Gjykatën Federale të Zvicrës për një

urdhër që rishikonte vendimin e saj që ndalonte transmetimin e reklamës. Në vitin 2002 Gjykata Federale e refuzoi kërkesën me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte dhënë një shpjegim të mjaftueshëm të natyrës së "ndryshimit të aktgjykimit dhe dëmshpërblimit që po kërkohej" ose nuk kishte treguar mjaftueshëm se kishte ende një interes për të transmetuar reklamën në versionin e saj origjinal të tetë viteve më parë. Më pas, shoqata depozitoi kërkesën aktuale në Gjykatë për të kundërshtuar atë vendim. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, nuk ishte i informuar për këto zhvillime. Në vitin 2003, pa dijeni për vendimin e Gjykatës Federale në vitin 2002, ajo përfundoi shqyrtimin e saj të kërkesës fillestare të shoqatës pasi vuri në dukje se shoqata kishte të drejtë të kërkonte rishikimin e vendimit fillestar të Gjykatës Federale që ndalon reklamën. Ndërkohë, shoqata iu drejtua sërish autoriteteve zvicerane për leje për të transmetuar reklamën me një koment shtesë. Kjo kërkesë e re u refuzua. Ankesa kundër këtij vendimi u hodh poshtë nga Zyra Federale e Komunikimit në 2003. Në një vendim të Dhomës së datës 4 tetor 2007, Gjykata Evropiane vendosi, me pesë vota pro dhe dy kundër, se kishte pasur shkelje të nenit 10.

Gjykata arsyetoi se rihapja e procedurave në nivel të brendshëm nuk ishte një qëllim në vetvete, por një mjet kyç që mund të përdoret për ekzekutimin e plotë dhe të duhur të vendimeve të Gjykatës. Megjithatë, procedura e rihapjes duhej t'u jepte gjithashtu autoriteteve të shtetit të paditur mundësinë për t'iu bindur përfundimeve dhe frymës së vendimit të Gjykatës që po ekzekutohej, duke respektuar masat mbrojtëse procedurale të Konventës. Duke pasur parasysh rëndësinë e ekzekutimit të vendimeve të saj në sistemin e Konventës dhe duke pasur parasysh ekuilibrin e drejtë që duhej të vendosej midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe interesave të individit, Gjykata duhej të përcaktonte nëse Shteti i paditur kishte një detyrim pozitiv për të marrë masat e nevojshme që të lejojë transmetimin e reklamës televizive në fjalë pas konstatimit të Gjykatës për shkelje të nenit 10.

Reklama në fjalë lidhej me shëndetin e konsumatorit, mbrojtjen e kafshëve dhe mjedisit si dhe ishte në interes të publikut. Interesi në shpërndarjen e një botimi nuk ulet domosdoshmërisht me kalimin e kohës. Gjykata ra dakord me Dhomën se qasja e Gjykatës Federale kishte qenë tepër formaliste dhe se vetëm shoqata ankuese kishte qenë kompetente në atë fazë për të gjykuar nëse kishte ende ndonjë qëllim në transmetimin e reklamës. Për më tepër, Gjykata Federale nuk kishte ofruar shpjegimin e saj se si debati publik mbi prodhimin e baterive kishte ndryshuar ose ishte bërë më pak aktual që nga viti 1994, kur reklama ishte menduar të transmetohej. As nuk

kishte treguar se pas vendimit të Gjykatës të vitit 2001 rrethanat kishin ndryshuar në atë masë sa të vinin dyshime mbi vlefshmërinë e arsyeve mbi të cilat Gjykata kishte gjetur shkelje të nenit 10. Gjykata gjithashtu hodhi poshtë argumentin se Shoqata kishte opsione alternative për transmetimin e reklamës në fjalë, për shembull nëpërmjet kanaleve private dhe rajonale, pasi kjo do t'u kërkonte palëve të treta, ose vetë shoqatës, të merrnin një përgjegjësi që u binte vetëm autoriteteve kombëtare: atë të ndërmarrjes së veprimeve të duhura. Parimi që vendos një detyrë për Shtetet Kontraktuese për të organizuar sistemet e tyre gjyqësore në një mënyrë të tillë që të mund të plotësonte kërkesat e Konventës që zbatohej edhe për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës. Rrjedhimisht, ishte e parëndësishme të argumentohej, siç kishte bërë Qeveria, se Gjykata Federale në asnjë rast nuk mund të kishin urdhëruar transmetimin e reklamës dhe se shoqata ankuese duhej të kishte nisur një proces civil. Me pak fjalë, autoritetet zvicerane nuk kishin përmbushur detyrimin e tyre pozitiv sipas nenit 10 të Konventës.

85. Për sa u përket kërkesave të nenit 46, duhet së pari të theksohet se një Shtet i gjetur në shkelje të Konventës ose Protokolleve të saj është nën detyrimin që t'u përmbahet vendimeve të gjykatës në çdo rast për të cilat është palë. Pra, një dështim i plotë ose i pjesshëm për të ekzekutuar një vendim të Gjykatës mund të angazhojë shtetin palë me përgjegjësi ndërkombëtare. Shteti Palë në fjalë do të jetë i detyruar jo vetëm të paguajë ndaj të interesuarve shumat e dhëna si kompensim i drejtë, por gjithashtu të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e brendshëm ligjor për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar efektet, me qëllim që kërkuesi, sa më shumë që të jetë e mundur, të vendoset në pozicionin në të cilin do të kishte qenë nëse do të ishin zbatuar kërkesat e Konventës (shih, mes shumë Scozzari dhe Giunta k. Italisë [GC], nr. 39221/98 dhe *98/41963, § 249, dhe Assanidze k. Gjeorgjisë [GC], nr. 71503/01, § 198).*

86. Këto detyrime pasqyrojnë parimet e së drejtës ndërkombëtare sipas të cilave një shtet përgjegjës për një veprim të padrejtë është i detyruar të bëjë kthimin, që konsiston në rivendosjen e situatës që ekzistonte përpara kryerjes së aktit të padrejtë, me kusht që kthimi të mos jetë "materialisht i pamundur" dhe "të mos përfshijë një barrë jashtë çdo proporcioni me përfitimin që rrjedh nga kthimi në vend të kompensimit" (neni 35 i projekt -neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare për Përgjegjësinë e Shteteve – shih paragrafin 36 më lart). Me fjalë të tjera, ndërsa kthimi është rregull, mund të ketë rrethana në të cilat shteti përgjegjës është liruar - plotësisht ose pjesërisht - nga detyrimi, me kusht që të mund të tregojë se rrethanat janë shfajësuese.

Neni 11

***Cudak k. Lituanisë* - nr. 15869/02, datë 23/03/2010**

Vendimi i çështjes *Cudak k. Lituanisë*, i shpallur nga gjykata më 23 mars 2010 fokusohet [ndër të tjera] në çështjen e imunitetit juridiksional në përputhje me nenin 11 të Konventës së Kombeve të Bashkuara.

Kërkuesja, shtetase lituaneze, punonte si sekretare dhe operatore tregtare në Ambasadën Polake në Vilnius. Në vitin 1999 ajo iu ankua Avokatit për Shanse të Barabarta për ngacmim seksual nga një koleg mashkull. Edhe pse ankesa e saj u miratua, Ambasada e shkarkoi atë me arsyetimin e mungesës së paautorizuar nga puna. Gjykatat lituaneze refuzuan juridiksionin për të provuar shkarkim të padrejtë të kërkueses pas gjetjes se punëdhënësi i saj gëzonte imunitet shtetëror nga juridiksioni i vendit. Gjykata e Lartë Lituaneze konstatoi se kërkuesja kishte ushtruar funksione publike gjatë punës së saj në Ambasadë dhe se nga titulli i saj i punës ishte e dukshme se detyrat e saj kishin lehtësuar ushtrimin nga Polonia të funksioneve të saj sovrane, duke justifikuar kështu zbatimin e rregullit të imunitetit të shtetit.

Gjykata arriti në përfundimin se gjykatat lituaneze kishin dështuar të ruanin një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit, kishin tejkaluar marzhin e tyre të vlerësimit dhe në këtë mënyrë është dëmtuar thelbi i të drejtës së kërkueses për qasje në gjykatë.

66. [...] "*Parimet e vendosura në Konventën e Kombeve të Bashkuara, në datë 02.12.2004 duhen konsideruar si parime të gjithëpranuara ndërkombëtare... Edhe në kushtet ku një shtet nuk e ka ratifikuar atë, duhet të konsiderohet i lidhur nga parashikimet e kësaj konvente, për sa kohë ato reflektojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare...*".

***Navalnyy k. Rusisë* - nr. 29580/12, 36847/12, 11252/13, 12317/13 dhe 43746/14, datë 15/11/2018**

Vendimi i çështjes *Navalnyy k. Rusisë*, i shpallur nga gjykata (Dhoma e Madhe) më 15 nëntor 2018 fokusohet në parimin e diskrecionit të ndërhyrjes së autoriteteve publike sipas nenit 11 të Konventës.

Kërkuesi, një aktivist politik, lider i opozitës, aktivist kundër korrupsionit dhe bloger i njohur, ka kryer aplikime që kanë të bëjnë me arrestimet e tij në shtatë raste në ngjarje të ndryshme publike. Ai u ankua për shkelje të lirisë duke pretenduar se arrestimi, ndalimi dhe akuzat administrative të ngritura kundër tij kishin ndjekur qëllimin për të cenuar të drejtën e tij për lirinë e tubimit, për arsye politike. Së fundi, ai pretendoi se procedurat administrative para gjykatave vendase nuk kishin garanci për një gjykim të drejtë.

Dhoma e Madhe e Gjykatës, një lidhje me zbatueshmërinë e nenit 11 të Konventës dhe ekzistencën e një ndërhyrjeje, rithekson se *98. […] e drejta për lirinë e tubimit është një e drejtë themelore në një shoqëri demokratike dhe, si e drejta për lirinë e shprehjes, është një nga themelet e një shoqërie të tillë*. Kështu, ai nuk duhet të interpretohet në mënyrë kufizuese (*shih, Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë [GC], nr. 37553/05, § 91, GJEDNJ 2015, dhe Taranenko kundër Rusisë, nr. 19554/05, § 65, 15 maj 2014*). Për të shmangur rrezikun e një interpretimi kufizues, Gjykata është përmbajtur nga formulimi i nocionit të një organizimi, të cilin e konsideron si një koncept autonom, ose duke renditur në mënyrë shteruese kriteret që do ta përcaktonin atë. Ai ka specifikuar në rastet përkatëse se e drejta e lirisë së tubimit mbulonte si takimet private ashtu edhe takimet në vende publike, qofshin ato statike apo në formë procesioni; përveç kësaj, ajo mund të ushtrohet nga pjesëmarrësit individë dhe nga personat që organizojnë mbledhjen (*shih, Kudrevičius dhe të tjerët, cituar më lart, § 91, me referenca të mëtejshme, dhe Lashmankin dhe të tjerët, cituar më sipër, § 402*). Ajo gjithashtu ka theksuar se neni 11 i Konventës mbron vetëm të drejtën për "tubim paqësor", nocion i cili nuk përfshin tubimet ku organizatorët dhe pjesëmarrësit kanë qëllime të dhunshme. Prandaj, garancitë e nenit 11 zbatohen për të gjitha tubimet, përveç atyre ku organizatorët dhe pjesëmarrësit kanë synime të tilla, nxisin dhunë ose ndryshe refuzojnë themelet e një shoqërie demokratike (*shih, Kudrevičius dhe të tjerët, cituar më lart, § 92, me referenca të mëtejshme*).

99. Kështu, çështja nëse një tubim hyn në konceptin autonom të "tubimit paqësor" në paragrafin 1 të nenit 11 dhe fushëveprimi i mbrojtjes që ofron kjo dispozitë është i pavarur nga fakti nëse ai tubim është kryer në përputhje me një procedurë të parashikuar nga ligji i brendshëm. Vetëm pasi Gjykata të ketë arritur në përfundimin se një tubim bie në fushën e mbrojtjes, klasifikimi dhe rregullimi i tij sipas ligjit kombëtar kanë një ndikim në vlerësimin e Gjykatës. Këta elementë janë të rëndësishëm për çështjen që pason për detyrimet negative të shtetit, përkatësisht nëse një kufizim i lirisë së mbrojtur justifikohet sipas paragrafit 2, si dhe për një vlerësim të detyrimeve pozitive të shtetit, d.m.th. nëse ky i fundit ka vendosur një ekuilibër të drejtë midis interesave konkurruese në lojë.

Në vlerësimin e njërit prej episodeve të ndalimit parag. 113 i vendimit, gjykata vlerëson se "Ankuesi u arrestua në një demonstratë spontane të palëvizshme me rreth 150 persona, të mbajtur në përgjigje të gjykimit në çështjen "Bolotnaya" të shpallur më parë atë ditë. Kërkuesi nuk e ka mohuar synimin e tij për të marrë pjesë në këtë tubim (shih, paragrafin 37 më lart). Gjykata nuk ka asnjë dyshim se kjo ngjarje përbënte një organizim sipas kuptimit të nenit 11, dhe konsideron se sjellja e ankuesit binte në kuadrin e kësaj dispozite. Prandaj, shpërndarja e tubimit dhe arrestimi i kërkuesit, transferimi në një komisariat, ndalimi dhe sanksionet administrative përbënin një ndërhyrje në të drejtën e tij për tubim paqësor sipas nenit 11 § 2 të Konventës".

Neni 14

Van Raalte k. Holandës – nr. 20062/92, datë 21/02/1997

Vendimi i *Van Raalte kundër Holandës*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 21 shkurt 2021, fokusohet tek parimi i mosdiskriminimit, i parashikuar në Nenin 14 të KEDNJ-së. Ai lidhet gjithashtu me mbrojtjen e pronës, të parashikuar në Nenin 1, Protokolli Nr. 1 i KEDNJ-së.

Kërkuesi është shtetas holandez, i lindur në vitin 1924 dhe banues në Amstelveen. Ai nuk ka qenë kurrë i martuar dhe nuk ka fëmijë. Në shtator të vitit 1987, Inspektori i Tatimeve Direkte i dërgoi kërkuesit një vlerësim të kontributeve të tij për vitin 1985 sipas skemave të ndryshme të sigurimeve shoqërore, përfshirë Aktin e Përgjithshëm të Përfitimeve të Kujdesit për Fëmijët. Kërkuesi paraqiti kundërshtim ndaj këtij vlerësimi, në tetor të vitit 1987, pasi ishte i mendimit se ky përjashtim duhet të shtrihet tek burrat në të njëjtën situatë si gratë pa fëmijë të pamartuara të moshës 45 vjeç e lart, të cilët ishin përjashtuar nga kontributet. Ai mori vlerësime të ngjashme në vitet vijuese 1986 deri në 1988, kundër të cilave ai gjithmonë paraqiste kundërshtime. Në nëntor 1987, inspektori nxori një vendim duke e shpallur kundërshtimin e parë të pabazuar me arsyetimin se "sipas legjislacionit kombëtar, zbatimi i nenit 25 (2) të Ligjit të Përfitimeve të Përgjithshme të Kujdesit për Fëmijët nuk është i mundur pasi personi nga i cili duhet të paguhen kontributet nuk është femër". Kërkuesi apeloi në Gjykatën e Apelit

në Amsterdam në dhjetor të vitit 1987. Përjashtimi që gëzojnë gratë pa fëmijë të pamartuara të moshës 45 vjeç e lart, nga detyrimi për të paguar kontribute sipas Aktit të Përgjithshëm të Përfitimeve të Kujdesit për Fëmijët, u hoq me Aktin e Parlamentit Holandez të 21 dhjetorit 1988, në fuqi nga 1 janari i vitit 1989. Gjykata e Apelit në Amsterdam hodhi poshtë apelimin e kërkuesit dhe konfirmoi vendimin e inspektorit në tetor 1989, me arsyetimin se nuk kishte pasur diskriminim nga ligji në fuqi. Kërkuesi apeloi në Gjykatën Supreme në dhjetor 1989, e cila hodhi poshtë apelin e tij në dhjetor 1991. Pas marrjes së këtij vendimi gjyqësor, inspektori nxori vendime duke hedhur poshtë kundërshtimet e kërkuesit ndaj vlerësimeve për vitet 1986, 1987 dhe 1988.

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së [linku me tekstin].

Gjykata konstaton se Neni 14 i KEDNJ-së është i zbatueshëm në rastin aktual. Neni 14 i KEDNJ-së plotësoi dispozitat e tjera thelbësore të Konventës dhe Protokolleve. Ai nuk kishte ekzistencë të pavarur pasi kishte efekt vetëm në lidhje me "gëzimin e të drejtave dhe lirive" të mbrojtura nga ato dispozita. Sipas Gjykatës, e drejta në fjalë, pra, e drejta e Shtetit për të "siguruar pagesën e taksave ose kontributeve të tjera" vjen brenda objektit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Sa i përket nenit 14 të KEDNJ-së, Gjykata përcakton parashkrimet e saj si më poshtë:

> *"Për qëllime të nenit 14 (neni 14), trajtimi i ndryshëm është diskriminues nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra nëse nuk ndjek qëllimin legjitim ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti mes mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohet të realizohet. Për më tepër, Shtetet Kontraktuese kanë një marzh vlerësimi kur vlerësojnë nëse dhe deri në çfarë mase dallimet në situata të tjera të ngjashme justifikojnë trajtimin e ndryshëm […] Megjithatë, arsye shumë të rëndësishme do të duhej të parashtroheshin para se Gjykata të mund të konsideronte trajtimin e ndryshëm të bazuar ekskluzivisht te seksi si në përputhje me Konventën.".*

Gjykata konstaton se ka pasur ndryshime në trajtim, bazuar në gjininë, sepse në kohën kur u ankuan rastet, kontributet sipas Aktit të Përgjithshëm të Përfitimeve të Kujdesit për Fëmijët u morën nga burra të pamartuar pa fëmijë të moshës 45 vjeç e lart, por jo nga gra të pamartuara pa fëmijë të së njëjtës moshë.

Sidoqoftë, nuk pati asnjë justifikim të arsyeshëm për këtë përjashtim tatimor.

> *„Gjykata vëren se Akti i Përgjithshëm i Përfitimeve të Kujdesit për Fëmijën krijoi një skemë sigurimesh shoqërore, në të cilën, në parim, e gjithë popullsia e rritur ishte subjekt, si kontribues ashtu edhe si përfitues të mundshëm.*
>
> *Tipari kryesor i kësaj skeme ishte se detyrimi për të paguar kontributet nuk varej nga ndonjë e drejtë e mundshme për përfitime që mund të ketë individi (shih paragrafin 21 më lart). Prandaj, përjashtimi në rastin aktual ishte në kundërshtim me karakterin themelor të skemës.*
>
> *Ndërsa Shtetet Kontraktuese kanë marzhin e caktuar të vlerësimit sipas Konventës në lidhje me përjashtimet nga detyrime të tilla kontributive, Neni 14 (neni 14) kërkon që çdo masë e tillë, në parim, të zbatohet në mënyrë të barabartë si për burrat ashtu edhe për gratë, përveç nëse janë paraqitur arsye detyruese që justifikojnë ndryshimin në trajtim.*
>
> *Në rastin konkret, Gjykata nuk bindet se ekzistojnë arsye të tilla. Në këtë kontekst, duhet të mbahet parasysh se ashtu si gratë mbi 45 vjeç mund të lindin fëmijë (shih paragrafin 17 më lart), ka nga ana tjetër burra mbi 45 vjeç ose më të vegjël, të cilët mund të mos jenë në gjendje të riprodhojnë. Gjykata më tej vëren se një grua e pamartuar pa fëmijë 45 vjeç e lart mund të ketë të drejtë për përfitime sipas Aktit në fjalë; ajo, për shembull, mund të martohet me një burrë që tashmë ka fëmijë nga martesa e mëparshme.*
>
> *Për më tepër, argumenti që të vendosësh kontribute sipas skemës së përfitimeve të kujdesit për fëmijët nga gratë e pamartuara pa fëmijë do të impononte një barrë të padrejtë emocionale mbi to dhe mund të zbatohet njësoj si për burrat pa fëmijë të pamartuar ose për çiftet pa fëmijë.".*

Neni 41

Engel & të Tjerë k. Holandës – nr. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72, datë 23/11/1976

Vendimi *Engel dhe të Tjerë k. Holandës*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 23 nëntor 1976, fokusohet në të drejtën për kompensim të drejtë sipas KEDNJ-së, të mishëruar në Nenin 41 të KEDNJ-së, në veçanti përllogaritjen e rëndësisë së shkeljeve të Konventës.

Rasti ka të bëjë me plotësimin e kushtit për një shkelje konkrete të KEDNJ-së. Në vendimin kryesor të 8 qershorit 1976, Gjykata, ndërsa hodhi poshtë ankesat e tjera të kërkuesve të parë, vërejti se e gjithë periudha e arrestimit të përkohshëm të kërkuesit të parë nga 20 deri më 22 mars 1971 kishte shkelur Nenin 5 të KEDNJ-së pasi nuk gjendej asnjë justifikim për të tek nën-paragrafët e kësaj dispozite; se përveç kësaj kishte shkelur Nenin 5

të KEDNJ-së përderisa kishte tejkaluar periudhën prej njëzet e katër orësh të përcaktuar me Nenin 45 të Aktit të Disiplinës Ushtarake Holandeze të 27 prillit 1903; se kishte pasur një shkelje të kërkesave të Nenit 6 të KEDNJ-së në rastin e kërkuesve të tjerë, z. de Wit, z. Dona dhe z. Schul, për aq sa seancat para Gjykatës së Lartë Ushtarake Holandeze ishin zhvilluar me dyer të mbyllura. Gjykata e rezervoi çështjen e aplikimit të Nenit 41 të KEDNJ-së ashtu siç u ngrit për të katër kërkuesit. Në këtë drejtim, z. Engel, z. De Wit, z. Dona dhe z. Schul nuk pretenduan se ata kishin pësuar ndonjë dëm material, humbje të të ardhurave, shpenzime ligjore apo kosto të tjera nga arrestimet dhe proceset në ngarkim të tyre, por secili prej tyre pretendoi një shumë "thjesht simbolike" prej një mijë franga franceze (1,000 FF), mesa duket për dëm moral.

Gjykata vendosi se Holanda duhet t'i paguajë zotit Engel shumën (atëherë) prej njëqind gilden holandezë dhe se deklarimet në vendimin kryesor realizojnë një shpërblim të përshtatshëm për ankuesit e tjerë.

Për sa i përket çështjes së kërkuesit të parë, z. Engel, Gjykata vlerëson se ai pësoi dëm moral që rezulton në një kompensim të drejtë sipas Nenit 41 të KEDNJ-së. Faktorë të ndryshëm duhet të merren parasysh dhe të trajtohen gjatë përcaktimit të dëmshpërblimit:

> *Z. Engel ishte privuar nga liria në kushte në kundërshtim me Nenin 5 par. 1 (Neni 5-1) i Konventës dhe për më tepër i papajtueshëm, në masën nga njëzet e dy deri në tridhjetë orë […], me Nenin 45 të ligjit të lartpërmendur të 27 prillit 1903. Gjatë kësaj periudhe ai hasi me efektet e pakëndshme të regjimit të arrestimit në izolim. Kështu ai pësoi dëm moral.*
>
> *Në vlerësimin e këtij dëmi, Gjykata nuk mund të anashkalojë periudhën e shkurtër të paraburgimit të z. Engel. Për më tepër, ai ishte kompensuar në masë të konsiderueshme për dëmin. Në fakt, pasi u shpall fajtor për veprën disiplinore që kishte çuar në arrestimin e tij më 20 mars 1971, ai nuk duhej të vuante arrestin me izolim dyditor të dhënë pak më vonë për atë vepër […]. Më 5 prill 1971, arrestimi i tij i përkohshëm u caktua kundër këtij dënimi me një vendim të oficerit të ankesave, të cilin Gjykata e Lartë Ushtarake e konfirmoi më 23 qershor 1971 […]. Ndonëse kjo nuk përbën restitutio in integrum (kthim të plotë), është e rëndësishme në kuptimin e Nenit 50 (N. 50) […]".*

Në lidhje me kërkuesit e tjerë, Gjykata vëren se ata nuk kanë pësuar ndonjë dëm që do të kërkojë dëmshpërblim sipas Nenit 41 të KEDNJ-së. Sipas Gjykatës, e vetmja shkelje për të cilën ata ishin viktima do të lindte

nga fakti se Gjykata e Lartë Ushtarake e dëgjoi çështjen e tyre me dyer të mbyllura dhe tashmë ishte vënë në dukje në vendimin përfundimtar të 8 qershorit 1976 se ata "nuk duken se kanë vuajtur për atë akuzë".

> *"Që atëherë, këta tre kërkues nuk kanë paraqitur asnjë argument që mund ta lëkundte këtë përfundim të përkohshëm. Pa dyshim, avokati i tyre, në letrën e tij të datës 17 qershor 1976 (paragrafi 3 më lart), shpreh mendimin se "për sa i përket z. Schul dhe z. Dona … mund të bëhet një krahasim midis rezultatit [përkatës] të gjykimit disiplinor kundër tyre" dhe të proceseve gjyqësore penale të ndërmarra kundër ushtarakëve të tjerë për vepra të të njëjtit lloj, të cilat ai i përmendi në fjalimin e tij në Gjykatë më 28 tetor 1975. Ai pretendoi se procesi penal i zhvilluar me gjykim të hapur për publikun, rezultoi me vënien e vetëm e një gjobe midis njëqind dhe dyqind e pesëdhjetë gildesh, një dënim që ishte "shumë më i favorshëm" sesa dënimi i dhënë ndaj z. Dona dhe z. Schul në kuadrin e procesit disiplinor.*
>
> *Gjykata nuk mund ta pranojë këtë propozim. Ajo vendosi në vendimin e saj të 8 qershorit 1976 se Konventa nuk i detyronte autoritetet kompetente holandeze të ndiqnin penalisht z. Dona dhe z. Schul - ose z. de Wit - "sipas Kodit Penal Ushtarak përpara një gjykate ushtarake" (Seria A nr. 22, fq. 36, parag. 85). Për rrjedhojë, krahasimi i bërë nga avokati i kërkuesve nuk jep asnjë argument në lidhje me Nenin 50 (N. 50)".*

Neni 46

Karanović k. Bosnjës dhe Hercegovinës - nr. 39462/03, datë 20/11/2007

Vendimi i çështjes *Karanović k. Bosnjës dhe Hercegovinës*, i shpallur nga gjykata më 20 nëntor 2000 fokusohet në detyrimet e shtetit të paditur që në përputhje me kërkesat e nenit 46 të KEDNJ-së të rishikojë sistemin e tij ligjor të brendshëm për të mundësuar përmirësimin e situatës së ankuesit.

Në vitin 1987 kërkuesit iu dha një pension pleqërie nga fondi i pensioneve të ish-Republikës Socialiste të Bosnjë-Hercegovinës. Në vitin 1992 ai u largua nga Sarajeva dhe u transferua në atë që tani njihet si Republika Srpska. Në vitin 2000, kërkuesi u kthye në Sarajevë, e cila është pjesë e Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës – entiteti tjetër brenda vendit – dhe u përpoq të rifillonte marrjen e pensionit të tij nga fondi i pensioneve të atij entiteti ("Fondi Federal"). Legjislacioni për pensionet nuk është ende i harmonizuar ndërmjet dy enteve dhe pensionet janë përgjithësisht më të ulëta në Republika Srpska sesa në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës. Meqenëse

kërkesa e kërkuesit për t'u lejuar të merrte pension nga Fondi Federal ishte e pasuksesshme, ai u ankua në Dhomën e të Drejtave të Njeriut për Bosnjë dhe Hercegovinën. Në një vendim të datës 10 janar 2003, Dhoma e të Drejtave të Njeriut vendosi se kërkuesi ishte diskriminuar në gëzimin e të drejtës së tij për sigurime shoqërore, siç garantohet nga neni 9 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Ajo urdhëroi Federatën e Bosnjë-Hercegovinës që të ndërmerrte hapat e duhur legjislativë dhe administrativë me synimin për t'i dhënë fund një diskriminimi të tillë dhe për t'i paguar kërkuesit diferencën midis shumës së pensionit që ai kishte marrë në fakt dhe shumës që duhej të kishte marrë nga Fondi Federal. Megjithatë, edhe pse ai mori disa shpërblime nga Fondi Federal, pensioni i kërkuesit vazhdoi të paguhej nga Republika Srpska.

28 . Para shqyrtimit të pretendimeve individuale të kërkuesit për shpërblim të drejtë sipas nenit 41 të Konventës dhe në funksion të rrethanave të çështjes në fjalë, Gjykata dëshiron të marrë parasysh se çfarë pasojash mund të nxirren për shtetin e paditur nga neni 46 të Konventës. Ai rithekson se në bazë të nenit 46, Palët e Larta Kontraktuese kanë marrë përsipër t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në çdo çështje në të cilën ato janë palë, ekzekutimi që mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës. Ndër të tjera, në një vendim në të cilin Gjykata konstaton një shkelje, i imponon shtetit të paditur një detyrim ligjor jo vetëm për t'u paguar të interesuarve shumat e dhëna si kompensim të drejtë sipas nenit 41, por edhe për të zgjedhur si subjekt i mbikëqyrjes nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është e përshtatshme ato individuale që duhet të miratohen në rendin e tyre juridik të brendshëm për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar aq sa është e mundur efektet (shih, Scozzari dhe Giunta kundër Italisë [GC], nr.39221/98 dhe 98/41963, § 249, GJEDNJ 2000-VIII, dhe Broniowski k. Polonisë [GC], nr.31443 / 96, § 192, GJEDNJ 2004-V).

Për më tepër, nga Konventa, dhe nga neni 1 në veçanti, rrjedh se në ratifikimin e Konventës, Shtetet Kontraktuese marrin përsipër të sigurojnë që legjislacioni i tyre i brendshëm të jetë në përputhje me të. Si pasojë, është detyrim për shtetin e paditur për të hequr pengesat në sistemin e tij të brendshëm ligjor që mund të parandalojnë aplikuesin ' s situatën nga të korrigjohet në mënyrë adekuate (shih Maestri v. Italisë [GC], nr. 39748/98, § 47, GJEDNJ 2004-I, dhe Assanidze kundër Gjeorgjisë [GC], nr. 71503/01, § 198, GJEDNJ 2004 II).

Scozzari dhe Giunta k. Italisë - nr. 39221/98 dhe 41963/98, datë 13/7/2013

Vendimi i çështjes *Scozzari dhe Giunta k. Italisë*, i shpallur nga gjykata më 13 korrik 2000 fokusohet në parimin *"restitutio in integrum"* në përputhje me kërkesat e nenit 46 të KEDNJ-së që ka parashikuar fuqinë detyruese të vendimeve të GJEDNJ-së si burimin për përgjegjësinë e shteteve jo vetëm të shlyejnë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrin masa individuale dhe/ose, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor për t'i dhënë fund shkeljes së gjetur nga gjykata, rregullimit të pasojave të shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur në gjendjen e mëparshme.

Kërkuesja e parë, një shtetase belge dhe italiane dhe kërkuesja e dytë, që është një shtetase italiane e cila jeton në Belgjikë, prindër të fëmijëve të vendosur në institucione kujdesiGjykata kishte pezulluar të drejtat prindërore të kërkueses dhe kishte urdhëruar vendosjen e fëmijëve në një komunitet pranë Firences. Dy nga drejtuesit kryesorë të atij komuniteti ishin dënuar në vitin 1985 për keqtrajtim të tre personave me aftësi të kufizuara që kishin qëndruar atje. Njëri prej tyre u dënua edhe për abuzim seksual. Dosja e çështjes tregon se të dy burrat vazhdojnë të mbajnë poste përgjegjësie brenda komunitetit dhe janë të përfshirë në mënyrë aktive në procedimet në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe në marrëveshjet për kujdesin e tyre. Ndonëse Gjykata e të Miturve dhe të Rinjve kishte urdhëruar që kërkuesja të kishte kontakt vetëm me fëmijën më të vogël, ajo u pengua ta bënte këtë në praktikë, ku vizitat u pezulluan disa herë për vite me radhë. Për këtë arsye, kërkuesja e parë, u ankua për shkelje të nenit 8 të Konventës në atë që të drejtat e saj prindërore ishin pezulluar, fëmijët e saj ishin marrë nën kujdes, autoritetet kishin vonuar përpara se ta lejonin përfundimisht të takonte fëmijët, ishin organizuar shumë pak vizita kontakti dhe autoritetet i kishin vendosur fëmijët në institucion komunitar. Kërkuesja e dytë pretendoi gjithashtu një shkelje të nenit 8, duke u ankuar se autoritetet kishin refuzuar mundësinë e saj për tu kujdesur për nipërit dhe kishin vonuar organizimin e kontaktit me ta.

Gjykata vlerësoi se kërkuesja e parë kishte pësuar padyshim dëm jo pasuror. Duke vendosur mbi baza të barabarta, ajo i dha asaj 100.000.000 ITL përveç shpenzimeve gjyqësore dhe fëmijëve të cilët kishin pësuar dëmtime personale, [...] ITL secilit.

249 . Gjykata vë në dukje se në bazë të nenit 46 të Konventës, Palët e Larta Kontraktuese morën përsipër t'u binden vendimeve përfundimtare të

Gjykatës në çdo çështje në të cilën ato ishin palë, duke mbikëqyrur ekzekutimin nga Komiteti i Ministrave. Nga kjo rrjedh, ndër të tjera, se një vendim në të cilin Gjykata konstaton një shkelje i imponon shtetit të paditur një detyrim ligjor jo vetëm për t'u paguar të interesuarve shumat e dhëna në formë të kompensimit të drejtë, por edhe për të zgjedhur, subjekt i mbikëqyrjes nga Komiteti të Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është e përshtatshme, individuale që duhet të miratohen në rendin e tyre juridik të brendshëm për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet (shih, mutatis mutandis, aktgjykimi Papamichalopoulos dhe të tjerët k. Greqisë (neni 50) i 31 tetorit 1995, Seria A nr. 330-B, f. 58-59, § 34). Për më tepër, objekt monitorimi nga Komiteti i Ministrave, Shteti mbetet i lirë për të zgjedhur mjetet me të cilat ai do të shkarkojë detyrimin e tij ligjor sipas nenit 46 të Konventës, me kusht që këto mjete të jenë në përputhje me përfundimet e përcaktuara në gjykatë së gjykimit. 250. Rrjedhimisht, sipas nenit 41 të Konventës, qëllimi i dhënies së shumave me anë të shpërblimit të drejtë është të sigurojë kompensim vetëm për dëmin e pësuar nga personat e interesuar në masën që ngjarje të tilla përbëjnë pasojë të shkeljes që nuk mund të korrigjohet ndryshe.

Neni 1 Protokolli nr. 1

Sporrong dhe Loennroth k. Suedisë – nr. 7151/75, 7152/75, datë 18/12/1984, 23/09/1982

Vendimet për *Sporrong dhe Loennroth kundër Suedisë*, të marra më 18 dhjetor 1984 (7151/75) dhe 23 shtator 1982 (7152/75) fokusohen tek e drejta për mbrojtjen e pronës, e parashikuar në nenin 1 të Protokollit nr. 1 në KEDNJ. Ato gjithashtu kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së dhe me të drejtën për kompensim të Nenin 41 të KEDNJ-së.

Dy ankuesit apeluan kundër vendimeve për shpronësimin afatgjatë dhe ndalimin e ndërtimit në pronën e tyre. Kërkuesit ishin pronarë të pronave në qendër të Stokholmit, Suedi. Në vitin 1954 dhe 1968, autoritetet përkatëse administrative të qytetit të Stokholmit vendosën ndalimin e ndërtimit në pronën e Sporrong Estate, në të cilën ishte një ndërtesë që datonte që prej viteve 1860 dhe në pronën e Zonjës Loennroth, e cila kishte dy ndërtesa që datonin që nga viti 1887. Ndalimet u lëshuan me arsyetimin se ndërtimi

i mundshëm në prona do të pengonte planet e autoriteteve të qytetit për ta transformuar të gjithë rrethin në kontekstin e planeve publike për të krijuar zyra të reja, dyqane, apartamente dhe rrugë për transport publik dhe privat. Ndalimet u zgjatën vazhdimisht derisa përfunduan në vitin 1979. Në vitin 1956 dhe 1971, Qeveria Kombëtare i dha Qytetit të Stokholmit leje shpronësimi për pronat me kusht që të zbatojë shpronësimin dhe të caktojë kompensim brenda pesë vjetësh para gjykatës përkatëse. Lejet u zgjatën vazhdimisht me kërkesën e Qytetit deri në vitin 1979, kur u anuluan së bashku me ndalimin e ndërtimit, pasi pronat konsideroheshin si jo të nevojshme për planet e qytetit. Sipas ligjit suedez të atëhershëm në fuqi, pronarët e pronave nuk kishin mundësi të merrnin një afat të caktuar kohor për lejet dhe ndalimet, as të merrnin kompensim ekonomik derisa të ishte kryer shpronësimi.

Gjykata konstatoi se Suedia kishte shkelur detyrimet e saj sipas Nenit 1 Protokolli Nr. 1 dhe Nenit 6 të KEDNJ-së dhe se ankuesit kishin të drejtë kompensimi për dëmet pasurore dhe jopasurore në bazë të Nenit 41 të KEDNJ-së.

Neni 1 Protokolli nr. 1 thotë se *"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të gëzojë qetësisht pronat e tij. Askush nuk mund të privohet nga zotërimet e tij, përveç në rastin e interesit publik dhe në varësi të kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Dispozitat e mësipërme, ndonëse, nuk do të dëmtojnë në asnjë mënyrë të drejtën e shtetit për të zbatuar ligje të tilla që ai i konsideron të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve të tjera apo dënimet."*. Neni 6 i KEDNJ-së thekson të drejtën për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 50 të KEDNJ-së thekson të drejtën për kompensim nga shkeljet e detyrimeve në përputhje me KEDNJ-në.

Sa i përket Nenit 1, Protokolli 1, Gjykata vendosi që, megjithëse të drejtat e pronarëve për të përdorur dhe disponuar pronat e tyre nuk preken në thelbin e saj formal nga lejet e shpronësimit, ato zvogëlojnë ndjeshëm mundësinë e ushtrimit të tij në praktikë. Gjykata vërejti se lejet e shpronësimit dhe ndalimet në ndërtim duhet të shqyrtohen së bashku:

"Kjo ndodh sepse, edhe pse nuk kishte domosdoshmërisht lidhje ligjore midis masave (shih paragrafin 35 më lart) dhe edhe pse ato kishin periudha të ndryshme vlefshmërie, ato ishin plotësuese dhe kishin objektivin e vetëm për të lehtësuar zhvillimin e qytetit në përputhje me planet e ardhshme të përgatitura për këtë qëllim."

Gjykata konstatoi se ekzistenca gjatë periudhës 25 dhe 12 vjeçare e ndalimeve në ndërtim theksoi edhe më tej efektet paragjykuese të lejeve. Bilanci i drejtë mes interesave publikë dhe privatë nuk u përmbush:

"Duke u kombinuar në këtë mënyrë, të dy seritë e masave krijuan një situatë që prishi ekuilibrin e drejtë, i cili duhet të vendoset mes mbrojtjes së të drejtës së pronësisë dhe kritereve të interesit të përgjithshëm: Sporrong Estate dhe Zonja Lönnroth mbanin një barrë individuale dhe të tepruar, e cila mund të ishte legjitime vetëm nëse do të kishin pasur mundësi të kërkonin ulje të afateve ose kompensim. Megjithatë, në kohën përkatëse ligji suedez i përjashtoi këto mundësi dhe ende e përjashton të dytën prej tyre.".

Sa i përket Nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstatoi se ankuesit nuk kishin mundësi efektive t'i kundërshtonin aktet përkatëse të qytetit apo qeverisë kombëtare. Sipas ligjit në fuqi në kohën e akteve, nuk kishte asnjë gjykatë kompetente që t'i shqyrtonte të gjitha aspektet e çështjes.

Sa i përket të drejtës për kompensim sipas nenit 41 të KEDNJ-së, Gjykata vendosi në vendimin vijues të vitit 1984 se Suedia nuk arriti të japë dëmshpërblim për Kërkuesit, të cilin ata kanë të drejtë ta marrin për shkak të dëmit të shkaktuar nga shkeljet e konstatuara në vendimin gjyqësor të vitit 1982.

Edhe pse krahasimi mes fillimit dhe mbarimit të periudhave të dëmit nuk tregon se kërkuesit ishin të paragjykuar në aspektin financiar, Gjykata nuk arrin në përfundimin se nuk kishte humbje brenda asaj periudhe. Ka, në fakt, faktorë të tjerë që gjithashtu kërkojnë vëmendje. Së pari, ka kufizime në përdorimin e pronave: kërkuesit nuk mund të ndërtonin "ndërtim të ri" në tokën e tyre dhe do ta kishin ekspozuar veten ndaj rreziqeve serioze nëse, edhe me leje, do të kishin kryer punë që nga koha kur ata do të detyroheshin të merrnin përsipër të mos pretendonin - në rast shpronësimi - asnjë dëmshpërblim për mbiçmimin rezultues të kapitalit [...] Kësaj i shtoheshin vështirësitë e hasura në marrjen e kredive të siguruara me hipotekë [...] Përveç kësaj, nuk mund të harrohet se gjatë periudhave të dëmtimit, vlera e pronave në fjalë ka rënë natyrshëm; është e qartë se një pronë e cila i nënshtrohet një leje shpronësimi dhe që mund t'i hiqet pronarit të saj në çdo moment nuk do të ruajë vazhdimisht vlerën e saj të mëparshme, edhe pse në rastin konkret pronat e Kërkuesve, pas periudhave të përmendura, edhe një herë në terma realë, nuk vlenin më pak se sa kur u miratuan masat në fjalë. Për më tepër, çdo skemë për rizhvillimin e pronave që kërkuesit mund të kenë menduar ishte e pazbatueshme në atë kohë. Në këtë aspekt, mund të thuhet se kanë pësuar humbje mundësish, që duhet të merren parasysh, pavarësisht se perspektivat e realizimit do të ishin të dyshimta. Mbi të gjitha, kërkuesit u lanë në një pasiguri të zgjatur: ata nuk e dinin se cili do të ishte fati i pronave të tyre dhe ata nuk kishin të drejtë të merrnin parasysh vështirësitë e tyre nga qeveria. Këtyre faktorëve u duhet shtuar dëmi jomonetar i shkaktuar nga shkelja e nenit 6 [...].

James & të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar – nr. 8797/93, datë 21/02/1986

Vendimi *James & të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, i dhënë nga Gjykata (Kolegjet e Bashkuara) më 21 shkurt 1986, fokusohet në të drejtën për mbrojtjen e pronës, Neni 1, Protokolli Nr. 1 i KEDNJ-së, dhe ka të bëjë edhe me Nenin 13 dhe 14 të KEDNJ-së.

Kërkuesit pretenduan kryesisht se transferimet e detyrueshme të pronave të tyre shkaktuan një shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Ata gjithashtu pretenduan se mungesa e ndonjë sistemi apelimi kundër atyre transferimeve shkelte Nenin 13 të KEDNJ-s. Kërkuesit janë ose ishin administratorë të besuar që vepronin në bazë të Testamentit të Dukës së Dytë të Westminster-it. Në zonën e Belgravia-s në Londrën Qendrore, në një vend që dikur ishte tokë bujqësore në periferi të qytetit të Londrës, familja Westminster dhe besuesit e saj kanë zhvilluar një Pronë të madhe që përfshin rreth 2.000 shtëpi, të cilat ishin bërë një nga zonat më të dëshirueshme të banimit në kryeqytet. Kërkuesit, si administratorë të besuar, janë privuar nga pronësia e tyre mbi një numër pronash në këtë Pasuri nëpërmjet ushtrimit të të drejtave të blerjes nga banorët të njohur nga Ligji i Reformës së Qirasë i vitit 1967, i ndryshuar. Ky legjislacion u jep qiramarrësve që banojnë në shtëpi të mbajtura për periudha "qiramarrjeje të gjata" (për periudha mbi, ose të ripërtërira për periudha që arrijnë një total prej mbi 21 vjet) me "qira të ulëta" të drejtën për të blerë në mënyrë të detyrueshme "si zotërim të lirë" pronën (interesin e pronarit të truallit) sipas parashikimeve të përcaktuara duke iu nënshtruar disa kushteve të caktuara. Nën sistemin e qiramarrësve afatgjatë, një qiramarrës zakonisht do të blejë një qira të gjatë prone për një shumë monetare dhe do të paguajë më pas një qira të vogël apo edhe nominale. Qiraja është një interes i pronës së paluajtshme, e regjistrueshëm në Regjistrin e Tokës. Legjislacioni në fjalë në rastin konkret nuk ka të bëjë me sistemin e zakonshëm të pronës së dhënë me qira, sipas të cilit qiramarrësi paguan një "qira për raft" që pasqyron vlerën e plotë vjetore të

pronës. Marrëdhënia e pronarit/qiramarrësit sipas sistemit të zakonshëm rregullohet, për shtëpitë nën një vlerë të caktuar (të përcaktueshme), me legjislacion të posaçëm në formën e "Ligjit për Qiranë", i cili siguron makineri për fiksimin e "qirave të drejta" dhe siguron siguri të caktuar të pronësisë për qiramarrësit (shih vendimin e Gjykatës për më shumë hollësi mbi legjislacionin e qirasë). Në shkëmbimet e përfunduara në periudhën midis prillit 1979 dhe nëntorit 1983, qiramarrësit e rreth 80 pronave të qirave afatgjata që ishin pjesë e pronës së banueshme në Belgravia, të cilën familja Westminster dhe kujdestarët e saj e kishin zhvilluar, ushtruan kompetencat e tyre sipas legjislacionit që u kundërshtua për të blerë në mënyrë të detyrueshme pronat në interes të tyre si pronarë që vetëkujdesen për pasurinë e tyre. Në secilën prej 80 shkëmbimeve, çmimi i paguar u përcaktua me anë të bisedimeve. Kërkuesit u këshilluan me këshilltarët e tyre ligjorë se ata nuk kishin asnjë arsye për të kundërshtuar të drejtën e ndonjërit prej qiramarrësve dhe se ata nuk mund të shpresonin në mënyrë të arsyeshme të merrnin një çmim më të lartë për ndonjë nga pronat përkatëse nga gjykimi para Gjykatës së Tokës ose Tribunalit të Vlerësimit të Qirasë. Humbjet e pretenduara nga kërkuesit janë pësuar nga nevoja për të shitur sipas kushteve ligjore në krahasim me kushtet e tregut të hapur dhe shkojnë nga 1.350 në 148.080 paund për secilën shitje dhe 1.479.407 paund gjithsej për pronat në lidhje me të cilat u zbatua vlerësimi i bërë në 1967 dhe 1.050.496 paund për pronat në lidhje me të cilat u zbatua baza e vlerësimit të kryer në vitin 1974.

Gjykata nuk gjeti shkelje të ndonjë neni.

Sa i përket Nenit 1 Protokolli Nr. 1, Gjykata vëren se as për shkak të parashikimeve dhe kushteve të Ligjit të Reformës së Qirasë të vitit 1967, të ndryshuar dhe as për shkak të rrethanave të veçanta të transaksioneve të së drejtës së pronësisë në lidhje me pronat e kërkuesve nuk ka pasur shkelje. Së pari, Gjykata përcakton qasjen që do të mbajë në lidhje me kërkesën e kërkuesit për të shqyrtuar bazueshmërinë e të tëra 80 çështjeve me hollësi. Meqenëse çështja thelbësore për vendimin ishte nëse shteti i paditur ka shkelur të drejtat e kërkuesve sipas Konventës duke fuqizuar qiramarrësit të fitojnë pronën e tyre sipas kushteve të përcaktuara në legjislacion, kjo çështje duhej të përcaktohej duke marrë parasysh nëse legjislacioni është në përputhje me Konventën dhe jo me shqyrtim të veçantë të transaksioneve individuale. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që Gjykata do të shqyrtojë legjislacionin në mënyrë abstrakte. Shfuqizimet individuale për të cilat paraqitej ankimi ishin ilustruese të ndikimit në praktikë të reformës që ajo prezantoi dhe, si të tilla, thelbësore për çështjen e përputhshmërisë së saj me Konventën. Së dyti, Gjykata përshkruan rekomandimet sipas Nenit 1 Protokolli Nr. 1 duke iu referuar çështjes së saj *Sporrong dhe Lönnroth*.

Së dyti, Gjykata vëren se privimi i kërkuesve ishte i justifikuar pasi ishte në interesin publik dhe plotësonte kërkesat e tjera të Nenit 1 Protokolli Nr. 1: "marrja e pronës e kryer në zbatim të politikave legjitime shoqërore, ekonomike ose të tjera të jetë "në interesin publik", edhe nëse komuniteti në përgjithësi nuk ka përdorim të drejtpërdrejtë ose gëzim të pronës së marrë. […] Besimi i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar në ekzistencën e një padrejtësie shoqërore nuk ishte i tillë që mund të karakterizohej si haptazi i paarsyeshëm [sepse qiramarrësit me qira afatgjatë do të kishin investuar shumë më tepër kapital në shtëpi sesa pronarët përkatës, domethënë kërkuesit] […] [Dhe] marrëdhënia e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohej të realizohej [u përmbush gjithashtu]". Për shkak të përmbushjes së kërkesave të veçanta nga "rregulli i privimit", parimi i përgjithshëm, gëzimi paqësor i pronave, i Nenit 1 Protokolli Nr.1 gjithashtu u përmbush.

Sa i përket pretendimit të kërkuesve për shkelje të Nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata vëren se "duke pasur parasysh objektivat legjitime që ndiqen në interesin publik dhe duke pasur parasysh kufirin e vlerësimit të shtetit të paditur, ajo politikë e trajtimit të ndryshëm nuk mund të konsiderohet si e paarsyeshme ose si imponim i një barre disproporcionale për kërkuesit […] Dispozitat në legjislacion që përfshijnë trajtim progresiv në mënyrë të pafavorshme për pronarin, aq më e ulët [do të] konsiderohet të jetë vlera e pronës si një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv dhe, rrjedhimisht, nuk janë diskriminuese." Prandaj, nuk pati shkelje të Nenit 14 të KEDNJ-së.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të Nenit 13 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se kërkuesit kishin mjete të mjaftueshme juridike në dispozicion. Gjykata e konsideron këtë të mjaftueshme kur është e mundur të sigurohet pajtueshmëria me ligjet përkatëse. Kjo kishte qenë e mundur. "Në veçanti, mosmarrëveshjet mbi të drejtën e qiramarrësit për të blerë pronën lirë sipas legjislacionit të reformës së qirasë dhe mbi çështjet e ndërlidhura përfshihen në juridiksionin e Gjykatës së Qarkut; dhe çmimi i blerjes i pagueshëm i nënshtrohet përcaktimit, në mungesë të marrëveshjes, prej Tribunalit vendas për Vlerësimin e Qirasë".

Van Marle dhe të tjerët k. Holandës – nr. 8543/79, 8674/79, 8675/79 & 8685/79, datë 26/06/1986

Vendimi për *Van Marle dhe të tjerët kundër Holandës*, i marrë më 13 tetor 1980 nga Gjykata (Dhoma), fokusohet tek e drejta për një proces te

rregullt, Neni 6 KEDNJ, dhe tek e drejta për mbrojtje të pronës, Neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ-së.

Kërkesat ishin për mbrojtjen ligjore në lidhje me të drejtat intelektuale si pronësi, në veçanti mënyrën se si autoritetet holandeze përcaktuan se kërkuesit nuk kishin kompetencë të mjaftueshme profesionale për të qenë kontabilistë të certifikuar sipas sistemit të kontabilitetit holandez dhe prandaj nuk u dhanë atyre të drejtën e ushtrimit të profesionit nën këtë titull pas marsit të vitit 1979. Kërkuesit janë shtetas holandezë që ushtronin profesionin e kontabilistit deri në vitin 1950. Sipas ligjit holandez, para vitit 1962, çdokush, pavarësisht aftësive të tij profesionale, mund ta quante veten "kontabilist" dhe të ushtronte profesionin me këtë emër. Kjo situatë, e cila u konsiderua e pakënaqshme, çoi në miratimin e dy ligjeve të veçanta. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të akteve të mësipërme, pra pas marsit të vitit 1979, emri "kontabilist" ishte i ligjshëm vetëm për personat e autorizuar për ta mbajtur titullin ose për kontabilistët e autorizuar apo të certifikuar. Në Aktin e vitit 1972, u bënë përditësime kalimtare për ata që, në datën e hyrjes në fuqi të tij, e kanë tashmë ushtruar profesionin e tyre nën emrin "kontabilist". Për përcaktimin e plotësimit ose jo të kushteve të caktuara të parashikuara në ligjin për ligjin për marrëveshjen kalimtare, u krijua një Bord Pranimi. Vendim për të refuzuar regjistrimin nga Bordi i Pranimit mund të kundërshtohet me ankesë në Bordin e Apelit. Ky Bord përbëhej nga pesë anëtarë dhe pesë anëtarë zëvendësues. Tre nga anëtarët dhe tre nga anëtarët zëvendësues u caktuan në mes të personave të klasifikuar si gjyqtarë dhe që ishin ose u ishte besuar një juridiksion, por që nuk e ushtronin ose nuk e kishin ushtruar profesionin e kontabilistit të autorizuar ose të certifikuar. Dy anëtarët e mbetur dhe anëtarët zëvendësues ishin ekspertë në fushën e kontabilitetit. Të katër kërkuesit aplikuan për statusin e kontabilistit, por pa sukses. Asnjë prej tyre nuk apeloi kundër vendimit përfundimtar të Bordit të Apelit në Këshillin e Shtetit në bazë të Aktit të Ankesave Administrative, pasi një zgjidhje e tillë do të ishte joefektive sepse Këshilli i Shtetit e kishte shpallur të papranueshme një ankesë të ngjashme me arsyetimin se ishte drejtuar kundër vendimit të një organi (Bordi i Apelit), të cilit i ishte besuar juridiksioni dhe që i cili nuk mund të konsiderohet si organ administrativ.

Gjykata konstatoi se Neni 6 i KEDNJ-së nuk ishte i zbatueshëm dhe nuk kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Sa i përket Nenit 6 të pazbatueshëm të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se nuk kishte pasur "kundërshtim" (mosmarrëveshje)" brenda kuptimit të Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Ai përcakton parimet që do të dilnin nga praktika gjyqësore e tij si më poshtë:

"(A) Përputhshmëria me frymën e Konventës kërkon që fjala "kundërshtim" (mosmarrëveshje) nuk duhet të "interpretohet shumë teknikisht" dhe duhet t'i "jepet kuptim përmbajtësor e jo formal"[...] (b)"kontestimi "(mosmarrëveshja) duhet të jetë e vërtetë dhe e një natyre serioze [...] (c)" Kontestimi "(mosmarrëveshja) mund të lidhet jo vetëm me" ekzistencën aktuale të një ... të drejte ", por edhe me fushëveprimin ose mënyrën e saj në të cilën mund të ushtrohet [...] (d) "Kundërshtimi" (mosmarrëveshja) mund të jetë për "çështjet e faktit" ashtu edhe për "çështjet e ligjit" [...] [e] Përveç kësaj, është e nevojshme të analizohet objekti i mosmarrëveshjes, i cili u paraqit në rastin konkret në Bordin e Apelit.".

Në rastin konkret, funksioni i Bordit të Apelit ishte rishikimi i sjelljes së duhur të procedurave të Bordit të Pranimit dhe rishqyrtimi i faktit nëse kërkuesit i kanë aftësitë, përvojën, kohëzgjatjen në profesion apo diplomat e kualifikimet përkatëse. Detyra e mëparshme mund të përfshijë çështje të tilla si vendosja nëse vendimi ishte arbitrar ose *ultra vires* ose nëse kishte parregullsi procedurale. Sipas Gjykatës, çështjet e këtij lloji në vetvete i nënshtrohen vendimit gjyqësor dhe çdo mosmarrëveshje rreth tyre mund të konsiderohet si "kundërshtim" (mosmarrëveshje) brenda kuptimit të nenit 6 të KEDNJ-së. Në rastet në fjalë, kërkuesit nuk kishin pretenduar para Bordit të Apelit se kishte pasur parregullsi të tilla. Me një përjashtim ku ankesat e bëra nga kërkuesit në Bordin e Apelit kishin të bënin, në thelb, me atë çka ata e konsideronin si vlerësim të pasaktë të kompetencës së tyre nga Bordi i Pranimit. Gjykata krahason një vlerësim të këtij lloji, duke vlerësuar njohuritë dhe përvojën për kryerjen e një profesioni nën një titull të caktuar, me një provim shkollor ose universitar, i cili është aq larg ushtrimit të funksionit normal gjyqësor, saqë masat mbrojtëse në nenin 6 të KEDNJ-së mund të mos merren si mbulim.

Sa i përket nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata vlerëson se ai është i zbatueshëm në rastin në fjalë pasi puna intelektuale e kërkuesve përbën posedim brenda kuptimit të Nenit 6 të KEDNJ-së:

"Gjykata bie dakord me Komisionin se e drejta tek e cila mbështeten kërkuesit mund të krahasohet me të drejtën e pronës të përfshirë në Nenin 1 (P1-1): kërkuesit kishin krijuar klientelën e tyre nga puna; kjo kishte, në shumë aspekte, natyrën e një të drejte private dhe përbënte pasuri e, rrjedhimisht, një posedim brenda kuptimit të fjalisë së parë të Nenit 1 (P1-1). Kjo dispozitë ishte në përputhje me rrethanat në rastin konkret.

Refuzimi për t'i regjistruar kërkuesit si kontabilistë të certifikuar ndikoi rrënjësisht në kushtet e aktiviteteve të tyre profesionale dhe qëllimi i atyre aktiviteteve u reduktuar. Të ardhurat e tyre ranë, së bashku me vlerën e klientelës dhe biznesit të tyre në përgjithësi. Si pasojë, pati ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzimin e qetë të pronave të tyre.".

Megjithatë, ndërhyrja e konstatuar në të drejtat e kërkuesve ishte e justifikuar:

"Së pari, Akti i vitit 1972 u krijua për të promovuar" interesin e përgjithshëm": qëllimi i tij ishte të strukturonte një profesion që është i rëndësishëm për të gjithë sektorin ekonomik duke i siguruar publikut garanci për kompetencën e atyre që kryejnë këtë profesion. Së dyti, ekuilibri i drejtë midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar (shih vendimin gjyqësor të sipërpërmendur Sporrong dhe Lönnroth, Seria A nr. 52, f. 26, paragrafi 69) sigurohej në çdo rast nga dispozitat kalimtare që i mundësonin ish-të kontabilistit të pakualifikuar të hyjë në profesionin e ri me kushtet e përcaktuara.".

Katte Klitsche k. Italisë – nr. 86/12539, datë 1994/10/27

Vendimi *Katte Klitsche kundër Italisë*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 27 tetor 1994, fokusohet në parimin e gjykimit të drejtë, të mishëruar në Nenin 6 të KEDNJ-së, veçanërisht në kohëzgjatjen e arsyeshme të një procesi, këtu edhe në rrethana të veçanta në lidhje me planifikimin e qytetit dhe mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, ai ka të bëjë me të drejtën për mbrojtjen e pronës, Neni 1, Protokolli Nr. 1 (nuk është pjesë e kësaj përmbledhjeje).

Kërkuesi e kundërshtoi kohëzgjatjen e procesit në përgjithësi në gjykatë që përfshin të tri nivelet e jurisprudencës. Kërkuesi ishte pronar i tokës, e cila i nënshtrohej një plani të përdorimit të tokës nga autoritetet përkatëse që mbulonte zhvillimin e tokës në lidhje me ndërtesa banimit zyra dhe përdorime të tjera. Midis 14 shkurtit 1976 dhe 25 shkurtit 1986, kërkuesi paraqiti padi të ndryshme kundër autoriteteve shtetërore në gjykatat administrative. Më 9 maj 1978, ai filloi procesin kundër Këshillit të Qarkut Tolfa dhe Autoritetit Rajonal të Lacio-s në Gjykatën e Rrethit të Romës. Më 12 shtator 1979, ankuesi paraqiti një kërkesë për një vendim paraprak mbi çështjen e juridiksionit në Gjykatën e Kasacionit, e cila dha vendimin e saj më 29 janar 1981, i depozituar në sekretari më 9 maj 1981. Procedurat në Gjykatën e Rrethit u rihapën nga kërkuesi më 7 korrik 1981. Më 1 mars 1982 kërkesa e tij u hodh poshtë. Ankesat e tij në Gjykatën e Apelit dhe në

Gjykatën e Kasacionit, të paraqitura më 15 qershor 1982 dhe përkatësisht më 21 dhjetor 1984, u rrëzuan më 4 korrik 1984 dhe 11 nëntor 1985, kjo e fundit u depozitua në sekretari më 13 maj 1986.

Sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë, Gjykata vërejti se Italia nuk e kishte shkelur Nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

Neni 6 § 1 i KEDNJ-së parashikon se: "*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, secili ka të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj* […]".

Duke iu referuar kushteve dhe kërkesave nga Neni 6 § 1 i KEDNJ-së siç deklarohet në praktikën e saj të mëparshme (*shiko më sipër, përmbledhjen e çështjes "Zimmermann dhe Steiner k. Zvicrës"*), Gjykata përcakton periudhën që do të merret parasysh*: [[Filloi] më 9 maj 1978 kur ankuesi filloi procedimet kundër Këshillit të Qarkut Tolfa dhe Autoritetit Rajonal të Lacio-s në Gjykatën e Rrethit të Romës. Ai përfundoi më 13 maj 1986, data në të cilën vendimi i Gjykatës së Kasacionit u depozitua në sekretari. Prandaj, zgjati pak më shumë se tetë vjet.* "

Së pari, Gjykata rithekson se ndikon në kohëzgjatjen e një gjykimi kur një çështje konsiderohet e ndërlikuar. Ajo vëren se rasti konkret ishte i ndërlikuar për sa i përket fakteve dhe ligjit, në veçanti për shkak të çështjeve të ndërlikuara teknike dhe pyetjeve juridike që preknin praktikën e mëparshme dhe të ardhshme të gjykatave vendimmarrëse.

Sa i përket sjelljes së kërkuesit si përcaktues i dytë i afatit të arsyeshëm, Gjykata thekson praktikën e saj të mëparshme gjyqësore se është e parëndësishme nëse kërkuesi përdor të drejtat që i njihen atij:

"Ashtu si ankuesi, Gjykata vëren se, duke i kërkuar Gjykatës së Kasacionit të vendosë për çështjen e juridiksionit [tashmë gjatë procedurës së shkallës së parë, pra si pyetje paraprake], një pyetje e cila ishte ngritur për më tepër nga Këshilli i Rrethit Tolfa dhe Autoriteti Rajonal i Lacio-s (shih, paragrafin 22 më lart), ankuesi po kërkonte të eliminonte në fillim çdo dyshim në lidhje me juridiksionin e gjykatës së shkallës së parë. Prandaj sjellja e tij në këtë drejtim nuk është e hapur për kritika.".

Duke iu kthyer kushtit të tretë, sjelljes së autoriteteve gjyqësore, Gjykata vëren se vërtet ka pasur "periudha jonormale", megjithatë ndërlikueshmëria e çështjes i justifikon ato për shkak të ndikimeve në praktikën gjyqësore të gjykatës së shtetit të paditur, si dhe rëndësisë së subjektet e përfshira.

"Megjithatë, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe kompleksitetin e fakteve dhe çështjeve ligjore të përfshira, këto periudha nuk garantojnë përfundimin se kohëzgjatja e procedurës ishte e tepruar, veçanërisht pasi vendimet që kishin të bënin me një zonë e ndjeshme si urbanistika dhe mbrojtja e mjedisit, mund të kishin, dhe në fakt kishin, pasoja të rëndësishme në praktikën gjyqësore italiane në lidhje me dallimin midis një të drejte dhe një interesi legjitim.".

Papamichalopoulos dhe të tjerët k. Greqisë **– nr. 14556/89, datë 31/10/1995**

Vendimi për *Papamichalopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 10 tetor 1995, fokusohet tek pretendimet e kërkuesve për shpërblim të drejtë sipas Nenit 41 të KEDNJ-së në kontekstin e shkeljeve të së drejtës për mbrojtjen e pronës, Neni 1 Protokolli 1 i KEDNJ-së.

14 kërkuesit kërkuan shpërblim të drejtë në bazë të nenit 41 të KEDNJ-së. Në vendimin parësor gjyqësor, Gjykata vendosi se "*humbja e të gjithë aftësisë disponuese të tokës në fjalë, e marrë së bashku me dështimin e përpjekjeve të bëra [deri atëherë] për rregullimin e situatës [kishte] sjellë pasoja mjaft serioze për kërkuesit [...] në mënyrë të papajtueshme me të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të pronës së tyre*"(fq. 70, paragrafi 45). Akti i Qeverisë në fjalë ishte marrja nga shteti e tokës që u përkiste individëve privatë, proces i cili ka zgjatur njëzet e tetë vjet ku autoritetet kanë injoruar kështu vendimet e gjykatave kombëtare dhe premtimet e tyre politike ndaj kërkuesve për korrigjimin e padrejtësive të qeverive të mëparshme.

Gjykata konstatoi se shteti i paditur (Greqia) duhet të sigurojë shpërblimin e drejtë për shkeljet e bëra në gjykimin e mëparshëm.

Neni 41 i KEDNJ-së thotë se *"Nëse Gjykata konstaton se një vendim ose një masë e marrë nga një autoritet ligjor ose autoritet tjetër i një Pale të Lartë Kontraktuese është plotësisht ose pjesërisht në kundërshtim me detyrimet që dalin nga ... Konventa, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës në fjalë lejon vetëm dëmshpërblim të pjesshëm për pasojat e këtij vendimi ose mase, atëherë vendimi i Gjykatës, nëse është e nevojshme, do të shpërblejë në mënyrë të drejtë palën e dëmtuar."*.

Gjykata vuri në dukje se Palët e Larta Kontraktuese janë parimisht të lira të zgjedhin mjetet që do të përdorin për respektimin e një vendimi, në të cilin Gjykata ka konstatuar shkelje dhe për të cilin ata detyrohen nga Neni 46 i KEDNJ-së:

"Ky diskrecion pasqyron lirinë e zgjedhjes që i bashkohet detyrimit parësor të shteteve kontraktuese në bazë të Konventës për të siguruar të drejtat dhe liritë e garantuara, Neni 1 i KEDNJ-së. Nëse natyra e shkeljes lejon restitutio in integrum, i takon shtetit të paditur ta bëjë atë.".

Megjithatë, Gjykata deklaroi se Neni 41 i KEDNJ-së e fuqizon atë që të japë shpërblimin e drejtë për palët e dëmtuara, nëse ligji kombëtar nuk lejon - ose lejon vetëm dëmshpërblim të pjesshëm për pasojat e shkeljes.

Gjykata nuk e pranoi parashtrimin e shtetit të paditur se dhënia e kompensimit për dëmin material është çështje ekskluzivisht brenda juridiksionit të gjykatave kombëtare. Ndër të tjera, mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut kërkon që vetë Gjykata të japë dëmshpërblimin:

"Gjykata vëren, së pari, se ndërtesat janë pjesë e restitutio in integrum (shih, paragrafin 38 më lart). Ajo thekson, së dyti, se i ka deklaruar kërkuesit si viktima të shkeljes së Protokollit rr. 1 (P1); kërkimi i përdorimit të të gjitha mjeteve të brendshme juridike nga ana e tyre në mënyrë që të marrin shpërblimin e drejtë nga Gjykata do ta zgjaste procedurën e vendosur nga Konventa në një mënyrë që nuk është në përputhje me idenë e mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut.".

Sa u përket faktorëve të përcaktimit të kompensimit që do të jepet për rastin në fjalë, Gjykata vërejti se ai nuk kufizohet në vlerën e pronave në datën kur shteti i ka zënë ato. Por, gjykata mori parasysh vlerën aktuale, përfshirë zhvillimet e pronës që prej marrjes së tokës.

"Për këtë arsye, ajo u kërkoi ekspertëve të vlerësojnë edhe vlerën aktuale të tokës në fjalë; kjo vlerë nuk varet nga kushtet hipotetike [...]. Është e qartë nga raporti i ekspertit se që atëherë toka dhe afërsia e saj [...] kanë pësuar zhvillim në formën e ndërtesave, të cilat shërbejnë si qendër argëtimi për oficerët detarë dhe për punë infrastrukturore. As Gjykata nuk e anashkalon se vetë kërkuesit në atë kohë kishin një skemë për zhvillimin ekonomik të pronave të tyre, mbi të cilat puna kishte filluar [...] Rrjedhimisht, Gjykata vëren se kthimi i tokës në fjalë [...] do t'i vendoste kërkuesit, për aq sa është e mundur, në një situatë ekuivalente me atë në të cilën do të kishin qenë nëse nuk do të kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1; dhënia e ndërtesave ekzistuese do t'i kompensojë plotësisht ato për pasojat e humbjes së pretenduar të përfitimit.".

Nëse kompensimi sigurohet me pagesë, kjo përfshin pagesën e kërkuesve për dëmin dhe humbjen e përfitimit, pasi autoritetet morën në zotërim

tokën, sipas vlerës aktuale të tokës, e rritur nga vlerësimi i shkaktuar nga ekzistenca e ndërtesave dhe kostot e ndërtimit të këtyre të fundit, plus normën e interesit nga përfundimi i periudhës gjashtë mujore deri në momentin e kryerjes së pagesës. Gjykata e përcaktoi këtë shumë duke u mbështetur në opinionin e një grupi të caktuar ekspertësh.

Gjykata dha gjithashtu një shumë të konsiderueshme për dëmin jomonetar të shkaktuar nga mosrespektimi i vendimeve të gjykatave dhe autoriteteve administrative.

"Gjykata vëren se shkelja e Konventës u shkaktoi kërkuesve dëm të përcaktuar jopasuror, që rrjedh nga ndjenja e pafuqisë dhe zhgënjimit, së pari, nga refuzimi i marinës dhe qeverive vijuese për të respektuar vendimet e gjyqësorit grek dhe të autoriteteve administrative [dhe] nga dështimi i përpjekjeve për ta rimarrë tokën me vlerë të barabartë në këmbim".

Sipas Gjykatës, shteti i paditur është i detyruar ta shlyejë kompensimin brenda gjashtë muajve nga marrja e vendimit.

Gaygusuz k. Austrisë – nr. 17371/90, datë 16/09/1996

Vendimi *Gaygusuz k. Austrisë*, i dhënë nga Gjykata (Dhoma) më 16 shtator 1996, fokusohet në parimin e mosdiskriminimit, të parashikuar në Nenin 14 të KEDNJ-së, në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e pronës, Neni 1, Protokolli Nr. 1 i KEDNJ-së.

Kërkuesi kundërshtoi një vendim të dhënë kundër tij mbi përfitimet shoqërore dhe të punësimit. Kërkuesi, një shtetas turk i lindur në 1950, jetoi në Hörsching (Austria e Sipërme) nga 1973 deri në shtator 1987. Që atëherë, ai jeton në Izmir (Turqi). Ai punoi në Austri, me ndërprerje, nga viti 1973 deri në tetor 1984. Prej atëherë deri më 1 korrik 1986, periudhat kur ai ishte i papunë alternoheshin me periudhat kur ai ishte i certifikuar si i papërshtatshëm për punë për arsye mjekësore dhe ai merrte përfitimet përkatëse. Nga 1 korriku 1986 deri më 15 mars 1987, ai mori një paradhënie për pensionin e tij të pleqërisë në formën e përfitimit të papunësisë. Kur e drejta e tij përfundoi, ai paraqiti kërkesë në Agjencinë e Punësimit të Linz-it për një paradhënie nga pensioni i tij në formën e ndihmës urgjente. Në korrik 1987, agjencia hodhi poshtë kërkesën me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte kombësi austriake, që ishte një nga kushtet e parashikuara në Nenin 33 (2) (a) të Ligjit për Sigurime të Papunësisë i vitit 1977 për të drejtën për një kompensim të atij lloji. Kërkuesi e kundërshtoi vendimin e mësipërm pa sukses pranë Agjencisë Rajonale të Punësimit të Austrisë së Sipërme.

Në nëntor 1987, kërkuesi paraqiti një ankim në Gjykatën Kushtetuese. Në shkurt 1988, pasi e shqyrtoi kërkesën e tij, Gjykata Kushtetuese nuk e pranoi çështjen për gjykim dhe për këtë arsye e delegoi çështjen në Gjykatën Administrative. Në shtator 1989, Gjykata Administrative vendosi se nuk kishte juridiksion të merrej me një kërkesë të tillë dhe e refuzoi atë.

Gjykata vërejti një shkelje të Nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me Nenin 1 Protokolli Nr.1.

Gjykata vëren se Neni 14 i KEDNJ-së, së bashku me Nenin 1 Protokolli Nr. 1, janë të zbatueshëm për mohimin e ndihmës emergjente. Neni 14 KEDNJ-së plotësoi dispozitat e tjera materiale të Konventës dhe Protokolleve. Ai nuk kishte ekzistencë të pavarur pasi kishte efekt vetëm në lidhje me "gëzimin e të drejtave dhe lirive" të mbrojtura nga ato dispozita. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në periudhën e referuar ndihma urgjente ishte dhënë për personat që kishin shteruar të drejtën e tyre për përfitimin e papunësisë dhe kishin përmbushur kushtet e tjera ligjore të përcaktuara në Nenin 33 të Ligjit për Sigurime të Papunësisë të vitit 1977. E drejta për këtë përfitim shoqëror lidhej me pagesën e kontributeve në fondin e sigurimit të papunësisë. Gjykata konsideron se e drejta për ndihmë emergjente - për aq sa parashikohet në legjislacionin në fuqi - është një e drejtë financiare për qëllimet e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Pra, kjo dispozitë është e zbatueshme edhe pa qenë e nevojshme të mbështetet në lidhjen midis të drejtës për ndihmë urgjente dhe detyrimit për të paguar "taksa ose kontribute të tjera".

Sa i përket Nenit 14 të KEDNJ-së, Gjykata fillon duke përcaktuar rekomandimet e saj si më poshtë:

"Për qëllimet e Nenit 14 (N. 14), një ndryshim në trajtim është diskriminues nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohej të realizohej. Për më tepër, Shtetet Kontraktore gëzojnë një hapësirë vlerësimi në përcaktimin nëse dhe deri në çfarë mase ndryshimet në rrethana të tjera të ngjashme justifikojnë një trajtim të ndryshëm [...] Megjithatë, arsye shumë të rëndësishme do të duhej të parashtroheshin para se Gjykata të mund të merrte parasysh një ndryshim në trajtimin e bazuar ekskluzivisht në bazë të seksit si të pajtueshme me Konventën.".

Sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata vëren se nuk ka pasur një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e pabarabartë të kërkuesit. Gjykata vëren se refuzimi i autoriteteve për t'i dhënë atij ndihmë urgjente ishte bazuar ekskluzivisht në faktin se ai nuk kishte kombësi austriake. Për më

tepër, nuk ishte argumentuar se ankuesi nuk i përmbushte kushtet e tjera ligjore për dhënien e përfitimit shoqëror në fjalë. Sipas Gjykatës, kërkuesi ndodhej në kushte të ngjashme me shtetasit austriakë në lidhje me të drejtën e tij për këtë lloj përfitimi.

"Padyshim, seksionet 33 dhe 34 të Aktit për Sigurime të Papunësisë të vitit 1977 (shih paragrafin 20 më lart) përcaktojnë disa përjashtime nga statusi i kombësisë, por kërkuesi nuk hyn në asnjë nga kategoritë përkatëse.

50. Prandaj, Gjykata i gjen argumentet e parashtruara nga Qeveria Austriake jo bindëse. Ajo mban parasysh, ashtu si Komisioni, se ndryshimi në trajtimin midis austriakëve dhe jo-austriakëve në lidhje me të drejtën për ndihmë urgjente, për të cilën z. Gaygusuz ishte viktimë, nuk bazohet në ndonjë "justifikim objektiv dhe të arsyeshëm".

***Sovtransavto Holding k. Ukrainës*– nr. 48553/99, datë 25/07/2002**

Vendimi për *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 25 korrik 2002, fokusohet tek e drejta për mbrojtjen e pronës, e parashikuar në nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Ai lidhet edhe me të drejtën për proces të rregullt të parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së dhe prek nenin 14 të KEDNJ-së.

Kërkuesi, Sovtransavto Holding, është kompani ruse për transportin publik e regjistruar në Moskë e themeluar në vitin 1993. Ajo zotëronte 49% të aksioneve në një kompani publike ukrainase, Sovtransavto-Lougansk. Në janar të vitit 1996, takimi i aksionarëve të Sovtransavto-Lougansk ndryshoi dhe ratifikoi publikisht memorandumin e tij dhe nenet e shoqërisë për ta shndërruar atë në një kompani private. Në vitet 1996, 1997 dhe në tetor të vitit 1997, Drejtuesi Menaxhues i Sovtransavto-Lougansk rriti kapitalin aksionar të kompanisë tre herë, duke zvogëluar kështu aksionet e kompanisë kërkuese nga 49% në 20,7%. Si rezultat i ndryshimeve, drejtorët e Sovtransavto-Lougansk ishin në gjendje të merrnin kontrollin e vetëm të menaxhimit dhe të aseteve të kompanisë. Kompania ankuese pretendon se Sovtransavto-Lougansk kishte mundësi t'i shiste një pjesë të aktiveve të saj në ndërmarrje të ndryshme të krijuara nga drejtuesi i saj menaxhues. Kompania ankuese paraqiti një ankesë të pasuksesshme në Gjykatën e Arbitrazhit të Rajonit Lougansk kundër Sovtransavto-Lougansk dhe Këshillit Ekzekutiv duke kërkuar një deklaratë se ndryshimet e formës së kompanisë dhe vendimet që i ratifikonin ato ishin të paligjshme. Në mars

të vitit 1998, Gjykata Supreme e Arbitrazhit e Ukrainës i la mënjanë ato vendime dhe ia kaloi çështjen Gjykatës së Arbitrazhit të Rajonit të Kievit. Ndërkohë, Presidenti i Ukrainës i kishte shkruar një letër Presidentit të Gjykatës Supreme të Arbitrazhit, duke i kërkuar atij të "mbronte interesat e shtetasve ukrainas". Në një zhvillim të veçantë, Komisioni i Shkëmbimit të Letrave me Vlerë të Ukrainës vendosi që rezolutat dhe vendimet e Sovtransavto-Lougansk ishin të paligjshme. Gjykata e Arbitrazhit e Rajonit të Kievit hodhi poshtë të gjitha kërkesat. Kompania apeloi në Gjykatën Supreme të Arbitrazhit të Ukrainës, por pa sukses. Më pas, sërish pa sukses i kërkoi Prokurorisë së Përgjithshme të ndërhynte në procedurë dhe i kërkoi Kryetarit të Gjykatës Supreme të Arbitrazhit që të paraqiste një kundërshtim. Në korrik të vitit 1999, në mbledhjen e aksionarëve të Sovtransavto-Lougansk, kompania u vendos në likuidim. Aktivet e saj u transferuan tek një njësi e re, një kompani publike e quajtur Trans King. Kundërshtimi u dëgjua nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Arbitrazhit, i cili hodhi poshtë vendimet e Gjykatës të Arbitrazhit të Rajonit të Kievit dhe gjykimin e dytë të Gjykatës së Lartë të Arbitrazhit dhe i dërgoi çështjet në Gjykatën e Arbitrazhit të Rajonit të Kievit për rishikim. Gjykata e Arbitrazhit u gjet pjesërisht në favor të kompanisë kërkuese, por, pas një kundërshtimi nga Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata Ekonomike e Apelit në Kiev e anuloi vendimin në janar të vitit 2002. Apeli i bërë nga kompania ankuese u hodh poshtë nga Gjykata e Lartë Ekonomike në prill të vitit 2002 me arsyetimin se nuk kishte arritur të siguronte prova që kishte paguar tarifën gjyqësore. Kompania kërkuese u ftua të përmbushë këtë kërkesë dhe të bëjë një apel të ri. Kur e bëri këtë, ky apel u hodh poshtë, pasi ishte jashtë afatit njëmujor.

Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për proces të rregullt, sipas Nenit 6 § 1 të KEDNJ-së dhe të drejtës për mbrojtjen e pronës të Nenit 1 Protokolli 1 i KEDNJ-së.

Sa i përket Nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se është shkelur e drejta për një seancë të drejtë dhe publike nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Ai më tej vëren se shqyrtimi i veçantë i ankesave në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve nuk ka qenë i nevojshëm. Gjykata vuri në dukje se në kohën materiale, ligji përkatës e autorizonte Kryetarin e Gjykatës së Lartë të Arbitrazhit që të kundërshtonte vendimet e formës së prerë në bazë të procedurës mbikëqyrëse të rishikimit duke paraqitur një kundërshtim. Kjo fuqi ishte diskrecionale, aq sa vendimet gjyqësore të formës së prerë mund të rishikoheshin pafundësisht, në shkelje të parimit të sigurisë juridike. Gjykata vuri në dukje se në çështjen para saj, kompanisë kërkuese i ishte dhënë mundësia e re për ta rishqyrtuar çështjen e saj, por më pas,

veçanërisht pas kundërshtimi nga Zyra e Këshillit Shtetëror të Ukrainës (e cila nuk ishte palë në procedurat fillestare), të gjitha akuzat e kompanisë kërkuese ishin hedhur poshtë. Siç qëndronin çështjet, asnjë nga kërkesat e saj nuk ishte pranuar dhe kompanisë ankuese i ishte hequr përfundimisht çdo mundësi për të pasur një seancë dëgjimore lidhur me akuzat e saj nga një gjykatë. Gjykata vëren se sistemet gjyqësore të karakterizuara nga procedura e kundërshtimit dhe si rrjedhim nga rreziku i anulimit të përsëritur të vendimeve të formës së prerë, ishin të papajtueshme me parimin e sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Më tej, Gjykata i vëren të habitshme qasjet e ndryshme, dhe me raste kontradiktore, që ishin ndjekur nga gjykatat ukrainase në zbatimin dhe interpretimin e ligjit të brendshëm: Gjykata e Lartë e Arbitrazhit kishte rrëzuar dy herë vendimet e gjykatave më poshtë me arsyetimin se ato nuk kishin zbatuar në mënyrë korrekte ligjin përkatës ose nuk kanë bërë ekzaminim e duhur të fakteve dhe të argumenteve të kompanisë kërkuese. Gjykata vëren gjithashtu se gjykatat e arbitrazhit në të cilat çështja ishte dërguar nuk duket të kenë qenë në përputhje me udhëzimet e Gjykatës së Lartë të Arbitrazhit, pavarësisht se kjo kërkohej nga ligji ukrainas. Për më tepër, Gjykata vëren se, duke pasur parasysh përmbajtjen e tyre dhe mënyrën se si janë bërë, ndërhyrjet e ndryshme nga autoritetet që veprojnë në nivelin më të lartë ishin të papajtueshme me nocionin e një "gjykate të pavarur dhe të paanshme". Ashtu siç u bënë edhe nga autoritetet ekzekutive të shtetit, ato ndërhyrje zbuluan mungesën e respektit për vetë detyrën gjyqësore. Së fundmi, Gjykata vëren se padia e kompanisë kërkuese në Gjykatën e Lartë Ekonomike, e cila ishte hedhur poshtë me arsyetimin se kompania nuk kishte arritur të siguronte prova se kishte paguar tarifën gjyqësore, ishte në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Pavarësisht pranimit se kompania kishte paguar faktikisht shumën e kërkuar dhe megjithëse duhet të ketë qenë në dijeni se afati kohor për paraqitjen e një ankese ishte gati të përfundonte, Gjykata e Lartë Ekonomike nuk dha asnjë zgjatje të kohës ose iu referua asaj çështjeje në gjykimin e saj fillestar.

Sa i përket nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata konstaton se, në shkelje të së drejtës përkatëse, mënyra në të cilën ishin zhvilluar procedurat në fjalë dhe pasiguria me të cilën përballej kompania kërkuese kishte prishur ekuilibrin e drejtë që duhej të ishte goditur mes interesit të përgjithshëm dhe interesit të kërkuesit. Sa i përket zbatueshmërisë së Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata konstatoi se aksionet e mbajtura nga kompania kërkuese kishin vlerë financiare dhe përbënin "zotërime" brenda kuptimit të asaj dispozite. Lidhur me mbrojtjen e pronës së kompanisë ankuese, Gjykata rithekson se Neni 1 i Protokollit Nr.1 vendosi detyrime pozitive ndaj shteteve palë,

duke përfshirë detyrimin për të përballuar procedimet gjyqësore që ofruan garancitë e nevojshme procedurale dhe u mundësuan gjykatave vendase të gjykojnë në mënyrë efektive dhe të drejtë çdo mosmarrëveshje midis individëve privatë. Gjykata kishte juridiksion të verifikonte nëse mënyra në të cilën ligji i brendshëm u interpretua dhe u zbatua nga gjykatat vendase ishte në përputhje me të drejtën e kompanisë ankuese për gëzimin paqësor të pronave të saj. Mënyra e padrejtë në të cilën ishin zhvilluar procedurat në fjalë kishte pasur ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtën e kompanisë ankuese për gëzim paqësor. Refuzimi i gjykatave për të respektuar udhëzimet e Gjykatës Supreme të Arbitrazhit, i shoqëruar me dallimet në interpretimin e ligjit të brendshëm, kishte krijuar pasiguri të përhershme sa i përket ligjshmërisë së rezolutave të Sovtransavto-Lougansk dhe ratifikimit të tyre të mëvonshëm. Kjo pasiguri kishte çuar në ndryshime të aftësisë së kompanisë ankuese për të kontrolluar menaxhimin dhe pasuritë e Sovtransavto-Lougansk.

Öneryıldız k. Turqisë – nr. 48939/99, datë 30/11/2004

Vendimi i çështjes Öneryıldız kundër Turqisë, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 30 nëntor 2004, fokusohet tek e drejta për jetën, neni 2 i KEDNJ-së, e drejta për zgjidhje efektive ligjore, neni 13 i KEDNJ, si dhe tek e drejta për mbrojtjen e pronës, Neni 1 Protokolli 1 i KEDNJ -së.

Kërkuesi, Z. Öneryıldız, është shtetas turk i lindur në vitin 1955. Në kohën e gjykimit ai jetonte me 12 të afërm të ngushtë në lagjen e varfër të Kazım Karabekir në Ümraniye (Stamboll). Zona Kazım Karabekir ishte pjesë e një hapësire banesash bazike të ndërtuara pa asnjë autorizim në një tokë që rrethohej nga një grumbull plehrash, e cila ishte përdorur së bashku nga katër këshillat e rretheve që nga vitet 1970, nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Këshillit Bashkiak të Stambollit. Një raport ekspertësh, i hartuar në maj të vitit 1991, me kërkesë të Gjykatës së Rrethit Üsküdar, në të cilin çështja ishte referuar nga një tjetër Këshill i Rrethit, tërhoqi vëmendjen e autoriteteve ndaj faktit që nuk ishte marrë asnjë masë për grumbullin e plehrave në fjalë për të parandaluar shpërthimin e metanit të krijuar nga mbeturinat e dekompozuara. Raporti krijoi një sërë mosmarrëveshjesh mes kryebashkiakëve përkatës. Megjithatë, para mbylljes së procedurave të ngritura nga secili prej tyre, në grumbullin e plehrave ndodhi një shpërthim metani më 28 prill 1993. Shpërthimi që shpërtheu nga grumbulli i mbeturinave përfshiu më shumë se dhjetë shtëpi të vendosura poshtë këtij grumbulli, përfshirë shtëpinë e kërkuesit, i cili humbi nëntë të afërm. Pas kryerjes së hetimeve penale dhe administrative për rastin, kryetarët

e bashkive të Ümraniye dhe Stambollit dolën para gjykatave, i pari për mospërmbushjen e detyrës së tij për urdhërimin e shkatërrimit të ndërtesave kasolle të paligjshme që rrethonin grumbullin e plehrave dhe i dyti për mos-sistemimin e grumbullit të plehrave apo urdhërimin e mbylljes së tij pavarësisht përfundimeve që ishin nxjerrë nga raporti i ekspertëve në maj të vitit 1991. Në prill të vitit 1996, kryebashkiakët në fjalë u dënuan të dy për "neglizhencë në kryerjen e detyrave të tyre" dhe të dy u gjobitën me 160.000 lira turke (TRL) dhe u dënuan me një afat minimal prej tre muajsh burgim të parashikuar në nenin 230 të Kodit Penal. Dënimet e tyre u shkëmbyen në gjoba, zbatimi i të cilave u pezullua. Më pas, kërkuesi ngriti një padi për dëmshpërblim në emrin e tij dhe në emër të tre fëmijëve të tij të mbijetuar në Gjykatën Administrative të Stambollit, duke bërë përgjegjës autoritetet për vdekjen e të afërmve dhe për shkatërrimin e pronës së tij. Në një vendim gjyqësor në nëntor të vitit 1995, autoritetet u urdhëruan t'i paguajnë kërkuesit dhe fëmijëve të tij 100.000.000 TRL për dëmin jomonetar dhe 10.000.000 TRL për dëmin material për shkatërrimin e artikujve shtëpiakë (ekuivalente në kohën materiale përkatësisht me afërsisht 2.077 euro dhe 208 euro). Në kohën e vendimit gjyqësor të KEDNJ-së, shumat nuk i ishin paguar ende kërkuesit dhe ai nuk i kishte filluar ende procedurat përmbarimore. Dhoma e GJEDNJ-së mori vendimin gjyqësor në qershor të vitit 2002, duke konstatuar shkelje. Me kërkesë të qeverisë turke, çështja iu referua Dhomës së Madhe.

Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për jetën, Nenit 2 të KEDNJ-së, të së drejtës për zgjidhje ligjore efektive, Neni 13 i KEDNJ-së, si dhe të së drejtës për mbrojtjen e pronës, Nenit 1, Protokolli 1 i KEDNJ-së.

Sa i përket shkeljes së nenit 2 të KEDNJ-së, Gjykata vëren, ndër të tjera, se meqë autoritetet turke e kishin ditur ose duhej ta dinin se kishte rrezik real ose të drejtpërdrejtë për personat që jetonin pranë grumbullit të plehrave, ata kishin si detyrim, në bazë të Nenit 2 të Konventës, që të marrin masat përkatëse parandaluese operacionale të nevojshme e të mjaftueshme për mbrojtjen e individëve, veçanërisht pasi ata vetë e kishin ngritur vendin e grumbullimit dhe kishin autorizuar funksionimin e tij, gjë që kishte shkaktuar rrezikun në fjalë.

Ishte e pamundur që autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e landfillit të mos kishin ditur për rreziqet e qenësishme në metanogjenezën përkatëse ose për masat e nevojshme parandaluese, veçanërisht pasi kishte rregullore specifike për këtë çështje. Gjykata e konsideron të vërtetuar se autoritete të ndryshme kishin qenë në dijeni të këtyre rreziqeve, të paktën deri më 27 maj 1991, kur ato ishin njoftuar për raportin e 7 majit të vitit 1991. Megjithatë, Këshilli i Qytetit të Stambollit jo vetëm që nuk kishte marrë masat e nevojshme urgjente, por kishte kundërshtuar edhe rekomandimin e Zyrës së Kryeministrit për Mjedisin për sistemimin e landfillit në përputhje me standardet në fuqi. Këshilli kishte kundërshtuar po ashtu edhe përpjekjen e gushtit të vitit 1992 të Kryetarit të Bashkisë së Ümraniye për marrjen e një urdhri gjykate për mbylljen e përkohshme të vendit të grumbullimit të mbeturinave.

Për më tepër, Gjykata pohon se Qeveria nuk mund të pohojë lirimin nga përgjegjësia për shkak të neglizhencës së viktimave apo mungesës së parashikimit. Gjykata vërejti se pavarësisht kufizimeve ligjore në fushën e planifikimit të qytetit, politika e qëndrueshme e shtetit turk për zonat e varfra kishte inkurajuar integrimin e zonave të tilla në mjedisin urban dhe kishte pranuar rrjedhimisht ekzistencën e tyre e mënyrën e jetesës së qytetarëve, të cilët gradualisht kishin ndërtuar banesat e tyre që prej vitit 1960, qoftë me vullnetin e tyre të lirë apo thjesht si rezultat i kësaj politike. Sipas Gjykatës, dukej gjithashtu se autoritetet kishin vendosur taksë këshilli për kërkuesin dhe banorët e tjerë të lagjeve të varfra të Ümraniye dhe u kishin ofruar atyre shërbime publike, për të cilat ata ishin tarifuar.

Sa i përket shkeljes së Nenit 1, Protokolli nr. 1, Gjykata vëren se kompensimi që gjykatat turke i dhanë kërkuesit për dëmin material nuk ishte paguar ende edhe pse ishte marrë vendimi i formës së prerë. Për më tepër, në bazë të detyrimit pozitiv ndaj autoriteteve sipas Nenit 1, Protokollit nr. 1, ata duhet të kishin ndërmarrë hapat praktikë që Gjykata i kishte treguar për të shmangur shkatërrimin e banesës.

Sa i përket shkeljes së Nenit 13 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se zgjidhja juridike administrative e përdorur nga kërkuesi duket se ishte e mjaftueshme për zbatimin e thelbit të padisë së tij në lidhje me vdekjen e të afërmve dhe që t'i jepte atij dëmshpërblimin e duhur për shkeljen e konstatuar të Nenit 2. Sidoqoftë, Gjykata e konsideron atë zgjidhje juridike si joefektive në disa aspekte dhe e konsideroi vendimtare që dëmet që iu shkaktuan kërkuesit - vetëm për dëmin jomonetar që erdhi si rezultat i humbjes së të afërmve të tij të ngushtë - në fakt nuk i ishte paguar kurrë atij.

Saghinadze dhe të tjerët k. Gjeorgjisë – nr. 18768/05, datë 27/05/2010

Vendimi për *Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, i marrë nga Gjykata (Dhoma) më 27 maj 2010, fokusohet tek e drejta për mbrojtjen e pronës e Nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, tek e drejta për liri dhe siguri e Nenit 5 të KEDNJ-së, si dhe tek e drejta për respektimin e banesës sipas Nenit 8 të KEDNJ-së.

Kërkuesi i parë kundërshtoi urdhrat e autoriteteve dhe vendimet e gjykatave, pra dëbimet e detyrueshme. Kërkuesit ishin persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), të cilët ishin larguar nga Abkhazia (Gjeorgji) në vitin 1993, duke braktisur shtëpitë dhe pronat e tyre atje pas konfliktit të armatosur të viteve 1992-93. Në vitin 1994, kërkuesit të parë, një zyrtari të lartë në Ministrinë e Brendshme Abkhaziane, iu ofrua posti i Shefit të Departamentit Hetimor brenda Ministrisë së Brendshme të Gjeorgjisë. Ai dhe familja e tij u vendosën më pas në një vilë që i përkiste Ministrisë, e cila kishte për qëllim t'u siguronte strehim anëtarëve të stafit jashtë vendit. Kërkuesi i parë dhe familja e tij, së bashku me tetë të afërm të tjerë të pastrehë, filluan të jetojnë në vilë dhe të përdorin tokën ngjitur ku rritnin perime dhe fruta, dhe mbanin shpendë e bagëti të vogla. Në vitin 1998, Kërkuesi i parë u tërhoq nga Ministria, e cila, në një letër drejtuar atij dhe autoriteteve përkatëse të qeverisjes vendore, konfirmoi se ai kishte posedim legjitim të vilës dhe ambienteve ngjitur me të, por që posedimi i tij ishte i një natyre të përkohshme dhe për një periudhë të papërcaktuar kohe. Pas Revolucionit të Trëndafilave në vitin 2003, kërkuesi i parë, ndonëse kishte dalë në pension, u thirr nga Ministri i sapoemëruar i Brendshëm dhe ra dakord të drejtonte hetimin në një çështje penale të profilit të lartë. Sipas tij, rezultatet e hetimit rezultuan të papërshtatshme për disa zyrtarë të rangut të lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm i atëhershëm i kërkoi atij personalisht të mos i ndiqte hetimet e tij. Në vitin 2004, ai Prokuror i Përgjithshëm u emërua Ministër i Brendshëm dhe dyshohet se largoi nga detyra kërkuesin e parë. Në nëntor të vitit 2004, në mungesë të kërkuesit të parë, një grup prej rreth gjashtëdhjetë agjentësh të armatosur të forcave speciale të veshur me maska të zeza si kapuça hynë në vilë dhe, pa asnjë dokument ligjor që autorizonte veprimet e tyre, dëbuan me forcë anëtarët e familjes dhe të afërmit e pranishëm. Pas dëbimit, oficerët e policisë mbetën të stacionuar në vilë dhe në tokën ngjitur me vilën. Gjykatat hodhën poshtë paditë civile dhe penale të kërkuesit të parë. Më pas, Kërkuesi i parë u dënua për vepra të ndryshme dhe u dënua me shtatë vjet burg.

Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për mbrojtjen e pronës, Neni 1 Protokolli Nr. 1, të së drejtës për liri dhe siguri, Neni 5 i KEDNJ-së, si dhe të së drejtës për respektimin e banesës, Neni 8 i KEDNJ-së.

Sa i përket shkeljes së Nenit 1 Protokolli Nr. 1, Gjykata thotë se vila në fjalë duhet të konsiderohet si "posedim" për qëllime të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Kërkuesi i parë kishte të drejtë ta përdorte vilën si strehim dhe kjo e drejtë kishte dimension të qartë pasuror. Kërkuesi i parë nuk e kishte zaptuar vilën, pasi ajo i ishte ofruar nga punëdhënësi i tij, Ministria e Brendshme, e cila, në përputhje me një urdhër ministror, ishte autorizuar ta përdorte vilën për

qëllime strehimi të anëtarëve të stafit të zhvendosur nga Abkhazia. Duke pasur parasysh tolerancën e dukshme të autoriteteve ndaj përdorimit ekskluziv, të pandërprerë dhe të hapur të kërkuesit të parë të vilës dhe ambienteve ngjitur për më shumë se dhjetë vjet, ky posedim ruajti karakterin e tij të mirëbesimit, edhe në mungesë të një titulli të regjistruar pronësie:

> *"Me rëndësi të madhe në këtë drejtim, sipas praktikës gjyqësore përkatëse të Gjykatës, ishte toleranca e qartë e vetë autoriteteve ndaj përdorimit ekskluziv, të pandërprerë dhe të hapur, nga kërkuesi i parë, i vilës dhe i ambienteve ngjitur për më shumë se dhjetë vjet. Kështu, gjatë asaj periudhe, Kërkuesi i parë instaloi pajisje të ndryshme, mbolli pemë dhe perime frutore dhe filloi të mbante shpendë e bagëti të vogla; ai ishte gjithashtu në gjendje të strehonte tetë të afërmit e tij të zhvendosur, pa aplikuar për leje shtesë nga Shteti; shteti nuk e kundërshtoi kurrë mjedisin socio-ekonomik dhe familjar të krijuar nga kërkuesi i parë […] Gjykata i jep rëndësi të mëtejshme faktit që, pas transferimit të vilës nga Ministria tek kërkuesi i parë për strehim të përkohshëm, shteti , duke miratuar akte të ndryshme ligjore, konfirmon të drejtat e PZHBV-ve në sektorin e strehimit dhe vendos garanci solide për mbrojtjen e tyre (shih paragrafët 39, 67 dhe 69 më lart). Më i spikaturi dhe më autoritari në mesin e tyre ishte Akti i PZHBV-ve, i cili pranoi se posedimi i një banese me mirëbesim nga një PZHBV përbënte të drejtë me natyrë pasurore."*.

Prandaj, PZHBV-ja nuk mund të zhvendoset kundër vullnetit të tij ose të saj nga një banesë e zënë pa ofruar në këmbim as strehim të ngjashëm, as kompensim të përshtatshëm monetar.

Duke iu kthyer ekzistencës së ndërhyrjes dhe justifikimit të saj, Gjykata konstaton se ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës së ankuesit të parë nuk kishte qenë e ligjshme, ndërsa shqyrtimi gjyqësor i mëvonshëm ishte arbitrar dhe ishte mohim i drejtësisë. Palët nuk patën kundërshtime mes tyre rreth faktit që ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit të parë për gëzimin paqësor të pronave të tij. Kështu, Gjykata konstaton se e vetmja mënyrë e ligjshme që Ministria e Brendshme ta ketë kërkuar shtëpinë nga kërkuesi i parë do të ishte ngritja e procedimeve kundërshtuese në gjykatë. Megjithatë, dëbimi dhe shpronësimi kishin ndodhur në mungesë të vendimeve gjyqësore, në bazë të një urdhri me gojë vetëm nga ministri i Brendshëm. Në procedimet e mëvonshme gjyqësore të ngritura nga kërkuesi i parë, gjykatat nuk kishin arritur të pranonin se ai ka qenë në zotërim të vazhdueshëm të vilës për më shumë se dhjetë vjet dhe se dëbimi dhe shpronësimi i tij ishin kryer në mënyrë të paligjshme. Ata gjithashtu nuk i kishin ofruar atij

mbrojtjen e parashikuar në ligjet përkatëse të brendshme për PZHBV-të. Gjykata Supreme kishte kundërshtuar veçanërisht jurisprudencën e saj të mëparshme, në të cilën kishte parandaluar një agjenci shtetërore që të merrte një banesë shtetërore nga PZHBV-të.

Romeva k. Maqedonisë së Veriut **- nr. 32141/2010, datë 12/3/2020**

Vendimi i çështjes *Romeva k. Maqedonisë së Veriut*, i shpallur nga gjykata më 12 mars 2020 fokusohet [ndër të tjera] në lidhje me balancën e drejtë që duhet vendosur mes interesit të publikut dhe të drejtave themelore të individit në përputhje me proporcionalitetin në ndërhyrjen legjitime të shtetit sipas nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Kërkuesja ishte përfituese e pensionit të pleqërisë dhe pas një rivlerësimi të akteve dhe procedurave të caktimit të pensionit të saj, nga ana e organeve përkatëse publike u bë ndërprerja e tij dhe detyrimi për të kthyer shumat e marra, vetëm mbështetur në aktet e dosjes së saj dhe pas një kohe të gjatë nga caktimi i pensionit.

Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, duke vërejtur se - si rezultat i masës së kundërshtuar - kërkuesja u përball, në mënyrë të menjëhershme, me humbjen totale të përfitimeve të saj të pensionit të saj, që përbënte burimin e saj të vetëm të të ardhurave (*shih, ndër të tjera, Moskal, § 74*).

> *73. […]"Në këtë kuadër, Gjykata i jep rëndësi të veçantë faktit se vendimi për dhënien e pensionit kërkueses nuk ishte bazuar në prova të reja por vetëm mbi një rivlerësim të të njëjtave tek të cilat ishte mbështetur vendimi administrativ, i cili u bë i formës së prerë për shkak se nuk u kundërshtua përpara gjykatave. Në këndvështrimin e Gjykatës, ky rivlerësim i provave ex proprio motu, jashtë sistemit të mjeteve të jashtëzakonshme për të prishur vendimet administrative të formës së prerë, vë në pikëpyetje sigurinë juridike në fushën e sigurimeve shoqërore".*
>
> *78. […] Gjykata konstaton se nuk është gjetur një balancë e drejtë mes kërkesave të interesit të përgjithshëm të publikut dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit dhe se barra e vendosur ndaj kërkueses ishte e tepërt.*

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës